si “*Iter criminis*”, thënë ndryshe “*trajektorja e krimi*”.¹⁰ Akti përgatitor, është ai që ndjek momentin ose shoqëron momentin kur individi ka realizuar vendimmarrjen për të kryer veprën penale por që i paraprin fillimit të ekzekutimit ose kalimit drejt kryerjes së veprimeve finale për konsumimin e veprës penale.¹¹ Kuptimin e akteve përgatitore kryesisht e bën spektri doktrinal por nuk kanë munguar rastet kur natyra e këtyre akteve është spjeguar edhe në kontekstin normativ. Konkretisht Kodi penal shqiptar i vitit 1952 parashikonte se: “*përgatitje quhej krijimi i kushteve, kërkimi dhe përgatitja e mjeteve ose e veglave për kryerjen e një krimi të rëndë*”.¹² Ndryshe nga kodi penal shqiptar i vitit 1952 që e lidh përgatitjen me kryerjen e një krimi të rëndë, kodi penal shqiptar i vitit 1977, parashikonte se: “... *përgatitje quhej krijimi i kushteve për kryerjen e një krimi*”.¹³ Kodi penal i ish-Çekosllovakisë, sanksiononte: “*Përbën akt përgatitor të një veprë penale, cdo aktivitet që është i rrezikshëm për shoqërinë dhe që konsiston në organizimin e veprës penale, sigurimin ose përshtatjen e mjeteve ose instrumentave që shërbejnë për kryerjen e veprës penale*”.¹⁴ Kodi penal i Republikës së Kosovës,¹⁵ përcakton se: “*Kur ligji parashih dënimin për përgatitjen e veprës penale të caktuar, përgatitja e veprës penale përfshin furnizimin ose aftësimin e mjeteve për kryerjen e veprës penale; mënjanimin e pengesave për kryerjen e veprës penale; marrëveshjen; planifikimin ose organizimin me personin tjetër për kryerjen e veprës penale si dhe veprimet e tjera me të cilat krijohen kushtet për kryerjen e drejtpërdrejtë të veprës penale por të cilat nuk përbëjnë veprimin e kryerjes*”. Aktet në fjalë, nënkuptojnë edhe elementin e refleksionit brendatyre, kështu që janë me karakteristike për veprat që konsumohen me paramendim (*dolus praemeditatis*). Në ndryshim nga kodi penal i RSH-së, kodi penal i Kosovës, është disi më konkret në shprehjen e parimit. Në nenin 27 të tij, legjislatori sanksionon: “*I. Kushdo që me dashje përgatit kryerjen e veprës penale, do të dënohet vetëm nëse parashihet shprehimisht me ligj*”. Në përpjekjet tona për të dhënë kuptimin juridik të konceptit të akteve përgatitore, çmojmë të rëndësishme për të trajtuar, natyrën e veçantë të këtyre akteve si edhe dënueshmërinë e tyre.

¹⁰ Shih: Jean Francois Meylan, *Les actes preparatoires delictueux en droit penal Suisse*, art. 260 Bis CP, Lausanne 1990, fq.17

¹¹ Shih: *Acte Preparatoire-Extraits de Dictionnaire de Droit Criminel* de Jean – Claude Doucet, i disponueshem ne faqen web: <http://axiome-x.tripod.com/ddcautresdelits/id27.html>, konsultuar ne shtator 2017.

¹² Neni 10 i kodit penal shqiptar të vitit 1952, jepte përkufizimin e institutit të përgatitjes.

¹³ Neni 11 i kodit penal shqiptar të vitit 1977.

¹⁴ Shih: Neni 7 I Kodit Penal te ish-Cekosllovakisë, i vitit 1950

¹⁵ Paragrafi 2 I nenit 27 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, I titulluar: “*Përgatitja e vepres penale*”.

2.1 Natyra e Akteve Përgatitore

Veprimet me të cilat përgatitet kryerja e veprës penale mund të shprehen në mënyra të ndryshme. Ndër format më të spikatura të akteve përgatitore janë: krijimi i kushteve që përfshin furnizimin ose sigurimin dhe përgatitjen e mjeteve për kryerjen e veprës penale, marrjen e masave të ndryshme për evitimin e pengesave që mund të dalin gjatë ekzekutimit të veprës, marrëveshja, planifikimi dhe organizimi i veprimeve të ndryshme me persona të tjerë për realizimin me sukses të veprës penale. Do të konsiderohet krijim kushtesh, edhe përgatitja e provave të paracaktuara për të mos patur përgjegjësi penale, pas kryerjes së krimit, p.sh: krijimi i alibisë dhe gjetja e personave dhe provave të tjera që do të vërtetojnë para organeve të drejtësisë këtë alibi.¹⁶ Ndonëse natyra e veprimeve që ndërmerren në fazën e përgatitjes, nuk është e drejtuar drejtpërdrejt në realizimin përfundimtar të veprës penale, gjithsesi tipiciteti i këtyre veprimeve është i tillë që synohet të ndërtohet infrastruktura që do të mundësojë vijimin e veprimeve të tjera plotësuese me karakter objektiv për të përfunduar veprën penale.¹⁷ Autori ndërmerr veprime me karakter përgatitor sepse beson se pa ato, nuk mund të realizojë rezultatin e veprës penale dhe se nëpërmjet tyre lehtësohet në kufijtë e të mundshmes, kryerja dhe përfundimi me sukses i veprës penale.¹⁸ Vendimi apo dëshira e një personi për të kryer vepër penale, nuk mund të ndëshkohet nga ligji penal për sa kohë nuk shfaqen së jashtmi. Madje edhe sjellja e njeriut nuk mund të formojë vepër penale, pa u parashikuar shprehimisht në ligj si e tillë.¹⁹ Në një shoqëri të lirë, nuk ka kufij në lidhje me atë çka njeriu mendon.²⁰ Është e vështirë të kuptohet natyra e refleksionit individual përveçse kur ajo formësohet në trajtën e veprimeve me karakter objektiv. Në fund të fundit, mendimi mund të lindë në lidhje me një veprim konkret, të veçantë, por ai orientohet edhe rreth natyrës së veprimit në fjalë. Sentenca e famshme "*cogitationis pœnam nemo patitur*",²¹ është pjesë e të drejtës penale moderne aktuale. Natyra e mendimeve që lindin tek njeriu, në fund të fundit ka të bëjë me filozofinë e njohjes dhe të veprimit me natyrë njerëzore. Shqetësimi

¹⁶ Shih: Marsela Pepi, *Tentativa, fazë e kryerjes së veprës penale*, Punim diplome i paraqitur për mbrojtje në Shkollën e Magjistraturës, Tiranë 2005, fq. 24

¹⁷ Shih: Marsela Pepi, *Vepër e cituar*, fq. 23

¹⁸ Shih: Hajri Shehu, *Përgatitja dhe kuptimi juridik i saj, si fazë paraprake e kryerjes së krimit*, Drejtësia Popullore Nr. 4, viti 1988, fq. 21

¹⁹ Parimi i ligjshmërisë në të drejtën penale.

²⁰ Shih: Gjergj Sinani, *Hyrje në Filozofinë e Historisë*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë 1999, fq.3

²¹ *Cogitationis pœnam nemo patitur* (lat.), Parim juridik sipas të cilit: Askush nuk mund të ndëshkohet për idenë e një krimi, në qoftë se ajo nuk shfaqet materialisht në botën e jashtme (*nuda cogitatio*). Shih: "*Dizionario Giuridico Romano*", Edizioni Simone, 2006, IV Edizione, fq.107, cituar nga Henrik Ligorini në artikullin e tij: "*Për kuptimin e tentativës në trafikimin e lëndëve narkotikëve dhe të armëve*", Revista Jeta juridike nr.1, mars 2009, fq. 47

për mendimet e njerëzve lidhet me etikën.²² Nëse e drejta penale do të ndëshkonte idenë, mendimin dhe dëshirën për të kryer veprë penale ajo do të njësohej me moralin. Por e drejta penale nuk karakterizohet nga standardi i moralit themelor, në kuptimin që jo çdo normë morale ka vlerën e normës ligjore dhe aq më tepër penale. Morali i përket ndërgjegjes individuale të personit ndërsa e drejta rrjedh nga një autoritet publik. Duke reflektuar në natyrën e akteve përgatitore dhe duke i vlerësuar drejt tiparet e tyre, jemi të mendimit se ato, as nuk çënojnë dhe as nuk rrezikojnë çënimin e vlerave të të mirave juridike që mbron posaçërisht normativa juridiko-penale. Edhe vetë ndërmarrja e veprimeve përgatitore, nuk do të thotë me siguri se vepra penale do të përfundojë përsa kohë ekziston mundësia që personi të ndërrojë mendje dhe të heqë dorë vullnetarisht nga kryerja e veprimeve të mëtejshme drejt rezultatit kriminal. Autori Ismet Salihu, shprehet se vepra penale, jo rrallë, mund të kryhet edhe pa u ndërmarrë veprimet përgatitore.²³ Në rastet e veprave penale të atypëratyshme, sidomos atyre që konsumohen në kushtet e afektit, autori i veprës penale nuk ndërmerr veprime përgatitore. Prej këtij versioni, konkludohet se aktet përgatitore si faze që i paraprin kryerjes së veprës, janë të mundshme por jo të domosdoshme për kryerjen e saj.²⁴ Natyra e akteve përgatitore nuk është ajo e veprimeve me karakter standard, identike për çdo lloj figure vepre penale. Karakteri i përgatitjes ndikohet nga një sërë faktorësh si: koha, vendi, lloji i veprës që do të kryhet, cilësitë e personit kundrejt të cilit drejtohet veprimi kriminal, mundësitë, aftësitë dhe prirjet e vetë autorit, etj. Në rastet kur aktet përgatitore manifestohen si krijim kushtesh, karakteri i tyre varet nga natyra dhe lloji i veprës penale që do të realizojë personi. Ndryshe formësohet krijimi i kushteve kur personi ka vendosur të kryejë një vrasje dhe ndryshe kur ai ka vendosur të falsifikojë një dokument.²⁵ Nëse aktet përgatitore do të kishin të bënin me kohën e kryerjes së veprës penale, ndryshe do të përgatitej personi për një vjedhje që do të kryhej ditën dhe ndryshe për një vjedhje që do të kryhej natën. Nëse këto akte do të kishin të bënin me mënjanimin e pengesave, kjo në parim, nuk përbën ndonjë veprë penale por përjashtimisht mund të ndodhë që evitimi i pengesave të cojë në konsumimin e ndonjë vepre penale. i tillë është rasti i personit i cili përgatitet të realizojë vjedhjen e një banke dhe për të mënjeluar pengesat zgjedh të vrasë rojen e bankës.²⁶ E veçantë dhe shumë interesante paraqitet situata në rastin e akteve përgatitore që përmbahen tek veprat penale të kryera me mosveprim. Edhe pse vepra penale konsumohet me mosveprim, aktet përgatitore nuk mund të shprehen ndryshe veçse me veprime aktive edhe në këtë rast. Kështu mund të përmendim rastin e personit i cili i shmangej thirrjes për

²² Shih: Gjergj Sinani, *Vepër e cituar*, fq. 7

²³ Shih: Ismet Salihu, *E Drejta penale, pjesa e përgjithshme*, Prishtinë 2015, fq. 339

²⁴ Për më tepër shih: Ismet Salihu, Hilmi Zhitija, Fejzullah Hasani, *Kodi Penal i Republikës së Kosovës – Komentar*, Botimi I pare, Prishtinë 2014, fq. 126

²⁵ Shih: Marsela Pepi, *Vepër e cituar*, Tiranë 2005, fq. 23

²⁶ Mënjanimi i pengesave në këtë rast dëshmon qartësisht konsumimin e veprës penale të vrasjes.

kryerjen e shërbimit ushtarak. Për të bërë të mundur këtë, ai përgatit një raport mjekësor të falsifikuar nëpërmjet të cilit do të justifikojë shmangien nga shërbimi. Tek veprat penale të konsumuara me mosveprim, aktet përgatitore në shumicën e rasteve, formojnë në vetvete figurën e një vepre tjetër penale.²⁷

2.2 Dënueshmëria e Akteve Përgatitore

Standardi normativ aktual penal, shqiptar dhe evropian, dëshmon qartë se përgjithësisht aktet përgatitore qëndrojnë jashtë prirjes së inkriminimit. Parimi i pandëshkueshmërisë së akteve përgatitore është ruajtur si standard edhe në vende të rëndësishme për nga influenca në doktrinën penale evropiane si: Franca, Gjermania, Zvicra, Italia, Spanja etj.²⁸

Megjithatë ky parim në disa akte juridike ndërkombëtare ka pësuar një modifikim të rëndësishëm. Në Statutet e Gjykatave Ushtarake Ndërkombëtare të Nurembergut dhe të Tokios dëshmohet qartë se aktet përgatitore asimilohen brenda konceptit të tentativës.²⁹ Në doktrinë ka patur mendime edhe nga autorë të ndryshëm, se aktet përgatitore kanë vend edhe në veprat penale të kryera me dashje indirekte. Pavarësisht se në parim njihet padënueshmëria e akteve përgatitore, njihen edhe përjashtime nga ky rregull, të cilat shfaqen në trajtën e veprave penale me karakter autonom. Nuk mungojnë rastet kur ky parim cenohet, për interesa të atij që njihet si “*parandalimi i posaçëm*” dhe që është i preferuar i legjislatorit. Nganjëherë, legjislatori tregohet “*më i ndjeshëm*” me spektrin dhe teknikat e inkriminimit, pikërisht kur vendos të marrë në mbrojtje marrdhënie të rëndësishme shoqërore, që në momentin kur ekziston rreziku për t’i cënuar ato. Kjo situatë, njihet ndryshe, si situata e “*mbrojtjes së shtuar*” ndaj marrdhënieve të caktuara shoqërore. Bazat e këtij qëndrimi, si shprehje e teorisë objektive, ose “*e vënies në rrezik për t’u cënuar*”, janë hedhur herët, rreth viteve 1800. Regjimi i veçantë i inkriminimit të akteve përgatitore, zbatohet për arsye dobishmërie, me efekt zgjerimin e spektrit inkriminativ dhe shpie në standardin e parandalimit të posaçëm nga e drejta penale substanciale. Një gjë e tillë dëshmon qartë se për disa forma të caktuara aktesh edhe përgatitja inkriminohet si vepër penale autonome. Kjo kategori veprash penale, strukturohet posaçërisht me epiqendër parandalimin, “*ante delictum*” si shprehje konkrete e funksionit të së drejtës penale.³⁰ Inventari i modeleve të akteve përgatitore, të transformuara nga legjislatori shqiptar në vepra penale autonome

²⁷ Në rastin e sipërcituar, aktet përgatitore në vetvete, formojnë veprën penale të falsifikimit të dokumentave zyrtare.

²⁸ Shih: Jean Francois Meylan, *Les actes preparatoires delictueux en droit penal Suisse, art. 260 Bis CP*, Lausanne 1990, fq. 23. Në Zvicër, ky parim është konsolidur që prej redaktimit të kodit penal të vitit 1937.

²⁹ Shih: Alain Prothais, *Tentative et attentat*, Paris 1985, fq.39 dhe vijues.

³⁰ Shih: Agnes Cerf, *La loi du 5 Mars 2007 et les infractions de prevention: l'exemple du delit d'embuscade et de sa declinaison, le guet-apens*, fq. 1-2, e disponueshme në faqen web: <https://www.unicaen.fr/puc/images/crd/f0613cerf.pdf>

është mjaft i pasur. Mund të përmendim këtu rastin e organizatës kriminale.³¹ Neni 333 i kodit penal të RSH-se parashikon: “*Krijimi, organizimi ose drejtimi i organizatave kriminale, dënohen me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Pjesëmarrja në një organizatë kriminale, dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet*”. Në rastin e nenit 333 të kodit penal të RSH-se, veprimet përgatitore janë plotësisht të përcaktuara.

Po kështu, mund të themi të njëjtën gjë edhe për nenin 109 të K.P. të RSH-së, “*Rrëmbimi apo mbajtja peng e personit*”, kur kjo vepër mund të konsumohet me qëllim për të përgatitur krijimin e kushteve lehtësuese për kryerjen e një krimi. Në kodin penal të RSH-se, spikat edhe një grup ose kategori e dytë veprash penale, që janë relativisht të përcaktuara. Mund të përmendim si të tillë: nenin 80 të K.P. të RSH-së, “*Sigurimi i kushteve dhe mjeteve materiale për të kryer vrasje*”.³² Në vijim, neni 333/a³³ i po këtij kodi, sanksionon: “*Krijimi, organizimi ose drejtimi i një grupi të strukturuar kriminal për kryerjen e veprave penale, dënohen me burgim nga tre deri në tetë vjet. Pjesëmarrja në grupin e strukturuar kriminal, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet*”. Nën efektin e Vendimit Kuadër të Këshillit, të 13 Qershorit të vitit 2002, me ligjin nr. 9275, datë 16.09.2004, në kodin penal shqiptar është shtuar neni 234/a me përmbajtje: “*Krijimi, organizimi, drejtimi dhe financimi i organizatës terroriste, dënohen me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet. Pjesëmarrja në organizata terroriste, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet*”. Neni 234/b i kodit penal të RSH-së, parashikon krijimin, organizimin, drejtimin dhe financimin e bandës së armatosur.³⁴ Neni 284/a i kodit penal të RSH-së, parashikon gjithashtu organizimin dhe drejtimin e një forme të posacme të organizatës kriminale me qëllim specifik të kultivimit, prodhimit, fabrikimit ose trafikut të paligjshëm të narkotikëve.³⁵ Në legjislacionin penal aktual në fuqi, veprimi i akteve përgatitore është përfshirë në profilin e veprave penale të parashikuara nga një sërë dispozitash të pjesës së posaçme të tij si në nenet: 95,

³¹ Ndryshuar me ligjin nr. 9275, datë 16.09.2004 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal I RSH-së”*”, i ndryshuar.

³² Vepra të tilla penale konsiderohen si “*Delicta preparata*” ose vepra penale të përgatitjes.

³³ Ndryshuar me ligjin nr. 9275, date 16.09.2004 “*Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.7895, date 27.01.1995 “, “Kodi Penal I RSH-se”*”, i ndryshuar.

³⁴ Përmbajtja e nenit 234/b të kodit penal të RSH-se, shtuar me ligjin nr. 9275, datë 16.09.2004 “*Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjinnr. 7895, date 27.01.1995 “, “Kodi Penal i RSH-se”*”, i ndryshuar, rezulton si vijon: “*Krijimi, organizimi, drejtimi dhe financimi i bandës së armatosur, dënohen me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Pjesëmarrja në bandën e armatosur dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet*”

³⁵ Neni 284/a i kodit penal te RSH-se, shtuar me ligjin nr. 8279, date 15.01.1998 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “, “Kodi Penal i RSH-së”*”, i ndryshuar, sanksionon si vijon: “*Organizimi, drejtimi dhe financimi i organizatave kriminale me qëllim kultivimin, prodhimin, fabrikimin ose trafikun e paligjshëm të narkotikëve, dënohet me burgim nga dhjetë deri në 20 vjet. Krijimi i kushteve apo lehtësirave për veprimtari të tilla nga persona me funksione shtetërore, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjet vjet*”.

110/a-&2, 114, 129, 142, 143/a-&2, 182, 185, 192, 216, 217, 218, 220-225, 233, 234, 234/a, 283/a-&2, 283/b, 284/a, 285/a, 286, 286/a, 298, 324, 333, 333/a, të kodit penal të RSH-së. Dënimi i akteve përgatitore, parashikuar në legjislacionet tona të mëparshme³⁶ ka qenë i veçantë. Inkrimoheshin dhe dënoheshin veprimet përgatitore të ndërmarra me qëllim kryerjen e veprave penale të caktuara. Këto akte nuk konsideroheshin vepra penale të posaçme por ato dënoheshin si përgatitje për kryerjen e veprës penale të caktuar. Këto 15 vitet e fundit, në Evropë e më gjerë, inkriminimi i veprave penale të papërfunduara është zgjeruar së tepërmi.³⁷ Neni 433-16 i Kodit Penal francez, parashikon një formë specifike përgatitore të inkriminuar që ka të bëjë me mbajtjen ilegale të uniformës e cila dënohet me 3 vjet burgim por vetëm kur ajo ka për qëllim të përgatisë ose të lehtësojë kryerjen e një krimi ose të një delikti.³⁸ Holanda, nga ana e saj, ka përqafuar qëndrimin e vendeve me traditë të së drejtës civile, kur ka parashikuar nënenin 140 të kodit të saj penal aktual, krijimin e organizatës kriminale,³⁹ objektivi i së cilës, është kryerja e veprave penale.⁴⁰

2.2 a Veprat penale materiale

Në shumicën e rasteve, kur legjislatori inkriminon një sjellje individuale, ai e bën këtë në funksion të rezultatit që mund të vijë. Pra rezultati është një ndër elementët më kryesore përbërës të veprës penale dhe nëse ai nuk vjen, vepra penale nuk konsumohet. Ky është modeli i asaj që ne e quajmë veprë penale materiale. Veprat penale materiale, janë ato vepra të cilat quhen të kryera kur kanë shkaktuar ardhjen e pasojës. Në këtë kategori veprash spikat lidhja shkakësore midis veprimit ose mosveprimit dhe pasojës së ardhur të caktuar me ligj.

2.2 b Veprat penale formale

Janë ato që konsiderohen të konsumuara nga çasti i kryerjes së veprimit të caktuar, pa qenë nevoja e ardhjes së pasojës. Vepra penale formale në të cilën gjejmë shpesh të përdorur termin e atentatit, faktikisht është ajo në të cilën ligji inkriminon një procedurë pa patur interes për atë që vjen më pas. Vepra penale është pra e konsumuar pavarësisht nga rezultati që mund të jetë pasojë. Vepra penale formale dëshmon qartë se ekzistenca e një rezultati, nuk ndikon dhe nuk ndryshon cilësimin juridik të veprës penale. Veprat penale formale po përdoren

³⁶ Në kodin penal shqiptar të vitit 1952 dhe atë të vitit 1977

³⁷ Shih: Caroline M. Pelsler, *Preparations to commit a crime. The Dutch approach to inchoate offences*, Utrecht Law Review, Vol 4, Issue 3, December 2008, fq. 57

³⁸ Delikti, kategorizohet ndërmjet krimit dhe kundërvajtjes si pjesë përbërëse e nocionit veper penale. Një nga karakteristikat kryesore të kodit penal francez dhe jo vetëm, është ndarja tripjesëshe e veprës penale.

³⁹ Termi organizatë në këtë kod, rezulton një term me përmbajtje të qartë faktuale.

⁴⁰ Shih: Caroline M. Pelsler, *Veprë e cituar*, fq. 69-70.

gjithmonë e më tepër. Ato “janë në modë”, sepse janë në koherencë me format dhe zhvillimet e aktivitetit kriminal aktual pa kufij. Duke u parashikuar si të tilla, atyre u mundësohet të nderhyjnë më herët në procesin kriminal. Kjo vjen në përputhje me një model të ri të politikës penale e cila e vë theksin më tepër te koncepti i parandalimit të veprës penale sesa tek thjesht trajtimi i pasojave material që ajo sjell. Disa autorë konsiderojnë që tentativa nuk dallohet nga akti i konsumuar në një veper penale formale, sepse ajo përfshihet me të në nocionin e atentatit.⁴¹

3. Dallimet ndërmjet fazave të kryerjes se veprës penale

Analiza e momenteve të veçanta të kryerjes se veprës penale ose dallimi mes fazave të kryerjes se veprës penale është i rendesishem sepse projektohet drejt-përdrejtë në qëndrimin dhe vlerësimin e gjykatës ndaj cështjes së individualizimit të dënimit me kufij të përcaktuar nga ligji. Edhe pse fazat e kryerjes se veprës penale kanë forma të caktuara e madje të percaktuara, gjithsesi dallimi mes tyre nuk është shume i thjeshtë në dukje. Kuptimi juridik i fazave të kryerjes së veprës penale supozon kufirin e veprimtarisë së veprës së kryer dhe veprimtarisë së veprës se ndërprerë në një nga fazat e veprimtarisë paraprake kriminale.⁴² Dallimi mes fazave të veprimtarisë paraprake kriminale bëhet duke marrë për bazë shkallën e realizimit të dashjes së drejtuar në arritjen e një rezultati të caktuar shoqërisht të rrezikshem, si edhe duke vlerësuar shkallen e rrezikshmërisë shoqërore të natyrës së veprimit dhe pasojave të tij, në funksion edhe të shkallës së realizimit të veprës.⁴³ Diferencat sasiore dhe cilësore që ekzistojnë ndërmjet fazave të kryerjes së veprës penale, janë në përpjestim të drejtë me rrezikshmërinë shoqërore që i kanoset një marrëdhënieje të caktuar shoqërore.

3.1 Dallim i brishtë ndërmjet akteve përgatitore dhe fillimit të ekzekutimit të veprës penale

Është i rëndësishëm gjithashtu dallimi nga pikëpamja teorike mes lindjes së mendimit kriminal dhe shfaqjes së tij, që konkretizohet nëpërmjet formave të të folurit, të shkruarit dhe të shprehurit në mënyrë simbolike. Lindja e mendimit nuk konsiderohet një fakt juridik dhe si i tillë nuk mund të dënohet. Në disa raste, shfaqja e mendimit mund të cojë në konsumimin e veprës penale, si në rastin e fyerjes. Po kështu e dënueshme është shfaqja e mendimit kur bëhet në formën e kanosjes serioze.⁴⁴ Ndërsa te përgatitja ekziston konkretizimi i mendimit kriminal, që gjen shprehjen në veprime konkrete materiale që përgatisin kushtet. Autori

⁴¹ *Les actes préparatoires demeurent-ils encore hors du champ penal?*, e disponueshme ne faqen web: www.droit.univ-nantes.fr/m2dp/upload/word/Actes_preparatoires.doc

⁴² Shih: Skender Kacupi, *Tentativa, fazë e kryerjes së veprës penale*, Shtypshkronja ILAR, Tiranë 2007, fq. 10

⁴³ Shih: Skender Kacupi, *Vepër e cituar*, fq. 8-9

⁴⁴ Shih: Skender Kacupi, *Vepër e cituar*, fq. 20

Molinier i karakterizonte aktet përgatitore në mënyrën e mëposhtme: «*Veprimet e përkthyer në fakte vepruese janë ato që përbëjnë veprën penale, që i japin asaj ekzistencën; veprimet e përkthyer në akte përgatitore janë ato që i paraprijnë ekzekutimit të veprës penale dhe janë të destinuara ta lehtësojnë atë, për ta bërë të mundur ndodhjen e saj; por aktet përgatitore nuk janë ngushtësisht aktet materiale përbërëse të veprës penale dhe nuk hyjnë në përkufizimin ligjor të një veprë penale*». Ky lloj karakterizimi duket në pamje të parë i qartë por gjithsesi duhet të saktësojmë se në *Iter criminis*, aktet përgatitore paraprijnë aktet e ekzekutimit të veprës dhe që në mungesë të një përkufizimi ligjor të këtyre dy koncepteve doktrinale, një situatë e paqartë karakterizon dallimin ndërmjet akteve përgatitore dhe fillimit të ekzekutimit të veprës penale. Fillimi i ekzekutimit nuk është vetëm përbërësja materiale e tentativës, ai zhvillohet gjithashtu në funksion të anës subjektive të veprës penale. Vetë fillimi i ekzekutimit është: “*akti që tenton drejtpërdrejt dhe në mënyrë të menjëhershme në kryerjen e veprës penale*”. Qëllimi kriminal është një element themelor në dallimin ndërmjet aktit përgatitor dhe fillimit të ekzekutimit të veprës penale. Një akt përgatitor transformohet në fillim të ekzekutimit, atëherë kur ai është shumë afër konsumimit të veprës penale dhe që transmeton padyshim qëllimin e autorit për të kryer veprën penale. Fakti i gjetjes së një arme ose i fshehjes në një vend prej nga mund të vëzhgojë sjelljet e viktimës përbën thjesht veçse akt përgatitor. Vendosija e autorit të veprës me armën në xhep, në një vend ku pret të kalojë viktimën potenciale, dëshmon qartë për një transformim të akteve përgatitore në fillim të ekzekutimit të veprës. Sjellja e personit do të përbëjë akt përgatitor gjer kur ai të fillojë ekzekutimin e aktit të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm që do të çojë në konsumimin e veprës penale. Konkretisht pozicionimi i armës në drejtim të viktimës potenciale dhe përgatitja për të qëlluar është padyshim fillim i ekzekutimit të veprës penale. Nëse tek përgatitja kemi fillimin e kryerjes së veprimeve aktive që përgatisin kryerjen e veprës, tek shfaqja e mendimit kjo gjë mungon krejtësisht. Sipas legjislationit penal shqiptar të vitit 1977, është pranuar pozita e përgjegjësisë penale të personit si për figurën e veprës penale të mbetur në fazën e përgatitjes⁴⁵ ashtu edhe për atë të veprës penale të konsumuar plotësisht. Po kështu edhe sipas legjislationit penal shqiptar të vitit 1952.⁴⁶

3.2 Dallim i qartë ndërmjet akteve përgatitore dhe tentativës

Në doktrinën penale evropiane ekziston mendimi, se aktet përgatitore dhe tentativa janë dy fazat që kanë dallimet më të rëndësishme mes tyre në raport me fazat e tjera. Ndryshimet ndërmjet akteve përgatitore dhe tentativës, janë ato

⁴⁵ Shih: Maksim Haxhia, *Disa vlerësime teorike dhe praktike lidhur me institutin e përgatitjes në krim*, Revista Drejtësia Popullore, Nr.2, viti 1984, fq.45

⁴⁶ Kur figura e veprës penale kishte mbetur në fazën e përgatitjes, ajo do të cilësohej sipas dispozitës përkatëse të pjesës së posacme, në lidhje me nenin 10 ose 11, përkatësisht të K.P. të vitit 1952 dhe K.P. të vitit 1977. Në vitin 1995, me hyrjen në fuqi të kodit të ri penal të RSH-së, veprimet përgatitore të caktuara u ngritën në fazën e veprës penale të kryer, për shkak të dobishmërisë shoqërore për të mbrojtur interesat sociale.

ndërmjet koncepteve të ndryshme të fazave të veprimtarisë kriminale. Me tentativë ose “*përpjekje të pasuksesshme*”, kemi të bëjmë atëherë kur vendimmarrja për të kryer një veprë penale, është shfaqur me akte të jashtme, të cilat formojnë fillimin e ekzekutimit të veprës penale ku rezultati i të cilës, nuk ka ardhur për shkaqe e rrethana krejtësisht të pavarura nga vullneti i personit që kishte planifikuar kryerjen e veprës penale.⁴⁷ Megjithëse ky konceptim është karakteristik për vendet me traditë romano-gjermanike, i njëjti mbizotëron edhe në vendet me traditë ligjore të Common Law-ut.⁴⁸ Në Itali kryesisht gjen vend mendimi i shfaqur nga autori Carrara,⁴⁹ sipas të cilit në diferencë nga akti përgatitor ekuivok, fillimi i ekzekutimit nuk mund të shpjegohet përveçse nëpërmjet qëllimit kriminal të autorit të tij.⁵⁰ Ligji penal, për ekzistencën e tentativës, kërkon që aktet e jashtme që manifestojnë projektin për të cilën ka rënë dakord autori të kryejë, të formojnë një fillim ekzekutimi të veprës penale sikundër autori dëshiron. Kjo do të thotë se autori ka filluar të ezaurojë ekzekutimin e veprës penale. Si tipar i domosdoshëm material i akteve përgatitore, duhet të njihet rrezikshmëria shoqërore që formon përgatitja e veprimeve të tilla. Krijimi i kushteve, i shkëputur nga faktorët e tjerë nuk mund të përbëjë tentativë. Kodi penal shqiptar përcakton kuptimin e tentativës si: “*Vepra penale quhet e mbetur në tentativë kur, megjithëse personi ndërmerr veprime të drejtpërdrejta për ta kryer atë, vepra ndërpritet e nuk përfundohet për rrethana të pavarura nga vullneti i tij*”.⁵¹ Kodi penal francez në nenin 121-5 të tij, e përkufizon tentativën të konsumuar atëherë kur manifestohet nëpërmjet fillimit të ekzekutimit, kur ajo nuk është pezulluar ose rezultati nuk ka ardhur për arsye të rrethanave të pavarura nga vullneti i tij. Kodi penal belg, e sanksionon tentativën e deliktit dhe krimin respektivisht në nenet 51 dhe 52 të tij. Kodi penal Italian në nenin 56/1 të tij parashikon tentativën: “...*kush kryen veprime të përshtatshme, të drejtuara drejtpërsëdrejti në realizimin e krimin, përgjigjet për tentativë krimi, nëse qëllimi nuk përmbushet ose ngjarja nuk provohet*”. Nuk kemi të bëjmë me tentativë kur akoma nuk janë krijuar kushtet që autori i krimin të veprojë drejtpërsëdrejti mbi objektin. Kushti tjetër që të ketë tentativë, është një lidhje shkakësore ndërmjet aktit të ekzekutimit dhe qëllimit të autorit të veprës penale. Në mungesë të shkakësisë,

⁴⁷ Shih: Victor Irengé Balemirwe, *De l’Incrimination de la Tentative en Droit Positif Congolais*, e disponueshme në faqen web: https://www.memoireonline.com/05/10/3465/m_DE-LINCRIMINATION-DE-LA-TENTATIVE-EN-DROIT-POSITIF-CONGOLAIS3.html, konsultuar në shtator 2017.

⁴⁸ Referuar seksionit 1 të: “*Criminal Attempts Act 1981*”, i cili është një statut i kodifikuar. Për më tepër referoju: Michael Molan, *Sourcebook on Criminal Law*, Cavendish Publishing Limited, 2001, fq. 475-479.

⁴⁹ Shih: F. Carrara, *Programma del corso di diritto criminale. Del delitto, della pena*, Bologna, 1993, fq. 334 dhe vazhdim.

⁵⁰ Shih: Jean Deveze, *Le Commencement d’Execution de l’Infraction en Jurisprudence*, Revue de Science Criminelle et de Droit Penal Compare nr. 4 Octobre – Decembre 1981, fq.782

⁵¹ Shih: Neni 22 i Kodit Penal të RSH-se, Qendra e Publikimeve zyrtare, Tiranë 2016

doktrina flet per tentativë të pamundur. Tentativa konsiderohet e pamundur kur akti i ekzekutimit nuk mund të shkaktojë qëllimin e kërkuar. Një shembull konkret është rasti kur dikush përpiqet të helmojë dikë me një substancë e cila nuk shkakton vdekjen. Një nga rastet është situata kur autori heq dorë spontalisht në momentin e fundit, nuk do të bëhet fjalë për një tentativë vrasje.⁵² Sipas disa autorëve, nuk ekzistojnë elementët e figurës së veprës penale të mbetur në fazën e tentativës.⁵³ Sipas mendimit tonë, ky mendim nuk është i drejtë sepse normativa juridike penale aktuale angazhon përgjegjësinë penale si për rastin e veprës penale të mbetur në fazën e tentativës ashtu edhe për veprën penale të konsumuar plotësisht. Në këtë logjikë ecën mendimi i një grupi të gjerë penalistësh.⁵⁴ Tentativa si fazë paraprake e veprës penale, edhe pse është e lidhur ngushtë me normën juridike të posaçme “*nomen juris*” të cilës i referohet, orientohet së pari për nga norma e përgjithshme inkriminuese që përmbahet në pjesën e përgjithshme të kodit. Në këtë këndvështrim, dënueshmëria e saj realizohet si rezultat i kombinimit të inkriminimit të veprës penale të posaçme⁵⁵ dhe nenit 22 të kodit penal të RSH-së që parashikon tentativën, pra dënimin e veprave penale që nuk kanë parë dritën e konsumimit.⁵⁶ Ndërsa aktet përgatitore, janë të lidhura ngushtë vetëm me normën e posaçme, nga pikëpamja e inkriminimit dhe e dënueshmërisë, në kushtet kur parimi i përgjithshëm është ai i mungesës së inkriminimit të akteve përgatitore. Shkalla e rrezikut që i kanoset një marrëdhënieje të caktuar në fazën e përgatitjes është më e vogël sesa shkalla e tij në fazën e tentativës.

3.3 Tejkallim jurisprudencial në dallimin mes veprës penale të mbetur në tentativë dhe veprës penale të konsumuar

Një nga problemet me natyrë doktrinale por edhe jurisprudenciale, e krimit të tentuar, është pikërisht përcaktimi i një kufiri se kur fillon “*akti ekzekutiv*” i veprës penale në pikëpamje të anës objektive. Përcaktimi i një momenti të tillë ka rëndësi jo vetëm për individualizimin e përgjegjësive penale por edhe në përcaktimin e kufijve dallues midis boshtit juridik “*krimi i tentuar*” - “*heqja dorë nga kryerja e veprës penale*” dhe “*akteve përgatitore*”.

Doktrina mazhoritare e ndan veprën penale në katër faza kryesore si: lindja e mendimit kriminal, përgatitja, ekzekutimi dhe konsumimi i veprës penale.⁵⁷

⁵² Shih: Nenet 52, 80 dhe 81 të kodit penal belg.

⁵³ Shih: Skënder Kacupi, *Vepër e citurar*, fq.110

⁵⁴ Shih: Spiro Spiro, *Kuptimi i objektit të figurës së krimit*, Revista Drejtësia Popullore, Nr. 6 viti 1972, fq.10; Niazi Jaho, *Përgatitja, tentativa dhe heqja dorë vullnetare nga kryerja e krimit*, Revista Drejtësia Popullore, Nr. 2 viti 1972, fq.14

⁵⁵ E cila parashikon edhe rrethanat përcaktuese prej nga lind përgjegjësia penale.

⁵⁶ Shih: A. Crespi, G. Zuccala, G. Forti, *Commentario breve al Codice Penale Italiano*, CEDAM, 2008, fq.180.

⁵⁷ Shih: Ferrando Mantovani, *Diritto penale, Parte generale*, Cedam 2016, fq. 431

Përgatitja konsiston në fazën ku vepra penale potencialisht mund të vijë, ndërsa ekzekutimi konsiston në intervalin përmes të cilit autori i veprës penale, shfaq në botën e jashtme veprime të nevojshme për të mundësuar ardhjen e pasojës së dëshiruar. *E thënë ndryshe përfaqëson rrugën, ose mjetin e mesëm për të prodhuar ekzistencën e veprës penale.*⁵⁸ Në këtë kuptim, individualizimi ekskluzivisht i momentit kur veprimi është penalisht i dënueshëm, përfaqëson pikën e interesit kryesor. Piketat kryesore janë mundur të vendosen nga jurisprudenca.

Kështu Gjykata e Kasacionit në Itali shprehet se: *“për përcaktimin e tentativës së dënueshme, kanë rëndësi penale, jo vetëm aktet me natyrë ekzekutive, por edhe ato akte të cilat për nga natyra mund të klasifikohen si aktë përgatitore, por për shkak të vendit, kohës, mjeteve, të bëjnë të besosh që aksioni (aktet ekzekutive) do të fillojë, dhe që për nga natyra e tij mund të realizojë objektivin e programuar, dhe se autori gjëndet në një pikë nga ku nuk mund të tërhiqet nga realizimi i krimit”.*⁵⁹ Ky qëndrim i Gjykatës së Kasacionit erdhi në një çeshtje ku i pandehuri kishte qëndruar përpara një banke për një periudhë të gjatë kohore me qëllim vjedhjen e saj, vjedhje të cilën do ta kryente duke e shoqëruar me armëmbajtje pa leje.⁶⁰ Referuar vendimit të mësipërm, mund të pohohet se *“ekzistenca e veprës penale të mbetur në tentativë mund të formësohet jo vetëm kur autori ka ndër marrë veprime tipike dhe të drejtpërdrejta për kryerjen e veprës penale por edhe kur tërësia e veprimeve të tij shfaqur në botën e jashtme, përbëjnë akte me natyrë përgatitore, me kushtin e vetëm që autori të mos ketë mundësi të tërhiqet”* (të heqë dorë nga kryerja e veprës penale).

Në këto kushte vlen të sille të vëmendje edhe Jurisprudenca e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë të RSH-se.⁶¹ Me vendimin nr. 608, datë 26.09.2007 kolegji është shprehur se: *“Figura e krimit të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, është figurë e prerë ose formale. Për këtë arsye, krimi duhet të quhet i konsumuar edhe pa ardhur pasoja kriminale, kalimi i lëndës narkotike në anën tjetër të kufirit shtetëror, mjaft të provohet ekzistenca qoftë edhe e njëjës prej formave të anës objektive të tij (importimi, eksportimi, tranzitimi ose tregtimi, në kundërshtim me ligjin”.*

Përmes këtij vendimi Kolegji Penal, konfirmon tezën se vepra penale e *“trafikut të lëndëve narkotike”*, do të konsiderohet e konsumuar pavarësisht faktit nëse lënda e ndaluar në qarkullimin civil ka dalë jashtë territorit të shtetit shqiptar, përmes arsytimit se këto vepra penale hyjnë në kategorinë e veprave penale formale për të cilat nuk pranohet teza e tentativës. Jemi të mendimit se ky qëndrim

⁵⁸ Shih: Giovanni Brichetti, *Il Delitto Tentato. Indagini*, 1965, fq.15.

⁵⁹ Shih: Cass. pen., *Sez.II, 13 marzo 2012*.

⁶⁰ Gjykata u shpreh se megjithëse veprimet e tij janë klasike për aktet përgatitore, mjete, koha, vendi dhe mënyra e përcaktuar për kryerjen e veprës tregojnë qëllimin e tij për ta çuar deri në fund planin dhe mendimin kriminal.

⁶¹ Shih: Vendimin nr. 608, datë 26.09.2007 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

i Kolegjit Penal, bën një reflektim jo të saktë të parimeve doktrimore. Pranohet se në pikëpamje të subjektit dhe sjelljes së tij në raport me faktet juridike, veprat penale ndahen në *vepra penale komisive* dhe në *vepra penale omisive*.⁶²

Në rastin e veprave penale *komisive*, krimi konsiderohet i konfiguruar me kryerjen e veprimit, ose aktit të kundraligjshëm pa qenë e nevojshme ardhja e një pasoje juridike të materializuar në botën e jashtme.⁶³ E ndryshme paraqitet situata në rastin e veprave penale *omisive*,⁶⁴ njohur ndryshe si vepra penale materiale, në të cilat zbatimi i normës abstraktë në çështjen konkretë, kushtëzohet nga ardhja e një pasoje materiale, mungesa e të cilës shtron për diskutim çështjen e tëntativës si mënyrë e shfaqjes së veprës penale. Në rastin në shqyrtim vepra penale e «trafikimit të lëndëve narkotike» duhet konsideruar si vepër penale me natyrë materiale pasi konsumimi i saj kërkon ardhjen e pasojës së dëshiruar, kalimin e lëndës së ndaluar jashtë territorit shqiptar.

Në vendimin unifikues nr 3 të vitit 2011 Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë: *«Vepra penale e trafikimit të narkotikëve (neni 283/a), në mënyrën e importimit, quhet e kryer me vërtetimin e rrethanës se lënda narkotike e ka kaluar kufirin tokësor, ajror a detar të Republikës së Shqipërisë, pavarësisht se ende mund të mos ketë mbërritur apo të ketë kaluar në pikat kufitare e doganore, stacionet, portet dhe aeroportet e vendit përfshirë këtu zonat e tyre të tranzitit. Po kështu, vepra penale quhet e kryer pavarësisht rrethanës që, lënda narkotike, pas kalimit të kufirit shtetëror apo edhe të kontrollit policor e doganor, ka mbërritur ose jo tek personi apo destinacioni i dëshiruar nga autorët e veprës në territorin shqiptar. Nëse lënda narkotike, megjithë veprimet a mosveprimet konkrete të drejtpërdrejta të autorëve të veprës për importimin e saj, nuk e ka kaluar kufirin shtetëror shqiptar, për rrethana që nuk varen nga vullneti i tyre, pavarësisht nga koha e vendi i ndërprerjes së veprimit kriminal, vepra penale kualifikohet si trafikim i narkotikëve në mënyrën e importimit e mbetur në tentativë parashikuar nga nenet 283/a dhe 22 të Kodit Penal.*

Vepra penale e trafikimit të narkotikëve (neni 283/a), në mënyrën e eksportimit, quhet e kryer me vërtetimin e rrethanës se lënda narkotike ka kaluar kufirin tokësor, ajror a detar të Republikës së Shqipërisë. Po kështu, vepra penale quhet e kryer pavarësisht rrethanës që, lënda narkotike, pas kalimit të kufirit shtetëror apo edhe të kontrollit policor e doganor, i është nënshtruar apo jo kontrollit policor e doganor të shtetit tjetër, nëse ka mbërritur tek personi apo destinacioni i dëshiruar nga autorët e veprës në territorin e atij shteti.

Nëse lënda narkotike, megjithë veprimet a mosveprimet konkrete e të drejtpërdrejta të autorëve të veprës për eksportimin e saj, nuk e ka kaluar kufirin

⁶² Shih: Silvia Cacciotti, *Diritto Penale per tutti i concorsi*, Alpha Test 1 Edizione, 2005, fq.29

⁶³ Në doktrinën penale shqiptare këto njihen edhe si vepra penale formale

⁶⁴ Në doktrinën penale shqiptare njihen si vepra penale materiale; Për më tepër shih: Shefqet Muçi, *E drejta Penale Pjesa e Përgjithshme*, Tiranë 2007,

shtetëror shqiptar, për rrethana që nuk varen nga vullneti i tyre, pavarësisht nga koha e vendi i ndërprerjes së veprimit kriminal në territorin shqiptar, vepra penale kualifikohet si trafikim i narkotikëve në mënyrën e eksportimit e mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 283/a dhe 22 të Kodit Penal.....”.

Kolegjet e Bashkuara vërejnë se, në zbatim të drejtë të ligjit penal dhe bazuar në jurisprudencën e konsoliduar penale, nisur nga veçantitë e mënyrës së kryerjes së veprës penale të trafikimit të narkotikëve (neni 283/a) dhe duke qenë se kryhet me dashje, sipas rastit, autorët kanë përgjegjësi penale për kryerjen e veprës penale ose për veprën penale të mbetur në tentativë, nëse, krahas shfaqjes së mendimit kriminal dhe përgatitjes eventuale për të ardhmen, ata me dashje, kryejnë veprime e mosveprime konkrete dhe të drejtpërdrejta mbi objektin e krimit, me të cilat synojnë (aty për aty) arritjen e qëllimit kriminal, ardhjen e pasojave të dëshiruara prej tyre, pra kryerjen e veprës. Sikurse është arsyetuar më sipër në këtë vendim për kualifikimin e veprës penale të trafikimit të narkotikëve (neni 283/a), ka rëndësi thelbësore të vërtetohet kryerja, me dashje, e veprimeve apo mosveprimeve, konkrete, për të realizuar, në mënyrë të kundërligjshme, qëllimin e dëshiruar nga autorët e veprës, pikërisht hyrjen (sjelljen) ose daljen (dërgimin) e paligjshëm të narkotikëve nga territori shqiptar ose kalimin e paligjshëm të tyre nëpërmjet territorit shqiptar në atë të shteteve të tjera, kryesisht për të realizuar përfitime të ndryshme për vete ose për të tretë. Kjo tezë mbështetet edhe nëse marrim në konsideratë praktikën e Gjykatës së Kasacionit në Itali. Kolegji Penal i kësaj gjykate konfirmon tezën se «*Vepra penale e kontrabandës për nga natyra e saj është vepër e qëndrueshme dhe jo e konsumueshme. Një fakt i tillë ka rëndësi praktike në kuadër të kryerjes së veprës penale në bashkëpunim. Kështu vepra penale e kontrabandës shtrihet në kohë dhe nuk konsumohet me hyrjen e tyre në territorin e shtetit por gjendja e paligjshmërisë (e qëndrueshmërisë së kontrabandës) vazhdon deri në daljen e tyre në qarkullim. Në këtë pikëpamje do të konsiderohet se vepra penale e kontrabandës, është kryer në bashkëpunim edhe nëse një person bashkohet me autorin menjëherë pas hyrjes së mallrave në territorin e shtetit me qëllim për ta ndihmuar atë për t'i vënë në qarkullimin civil ose për t'iu shmangur kontrollit doganor”.*

Konfirmimi i tezës se vepra penale duhej konsideruar e mbetur në tentativë nëse autori arrestohet përpara pikave të kalimit kufitar, vjen e tillë edhe nga trajtimi i institutit të heqjes dorë nga kryerja e veprës penale. Autorë të ndryshëm shprehen se: “*Mundësia e heqjes dorë nga kryerja e krimit të trafikimit të lëndëve narkotike, edhe pse subjekti i ka ndërmarrë të gjitha veprimet e përshtatshme, të drejtpërdrejta dhe të domosdoshme për kryerjen e tij (sidomos në rastin tipik të eksportimit), provon pathemelësinë e tezës së kolegjit se krimi i sanksionuar nga neni 283/a i Kodit është figurë e natyrës formale. Në çdo rast, kjo lloj vepre është figurë me natyrë të qartë materiale”.*⁶⁵ Duke iu rikthyer vendimit të mësipërm të Gjykatës së Kasacionit, rezulton se aktet me natyrë përgatitore ose ndryshe aktet me natyrë

⁶⁵ Shih: Henrik Ligori, *Për kuptimin e tentativës në trafikimin e lëndëve narkotike dhe të armëve*, Revista “Jeta Juridike”, nr. 77(2), 2009

joekzekutive të vlerësuara në unitetin e tyre janë relevantë për ardhjen e pasojës dhe realizimin e objektivit kriminal, me kusht që subjekti të ndodhet në një pikë që nuk mund të tërhiqet ose të heqë dorë. Ky pohim gjyqësor, duke e lidhur me rastin objekt vlerësimi, sjell situatën juridike ku autori, ende pa hyrë në territorin doganor ose edhe kur ka hyrë brenda tij, mund të heqë dorë nga kryerja e veprës penale dhe kështu të mbajë përgjegjësi penale për atë figurën e veprës penale që ka realizuar me veprimet e tij deri në atë moment.

3.4 Heqja dorë vullnetarisht si shkak final i moskryerjes së veprës penale

Pa dyshim që aktet përgatitore mund të lajmërojnë qëllimin negativ të individit. Në njëfarë mase, ato manifestojnë së jashtmi mendimin dhe vendimmarrjen e individit në trajtën e prirjes për të kryer veprën penale. Por nga ana tjetër, teorikisht dhe praktikisht, ato për nga natyra, qëndrojnë larg kryerjes së veprës penale për t'i lënë hapësirë edhe pendimit të mundshëm të individit duke realizuar një qëndrim të ndryshëm ose një qëllim definitiv.⁶⁶ Për të zbritur nga tentativa të heqja dore-vullnetarisht nga kryerja e veprës penale, duhet të kuptojmë se situata e tentativës, në përbërje të elementit material të faktit penal, është e lidhur ngushtë me elementin psikologjik, subjektiv: mungesën e heqjes dorë në mënyrë të vullnetshme nga kryerja e veprës penale. Heqja dorë vullnetarisht nga kryerja e veprës penale, në doktrinën penale evropiane, vlerësohet si një reagim psiko-fizik që formësohet materialisht në formën e pendesës dhe të keqardhjes.⁶⁷ Ky sens moral në rastin e tërheqjes nga kryerja e mëtejshme e veprimeve të caktuara, dëshmon qartë për lidhjen mes moralit⁶⁸ dhe të drejtës penale.⁶⁹ Edhe pse e drejta penale nuk është në themel të moralit, (*e anasjellta është e vlefshme*) ajo perben një “*moral shoqëror të shprehur në trajtë normative*”. Në praktike, rastët e heqjes dorë vullnetarisht nga kryerja e veprës penale nuk mungojnë. Ky veprim mund të ndodhë qoftë në rastin e ndërmmarrjes së veprimeve përgatitore, qoftë në rastin e tentativës me qëllim kryerjen e veprës penale. Heqja dorë vullnetarisht nga kryerja e veprës penale, duhet të karakterizohet nga një vullnet real për të evituar lirisht dhe në mënyrë individuale veprën penale. Në momentin kur personi mund të konsumojë veprime të tjera me karakter objektiv, të cilat do të sjellin pasojën kriminale duke konsumuar kështu veprën penale, ai vendos me vullnetin e tij të lirë të tërhiqet dhe të mos e kryejë veprën, së jashtmi nuk materializohet asnjë pasojë kriminale. Nëse heqja dorë nga vepra penale, bëhet e detyrueshme nga shkaqe që dalin jashtë vullnetit të individit, atëherë nuk kemi të bëjme me heqje dorë vullnetarisht nga

⁶⁶ Shih: Garçon, *Code Penal Annoté*, i disponueshem në faqen web:<http://axiome-x.tripod.com/ddcautresdelits/id27.html>, konsultuar në shtator 2017.

⁶⁷ Shih: Jonathan Kochel, *Le repentir en droit penal français*, Memoire de Master II Recherche, Université Paris II Pantheon-Assas, Bibliotheque Cujas,

⁶⁸ Morali në rastin konkret i perket ndërgjegjes individuale të personit.

⁶⁹ E drejta shfaqet si produkt i një autoriteti publik.

kryerja e veprës penale. Ky është sigurisht, një moment i rëndësishëm juridik për tu vlerësuar dhe reflektimi i parë mbi këtë moment i takon gjykatës, e cila duhet të çmojë së pari karakterin e vetëdijshëm të personit, i cili e kishte plotësisht të mundur, referuar edhe rrethanave të ngjarjes të intensifikonte natyrën e veprimeve me karakter objektiv për të finalizuar veprën penale.⁷⁰

4. KONKLUZIONE DHE PËRFUNDIME

Përcaktimi i kufijve të qartë ndarës ndërmjet fazave ka rëndësi të madhe sidomos në drejtim të zbatimit të parimit të ligjshmërisë kriminale dhe të sigurisë juridike të qytetarëve. Për këtë ligjvënësi duhet të përcaktojë qartë dallimet midis veprimeve përgatitore e tentativës dhe ky dallim duhet të jetë vërtet çështje juridike.⁷¹ Në të drejtën penale, edhe nga studimet aktuale është rikonfirmuar se nuk është e lehtë të diferencohen elementët konceptuale të fazave të kryerjes së veprës penale. Alfa e këtyre fazave, aktet përgatitore në të drejtën penale janë një mjet i shprehjes së vullnetit për të komunikuar një realitet të kundërligjshëm kriminal në mjedisin shoqëror dhe si të tilla janë mjaft të rëndësishme për t'u njohur e trajtuar. Trajtesat për këtë tematikë, edhe sot qëndrojnë akoma të zhvilluara në mënyrë të vakët.⁷² Aktet përgatitore, janë kryesisht veprime që nuk përkthehen në sigurinë e kryerjes së veprës penale dhe ardhjes së rezultatit kriminal. Këto akte mund të jenë të mundshme por jo të nevojshme për kryerjen e saj. Janë kryesisht veprime që mund t'i përmbledhim nën epitelin "*thujse identike*" por jo për çdo lloj figure vepre penale. Ky identicitet, kushtëzohet pa dyshim nga karakteri dhe kategoria e veprës penale. Parimi i përgjithshëm që promovohet sot nga doktrinën penale bashkëkohore është ai i përjashtimit të këtyre akteve nga inkriminimi penal. Mund të imagjinojmë se të gjithë këto përjashtime që i bëhen parimit të mosinkriminimit të akteve përgatitore, i detyrohen politikës kriminale. Mund të konkludohet me plot të drejtë që aktet përgatitore të një vepre penale në një pjesë të konsiderueshme të legjislacioneve penale evropiane qëndrojnë jashtë prirjes së inkriminimit penal.⁷³ Në ato raste kur thyhet ky parim, inkriminimi i akteve përgatitore, dëshmon qartë preokupacionin e legjislatorit për të inkriminuar në një fazë të hershme veprat penale që konsiderohen "*vepra penale mjet*" për të konsumuar forma të tjera më të ndërlikuara të aktivitetit kriminal si edhe bashkëpunimin e vendeve edhe në fushën

⁷⁰ Heqja dorë vullnetarisht nga kryerja e veprës penale, është një moment që gjen vetëm një përgjigje në shumë kode penale të familjes evropiane, atë të mosdënimit ose të lirimit nga dënimi të autorit të këtyre veprimeve.

⁷¹ Shih: Marsela Pepi, *Vepra e cituar*, fq. 38

⁷² Shih: F. Antolisei, *Manuale di diritto penale, parte generale*, XVI ed., Milano, 2003, fq. 486.

⁷³ Shih: Ioana Celina Pasca, *The Tendency of Criminalizing Preparatory Acts as Self-Standing Offences or Attempt to Commit an Offence*, J.E.E-Eur.Crim. L. 46 (2017), Heinonline, fq. 1-3

e harmonizimit të së drejtës penale substanciale.⁷⁴ Inkriminimi i këtyre formave përgatitore, bëhet kryesisht për akte që lidhen ngushtësisht me kryerjen e një vepre penale kryesore. Inkriminimi i akteve përgatitore, është një dëshmi se në veprimet e personit që krijon kushtet ose drejton veprimtarinë drejtpërsëdrejti në funksion të ardhjes së pasojës kriminale, përmbahen elementët e veprës penale.⁷⁵ Veprat penale autonome, produkt i inkriminimit të posaçëm të akteve përgatitore janë tregues i “lëvizjes së subjektivizimit”⁷⁶ të së drejtës penale. Inkriminimi i akteve përgatitore në të drejtën penale, përbën akoma edhe sot një ndër më të debatuarit që i ka lënë juristët thuajse në një situatë kaotike. Përveç konceptit të akteve përgatitore në të drejtën penale, të rëndësishme janë evidentuar edhe momente të tjera domethënëse juridike si: fillimi i ekzekutimit të veprës penale, tentativa e veprës penale dhe heqja dorë vullnetarisht nga kryerja e veprës penale. Debatet shkencore realisht nuk kanë konkluduar kurrë në një qëndrim të qartë, të unifikuar, mbi dallimin që ekziston ndërmjet akteve përgatitore dhe atyre që karakterizojnë fillimin e ekzekutimit të veprës penale.⁷⁷ Pika delikatë ndërmjet akteve përgatitore dhe fillimit të ekzekutimit të veprës penale lidhet me elementin kohë. Pikërisht momenti i fillimit të ekzekutimit të veprës penale, është treguesi që shërben si kufi ndërmjet përfundimit të akteve përgatitore dhe fillimit të ekzekutimit të veprës penale. Çdo veprim mund të jetë në origjinën e fillimit të ekzekutimit, nëse ky akt do të ketë për pasojë të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershme konsumimin e veprës penale. Kuptimi i tentativës na tregon se që një akt të jetë i dënueshëm, nuk do të thotë që ai duhet të kryhet patjetër në tërësinë e tij bashkë me pasojën kriminale. Zhvillimet e reja të së drejtës penale, prej kohësh janë orientuar në interpretimin e kuptimit subjektiv të tentativës. Nuk do të konsiderohet se ekziston tentativa, nëse personi nuk ka vendosur të kryejë veprën e caktuar, edhe pse i ka ndërmarrë disa veprime.⁷⁸ Për t’u konsideruar veprimi si pjesë përbërëse e veprës penale, duhet që ai të jetë drejtuar drejt realizimit të saj dhe që nga ana subjektive, veprimi të jetë realizuar për këtë qëllim. Disa autorë pranojnë mundësinë e kryerjes së tentativës me dashje indirekte, por thonë se në praktikë është e vështirë të vërtetohet se personi ka vepruar me dashje eventuale të arrijë një rezultat të caktuar, shoqërisht të rrezikshëm. Vepra penale nuk mund të mbetet në tentativë, kur personi vepron nga pakujdesia, në të dy format e saj. Disa autorë

⁷⁴ Shih: Resolution Draft “*The Expanding Forms of Preparation and Participation*”, International Review of Penal Law, Vol 78, 2007/3, fq. 509 - 513

⁷⁵ Shih: Skënder Kacupi, *Tentativa, fazë e kryerjes së veprës penale*, Shtypshkronja ILAR, Tirane 2007, fq. 44

⁷⁶ Shih: *Lexique juridique–Infraction Obstacle*, e disponueshme në faqen web: <http://www.droit.fr/lexique/index.php/term/Juridico,2767-infraction-obstacle.xhtml>

⁷⁷ Shih: Droit Penal Approfondi, *Les actes préparatoires demeurent-ils encore hors du champ penal?*, e disponueshme në faqen web: www.droit.univ-nantes.fr/m2dp/upload/word/Actes_preparatoires.doc

⁷⁸ P.sh: kur personi nxjerr nga këllëfi thikën dhe i drejtohet tjetrit por akoma nuk ka vendosur të godasë mbi të.

mendojnë se tentativa ekziston edhe tek veprat penale formale. Në rastin e veprës penale të shpifjes, mund të rezultojë një gjë e tillë.⁷⁹ Në legjislacionin e kohës së diktaturës në Shqipëri, në raste të veçanta, kjo prirje, përfshinte tek tentativa, në mënyrë krejt të paarsyeshme edhe aktet përgatitore.⁸⁰ Madje u shkua edhe më tej, duke përfshirë edhe format e shfaqjes së mendimit. Këto teori në fushën e të drejtës penale, i shërbyen një qëllimi të vetëm, atij të mbrojtjes së pozitës të pushtetit politik në fuqi. Me qëndrimin e saj ndaj natyrës së akteve përgatitore, tentativës dhe heqjes dorë vullnetarisht nga kryerja e veprës penale, e drejta penale dëshmon pozitën e saj si një kujdestare e denjë duke realizuar një shërbim me dobishmëri të lartë shoqërore që influencon drejtëpërsëdrejti në ruajtjen e ekuilibrit të marrëdhënieve njerëzore dhe vetë rendit shoqëror. Ky moment është pikërisht ai kur e drejta penale mund të ndërhyjë për të sanksionuar sjelljen e individit që tenton të kryejë ose kryen një vepër penale.⁸¹ Praktikisht, mbështetur edhe në mendimin e autorëve të tjerë, vendas dhe të huaj, mund të konkludojmë se ndërmjet akteve përgatitore dhe atyre që karakterizojnë fillimin e ekzekutimit të veprës ekziston një dallim shumë delikat. Nisur nga kuptimi dhe natyra e akteve përgatitore, nuk mund të konstatojmë me siguri se personi do të kryejë apo jo veprën penale.

Aktet përgatitore dhe tentativa e veprës penale janë momente juridike të mungesës së rezultatit kriminal. Ajo që vlen të theksohet nga krahasimi i këtyre dy institutive të së drejtës penale, është diferenca e tyre konceptuale (është fjala për përgatitjen dhe për tentativën). Nisur nga çfarë jemi përpjekur të parashtrijmë më sipër, jemi të mendimit se aktet përgatitore nuk mund të jenë të pranishme në rastin e një vepre penale me dashje indirekte.⁸² Nuk ka bazë logjike dhe ligjore. Në situatën e dashjes indirekte, doktrina penale shqiptare është e qëndrimit se autori i veprës penale nuk dëshiron të arrijë ndonjë rezultat shoqërisht të rrezikshëm, nuk dëshiron ardhjen e pasojave. Në fazën e akteve përgatitore, autori nuk mund të përcaktojë nëse rezultati i mundshëm do të vijë apo jo. Ashtu si në disa raste, sikurse e përmendëm më sipër, është e vështirë të dallojmë aktet përgatitore nga tentativa, nganjëherë është e vështirë të dallojmë edhe nëse jemi përpara tentativës së një vepre penale apo një forme të konsumuar të veprës penale. Kësaj vështirësie nuk i ka rezistuar edhe qëndrimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë të RSH-së, duke u

⁷⁹ Kur një person ka shkruar një artikull në të cilin çënohet nderi dhe dinjiteti i një personi publik. Ai përipiqet ta botojë artikullin që ta bëjë publik, por nuk arrin ta bëjë një gjë të tillë pasi numri i gazetës në të cilin ai dëshironte ta botonte kishte kaluar në stampim. Në këtë rast themi se vepra penale e shpifjes ka mbetur në fazën e tentativës, pasi ajo nuk arriti të realizohej për shkakë të cilat nuk vareshin nga vullneti i subjektit të kryerjes së veprës penale.

⁸⁰ Shih: Marsela Pepi, *vepër e cituar*, fq. 33

⁸¹ Shih: *La notion du commencement d'execution-determination et repression*, e disponueshme në faqen web: <https://www.doc-du-juriste.com/droit-prive-et-contrat/droit-penal/dissertation/notion-commencement-execution-451876.html>, konsultuar në shtator 2017.

⁸² Për më tepër referoju: Skënder Kacupi, *Tentativa, fazë e kryerjes së veprës penale*, Shtypshkronja ILAR, Tiranë 2007, fq. 44-45

shfaqur si një tejkalim jurisprudencial. Dimensioni i tejkalimit jurisprudencial është shfaqur në disa raste dhe për këtë ka, ka patur jo pak debate, përsa i përket cilësimit ligjor të faktit veprë penale në rastet kur objekti material⁸³ sekuestrohet nga policia gjyqësore përpara kalimit të kufijve shtetërorë.⁸⁴ Kolegji penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar në raste të tilla, se vepra penale do të konsiderohet e konsumuar. Një qëndrim i tillë eviton haptazi hipotezën e tentativës së veprës penale respektive.⁸⁵ Kjo zgjidhje, megjithëse një tendencë drejt një prirjeje unifikative, i dha shtysë më tepër debatit shkencor, i cili për hir të së vertetes gjën mjedisin ideal në qëndrimet e kundërta. Referuar aspekteve doktrinare të konceptit, pas një spiraleje qëndrimesh gjyqësore, një pozicionim i tillë, shfaqet jo pak problematik sipas meje,⁸⁶ për të mos thënë aspak bindës. Vendimi i Kolegjit penal të Gjykatës së Lartë e RSH-së, më shumë krijon përshtjellim juridik sesa qartëson situatën interpretative. Veprat penale formale nuk duhet të jenë të dallueshme duke qenë thjesht dhe vetëm objekt interpretimi.⁸⁷ Pikësëpari në aspektin normativ, ato duhet të jenë formuluar në formën e tyre më të qartë nga pikëpamja e teknikës së inkriminimit, gjë e cila shpreh qartë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë vullnetin e vetë legjislatorit. Këtë vullnet për qartësi në teknikën e formulimit të dispozitës, nuk e konstatojmë në nivelin e duhur, respektivisht në nenet 283/a dhe 278/a të Kodit Penal të RSH-së.⁸⁸

5. BIBLIOGRAFIA

Jean-Claude Doucet, *Acte Preparatoire – Extraits de Dictionnaire de Droit Criminel*, i disponueshëm në faqen web: <http://axiome-x.tripod.com/ddcautresdelits/id27.html>, konsultuar në shtator 2017.

Garçon, *Code Penal Annote*, i disponueshëm në faqen w: <http://axiome-x.tripod.com/ddcautresdelits/id27.html>, konsultuar në shtator 2017.

Celine Bon, *L'Infraction de tentative en droit penal canadien et en droit penal francais-de la conciliation entre necessaire anticipation de la repression et l'exigence de culpabilitë morale*, Memoire, Universitë Laval 2017.

⁸³ Lënda narkotike ose armët p.sh.

⁸⁴ Në këto raste edhe organi i Prokurorisë nuk ka patur një qëndrim të qartë, të unifikuar dhe të pandryshuar.

⁸⁵ Qëndrimi i Kolegjit Penal të GJ.L. të RSH-se, kundërshton qëndrimin e mbajtur nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.

⁸⁶ Në kundërshtim me vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, shfaqet vendimi i trupës gjyqësore të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.

⁸⁷ Shih: Henrik Ligori, “Për kuptimin e tentativës në trafikimin e lëndëve narkotike dhe të armëve”, Jeta juridike nr.1, mars 2009, fq. 47

⁸⁸ Për më tepër shih: Henrik Ligori, *Vepër e cituar*, fq. 49

Ismet Salihu, *E Drejta penale, pjesa e pergjithshme*, Prishtinë 2015,
Ismet Salihu, Hilmi Zhitija, Fejzullah Hasani, *Kodi Penal i Republikës së Kosovës – Komentar*, Botimi i parë, Prishtinë 2014

Shefqet Muci, *E Drejta Penale-pjesë e përgjithshme*, Botimet Dudaj, Tiranë 2007

Dizionario Giuridico Romano, Edizioni Simone, 2006

F. Antolisei, *Manuale di diritto penale, parte generale*, XVI ed., Milano, 2003

F. Carrara, *Programma del corso di diritto criminale. Del delitto, della pena*, Bologna, 1993

Jean Francois Meylan, *Les actes preparatoires delictueux en droit penal Suisse, art. 260 Bis CP*, Lausannë 1990

Nazmi Peza, Ismet Elezi, Grigor Gjika, Aranit Çela, *E Drejta Penale e Republikës Popullore të Shqipërisë*, pjesa III-të, Tiranë 1976

Henrik Ligori “*Për kuptimin e tentativës në trafikimin e lëndëve narkotikëve dhe të armëve*”, Revista Jeta juridike nr.1, mars 2009

Caroline M. Pelsler, *Preparations to commit a crime. The Dutch approach to inchoate offences*, Utrecht Law Review, Vol 4, Issue 3, December 2008

Jean Deveze, *Le Commencement d'Execution de l'Infraction en Jurisprudence*, Revue de Science Criminelle et de Droit Penale Compare nr. 4 Octobre – Decembre 1981

Ligji nr. 98/2014, datë 31.07.2014 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995*”, “*Kodi Penal I RSH-se*”, i ndryshuar.

Ligji nr. 9686, datë 26.02.2007 “*Per disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995*”, “*Kodi Penal I RSH-se*”, i ndryshuar.

Ligji nr. 9275, datë 16.09.2004 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995*”, “*Kodi Penal I RSH-se*”, i ndryshuar.

Ligji nr. 8279, datë 15.01.1998 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995*”, “*Kodi Penal I RSH-se*”, i ndryshuar.

Victor Irengë Balemirwe, *De l'Incrimination de la Tentative en Droit*

Positif Congolais, e disponueshme në faqen web: https://www.memoireonline.com/05/10/3465/m_DE-LINCRIMINATION-DE-LA-TËNTATIVE-EN-DROIT-POSITIF-CONGOLAIS3.html, konsultuar në shtator 2017.

La notion du commencement d'execution-determination et repression, e disponueshme në faqen web: <https://www.doc-du-juriste.com/droit-prive-et-contrat/droit-penal/dissertation/notion-commencement-execution-451876.html>, konsultuar në shtator 2017.

Hajri Shehu, *Përgatitja dhe kuptimi juridik i saj, si fazë paraprake e kryerjes së krimit*, Drejtësia Popullore Nr. 4, viti 1988

Maksim Haxhia, *Disa vlerësime teorike dhe praktike lidhur me institutin e përgatitjes në krim*, Revista Drejtësia Popullore, Nr.2, viti 1984

Spiro Spiro, *Kuptimi i objektit të figurës së krimit*, Revista Drejtësia Popullore, Nr. 6 viti 1972

Niazi Jaho, *Përgatitja, tentativa dhe heqja dorë vullnetare nga kryerja e krimit*, Revista Drejtësia Popullore, Nr. 2 viti 1972

Lexique juridique–Iter criminis, i disponueshëm në faqen web: <http://www.droit.fr/lexique/index.php/term/Juridico,2769-iter-criminis.xhtml>

Ismet Salihu, *E Drejta Penale pjesë e përgjithshme*, Prishtinë 2005

Calewaert W C.J., *Belgisch Strafrecht*, 2 edition, Anvers, E. Story-Scientia, 1976

Trousse P., *Les principes generaux du droit penal positif*, Les nouvelles, droit Penal, Toome 1, Volume 1, Bruxelles, Larcier 1956, fq. 354, cituar nga Maureen Ganser ne: *La tentative punissable: Champ d'Application et peines. Presque une infraction accomplie?* Faculte de Droit de l'Universite de Liege, Belgique, Maitrise en Droit 2016–2017

Skënder Kacupi, *Tentativa, fazë e kryerjes së veprës penale*, Shtypshkronja ILAR, Tiranë 2007

Acte Preparatoire–Extraits de Dictionnaire de Droit Criminel de Jean – Claude Doucet, i disponueshem ne faqen web: <http://axiome-x.tripod.com/ddcautresdelits/id27.html>, konsultuar ne shtator 2017.

Kodi Penal i Republikës Popullore të Shqipërisë, Tiranë 1952

- Kodi Penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Tiranë 1977
- Kodit Penal i Cekoslllovakisë, i vitit 1950
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Prishtinë 2015
 “*Dizionario Giuridico Romano*”, Edizioni Simone, 2006, IV Edizione
- Marsela Pepi, *Tentativa, fazë e kryerjes së veprës penale*, Punim diplome i paraqitur për mbrojtje në Shkollën e Magjistraturës, Tiranë 2005
- Gjergj Sinani, *Hyrje në Filozofinë e Historisë*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë 1999
- Alain Prothais, *Tentative et attentat*, Paris 1985
- Agnes Cerf, *La loi du 5 Mars 2007 et les infractions de prevention: l'exemple du delit d'embuscade et de sa declinaison, le guet-apens*, e disponueshme në faqen web: <https://www.unicaen.fr/puc/images/crdf0613cerf.pdf>
- Caroline M. Pelsler, *Preparations to commit a crime. The Dutch approach to inchoate offences*, Utrecht Law Review, Vol 4, Issue 3, December 2008
- Skender Kacupi, *Tentativa, faze e kryerjes së veprës penale*, Shtypshkronja ILAR, Tiranë 2007
- Michael Molan, *Sourcebook on Criminal Law*, Cavendish Publishing Limited, 2001
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Tiranë 2016.
- Skender Kacupi, *Fazat e kryerjes së veprës penale*, Disertacion, Tiranë 1990
- A. Crespi, G. Zuccala, G. Forti, *Commentario breve al Codice Penale Italiano*, CEDAM, 2008
- Ferrando Mantovani, *Diritto penale, Parte generale*, Cedam 2016
- Giovanni Brichetti, *Il Delitto Tentato. Indagini*, 1965
- Cass.pen., Sez. II, 13 marzo 2012.
- Silvia Cacciotti, *Diritto Penale per tutti i concorsi*, Alpha Test 1 Edizione, 2005

Jonathan Kochel, *Le repentir en droit penal francais*, Memoire de Master II Recherche, Universite Paris II Pantheon–Assas, Bibliotheque Cujas,

Ioana Celina Pasca, *The Tendency of Criminalizing Preparatory Acts as Self-Standing Offences or Attempt to Commit an Offence*, J.E.E-Eur.Crim. L. 46 (2017), Heinonline.

Resolution Draft “*The Expanding Forms of Preparation and Participation*”, International Review of Penal Law, Vol 78, 2007/3.

Lexique juridique–Infraction Obstacle, e disponueshme në faqen web:<http://www.droit.fr/lexique/index.php/term/Juridico,2767-infraction-obstacle.xhtml>

Les actes préparatoires demeurent-ils encore hors du champ penal?, e disponueshme në faqen web: www.droit.univ-nantes.fr/m2dp/upload/word/Actes_preparatoires.doc

ALTERNATIVAT E DËNIMIT PENAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË TË KRAHASUARA ME SISTEMET PENALE BASHKËKOHORE

Dr. Adrian LEKA

Universiteti: “Luigj Gurakuqi”

“Fakulteti i Drejtësisë”

e-mail: leka-ad@live.com

ABSTRAKT

Historia e së drejtës penale shqiptare si pjesë e rëndësishme e historikut të organizimit shtetëror dhe social të popullit shqiptar është e lidhur mjaft ngushtë me rrethanat dhe faktorët midis të cilave është zhvilluar ky komb.

E drejta penale si domosdoshmëri e bashkekzistencës njerëzore dhe e ruajtjes së sigurisë publike është përpjekur në shekuj që qëllimet e saj të transmetohen me çdo kusht. Pra e drejta penale historikisht është parë si mjeti kryesor i arritjes së ekuilibrave të mirëkuptimit njerëzor. Duke manifestuar këto qëllime të larta, kjo e drejtë ka arritur të nxjerrë instrumentat e saj për procedimin dhe zbatimin e politikave social-antikriminale. Një nga këto instrumenta, ose ai më kryesor i është dënimi penal. Dënimi penal si institut penal që zë sot vendin primar përse i përket hartimit të politikave të parandalimit të krimit, është shndërruar në vetë nga një mjet i thjeshtë ndëshkues i drejtuar kundër një fajtori, në një element përbërës i praktikave të integritit dhe risocializimit të dënuarve. Por duhet thënë që dënimi penal megjithë formën e tij të përgjithshme ndëshkuese ka arritur të pësojë zbutje ose një fleksibilitet të dukshëm. Sigurisht që nuk duhet të kuptojmë me këtë që qëllimi i dënimit është zvogëluar. Një elasticitet të tillë të dënimit e shohim me aplikimin e alternativave të dënimit me burgim, ku një dënim më i rëndë ku plotësohen disa kushte e rrethana të caktuara arrin të konvertohet në një dënim më të butë. Sot në legjislacionet penale bashkëkohore alternativat e dënimit me burgim zënë një hapësirë të gjerë, duke e bërë sa më shumë të aplikueshme në praktikë. Parë në këndvështrim edhe Kodi ynë penal i ri arrin të përmbushë mjaft mirë qëllimet e larta integruese të dënimit penal. Ky kod për herë të parë në historikun e legjislacionet të së drejtës penale arrin të parashikojë dhe zërtheje gjerësisht alternativat e dënimit. Mirëpo duhet të jemi të ndërgjegjshëm që risija që solli ky Kod nuk është absolutisht e papërmirësueshme. Kjo për dy arsye, e para se akoma në shqiperi nuk është farkëtuar një sistem i qëndrueshëm i drejtësisë gjë që çon në mosaplikimin e saktë apo mosmarrjen parasysh të mjaft elementëve që na servira praktika jonë gjyqësore. Së dyti duhet thënë se edhe ligji penal mbi alternativën e dënimit ka akoma nevojë për inkorporimin e disa elementëve cilësor që traditat juridike sidomos e Common Law i ka të zhvilluara.

Fjalët kyçe: Alternativat e Dënimit, Dënimi Penal, Kodi Penal

1. Kuptimi i përgjithshëm i dënimit penal

Strukturat përbërëse të legjislacioneve penale bashkëkohore paraqesin një evolucion progresiv në teresi për institutet e të drejtës penale. Evolucion ky i cili është paraprirë nga debatet juridiko-shkencore për shumë vite me radhë duke lënë shtigje të lira edhe për më tej. Duhet nënvizuar se në këtë fushë juridike pozicion mjaft të rëndësishëm aq edhe të domosdoshëm zë instituti i dënimit penal. Dënimi penal ka inkadruar rëndësinë e tij si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik. Është dënimi penal që ka vlerë determinante mbi parandalimin dhe kufizimin e kriminalitetit. Në shumë legjislacione penale të shteteve të ndryshme si ato të tradites Common Law ashtu edhe ato kontinentale nuk kemi një përkufizim të mirfilltë të dënimit penal. Ndërsa në të drejtën penale shqiptare me miratimin e Kodit Penal të 1995 u përkufizua edhe dënimi penal. Me dënim penal do të kuptohet ajo masë shtrënguese që zbatohet nga shteti nëpërmjet gjykatave në bazë të ligjit kundër personave fajtorë që kanë kryer vepra penale. Në zbatimin e një politike të drejtë penale dhe specifikisht caktimin e një mase të drejtë dënimi gjykata duhet të udhëhiqet nga interesat sociale të publikut si dhe nga fryma e parimeve demokratike mbi liritë dhe të drejtat themelore të njeriut.

Zgjidhja e drejtë dhe proporcionale e çështjeve të përgjegjesisë penale dhe e sistemit të dënimeve si dhe organizimi i drejtë i vuajtjes së dënimeve ndihmojnë në luftën kundër kriminalitetit. Dënimi penal si masë reaguese ndaj një veprimi që binte në kundërshtim me normat e moralit social ka lindur me lindjen dhe organizimin e thjeshtë të shoqërisë njerëzore. Pra ky reagim ka qenë në funksion të fazës së zhvillimit të shoqërisë njerëzore. Duke u nisur nga ky zhvillim ekonomik-shoqëror i njerëzimit edhe reagimin ndaj veprave antishoqërore ka qenë në evolucion si në formë ashtu edhe në qëllim. Në fillesat e organizimit të shoqërisë njerëzore kemi të bëjmë me atë që quhet reagim të drejtëpërdrejtë ose reagim privat. Ky reagim ka qenë karakteristikë për shoqëritë primitive ku ndaj veprave kriminale reagonte vetë grupi ose individi personalisht. Kuptohet që në këtë fazë të zhvillimit të shoqërisë njerëzore mungonin institucionet shtetërore të sjelljeve dhe veprimeve të ndaluara nga shoqëria. Format e reagimit të kesaj shoqërie ishin:

a-dëbimi ose përzënia

b-hakmarrja ose gjakmarrja

c-shpagimi me dëmshpërblim ose kompozicioni

a. Me dëbim, kuptohet përzënia nga fisi apo familja i elementeve që kishin kryer vepra antishoqërore kundër interesave të fisit ose grupit. Në këtë periudhë ky dënim mund të barazohet me dënimin me vdekje. Duhet thënë se sjelljet negative ose cënimi i normave dhe vlerave morale të fisit nga individë të veçantë cilësohej jo vetëm si veprim që drejtohej kundër fisit apo klanit ku bënin pjesë por edhe kundër idhullit të tij. Prandaj personi që dëbohej shpesh bëhej flij. Kjo formë reagimi ka

ekzistuar edhe më vonë në mënyra të ndryshme. Veçojmë këtu që kjo ka qenë e pranishme edhe në të drejtën zakonore sidomos e shprehur më qartë në kanunin e Lekë Dukagjinit por gjithashtu edhe në vendet e tjera.

b. Hakmarrja dhe gjakmarrja

Kjo formë reagimi paraqitet si kthimi i të keqes së shkaktuar me një të keqe më të madhe. Gjakmarrja është formë e hakmarrjes (marrje e gjakut për vrasje). Ky reagim duhej të ishte me pasoja të rënda për palët kundërshtare. Ky qe qëllimi i hakmarrjes. Karakteristikë e kësaj mase reaguese është se nuk ekziston ndonjë proporcion ose ekuilibër ndërmjet cënimit të shkaktuar dhe të shkallës së reagimit ndaj tij.

Nje veçori tjetër e hakmarrjes është detyrimi i çdo anëtari të fisit që në mënyrë individuale ose kolektive duhet të hakmerret. Madje ky konsiderohet si detyrim i shenjtë duke u lënë edhe si amanet që ta plotësonin atë brezat e ardhshëm. Në kohët e mëvonshme kjo mënyrë reagimi fillon të modifikohet dhe të kufizohet si në aspektin e pasojave ashtu edhe në atë të personave që e kryejnë apo pësojnë atë. Hakmarrja nuk është më instiktive por kryhet sipas normave zakonore. Hakmarrja dhe gjakmarrja kanë vazhduar të ekzistojnë edhe pas krijimit të bërthamave të para shtetërore por duke përcaktuar rregulla më strikte midis dy palëve. Këtu do të përmendim midis të tjerash parimin e Talionit.

Ky parim ka mbizotëruar për një kohë të gjatë si mënyrë reagimi ndaj sjelljeve që cënonin moralin dhe sigurinë e fisit apo grupeve të shoqërisë. Vlen të theksohet se me parimin e Talionit shpërblimi për dëmin e pësuar kishte parametra ekuivalent.

c. Shpagim me dëmshperblim ose kompozicioni

Kjo formë reagimi është më e mëvonshme se dy të parat. Ajo synonte zëvendësimin e hakmarrjes me një zgjidhje që të kënaqte të dyja palët në një masë të konsiderueshme. Në këtë mënyrë synohej pajtimi ose lidhja ndërmjet fiseve. Procesi i zëvendësimit të këtyre masave ka qenë i gjatë dhe fillimisht ka ekzistuar për disa lloj deliktësh. Pavaresisht nga aplikimi i kësaj forme të re, hakmarrja dhe gjakmarrja kanë vazhduar të ekzistojnë për lloje të caktuara krimesh.

Shteti në fillimet e tij ka përdorur kompozicionin si formë reagimi madje e ka favorizuar atë për interesa financiare pasi mblidheshin taksa. Por kompozicioni në doktrinën penale theksohet se në disa fise nuk ka patur karakter kompensimi dhe dëmshperblimi material por më tepër ka patur karakter moral.

2. Elementët themelore të dënimit

Nga nocioni formal e material i dënimit del se ai posedon këto elementë themelorë:

a. sipas thelbit të tij dënimi duhet të parqesë vlerësim negativ moralo-etik ndaj veprës penale dhe autorit.

b. dënimi duhet të ketë qëllimin e caktuar i cili dëshirohet të arrihet me

ekzekutimin e tij. Qëllimi i përgjithshëm i dënimit është mbrojtja e shoqërisë dhe e qytetarëve prej veprave të rrezikshme me të cilat dëmtohen apo rrezikohen vlerat më të rëndësishme të individit dhe shoqërisë.

c. si masë e dhunshme dënimi duhet të paraqesë një të keqe e cila godet personin i cili ka kryer një vepër penale. Kjo e keqe konsiston në marrjen apo kufizimin e të mirave të caktuara juridike siç janë jeta, liria, pasuria etj. Ky është element retributiv i dënimit. Në krahasim me sanksionet e tjera penale retribucioni të dënimi është në formën më të theksuar.

d. dënimi duhet të jetë i përcaktuar në ligj. Ky është parimi i ligjshmërisë së dënimit që rrjedh nga maksima latine “Nulla poena sine lege”. Sipas këtij parimi autorit mund t’i jepet vetëm ajo lloj lartësie dënimi që është parashikuar me ligj për veprën penale konkrete. Parimi i ligjshmërisë paraqet garanci dhe mbrojtje të qytetarëve nga arbitrariteti eventul i organeve shtetërore. Përkatësisht cënimi i parimit të ligjshmërisë së dënimit nga ana e organeve shtetërore paraqet një nga shkeljet më të rënda të ligjit, dhe ndaj qytetarëve shkakton pasoja shumë të rënda të cilat shpesh herë janë të papërmirsueshme.

e. dënimi mund t’i drejtohet vetëm personave që kanë kryer vepra penale dhe janë të përgjegjshëm. Për këtë arsye dënimi mund t’i jepet vetëm atyre personave të cilët në kohën e kryerjes së veprës penale kanë qenë të përgjegjshëm dhe fajtorë. Kjo nga fakti se vetëm personi penalisht i përgjegjshëm mund ta përjetojë dënimin si një të keqe e cila godet për shkak të veprës së dëmshme që ka kryer dhe vetëm ndaj personit të këtillë, dënimi mund të ketë efekt që ai në të ardhmen të mos kryejë më vepra penale.

f. dënimin mund ta japë vetëm ai organ i specializuar shtetëror që është i autorizuar publikisht për zgjidhjen e çështjeve të tilla. Ky organ është Gjykata, e cila jep dënimin në bazë të një procedure rigorizisht të përcaktuar. Asnjë organ tjetër sot në legjislacionet bashkëkohore nuk lejohet të japë dënime penale.

g. dënimi jepet vetëm kur kryhet një veprim ose mos veprim të cilin ligji shprehimisht e përcakton si vepër penale. Kjo rrjedh nga parimi tjetër i rëndësishëm latin “Nullum crime sine lege”.

Elementët që radhitëm më lart të dënimit janë të natyrës konstituive. Në mungesën e vetëm njërit nga këto elementë nuk mund të ketë dënim në kuptimin e mirëfilltë të së drejtës penale. Nga kjo rezulton se pa përjashtim çdo dënim duhet me doemos t’i posedojë të gjitha elementët e prekura.

2.1 Karakteristikat themelore të dënimit

Duke u nisur nga elementet konstituive si dhe funksionimin që duhet ta ushtrojë dënimi, e drejta penale bashkëkohore i përcakton edhe disa karakteristika apo tipare që duhet të përmbushen me rastin e vendimit dhe zbatimit të tij. Këto tipare themelore të dënimit konsistojnë në sa vijon:

a. Dënimi duhet të jetë personal. Ndryshe nga të drejtat penale primitive sipas të cilave dënimi e ka goditur jo vetëm autorin e veprave penale por edhe të afërmit

e tij, antarët e familjes apo fisit të tij, sipas të drejtave penale sot dënimi duhet të jetë personal. Kjo do të thotë që dënimi duhet të godasë vetëm autorin e veprës penale dhe jo personat e tjerë. Mirëpo duhet theksuar se përkundër këtij parimi dhe synimeve të politikës ndëshkuese bashkëkohore që të përmbushet ky kusht që dënimi duhet të jetë personal, të godasë vetëm autorin edhe sot pothuajse çdo dënim në një formë dhe mase godet edhe personat e tjerë, sidomos antarët e familjes. Duhet ta kemi të qartë se nuk kemi të bëjmë me një veprim direkt por në mënyre indirekte ai vepron shumë rëndë në moralin dhe psikologjinë e të afërmeve karshi shoqërisë që i shikon veprat penale si sëmundje të këqija të saj.

b. Dënimi duhet të jetë legjitim. Rrjedhimisht për të qenë një dënim i drejtë duhet të jetë edhe legjitim. Dënimi është legjitim vetëm nëse gjyqi vendos atë lloj lartësie dënimi i cili është i domosdoshëm për mbrojtjen e shoqërisë nga kriminaliteti dhe për përmirësimin e fajtorit. Lidhur me këtë është mjaft përshtypjëlënës konstatimi vijues i penologeve të sotëm “Një represion që nuk është i preokupuar me risocializmin e delikuentit bën një punë të kotë dhe jo humane”. Dhe pikërisht nëqoftëse do të jepeshin dënime dragoniane të cilat në masë të theksuar kanë tipare retributive dhe shprehin hakmarrje, edhe urrejtje ndaj delikuentit, atëherë ato dënime nuk janë legjitime dhe në brendinë e tyre janë edhe kundraligjore.

c. Dënimi duhet të jetë proporcional me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të autorit. Me këto tipare përmbushet edhe postulati i drejtësisë së dënimit, Përpjestueshmëria dhe drejtësia e dënimit shprehen duke marrë parasysh jo vetëm peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale por edhe rrethanat e tjera objektive dhe subjektive siç janë veprimtaria jetësore e mëparshme e autorit, sjellja pas kryerjes së veprës penale, rrethanat në të cilën është kryer vepra penale, gjendja e tij në momentin e kryerjes penale etj.

d. Dënimi duhet të jetë human. Kjo do të thotë se dënimi nuk duhet të manifestojë mundim dhe përbuzje të rëndë ndaj delikuentit si dhe nuk duhet të shkaktojë dëmtimin e shëndetit të tij. Në këtë drejtim edhe legjislacioni i sotëm botëror madje edhe ai shqiptar garanton respektimin e personalitetit dhe dinjitetin e njeriut në procedurën penale, dhe gjate fazës së ekzekutimit të dënimit në entet penitenciare. Duhet të veçojmë se këtu disa konventa ndërkombëtare që u referohen lirive dhe të drejtave të njeriut ndaj qytetarit siç janë Deklarata e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut dhe Pakti Nderkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike ku parashikohen edhe norma mbi të cilat kërkohet që dënimi të jetë human.

e. Dënimi brenda kuadrit të nevojshëm ligjor që lejojnë individualizmin e dënimit duhet të godasë njësoj autorët e veprave penale pa u marrë parasysh përkatësi nacionale, fetare, racore, sociale, politike etj. Kjo karakteristikë e dënimit në fakt konsiston në realizimin e parimit të barazisë së qytetarëve para ligjit dhe gjyqit dhe në realizimin e politikës ndëshkuese unike. Kjo çështje është posaçërisht e rëndësishme në të dejtat penale bashkëkohore sepse në legjislacionet penale në fuqi sanksionet penale në kuadrin e tyre dhe dënimet janë si të themi të parashikuara

saqë gjykatave u japin autorizime të drejtpërdrejta lidhur me zgjedhjen e llojit dhe masës së dënimit që mund t'i jepet autorit të veprës penale. Ky tipar implikon në vetë kërkesën që autorit të veprës penale identike të dënohen me dënime identike. Në të kundërtën nëse vijnë në shprehjen zgjidhje kontradiktore në fushën e politikës ndëshkuese ndër vendime të të njëjtës gjykatë apo atyre të krahinave të tjera të shtetit, për të njëjtat vepra të kryera nga autorët të ngjashëm, atëherë ky është shembull i pabarazisë së qytetarëve në jurisprudencën penale.

f. Dënimi penal duhet të jetë i ndarë. Dënimi është i ndarë nëse ai mund të vendoset në masë më të vogël apo më të madhe varësisht nga pesha e veprës penale, rrethanat në të cilat ajo është e kryer dhe e rrezikshmerise se autorit të veprës penale. Kjo karakteristike shprehet qartë te denimi me heqje të lirisë dhe tek denimi në formë gjobe por jo tek dënimi me vdekje.

g. Dënimi duhet të jetë i revokueshëm, përkatesisht në rastet kur konstatohet se dënimi është dhënë në kundërshtim me ligjin për të lajthimit juridik të gjykatës të provave të pabazuara, apo daljen e fakteve dhe rrethanave të reja të tilla që rrëzojnë katërcipërisht me vendimin e dhënë, ai duhet të abrogohet. Kjo karakteristike mund ti atribohet të gjitha llojeve të dënimit me përjashtim të atij me vdekje nëse është ekzekutuar.

h. Dënimi duhet të jetë i përmirsueshem. Karakteristike kjo që duhet të shprehet në rastet kur dënimi është dhënë në kundërshtim me ligjin për shkak të dëshmise së rreme apo ndonjë rrethanë tjetër. Dënimet pasurore janë të përmirsueshme mirëpo denimi me vdekje nëse është ekzekutuar nuk mund të ketë vlerë përmirsuese më. Gjithashtu për shkak të pasojave të shumta dhe natyrës së ndryshme pas shumicës së studiuesve të së drejtës penale edhe dënimi me burg i cili pjesërisht apo në tërësi është ekzekutuar nuk mund të përmirsohet ngaqë të dënuarit nuk mund t'i kthehet liria gjatë asaj kohe sa ka qëndruar në burg. Kompensimi në të holla që zakonisht jepet për këto raste më tepër ka karakter të dëmshpërblimit material, dëmshpërblim ky i cili nuk mund të eliminojë të gjitha pasojat e shkaktuara nga dënimi me burg. Duke e mbyllur këtë analizë të përgjithshme mbi dënimin kemi arritur të krijojmë vizion kompleks si për sa i përket shkaqeve dhe qëllimit mbi dënimin ashtu edhe për përbërësit strukturorë të nocionit dënim.

Ndoshta u zgjatëm pak ne trajtimin e këtij aspekti duke filluar që në hapat e para të dënimit apo ndëshkimit drejt evolucionit të sotëm në këtë drejtim. Por më duket e papërshtatshme që të mund të shqyrtojmë llojet e dënimit sot dhe alternativat e tij duke mos paraqitur një kornizë teorike-historike të punuar në vite. Në bazë të kësaj analize arrijmë në konkluzionin se kur të kuptojmë qartë dhe pa ekuivoke të kaluara qëllimin e ndëshkimit penal duke prekur thelbin e tij autentik atëherë do të mund të realizojmë një dënim efektiv duke alternuar midis formave konkrete për sa i përket rrethanave në realizimin e asaj që sot ndërjegjësisht jemi larg. Pra shërimin e shoqërisë nga kriminaliteti shumë-anësh.

3. Kuptimi i alternativave të dënimit

Hartimi i legjislacionit penal demokratik imponon kërkesën për përfshirjen në të të instrumentave ligjore që ndihmojnë shumë në rolin ndëshkues të dënimit të dhënë nga gjykata, duke ju përshtatur një sërë faktorëve dhe rrethanave që nuk mund të pranohet ashpërsinë e dënimeve klasike. Kjo do të rriste në maksimum karakterin human të ligjit por gjithashtu do të ndikonte në nivele të konsiderueshme mbi qëllimin përmirësues të dënimit.

Me fjalë të tjera ligji penal ka shumë nevojë për fleksibilitet juridik duke i dhënë një ndihmë të konsiderueshme edhe organeve gjyqësore. Ky fleksibilitet arrihet duke përdorur jo vetëm dënime të përcaktuara qartë dhe ngurtësisht por edhe duke krijuar në qoftëse mund të shprehemi kështu një amalgamë juridike që rrjedh nga marrja e elementeve cilësore të disa lloje dënimesh gjithnjë duke ruajtur karakterin e qëndrueshëm të dënimit penal.

Pra mund të themi se ky elasticitet ndërmjet llojesh të dënimeve na çon para asaj që quhet alternativë e dënimit. Duhet ta kemi të qartë se me alternativë nuk duhet të kuptojmë nocionin e gjerë të këtij termi pra për një vepër penale mund të zgjedhësh dënim me burgim ose gjobë, sepse këtë zgjedhje e përcakton ligji pa shumë rrëshqitje. Por kemi të bëjmë me një proces i cili na lejon që brenda një lloji dënimi të përcaktuar qartë të mund të shkëpusim disa elementë të tjerë juridiko-penal duke ndërtuar kështu një formë të qëndrueshme penale me tipare krejtësisht ndëshkuese, por mënyrat e ekzekutimit të saj të përbajnë në thelb atë që ne e quajmë riintegrim të moralit shoqëror të autorit të veprës penale.

Sot këtë ndërveprim e shohim shumë të qartë në dënimin me burgim që është dhe kjo një formë dënimi relativisht e re në krahasim me të tjerat. Por çfarë do të kuptonim me alternativë të dënimit? Këtu gjërat mund të komplikohen vetëm për sa i përket përkufizimeve fikse që doktrina dëshiron sepse praktika gjyqësore dhe se fundi ligji penal e kanë përkrahur pa kërkuar shumë qartësira juridike.

Duke përmbledhur atë që thamë me lart për alternativën e dënimit me burgim do të jepja këtë përkufizim: me alternativë dënimi me burgim do të kuptojmë ato dënime të dhëna nga gjykata për vepra kur ligji vë kriteret të dallueshme të cilat qëndrojnë brenda kuadrit të dënimeve me burgim por për shkak të rrethanave të caktuara psikologjike, morale, familjare, mënyra e ekzekutimit të tyre nuk rregullohet rigorozisht me anë të izolimit të zakonshëm.

Në radhë të parë duhet të përmendim një fakt të rëndësishëm se alternativa e dënimit nuk është përjashtim nga dënimi. Ky aspekt duhet të jetë mëse i qartë. Në bazë të këtyre alternativave gjykata cakton masën e dënimit sipas rregullave të përgjithshme të përcaktuara shprehimisht në ligj. Ndërsa vuajtjen e dënimit gjykata e kushtezon me një sërë faktorësh prezent si dhe me mënyrën si do të silllet në të ardhmen autori. Pra kemi të bëjmë me nocione të përcaktuara saktë. Por duhet të shtoj se ka edhe ndryshime të rëndësishme për sa i përket mënyrës së marrjes së këtij vendimi si dhe formës së ekzekutimit në lidhje me dënimet e

tjera fikse. Përsa i përket mënyrës së marrjes së vendimit ndryshe nga dënimet e tjera gjykata ka akses më të gjerë në dhënien e këtyre dënimeve. Sepse megjithëse ligji vendos kritere rigide për këto raste përsëri roli i gjykatës është vendimtar në analizimin dhe përcaktimin e rrethanave të caktuara që bën të nevojshëm marrjen e një vendimi me karakter të tillë. Këto rrethana mund të jenë nga me të ndryshmet, me karakter shëndetësor, familjar, profesional, moral ku gjykata duhet të vendosë rast pas rasti se kur përmbushen elementët e dobishmërisë relative për dhënien e një alternative të dënimit me burgim. Ndërsa lidhur për formën e ekzekutimit të dënimit këtu kemi një ndryshim kryesor në lidhje me mënyrën e ekzekutimit sepse megjithëse alternativa e dënimit me burgim për sfond juridik ka dënimin me heqje lirie, ekzekutimi i dënimit shumë larg kësaj forme klasike bëhet duke u ekzekutuar në mënyrë origjinale larg izolimit tradicional.

3.1 Nocioni i dënimit me kusht

Dënimi me kusht është pezullimi i ekzekutimit të dënimit të vendosur për një kohë të caktuar dhe me kushte të caktuara. Ky është një lloj sanksioni parapenal. Nëse personi i dënuar me kusht nuk kryen veprën penale të re brenda afatit të caktuar dhe nëse i përmbush kushtet të cilat ja ka caktuar gjykata dënimi i dhënë nuk do të ekzekutohet, kurse personi i këtillë nuk do të konsiderohet i dënuar. Në të kundërtën nëse personi i dënuar me kusht gjatë afatit të pezullimit të këtij vendimi, kryen veprën të re penale apo nuk i përmbush kushtet e tjera të dënimit me kusht ky lloj i sanksionit penal do të revokohet dhe personi i dënuar me kusht do të detyrohet të mbajë dënimin.

Në brendinë e tij dënimi me kusht konsiston në faljen me kusht të dënimit ndaj autorit të veprës penale nga ana e shoqërisë. Kjo është falje e mbështetur në bindjen se autori i veprës penale në të ardhmen do të respektojë ligjin dhe nuk do të kryejë vepra penale. Dënimi me kusht si lloj sanksioni i posaçëm penal është paraqitur në shekullin e XIX-të si rezultat i njohurive se një numer i personave që i kanë dënuar gjykatat kanë kryer vepra penale më pak të rrezikshme për shoqërinë si dhe persona të cilët kanë kryer veprën për herë të parë dhe të cilët veprën penale e kanë kryer për shkak të gjendjes së vështirë materiale apo të efektit momental të mendjelehtësisë apo pamaturisë së tyre. Dënimi me kusht për herë të parë është paraqitur në SH.B.A.dhe në Angli. Ky lloj sanksioni u paraqit nën ndikimin e lëvizjes për zëvendësimin e dënimeve afatshkurtra me burg. Qëllimi i dënimit me kusht është risocializimi i delikuentit me anë të pezullimit të dënimit. Me anë të dënimit me kusht në fakt autorët e veprës penale i tërhiqet vërejtja seriozisht dhe me anë të këtij dënimi bëhet me dije se nëse kryen veprën penale tjetër dënimi i pezulluar për një kohë të caktuar do të ekzekutohet. Ky lloj sanksioni penal paraqitet si metodë e posaçme psikologjike-pedagogjike me atributet e kërcënimit në luftë kundër kriminalitetit. Për nga natyra e tij dënimi me kusht është i përshtatshëm të jepet në vend të vendimit afatshkurtër me burg për delikuentët e rastit e në përgjithësi për autorët e veprave penale të lehta.

3.2 Sistemet e dënimit me kusht

Në legjislacionet penale janë të njohura tre sisteme të dënimit me kusht, sistemi anglo amerikan, sistemi evropian kontinental dhe sistemi i përzier.

1. *Sistemi anglo amerikan* është paraqitur në disa shtete të amerikës veriore dhe në angli në “fund të shekullit XIX - të si formë e zëvendësimit të dënimit me burg. Së pari ky sistem i dënimit me kusht është parashikuar për autorët e mitur të veprave penale e më pas për autorët e rritur. Si karakteristikë e këtij sistemi është se ndaj autorit të veprës penale zhvillohet procedura penale, konstatohet fajësia e tij, mirëpo, nuk i jepet dënimi. Dhënia e dënimit pezullohet për një kohë të gjatë dhe caktohen kushtet që duhen përmbushur. Gjithashtu personi i këtillë gjatë kohës së pezullimit të dhënies së dënimit vihet nën mbikqyrje të posaçme të cilën e ushtron personi zyrtar i emëruar nga ana e gjykatës. Nëse autori gjatë kohës që cakton gjykata nuk kryen vepër të re penale dhe nëse i përmbush kushtet e tjera të caktuara nga ana e gjykatës dënimi nuk do të jepet fare. Gjithashtu me skadimin e kohës gjatë së cilës personi i dënuar me kusht ka qenë në sprovë, pushon çdo mbikqyrje të cilën e kanë ushtruar persona zyrtarë.

2. *Sistemi evropian kontinental* është paraqitur në fund të shekullit XIX së pari në Belgjikë dhe në Francë dhe për atë që quhet edhe sistem belgo - francez. Më pas ky sistem përvetsohet edhe në shtetet e tjera të Europës. Karakteristikë e këtij sistemi të dënimit me kusht është se autorin e veprës penale gjyqi e shpall fajtor dhe ia jep dënimin, mirëpo dënimin e dhënë nuk e ekzekuton, këtë e pezullon për një kohë të caktuar me kusht që autori gjatë kësaj kohe të mos kryejë vepër penale të re, dhe t’i përmbushë kushtet e tjera të cilat gjyqi mund t’ia caktojë në vendimin e dënimit. Ndryshe nga sistemi anglo - amerikan, në sistemin evropiano-kontinental, gjatë kohës së provës, të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me kusht, autorit të veprës penale nuk i caktohet kurrfarë mbikqyrjeje, këshille apo ndihmë. Kjo karakteristikë e sistemit evropian kontinental, e dënimit me kusht konsiderohet si e metë e madhe ngaqë personi i dënuar me kusht lihet në teresi pa kurrfarë ndihme dhe për këtë shkak mund të hasë në të tilla rrethana dhe vështirësi të cilat mund të kontribuojnë që ky sërish të kryejë vepra penale. Megjithatë edhe në disa vende të europës kontinentale parashikohet ashtu si në vendet Common Law një pezullim i shpalljes së dënimit. Dhe ky pezullim lihet me qëllim të posaçëm për të parë reagimin e të akuzuarit më pas.

3. *Sistemi i përzier*, duke pasur parasysh përparësitë e dy sistemeve më lart përmendura të dënimit me kusht legjislacionet e shteteve të ndryshme të europës që nga fillimi i shekullit XIX-të e përvetësojnë një sistem të përzier i cili përmban si elementë të sistemit kontinental ashtu edhe elementë të sistemit anglo-amerikan. Sipas këtij sistemi të përzier ndaj autorit të veprës penale zhvillohet procedura penale, i jepet dënimi dhe pezullohet ekzekutimi i tij, por gjykata mund t’i caktojë edhe masë të posaçme të mbikqyrjes për një kohë të caktuar. Në këtë sistem të përzier të dënimit me kusht evitohen të metat e sistemit kontinentalo-evropian dhe përvetësohen avantazhet e sistemit anglo - amerikan.

4. Parimi i individualizimit të dënimit

4.1 Nocioni dhe rëndësia e individualizimit të dënimit

Me individualizim të dënimit nënkuptohet përshtatja e dënimit të veprës penale dhe autorit të saj. Qëllimi i individualizimit është që të jepet ai dënim i cili në mënyrë më efektive do të ndikojë në riedukimin e autorit të veprës penale. Të drejtat penale të vjetra nuk e kanë njohur institucionin e individualizimit të dënimit. Individualizimi i dënimit në të drejtën penale për herë të parë është paraqitur në Kodin Penal të Francës të vitit 1810. Përkatësisht sipas Kodit Penal të mëparshëm të Francës të vitit 1790 dënimet kanë qenë të përcaktuara në mënyrë absolute, sipas sistemit absolut ligjor të dënimit. Siç kemi parë edhe shkolla nuk ka njohur institucionin e individualizimit të dënimit. Sipas botëkuptimit të kësaj shkolle lartësia e dënimit varet vetëm nga pesha e veprës penale. Matja e kësaj e dënimit ka passur për qëllim që t'i ndëshkojë njësoj të gjithë autorët e veprave penale dhe në këtë mënyrë ka pretenduar të jetë e drejte. Mirëpo në praktikë kjo mënyrë e matjes së dënimit është treguar jo e drejtë dhe si ndëshkim jo i barabartë edhe në rastet kur pesha e veprave penale konkrete ka qenë i njëjtë ngase ato i kanë kryer personat e ndryshëm nga motive dhe rrethana të ndryshme. Këto fakte i kanë detyruar ligjvënësit që ta braktisin sistemin absolut të dënimeve dhe ta përvetësojnë sistemin relativ të caktimit të dënimeve, sistem ky i cili do t'ia bëjë të mundur gjykatës që brenda kufijve të caktuar me ligj t'ia përshtasë dënimin peshës së veprës dhe autorit të saj. Meritë të veçantë për futjen e individualizimit të dënimit në të drejtën penale ka shkolla pozitive dhe sociologjike.

4.2. Metodatat e individualizimit të dënimit në të drejtën penale

E drejta penale i kushton rëndësi të posaçme individualizimit të dënimit. Legjislacioni penal parashikon një varg dispozitash për zbatimin e individualizimit të dënimit në praktikë. Rrjedhimisht ligji penal në pjesën e posaçme përcakton llojet dhe minimumin dhe maksimumin e dënimit për çdo vepër penale veç e veç. Kësisoj duke i përcaktuar llojet e dënimeve dhe kufijte brenda të cilëve gjykata mund të vendosë, është pretenduar të evitohet arbitrariteti i gjykatës dhe, të sigurohet ligjshmëria dhe në të njëjtën kohë i është bërë e mundur gjykatës që të jetë aktive në matjen e dënimit duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat konkrete të veprës penale dhe autorit të saj. Në funksion të individualizimit të dënimit, ligji penal parashikon edhe dispozita të veçanta për këtë qëllim. Kësisoj në mjaft legjislacione demokratike si ato të Common Law, ashtu dhe në rastin e caktimit të dënimit duhet t'i marrë parasysh rrethanat objektive dhe subjektive në të cilat është kryer vepra penale. Madje krahas rregullave të përgjithshme këto legjislacione parashikojnë edhe rregulla të posaçme me të cilat në një sërë çështjesh gjykata autorizohet që autorit të veprës penale t'ia zbusë dënimin. Gjithashtu e drejta penale në përgjithësi e ka përvetësuar konceptin së individualizimi i dënimit duhet të bëhet edhe gjatë

fazës së ekzekutimit të dënimit. Kjo nga fakti se vetëm me individualizimin e dënimit gjatë caktimit të dënimit dhe ekzekutimit të tij mund të realizohet qëllimi i dënimit. Në këtë drejtim ligji penal e më tepër ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, parashikojnë një varg rregullash me të cilat përcaktohet mënyra e ekzekutimit të dënimit dhe individualizimit gjatë fazës së ekzekutimit.

4.3. Rrethanat lehtësuese dhe rënduese

Matja ose caktimi i dënimit nga ana e gjykatës bëhet brenda minimumit dhe maksimumit të dënimit të parashikuar në ligj për ato vepra penale si dhe nën ndikimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese.

Në mesin e rrethanave që i parashikon ligji penal gjenden rrethanat objektive që i referohen autorit të veprës penale. Me rrethana rënduese nënkuptojmë ato rrethana të cilat ndikojnë që dënimi të jetë më i rreptë brenda kufijve të paraparë me ligj për atë vepër penale.

Ndërsa me rrethana lehtësuese nënkuptojmë ato rrethana të cilat ndikojnë që dënimi të jetë më i butë gjithashtu brenda kufijve të përcaktuar me ligj. Siç theksuam më sipër legjislacionet penale bashkekohore prekin vetëm në menyre ekzemplare rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat më së shpeshti ndodhin dhe të cilat janë më tipike, kështu që gjykatës i është lënë mundësia që me rastin e matjes së dënimit të marrë parasysh edhe rrethana të tjera për çdo rast konkret.

Me aq sa kemi vënë re rrethanat rënduese dhe lehtësuese sipas legjislacioneve të ndryshme janë të ndryshme. Kuptohet kjo për vetë traditën dhe parimet të cilat frymëzohen këto sisteme penale, megjithatë shohim se elementët thelbësorë që përbejnë këto rrethana janë pak a shumë të njëjtë në të gjitha legjislacionet që ecin mbi shinat e parimeve demokratike.

Dhe pikerisht këto elemente të përbashkët janë:

a. Shkalla e përgjegjësisë penale e cila ndikon në caktimin e dënimit. Shkalla e përgjegjësisë penale permban në vete shkallen e përgjegjësisë dhe të fajësisë. Meqë përgjegjësia dhe fajësia si elementë të përgjegjësisë penale mund të shkallëzohen, edhe përgjegjësia penale mund të shkallëzohet, kështu në përgjegjësi. Kështu në përgjegjësinë penale mund të ndikojnë rrethanat se autori veprën e ka kryer me dashje direkte apo indirekte, nga pakujdesi në formë neglizhence apo vetbesim i tepruar. Prej shkallës së përgjegjësisë dhe llojet e fajësisë varet se a do të jepet masë më e vogël apo më e madhe dënimi.

b. Motivet nga të cilat është kryer vepra penale janë shkaqet psikike të cilat e kanë shtyrë personin të kryejë një vepër penale. Kjo rrethanë mund të merret parasysh në rastin e caktimit të dënimit vetëm nëse nuk është element përbërës i figurës së veprës penale. Kjo nga fakti se një rrethanë e njëjtë nuk mundet dy herë të merret parasysh për caktimin e dënimit më parë nga ligjvënësi dhe më pas nga gjykata. Motivet mund të jenë të natyrës së dobët, siç janë p.sh. urrejtja, shpifligësia, egoizmi, hakëmarria, xhelozia që zakonisht quhen motive të dobëta,

dhe këto raste këto motive konsiderohen si rrethana rënduese. Mirëpo motivet nga të cilat kryhen veprat penale mund të jenë dhe pozitive ose humane si p.sh nga dhembshuria, nga dashuria, nga ndjenja e obligimit apo e nderit etj. Dhe në këto raste këto motive konsiderohen si rrethanan lehtësuese.

c. Jeta e mëparshme dhe rrethanat personale të autorit janë gjithashtu të rëndësishme për çmuarjen e peshonalitetit të autorit fajtor, dhe rrezikshmerise se tij shoqërore, kështu p.sh. nëse një person në jetën e tij të mëparshme ka pasur sjellje korrekte dhe ka qenë shembull për të mirë në mjedisin e tij, tregojnë se autori nuk është moralisht i prishur dhe se me zbatimin edhe të dënimit më të butë mund të arrihet qëllimi edukues i ligjit të dënimit. Në të kundërtën nëse autori i veprës penale ka qenë edhe më parë i dënuar, (recidivist), apo nëse ka bërë jetë parazitike siç janë bixhozi, papunësia, bredhja pa orar etj atëherë këto veti do t'i merren si rrethana rënduese me rastin e caktimit të dënimit, ngaqë tregojnë qartë se për t'u arritur qëllimi i dënimit duhet dhënë lloji dhe mase dënimi më të rëndë.

d. Sjellja e autorit pas kryerjes së veprës penale gjithashtu është me rëndësi për caktimin e masës së dënimit. Kjo nga fakti se sjellja e autorit të veprës tregon jo vetëm qëndrimin e autorit të veprës penale ndaj veprës së vet por edhe çfarë sjellje do të ketë në të ardhmen. Kësisoj pranimi i kryerjes së veprës penale, gjithashtu është me rëndësi për caktimin e masës së dënimit. Kjo nga fakti se sjellja e autorit të veprës tregon jo vetëm qëndrimin e autorit të veprës penale ndaj veprës së vet por edhe çfarë sjelljeje do të ketë në të ardhmen. Kësisoj pranimi i kryerjes së veprës penale apo mohimi kategorik i veprës penale edhe për kundër provave të pa kontestueshme, mandej pendimi real apo kënaqësinë që tregon se e kam kryer veprën penale, dhënia e ndihmës viktimës dhe familjes së tij etj. janë rrethana që medoemos ndikojnë që të jepet dënim më i butë apo më i rreptë.

e. Intesiteti i rrezikimit apo i dëmtimit të mirës së mbrojtur është rrethanë objektive e cila tregon shkallë më të madhe apo më të vogël të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe si e tillë ndikon në caktimin e dënimit. Meqë vepra penale konsiderohet se është kryer duke dëmtuar apo duke rrezikuar marrëdhënjen juridike të caktuar dënimi do të jetë më i rreptë apo më i butë, në vartësi prej faktit se a është dëmtuar apo rrezikuar e mira juridike.

f. Rrethanat në të cilat është kryer vepra penale mund të jenë të natyrës objektive dhe subjektive dhe mund t'i referohen veprës penale, autorit të saj si dhe subjektit pasiv të veprës penale. Këto rrethana mund t'i përkasin kohës, mjeteve, mënyrës dhe vendit të kryerjes së veprës penale, dhe disa gjendjeve psikike të autorit dhe viktimës, raporteve të tyre etj. Që mund të merren parasysh këto rrethana si lehtësuese apo rënduese, është e nevojshme që ligjvënësi të mos i ketë para parë si të këtille në figurën e veprës penale.

g. Gjendja pasurore e autorit zakonisht nuk ndikon në matjen e dënimit sipas parimit se dënimi duhet të godasë njësoj qytetarët e varfër. Mirëpo për të mundur ti godasë dënimi në të holla, njësoj të gjithë qytetarët duhet pasur patjetër parasysh gjendjen materiale të autorit. Se a do ta godasë më lehtë apo me rëndë dënimi në

të holla ndonjë person, varet prej gjendjes materiale. Kështu që gjykata është e detyruar që dënimin në të holla ta mase jo vetëm sipas peshës së veprës penale dhe rrethanave të tjera, por edhe sipas mundësisë pasurore të autorit.

4.4. Zbutja e dënimit

a. Rrethanat lehtësuese dhe rënduese mund të kenë ndikim në matjen e dënimit vetëm brenda minimumit dhe maksimumit të dënimit të përcaktuar me ligj për atë vepër penale. Mirëpo në jetën e përditshme mund të kryhen vepra penale në rrethana të tilla të cilat veprën e bëjnë veanërisht të lehtë. Në raste të tilla caktimi i dënimit brenda kufijve të minimumit dhe maksimumit të posaçëm nuk do të ishte në pajtim me parimin e drejtësisë dhe nuk do ti përgjigjej qëllimit të dënimit, kështu dënimi do të ishte i rreptë. Mundësia e zbutjes së dënimit parashikohet zakonisht edhe në dispozitat e posaçme duke lënë mundësi të tillë për kategori veprash të caktuara.

b. Zbutja e dënimit sipas bindjes së gjykatës është e lejuar me ligj shprehimisht. Përkatësisht me dispozitat përkatëse ligji në disa raste të veprave penale të kryera veçanërisht në rrethana lehtësuese e autorizon gjykatën që edhe të ja zbusë dënimin sipas cmuarjes së lirë. Këtë mundësi gjyqi do t'a shfrytëzojë në rastet kur konstaton se ekzistojnë të tilla rrethana objektive dhe subjektive të cilat tregojnë qartë se edhe me dënim të butë apo me lloje më të buta dënimi do të, arrihet qëllimi i ndëshkimit. Kjo mënyrë e zbutjes së dënimit është e karakterit të institutit të përgjithshëm.

4.5. Lirimi nga denimi

Në të drejtën penale është parim se çdo person që kryen vepër penale dhe që është penalisht i përgjegjshëm duhet të dënohet. Mirëpo për kundër këtij parimi në disa raste mund të ndodhë që gjykata të konstatojë se është kryer vepra penale dhe autori i saj është penalisht i përgjegjshëm, por vendimi i dënimit nuk do të ishte i arsyeshëm për shkak të intesitetit të vogël të veprës apo për shkaqe penalo - politike.

Në rastet e këtilla me ligj është autorizuar gjykata që autorin ta shpallë fajtor për veprën penale të kryer por edhe ta lirojë nga dënimi në të drejtën penale të shumë legjislacioneve si ato të familjes kontinentale ashtu edhe ato anglo - amerikane është parashikuar mundësia e lirimit nga dënimi nga ana e gjykatës.

Mirëpo duhet theksuar, se gjykata mund ta lirojë autorin e veprës penale nga dënimi vetëm në rastet kur ligji shprehimisht e parashikon këtë mundësi. Pra një aspekt duhet të jetë mjaft i qartë se gjykata nuk mundet sipas bindjes së saj të lirë ta lirojë autorin e veprës penale nga dënimi.

Sipas legjislacionit penal - kontinental njihen dy grupe të rasteve kur autori mund të lirohet nga dënimi.

- Grupi i parë i rasteve parashikohet në dispozitat e posaçme të legjislacionit penal. Me dispozitat e kësaj pjese të ligjit penal mundësia e lirimit nga dënimi është parashikuar p.sh. për rastet kur pjestari i shoqatës kriminale e zbulon atë para se të ketë kryer vepra penale.

- Grupi i dytë është ai i dispozitave të pjesës së përgjithshme. Me këto dispozita penale - juridike mundësia e lirimit nga dënimi është parashikuar në rastet kur vepra penale kryhet në lajthim juridik, në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme dhe të nevojës ekstreme si dhe në rastet e heqjes dorë vullnetarisht nga kryerja e veprës penale.

Mundësia e lirimit nga dënimi si prerogative e gjykatës është fakultative. Te lirimi nga dënimi gjykata nxjerr akt gjykimin me të cilin e shpall fajtor autorin e veprës penale por e liron nga dënimi. Lirimi nga dënimi nga ana tjetër nuk shkakton asnjë pasojë juridike

BIBLIOGRAFIA

1. Kodi penal i Republikës së Shqipërisë
2. Komentari i Kodit Penal
(I Elezi, S. Kacupi, M.Haxhiaj).
3. Jurisprudenca shqiptare
(vellimi3)
4. Kanuni i Lekë Dukagjinit
5. Kodi Penal italian.
6. Criminal Law and its processes.
(Kadish SCHULHOFER sixth edition).
7. Kriminologji dhe penologji
(Ragip Halili. Prishtine 1996).
8. E Drejta Penale, pjesa e përgjithshme.
(C Ismet Salihu - Universiteti i Prishtines).
9. Revista Tribuna Juridike Nr.23 -1996.
10. Probation and Related Measures.
(Edition by Council, of Europa).
11. The prison study in international organisation and Change.
(David Cressey New York 1961,).
12. Criminology and penology.
(J.L. Gillin New York-1 945).
13. Criminal Law.
(Joel Samaha).
14. Codice penale comentato con la giurisprudenza di legittimita.
(Sergio Beltrani, Francesco Caringelo, Rafaello Marino).
15. Crime and criminal Law. (B. Wootton).
16. Persons and punishment. (H. Morris 1968).
17. The aims of the Criminal Law. (H. LA. Hart 1958)
18. Criminal responsability . (G. Hughes 1964).
19. Cases and materials.
(Faculty of Law • New York 1983).

ROLI KONSTRUKTIV I PRAKTIKËS SË GJYKATËS KUSHTETUESE DHE GJYKATËS SË LARTË NDAJ DISA DISPOZITAVE TË Pjesës SË PËRGJITHSHME TË KODIT PENAL

Prof. Asoc. Dr. Dorina HOXHA
Prof. Dr. Skënder KAÇUPI

Roli i gjykatës Kushtetuese në lidhje me ndërhyrjet në Kodin Penal ka qënë më aktiv vetëm në dhjetëvjeçarin e fundit. Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar disa dispozita të Kodit Penal të Pjesës së Përgjithshme, përkatësisht nenet 29/1, 34/VII, VIII, nenin 55/2 dhe në pjesën e posaçme në nenet 190, 191, 278/5,6. Të një rëndësie të veçantë janë tre vendimet nr. 19/2011, 47/2012, 9/2016, të cilat bazohen në respektimin e parimit të proporcionalitetit, të sanksionuar nga neni 17/1 i Kushtetutës. Në këto vendime ajo i ka dhënë vlerë një sërë parimesh, ku më i rëndësishmi është parimi i përpjestimit të drejtë të dënimit me veprën penale dhe ai i barazisë para ligjit. Edhe pse Gjykata Kushtetuese ka bërë shfuqëzimin e këtyre dispozitave, roli i saj është konstruktiv pasi ka garantuar respektimin e një sërë parimesh me legjitimitet kushtetues.

Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë jo vetëm përmes vendimeve të saj unifikuese por edhe më tej, ka pranuar nocione të reja në teorinë e së drejtës shqiptare, siç është vepra penale e pamundur me vendimin nr. 157/2015, duke hedhur një hap të ri mbi kuptimin e tentativës dhe ndarjeve të saj.

Ky punim kërkon të realizojë të verë theksin të respektimi të parimeve me karakter kushtetues jo vetëm nga Gjykata Kushtetuese por edhe nga Gjykata e Lartë, duke analizuar vendimet thelbësore në këtë aspekt.

***Fjalë kyçe:** praktika gjyqësore, parime, kodi penal, gjykata.*

Roli konstruktiv i praktikës së Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë ndaj disa dispozitave të Pjesës së Përgjithshme të Kodit Penal

HYRJE

Roli i Gjykatës Kushtetuese në lidhje me ndërhyrjet në Kodin Penal ka qënë më aktiv vetëm në dhjetëvjeçarin e fundit. Kështu, me vendimin nr. 65/1999 ka qënë hapi i saj i parë në lidhje me shfuqëzimin e një nga llojet e dënimeve, ai i dënimit me vdekje, për të hedhur më tej hapin e saj të dytë, për një kohë relativisht të gjatë në vitin 2008 në shfuqëzimin e nenit 315 i KP i cili parashikonte “Dhënia e një vendimi gjyqësor përfundimtar që dihet se është i padrejtë”, pasi binte ndesh me nenin 145/1,3 të Kushtetutës që garanton pavarësinë e gjyqtarëve, të cilët i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve (neni 145/1).

Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar disa dispozita të Kodit Penal të Pjesës së Përgjithshme, përkatësisht nenet 29/1, 34/VII, VIII, nenin 55/2 dhe në pjesën e posaçme në nenet 190, 191, 278/5,6.

Të një rëndësie të veçantë janë tre vendimet nr. 19/2011, 47/2012, 9/2016, të cilat bazohen në respektimin e parimit të proporcionalitetit, të sanksionuar nga neni 17/1 i Kushtetutës. Në këto vendime ajo i ka dhënë vlerë një sërë parimesh, ku më i rëndësishmi është parimi i përpjestimit të drejtë të dënimit me veprën penale dhe ai i barazisë para ligjit.

a) Në kërkesat e pranuar nga Gjykata Kushtetuese për *cenimin e parimit të barazisë së shtetasve para ligjit* mund të përmendim:

- vendimin nr. 19/2011 të Gjykatës Kushtetuese ku është vendosur shfuqizimi si të papajtueshëm me Kushtetutën, të paragrafit 8 të nenit 34 të Kodit Penal dhe është konstatuar se:

konvertimi i dënimit me gjobë në dënim me burgim sjell diskriminimin e të dënuarit për arsye të gjendjes së tij ekonomike, si rrjedhojë *cenimin e parimit të barazisë së shtetasve para ligjit*, të parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës.

b) Në kërkesat e pranuar nga Gjykata Kushtetuese për *parimin e përpjesëtimit të drejtë të dënimit me veprën penale* mund të përmendim:

- Në lidhje me *pjesën e përgjithshme*, me vendimin e nr. 47/2012 është vendosur shfuqizimi si të papajtueshëm me Kushtetutën, të nenit 29, paragrafi i fundit, të Kodit Penal, pasi është në kundërshtim me nenin 17 (*parimi i përpjestimit të drejtë të dënimit me veprën penale*) të Kushtetutës dhe si të tillë duhen shfuqizuar.

- Në lidhje me *pjesën e posaçme*, nenet 190 dhe 191 të Kodit Penal, në pjesën që parashikojnë dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim janë shfuqizuar pasi është konstatuar se: parashikimi *a priori* i dy dënimeve kryesore edhe për vepra penale të tilla si falsifikimi i vulave, stampave ose formularëve apo falsifikimi i akteve të gjendjes civile, jashtë kriterëve të analizuar më lart, nuk është në proporcion me gjendjen që i ka diktuar (lufta kundër krimit të organizuar) si dhe bie ndesh me *parimin e individualizimit të dënimit* e si rrjedhojë me *parimin e dhënies së drejtësisë* nga ana e gjykatës, pasi i heq kësaj të fundit mundësinë e përcaktimit, rast pas rasti, të dënimit penal sipas rrethanave të çështjes konkrete në shqyrtim. Nenet 190 dhe 191, të KP-së që sanksionojnë parashikimin e njëkohshëm të dy dënimeve kryesore, atij me burgim dhe me gjobë janë në kundërshtim me nenin 17 (*parimi i përpjesëtimit të drejtë të dënimit me veprën penale*) të Kushtetutës dhe si të tillë duhen shfuqizuar.

c) Në kërkesat e pranuar nga Gjykata Kushtetuese për *cenimin e parimit të ndarjes së pushteteve, të pavarësisë së pushtetit gjyqësor* mund të përmendim:

- Në lidhje me *pjesën e përgjithshme*, me vendimin nr 9/2016 është vendosur shfuqizimi i nenit 55/2 i k.Penal pasi është konstatuar se: shtesa e bërë në nenin 55, paragrafi i dytë i KP-së, cenon parimin e ndarjes së pushteteve, të pavarësisë së pushtetit gjyqësor, si dhe përbën kufizim të kompetencave në dhënien e drejtësisë, në kundërshtim me nenet 7, 135/1 dhe 145/1 të Kushtetutës.

- Në lidhje me *pjesën e posaçme*, me vendimin nr 9/2016 është vendosur se paragrafi i pestë dhe i gjashtë i nenit 278 të KP pasi mbartin të njëjtat probleme kushtetutshmërie, janë dukshëm joproporcional dhe në kundërshtim me parimin

e sigurisë juridike për shkak se bien në kundërshtim me nenet 7, 17/1, 135/1 dhe 145/1 të Kushtetutë.

1. Antikushtetutshmëria e paragrafit 8, të nenit 34 të KP

Parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore, përfshi këtu edhe ligjin penal. Konkretisht, Gjykata Kushtetuese është shprehur se: “*Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllajta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia para ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta*”, si dhe “*Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë*”⁽¹⁾.

Gjykata Kushtetuese në disa raste është shprehur edhe mbi cenimin e parimit të barazisë para ligjit konkretisht duke deklaruar antikushtetutshmërinë e paragrafit 8, të nenit 34 të KP. Në analizë të saj, konvertimi i dënimit me gjobë në dënim me burgim, kur autori është në pamundësi për të shlyer gjobën, cenon standardin e barazisë së shtetasve para ligjit dhe, në këtë kuptim, nuk është në përputhje me këtë funksion riedukativ që duhet të luajë sanksioni penal. Vuajtja e dënimit me burgim, nga persona të cilët janë në pamundësi absolute të shlyejnë detyrimet monetare kundrejt shtetit, diskriminon personat që nuk kanë mundësi financiare kundrejt atyre që i kanë këto mundësi².

Konvertimi i dënimit, kur personi është në pamundësi objektive, çka do të thotë se burgimi nuk varet nga ana subjektive e autorit, por nga kushtet ekonomike të të dënuarit, do të shkaktonte një trajtim të diferencuar vetëm në varësi të gjendjes ekonomike, duke sjellë si pasojë cenimin e parimit të barazisë para ligjit, të sanksionuar nga neni 18 i Kushtetutës

Parimi i barazisë para ligjit kërkon në vetvete edhe respektimin e nenit 17 të Kushtetutës, i cili parashikon *parimin e proporcionalitetit* ku dënimi penal në aspektin kushtetues, duhet të jetë i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën³.

Në përputhje me frymën e Kushtetutës, sanksioni penal i çfarëdolloj natyre duhet të synojë vetëm riedukimin dhe më pas integrimin e të dënuarit në jetën shoqërore. Gjykata Kushtetuese, duke pasur parasysh edhe doktrinën e konsoliduar evropiane në këtë fushë, ka theksuar se që të jetë i pranueshëm dënimi penal në

¹ Shih vendimet nr.34, datë 20.12.2005; nr.39, datë 16.10.2007; nr.4, datë 12.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese.

² Shih vendimin e GJK nr. 19 datë 1.06.2011, i cili ka shfuqizuar paragrafin VIII të nenit 34 të K.P.

³ Gjykata Kushtetuese në respektim të këtij parimi Shfuqizimin e paragrafit të dytë të nenit 55 të Kodit Penal, shtuar me ligjin nr.144/2013, si dhe të paragrafit të pestë dhe të gjashtë të nenit 278 të Kodit Penal, shtuar me ligjin nr.144/2013, ndryshuar me ligjin nr.98/2014 dhe shfuqizimin e dënimit kryesor me gjobë për nenin 190 dhe nenin 29 me vendimin VGJK 47/2012.

aspektin kushtetues, në përputhje me nenin 17/1 të Kushtetutës, duhet të jetë i drejtë edhe në përpjesëtim me veprën. Në këtë mënyrë, që të mund të ketë një proces riedukativ të suksesshëm, duhet që ndëshkimi penal të perceptohet nga autori i veprës si i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën e kryer.⁴

Lidhur me parimin e proporcionalitetit, Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka theksuar se proporcionalitetin e një kufizimi Gjykata e vlerëson rast pas rasti duke pasur parasysh disa aspekte si balancën mes të drejtës së kufizuar dhe interesit publik ose mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve, mjetin e përdorur në raport me gjendjen që e ka diktuar atë, të drejtën e cenuar dhe synimin që kërkon të arrijë legjislatori. Këto aspekte nuk duhet të analizohen veç e veç, por të gërshetuara me njëra tjetrën⁵.

Balanca mes të drejtës së kufizuar dhe interesit publik, nuk është gjë tjetër veçse gjetja nga legjislatori e pikës së ekuilibrit midis të drejtës së shtetit për të siguruar rendin publik e shoqëror nga njëra anë, dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të individit nga ana tjetër. Për këtë arsye sanksionet penale, për shkak të kufizimeve që përcaktojnë në të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, parashikohen vetëm për ato lloj veprimesh ose mosveprimesh, të cilat, në përputhje me parimin e proporcionalitetit, të jenë të krahasueshme për nga rëndësia me vlerat që mbrojnë. Është e vërtetë se është në diskrecionin e ligjvënësit vlerësimi i mjetit të zgjedhur për ndëshkimin e shkelësve të ligjit dhe qëllimit që kërkohet të arrihet, por, kur është fjala për parashikimin e dispozitave penale dhe sanksioneve përkatëse si "*ultima ratio*", ligjvënësi duhet të udhëhiqet nga parimet kushtetuese dhe funksionet që karakterizojnë dënimet penale. Ndërkohë, i përket Gjykatës Kushtetuese të analizojë proporcionalitetin e kësaj mase në raport me gjendjen dhe me shkeljet për të cilat është parashikuar dhënia e tyre.⁶ Parimi i proporcionalitetit rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës, në fakt nga vetë thelbi i të drejtave themelore, sidomos i lirisë personale, të cilat duhet të kufizohen nga pushteti shtetëror vetëm në atë masë sa të jetë e domosdoshme për mbrojtjen e interesave publike. Pra, rëndësi të veçantë në fushën penale, sidomos në atë të parashikimit të dënimeve dhe ekzekutimit të tyre, zë mbrojtja e të drejtave të njeriut. Kjo do të thotë se edhe pse prej kohësh e drejta penale ka detyrën e mbrojtjes së bazave të një bashkëjetese të rregulluar në shoqëri, ajo nuk është mjete kryesor i mbrojtjes ligjore me gjithë karakterin e saj më të fuqishëm. Si pasojë, përdorimi i saj duhet t'i nënshtrohet kërkesave të parimit të proporcionalitetit.

2. Antikushtetutshmëria e nenit 29 të K.Penal

Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 47, datë 26.7.2012 ka shfuqizuar paragrafin e fundit të nenit 29 i cili parashikonte dhënien e dënimit me burgim dhe

⁴ Shih vendimin nr.19, datë 01.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese

⁵ Shih vendimin nr.12, datë 14.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese.

⁶ Shih vendimin nr.12, datë 14.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese.

gjobë bashkarisht, kur parashikoheshin nga dispozitat përkatëse të Kodit Penal. Gjykata çmon se, në vetvete, secili prej dënimeve kryesore të parashikuara nga neni 29 i KP-së, të zbatuara kur është nevoja së bashku me dënimet plotësuese si dhe me dënimin me gjobë sipas parashikimit të nenit 34, paragrafi i pestë dhe i gjashtë, të KP-së, janë të mjaftueshëm në arritjen e qëllimit të dënimin penal dhe në proporcion me parimet e legjislacionit penal duke respektuar njëkohësisht parimin e ndarjes së pushteteve. Gjykata arrin në përfundimin se neni 29, paragrafi i fundit, që sanksionon parashikimin e njëkohshëm të dy dënimeve kryesore, atij me burgim dhe me gjobë, vijnë në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës dhe si të tillë duhen shfuqizuar.

Për pasojë, Gjykata Kushtetuese është shprehur se, parashikimi *a priori* i dy dënimeve kryesore nuk është në proporcion me gjendjen që i ka diktuar (lufta kundër krimit të organizuar) si dhe bie ndesh me parimin e individualizimit të dënimin e si rrjedhojë me parimin e dhënies së drejtësisë nga ana e gjykatës, pasi i heq kësaj të fundit mundësinë e përcaktimit, rast pas rasti, të dënimin penal sipas rrethanave të çështjes konkrete në shqyrtim.

Siç u shprehëm dhe më lart me vendimin nr datë Gjykata Kushtetuese, shfuqizoi dënimin kumulativ, i cili parashikonte dënim me burgim dhe dënimin me gjobë bashkarisht, për probleme kushtetushmërie, pasi binte ndesh me parimin e individualizimit të dënimin, dhe si rrjedhojë me parimin e dhënies së drejtësisë nga ana e gjykatës.

Shfuqizimi i nenit 29 paragrafi i fundit u shoqërua edhe me shfuqizimin e 44 neneve të pjesës që parashikonte si dënim kryesor edhe dënimin me gjobë, krahas dënimin me burgim, por duke harruar pa kryer të njëjtat ndryshime edhe në nenet 114/b, 124/b dhe 206/a të K.Penal, në të cilat përsëri aktualisht janë në fuqi caktimi i dy dënimeve kryesore.

3. Antikushtetushmëria e nenit 55 të Kodit Penal

Me ligjin nr. 135 datë 5.12.2015 ligjvënësi parashikoi një rast më vete të caktimit të dënimin, i cili është një nën sistem i sistemit të ashpërsimit, pasi në këtë rast parashikohet shuma algjebrikë për dy vepra penale të caktuara. Ky ligj shtoi paragrafin e dytë të nenit 55 të K.Penal i cili parashikonte shprehimisht: *“Dënimi më i rëndë i shtuar përbëhet nga shuma e përgjithshme e dënimeve për secilën vepër penale në rastin kur personi ka kryer një krim kundër jetës me dashje, me përdorim pa leje të armëve luftarake dhe municionit, ose vepra penale me qëllime terroriste, korrupsion pasiv ose vepra penale kundër të miturve”*.

Duket se qëllimi i ligjvënësit, duke shtuar këtë paragraf në nenin 55 të Kodit Penal, ka qenë që të detyrojë gjykatat që në të gjitha rastet kur personat kryejnë krime kundër jetës me dashje, me përdorimin pa leje të armëve luftarake dhe municionit, të aplikojnë si masë dënimi përfundimtar sistemin e mbledhjes aritmetike të dënimeve të caktuara më parë për secilën vepër penale. Por para shtesës së bërë në

nenin 55 të Kodit Penal gjykatat nuk kishin asnjë pengesë që si dënim më të rëndë të shtuar të zbatonin mënyrën e mbledhjes aritmetike të dënimeve.

Si pasojë, në përcaktimin e dënimit, për vepra të ndryshme penale, organi legjislativ nuk duhet të ketë parasysh vetëm parimin e parashikimit me ligj të dënimit dhe atë të sigurisë juridike. Ai duhet të marrë parasysh mjaftueshëm edhe konceptin e fajit në kuadër të parimit të shtetit të së drejtës dhe nëpërmjet formulimit të sanksionit t'i mundësojë gjyqtarit dhënien e një gjykimi të drejtë dhe proporcional në raste konkrete.

Kjo dispozitë u shfuqizua nga Gjykata Kushtetuese me të drejtë pasi çenoheshin një sërë parimesh që kishin të bënin me caktimin e dënimit. Konkretisht me vendimin nr. 9 datë 26.02.2016 u shfuqizua neni 55/2 me këto arsye:

1. Shtesa që i është bërë nenit 55/2 të KP-së vjen në kundërshtim me nenet 7, 135/1 dhe 145/1 të Kushtetutës, duke cenuar për këtë arsye parimin e ndarjes dhe pavarësisë së pushteteve.

2. Është cenuar parimi i shtetit të së drejtës pasi ndarja e pushteteve është një element i këtij parimi⁷.

3. Sipas metodologjisë së parashikuar në paragrafin e dytë të nenit 55 të KP-së, ligjvënësi u ka hequr gjykatave të sistemit gjyqësor të drejtën të vlerësojnë pikërisht elementet e parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 47 të KP-së të përmendura më lart (prg. 23), të cilat janë jo vetëm përcaktuese në individualizimin e drejtë të dënimeve penale, por njëkohësisht janë edhe në kompetencën ekskluzive të gjyqësorit. Në vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese ky rregullim i ri përbën cenim të parimit të ndarjes së pushteteve dhe të pavarësisë funksionale të pushtetit gjyqësor.

4. Interpretimi autentik (legal) ose i detyrueshëm i Gjykatës Kushtetuese

Në bazë të neneve 124 dhe 131 shkronja a,b, dhe c të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se: “Gjykata Kushtetuese zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës”. Ndërsa neni 131 parashikon pajtueshmërisë e ligjit me Kushtetutën, marrëveshjet ndërkombëtare dhe me aktet normative të organeve qendrore dhe vendore.⁸

Interpretimi i bërë nga Gjykata Kushtetuese nuk është krijim i një norme të re, por jep kuptimin e saktë dhe të rregullt të normave kushtetuese, duke marrë në konsideratë kuptimin e tyre gjuhësor, logjik, historik, social, analitik si dhe

⁷ Shih vendimin nr.29, datë 31.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese.

⁸ Gjykata Kushtetuese vendos për: a) pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, siç parashikohet në nenin 122; b) pajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën para ratifikimit të tyre; c) pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare;

qëllimin e vetë dispozitës (teleologjik)⁹. Nëpërmjet interpretimit zbërthehen dyshimet interpretuese, eliminohen ekuivoket pa shkelur parimet kushtetuese dhe në përputhje me elementët e shtetit të së drejtës. Interpretimi, si funksion dhe metodë, ka vend për një normë ekzistuese kur ka paqartësi në kuptimin e saj plotësuar boshllëkun, sepse përndryshe Gjykata Kushtetuese do të vihej në pozicionin e gabuar të krijuesit të normës juridike, funksion që, siç dihet, i përket ligjvënësit.¹⁰

Çdo dispozitë e Kushtetutës duhet të interpretohet në mënyrë të tillë që të jetë e pajtueshme me parimet themelore kushtetuese. Çdo dispozitë është në lidhje të caktuar me dispozitat e tjera dhe së bashku ato formojnë një entitet. Për pasojë asnjë dispozitë e Kushtetutës nuk mund të nxirret jashtë kontekstit të saj dhe të interpretohet më vete¹¹.

Interpretimi përfundimtar që bën Gjykata nuk ka si qëllim shtimin e normave të reja në sistemin e normave detyruese ligjore, por deklarimin ose pohimin e përmbajtjes së këtyre normave. Me qëllim shmangien e çdo mundësie për ndërhyrje nga Gjykata në kompetencat e pushtetit ligjvënës. Gjykata nuk merr përsipër të kryejë rolin e legjislatorit, por t'u japë jetë normave kushtetuese përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre. Gjykata kontrollon nëse aktet normative që miraton/nxjerr ligjvënësi janë në përputhje me normat e Kushtetutës. Kuvendi, si organi i ngarkuar me kompetencën e miratimit të ligjeve, në ushtrimin e këtij funksioni kryesor, mbështetet së pari te normat kushtetuese dhe, për rrjedhojë, shfaqet si interpretues i parë i normës kushtetuese.¹²

Për këtë arsye, ushtrimi i kompetencës së interpretimit përfundimtar të normës kushtetuese nga gjykata Kushtetuese kërkon plotësimin e kushteve:¹³

- **Së pari**, norma që kërkohet të interpretohet duhet të jetë e paqartë, ekuivoke, kontradiktore dhe, si pasojë e këtyre paqartësive që ajo mbart dhe kuptimit të padrejtë që i është dhënë, ka lindur një “problem/mosmarrëveshje kushtetues/e”;

- **Së dyti**, kërkohet të ekzistojë një marrëdhënie e ngushtë ndërmjet normës

⁹ Shih vendimin nr.75/2002 të Gjykatës Kushtetues.

¹⁰ Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 18/2003 shprehet në lidhje me detyrën e saj kushtetuese gjatë interpretimit të normave juridike: “Mbi bazën e kësaj analize doktrinare që Gjykata Kushtetuese i bën nenit 77 pika 2 të Kushtetutës, nisur dhe nga fakti se përveç kryerjes së funksionit të saj kushtetues për interpretimin përfundimtar të çështjes objekt shqyrtimi, nuk merr përsipër të krijojë norma të reja, ajo arrin në përfundimin se interpretimi i bërë i dispozitave, fjalive apo shprehjeve konkrete brenda saj, ka për qëllim që në mënyrë analitike të japë dhe të përcaktojë konceptet bazë si dhe parimet mbi të cilat duhet të mbështetet organi kompetent për të konkluduar lidhur me zbatimin e drejtë dhe korrekt të saj”.

¹¹ Shih vendimin nr.2/2005 të Gjykatës Kushtetuese.

¹² Shih vendimet nr.18/2003; nr.1/2005; nr. 19/2007; nr.12/2010 të Gjykatës Kushtetuese mbi interpretimin.

¹³ Shih, Tema e konferencës “Kontrolli kushtetues: doktrina dhe praktika” mbajtur në Moskë –Rusi 28-30 Tetor 2011 me temë “Disa elementë të kontrollit kushtetues sipas jurisprudencës shqiptare” nga Bashkim Dedja Kryetar Gjykata Kushtetuese Shqiptare.

konkrete kushtetuese dhe fakteve, mosmarrëveshjeve ose çështjeve të përcaktuara konkretisht në një ose disa akte të organit kompetentë, si pasojë e zbatimit ose kuptimit të pasaktë të kësaj norme kushtetuese.¹⁴

Interpretimi që bën gjykata Kushtetuese në bazë të nenit 131 të Kushtetutës quhet *interpretim pajtues*. Ky interpretim është i mundur kur një ligj apo dispozitë ligjore mund të interpretohet në më shumë se një mënyrë, njëra nga të cilat është në pajtim me Kushtetutën. Kjo metodë kërkon efektet kushtetuese të rezultateve të ndryshme dhe përzgjedh rezultatin që është në pajtim me vlerat kushtetuese, duke marrë parasysh këtu të drejtat themelore të individëve. Prandaj dhe lidhur me antikushtetutshmërinë e pretenduar duhet të parashtrihen argumente bindëse për t'i dhënë mundësi Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë nëse zgjidhjet ligjore të aplikuara shkelin normat dhe vlerat kushtetuese.¹⁵

Duke arritur në këto konkluzione të praktikës së Gjykatës Kushtetuese arrijmë në përfundimi se interpretimi autentik është ai më i rëndësishmi dhe vendimtari. Për këtë arsye, interpretimi autentik është i vetmi interpretim i detyrueshëm për të gjitha organet.

Interpretimi autentik bëhet sipas procedurës që vlen për nxjerrjen e ligjeve. Gjithashtu edhe shpallet në të njëjtën mënyrë sikundër edhe ligji prandaj interpretimi autentik konsiderohet pjesë përbërëse e ligjit.¹⁶

Duke patur parasysh edhe parimin e ndalimit të fuqisë prapavepruese të ligjit penal, nuk mund të zbatohet interpretimi autentik i cili është jo favorizues, nëse ky interpretim është bërë pas kohës së kryerjes së veprës penale, pasi nëse do t'i jepej fuqi, do të shkelnim nenin 3/1 të Kodit Penal.

5. Roli konstruktiv i praktikës së Gjykatës së Lartë ndaj nocioneve të reja në teorinë e së drejtës

Doktrina bashkëkohore e huaj prej kohësh ka pranuar nocionin e *veprës penale të pamundur* për shkak të *mos ekzistencës absolute të objektit* dhe pamundësisë së tij për t'u cenuar, në vendin dhe në kohën ku kryhet ajo. Edhe praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 157 datë 7.10.2015, ka njohur raste e inekzistencës absolute të objektit in *rerum natura*, si raste ku nuk mund të linde përgjegjesi penale dhe nuk mund të bëhet fjalë as për zbatimin e institutit të tentativës.

E thënë ndryshe, objekti sipas kësaj analize, ndërhyr në kuptimin e tij material si personi ose sendi mbi të cilin zhvillohet aktiviteti i paligjshëm i kryesit të veprës, si element i cili duhet domosdoshmërisht të mbahet parasysh në vlerësimin e dënueshmërisë së veprimit konkret, bazuar edhe në parimin e ligjshmërisë, të sanksionuar në nenin 2 të K.Penal, sipas të cilit: *“Askush nuk mund të dënohet penalisht për një vepër që më parë nuk është parashikuar në ligj si krim ose*

¹⁴ Shih vendimin nr.29/2011 të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁵ Shih vendimi nr.16/2008 dhe 29/2010 të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁶ Ismet Salihu, *E drejta penale, Pjesa e përgjithshme*, fq. 142.

kundravajtje penale....”. Mungesa absolute, “*in rerum natura*” e objektit material, i cili nuk ka ekzistuar kurrë apo ka pushuar së ekzistuari, nuk mund të dënohet penalisht, ndërsa, në rastet e mungesës së objektit të ndryshme nga mosekzistenca, mund të flitet për veprë penale të mbetur në tentativë. Në këto raste, objekti gjithmonë ekziston dhe luan një rol jo të ndryshëm nga ai që luajnë rrethanat e tjera që konkurojnë në përcaktimin e kundërligjshmërisë së veprimeve konkrete. Do të ishte jo vetëm absurde, por dhe në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë, si një nga parimet themelore të K.Penal, të sanksionuar në nenin 2 të tij, të sipërcituar, të dënohen si të mbetura në tentativë rastet kur, edhe pse nuk ekziston apo nuk ka ekzistuar asnjëherë objekti i veprës penale, veprimet ishin të tilla që do të ishin në gjendje ta cënonin në rast se ai do të kishte ekzistuar¹⁷.

Kështu me të drejtë Gjykata e Lartë ka konstatuar se nuk kemi të bëjmë me veprë penale të “*Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve*” parashikuar nga neni 283 K.Penal kur lënda narkotike e dyshuar si e tillë, nuk bën pjesë në grupin e lëndëve narkotike e psikotrope, referuar ligjit nr 7975 datë 26.07.1995, pavarësisht qëndrimit të autorit të veprës penale.

Për të konstatuar *veprën penale të pamundur* kërkohet domosdoshmërisht mungesa absolute e mundësisë për të cenuar të mirën juridike të mbrojtur nga norma. Ky qëndrim teorik, të cilin ne e mbështetëm plotësisht, në dallim nga trajtimi teorik i mëparshëm, vendos në qëndër të veprës penale të pamundur parimi në bazë të të cilit, nuk mund të ketë veprë penale nëse është e pamundur të cënohet apo të vihet në rrezik e mira e mbrojtur me ligjin penal. Për të dënuar një veprim apo mosveprim duhet të ketë një qartësi mbi mundësinë e cënimit të të mirës juridike të mbrojtur nga norma pemale. Nëse veprimi apo mosveprimi nuk është në gjendje të realizojë këtë lloj cënimi apo rrezikimi, apo objekti nuk ekziston, jemi jashtë rasteve të dënueshmërisë të figurës së veprës penale, (të konsumuar apo të tentuar) dhe kemi të bëjmë me një veprim të parëndësishëm penalisht. kjo është dhe arsyeja që *vepra penale e pamundur*, është e tillë pasi e pamundur është ardhja e pasojës së dëmshme apo të rrezikshme.

Me fjalë të tjera, kemi të bëjmë me vepra penale të pamundura, kur veprimi është tipik siç e kërkon vetë norma penale, por megjithatë përsëri është i pamundur , në mënyrë absolute, që të shkaktoje pasojë apo mundësinë e ardhjes së tyre. Në rastin e tentativës cënimi apo rrezikimi mund të jetë i mundur, por nuk realizohet konkretisht për faktorë të ndryshëm të cilët bëjnë që veprimi të mos realizohet apo pasojë të mos vijë. Duhet theksuar që, inekzistenca e objektit i referohet objektit material të tij, ashtu sic theksohet edhe në vendimin 157/2015 të Gjykatës së Lartë, i cili duhet kuptuar në kuptim të dyfishtë njëherë si *ineksistencë absolute ne rerum natyra*¹⁸ dhe si ineksistence normative.

¹⁷ Për më tepër për këtë argument do të trajohet tek instituti i tentativës me objekt të papërshtatshëm.

¹⁸ Inekzistenca relative përfshin të gjitha rastet e tentativës, ku në momentin e ndërmarrjes së veprimit ekziston objekti në një vend të ndryshëm nga ai që ndërmerret veprimi.

- kemi të bëjmë me *ineksistencë absolute ne rerum natyra* kur objekti nuk ekziston. Pranimi i kësaj ineksistence absolute mund të bëhet vetëm ndërmjet një vlerësimi *ex ante* në momentin e kryerjes së veprës penale: vepra penale do të konsiderohet e pamundur atëherë kur objekti i nevojshëm për vetë konsumimin e veprës penale është inekzistent në kohën në të cilën autori kryen veprimin e tij. Kështu duhet të theksojmë që nuk ka përgjegjësi penale për shkak të mungesës absolute të objektit, në rastin kur personi qëllon mbi kufomën e cili ka vdekur disa çaste më parë. Kjo është një vepër penale materialisht e pamundur, duke patur parasysh faktin që në rastin e vrasjes parashikuar nga nei 76 i K.Penal, kërkon një person të gjallë.

- kemi të bëjmë me *inekzistencë normative* kur inekzistenca e objektit rrjedh nga norma që e konsideron objektin juridik pa rëndësi për të drejtën penale. Siç ka ndodhur gjetja e një sasive teper të vogël eksplozivi, mbajtja e të cilit, nuk arrin të krijojë asnjë rrezikshmëri shoqërore dhe si e tilla nuk mund të kemi përgjegjësi penale për mbajtësin e saj.¹⁹

Në çdo rast kemi të bëjmë me vepër penale të pamundur vetëm kur kemi të bëjmë me inekzistencë absolute apo një papërshtatshmëri të përgjithshme të objektit ndaj të cilët kryhet veprimi, dhe jo një shkak momental, rastësor mbi inekzistencën apo papërshtatshmërinë e vetë objektit.

Nga vendimi nr. 157/2015²⁰ ka rezultuar se A-së, B-së dhe C-së u është gjetur në makinë një lëndë që fillimisht është dyshuar se është lëndë narkotike por që në fakt ishte lidokainë dhe nuk klasifikohet si lëndë narkotike bazuar në Ligjin Nr. 7975, ent 26.07.1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”²¹. Në këtë rast kemi të bëjmë me një vepër penale të ngelur në tentativë me objekt të papërshtatshëm, pasi sendi nuk i ka ato cilësi për të cilat ka vepruar personi, apo jemi para një vepre penale të pamundur.

Fillimisht duhet theksuar se parashikimi i institutit të tentativës në Kodin Penal, bën që të dënohen penalisht edhe ato akte, veprime apo mosveprime, të cilat nuk i përmbajnë të gjithë elementët e veprës penale konkrete të parashikuar nga ligji. Në rastet e krimit të mbetur në tentativë, ajo që mungon është pasoja si element i anës objektive të veprës penale, **por jo objekti i saj**. Mungesa absolute e

¹⁹ Shih vendimin 159077/1983 të Gjykatës së Kasacionit italiane.

²⁰ Të njëjtin qëndrim mban edhe praktika gjyqësore italiane e cila për një çështje të ngjashme në lidhje me mungesën absolute të objektit ka pushuar çështjen me vendimin e gjykatës së Kasacionit : Cass.Sez. II, 13.11.2013, n.8026, 8 janar 2009, nr. 3189.

²¹ Objekti i veprës penale të parashikuar nga neni 283 i K.Penal, për të cilën janë akuzuar A,B dhe C janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar rendin dhe sigurinë publike, jetën dhe shëndetin e personit, rregullat për shitjen, dhënie, marrjen apo mbajtjen në çdo mënyrë të substancave narkotike ose psikotrope, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, si dhe të farërave të bimëve narkotike, të mbrojtura posaçërisht nga legjislati i penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale. Objekti material i kësaj vepre janë pikërisht lëndët apo substancat, të cilat, sipas Ligjit Nr.7975, dt. 26.07.1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”, klasifikohen si narkotike ose psikotrope.

objektit material të veprës penale, në kohën dhe vendin ku kryhet ajo, e përjashton dënueshmërinë nën titullin e tentativës. Kjo pasi, në rastet kur vepra penale mbetet në tentativë, objekti i saj ekziston edhe pse nuk preket apo nuk çënohet, rrezikohet apo ka mundësi potenciale për t'u çenuar.

Objekti që analizohet në këtë rast nuk është objekti juridik, por material si personi ose sendi mbi të cilin zhvillohet aktiviteti i paligjshëm i kryesit të veprës, si element i cili duhet domosdoshmërisht të mbahet parasysh në vlerësimin e dënueshmërisë së veprimit konkret, bazuar edhe në parimin e ligjshmërisë, të sanksionuar në nenin 2 të K.Penal, sipas të cilit: *“Askush nuk mund të dënohet penalisht për një veprë që nuk është parashikuar në ligj si krim ose kundravajtje penale....”*. Mungesa absolute, *“in rerum natura”* e objektit material, i cili nuk ka ekzistuar kurrë apo ka pushuar së ekzistuari, nuk mund të dënohet penalisht, ndërsa, në rastet e mungesës së objektit të ndryshme nga mosekzistenca, mund të flitet për veprë penale të mbetur në tentativë, me objekt të papërshtatshëm.

Në këto raste objekti gjithmonë ekziston dhe luan një rol të ndryshëm nga ai që luajnë rrethanat e tjera që konkurojnë në përcaktimin e kundërligjshmërisë së veprimeve konkrete. Do të ishte jo vetëm entat, por dhe në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë, si një nga parimet themelore të K.Penal, të sanksionuar në nenin 2 të tij, të sipërcituar, të dënohen të mbetura në tentativë rastet kur, edhe pse nuk ekziston apo nuk ka ekzistuar asnjëherë objekti i veprës penale, veprimet ishin të tilla që do të ishin në gjendje ta çënonin në rast se ai do të kishte ekzistuar. Në rastin konkret, ajo çka ligjvënësi parashikon si krim në nenin 283 të K.Penal, është blerja, shitja, mbajtja në doza të mëdha dhe jo për përdorim vetjak e lëndëve narkotike dhe atyre psikotrope dhe jo e çdo lloj lënde tjetër. Pikërisht kjo është arsyeja se pse duhet patjetër të ekzistojë objekti i kësaj vepre penale.

Akuza e ngritur ndaj të pandehurve A, B, C, për *“Prodhim dhe shitje e narkotikëve e kryer në bashkëpunim mbetur në tentativë”* e parashikuar nga neni 283/2 e 22, nuk përbën veprë penale dhe duhet rrëzuar pasi mungon objekti i veprës penale. Dispozita e nenit 283 të K.P është dispozitë blanket, e cila në përcaktimin e faktit nëse lënda është narkotike referon tek ligji specifik dhe në rastin konkret lënda që kanë mbajtur të pandehurit nuk bën pjesë në grupin e lëndëve narkotike.

Në rast se do të pranohej se të pandehurit e kanë konsumuar veprën pasi edhe pse mungonte objekti, (lënda narkotike), ata nuk ishin në dijeni të këtij fakti dhe i kanë kryer të gjitha veprimet sikur ky objekt të ekzistonte, *atëherë do të pranohet të dënueshme penalisht dhe fazën e lindjes së mendimit kriminal apo të përgatitjes.*

Nuk mund të qëndrojë, se nga të pandehurit janë konsumuar të gjithë elementët e anës objektive të entatit së veprës penale të parashikuar nga neni 283/2 i K.Penal dhe se kjo veprë ka mbetur në tentativë për shkaqe të pavarura prej tyre. Kështu, në rastet e mbetjes së veprës në tentativë, *personi, pra kryerësi i veprës, i kryen të gjitha veprimet e nevojshme dhe të domosdoshme për kryerjen e saj por pasoja nuk vjen. Në këtë rast, personi nuk kryen veprime të çfarëdoshme, por ato veprime që përfshihen në anën objektive të entatit së veprës penale konkrete dhe*

synojnë e kanë mundësi potenciale të sjellin pasojën e parashikuar në ligj, pikërisht cënimin e objektit të mbrojtur. Në këtë rast, këto veprime mungojë pasi jo vetëm nuk ekziston objekti i veprës penale, jo vetëm që ai nuk është cënuar, por as nuk ka patur ndonjëherë mundësi për t'u prekur apo rrezikuar. Gjithashtu, veprimet e të pandehurve në mbajtjen, blerjen apo shitjen e një lënde, e cila nuk klasifikohet si lëndë narkotike nga ligji, nuk plotësojnë kushtet dhe elementët e anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 283 i K.Penal.

Tentativa, si institut i parashikuar nga neni 22 i K.Penal nuk është gjë tjetër veçse një nga fazat e kryerjes së veprës penale. Nga momenti që kryerësit të veprës i lind mendimi kriminal deri në materializimin, shfaqjen e tij në botën e jashtme enta e sjelljeve (veprimeve apo mosveprimeve) konkrete, të cilat përmbajnë të gjithë elementët e entatit së një vepre penale të parashikuar enta tillë në K.Penal, kalojnë disa faza (lindja e mendimit kriminal, përgatitja entative, kryerja e veprës), ndër të cilat, e dënueshme është entative. Në parashikimin e këtij entative, qëllimi i ligjvënësit është ngritja në nivelin e veprës penale dhe dënimi edhe i atyre veprimeve të cilat në vetvete nuk i përmbajnë të gjithë elementët e një figure vepre penale konkrete, dhe që, edhe pse nuk e prekin objektin e mbrojtur nga legjislacioni penal, potencialisht do ta kishin prekur atë në rast se nuk do të kishin ndërhyrë faktorë të jashtëm, të pavarur nga vullneti i autorit.

Ky rast nuk mund të cilësohet si tentativë me objekt të papërshtatshëm pasi entative me objekt të papërshtatshëm, është entative e bërë kundër një raporti juridik që nuk mund të preket apo cënohet në rrethanat konkrete në të cilat ka vepruar autori, por që në fakt ekziston. Duhet të bëhet dallim mes mungesës absolute të objektit të veprës penale konkrete, me mungesën e rastësishme apo relative, pra mungesa e mëparshme nga ajo e mëpasshme nga fillimi i veprimit të autorit. Për ta konsideruar një vepër enta mbetur në tentativë, duhet të vlerësohet mbi bazën e një gjykimi paraprak “*ex ante*”, nëse prania e objektit në kohën dhe vendin e kryerjes së veprës, ishte e pritshme. Pra, nëse ekzistonte një mundësi e logjikshme që veprimet e autorit të preknin objektin e mbrojtur nga ligji, fakt që nuk evidentohet në këtë rast, pasi siç është shprehur edhe ky vendim, në këtë rast nuk ekziston objekti i veprës penale.

Vepër penale e pamundur do të konsiderohet edhe rasti kur qëllohet mbi një person të vdekur më parë, pasi mungon objekti juridik që është jeta e personit, një mosekzistencë absolute e saj.

BIBLIOGRAFIA

Ambrosetti E.M., Abolitione criminis e modifica della fattispecie, Padova, 2004.

Antolisei, Manuale di diritto penale, Parte generale, 2008.

Aurela Anastasi & Luan Omari “E drejta kushtetuese”, ABC, Tirane 2010.

Ashworth, *Principles of criminal law*, Oxford, 2003. Cadoppi A., Il principio di irretroattività.

Capozzi, *Temporalitae norma nella critica della ragione giuridica*, Napoli.

Cela, Elezi, Peza, Gjika, *E drejta penale e Republikës së Shqipërisë, Pjesa e përgjithshme III*, 1976..

Cela, Peza, Elezi, Gjika, *E drejta penale e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Pjesa e përgjithshme*, 1982.

Crespi, Stella, Zuccala, “*Commentario breve al codice penale*”, Ed. Cedam, Padova 1999.

Eelezi, I., Kacupi, S., Haxhia. M., *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë*, 2012.

Elezi, *E drejta penale e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. (Pjesa e posaçme)*, 1983..

Elezi, *E drejta penale, Pjesa e përgjithshme*, 2008.

Elezi, I., Kacupi, S., Haxhia, M., *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë*, Botime Geer 2006,

Elezi, Kaçupi, Haxhia, *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë*, 2011.

Elezi.I.,*E drejta penale, Pjesa e posaçme*, Botime Erik, 2007.

Engish K. *Die Zeit im Recht*, 1965.

Engish, *die Zeit im Recht*.

Fiandaca Musco, *Diritto penale, Parte generale*, botimi i dytë, 1995.

Fiandaca.M., Musco.E. *Diritto penale, Parte generale*, Seconda edizione, 1997, Zanichelli Bologna.

Fiandaca-Musco, *Diritto penale. Parte generale*, Bologna 2007.

Ismet Elezi, *E drejta penale, Pjesa e posaçme*, 2009.

Ismet Elezi, Skënder Kaçupi, Maksim R. Haxhia, *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë* 2012.

Ismet Salihu, *E drejta penale, Pjesa e Përgjithshme*, 2010.

Kambovski Vllado, *E drejta penale, Pjesa e përgjithshme*, Furkan, 2010.

Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, 1995.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, 1995.

Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Ismet Elezi, Skënder Kaçupi,

KRITERI NDALUES PËR PËRFITIMIN E AMNISTISË NË FUSHËN E VEPRAVE PENALE KUNDËR MJEDISIT

Dr. Enkelejda TURKESHI

Departamenti i të Drejtës Penale, Fakulteti i Drejtësisë,
Universiteti i Tiranës
enkelejda.turkeshi@fdut.edu.al

ABSTRAKT

Instituti i amnistisë, i cili është parashikuar shprehimisht në një dispozitë të posaçme të Pjesës së Përgjithshme të Kodit Penal në fuqi duke filluar nga koha e miratimit të tij në vitin 1995, është një institut që mund të shërbejë për zbatimin e disa parimeve të rëndësishme në të drejtën penale. Ndonëse dhënia e amnistisë mbetet në diskrecionalitetin e ligjvënësit, në çdo rast të hartimit të ligjit përkatës favorizues, të miratuar me shumicë të cilësuar, është e domosdoshme të sigurohet balanca e duhur midis zbatimit të parimit të humanizmit, nga njëra anë, dhe arritjes së qëllimeve të dënimit penal dhe mbrojtjes së interesit publik nga ana tjetër. Në këtë kontekst, një element i rëndësishëm i ligjeve për dhënie amnistie, i cili kërkon një vëmendje të veçantë nga ligjvënësi, është përjashtimi i disa veprave penale nëpërmjet përcaktimit të një kriteri ndalues për përfitimin e amnistisë, me synim koordinimin më të mirë të politikës së ndjekur përmes amnistisë me politikën e dënimit të ndjekur nga ligjvënësi për vepra penale të caktuara.

Në këtë punim do të analizohet qëndrimi i ligjvënësit shqiptar lidhur me zbatimin e institutit të amnistisë ndër vite në fushën e veprave penale kundër mjedisit, si një grup veprash penale që kanë për objekt të tyre një të mirë juridike shumë të rëndësishme, rrezikimi apo dëmtimi i rëndë i të cilës mund të ndikojë jo vetëm në brezin e sotëm, por edhe ato të ardhshëm. Tendencat kryesore lidhur me përfshirjen e veprave të caktuara në kriterin ndalues për përfitimin e amnistisë do të analizohen edhe në kontekstin e rekomandimeve përkatëse të Këshillit të Evropës në fushën e mbrojtjes së mjedisit nëpërmjet të drejtës penale, si dhe në perspektivën e amendimeve të pritshme në Kodin Penal në kuadrin e reformës në sistemin e drejtësisë, të cilat synojnë harmonizimin e tij me standardet e Direktivave të Bashkimit Evropian mbi krimin mjedisor.

***Fjalë kyçe:** amnistia e dënimit, amnistia nga ndjekja penale, Kodi Penal, ligji për dhënie amnistie, kriteri ndalues, veprat penale kundër mjedisit, shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor.*

1. Amnistia si masë e përgjithshme faljeje dhe parimet bazë për dhënien e saj

Krahaz institutit të faljes, në Pjesën e Përgjithshme të Kodit Penal (KP) në fuqi, ligjvënësi ka parashikuar shprehimisht edhe institutin e amnistisë, e cila përbënte një risi në kohën e miratimit të këtij kodi (1995) duke qenë se në KP të mëparshëm nuk parashikohej shprehimisht një institut i tillë.¹ Në dispozitën e posaçme mbi amnistinë, të përfshirë në kreun e tetë mbi “shuarjen e ndjekjes penale, të dënimeve dhe mosekzekutimin e tyre”, është parashikuar se në aktin përkatës të amnistisë mund të vendoset përjashtimi nga ndjekja penale, përjashtimi nga vuajtja tërësisht ose pjesërisht e dënimit, ose zëvendësimi i dënimit me një lloj dënimi më të butë, efekte këto që, si rregull, shtrihen mbi veprat penale që janë kryer deri një ditë para shpalljes së amnistisë.² Në këtë kontekst, në interpretim të nenit 71 të KP, në doktrinën penale dhe në jurisprudencë njihen dy lloje të amnistisë: amnistia e veprës penale dhe amnistia e dënimit.³ Ndërkohë, vlen të theksohet se dispozita e KP mbi amnistinë nuk e trajton çështjen e efektit të amnistisë në të drejtat civile të personit të dëmtuar nga vepra penale.⁴

Në dallim nga instituti i faljes, i cili karakterizohet nga natyra individuale e aktit human të mëshirës dhe shtrihet vetëm mbi personat e dënuar,⁵ amnistia njihet si një “masë e përgjithshme faljeje për kategori të përcaktuara veprash penale të kryera në një periudhë të caktuar kohe, apo dënimeve përkatëse”.⁶ Ajo përdoret si një instrument kriminalo-politik për zgjidhjen efikase të situatave të caktuara, duke patur gjithmonë një “arsyetim politiko-kriminal”, në përputhje me “qëllimet e përgjithshme” të caktimit dhe ekzekutimit të sanksioneve penale.⁷

Duke filluar nga hyrja në fuqi e KP, ligjvënësi ka miratuar disa ligje për dhënie amnistie, në të cilat janë përfshirë të dy llojet e lartpërmendura, me përjashtim të njëjës prej formave të amnistisë së dënimit.⁸ Sipas analizës së kryer në kuadrin e reformës në drejtësi, dispozita e KP mbi amnistinë përmban një formulim të paqartë

¹ Në KP të mëparshëm parashikohej vetëm instituti i parashkrimit (Shih pjesën e përgjithshme të KP 1977).

² Në bazë të nenit 71, paragrafi i dytë të KP, në aktin e amnistisë, ligjvënësi mund të përcaktojë një datë tjetër, të ndryshme nga data e shpalljes së saj.

³ Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 16, datë 19.04.2010, si dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.1, datë 20.01.2014.

⁴ Në disa shtete të tjera, dispozita e KP mbi amnistinë e përmban edhe këtë parashikim të veçantë mbi efektin e amnistisë në të drejtat civile të personit të dëmtuar nga vepra penale. Shih p.sh., KP të Maqedonisë, KP të Sllovenisë, KP të Rumanisë, KP të Francës, etj.

⁵ Shih nenin 70 të KP, si dhe nenet 1 dhe 2 të ligjit nr.10295/2010 “Për faljen”.

⁶ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.16, datë 19.04.2010.

⁷ V.Kambovski, *E drejta penale, Pjesa e Përgjithshme*, Botim i dytë, Furkan ISM, Shkup, 2007, f. 581 dhe 587.

⁸ Zëvendësimi i dënimit me një lloj dënimi më të butë.

në lidhje me formën e zëvendësimit të dënimit me një lloj dënimi më të butë, i cili përbën edhe një nga problematikat e evidentuara lidhur me institutin e amnistisë, krahas problematikës së “kufizimit të dhënies së amnistisë për kategori veprash të caktuara”.⁹ Në këtë kontekst, një ndër synimet e ndryshimeve ligjore në kuadrin e përmirësimit të KP është përcaktuar edhe qartësimi dhe plotësimi i dispozitës së veçantë mbi amnistinë.¹⁰

Ndonëse dhënia e amnistisë mbetet në diskrecionalitetin e ligjvënësit, në çdo rast të hartimit të ligjit përkatës favorizues, të miratuar me shumicë të cilësuar,¹¹ është e domosdoshme të sigurohet balanca e duhur midis zbatimit të parimit të humanizmit, nga njëra anë, dhe arritjes së qëllimeve të dënimit penal dhe mbrojtjes së interesit publik nga ana tjetër.

Sikurse është parashikuar shprehimisht në ligjet për dhënie amnistie të viteve të fundit, duke filluar për herë të parë me ligjin e vitit 2012, të miratuar me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së pavarësisë, parimet që duhet të udhëheqin dhënien e amnistisë janë: humanizmi, arritja e qëllimit të dënimit, rrezikshmëria e ulët e personave që amnistohen, edukimi dhe rehabilitimi, si dhe mbrojtja e interesit publik.

Ndërkohë, në propozimin për miratimin e ligjeve më të fundit për dhënie amnistie është theksuar problematika shqetësuese e mbipopullimit të burgjeve dhe nevoja për rivendosjen e dinjitetit të të dënuarve. Kështu, sipas relacionit shpjegues të ligjit të vitit 2015, në ngjashmëri me amnistinë e mëparshme (2014), edhe kjo amnisti është propozuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, kryesisht me argumentin se ajo ndikon në uljen e mbipopullimit të burgjeve dhe rivendosjen e dinjitetit të të dënuarve.¹² Megjithatë, sikurse theksohet në literaturën vendase dhe të huaj, amnistia mbetet vetëm një nga masat emergjente që mund të ndërmerren nga shteti në një periudhë afatshkurtër në përpjekjen për të ulur mbipopullimin në burgje, duke qenë se ligjet amnistuese “e kanë të pamundur të zgjidhin në afatgjatë” këtë çështje problematike.¹³

⁹ Kuvendi i Shqipërisë, Komisioni i posaçëm parlamentar për reformën në sistemin e drejtësisë, *Analizë e sistemit të drejtësisë në Shqipëri*, Tiranë, 2015, f.156.

¹⁰ Kuvendi i Shqipërisë, Komisioni i posaçëm parlamentar për reformën në sistemin e drejtësisë, *Plani i veprimit për zhvillimin e strategjisë për reformimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri*, Drejtësia Penale: Objektivi 5.

¹¹ Sikurse përcaktohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjet për dhënie amnistie miratohen me shumicën e cilësuar prej 3/5 të deputetëve (shih nenin 81/2/ë).

¹² Relacioni për projektligjin “Për dhënie amnistie” të vitit 2015, si dhe M.F. Aebi, M.M. Tiago, C. Burkhardt, *SPACE I – Council of Europe Annual Penal Statistics: Prison populations. Survey 2014*. Strasbourg: Council of Europe, 2015, f. 26, në faqen e internetit http://wp.unil.ch/space/files/2016/05/SPACE-I-2014-Report_final.1.pdf (Akses më 07/11/2017).

¹³ M.Cavadino, J. Dignan, *The Penal System, An Introduction*, Third Edition, SAGE Publications, London, 2003, f.344, si dhe A. Nikolli, *Politika e caktimit të dënimit penal në Shqipëri*, Disertacion, UET, Tiranë, f.61.

2. Zbatimi i institutit të amnistisë dhe zgjedhja e ligjvënësit në përcaktimin e kriterit ndalues në fushën e veprave penale kundër mjedisit

Duke iu referuar parimeve të lartpërmendura të ligjeve për dhënie amnistie, një element i rëndësishëm, i cili kërkon një vëmendje të veçantë nga ligjvënësi, është përjashtimi i disa veprave penale nëpërmjet përcaktimit të një kriteri ndalues për përfitimin e amnistisë, me synim koordinimin më të mirë të politikës së ndjekur përmes amnistisë me politikën e dënimit të ndjekur nga ligjvënësi për vepra penale të caktuara.

Konkretisht, politika që ndiqet përmes zbatimit të institutit të amnistisë dhe veçanërisht, vlerësimi që kryhet në çdo rast lidhur me veprat penale që do të përfshihen në kriterin ndalues për përfitimin e amnistisë, ka një rëndësi të veçantë edhe në drejtim të garantimit të një luftime sa më efektive kundër kriminalitetit mjedisor që përfaqëson një sfidë të aktualitetit në Republikën e Shqipërisë, duke qenë se kreu i posaçëm në KP mbi veprat penale kundër mjedisit¹⁴ mbetet ende i paharmonizuar plotësisht me Direktivat e Bashkimit Evropian mbi Krimin Mjedisor¹⁵, ndonëse ky kriminalitet çënon një të mirë juridike shumë të rëndësishme, rrezikimi apo dëmtimi i rëndë i të cilës mund të ndikojë jo vetëm në brezin e sotëm, por edhe ato të ardhshëm.

Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, që në Rezolutën e tij të parë të viteve 1970 mbi kontributin e të drejtës penale për mbrojtjen e mjedisit, është shprehur specifikisht në lidhje me zbatimin e kësaj “mase të përgjithshme faljeje” për veprat penale kundër mjedisit, duke rekomanduar “*përjashtimin nga amnistia të veprave penale serioze që drejtohen kundër mjedisit*”.¹⁶

Duke iu referuar qëndrimit të mbajtur nga ligjvënësi shqiptar lidhur me zbatimin e institutit të amnistisë ndër vite në fushën e veprave penale kundër mjedisit, vlen të theksohet se, në kriterin ndalues për përfitimin e amnistisë të miratuar në vitin 2014, për herë të parë, janë përfshirë edhe dy krime kundër mjedisit të parashikuara në kreun e veçantë të Pjesës së Posaçme të KP. Konkretisht, nga kjo amnisti janë përjashtuar shprehimisht personat e dënuar për dy krimet serioze në fushën e pyjeve dhe mjedisit pyjor, të shtuara në KP në vitin 2008: shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor (neni 206/a), si dhe shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor (neni 206/b).¹⁷

¹⁴ Kreu IV i Pjesës së Posaçme të KP.

¹⁵ Direktiva 2008/99/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 19 Nëntor 2008 mbi mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet të drejtës penale (Official Journal of the European Union L 328, 6/12/2008), si dhe Direktiva 2009/123/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 21 tetor 2009 që ndryshon Direktivën 2005/35/KE mbi ndotjen e shkaktuar nga anijet dhe parashikimin e dënimeve për shkeljet (Official Journal of the European Union L 280, 27/10/2009).

¹⁶ Rezoluta (77) 28 mbi kontributin e të drejtës penale për mbrojtjen e mjedisit, miratuar nga Komiteti i Ministrave në datën 28.09.1977, Rekomandimi 4(d).

¹⁷ Neni 6/1/g i ligjit nr. 22, datë 10.03.2014 “Për dhënie amnistie”.

Një përjashtim i tillë, i cili përbën një hap përpara në këtë drejtim, korrespon- don me politikën e ashpër që është ndjekur në vijimësi nga ligjvënësi lidhur me këto dy krime mjedisore, duke filluar që është ndjekur në vijimësi nga ligjvënësi lidhur me këto dy krime mjedisore, duke filluar që nga momenti kur ato janë shtuar në KP në vitin 2008, si të vetmet krime kundër mjedisit të dënueshme me një sanksion kumulativ, si dhe duke vijuar më tej me ashpërsimin e dënimit me burgim të parashikuar për secilën prej tyre, pas shfuqizimit të sanksionit kumulativ.¹⁸ Megjithatë, duke iu referuar të dhënave statistikore, rezultojnë një mungesë pothuajse e plotë e zbatimit në praktikë të dënimeve të parashikuara për këto krime serioze, veçanërisht për krimin e kryer me dashje.¹⁹

Ndërkohë, për të gjithë veprat e tjera penale kundër mjedisit, për të cilat do të mund të përfitohej nga amnistia e vitit 2014, personat e dënuar për kryerjen e tyre do të përfitonin nga ligji i ri edhe nëse ata i ishin shmangur ekzekutimit të dënimit të dhënë, pasi në dallim nga amnistia e mëparshme e vitit 2012,²⁰ në këtë ligj nuk ishte parashikuar një përjashtim për këtë kategori të të dënuarve. Kjo mund të vlerësohet si një hap prapa në këtë drejtim, duke patur parasysh qëndrimin mospërfillës që ka treguar i dënuari në raste të tilla për ligjin dhe sistemin e drejtësisë penale në tërësi. Përjashtimi i kësaj kategorie të veçantë të të dënuarve, të cilët nuk mund të konsiderohen si persona me rrezikshmëri të ulët, do të shërbente më së miri për respektimin e plotë të parimeve të shpallura për dhënien e amnistisë, një prej të cilave është edhe rrezikshmëria e ulët e personave që amnistohen.

Vlen të theksohet se veprat penale kundër mjedisit ishin parashikuar vetëm në kriterin ndalues për amnistinë e dënimit, ndonëse, për herë të parë, ligji i vitit 2014 parashikonte një kriter ndalues edhe për përfitimin nga amnistia e veprës penale për kundërvajtjet penale.²¹ Në këtë të fundit nuk është përfshirë asnjë nga kundërvajtjet penale kundër mjedisit. Ndërkohë që, vihet re se, ndër kundërvajtjet penale të listuara në kriterin ndalues, të parashikuar në nenin 6/2 të këtij ligji,²² janë përfshirë edhe disa kundërvajtje penale për të cilat KP parashikon, si alternativë të dënimit me gjobë, dënimin me burgim me një maksimum shumë të ulët, sikurse është rasti i kundërvajtjes penale të “Organizimit të lotarive të palejuara”, të parashikuar në nenin 197 të KP, me një sanksion që përfshin, në formë alternative, dënimin me gjobë dhe dënimin me burgim në maksimum deri në tre muaj.

¹⁸ Shtesa dhe ndryshime të bëra përkatësisht me ligjin nr. 10 023, datë 27.11.2008 dhe ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013.

¹⁹ Ministria e Drejtësisë, *Vjetari Statistikor* për vitet 2004-2015.

²⁰ Shih nenin 4/2 të ligjit nr. 107, datë 8.11.2012 “Për dhënie amnistie”.

²¹ Në bazë të nenit 5 të ligjit nr. 22/2014: “Amnistohen nga ndjekja penale të gjithë personat, të cilët deri në datën 31 dhjetor 2013 kanë kryer vepra penale, të cilat parashikojnë një dënim në maksimum deri në dy vjet burgim ose çdo lloj dënimi tjetër më të lehtë, me përjashtim të veprave të parashikuara në pikën 2 të nenit 6 të këtij ligji.”

²² Kjo dispozitë e ligjit parashikon edhe disa vepra penale të cilat janë të dënueshme me burgim në maksimum deri në 3 vjet, ndonëse ajo përcakton veprat penale për të cilat nuk mund të përfitohet nga parashikimet e nenit 5 të këtij ligji mbi amnistinë nga ndjekja penale.

Duke patur parasysh shkallën e rrezikshmërisë shoqërore që po paraqesin disa nga veprat penale kundër mjedisit, të cilat aktualisht parashikohen si kundërvajtje penale, do të kishte qenë një hap tejet pozitiv dhe me vlerë të veçantë edhe në drejtim të ndërgjegjësimit të shoqërisë për veprat penale mjedisore, nëse ligjvënësi do të kishte përfshirë edhe këto kundërvajtje penale në kriterin ndalues të amnistisë së veprës penale, për sa kohë që ekzistonte një kriter i tillë për kundërvajtjet penale. Në bazë të të dhënave statistikore, në përgjithësi, çështjet gjyqësore me persona të dënuar për vepra penale kundër mjedisit janë të përqendruara vetëm në këto katër kundërvajtje penale: prerja e paligjshme e pyjeve (neni 205), peshkimi i ndaluar (neni 204), ndotja e ajrit (neni 201/1), si dhe prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë (neni 206).²³

Në një rast konkret,²⁴ për shkak të ligjit “Për dhënie amnistie” të vitit 2014, Gjykata e Apelit Tiranë ka prishur vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër dhe ka vendosur pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit A.L., i akuzuar për veprën penale të prerjes së paligjshme të pyjeve.

Më datë 17.07.2013 i pandehuri ishte kapur në flagrancë nga punonjësit e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Dibër duke prerë lëndë drusore pa leje, me vlerë 240 000 lekë. Sikurse arsyeton Gjykata e Apelit Tiranë, tre kushtet e parashikuara në ligjin për amnistinë plotësoheshin në këtë rast konkret, pasi:

1) i pandehuri veprën penale e kishte kryer para datës 31 dhjetor 2013 (në datë 17 korrik 2013),

2) vepra penale për të cilën po ushtrohej ndjekja penale ndaj tij parashikon një dënim në maksimum deri në një vit burgim (neni 205 KP),

3) vepra penale nuk përjashtoj nga amnistia sipas përcaktimeve të nenit 6/2 të ligjit.

Ndër risitë e ligjit “Për dhënie amnistie” të vitit 2014, vlen të theksohet edhe përfshirja e një dispozite të veçantë mbi çështjen e efekteve të amnistisë në të drejtat civile në procesin penal, e cila lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me çështjen e riparimit të dëmit të shkaktuar nga vepra penale, dhe si e tillë, është veçanërisht e rëndësishme edhe në rastin e veprave penale kundër mjedisit. Konkretisht, e drejta e viktimit të veprës penale për të vazhduar ndjekjen e padisë së pashqyrtuar nga gjykata penale në një gjykatë civile, është garantuar shprehimisht në nenin 7 të këtij ligji, në të cilin është theksuar se “nga zbatimi i këtij ligji nuk cënohen të drejtat civile në procesin penal”.

Duke iu referuar ligjeve pasuese për dhënie amnistie, konstatohet një qëndrim pothuajse konstant i ligjvënësit lidhur me përcaktimin e kriterit ndalues në fushën e veprave penale kundër mjedisit. Kështu, në ligjin e miratuar vetëm një vit më

²³ Ministria e Drejtësisë, *Vjetari Statistikor* për vitet 2004-2015.

²⁴ Vendimi nr. 30-2015-1466, datë 16.03.2015 i Gjykatës së Apelit Tiranë (dokumenti i marrë nga www.gjykata.gov.al)

pas (2015), në kriterin ndalues për amnistinë e dënimit janë përfshirë të njëjtët krime kundër mjedisit (shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor, si dhe shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor), ndonëse, tashmë, me përjashtimin e personave të dënuar që i janë shmangur ekzekutimit të dënimit të dhënë, për të cilët është parashikuar shprehimisht se nuk përfitojnë nga kjo amnisti.²⁵

Ndërkohë, në këtë ligj nuk janë parashikuar amnistia nga ndjekja penale, kriteri ndalues për përfitimin nga kjo amnisti për kundërvajtjet penale, si dhe dispozita e veçantë mbi çështjen e efekteve të amnistisë në të drejtat civile në procesin penal.

Në ligjin më të fundit për dhënie amnistie, të vitit 2016, janë përfshirë sërish të dy llojet e amnistisë (të ndjekjes penale dhe të dënimit), si dhe dispozita e veçantë mbi të drejtat civile në procesin penal, por ndërkohë, në dallim nga dy ligjet e mëparshme, në kriterin ndalues për amnistinë e dënimit është përjashtuar paragrafi i parë i nenit 206/b, në të cilin parashikohet figura e thjeshtë e krimit të shkatërrimit nga pakujdesia me zjarr të pyjeve dhe të mjedisit pyjor.²⁶ Pra, tendenca ka qenë drejt zgjerimit të fushës së zbatimit të amnistisë në këtë drejtim, krahasuar me ligjet e dy viteve më parë.

Në ngjashmëri me ligjin e mëparshëm të vitit 2015, në po të njëjtën dispozitë mbi kriterin ndalues për përfitimin e amnistisë, është parashikuar se nuk përfitojnë nga kjo amnisti “personat, të cilët i janë shmangur drejtësisë, qofshin këta shtetas që i janë shmangur autoritetit të ndjekjes penale apo të dënuar që i janë shmangur ekzekutimit të vendimit të dhënë”. Ndërkohë, kriteri ndalues i parashikuar për amnistinë e vitit 2016 është shtrirë edhe mbi përsëritësit e së njëjtës vepër penale.²⁷

Lidhur me amnistinë nga ndjekja penale, sërish nuk është përjashtuar asnjë nga kundërvajtjet penale kundër mjedisit. Si rrjedhim, personat që kanë kryer kundërvajtjen penale të prerjes së paligjshme të pyjeve do të mund të përfitojnë edhe nga kjo amnisti, ndonëse në muajin shkurt të të njëjtit vit është miratuar një ligj për moratoriumin në pyje. Ndërkohë, në dispozitën mbi amnistinë nga ndjekja penale është parashikuar se nga kjo amnisti nuk do të përfitonin personat që i ishin shmangur ndjekjes penale apo procesit hetimor nga autoriteti publik i ushtrimit të ndjekjes penale deri në datën 25.12.2016, por në dallim nga kriteri ndalues i lartpërmendur mbi amnistinë e dënimit, në këtë përjashtim nuk janë përfshirë përsëritësit e të njëjtës vepër penale.

²⁵ Neni 5, pika 1, shkronja “g”, si dhe neni 5, pika 2 e ligjit nr.154/2015 “Për dhënie amnistie”.

²⁶ Në nenin 4/gj parashikohet se nuk përfitojnë nga kjo amnisti personat e dënuar për “vepra penale kundër mjedisit, të parashikuara në nenin 206/a, në paragrafin e dytë të nenit 206/b, të Kodit Penal”.

²⁷ Neni 4, pika 3 e ligjit nr.141/2016 “Për dhënie amnistie”.

3. KONKLUZIONE

Duke qenë se është e nevojshme që të ketë një koordinim midis politikës që ndiqet përmes ndryshimeve në KP dhe ligjeve që miratohen për dhënie amnistie, në fushën e veprave penale kundër mjedisit, në pamje të parë, duket se ka koherencë duke filluar nga amnistia e vitit 2014, meqenëse janë marrë parasysh ndryshimet ashpërsuese në kreun përkatës të KP.

Megjithatë, duke marrë në konsideratë se në amnistitë e fundit është shtuar një kriter ndalues edhe për kundërvajtjet penale, si dhe duke u bazuar në faktin se prej vitesh tashmë në strukturën e kriminalitetit mjedisor në Republikën e Shqipërisë mbizotërojnë veprat e cilësuar si kundërvajtje penale (kryesisht ato në fushën e pyjeve për të cilët tashmë është miratuar edhe një moratorium 10-vjeçar), atëherë sërish ka hapësirë për përmirësime të mundshme në këtë drejtim, krahas përmirësimeve të nevojshme në lidhje me vetë aplikimin e institutit të amnistisë në përgjithësi.

Ndërkohë, në perspektivën e ndryshimeve të pritshme në KP në fushën e veprave penale kundër mjedisit, në kontekstin e harmonizimit të tij të plotë me Direktivat e Bashkimit Evropian mbi krimin mjedisor (të viteve 2008 dhe 2009),²⁸ në ligjet e ardhshme për dhënie amnistie do të jetë e nevojshme që në kriterin ndalues për përfitimin e amnistisë përkatëse të përfshihen edhe veprat e reja penale, të cilësuar si krime serioze, sikurse është rekomanduar nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës në rezolutën e tij të parë në fushën e mbrojtjes së mjedisit nëpërmjet të drejtës penale.

BIBLIOGRAFIA

- Aebi, M.F., Tiago, M.M., Burkhardt, C. (2015). *SPACE I – Council of Europe Annual Penal Statistics: Prison populations. Survey 2014*. Strasbourg: Council of Europe, 2015, në faqen e internetit http://wp.unil.ch/space/files/2016/05/SPACE-I-2014-Report_final.1.pdf
- Cavadino, M., Dignan, J., *The Penal System, An Introduction*, Third Edition, SAGE Publications, London, 2003.
- Kambovski, V., *E drejta penale, Pjesa e Përgjithshme*, Botim i dytë, Furkan ISM, Shkup, 2007.
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Kuvendi i Shqipërisë, Komisioni i posaçëm parlamentar për reformën në sistemin e drejtësisë, *Analizë e sistemit të drejtësisë në Shqipëri*, Tiranë, 2015, në faqen e internetit <https://reformatdrejtesi.al/dokumenti-analitik>
- Kuvendi i Shqipërisë, Komisioni i posaçëm parlamentar për reformën në

²⁸ Shih Strategjinë e Reformës në Sistemin e Drejtësisë, 2015, f.25.

sistemin e drejtësisë, *Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë dhe Plani i veprimit për zhvillimin e strategjisë për reformimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri*, në faqen e internetit <https://reformanedrejttesi.al/dokumenti-strategjik-dhe-plani-i-veprimit>

- Ligjet për dhënie amnistie të viteve 1997-2016.
- Ministria e Drejtësisë, *Vjetari Statistikor* për vitet 2004-2015.
- Nikolli, A., *Politika e caktimit të dënimit penal në Shqipëri*, Disertacion, UET, Tiranë, në faqen e internetit <http://www.uet.edu.al>
- Relacion për projektligjin “Për dhënie amnistie” të vitit 2015, në faqen e internetit <https://www.parlament.al/dokumentacioni/projektligje/>
- Rezoluta (77) 28 mbi kontributin e të drejtës penale për mbrojtjen e mjedisit, miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës në datën 28.09.1977.
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 16, datë 19.04.2010.
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.1, datë 20.01.2014.
- www.gjykata.gov.al

VËSHTRIM I SHKURTËR HISTORIK I LEGJISLACIONIT PENAL SHQIPTAR PËR VEPRAT PENALE TË TRAFIKIMIT

PROF. ASOC. DR. Ilir RUSI
Pedagog, Fakulteti i Drejtësisë UT
ilirusi@yahoo.com

PROF. ASOC. DR. Dorina HOXHA
Pedagog, Fakulteti i Drejtësisë UT
dorina.hoxha@fdut.edu.al

ABSTRAKT

Nga llojet e ndryshme të veprave penale që parashikohen në Kodin Penal, veprat penale të trafikimit, paraqesin një rrezikshmëri të madhe shoqërore, pasi çënojnë, në të njëjtën kohë, si të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, ashtu edhe rendin juridik në tërësi. Për këtë arsye, parashtrimi i mënyrës se si ka evoluar legjislacioni penal në Shqipëri për këtë kategori veprash penale dhe sidomos, diskutimi i problemeve juridike që kanë dalë në lidhje me kuptimin e drejtë të këtyre veprave penale, mendojmë se, paraqet një interes të veçantë për studiuesit e së drejtës.

Punimi do të përbëhet nga dy çështje kryesore; në çështjen e parë do të trajtohet evoluimi i legjislacionit penal shqiptar përse i përket veprave penale të trafikimit, ndërsa, në çështjen e dytë do të ndalemi tek problemet praktike që kanë dalë në lidhje me kuptimin e drejtë të këtyre veprave penale.

Në fund të këtij punimi do të jepen edhe disa konkluzione në lidhje me çështjet e trajtuara, ku padyshim do të konstatohet se parandalimi, hetimi dhe gjykimi i drejtë i veprave penale që kanë të bëjnë me trafikimin, si vepra penale me rrezikshmëri të madhe shoqërore, përbën një nga sfidat e shoqërisë shqiptare, me funksion final, ndërtimin e shtetit të së drejtës dhe integrimin e Shqipërisë në familjen e madhe evropiane.

***Fjalë kyçe:** trafikimi, vepër penale, traditë juridike, shtet i së drejtës, integrim evropian.*

1. Evoluimi i veprave penale të trafikimit nga shpallja e pavarësisë së Shqipërisë

Duke iu referuar aspektit historik në Shqipëri, veprat penale të trafikimit, ku përfshihen të tre kategoritë, ato të trafikimit të personave, të trafikimit të narkotikëve dhe trafikimit të armëve dhe municionit, janë përgjithësisht një fenomen i shoqërisë së sotme bashkëkohore, të cilat kanë lindur në kushtet e qarkullimit të lirë të mallrave, personave, shërbimeve dhe kapitaleve, shtuar kësaj edhe globalizimin e

ekonomisë dhe shoqërisë së sotme. Për këtë arsye, këto vepra penale, me përjashtim të veprave penale të trafikimit të personave, të cilat kanë qenë të parashikuara vetëm në Kodin Penal të Zogut, dhe në asnjë prej Kodeve të mëpasshme të shtetit monist, nuk kanë qenë të parashikuara më parë në legjislacionin penal shqiptar, për vetë kushtet e zhvillimit historik të Shqipërisë.

Kështu, përsa i përket periudhës së viteve 1912-1924, kjo periudhë e cila i takon dekadës së parë të pasformimit të shtetit të ri shqiptar, Shqipëria nuk ishte konsoliduar ende si shtet në kuptimin e plotë të fjalës, për pasojë edhe legjislacioni penal nuk ishte i plotë. Kësaj gjendjeje në Shqipëri, i duhen shtuar edhe rrethana të jashtme ndërkombëtare, siç ishte Lufta e Parë Botërore, ku vendi ynë për katër vjet 1914-1918, qëndroi i pushtuar duke mos ekzistuar si shtet i pavarur, si dhe fakti se edhe në shtetet e tjera këto vepra penale ende nuk ishin shumë të përhapura dhe ende nuk përbënin një rrezik serioz për shoqërinë në tërësi.

Në periudhën e viteve 1925-1939, Shqipëria u konsolidua plotësisht si shtet i pavarur, ku u krijuan dhe funksionuan rregullisht të gjitha institucionet shtetërore, për herë të parë në të gjithë territorin e vendit, dhe ku u bënë hapa në drejtim të pajisjes së vendit me një legjislacion modern, në përputhje me kohën. Në këto kushte, nga ana e Kodit Penal të Zogut, i cili hyri në fuqi në vitin 1927, në ndryshim nga Kodet e mëpasshme penale të shtetit monist, madje në ndryshim edhe nga Kodi Penal i ri, i vitit 1995, në kohën e miratimit të tij, gjenden të parashikuara dy dispozita penale që trajtojnë çështjen e trafikimit të personave, ndërkohë që as në këtë Kod dhe as në Kodet e mëpasshme të shtetit monist, nuk ka ndonjë dispozitë që të parashikojë trafikimin e narkotikëve dhe atë të armëve dhe municionit.

Në lidhje me veprën penale të trafikimit të personave, kjo veprë penale ishte parashikuar nga Kodi Penal i Zogut në nenet 161 dhe 162 të tij, ku në nenin 161 të këtij Kodi ishte parashikuar vepra penale e skllavërisë, ndërsa në nenin 162 të tij ishte parashikuar vepra penale e rrëmbimit të personit. Kështu, konkretisht neni 161 i Kodit Penal të Zogut, ka këtë përmbajtje:

- “Kushdo që, vë një njeri në rrobëri ose në të tjera gjendje analoge, ndëshkohet me burgim të randë nga dymbëdhjetë deri në njëzet vjet”.

Nga ana tjetër, po ky Kod parashikon:¹

- “Kushdo që, jashtë ligjës, privon ndonjë njeri nga liria vetjake, ndëshkohet me burgim të randë nga një muaj deri në pesë vjet dhe me gjobë të randë deri në një mijë fr. ari.

Në qoftë se fajtori, për të kryemit e veprës ose sa vazhdon ajo, përdor mundime, frikësime, dhëlpënina ose e ban atë veprë me qëllim vendete ose fitimi, ose me qëllim ose me pretekst fetar, ose e dorëzon personin për një shërbim ushtarak përjashta, ndëshkimi asht me burgim të randë nga tre deri në tetë vjet dhe me gjobë të randë nga pesëqind, deri në tre mijë fr. ari.

Në qoftë se kjo veprë bahet kundra prindit ose kundra burrit ose grues, ose kundër një anëtari të Dhomave Legjisllative, ose kundër një nëpunësi të Shtetit për

¹ Neni 162 i Kodit Penal i Zogut, i vitit 1927

shkak të nëpunësisë së tij ose nga vepra i shkaktohet të damtuemit një dam i randë në personin, në shëndetin ose në pasuninë e tij, ndëshkimi asht me burgim të randë nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë të randë nga një mijë deri në pesë mijë fr. ari.

Ndëshkimit i zbritet një e gjashta deri në gjysmën, në qoftë se fajtori liron me dashjen e vet atë person para se të bahet çdo veprim ndjekjeje, pa që t' i ketë mbërritë qëllimit dhe pa që t' i ketë shkaktue ndonjë dam”.

Duke i bërë një analizë të shkurtër juridike nenit 161 të Kodit Penal të vitit 1927, i cili parashikon veprën penale të “Skllavërisë” ose të “Robërisë”, konstatohet si ky Kod, ka parashikuar në fakt një nga format kryesore të veprave që kanë të bëjnë me trafikimin, dhe që është konkretisht trafikimi i personave, i cili përbën edhe një nga veprat penale që paraqet rrezikshmëri më të madhe shoqërore, krahasuar kjo me dy llojet e tjera të veprave penale, ato të trafikimit të narkotikëve dhe të armëve dhe municionit.

Neni 162 i Kodit Penal, të vitit 1927, parashikon rrëmbimin e personit, si vepër penale, duke u ndërtuar në disa paragrafe, ku në paragrafin e parë parashikohet heqja e paligjshme e lirisë, në paragrafin e dytë parashikohet rrëmbimi i personit, në paragrafin e tretë, parashikohet rrëmbimi i personit në rrethana cilësuese, dhe në paragrafin e katërt, parashikohet, rrëmbimi i personit në rrethana lehtësuese. Të gjitha këto forma të rrëmbimit të personit, me përjashtim të paragrafit të katër të këtij neni, përbëjnë në vetvete, forma të kryerjes së veprës penale të trafikimit të personave, sipas Kodit Penal në fuqi, sepse ashtu siç mund të konstatohet nga përmbajtja e nenit 110/a të Kodit Penal në fuqi, rrëmbimi i personit, është një nga format e kryerjes së veprës penale të trafikimit të personave, dhe ndoshta një nga format më të rrezikshme të saj.

Për sa i përket periudhës së viteve 1945-1990, në Shqipëri u vendos shteti komunist dhe gjatë gjithë kësaj periudhe u miratuan dy Kode Penale, ai i vitit 1952, me ndryshimet e mëvonshme dhe Kodi Penal i vitit 1977, i cili me disa ndryshime qëndroi në fuqi, deri në miratimin e Kodit Penal të ri, në vitin 1995, në të dy këto Kode konstatohet se nuk është parashikuar asnjë vepër penale që ka të bëjë me trafikimin.

Me miratimin e Kodit të ri Penal të vitit 1995, i cili u miratua me ligjin 7895, datë 27.1.1995 dhe që hyri në fuqi më datë 1 qershor 1995, u vendosën bazat e një legjilacioni penal modern në Shqipëri, duke shënuar një hap të madh përpara drejt demokratizimit të sistemit ligjor në tërësi dhe atij penal në veçanti.

Vepra penale e trafikimit të narkotikëve, u parashikua për herë të parë, në Kodin Penal shqiptar, në vitin 1997, me ligjin nr. 8175, në nenin 33 të tij, pra, rreth dy vite pas miratimit të Kodit të ri Penal. Përcaktimi i bërë nga ligji i mësipërm i veprës penale të “Trafikimit të narkotikëve”, mendoj se ishte i pasaktë dhe e bënte të vështirë zbatimin e drejtë dhe ligjor të kësaj vepre penale në praktikë. Pas shfuqizimit në tërësi të ligjit nr. 8175 i vitit 1997 nga ana e Gjykatës Kushtetuese, ku për pasojë u shfuqizua edhe neni 33 të tij, nga ana e ligjvënësit një vit më vonë,

konkretisht me ligjin nr. 8279, datë 15.01.1998, u parashikua përsëri vepra penale e trafikimit të narkotikëve.

Formulimi që iu bë veprës penale të trafikimit të narkotikëve me ligjin e ri nr. 8279, datë 15.01.1998, përbënte në vetvete, thjesht një kopjim të paragrafit të dytë të këtij neni, i cili ishte parashikuar me ligjin nr. 8175 të vitit 1997. Kuptohet se një parashikim ligjor për veprën penale të “Trafikimit të narkotikëve”, e cila po bëhej gjithnjë e më shumë shqetësim serioz për shoqërinë shqiptare, nuk mund ta kishte jetën e gjatë, dhe për këtë arsye u ndryshua në vitin 2001, me ligjin nr. 8733, datë 24.1.2001.

Në nenin 64 të këtij ligji, u parashikua më së fundi, në mënyrën e duhur ligjore vepra penale e “Trafikimit të narkotikëve”, e cila është në fuqi edhe sot me të njëjtën përmbajtje. Nga ana tjetër, formulimi që kishte neni 283/a i Kodit Penal sipas ligjit nr. 8279, datë 15.01.1998, u kalua me të drejtë me anë të ligjit nr. 8733, datë 24.1.2001, me nenin 65 të tij, në një vepër penale më vete, duke u shtuar neni 283/b i Kodit Penal, e cila u titullua “Krijimi i lehtësirave për marrjen dhe përdorimin e drogës”, me të njëjtën përmbajtje siç ishte në nenin 283/a të ligjit të mëparshëm dhe ku tashmë titulli i dispozitës është në përputhje me përmbajtjen e saj dhe kjo dispozitë është plotësisht e qartë dhe e plotë.

Përsa i përket veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore, kjo vepër penale, po ashtu, nuk u parashikua në Kodin Penal të ri, në vitin 1995, në kohën e miratimit të tij, por, u parashikua për herë të parë në vitin 2001, e cila parashikoi në vetvete, tre dispozita penale. Përsa i përket përmbajtjes së këtyre dispozitave, duhet thënë se këto dispozita nuk e përcaktonin me elementë të qartë, anën objektive të këtyre veprave penale, gjë e cila bëhej në aktet ndërkombëtare dhe që kishte rëndësi të madhe, për kuptimin e drejtë të natyrës juridike të këtyre veprave penale. Për këtë arsye, dispozitat e mësipërme të Kodit Penal, u ndryshuan në vitin 2004, me ligjin nr. 9188, datë 12.2.2004, i cili nga ana e tij bëri një përcaktim të saktë dhe të qartë të përmbajtjes së veprave penale të trafikimit të personave, në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe i ndërtoi këto dispozita në disa paragrafe, duke parashikuar në secilin prej tyre, rrethana cilësuese, në kryerjen e këtyre veprave penale.

Vepra penale e trafikimit të armëve dhe municioneve, u parashikua në Kodin e ri Penal, po ashtu në vitin 2001, në nenin 278/a të tij, me dy paragrafe, ku duhet thënë që në fillim se kjo vepër u hartua nga ligjvënësi në përputhje me standardet ndërkombëtare, dhe në zbatimin në praktikë të saj, janë shfaqur më pak probleme se për dy llojet e tjera të trafikut, atë të trafikimit të personave dhe atë të trafikimit të narkotikëve.

2. Analizë e shkurtër juridike në lidhje me veprat penale të trafikimit dhe problemet e dala nga zbatimi në praktikë i tyre, në këndvështrim historik

Analizën juridike të veprave penale të trafikimit do ta nisim me veprat penale të trafikimit të personave, të cilat, siç u tha më lart, parashikohen në tre dispozita të veçanta dhe konkretisht në nenet 110/a, të quajtur: “Trafikimi i personave”,

nenin 114/b, të quajtur “Trafikimi i femrave” dhe nenin 128/b, të quajtur “Trafikimi i të miturve”, për faktin se kjo veprë penale paraqet rrezikshmëri më të madhe shoqërore, krahasuar me dy llojet e tjera të trafikimit, por, edhe për faktin se kjo veprë është në kundërshtim me rregullat morale dhe zakonet e mira të popullit shqiptar.² Në trajtimin e shkurtër juridik që do t’i bëjmë kësaj veprë penale, po ashtu, duhet të themi se, ne do të ndalemi vetëm tek analiza juridike e veprës penale të: “Trafikimi i personave”, të parashikuar nga neni 110/a të Kodit Penal, pasi elementët e kësaj veprë penale, janë të njëjta me veprat penale të: “Trafikimi i femrave” dhe “Trafikimi i të miturve”, të parashikuara nga nenet 114/b dhe 128/b të këtij Kodi, dhe rregullat juridike që vlejné për këtë veprë penale, vlejné edhe për dy veprat e tjera.

Duke iu referuar përmbajtjes së nenit 110/a të Kodit Penal, i cili parashikon veprën penale të: “Trafikimi i personave”, rezulton se objekti i kësaj veprë penale, është i dyfishtë, nga njëra anë janë, marrëdhëniet juridike të vendosura për të mbrojtur dhe garantuar lirinë e personit, shëndetin dhe jetën e tij, nga ana tjetër, janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar rendin juridik në tërësi, kjo për faktin se nisur nga rrezikshmëria e lartë që paraqet kjo veprë penale, nga kryerja e saj çenohet jo vetëm liria, shëndeti dhe jeta e personit, por edhe rendi juridik në tërësi.

Nga pikëpamja e anës objektive, kjo veprë penale, në çdo rast përbëhet nga tre elementë, që duhet të ekzistojnë në të njëjtën kohë dhe që janë:

a) Elementi i parë është: rekrutimi, transportimi ose transferimi ose fshehja apo pritja e personave;

b) Elementi i dytë është që: rekrutimi ose transportimi se transferimi ose fshehja apo pritja e personave të bëhet nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfutimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër;

c) Elementi i tretë është që: rekrutimi ose transportimi se transferimi ose fshehja apo pritja e personave, e bërë nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfutimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, të bëhet me qëllimin e posaçëm të shfrytëzimit të prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose të transplantit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit.

Subjekt i kësaj veprë penale, është subjekti i përgjithshëm, çdo person që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, dhe është i përgjegjshëm para ligjit.

² - Kodi Penal i vitit 1995

Nga ana subjektive kjo vepër kryhet në çdo rast me dashje direkte dhe me qëllim përfitimin material ose jo material.

Përsa i përket problemeve që ka hasur zbatimi në praktikë i kësaj vepre penale, duhe thënë se probleme ka patur në përcaktimin e momentit se kur vepra konsiderohet e kryer dhe për pasojë nëse, kjo vepër ngel apo jo në fazën e tentativës. Në lidhje me problemin e parë, mendojmë se kjo vepër konsiderohet e kryer plotësisht që në momentin kur subjekti i veprës penale, ka kryer rekrutimin ose transportimin ose transferimin ose fshehjen apo pritjen e të dëmtuarit, veprime këto që duhet të jenë bërë nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfutimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike ose dhënie apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër dhe me qëllimin e posaçëm shfrytëzimit e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose të transplantit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit dhe nuk kërkohet që të jetë bërë transferimi i personit jashtë shtetit, apo të ketë filluar shfrytëzimi i tij.

Në lidhje me problemin tjetër, nëse kjo vepër penale mbetet apo jo në tentativë, duke u nisur nga mënyra sesi është formuluar neni 110/a i Kodit Penal që e parashikon këtë vepër penale, sipas të cilës, rëndësi vendimtare për t'u konsideruar si e kryer plotësisht kjo vepër ka thjesht vetëm qëllimin për të trafikuar personin dhe jo realizimin e qëllimit, mendojmë se kjo vepër penale nuk mund të mbetet në tentativë, ajo ose është kryer plotësisht, në rast kur plotësohen të gjitha elementët e anës objektive të saj, ose nuk është kryer fare, për mungesë të një ose disa prej këtyre elementeve.

Problemi fundit i dalë në praktikë në lidhje me veprën penale të trafikimit të personave, është fakti se kjo vepër penale, sidomos kur flasim për veprën penale të trafikimit të femrave të parashikuar nga neni 114/b i Kodit Penal, është fakti se kjo vepër penale nuk përthithet, por, konkuron me veprën penale të: “Shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese”, të parashikuar nga neni 114/a i Kodit Penal, ose edhe me veprën penale të: “Shfrytëzimit të prostitucionit” të parashikuar nga neni 114 i Kodit Penal, pasi vepra penale e trafikimit të personave kryhet edhe pa patur nevojë për ta zhvendosur personin jashtë shtetit.

Vepra penale e “Trafikimit të narkotikëve”, është parashikuar në nenin 283/a të Kodit Penal, nga përmbajta e të cilës rezulton se, objekt i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura nga aktet kombëtare (konkretisht neni 283/a/2 i Kodit tonë Penal) dhe aktet ndërkombëtare (konkretisht gërma “m” e nenit 1 të “Konventës mbi drogat narkotike” e vitit 1961, e ndryshuar nga Protokollin e vitit 1972, që ndryshon Konventën e vetme mbi drogat narkotike të vitit 1961) dhe që garantojnë qarkullimin në përputhje me ligjin e lëndëve narkotike dhe psikotrope nga njëri shtet në tjetrin. Në rastin konkret me veprimet e tij të kundërligjshme, autori i veprës penale çënon rendin juridik në lidhje me qarkullimin e ligjshëm të

lëndëve narkotike, të dy ose më shumë shteteve, çka e përbën këtë vepër, vepër penale ndërkombëtare, e cila është edhe veçoria kryesore e veprës penale të “Trafikimit të narkotikëve”.

Nga ana objektive, kjo vepër penale, kryhet konkretisht, një ose disa prej formave që dispozita penale, ka parashikuar shprehimisht dhe që janë:

- a) importimi i lëndëve narkotike ose psikotrope, si dhe i farërave të bimëve narkotike ose:
- b) eksportimi i lëndëve narkotike ose psikotrope, si dhe i farërave të bimëve narkotike ose
- c) tranzitimi i lëndëve narkotike ose psikotrope, si dhe i farërave të bimëve narkotike ose
- ç) tregtimi i lëndëve narkotike ose psikotrope, si dhe i farërave të bimëve narkotike.

Se çfarë duhet kuptuar me konceptet “importim”, “eksportim”, “tranzitim” dhe “tregtim” të lëndëve narkotike ose psikotrope, si dhe i farërave të bimëve narkotike, është sqaruar përfundimisht në mënyrë të plotë dhe të qartë, me Vendimin Unifikues³. Duke iu referuar këtij Vendimit Unifikues, në mënyrë të përmblodhur, mund të themi se, vepra penale e “Trafikimit të narkotikëve”, konsiderohet e kryer në formën e importimit, në rastet kur, subjekti, e sjell lëndën narkotike, nga një shtet tjetër, me qëllim për ta futur në territorin e shtetit shqiptar; kjo vepër konsiderohet e kryer në formën e eksportimit, kur subjekti, lëndën narkotike, e dërgon nga Shqipëria, në një shtet tjetër; kjo vepër kryhet në formën e tranzitimit, kur, subjekti lëndën narkotike, e merr nga një shtet tjetër, e kalon tranzit nëpër territorin e Shqipërisë dhe e dërgon më pas në një shtet tjetër që është shteti i destinacionit, dhe së fundi, kjo vepër konsiderohet e kryer në formën e tregtimit, në rastet kur lënda narkotike është importuar ose tranzituar në Shqipëri dhe më pas i nënshtrohet, tregtimit të saj, në vendin tonë.

Subjekti i kësaj vepre penale, është i përgjithshëm, për çdo person që ka arritur moshën ligjore për përgjegjësi penale dhe është ligjërisht i përgjegjshëm.

Nga ana subjektive, kjo vepër penale kryhet me dashje dhe me qëllim fitimi material ose jo material.

Problemi kryesor i dalë në praktikën gjyqësore, në lidhje me veprën penale të: “Trafikimit të narkotikëve”, e parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, është fakti nëse kjo vepër mund të mbetet në tentativë dhe cilat janë kushtet ligjore për një gjë të tillë, problem i cili është zgjidhur nga Gjykata e Lartë, me Vendimin e mësipërm Unifikues, ku ndër të tjera ka unifikuar praktikën gjyqësore si më poshtë:

a) ...Nëse lënda narkotike, megjithë veprimet a mosveprimet konkrete të drejtpërdrejta të autorëve të veprës për importimin e saj, nuk e ka kaluar kufirin shtetëror shqiptar, për rrethana që nuk varen nga vullneti i tyre, pavarësisht nga koha e vendi i ndërprerjes së veprimit kriminal, vepra penale kualifikohet si trafikim

³ Shih për më tepër: Vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë, nr.3, datë 24.1.2011.

i narkotikëve në mënyrën e importimit e mbetur në tentativë parashikuar nga nenet 283/a dhe 22 të Kodit Penal.

b) ...Nëse lënda narkotike, megjithë veprimet a mosveprimet konkrete e të drejtpërdrejta të autorëve të veprës për eksportimin e saj, nuk e ka kaluar kufirin shtetëror shqiptar, për rrethana që nuk varen nga vullneti i tyre, pavarësisht nga koha e vendi i ndërprerjes së veprimit kriminal në territorin shqiptar, vepra penale kualifikohet si trafikim i narkotikëve në mënyrën e eksportimit e mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 283/a dhe 22 të Kodit Penal.

c) ...Nëse lënda narkotike, me gjithë veprimet a mosveprimet konkrete e të drejtpërdrejta të autorëve të veprës për tregtimin ndërkombëtar të saj, sipas rastit, nuk ka hyrë apo nuk e ka kaluar kufirin shtetëror shqiptar, për rrethana që nuk varen nga vullneti i tyre, pavarësisht nga koha e vendi i ndërprerjes së veprimit kriminal brenda a jashtë vendit, vepra penale kualifikohet si trafikim i narkotikëve në mënyrën e tregtimit ndërkombëtar e mbetur në tentativë parashikuar nga nenet 283/a dhe 22 të Kodit Penal.

ç) ...Kur lënda narkotike, e cila ka hyrë më parë në territorin shqiptar, me gjithë veprimet a mosveprimet e mëtejshme, konkrete e të drejtpërdrejta, të autorëve të veprës për tranzitimin e saj jashtë këtij territori, nuk e ka kaluar kufirin shtetëror shqiptar, për rrethana që nuk varen nga vullneti i tyre, vepra penale kualifikohet si trafikim i narkotikëve në mënyrën e tranzitimit e mbetur në tentativë parashikuar nga nenet 283/a dhe 22 të Kodit Penal, pavarësisht nga koha e vendi i ndërprerjes së këtij veprimi kriminal brenda territorit shqiptar”.

Një tjetër problem i hasur në praktikë, në lidhje me veprën penale të: “Trafikimit të narkotikëve”, është përcaktimi i rasteve se, kur kjo vepër do të konsiderohet si e kryer në bashkëpunim, si dhe më konkretisht çështja nëse, në mënyrë që kjo vepër të konsiderohet si e kryer në bashkëpunim, është e domodoshme të identifikohen në mënyrë të plotë, të paktën dy persona, të cilët me marrëveshje ndërmjet tyre ta kenë kryer veprën penale, duke përcaktuar edhe rolin konkret të secilit në kryerjen e kësaj vepre. Përsa i përket kësaj çështjeje, në praktikën e punës së Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, por, edhe e gjykatave më të larta janë vërejtur qëndrime të ndryshme, qëndrime të cilëve iu dha fund, me Vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë, nr. 4, datë 15.4.2011, e cila unifikoi praktikën gjyqësore në këtë mënyrë: “kur nga pikëpamja e anës objektive provohet se vepra penale është kryer nga dy ose më shumë persona, vepra do të konsiderohet e kryer në bashkëpunim. Kjo si për rastet kur nuk identifikohen bashkëpunëtorët, ashtu edhe për rastet kur bashkëpunëtori nuk ka përgjegjësi penale për shkak të paaftësisë apo moshës për përgjegjësi penale. Cilësitë e veçanta që shtojnë, pakësojnë apo përjashtojnë dënimin merren parasysh vetëm për bashkëpunëtorin tek i cili ato ekzistojnë”.⁴

Në lidhje me veprën penale të: “Trafikimit të armëve luftarake dhe municionit”, objekt i kësaj vepre penale, janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar

⁴ Shih për më tepër: Vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë, nr. 4, datë 15.4.2011.

qarkullimin e rregullt ndërkombëtar të armëve dhe municionit luftarak, në përputhje me legjilacionin shqiptar dhe me aktet ndërkombëtare, nga çdo veprim ose mosveprim kriminal.

Nga ana objektive, kjo vepër penale, kryhet në një ose disa nga këto forma:

a) me anë të importimit të armëve luftarake dhe municionit, domethënë, me futjen e tyre nga jashtë, në territorin e shtetit shqiptar, në kundërshtim me ligjin dhe pa qenë i autorizuar ligjërisht;

b) me anë të eksportimit të armëve luftarake dhe municionit, që do të thotë që armët dhe municioni, dalin nga territori i shtetit shqiptar, drejt një shteti tjetër, në kundërshtim me ligjin dhe procedurat e përcaktuara në ligj;

c) me anë të tranzitimit të armëve luftarake dhe municionit, që do të thotë që armët dhe municioni luftarak, transferohen në mënyrë të kundërligjshme, nga një shtet i huaj, kalojnë nëpër territorin e shtetit shqiptar me qëllim arritjen e destinacionit në një shtet të tretë, i cili është shteti pritës ose i destinacionit;

ç) me anë të tregtimit të armëve luftarake dhe municionit, që do të thotë që armët dhe municioni luftarak, pasi kanë hyrë nga jashtë në territorin e Republikës së Shqipërisë, tregtohen në këtë vend në mënyrë të kundërligjshme.

Subjekt i kësaj vepre penale, është i përgjithshëm, domethënë, çdo person që ka arritur moshën për përgjegjësi penale, dhe është i përgjegjshëm para ligjit për veprimet që kryen.

Nga ana subjektive, kjo vepër penale kryhet me dashje direkte, dhe kryesisht me qëllim realizimin e përfitimeve materiale ose jo materiale.

Përsa i përket problemeve të hasura në praktikë për veprën penale të: “Trafikimit të armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuar nga neni 278/a i Kodit Penal, duhet thënë se problemet në lidhje me këtë vepër penale, janë përgjithësisht të njëjtat me ato të veprës penale të: “Trafikimit të narkotikëve”, pra, që kanë të bëjnë me rastet kur kjo vepër mbetet në tentativë dhe kur ajo konsiderohet e kryer në bashkëpunim. Duke qenë se këto probleme janë trajtuar nga ana jonë, kur është folur për veprën penale të: “Trafikimit të narkotikëve”, si dhe duke u nisur nga fakti se të dy këto vepra, në thelb, përsa i përket elementëve të analizës juridike, janë të ngjashme, i vetmi ndryshim është së në rastin e parë, trafikohet lëndë narkotike, ndërsa në rastin e dytë, trafikohen armë dhe municione luftarake, trajtimi i këtyre problemeve nuk do të bëhet nga ana jonë përsëri, për efekt të mospërsëritjes.

PËRFUNDIME

Nga analiza që iu bë evoluimit historik të veprave penale të trafikimit, mund të nxjerrim këto përfundime:

- veprat penale të trafikimit mund të ndahen në tre grupe kryesore: veprat penale të trafikimit të qenieve njërëzore, veprat penale të trafikimit të narkotikëve dhe veprat penale të trafikimit të armëve luftarake dhe municionit;

- veprat penale të trafikimit të narkotikëve dhe ato të trafikimit të armëve luftarake dhe municionit, kanë si veçori se, janë vepra penale me karakter ndërkombëtar, pra, nga kryerja e tyre nuk çenohet vetëm rendi juridik i shtetit shqiptar, por, edhe rendi juridik, i një ose disa shteteve të tjera;

- nga pikëpamja historike, mund të themi se në përgjithësi, veprat penale të trafikimit, nuk janë parashikuar nga legjislacioni penal shqiptar, para Kodit të ri Penal të vitit 1995, përjashtim bën në këtë drejtim Kodi Penal i Zogut, i vitit 1927, i cili kishte parashikuar veprën penale të trafikimit të personave, në dy forma të kryerjes së saj, atë të vënies në gjendje skllavërie ose robërie dhe atë të rrëmbimit të personit;

- asnjë prej veprave penale të trafikimit, nuk u parashikua në Kodin e ri Penal, në kohën e miratimit të tij në vitin 1995, kjo ndoshta edhe për mungesë të traditës, por, edhe si pasojë e neglizhencës së ligjvënësit;

- problemi kryesor që është hasur në praktikën gjyqësore në lidhje me veprën penale të “Trafikimit të narkotikëve”, është fakti nëse kjo vepër mbetet apo jo në tentativë, gjë që u zgjidh përfundimisht nga Gjykata e Lartë, me Vendimin e saj Unifikues nr. 3, datë 24.1.2011, me anë të të cilit u unifikua praktika gjyqësore, duke u konkluduar se, kjo vepër mund të mbetet në tentativë, si dhe u përcaktuan kriteret ligjore se, kur ajo do të konsiderohet e mbetur në tentativë;

- një problem tjetër i hasur në praktikë në lidhje me këtë vepër penale, i referohet çështjes së indentifikimit apo jo të të paktën dy bashkëpunëtorëve në kryerjen e veprës penale, me marrëveshje ndërmjet tyre, çështje e cila u zgjidh, po ashtu, nga Gjykata e Lartë me Vendimin e saj Unifikues nr. 4, datë 15.4.2011, e cila unifikoi praktikën gjyqësore duke përcaktuar se, nuk është e nevojshme që të identifikohen të paktën dy persona, në mënyrë që vepra të konsiderohet e kryer në bashkëpunim, mjafton që të provohet nga ana objektive kryerja e veprës penale nga dy ose më shumë persona;

- vepra penale e trafikimit të qenieve njerëzore, u parashikua për herë të parë në Kodin e ri Penal, në vitin 2001, në tre dispozita, ku parashikohej në mënyrë të veçantë trafikimi i personave, në përgjithësi, trafikimi i femrave dhe trafikimi i të miturve, por, përmbajtja e dispozitave nuk ishte në përputhje me aktet ndërkombëtare që parashikonin këtë vepër penale;

- problemi kryesor i hasur në lidhje me veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore, posaçërisht, në veprën penale të trafikimit të femrave, është fakti se në shumicën e rasteve, autorët e veprës penale, kryejnë edhe veprën penale të: “Shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese”, të parashikuar nga neni 114/a të Kodit Penal, e cila nuk thithet, por, konkuron me veprën penale të: “Trafikimit të femrave”, të parashikuar nga neni 114/b të Kori Penal, megjithatë nga prokuroria, asnjëherë, nuk është ngritur akuzë edhe për kryerjen e veprës penale të: “Shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese”, të parashikuar nga neni 114/a të Kodit Penal;

- një tjetër problem praktik që është hasur në lidhje me veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore, është se kjo vepër, nga disa autorë, konsiderohet si vepër me karakter ndërkombëtar, gjë që nuk është aspak e vërtetë, pasi veprat penale që kanë të bëjnë me trafikimin e personave, mund të kryhen edhe brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ashtu edhe jashtë këtij territori, dhe përgjegjësia e autorit të veprës penale është e njëjtë, pavarësisht nga fakti se, duhet pranuar që, kur kjo vepër kryhet jashtë territorit shqiptar, ajo paraqet rrezikshmëri më të madhe shoqërore;

- vepra penale e trafikimit të armëve luftarake dhe municionit është parashikuar për herë të parë në Kodin e ri Penal, në vitin 2001, në nenin 278/a të tij dhe parashikimi i bërë prej tij është në përputhje të plotë me aktet dhe standartet ndërkombëtare, dispozitë e cila është aktualisht në fuqi;

- në përgjithësi vepra penale e trafikimit të armëve luftarake dhe municionit, ka pasur probleme më pak në praktikën e punës së Gjykatës për Krime të Rënda, kjo nisur edhe nga përhapja jo shumë e madhe e saj, megjithatë, duhet thënë se për zgjidhjen e problemeve që mund të hasen gjatë zbatimit në praktikë të saj, zbatohen rregullat juridike dhe Vendimet Unifikuese që kanë trajtuar problemet që ka hasur vepra penale e trafikimit të narkotikëve.

BIBLIOGRAFIA

- Kodi Penal i Zogut, i vitit 1927;

- Ligj nr. 1470, datë 23.5.1952 “Kodi Penal i Republikës Popullore të Shqipërisë”, hyrë në fuqi me 1 shtator 1952;

- Ligj nr. 5591, datë 15.6.1977 “Kodi Penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, hyrë në fuqi me 1 tetor 1977;

- Kodi Penal i vitit 1995;

- Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë, nr.3, datë 24.1.2011

- Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë, nr. 4, datë 15.4.2011.

DISA PROBLEMATIKA AKTUALE NË TË KUPTUARIT E FIGURËS SË VEPRËS PENALE “MJEKIM I PAKUJDESSHËM” NË OPTIKËN E SË DREJTËS PENALE TË KRAHASUAR

Dr. Rezarta DEMNERI¹
Arnisa GOREZI, PhD²

*A Comparative Law Analysis of a Few Current Issues Concerning
the Understanding of the Figure of Crime “Negligent Medication”*

ABSTRACT

This paper aims to present a brief analysis of several issues surrounding the understanding of the figure of crime “*Mjekimi i pakujdesshëm*” (Negligent medication) provided by Article 96 of the Albanian criminal code. Due to the void in the Albanian doctrine and jurisprudence, the Italian regulation will serve as a reference point, by so enabling the chosen comparative law perspective. The two criteria upon which this analysis will be carried on are the degree of culpability in the conduct of the physician and the seriousness of harm to the health of the patient. The risk of equating these two criteria is significant considering how shallow the Albanian doctrine exploring the criminal relevance of medical negligence is. Empirical ground of the evolution of the criminal liability of the physician shall be provided by referring to the jurisprudence of the Albanian as well as Italian Supreme Court. This method would also highlight the eventual challenges to be expected from the reformulation of the Article 96 of the criminal code, as proposed by the Albanian Ministry of Justice.

Keywords: *medical negligence, criminal liability of the physician, degrees of culpability, Albanian regulation, Italian regulation.*

HYRJE

Motivacioni për shkrimin e këtij punimi buron nga përpjekjet e ndërmarra në vitin 2016 nga Ministria e Drejtësisë për të riformuluar dispozitën e Kodit Penal (KP) mbi mjekimin e pakujdesshëm. Pretendimi kryesor i prezantuar në debatet publike nga subjektet që mbështesin depenalizimin qoftë edhe të pjesshëm të pakujdesisë në mjekim, bazohet në parimet e etikës biomjekësore të përmbajtura

¹ Lektore e së Drejtës Penale dhe e së Drejtës Biomjekësore pranë Departamentit të së Drejtës Penale, Fakulteti i Drejtësisë, UT. E-mail: rezarta.demneri@fdut.edu.al.

² Pedagoge e ftuar. E-mail: goreziarnisa@gmail.com.

edhe në Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore shqiptar, të cilat përcaktojnë se mjeku duhet të prirët për “të bërë mirë” si dhe për mos i shkaktuar dëm pacientit³.

Qëllimi i këtij punimi është të argumentuarit se më tepër sesa tek përmbajtja e dispozitës së Neni 96 së Kodit Penal, mangësitë duhen gjurmuar tek keqinterpretimet e kësaj dispozite nga ana e gjykatës dhe e organit të akuzës. Lindja e kësaj situatë është e kushtëzuar pjesërisht nga fakti se mjekësia nuk është shkencë ekzakte ndërkohë që vendimi mbi fajësinë apo pafajësinë për mjekim të pakujdesshëm duhet të shprehet “*përtej çdo dyshimi të arsyeshëm të bazuar në ligj*”. Një depenalizim *tout court* i kësaj veprë penale do të ishte i sforcuar dhe jo vetëm nuk do zgjidhte problemet e hasura në praktikë, por do të përfaqësonte një përpjekje për injorimin e mangësive - apo edhe të dështimeve - të organeve të përfshira në interpretimin e normativës përkatëse me karakter civil, penal dhe administrativ.

A. Analizë Krahasimore e Elementëve të Figurës së Veprës Penale “Mjekim i Pakujdesshëm” me Plagosjen nga Pakujdesia

Një analizë bazike e figurës së veprës penale të parashikuar nga Neni 96 KPSH ofrohet nga Elezi⁴. Një figurë veprë penale e posaçme si “Mjekimi i pakujdesshëm” mungon në Kodin Penal italian (KPI) dhe cënimi i integritetit fizik apo vdekja e pacientit të ardhura si rrjedhojë e pakujdesisë në mjekim janë të cilësueshme si plagosje apo vrasje nga pakujdesia, përkatësisht sipas neneve 582 KPI dhe 589 KPI. Për efekt të evidentimit të veçorive të “Mjekimit të pakujdesshëm”, në këtë seksion do t’i referohemi si “Plagosjes së rëndë nga pakujdesia” (Neni 91 KPSH) ashtu edhe “Plagosjes së lehtë nga pakujdesia” (Neni 92 KPSH).

Objekti grupor i “Mjekimit të pakujdesshëm” konsiston në shëndetin e pacientit subjekt pasiv mbi të cilin janë zbatuar trajtime mjekësore. Për nga natyra, ndërhyrjet kirurgjikale çenojnë, edhe pse përkohësisht, shëndetin e personit. Por, nëse janë të kryera *lege artis*, ndërhyrjet kirurgjikale nuk mund të cilësohen si plagosje e të bëhen shkas për ngarkimin e mjekut me përgjegjësi.

Koncepti i shëndetit shkon përtej mungesës së një patologjie Në Preambulën e Kushtetutës së Organizatës Botërore të Shëndetit (WHO), shëndeti përkufizohet si “*një gjendje e plotë mirëqenie fizike, mendore dhe shoqërore dhe jo thjesht si një mungesë sëmundjeje apo paaftësie*”⁵. Jurisprudenca italiane i drejtohet shkencës mjekësore për të përfutuar përkufizimin e “sëmundjes” me qëllim për të qartësuar se cilat veprime të mjekut kanë relevancë juridike përsa çënuese të shëndetit të

³ Parimet e etikës biomjekësore i.e. *autonomy, beneficence, non-maleficence, justice*, janë përpunuar për herë të parë nga Beauchamp, T. L., & Childress, J. F., “*Principles of biomedical ethics*”, New York: Oxford University Press, 2009.

⁴ Elezi, *E Drejta Penale (pjesa e posaçme)*, Botime Kumi, 2014.

⁵ Preamble to the Constitution of the World Health Organization as adopted by the International Health Conference, New York, 19-22 June, 1946; signed on 22 July 1946 by the representatives of 61 States (Official Records of the World Health Organization, no. 2, p. 100) and entered into force on 7 April 1948.

pacientit i.e. integritetit fizik e psikik të personit. Sëmundja përkufizohet si një proces patologjik në zhvillim e sipër që shoqërohet domosdoshmërisht me cënimin pak a shumë të rëndë të një apo disa prej funksioneve të organizmit⁶. Ndryshimet në tërësinë anatomike që nuk ndikojnë në aftësitë funksionale të personit, nuk mund të konsiderohen si sëmundje dhe për efekt të zbatimit të ligjit penal si plagosje.⁷ Në këtë sens, objekti juridiko-penal do të konsiderohet si i cënuar nëse provohet se nga ndërhyrja e mjekut ka ardhur një përkeqësim i gjendjes së pacientit⁸.

Neni 582 KPI dënon plagosjen kur nga ndërhyrja mjekësore janë cënuar funksionet mendore apo fizike të personit duke parashikuar kështu shprehimisht mundësinë që cënimi i shëndetit të mos ketë karakter ngushtësisht fizik⁹. Doktrina shqiptare aktuale është e fiksuar ende në një interpretim të ngushtuar brenda caqeve të dimensionit fizik se çfarë do të kuptohet me ‘shëndet’ kur shprehet se “*me plagosje në kuptimin juridiko-penal kuptohet dëmtimi i kundraligjshëm i shëndetit të njeriut tjetër i kryer me dashje ose nga pakujdesia që shprehet në prishjen e tërësisë anatomike ose të funksionimit normal të organeve të ndryshme të trupit*”¹⁰. Sidoqoftë, mund të vërehet që edhe sipas këtij përkufizimi, plagosja lidhet me funksionimin normal të organeve të ndryshme të njeriut përpos integritetit fizik *strictu sensu*.

Ligji penal shqiptar ashtu si edhe ai italian, e lidh shkallën e rëndësisë së plagosjes me dy kritere: së pari, me *paafhtësinë në punë* të shkaktuar nga veprimi apo mosveprimi (kur dëmtimi është i përkohshëm); së dyti, me karakterin e përhershëm të *humbjes së funksionit* të një organi. Paaftësia për punë mund të jetë e diktuar nga një gjendje tronditjeje psikike e shkaktuar nga një veprim i dhunshëm i subjektit aktiv që mund të ketë cënuar ekuilibrin mendor të subjektit pasiv, duke i shkaktuar një patologji me karakter psikik (i tillë është për shembull çrregullimi i stresit post-traumatik).

Nga pikëpamja juridike, integriteti fizik dhe ai psikik i personit mund të konsiderohet si i cënuar në një kohë që organet përgjegjëse të vazhdojnë të jenë plotësisht funksionale¹¹. Për shembull, veprimtaria mendore është funksion i orga-

⁶ Relazione Ministeriale sul Progetto del Codice Penale siç është cituar nga Vergallo G. M., *Il rapporto medico-paziente: Consenso e informazione tra libertà e responsabilità*, Milano, Giuffrè, 2008, f. 190.

⁷ Cass. Pen., Sez. IV, Sentenza n. 10643/96; Cass. Pen. Sentenza 22156/16.

⁸ Cass. Pen., Sentenza n. 2782/89; Cass. Pen. Sentenza n. 7475/85; Cass. Pen., Sez. Sentenza n. 46586/04; Cass. Pen. Sentenza n. 10643/96; Cass. Pen. Sentenza n. 17505/08.

⁹ Art 582 KPI “*Lesioni personali - Chiunque cagiona ad alcuno una lesione personale, dalla quale deriva una malattia nel corpo o nella mente, è punito con la reclusione da tre mesi a tre anni(...)*”.

¹⁰ Elezi, I., *E drejta penale*, Botime Erik, 2008, *ibid*, f. 83.

¹¹ Cass. Pen., Sentenza n. 714/98. Sulmuesi kishte shtrënguar qafën e viktimës duke i shkaktuar kësaj të fundit që të shembej përtokë në një gjendje gati të fikëti, me vështirësi serioze për të marrë frymë. Gjykata shprehej se cënimi i shëndetit “*(...) non necessita di particolari riscontri medici,*

nit tru; gjithsesi nuk mund të pohohet se kemi një cënim anatomik të trurit kur nga veprimi i subjektit aktiv është shkaktuar një çrregullim në ekuilibrin psikik të personit. Kjo është arsyeja se përse në analizë të figurës së veprës penale të plagosjes, jurisprudenca italiane e interpreton cënimin e shëndetit si “*ndryshim të funksioneve të organizmit*” dhe jo ngushtësisht të integritetit fizik¹².

Gjykata e Kasacionit italiane shprehet se duke pranuar një interpretim funksionalistik të konceptit të shëndetit¹³, edhe pse veprimet e mjekut mbi pacientin janë në thelb cënuese të integritetit fizik, nuk mund të cilësohen si plagosje me dashje. Meqenëse ushtrimi i profesionit mjekësor është një e drejtë e njohur brenda së drejtës për shëndet nga Kushtetuta italiane (Neni 32), ekziston prezumimi ligjor sipas së cilit mjeku do të konsiderohet të ketë vepruar me pakujdesi – pra jo me dashje - edhe në ato raste kur ndërhyrja mjekësore nuk është kryer në përputhje me *lege artis* duke shkaktuar dëmtimin e shëndetit të pacientit. Kjo vërejtje duhet mbajtur në konsideratë në momentin e përballjes me pretendimin se nuk është i nevojshëm parashikimi i përgjegjësisë penale për pakujdesinë në mjekim meqenëse mjeku ‘nuk ka për qëllim cënimin e shëndetit të pacientit’.

Ana objektive: Vepra kryhet me veprime aktive apo mosveprime të kundraligjshme. Në rastin kur vepra është kryer me mosveprim, nevojitet që të vërtetohet që mjeku (apo subjekti tjetër i posaçëm cituar në dispozitë) ka pasur një detyrim për të vepruar por nuk e ka përmbushur atë i.e. nuk ka vepruar¹⁴. Llojet e veprimeve dhe mosveprimeve të kundraligjshme ndryshojnë në varësi të subjektit që ka detyrimin për të dhënë kujdes mjekësor, duke konsideruar ekzistencën e një marrëdhënieje hierarkike mes subjekteve të përfshira, ku vartësi (p.sh infermieri) ka detyrimin të zbatojë urdhrat e eprorit (mjekut), i cili anasjelltas, ka detyrimin që të japë udhëzime dhe urdhra mbi sjelljen që duhet të ndjekë i pari.

Pakujdesia në mjekim mund të shfaqet në një apo në të tërë fazat e mjekimit i.e. diagnostifikimit, trajtimit (që ka të bëjë me përcaktimin si edhe me zbatimin

essendo sufficiente la comune esperienza per ritenere che una forte e prolungata stretta al collo, anche in assenza di visibili lesioni anatomiche sulla pelle, determina difficoltà respiratorie; e nel caso in esame l'alterazione della funzionalità respiratoria neppure può ritenersi essere stata di scarso rilievo, considerato che la parte offesa è caduta a terra semisvenuta”.

¹² Cass. Pen. Sez. V, Sentenza n. 714/98; Cass. Pen., Sez. IV, Sentenza n. 3448/04; Cass. Pen., Sez. IV, Sentenza n. 17505/08.

¹³ Cass. Pen., Sez. V, Sentenza n. 33136/11. Sëmundja përkufizohet si “(...) *un processo patologico evolutivo necessariamente accompagnato da una più o meno rilevante compromissione dell'assetto funzionale dell'organismo, ne deriva che le mere alterazioni anatomiche che non interferiscano in alcun modo con il profilo funzionale della persona non possono integrare la nozione di 'malattia', correttamente intesa*”. Ky përkufizim përputhet me sa interpretuar nga Cass. Pen., Sez. IV, Sentenza n. 10643/96, *supra note*.

¹⁴ Kodi Penal shqiptar nuk parashikon shprehimisht se kur vepra penale do të quhet e kryer me mosveprim por neni 609 i Kodit Civil shqiptar reciton “(...) *Mospengimi i një ngjarjeje nga personi që ka detyrimin ligjor për ta mënjanuar; e ngarkon atë (mbikëqyrësin, sh.a.) me përgjegjësi për dëmin e shkaktuar*”.

e terapisë) apo rehabilitimit¹⁵. Por të pasur veprën penale të parashikuar në nenin 96 KPSH, kërkohet që nga pakujdesia të ketë ardhur domosdoshmërisht një nga pasojat i.e. dëmtimi i rëndë i shëndetit, rrezikimi i jetës, vdekja e pacientit apo infektimi me HIV/AIDS, si rrethanë e cilësuar.

Kujdesi në mjekim përfshin edhe detyrimin e mjekut për t'i dhënë pacientit informacionin e nevojshëm në mënyrë që ky i fundit ta zbatojë siç duhet kurën e caktuar. Në një vendim të Gjykatës së Kasacionit italiane, mjeku u ngarkua me përgjegjësi penale për mosvënien në dijeni të pacientit, përpara se ky i fundit të lirohej nga shtrimi, mbi efektet anësore (konkretisht të ndjenjës së gjumit) të shkaktuara nga barnat e listuara në recetën mjekësore. Pacienti kishte pësuar një aksident si rrjedhojë e narkolepsisë së shkaktuar nga barnat e administruara dhe gjykata vlerësonte se mjeku kishte pasur detyrimin që ta informonte pacientin me qëllim parandalimin e ardhjes së pasojës që në fakt erdhi¹⁶. Duke qëndruar në tematikën e detyrimit të mjekut për të informuar pacientin, në një rast tjetër të praktikës gjyqësore italiane, mjeku u ngarkua me përgjegjësi sepse kishte kryer ndërhyrje kirurgjikale pa dhënë informacione të plota mbi risqet dhe përfitimet që priteshin të vinin nga ndërhyrja, e cila rrjedhimisht konsiderohej se ishte kryer pa marrë pëlqimin e informuar të pacientit¹⁷.

Pasaja duhet të konsistojë në cënimin e rëndë të shëndetit apo rrezikimin e jetës, vdekjen apo infektimin me HIV/AIDS të pacientit. Cilësimi i këtyre pasojave alternative si kusht për lindjen e përgjegjësive penale, nuk ndikon gjithsesi në të drejtën e personave të legjitimuar për të kërkuar shpërblimin e dëmit në një gjykim civil, në rast se dëmi në shëndet nuk ka qenë i këtij serioziteti.

Lind pyetja nëse subjektet e posaçme të listuara në dispozitën e nenit 96 KPSH do të mund të merreshin në përgjegjësi penale për "*Plagosje të lehtë nga pakujdesia*" (Neni 92 KPSH) nëse nga sjellja e tyre vjen një pasojë e ndryshme i.e. një cënim më i lehtë i shëndetit të personit nga sa është parashikuar prej nenit 96 KPSH. Në këtë rast mund të ngrihen dy hipoteza:

a) "*Mjekimi i pakujdesshëm*" të interpretohet si një formë e posaçme (për shkak të subjektit të posaçëm) e "*Plagosjes së rëndë nga pakujdesia*" apo alternativisht të "*Vrasjes nga pakujdesia*". Deduktohet se në këtë rast, do të përjashtohej mundësia e ngarkimit me përgjegjësi penale të këtyre subjekteve të posaçme për "*Plagosje të lehtë nga pakujdesia*" përsa lindja e përgjegjësive profesionale penale për mjekun, do të ishte e kufizuar veç në ato raste kur ka ardhur një cënim i rëndë i shëndetit të pacientit.

b) Cënimi i rëndë i shëndetit apo rrezikimi i jetës, vdekja apo infektimi me HIV/AIDS të interpretohen si pasoja të domosdoshme për cilësimin sipas nenit 96 KPSH; sakaq vepra penale e "*Plagosjes së lehtë nga pakujdesia*" të jetë e

¹⁵ De Ferrari, F., Palmieri, L., *Manuale di medicina legale*, Giuffrè, Milano, 2007 ff. 559-560.

¹⁶ Cass. Pen., Sez. IV, Sentenza n. 1025/07.

¹⁷ Cass. Pen., Sez. V, Sentenza n. 33136/11.

cilësueshme sa herë që një subjekt, pavarësisht cilësive të tij të posaçme, ka cënuar objektin juridiko-penal të integritetit fizik e psikik të personit i.e. edhe kur dëmtimi i shëndetit nuk ka qenë i rëndë. Praktika shqiptare nuk e ka përqaftuar këtë interpretim, duke mbështetur *de facto* qëndrimin se veprimtaria e mjekut ka relevancë penale veçse në rastet kur pakujdesia në mjekim ka shkaktuar dëmtime të rënda në shëndetin e pacientit. Këtu ndryshon thelbësisht nga rregullimi italian që bënte reforma ligjore Balduzzi, hyrë në fuqi në vitin 2012, sipas së cilit mjeku do të mbajë përgjegjësi penale vetëm nëse ka vepruar me neglizhencë, vetëbesim të tepruar (pavarësisht nga shkalla e fajit) dhe paaftësi (*imperizia*, it.) me pakujdesi të rëndë¹⁸.

Një veçori tjetër e figurës së veprës penale “*Mjekim i pakujdesshëm*” është se objektet juridike-penale që mbrohen në këtë dispozitë janë dy i.e. jeta dhe shëndeti i pacientit. Ndërkohë që objekti juridiko-penal i mbrojtur tek “*Plagosja e rëndë nga pakujdesia*” (Neni 91 KPSH) i referohet vetëm cënimit të shëndetit dhe jo edhe jetës.

Subjekti aktiv është i posaçëm por përveç mjekut, dispozita parashikon mundësinë e ngarkimit me përgjegjësi penale edhe të personelit mjekësor vartës apo të përfshirë në dhënie e kujdesit mjekësor si për shembull infermieri apo farmacisti.

Ana subjektive: Sipas Muçit, mjekimi i pakujdesshëm kryhet vetëm me pakujdesi në formën e neglizhencës¹⁹. Një interpretim i tillë nuk gjen gjithmonë zbatim sepse mjekimi i pakujdesshëm mund të jetë rezultat i një serie veprimesh apo mosveprimesh të kryera me forma të ndryshme të pakujdesisë. Gjithashtu, sjellja e pakujdesshme e mjekut mund të konkurrojë me shkaqe të tjera të pavarura nga veprimtaria e tij apo e saj si për shembull veti fizike të pacientit, patologji nga të cilat ai ose ajo vuante paraprakisht, sjellje e pakujdesshme e vetë pacientit etj. Për të sqaruar këtë çështje, paraqesim një vendim të Gjykatës së Lartë shqiptare të vitit 1969 si më poshtë:

“(…) është qëndrim i pakujdesshëm në detyrë²⁰, *shkaktimi i vdekjes nga bërja e një injeksioni intravenoz në kundërshtim me rregullat. Vdekja e qytetares N.M ka lidhje të drejtpërdrejtë me aplikimin në venë të solucionit të adrenalinit në dozën 1 miligram. (...) I gjykuari Y.K. megjithëse i porositur më parë nga kryeinfermieri S.C që të këshillohej me mjekun para se të aplikonte adrenalinen, pa marrë udhëzime konkrete nga mjeku Rr. K., ka lejuar të aplikohet adrenalina direkt në venë, kur duhej të bëhej nën lëkurë. Nga materialet dhe nga shpjegimet*

¹⁸ Mbi shkallët e pakujdesisë dhe dy reformat ligjore mbi pakujdesinë në mjekim të hyra në fuqi në Itali në vitet 2012 dhe 2017, *infra note*.

¹⁹ Muçi, Sh., *E drejta penale (pjesa e përgjithshme)*, Botime Dudaj, Tiranë, 2007, f. 145.

²⁰ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë së vitit 1954, Neni 211 “*Qëndrim i pakujdesshëm në detyrë* – Qëndrimi i pakujdesshëm i personit zyrtar në përmbushjen e detyrës së tij që i ka sjellë një dëm të rëndësishëm interesave shtetërore, shoqërore apo interesave të ligjshme të qytetarëve dënohet me humbjen e nëpunësisë ose me punë korrektonjëse”

e tij rezulton se i gjykuari Y.K. ka mësuar dhe ka ditur mirë që adrenalina në raste të jashtëzakonshme bëhet në venë, kurse zakonisht bëhet nën lëkurë. Në rastin konkret i gjykuari Y.K. është treguar i pakujdesshëm në zbatimin e detyrave të tij si infermier. (...) me të drejtë gjykata veprimin dhe mosveprimin e të gjykuarve e ka cilësuar si pakujdesi në detyrë.²¹

Pavarësisht se Kodi Penal shqiptar në fuqi asokohe nuk parashikonte një dispozitë të posaçme të mjekimit të pakujdesshëm, është e qartë se në rastin e mësipërm, pakujdesia në mjekim është shfaqur në formën e vetëbesimit të tepruar nga ana e infermierit.

Përgjegjësia për pakujdesi në mjekim për mjekun mund të burojë edhe nga mospërbushja e detyrimit për mbikëqyrje të veprimeve të kryera nga vartësit i.e. nga veprimtari të ndryshme nga vënia në jetë e dijeve të posaçme për ekzekutimin e një ndërhyrjeje mjekësore *strictu sensu*²². Gjithashtu, pacienti mund të pësojë dëmtime në shëndet si rrjedhojë e papërshtatshmërisë apo mosfunksionimit të makinerive apo intrumenteve të vëna në dispozicion nga struktura spitalore apo edhe nga mungesa e higjienës së ambienteve spitalore. Në këtë eventualitet, mjeku do të ishte përgjegjës për mospërbushjen e detyrimit për informimin e pacientit mbi rreziqet e mundshme prej kushteve të ofruara nga struktura spitalore ku do të kryhet trajtimi. Pëlqimi i dhënë nga pacienti për t'iu nënshtuar ndërhyrjes mjekësore në këto kushte, nuk do të ishte i informuar, rrjedhimisht do të ishte i pavlefshëm nga pikëpamja ligjore. Mjeku ka detyrimin që t'i japë mundësinë pacientit për të zgjedhur që të mos i nënshtrohet ndërhyrjes në një strukturë spitalore të papërshtatshme, duke proceduar kështu me referimin e tij apo të saj në një tjetër strukturë²³.

Detyrimi për informim që ka mjeku ndaj pacientit përfshin edhe ato të dhëna që kanë të bëjnë me sigurinë dhe efikasitetin e barnave të administruara²⁴, të gjakut

²¹ Vendim 23.1.1969, “Udhëzime dhe vendime të Gjykatës së Lartë të RPSH” (Përmbledhje të viteve 1967, 1968, 1969, 1970), 8 Nëntori, Tiranë, 1975, f. 131.

²² Neni 615 KCSH “Dëmi nga personat nën mbikëqyrje” ; Neni 609 KCSH “Dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit ose mosveprimit të personit. Mospengimi i një ngjarjeje nga personi që ka detyrimin ligjor për ta mënjanuar, e ngarkon atë me përgjegjësi për dëmin e shkaktuar.”

²³ Chindemi, D. *Responsabilità del medico e della struttura sanitaria pubblica e privata* siç është cituar nga Albertazzi, L., Cataldi, R., Romanelli, F., Storani, P.M., Vagnoni, S., *La responsabilità della struttura sanitaria pubblica e privata*, Maggioli, 2014, f. 146.

²⁴ Në zbatim të detyrimit për farmakovigjilencë të parashikuar në pikën 30 të nenit 3 si dhe neni 21/1 të Ligjit n. 9323/04 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik” (i ndryshuar). Po ashtu mbi sigurinë e barnave gjatë provave klinike, nenet 22-26 të Ligjit n. 7815/94 “Për barnat” (i ndryshuar)

dhe të hemoderivateve²⁵, në kuadrin e riskut të infektimit me sëmundje të ndryshme përfshirë HIV/AIDS. Në këto raste, ravijëzohet mundësia e lindjes së përgjegjësishë penale të personit juridik i.e. entit spitalor.

Ndjekja penale për “Mjekim të pakujdesshëm” fillon kryesisht kurse për “Plagosje të rëndë nga pakujdesia” lind vetëm mbi bazën e ankimit të viktimës akuzuese²⁶.

B. Detyrimi për Rezultat dhe Detyrimi për Kujdes

Për të kuptuar pakujdesinë në mjekim duhet që më parë të qartësohet natyra e detyrimit që merret përsipër nga mjeku në ushtrim të profesionit të tij. Doktrina dhe jurisprudenca italiane është univoke në qëndrimin se mjeku ka detyrimin për të përdorur sipas *lege artis* mjetet dhe dijet që zotëron (*obbligatio di mezzi*, it), pavarësisht nga rezultati pozitiv apo negativ që rrjedh prej procedurës së zbatuar. Rrjedhimisht, duke pranuar se qëllimi i trajtimeve mjekësore është ai i përmirësimit të kuadrin klinik të pacientit, mund të konkludohet se mjeku do të mbajë përgjegjësi vetëm nëse nuk ka patur një sjellje profesionale të përshtatshme (në përputhje me *lege artis*) e të kujdesshme dhe jo sepse nuk ka arritur rezultatin e shërimit të pacientit (*obbligatio si risultato*, it)²⁷. Përrjashtimisht, kirurgu plastik, i cili kryen ndërhyrje kirurgjikale me natyrë rikonstruktive²⁸ apo estetike²⁹, është i ngarkuar si me detyrimin për kujdes, ashtu edhe me atë për rezultat³⁰. Sterilizimi është një tjetër procedurë që e ngarkon mjekun edhe me një detyrim për rezultat. Në këtë lloj ndërhyrjeje, nuk bëhet dallim midis detyrimit për kujdes e detyrimit për rezultat, meqenëse kujdesi i mjekut gjen zbatim pikërisht në arritjen e rezultatit të sterilizimit të pacientit³¹.

²⁵ Neni 25, neni 26 i Ligjit n. 9739//07 “Për shërbimin e transfuzionit të gjakut” (i ndryshuar).

²⁶ Neni 59 i Kodit të Procedurës Penale.

²⁷ Detyrimi për kujdes parashikohet nga neni 455 KCSH ndërsa ai për rezultat nga neni 480 KCSH.

²⁸ Kirurgjia plastike rikonstruktive ka si qëllim kryesor rindërtimin e një pjese të deformuar apo që mungon plotësisht në trupin e pacientit.

²⁹ Kirurgjia plastike estetike përqendrohet në pjesën sipërfaqësore të pamjes fizike i.e. të fytyrës apo linjave trupore. Qëllimi i saj është që t'i mundësojë pacientit që të arrijë mirëqenien psikologjike duke i mundësuar që të shprehë personalitetin sipas konceptit personal që ka për bukurinë.

³⁰ Cass. Civ. Sez. II, Sentenza n. 4394/85, Cass. Civ. Sez. III, Sentenza n. 9705/97; Cass. Civ. Sez. II, Sentenza n. 3046/97; Cass. Civ. Sez. III, Sentenza n. 10014/94; Cass. Civ. Sez. III, Sentenza n. 364/97.

³¹ Cass. Civ., Sez. III. Sentenza n. 6416/79 si dhe Cass. Civ., Sez. III. Sentenza n. 9617/99.

C. Shkallët e Fajit dhe ato të Dëmit të ardhur në Shëndetin e Pacientit si Kritere për Lindjen e Përgjegjësive Penale

Për të vlerësuar nëse pakujdesia në mjekim ka qenë e rëndë apo e lehtë³², gjyqtari duhet t'u referohet rregullave të përgjithshme si dhe atyre të posaçme të kujdesit e përpos këtyre, edhe udhëzuesve klinikë, protokolleve mjekësore dhe praktikës së mirë shkencore. Këto tre të fundit janë standarde suplementare dhe zvogëlojnë diskrecionin e gjyqtarit në vlerësimin e pakujdesisë në mjekim ndërsa përcaktojnë, me nivele të ndryshme detyrueshmërie, rregullat e kujdesit minimal të zbatueshme në një veprimtari të rrezikshme siç është ajo e mjekimit. Për të qenë të vlefshme e rrjedhimisht të detyrueshme, këto tre lloje standardesh duhet të jenë shkencore dhe aktuale.

Fakti që udhëzuesit apo protokollat mjekësore janë kritere të domosdoshme për vlerësimin e pakujdesisë nuk mund gjithsesi të çenojnë autonominë e mjekut në ushtrimin e profesionit të tij, përsa në çdo rast, ky i fundit duhet të udhëhiqet nga qëllimi për të realizuar interesat më të mira të pacientit. E shprehur ndryshe, mjeku nuk është i detyruar që të ekzekutojë në mënyrë strikte rregullat e përmbajtura në këto norma të kujdesit të posaçëm. Sipas Sirena, udhëzuesit apo protokollat mjekësore janë norma orientuese të vlerësimit të pakujdesisë penale të cilave u mungon karakteri urdhërues dhe zbatueshmëria e tyre është e kufizuar, përsa e varur nga kushtet klinike të çdo rasti konkret³³. Mosrespektimi i parashikimeve të protokolleve mjekësore, të udhëzuesve klinikë apo të praktikës së mirë mjekësore, nuk passjell përgjegjësi penale për mjekun, nëse ekzistojnë njëkohësisht tre kushte: ndërhyrja është kryer sipas *lege artis*; nga ndërhyrja ka ardhur përmirësimi i gjendjes shëndetësore të pacientit dhe pacienti nuk kishte refuzuar shprehimisht për t'u nënshtruar ndërhyrjes i.e. mungon konsenti por nuk ka refuzim të shprehur nga ana e pacientit³⁴.

Në mënyrë të përmbledhur, qëndrimi aktual i Gjykatës së Kasacionit italiane është se për çështjet e pakujdesisë në mjekim të shqyrtuara para hyrjes në fuqi të Ligjit n. 24/2017 (reforma ligjore Gelli-Bianco) duhet të zbatohet ligji i mëparshëm

³² Rregullimi juridik penal dhe civil italian kategorizon pakujdesinë në të lehtë dhe të rëndë. Sipas doktrinës shqiptare, “*Sa më i mundshëm të ketë qenë parashikimi i mundësisë së ardhjes së pasojës aq më e rëndë do jetë shkalla e fajësisë*”. Nuni, A., Mustafaj, I., Vokshi, A., “*E drejta e detyrimeve I*”, Tiranë 2008, f. 99. Për më shumë mbi shkallën e fajit në formën e pakujdesisë gjatë dhënies së kujdesit mjekësor, shih Demneri, R. “*The degrees of negligence as an element of culpability in criminal law versus civil law applied to the medical profession*”, Book of Proceedings of “Social-Economic Regional Cooperation towards the Developed Markets Conference”, University of Elbasan “Aleksandër Xhuvani” November 2015.

³³ Sirena, P., La responsabilità medica alla luce della legge Balduzzi, Relacion i prezantuar me rastin Convegno Ischia, 13-14 aprile 2013, aksesuar më dhjetor 2017 nga <http://www.altalex.com/index.php?idnot=63007>

³⁴ Cass. Pen., SS.UU., Sentenza n. 2437/09. Gjykata e Kasacionit kishte pushuar çështjen me arsyetimin se fakti nuk përbënte vepër penale.

n. 189/2012 (reforma ligjore Balduzzi) sipas së cilit, mjeku që ka vepruar me pakujdesi të lehtë në formën e paaftësisë (kuptuar si mungesë përvoje profesionale, *imperizia*, it.), nuk mban përgjegjësi penale nëse ka zbatuar drejt udhëzuesit dhe protokollet mjekësore apo në mungesë të tyre, praktikën e mirë mjekësore. Nga ana tjetër, Gjykata e Kasacionit në vendimin e vonshëm *Cavazza*³⁵, vëren se rregullimi i ri ligjor Gelli-Bianco i vitit 2017, ka hequr dallimin midis shkallëve të pakujdesisë profesionale duke parashikuar mundësinë e lindjes së përgjegjësisë penale nëse mjeku ka vepruar me paaftësi (*imperizia*). Për këtë arsye, sipas Gjykatës së Kasacionit, teorikisht është e mundur që të përjashtohet nga përgjegjësia penale edhe mjeku i cili ka vepruar me pakujdesi të rëndë, çka normativa e mëparshme e (Ligji Balduzzi n. 189/2012) nuk lejonte.³⁶

Kritika kryesore në fushën e përgjegjësisë profesionale penale që i bëhet reformës ligjore Gelli-Bianco është se në thelb ajo çon në gjykime aprioristike të veprimtarive që në *fakt* karakterizohen nga një shkallë e lartë dinamizmi dhe specificiteti. E shprehur ndryshe, udhëzuesit klinikë ndryshojnë me një ritëm jashtëzakonisht të shpejtë sepse vetë shkenca mjekësore zhvillohet në mënyrë të vrullshme. Ndaj rregullat e kujdesit të përmbajtura në udhëzuesit apo protokollet mjekësore janë gjithmonë në ndryshim e sipër si edhe *case-sensitive*. Ky tipar i fundit, bën që këto norma të kujdesit të kenë një shkallë të ulët përgjithësimi krahasuar me ato të zbatueshme në fusha të tjera si p.sh rregullat e kujdesit teknik në ndërtim.

Riformulimi i nenit 96 KPSH siç parashikohet në Draftin e Projektligjit për ndryshime në Kodin Penal është, në vlerësimin tonë, i rrezikshëm si për shkak të terminologjisë së përzgjedhur ashtu edhe për shkak të mangësive në logjikë³⁷. Në

³⁵ Cass. Pen., Sentenza n. 50078/17 (Sentenza Cavazza).

³⁶ Për shkak të konfuzionit të krijuar nga ligji Gelli-Bianco, Gjykata e Kasacionit italiane do të mblihdet më 21 dhjetor 2017 në Kolegje të Bashkuara me qëllim për të kthjellësuar dhe unifikuar jurisprudencën, e cila ka hasur probleme të konsiderueshme përsa i përket mundësisë për të përjashtuar nga përgjegjësia penale mjekun që ka vepruar me pakujdesi të rëndë. Mbi problemet e hasura si rrjedhojë e aprovimit të reformës Gelli-Bianco, shih ndër të tjerë, Caletti, G.M. Mattheadakis, M.L., “Una prima lettura della legge “Gelli-Bianco” nella prospettiva del diritto penale”, *Diritto Penale Contemporaneo* n. 2/2017, ff. 84-108, aksesuar më dhjetor 2017 nga <https://www.penalecontemporaneo.it/d/5272-una-prima-lettura-della-legge-gelli-bianco-nella-prospettiva-del-diritto-penale>

³⁷ Ministria e Drejtësisë, Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, 19.12.2016, Neni 96 “Shkelja e etikës mjekësore dhe trajtimi mjekësor alternativ - Veprimi apo mosveprimi i mjekut në kundërshtim me kërkesat e kodit të etikës profesionale, duke shkaktuar dëmtim të konsiderueshëm të shëndetit të pacientit, dënohet me gjobë, heqje të së drejtës së ushtrimit të profesionit dhe me shpërblimin e dëmit të shkaktuar pacientit. Veprimi apo mosveprimi i punonjësve të tjerë mjekësorë, të cilët gjatë kryerjes së detyrave kanë vepruar në kundërshtim me kërkesat e kodit të etikës profesionale, duke shkaktuar dëmtim të konsiderueshëm të shëndetit të pacientit, dënohet me gjobë, heqje të së drejtës së ushtrimit të profesionit dhe me shpërblimin e dëmit të shkaktuar pacientit. Ushtrimi i mjekësisë alternative, pa autorizimin përkatës të autoriteteve shëndetësore, kur i ka shkaktuar një dëmtim të konsiderueshëm shëndetit të pacientit, dënohet me gjobë, heqje

mënyrë të përmbledhur parashtrijmë *disa nga* vërejtjet kryesore:

a. Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore (KEDM) nuk përmban norma të kujdesit profesional por parime etike dhe deontologjike nga të cilat profesionisti mjekësor duhet të udhëhiqet gjatë ushtrimit të artit mjekësor. KEDM nuk përcakton se cilat janë procedurat e përshtatshme për t'u ndërmarrë nga stafi mjekësor në prezencë të rrethanave që karakterizojnë rastet e veçanta klinike. Ndaj referimi tek Kodi i Etikës Profesionale i kryer nga kjo dispozitë e Projektligjit për të kryer vlerësimin e kundraligjshmërisë së sjelljes “*që ka shkaktuar një dëmtim të konsiderueshëm*” në shëndetin e personit, është i gabuar. Mund të hipoti-zohet se hartuesi i Projektligjit ka patur për qëllim që të referonte në udhëzuesit dhe protokollet mjekësore siç ka bërë ligjvënësi italian me Reformën Balduzzi dhe me atë Gelli-Bianco. Gjithsesi, për të garantuar uniformitetin dhe qartësinë në rregullat e kujdesit që duhen ndjekur, ligjvënësi italian ka përcaktuar në ligj se udhëzuesit mjekësorë do të miratohen dhe publikohen nga Ministria e Shëndetësisë, si organi përgjegjës.

b. Më tepër sesa një riformulim, dispozita e “*Shkelja e etikës mjekësore dhe trajtimi mjekësor alternativ*” është një figurë vepr penale totalisht e re. Formulimi i saj mund të bëhet shkas që të mund të ravijëzohet një përgjegjësi penale objektive, çka bie ndesh me rregullimin ligjor penal shqiptar. Në interpretim të kësaj dispozite, subjekti i posaçëm do të merrej në përgjegjësi penale automatikisht për moszbatim të rregullave të kujdesit, pa u ndalur paraprakisht në vlerësimin nëse veprimi apo mosveprimi i kundraligjshëm është kryer me faj. Siç u trajtua nga jurisprudenca e Gjykatës së Kasacionit italian parashtruar në këtë punim, ligji nuk mund dhe nuk duhet të kërkojë një ekzekutim të verbër të udhëzuesve apo protokolleve mjekësore, përse mjekut i duhet lënë autonomia që të kryejë zgjedhje e të zbatojë ato rregulla kujdesi që ai çmon si më të përshtatshmet për rastin konkret.

c. Nuk përcaktohet se çfarë do të kuptohet me “*dëmtim të konsiderueshëm*” të shëndetit të personit për efekt të zbatimit të ligjit penal. Ky është një problem që vazhdon të zvarritet nga rregullimet juridike pararendëse. Në këtë kuadër, mbetet problemi që doktrina dhe jurisprudenca penale shqiptare nuk kanë ofruar një interpretim të shkallës së fajit që të jetë i pavarur nga rëndësia e dëmit të ardhur.

Mund të hipotizohet se përpjekja për riformulimin e nenit 96 KPSH të jetë e diktuar nga ngjarjet dhe debatet e regjistruara së fundmi në media mbi kufizimin e përgjegjësisë profesionale të mjekut për pakujdesi në mjekim vetëm në kuadrin juridiko-civil dhe atij administrativ³⁸. Gjithsesi, parashikimi i KEDM se veprimtaria

të së drejtës së ushtrimit të profesionit dhe me shpërblimin e dëmit të shkaktuar. Po kjo vepr, kur ka shkaktuar vdekjen e pacientit, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet”. Aksesuar më dhjetor 2017 nga http://www.drejtësia.gov.al/files/userfiles/Legjislacioni/Projekt_Akte/Ndryshime_thelbesore_në_politikën_penale/KODI_PENAL_19.12.2016_OK.pdf

³⁸ Nder rastet më të bujshme të raportuara në media së fundmi: <http://gazeta-shqip.com/lajme/2017/02/08/humb-jetën-pas-lindjes-foshnja-dyshohet-për-mjekim-të-pakujdesshëm/>, <http://www.oranews.tv/article/mjeket-mjekimi-i-pakujdesshëm-të-mos-konsiderohet-vepër-penale>, dhe <http://shqiptarja.com/home/1/drejt-sia-europiane-e-padreit-sia-e-ligjit-ndaj-mjekut-shqiptar--379610.html> (aksesuar më dhjetor 2017).

e mjekut udhëhiqet nga qëllimi për ta përmirësuar shëndetin e pacientit dhe për të mos e përkeqësuar atë, nuk mund të shërbejë si justifikim, aq më pak të vishet me detyrueshmëri ligjore, për përjashtimin *a priori* nga përgjegjësia pe-nale të profesionistit të kujdesit mjekësor që vepron pakujdesi. Kjo edhe sepse parashikimi i nenit 96 KPSH për përgjegjësinë penale të mjekut është i kufizuar vetëm në sjelljet e kryera me pakujdesi, ndërkohë që ndalimi i sipërpërmendur që bën KEDM i referohet veprimeve cënuese të shëndetit të pacientit të kryera me dashje.

D. Jurisprudenca Aktuale e Gjykatës së Lartë

Jurisprudenca shqiptare ka ende mangësira të theksuara përsa i përket trajtimit të elementëve të pakujdesisë në mjekim. Në një vendim të vitit 2013, Gjykata e Lartë (GJL) shprehet se për t'u cilësuar si “*Mjekim i pakujdesshëm*”, “*(...) duhet të provohet nëse pasoja ka ardhur për shkak të neglizhencës, pakujdesisë a paaftësisë, apo për mosrespektim të ligjit, të një akti nënligjor, rregulloreje, etj.*”³⁹. Në po të njëjtin vendim, GJL praktikisht ekuivalentonte, duke gabuar, neglizhencën në dhënien e kujdesit mjekësor me mosdhënien e ndihmës, parashikuar si vepër penale nga neni 97 KPSH⁴⁰.

Në aktin e ekspertimit të cituar nga Gjykata e Lartë në vendimin e sipërpërmendur, ekspertët janë shprehur mbi faktin nëse mjeku ka vepruar apo jo me pakujdesi, çka bie ndesh me sa është parashikuar mbi detyrat e ekspertit në Kodin e Procedurës Penale. Gjykata e Lartë shprehet se nuk është konsumuar vepra penale e “Mjekimit të pakujdesshëm”, meqenëse dy prej tre ekspertëve të thirrur për të kryer riekspertimin (asnjëri prej ekspertëve të caktuar nuk ishte mjek specialist), janë shprehur se sjellja e kirurgut-roje ka qenë “*korrekte*”. Në këtë vendim, GJL nuk ka kryer një analizë të ekzistencës së lidhjes shkakësore mes veprimeve dhe mosveprimeve të mjekut dhe përkeqësimit të gjendjes shëndetësore të pacientit⁴¹.

³⁹ Gjykata e Lartë, Vendimi n. 00-2013-645 datë 20.03.2013, Pika 16. Për mendimin tonë arsyetimi ka një lapsus përsa e drejta shqiptare njeh vetëm dy forma të pakujdesisë i.e. neglizhencën dhe vetëbesimin e tepruar. Paaftësia (*imperizia*, it.) si formë e cilësuar e neglizhencës apo e vetëbesimit të tepruar është e parashikuar në rendin juridik italian.

⁴⁰ *Ibid.*, Pika 22-24. Çështja i referohej një personi i cili kishte pësuar dëmtime si rrjedhojë e rënies nga skela e një ndërtese që po ndërtonte. Pasi ishte shtruar në urgjencën e spitalit, viktimës i ishte administruar nga mjeku në shërbimin e rojes, terapia me antibiotikë, antiedematoz dhe likide. Kjo terapi iu administrua pacientit në përputhje me diagnozën “*Comotio cerebri, contusio thoraksi, fraktura costae 7-9, hemopneumothoraksi minimal sinistra*” të përcaktuar nga po i njëjti mjek. Analizat e urdhëruara nga mjeku që në momentin e shtrimit, nuk ishin kryer ende pas shumë se 4 orësh kur gjendja e pacientit erdhi duke u përkeqësuar. Pasi u kryen dhe u morën përgjigjet e analizave, mjeku vlerësoi se gjendja e pacientit nuk ishte shqetësuese duke i shtuar terapisë vetëm glukozë e vitamina. Gjendja shëndetësore e pacientit vijoi të përkeqësohej aq sa mjeku vendosi ta transferonte atë me ambulancë në një strukturë të specializuar por pacienti vdiq me të mbërritur në spital.

⁴¹ Doktrina dhe jurisprudenca italiane janë univoke në hapat që duhen ndjekur për vlerësimin e ekzistencës së lidhjes shkakësore në dy etapa: Në vlerësimin *ex ante* përcaktohet nëse veprimet apo mosveprimet e subjektit aktiv janë në gjendje të shkaktojnë pasojën e ardhur, në vlerësimin *ex*

Konkretisht nuk është shqyrtuar cilat prej parashikimeve të protokolleve mjekësore apo të udhëzuesve, konfirmonin se veprimet e mjekut kishin qenë të përshtatshme për atë rast konkret.

Në dhënien e vendimit, Gjykata e Lartë duhej të kishte arsyetuar edhe nëse vendimet e Gjykatës së Faktit apo asaj të Apelit, përjashtonin apo konfirmonin përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, të qenurit e sjelljes së mjekut faktor i domosdoshëm në lidhjen shkakësore, ku hallka të tjera të rëndësishme janë faktori paraprirës i aksidentit edhe ai përfundimtar i ardhjes së pasojës me vdekje. Mungesa e kryerjes së ekzaminimeve të mëtejshme diagnostifikuese nga ana e mjekut si p.sh. skaneri i trurit apo i toraksit, të cilat do të qartësonin kuadrin klinik të pacientit shtruar në urgjencë apo vonesa në marrjen e rezultateve të analizave të urdhëruara, mund të kenë qenë faktor ndikues në ardhjen e pasojës. Mandej, mungesa eventuale e instrumentave të posaçëm në strukturën spitalore, mund të ketë qenë shkak i arsyeshëm për urdhërimin e transferimit të pacientit në një strukturë tjetër të specializuar, gjë që në fakt ndodhi, edhe pse me vonesë.

Të mosvepruarit, po ashtu si të vepruarit në mënyrën e gabuar, përbëjnë raste tipike të pakujdesisë. Tërësia e veprimeve dhe mosveprimeve të mjekut apo koha dhe mënyra e kryerjes së tyre, duhej të ishin marrë në shqyrtim nga gjykatat së bashku me të gjitha rrethanat e tjera me karakter natyror apo njerëzor. Kështu do të mundësohej arritja në konkluzionin nëse pasoja mund të ishte shmangur apo nëse veprimet e kryera prej kirurgut nuk kishin ndikuar negativisht në gjendjen shëndetësore të pacientit apo akoma, nëse mjeku kishte vepruar apo jo sipas *lege artis*. Gjykatat duhej të kishin konkluduar mbi fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit duke përpunuar një arsyetim juridik në të cilin të ishin vlerësuar të gjitha aspektet e detyrimit për kujdes që ka mjeku, duke mos u bazuar ekskluzivisht mbi njërin prej akteve të ekspertimit të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Në një tjetër vendim me objekt pakujdesinë në mjekim, GJL ka kthyer për rigjykim çështjen duke parashtruar edhe pyetjet përkatëse⁴².

Akti i ekspertimit i cili përcaktonte shkakun e vdekjes së pacientes është vlerësuar si i qartë nga palët dhe Gjykata. Akti i dytë i ekspertimit mjeko-ligjor, i cili shprehej mbi veprimet e mjekes obstetër-gjinekologe, ishte

post arsyetohet nëse pasoja do të kishte ardhur sidoqoftë po të mos ishte kryer veprimi aktiv apo të ishte kryer veprimi që duhej të ishte ndërmarrë por që në fakt mungoi (kur vepra është kryer me mosveprim). Për më gjerë, Demneri, R., “Përgjegjësia Penale e Mjekut – Aspektet Krahasuese me Normativën Penale Italiane”, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, 2014, ff. 39-81.

⁴² Gjykata e Lartë, Vendimi Nr.00-2012-1406 i Vendimit (235) datë 19.09.2012. Çështja kishte të bënte me një grua shtatzënë e cila kishte thyer kërcirin e këmbës së majtë. Mjeku ortoped i Urgjencës së Spitalit kishte kryer imobilizimin e këmbës nëpërmjet vënies në gips. Pacientja është mbajtur nën vëzhgim për 10 ditë nga mjekja obstetër-gjinekologe e cila e përshkruante gjendjen e pacientes në kartelë klinike si “*të mirë, në pozicion të detyruar në krevat*”. Në këtë periudhë pacientja i ishte nënshtruar operacionit cezarian dhe kishte lindur fëmijën. Pacientes i ishte administruar fraksiparinë, një antikoagulant për tre ditë pas lindjes. Ditën e katërt, gruaja ishte ngritur për të lëvizur dhe menjëherë ishte rrëzuar dhe kishte vdekur si rrjedhojë e një insufiçience kardio-respiratore, siç konfirmohej në ekspertimin mjeko-ligjor.

vlerësuar si i vagët në disa pika nga ana e GJL. Me qëllim për të mbështetur kritikën e parashtruar ndaj vendimit të sipërcituar të GJL të vitit 2013, paraqesim më poshtë pyetjet e shtruar nga GJL në vendimin n. 00-2012-1406 të vitit 2012 si dhe komentet përkatëse:

– A janë dhënë apo jo medikamentet e përshtatshme për të siguruar antikoagulimin?

– Sa ditë duhej të vazhdonte dhe a ishte i mjaftueshëm trajtimi me fraksiparinë si dhe a ishte ky i vetmi medikament që duhet t'i ishte dhënë pacientes.

– A është e përcaktuar në protokollet mjekësore kur dhe sa duhet të zgjasë trajtimi i pacientit me antikoagulate? Këtu vërejmë se si GJL orienton vlerësimin e lidhjes shkakësore drejt rregullave të përmbajtura në protokollet mjekësore, siç veprohet aktualisht në Itali.

– Cili ishte mjeku kurues që kishte detyrimin për të përcaktuar terapinë e pacientes i.e. kirurgu ortoped apo mjeku obstetër-gjinekolog? Kjo pyetje ka rëndësi të veçantë sepse përgjigjja mund të çojë në ngarkimin me përgjegjësi të mjekut ortoped i cili ishte mjeku kurues para se pacientja të kalonte nën kujdesin e mjekes obstetër-gjinekologe. Mungesa e një fletë-shoqërimi për tek mjekja obstetër-gjinekologe lëshuar nga mjeku ortoped mund të përbëjë në fakt neglizhencë në dhënie të kujdesit nga ana e këtij të fundit. Vërejmë në këtë pikë sesi shpesh në praktikën gjyqësore italiane, vendimet e fajësisë për pakujdesi në mjekim, vijnë si rezultat i pamundësisë së mjekut për të paraqitur dokumentacion të mjaftueshëm në mbështetje të pretendimit se kishte respektuar rregullat e nevojshme të kujdesit.

– A duhej të kishte filluar mjekimi me fraksipirinë (antikoagulant) fill pas thyerjes së këmbës dhe vendosjes së saj në allçi apo ky hap mund të shtyhej deri pas operacionit? Përgjigjja e kësaj pyetjeje do të shpjegonte nëse neglizhenca në mjekim i përkiste të dy mjekëve apo vetëm mjekes obstetër-gjinekologe.

– A ishte e nevojshme që të kërkohej një mendim i mëtejshëm i ekspertëve mjeko-ligjorë apo specialistë nëse përfundimet që përmbante akti i ekspertimit nuk ofronin qartësi të plotë.

Pasojat juridike që rrjedhin nga pozita e mjekut si garant i shëndetit të pacientit dhe delegimi eventual i këtij funksioni nga një mjek tek tjetri, trajtohen edhe në një tjetër vendim të GJL mbi mjekimin e pakujdesshëm⁴³. Duke kthyer

⁴³ Gjykata e Lartë, Vendimi Nr.00-2012-878 i Vendimit (15) datë 23.01.2013. Çështja kishte të bënte me një pacient U.B të shtruar me dëmtime të rënda në Repartin e Reanimacionit të spitalit si rrjedhojë e një aksidenti që kishte pësuar duke u përplasur me një autoveturë. Gjatë periudhës 21.07.2007-13.08.2007, Përgjegjësi i Repartit të Reanimacionit të Spitalit ishte M.K., i cili pas kësaj date ishte larguar për pushime. Më datën 21.08.2007, i pandehuri V.K., mjek reanimator, ka vizituar pacientin dhe ka shënuar në kartelën klinike mbi nevojën e kryerjes së një grafie pulmonare, grafi që nuk u krye asnjëherë si rrjedhojë e faktit që pacienti nuk mund të lëvizte sepse merrte frymë nëpërmjet maskës së oksigjenit dhe Spitali nuk dispononte aparat portativ që mundësonte kryerjen e ekzaminimit në vend. Pacienti do të vdiste një ditë më vonë, më 22.08.2007, nga “*gjendja e rëndë septike me infeksion të qelbëzuar të mushkërive dhe cipave*”

çështjen për rigjykim, GJL vërente domosdoshmërinë e përcaktimit se cili ka qenë profesionisti mjekësor që kishte pasur detyrimin për t'u kujdesur për pacientin. Kjo sepse rezultonte një periudhë e “zbuluar” (nga 13.08.2007 deri më 21.08.2007), përgjatë së cilës përgjegjësi i Repartit të Reanimacionit, ishte larguar nga shërbimi pa deleguar nëpërmjet një akti zyrtar mjekun që do ta mbulonte këtë funksion. Ky funksion ishte kryer *de facto* nga mjeku reanimator me iniciale V.K. (i pandehuri), si mjeku i gatshëm me vjetërsinë më të madhe në punë. Mungesa e një akti zyrtar që e emëronte mjekun V.K. si përgjegjës, prezantohej nga ky i fundit si provë që nuk kishte qenë ai në krye të Repartit të Reanimacionit e rrjedhimisht nuk ishte as përgjegjës për kujdesin ndaj të sëmurëve rëndë si edhe përsa i përket “*organizimit dhe drejtimit të punës në klinikë në planin diagnostik, kurativ dhe organizativ*”.

Në po këtë çështje, GJL vërente se për të vlerësuar lidhjen shkakësore, Gjykata duhej të kishte qartësuar nëse kishte, dhe cilat ishin konkretisht ato veprime, që duhej të ishin ndërmarrë për trajtimin e atij pacienti si dhe nëse këto veprime do të kishin qenë të përshtatshme për të shmangur ardhjen e pasojës nëse do të ishin ndërmarrë. Këtu duhet të rikujtojmë se përshtatshmëria apo papërshtatshmëria e sjelljes së mjekut në dhënien e kujdesit mjekësor, nuk varet domosdoshmërisht nga mundësia e saj për të sjellë shërimin e pacientit meqenëse si rregull, mjeku ka detyrimin për kujdes, jo atë për rezultat.

Së fundmi, mund të vërehet se mungesa e një akti formal që caktonte përgjegjës të Repartit mjekun më me eksperiencë, nuk mund të shërbejë si justifikim për ta përjashtuar këtë të fundit nga përgjegjësia penale përsa siç pohohet edhe nga eksperti i caktuar nga Urdhri i Mjekëve “*(...) në repartin e reanimacionit pacientët nuk kurohen nga mjekë konkretë, por nga gjithë stafi i shërbimit të atij reparti*”. Pacienti U.B. kishte qenë në një gjendje shëndetësore kaq të rëndë saqë ishte zhvendosur në një dhomë tjetër për shkak të erës së fortë që dilte prej trupit të tij të infektuar. Ndërkohë ekzamiminimet e vetme të cilave u ishte nënshtruar pacienti ishin bronkoskopia dhe grafia pulmonare, çka tregonte se nuk ishin ndërmarrë hapa të mjaftueshme për trajtimin e tij.

Në një rast të ngjashëm, Gjykata e Kasacionit italiane ngarkonte me përgjegjësi penale kirurgun që ishte larguar pasi kishte mbaruar turnin, pa i dhënë stafit indikacione të posaçme mbi terapinë apo nevojat specifike të pacientit në fazën-operatore⁴⁴. Meqenëse trajtimi mjekësor përfshin edhe këtë fazë, Gjykata e Kasacionit vërente se kishte pasur neglizhencë si nga ana e mjekut kirurg ashtu dhe nga stafi infermierëve, pjesëtarët e të cilit nuk ishin aktivizuar në dhënien e kujdesit të duhur mjekësor, paçka se bashkëshortja e pacientit sihte ankuar mbi gjendjen e rëndë të bashkëshortit të saj.

Në një rast tjetër, në kuadrin e pozitës së garantit dhe parimit të besimit

mbështjellëse të tyre me grumbullim të rreth 2 litrave qelb në anën e djathtë të gjoksit, ndërlikime këto të dëmtimeve të rënda të pësuar në aksidentin automobilistik të datës 01.07.2007” siç konkludohet edhe në aktin e ekspertimit.

⁴⁴ Cass. Pen. Sez. IV, Sentenza n. 9739/05.

tek tjetri, Gjykata e Kasacionit vlerëson se parimi i “besimit tek tjetri” nuk e përjashton mjekun nga detyrimi që nëse është e nevojshme, të saktësojë brenda specialitetit të tij, diagnozën e kryer nga një mjek tjetër që ka patur nën kujdes pacientin, duke interpretuar analizat e urdhëruara prej tij⁴⁵.

KONKLUSIONE

Përgjegjësia penale për pakujdesi në mjekim mund të lindë si rrjedhojë e mospërmbyshjes nga ana e mjekut të detyrimit për kujdes gjatë kryerjes së një shumëllojshmërie veprimtarish. Këto veprimtari përfshijnë vënien në jetë sipas *lege artis* të dijeve dhe aftësive teknike, detyrimin për informim mbi risqet dhe benefitet nga trajtimi i propozuar apo mbi mangësitë në kushtet e ofruara nga enti spitalor ku do të jepet kujdesi mjekësor. Po kështu, për mjekun mund të lindë përgjegjësia nga detyrimi që ka për të mbikëqyrur personat në varësi.

Duke pranuar prezumimin ligjor se dëmi i shkaktuar nga veprimet e mjekut do të konsiderohet i ardhur nga pakujdesia dhe jo nga dashja, mendojmë se dispozita e Nenit 96 KPSH mund të saktësohet duke përcaktuar shprehimisht në ligj normat e posaçme të kujdesit që duhet të respektohen nga profesionistët e kujdesit mjekësor i.e. protokollet dhe udhëzuesit klinikë si dhe praktika e mirë mjekësore, siç parashikohet aktualisht në rregullimin ligjor italian. Gjithashtu do të ishte e rekomandueshme që të saktësohej për efekt të zbatimit të ligjit penal se cili është kuptimi i “dëmit të rëndë” në shëndet. Përtej kuadrit të pakujdesisë në mjekim, jurisprudenca dhe doktrina shqiptare ende nuk ka përpunuar se cilat janë hapat e nevojshme për vlerësimin e lidhjes shkakësore. Ky korrektim do të shmangte rrezikun e kthimit të ekspertit mjeko-ligjor në një gjyqtar *de facto* të pakujdesisë në mjekim. Sa parashtruar në këtë punim, orienton drejt nevojës për të parashikuar në ligj se cilat janë rregullat e kujdesit të posaçëm që duhet të respektohen nga profesionisti i kujdesit mjekësor i.e. udhëzuesit klinikë, protokollet mjekësore dhe në mungesë të tyre, praktika e mirë mjekësore. Sidoqoftë është e domosdoshme që të qartësohet se këto rregulla kanë karakter suplementar të rregullave të përgjithshme të kujdesit dhe se mjeku duhet të gëzojë autonomi në përzgjedhjen e trajtimit më të përshtatshëm mes atyre të mundshme.

BIBLIOGRAFIA

1. Albertazzi, L., Cataldi, R., Romanelli, F., Storani, P.M., Vagnoni, S., La responsabilità della struttura sanitaria pubblica e privata, Maggioli, 2014.
2. Beauchamp, T. L., & Childress, J. F., “Principles of biomedical ethics”, New York: Oxford University Press, 2009.
3. Caletti, G.M. Mattheudakis, M.L., “Una prima lettura della legge “Gelli-Bianco”

⁴⁵ Cass. Pen., Sen. IV, Sentenza n. 13542/13.

- nella prospettiva del diritto penale”, *Diritto Penale Contemporaneo* n. 2/2017, ff. 84-108, aksesuar më dhjetor 2017 nga <https://www.penalcontemporaneo.it/d/5272-una-prima-lettura-della-legge-gelli-bianco-nella-prospettiva-del-diritto-penale>
4. De Ferrari, F., Palmieri, L., *Manuale di medicina legale*, Giuffrè, Milano, 2007.
 5. Demneri, R. “The degrees of negligence as an element of culpability in criminal law versus civil law applied to the medical profession”, *Book of Proceedings of “Social-Economic Regional Cooperation towards the Developed Markets Conference”*, University of Elbasan “Aleksandër Xhuvani”, November 2015.
 6. Demneri, R., “Përgjegjësia Penale e Mjekut – Aspekte Krahasuese me Normativën Penale Italiane”, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, 2014.
 7. Elezi, E *Drejta Penale (pjesa e posaçme)*, Botime Kumi, 2014.
 8. Elezi, I., *E Drejta Penale*, Botime Erik, 2008.
 9. Muçi, Sh., *E Drejta Penale (pjesa e përgjithshme)*, Botime Dudaj, Tiranë, 2007.
 10. Nuni, A., Mustafaj, I., Vokshi, A., “E drejta e detyrimeve I”, Tiranë, 2008.
 11. Preamble to the Constitution of the World Health Organization as adopted by the International Health Conference, New York, 19-22 June, 1946; signed on 22 July 1946 by the representatives of 61 States (*Official Records of the World Health Organization*, no. 2, p. 100) and entered into force on 7 April 1948.
 12. Sirena, P., *La responsabilità medica alla luce della legge Balduzzi*, Relacion i prezantuar me rastin *Convegno Ischia*, 13-14 aprile 2013, aksesuar më dhjetor 2017 nga <http://www.altalex.com/index.php?idnot=63007>
 13. Vergallo G. M., *Il rapporto medico-paziente: Consenso e informazione tra libertà e responsabilità*, Milano, Giuffrè, 2008.
 14. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.
 15. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë.
 16. Kodi Penal i Republikës Popullore të Shqipërisë i vitit 1954.
 17. Kodi Penal i Republikës së Italisë.
 18. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
 19. Kushtetuta e Republikës së Italisë.
 20. Ligji n. 7815/94 “Për barnat” (i ndryshuar).
 21. Ligji n. 9323/04 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik” (i ndryshuar).
 22. Ligji n. 9739//07 “Për shërbimin e trasfuzionit të gjakut”(i ndryshuar).
 23. Ministria e Drejtësisë, Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, 19.12.2016. Aksesuar më dhjetor 2017 nga http://www.drejtësia.gov.al/files/userfiles/Legjislacioni/Projekt_Akte/Ndryshime_thelbësore_në_politikën_penale/KODI_PENAL_19.12.2016_OK.pdf
 24. Cass. Civ., Sez. III, Sentenza n. 6416/79; Cass. Civ. Sez. II, Sentenza n. 4394/85; Cass. Civ. Sez. III, Sentenza n. 9705/97; Cass. Civ. Sez. III, Sentenza

- n. 10014/94; Cass. Civ. Sez. III, Sentenza n. 364/97; Cass. Civ. Sez. II, Sentenza n. 3046/97; Cass. Civ., Sez. III, Sentenza n.9617/99.
25. Cass. Pen., Sentenza 22156/16; Cass. Pen., Sentenza n. 10643/96; Cass. Pen., Sentenza n. 2782/89; Cass. Pen., Sentenza n. 50078/17 (Sentenza Cavazza); Cass. Pen., Sentenza n. 714/98; Cass. Pen., Sentenza n. 7475/85; Cass. Pen., Sez. IV, Sentenza n. 1025/07; Cass. Pen., Sez. IV, Sentenza n. 10643/96; Cass. Pen., Sez. IV, Sentenza n. 13542/13; Cass. Pen., Sez. IV, Sentenza n. 17505/08; Cass. Pen., Sez. IV, Sentenza n. 3448/04; Cass. Pen., Sez. IV, Sentenza n. 9739/05; Cass. Pen., Sez. Sentenza n. 46586/04; Cass. Pen., Sez. V, Sentenza n. 714/98; Cass. Pen., Sez. V, Sentenza n. 33136/11; Cass. Pen., SS.UU., Sentenza n. 2437/09.
26. Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë, Vendimi Nr.00-2012-1406 i Vendimit (235) datë 19.09.2012; Vendimi Nr.00-2012-878 i Vendimit (15) datë 23.01.2013; Vendimi n. 00-2013-645 datë 20.03.2013.
27. Udhëzime dhe vendime të Gjykatës së Lartë të RPSH (Përmbledhje të viteve 1967, 1968, 1969, 1970), 8 Nëntori, Tiranë, 1975.
28. Web (aksesuar më dhjetor 2017): <http://gazeta-shqip.com/lajme/2017/02/08/humb-jeten-pas-lindjes-foshnja-dyshohet-per-mjekim-te-pakujdesshem/>; <http://www.oranews.tv/article/mjeket-mjekimi-i-pakujdesshem-te-mos-konsiderohet-veper-penale>; <http://shqiptarja.com/home/1/drejt-sia-europiane-e-padrejt-sia-e-ligjit-ndaj-mjekut-shqiptar--379610.html>

ANALIZË MBI PROBLEMATIKËN TEORIKE DHE PRAKTIKE TË VEPRAVE PENALE NË FUSHËN E DOGANAVE

DR. Kreshnik MYFTARI

Departamenti i të Drejtës Penale,
Fakulteti i Drejtësisë,
Universiteti i Tiranës

DR. Anisa ANGJELI

Departamenti i të Drejtës Publike,
Fakulteti i Drejtësisë,
Universiteti i Tiranës

ABSTRAKT

Në kuadrin e reformimit të kuadrit ligjor, në vitin 2015 Kodi Penal iu nënshtrua një sërë ndryshimeve të rëndësishme me qëllim harmonizimin e tij me legjislacionet e vendeve të zhvilluara të Bashkimit European. Ndryshimet e legjislacionit penal në këtë vit prekën më së shumti pjesën e posaçme të Kodit duke filluar me disa ndryshime në veprat penale kundër personit dhe veprat penale kundër pasurisë. Të tjera ndryshime ishin bërë në vitin 2013, por ato i drejtoheshin kryesisht instituteve të përgjithshme të Kodit dhe disa veprave penale specifike të parashikuara në pjesën e posaçme.

Këto amendime prekën fillimisht institutet e pjesës së përgjithshme të së drejtës penale, siç është ai i caktimit të dënimit për disa vepra penale, parashikuar nga neni 55 i Kodit Penal. Në të njëjtën kohë ndryshime të rëndësishme pati edhe pjesa e posaçme e Kodit Penal, fillimisht në veprat penale kundër personit dhe kundër jetës, po ashtu edhe veprat penale kundër pasurisë edhe në sferën ekonomike. Edhe pse në tërësinë e tyre këto amendime ishin pozitive dhe sollën një qasje të re dhe harmonizim të Kodit Penal me legjislacionin penal të vendeve të tjera, duhet theksuar se në mjaft krerë dhe seksione ku Kodi pësoi ndryshime, u hasën vështirësi teorike, për sa i përket interpretimit dhe dallimit të veprave penale ashtu sikurse edhe vështirësi praktike, për sa i përket kualifikimit të saktë ligjor të veprës.

Referuar parashtrimeve të mësipërme, përmes këtij punimi synojmë pikërisht të analizojmë problematika të natyrës teorike dhe praktike që sollën ndryshimet e legjislacionit penal në veprat penale në fushën e doganave. Në përfundim do të paraqesim dhe një sërë sugjerimesh dhe rekomandimesh me qëllim ndryshimin dhe përmirësimin e këtyre dispozitave.

Fjalë kyçe: Kodi Penal, akcizë, regjim doganor

HYRJE

Veprat penale të kontrabandës janë të parashikuara në Seksionin V, Kreu III në veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike. Ato paraqesin një rëndësi të veçantë për aq kohë sa prekin drejtpërdrejt interesat ekonomikë të shtetit.

Për herë të parë këto vepra u parashikuan si të tilla nga Kodi Penal i Republikës Popullore të Shqipërisë i vitit 1952. Konkretisht kontrabanda parashikohej si vepër penale nga neni 91, i cili i referohej në mënyrë të përgjithshme veprës penale vetëm si kalim i mallrave fshehurazi në kufijtë e Republikës Popullore të Shqipërisë. Në vetvete vepra penale ishte një kundërvajtje penale pasi në paragrafin e parë dënohej në maksimum deri në një vit burgim. Hyrja në fuqi e Kodit Penal të vitit 1981 nuk solli asnjë ndryshim në lidhje me përkufizimin e veprës penale, po ashtu nuk solli as figura të reja të veprës penale të kontrabandës. Ai u kufizua vetëm në ndryshimin e masës së dënimit, konkretisht heqjen e lirisë, duke ndryshuar kështu konceptin e veprës penale, nga kundërvajtje në krim. Megjithatë në periudhën kohore në fjalë, për të kuptuar veprën penale të kontrabandës, juristët i referoheshin legjislacionit doganor, i cili përmbante në vetvete përkufizime të sakta të shkeljeve në fushën e doganave.

Me ndryshimet e vitit 1992 dhe ardhjen e pluralizmit politik, legjislacioni penal iu nënshtrua një reforme gjithëpërfshirëse duke sjellë hartimin e një Kodi të ri Penal. Përkrah këtyre ndryshimeve, u hartuan ligje të reja edhe në fushën e tatimeve dhe doganave, siç është ligji nr. 7599, datë 02.09.1992 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 8148, datë 11.09.1996.

Në një përkufizim të përgjithshëm kontrabanda i referohet çdo veprimi apo mosveprimi të kryer me dashje që ka për qëllim shmangien dhe mospagimin e detyrimeve doganore. Viti 2015 solli ndryshimet thelbësore në këtë seksion duke prekur drejtpërdrejt pothuajse çdo vepër penale të kryer në fushën e doganave. Edhe pse ndryshimet ishin një domosdoshmëri si pasojë e rritjes së kriminalitetit në këtë fushë, ato sollën probleme kryesisht praktike që lidhen me cilësimin juridik, sepse shumë koncepte, siç është ai i akcizës ose regjimeve doganore, u bënë pjesë e përmbajtës të pothuajse çdo norme brenda këtij seksioni.

Kontrabanda në Kodin Penal dhe problematika e ndryshimeve ligjore të vitit 2015

Në Kodin Penal, veprat penale në fushën e doganave janë të parashikuara nga Seksioni V i Kreut III, pra në konceptin e veprave penale kundër pasurisë. Edhe pse në një kuptim të përgjithshëm kontrabanda përbën një vepër penale, ajo ishte e strukturuar në nëntë dispozita, pra figura të posaçme kryesore dhe në dy norma juridike, të cilat nuk sanksiononin drejtpërdrejt kontrabandën si veprim, por merrnin në përgjegjësi penale personat që i tregtonin, ruanin ose depozitonin mallrat e kontrabanduara.

Një problematikë që u has ndër vite lidhej me konkurimin e veprave penale brenda të njëjtit seksion dhe me cilësimin juridik kur një veprim parashikonte elementë të dy normave të ndryshme. Konkretisht bëhej fjalë për ekzistencën e konkurimit të figurave të kontrabandës të parashikuara nga neni 171 dhe 177 i Kodit Penal, pra kontrabanda me mallra që paguhet akcizë dhe kontrabanda e mallrave me regjim të ndërmjetëm.

Kjo pyetje mori përgjigje me vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë,¹ e cila sanksionoi përfundimisht se, me përjashtim të mallrave të ndaluar, të cilët nuk lejohet absolutisht as të hyjnë, as të dalin, as të kalojnë tranzit në territorin e Republikës së Shqipërisë, çfarëdo lloj malli tjetër në qarkullimin civil dhe i vendosur në një regjim lejimi, përpunimi ose magazinimi² do të konsiderohet si kontrabandë me mallra me regjim të ndërmjetëm. Duke qenë normë e posaçme, kjo prevalon përkundrejt normave të tjera të cilat në themel të tyre përcaktojnë shprehimisht llojin e mallit, siç është malli i akcizës, ai i licencuar apo ai i lejuar. Pra përgjegjësia penale do të jetë sipas kësaj norme speciale të parashikuar nga Kodi Penal.

Në vitin 2015 Kodi Penal iu nënshtrua ndryshimeve thelbësore, të cilat prekën në të njëjtën kohë gjithë strukturimin e seksionit të veprave penale në fushën e doganave. Kontrabanda aktualisht nuk parashikohet më nga nëntë nene, por nga dhjetë; kjo pasi u shtua një dispozitë penale që është ajo e kontrabandës së kryer nga kapiteni i anijes. Po ashtu edhe veprat e tjera që nuk preknin drejtpërdrejt kontrabandën u rikonceptuan. Veprat penale që u prekën më shumë janë kontrabanda me mallra që paguhet akcizë³, kontrabanda me mallra të tjerë⁴ dhe kontrabanda me mallra me regjim të ndërmjetëm.⁵

Këto ndryshime sollën një problematikë të re praktike që lidhet drejtpërdrejt me cilësimin juridik të këtyre veprave penale. Fillimisht këtu mund të përmendim problematikën që lidhet me konceptin e akcizës që nuk është më element vetëm i kontrabandës me mallra që paguhet akcizë, por gabimisht është përfshirë edhe në norma të tjera juridiko-penale, siç është kontrabanda me mallra të tjerë dhe kontrabanda me mallra me regjim të ndërmjetëm. Kjo përfshirje e konceptit të akcizës në disa figura prek drejtpërdrejt identitetin e këtyre veprave penale duke i bërë ato të padallueshme nga njëra-tjetra.

Duhet të theksohet se mallrat kanë natyrë të ndryshme, referuar këtu edhe përcaktimeve që jepen nga Kodi Doganor. Një mall akcize është tërësisht i ndryshëm nga një mall i konsumit të përditshëm, siç janë mallrat e lejuar. Në të njëjtën

¹ Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë Nr. 1/2002

² Bëhet fjalë për mallrat me regjim të ndërmjetëm në referim të neneve 203 e vijues të Kodit Doganor

³ Parashikuar nga neni 172 i Kodit Penal

⁴ Parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal

⁵ Parashikuar nga neni 177 i Kodit Penal

kohë, përfshirja e konceptit të akcizës edhe në veprën penale të kontrabandës me regjim të ndërmjetëm dhe parashikimi i regjimit të ndërmjetëm në veprën penale të kontrabandës me mallra që paguhet akcizë, sjell në vetvete një regres juridik lidhur me dallimin ndërmjet këtyre dy normave juridiko-penale dhe cilësimin e tyre juridik, duke rënë në kundërshtim edhe me praktikën e Gykatës së Lartë që i dha zgjidhje kësaj problematike vite më parë, nëpërmjet vendimit unifikues.

Probleme të tjera hasen në formulimin dhe strukturimin e këtyre normave juridiko-penale. Kështu për shembull, kontrabanda me mallra që paguhet akcizë e strukturuar në tre paragrafë, një paragraf kryesor që interpreton kuptimin e kontrabandës dhe dy paragrafë të parashikuar si rrethana të cilësuar të normës, dënon më pak rrethanën e cilësuar, të parashikuar në paragrafin e dytë se sa veprimin konkret që lidhet drejtpërdrejt me kontrabandën, të parashikuar në paragrafin e parë.

E drejta penale i parashikon rrethanat e cilësuar në kuptim të rrethanave rënduese, por me dallimin nga këto të fundit për faktin se rrethanat e cilësuar janë pjesë e integruar e normës juridiko-penale, ndërkohë që për aplikimin e rrethanave rënduese, ne duhet t'i referohemi pjesës së përgjithshme të Kodit Penal.

Kjo mënyrë strukturimi e dispozitave bie ndesh edhe me parimet e teknikës legjislative sipas së cilës formulohet dhe strukturohet një dispozitë juridike.

Të njëjtat ndryshime sollën një problematikë jo vetëm me veprat kryesore të kontrabandës, por edhe me veprat e tjera të parashikuara në këtë seksion, që lidhen me ruajtjen, depozitimimin dhe tregtimin e këtyre mallrave. Kështu për shembull vepra penale e kontrabandës me mallra që paguhet akcizë parashikon në paragrafin e dytë si rrethanë të cilësuar hedhjen në konsum të këtyre mallrave, ndërkohë që kjo e fundit përbën një figurë më vete të këtij seksioni, që është ajo e tregtimit të mallrave kontrabandë. I njëjti paragraf parashikon në formulim edhe rrethana të tjera që janë të parashikuara edhe nga një vepër tjetër penale që lidhet drejtpërdrejt me kontrabandën, ajo e kontrabandës me mallra me regjim të ndërmjetëm.

Kontrabanda në Kodin Doganor

Me ndryshimin e sistemit dhe ardhjen e pluralizmit politik në vitin 1991, lindi nevoja e menjëhershme e reformimit të kuadrit ligjor në pothuajse çdo fushë e veprimtari institucionale. Ndryshimet demokratike sollën problematika të reja kriminale të pahasura deri në ato vite. Hapja e kufijve bëri që tregtia, nga monopol i shtetit të zhvendosej në duart e individit. Në këtë kohë u pa i nevojshëm hartimi i një Kodi të ri Doganor, i cili hyri në fuqi në vitin 1992.

Ky kod rikonceptoi veprën penale të kontrabandës, ndryshe nga ligji i mëparshëm në fushën e doganave dhe nga Kodi Penal i vitit 1977. Megjithatë vepra penale vazhdoi të mbetej një përkufizim i përgjithshëm me natyrë teknike. Kjo vepër penale u parashikua si e tillë në Kodin Doganor të vitit 1992 në nenin 63 të tij.⁶

⁶ Ligj nr. 7599, datë 10.02.1992 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”

Gjatë kësaj periudhe kohore, duke qenë se nuk ishte miratuar Kodi i ri penal, për identifikimin dhe marrjen në përgjegjësi penale të këtyre veprave procedohej me Kodin Penal të vjetër dhe me Kodin e ri Doganor.

Përveç sanksionimit në Kodin Penal, veprat penale në fushën e doganave, konkretisht edhe kontrabanda, parashikohet edhe nga Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë.⁷

Kodi në fjalë jep përcaktimet e përgjithshme të kontrabandës, format dhe mënyrat e kryerjes së saj. Në të njëjtën kohë, ai parashikon edhe sanksionet administrative për këto shkelje, përkrah sanksioneve penale. Me fjalë të tjera, marrja në përgjegjësi penale, pra dënimi për kryerjen e veprave penale të kontrabandës nuk e përjashton personin në të njëjtën kohë nga përgjegjësia administrative.⁸

Prej kohësh diskutohet ndërmjet juristëve problematika e ekzistencës në të njëjtën kohë e përgjegjesisë penale dhe asaj administrative dhe cënimin në këto kushte të parimit të ligjshmërisë “*ne bis in idem*”.⁹

Problematika që sollli hyrja në fuqi e Kodit të ri Doganor në vitin 2014 lidhet drejtpërdrejt me ndryshimet që iu bënë Kodit Penal, konkretisht seksionit të krimeve në fushën e doganave në vitin 2015. Shumë koncepte të parashikuara në Kodin Doganor u kopjuan dhe u përfshinë në ligjin material pa iu nënshtuar asnjë lloj përshtatjeje dhe strukturimi. Kështu për shembull hedhja në konsum e mallrave të vendosura në qarkullim të lirë, parashikuar nga neni 266 i Kodit Doganor u përfshi edhe në nenin 172, paragrafi 2 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë”, në kundërshtim me të gjitha parimet e teknikës legjislative dhe të të drejtës penale sa i përket strukturimit dhe formulimit të një norme juridike.

Sikurse është theksuar edhe më sipër, Kodi Penal parashikon një normë specifike e cila lidhet me tregtimin, ruajtjen dhe depozitimimin e mallrave kontrabandë dhe nuk ishte e nevojshme që kjo formë e kontrabandës, e parashikuar në Kodin Doganor, të integrohej edhe në normën e sipërcituar të Kodit Penal.

Kodi Doganor i vitit 1999 ishte më i harmonizuar me Kodin Penal duke qenë se normat që lidheshin me përgjegjësinë penale në fushën e doganave, nuk binin ndesh me njëra-tjetrën. Ai parashikonte format e përgjithshme dhe të posaçme të kryerjes së kontrabandës, të cilat qëndronin më vete, dallonin nga përkufizimi i kontrabandës në Kodin Penal dhe nuk sillnin asnjë problematikë lidhur me identifikimin e këtyre normave në praktikë.

Është për t’u theksuar se sikurse edhe Kodi Doganor i vitit 1999, edhe Kodi i ri Doganor, i kanë krijuar mundësinë shtetasve që përgjegjësinë për veprën e

⁷ Kreu III, nenet 266 e vijues të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë

⁸ Neni 270 i Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë

⁹ Mosdënimi dy herë për të njëjtin fakt

kontrabandës ta zgjidhin në rrugë administrative, duke shmangur në këtë mënyrë dënimin penal. Kështu ligjvënësi i ka dhënë mundësinë individëve që nëse nuk ka filluar ende ndjekja penale ose detyrimi doganor është më i ulët se 5 milionë lekë, ose kur personi i akuzuar deklaron se heq dorë nga e drejta e ankimit administrativ, shkelësi mund t'i kërkojë autoriteteve doganore zgjidhjen në rrugë administrative të kontrabandës.¹⁰

Duhet të pranojmë se legjislacioni doganor është mjaft i përparuar dhe i harmonizuar me legjislacionin e Bashkimit European, duke qenë se në shumë vende komunitare veprat penale në fushën e doganave kanë shkuar drejt depenalizimit, marrim si shembull këtu legjislacionin Italian të cilin do ta trajtojmë në vijim.¹¹

Për sa i përket kuptimit të kontrabandës dhe dallimit që ka parashikimi në Kodin Doganor me atë në ligjin material, përveç rasteve të dallimit ndërmjet përgjegjësish administrative dhe asaj penale, një dallim që paraqet interes është edhe ai i kontrabandës së mbetur në tentativë. Ndryshe nga Kodi Penal i cili e merr në përgjegjësi penale individin edhe për kontrabandën e mbetur në tentativë, duke zbutur dënimin për shkak të rrezikshmërisë më të ulët shoqërore, nuk mund të themi të njëjtën gjë për parashikimet e Kodit Doganor. Kontrabanda e mbetur në tentativë, si shkelje administrative, dënohet njëlloj nga Kodi Doganor sikurse edhe shkelja e kryer.

Depenalizimi i kontrabandës në legjislacionin Italian

Ndërmjet shumë veprave penale të depenalizuara nga qeveria Italiane siç është shpifja, drejtimi i automjetit pa patentë, përfshihet edhe vepra penale e kontrabandës me qëllim që sistemi ndëshkimit të jetë efektiv. Në këtë këndvështrim disa vepra penale u transformuan në kundërvajtje të thjeshta administrative. Kjo reformë i referohet në mënyrë të veçantë kontrabandës, pra lëvizjes së mallrave nëpërmjet kufijve tokësorë, ajrorë ose detarë ose përtej pikave doganore.¹²

Konkretisht me miratimin e dekretit legjislativ nr. 8, datë 15.01.2016, në kuadër të depenalizimit të disa veprave penale, qeveria e Republikës së Italisë vendosi ndër të tjera heqjen e dënimit me burgim për veprën penale të kontrabandës si dhe ndëshkimin e kësaj vepre vetëm me masën administrative të gjobës në raport me llojin e mallrat të kontrabanduar dhe mënyrën e kalimit të tij. Në këtë mënyrë ndryshoi tërësisht natyra e këtyre shkeljeve duke i parashikuar tanimë si kundërvajtje administrative dhe jo më si vepra penale. Megjithatë u parashikua ndër të tjera, se kryerja e këtyre veprave në mënyrë të përsëritur, përveç sanksionimit me gjobë do të kishte përkrah edhe dënimin deri në një vit burgim. Ky sanksion

¹⁰ Neni 272 i Kodit Doganor

¹¹ Artikull - "Il contrabbando non e piu reato", Valeria Zeppilli, 29.01.2016

¹² Artikull - "Depenalizzazione del contrabbando e attenuate tutela degli interessi finanziari dell'Unione Europea", Samuel Bolis; www.dirittopenalecontemporaneo.it

administrativ duhet të sigurojë një mbrojtje analoge ose e thënë ndryshe duhet të garantojë një efikasitet në analogji me sanksionin penal. Ndërkohë me këtë lloj të veçantë sanksioni administrativ nuk mund të arrihet një nivel i mjaftueshëm parandalimi. Kur shkeljet i përkasin një të mire juridike të rangut primar, sanksioni penal duket pothuajse gjithmonë i nevojshëm, dhe ndonjëherë edhe i justifikuar.¹³

Krimi i kontrabandës mbron një të mirë juridike me vlerë Europiane, duke qenë se taksat doganore përbëjnë një nga të ardhurat kryesore të Bashkimit European. Prandaj është e domosdoshme që të reflektohet mbi ndryshimin në sistemin doganor në një kuadër më të gjerë, atë të së drejtës komunitare.

Depenalizimi i krimit të kontrabandës gjithashtu bie ndesh me qëndrimin e mbajtur nga Ekzekutivi Italian në trajtimin e propozimit më të fundit të Direktivës së Parlamentit European dhe Këshillit mbi kuadrin ligjor të Bashkimit European lidhur me shkeljet dhe dënimet doganore të vitit 2013.

Në kuadër të reformave ligjore dhe problematikave kriminale, ne mendojmë se nuk është ende momenti që këto vepra penale të depenalizohen ose më tej akoma të përfshihen në kategorinë e kundërvajtjeve administrative. Kjo për arsye që lidhen me faktin se fenomeni i kontrabandës në vendin tonë është ende mjaft i përhapur dhe nga ana tjetër, niveli i mbledhjes së taksave është mjaft i ulët. Depenalizimi në këtë mënyrë do të shkaktonte jo vetëm përhapje të mëtejshme të këtyre veprave penale, por edhe do të sillte një përkeqësim të theksuar në buxhetin e shtetit në mbledhjen e taksave dhe tatimeve, që për hir të së vërtetës në Shqipëri është mjaft i ulët.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në përfundim mund të themi që edhe pse ndryshimet e seksionit të veprave penale në fushën e doganave ishin një domosdoshmëri për shkak të fenomenit gjithnjë e në rritje të kontrabandës, mënyra se si këto vepra u formuluan dhe u strukturuan solli probleme lidhur me identifikimin e tyre në praktikë dhe cilësimin e saktë juridiko-penal.

Pavarësisht faktit se problematikës më të madhe të këtij seksioni, lidhur me konkurimin dhe cilësimin juridik të veprave penale në fushën e kontrabandës, i kishte dhënë zgjidhje Gjykata e Lartë nëpërmjet vendimit unifikues, ndryshimet ligjore të vitit 2015 na rikthejnë edhe një herë paqartësitë e mëparshme.

Është e vërtetë se ndryshimet në tërësi të Kodit Penal në vitin 2015 duhet të konsiderohen si ndryshime pozitive, ndërkohë që nuk mund të themi të njëjtën gjë për sa i përket veprave penale në fushën e doganave. Ndryshimet tërësore që

¹³ Artikull – “Il contrabbando dopo la depenalizzazione”, Pittaluga Francesco, 19.09.2016; www.diritto.it

pësoi pothuajse çdo normë e këtij seksioni, nuk respektuan parimet bazë të teknikës legislative dhe të të drejtës penale. Në pothuajse çdo normë u ngatërruan institutet dhe nocionet në raste specifike të kontrabandës. Mendojmë se ka ardhur momenti që këto vepra penale të riformulohen dhe ristrukturohen edhe një herë, pasi është e domosdoshme që ato të dallojnë nga njëra-tjetra, por nga ana tjetër nuk propozojmë që ato të kthehen në përkufizimin e mëparshëm.

Në kuadër të reformimit të këtyre veprave penale nuk propozojmë që të ndjekim modelin e shtetit Italian për sa i përket depenalizimit të këtyre normave për arsye se fenomeni i kontrabandës në vendin tonë është ende në nivele shumë të larta. Jo çdo reformë e kryer nga një vend i BE-së mund të implementohet pa u përshtatur me kontekstin social dhe ekonomik të një vendi. Megjithatë, dëshirojmë të theksojmë se Kodi Doganor i ka krijuar shumë avantazhe shtetasve që kanë kryer veprën penale të kontrabandës, në mënyrë që këto raste të zgjidhen në rrugë administrative pa qenë nevoja e fillimit të ndjekjes penale.

Së fundmi dhe nga gjithë sa është analizuar më sipër, arrihet në përfundimin se detyra e ligjvënësit nuk është vetëm hartimi i ligjeve formalisht, por formulimi i tyre i saktë dhe i qartë në mënyrë që të jenë të kuptueshëm dhe të aplikueshëm në praktikë.

BIBLIOGRAFI

- Ligj nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Kodi Penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë i vitit 1977;
- Kodi Penal i Republikës Popullore të Shqipërisë i vitit 1952;
- Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë Nr. 1/2002;
- Ligji nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji nr. 7599, datë 02.09.1992 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”;
- Artikull - “Il contrabbando non e piu reato”, Valeria Zeppilli, 29.01.2016
- Artikull – “Depenalizzazione del contrabbando e attenuate tutela degli interessi finanziari dell’Unione Europea”, Samuel Bolis; www.dirittopenale-contemporaneo.it
- Artikull – “Il contrabbando dopo la depenalizzazione”, Pittaluga Francesco, 19.09.2016; www.diritto.it
- Dekreti legjislativ nr. 8, datë 15.01.2016 “Disposizioni in materia di depenalizzazione a norma dell’articolo 2, comma 2, della legge 28 aprile 2014, n. 67”.

PËRDORIMI I FORCËS PËR TË MBROJTUR PRONËN NË LEGJISLACIONIN CIVIL DHE NË ATË PENAL

Prof. asoc. Dr. Florian BJANKU
Fakulteti i Drejtësisë
Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

ABSTRAKT

Në këtë punim shtrohet diskutimi nëse pronari ose poseduesi i pronës (e luajtshme ose e paluajtshme) mund të përdorë forcën për të kundërshtuar një sulm të çastit, të realizuar nga një ose disa persona të tjerë, që ka për qëllim cenimin ose zhveshjen nga posedimi. Gjithashtu, trajtohet edhe rasti i përdorimit të forcës vdekjeprurëse, ku legjislacione në vende të ndryshme ndahen sa i takon kushteve që duhet të plotësohen në justifikimin e saj. Forca e arsyeshme nënkupton sasinë e forcës që një person i arsyeshëm në të njëjtën situatë do të besonte se është e nevojshme për të mbrojtur pasurinë nga dëmtimi i menjëhershëm. Gjatë vlerësimit të organeve të ndjekjes penale apo gjykatës, nëse kemi përdorim të forcës së arsyeshme, duhen marrë parasysh rrethanat siç njiheshin nga personi që e ka përdorur atë dhe duke marrë parasysh atë që një njeri i arsyeshëm, në një situatë të ngjashme, me njohuri të ngjashme do të kishte besuar. Nëse besimet e të pandehurit ishin të arsyeshme, rreziku ka apo nuk ka nevojë të ekzistojë në të vërtetë? Barra e provës përtej dyshimit të arsyeshëm, nëse ka përdorur ose jo më shumë forcë sesa ishte e përshtatshme për të mbrojtur pronën nga dëmtimi i menjëhershëm, merren krahasimisht në vende të ndryshme, si dhe në interpretim të nenit 310 të Kodit Civil “Mbrojtja e atëçastme” dhe nenit 19 të Kodit Penal të RSH “Mbrojtja e nevojshme”, si dhe rasteve të praktikës nga organet e ndjekjes penale dhe ato gjyqësore.

Fjalë kyçe: Pronë; mbrojtje e nevojshme; dëmtim i çastit; mbrojtja e atëçastme.

I. HYRJE

Në këtë punim fokusi i trajtimit ka të bëjë me të drejtën e pronarit ose të poseduesit të ligjshëm për të përdorur forcën, madje edhe forcën vdekjeprurëse, për të sprapsur ata që sulmojnë pronën e tij. Hipoteza ime fillestare në këtë punim është ajo ligjore, leja e dhunës në mbrojtje të pronës rrjedh nga analitika dhe marrëdhëniet normative midis pronës si send dhe personitetit të pronarit apo poseduesit të ligjshëm si subjekt, duke u formuluar kështu si një argument i dyfishtë.

Kur çështje të tilla përfundojnë në gjykatë, çështja shtrohet: A munden njerëzit të përdorin ligjërisht forcën për të mbrojtur pronën e tyre dhe nëse po, sa? Përgjigjja

e përbashkët do të ishte po, në një shkallë të arsyeshme, dhe përgjigjja ligjore është e ngjashme. Teoritë moderne argumentojnë se e drejta e vetëmbrojtjes është një e drejtë themelore e njeriut, e cila në të gjitha rastet, pa përjashtime, justifikon përdorimin e dhunës, e cila rrjedh nga kjo e drejtë, pavarësisht nëse mbron personin apo pasurinë¹. Në përgjithësi, legjislacionet e vendeve të ndryshme pranojnë se kushdo mund ta përdorë ligjërisht forcën për të penguar ose kapur një person që i cënon pronën. Por gjithsesi ka kufizime për këto kompetenca. Nëse pronari apo poseduesi i ligjshëm përdor armën e zjarrit kundër një hajduti që ka hyrë në banesën e tij dhe e vret atë në mungesë të një besimi të arsyeshëm për rrezik personal, mund të mbajë përgjegjësi penale dhe të shpallet fajtor për vrasje ose, të paktën, për kapërcim të kushteve të mbrojtjes së nevojshme. Kur një pjesë e dhunës është e justifikuar, por përdoret forcë e tepruar, disa juridiksione në vende të ndryshme do t'i mohojnë çdo mbrojtje nëse i shkakton vrasjen e cënuesit. Si e tillë, vrasja nëpërmjet forcës së tepruar nuk është as e justifikuar as e pranuar. Juridiksione të tjera do të mundësojnë në këto raste një mbrojtje të pjesshme, duke reduktuar dënimin për veprën penale të vrasjes.

Dy nga parimet më themelore ligjore perëndimore janë e drejta e jetës dhe e drejta e pronës. Por çfarë ndodh kur jeta dhe prona ballafaqohen me njëra tjetrën? Një mundësi e tillë ekziston kur pronari apo poseduesi i ligjshëm mund të realizojë një vrasje në mbrojtje të pronës. E drejta e jetës tani është e njohur ndërkombëtarisht si një e drejtë themelore e njeriut, domethënë një e drejtë bazë e disponueshme për të gjithë qëniet njerëzore.

Çështja doktrinale e mbrojtjes së tepërt të pronës përmban dallime në legjislacionet e vendeve të ndryshme. Ndoshta tre ide të përgjithshme mund të veçohen nga burimet ligjore ndërkombëtare. Së pari, prona për shumë legjislacione nuk është një vlerë e vlefshme dhe e mjaftueshme për t'u mbrojtur me forcë kur nuk ka kërcënim shoqëruar për jetën dhe shëndetin e pronarit ose të poseduesit të ligjshëm. Së dyti, ligji në vende të tjera nga pikëpamja e mbrojtjes, nuk bën dallimin ndërmjet personit fizik të pronarit dhe pronës së tij, në këtë mënyrë mbrojtja e dhunshme e pronës konsiderohet e justifikuar, madje edhe atëherë kur nuk ekziston kërcënim për sigurinë trupore ose personale të tij. Së fundi, motivi dhe qëllimi, *pra mens rea*, luajnë një rol të rëndësishëm në dhënien e fajësisë në rastin e përdorimit të tepërt të forcë në mbrojtjen e pronës.

Në këtë punim të tre idetë e mësipërme fillimisht paraqiten në doktrinat, legjislacionet dhe jurisprudencat e disa vendeve në mënyrë që situata të bëhet më e kuptueshme kur trajtohet rasti i vendit tonë. Doktrina e “Kështjellës” (Castle Doctrine) e aplikueshme kryesisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës vendoset përballë, në një vështrim krahasimor, me teori që mbështesin shmangien e dhunës për atë që nuk ka rrezik të cënohet jeta apo shëndeti.

¹ G, Castles and Characters; Proportionality and Use of Deadly Force in Defense of Dwelling and Property, 1999 University of Illinois Law Review

Instituti i mbrojtjes së nevojshme është parashikuar edhe në legjislacionin shqiptar që me fillimet e së drejtës penale shqiptare. Kështu, që në Kodin Penal Shqiptar të vitit 1928², trajtohej mbrojtja e nevojshme, por kufizohej vetëm në mbrojtjen e personit ose të nderit të tij apo të tjetrit. Gjithashtu, parashikohej edhe në Kodin Penal të Republikës Popullore të Shqipërisë të vitit 1952, ku objekti i këtij instituti zgjerohet dhe merr një përkufizim tjetër³, ndërsa në nenin 9 të Kodit Penal të Vitit 1977 shtohet edhe mbrojtja e “Partisë së Punës të Shqipërisë” dhe e “gjithë rendit shoqëror socialist”. Pavarësisht nga diferencat e lartpërmendura, objekti i mbrojtjes së nevojshme në të drejtën penale shqiptare dhe atë ndërkombëtare nënkuptohet kurdoherë një e drejtë, me fjalën e drejtë duhen nënkuptuar të gjitha të drejtat të cilat lidhen me jetën, shëndetin apo paprekshmërinë e personit si dhe ato të drejta të cilat lidhen me pasuritë⁴.

II. “Doktrina e Kështjellës” përballë teorisë së shmangies ndaj dhunës joproportionale

“Doktrina e Kështjellës” është një term që përdoret kryesisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, megjithëse edhe në legjislacionet e vendeve të tjera gjejmë parime të ngjashme. Kjo doktrinë e njohur gjithashtu si një ligj “kështjellë” ose një mbrojtje e banesës, është një doktrinë ligjore që përcakton vendbanimin e një personi ose çdo vend të zënë në mënyrë të ligjshme - p.sh. një automjet apo shtëpi - si një vend ku ky person ka mbrojtje të veçantë duke lejuar pronarin apo poseduesin e ligjshëm, në rrethana të caktuara, të përdorë forcën (duke përfshirë forcën vdekjeprurëse në raste ekstreme) për t’u mbrojtur kundër një ndërhyrjeje të paligjshme. Në këto raste të përdorimit të forcës personi që e shkakton atë nuk mban përgjegjësi penale.

Mjaft shtete në legjislacionet e tyre civile dhe penale argumentojnë se një person duhet të tërhiqet për të shmangur përdorimin e dhunës ekstreme, nëse për këtë ka hapësira për të mos u përballur me agresorin dhe këtë mund ta realizojë në mënyrë të arsyeshme. Siç do ta trajtojmë më poshtë në këtë punim, legjislacioni dhe jurisprudenca shqiptare bazohen më tepër në parimet e teorisë së shmangies së përdorimit të dhunës vdekjeprurëse aty ku është e mundur, se sa atë të “Kështjellës”. Në shumicën e vendeve të Europës, ashtu si në Shqipëri, banesa nuk ka një mbrojtje

² Neni 50 i Kodit Penal të Rrepublicës së Shqipërisë, të vitit 1928, “Në të cilin përkufizohet si kundërveprim i shtrënguar nga nevoja për të sprapsur një violencë të çastit e të padrejtë, të drejtuar kundër personit ose nderit të tij ose të tjetrit, për sprapsjen e së cilës nuk ka pasur as kohë e as mjete të tjera më të lehta”

³ Neni 8 i Kodit Penal të Republikës Popullore të Shqipërisë, viti 1952 “Nuk përmban përgjegjësi penale personi që kryen një veprë të parashikuar nga ligji penal për të mbrojtur pushtetin popullor, pasurinë shtetërore dhe shoqërore, personin ose të drejtat e tij ose të një tjetri nga një sulm i padrejtë, i vërtetë dhe i atëçastshëm me kusht që të mos kapërcejë kufijtë e mbrojtjes së nevojshme”

⁴ Ela Podgorica “Refleksione mbi anën objektive të figurës së veprës penale (disertacion për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor”); Fakulteti i Drejtësisë UT; fq. 79.

specifike në legjislacion që justifikon përdorimin e forcës vdekjeprurëse në rastin e cënimit të saj. Në vendet që nuk ndjekin “Doktrinën e Kështjellës”, pronari ose poseduesi i ligjshëm dhe banesa e tij nuk trajtohen në të njëjtën mënyrë.

Kodi Civil zviceran parashikon të drejtën e vetëmbrojtjes në nenin 926 ku parashikohet se: *“Poseduesi ka të drejtën e përdorimit të forcës në vetëmbrojtje kundër ndonjë ndërhyrjeje të paligjshme. Në qoftë se atij i është hequr posedimi i një objekti me forcë ose në menyrë të fshehtë, ai ose ajo ka të drejtë ta rimarrë atë menjëherë duke dëbuar shkelësin nga prona e tij ose, në rast se kemi të bëjmë me një send të luajtshëm, duke e marrë atë nga personi i kapur në flagrance i ndjekur menjëherë. Duke vepruar kështu, ai ose ajo duhet të abstenojë nga e gjithë forca e pajustificuar në baze të rrethanave”*.

Kodi Civil gjerman ka parashikuar të drejtën e përdorimit të forcës nga ana e poseduesit të ligjshëm, në nenin 859 thuhet se: *“Poseduesi mund të përdorë forcën për të mbrojtur veten e tij nga ndërhyrja e paligjshme. Në qoftë se një send i luajtshëm i është marrë poseduesit nëpërmjet ndërhyrjes së paligjshme, poseduesi mund të përdorë forcën që ta rimarrë atë nga ndërhyrësi, i cili është kapur në flagrancë ose që ndiqet. Në qoftë se poseduesi i një parcele toke është privuar nga posedimi nëpërmjet një ndërhyrjeje të paligjshme, poseduesi mund ta rifitojë posedimin menjëherë pas heqjes së posedimit duke larguar ndërhyrësin. Poseduesi ka të njëjtat të drejta kundër personit, i cili në bazë të seksionit 558 (2) të sipërcituar mund të lejojë që të metat e posedimit të pohohen kundër vetes së tij”*.

Ligji “Per pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore”⁵ i Republikës së Kosovës parashikon gjithashtu përdorimin e forcës nga ana e poseduesit të ligjshëm në nenin 112 ku parashikohet se: *“Poseduesi mund të përdorë forcën e arsyeshme për mbrojtje nga veprimet e paligjshme në pengimin e posedimit të tij, në qoftë se ndërhyrja është atëçastshme dhe janë ndërmarrë masat adekuate (proporcionale) për mbrojtje, menjëherë me paraqitjen e ndërhyrjes (rrezikut). Nëse një send i luajtshëm i merret poseduesit me pengim të kundërligjshëm, poseduesi mundet të përdorë force të arsyeshme që ta heq sendin nga penguesi i cili është zënë në vepër ose ndiqet. Te drejtat e cekura në paragrafet e sipërm për vetëndihmen e poseduesit mund të ushtrohen edhe nga detentori sipas nenit 105 të këtij ligji”*.

Ndërsa, “Doktrina e Kështjellës” nuk mbështetet në teorinë e tërheqjes kur një individ sulmohet në vendbanimin e tij, ku ai ka të drejtë të jetë, si brenda shtëpisë së vet. Forca vdekjeprurëse mund të justifikohet dhe mbrojtja e nevojshme e vrasjes së justifikueshme zbatohet, në rastet kur “autori ka arsye të frikësohet për rrezikun e menjëhershëm të vdekjes ose të dëmtimit të rëndë trupor ndaj vetvetes ose tjetrit”. Doktrina e kështjellës nuk është thjesht një ligj i caktuar, por një sërë parimesh që përfshihen në legjislacionin civil dhe atë penal.

Vrasja e justifikueshme brenda shtëpisë është e dallueshme, si një çështje e

⁵Ligji Nr. 2009/03-L-154) “Per pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore” i Republikës së Kosovës

ligjit, nga doktrina e kështjellës, sepse thjesht ndodhja e cënimit - dhe herë pas herë e ekzistencës së kërkesës subjektive të frikës - është e mjaftueshme për të thirrur doktrinën e kështjellës, barra e provës së fakteve është shumë më pak sfiduese sesa ajo e justifikimit të një vrasjeje. Me një ligj të zakonshëm që lejon realizimin e vrasjes në kushte të caktuara, në përgjithësi duhet të dëshmohet në mënyrë objektive një faktor përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, qëllimin në mendjen e cënuesit për të kryer dhunë ose një krim. Nga ana tjetër, do të ishte një keqkuptim i ligjit për të konkluduar se vetëm për shkak se një shtet ka dispozita ligjore që parashikojnë cënimin e vendbanimit, ai ka një “doktrinë kështjelle” të justifikueshme të vrasjeve.

Përdorimi i këtij parimi ligjor në Shtetet e Bashkuara ka shkaktuar shumë debate në lidhje me një numër rastesh në të cilat është përdorur nga jurisprudenca, përfshirë vdekjen e studentit Hattori⁶. Ai ishte një student japonez që kishte ardhur në SHBA në një program të shkëmbimit të studimeve dhe banonte në Luiziana. Në kohën e vdekjes së tij, viti 1992, Hattori ishte nisur për të shkuar në një mbrëmje të Halloween, por ai ngatërroi adresën dhe shkoi rastësisht në shtëpinë e gabuar. Pronari i banesës, R. P, qëlloi dhe vrau Hattorin, duke menduar se ai kishte qëllime kriminale. Gjykata e Luizianës⁷ vlerësoi se pronari kishte vepruar brenda kushteve të mbrojtjes së nevojshme edhe pse studentin nuk kishte asnjë qëllim për të dëmtuar atë apo pronën e tij. Frika e pronarit u vlerësua e arsyeshme dhe në përputhje me veprimet e tij që sollën vdekjen e studentit japonez.

Në kontrast me mënyrën se si ndodhi ngjarja me studentin japonez Hattori, një rast që dominoi vëmendjen e opinionit publik në Britaninë e Madhe në vitet 2000, sa i takon përdorimit të forcës në mbrojtje të pronës dhe shkaktimit të vdekjes së cënuesit, është ai i Tony Martin, një fermer i vetmuar në Norfolk të Anglisë, i cili vrau një hajdut dhe pastaj u ndoq penalisht për vrasje. Ai u dënua dhe fillimisht iu dha dënimi i përjetshëm. Martin kishte pësuar vjedhje të shumta në një fermë të izoluar dhe kishte humbur besimin tek policia se do të vepronte në kapjen e hajdutëve. Ai argumentoi në mbrojtjen e tij, se rrethanat ishin të arsyeshme që të përdoret forca vdekjeprurëse në mbrojtje të shtëpisë nga hajduti që e kishte cënuar atë. Më 20 gusht 1999, kur Martin pësoi një tjetër vjedhje, ai pretendoi se kishte vepruar nga frika e tre hajdutëve që e kishin sulmuar atë, dhe për këtë arsye kishte qëlluar me armë dy nga ata. Megjithatë, prokuroria argumentoi se ai kishte qëlluar vjedhësit nga prapa kur ata po largoheshin. Njëri nga të dy hajdutët vdiq dhe një tjetër u plagos në këmbë, por u arratis. Historia e saktë është e rëndësishme sepse vërtetë Martin vrau hajdutët e banesës së tij, por ai në atë moment nuk veproi nën frikën e sigurisë së tij personale. Përkundrazi, u konsiderua se ai kishte vepruar si gjykatës dhe ekzekutues, duke dhënë një dënim të ashpër personal hakmarrës. Pavarësisht se Gjykata e Apelit e reduktoi ndjeshëm masën e dënimit për Martin, pasi u provua

⁶ Yoshihiro Hattori (22 nëntor 1975 - 17 tetor 1992)

⁷ *Hattori v. Peairs*, 662 So. 2d 509 (Louisiana Court of Appeal 6 October 1995)

se gjendja mendore e tij ishte paranojake, ajo u pajtua me konsiderimin si veprime të paarsyeshme të Martin, në raport me rrezikun e paraqitur⁸.

“Doktrina e Kështjellës” është një koncept që vjen nga filozofia se çdo person është “Mbreti” ose “Mbretëresha” e shtëpisë së tyre. Kështu, asnjëherë nuk ka nevojë që monarku i mbretërisë të ikë nga kështjella para përdorimit të forcës kundër një ndërhyrjeje të paligjshme. Kodi Penal i Teksasit §9.31 (që rregullon përdorimin e justifikuar të forcës jo vdekjeprurëse) dhe §9.32 (që rregullojnë përdorimin e justifikuar të forcës vdekjeprurëse) janë versioni tipik i Doktrinës së Kështjellës.

Brenda “kështjellës” së pronarit apo poseduesit të ligjshëm, në rrethana të caktuara, ligjet që mbështesin në këtë teori, mbrojnë faktin e përdorimit në mënyrë të arsyeshme të forcës, deri në veprime kundërshtuese vdekjeprurëse për të mbrojtur veten nga një person cënues që hyn në banesën, automjetin ose vendin e punës. Cilat janë rrethanat dhe rastet që duhet të ekzistojnë sipas kësaj doktrine?

Së pari, kur një individ në mënyrë të paligjshme dhe me forcë, hyn ose përpiket të hyjë në banesën, automjetin ose vendin e biznesit apo të punës të një personi.

Së dyti, kur një individ në mënyrë të paligjshme dhe me forcë, largon ose përpiket të largojë një person nga vendbanimi, automjeti ose vendi i tij i punës.

Nëse ekzistojnë këto situata, vendet që i përmbahen “Doktrinës së Kështjellës”, psh. ligji i Teksasit në SHBA, prezumohet se nga pronari apo poseduesi i ligjshëm është vepruar në mënyrë të arsyeshme dhe të justifikuar në përdorimin e forcës deri edhe në veprime që mund t’i shkaktojnë vdekjen cënuesit. Në këto raste barrën e provës e kanë organet e ndjekjes penale për të provuar se veprimet kundërshtuese nuk kanë qenë të arsyeshme apo në kapërcim të mbrojtjes së nevojshme.

Për sa i përket përdorimit të forcës ose forcës vdekjeprurëse për të mbrojtur “kështjellën”, Kodi Penal i Teksasit përdor në mënyrë specifike fjalën “vendbanim”, jo fjalët “ndërtim” ose “pronë”. Teksas ka një përkufizim shumë të kufizuar të asaj që kualifikohet si banesë. “Doktrina e Kështjellës” nuk mbulon tërë pjesën e pasurisë së pronarit. Termi ligjor “vendbanim” përcaktohet nga Kodi Penal i Teksasit § 30.01 si “një strukturë ose mjet i përshtatur për akomodimin të personave; dhe përfshin secilën pjesë të veçantë të siguruar ose të zënë të strukturës ose automjetit; dhe çdo strukturë që i përket ose që lidhet me strukturën ose mjetin.” Kjo do të thotë që strukturat që janë të shkëputura nga vendi ku flihet gjatë natës nuk konsiderohen si vendbanim, psh. garazhet. Megjithatë, nëse garazhi, ballina e përparme ose e pasme është e lidhur me strukturën që përmban vendet e fjetjes, konsiderohet pjesë e banimit, siç përcaktohet nga Kodi Penal i Teksasit. Po, ky dallim i vogël në dizajnin arkitektural mund të ndikojë në të drejtat ligjore të pronarit apo poseduesit të ligjshëm.

Duke iu referuar rastit të automjeteve, Kodi Penal i Teksasit §30.01 përcakton një automjet “si çdo pajisje, në ose në të cilën çdo person ose pasuri është ose mund të lëvizet ose tërhiqet në rrjedhën normale të tregtisë ose transportit.” Ky është një përkufizim shumë i gjerë dhe duket se përfshin çdo gjë që mban njerëzit ose pronën

⁸ Martin v R [2001] EWCA Crim 2245 (30 October 2001)

nga një vend në tjetrin, duke përfshirë makina, kamionë, anije, aeroplanë, karroca etj. Pika e rëndësishme për të kujtuar është posedimi i makinës për t'u dhënë prezumimin e arsyeshmërisë sipas Kodit Penal të Teksasit §9.31 dhe §9.32.

Pavarësisht më sipër, Doktrina e Kështjellës nuk lejon për të përdorur forcën vdekjeprurëse thjesht për shkak se dikush është në pronën e dikujt. Nganjëherë nga njerëzit aludohet se ligji lejon përdorimin e forcës vdekjeprurëse kundër një shkelësi të thjeshtë. Në fakt, ligji i Teksasit thotë të kundërtën e saktë. Kodi Penal i Teksasit §9.41 lejon përdorimin e forcës, jo forcën vdekjeprurëse, që është e nevojshme për të parandaluar ose ndërprerë shkeljen e një tjetri në vendin tuaj.

Sipas Kodit Penal të Teksasit, pronari apo poseduesi i ligjshëm, ka të drejtë ligjore për të përjashtuar ose larguar shkelësit; megjithatë ata janë të kufizuar vetëm në përdorimin e forcës jo vdekjeprurëse për ta bërë këtë. Përdorimi i forcës mund të ketë shumë manifestime të ndryshme, nga konfrontimi fizik dhe deri me shfaqjen e një arme. Kodi Penal i Teksasit §9.04 parashikon se për qëllime mbrojtëse nxjerrja e një arme për të mundësuar kapjen e një personi tjetër konsiderohet përdorim i forcës, jo forcë vdekjeprurëse. Kjo do të thotë që nëse dikush çënon pronën e dikujt, pronari apo poseduesi i ligjshëm mund të nxjerrë armën e zjarrit për të krijuar frikë se do të përdoret forca vdekjeprurëse nëse është e nevojshme. Pavarësisht kësaj, ai nuk do të justifikohet ligjërisht në shkrehjen e armës së zjarrit, por vetëm në nxjerrjen e saj për të “krijuar kapjen” sipas ligjit. Vetëm nëse shkelësi kryen veprime të tjera pas kësaj, mund të justifikojë përdorimin e forcës vdekjeprurëse dhe mund të lejohet shkrehja e armës së zjarrit.

III. Përdorimi i forcës në mbrojtje të pronës sipas legjislacionit aktual shqiptar

Mjeti i parë që parashikon Kodi Civil për të realizuar mbrojtjen e posedimit është mbrojtja e atëçastme (neni 310 i K.Civil). Në nenin 310 të Kodit Civil parashikohet se: *“Poseduesi ka të drejtë të kundërshtojë aty për aty, duke përdorur një mbrojtje të përshtatshme, çdo veprim që ka për qëllim cenimin ose zhveshjen nga posedimi. Kur sendi është marrë me dhunë ose fshehurazi, poseduesi ka të drejtë ta marrë atë menjëherë ose në ndjekje e sipër, por duke evituar veprimet e dhunës që nuk pajtohen me rrethanat e ngjarjes. Ndërsa neni 311 i KC parashikon se: “E drejta për të mbrojtur posedimin i njihet edhe mbajtësit të sendit, kundër çdo personi tjetër, përveç ndaj atij nga i cili i vijnë këto të drejta”.*

Pra ligjvënësi i ka njohur pronarit apo poseduesit të ligjshëm: a) Të drejtën që të kundërshtojë aty për aty veprimet që synojnë cënimin ose zhveshjen e tij nga posedimi i sendit ose i të drejtes reale dhe b) të drejtën që kur zhvishet nga posedimi i sendit me dhunë ose fshehurazi ta rivendosë menjëherë sendin në posedimin e tij ose në ndjekje e sipër të cënuesit të realizojë rivendosjen e sendit në posedimin e tij⁹.

⁹ Altin Shkurti “Posedimi dhe mbrojtja e tij”, disertacion grada “Doktor”, Tiranë, 2015, Fakulteti i Drejtësisë UT, fq. 122.

Ligjvënësi njohjen e së drejtes së poseduesit për të kundërshtuar veprimet që synojnë cënimin ose zhveshjen e posedimit e ka kushtëzuar me realizimin e saj brenda kufijve *‘të një mbrojtjeje të pershtatshme’*. Me termin *‘mbrojtje e pershtatshme’* ligjvënësi, ka përcaktuar që kufijtë e mbrojtjes së posedimit janë ata të mbrojtjes së nevojshme të parashikuara nga neni 19 i Kodit Penal: *“Nuk ka përgjegjësi penale personi që ka kryer veprën duke qenë i detyruar të mbrojë jetën, shëndetin, të drejtat dhe interesat e tij ose të një tjetri, nga një sulm i padrejtë, i vërtetë dhe i çastit me kusht që, karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me rrezikshmërinë e sulmit. Mospërputhja haptazi ndërmjet tyre përbën kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme”*.

Brenda kuptimit të nenit 19 të Kodit Penal janë edhe të drejtat që lidhen me mbrojtjen e pronës ashtu edhe mbrojtja e disa të drejtave reale të lidhura me të. Pavarësisht se në këtë nen nuk përmendet shprehimisht fjala “pronë”, “pronar” apo “pasuri”, kjo përfshihet tek të drejtat dhe interesat e personit që, ashtu si jeta dhe shëndeti të specifikuar në këtë nen, mund të jenë objekt i cënimit nga një sulm i padrejtë, i vërtetë dhe i çastit.

Kur trajtojmë konceptin e mbrojtjes së nevojshme, si rast specifik i përjashtimit nga përgjegjësia penale, përveç normave përkatëse të Kodit Penal, duhet njëkohësisht që t’i referohemi edhe Kodit Civil sa i takon koncepteve të tij të pronës, sendit dhe mbrojtjes juridike të tyre. Sipas nenit 152 të Kodit Civil, sendet u përkasin personave fizikë, personave juridikë dhe shtetit. Prandaj, objekt i mbrojtjes së nevojshme janë si marrëdhëniet juridiko-penale, të cilat lidhen me pronën private, ashtu edhe ato të cilat lidhen me pronën publike, si dhe ato të cilat u përkasin personave fizikë, ashtu edhe ato të cilat u përkasin personave juridikë ose shtetit. E rëndësishme është që më anën e kundërsulmit të mbrohet kjo pasuri nga vjedhja, dëmtimi apo shkatërrimi imediat që i kanoset nga sulmi i padrejtë dhe i çastit.

Kështu, do të quhej në mbrojtje të nevojshme personi që përdor armë zjarri kundër një personi tjetër ose një bande që është duke sulmuar po me armë zjarri që të futet në banesën e tij për grabitje. Nga nocioni i mbrojtjes së nevojshme del se për t’u konsideruar se ekziston mbrojtja e nevojshme duhet të shprehet sulmi dhe mbrojtja. Veprimet e pronarit ose poseduesit të ligjshëm duhet të drejtohen për mbrojtjen e posedimit dhe jo për cënimin e integritetit fizik të personit që synon cënimin ose zhveshjen e posedimit. Intensiteti i veprimeve mbrojtëse duhet të jetë i barabartë me intensitetin e veprimeve që synojnë cënimin ose zhveshjen e posedimit¹⁰.

Sulmi dhe mbrojtja njëherazi janë dy elementë kryesorë të mbrojtjes së nevojshme, të cilat duhet t’i përmbushin kushtet e caktuara. Përndryshe, nëse këto dy elemente kryesore nuk shprehen në kushtet dhe sipas rregullave të caktuara me ligj, nuk mund të bëhet fjalë për ekzistencën e mbrojtjes së nevojshme. Sulmi është çdo

¹⁰ Altin Shkurti “Posedimi dhe mbrojtja e tij”, disertacion grada “Doktor”, Tiranë, 2015, Fakulteti i Drejtësisë UT, fq. 122.

veprim i njeriut i cili është i detajuar në dëmtimin apo rrezikimin e ndonjë të mire juridike. Zakonisht sulmi mund të kryhet vetëm me veprim¹¹.

Dispozita e nenit 19 të Kodit Penal përcakton tiparet që duhet të karakterizojnë sulmin dhe kriterin bazë të cilin duhet të respektojë mbrojtja për të pranuar ekzistencën e mbrojtjes së nevojshme. Karakteristikat e sulmit në mbrojtjen e nevojshme janë:

1 - Sulmi të jetë veprim i njeriut.¹² Për të ekzistuar mbrojtja e nevojshme, sulmi duhet të ndërmerret nga njeriu. Në të drejtën tonë penale, në rastet kur sulmi vjen nga kafshët, fuqitë mbinatyrore, konsiderohet se ekziston nevoja ekstreme, veprimi i njeriut, është një nga karakteristikat kryesore të dallimit të mbrojtjes së nevojshme nga instituti i nevojës ekstreme¹³.

2 - Sulmi të jetë i padrejtë. Sulm i padrejtë është ai veprim i njeriut i cili është në kundërshtim me ligjin dhe që vë në rrezik të drejta dhe interesa të mbrojtura nga ligji. Është pikërisht padrejtësia e sulmit, ajo e cila e dallon atë nga veprimet e personave që përmbushin detyra shtetërore apo shoqërore sipas ligjit ose ushtrojnë të drejta, nga përmbushja e të cilave preken apo dëmtohen të drejta apo interesa të personave të ndryshëm, përgjithësisht të personave kundër të cilëve drejtohen këto veprime¹⁴. Për shembull nuk mund të quhen sulm i padrejtë veprimet e përmbarusit gjyqësor për zbatimin forcërisht të një vendimi gjyqësor civil ose të një titulli tjetër ekzekutiv. Mbrojtja e nevojshme gjithashtu nuk legjitimohet as për personin e tretë i cili shkon në ndihmë të atij që ka provokuar sulmin¹⁵.

3 - Sulmi të jetë i vërtetë. Kërkesa që sulmi i padrejtë të jetë i vërtetë ose real, është vendosur për të parandaluar rastet e simulimeve ose të sulmeve imagjinare. Sulm i vërtetë është ai veprim i padrejtë i sulmuesit i cili ekziston objektivisht, i shfaqur aty për aty në botën e jashtme dhe që rrezikon seriozisht të drejta të mbrojtura me ligj, gjë që justifikon edhe reagimin ndaj tij. Në rastin kur sulmi nuk ekziston realisht, por përfytyrohet në imagjinatën e personit ose supozohet se mund të bëhet, nuk përlligjet asnjë lloj reagimi me pasoja të dëmshme nga ana e personit që e përfytyron atë, kundër autorit të supozuar të tij.

4 - Sulmi të jetë i çastit (aktual). Në kuptimin e mbrojtjes së nevojshme, sulmi konsiderohet i çastit në rastet kur në çdo moment pritet se do të fillojë, kur ka filluar të veprojë dhe derisa të zgjasë, përkatësisht deri në përfundim¹⁶. Nuk është

¹¹ Ela Podgorica “Refleksione mbi anën objektive të figurës së veprës penale (disertacion për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor”), Fakulteti i Drejtësisë UT, fq 81.

¹² Vendimet Nr. 346, datë 23.05.2002; Nr. 38, datë 15.01.2003; Nr. 100, datë 16.02.2005; Nr.244, datë 06.05.2009, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

¹³ I.Salihi., vepër e cituar, fq. 238

¹⁴ Ela Podgorica “Refleksione mbi anën objektive të figurës së veprës penale (disertacion për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor”), Fakulteti i Drejtësisë UT, fq. 81.

¹⁵ Ela Podgorica “Refleksione mbi anën objektive të figurës së veprës penale (disertacion për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor”), Fakulteti i Drejtësisë UT, fq. 81.

¹⁶ I.Salihi., vepër e cituar, fq. 238

e lejuar mbrojtja ndaj ndonjë sulmi i cili do të pasojë pas një kohe si dhe mbrojtja ndaj sulmit i cila ka përfunduar, ka pushuar së vepruari. Nuk mund të cilësohet në kushtet e mbrojtjes së nevojshme vepra e kryer për të shmangur një sulm i cili përgatitet të bëhet në të ardhmen, edhe sikur të ketë të dhëna të plota se ardhja e tij është e sigurt, sepse në sulme të kësaj natyre personi i rrezikuar ka mundësi dhe kohë të mjaftueshme për ta parandaluar atë në rrugë të tjera, duke përdorur mjete dhe mënyra të tjera më të përshtatshme.

Në lidhje me situata të përdorimit të forcës vdekjeprurëse në kushtet e mbrojtjes së nevojshme të pronës, rasti më tipik i ndodhur në Shqipëri vitet e fundit është ai i biznesmenit F.Y autor i vrasjes së dy personave të maskuar që kishin hyrë brenda banesës së tij në Selitë të Tiranës, më 18 dhjetor 2014. Sipas Prokurorisë së Tiranës, nën kërcënimin e armës këta persona të maskuar e kanë detyruar bashkëshorten e autorit të vrasjes që t'ju tregojë vendin se ku ishte kasaforta që mbanin lekët. Në një moment autori F.Y ka dalë nga dhoma dhe është përleshur me personin me maskë i cili i kishte drejtuar armën bashkeshortes së tij, dhe pasi i ka marrë armën atij, ia ka drejtuar duke i thënë që të mos levizi, por arma ka shkrepur dhe ky person është rrëzuar në tokë. Me pas i ka drejtuar armën personit tjetër me maskë që ishte brenda në dhome duke i thënë që të hiqte kapucin, por ky shtetas nuk ka pranuar dhe ka tentuar për të ngritur dorën në atë moment F.Y e ka qëlluar dhe ai ka qendruar pa lëvizur. Pas kësaj F.Y i ka marrë armën nga dora këtij personi dhe ka tentuar ta qëllojë por ajo armë nuk ka shkrepur. Nga ky moment autori F.Y, ka sqaruar se nga frika se mos e qëllonte ndonjeri nga këta shtetas me ndonjë armë të fshehur në trup i ka qëlluar disa herë personat me maska që qendronin të shtrirë.

Fillimisht Prokuroria e Tiranës ngriti akuzën se shtetasi F.Y kishte konsumuar elementët e veprave penale të “Vrasjes se kryer në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake”, parashikuar nga neni 83 dhe 278/3, i Kodit Penal. Nga Prokuroria e Tiranës, e cila kërkoi edhe arrestimin e F.Y, u ngritën dyshimet paraprake se ai i ka qëlluar autorët edhe pasi këta të fundit nuk kanë patur më mundësi të reagojnë. Gjithashtu, një gëzhgojë dhe predha nuk i përkisnin kalibrit të asnjërës prej dy armëve të gjetura dhe të sekuestruara në vendngjarje, duke krijuar dyshimin e bazuar se në vendin e ngjarjes është realizuar qitje edhe me armë të tjera të cilat shtetasi F.Y, edhe sipas deklarimeve të tij i ka hedhur ne oborr. Por nga këqyrja e vendit të ngjarjes (oborrit, shtëpisë dhe zonës përreth) nuk është gjetur asnjë armë tjetër. Kjo krijoi dyshimin se armët janë larguar nga vendi i ngjarjes para mbërritjes së policisë pasi kanë qenë të disponuara pa leje nga autori. Por në përfundim të hetimeve për ngjarjen, ku mbetën të vrarë dy të rinjtë që kishin hyrë me maska në banesën e shtetasit F.Y, Prokuroria e Tiranës ka pushuar këto akuza ndaj tij. Biznesmeni është dërguar për gjykim vetëm për akuzën e “Veprimeve që pengojnë zbulimin e të vërtetës”¹⁷.

¹⁷ Dosja ku rezulton i pandehur F. Y, është depozituar në Gjykatën e Tiranës më 26 qershor 2015

Kërkesat të cilat e bëjnë mbrojtjen apo kundërsulmin të ligjshëm, janë përcaktuar nga teoria dhe praktika e të drejtës penale¹⁸. Këto kërkesa janë:

1- Mbrojtja të drejtohet kundër sulmuesit. *Qëllimi i vetëm i mbrojtjes është sprapsja e sulmit të padrejtë për të mbrojtur të drejtën që rrezikohet të preket apo të dëmtohet nga ky sulm i çastit, mbrojtja ka të drejtë të ballafaqohet e të kundërsulmojë vetëm autorin e sulmit të drejtpërdrejtë, por kurrsesi me persona të tjerë të cilët nuk kanë lidhje më të.*

2- Karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me rrezikshmërinë e sulmit. Mbrojtja nuk është e pakufizuar dhe e pakontrolluar në veprimet e saj, por ka një limit, vepron brenda disa qaqeve të caktuara dhe me fuqi të mjaftueshme sa për të realizuar detyrën, mbrojtjen e së drejtës së rrezikuar nga sulmi. Ndryshe nga sulmi ku tiparet e tij jepen të plota, lidhur me mbrojtjen ligji shqiptar parashikon vetëm një kusht, që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me rrezikshmërinë e sulmit, pa e përcaktuar këtë karakter dhe këtë proporcion, gjë të cilën do të duhet ta bëjë praktika dhe teoria e së drejtës penale. Intensiteti i saj duhet të jetë i barabartë apo më pak i madh se intensiteti i sulmit, sipas ligjit të thjeshtë të lidhjes aksion-reaksion¹⁹, nëse është më i vogël sulmi nuk mund të refuzohet. Për vlerësimin objektiv të të sulmuarit për faktin se cila mënyrë apo cili mjet ka qenë domosdoshmërisht i nevojshëm për mbrojtje, duhet të merren parasysh të gjitha rrethanat, e sidomos momenti psikologjik i befasisë, i frikës apo situatë e ngjashme psikologjike, prezente në situata të tilla²⁰, në të cilat nuk mund të pritet një sjellje apo llogjikim i ftohtë dhe i arsyeshëm i një mbrojtjeje që plotësisht do t'i përgjigjej intensitetit të sulmit. Për të qënë në gjëndjen e mbrojtjes së nevojshme, thuhet në një vendim të Gjykatës së Lartë, nuk kërkohet që të ketë barazi mjetesh sulmi dhe mbrojtjeje. Kërkohet që mbrojtja të bëhet në përputhje me karakterin dhe forcën e sulmit, me fjalë të tjera, intensiteti i mbrojtjes t'i përshtatet intensitetit të sulmit²¹.

3- Mbrojtja të mos kapërcejë kufijtë e mbrojtjes së nevojshme. I sulmuari nuk ka të drejtë të pakufizuar të mbrohet në çfarëdo mënyre, me cilado mjete dhe me cilindo intensitet të mbrojtjes. E drejta e tij e mbrojtjes së nevojshme është e kufizuar me elementë të përqendruar rreth sulmit dhe mbrojtjes, e secili nga ato elementë ka përmasa të ndryshme të elementëve sasiore dhe cilësore²², sasia e mbrojtjes është e përcaktuar në sasinë e sulmit. Kur mbrojtja ndërmerret para sulmit apo pas ndërprerjes së tij duhet konsideruar se nuk ekziston mbrojtje e nevojshme dhe as tejkalim i saj²³

dhe çështja penale në ngarkim të tij dhe mban numrin 3601.

¹⁸ Sh. Muçi., vepër e cituar, Fq.191

¹⁹ V.Kambovski., vepër e cituar, fq.215

²⁰ V.Kambovski., vepër e cituar, fq.215

²¹ Sh. Muçi., vepër e cituar, fq.194

²² V.Kambovski., vepër e cituar, fq.217

²³ V.Kambovski., vepër e cituar, fq.218

IV. KONKLUZIONE

Në përgjithësi legjislacionet e vendeve të ndryshme pranojnë se kushdo mund ta përdorë ligjërisht forcën për të penguar ose kapur një person që i cënon pronën. Në Shqipëri kjo e drejtë parashikohet në Kodin Civil si një mënyrë e mbrojtjes së posedimit, si dhe nga Kodi Penal si rast që shmang në mënyrë përjashtimore përgjegjësinë penale në rastin e veprave penale kundër jetës dhe shëndetit të personit. Çështja doktrimore e mbrojtjes pronës me anë të përdorimit të forcës përmban dallime në legjislacionet e vendeve të ndryshme. Tre ide të përgjithshme mund të veçohen nga burimet ligjore ndërkombëtare.

1. Prona për shumë legjislacione nuk është një vlerë e vlefshme dhe e mjaftueshme për t'u mbrojtur me forcë kur nuk ka kërcënim shoqëruar për jetën dhe shëndetin e pronarit ose të poseduesit të ligjshëm. Veprimet e pronarit ose poseduesit të ligjshëm duhet të drejtohen për mbrojtjen e posedimit dhe jo për cënimin e integritetit fizik të personit që synon cënimin ose zhveshjen e posedimit. Në shumicën e vendeve të Europës, ashtu si në Shqipëri, banesa nuk ka një mbrojtje specifike në legjislacion që justifikon përdorimin e forcës vdekjeprurëse në rastin e cënimit të saj. Në vendet që nuk ndjekin “Doktrinën e Kështjellës”, pronari ose poseduesi i ligjshëm si subjekt i cënimit të mundshëm dhe banesa e tij nuk trajtohen dhe mbrohen në të njëjtën mënyrë. Jeta e personit ka prioritet në mbrojtjen nga ligji. Në këto vende barra e provës i takon personit që ka përdorur forcën për të provuar se vdekja apo dëmtimi i rëndë i shëndetit i agresorit ka ndodhur për shkak që përveç cënimit të pronës ka patur bindje të arsyeshme edhe në cënimin e jetës apo shëndetit të pronarit apo poseduesit të ligjshëm. Në jurisprudencë ndër rastet më tipike të kësaj doktrine është ai “Tony Martin” në Angli trajtuar më sipër.

2. Ligji në vende të tjera nga pikëpamja e mbrojtjes, nuk bën dallimin ndërmjet personit fizik të pronarit dhe pronës (banesës) së tij, në këtë mënyrë mbrojtja e dhunshme e pronës konsiderohet e justifikuar, madje edhe atëherë kur nuk ekziston kërcënim për sigurinë trupore ose personale të tij. Forca vdekjeprurëse mund të justifikohet dhe mbrojtja e nevojshme e vrasjes së justifikueshme zbatohet, në rastet kur “autori ka arsye të frikësohet për rrezikun e menjëhershëm të vdekjes ose të dëmtimit të rëndë trupor ndaj vetvetes ose tjetrit”. “Doktrina e kështjellës” nuk është thjesht një ligj i caktuar, por një sërë parimesh që përfshihen në legjislacionin civil dhe atë penal. Në këto raste barrën e provës e kanë organet e ndjekjes penale për të provuar se veprimet kundërshtuese nuk kanë qenë të arsyeshme apo në kapërcim të mbrojtjes së nevojshme. Në jurisprudencë ndër rastet më tipike të “Doktrinës Kështjelle” është ai “Hattori” në Luiziana të SHBA-ve trajtuar më sipër.

3. Motivi dhe qëllimi, *pra mens rea*, luajnë një rol të rëndësishëm në dhënien e fajësisë në rastin e përdorimit të tepërt të forcës në mbrojtjen e pronës në të dy doktrinën. Në Shqipëri dhe në vendet e tjera që aplikojnë sisteme që kërkojnë shmangien e dhunës ekstreme dhe jopropocionale, realizimi e vrasjes në kushtet e mbrojtjes së nevojshme duhet të dëshmohet në mënyrë objektive, përtej çdo

dyshimi të arsyeshëm, qëllimi në mendjen e cënuesit për të kryer dhunë ose një krim që rrezikon edhe jetën apo shëndetin e pronarit apo poseduesit të ligjshëm. Nga ana tjetër, në “Doktrinën Kështjellë” barra e provës së fakteve është shumë më pak sfiduese, pasi mjafton mendimi i arsyeshëm dhe frika se cënuesi ka qëllime kriminale në cënimin e banesës, për të justifikuar veprimet e dhunshme brenda kushteve të mbrojtjes së nevojshme.

BIBLIOGRAFIA

Doktrinë

G, CASTLES and Characters; Proportionality and Use of Deadly Force in Defense of Dwelling and Property, 1999 University of Illinois Law Review.

KAMBOVSKI.V, E Drejta Penale, Pjesa Përgjithshme, Shkup 2010

MUÇI.SH, E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme, Tiranë 2012

P. ROCCO, Compendio del Diritto Penale, Parte Speciale, V.2002

PODGORICA.E “Refleksione mbi anën objektive të figurës së veprës penale (Disertacion për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor”), Fakulteti i Drejtësisë UT, 2014.

SALIHU.I, E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme, Prishtinë 2010

SHKURTI. A “Posedimi dhe mbrojtja e tij”, disertacion grada “Doktor”, Tiranë, 2015, Fakulteti i Drejtësisë UT.

Jurisprudencë

Hattori v. Peairs, 662 So. 2d 509 (Louisiana Court of Appeal 6 October 1995)

Martin v R [2001] EWCA Crim 2245 (30 October 2001)

Vendimet Nr. 346, datë 23.05.2002; Nr. 38, datë 15.01.2003; Nr. 100, datë 16.02.2005; Nr.244, datë 06.05.2009, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Legjislacion

Kodi Penal i Shqipërisë, viti 1928

Kodit Penal të Republikës Popullore të Shqipërisë, viti 1952

Kodi Penal i RSH, viti 1995

Kodi Civil i RSH, Viti 1994

Kodi Civil i Zvicrës

Kodi Civil i Gjermanisë

Ligji Nr. 2009/03-L-154) “Per pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore” i Republikës së Kosovës

Kodi Penal i Teksas (SHBA)

**ANALIZA E VEPRËS PENALE TË MASHTRIMIT
KUFIJTË MES PËRGJEGJËSISË PENALE DHE DETYRIMIT
JURIDIKO – CIVIL**

**Prof. Dr. Sokol MENGJESI,
Prof. Asoc. Dr. Klodjan SKENDERAJ**
Fakulteti Drejtësisë Universiteti i Tiranës

ABSTRAKT

Vepra penale e mashtrimit është një ndër veprat kryesore penale që mbrojnë pasurinë. Zbatimi i kësaj vepre penale në praktikë është rritur ndjeshëm dhe pikërisht kjo është një prej arsyeve që më çuan në punimin dhe prezantimin e këtij punimi në këtë konferencë. Nga zbatimi i kësaj vepre penale në praktikë janë hasur disa problematika shumë thelbësore, të cilat nuk kanë të bëjnë thjesht dhe vetëm me interpretimin e saktë doktrinal të elementëve të kësaj vepre penale, por kanë lidhje me dallimin e kësaj vepre me marrëdhënien juridiko civile të një detyrimi të pashlyer. Ky dallim është tepër i nevojshëm dhe domosdoshëm, pasi rëndësia është e vetëkuptueshme, duke u nisur nga fakti që dallimi i saktë dhe konciz i kësaj ndarjeje përbën themelin për ekzistencën ose jo të përgjegjësisë penale.

Gjatë këtij punimi do të fillojmë analizën fillimisht me benefitin juridik të mbrojtur me këtë vepër penale, duke përcaktuar edhe disa prej teorive kryesore për përcaktimin e pasurisë, si koncept ekonomik por edhe juridik. Më pas do të vijojmë analizën me një shpjegim të detajuar të gjithë komponentëve përbërës të kësaj vepre penale, duke nisur nga subjekti, ana objektive, ana subjektive si dhe masa e dënimit. Kuptohet që gjatë kësaj analize do të bëhet një përpjekje më e detajuar në disa prej komponentëve të kësaj vepre penale, siç janë mënyra e kryerjes së saj, por edhe anës subjektive nga ana tjetër, pasi përveçse këto elementë shërbejnë për të bërë analizën e detajuar doktrinale të kësaj vepre penale, shërben gjithashtu edhe për të bërë dallimin thelbësor midis kësaj vepre penale dhe detyrimit juridiko civil. Gjithashtu do të analizohen dhe rastet e veçanta të shfaqies së fenomenit penal si tentativa dhe bashkëpunimi.

Një theks i veçantë gjatë këtij punimi do t'i jepet edhe ndryshimeve ligjore që janë realizuar në kuadër të kësaj vepre penale sidomos përsa i përket përpjekjeve për riformulimin e anës objektive por edhe të masës së dënimit.

***Fjalëkyçe:** mashtim, detyrim juridiko civil, benefit juridik, pasuri, anë objektive, anë subjektive, dënim, tentativë, bashkëpunim.*

Vepra penale e mashtrimit

Në nenin 143 KP është parashikuar vepra penale e mashtrimit “Përvetësimi i pasurisë private ose publike nëpërmjet paraqitjes së fakteve të rreme ose duke

fshehur fakte të vërteta, gënjeshtërs ose shpërdorimit të besimit, për vete ose persona të tjerë, përbën veprën penale të mashtrimit dhe dënohet me burgim deri në pesë vjet.

Kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.

Kur vepra, ka sjellë pasoja të rënda dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.”

Vepra penale e mashtrimit është një vepër penale me subjekt të përgjithshëm çka do të thotë se subjekt i kësaj vepre penale mundet të jetë kushdo¹.

Në anën objektive të kësaj vepre penale, si sjellje të dënueshme parashikohet sjellja mashtruese, e cila konkretizohet me gjithsecilën prej katër mënyrave se si mundet të kryhet kjo vepër penale. Mënyrat se si mundet të kryhet vepra penale, ose e thënë ndryshe *modus operandi*, është e përcaktuar shprehimisht nga ana e ligjvënësit dhe këto janë: a) nëpërmjet paraqitjes së fakteve të rreme, b) duke fshehur fakte të vërteta, c) nëpërmjet gënjeshtërs, d) nëpërmjet shpërdorimit të besimit. Nisur nga sa më sipër arrihet në konkluzionin se bëhet fjalë për një vepër penale me modus operandi të shumëfishtë e mirëfilltë, pasi të katërta mënyrat e parashikuara në anën objektive të veprës penale mundet të alternohen nga ana e autorit dhe përsëri autori do të dënohet vetëm një herë².

Mënyra e parë për kryerjen e kësaj vepre penale është ***paraqitja e fakteve të rreme***³. Duhet theksuar se me fakt kuptohet çdo ngjarje apo situatë si dhe çdo gjëndje e botës së jashtme apo botës së brendshme, që i referohet të tashmes apo të shkuarës dhe mundet të vërtetohet. Duke u nisur nga ky definicion, ne arrijmë në konkluzionin se megjithëse nga ana e ligjvënësit nuk përcaktohet nëse bëhet fjalë për fakte të rreme që i takojnë të shkuarës, të tashmes apo të ardhmes, do të duhet të pranojmë se në konceptin e paraqitjes së fakteve të rreme, hyjnë faktet e të shkuarës dhe të tashmes dhe jo “fakte” që i referohen të ardhmes. Kjo ndodh për arsye sepse vetëm përse a fakteve të të shkuarës e të tashmes ne mundet të kemi një masë krahasimi me realitetin objektiv, për të arritur në përfundimin e pakontestueshëm nëse këto fakte përshtaten apo nuk përshtaten me realitetin objektiv dhe në këtë aspekt nëse janë të vërteta apo të rreme. Përse i përket parashtrimit të situatave që i referohen së ardhmes mundet të themi se këto hyjnë në konceptin faktit, por të supozimit, pasi fakti ashtu siç është parashtruar edhe më lart i referohet një ngjarjeje objektive e cila ka ndodhur. Në këtë aspekt nuk hyjnë në konceptin e faktit, përveç situatave apo premtimeve që i referohen së ardhmes, situatat që i referohen botës së brendshme shpirtërore, gjykimet apo mendimet vlerësuese, përveç faktit gjykimi

¹ Për subjektin e kësaj vepre penale por përgjithësisht edhe për analizën e kësaj vepre penale, ashtu siç ka qënë para ndryshimeve ligjore, shiko *Elezi*, Mbrojtja e pasurisë, fq. 99, e në vijim.

² Shiko Mëngjesi, Bazat e Doktrinës të së Drejtës Penale, Tiranë 2016 fq. 93 e në vijim.

³ Për interpretimin e kësaj mënyre të kryerjes së veprës penale të mashtrimit në Greqi shiko Καρανίκα, Εγχειρίδιον, том. Γ, τευχ. Β, σελ. 554, Παπαδαμάκη, Τα περιουσιακά, σελ. 93, Κωστάρα, Επιτομή, ερμ. ά. 386 α.π. 15.

apo vlerësimi bazohet mbi një rrethanë faktike. Duke qenë se kemi përcaktuar konceptin e faktit, mundet të vijojmë analizën me paraqitjen e fakteve të rreme⁴.

Jemi përpara paraqitjes së fakteve të rreme kur autori i parashtrohet viktimës një situatë apo ngjarje faktike e cila nuk ekziston. Përkundrazi parashtimi i situatave që i referohet së ardhmes, ku padiskutim futen edhe premtimet, nuk hyjnë në konceptin e paraqitjes së fakteve të rreme, për arsye se nuk kanë një masë krahasimi të sigurt për të vlerësuar nëse janë të vërteta apo të rreme, në momentin e parashtimit. Duhet theksuar se personi që i referohet një premtimi apo situatë të së ardhmes, si rregull mundet të ketë dijeni nëse ajo së cilës i referohet do të realizohet ose jo, e për pasojë nëse është e vërtetë apo e gënjeshtërt, por diçka e tillë vlen vetëm për atë individualisht e për askënd tjetër, në këtë aspekt nuk ka një masë krahasimi objektive, por vetëm subjektive, që është një kriter i pasigurt për të interpretuar anën objektive të një veprë penale. Masë krahasimi objektive ekziston në të gjitha ato raste kur ekziston mundësia krahasuese me realitetin, me qëllim që në mënyrë të pakontestueshme dhe përkundrejt cilitdo të karakterizohet me siguri absolute një ngjarje e vërtetë ose e rreme. Megjithatë pavarësisht nga analiza e mësipërme pranohet nga ana e disa doktrinalistëve se përjashtimisht mundet të konsiderojmë si fakt edhe një plan që i referohet të ardhmes, por me kushtin që të lidhet me një situatë konkrete ekzistenciale, e cila mundet të vërtetohet.

Jemi përpara paraqitjes së fakteve të rreme edhe në rastin kur autori i parashtrohet viktimës një situatë apo ngjarje faktike, me një mënyrë të tillë që nuk përputhet me realitetin, me fjalë të tjera tejkalon kufijtë e realitetit.

Parashtimi mundet të realizohet me çfarëdolloj mënyrë të drejtpërdrejtë apo konkludente, gojarisht, me shkrim apo me ndonjë formë tjetër. Mënyra tjetër për kryerjen e veprës penale është *nëpërmjet fshehjes së fakteve të vërteta*⁵. Jemi përpara rastit të fshehjes së fakteve të vërteta në të gjitha rastet kur autori krijon pengesa të çfarëdolloj forme, në mënyrë që viktimë mos të vijë në dijeni të dimensionit real të situatës apo ngjarjeve faktike.

Një mënyrë tjetër e parashikuar për kryerjen e veprës penale të mashtrimit është *nëpërmjet gënjeshtërsi*. Duhet theksuar se sipas fjalorit të gjuhës shqipe me gënjeshtëri kuptohet "*fjalë e thënë që s'është e vërtetë; pohim që nuk përputhet me*

⁴ Për më tepër detaje shiko, Μπέκα, Πρακτικά θέματα Ειδικού Μέρους, σελ. 142, Παπαδαμάκη, Τα περιουσιακά, σελ. 94, Μυλωνόπουλου, Ειδικό, εκδ. Β, α.π. 970 επ. Πρβλ. Καρανίκα, Εγχειρίδιον, том. Γ, τευχ. Β, σελ. 554 επ., Γάφου, Ειδικόν, том. ΣΤ, σελ. 130 επ., Τούση-Γεωργίου, Ποινικός, том. Β, εκδ. Γ, σελ. 1051 επ., Σπινέλλη, Ειδικό, τευχ. Β, σελ. 72, Μπιτζιλέκη, Γεγονότα και κρίσεις στο Δίκαιο και ειδικότερα στο Ποινικό Δίκαιο, 1999, σελ. 139, Αποστολίδου, Απάτη, σελ. 306 επ., Κουράκη-Αθανασίου-Πατεράκη, απάτης, α.π. 14 επ.

⁵ Shiko për më tepër përse i përket fshehjes së fakteve të vërteta Καρανίκα, Εγχειρίδιον, том. Γ, τευχ. Β, σελ. 557, Μπουρόπουλου, Ερμηνεία, 3^{ος} том., σελ. 72, Γάφου, Ειδικόν, том. ΣΤ, σελ. 134, Τούση-Γεωργίου, Ποινικός, том. Β, εκδ. Γ, σελ. 1052, Σπινέλλη, Ειδικό, τευχ. Β, σελ. 74, Μανωλεδάκη, Ερμηνεία, σελ. 148, Κουράκη-Αθανασίου-Πατεράκη, απάτης, α.π. 21, Αποστολίδου, Απάτη, σελ. 189, Παπαδαμάκη, Τα περιουσιακά, σελ. 100 επ., Κωστώρα, Επιτομή, ερμ. ά. 386 α.π. 15, Μυλωνόπουλου, Ειδικό, εκδ. Β, α.π. 998 επ.

të vërtetën, që shtrembëron a e fsheh me qëllim të vërtetën; rrenë, mashtrim; diçka e paqenë, e trilluar.”

Nisur nga kuptimi që ka fjala “gënjeshtër”, sipas fjalorit të gjuhës shqipe, arrihet në konkluzionin se gënjeshtër, si mënyrë e kryerjes së veprës penale, nuk është një mënyrë autonome, por është një mënyrë sinonime, që përputhet totalisht me dy mënyrat e para të formuluar nga ligjvënësi dhe të analizuar tashmë, pra është thjesht një sinonim i “*paraqitjes së fakteve të rreme*” dhe “*fshehjes së fakteve të vërteta*”. Në përpjekje për të qënë sa më të saktë gjatë interpretimit, duhet të analizojmë nëse vërtet gënjeshtër si mënyrë për kryerjen e kësaj vepre penale është një mënyrë sinonime me dy mënyrat e tjera të sipërcituara, apo mos ndoshta është një mënyrë autonome, e cila mbulon raste të tjera, të cilat nuk mundet të mbulohen nga dy mënyrat e para, tashmë të analizuar. Në aspektin që sipas kuptimit literal gënjeshtër përputhet totalisht me paraqitjen e fakteve të rreme apo me fshehjen e fakteve të vërteta, atëherë padiskutim që konkluzioni është se kemi mënyra sinonime. Pikëpyetja sidoqoftë që ngelet ka lidhje me arsyen se përse ligjvënësi ka parashikuar mënyra sinonime për kryerjen e kësaj vepre penale. Kjo pikëpyetje e ka një shpjegim që po e qartësojmë në vijim. Duhet theksuar paraprakisht se para ndryshimeve të Kodit Penal me ligjin nr. 36/2017 vepra penale e mashtrimit parashikohej si në vijim, “*Vjedhja e pasurisë me anë të gënjeshtres ose shpërdorimit të besimit dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.*” Pra përpara ndryshimeve vepra penale e mashtrimit kishte një tjetër formë dhe vetëm dy mënyra për kryerjen e saj, gënjeshtër dhe shpërdorimin e besimit. Me ndryshimet që pësoi u futën dy mënyra të reja për kryerjen e kësaj vepre penale, paraqitja e fakteve të rreme dhe fshehja e fakteve të vërteta. Megjithëse me të drejtë ligjvënësi futi këto dy mënyra të reja për kryerjen e mashtrimit, duke specifikuar në mënyrë më të detajuar elementët e anës objektive të kësaj vepre penale, siç në fakt e ka detyrim kushtetues që buron nga parimi “NCNPSL”, nuk u kujdes të eliminonte termin “nëpërmjet gënjeshtres”, i cili në fakt u specifikua nëpërmjet dy mënyrave të reja që u parashikuan. Arsyeja, ashtu siç ndodh edhe në raste të tjera, ka të bëjë me ngurrimin dhe druajtjen e ligjvënësit, se mos ndoshta me eliminimin e këtij termi ngelen të zbuluara raste specifike.

Mënyra e fundit e kryerjes së kësaj vepre penale është nëpërmjet shpërdorimit të besimit. Kjo është një rrethanë specifike, e cila në ndryshim nga rastet e tjera, nuk shpjegon mënyrën e arritjes së rezultatit, por specifikon një rrethanë nën të cilën realizohet pasoja e ndërmjetme e veprës penale të mashtrimit, pra bindja e viktimës për të disponuar elementë pasurorë. Sipas kësaj rrethane rezulton se autori dhe viktimja paraprakisht kanë njohje dhe jo vetëm kaq por marrëdhënia midis tyre ka kaluar në një stad më të lartë, duke krijuar viktimja përkundrejt autorit një ndjenjë sigurie për meritat, ndershmërinë, ndërgjegjen, çiltërsinë apo veti të tjera moral-shoqërore të tij. Gjithsesi pavarësisht kësaj rrethane nevojiten veprime të tjera aktive të autorit që të alternuara me ndjenjën e besimit që ka viktimja për të bërë të mundur lehtësisht që tek viktimja të krijohet një perceptim i gabuar.

Pasoja e sjelljes mashtruese deri në realizimin pasojës përfundimtare siç ekzaktësisht është parashikuar në anën objektive **“përvetësimi i pasurisë private ose shtetërore për vete ose për persona të tjerë”** kalon në disa stade apo më saktë të themi në pasoja të ndërmjetme. Më konkretisht si pasojë e sjelljes mashtruese **viktima krijon një perceptim të gabuar**. Kjo është pasoja e parë e ndërmjetme. Si pasojë e perceptimit të gabuar viktima **disponon pasurinë e tij**, të cilën **e përvetëson autori ose një i tretë**⁶. Pra, si përvetësim i pasurisë duhet kuptuar kalimi i pasurisë nga viktima tek autori ose një person i tretë sipas vullnetit të autorit. Në thelb kjo është edhe pasoja përfundimtare e kësaj veprë penale, pra dëmtimi i pasurisë së viktimës së veprës penale.

Jemi përpara pasojës së ndërmjetme **të krijimit të një perceptimit të gabuar** kur viktima bindet nga sjellja mashtruese e autorit dhe krijon një perceptim, i cili nuk përputhet me realitetin objektiv. Duhet theksuar se këtë perceptim të gabuar të realitetit shpesh herë i’ a impon autori viktimës me sjelljen e tij mashtruese, ndërsa në raste të tjera viktima e krijon vetë perceptimin e gabuar të ralityetit dhe autori thjesht kontribon në ruajtjen e këtij perceptimi të gabuar. Në të dyja rastet autori ngarkohet me përgjegjësi penale.

Krijimi i perceptimit të gabuar duhet të shkaktojë **disponimin e pasurisë nga ana e viktimës**, disponim i cili i shkakton viktimës dëm pasuror. Si rrjedhojë nuk jemi përpara mashtrimit, kur megjithëse nga sjellja mashtruese e autorit, viktima ka krijuar një perceptim të gabuar, por megjithatë nuk ka vijuar me disponim pasuri. Në këtë rast, në qoftë se plotësohen dhe kushte të tjera, ndoshta mundet të flasim për tentativë. Disponimi i pasurisë nga ana e viktimës mundet të realizohet me veprim ose me mosveprim. Për shembull viktima paguan paratë për blerjen e një sendi, i jep autorit një send të caktuar ose me mosveprim në rastet kur viktima nuk ndërmerr veprime ligjore duke dëmtuar në këtë mënyrë pasurinë e vet, nuk ngre padi në gjykatë etj. Nuk ka rëndësi fakti nëse viktima ka koshiençë apo jo se me këtë mënyrë që po vepron po disponon pasurinë e vet, rëndësi ka fakti që domosdoshmërisht nuk duhet të ketë koshiençë dhe dijeni të faktit se po dëmton pasurinë e vet në këtë mënyrë. Duhet theksuar fakti se personi që disponon dhe ai që dëmtohet zakonisht është i njëjti, por nuk përjashtohet gjithashtu mundësia që të jenë dhe të ndryshëm, p.sh. personi që disponon është banka, ndërsa personi i dëmtuar është titullari i llogarisë bankare. Në këto raste bëhet fjalë për mashtrim trekëndësh, pasi kemi të bëjmë me tre persona, autorin, disponuesin e pasurisë dhe viktimën. Duhet theksuar se nuk ka rëndësi fakti nëse disponuesi i pasurisë ka tagër juridik për të disponuar pasurinë, apo nëse ka tagrin fizik për të disponuar, p.sh. bashkudhëtarit që i janë lënë në ruajtje disa sende personale, ka tagrin t’i disponojë nëse dikush i shfaqet dhe i prezantohet si djali i personit që ia la në ruajtje.

⁶ Përsa i përket pasojës përfundimtare por edhe pasojave të ndërmjetme shiko, Παπαδαμάκη, Τα περιουσιακά, σελ. 110, Γάφου, Ειδικόν, τομ. ΣΤ, σελ. 135, Σπινέλλη, Ειδικό, τευχ. Β, σελ. 77, Αποστολίδου, Απάτη, σελ. 215, Κωστάρα, Επιτομή, ερμ. ά. 386 α.π. 20, Μυλωνόπουλου, Ειδικό, εκδ. Β, α.π. 1002.

Më tej kalimi i pasurisë nën pushtetin e autorit apo një personi tjetër sipas vullnetit të autorit përbën dhe pasojën përfundimtare të kësaj vepre penale, që është *përvetësimi i pasurisë private ose shtetërore për vete ose për persona të tjerë*.

Dallimi midis mashtrimit dhe marrëdhënieve juridiko civile

Zakonisht në praktikën e gjykatave tona pretendohet se elementi kryesor që e dallon krimin e mashtrimit nga krimet e tjera kundër pasurisë, si dhe marrëdhëniet e tjera juridiko civile, është pikërisht përdorimi i gënjeshtërsë ose shpërdorimit të besimit, si mjet për të hedhur në dorë pasurinë e detyrimit ose përfitime të tjera pasurore. Flasin vetëm për gënjeshtërsinë apo shpërdorimin e besimit, pasi kjo praktikë e gjykatës e hulumtuar është para ndryshimeve ligjore me ligjin 36/2017, ku u ndryshua kjo vepër penale dhe u shtuan edhe mënyrat e tjera për kryerjen e saj.

Elementi kryesor që dallon mashtrimin nga një marrëdhënie juridiko civile në thelb nuk është mjeti që përdoret, por ana subjektive. Kjo do të thotë që kur jemi përpara veprës penale të mashtrimit autori në momentin që ndërmer veprime apo mosveprimet që parashikon vepra penale ka si qëllim përvetësimin e tyre pra që në këtë moment autori ka vetëdijen dhe koshiencën e plotë për mos t'i kthyer më këto lekë. Ana subjektive jo vetëm në veprën penale të mashtrimit por në çdo vepër penale është nga elementët më të vështirë për tu provuar. Pavarësisht vështirësisë për të provuar anën subjektive të autorit në rastin konkret, kjo nuk e zhvesh organin e akuzës nga barra e provës së këtij elementi dhe gjykatën në argumentimin e vendimmarrjes së saj. Së dyti, pranohet sot gjerësisht që elementi subjektiv pra qëllimi, arrin të vërtetohet nëpërmjet të gjitha rrethanave objektive. Në rastin konkret ekzistojnë të gjitha rrethanat objektive që vërtetojnë krejtësisht të kundërtën.

Jemi përpara rastit kur detyrimi përbën një marrëdhënie juridiko civile në momentin që i “dëmtuari” i drejtohet me kërkesë padi Gjykatës civile për kthimin e pasurisë. Për më tepër në rastin kur një gjykatë civile merr një vendim për kthimin e pasurisë dhe kthimi bëhet i kërkueshëm ligjërisht nëpërmjet një procesi civil, atëherë “i dëmtuari” e ka garantuar pasurinë e vet, në kuptimin më të gjerë të fjalës. Pasuria në këtë koncept përbëhet nga shuma ndërmjet të drejtave pasurore dhe detyrimeve të një personi. Në konceptin e të drejtave pasurore përfshihen jo vetëm resurset aktive që posedon një person, por dhe të drejtat e kërkueshme ligjërisht kundrejt personave të tretë. Në këtë analizë, pamundësia relative e përmbushjes së kësaj të drejte në një periudhë provizore nuk ja dëmton pasurinë kreditorit dhe në këtë aspekt nuk mund të flitet për veprën penale të mashtrimit e cila pikërisht mbron pasurinë. Pamundësia e debitorit për të shlyer një detyrim civil nuk e shndërron automatikisht këtë marrëdhënie civile në vepër penale të mashtrimit.

Duke marrë në konsideratë gjithë sa më sipër, duhet të theksojmë se kjo vijë e hollë ndarëse dhe jo lehtësisht e konceptueshme nuk shmang zbatimin e parimeve garantuese të të drejtës penale.

Flasim pikërisht për parimin in dubio pro reo, çka e materializuar në rastin konkret do të thotë se në qoftë se kemi dy këndvështrime kontradiktore mbi të njëjtin fakt (këndvështrimi i akuzës qëllim përvetësimi dhe këndvështrimi i mbrojtjes pamundësi objektive dhe e përkohshme për përmbushje detyrimi civil), atëherë është detyrim që të merret për bazë argumentimi më i favorshëm për të pandehurin.

Duhet të theksojmë gjithashtu faktin se gjithë analiza e mësipërme vlen në rastin kur paraprakisht nuk është lidhur një marrëveshje civile midis palëve për të rregulluar marrëdhënien e tyre financiare, pavarësisht llojit të kontratës apo më në përgjithësi të marrëdhënies juridiko civile. Në qoftë se jemi përpara rastit kur lidhet një marrëdhënie juridiko civile paraprakisht, psh po marrim rastin më klasik të kontratës së huadhënies, atëherë në rast të mospërmbushjes së detyrimit kontraktor, kurrsesi nuk mundet të flasim dot për veprën penale të mashtrimit duke u bazuar mbi disa argumenta. Së pari nuk përmbushet një prej formave të caktuara shprehimisht nga ligjvënësi për kryerjen e kësaj vepre penale. Në këtë rast në qoftë se pretendohet për mashtrim në lidhjen e kontratës do të duhet fillimisht të konstatohet si absolutisht e pavlefshme kontrata civilisht dhe në rast se kjo ndodh mbetet e hapur rruga që në qoftë se ekzistojnë edhe elementët e tjerë të anës objektive dhe subjektive të mashtrimit të procedohet me fillimin e ndjekjes penale. Së dyti nuk jemi përpara mashtrimit kur marrëdhënia është formalizuar që në fillim me një marrëveshje juridiko civile, pasi nuk ekziston në këtë rast pasoja e ndër-mjetme, pra perceptimi i gabuar nga ana e viktimës. Në këtë rast që prej fillimit të kësaj marrëdhënieje është fare normale që ekziston një përqindje e caktuar rrisht për shlyerjen e detyrimit në kohë dhe sipas parashikimeve të marrëveshjes mes palëve, gjë e cila padiskutim mundet të ndodhë për rrethana objektive por edhe për rrethana që kanë lidhje me debitorin. Por edhe në rastin kur për rrethana që lidhen me debitorin, detyrimi nuk përmbushet nuk jemi përpara mashtrimit, pasi që në fillim kreditori e ka disponuar pasurinë e vet duke e ekspozuar në një rrisht të zakonshëm dhe të pranueshëm në marrëdhëniet e zakonshme transaksionale dhe për pasojë vetëm nëpërmjet rrugës civile mundet të mbrojtë pasurinë e vet.

BIBLIOGRAFIA

Ανδρουλάκη, Η «απειλή κινδύνου χειροτερεύσεως της ενεστώσης περιουσιακής καταστάσεως» ως περιουσιακή βλάβη και η αντιστοιχία ζημίας και οφέλους εν τω εγκλήματι της απάτης, ΠοινΧρ. ΚΑ, σελ. 1 επ.

Αποστολίδου, Απάτη-Η πλάνη ως αποτέλεσμα της πράξης εξαπάτησης και η περιουσιακή διάθεση στο έγκλημα της απάτης, 2002

Mëngjesi, Bazat e Doktrinës të së Drejtës Penale, Tiranë 2016

Elezi, E drejta penale e Republikës së Shqipërisë, Pjesa e Posaçme 2, 1999

Elezi, Mbrojtja juridike penale e pasurisë, 2002

Elezi-Kaçupi-Haxhia, Komentari i Kodit Penal të Republikës

Popullore së Shqipërisë, 2004

Elezi, E drejta penale, Pjesa e Posaçme, Tiranë 2005
Elezi, E drejta penale, Pjesa e Posaçme, Tiranë 2007
Κωστήρα, Έννοιες και Θεσμοί του Ποινικού Δικαίου, 2^η εκδ., 2004
Κωστήρα, Ποινικό Δίκαιο, Επιτομή Ειδικού Μέρους, 2007
Μυλωνόπουλου, Ποινικό Δίκαιο, Ειδικό Μέρος, Εγκλήματα κατά της ιδιοκτησίας και κατά της περιουσίας, εκδ. Β, 2006
Παπαδαμάκη, Τα περιουσιακά εγκλήματα, 2000
Σπινέλλη, Ποινικό Δίκαιο, Ειδικό Μέρος, Πανεπιστημιακές παραδόσεις, Εγκλήματα κατά περιουσιακών έννομων αγαθών, τευχ. Α, 1984, τευχ. Β, 1985

SHKELJA E RREGULLAVE TË MBROJTJES NË PUNË

Av. Asllan DOGJANI

ABSTRAKT

Në këtë punim jemi përqendruar tek shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë, tek mbrojtja në punë e punëmarrësve, çështjet e sigurimit teknik dhe higjienosanitar si çështje shumë të rëndësishme që kërkojnë një vëmendje të veçantë në politikatat sociale të një shtetit demokratik. Pavarësisht se shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë është e parashikuar si vepër penal dhe pasojat që vijnë janë shumë herë më të mëdha se shumë vepra të tjera deri në humbje njerëzish vemë re se në jetën e përditshme këto aksidente që vijnë për shkak të mosrespektimit të këtyre rregullave zënë shumë pak vend në opinionin publik, zënë shumë pak hapësirë si në median e shkruar apo vizive dhe njëkohësisht nuk vlerësohet si duhet dhe nga institucionet ligjzbatuese, organi i akuzës apo dhe gjykatat pavarësisht se dëmi që i shkaktohet shoqërisë, shtetit, familjes është shumë i madh. Në jetën e përditshme duket si diçka e zakonshme për qytetarët kur dëgjojnë për aksidente të tilla me shprehjet se ndodh aksidenti nuk kishim çfarë ti bënim se nuk parandalohej etj.. Por në fakt po qe se respektohen rregullat e shkruara të mbrojtjes në punë, rregullat e sigurimit teknik aksidente, që vijnë nga shkelja e këtyre rregullave do të minimizohen. dhe do shkohet drejt parandalimit të tyre

Nga të dhënat që kemi grumbulluar për numrin e aksidenteve në punë dhe pasojave që kanë ardhur si rezultat i shkeljeve të rregullave të mbrojtjes në punë apo mosmarrjen e masave të sigurimit teknik ka rezultuar se në tre vite konkretisht nga viti 2014-2015-2016 gjithsej kanë ndodhur 289 aksidente në punë nga këta 85 persona kanë humbur jetën ndërsa mbi 200 persona janë të gjymtuar.

Më konkretisht në vitin 2014 kanë ndodhur 110 aksidente në punë me 25 të vdekur

Në vitin 2015 gjithsej 97 aksidente me 23 të vdekur

Në Vitin 2016 gjithsej 82 aksidente me 17 të vdekur

Referuar numrit të popullsisë apo numrit të punësuarve kjo shifër është shumë e madhe.

Pra vetëm në tre vite kemi 85 njerëz që kanë vdekur ndërsa mbi 200 të tjerë që janë të gjymtuar dhe marrin pagesa nga buxheti i shtetit si persona me aftësi të kufizuara. Mbrojtja në punë përfshin atë pjesë të normave të së drejtës së punës që sanksionojnë posaçërisht mbrojtjen në punë të punëmarrësve. Mbrojtja në punë krahas rëndësisë shoqërore, ka edhe rëndësinë ekonomike, sepse duke u mbrojtur jeta dhe shëndeti i punëmarrësve, bëhet e mundur rritja e prodhimit, ngritja e rendimentit dhe sigurohet kështu perspektive në zhvillimin ekonomik të vendit. Në kuadrin e mbrojtjes në punë të punëmarrësve, administrata e ndërmarrjes apo

institucionit punëdhënës detyrohet të përmbushë një varg detyrimesh juridike. Detyrimi më kryesor i punëdhënësit është që të marrë masa efektive të gjithanshme të mbrojtjes në punë të punëmarrësve, në mënyrë që të parandalohen faktorët negativë dhe rreziqet e punës, të cilët prekin jetën ose shëndetin e punëmarrësve. Punëdhënësi detyrohet të informojë punëmarrësit mbi rreziqet që lidhen me punën dhe kërkohet të kualifikojë punëmarrësit për respektimin e kërkesave në fushën e shëndetit, sigurimit dhe higjienës. Kjo e parashikuar në nenin 43 të K. Punës. Punëdhënësi detyrohet t'u shpjegojë punëmarrësve të ekspozuar ndaj rreziqeve, domosdoshmërinë e respektimit të masave të sigurimit teknik dhe higjienës në punë. Në kuadrin e detyrimeve që burojnë nga mbrotja në punë, në nenin 66 të Kodit të Punës, parashikohet se punëdhënësi duhet të vërë në dijeni punëmarrësit për rreziqet nga zjarri dhe shpërthimet e ndryshme si dhe mbi mjetet mbrojtëse për të parandaluar shfaqjen e rreziqeve të tilla. Punëdhënësi, u mëson punëmarrësve, mënyrën e përdorimit të fikësave dhe mjeteve të tjera mbrojtëse kundër zjarrit. Ai u tregon punëmarrësve rrugët e daljes në rast zjarri dhe organizon të paktën një herë në vit ushtrime të luftës kundër zjarrit dhe mënyrën e evakuimit të personave. Punëdhënësi është i detyruar të bej instruksionin në punë të afishoj në vende të dukshme rregullat e mbrojtjes

Neni 289 i K.Penal: Shkaktimi i vdekjes ose dëmtimi i rëndë i shëndetit të personit ardhur si pasojë e mosrespektimit të rregullave që kanë të bëjnë me punën, prodhimin, shërbimin të përcaktuar në ligj, në aktet e Këshillit të Ministrave apo në rregulloret përkatëse të sigurimit teknik, të disiplinës teknike, të mbrojtjes në punë, të higjienës dhe sigurimit nga zjarri prej personave të ngarkuar me respektimin e rregullave dhe marrjen e masave në zbatim të tyre, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dhjetë vjet. Kur nga vepra penale është shkaktuar vdekja ose dëmtimi i rëndë i shëndetit të disa personave, dënohet me burgim jo më pak se pesë vjet. Por nga praktika ka rezultuar se jo pak vepra penale që vijnë si rezultat i mosrespektimit të rregullave të mbrojtjes në punë nuk raportohen për shkak se punonjësit nuk sigurohen nga kompanitë duke bërë marrëveshje midis punëdhënësit e punëmarrësit në dëm të këtij të fundit. Pra siç shihet pasojat, dëmi kostoja janë shumë të mëdha për taksapaguesit, familjen, shoqërinë prandaj mendoj se është shumë e domosdoshme që të rritet vëmendja ndaj kësaj veprë penale me qëllim sensibilizimin e institucioneve përkatëse, sesnibilizimin e opinionit publik, të gjykatave e prokurorisë me qëllim marrjen e masave që nëpërmejt gjykimeve të shpejta dhe me objektivitet, asistencës e kontrolleve të ushtruara për mbrojtjen në punë të punëmarrësit dhe aftësimin nga ana profesionale të administratës respektimin dhe njohjen e rregullave në punë të arrijmë drejt minimizimit apo parandalimit të veprave penale. Në të gjitha veprimtaritë me burim rreziku të shtuar dhe me risk të lartë për shëndetin dhe sigurinë rekomandohet që të avancohet detyrimi ligjor me instruktazh nga njëherë në muaj që është të bëhet njëherë në javë shto dhe kontrollin pas ditëve të pushimit dhe festave, pasi sipas statistikave botërore numri me j madh j aksidenteve është në ditën pas pushimit javor apo pas festave.

Mbrojtja në punë:

Problemet e mbrojtjes në punë të punëmarrësve, çështjet e sigurimit teknik dhe higjienosanitar, përbëjnë objektin e një vëmendjeje të veçantë në politikën sociale të një shtetit demokratik. Mbrojtja në punë përfshin atë pjesë të normave të së drejtës së punës që sanksionojnë posaçërisht mbrojtjen në punë të punëmarrësve.

Bazën ligjore për mbrojtjen në punë e përbëjnë sidomos dispozita juridike kushtetuese:

- Neni 49 I Kushtetutës
- Kodi i punës (krerët VIII dhe X)
- Ligji nr. 8857, datë 07.02.2002 “Për inspektoriatin shtetëror të punës”
- Ligji nr. 8766, datë 05.04.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri”
- Ligji nr. 8934, datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”
- Vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave¹

Mbrojtja në punë krahas rëndësisë shoqërore, ka edhe rëndësinë ekonomike, sepse duke u mbrojtur jeta dhe shëndeti i punëmarrësve, bëhet e mundur rritja e prodhimit, ngritja e rendimentit dhe sigurohet kështu perspektive në zhvillimin ekonomik të vendit.

Në kuadrin e mbrojtjes në punë të punëmarrësve, administrata e ndërmarrjes dhe institucionit punëdhënës detyrohet të përmbushë një varg detyrimesh juridike.

Detyrimi më kryesor i punëdhënësit është që të marrë masa efektive të gjithanshme të mbrojtjes në punë të punëmarrësve, në mënyrë që të parandalohen faktorët negativë dhe rreziqet e punës, të cilët prekin jetën ose shëndetin e punëmarrësve².

Punëdhënësi detyrohet të informojhë punëmarrësit mbi rreziqet që lidhen me punën dhe kërkohet të kualifikojë punëmarrësit për respektimin e kërkesave në fushën e shëndetit, sigurimit dhe higjienës. Punëdhënësi, detyrohet t’u shpjegojë punëmarrësve të ekspozuar ndaj rreziqeve, domosdoshmërinë e respektimit të masave të sigurimit teknik dhe higjienës në punë.

Instruktimi i mbrojtjes në punë bëhet sidomos në dy momente kryesore të punës së punëmarrësit:

- a) Instruktimi në rastin e hyrjes rizhtaz në punë, në një ndërmarrje, institucion.
- b) Instruktimi në vendin e punës.

Instruktimi i llojit të parë bëhet në mënyrë të detyrueshme për të gjithë punëmarrësit e ardhur rizhtaz në ndërmarrje. Atyre u mësohen rregulla të përgjithshme të sigurimit teknik dhe higjienosanitar në punë. Ky instruktim bëhet nga specialistë kompetentë të ngarkuar me këtë detyrë në ndërmarrje. Instruktimi në

¹ Për shembull, V.K.M nr. 692, datë 13.12.2003 “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”

² “Hygiene et securite du travail” në tekstin “Droit du travail”, Paris 1992, fq. 420-432 të autorëve Gerard Lyon-Caen dhe Jean –Pelissier; “Codice di diritto del lavoro”, Bari 1988, përgatitur nga Prof.Gino Giuni, fq 220-227.

këtë rast dokumentohet në një evidencë të posaçme, ku vihen nënshkrimet e secilit prej punëmarrësve që i nënshtrohen instruktimit.

Instruktimi në vendin e punës u bëhet punëmarrësve të rinj dhe atyre që vijnë nga reparte të tjera ose brenda të njëjtit repart të ndërmarrjes. Ky instruktim zhvillohet në vendin e punës nga përgjegjësi i repartit. Në këtë instruktim, i tregohen punëmarrësit kushtet e vendit të punës, procesi teknologjik, përbërja e makinerive, pjesët e rrezikshme të saj, mjetet mbrojtëse, rregullat mbi mbajtjen pastër të vendit të punës dhe higjiena personale e punëmarrësit. Në kuadrin e detyrimeve që burojnë nga mbrojtja në punë, në nenin 66 të Kodit të Punës, parashikohet se punëdhënësi duhet të vërë në dijeni punëmarrësit për rreziqet nga zjarri dhe shpërthimet e ndryshme si dhe mbi mjetet mbrojtëse për të parandaluar shfaqjen e rreziqeve të tilla. Punëdhënësi, u mëson punëmarrësve, mënyrën e përdorimit të fikësave dhe mjeteve të tjera mbrojtëse kundër zjarrit. Ai u tregon punëmarrësve rrugët e daljes në rast zjarri dhe organizon të paktën një herë në vit ushtrime të luftës kundër zjarrit dhe mënyrën e evakuimit të personave. Punëdhënësi, duhet të tregojë kujdes që riparimi, mirëmbajtja, gratatimi dhe kontrollimi i makinerive, i pajisjeve, i transmiseve ose i mekanizmave që përmbajnë pjesën lëvizëse, të bëhet vetëm pasi të jetë ndaluar makineria, mbasi të jetë kontrolluar dhe të jetë siguruar për të gjitha mundësitë e vënies së saj dhe mbasi të ketë ndërprerë energjinë elektrike që vë në lëvizje makinerinë.

Rregullat e mbrojtjes në punë sipas Kodit të Punës:

Këshilli i Ministrave ose organi i autorizuar prej tij përcakton kufijtë e lejueshëm për mbrojtjen nga ndotja e ajrit, lëndët kimike, radioaktiviteti, zhurmat dhe dridhjet në vendet e punës³.

AJRI

1) Mjedisi i punës duhet të jetë i ajrosur dhe të ketë sistem ventilimi për mënjanimin e temperaturës së dëmshme për shëndetin e punëmarrësve dhe erërave të pakëndshme.

2) Ajrimi duhet të realizohet me dalje drejtpërdrejt jashtë. Në rast pamjaftueshmërie të ajrimit natyror, ai duhet të plotësohet me ventilim mekanik në përputhje me vëllimin e mjedisit dhe me numrin e njerëzve që ndodhen aty.

3) Atmosfera e mjedisit dhe e vendit të punës duhet të mbahet në gjendje të pastër në mënyrë që të mbrohet shëndeti i punëmarrësve.

4) Nuk lejohej të pihet duhan në mjediset ku punon më shumë se një punëmarrës.

5) Në qoftë se disa procese pune nuk lejojnë mënjanimin e plotë të prodhimit të lëndëve ndotëse shqetësuese, të dëmshme për shëndetin, pluhurat, tymrat, gazrat, duhet të nxirren vazhdimisht jashtë mjedisit të punës me anë të aparateve të posaçme.

³Neni 48 I Kodit të Punës se Republikës së Shqipërisë

ZHURMA DHE DRIDHJET⁴

1) Intensiteti i zhurmave të përballeshme nga punëmarrësi duhet të mbahet në nivel të pajtueshëm me shëndetin e tij nëpërmjet amortizimit ose zvogëlimit të zhurmave që nga burimi i tyre dhe të izolimit të mjedisit me mjetet e përshtatshme.

2) Intensiteti i dridhjeve që përballohet nga punëmarrësi duhet të mbahet në një nivel të pajtueshëm me shëndetin e tij nëpërmjet amortizimit ose zvogëlimit të dridhjeve nga burimi i tyre me mjetet e përshtatshme.

C. MAKINERI TË RREZIKSHME MBROJTJA E PËRGJITHSHME

1) Asnjë punëmarrës nuk duhet të përdorë makineri pa marrë paraprakisht të gjitha masat mbrojtëse të nevojshme.

2) Pjesët e rrezikshme të makinerive duhet të pajisen me mjete mbrojtëse.

MIRËMBAJTJA

(Ndryshuar me ligjin nr.8085, datë 13.03.1996)

Punëdhënësi duhet të tregojë kujdes që riparimi, mirëmbajtja, grasatimi dhe kontrolli i makinerive, i pajisjeve, i transmisioneve ose i mekanizmave që përmbajnë pjesë lëvizëse të bëhet vetëm pasi të jetë ndalur makineria, pasi të jetë kontrolluar dhe të jetë siguruar për të gjitha mundësitë e vënies së saj në punë dhe pasi të ketë ndërprerë energjinë elektrike që vë në lëvizje makinerinë.

PËR MASAT E VEÇANTA TË SIGURIMIT DHE MBROJTJES SË SHËNDETIT NË PUNË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe nenit 40 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8085, datë 13.3.1996, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Sigurimi i jetës dhe shëndetit të punëmarrësve të bëhet nëpërmjet zbatimit të masave të nevojshme për parandalimin e rreziqeve në punë.

2. Punëdhënësi, për të mbrojtur dhe siguruar jetën dhe shëndetin e punëmarrësit në punë është i detyruar:

a) të shmangë rreziqet, duke i vlerësuar ato realisht dhe në origjinë;

b) të vendosë punëmarrësit në punë sipas:

- aftësive profesionale;

- gjendjes shëndetësore të bazuar në vizitën mjekësore, të kryer nga specialistë,

para pranimit në punë;

- moshës;

- seksit.

⁴ Neni 50 i kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë

- c) të marrë parasysh zhvillimin e teknikës;
- ç) të zbatojë masat që vënë mbrojtjen kolektive mbi atë individuale;
- d) t'u japë punëmarrësve instruksionet e duhura për mbrojtjen e shëndetit në punë dhe për njohjen dhe zbatimin e rregullave të sigurimit teknik;
- dh) të vendosë në përdorimin e makinerive dhe të mekanizmave me shkallë rrezikshmërie kolektive punëmarrës të pajisur me dëshmi aftësie;
- e) të marrë në provë çdo muaj punëmarrësit e pakualifikuar dhe çdo 3 muaj punëmarrësit e kualifikuar për përvetësimin e rregulloreve të sigurimit teknik.

2/1. Punëdhënësi siguron funksionimin e shërbimit mjekësor, nëpërmjet mjekut të ndërmarrjes, në të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari prodhuese, private ose shtetërore, vendase ose të huaja, juridike ose fizike.

2/2. Mjekët e ndërmarrjes pajisen me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë, në përputhje me vendimin nr.500, datë 23.11.1992 të Këshillit të Ministrave "Për dhënien e licencave për ushtrimin e profesionit në fushën e mjekësisë, në profesion të lirë privat", i ndryshuar.

2/3. Mjekët e ndërmarrjes merren në punë si nëpunës të ndërmarrjes dhe varen drejtpërdrejt nga punëdhënësi. Punëdhënësi e njeh mjekun me detyrat e shërbimit shëndetësor të ndërmarrjes dhe kërkon zbatimin e tyre, sipas legjislacionit të punës. Marrëdhëniet ndërmjet punëdhënësit dhe mjekut të ndërmarrjes përcaktohen në bazë të kontratës së punës që lidhin palët, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2/4. Mjeku i ndërmarrjes ka këto detyra:

a) Këshillon punëdhënësin për problemet e mbrojtjes në punë, për shmangien e aksidenteve dhe të sëmundjeve profesionale, si dhe për të gjitha çështjet e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë;

b) vlerëson çështje të fiziologjisë së punës, të problemeve higjienike e sanitare, veçanërisht të ritmit e të kohës së punës, të organizimit të vendit të punës, të zhvillimit dhe të mjediseve të punës;

c) rekomandon çështje të ndryshimit të vendeve të punës për riintegrimin e të gjymtuarve në procesin e punës dhe të të sëmurëve me sëmundje profesionale, si dhe studion shkaqet e aksidenteve në punë e të sëmundjeve profesionale, duke i propozuar punëmarrësit masat për shmangien e tyre;

ç) kontrollon pranimin në punë të punëmarrësve, në përputhje me raportin mjekësor të lëshuar nga komisioni medikoligjor, në bazë të aftësive shëndetësore për procesin konkret të punës, si dhe organizon ekzaminimin periodik, shëndetësor, për të gjithë punonjësit, një herë në 6 muaj;

d) ndjek, në mënyrë të vazhdueshme, të sëmurët kronikë, bën konsulta me mjekët e familjes dhe specialistët, si dhe ndërhyr te punëdhënësi, që, në rast nevojë, të bëjë ndërrimin e vendit të punës;

dh) bashkëpunon me mjekun e sëmundjeve profesionale dhe repartet klinike të sëmundjeve profesionale, për diagnozën dhe trajtimin e të sëmurëve me sëmundje profesionale;

e) plotëson regjistrin e paaftësisë së përkohshme në punë, të aksidentit në punë dhe sëmundjeve profesionale, si dhe, në bashkëpunim me punëdhënësin, denoncon pranë Inspektoratit të Punës rastet e aksidenteve dhe të sëmundjeve profesionale.

3. Punëdhënësi duhet të vlerësojë (të ketë parasysh) aftësitë profesionale të punëmarrësve në fushën e sigurimit dhe të shëndetit kur u ngarkon detyrat, si dhe të garantojë se vetëm punëmarrësit që kanë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme mund të futen në zonat me rrezik të madh dhe të veçantë. Kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale përcaktohen në rregulloren e sigurimit teknik.

4. Punëdhënësi duhet t'i pajisë punëmarrësit me mjete mbrojtëse, individuale të përshtatshme për realizimin e funksioneve që kanë dhe të kujdeset për përdorimin e duhur të tyre, sipas natyrës së punës. Gjithashtu, punëdhënësi duhet të kujdeset që pajisjet e punës të jenë të përshtatshme dhe të garantojnë sigurimin e shëndetit të punëmarrësve gjatë përdorimit.

5. Punëdhënësi duhet të garantojë që çdo punëmarrës të aftësohet dhe të formohet profesionalisht në fushën parandaluese që në fillim të punës e në vazhdim, duke pasur parasysh ndryshimet e funksionit që ai kryen ose në rastet kur futen teknologji të reja apo bëhen ndryshime në pajisjet e punës. Formimi duhet të përqendrohet, veçanërisht, në vendin e punës dhe në funksion të çdo punëmarrësi.

6. Një herë në çdo muaj punëdhënësi duhet të instruktojë punëmarrësit për makineritë dhe teknologjitë e reja. Çdo punëmarrës duhet të ketë njohuri për të respektuar rregullat, duke mos rrezikuar veten dhe çdo person që ka pranë nga veprimi i lëndëve helmuese, rryma elektrike, zjarri ose nga goditjet mekanike.

7. Punëdhënësi është i detyruar që:

- të vendosë në vende të dukshme të sektorëve të punës dhe të lexueshme nga punëmarrësit rregullat e sigurimit teknik për dhënien e ndihmës së parë dhe rregullat për mbrojtjen në punë;

- të bëjë matje në mjediset e brendshme të punës për nivelet e ndotjes nga lëndët kimike, pluhuri, lagështia, zhurmat dhe t'i krahasojë rezultatet me normat e lejueshme.

8. Kur punëmarrësit janë ose mund të jenë të ekspozuar ndaj një rreziku të rëndë, punëdhënësi është i detyruar t'i njoftojë menjëherë punëmarrësit e cenuar për praninë e këtij rreziku dhe të marrë masat e duhura për parandalimin e tij.

9. Punëdhënësit janë të detyruar të mbrojnë gratë shtatzëna dhe nënat me fëmijë në gji ndaj agjentëve të dëmshëm, në përputhje me kërkesat e raportit mjekësor, të lëshuar nga mjeku specialist. Kur paraqitet rrezik për sigurimin dhe shëndetin apo ndonjë ndikim të mundshëm mbi shtatzëninë apo mbi qumështin e gjirit të këtyre punëmarrësve, punëdhënësi duhet të marrë masat e nevojshme për të shmangur ekspozimin e këtij rreziku, për të përmirësuar kushtet e punës dhe për ndërrimin në një vend tjetër pune që ka më pak rrezikshmëri nga lëndët kimike për shëndetin e nënës dhe të fëmijës.

10. Çdo punëmarrës ka detyrë të kujdeset për sigurimin dhe shëndetin në punë.

Punëmarrësit, në përputhje me formimin dhe me instruksionet e punëdhënësit, duhet në mënyrë të veçantë;

- të përdorin, në mënyrë të përshtatshme, në përputhje me natyrën dhe rreziqet e parashikuara, makinat, aparatet, substancat e rrezikshme pajisjet e transportit dhe, në përgjithësi, të gjitha mjetet e tjera, me të cilat zhvillojnë veprimtarinë e tyre;

- të përdorin në mënyrë të vazhdueshme mjetet dhe pajisjet mbrojtëse të dhëna nga punëmarrësi.

10/1. Marrja në punë e mjekut është e detyrueshme për të gjitha subjektet, veprimtaria e të cilave klasifikohet sipas vendimeve nr.459, datë 22.7.1998 “Për substancat e rrezikshme”, nr.419, datë 4.8.2000 “Për objektet e rrezikshme” dhe nr. 207, datë 9.5.2002 “Për përcaktimin e punëve të vështira ose të rrezikshme” të Këshillit të Ministrave, pavarësisht nga numri i të punësuarve.

10/2. Për subjektet që nuk përfshihen në pikën 12/1 të këtij vendimi, marrja në punë e mjekut të ndërmarrjes është e detyrueshme për ato ndërmarrje, ku numri i të punësuarve është jo më pak se 15 punonjës.

10/3. Mjeku i ndërmarrjes mban përgjegjësi sipas ligjit për pasojat, që mund të vijnë nga moszbatimi i detyrave të përcaktuara sipas pikës 2/4 të këtij vendimi.

11. Kur inspektori i punës verifikon moszbatimin e normativave për parandalimin e rreziqeve në punë dhe gjykon se kjo veprimtari mund të sjellë pasoja të rënda urdhëron ndërprerjen e menjëhershme të punës.

Kjo masë i komunikohet punëdhënësit, i cili menjëherë vë në dijeni punëmarrësit.

Rifillimi i punës pas ndërprerjes bëhet nga inspektori i punës, kur shmangen shkaqet që e sollën këtë ndërprerje. Gjatë ndërprerjes së punës punëdhënësi është i detyruar t’i paguajë punëmarrësit në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës.

Sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë neni 289: Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë

Shkaktimi i vdekjes ose dëmtimi i rëndë i shëndetit të personit ardhur si pasojë e mosrespektimit të rregullave që kanë të bëjnë me punën, prodhimin, shërbimin, të përcaktuara në ligj, në aktet e Këshillit të Ministrave apo në rregulloret përkatëse të sigurimit teknik, të disiplinës teknike, të mbrojtjes në punë, të higjienës dhe sigurimit nga zjarri prej personave të ngarkuar me respektimin e rregullave dhe marrjen e masave në zbatim të tyre, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dhjetë vjet.

Kur nga vepra penale është shkaktuar vdekja ose dëmtimi i rëndë i shëndetit të disa personave, dënohet me burgim jo më pak se pesë vjet.

Objekt i krimit janë marrëdhëniet juridike të vendosura nga shteti me ligj apo me akte nënligjore për mbrojtjen në punë apo sigurimin teknik, që kanë të bëjnë me jetën dhe shëndetin e punonjësve gjatë procesit të prodhimit apo të shërbimit dhe jo jashtë tyre, të mbrojtura posaçërisht me legjisllacionin penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

Nga ana objektive, krimi kryhet me veprim ose mosveprim që qëndron në shkeljen e rregullave të mbrojtjes në punë, të sigurimit teknik, të disiplinës teknike, të higjienës dhe të sigurimit nga zjarri si dhe në mosmarrjen e masave për respektimin dhe zbatimin e tyre.

Rregullat e mbrojtjes në punë përcaktojnë kushtet normale, teknike, dhe higjienike për punë, sigurimin e veshmbathjes së posaçme me mjete mbrojtëse në sektorë të caktuar. Me shkelje të kushteve të punës kuptohet psh., mungesave e valvolave të sigurimit në kazanët.

Shkelen rregullat e sigurimit teknik kur nuk merren masat mbrojtëse në punimet e ndërimit, ose nuk sigurohen punëtorët që punojnë në miniera me mjete antishpërthimi, mungojnë mjetet e sinjalizmit etj.

Shkelja e rregullave të higjienës qëndron në mbajtjen e gazrave të ndotjeve etj, në vendet e punës të punonjësve, që dëmtojnë shëndetin e tyre. Mungesa e ventilatorëve dhe e aspiratorëve kundër pluhurit në miniera është shkelja e rregullave të higjienës.

Shkelja e rregullave kundër zjarrit, të cilat parashikohen në dispozita të posaçme, është psh., pirja e duhanit në vendet ku ka lëndë plasëse, benzinë, vajguri, Vajra lubrifikantë, në vende të pasigurta nga zjarri etj.

Në çdo rast është e domosdoshme të vërtetohet cilat rregulla konkrete janë shkelur. Këtë kusht e ka kërkuar vazhdimisht edhe praktika gjyqësore.

Kusht tjetër i domosdoshëm për përgjegjësi penale është që nga shkelja e rregullave në punë, të kenë ardhur pasojat kriminale: vdekja ose dëmtimi i shëndetit të personit. Krijimi i rrezikut për jetën dhe shëndetin nuk përbën veprë penale, siç ishte në Kodin Penal të mëparshëm por vetëm përgjegjësi disiplinore dhe administrative.

Gjithashtu, për të pasur përgjegjësi penale kërkohet që, misdis veprimit ose mosveprimit të shkeljes së rregullave në punë ose mosrespektimit dhe moszbatimit të masave e pasojave të ketë lidhje shkakësore dhe të drejtpërdrejtë, që ato shkelje të jenë shkak kryesor përcaktues për ardhjen e pasojës.

Subjekt i krimit mund të jenë personat e ngarkuar me respektimin e rregullave dhe marrjen e masave për zbatimin e tyre.

Nga ana subjektive, krimi i shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë mund të kryhet me dashje ose nga pakujdesia, ndërsa pasojat vijnë kurdoherë nga pakujdesia në formën e neglizhencës apo vetëbesimit të tepruar. Në qoftë se pasojat shkaktohen me dashje, vepra cilësohet si krim kundër personit, sipas rastit-vrasje, plagosje, por jo në bazë të nenit 289 të Kodit Penal.

Rrethana të cilësuarat të krimit janë ato kur, nga shkeja e rregullave të mbrojtjes në punë është shkaktuar vdekja ose dëmtimi i rëndë i shëndetit të disa personave.

Kur vdekja e personit është shkaktuar si pasojë e shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë, cilësohet sipas nenit 289 të Kodit Penal dhe dallohet nga vrasja nga pakujdesia, sepse, në rastin e fundit, objekt është jeta e njeriut drejtpërdrejt, kurse në rastin e parë objekt kryesor janë rregullat e mbrojtjes në punë.

Edhe në këtë dispozitë, dënimi që parashikohet nuk përligjet, derisa pasojat mund të vijnë nga pakujdesia.

BIBLIOGRAFIA

Kodi Penal

Kodi i Punës

Vendimi nr. 692. Datë. 13.12.2001 “Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë”

E drejta e punës, Kudret Çela

Inspektoriati Shtetëror i Punës

LIGJI PENAL NË KOHË, NË RAPORT ME GJAKMARRJEN SI ANTROPOLOGJI SOCIALE

Prof. Asc. Dr. Rezana KONOMI¹
Prof. ASC. Dr. Helga VUKAJ

1.1 HYRJE

Në një shoqëri të emancipuar dhe demokratike, respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut marrin një vlerë mjaft të madhe. Ato pasqyrohen në mënyrë më të plotë në kushtetutat e çdo shteti demokratik me formulimin “*Jeta e personit mbrohet me ligj*”. Në këtë mënyrë është sanksionuar koncepti juridik i mbrojtjes së jetës njerëzore. Ky formulim shpreh qartë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë mbrojtjen e jetës së njeriut, e cila përbën një vlerë kushtetuese. Sipas nenit 15 të Kushtetutës, “të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme” dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. Për këtë arsye ekziston edhe detyrimi parësor dhe kushtetues i shtetit, nëpërmjet organeve të tij, që t’i respektojë dhe t’i mbrojë këto të drejta. Mbi këto koncepte është ndërtuar gjithë legjislacioni ynë dhe mbi te gjitha legjislacioni penal. Por ndërsa baza ligjore e cila ka evoluar në kohë, iu është përgjigjur kushteve të një shoqërie moderne, të emancipuar dhe demokratike, mentaliteti shoqëror dhe tradicional, nga ana tjetër përbën një pengesë tepër të vështirë në përsosjen dhe konsolidimin e kësaj shoqërie.

Në Shqipërinë e 100 viteve të fundit kanë ndodhur gjithmonë ngjarje e zhvillime, përballë të cilave ne, por më së shumti të huajt kanë mbetur të shokuar. Por nuk besohet se mund të ketë tronditje më të madhe se sa pranimi i ekzistencës së gjakmarrjes në vitin 2012. Natyrisht që legjislacioni penal ka evoluar dhe ka pasqyruar kohë pas kohe ndryshimet e realitetit përkundrejt veprave penale në përgjithësi dhe gjakmarrjes në veçanti, sipas kurbes në ulje apo në ngritje të kriminalitetit. Natyrshëm mund të lind pyetja: A ndodhemi të përgatitur kulturalisht dhe a ndihet komod shteti dhe shoqëria shqiptare në përgjithësi përballë një legjislacioni të tillë emancipues e modern? A janë ato në gjendje që të garantojnë jetën e personit, lirinë dhe sigurinë e tij, ndërkohë që kanuni, rregullat zakonore, vetëgjyqësia dhe gjakmarrja arrijnë të zbehin ligjin dhe zbatimin e tij?

2.1 Pak histori për gjakmarrjen dhe hakmarrjen si antropologji sociale

Studimi dhe shpjegimi i historisë së vrasjeve dhe hakmarrjes ashtu sikurse i çdo instituti tjetër juridiko-penal dhe i së drejtës penale në tërësi, mund të bëhet vetëm nëse merren të lidhura dhe të kushtëzuara me historinë e zhvillimit të shoqërisë

¹ Dekane Fakulteti Drejtësisë, Kolegji Uiversitar Luarasi, Pedagoge efektive Kolegji Universitar Luarasi.

dhe të marrëdhënieve ekonomike. Pikërisht nga studimi historik i vrasjeve për hakmarrje e gjakmarrje në të kaluarën, mund të kuptohet rishfaqja e kësaj dukurie në të tashmen dhe të parashikohen prirjet e saj në të ardhmen. Hakmarrja lindi historikisht dhe ka siç do fenomen tjetër shoqëror burimin e saj tek kushtet materiale të jetës. Në shoqërinë pa klasa hakmarrja lindi si nevojë mbrojtjeje dhe sigurie e pjestarëve të fisit. Natyrisht që ky zakon ka qenë i përhapur në të gjitha vendet e botës dhe në themelin e saj qëndronin marrëdhëniet shoqërore të rendit fisnor. Hakmarrja ishte jo vetëm e drejtë, por dhe detyrë e të afërme të të dëmtuarit. Nga lidhjet e gjakut, thekson Engelsi, lindi detyra për të marrë hakun.² Në Shqipëri gjatë pushtimit pesëshekullor të Perandorisë Osmane kanë sunduar marrëdhëniet ekonomike patriakale-fisnore e feudale. Sheriati dhe legjislacioni penal i pushtuesve osman nuk ishin në gjendje të pakësonin sado pak vrasjet për hakmarrje dhe për gjakmarrje dhe nuk luanin ndonjë rol pozitiv në dënimin e fajtorëve për vrasje përdërisa nuk prekej jeta e personit të pushtuesve ose të klasës feudale. Përveç kësaj, ky legjislacion nuk mund të mbronte jetën e personit të shumicës së madhe të popullit shqiptar, sepse ai sundonte vetëm në zonat ku turqit vepronin, kurse në zonat malore zbatoheshin drejta zakonore.

Gjatë procesit të shthyrjes së rendit skllavo-pronar në Shqipëri dhe lindjes së marrëdhënieve feudale për mënyrën se si është rregulluar instituti i vrasjes në përgjithësi dhe i hakmarrjes në veçanti nuk ekzistojnë dokumenta të drejtëpërdrejta. Në një dokument të fillimit të shek.XIV të perandorit Andronicus II viti 1319 lëshuar për qytetin e Janinës, flitet për çeshtjen e vrasjes në Shqipëri. Këtu thuhet, citoj:” Zakoni sipas të cilit duhet dënuar vrasja është ai i shqiptarëve, i cili duke u larguar nga ligja e mbretërisë bizantine kërkon paragjaka”³. Por megjithëse institutet e hakmarrjes, talionit, sistemit të shpërblimit, lindën që në rendin e bashkësisë primitive, në atë kohë ato nuk mund të quheshin institute juridike dhe nuk kanë asgjë të përbashkët me të drejtën penale. Duhej medoemos të krijoheshin shteti dhe të sanksioneshin prej tij: hakmarrja, gjakmarrja, talioni dhe sistemi i shpërblimit, që këto institute të pushonin së qeni zakone dhe të merrnin karakter juridik. Me shkatërrimin e sistemit fisnor zakonet transformohen në të drejtë zakonore. Krijimi i saj është fenomen i pashmangshëm, domosdoshmëri objektive që përcaktohet nga lindja e pronës private dhe diferencimi shoqëror në gjirin e fisit. Në kanunin e LD por edhe kanunet e tjera që vepronin në Shqipëri ashtu sikurse dhe në legjislacionin penal të vendeve të tjera, në krimet kundër personit si lloj kryesor i shpagimit parashikoheshin hakmarrja. Në kanun ruhet parimi i talionit (gjak për gjak) por edhe ai i shpërblimit të gjakut. Këto institute në kanun pasqyrojnë zhvillimin historik, evolucionin e masave shtrënguese nga një shoqëri e organizuar në bazë fisi ku jetonin pjesëtarë të barabartë, në një shoqëri me klasa të kundërta.

² Engels, “*Origjina e familjes, pronës private dhe shtetit*”, Tirane, 1949, fq.82-83

³ Elezi.I: “*Mbrojtja juridike penale e jetës së njeriut në Rep. Pop. Shqipëri*”, Tiranë 1962, shtypur në N.I.SH, fq.20.

Veprimi në kohë i të drejtës zakonore vazhdoi gjatë në Shqipëri edhe më gjatë se në vendet e tjera dhe shkak u padyshim është tek ekzistenca e marrëdhënieve patriakale feudale të cilat u ruajtën deri në çlirimin e vendit në 1944. Edhe pas formimit të shtetit shqiptar 1912, klasat sunduese shfrytëzuese e kanë përdorur hakmarrjen si një armë në duart e tyre, madje vetë regjimi i Zogut përkrahte dhe nxiste, kur e kërkonte interesi i tij, vrasjet për hakmarrje me qëllim që të përhapej armiqësia dhe të pengohej bashkimi. Natyrisht në ruajtjen e këtij instituti një rol të madh kanë luajtur dhe pushtimet e huaja të njëpasnjëshme që kanë ndodhur në terrenin shqiptar. Në krahinat malësore, të cilat nuk iu nënshtuan pushtimeve të huaja dhe sidomos atij turk, u ruajt autonomia dhe duke mos patur tjetër organizim, detyroheshin të zbatonin hakmarrjen si mjet për zgjidhjen e konflikteve. Kanë ekzistuar disa teori të cilat janë orvatur të shpjegojnë për shkaqet e ekzistencës së hakmarrjes në Shqipëri. Njëra prej tyre është teoria biologjike apo biosociologjike, sipas të cilës shkaqet e ekzistencës së hakmarrjes janë etnike dhe fizike, sipas tyre “shqiptarët janë të prirur ndaj gjakmarrjes”⁴ duke e shkëputur nga shtrati shoqëror ekonomik. Gjithashtu dhe rryma lombrosiane, me përfaqësues Cezare Lambroso (1836-1909) e shikon krimin si fenomen biologjik dhe rrezikun e gjen jo tek krimi por tek kriminaliteti i lindur i kriminelit. Përfaqësuesi i kësaj rryme që në vitin 1901 shkruante se numri i madh i gjakësorëve në Kalabri dhe Sicili shpjegohet nga fakti se në këto krahina ndodheshin shumë shqiptarë.⁵ Madje shumë autorë, kundërshtarë të kombit shqiptar kërkonin të tregonin barbarinë e ligjeve, egërsinë e popullsisë së malësive, duke iu referuar zakonit të gjakmarrjes. Edhe përpara Lombrosos, Enriko Ferri, në vitin 1895 theksonte këtë “tendencë të natyrshme të deliktëve të gjakut të shqiptarëve.⁶ Natyrisht që një përgjigje të argumentuar që hedh poshtë këto pikëpamje, sa antishkencore aq dhe antishqiptare, i është dhënë nga At Gjergj Fishta, i cili pohon se: vrasja sipas kanunit, dënohej por duke mos patur shtet e gjyqe, i lihej shteg gjakmarrjes individuale.⁷ Nuk mund të mohojmë se faktorët psikologjikë, si temperamenti, karakteri, gjaknxehtësia, emocionet ndikojnë mbi subjektin e vrasjeve për gjakmarrje, por nuk mund të pranohet se këta janë faktorët vendimtarë dhe përcaktues të kësaj sjelljeje.

3.1 Zhvillimi i ligjit penal në raport me gjakmarrjen

Kuvendi i Vlorës, (1912) i cili shpalli shtetin e parë shqiptar, adoptoi ligjin penal osman derisa të krijonte një legjislacion të plotë të shtetit shqiptar dhe njëkohësisht lejonte që për aq sa ishte e mundur të zbatoheshin dhe zakonet e

⁴ Elezi.I, “*Vrasjet për Hakmarrje e gjakmarrje në Shqipëri*”, Botim i Qendrës për të drejtat e Njeirut, Tiranë 2000, fq.82

⁵Elezi. I:” *Mbrojtja juridike penale*”, Tiranë 1962, fq.39.

⁶ cituar indirekt nga Elezi.I “*Vrasjet për hakmarrje dhe gjakmarrje në Shqipëri*” botim i Qendrës për të Drejtat e Njeiut, Tiranë 2000, fq. 44 (E. Ferri, L’OMICIDA, Torino, 1925, fq.54).

⁷ *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, parathënie shkruar nga Fishta, Shkodër 1933, fq. XXXIII.

vendit në zgjidhjen e çështjeve konkrete. Ky është akti i parë dhe burimi kryesor i të drejtës shqiptare në përgjithësi dhe asaj penale në veçanti. Marrëdhëniet juridiko civile rregulloheshin sipas Mexhelese (Kodi Civil turk përpunuar në 1869-1876), marrëdhëniet familjare, martesore sipas Sheriatit, në fushën Penale nga Kodi Penal i vitit 1858. Në këtë periudhë klasat sunduese nxisnin vëllavrasjen dhe hakmarrjen. Për këtë arsye qeveria e Fan Nolit në programin e saj ndër të tjera parashikonte dhe reforma radikale të kanuneve gjyqësore të vjetëruara.⁸ Por ky program nuk u realizua për shkak të vendosjes së regjimit të Ahmet Zogut në dhjetor të vitit 1924. Në shtypin e kohës gjatë periudhës 1928-1932 shpesh shkruhej se: “Ligjet e imponuara në shumë raste binin në kundërshtim me njera tjetrën. Legjislatori shqiptar nuk u kujdesua që ti harmonizojë. Qe pra nje kaos që u krijua që në ditët e para të independencës e që vazhdon për fat të keq edhe sot e kësaj dite. Ligjet e reja u interpretuan nga njerëz me kokë të vjetër, prej atyre që gjer në atë çast, kishin shkuar nëpër duar vetëm qitapet e Turqisë Osmane.”⁹

Kodi penal shqiptar i cili hyri në fuqi në 1 janar 1928, nga forma paraqiste atë çfarë borgjezia e Europës kishte realizuar 100 vjet më parë, por nga përmbajtja mbronte interesat e klasave sunduese. Ky Kod u hartua sipas modelit të Kodit Penal Italian të vitit 1889, që konsiderohej ndër më të mirët në Europë për atë kohë. Në kodin penal, titulli i IX i kushtohej delikteve kundër personit dhe në nenet 403-411 vrasjeve. Njëkohësisht me ekzitencën e ligjit pozitiv vepronte dhe ligji i hakmarrjes sipas kanunit të maleve. Në vend që kjo mënyrë të sjelluri të kufizohej dhe zhdukej përkundrazi ajo ushqehej nga klasat reaksionare. Legjislacioni penal shqiptar nuk e parashikonte vrasjen për hakmarrje si vrasje të cilësuar shprehimisht. Gjykatat çmonin në çdo rast duke u udhëhequr nga interesat e klasave që ata përfaqësonin. Për këtë arsye vrasjet për hakmarrje zinin një vend shumë të madh në numrin e përgjithshëm të vrasjeve. Në kushtet e luftës nacional çlirimtare në aktet me karakter juridik që u miratuan në atë kohë, shprehej politika lidhur me vrasjet për hakmarrje dhe sidomos pajtimi i gjaqeve. Merita e qeverisë së përkohshme të Vlorës ishte se në një kohë të shkurtër nxori Kanunin e Jurisë (Zhurisë) 10 Maj 1913, Kanunin e Përshtatshëm të administratës civile shqiptare dhe Kanunin e dëmeve. Këto ishin aktet më të rëndësishëm juridike të shtetit të sapo krijuar që hodhën themelet e së drejtës pozitive shqiptare, sipas modeleve të ligjeve demokratike të shteteve perëndimore. Në kanunin e Zhurisë, një interes të veçantë ka parathënia ku është shprehur nocioni i veprës penale, si veprim që prek të drejtat e njeriut, jetën, lirinë dhe pronën e tij. Kanuni i Jurisë u orientua nga legjislacioni demokratik i shteteve perëndimore për organizimin gjyqësor dhe pranoi sistemin e jurisë duke shfuqizuar sistemin osman të kadinjve, por duke qenë së vepronte dhe e drejta zakonore si e drejtë paralele, ekzistonin dhe gjykatat e pleqve (pleqësitë). Fakti që edhe pas viteve 20 vazhdonte të vepronte e drejta zakonore penale është tregues i ekzisten-

⁸ Fletore Zyrtare 22 korrik 1924.

⁹ Cituar indirekt nga Elezi. I:” *Zhvillimi historik i mendimit teorik-juridik shqiptar*”, (Arbëria, 20 shkurt 1936), botimet Erik, Tiranë 2010, fq. 270.

cës së vrasjeve për gjakmarrje edhe në këtë periudhë të shtetformimit.

Kodi Penal i shtetit shqiptar i vitit 1928, së bashku me ligjin “Mbi aplikimin e Kodit Penal”, ishin aktet që zëvendësuan Kodin Penal Turk të vitit 1858 (1274 sipas kalendarit të vjetër turk) si dhe ligjet e posaçme penale të nxjerra nga shteti shqiptar. Ky është dhe momenti historik kur shteti shqiptar ka ligjin e vet penal si burim kryesor i të drejtës penale në këtë periudhë historike. Në Konferencën e dytë Nacional çlirimtare në Labinot (5 shtator 1943), u miratua Statuti i Lëvizjes Nacionalçlirimtare dhe Rregullorja e Këshillave nacionalçlirimtare, akte që shënuan një burim të ri të së drejtës penale. Në këtë Rregullore ekzistonte një kre i veçante mbi krimet. Vendin kryesor e zinte pajtimi i gjaqeve sipas traditës së lashtë, lufta kundër hakmarrjes si plagë e madhe shoqërore e trashëguar nga e kaluara që dëmtonte bashkimin e popullit në luftë kundër pushtetuesve. Në rregullore thuhej: “Ata që do të kërkojnë marrje gjaqesh konsiderohen armiq dhe në dëm të interesit të bashkimit kombëtar, prandaj çdo luftëtar në çetë ka të drejtë t’i vrasë këta gjakësorë dhe s’ka asnjë përgjegjësi pse i vret, edhe kur gjakmarrja bëhet kundër ushtarëve nacionalçlirimtare, çetat zhdukin krejt atë dhe bashkëpunëtorët e tij”.¹⁰ Rregullorja parashikonte dënimin me vdekje për vrasjet për hakmarrje dhe këshillat nacionalçlirimtare luajtën një rol aktiv në pajtimin e gjaqeve. Në kushtet e luftës nacionalçlirimtare i kushtohej një rëndësi e dorës së parë pajtimin të gjaqeve, të hasmërive të vjetra, luftës kundër vrasjeve dhe hakmarrjeve të trashëguara nga e kaluara, duke i konsideruar ato si problem me karakter të theksuar politiko-shoqëror, sepse ato ndikonin drejtpërdrejt në bashkimin e popullit në luftë kundër pushtetuesve. Praktika e asaj periudhe ka treguar dhe vërtetuar plotësisht se në zonat e çliruara vrasjet për hakmarrje ishin fenomen i rrallë dhe hasmërite konsideroheshin si një mentalitet i vjetër të cilat i shërbenin më shumë armikut që dëshironte t’i shihte njerëzit të gjakoseshin. Edhe pas çlirimit të vendit vazhdoi të vepronte Kodi Penal i shtetit shqiptar (1928) përsa u përket vrasjeve për hakmarrje dhe për gjakmarrje. Legjislacioni penal i pasçlirimit por edhe praktika gjyqësore e ka konsideruar vrasjen për hakmarrjesi vrasje të cilësuar në kundërshtim me praktikën gjyqësore të periudhës paraçlirimit. Në një vendim të gjykatës së lartë, Nr. 61 datë 20.05.1946 thuhej:” Hakmarrja ky zakon prapanik i vendit që njollos qytetërimin e kohës së sotme, duhet të quhet shkak rëndësor dhe jo lehtësor. Nuk kanë të drejtë privatët të hakmerren, të bëjnë vetëgjyqësi. Vetëm shteti ka tagrin të japë drejtësi me gjykatat që ka ngritur dhe të cilat gjykojnë në paanësi të plotë”. Në Kodin penal të Rep. Pop. Shqipërisë, është parashikuar vrasja me dashje e cilësuar e kryer: për hakmarrje (Kodi penal i vitit 1948 parashikon si krim të kryer në rrethana rënduese kur është kryer për motive të dobëta ku përfshihej dhe hakmarrja). Kodi Penal pas 1948 parashikon gjithashtu si rrethanë rënduese vrasjen për hakmarrje.

Pas çlirimit, ligji i parë që pushteti popullor shpalli ishte ligji Nr.382 datë

¹⁰ Elezi. I, Elezi. E: “*Historia e te drejtes Penale*”, shtëpia botuese e Librit Universitar, 2010, fq.146

24.12.1946 “Mbi dispozitat e përgjithshme penale”. Natyrisht që mbi kete baze dolen dhe ligje te tjera penale te posacme per krime te ndryshme. Ky akt veproi deri në vitin 1948, pasi në këtë vit me dekretin Nr.615 datë 13 maj 1948 u shpall ligji Nr.599 datë 13.05.1948 “Mbi pjesën e përgjithshme të Kodit Penal që hyri në fuqi në 1 shtator 1948. Ndërsa Kodi Penal që hyri në fuqi ne 1.09.1952 ishte i pari pas Luftës së Dytë Botërore që ishte kod i plotë me pjesën e përgjithshme dhe të posaçme. Kodi Penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë që hyri në fuqi në 1 tetor 1977 ashpërsoi shumë politikën e dënimeve me vdekje. Si në Kodin e vitit 1952 ashtu dhe në atë të vitit 1977 (nenet përkatëse) e parashikonin vrasjen për hakmarrje si vrasje në rrethana rënduese për të cilën dënimi ishte deri në vdekje. Në këtë Kod për vrasjet e kryera për interes, hakmarrje, zili dhe shkaqe të tjera të dobëta janë caktuar masa dënimi tv rrepta dhe kjo në përgjithësi është drejtë, për arsye se kemi të bëjmë me vrasje të cilësuar nga ana subjektive. Në një Vendim të Kolegjit penal të Gjykatës së lartë, theksohej: “gjykata duhej të kishte pasur parasysh se rrezikshmëria shoqërore e një vrasje të kryer për hakmarrje është e theksuar. Për zhdukjen rrenjësore të zakonit tepër të dëmshëm të hakmarrjes... si dhe për mbrojtjen e jetës së njeriut që është kapitali më i çmuar i shoqërisë, fajtorët që kryejnë kësi lloj krimesh duhen të dënohen me ashpërsinë më të madhe të ligjës.¹¹ Por më pas në vitin 1988, u bënë disa ndryshime në Kodin Penal kryesisht në pjesën e përgjithshme të tij. Ndërsa ndryshimet që u realuan me ligjin Nr.7380 datë 8.05.1990 Kodit Penal kishin të bënin me të gjitha ndryshimet e proceseve demokratike që ndodhën në vendin tonë në çdo sferë të jetës. Natyrisht që një nga tiparet dhe prirjet kryesore të legjislacionit tonë ne teresi dhe atij penal ne vecanti është dinamizmi progresiv, zhvillimi dialektik i tij në përputhje me kërkesat objektive të shoqërisë tonë në çdo stad të zhvillimit të tij.¹²

Si rrjedhojë e ndryshimeve të thella politike e sociale ekonomike që ndodhën në vendin tonë pas viteve 90 si dhe reformave ligjore të njëpasnjëshme gjatë viteve 1990-1995 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi Kodin Penal i cili hyri në fuqi në 1 qershor 1995. Me këtë akt u hodh një hap përpara drejt të drejtës penale europiane. Ky kod i kushton një vend kryesor mbrojtjes së jetës së njeriut, në kundërshtim parimor me Kodin Penal të shtetit totalitar, që bazohej në konceptin se shteti është mbi gjithçka. Vendosja e raporteve të drejta midis individit e shtetit, duke i dhënë përparësi mbrojtjes së individit, përbën karakteristikën themelore të këtij Kodi. Ky Kod parashikonte: “Vrasja e kryer me paramendim dënohet me burgim nga 15 -25 vjet dhe kur ka rrethana rënduese, me burgim të përjetshëm a me vdekje” (neni 78). Në vrasjet me paramendim, si rregull hyjnë dhe vrasjet për hakmarrje e për gjakmarrje. Natyrisht që në këtë dispozitë nuk flitet shprehimisht për hakmarrje apo gjakmarrje dhe kjo ka sjellë që shumë cilësime juridike të ishin jo të rregullta.

¹¹ Elezi. I: “Mbrojtja juridike penale e jetës së njeriut” Tiranë 1962, shtypur nga Mihal Duri, fq.221.

¹² po aty, fq.175

Në vendimet e kësaj periudhe të gjykatave të Apelit apo të Kasacionit, flitej vetëm për vrasje me paramendim, pa e bërë dallimin midis vrasjeve për hakmarrje e për gjakmarrje. Në këto akte ndër llojet e vrasjeve që paraqesin interes dhe rëndësi të veçantë historike, shoqërore, juridike janë ato për hakmarrje e gjakmarrje.

4.1 Situata aktuale në raport me gjakmarrjen, reflektimi në dispozitat e Kodit Penal

Sikurse e cituam edhe më lart, vrasjet për gjakmarrje janë fenomen historik, shoqëror dhe me karakter ndërkombëtar sepse ato janë shfaqur e zhdukur në vende të ndryshme në kohë të ndryshme. Në Shqipëri vrasjet për gjakmarrje janë ndeshur më vonë për shkak të pushtimeve të gjata shekullore të të huajve dhe të mungesës së autoritetit shtetëror shqiptar. Shteti shqiptar që u krijua në vitin 1912 nuk mundi të stabilizohej për shkak të Luftës Ballkanike, të Luftës së Dytë Botërore kur përsëri Shqipëria u pushtua nga të huajt por edhe për shkaqe të tjera shoqërore, ekonomike, psikologjike, etj. Ndërsa gjatë periudhës së tranzicionit, në vendin tonë ndodhi një ‘ç’organizim shoqëror’ i cili u shpreh dhe në mosfunksionimin normal të shtetit, keqkuptimin e lirisë dhe demokracisë, duke i njehsuar këto vlera me anarkinë dhe vetëgjyqësinë. Kjo situatë bëri që dhe vrasjet për gjakmarrje e hakmarrje të rishfaqeshin dhe sidomos kjo u bë më e dukshme për shkak të kaosit që u krijua gjatë vitit 1997, kur u paralizua aparati shtetëror dhe nuk u zbatuan ligjet e shtetit. Nga pikëpamje juridike vrasjet për gjakmarrje dënohen sipas Kodit Penal me burgim jo më pak se 20 vjet ose me burgim të përjetshëm. Kjo shtesë që iu bë dispozitës përkatëse kishte parasysh rishfaqjen e fenomenit pas vitit 1991 dhe sidomos pas vitit 1997. Procesi i ndryshimeve demokratike u shoqërua me kriza të mëdha politike, institucionale, ekonomike, psikologjike dhe rishfaqja aktualisht e këtij fenomeni edhe pas 20 viteve tranzicion kërkon një analizë më të thelluar, për të njohur gjendjen reale të kriminalitetit lidhur me këto lloj vrasjesh, me dinamikën e tyre në kohë, strukturën apo shtrirjen gjeografike, në mënyrë që të merren masat e duhura parandaluese. Është e pafalshme që edhe pas 100 viteve shtet shqiptarët dhe Shqipëria të indetifikohen në botë si njerëz barbarë që udhëhiqen nga instikte barbare të kohës së lashtë, si një vend ekzotik ku mbizotëron sensi i vetgjyqësisë.

Në analizën që duhet të bëhet për këtë fenomen duhet të jemi shumë të kujdesshëm, sepse jo në pak raste hetimi por edhe gjykimi nuk nxjerr në pah shkaqet e vërteta të vrasjeve, duke mos bërë cilësime juridike të sakta, por i vesh mbulesën “vrasje për gjakmarrje” dhe kjo sjelle që të ketë mosnjohje të realitetit por në mjaft raste dhe fryrje të statistikave të cilat padyshim që dëmtojnë imazhin e demokracisë dhe interesat kombëtare. Natyrisht që rishfaqja e kësaj dukurie në ditët tona ka të bëjë me shumë me tronditjen e fortë që pësoi sistemi i vlerave në shoqërinë shqiptare. Kjo krizë vlerash si dhe mungesa e modeleve të qëndrueshme sociale shoqëruar me vakumin administrativ dhe praninë e pamjaftueshme të shtetit, solli që mjaft nga bashkësitë malësore (të cilat janë zhvendosur nga vendqëndrimet e tyre

tradicionale) të prireshin drejt modeleve të vjetra, patriakale, fisnore tek sistemi vetkontrollues i kanunit, pikërisht tek ky rend i cili në kohët e vjetra kishte kompensuar mungesën e pushtetit qendror. Çorganizimi shoqëror lidhet me ç'organizimin individual, që duket në sjelljen jo të kulturuar të njerëzve, në grindje e mosmarreveshje, në mungesën e tolerancës, në acarime politike, humbje të besimit ndaj pushtetit, ligjit e shoqërisë, gjë e cila çon në krime, përfshirë dhe vrasjet për hakmarrje e gjakmarrje.

Vrasjet për gjakmarrje në kushtet e sotme mund t'i klasifikojmë në dy grupe: 1) vrasje për gjakmarrje të vjetra, para 20-40 vitesh e më tepër dhe 2) vrasje për gjakmarrje të reja, si pasojë e vrasjeve për shkaqe të ndryshme.¹³ Ndërsa vrasjet e vjetra janë duke u pakësuar sepse dhe koha e gjatë ka bërë që të shkëputen nga mendimi i gjakmarrjes dhe pajtimi është shumë i mundshëm, ndryshe qëndron puna tek vrasjet e reja, të cilat duket se janë shtuar kohët e fundit. Mosdenimi i fajtorit, ose largimi i tyre jashtë vendit dhe ngujimi i familjarëve ka sjellë një gjendje pasigurie dhe marrje jetësh të pafajshme. Nëse shteti nuk do të ushtrojë pushtetin e vet në të gjithë vendit, krijon kushtet për vazhdimin e vetgjqësisë. Pasi aty ku shteti e ligji nuk vepron, i lihet shteg kanunit, rigjallërimit të fenomenit të gjakmarrjes, pavarësisht se i devijuar në formë e përmbajtje. Megjithatë kërkohet medoemos të bëhet një analizë më e detajuar në çdo rast vrasje. Natyrisht që nuk mund të mohohet se në vrasjet për hakmarrje e gjakmarrje kanë ndikimet e veta dhe kanunet, por fakti se shumica e tyre kryhet nga moshat e reja 25-35 vjeç që nuk e njohin kanunin, si dhe në shumë raste ato janë kryer në kundërshtim apo shmague nga rregullat kanunore, si p.sh. përdoret automatiku, minat, bombat jo vetëm kundrejt vrasësit por edhe familjes, vriten pleq, fëmija e gra, gjë që kanuni nuk i lejonte, nuk mund të flitet për rishfaqje por dukje të një fenomeni të ri të fshehur nën emërtimin e të vjetrin dhe kjo jo pa shkak.

Respektimi i përpiktë dhe i drejtë i Kodit Penal dhe i Procedurës Penale për hetimin e gjykimin e rregullt të krimit të vrasjes, për cilësimin e saktë juridik të krimit, dhënia e dënimeve të rrepta e të drejta kundër fajtorëve, janë kushti i domosdoshëm për parandalimin e vrasjeve për hakmarrje e për gjakmarrje për t'i prerë rrugën vetgjqësisë. Sigurisht që respektimi dhe zbatimi i përpiktë i ligjit varet në shkallë të konsiderueshme nga vendosja e rendit dhe e qetësisë publike, nga stabiliteti politik i vendit, si dhe nga faktorët e tjerë ekonomike-shoqërore. Diskutimi aktual për ndryshime në dispozitat e Kodit Penal lidhur me caktimin e dënimeve fikse, është këmbanë alarmi për fenomenin, i cili mesa duket po gjen terren dhe është shtrirë përtej asaj që vetë kanuni mbron, jetën e grave dhe fëmijëve. Megjithatë lidhur me sanksionet fikse më parë është ezauruar një debat, i cili ka konkluduar se me përcaktime të tilla cënohen të drejtave themelore të njeriut,

¹³ Elezi. I: "*Vrasjet per hakmarrje e gjakmarrje ne Shqiperi*", Tirana 2000, Botim i Qendres per te drejtat e njeriut, fq. 74.

të garantuara me parimet kushtetuese për një proces të rregullt ligjor dhe për një gjykim të drejtë,¹⁴ dhe roli i mbrojtjes mbetet pa kuptim e pa efekt, pasi masa e dënimit është caktuar nga vetë ligjvënësi. Studimet kriminologjike shkencore duhet të jenë burimi bazë për të orientuar shtesat dhe ndryshimet e nevojshme të Kodit Penal për inkriminimin e veprave penale të reja apo për depenalizimin e tyre. Vetëm kështu ato do të shërbejnë si bazë për politikën kriminale e cila orienton masat parandaluese dhe politikën ndërshkuese në unitet me kriminologjinë dhe të drejtën penale, si shtylla kryesore të sistemit të drejtësisë penale.

5.1 KONKLUZIONET

Drejtësia penale në Shqipëri synon të arrijë standardet europiane dhe kjo është sfidë e madhe që do kapërçyer me kujdes dhe me punë të vërtetë shkencore. Ekzistenca e vrasjeve për gjakmarrje e hakmarrje janë paradokse të demokracisë, të papajtueshme me natyrën e shtetit të së drejtës dhe me aspiratat e popullit për të qenë përkrah popujve të tjerë të qytetëruar. Masat parandaluese duhet të marrin përparësi përkundrejt rolit edukues të dënimit penal, sepse janë masat paraprake ato që kanë për qëllim ç'rrenjosjen nga jeta e shoqërisë së hakmarrjes dhe gjakmarrjes, si ndjenja primitive e anticivilizuese. Nëse ligjet nuk do të zbatohen, nëse shteti nuk do të ushtrojë forcën e tij shtrënguese, natyrshëm i lihet shteg kanunit. Në shtetin juridik që duam të ndërtojmë nuk mund të ketë dualitet juridik, midis ligjit e kanunit, prandaj dhe njohja e ligjeve dhe rritja e ndërgjegjes juridike është mjaft e rëndësishme. Kundër vrasjeve për gjakmarrje e hakmarrje duhet të organizohet një goditje e përqendruar dhe e ashpër, duke përdorur të gjitha mekanizmat që ligji lejon apo dhe traditat pozitive më të mira të së kaluarës, siç janë pajtimi, besëlidhjet ndërmjetësimi, institutë që i përmbajnë dhe kanunet dhe që ruajnë vlerat kulturore të popullit si monumente historike. Përvoja jetësore ka vërtetuar se vrasjet për gjakmarrje apo hakmarrje janë plotësisht të kapërçyeshme, pikërisht duke kultivuar ndjenja të tilla si mirëkuptimi, bashkimi, toleranca e vëllazërimi, sepse vetëm kështu mund të sigurohet jeta e njeriut, si gjëja më e çmuar, të mbrohet ajo në mënyrë të gjithanshme si qëllimi më i lartë i demokracisë. Orientimi filozofik i së drejtës penale mbetet filozofia liberal-demokratike, mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe parandalimi e goditja me ashpërsi e krimeve të rënda, që e çënojnë këtë të drejtë.¹⁵

¹⁴ Vendime të Gjykatës Kushtetuese të RSH (2004), fq.26-35

¹⁵ Elezi.I, Elezi. E: “*Historia e të drejtës penale*”, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë 2010, fq.283

BIBLIOGRAFIA

- Elezi. I, E drejta Zakonore penale e shqiptarëve, Tiranë 1983
- Elezi. I, Vrasjet për hakmarrje dhe për gjakmarrje, Tiranë, 2000
- Elezi. I, Zhvillimi historik i mendimit teorik- juridik shqiptar, Tiranë 2010
- Elezi.I, Mbrojtja juridike penale e jetës së njeriut në Republikën Popullore të Shqipërisë, Tiranë 1962
- Elezi.I, Elezi.E, Historia e të drejtës penale, Tiranë 2010
- Elezi. I, Komentari i shtesave dhe ndryshimeve të reja në Kodin Penal 2003-2004, Tiranë 2004
- Engels, M “Origjina e familjes, pronës private dhe shtetit”, Tiranë, 1949
- Ferri. E, Sociologia kriminale, Torino, 1925
- Gjecov.Sh, Kanuni i Lekë Dukagjinit, Shkodër 1933
- Kodi Penal i Republikës Popullore të Shqipërisë, Tiranë 1948, 1952,1977
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Tiranë 1995 (i azhornuar nga Qendra e Botimeve Zyrtare, Tiranë 2004 e në vijim)
- Kodi Penal i Shtetit Shqiptar, Tiranë 1929
- Kushtetuta e Shqipërisë, Tiranë, 1998
- Ligja penale otomane, Tiranë 192
- Lombrozo. C, L'uomo delinquent, 5 ediz Torino, 1897
- Toci.T, E drejta ndërshkimore, parime të përgjithshme, Shkodër 1926
- Vendime të Gjykatës Kushtetuese (çeshtje penale) 1996-2005
- Dokumenta të organeve të larta ë pushtetit revolucionar nacionalçlirimtar, Tiranë 1962

MJEKIMI I PAKUJDESSHËM NË LEGJISLACIONIN PENAL SHQIPTAR DHE NDRYSHIMET E MUNDSHME NË KUADËR TË HARMONIZIMIT ME LEGJISLACIONIN E SHTETEVE EUROPIANE

PhD. Emanuela FURRAMANI

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”,

Fakulteti i Drejtësisë

E-mail: efurramani@unishk.edu.al

ABSTRAKT

Proceset gjyqësore të lidhura me mjekimin e pakujdesshëm kanë pësuar një rritje edhe në Shqipëri ashtu si në vendet e tjera Europiane dhe kjo si rezultat i natyrës themelore të të drejtave që vihen në rrezik nga kjo vepër penale. Çështja e përgjegjësisë penale të mjekut përbën një çështje shumë komplekse, veçanërisht nëse i referohemi problematikave që lidhen me përcaktimin e elementit psikologjik dhe me elementët përbërës të anës objektive.

Mbi bazën e këtyre premisave, vlen të theksohet se problemi themelor i përgjegjësisë penale të mjekut qëndron në identifikimin e fajit të mjekut si një kategori e fajit të posaçëm: në identifikimin e pakujdesisë në dy format e saj: neglizhencë apo vetbesim i tepruar që karakterizohen nga shkelja apo mosrespektimi i rregullave dhe protokolleve të aprovuara nga shkenca mjekësore. Në thelb, për përcaktimin e përgjegjësisë penale të mjekut është e nevojshme që të vërtetohet që sjellja e mjekut ka qënë e papërgjegjshme dhe që pasoja e dëmshme ka qënë e parashikueshme dhe e evitueshme njëkohësisht.

Duke pasur parasysh shumëllojshmërinë e problematikave që shfaq mjekimi i pakujdesshëm, konsiderohet e nevojshme që gjatë këtij punimi të kryhet një studim i shkurtër edhe mbi lidhjen shkakësore si një nga elementët thelbësorë në përcaktimin e përgjegjësisë penale të mjekut, duke iu referuar edhe vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjykatat shqiptare.

Fjalë kyçe – Mjekim i pakujdesshëm, përgjegjësi penale, neglizhenca, lidhje shkakësore

1. Hyrje

2. Mjekimi i pakujdesshëm në legjislacionin penal shqiptar

3. Mjekimi i pakujdesshëm në praktikën e gjykatave shqiptare

3.1. Përcaktimi i lidhjes shkakësore në mjekimin e pakujdesshëm

4. Legjislacioni i disa shteteve europiane mbi mjekimin e pakujdesshëm

5. Përfundime

6. Bibliografi

1. HYRJJE

Mjekimi i pakujdesshëm është një nga veprat penale më problematike në pjesën më të madhe të shteteve europiane. Problemi kryesor përta i përket veprës penale të mjekimit të pakujdesshëm qëndron në përcaktimin e anës subjektive të veprës penale dhe në veçanti në identifikimin e pakujdesisë profesionale të mjekut, si një kategori e veçantë faji, e karakterizuar nga shkelja ose mosrespektimi i ligjeve, rregulloreve, urdhrave dhe disiplinave.

Pas kësaj premise të përgjithshme, është e mundur të analizohen elementët që karakterizojnë pakujdesinë mjekësore. Është e rëndësishme të theksohet se kur bëhet fjalë për veprimtarinë mjekësore-kirurgjikale, si veprimtari e rrezikshme por e lejuar sepse është e dobishme për shoqërinë¹, bëhet fjalë për të ashtuquajturën pakujdesi e veçantë: pakujdesi e karakterizuar nga mosrespektimi i rregullave të sjelljes edhe nëse këto të fundit nuk janë të shkruara që kanë për qëllim kryesor shmangien e rrezikut tipik të aktivitetit mjekësor². Prandaj, në sintezë, pakujdesia në veprimtarinë mjekësore apo kirurgjikale konsiston në dështimin e marrjes së masave paraprake nga mjeku për të shmangur rrezikun tipik të aktivitetit mjekësor³.

Në hulumtimin tonë mbi pakujdesinë mjekësore, si fillim do të analizojmë faktorët që ndikojnë në pakujdesinë mjekësore, dhe për këtë qëllim ne duhet t'i referohemi doktrinës dhe jurisprudencës shqiptare duke hedhur një vështrim edhe mbi legjislacionin e disa prej shteteve europiane në lidhje me mjekimin e pakujdesshëm.

2. Mjekimi i pakujdesshëm në legjislacionin penal shqiptar

Mjekimi i pakujdesshëm është i parashikuar nga neni 96 i Kodit Penal Shqiptar dhe sipas këtij neni parashikohet se *“Mjekimi i pakujdesshëm i të sëmurëve nga ana e mjekut ose i personelit mjekësor, si dhe moszbatimi i terapisë ose i porosive të mjekut nga ana e personelit mjekësor, apo farmacistit kur ka shkaktuar dëmtimin e rëndë të shëndetit, ka rrezikuar jetën e personit ose ka shkaktuar vdekjen e tij dënohet me gjobë ose me burgim deri në 5 vjet. Po kjo vepër, kur ka shkaktuar infektimin e të sëmurëve me infeksionin HIV/AIDS, dënohet me burgim deri në 7 vjet.”*

Sipas doktrinës dhe jurisprudencës shqiptare ky nen përfshin një gamë të gjërë të veprimeve apo mosveprimeve të pakujdesshme të mjekut apo personelit

¹ M. N. GRIBAUDI, *Consenso e dissenso informati nella prestazione medica*, Giuffrè Editore, Milano, 2012, fq. 59.; Cass. Pen., Sez. IV, 2 ottobre 2003, n. 37473. *CED Cassazione*, 2003, n. 225958.

² Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Vendim nr. 947, datë 22.06.2009.

³ Cass. Pen., Sez. IV, 9 luglio 2003, n. 37473. *CED Cassazione*, n. 225958.; Cass. Pen., Sez. IV, 21 novembre 1996, n. 2139, Spina. *CED Cassazione*, n. 207873.; C. CUPELLI, *Responsabilità colposa e accanimento terapeutico consentito*. *Cass. pen.*, 2011, 3, fq. 2947.

mjekësor, që lidhen me parandalimin, diagnostikimin dhe mjekimin e pacientit⁴. Por, jo çdo veprim apo mosveprim i mjekut bën që ky i fundit të konsiderohet si mjekim i pakujdesshëm, pasi në mënyrë që mjeku të përgjigjet penalisht për mjekim të pakujdesshëm duhet që si rezultat i neglizhencës apo vetëbesimit të tepruar, pacientit t'i jetë shkaktuar një dëmtim i rëndë i shëndetit, rrezikimi i jetës, vdekja apo mbi bazën e paragrafit të dytë të këtij neni të jetë infektuar me virusin HIV/AIDS.

Duhet të theksohet menjëherë se kriteret bazë të përgjegjësisë penale me pakujdesi janë parashikueshmëria dhe evitueshmëria e pasojës së dëmshme apo të rrezikshme të verifikuar⁵. Në këtë drejtim, duhet marrë parasysh orientimi doktrinal sipas të cilit pakujdesia kërkon domosdoshmërisht një koeficient thelbësor psikologjik⁶ dhe për këtë arsye kërkon mundësinë e dijes së shkaqeve të jashtme të dëmit nga subjekti aktiv apo mundësisë objektive për ta shmangur atë⁷. Kur bëhet fjalë për veprimtarinë mjekësore si kategori e veçantë faji, duhet që pasoja e dëmshme, jo vetëm të ketë qenë e parashikueshme dhe e evitueshme, por duhet që ajo të ketë ardhur si pasojë e shkeljes së rregullave apo protokolleve mjekësore klinike të bazuara në literaturën bashkëkohore, të cilat kanë qëllim kryesor orientimin e mjekut në trajtimet mjekësore, veçanërisht në parandalimin dhe shmangien e rreziqeve tipike të aktivitetit mjekësor.

Në këtë mënyrë, në fushën e së drejtës penale, mjeku konsiderohet përgjegjës për mjekim të pakujdesshëm për mos përshtatjen e sjelljes së tij me nevojat dhe rreziqet tipike të mjekimit apo ndërhyrjes mjekësore.

2.1. Përcaktimi i lidhjes shkakësore në mjekimin e pakujdesshëm

Lidhja shkakësore është një element i domosdoshëm i anës objektive të veprës penale të mjekimit të pakujdesshëm dhe mund të përcaktohet vetëm nëpërmjet ekspertizës mjeko-ligjore. Kjo e fundit shumë e rëndësishme në përcaktimin e veprimit apo mosveprimit mjekësor që ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të domosdoshme në ardhjen e pasojës.

Problemi vërehet më tepër në identifikimin e lidhjes shkakësore midis mosveprimit të mjekut dhe pasojës së dëmshme të ardhur si pasojë e tij. Sipas jurisprudencës së Gjykatës Italiane të Kasacionit, veprimi apo mosveprimi njerëzor duhet të jetë kusht i domosdoshëm në ardhjen e pasojës ose ndryshe "*conditio sine*

⁴ I. ELEZI, *E drejta penale. Pjesa e posaçme*, Tiranë, 2014, fq. 100.

⁵ A. R. DI LANDRO, *Dalle linee guida e dai protocolli all'individuazione della colpa penale nel settore sanitario*, Giappichelli Editore, Torino, 2012. fq. 3, 125.; Për një mendim ndryshe L. STORTONI, *La categoria della colpa tra oggettivismo e soggettivismo (che ne è della colpa penale)*. *Ind. pen.*, 2016, fq. 17.

⁶ CASTRONOVO, *La colpa "penale". Misura soggettiva e colpa grave*. AA.VV., *Reato colposo e modelli di responsabilità – le forme attuali di un paradigma classico*, (a cura di) DONINI, ORLANDI, BUP, Bologna, 2013, fq. 183.

⁷ A. PRINCIGALLI, *La responsabilità del medico*, Napoli, 1983, fq. 47.

qua non”⁸ (kusht pa të cilin). Gjykata Italiane e Kasacionit është shprehur se lidhja shkakësore midis veprimit/mosveprimit dhe pasojës duhet të provohet konkretisht nga gjykata, mbi bazën e probabilitetit logjik, sipas të cilit lidhja shkakësore ekziston atëherë kur provohet se, nëse veprimi i detyrueshëm i mjekut do ishte kryer, pasoja e dëmshme nuk do të kishte ardhur⁹ ose do të kishte ardhur, por me më pak intensitet nga ato që u realizuan në të vërtetë¹⁰. Në të njëjtën mënyrë është shprehur edhe Gjykata e Apelit Tiranë në vitin 2016¹¹.

Prova konkrete për të përcaktuar lidhjen shkakësore duhet të jetë e bazuar në ligjet shkencore, mbi bazën e të cilave një ngjarje mund të jetë e lidhur në lidhje shkakësore me një tjetër, kur kjo vërtetohet nga një ligj me vlera universale që konfirmon rregullsinë e lidhjes shkak-pasojë¹².

3. Mjekimi i pakujdesshëm në praktikën e gjykatave shqiptare

Për të patur një ide më të qartë mbi mjekimin e pakujdesshëm duhet t’i referohemi edhe jurisprudencës së gjykatave shqiptare dhe interpretimeve të tyre mbi nenin 96 të Kodit Penal.

Mbi bazën e këtij neni Gjykata e rrethit gjyqësor Korçë¹³ ka vendosur deklarinimin fajtor të mjekut për mjekim të pakujdesshëm për shkak se ky i fundit përpara një dëmtimi të gjurit të pacientit, ka vendosur hedhjen në allçi të këmbës, duke mos bërë ekzaminimet e duhura dhe duke mos u kujdesur për pacientin, i cili si rezultat i përkeqësimit të gjëndjes shëndetësore, u detyrua të shtrohet në spitalin ushtarak të Tiranës, ku edhe iu nënshtua prerjes së këmbës të kaluar në gangrenë. Në vendimin gjyqësor, gjykata është bazuar në ekspertizën mjekësore e cila ka nxjerrë në pah që mjeku kishte bërë disa shkelje në formën e neglizhencës mjekësore për “*mos ndjekjen e të sëmurit nga momenti i shtrimit deri sa është instaluar gangrena në këmbën e majtë. Për këtë mbajnë përgjegjësi personeli i lartë dhe i mesëm mjekësor që kanë pasur për detyrë trajtimin e këtij të sëmurit*”¹⁴.

⁸ “*La condotta umana è condizione necessaria dell’evento se, eliminata mentalmente dal novero dei fatti realmente accaduti, l’evento non si sarebbe verificato, mentre non è condizione necessaria se, eliminata mentalmente mediante il medesimo procedimento, l’evento si sarebbe egualmente verificato.*” cit., C. CORATELLA, *Responsabilità penale del medico (supplemento di diritto e giustizia)*, Giuffrè Editore, Milano, 2006, fq. 80.; Cass. Pen., Sez. IV, 28 settembre 2000, n. 1688, (Baltrocchi). *Riv. it. med. leg.*, 4-5, 2001, fq. 805.

⁹ P. BENCIOLINI, *Giudice e perito dinanzi ai problemi di valutazione dell’ipotesi di responsabilità per omissione di accertamenti medici dovuti.* *Riv. it. med. leg.*, 3, 2001, fq. 653.

¹⁰ Në të njëjtën mënyrë Cass. Sez. IV, 20 marzo 2012, n. 10864: “*il reato si configura solo se l’evento, con elevato grado di credibilità razionale non avrebbe avuto luogo o avrebbe avuto luogo in epoca significativamente posteriore o con minore intensità lesiva.*”

¹¹ Gjykata e Apelit Tiranë, Vendim Nr. 975, datë 15.07.2016.

¹² Cass. Pen., Sez. IV, 28 settembre 2000, n. 1688.

¹³ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, Vendim Nr.540, datë 22.11.2011.

¹⁴ Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, Vendim Nr.00-2014-1100, datë 25.02.2014.

Është e rëndësishme të vërehet se si Gjykata e Apelit Tiranë, në rastin e një gabimi mjekësor në diagnostikimin e sëmundjes e ka konsideruar në mirëbesim veprimin e mjekëve dhe si të tillë i ka përjashtuar nga përgjegjësia penale. Në rastin konkret bëhej fjalë për një vajzë 22 vjeçare që ishte shtruar në spitalin onkologjik të Tiranës me temperaturë të lartë. Mjekët i kanë bërë në biopsi prej së cilës rezultoi një tumor malinj dhe si rezultat pacientja iu nënshtrua kemioterapisë dhe rrezatimit radioaktiv. Kjo terapi i shkaktoi pacientes dëmtime të pashërueshme, kriza epileptike, tumor të lëkurës dhe leuçemi si dhe pasoja të tjera tepër të rënda, të pakthyeshme, kur në të vërtetë pacientja kishte patur një infeksion të rëndë. Në fakt gjykata është bazuar në aktin e ekspertimit të mjekëve, të cilët veprimin e mjekëve të akuzuar e kanë konsideruar si *gabim mjekësor*, të kryer në mirëbesim dhe duke përdorur mjete dhe metoda nga shërbimi i histologjisë së spitalit onkologjik të Tiranës dhe njëkohësisht në vendim thuhet se pacientes thjesht i janë *rënduar kushtet shëndetësore dhe nuk ka ardhur ndonje gjymtim apo shëmtim i përhershëm apo ndërpreje e shtatzanisë*. Pra, sipas interpretimit të gjykatës, shkaktimi i sëmundjeve kancerogjene apo i atyre mendore me efekt të pakthyesëm, apo humbja e mundësisë për të lindur fëmijë, nuk konsiderohet dëmtim i rëndë i shëndetit. Ky argumentim na lë disa rezerva sidomos përsa i përket interpretimit të bërë mbi dëmtimin e rëndë.

Në një vendim tjetër të Gjykatës së Lartë të vitit 2013, një person i aksidentuar në punë, pasi ishte rrëzuar nga skela paraqitet në urgjencën e spitalit të Lushnjës, ku mjeku i turnit disponon ekzaminimet dhe përcakton diagnosën e të sëmurit duke i dhënë dhe terapinë përkatëse. Por, me kalimin e kohës i sëmuri u përkeqësua dhe si rezultat mjeku u detyrua ta transferojë në spitalin ushtarak në Tiranë, por gjatë rrugës pacienti ndërroi jetë.

Ekspertimi mjeko-ligjor përcaktoi se pacienti ka marrë ndihmën e duhur mjekësore dhe konkretisht në raport thuhet: *“Duke u mbështetur në të dhënat e kartelës në ekzaminimet e kryera dhe në mjekimin e aplikuar arrijmë në konkluzionin se, gjatë kohës së qëndrimit në spital i është dhënë ndihma e duhur mjekësore”*. Familjarët e viktimës kanë kërkuar një riekspertim mjeko-ligjor mbi bazën e të cilit kanë ngritur çështjen penale për mjekim të pakujdesshëm dhe Gjykatat e Apelit e ka dënuar mjekun për mjekim të pakujdesshëm. Por, Sipas Gjykatës së Lartë, mungojnë në rastin konkret elementët e veprës penale të mjeki-mit të pakujdesshëm, duke u bazuar edhe tek aktet e ekspertimit mjeko-ligjor sipas të cilëve: *“Megjithëse në konkluzione të ndryshme, të gjithë ekspertët mjeko-ligjore pranojnë një fakt, atë që, ka rezultuar nga autopsia dhe që s’mund të mohohet se: “I ndjeri ka pasur dëmtime në kokë, frakturë e bazës së kafkës si dhe të kockave petroze, hemorragji punktiforme në trurin e vogël, në lobin e majtë, hemorragji të trurit të madh që konstatohet edhe gjatë prerjes së tij”*. Bazuar në të dhënat e protokollit të autopsisë, e dhëna më e saktë shkencore, por edhe në ato të ekzaminimeve imazherike, laboratorike dhe klinike, mendojmë se shkak i vdekjes së shtetasit Ç. G. ka qenë dëmtimi i

*rëndë kafko-trunor, i shoqëruar me kontuzionin hemorragjik të trurit dhe fraktura e bazës së kafkës*¹⁵. Prandaj, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka konsideruar që mjeku ka qënë korrekt në trajtimin e shtetasit, si në momentin e pritjes ashtu edhe të diagnostikimit dhe terapisë së aplikuar. Njëkohësisht, ka konsideruar të drejtë edhe vendimin e transferimit të pacientit në spitalin ushtarak duke marrë në konsideratë dëmtimet e rënda të pacientit dhe kushtet për të trajtuar një rast të tillë në Spitalin e Lushnjës.

Ajo që duhet patur parasysh në këtë rast duhet të jetë dhe një referim i shkurtër mbi lidhjen shkak-pasojë. Në rastin konkret Gjykata duhet të vlerësonte nëse, po të ishte vepruar në kohë nga ana e mjekut, pra të ishin bërë ekzaminimet e tjera të nevojshme për të kuptuar gjëndjen shëndetësore të pacientit, jeta e tij do ishte shpëtuar apo jo. Në fakt mbi lidhjen shkakësore edhe jurisprudenca Italiane bazohet mbi një analizë të kundërt të fakteve për të parë se cili ka qënë faktori determinues, i domosdoshëm dhe i drejtpërdrejtë në ardhjen e pasojës. Nëse pasoja e dëmshme do të kishte ardhur sërish, pavarësisht ndërhyrjes së mjekut atëherë është krejtësisht e qartë që mungon lidhja shkakësore dhe si rezultat mjeku nuk mund të mbajë përgjegjësi penale.

Por, pyetjet që ngrihen në këtë çështje janë: duke patur parasysh traumën që kishte pësuar pacienti, përse mjeku nuk disponoi ekzaminime më të detajuara dhe të domosdoshme për përcaktimin e një diagnoze të saktë në mënyrë që të ishte parandaluar pasoja e dëmshme? Këto ekzaminime mund të kishin bërë që pacienti të dërgohej në një qendër të specializuar para se gjëndja e tij të përkeqësohej aq rëndë. Duhet patur parasysh edhe fakti nëse spitali i Lushnjës i dispononte këto mjete për ekzaminim. Sepse, nëse jo, këtu qëndron edhe një problem tjetër që lidhet me strukturën spitalore. A janë të pajisura me të gjitha mjetet dhe aparaturat e nevojshme për të përcaktuar një diagnozë dhe për të dhënë në kohë ndihmën e shpejtë? Dhe në rast mungesash të aparaturve, të cilat janë të domosdoshme në përcaktimin e diagnozës, kush do të mbajë përgjegjësi?

Në lidhje me dhënien e përgjigjeve ndaj këtyre pyetjeve konsiderohet me rëndësi t'i referohemi një vendimi tjetër të Gjykatës së Lartë, e cila në prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit në lidhje me veprën penale të mjekimit të pakujdesshëm, ndaj një pacienti të aksidentuar me makinë, i cili gjen vdekjen në spital pas dy javësh si rezultat i infeksionit të grumbulluar në mushkëri, me të drejtë arrin në konkluzionin se për të përcaktuar përgjegjësinë penale të mjekut duhet:

1. *“Të thirret grup ekspertësh për të përcaktuar shkakun e vdekjes së viktimës, nëse mund të përcaktohej, në rast të kundërt, shkakun më i afërt i ardhjes së pasojës, dhe nëse nga ana e të pandehurit, në pozicionin e shefit të pavionit kishte veprime të cilat po të kryheshin nga ana e tij do të sillnin shpëtimin e jetës së pacientit.*

2. *Të përcaktohen qartë detyrat e të pandehurit në momentin që merr pozitën e shefit të pavionit.*

¹⁵ Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, Vendim Nr.00-2013-645, datë 20.03.2013.

3. Të përcaktohet nëse kishte përgjegjësi të përzier në ardhjen e pasojës. Kjo e fundit pasi gjatë gjykimit nga i gjykuari është pretenduar vazhdimisht se, nga ana e tij detyra është marrë vetëm pak para ngjarjes, pra nëse kemi të bëjmë me pasojë e cila ka ardhur nga veprimet e drejtpërdrejta të të gjykuarit apo jo”¹⁶.

Në fakt, problemi i pakujdesisë mjekësore lidhet ngushtërisht edhe me përshatshmërinë e qendrave spitalore në mjekimin apo trajtimin e pacientëve, me mungesën e protokolleve dhe udhërrëfyesve të praktikës klinike, apo edhe me mënyrën se si bëhet ekspertiza mjeko-ligjore, e cila shërben si provë në procesin penal. Ku bazohet ajo? A duhet të jenë mjekët e ekspertizës ekspertë të fushës dhe a bëhet autopsia për të përcaktuar më qartë shkaqet e vdekjes? Të gjitha këto së bashku bëjnë që problemi i plagosjes së rëndë apo edhe i vdekjes si rezultat i pakujdesisë mjekësore të jetë një problem shumë kompleks dhe si i tillë duhet parë të gjitha këndvështrimet e mundshme për të bërë zgjedhjen e duhur.

Një problematikë tjetër që është vënë re kohët e fundit është ajo që ka të bëjë me gabimin mjekësor dhe përgjegjësinë penale të mjekut për gabimin mjekësor. Së pari, duhet të përcaktohet se çfarë është gabimi mjekësor, por duhet patur parasysh nëse gabimi mjekësor i atribuohet veprimit të pakujdesshëm të mjekut apo vjen nga vetë natyra e shkencës mjekësore si shkencë jo ekzakte.

Në fakt, nëse i referohemi shteteve europiane gabimi mjekësor përfshihet tek pakujdesia mjekësore dhe veçanërisht tek neglizhenca. Nëse i referohemi jurisprudencës italiane, gabimi në përcaktimin e diagnozës nga ana e mjekut konsiderohet si shkak për përgjegjësi penale, për shkak të mosmarrjes së masave të duhura apo moskryerjen e ekzaminimeve të duhura në përcaktimin e diagnozës¹⁷. Në një çështje të vitit 2016, Gjykata Italiane e Kassacionit ka konsideruar fajtor mjekun, i cili në prezencë të shumë simptomave të një sëmundjeje shumë të njohur, nuk ka arritur të bëjë diagnozën¹⁸. Në të njëjtën mënyrë është është shprehur për rastin kur mjeku nuk disponon kontrolllet apo ekzaminimet e duhura për të përcaktuar diagnozën. Por, njëkohësisht, Gjykata ka përcaktuar që gabimi mjekësor, për t’u konsideruar me rëndësi penale duhet që të jetë një gabim i pafalshëm, pra në këtë

¹⁶ Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, Vendim Nr.00-2012-878, datë 23.01.2013.

¹⁷ Cass. Pen., Sez. IV, 11 maggio 2016, (dep. 6 giugno 2016), n. 23283. *Dir. pen., cont.*, 27 giugno 2016, me koment të C. CUPELLI, *La colpa lieve del medico tra imperizia, imprudenza e negligenza*, in www.penalecontemporaneo.it.; Cass. Pen., Sez. IV, 19 aprile 2013, n. 26966. *C.E.D. Cassazione*, n. 255463; Cass. Pen., Sez. IV, 15 febbraio 2013, n. 18185: “*La responsabilità professionale medica derivante da imperizia, imperizia e negligenza per non aver, i medici, preventivamente disposto ulteriori accertamenti prima dell’esecuzione di una operazione chirurgica, che avrebbe avuto con alta prevedibilità effetti gravemente invalidanti, non è addebitabile ai professionisti se il caso specifico è connotato da palese urgenza e imprevedibile evoluzione delle condizioni della paziente. Ne consegue che, in tale ipotesi, ai medici non è addebitabile neppure l’omessa richiesta di innovazione del consenso alla prosecuzione di detto intervento*”; Cass. Pen., Sez. IV, 4 dicembre 2012 – 7 marzo 2013, n.10615. *Riv. it. med. leg.*, 2013, 3, fq. 1449.

¹⁸ Cass. Pen., Sez. IV, 11 maggio 2016, (dep. 6 giugno 2016), n. 23283. *Dir. pen. cont.*

rast mjekut duhet t'i mjaftojnë njohuritë dhe aftësitë e një mjeku të zakonshëm për të përcaktuar diagnozën.

Por është i vërtetë edhe fakti që gabimi mjekësor jo gjithmonë çon në përgjegjësi penale të mjekut, edhe në këto rast është e nevojshme ekspertiza mjekoligjore, veçanërisht kur ka kontradikta në vetë teoritë shkencore.

Pra, në mënyrë që të ketë siguri juridike, duhet patjetër që të përcaktohet koncepti i gabimit mjekësor në mënyrë që të bëhet dallimi me pakujdesinë mjekësore. Një gjë është e sigurt që mjeku të përjashtohet nga përgjegjësia penale për shkak të gabimit mjekësor duhet që ky i fundit të mos ketë qenë i parashikueshëm, pra në situatën në të cilën ndodhej mjeku nuk ka patur mundësi ta parashikonte, pasi ndryshe nëse ka patur mundësi ta parashikonte dhe ta evitonte dhe njëkohëshit nuk ka respektuar rregullat mjekësore të cilat do të kishin bërë që gabimi të evitohet, do të jemi brenda kufijve të pakujdesisë, në formën e neglizhencës, që do të thotë që mjeku duhet të jetë përgjegjës për pasojat e dëmshme që kanë ardhur si rezultat i veprimit apo mosveprimit të tij.

Nga ana tjetër, qëndron edhe një problem që lidhet me strandardet mjekësore¹⁹ që duhet të përdorë mjeku në punën e tij në mënyrë që të përjashtohet nga përgjegjësia penale. Aktualisht Ministria e Shëndetësisë ka miratuar disa protokolle mjekësore që i referohen trajtimeve të ndryshme mjekësore, të miratuara me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë në 2014, por që edhe ato nuk janë shumë të detajuara. Këto protokolle duhet të bazohen në literaturën shkencore bashkëkohore dhe kanë për qëllim parandalimin e rreziqeve që mund të vijnë si rezultat i trajtimit mjekësor, por pavarësisht kësaj nuk ka garanci 100 %, duke konsideruar edhe faktin që shkenca mjekësore nuk është një shkencë ekzakte, është një shkencë në zhvillim e sipër dhe vazhdimisht ka zbulime të reja shkencore të cilat shpesh herë janë të kundërshtim edhe më praktikat mjekësore të zbatuara deri në atë moment.

Por, nëse hedhim një vështrim në shtetet e tjera Europiane, ato parashikojnë protokolle dhe udhërrëfyes të praktikës klinike, që përmbajnë rregullat që duhet të respektojë mjeku në të gjitha situatat, të mbrojtura me ligj dhe kjo përbën një siguri juridike dhe shkencore edhe për mjekun, në mënyrë që ky i fundit të jetë i sigurt në veprimtarinë e tij. Por duke konsideruar faktin që protokollat janë të nxjerra me akte nënligjore, atyre shpesh nuk iu referohet gjykata apo ekspertiza mjeko-ligjore. Një nga rastet në të cilat gjykata iu është referuar protokolleve mjekësore është një vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 00-2012-1406, datë 19.09.2012, ku ka argumentuar se ekspertiza mjeko-ligjore nuk kishte përcaktuar me qartësi se cili mjek, ortopedi apo gjinekologu kishte detyrimin për të ndjekur protokollin e mjekimit me antikoagulantë²⁰.

¹⁹ Neni 27 i *Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore*, miratuar nga Këshilli Kombëtar me vendimin Nr. 9 datë: 11/11/2011.

²⁰ Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, Vendim Nr.00-2012-1406, datë 19.09.2012

Është për t'u vlerësuar në këtë kuadër, vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë në 2016, e cila i është referuar protokolleve mjekësore, duke e konsideruar trajtimin në spitalin Gjerman me bikarbonat sodiumi, të bërë nga dy mjekë italianë ndaj një shtetasi italian që vuante nga një tumor malinj, si jashtë protokolleve bashkëkohore. Gjykata në rastin konkret ka evidentuar elementë të neglizhencës mjekësore që kanë sjellë rëndimin e gjendjes shëndetësore dhe përshpejtimin e ardhjes së vdekjes dhe sipas ekspertizës mjeko ligjore “*Trajtimi i tumorit-oligodentroglioma e gradës së dytë nuk është bërë në mënyrë të saktë shkencore sipas protokolleve bashkëkohore*²¹”

Në shtetet që parashikojnë rregulla dhe standarte mjekësore, mjeku i cili vepron duke respektuar këto linja udhëzuese apo protokolle, përjashtohet nga përgjegjësia penale, përveç rasteve kur ka pakujdesi të rëndë dhe kur situata mjekësore e pacientit nuk kërkon një veprim ndryshe nga ai i parashikuar nga protokollat mjekësore. Ashtu siç u përmend edhe më sipër, shkenca mjekësore nuk është një shkencë ekzakte dhe pasoja e dëmshme, si dëmtimi i shëndetit të pacientit apo edhe vdekja mund të vijnë si rezultat i shumë faktorëve të cilët nuk lidhen drejtpërdrejt me veprimin apo mosveprimin e mjekut.

Një problem tjetër qëndron edhe tek konsenti i informuar apo i quajtur ndryshe pëlqimi pas informimit, sipas të cilit pacienti duhet të informohet më parë për diagnozën, ndërhyrjet apo trajtimet mjekësore, të cilave duhet t’iu nënshtrohet, rreziqet që vijnë si rezultat i tyre, si dhe trajtimet alternative. Jo vetëm, por informacioni duhet t’i referohet edhe kushteve të qendrës spitalore apo mosfunksionimit të aparaturave. Në këtë mënyrë pacienti informohet mbi rreziqet e trajtimit mjekësor, para se t’i nënshtrohet trajtimit mjekësor. Por të drejtës për pëlqimin e informuar nuk i jepet rëndësi as nga pacienti dhe as nga gjykatat. Të vetmet dokumente që e parashikojnë këtë të drejtë janë *Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore* dhe *Karta e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Pacientit*, të cilët janë të miratuara me akte nënligjore.

4. Legjislacioni i disa prej shteteve europiane mbi mjekimin e pakujdesshëm

Në Kodin Penal Italian deri në mars të 2017, nuk parashikohej ndonjë dispozitë ligjore e veçantë që t’i referohej mjekimit të pakujdesshëm, por gjykata në rastet kur vërtetohej faji i mjekut dhe mbi bazën e pasojës së dëmshme të shkaktuar, i referohej neneve që parashikonin plagosjen nga pakujdesia (neni 589 të Kodit Penal Italian) ose vrasjen nga pakujdesia (neni 590 Kodi Penal Italian). Mungesa e kësaj dispozite ka bërë që jurisprudenca e këtij shteti, veçanërisht ajo e Gjykatës së Kasacionit të jetë kontradiktore, duke arritur deri në atë pikë sa trajtimi mjekësor pa pëlqimin e pacientit, prej të cilit kishte ardhur vdekja, të konsiderohej si plagosje e rëndë me dashje me pasojë vdekjen (*omicidio preterintenzionale*) mbi bazën e nenit

²¹ Gjykata e Apelit Tiranë, Vendim Nr. 975, datë 15.07.2016.

584 KPI, pa marrë parasysh faktin që veprimi i mjekut nuk mund të krahasohet me veprimin e një kriminelit që ka për qëllim të dëmtojë rendë shëndetin e viktimës.

Përsa i përket pakujdesisë mjekësore, një pjesë autoritative e doktrinës kriminale argumenton se për të konsideruar një subjekt përgjegjës për një vepër penale me pakujdesi, dhe veçanërisht kur bëhet fjalë për mjekun, nuk mjafton lidhja e thjeshtë shkak-pasojë midis veprimit apo mosveprimit dhe pasojës së dëmshme, megjithëse pasoja mund të jetë e parashikueshme dhe e evitueshme, por është e domosdoshme që pasoja e dëmshme të ketë ardhur si rezultat i mosrespektimit të një rregulli të shkruar ose jo, që ka qëllimin kryesor shmangien e asaj pasoje të dëmshme²².

Mbi bazën e këtyre konsideratave, studiuesit më të vëmendshëm vërejnë se faji mjekësor karakterizohet nga mosrespektimi i rregullave të sjelljes që synojnë parandalimin e rrezikut dhe nga parashikueshmëria dhe mundësia e shmangies së ngjarjes së dëmshme²³. Rregullat e lartpërmendura të sjelljes, nëse respektohen, kanë qëllimin parësor parandalimin e rrezikut të dëmtimit të jetës apo shëndetit të pacientit²⁴.

Është e rëndësishme t'i hedhim një sy ndryshimeve të fundit në Kodin Penal Italian, si rezultat i ligjit nr. 24, datë 8 mars 2017 “*Dispozitat mbi sigurinë e kujdesit dhe personit të asistuar, si dhe mbi përgjegjësinë profesionale të personelit mjekësor*”, të miratuar nga Parlamenti Italian, i cili parashikon pikërisht një dispozitë të veçantë *Plagosjen ose vrasjen me pakujdesi* të realizuar nga mjeku apo personeli mjekësor ndihmës.

Përgjegjësia penale e mjekut konkretisht trajtohet në nenin 6 të këtij ligji, ku parashikohet një nen i ri në Kodin Penal Italian, neni 590-*sexies*, *Përgjegjësia për vdekjen ose plagosjen në sektorin e kujdesit shëndetësor*: “*Nëse pasojat e parashikuara në nenet 589 dhe 590 janë kryer në ushtrimin e profesionit të mjekësor, atëherë sanksionet e parashikuara në të do të zbatohen, përveç rasteve të parashikuara në paragrafin e dytë. Nëse ngjarja ka ndodhur për shkak të papërsosmërisë, ndëshkimi përjashtohet kur mjeku ka ndjekur rekomandimet e përcaktuara në udhëzimet sipas përcaktimeve të ligjit ose, në mungesë të kësaj, praktikat e mira klinike-mjekësore, me kusht që rekomandimet e paraqitura në udhëzimet e lartpërmendura të jenë të përshtatshme me specifikat e rastit të pacientit*”²⁵.

²² A. PAGLIARO, *Principi di diritto penale*, Giuffrè, Milano, 1980, I, fq. 306.; G. FIANDACA, E. MUSCO, *Un'introduzione al fatto di reato*, Catania, 1982, fq. 109.

²³ G. FORTI, *Colpa ed evento nel diritto penale*, Milano, 1990.

²⁴ C. CORATELLA, *Responsabilità, vep. e cit.*, fq. 59.; G. LATTANZI, E. LUPO, *Codice penale. Rassegna di giurisprudenza e di dottrina*, Volume II, Libro I, artt. 39-84, Giuffrè Editore, Milano, 2015, fq. 267.

²⁵ Ligji i Parlamentit Italian, nr. 24, datë 8 mars 2017 “*Dispozitat mbi sigurinë e kujdesit dhe personit të asistuar, si dhe mbi përgjegjësinë profesionale të personelit mjekësor*”.

Nëse i referohemi Kodit Penal Francez, ai e konsideron veprimin apo mosveprimin e pakujdesshëm të mjekut delikt, duke përcaktuar përgjegjësinë penale të mjekut në rastet e pakujdesisë, neglizhencës apo deshtimit në respektimin e detyrimit për kujdesin e duhur ndaj pacientit, apo deshtimin në marrjen e masave paraprake, të vendosura nga statutet apo rregulloret. Sipas përcaktimeve të kodit penal konsiderohet se mjeku ka dështuar në kujdesin e duhur ndaj pacientit, duke marrë parasysh natyrën dhe rolin e funksioneve të tij, kapacitetin, kompetencat dhe mjetet që ka në dispozicion²⁶. Në rastin e pakujdesisë, mjeku i cili shkakton vdekjen e pacientit mund të akuzohet për *homicide involontare*²⁷.

Po ashtu edhe në Angli, pavarësisht se numri i çështjeve penale është më i ulët në krahasim me Francën dhe Italinë. Çështja konsiderohet si penale kur vihet re pakujdesia e rëndë "*Gross negligence*" e cila është e lidhur ngushtërisht me shkëlqjen e detyrimit të kujdesit ndaj pacientit, duke mos respektuar rregullat dhe standardet e kujdesit shëndetësor²⁸. Doktrina angleze është munduar të ndajë midis shumë llojeve të gabimeve mjekësore: *gabimet* (gabime në planifikimin e veprimeve të ndryshme), gabime që lidhen me dështimin për shkak të mungesës së përqendrimit, *gabime teknike* dhe *shkelje* apo shmangie nga rregullat dhe praktikat mjekësore të sigurta²⁹.

5. PËRFUNDIME

Mjekimi i pakujdesshëm vë në rrezik shëndetin dhe jetën e njeriut, dy të drejta themelore të cilat duhet të gjejnë garanci të plotë edhe në kodin penal, por duhet patur kujdes në përcaktimin e kritereve që merren për bazë në identifikimin e përgjegjësive penale të mjekut, detyrave që ka, funksioneve që ushtron dhe mjeteve që ka në dispozicion.

Nga ana tjetër duhet të konsiderohet edhe dëmshpërblimi civil që duhet t'i garantohet pacientit të dëmtuar. Në pjesën më të madhe të vendeve të botës ekziston një sistem sigurimesh i qendrave spitalore dhe i mjekëve të cilët dëmshpërblejnë pacientin në rastin e dëmtimeve të shëndetit që ai mund të ketë marrë, gjë që në Shqipëri nuk ndodh.

Në kryerjen e aktiviteteve të rrezikshme, por të domosdoshme por të dobishme

²⁶ 121-3, *Code Pénal Français*, Modifié par Loi n°2000-647 du 10 juillet 2000 - art. 1 JORF 11 juillet 2000.

²⁷ 221-6, *Code Pénal Français*: «*Le fait de causer, dans les conditions et selon les distinctions prévues à l'article 121-3, par maladresse, imprudence, inattention, négligence ou manquement à une obligation de sécurité ou de prudence imposée par la loi ou le règlement, la mort d'autrui constitue un homicide involontaire puni de trois ans d'emprisonnement et de 45000 euros d'amende.*»

²⁸ *R v Adomako* [1995] 1 AC 171.

²⁹ RE Ferner, SE McDowell, *Doctor charged with manslaughter in the course of medical practice, 1795-2005: a literature review*. JR Soc Med 2006; 99: 309-14.

nga ana shoqërore³⁰ ashtu si veprimtaria mjekësore-kirurgjikale, mjeku përgjigjet vetëm për ato dëmtime që mund të parashikohen dhe shmangen duke respektuar rregullat mjekësore, por jo pasojat e dëmshme që mund të vijnë pavarësisht respektimit të rregullave të shkencës mjekësore³¹.

Një nga sugjerimet e mundshme do ishte ai i qartësimit të nenit 96 të kodit penal që parashikon mjekimin e pakujdesshëm, në mënyrë që të mos ngelet në dorë të gjykatës apo prokurorisë interpretimi i tij, gjë që shpesh çon në mungesën e një orientimi të përbashkët në jurisprudencë apo edhe në arbitrarizime.

Por, gjithsesi, kjo zgjedhje e vetme sërish nuk do të funksiononte pa krijuar së pari standarde mjekësore të bazuara në shkencën bashkëkohore, si protokolle apo udhërrëfyes të praktikës klinike që janë të detyrueshme për mjekun, të cilat funksionojnë në shumë vende të botës dhe shërbejnë si pikë referimi për mjekun, në mënyrë që ky i fundit të gabojë sa më pak. Por, nga ana tjetër, duhet të përcaktohet edhe përgjegjësia e qendrës spitalore, përgjegjësi civile natyrisht, në mënyrë që pacientit që i është dëmtuar shëndeti apo jeta, t'i jepet dëmshpërblimi i duhur për dëmin e vuajtur, pavarësisht se ky i fundit ka ardhur nga një gabim apo pakujdesi e mjekut apo e personelit mjekësor ndihmës.

6. BIBLIOGRAFI

1. CASTRONOVO, *La colpa "penale". Misura soggettiva e colpa grave*. AA.VV., *Reato colposo e modelli di responsabilità – le forme attuali di un paradigma classico*, a cura di DONINI, ORLANDI, BUP, Bologna, 2013, fq. 183.
2. CASTRONOVO, *La colpa penale*, Milano, 2009.
3. CORATELLA C., *Responsabilità penale del medico (supplemento di diritto e giustizia)*, Giuffrè Editore, Milano, 2006.
4. CUPELLI C., *La colpa lieve del medico tra imperizia, imprudenza e negligenza*. (www.penalecontemporaneo.it)
5. CUPELLI C., *Responsabilità colposa e accanimento terapeutico consentito*. *Cass. pen.*, 2011, 3, fq. 2947.
6. DI LANDRO R., *Dalle linee guida e dai protocolli all'individuazione della colpa penale nel settore sanitario*, Giappichelli Editore, Torino, 2012.
7. ELEZI I., *E drejta penale. Pjesa e posaçme*, Tiranë, 2014.
8. FERRARI S., *Sulla valutazione della responsabilità medica per colpa*. *Giur. it.*, 2004, fq.1492.
9. FERNER RE, MCDOWELL SE, *Doctor charged with manslaughter in the course of medical practice, 1795-2005: a literature review*. *JR Soc Med* 2006; 99: 309-14.

³⁰ G. MACCARI, *Interferenze tra causalità materiale e causalità della colpa nella diagnostica medica*. *Cass. pen.*, 2011, fq. 2578.

³¹ S. FERRARI, *Sulla valutazione della responsabilità medica per colpa*. *Giur. it.*, 2004, fq.1492.

10. FIANDACA G., MUSCO E., *Un introduzione al fatto di reato*, Catania, 1982.
11. FORTI G., *Colpa ed evento nel diritto penale*, Milano, 1990.
12. GRIBAUDI M. N., *Consenso e dissenso informati nella prestazione medica*, Giuffrè Editore, Milano, 2012.
13. LATTANZI G., LUPO E., *Codice penale. Rassegna di giurisprudenza e di dottrina*, Volume II, Libro I, artt. 39-84, Giuffrè Editore, Milano, 2015, fq. 267.
14. MACCARI G., *Interferenze tra causalità materiale e causalità della colpa nella diagnostica medica*. *Cass. pen.*, 2011, fq. 2578.
15. PAGLIARO A., *Principi di diritto penale*, Giuffrè, Milano, 1980, I.
16. PRINCIGALLI A., *La responsabilità del medico*, Napoli, 1983.
17. STORTONI L., *La categoria della colpa tra oggettivismo e soggettivismo (che ne è della colpa penale)*. *Ind. pen.*, 2016, fq. 17.
18. Ligji i Parlamentit Italian, nr. 24, datë 8 mars 2017 “*Dispozitat mbi sigurinë e kujdesit dhe personit të asistuar, si dhe mbi përgjegjësinë profesionale të personelit mjekësor.*”
19. *Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore*, miratuar nga Këshilli Kombëtar me Vendimin Nr. 9 datë: 11/11/2011.
20. *Code Pénal Français*, Modifié par Loi n°2000-647 du 10 juillet 2000 - art. 1 JORF 11 juillet 2000.

JURISPRUDENCË

1. Gjykata e Apelit Tiranë, Vendim Nr. 975, datë 15.07.2016.
2. Cass. Pen., Sez. IV, 11 maggio 2016, (dep. 6 giugno 2016), n. 23283. *Dir. pen., cont.*, 27 giugno 2016, con nota di C. CUPELLI, *La colpa lieve del medico tra imperizia, imprudenza e negligenza* (www.penalecontemporaneo.it).
3. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, Nr.00-2014-1100, 25.02.2014.
4. Cass. Pen., Sez. IV, 19 aprile 2013, n. 26966. *C.E.D. Cassazione*, n. 255463.
5. Cass. Pen., Sez. IV, 15 febbraio 2013, n. 18185.
6. Cass. Pen., Sez. IV, 4 dicembre 2012 – 7 marzo 2013, n. 10615. *Riv. it. med. leg.*, 2013, 3, fq. 1449.
7. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, Vendim Nr.00-2013-645, datë 20.03.2013.
8. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, Vendim Nr.00-2012-878, datë 23.01.2013.
9. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, Vendim Nr.00-2012-1406, datë 19.09.2012.
10. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, Vendim Nr. 540, datë 22.11.2011.
11. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Vendimi Nr.947, datë 22.06.2009.
12. Cass. Pen., Sez. IV, 2 ottobre 2003, n. 37473. *CED Cassazione*, 2003, n. 225958.
13. Cass. Pen., Sez. IV, 28 settembre 2000, n. 1688, (Baltrocchi). *Riv. it. med. leg.*, 4-5, 2001, fq. 805.
14. Cass. Pen., Sez. IV, 21 novembre 1996, n. 2139, Spina. *CED Cassazione*, n. 207873.
15. *R v Adomako* [1995] 1 AC 171.

MASHTRIMET NË SIGURIME

Dr. Juliana BYLYKBASHI
julibylykbashi74@gmail.com

Prof. Asoc. Dr. Eneida SEMA
eneidasema@yahoo.com

ABSTRAKT

Arsyet e ndodhjes së mashtrimeve në sigurime janë të ndryshme, por kryesorja është përfitimi financiar. Mashtrimi në sigurime përbën një figurë kriminale komplekse dhe delikate sepse nënkupton një numër të madh të fakteve që paraqesin ndërmjet tyre një ndryshim të theksuar. Esenciale në këtë figurë krimi, duke iu referuar si legjislacionit shqiptar edhe atij të huaj është *gënjeshtria dhe shpërdorimi i besimit*, me anë të së cilës personi shtyhet të kryejë një veprim negativ, që sjell si pasojë një pakësim të pasurisë së tij. Në këtë punim në pjesën e parë të tij do të trajtojmë këtë figurë krimi me elementët përbërës të saj, mënyrat e kryerjes së mashtrimit nga ana e individëve, sikurse edhe subjekteve. Të gjitha ata që kryejnë këtë vepër penale mendojnë se mashtrimi në sigurime është një veprim, i cili siguron të ardhura të larta financiare në një mënyrë jo të vështirë dhe me rrezikshmëri të ulët. Arsye tjetër që shumë persona kryejnë këtë vepër penale është edhe prioriteti i ulët që i japin institucionet shtetërore luftës kundër këtij krimi. Një arsye më shumë është edhe nënvlerësimi që konsumatorët i bëjnë kësaj vepre penale, duke menduar se mashtrimi në sigurime justifikohet nga kushtet shoqërore. Kjo neglizhencë, si e autoriteteve ashtu edhe vetë konsumatorëve, bëjnë që ata që konsumojnë këtë vepër penale, të gjejnë një terren më të përshtatshëm në kryerjen e kësaj vepre. Në sigurimin privat, lufta kundër dëmeve mashtruese është shndërruar në objektivin kryesor të administrimit të dëmeve nga shoqëritë siguruese.

Fjalë kyçe: përfitim financiar, dëme, shpërdorim besimi, neglizhencë.

ABSTRACT

The reasons for the insurance fraud are different, but the foremost is financial gain. Fraud in insurance constitutes a complex and delicate criminal figure, because it implies a large number of facts that present a significant change among them. Essential in this crime figure, referring both to Albanian and foreign legislation, is the lie and abuse of trust by which the person perform a negative act, resulting in a diminution of his health. In this paper in its first part we will treat this crime figure with its constituent elements, the ways of doing fraud by individuals, as well as subjects. Those who commit this criminal act believe that fraud in insurance is an

action that provides high financial income in an inexpensive and low-risk manner. Another reason many people commit this crime is the low priority given by state institutions to the fight against this crime. Another reason is the underestimation that consumers commit this criminal offense, thinking that insurance fraud is justified by social conditions. This negligence, both of the authorities and the consumers themselves, makes those who commit this criminal offense find a more appropriate ground in committing this offense. In private insurance, the fight against fraudulent damages has become the main objective of managing damages from insurance companies.

Key words: financial gain, damage, abuse of trust, negligence.

HYRJE

Pothuajse të gjithë jemi njohur me mashtrimet në sigurime. Shpesh kemi dëgjuar për historitë e njerëzve të cilët kanë marrë miliona pas një aksidenti me makinë apo për kompanitë famëkeqe të sigurimit, të cilat kanë refuzuar për të paguar edhe pas vërtetimit të ngjarjeve. Mashtrimi në sigurime është një nga llojet më të vjetra të mashtrimeve, që daton që prej shek 300 p.k, dhe zanafillën e saj e ka që në kohën e antikitetit, kur një tregtar grek fundosi qëllimisht anijen e tij, në një përpjekje për të marrë të hollat e sigurimit. Sigurimet luajnë një rol të rëndësishëm në jetën dhe ekonominë e qytetarëve, si individë dhe si shoqëri. Rëndësia e tyre është e pakontestueshme për të mirën e qytetarëve sidomos tani kur jemi duke jetuar në një botë shumë dinamike, ku puna dhe aktivitetet e përditshme jetësore kanë filluar të bartin me vete rreziqe të ndryshme. Për këtë arsye shumica e qytetarëve sot, lidhin kontrata me shoqëri sigurimi për ta bërë jetën e tyre më të sigurt nga çdo rrezik që i kanoset. Një problem që është mjaft prezent edhe në ditët e sotme ka të bëjë me mashtrimin në sigurime. Ky fenomen nuk ndodh vetëm nga ana e shoqërive të sigurimit, por edhe nga vetë individët të cilët nëpërmjet falsifikimit të dokumenteve, dhënien e informacioneve të rreme, fshehjen e fakteve të vërteta mashtrojnë në mënyrë të padrejtë shoqëritë e sigurimit për të përfituar për vete ose për persona të tjerë, në mënyrë të kundraligjshme, duke u shkaktuar shoqërive të sigurimit një dëm në pasurinë e tyre. Sigurimi bazohet në parimin e përfitimit reciprok dhe është i dizenuar për të mbrojtur nga humbjet e rënda financiare, por të pasigurta. Mashtrimet në sigurime e dëmtojnë këtë sistem, pasi aplikimet dhe pretendimet mashtruese prekin fondet e paguara nga shumë të siguruar të ndershëm për të mbuluar humbjet e vërteta. Mashtrimi ka ndikim jo vetëm tek siguruesit, por edhe ndaj policmbajtësve. Ajo gjithashtu ka një ndikim në shoqërinë në përgjithësi, sepse mashtrimet e sigurimeve mund të përdoren për të financuar veprimtarinë kriminale. Pjesa më e madhe e konsumatorëve në sigurime përfundojnë duke paguar për pandershmërinë e të paktëve, nëpërmjet primeve më të larta të sigurimit. Kjo është arsyeja pse industria e sigurimit është e vendosur të bëjë gjithçka që mundet për të reduktuar problemin.

1. Koncepti i mashtrimit në sigurime

Mashtrimi është pothuajse po aq i vjetër sa dhe vetë historia e sigurimeve. Në të shkuarën pa dyshim që ka ekzistuar një numër mashtrimesh i paidentifikuar, por zhdukja e tyre nuk përbënte prioritet të lartë. Biznesi i sigurimeve dhe jo vetëm, është tepër i ndjeshëm ndaj mashtrimeve. Sigurimet janë një sistem i shpërndarjes të rrezikut që kërkon akumulimin e aseteve likuide (primeve) në formën e fondeve rezervë, për të përballuar (paguar) pretendimet për humbje (dëmet). Kompanitë e sigurimeve gjenerojnë flukse të qëndrueshme të parasë përmes primeve të sigurimit. Ky fluks i qëndrueshëm është një burim i rëndësishëm ekonomik. Akumulime të mëdha të aktiveve likuide i bëjnë kompanitë e sigurimeve tërheqëse për të marrë përsipër risqe dhe plane të ndryshme sigurimesh. Kompanitë e sigurimeve janë nën presionin e maksimizimit të kthimit mbi investimin e fondeve rezervë. Lufta kundër dëmeve mashtruese është shndërruar në objektivin kryesor të administrimit të dëmeve.

Mashtrimi në sigurime ekziston kur individët përpiqen të përfitojnë duke mos përmbushur kushtet e marrëveshjes së sigurimit. Mashtrimi ndikon në çdo lloj sigurimi, pavarësisht nëse është sigurimi i jojetës, sigurimi i jetës dhe mbrojtjes, ose sigurim shëndetësor. Ai përfshin: dhënien e informacionit të pavërtetë ose jo të plotë, në aplikimet për sigurim, ose përgjigjet në formularin e propozimit të sigurimit; paraqitjen e një kërkesë për dëmshpërblim bazuar në rrethana mashtruese ose jo të vërteta, duke përfshirë ekzagjerimin e një pretendimi të vërtetë; dhe duke qenë rrethana mashtruese ose të pavërteta në marrëdhëniet me një sigurues, me qëllim të fitimit të një përfitimi sipas kontratës së sigurimit. Mashtrimi mund të ndodhë në çdo fazë të një veprimtarie sigurimi, por kryesisht me secilën nga këto raste: a) Individët që aplikojnë për sigurim; b) Mbajtësit e policave; c) Paraqitësit e palëve të treta; d) Profesionistët që ofrojnë shërbime për aplikuesit e kërkesave.

Parashikimi i figurës së mashtrimit në përgjithësi, si vepër penale me rrezikshmëri shoqërore, në kohë ka pasur veçori të ndryshme. Nëse i referohemi Kodit Penal¹ për figurën e mashtrimit konsiston në marrjen ose hedhjen në dorë me anë të gënjeshtërs apo shpërdorimit të besimit, pasurinë apo të drejtat pasurore të personit fizik, juridik apo shtetit, të kryera me dashje dhe me qëllim të përfitimit material për vete ose për të tjerë. Siç e vëmë re, në këtë Kod vihet në plan të parë objekti konkret ku drejtohet vepra penale duke i kushtuar rëndësi mënyrës dhe vendit të kryerjes së veprës penale, veçojmë këtu mashtrimet në subvencione, në sigurime, në kredi. Pra, janë subvencionet, sigurimet dhe kreditë që në kushtet e reja social - ekonomike mund të jenë objekt i veprës penale të mashtrimit dhe që Kodi Penal i

¹ Me ligjin nr. 7895 datë 27/01/1995 u miratua Kodi Penal, i cili hyri në fuqi më 1 Qershor 1995. Kodi Penal parashikon me hollësi llojet e ndryshme të mashtrimeve kundër personit fizik, personit juridik apo shtetit. Këto parashikohen në Kreun III të K.P. që sanksionojnë veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike. Parashikohen nëni 144 Mashtrime në subvencione, nëni 145 ku parashikohet Mashtrimi në sigurime, nëni 146 ku parashikohet Mashtrimi në kredi, nëni 147 ku parashikohet Mashtrimi për veprat e artit dhe të kulturës.

ka specifikuar në dispozita më vete. Një kuptim të përafërt për krimin e mashtrimit kanë dhënë edhe legjislacione të tjera si: Kodi Penal italian në nenin 640², Kodi Penal zvicerian³. Një analizë të hollësishme për krimin e mashtrimit në sigurime ka bërë edhe Federata Europiane e Sigurimit dhe Risigurimit (CEA). Sipas saj mashtrimi në sigurime konsiston në pretendimet e palëve për kompensim apo marrjen e kompensimit nëpërmjet mashtrimit. CEA për ta bërë më të qartë krimin në fushën e sigurimeve ka sjellë si shembuj disa kategori krimesh:

- Në kompani të ndryshme kërkohen shumë sigurime mbi të njëjtin objekt, me qëllim për të kërkuar disa kompensime për një dhe të njëjtin dëm.
- Mbisigurimi, në ato raste kur shumica e sigurimit është më e madhe se vlera e vërtetë e pronës.
- Mbajtja e informacionit për disa arsye, me qëllim për të paguar një prim më të ulët sigurimi.
- Lidhja e një marrëveshjeje sigurimi, pasi ka ndodhur dëmi.
- Dëmi i rremë, në ato raste kur kërkohet kompensim për një dëm që nuk ka ndodhur.
- Shkaktimi i dëmeve me dashje.
- Mbivlerësimi i dëmeve të pasurisë.

Sipas CEA-s në thelb të këtij mashtrimi është marrja e një kompensimi nën pretendime të pavërteta, duke e orientuar gabim siguruesin, duke përfshirë vijueshmërinë e ngjarjes dhe sasinë e kompesimit, ndërmjet të tjerave: Ekzagjerimin e madhësisë së dëmit nga pala e dëmtuar dhe riparimin e tij; Prezumimi i faturave false për riparimin dhe shkëmbimin e pjesëve; Sigurimi i shumëfishtë i së njëjtës pronë dhe paraqitjen më vonë të kërkesës për sigurim në shumë kompani sigurimi; Falsifikimi i një vjedhjeje, pasi e ka shitur më parë pronën; Djegia e qëllimshme e pronës së siguruar; Falsifikimi i një aksidenti me makinë shoqëruar me një deklaratë të rreme.⁴

Federata Europiane e Sigurimit dhe Risigurimit për ta bërë më të qartë krimin e mashtrimit në sigurime merr në analizë disa raste specifike. *Rasti i parë* ka të bëjë me falsifikimin e një aksidenti me makinë, ku dëmi i automjetit është bërë nga vetë shoferi, pa prezencën e një automjeti tjetër. Në një rast të tillë ky person bind një person tjetër për të bërë një deklaratë false në lidhje me rrjedhën e ngjarjes. Shembulli klasik i këtij lloji mashtrimi është e ashtuquajtura “prerja e rrugës së dikujt”. Një lloj i tillë mashtrimi ndodh edhe në ato raste kur personi nuk ka një sigurim të plotë të mjetit motorik, kryen një aksident (p.sh. përplas një pemë). Për

²Neni 640 përcakton “me mashtrim kuptohet çdokush që me dredhi ose mashtrim, i siguron vetes ose një tjetri një përfitim të padrejtë në dëm të një personi tjetër dënohet”

³Neni 148 përcakton: Çdokush për të siguruar për vete ose për të tjerë një përfitim të padrejtë, gënjen me dinakëri një person duke paraqitur gjëra false ose duke fshehur gjëra të vërteta ose përfiton me hile nga gabimi në të cilin ka rënë tjetri”.

⁴Shih për më shumë, materialin e Federatës Europiane të Sigurimit dhe Risigurimit

shkak të mungesës së plotë të sigurimit, atij nuk mund t'i llogaritet kompensim. Për këtë arsye ai kërkon një person, në shumicën e rasteve midis miqve dhe familjes, i cili ka një makinë dhe është i lidhur me sigurim për dëmet e shkaktoara palëve të treta. Në një rast të tillë personi i tretë detyrohet të bëjë një deklaratë të rreme, se për shkak të drejtimit të pakujdesshëm të tij, ai i preu rrugën këtij personi, gjë e cila shkaktoi aksidentin. Një lloj tjetër i këtij mashtrimi janë edhe kërkesat e fermerëve se një lope apo kalë janë shkelur në rrugë. Metoda e mashtrimit është e njëjtë. Një formë e fundit e këtij lloj mashtrimi janë edhe të ashtuquajturat “rezervat”, ku dy automjete të përplatura, vendosen pranë njëra-tjetrës, në një zonë të izoluar natën vonë. Pas kësaj policia merr një raport për aksidentin dhe kërkesat e palëve.

Rasti i dytë i shqyrtuar nga Federata Europiane e Sigurimit dhe Risigurimit, ka të bëjë me falsifikimin e vjedhjes së makinës. Në rastin e një mashtrimi të tillë, siguruesi i paguan kompensim palës së dëmtuar në shumën e përcaktuar në kontratën e sigurimit. Ky lloj i kundravajtjes është i bazuar në format e mëposhtme: a) shitja e automjetit tek një palë e tretë dhe raportimin e vjedhjes së automjetit; b) dëmtimi i plotë i automjetit me anë të zjarrit dhe raportimin zyrtar të vjedhjes; c) heqja e shumë elementëve të makinës dhe falsifikimi i vjedhjes së saj, si dhe braktisja në një shtet tjetër. Në një rast të tillë autori i krimit përfiton benefite të dyfishta duke e shitur makinën tek një palë e tretë dhe pastaj duke raportuar vjedhjen dhe në fund pretendimi për kompensim. Ndërmjetësi⁵ merr pjesë gjithashtu në kundravajtje të tilla, duke mbajtur automjetin jashtë vendit. Kryesorja për autorët e krimit është që ta bëjnë të besueshme vjedhjen e raportuar të automjetit dhe të mbrojnë vetveten nga kjo situatë. Autorët e këtij krimi kanë zotëruar metodat e kryerjes së kundravajtjeve të tilla, ku pas sigurimit të plotë të mjetit me sigurim, përpara skadimit të afatit për sigurim, automjeti me çelësat dhe dokumentet i transferohen ndërmjetësit, i cili ilegalisht nxjerr makinën jashtë vendit dhe e braktis atë duke e kthyer në vend automjetin dhe i kthen pronarit librin e regjistrimit, i cili njofton policinë për vjedhjen.

2. Elementët e figurës së veprës penale të mashtrimit në sigurime

Vepra penale e mashtrimit ka si objekt të saj, marrëdhënien juridike të mbrojtjes së pasurisë, nga veprimet ose mosveprimet e kundraligjshme. Në Kodin Penal ajo është e zberthyer në disa figura krimi. Në varësi të elementëve përbërës të saj, do të bëhet edhe kualifikimi në bazë të marrëdhënies juridike të cënuar nga veprimet e kundraligjshme. Mashtrimi në sigurime parashikohet shprehimisht, në

⁵ Ndërmjetësi sipas ligjit nr.52/2014 është personi fizik ose juridik i miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të cilët kryejnë ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime, kryejnë veprimtarinë e prezantimit, propozimit dhe kryerjes së aktiviteteve të tjera përgatitore deri në nënshkrimin e kontratës së sigurimit ose risigurimit, si dhe dhënien e asistencës gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës, veçanërisht në rast dëmi. Autoriteti ndalon ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime dhe e çregjistron atë nga regjistri, nëse kryen mashtrime gjatë ushtrimit të veprimtarisë në fushën e sigurimeve.

mënyrë të drejtpërdrejtë në Kodin Penal në nenin 145.⁶ *Objekt i përgjithshëm i këtij krimi, parashikuar nga Kodi Penal janë marrëdhëniet juridike për të garantuar veprimtarinë e rregullt dhe normale të shtetit shqiptar, si dhe të institucioneve të tjera shtetërore ose private, në fushën e sigurimeve nga çdo lloj cënimi kriminal që i bëhet.* Pra, janë ato marrëdhënie që garantojnë moscënimin e interesave pasurore të të gjithë organizmave shtetërore, private, vendase apo të huaja që kanë aktivitet në fushën e sigurimeve. Pra shtrihet edhe në sigurimin shoqëror apo shëndetësor të detyrueshëm, të cilat menaxhohen nga ente publike si: Instituti i sigurimeve shoqërore dhe Instituti i kujdesit shëndetësor. Në tregun e sigurimeve private ushtrojnë veprimtarinë në sigurime 12 shoqëri sigurimi të licencuara në sigurimin e jetës ose të jojetës.

Objekt material i këtij krimi është ai që është objekt i sigurimit, pra mbi atë gjë, mbi të cilën rreziku mund të ndodhë, objekt fizik, një e drejtë, përgjegjësi mbi të siguruarin si shtëpia, toka, makina, jeta, shëndeti etj. Kështu në ligjin Nr.7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, fondi i pensioneve⁷ gëzon një mbrojtje të posaçme, pasi është parashikuar si figurë më vete në Kodin Penal. Po kështu në ligjin Nr. 52/2014 “Për Veprimtarinë e Sigurimit dhe të Risigurimit” kemi këto grupe kryesore të sigurimeve: a) sigurim i aksidenteve dhe shëndetit; b) sigurimet motorike: mjetet tokësore, mallrat në transport, përgjegjësitë nga përdorimi i automjeteve; c) sigurimi i marinës dhe i transportit; d) sigurimi i avionëve, aksidentet, mallrat në transport, përgjegjësitë civile nga përdorimi i avionëve; e) sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë, në këtë të fundit përfshihen, stuhitë, dëmtimet ose humbja e pasurisë nga breshëri etj; f) sigurimi përgjegjësive; g) sigurimi i kreditit dhe i garancisë, paaftësia paguese e përgjithshme, garancitë, humbjet financiare (nga qiratë, nga ulja e vlerës së tre-gut, etj); h) sigurimi i jetës dhe shëndetit; jeta, vdekja.

Natyrisht që pasuria nuk mund të sigurohet nga çdo lloj rreziku i mundshëm. Çdo institucion sigurimi ka rregullin e vet në të cilin përcaktohet se nga cilat rreziqe e siguron pasurinë. Këtë lloj mashtrimi që është relativisht i ri për legjislacionin tonë e gjejmë edhe në Kodin Penal Italian në nenin 642 i cili parashikon konkretisht se kur jemi përpara këtij krimi. Sipas nenit 642 të K.P italian, ndëshkohet cilido që me qëllim për të marrë për vete ose për të tjerë çmimin e një sigurimi kundër aksidenteve apo fatkeqësive, shkatërron, dëmton, humb ose fsheh sende të veta si

⁶ Neni 145 i Kodit Penal: “Mashtrimi në sigurime” përcakton se: Paraqitja e rrethanave të rreme në lidhje me objektin që sigurohet ose krijimi i rrethanave të rreme dhe paraqitja e tyre në dokumente, duke përfutur padrejtësisht sigurime, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

⁷ Pensionet e pleqërisë organizohen dhe funksionojnë në degën e pensioneve. Pensioni është një shumë e caktuar të ardhurash periodike, të cilat përfitoohen përkundrejt plotësimit të kushteve të përcaktuara në ligjin Nr.7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Në degën e sigurimit të pensioneve përfshihen: a) pensioni i plotë i pleqërisë b) pensioni i pjesshëm i pleqërisë c) pensioni i reduktuar i pleqërisë d) pensioni i plotë i invaliditetit (i përhershëm) e) pensioni i pjesshëm i invaliditetit f) pensionet familjare.

dhe ai, i cili i shkakton vetes një dëmtim trupor ose rëndon pasojat e dëmtimit të ardhur nga aksidenti. Ky krim është parashikuar gjithashtu edhe nga Kodi Penal Polak ne artikullin 298/1. Sipas këtij Kodi, kushdo që në mënyrë për të përfituar kompensim nga një kontratë sigurimi, shkakton një ngjarje të pavërtetë, e cila çon në dhënie kompensimi nga ana e shoqërisë së sigurimit, do të jetë subjekt i ndalimit nga tre në pesë vjet. Sipas kuptimit që i ka dhënë Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, *ana objektive* e këtij krimi kryhet me anë të veprimeve aktive kriminale, *kur plotësohen dy kushte thelbësore për këtë figurë krimi:*

- të ketë ndodhur marrja ose hedhja në dorë e pasurisë së tjetrit;
- ky akt të jetë pasojë e drejtpërdrejtë e gënjeshtërs⁸, apo shpërdorimit të besimit⁹

Ajo që e karakterizon këtë figurë dhe që e dallon nga vjedhja është pëlqimi i dhënë nga viktima (i rrëmbyer kjo me anën e mashtrimit). Ndërsa tek vjedhja, kalimi i pasurisë nga pronari i ligjshëm tek subjekti kriminal realizohet në mungesë dëshire flagrante të pronarit të ligjshëm. Në fakt, termi mashtrim në fund të fundit është i ndjekur nga i njëjti qëllim si dhe vjedhja, e pikërisht shtënia në dorë e pasurisë së tjetrit. Pra, mashtrimi përbën një mënyrë shumë të ndryshme dhe në qoftë se mund të thuhet më të avancuar. Kjo sepse mashtruesi nëpërmjet gënjeshtrove ose shpërdorimit të besimit, arrin që viktima të dëmtohet vetë; kështu dorëzon një send, merr përsipër një detyrim, heq dorë nga një e drejtë që i përket etj, kryen pra, një veprim të dëmshëm për pasurinë e tij, dhe fitimdhënës (prurës) për të tjerët. Për aq sa është thënë, është e kuptueshme që qëllimi i inkriminimit të mashtrimit *nuk është vetëm mbrojtja e pasurisë, por edhe mbrojtja e lirisë së dhënies së pëlqimit a miratimit në transaksionet tregtare*. Pra, mbrojtja e një prej parimeve të së drejtës civile, atë të mirëbesimit që qëndron në themel të kontraktimit. *Ana subjektive* e këtij krimi kryhet vetëm me dashje direkte sepse ai i parashikon pasojat e veprës penale dhe e dëshiron ardhjen e tyre. Gjithashtu ai vepron me qëllimin për të përfituar padrejtësisht sigurime.

Nga ana objektive, ky krim kryhet me anë të veprimeve aktive kriminale që konsistojnë në: *1) paraqitjen e rrethanave të rreme në dokumente, nëpërmjet të cilave autori i veprës penale të mashtrimit realizon sigurimin e objektit konkret, dhe si rrjedhim kërkon të përfitojë padrejtësisht një sigurim që nuk i takon*. Kjo realizohet nëpërmjet ndryshimit të qëllimshëm të cilësisë së objekteve gjithmonë në

⁸ Gënjeshtro është paraqitja e rreme e gjendjes nga subjekti në mënyra të ndryshme dhe për pasojë shtyrjen e të dëmtuarit në gabim për shkak të së cilës ai dorëzon pasurinë ose bën ndonjë veprim me karakter pasuror. Duhet thënë se në çfarëdo forme që të paraqitet gënjeshtro, me gojë, me shkrim, e thjeshtë ose e shoqëruar me fakte të tjera, kur kjo përdoret për të gabuar të dëmtuarin me qëllim që t'i merret pasuria ose të fitohen të drejta mbi pasurinë e tij, duhet konsideruar si element i krimit të mashtrimit.

⁹ Me shpërdorim besimi kuptohet shfrytëzimi nga subjekti i besimit reciprok, që ekziston midis subjektit e të dëmtuarit, me qëllim që të hedhë në dorë pasurinë apo të drejtat pasurore apo kur subjekti duke përfituar nga të drejtat që i janë dhënë lidhur me administrimin e një pasurie me qëllim të nxjerrë përfitime në dëm të shoqërisë a institucionit ku ai punon.

sensin për të rritur vlerën e fitimeve të tij. Nëse do t'i referohemi sigurimit shoqëror të detyrueshëm, numrin më të madh të mashtrimeve në sigurime e zë paraqitja e rrethanave të rreme për përfitimin nga dega e pensionit, por kryesisht përfitime nga pensioni i pleqërisë, p.sh., certifikata është e falsifikuar në rubrikën e datëlindjes dhe vendlindjes. Po kështu përdoret edhe vërtetimi i vjetërsisë në punë, i falsifikuar. Pensioni i pleqërisë në vetvete është një lloj i veçantë i sigurimeve, i administruar nga ente publike si Instituti i Sigurimeve Shoqërore, dega e pensioneve dhe autorët e krimit duke për-

dorur gënjeshtren të pasqyruar në dokumente të falsifikuara, kanë kryer me qëllim, përfitimin ekonomik duke i shkaktuar dëm ekonomik shtetit në shuma të konsiderueshme, nga përfitimi i padrejtë i pensionit urban. Kjo veprë kryhet me dashje direkte, me qëllimin për të përfituar padrejtësisht pension pleqërie.¹⁰ Pensioni i pleqërisë në vetvete është një lloj i veçantë i sigurimeve që rregullohet nga ligji Nr.7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Në këtë rast subjekti i dëmtuar nga veprimet e kundraligjshme është fondi i pensioneve, i cili gëzon një mbrojtje të posaçme, pasi është parashikuar si figurë më vete në Kodin Penal. Pensioni është përfitimi që u jepet personave në bazë të kriterëve të vendosura me ligj të posaçëm. Ky përfitim jepet në bazë të kontributit të përgjithshëm që japin të gjithë subjektet e punësuar dhe që administrohen nga një ent shtetëror, i cili më pas ia përcjell subjektit vendor me qëllim shpërndarjen tek personat që kanë nevojë. Duke paraqitur rrethana të rreme përfitojnë pension të pamerituar.¹¹ Në një rast tjetër, paraqitja e rrethanave të rreme ka shkuar edhe më tej. Mbi bazën e kallëzimit penal të shoqërisë së sigurimit Atlantik sh.a. për veprën penale të “Mashtrimit me pasoja të rënda në bashkëpunim”¹², dy shtetas kanë mashtruar duke fshehur faktin se personi i siguruar X, ka vdekur në dt 03.07.2013 dhe ky fakt, i është fshehur edhe Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Gjykatës së Lartë, Tiranë, të cilat kanë vendosur një shumë të lartë dëmshpërblimi që konsiston në shpenzime mjekimi dhe përkujdesjeje për gjithë jetën.

Raste të tjera të mashtrimit në sigurime kanë të bëjnë me sigurimin privat. Autori i krimit në dt.24.11.2009 ka depozituar kallëzimin e tij penal përpara oficerëve të Policisë sipas të cilit ai pretendon se i ishte vjedhur mjeti i tij motorik, mjet të cilin ai pretendon në kallëzim se e kishte parkuar në afërsi të banesës, ku ai jetonte me qera. Po kështu ka rezultuar gjatë hetimit të kësaj çështje, se pasi ka kallëzuar pranë organeve të policisë mjetin e tij si të vjedhur, ka njoftuar pranë Departamentit të Administrimit të dëmeve të shoqërisë të sigurimeve “Sigma”sh. a., rastin e vjedhjes së mjetit të tij dhe ka kërkuar nga kjo shoqëri trajtimin me

¹⁰ Shih për më shumë Vendimin nr 410 datë 17.03.2015, i Gjykatës së Apelit, Tiranë

¹¹ Shih për më shumë Vendimin nr 905 datë 06.05.2012, i Gjykatës së Apelit, Tiranë

¹² Regjistrimi i procedimit penal nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë dt 07.09.2017. Me qëllim që të vërtetohet kryerja e veprës penale është vendosur sekuestrimi i praktikës pranë shoqërisë përmbartimore.

dëmspërblim. Ka rezultuar se autori me vullnetin e tij ia ka kaluar posedimin e mjetit motorik me anë të një kontrate “premtim shitje” e pa formalizuar (të pas-hkruar) një shtetasi tjetër, pasi kanë rënë dakort për shitjen e këtij automjeti tek ky shtetas. Pra, nuk ka rezultuar që sipas kallëzimit përpara Oficerit të Policisë Gjyqësore, se sendi pronë e tij ishte vjedhur. Për pasojë ky kallëzim ishte i rreme dhe është bërë vetëm për të justifikuar dhe më pas për të përfituar vetëm vlerën e dëmspërblimit nga shoqëria e sigurimit ku sendi ishte i siguruar në sigurimin “kasko”, ç’ka mbulon edhe sigurimin e sendit nga vjedhja.¹³

2) Krijimin e rrethanave të rreme nga subjekti kriminal, pasi ai ka bërë sigurimin e objektit. Kështu subjekti ka respektuar gjithë procedurat për sigurimin e objektit, por pas sigurimit, subjekti kriminal ka trilluar ngjarje të cilat passjellin në mënyrë fiktive, humbjen, dëmtimin ose shkatërrimin e objektit. P.sh., rasti i një të siguruari i cili stimulon vjedhjen e makinës ose të apartamentit të tij. Një rast tjetër i ngjashëm, është ai i një pronari bagëtish që i bënë bagëtisë së tij injeksione me qëllim, për ta bërë të besueshme se kafshët janë prekur nga turberkulozi, në mënyrë që të marrë shpërblimin e parashikuar për këtë rast.

Rast tjetër nga mashtrimi në sigurime ka të bëjë me implikimin në skemën e mashtrimit me siguracionet e automjeteve me targa të huaja.

Kanë qënë pikërisht përfaqësuesit e kompanisë greke, ata që kanë nxjerrë zbuluar pozicionin e dy efektivave të policisë të cilët kishin inskenuar një aksident rrugor, duke tentuar të përfitojnë një shumë financiare prej 32 milionë lekë të vjetra, para këto që do të jepeshin nga kompania greke e siguracionit të makinave. Skema e mashtrimit të tyre ishte duke ecur sipas parashikimeve, pasi ata kishin arritur të “ndërtonin” një aksident rrugor në rrugën Durrës-Kavajë dhe prej këtej kanë përpiluar dokumentacionin lidhur me dëmet e shkaktuara. Sipas dokumentacionit të përpiluar aksidenti kishte ndodhur midis dy mjeteve njëra me targa italiane dhe tjetra me targa greke. Pikërisht nga kjo e fundit është dashur të përfitohet shuma prej 32 milionë lekë të vjetra, nga kompania greke ku ishte prerë siguracioni i makinës. Kompania greke që kishte marrë në dispozicion dokumentacionin nga një emigrant shqiptar, i cili interesohej lidhur me procedurat e ndjekura pranë zyrave të kësaj kompanie, ka bërë verifikimet e nevojshme lidhur me dëmet e aksidentit dhe vendndodhjen e makinës ditën kur ka ndodhur përplasja.

Nga verifikimet e kryera ka rezultuar se pikërisht në ditën kur, dy policët kishin fiksuar në dokumente se kishte ndodhur aksidenti, automjeti në fakt ndodhej në Greqi dhe s’kishte pasur asnjë dëmtim apo aksident të mundshëm. Kaq ka mjaftuar që punonjësit e shoqërisë greke të sigurimit të makinave të bien në gjurmët e të gjithë kësaj skeme mashtrimi, duke denoncuar në policinë greke. Për shkak se të gjitha veprimet kriminale të dy efektivave të policisë ishin kryer në Shqipëri, autoritetet policore greke i kanë referuar dosjen Policisë së Shtetit.¹⁴

¹³ Vendimi Nr.460, dt.23.03.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë

¹⁴ Vendimi nr.222 datë 14.04.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës

Subjekt i këtij krimi mund të jetë çdo person i cili ka mbushur moshën 14-vjeç dhe është i përgjegjshëm. Subjekti është i posaçëm, janë pikërisht të siguarit, që nëpërmjet paraqitjes së rrethanave të rreme përfitojnë padrejtësisht sigurime.

Përsa i përket kësaj vepre penale Kodi Penal nuk përcakton, *nuk jep kriteret sipas të cilave mashtrimi do të quhet i kryer me pasoja të rënda*. Kjo çështje i lihet teorisë dhe praktikës gjyqësore. Një nga kriteret bazë të përcaktimit të pasojës së rëndë, sipas teorisë, është vlera e pasurisë së marrë me anë mashtrimi. Po kështu një kriter tjetër mund të jetë edhe numri i madh i personave të dëmtuar që përbëjnë një pjesë të mirë të popullsisë së një zone, qyteti, rrethi etj. Duhet thënë se dhe përcaktimi se sa duhet të jetë kjo vlerë, ose ky numër personash që të kemi pasojë të rëndë do të përcaktohet nga praktika, ndonëse e vështirë sidomos me vlerën e pasurisë, Kështu që përcaktimi i tyre do të jetë shumë subjektiv.

3. Format të tjera të mashtrimit në sigurime

Legjislacione të ndryshme kanë përcaktuar mashtrimin e rëndë ose i quajtur ndryshe *Hard Fraud*. Konsiderohet si i tillë një aksident i rremë, dëmtime të sajuara ose çdo lloj humbje tjetër për të përfituar dëmshpërblim nga kompania e sigurimit. Këtë lloj forme e gjejmë zakonisht individuale dhe nuk implikon grupe të tjera pjesëmarrëse. Mënyra e dytë konsiderohet mashtrim i butë ose i quajtur ndryshe *Soft Fraud*, implikimi i palëve të treta si; abuzimet me çmimet nga ana e rrjeteve mjekësore konsiderohet si mashtrim.

Forma të mashtrimit në sigurime i gjejmë të ilustruara dhe në *natyrën e palëve pjesëmarrëse* në sistemin e sigurimeve, si; *a) Mashtrimi agent/broker*¹⁵; Llogaritë fiktive ndodhin në rastet kur punonjës të kompanisë së sigurimit pa dijeninë e të siguarit, depozitim të ardhurave nga primi i sigurimit të të siguarit e arkëtojnë në llogarinë e tij bankare apo një llogari fiktive; Pagesa fiktive, agjenti merr pagesën e primit nga i siguruari, por nuk e arkëton në llogari të kompanisë së sigurimit. Në këtë rast i siguruari nuk ka mbulim sigurimi; Kërkesat fiktive (sigurimin e jetës), në rastet kur tërhiqen çertifikata false për të tërhequr shumat e sigurimit.

b) Nga marrësit në sigurim: Shtrembërim i të dhënave dhe informacioni rremë, mund të ndodhë atëherë kur përfaqësues të shitjes bëjnë deklarata të rreme me qëllim tërheqjen e klientëve të ardhshëm. Shtrembërimet konkrete që kanë të bëjnë me informacionin mjekësor dhe datëlindjen për një prim më të ulët, etj. *c) Nga të siguarit*. Mosdeklarimi i saktë i fakteve materiale dhe fshehja e tyre në deklarata dhe pyetësorët e marrjes në sigurim. Dorëzimi i dokumentacionit fals për rimbursim pranë kompanisë së sigurimit; *d) Nga palët e përfshira në proces*. Termi “mashtrimi i bluzave të bardha”. Për herë të parë në kompanitë e sigurimit haset termi i mashtrimit nga ‘bluzat e bardha’. Ky lloj mashtrimi përfshin para-

¹⁵ Janë ndërmjetës, persona fizikë të miratuar nga AMF-ja, në të cilën agjenti vepron në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit dhe brokeri ndërmjetës që vepron në emër dhe për llogari të policmbajtësit.

qitjen e pandershme të dokumenteve mjekësore për qëllime përfitimi. Skemat më të zakonshme të mashtrimit në sigurime përfshijnë marrjen e medikamenteve mjekësore të panevojshme të rimbursueshme ose plotësisht të mbuluara për t'i shitur në tregun e zi për qëllime përfitimi; Faturim për kujdes mjekësor të pakryer; Paraqitja e kërkesave për të njëjtin shërbim të kryer, duke ndryshuar datat, përshkrimin e shërbimeve, apo identitetin e marrësit të shërbimit; Raportim i qëllimshëm i gabuar i diagnozave për të maksimizuar pagesën nga ana e kompanive të sigurimit; Përdorim i stafit të palicencuar; Referim i të dhënave për një anëtar tjetër në vend të të siguruarit.

3.1 Zbritjet nga kartat e sigurimit

Me blerjen e një police sigurimi, kompania e sigurimit pajis të siguruarit me karta individuale ose familjare sigurimi. Avantazhet e kartës së shëndetit lidhen me krijimin e lehtësirave për të siguruarit, pasi bëhet i panevojshëm konfirmimi nga ana e kompanisë së sigurimit sa herë që ky i fundit paraqitet pranë Institucioneve mjekësore për marrjen e shërbimeve. Institucionet bashkëpunuese marrin informacion për kategorinë e personit përfitues duke identifikuar lehtësisht shërbimet e përfituara. Kartat e sigurimit u japin mundësinë e përfitimeve të zbritjeve në çmime për shërbimet mjekësore. Kjo është forma më e hasur e abuzimit të personave të pasiguar. Llojet e mësipërme të mashtrimit rrisin drejtpërdrejt kostot e kompanive të sigurimeve të cilat për rrjedhojë rëndojnë mbi klientët e këtyre të fundit.

4. Mënyrat e zgjidhjes.

Qëndrimi i siguresve kundrejt mashtrimit

Mashtrimi në sigurime shfaqet si nga vetë individët, ashtu edhe nga shoqëritë e sigurimit. Një numër i madh shoqërisht sigurimi mund të mashtrojnë individë të ndryshëm duke u marrë atyre për një kohë të gjatë primin e sigurimit dhe në momentin e vërtetimit të ngjarjes së sigurimit, nëpërmjet manipulimeve të shumta nuk paguajnë shumën e sigurimit, duke shkaktuar në këtë mënyrë një dëm në pasurinë e individëve apo subjekteve. Për të eliminuar sa të jetë e mundur pasojat negative që rrjedhin nga mashtrimi, AMF-ja¹⁶ për mbrojtjen e konsumatorit ka bërë të mundur, që të shmangë një nga mashtrimet më të zakonshme atë të aksidenteve të mjeteve motorrike. Nga momenti i nënshkrimit të kontratës së sigurimit të detyrueshëm motorik, çdo i siguar mund të verifikojë vlefshmërinë e policës së sigurimit në faqen zyrtare të AMF-së.¹⁷ Të siguruarit për të shmangur sa të jetë e mundur mashtrimet, kanë mundësinë të njihen me kushtet e kontratës së sigurimit

¹⁶ Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është institucioni i vetëm kompetent për licencimin e subjekteve në fushën financiare jobankare dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë të tregut të sigurimeve, rregulluar me ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar.

¹⁷ Faqja zyrtare e AMF-së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

të afishuara pranë pikave të shitjes së shoqërive të sigurimit. Gjithashtu pranë AMF-së funksionon njësia për trajtimin e ankesave të të siguruarve. Kjo strukturë do të trajtojë në mënyrë të paanshme, me profesionalizëm dhe brenda afateve të gjitha ankesat që do t'i paraqiten, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi ia kthen për rishqyrtim shoqërisë së sigurimit çështjen e ankimit. Çdo person i dëmtuar i cili pretendon dëmshpërblim nga shoqëritë e sigurimit dhe mbetet i pakënaqur për mënyrën e trajtimit të dëmit, masën e dëmshpërblimit apo refuzimin e saj, pasi ka depozituar një ankesë pranë shoqërisë së sigurimit trajtuese e dëmit, mund të kontaktojë apo të depozitojë një ankesë tek AMF-ja. Kjo është një mënyrë për të shmangur sa të jetë e mundur pasojat që sjell mashtrimi apo shkaqe të tjera ndaj të siguruarve. Gjithashtu siguresi, para nënshkrimit dhe gjatë periudhës në të cilën kontrata është e vlefshme, duke marrë për bazë parimin e mirëbesimit duhet të ndihmojnë konsumatorët për të kuptuar sa më qartë aspektet teknike të mbulimit të sigurimit dhe elementët e tjera të kontratës së sigurimit, nëpërmjet dhënies së informacionit, me gojë dhe me shkrim, duke mos vepruar në mënyrë mashtruese dhe çorientuese.¹⁸ Një detyrim tjetër i shoqërisë së sigurimit, në rastet kur jep informacion promociional rreth saj dhe produkteve të ofruara prej saj, është se ajo nuk duhet të fshehë apo të tregojë në mënyrë mashtruese e çorientuese qëllimin e promociionit dhe të informacionit, duhet të japë një përshkrim të plotë, të saktë, të qartë dhe të vërtetë të produktit të sigurimit, të detyrimeve ligjore, të ardhurat e pritshme, si dhe një përshkrim të rrezikut që rrjedh nga këto produkte, të mbështesë faktet e dhëna me dokumentet origjinale, nuk duhet të deklarojë tregues të rremë apo të pavërtetë për shoqërinë e sigurimit si dhe duhet të garantojë se informacioni është i njëjtë dhe konsekuent për nga pamja, përmbajtja dhe forma.¹⁹ Në rastet kur shoqëritë e sigurimit nuk u përmbahen këtyre detyrimeve taksative dhe mashtrojnë të siguruarin, nëpërmjet dhënies së informacioneve të rreme ose informacioni, i cili është në kundërshtim me faktet e ndodhura para nënshkrimit të kontratës apo gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës dhe ky informacion ndikon në vendimmarrjen e të siguruarit, ky i fundit ka të drejtë të zgjidhë kontratën dhe të kërkojë pagesën e dëmshpërblimit për dëmin e shkaktuar.²⁰

Në këndvështrimin e siguresit, në lidhje me shkaqet që do të verifikohen, siguresit tregojnë një qëndrim të ashpër ndaj mashtrimit dhe nuk ngurojnë të marrin masa ligjore në rastet e duhura. Për këtë siguresit i duhet të njohë tre elementë: a) *Njohja e motivimit të mashtrimeve*; Është bërë një kërkim i gjërë kohët e fundit mbi motivin që i nxit individët për një mashtrim në sigurime. Ky kërkim ka identifikuar një numër pyetjesh të cilat individët sjellin ndërmend para se të marrin përsipër një veprim mashtrues. Nëse individit e ndjen se mundësia e zbulimit është e vogël dhe dënimi do të jetë i lehtë, ata nuk do të kërkojnë ndonjë

¹⁸ Ligji Nr.52/2014, “Për Veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit”, Neni 61/1

¹⁹ Neni 68 i Ligjit “Për Veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit” Nr.52/2014

²⁰ Neni 62 i Ligjit “Për Veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit” Nr.52/2014

shpërblim për ta provuar. Nuk ka ndonjë tregues të vërtetë. përse duhet të jetë kështu. E vërteta është sepse shumë njerëz nuk e konsiderojnë këtë krim serioz. Në fakt shumë individë do të shkonin aq larg sa të bënin ndonjë mashtrim modest sigurimi. Ka prova që sidomos në rast sigurimi udhëtimesh, policia shihet si një investim për ta përdorur “dëmin” si rifitim të një pjese të kostos së pushimeve.

b) *Bashkëpunimi ndërmjet shoqërive të sigurimit për të edukuar publikun.* Përveç argumenteve, pagesa e dëmeve mashtruese për një kohë të gjatë shkakton rritjen e primit për komunitetin e sigurimeve në përgjithësi. Kostoja mbrojtëse për një dëm mashtrues në gjykatë mund të jetë e lartë dhe në të shkuarën, në tregun e sigurimeve kjo ka penguar siguruesit të luftojnë të tilla dëme. Sidoqoftë, ka patur një tendencë në rritje për mospranim dhe vënien në dyshim të dëmeve që besohen se janë mashtruese.

c) *Zhvillimet në teknologji.* Kontrolli nëpërmjet teknologjisë së re në luftën kundër mashtrimin në sigurime përfshin përdorimin e të dhënave mbi dëmet, ku siguruesit mund të ndërmarrin informacion nga një larmi siguruesish të ndryshëm dhe të mundohen që t’i ndalojnë të dëmtuarit e përsëritur duke përputhur detajet e dëmeve të reja me ato që kanë bërë. Zhvillimet teknologjike në lidhje me *ndërtimin e një qendre informacioni racional*²¹ bëjnë të mundur krahasimin e policave me mbajtësit e tyre. Qëllimi është identifikimi i mashtruesit para se ky të jetë në gjendje të mbulojë gjurmët. Ka të dhëna që ky bashkëpunim, me shtimin e përparimeve teknologjike brenda industrisë, nis me filtrimin publik. Ky lloj bashkëpunimi është shumë i mundur të drejtojë zbulimin dhe më të gjerë të mashtrimin dhe përfundimisht, do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë që mashtruesit të perceptojnë mundësitë për t’u ndaluar. Shpresohet shumë dhe madje parashikohet që kjo rritje, e parë në mundësitë e ndalimit, do të sjellë rënien e rasteve të mashtrimin me kalimin e kohës.

KONKLUZIONE

Nga gjithë sa u tha më sipër, dalim në përfundimin se kryesore në këtë figurë krimi, duke iu referuar jo vetëm legjislacionit shqiptar por edhe atij të huaj, është gënjeshtria ose shpërdorimi i besimit, me anë të së cilës personi shtyhet që të kryejë një veprim pozitiv ose negativ, që sjell si pasojë një pakësim të pasurisë së tij dhe njëkohësisht të një përfitimi në favor të mashtruesit apo të një personi tjetër. Mashtrimi në përgjithësi dhe ai në sigurime në veçanti përbëjnë një nga figurat kriminale më komplekse dhe delikate sepse nënkupton një numër të madh të fakteve që paraqesin ndërmjet tyre një ndryshim të theksuar.

²¹ Neni 38, i Ligjit Nr. 10076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e Detyrueshëm në Sektorin e Transportit” ka përcaktuar se për dhënien e statistikave të besueshme, standardizimin e praktikave, shmangien e rasteve të mashtrimin dhe dëmshpërblimin e palës së dëmtuar në kohën dhe në masën e duhur, të krijohet qendra e informacionit të sigurimeve të detyrueshme, e cila krijon një bazë elektronike për ruajtjen e të dhënave të përfuara nga shoqëritë e sigurimeve, që lidhen me të gjitha llojet e sigurimit të detyrueshëm.

Mashtrimet në sigurime kryesisht lidhen me: fshehje të informacionit nga të siguruarit në lidhje me gjëndjet paraekzistuese, me falsifikimin e dokumenteve dhe policave të sigurimit për të përfituar mbulim të shpenzimeve, përfitim nga kartat e sigurimit të personave të pasiguar, bashkëpunim me palët e treta, etj. E pikërisht kjo larmishmëri formash të ndryshme të mashtrimeve në këtë treg kanë bërë që të rritet vigjilenca dhe masat ligjore ndëshkuese.

Kjo vepër parashikohet edhe nga legjislacioni ynë dhe konkretisht në Kodin Penal (neni 145) i cili e dënon mashtrimin në sigurime në disa forma, por që nuk janë taksative pasi praktika tregon që subjektet që tentojnë për të kryer këtë fenomen nxjerrin metoda dhe mënyra të ndryshme që ligji mund të mos t'i ketë parashikuar. Praktika jonë gjyqësore nuk është shumë e pasur, por edhe legjislacioni ynë nuk i përgjigjet kësaj praktike, pasi kjo vepër parashikohet vetëm në një dispozitë të Kodit Penal.

Mashtrimi i sigurimeve nuk kufizohet vetëm në një grup, racë ose gjini. Ky është një krim i “mundësive të barabarta” që mund të kryhet nga një sigurues ose një i siguruar. Mashtruesit e sigurimeve kanë më pak gjasa të dorëzohen tek autoritetet, sepse ata zakonisht nuk janë të pajisur për të trajtuar ose kryer një hetim adekuat, për shkak të mungesës së ekspertizës në fushën e sigurimit. Në mënyrë që mashtrimet e sigurimit të adresohen në mënyrë proaktive, siguruesit duhet të trajtojnë personelin e tyre në identifikimin e skemave të mashtrimit të sigurimeve. Konsumatorët janë të prekur drejtpërdrejt nga mashtrimet e sigurimeve edhe kur nuk janë kryer nga ata, për shkak se kompanitë e sigurimeve janë të detyruar t'i ngarkojnë prime më të larta për të kompensuar fondet që humbin për shkak të veprimtarisë mashtruese. Për ta eliminuar sa të jetë e mundur mashtrimin në sigurime të dyja palët si shoqëritë e sigurimit ashtu edhe të siguruarit duhet të bashkëpunojnë me sinqeritet, duke pasur në bazë të marrëdhënies së tyre parimin e mirëbesimit, duke mos patur si qëllim arritjen e përfitimeve të padrejta nëpërmjet praktikave mashtruese. Përveç dakordësisë së ligjit e rregullave të përcaktuara për këtë pjesë, palët duhet të tregojnë një dakordësi me njëri-tjetrin duke u treguar të sinqertë për të pasur një bashkëpunim efikas dhe me përfitim të ndërsjelltë. Duke vepruar me drejtësi tregu i sigurimeve do të mundë të jetë sa më pranë qytetarëve, për të përmbushur nevojat dhe kërkesat e tyre, si dhe të ofrojë një të ardhme sa më të sigurt, duke mos lejuar që një rrezik i vogël të shkaktojë humbje të mëdha.

BIBLIOGRAFIA

Legjislacion

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
- Kodi Penal Italian
- Kodi Penal Polak
- Ligji Nr.52/2014 “ Për Veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit”;

- Ligji Nr. 10076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e Detyrueshëm në Sektorin e Transportit”;
- Ligji Nr.7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”

Botime

- Ilir Hoti, “Industria e sigurimeve dhe Menaxhimi i Rrezikut”, Tiranë 2008
- Richard A. Derrig, “Insurance fraud”, The Journal Of Risk And Insurance, 2002, volumi 69, nr.3, 271-287;
- Material i Federatës Europiane të Sigurimit dhe Risigurimit;
- Zhaklina Peto, “E drejta e sigurimeve shoqërore”, botimet 2009

Vendime gjyqësore

- Vendimi nr.222 datë 14.04.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës
- Vendimi Nr.460, dt.23.03.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë
- Vendimin nr 905 datë 06.05.2012, i Gjykatës së Apelit, Tiranë
- Vendimin nr 410 datë 17.03.2015, i Gjykatës së Apelit, Tiranë

Website

- amf.gov.al/pdf/publikime2/periodik/amf
- www.gjykataeapelittirane.al/
- www.gjykataelarte.gov.al/

REFLECTION ON THE DEVELOPMENT OF THE ALBANIAN DOCTRINE IN THE CRIMINAL LAW FIELD

Prof. Asoc. Engjëll LIKMETA¹
Dr. Ilda MUÇMATAJ²

ABSTRACT

The focus of this paper is the legal thinking in the field of criminal law in Albania, analyzed based on some of the important historical stages of the Albanian state.

First, the authors present a general picture of the Albanian legal opinion in the field of criminal law which was in force during the first years following the independence declaration and during the Albanian Monarchy of 1928-1939.

Secondly, the authors address the development of legal thinking in the area of criminal law during 1944-1990, as well as in the current period.

The ultimate goal of this approach is to present a detailed analysis of the Albanian legal opinion in the field of criminal law, and in particular to distinguish and to further testify the immense contribution given over the years by the Faculty of Law professoriate in the development of legal thinking in this field of legal science.

The authors hope that the chosen themes will be welcomed and will convey a positive effort in the rich pantheon of Albanian legal literature on the occasion of the 60th anniversary of the University of Tirana.

Key words: *Right; Thought; Law; Criminal.*

1. INTRODUCTION

The authors in the selection of this subject were driven by the high considerations and deep gratitude that sincerely exists and should characterize the new law scholars, generally for the University of Tirana professoriate, and in particular for the academic staff of the Faculty of Law who during these 60 years of the establishment of the Public University have tried and helped a lot in building a science of Albanian law in contemporary settings despite all the obstacles and difficulties of the time.

Through this paper the authors aim to highlight some important aspects of the development of legal thinking in the field of criminal law throughout the years of

¹ Full Time Professor, Criminal Law Department, Faculty of Law, University of Tirana. E-mail: engjell.likmeta@fdut.edu.al

² Full Time Professor, Civil Law Department, Faculty of Law, University of Tirana. E-mail: ilda_mucmataj@hotmail.com

the state-forming history of Albania and earlier. At the same time, the authors will ensure that this work serves as a reminder of the academic and scientific activity of the Faculty of Law professorship over the years.

2. The Albanian juridical opinion in the field of criminal law before the Declaration of Independence.

The Albanian juridical opinion in the field of criminal law at its beginning is distinguished by the existence of an organic connection with customary law³.

The main sources of Albanian customary law are the Albanian canons. Their codification was done very late. The canons have been codified by Albanian researchers only in recent years (during the contemporary period). The Albanian customary law through its criminal sanctions that regulated the social relations does not only show the existence of an authentic Albanian law, but it also reflects the Albanian legal opinion in the field of criminal law.

The Statutes of Scutari and those of Drishti constitute an invaluable asset of the Albanian nation in terms of the existence of law, as well as the Albanian legal opinion in the field of criminal law before the declaration of independence of our state.

The Statutes of Scutari are another indicator of the regulation of social life in the country by legal norms of a penal nature.

The authors believe that the recognition and development of Albanian historiography as an essential element in the creation of the elite culture of our society⁴ will make a major contribution to the development of the legal science and legal opinion of that period. Despite the existence of a number of institutions of criminal law in the Statutes of Scutari, Drishti but also in Albanian customary law mean, the legal opinion in the field of law during this particular period of time is still not fully and properly analyzed. However, as Professor Elezi rightly points out: “... *the lack of legal works makes it difficult, but it does not make it impossible to argue the existence and development of legal thought, no matter in embryonic and empirical form*”⁵.

3. The Albanian juridical opinion in the field of criminal law uring 1912-1944

In the first years after the Declaration of Independence, the Albanian legal opinion was still fragile and unconsolidated. According to Professor Elezi, the theory of Albanian criminal law is greatly enriched with the scientific work of the scholar and “Arbëresh” intellectual Mr. Terenc Toçi⁶. His work “punitive law”

³ Elezi, I., *Albanian Juridical Opinion*, “albin” publishing house, Tirana, 2002, p. 11.

⁴ Egro, D., *History and Ideology*, “Maluka” publishing house, Institute of History, Tirana, 2007, p. 11.

⁵ Elezi, I., *Albanian Juridical Opinion*, “albin” publishing house, Tirana, 2002, p. 11.

⁶ Ibid.

carries true scientific and historical values. It is the first cell from which the legal literature in the field of criminal law takes over. The content of this scientific work is characterized by the contemporary European spirit which was something quite positive and rare for that period.

In this research, besides the definitions of law, guilt, the qualifications of criminal offenses, the prescription of criminal prosecution and criminal institutes such as “pardon”, the author has also elaborated on the views that prevailed in the field of criminal law during that time.

The authors recommend that it would be of a high interest for a copy of his work to be put in the Faculty of Law library to serve as a tool which will further highlight the origin of legal opinion and the science of Albanian criminal law in those years.

4. The Albanian juridical opinion in the field of criminal law during the period, 1944-1990

The Albanian juridical opinion in the field of criminal law during the rule of dictatorship has represented an attempt to be treated in full harmony in three perspectives; ideological, political and legal⁷. Thus, the criminal law principles of the socialist family and the party-state lessons that ruled every aspect of life in Albania as well as the Marxist-Leninist philosophy were the core elements that characterized each work paper in the field of criminal law and not only⁸.

The development of juridical opinion in the field of criminal law during the communist dictatorship were based on studies and work papers under taken with the respect of scientific titles and degrees received from the Law Faculty and the scientific and political journal of the time “The People’s Justice” and different textbooks.

The scientific edition “The Criminal Law of the Socialist Republic of Albania” published by Tirana University, the Law and Political Science Faculty is a very important work-paper⁹ beyond the political colors of the time. It theoretically explains and analyzes all criminal offences viewed as closely connected with the Albanian judicial practice of the time as well as the type and punishment for each criminal offence as well as all principles and institutes upon which the Albanian criminal law has been established especially the special section¹⁰. In addition to the irreplaceable values, this work paper has served as an essential text for the

⁷ Sauli, Gj., *Criminal Responsibility for the Crime of Abuse with Duty under the Criminal Law of the Socialist Republic of Albania*, Tirana University, Law and Political Science Faculty, “Doctor” scientific degree topic, Tirana, 1984, p.160.

⁸ Ibid.

⁹ Elezi, I., *Criminal Law of the Socialist Republic of Albania*, Tirana University, Law and Political Science Faculty, 1983, p. 4-12.

¹⁰ Ibid.

formation of law students and their acquaintance with the theory of law that existed in our country in that time.

Undoubtedly, the Albanian juridical literature in the field of criminal law is closely connected with the scientific work of Professor Kaçupi who has given his greatest contribution with the analysis of the phases, the structure and the content of criminal offense - which has also enriched the Albanian doctrine not only with the qualification of the criminal offence but also with the phases such as with the preparation, the attempt and the preliminary phase which at the same time clarifies all doubts that may have existed with our investigative and/or judicial practice during their qualification¹¹.

The criminal punishment as one of the most important institutes of criminal law is the subject of Professor Haxhia's scientific research: "Criminal punishment in P.S.R.A."¹². Professor Haxhia, in his work-paper, is mostly focused on the concept of punishment as an austerity measure, its aims and the scientific elaboration of punishment system and their types. The Albanian criminal law theory does not accept the existence of capital punishment, because, according to Professor Haxhia, the very existence of this legal disposition contradicts the human nature and the concepts which describe our society and our state¹³.

The work-paper of Mr. Muçi highlights not only the importance of studying the dynamic character of punishment but also it accentuates the need for further perfection of the sentence system by the legislator in the function of drafting new criminal laws¹⁴. He mentions that in any case, the knowledge and application of scientific principles, criteria and sentencing modes as well as the equalization of judicial practice in criminal offence competition will help to create a fair policy of criminal law and moreover will strengthen legality¹⁵.

There is no doubt that Professor Elezi-rightly considered to be the father of Albanian criminal law- is at the same time the conveyor of the greatest values of the Albanian legal opinion in the sphere of criminal law and not only. Professor Elezi his studies gave an outstanding contribution in the development of Albanian juridical opinion in the field of criminal law and in all Albanian speaking areas. Professor Elezi's work paper "The Juridical Defense provided against crimes committed against Human Life in the People's Republic of Albania" is undoubtedly

¹¹ Kaçupi, S., *Phases of Committing a Criminal Offense*, Tirana University, Law and Political Science Faculty, "Doctor" scientific degree topic, Tirana, 1990, p. 2-170.

¹² Haxhia, M., *Criminal Punishment in People's Socialist Republic of Albania*, Tirana University, Law and Political Science Faculty, "Doctor" scientific degree topic, Tirana, 1989.

¹³ Ibid. p. 222.

¹⁴ Muçi, Sh., *Deciding Punishments based on the Criminal Law of the Albanian Socialist People's Republic*, Tirana University, Law and Political Science Faculty, "Doctor" scientific degree topic, Tirana, 1989, p. 3-326.

¹⁵ Ibid., p. 326-328.

the first genuine work paper in the field of criminal law (Special section)¹⁶. The paper is organized by three main chapters. The first chapter of the work-paper includes the definition of murder and its historical context as well as the system of crimes committed against human life in the Albanian criminal law. In the second chapter, Professor Elezi has made an analysis of the elements of crimes committed against human life. While, in the third chapter, Professor Elezi is mostly focused on some moments of general criminal law regarding murder such as: some criminal circumstances excluding the criminal responsibility in crimes of murder, the phases of development and punishments. This work paper, after almost three decades, is brought in the form of a scientific monograph titled “Crimes committed against human life”¹⁷. Professor Elezi, having good intention to give a hand in the development of the Albanian criminal science and juridical opinion, has elaborated important elements of customary criminal law throughout his work paper. Through his paper Professor Elezi has been careful to reveal values of guilt, co-operation, main phases and types criminal offences to assist the development of the Albanian criminal law and science¹⁸.

According to Professor Elezi, the criminal law theory has been guiding our judicial activity and practice regarding murder crimes¹⁹. Moreover, the juridical defense provided for crimes against human life is considered as an integral part of general government policies for the maintenance and strengthening of the law and the working of democracy in our time²⁰.

The young researcher of that time, Professor Brozi, was highly appreciated for developing Albanian legal opinion in the field of criminal law. Professor Brozi has been very careful when it comes to the theoretical and practical treatment and analysis of intentional injury as one of the criminal offences. In this aspect, being the first to treat the serious intentional injury, Mr. Brozi, as a courageous Professor tried to provide his answers to some issues that are still debatable in the current criminal doctrine and tried to rightfully address the fight against the prevention of this crime²¹. He also tried to argue the inappropriateness of qualifying

¹⁶ Elezi, *Legal Defense for Crimes Committed Against Human Life in the People's Republic of Albania*, Tirana University, Law and Political Science Faculty, “Doctor” scientific degree topic, Tirana, 1960, p. 307.

¹⁷ Elezi, *Crimes Committed Against Human Life*, Tirana University, Law Faculty, University Publishing House, Tirana, 1989.

¹⁸ Elezi, *Albanians Customary Criminal Law*, “8 November” Publishing House, Tirana, 1983, p. 285-287.

¹⁹ Elezi, *Crimes Committed Against Human Life*, Tirana University, Law Faculty, University Publishing House, Tirana, 1989, p. 304.

²⁰ *Ibid.*, p. 364.

²¹ Brozi, Z., *Intentional Injuries, and some of their Criminal Aspects in Northeastern Albania*, Tirana University, Law and Political Science Faculty, “Doctor” scientific degree topic, Tirana, 1988, p. 4-168.

the non serious intentional injury as a criminal offense. In this sense, the author says that: "... *such definition brings nothing new and it does not clearly express the hazardousness of this criminal offense, which cannot be considered a crime. This would undermine the policy of criminal punishment and would have a negative effect on the prevention of these criminal offenses*"²². Another aspect which enriched the theory of criminal law was Brozi's proposal, taken in the context of his doctoral study, to consider the cooperation as a qualifying circumstance in the crime of intentional injury, as a consequence of what the practice dictated (During 1980-1986, the crime of intentional injury was mostly carried out in co-operation)²³.

Mr. Abdiu work-paper is characterized by the theoretical and practical treatment of problems met with crimes committed against state. Knowing in theory the elements of these criminal offences had great significance to law enforcement agencies of the time. In this regard, the work paper presents the tendency to accurately analyze the judicial practice for this set of criminal offenses²⁴. The theory of criminal law is enriched with the author's views regarding the typical distinctions of criminal offenses committed against state or public order as compared to the crimes committed during the exercise of duty, as well as the mutual aspects and the differences between crimes of "insult and defamation"²⁵ committed because of the duty.

Mr. Sauli work-paper attracts the attention for the particular writing style and the very rich legal language. The researcher has rigorously treated criminal law development in historical aspect for crimes committed during the exercise of duty. He made an overall assessment of criminal law science in the context of investigating crimes committed during the exercise of duty. The author believes that the correct definition of those elements is of great importance to the theory of law, as it makes the criminal offense more understandable and increases its preventative effect. At the same time, it serves as a solid basis for training professionals in the justice system by eliminating the shortcomings met during the exercise of their law enforcement activities²⁶. Moreover, the author has also focused on the crucial role of the criminal law in the fight against criminal offenses committed during the exercise of duty.²⁷

²² Ibid.

²³ Ibid.

²⁴ Abdiu, F., *Criminal Responsibility for Crimes committed Against State and/or Social Activity in the People's Socialist Republic of Albania*, Tirana University, Law and Political Science Faculty, "Doctor" scientific degree topic, Tirana, 1987, p. 2-100.

²⁵ Ibid.

²⁶ Sauli, Gj., *Criminal Responsibility for the Crime of Abuse with Duty under the Criminal Law of the Socialist Republic of Albania*, Tirana University, Law and Political Science Faculty, "Doctor" scientific degree topic, Tirana, 1984, p.10.

²⁷ Ibid., p.168.

Beside other things, the author through this work paper aims to improve the judicial practice of the High Court regarding the uncertainties existing in the right understanding of causal relationship. In the work-paper, it is underlined that: *“it is not fair to say that causal relationship exists between the criminal offense and the consequence and this also due to the fact that when we mention the criminal act we mean the existence of criminal offense which includes the existence of the causal relationship and the consequence as elements of objective side ... the serious consequence should be a direct effect of illegal actions undertaken by the offender”*²⁸.

5. Juridical opinion in the field of criminal law during the period, 1990-2017

The specter of legal opinion in the field of criminal law has been greatly enhanced during the years of democracy. During this period, qualitative the scientific works, which involved scientific monographs, doctoral studies, or articles written in scientific journals such as “Legal Studies” and “Legal Life” of Faculty of Law of Tirana University and the School of Magistrates, reflect the scientific development of legal thinking in the field of criminal law. In these legal cadres of legal opinion it is difficult to ignore the close connection between the theory of criminal law and Albanian jurisprudence.

The Albanian legal literature is enriched in relation to the birth and development of Albanian criminal law through the scientific work of Professor Elezi.²⁹

² Di quest’ultime previsioni viene effettuato il richiamo nella disciplina del rito abbreviato in caso di trasformazione dal giudizio direttissimo (art. 452, comma 2, c.p.p.), dal rito immediato (art. 458, commi 1 e 2, c.p.p.) e in quello operante a seguito di opposizione al decreto penale di condanna (art. 464, comma 1, c.p.p.).

cui all'imputazione e loro qualificazione giuridica; punibilità e pena; responsabilità civile da reato; fatti in relazione all'applicazione di norme processuali), con riferimento ai quali sono sviluppati i motivi di fatto e di diritto a sostegno, i risultati acquisiti, i criteri di valutazione delle prove (condivise) e di quelle (negate). Il linguaggio dovrà essere sobrio ed essenziale – capace di evitare inutili esibizioni argomentative e dimostrative – così da costituire la ineludibile premessa sulla quale innestare – attraverso la forma, nonché la sostanza delle impugnazioni (art. 581 c.p.p.) – la necessaria premessa dell'oggetto del *devolutum*, degli errori dedotti, delle richieste, favorendo la funzione di controllo delle impugnazioni, evitando inutili reiterazioni dei giudizi.

Il nucleo centrale dell'intervento riformatore è costituito dalla “semplificazione delle impugnazioni” (Capo III del Titolo II). A questi ultimi profili il legislatore dedica la modifica dell'art. 581 c.p.p. che, come anticipato, si correla strettamente a quanto stabilito dall'art. 546 c.p.p. in tema di struttura della sentenza. Gli elementi di novità sono, infatti, rappresentati dalla previsione espressa della sanzione di inammissibilità (peraltro già genericamente presente nell'art. 591 c.p.p.) in caso di mancata enunciazione specifica dei capi e dei punti, della decisione impugnata, delle prove di cui si deduce, l'inesistenza, l'omessa assunzione o l'omessa o erronea valutazione, delle richieste anche istruttorie, dei motivi con l'indicazione delle ragioni di diritto e degli elementi di fatto a sostegno di ogni richiesta. Il riferimento relativo ai capi si correla all'imputazione e al dispositivo della sentenza; quello sui punti si rifà alle indicazioni di cui ai nn. 1, 2, 3 e 4 della lett. e dell'art. 546, comma 1, c.p.p.; quello attinente alle prove trova riscontro alla lett. e del comma 1 dell'art. 546 alla quale si rifà anche l'esposizione dei motivi in fatto ed in diritto di critica della decisione appellata e le richieste, anche istruttorie.

Un ruolo significativo in materia di riforma delle impugnazioni è attribuito all'appello, al quale – molto più che al ricorso per cassazione – la previsione appena analizzata (art. 581 c.p.p.) è sicuramente riferita: difficoltà di tipizzazione dei motivi in un numero determinato o restrittivamente determinato, effetto devolutivo, rinnovabilità dell'istruzione dibattimentale, latitudine dei poteri decisorii, anche officiosi, ne costituiscono l'ineludibile premessa. L'appello è da sempre considerato l'anello più problematico della sequenza procedimentale sia nei sistemi inquisitori, sia in quelli accusatori, senza per questo escludere quelli misti. Ritenuto responsabile dell'allungamento dei tempi di definizione della vicenda processuale, non appare in linea né con le istanze autoritarie, né con la logica dell'oralità, né con entrambe nella composita articolazione delle sue cadenze. Nell'impossibilità d'una sua “soppressione”, si è optato per una rivisitazione funzionale che ne valorizzi il ruolo. Viene recepita la giurisprudenza consolidata della Corte europea, fatta propria di recente in termini significativi delle Sezioni Unite Dasgupta, per la quale si dovrà rinnovare l'istruzione dibattimentale in caso di appello del pubblico ministero nei confronti di una sentenza di proscioglimento (sottintendendo che sia richiesta una decisione di condanna) (art. 603, comma 3 bis, c.p.p.). Un elemento qualificante

della riforma dell'appello è sicuramente rappresentato dalla reintroduzione del concordato anche con rinuncia ai motivi di appello. Il testo dell'art. 599 bis c.p.p. e dell'art. 602, comma 1 bis, c.p.p. riproducono la formulazione abrogata. Controverso meccanismo deflattivo e per nulla premiale, nonostante l'ampio coinvolgimento consensuale (giudici, procure, difesa) è fortemente avversato da una parte della magistratura che teme un "cedimento" all'effettività della pena (soprattutto in relazione alla sentenza del giudizio abbreviato). Senza esplicitare il "retrogusto" delle varie (e non tutte nobili) posizioni formulate sul punto, la resistenza alla reintroduzione è resa evidente dall'esclusione per molti gravi reati (fra i quali quelli di cui all'art. 51, comma 3 bis e 3 quater c.p.p.

Efficientismo, decompressione, valorizzazione connotano anche le ipotizzate modifiche del procedimento di Cassazione. Nella logica del decongestionamento va inquadrata la previsione con cui si esclude che l'imputato possa proporre personalmente ricorso. La finalità di decongestionare il lavoro del Supremo Collegio è ulteriormente perseguita, innanzitutto, trasferendo alla Corte d'appello la competenza in tema di rescissione del giudicato (art. 629 bis c.p.p., previa abrogazione dell'art. 625 ter c.p.p.: al riguardo, si prevede la possibilità della sospensione dell'esecuzione della sentenza e la ricorribilità per cassazione). In secondo luogo, l'obiettivo è sotteso, come visto, al reclamo al tribunale in composizione monocratica relativamente all'invalidità dei provvedimenti di archiviazione (art. 410 bis, commi 3 e 4, c.p.p.). Alla logica della semplificazione dei ricorsi sono riconducibili altresì le previsioni in tema di ricorso soltanto per violazione di legge: le sentenze di appello del procedimento di competenza del giudice di pace (lett. f dell'art. 35); le sentenze di non luogo pronunciate in grado di appello (art. 428, comma 3 bis, c.p.p.); le sentenze d'appello di conferma del proscioglimento disposto in primo grado (art. 608, comma 1 bis, c.p.p.).

Una parte della riforma del giudizio di cassazione – che si auspica di potenziare già con i riferiti strumenti – è costituita dall'accentuazione della sua funzione nomofilattica, che peraltro si cerca di rafforzare anche attraverso altri strumenti, come: il superamento dei contrasti interpretativi, con accentuato e celere intervento delle Sezioni Unite, e lo sfoltoimento della massimazione risalente e non più "attuale". Si prevede, in primo luogo, sul modello di quanto previsto in sede civile (art. 374, comma 3, c.p.c.), che alle Sezioni Unite sia rimessa (motivatamente) da una delle Sezioni semplici la questione di diritto in ordine alla quale essa manifesti una dissenting opinion (art. 618, comma 1 bis, c.p.p.). In secondo luogo, è previsto che il Collegio riunito possa pronunciarsi sulla questione di diritto rimessa alla sua valutazione anche nel caso di ricorso inammissibile per una causa sopravvenuta (art. 618, comma 2 ter, c.p.p.). Inoltre, è ampliato l'ambito di operatività della lett. e dell'art. 620 c.p.p. in relazione alle situazioni di annullamento senza rinvio. Infine, ai sensi dell'art. 625 bis comma 3 c.p.p. la Corte potrà procedere alla correzione degli errori materiali "senza formalità", nonché rilevare, d'ufficio, l'errore di fatto entro novanta giorni dalla deliberazione. Trova spazio nella materia delle impugnazioni

in cassazione anche la disciplina del gravame nei confronti dei provvedimenti cautelari reali: “correggendo” – a stretto giro – le contrastate conclusioni delle Sez. Unite Maresca e recependo le opinioni della Procura Generale, si “recupera” nel comma 3 dell’art. 325 c.p.p., il comma 5 dell’art. 311 c.p.p., statuendo che l’udienza in cassazione si svolga nella forma partecipata. Ben altra attenzione sarebbe stata necessaria per correggere discutibili orientamenti giurisprudenziali (arg. ex art. 324, comma 7, c.p.p. in relazione al comma 10 dell’art. 309 c.p.p.) in una materia che sembra richiedere – al di là dell’operatività del comma 9 dell’art. 309 c.p.p. (Sez. Unite Capasso) – una profonda rimediazione.

Sotto il generico Titolo III (Modifiche alle norme di attuazione, di coordinamento e transitorie del codice di procedura penale e alla normativa dell’organizzazione dell’ufficio del pubblico ministero), il dato più significativo è costituito da una incisiva riformulazione della disciplina della partecipazione al dibattimento a distanza. (In particolare, con riferimento a quest’ultima a disposizione, destinata ad essere operativa con l’entrata in vigore della legge per i soggetti che si trovino in stato di detenzione relativamente ai delitti di cui all’art. 270 bis c.p., all’art. 416 bis secondo comma, c.p. e all’art. 74, comma 1, t.u. stup. d.p.r. n. 309 del 1990, e dopo un anno dalla pubblicazione della legge nella G.U. negli altri casi, la disciplina della partecipazione al dibattimento a distanza di 8. 1/2016 è stata quasi completamente riscritta.

Considerazioni sulla riforma della giustizia in Italia

Come anticipato in esordio, nella riforma confluiscono istanze diversificate provenienti da diversi settori del pianeta giustizia che reclamano interventi “correttivi” ritenuti funzionali ad un migliore assetto del sistema penale. Le convergenze – come detto – si sono rese necessarie soprattutto in tema di prescrizione e di intercettazioni telefoniche. Si conferma, però, anche la tendenza ad accompagnare le più significative riforme in materia penale, con una attività di monitoraggio sulle implicazioni dalle stesse indotte. Va richiamato, al riguardo, quanto già evidenziato in tema di riscontro sull’operatività dell’art. 599 bis c.p.p. e sulla durata dei giudizi d’appello che prevedono la presenza di condannati; il controllo sull’osservanza delle disposizioni relative all’iscrizione delle notizie di reato; i dati della sentenza che riconoscano il diritto alla riparazione per ingiusta detenzione.

Da un’attenta lettura del testo affiora, confermando quanto già prospettato a più riprese dal legislatore (recentemente, con i limiti al patteggiamento), anche il riferimento alla tematica della legalità della pubblica amministrazione: vi fanno riferimento la già ricordata lett. d dell’art. 35 in tema di semplificazione delle condizioni di impiego delle intercettazioni; la disposizione in materia di formazione – con criteri di priorità assoluta – dei ruoli di udienza e della trattazione dei processi (art. 132 bis c.p.p.) (art. 31); le modifiche all’art. 161 c.p. in materia di interruzione della prescrizione (art. 10).

Va, altresì, sottolineato che mentre non trova alcuna risposta la tutela anche economica del soggetto assolto e si ridimensionano i pochi spazi di tutela per il danno da processo, come nel caso della durata irragionevole del processo (legge Pinto l. n. 89 del 2001 ex art. 1, comma 777, l. n. 208 del 2015), il legislatore punta a sanzionare, con inasprimenti economici, le attività processuali inammissibili così da scoraggiare – indirettamente e surrettiziamente – eventuali iniziative (dilatatorie). Al di là di quanto già detto in materia di ricorso per cassazione (art. 616, commi 1 e 1 bis c.p.p.) e di rimessione (art. 48, comma 6 e 6 bis c.p.p.), va ricordato anche quanto previsto per il reclamo nei confronti dei provvedimenti di archiviazione (art. 410 bis comma 4 c.p.p.). In filigrana, l'intervento sulle impugnazioni tende sicuramente a rendere il giudizio di controllo più penetrante e maggiormente finalizzato alla sostanza (ed alla concretezza, come emerge coordinando gli artt. 546, 581, 591, 610 c.p.p.), anche in relazione al ruolo delle parti, dove risultano significative le disposizioni sul p.m.

Sotto traccia, nell'impossibilità di riformare il comma 7 dell'art. 111 Cost., prevedendo una riserva di legge modellata sulle diverse situazioni processuali interessate all'intervento del Supremo Collegio, si tende – “salvando il salvabile” della Carta di Napoli – da un lato, ad accentuare – a volte ritagliandone il contenuto – le ipotesi di ricorso per violazione di legge, dall'altro, a privilegiare lo svolgimento dell'udienza camerale nella forma non partecipata, ma in quella cartolare. Abbandonata la contrastata proposta di introdurre un rito speciale contenente la richiesta – fortemente premiale – di condanna da parte dell'imputato e venuta conseguentemente meno la possibilità di ridefinire il patteggiamento (riducendone lo spazio operativo allargato); introdotti o prefigurati procedimenti e meccanismi volontari o a richiesta (sospensione del processo e messa alla prova; condotte riparatorie) finalizzati a definire in termini endoprocedimentali i profili sanzionatori con, variamente articolati, effetti estintivi; realizzate o ipotizzate deflazioni del carico giudiziario (tra particolare tenuità del fatto e ampliamento delle ipotesi di perseguibilità a querela); disincentivata l'opposizione al decreto di condanna attraverso un più favorevole meccanismo di conversione della pena detentiva in pecuniaria; l'attenzione verso i riti speciali – nell'impossibilità di intervenire sul giudizio direttissimo e sull'immediato, soprattutto quello custodiale – si sposta sugli effetti che nel rito abbreviato il consenso dell'imputato determina sulle invalidità, decretandone – come detto – la sanatoria; nonché sulle ricadute dell'accordo sul controllo della decisione patteggiata, prospettando, come si è visto, la compressione dei motivi della ricorribilità.

Se sicuramente l'allungamento dei termini della prescrizione favorirà – se non addirittura renderà per la difesa “necessario” – l'accesso ai riti premiali nei cui confronti, peraltro, il legislatore, da ultimo, non sembra dimostrare grande favore (si pensi alle già ricordate recenti modifiche al patteggiamento che per numerosi reati ne escludono l'applicazione, ovvero ne condizionano l'accesso), potrebbe non essere inopportuna una rivisitazione complessiva della materia,

soprattutto del patteggiamento, con una significativa differenziazione delle sue due articolazioni, allargando – anche con opportuni distinguo – i contenuti degli strumenti di controllo. Se, soprattutto, dai criteri della delega in tema di casellario, di ordinamento penitenziario nonché in materia di revisione delle misure di sicurezza e delle REMS emergono profili di sensibilità verso la persona; se, sempre la delega, in tema di intercettazioni, evidenzia attenzione alla tutela della persona e dei terzi estranei; se elementi positivi potranno ricavarsi dall’attuazione della delega sulla perseguibilità a querela; se qualche miglioramento potrà venire dai prospettati decongestionamenti, dalle ipotizzate razionalizzazioni, dalle prefigurate scansioni temporali, deve esserci la consapevolezza che i nodi strutturali del nostro processo – soprattutto nel rapporto tra indagini e giudizio – sono lontani dall’essere risolti.

Alcune indicazioni e qualche monito per i giuristi albanesi

Nell’impossibilità di poter espletare un’analisi della riforma del codice di procedura penale albanese nel merito, si è ritenuto utili indicare alcuni dei punti centrali di quella approvata in Italia, evidenziando anche le logiche sottese alla stessa. Le riforme – se e quando vengono fatte – rispondono a delle specifiche esigenze avvertite non solo e non sempre dagli operatori della giustizia ma anche dal tessuto sociale di cui spesso il legislatore ne diventa portavoce per motivi spesso legati al consenso politico.

Sicuramente, però, le premesse da cui parte la riforma in Albania sono diverse da quella italiana.

Con riferimento all’Italia, si ha la sensazione che la riforma manchi di un respiro comune e orizzonte condiviso; restano troppo diversi gli approcci nel pianeta della giustizia penale. Da un lato si assiste ad una avvocatura troppo opaca e troppo sulla difensiva, quasi rassegnata, mentre dall’altro, si assiste ad una magistratura troppo spesso autoreferenziale e, al contempo, perfettamente consapevole del proprio ruolo di protagonista nella vita sociale; una magistratura che tende a modellare il processo con la propria giurisprudenza e con le prassi, nonché con vari strumenti di soft law (decreti, circolari, protocolli, modelli organizzativi). A ciò va aggiunto il legislatore: il suo atteggiamento è stesso incerto ed ondivago.

Conclusioni: la scenario che ci viene consegnato non è esaltante.

Anche in Albania i problemi non mancano, ma sembrerebbe che i termini della questione siano sostanzialmente diversi: la riforma sembrerebbe nasca per dare un’effettiva risposta a significative ed indifferibili problematiche di natura politica e soprattutto sociale che vedono nella magistratura un protagonista negativo.

Facendo riferimento agli scritti proposti dai giuristi albanesi, sembrerebbe che sul piano politico, la riforma della giustizia penale costituisca il punto centrale per l’avvio del percorso di adesione all’Unione Europea; se sono proprio gli organismi dell’Unione a chiedere con forza a Tirana l’attuazione della riforma, indicando in quest’ultima la “conditio sine qua non” per l’avvio dei negoziati per l’entrata nella famiglia dei ventisette, ciò significa che il problema della giustizia

è particolarmente complesso non solo per i cittadini albanesi ma anche per quelli europei. Ciò si comprende chiaramente soprattutto se – come si sottolinea con forza dalla dottrina locale – si tiene conto che, sul versante sociale, la lotta al fenomeno della corruzione all'interno della magistratura sembrerebbe sia sentita come una impellente e improrogabile esigenza³ non solo da parte dei cittadini albanesi ma, al contempo, anche dall'UE; del resto, la lotta al fenomeno del traffico illecito dei stupefacenti (purtroppo l'Albania tiene il record di primo produttore mondiale di marijuana) e della criminalità organizzata albanese può essere arginato solo mediante l'edificazione di una magistratura seria e onesta, capace di spedire al mittente eventuali – non certo commendevoli – tentazioni economiche provenienti dai narcotrafficanti ovvero dalla politica.

Certo se, almeno stando alle osservazioni degli studiosi albanesi comparse il riviste italiane, il dilagante fenomeno corruttivo nella magistratura albanese⁴ è favorito da molti fattori, tra cui un sistema di controllo dell'operato dei magistrati poco efficiente, un superficiale livello di approfondimento ed interpretazione delle norme sia da parte di questi ultimi che degli avvocati, una poca attenzione verso gli aspetti scientifici del diritto in occasione dell'insegnamento universitario ecc., non si può pensare che tutti i problemi possano essere risolti con un "colpo di maglietta" da parte del legislatore.

Sicuramente, però, il recupero di valori cardine cui si fonda la buona amministrazione della giustizia, come quelli di probità e senso delle istituzioni,⁵ deve rappresentare il primo obiettivo da realizzare concretamente sul piano dell'educazione delle nuove classi dirigenziali; solo così gli interventi riformatori possono assumere un effettivo significato; solo mediante l'edificazione di una classe di magistrati onesta e, al contempo, preparata⁶ si può pensare di combattere il fenomeno della corruzione nella politica⁷ ovvero quello dei legami tra politica e criminalità organizzata⁸.

Del resto, solo una magistratura forte e pulita può combattere una politica segnata dal marcio e che spesso trova nel crimine un alleato da coltivare e proteggere piuttosto che un nemico da combattere.

Ma perché ciò avvenga, occorre, *in primis*, che i sistemi di controllo tra

³ E. BOZHUKU, *La riforma costituzionale ("strutturale) del sistema di giustizia in Albania*, in *Diritto penale contemporaneo*, ottobre 2016, www.dirittopenalecontemporaneo.it.

⁴ *Ibidem*.

⁵ *Ibidem*.

⁶ Sul problema del livello della preparazione dei giuristi albanesi v. G. JAHJOLLI, *Problematikat e Sistemit penal dhe atij procedural penal në Shqipëri*, in *Illyrius*, 4/2014, p. 96 ss.

⁷ E. BOZHUKU, *La responsabilità da reato degli enti in Italia e Albania. Il ponte tra le due sponde dell'Adriatico*, Torino, 2016, p. 23 ss.

⁸ E. BOZHUKU, *Le problematiche del sistema penalistico albanese: un panoramico sguardo d'insieme*, in AA. VV., *Scritti in onore di Alfonso M. Stile*, Napoli, 2013, p. 1227.

magistrati siano più penetranti ed efficienti. In questa prospettiva, sembrerebbe possa leggersi con favore l'inserimento della figura del GUP all'interno del codice di rito albanese; anche se privo di poteri decisori, la sua funzione potrebbe, tuttavia, risultare centrale per controllare l'operato del P.M.; quest'ultimo non può più scegliere discrezionalmente quali processi portare a giudizio e quali archiviare, ma il suo operato sarà oggetto di controllo da parte di un altro magistrato. E in un sistema come quello albanese dove vige una netta separazione delle carriere, il meccanismo di controllo – sia nella prospettiva di evitare facili rinvii a giudizio che in quella di arginare sospette archiviazioni – può essere effettivamente efficace.

Tornando sul versante della riforma italiana, sarà il tempo a dirci sé, e in che misura, le modifiche al codice di procedura penale risolveranno i problemi della nostra lenta giustizia; sicuramente il dato che non conforta è il sotteso “sentimento moralistico” che contraddistingue una parte della magistratura che per ovvi motivi trova in una politica populistica – attenta più alle “grida della piazza” da dove trarre consensi piuttosto che alle effettive esigenze del sistema – terreno fertile cui coltivare le proprie istanze. In un quadro dove la magistratura, oltre alla propria e naturale funzione di organo di interpretazione ed applicazione della legge, assume anche quelli paternalistici di custode della morale – grazie anche all'ausilio del legislatore che non manca di intervenire con riforma sempre più orientate a soddisfare gli appetiti della piazza – le garanzie all'individuo-indagato (imputato) rischiano di essere seriamente compromesse. Con ciò non si vuole criticare la riforma c.d. Orlando, ma solo offrire al lettore – specie a quello d'oltre Adriatico – l'idea di come una giustizia populista dalle ridotte garanzie possa portare a dubbi sulla sua stessa essenza.

L'auspicio è quello per cui, quella che possiamo considerare una patologia del sistema italiano (*rectius*: l'eccessivo moralismo della magistratura), non diventi nel tempo una sfida anche per l'Albania; del resto, l'eccessiva esaltazione del valore moralistico delle legge e soprattutto di chi la legge è chiamato ad interpretare ed applicare può essere, a sua volta, pericolosa; una magistratura pulita e che in virtù di questa sua igiene interna miri a portare sui banchi del tribunale giudizi basati più sulla morale piuttosto che sulle norme e tuttavia portati avanti mediante una distorta interpretazione della norme stesse, a sua volta non risponde e non offre alcun servizio alla giustizia, intesa come uno dei massimi valore di “civiltà” ove ciò che è giusto e ciò che è sbagliato lo si può stabilire solo attraverso la corretta interpretazione delle leggi.

Ad avviso di chi scrive i giudici devono fare i giudici e cioè devono giudicare le persone in base alle leggi, le quali non costituiscono uno strumento che impedisce la realizzazione della giustizia, ma semmai sono “lo strumento” attraverso il quale si deve fare giustizia.

Non va mai dimenticato che le leggi nascono a garanzia del cittadino; esse sono il frutto di secoli e secoli di lotte per la giustizia e nella giustizia fondano le loro radici.

**GUARANTEE FOR REVIEW OF THE DECISIONS IN ABSENTIA
AS ONE OF THE CONDITIONS TO ALLOW EXTRADITION
ACCORDING THE ALBANIAN LAW**

**PhD C. Joana QELESHI
Prof. Dr. Artan HOXHA**

ABSTRACT

The amendments of the Albanian Criminal Procedure Code (CPC) effectuated by the Law no.35/2017 aimed on one hand to regulate the legal situations that were considered as problematic by the doctrine and judicial practice and on the other hand to include in the national law the European standards for the protection of human rights in criminal procedure.

One of the biggest problems of the Albanian criminal procedure regarding the respect of the right to a fair trial was considered the trial in absentia and by amending the articles 351 and 352 of the CPC and also article 450, the legislator tried to solve this issue. This amendment was also reflected in article 491 of the CPC by adding as one of the reasons for the rejection of the request for extradition letter f) according to which extradition is refused if the person has been trialed in absentia and the requesting party does not offer guarantees that he is going to be given the right to a review.

This paper tries to analyze how should this provision be understood and implemented in practice, what should be considered as trial in absentia in reference to this provision, which is the authority that applies it and what should be considered as guarantee for a review.

Key words: *fair trial, extradition, trial in absentia, competent authority, review.*

**NDRYSHIMET NË LIGJIN PËR PARANDALIMIN E GODITJEN
E KRIMIT TË ORGANIZUAR. RAPORTI I EFEKTIVITETIT
TË PROCEDIMIT PASUROR ME GARANCITË PËR MBROJTJEN
E PASURIVE TË LIGJSHME TË SUBJEKTEVE TË LIGJIT**

Punoi: **Sandër SIMONI**

*Gjyqtar, Gjykata e Krimeve të Rënda, Kryetar
Pedagog i jashtëm në Shkollën e Magjistraturës
Doktorant pranë Departamentit të së Drejtës Penale*

Ligji “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë,” ose siç quhet ndryshe “**ligji antimafia**” dhe zbatimi i tij në Shqipëri, përbën në vetvete një histori suksesi të veprimit të ligjit, një risi për nga pikëpamja e natyrës ligjore e zbatimit të tij, një proces dinamik për nga mënyra e diskutimit të përputhshmërisë së tij me sistemin ligjor shqiptar që ka kaluar në një periudhë të shkurtër të gjitha fazat e zakonshme me të cilat ballafaqohen ligjet atraktive e ato të diskutueshme.¹

Konfiskimi i produkteve të krimit vendos parimin se askush nuk mund të përfitojë nga krimi. Qëllimi i tij është jo vetëm të parandalojë dhe të ndëshkojë, por dhe të mbrojë interesat e palës së dëmtuar. Detyrimi ynë si shtet për të konfiskuar të ardhurat e paligjshme nga krimi i organizuar dhe trafiket vjen si rezultat i përbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga normat ndërkombëtare.

Hartimi i kornizës ligjore dhe krijimi i institucioneve për konfiskimine produkteve të krimit u parashikua si një kusht i Shqipërisë në kuadër të procesit të integritetit dhe, si rrjedhim, dhe vendi ynë duhej të ndiqte këtë standard. Pas nënshkrimit të disa Konventave, e disa ndryshimeve në legjislacionin penal material e procedural, pas miratimit të ligjit për gjykatat e krimeve të rënda dhe fillimit të funksionimit të tyre e një sërë ligjesh të tjera, në shtator të vitit 2004 u miratua ligji “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”²

Ky ligj ishte një risi për sistemin ligjor penal shqiptar dhe për botëkuptimin rreth këtij sistemi. Qëllimi i këtij ligji ishte parandalimi dhe goditja e krimit të organizuar nëpërmjet zbulimit, identifikimit, sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive të paligjshme të personave të dyshuar si pjesëmarrës në krimin e organizuar, si dhe përcaktimi i mënyrës së përdorimit të këtyre pasurive.

Me ligjin nr. nr. 10 192 datë 03.12/2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”

¹ Raporti i Konferencës së organizuar nga Komisioni European, Misioni EURALIUS dhe Gjykata e Krimeve të Rënda “Praktikat më të mira të drejtësisë penale - Aktiviteti i Gjykatës së Krimeve të Rënda kontribut solid në luftën kundër krimit të organizuar”, mbajtur nga Sandër Simoni, 13 korrik 2012. www.gjkr.gov.al

² Ligjit nr. 9284, datë 30.09.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar nëpërmjet masave parandaluese të pasurisë “

ndryshoi shumë çështje të ligjit të mëparshëm. Risetë e këtij ligji konsistojnë në riformulimin dispozitave të neneve 7, 9 e 10 të ligjit nr. 9284, datë 30.09.2004, të cilat kanë qenë objekt unifikimi nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Shtesat dhe ndryshimet në ligj, synojnë t'i jepnin zgjidhje disa problemeve të evidentuara në praktikë lidhur me interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të tij konkretisht ato që kishin të bënin me fushën e zbatimit të ligjit dhe fuqinë e tij parapavepruese në kohë, gjykatën kompetente, përbërjen e trupit gjykues që gjykon kërkesën.³

Çështjet e praktikës gjyqësore dhe interpretimet e ndryshme nga gjykatat në lidhje me institutet e këtij ligji e në mënyrë të veçantë ato që lidhen me rrethin e personave ndaj të cilëve zbatohet ligji e pozita procedurale e tyre, veprimet procedurale të cilat duhet të kryente dhe kishte mundësi të zbatonte prokuroria gjatë fazës së hetimit pasuror dhe nëse referimi në rregullat e procedurës civile nënkuptonte disponibilitet të plotë të prokurorisë mbi kërkesën për konfiskim⁴ e ngjashme me atë të disponimit të padisë, çështjet e të provuarit, të standardit të provës, kuptimi i indicies që mbështesin dyshimin për përfitimin e pasurisë kriminale etj. Këto kanë qenë çështjet e debatueshme të zbatimit të këtij ligji në kohë. Sigurisht dhe fakti që procedimi pasuror një procedurë e bazuar në rregullat e procedimit civil, mbështetej kryesisht mbi aktet e përfuara nga procedimi penal si dhe institutet e procedimit civil zbatoheshin nga një gjykatë penale ishte një disavantazh në zbatimin e këtij ligji apo fakti që fusha e veprimit të këtij ligji përfshinte dhe pasurinë e vënë me kryerjen e veprave penale të cilat nuk ishin në kompetencën e gjykatës kompetente, asaj të krimeve të rënda.

Këto çështje sollën dhe nevojën e rishikimit të tij. Me Ligjin e ri nr. 70 / 2017 datë 27.04.2017 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 192 datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”*,⁵ i ndryshuar tashmë legjislatori ka synuar t'u japë zgjidhje çështjeve të tilla. Ky ligj me ndryshimet përkatëse ka synuar harmonizimin e përmbajtjes së ligjit me praktikën më të mirë të zbatimit të tij në këto vite si dhe zgjidhjen e çështjeve të diskutueshme si pika të dobëta të tij

³ Ligji 10192, datë 3.12.2009, *“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”*

⁴ Shih vendimin nr. 1 datë 16.01.2014 të Gjykatës së Shkallës Për Krime të Rënda dhe vendimin nr. 8 datë 02.04.2014 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda sipas së cilëve heqja dorë e prokurorit nga gjykimi i kërkesës nuk çon detyrimisht gjykatën në vendimarrjen për pushimin e saj sipas nenit 201/1 të KPrC, pasi prokurori nuk gëzon tagër disponimi padie meqenëse pasuria nuk është dhe interesi publik duhet të prevalojë në këtë rast. Shih dhe vendimin nr. 224 datë 09.12.2014 të Gjykatës së Lartë që i prish këto dy vendime.

⁵ Ligji 70 / 2017 datë 27.04.2017 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 192 datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”* është miratuar në Parlament me datën 24.07.2017 dhe ka hyrë në fuqi me datën 22.05.201.

sipas modeleve ligjore të përparuara e normave ndërkombëtare të fundit siç janë direktivat e Komisionit European.

Por ndryshimi i rregullave procedurale në zbatim të këtij ligji sjell diskutimin mbi raportin e efektivitetit të procedimit pasuror me garancitë për mbrojtjen e pasurive të ligjshme të subjekteve të ligjit. A kemi tashmë një procedim pasuror më efektiv e më pak instrumente në dorën e subjekteve të tij për t'u mbrojtur apo kemi avancim të garancive e mun-dësive për të justifikuar pasurinë e ligjshme.

Ky punim trajton pikërisht këtë çështje delikate dhe sfidat që sjell zbatimi në praktikë i ligjit të ri dhe çështje të perspektivës ligjore të tij.

Çështja e natyrës së ligjit tonë tashmë është një çështje që duhet diskutuar nga pikëpamja teorike. Ndryshimet e fundit në këtë ligj janë ndryshime thelbësore e pas këtyre ndryshimeve lind pyetja *se cila është natyra e ligjit tonë tashmë, cilës traditë ligjore i përket dhe nëse është një ligj i karakterit penal apo atij civil.*

Për t'i dhënë një përgjigje kësaj pyetje së pari duhet të hedhim këndvështrimin mbi natyrën e konfiskimit si masë parandaluese, llojeve të konfiskimit apo natyrës së tij penale apo civile duke u ndalur veçanërisht në legjispcionin italian. Kjo për arsyen se ligji shqiptar nr.10192, datë 03.12.2009 "*Për parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar, trafikut dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*», është qartësisht i bazuar në përvojën italiane. Ligji italian antimafia e ka kaluar testin e ballafaqimit me kontrollin e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriur dhe përbën një shëmbull të shkëlqyer të përshtatshmërisë së ligjit në kohë me qëllim balancimin e efektivitetit të procedimit pasuror me mbrojtjen e pasurisë së ligjshme të shtetasve nën frymën e procesit të rregullt ligjor, e kjo kryesisht nga interpretimi gjyqësor e praktika gjyqësore.

Masat parandaluese kundër pasurisë, të cilat janë futur në sistemin ligjor Italian në 1982 me anë të *ligjit Rognoni - La Torre*⁶, kanë përcaktuar një përmirësim të dukshëm në luftën kundër dimensionit ekonomik të krimit të organizuar. Forma tradicionale e konfiskimit sipas Kodit Penal Italian e konsideronte dimensionin ekonomik të krimit, thjesht në perspektivën individuale. Pasja e një dënimi ishte parakusht për konfiskimin e mjeteve të përdorura për kryerjen e një krimi, për konfiskimin e objekteve të gjeneruara nga vepra, fitimit që rrjedh prej krimit e madje edhe të vlerës së fituar nga autori për kryerjen e një krimi. Duke qënë se kërkohej një lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet të mirave që duhej të konfiskoheshin dhe veprës penale, asetet e pastruara dhe fitimet e pastruara nuk mund të konfiskoheshin. Akoma më tej, konfiskimi nuk mund të urdhërohej nëse asetet i përkisnin personave të tjerë veç të pandehurit dhe si rrjedhojë, pronat në pronësi të personave mbulues nuk mund të sulmoheshin.

Rregulli i ri i prezantuar nga *ligji Rognoni - La Torre* lejonte përdorimin e sekuestrimit dhe të konfiskimit si masa parandaluese kundër personave për të cilët kishte dyshime se ishin pjesë e një organizate kriminale. Zhvillimet pasuese

⁶ Ligji njihet si ligji Rognoni – La Torre në emër të iniciatorëve dhe hartuesve të tij.

në përvojën gjyqësore italiane mund të përshkruhen si një kalim nga dyshimi tek prova dhe si një zbulim i dimensionit sistemik të krimit. Para ekzistencës së kësaj qasjeje, kishte shumë dyshime lidhur me krimin e organizuar dhe shumë gjyqe që trajtonin çështje të ndara korrupsioni, mashtrimi apo të krimit financiar. Mirëpo, gjyqet që trajtonin krimin e organizuar nuk e përfshinin kurrë botën ekonomike dhe atë administrative dhe shpesh rezultojnë në dhënien e pafajësisë për shkak të mungesës së provave.

Pika e kthimit u arrit në vitet tetëdhjetë kur gjyqtarë si Rocco Chinnici, Giovanni Falcone, Paolo Borsellino, konceptuan një qasje të re të bazuar në përdorimin e hetimit financiar kundër krimit të organizuar. Për herë të parë, mafia, niveli i lartë i korrupsionit në sektorin publik dhe mashtrimi që ndikonte në buxhetin e shtetit dhe të Bashkimit Europian, u ekzaminuan në mënyrë të përbashkët. Ato u konsideruan si pjesë përbërëse e të tërës dhe jo si fenomene kriminale të izoluar.

Niveli në rritje i sfidës kundër kriminalitetit u shoqërua nga një nivel në rritje i provave të mbledhura, përfshirë gjithashtu përgjimin e komunikimeve nën kontrollin gjyqësor dhe dëshmitë e “*bashkëpunëtorëve të drejtësisë*”, të testuara nga ballfaqimet në gjykatë. Për herë të parë, u mblodh një mozaik kaq i plotë provash në “*gjyqin e madh*” sa që pati një domethënie historike dhe u konsiderua nga Giovanni Falcone si prova se “*duke respektuar rregullat e demokracisë mund të arrijmë rezultate të rëndësishme kundër krimit të organizuar*”.⁷ Një tipar shumë i rëndësishëm dhe shumë i vlerësuar i sistemit Italian kundër aseteve të paligjshme, konsiston në ndërthurjen e dy aspekteve të efencës dhe garancive në një marrëdhënieje të ndërsjellë përforcuese, në përputhje me ide të përcaktuara që datojnë që në ndërtimin fillestar të “*ligjit kundër krimit të organizuar*” në vendin tonë.⁸

Më pas, u vu në dukje se “*thembra e vërtetë e Akilit*” të organizatave mafioze që merren me veprimtaritë kriminale më fitimprurëse, konsiston në gjurmët që lenë lëvizjet e parave” dhe si rezultat ndjekja e këtyre gjurmëve në një hetim për asetet që ndjek lëvizjet e parave që gjenerohen nga trafikimi i paligjshëm, është rruga kryesore që duhet ndjekur në hetimet lidhur me Mafian, pasi kjo mënyrë u lejon hetuesve krijimin e një sërë provash objektive, të dokumentuara dhe të pakundërshtueshme të cilat është shumë e vështirë të hidhen poshtë dhe që ëojnë në konfirmimin e të dhënave që vijnë nga aktiviteti provues tradicional⁹».

Ky këndvështrim, i shprehur 32 vjet më parë, tani duket më aktual se kurrë dhe dëshmon se sistemi i masave parandaluese kundër pasurisë përfaqëson një fushë të privilegjuar për zhvillimin e “*kulturës së fenomeneve sociale*”. Është një parakusht thelbësor për interpretimin dhe aplikimin e metodave ligjore për të luftuar fytyrën

⁷ Antonio Balsamo, referim në seminarin me teme “Konfiskimi nëpërmjet ligjit antimafia“, organizuar nga PAMECA, 20 nëntor 2017

⁸ Codice Antimafia, Legge 17/10/2017 nr. 161, G.U.04/11/2017

⁹ Falkone and Turone, 1983.

e re të krimit të organizuar, dimensionin rajonal dhe kombëtar. Që prej viteve shtatëdhjetë, ka pasur një trend evolutiv të sistemeve ligjore të cilët janë më të ekspozuarit ndaj lindjes së formave të reja të penetrimit në ekonomi, lidhur me përzjerjen e grupeve kriminale me botën e biznesit, duke sjellë pasoja në fushat e menaxhimit të pushtetit publik si edhe të formimit të konsensusit politik. Ky trend është i orientuar ndaj futjes së formave "moderne" të konfiskimit, të karakterizuara si nga zgjerimi i fushës së tyre të veprimit ashtu edhe nga thjeshtësimi i barrës së provës së prokurorit, mbi bazën e dijenisë së fenomenet e pastrimit të parave dhe ri-investimit të parave të pista e bëjnë shumë të vështirë gjetjen e një lidhjeje të saktë ndërmjet veprës penale dhe fitimeve, që lidhen me përdorimin e konfiskimit "klasik".¹⁰

Kështu, sistemet ligjore të ndryshme kombëtare riprodhojnë metoda të ndryshme të konfiskimit, të cilat mund të klasifikohen në katër kategori:

"Konfiskimi i përgjithshëm i aseteve": prek ata individë të cilët janë shpallur fajtorë në një çështje penale, pavarësisht nga origjina e pasurive kriminale të cilat duhet të konfiskohen; megjithatë, ky model paraqet probleme të pakapërcyeshme për sa i takon prezumimit të pafajësisë dhe parimit të proporcionalitetit.

Konfiskimi i aseteve me destinacion të paligjshëm: prek ato asete të cilat zotërohen nga persona që janë pjesë e organizatës kriminale dhe supozohet se përdoren për të financuar veprimtari të paligjshme për qëllime të paligjshme të organizatës;

konfiskimi penal "i zgjeruar" i aseteve të dyshuara me origjinë të paligjshme: ky model është sigurisht ai më i perhapuri në Europë dhe bazohet në prezumimin e origjinës së paligjshme të aseteve të personave të dënuar për disa lloje veprash penale, tipikisht të lidhura me përfitimin e paligjshëm si për shembull korrupsioni apo pjesëmarrja në organizata të llojit mafioz.¹¹ Prezumimi i origjinës së paligjshme sipas këtij rregulli i referohet të gjitha aseteve të personit të dënuar, por mbetet subjekt i plotësisht të barrës së provës, ndonëse të reduktuar, nga ana e prokurorit (*i cili duhet të provojë mospërrputhjen ndërmjet akumulimit të kapitalit të pandehurit dhe të ardhurave të tij të deklaruara për qëllimet e tatimeve ose veprimtarisë së tij të ligjshme ekonomike*).

Në vende të tjera, ka dispozita ligjore që e kufizojnë prezumimin për asetet e fituara brenda një periudhe kohe specifike që lidhet me kryerjen e veprës penale, ose që përcaktojnë një kthim të vërtetë të barrës së provës;

Konfiskimi i pabazuar në dënim (ose konfiskimi in-rem): gjë zbatim pas një procesi gjyqësor për asetet dhe nuk ka nevojë për pasjen e një dënimi si parakusht. Prototipi i këtij modeli përfaqësohet nga konfiskimi civil i cili është shumë i përdorur në vendet e Common Law (*MB, SHBA, Australia, Irlanda etj*);

¹⁰ Fornari 1997, 5- 102, 120, 169, 208, 209, 214, 224.

¹¹ Në ligjin italian, ky lloj konfiskimi parashikohet nga Neni 12-sexies i dekretit të 8 qershorit 1992, nr. 306, konvertuar në Ligjin e 7 gushtit 1992, no. 356;

pas reformave të fundit legislative, sistemi italian i masave parandaluese kundër pasurisë mund të thuhet se përfshihet në këtë kategori.

Lidhur me masën e fundit, dyzimi që lind prej krijimit të dy formave të ndryshme të konfiskimit (*konfiskimi penal dhe konfiskimi civil*), rezulton në një shumësi instrumentesh që orientohen kundër disa prej formave më të rrezikshme të krimit.

'*Konfiskimi penal*' gjen zbatim në procedimet in personam. Ai varet nga dënimi dhe vendoset nga një gjykatë penale; përkundrazi, "konfiskimi civil" gjen zbatim pas procedimit in rem që ka lidhje me asetet. Konfiskimi civil nuk ka nevojë për dënimin si kusht i domosdoshëm dhe mund të jepet si nga një gjykatë civile ashtu edhe nga autoritetet ligjzbatuese.¹²

'*Konfiskimi civil*', i cili në Shtetet e Bashkuara përfaqëson një prej instrumenteve më të rëndësishme të ndërhyrjes tek financat e organizatave kriminale, është subjekt i rregullave për provat dhe procedurave që janë të ndryshme prej atyre në çështjet penale. Actio in rem është autonom dhe kundër aseteteve të njollosura nga krimi, kurse fajti i pronarit është jorelevant; konfigurimi special i kësaj mase lejon barrën e provës, nëpërmjet përdorjes së nocioneve të shkakut të mundshëm (*d.m.th., një probabiliteti ti drejtë për të menduar se asetet janë blerë me fitime të paligjshme, të mbështetur nga provat që, megjithëse nuk e arrijnë nivelin e provimit përtej Gdo dyshimi të arsyeshëm, janë më tepër se sa thjesht dyshim*) si edhe mbizotërimin të provave (*barra tipike e gjyqit civil, i cili privilegjon provën që mbizotëron me një shkallë më të lartë gjase dhe besueshmërie se sa hipoteza e kundërt*).

Si asetet që rrjedhin prej veprës penale ashtu edhe asetet që janë përdorur ose që synohet të përdoren për veprimtari të paligjshme, mund të jenë subjekt i konfiskimit, po ashtu edhe sendet që lehtësojnë kryerjen e krimit (për shembull e gjithë ndërmarria është konfiskuar në rastin kur janë kryer transaksione të paligjshme që sidoqoftë, kishin lidhje vetëm me një aspekt të veprimtarisë ekonomike që ajo kryente).

Në Shtetet e Bashkuara, me Ligjin për Reformën e Konfiskimit të Aseteve Civile të vitit 2000, u synua që të kufizohej fusha e veprimit të konfiskimit civil, duke vendosur mbi prokurorinë barrën për të treguar ekzistencën e një "*lidhjeje thelbësore ndërmjet asetit dhe veprës*" Arsyja kryesore që preferohen procedimet civile ndaj procedimeve penale, është barra më e ulët e provës. Ama nga ana tjetër, një model i tillë ka disavantazhin e moslejimit të autoriteteve për përdorimin e atyre mjeteve të hetimit që janë tipike për gjykimin e çështjes penale (*duke iu referuar sidomos mundësisë për të kryer format e përgjimit elektronik: mbi të gjitha, përgjimet telefonike*).

Modeli i sipërpërmendur është baza e Ligjit për Fitimet nga Krimi i vitit 2002 (POCA) i cili trajton që të dy urdhrat e konfiskimit kundër personave të dënuar si edhe masat (rikuperimi civil dhe konfiskimi i kartëmonedhave) që lejojnë konfiskimin e fitimeve të krimit pa patur nevojën e një dënimi penal. Kthimi civil është një formë

¹² Vervaele, botim 1998.

konfiskimi asetesh i pabazuar në dënim që lejon kthimin në procedim civil para gjykatës së lartë të pronave të cilat janë fituar nëpërmjet veprimtarive të paligjshme. Padia është kundër vetë pronës (*in rem*) dhe jo kundër individit (*in personam*). Rrjedhimisht, personi që është zotërues i asetëve që janë subjekt i urdhrit mund të mos jetë personi i cili ka kryer veprimtaritë e paligjshme. Këto procedime janë procese civile ku gjen zbatim standardi civil i provës (balanca e probabiliteteve)¹³. Nuk është e nevojshme që të provohet kryerja e një veprë penale specifike nga një person i vegantë. Megjithatë, gjykata nuk mund të nxjerrë në urdhrin e kthimit dispozita që janë në kundërshtim me të drejtat e Konventës¹⁴. Procedura thjeshtohet kur asetet që fitohen direkt nëpërmjet sjelljes së paligjshme (*apo ekuivalentes*) apo që synohet të përdoren për të kryer një krim, janë kartëmonedha (*përfshirë çeqet, obligacionet etj*). Konfiskimi i kartëmonedhave (*cash*) është një procedurë e përshpejtuar për konfiskimin pa dënim që përdoret nga magjistratet për marrjen e parave

Ligji ynë përpara ndryshimeve kishte këtë tipar e bazohej kryesisht në procedurën civile. Kjo zgjidhje pranohet në doktrinën bashkëkohore, *ku procedimi civil për sekuestrimin/konfiskimin është një procedim gjyqësor in rem i cili vepron ndaj pasurisë* (i shkëputur dhe në mënyrë autonome nga procedimi penal) përkundërt procedimit penal kundër personit i cili është procedim gjyqësor *in personam*. Në këtë të fundit, sekuestrimi/konfiskimi janë veprime hetimore dhe rezultat i një vendimi të organit procedues mbi deklarinimin fajtor të personit për një veprë penale. Ky procedim gjyqësor, i cili është një procedim gjyqësor *sui generis*, do të zhvillohet duke marrë në çdo rast për bazë parimet e një procesi të rregullt ligjor dhe të drejtat e liritë themelore të njeriut.

Tashmë ligji i ri ka ndërruar tipar dhe bazohet tërësisht në eksperiencën e ligjit italian. Kjo pasi ndryshimet janë thelbësorë. Kështu objekti i të vepruarit të ligjit tashmë është zgjeruar duke përfshirë në fushën e veprimit të tij dhe veprat penale të tjera nga ato të cilat kishte ligji i vjetër.¹⁵ Në fushën e veprimit të tij janë shtuar veprat penale të korrupsionit në tërësi si dhe gjithë veprat penale që janë tashmë në kompetencën lëndore të Gjykatës së Antikorrupsionit dhe Krimin të Organizuar sipas ndryshimeve në nenin nr. 75/a të KPrP¹⁶ të ndryshuar me ligjin nr. 35/2017 “Për

¹³ Section 241 POCA

¹⁴ Seksioni 266 POCA

¹⁵ Sipas ndryshimit në pikën 1 të ligjit, Objekti është shtuar shprehja “ ..dhe krime të tjera “

¹⁶ Neni 75/a “Kompetencat e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar gjykon: a) krimet e parashikuara nga nenet 244, 244/a, 245, 245/1, 257, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e; b) çdo veprë penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal; c) akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkisë, deputetit, zëvendësministrit,

disa ndryshime në KPrP”. Ajo çfarë është më e rëndësishme në këtë ndryshim është përfshirja e veprave penale në fushën e korrupsionit dhe të theksuarit se në këtë rast fillon procedimi pasuror *kur ka indicie për përfitim pasuror të paligjshëm*.¹⁷

Zgjerimi i veprave penale të tjera në fushën e veprimit të këtij ligji, njëkohësisht me mundësinë që ky ligj të përdoret dhe nga juridiksioni i zakonshëm i prokurorive dhe gjykata rrit mundësitë e këtyre organeve për të bërë të mundur hetimin pasuror për vepra penale të cilat nuk janë më në kompetencën e prokurorisë dhe gjykatës së posaçme, por në të njëjtën kohë lë dyshime për efikasitetin në procedurat e hetimit pasuror një procedurë që kërkon një specializim dhe një kujdes të posaçëm gjatë aplikimit.

Ngushtimi i rrethit të personave ndaj të cilëve vepron ligji antimafia është një nga hapat pozitive në ndryshimet e fundit të tij. Tashmë dispozitat e ligjit zbatohen ndaj pasurive të personave të përmendur në pikën 1 të nenit 3 të tij¹⁸, në pronësi ose të zotëruara në mënyrë të tërthortë nga persona të afërm e konkretisht bashkëshorti, fëmijët, të paralindurit, të paslindurit, të paralindurit, vëllezërit, motrat, bashkëjetuesi për të cilët prezumohet regjistrimi i rremë i pasurisë.¹⁹ Rethi i gjerë i personave ndaj të cilëve vepronte ligji e bënte këtë një zgjerim formal, pasi asnjëherë hetimet pasurore nuk shtriheshin aq gjerë duke e bërë thuajse të pamundur.

Në drejtim të një garancie më të madhe për mbrojtjen pasurisë së ligjshme të kësaj kategorie personash, në kuptim të standardit mbi të cilin bazohet procedimi pasuror ligji i ri sjell një hap pozitiv, pasi në është theksuar tashmë që prezumimi i regjistrimit të rremë të kësaj kategorie personash të të afërmeve të subjektit, zbatohet *kur ka të dhëna të dobishme, të siguruara në rrugë të ligjshme, të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm për paligjshmërinë e origjinës së pasurisë*.²⁰ Ky lloj përcaktimi përbën një standard më të fortë e të sigurt provueshmërie duke kërkuar të dhëna të dobishme dhe që sigurohen në njërin nga mundësitë procedurale ligjore me qëllim mbështetjen e dyshimit të arsyeshëm të origjinës së pasurisë. Kriteret mbi të cilat vendoset sekuestrimi dhe konfiskimi janë përcaktuar më qartë në ligjin e ri, nga ku tashmë është saktësuar se duhet që indiciet të tregojnë qartë përfshirjen në veprimtarinë kriminale.²¹

Ligji i vjetër nuk kishte një parashikim të tillë duke bërë që dyshimet për

anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj;

ç) akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës.”.

¹⁷ Shkronja d) paragrafi i parë i nenit 3, të ligjit, i ndryshuar me ligjin nr. 70/2017

¹⁸ Neni 3, „Fusha e zbatimit, e ndryshuar me ligjin nr. 70/2017.

¹⁹ Neni 3, paragrafi 2, shkronja a), e ndryshuar me ligjin nr. 70/2017.

²⁰ Paragrafi 4 i nenit 3 të ligjit të ndryshuar me ligjin nr. 70/2017.

²¹ Neni 11, kriteret për sekuestrim të pasurisë.

regjistrimin e rremë të pasurisë të mos ishin të bazuara. Kjo përbën një garanci më tepër në mbrojtjen e pasurisë së ligjshme të personave të të afërmeve të dyshuar për përfitim pasuror kriminal duke rregulluar në këtë mënyrë një nga çështjet me delikate të tij. Është e vërtetë që procedimi pasuror është një procedim *in rem* e jo *in personam*, por e drejta e pronës është një nga të drejtat kryesore të individit e gëzon mbrojtje të veçantë nga ana e KEDNJ.

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, thekson se procedimet *in rem*, që nuk lidhen me gjetjen apo ndëshkimin e autorit, nuk mbulohen nga paragrafi 3 i Nenit 6 të KEDNJ që ka të bëjë me të drejtat e personave të akuzuar për një vepër penale, por vetëm nga paragrafi i parë i këtij neni, e drejta për një proces të rregullt ligjor.²²

Në një Vendim Gjykata e Kasacionit në Itali²³ shprehet se “... në rastin e vërtetimit që një pasuri nuk i përket personit të supozuar gjyqtari nuk duhet të bazohet vetëm tek rrethanat rastësore apo faktet që përbëjnë prova rrethore, por duhet të bazohet në fakte të forta, të sakta e të qëndrueshme që të mund të mbështesin e të tejkalojnë supozimin mbi përkimin e dukshëm e të tejkaluar midis pronësisë dhe disponueshmërisë efektive të pronës. Kjo duke patur si udhërrëfyes të barrës së provës lidhur me rigorizitetin e provueshmërisë së disponimit direkt të pronës së prejardhur nga aktiviteti kriminal e në pronësi efektive të një tjetri. Disponueshmëria duhet të vërtetohet thelbësisht, në kontrast me pronësinë e dukshme të të tretëve, ajo duhet të vërtetohet nga investigimet rigoroze, intensive dhe të thella, dhe jo nga konotacionet e rastit apo rezultatet e përcipta.”

Referuar veprimit invers të ligjit në kohë për pasuritë e personave, të vëna përpara hyrjes në fuqi të tij, tashmë kërkohen indicie të rëndësishme për përfshirjen në veprimtari kriminale të subjektit në kohën e vënies së pasurisë. Krahasuar me ligjin e mëparshëm ky është një standard më i lartë i provueshmërisë kjo pasi në kuptim të provës indiciet e rëndësishme kur janë më shumë dhe përputhen me provat e tjera barazohen në vlerë me provat e parashikuara nga ligji procedural. Edhe në këtë aspekt ndryshimet e ligjit përbëjnë një hap pozitiv.

Në marrëdhëniet me procedimin penal ky ligj tashmë bazohet në procedurën penale, duke u mbështetur në rregullimet procedurale penale dhe duke lejuar mundësinë që të përdoren të dhënat e marra gjatë procesit penal. Sigurisht që ky ndryshim ka pasur si qëllim rritjen e efektivitetit të procedimit pasuror dhe mundësinë e përdorimit të instituteve procedurale si mjete më të mira për të mbledhur të dhëna. Edhe të bazuarit në procedurën civile ishte një proces tërësisht i njëanshëm nga ana e prokurorisë, megjithëse ka mendime që procedura civile ofronte shumë mundësi mbrojtjeje në favor të barrës së të provuarit. Ndërsa procedimi penal ofron mundësi dhe garanci ligjore për procesin e rregullt ligjor, duke i

²² Çështja Brems, Vendimi i GJEDNJ 2005.

²³ Vendimi nr. 46857/2009 i Gjykatës së Kasacionit në Itali mbi aplikimin e ankuesit Angelo Fiorisi.

dhënë mundësi personit pasuria e të cilit është në procedim pasuror për t'u vënë në dijeni si rezultat i veprimeve hetimore të pyetet dhe ti merren deklarime mbi bazën e të cilave ai mund të japë shpjegimet e nevojshme që në fazën e hetimit pasuror .

Gjatë përdorimit të procedurës civile kjo ka qenë një çështje problematike, pasi subjektet paraqiteshin vetëm përpara Gjykatës, duke sjellë prova shkresore, të cilat nuk ishin në formën e duhur ligjore, çka i bënte formale dhe këto mundësi procedurale që ofronte kjo lloj procedure. Mbledhja e provave nga ana e prokurorisë bazuar në procedurën penale nënkupton hetimet e specializuara dhe të thelluara. Referimi në procedurën penale a e bën një ligj tërësisht penal dhe a referon të gjitha rregullat e instituteve penale.

Në lidhje me këtë çështje është interesante një gjykim i kryer nga *Gjykata Federale Penale Zviceriane*²⁴. Në këtë gjykim Gjykata rrëzoi kërkesën e paraqitur nga një person i dyshuar që i përkiste "Ndrangheta"s dhe i dënua në Itai për përfshirje në trafikim droge dhe dhënie parash me fajde, kundër vendimit të autoriteteve kompetente zviceriane për të pranuar kërkesën për asistencë juridike të paraqitur nga prokurori italian në kuadrin e procedurave të parandalimit.

Kërkesa për asistencë ishte drejtuar me marrjen e informacionit dhe dokumentacionit, me qëllim konfiskimin e llogarive bankare të vendosura në territorin zvicerian. Bazuar në premisën e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar mund të arrihet vetëm në kuadrin e procedimeve penale, Gjykata Zviceriane u ballafaqua me çështjen lidhur me natyrën ligjore të procedurave italiane të sekuestrimit dhe konfiskimit, me supozimin e natyrës interpretuese jo-detyruese të cilësimit ligjor që përdor legjislacioni kombëtar.

Nga ky këndvështrim gjykata zviceriane ka pranuar që mund të ofrohet asistencë gjyqësore ndërkombëtare për procedura, të cilat megjithëse jo-zyrtarisht penale, kanë për qëllim hapjen e procedimeve penale ose të lidhura ndryshe me një çështje penale. Mbi bazën e këtyre argumenteve, Gjykata Zviceriane pranoi natyrën thelbësisht penale të procedimeve në lidhje me sekuestrimin dhe veçanërisht konfiskimin. Kështu, ajo hodhi poshtë ankesën kundër zbatimit të asistencës gjyqësore ndërkombëtare.

Arsyetimi i gjykimit citoi jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, e cila konstatoi se konfiskimi parandalues, përbën ndërhyrje në të drejtën e një personi për të gëzuar paqësisht pasuritë e tij, por është e përcaktuar me ligj dhe në proporcion me qëllimin e legjitim të ndjekur, duke i shërbyer interesit të përgjithshëm me anë të parandalimit të përdorimit të paligjshëm në një formë që është e rrezikshme për shoqërinë, të pasurive origjina e ligjshme e të cilave nuk është e përcaktuar.

Në këtë këndvështrim, Gjykata Europiane theksoi se masa parandaluese pasurore është pjesë e një politike të parandalimit të krimit, ajo gjykoi se për zbatimin e një politike të tillë, organi ligjvënës duhet të ketë një hapësirë të gjerë

²⁴ Vendimi i datës 21 Janar 2011 nga Gjykata Federale Penale Zviceriane, Divizioni i dytë.

vlerësimi, si në lidhje me ekzistencën e një problemi që prek interesin publik, i cili kërkon masa të kontrollit dhe mënyrën e duhur për zbatimin e këtyre masave. Gjykata më tej vërejtë se në Itali problemi i krimit të organizuar ka arritur një nivel shumë shqetësues. Fitimet kolosale që organizatat kriminale nxjerrin nga akti-vitetet e tyre të paligjshme u japin atyre një shkallë pushteti që vë në rrezik sundimin e ligjit brenda Shtetit. Mjetet e përdorura për të luftuar këtë pushtet ekonomik, veçanërisht masa parandaluese e konfiskimit, mund të shfaqet si e domosdoshme për vazhdimin me sukses të betejës kundër organizatave në fjalë.

Përveç kësaj, Gjykata Europiane njohu përputhshmërinë e procedurës së konfiskimit në lidhje me parimet e procesit të rregullt dhe të drejtën e mbrojtjes. (neni 6 KEDNJ). Gjykata e Strasburgut vuri në dukje se procedurat për zbatimin e masave parandaluese pasurore kryhen në prani të dy palëve para tre gjykatave të njëpasnjëshme, Gjykatës së Rrethit, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Kasacionit. Në veçanti të pandehurit, duke udhëzuar avokatinë e tyre, janë në gjendje të ngrenë kundërshtime dhe paraqesin provat që ata i konsiderojnë të domosdoshme për të mbrojtur interesat e tyre, gjë që tregon se respektohen të drejtat e mbrojtjes.²⁵

Për më tepër, Gjykata Europiane vërejtë se gjykatave italiane nuk u lejohet të bazojnë vendimet e tyre thjesht mbi dyshime. Ato duhet të përcaktojnë dhe vlerësojnë në mënyrë objektive faktet e paraqitura nga palët dhe nuk ka asgjë që sugjeron se ato vlerësojnë arbitrarisht provat e paraqitura para tyre. Sipas Gjykatës Zviceriane, aspektet procedurale të konfiskimit të sipërpërmendura, të miratuara pas përfundimit të një procesi thelbësisht gjyqësor, të mbështetura në garanci të ngjashme me ato të gjyqimit penal, përbëjnë elemente konkludues të një natyre penale të kësaj mase dhe të procedimeve përkatëse.²⁶ Siç duket, në themel të këtij vlerësimi të bërë nga autoriteti gjyqësor i huaj, ka qënë aftësia e gjyqësorit italian për të ndërtuar një “*ligj në veprim*” në përputhje me standardet ndërkombëtare të “*gjyqimit të drejtë*”.²⁷ Një zhvillim i tillë është shoqëruar me një sistem veçanërisht të efektshëm të kontrollit të përdorimit të pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm, si kundër-masë ndaj ndërveprimit kompleks midis Mafias dhe ekonomisë në Italinë Veriore, si dhe në Jug.

Si konkluzion mund të themi që ligji i ri përbën një hap përpara në identifikimin e natyrës ligjore të tij, si në raport të efektivitetit të procedimit pasuror ashtu edhe të garancive e balancimit të të drejtave pasurore të personave ndaj të cilit ai vepron. Do ishte e rekomandueshme që ligji ynë të kishte *rregulla më të detajuara të ngjashme me ato të ligjit italian*. Kjo pasi procedimi *in rem* duhet të jetë më fleksibël

²⁵ Çështja Brems, Vendimi i GJEDNJ, 2005

²⁶ Balsamo and Luparello, referim 2013.

²⁷ Antonio Balsamo, referim në seminarin me temë “Konfiskimi nëpërmjet ligjit antimafia”, organizuar nga PAMECA, 20 nëntor 2017

sesa procedimi penal, pasi jo çdo institut procedimi penal është i zbatueshëm në procedimin pasuror.

Ligji mund të ketë në përmbajtje të tij të drejta të përcaktuara në mënyrë të shprehur si atë të mbrojtjes, të drejtën për t'u informuar pa vonesë për procedimin, atë për ndihmë ligjore falas, dhe të drejtat për të marrë e mbledhur prova gjatë fazës së hetimit pasuror, për të pyetur dëshmitarë e për t'u njohur me to.

Meqenëse prezumimi i pafajësisë nuk gjen zbatim në këtë rast, ligji duhet të kishte të drejta që tejkalojnë përmbajtjen e Konventës dhe rregullat e procedurat tipike procedurale p.sh. pamundësinë për të përdorur deklaratimet e mëparshme të dëshmitarëve (*deklaruesve*), të ashtuquajturat leximet e lejueshme apo kundërshtimet e dëshmisë si tejkallim i parimit të marrjes së provës në mënyrë të drejtpërdrejtë.

E drejta europiane e shprehur në direktivën e re të Këshillit të Prillit 2014,²⁸ e vë theksin tek *garancitë e posaçme dhe mjetet gjyqësore në dobi të garantimit të së drejtës së pronës së ligjshme*. Tendenca europiane është në procedurat e përcaktuara qartë dhe në kompetencën e gjykatave të specializuara, si dhe në përdorim inovativ të rregullave të veçanta, e aplikimit me sukses i kërkesave për bashkëpunim ndër-kombëtar. Gjithashtu tendenca është që procedimet pasurore të zhvillohen në përfundim të procedimit penal e pasi të kemi një vendim penal të formës së prerë.

Në këto drejtime mund të orientohet në të ardhmen dhe ligji ynë me qëllim përmbushjen e garancive për mbrojtjen e pasurisë së ligjshme të shtetasve ndaj të cilëve vepron ligji.

BIBLIOGRAFIA

Kodi i Procedurës Penale

Kodi i Procedurës Civile

Ligji “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar” nr. 9284, datë 30.09.2004.

Ligji nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Ligji 35/2017 datë 27.04.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10192 datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Ligji 70/2017 “Për disa ndryshime në KPrP”

Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 1, datë 25.01.2007

Raporti i Konferencës së organizuar nga Komisioni Europian, Misioni EURALIUS dhe Gjykata e Krimeve të Rënda “Praktikat më të mira të drejtësisë penale - Aktiviteti i Gjykatës së Krimeve të Rënda kontribut solid në luftën kundër krimin të organizuar”, mbajtur nga Sandër Simoni, 13 korrik 2012. www.gjkr.gov.al.

²⁸ Direktiva e Këshillit të Ministrave të KE 2014/42/EU

Codice Antimafia, Legge 17/10/2017 nr. 161, G.U.04/11/2017.

Falkone and Turone, 1983, Relacion para Ministrisë së Drejtësisë Italiane.

Direktiva e Këshillit të Ministrave të KE 2014/42/EU.

Cështja Brems, Vendimi i GJEDNJ 2005.

Vendimi nr. 46857/2009 i Gjykatës së Kasacionit në Itali mbi aplikimin e ankuesit Angelo Fiorisi.

Vendimi i datës 21 Janar 2011 nga Gjykata Federale Penale Zviceriane, Divizioni i dytë.

Ligjin për Reformën e Konfiskimit të Aseteve Civile të vitit 2000, SHBA.

Fjalët kyçe: *ndyshimet, ligj, antimafia.*

REFORMA LIGJORE NË SEKUESTRIMIN DHE KONFISKIMIN E PRODUKTEVE TË VEPRËS PENALE (PROCEDIMI PARANDALUES OSE LIGJI ANTI-MAFIA)

Prof.As. Lirime ÇUKAJ (PAPA)

Universiteti i Tiranës

Fakulteti i Drejtësisë

Lektore në Departamentin Penal

e-mail: lilicukaj@yahoo.it

Mob: 0692170468, Tel: 042236945.

Elsa MIHA

Prokurore Pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë

email elsamiha@yahoo.it

Tel 0699113630

ABSTRAKT

Vazhdimi i mëtejshëm i reformave ligjore në procedimin parandalues, nëpërmjet ndryshimit të ligjit Antimafia

Ligji Antimafia, ashtu si edhe ligji kundër Krimit të Organizuar (këtu e në vijim KO), në momentin e miratimit të tij, pati si qëllim luftën kundër KO-së, nëpërmjet sekuestrimit dhe konfiskimit të produkteve që rrjedhin nga aktivitete të tilla kriminale. Ky procedim ndryshe njihet edhe me emrin procedimi parandalues. Ky ligj ishte vazhdim dhe përmirësim i ligjit kundër Krimit të Organizuar dhe i reformave të nisura ndaj krimit të organizuar, por miratimi i këtij ligji nuk kënaqi pritshmëritë e ligjvënësit. Në këto kushte u pa e domosdoshme që të vazhdohej reforma e këtij ligji, me qëllim rritjen e efikasitetit të tij. Kështu u miratuan ndryshimet në vitin 2014, të cilat zgjeruan fushën e veprimit të ligjit, duke shtuar veprat penale në fushën e korrupsionit pasiv dhe aktiv.

Por këto ndryshime ishin pjesore dhe nuk ishin një reformë e mirëfilltë ligjore. Në kuadër të reformave ligjore në tërësi u pa e udhës që të bëheshin ndryshime edhe në ligjin Antimafia. Ndryshimet ishin të shumta dhe pozitive, ato filluan me ndryshimin e titullit të ligjit, vazhduan me ndryshimin e procedurës për vendosjen e sekuestrimit, përmirësuan procedurat e ekzekutimit, përcaktuan vendosjen e konfiskimit edhe kryesisht nga vetë gjykata kur ka një masë të vlefshme sekuestrimi. Procedimi parandalues zgjeroi fushën e veprimit, pasi shtoi numrin e veprave penale ndaj të cilave vepron, ndërkohë kemi një reduktim të subjekteve ndaj të cilëve vepron. Kemi një shtim të gjykatave, ku masat me karakter pasuror do të gjykohen edhe nga gjykatat e rretheve gjyqësore. Ka një përcaktim më të qartë të barrës së provës, si dhe një rregullim ligjor më të drejtë në lidhje me revokimin

e sekuestrimit. Kur revokohet sekuestrimi, pasuria i kthehet personit, i cili ka të drejtë të kërkojë edhe pagimin e dëmit të shkaktuar. Këto dhe jo vetëm do të jenë objekt trajtimi në këtë artikull joshterues.

Fjalë kyçe: sekuestrim, konfiskim, reformë ligjore, produkte të veprimtarive kriminale

1. Reforma ligjore në ligjin Antimafia të vitit 2017

Në kuadër të reformës në drejtësi, e cila përfshiu pothuajse të gjitha fushat dhe sektorët e saj, u pa e domosdoshme që të vazhdohej reforma edhe në ligjin Antimafia. Objekti i këtij ligji para ndryshimeve të vitit 2017, por duke përfshirë ato të vitit 2014, ishte lufta kundër krimit të organizuar, akteve terroriste, akteve korruptive.

Zbatimi i këtij ligji në praktikë nuk kënaqi pritshmëritë e ligjvënësit, prandaj u pa e udhës që të bëhej një reformë ligjore që të rriste në praktikë efikasitetin e këtij ligji, duke sekuestruar dhe konfiskuar sa më shumë pasuri që rrjedhin nga aktiviteti kriminal. Reforma ishte e gjithanshme dhe gjithë përfshirëse, por ajo ka pak kohë që po zbatohet, nuk na ngelet gjë tjetër veçse të presim, për të dalë në kokluzionin, që kjo reformë ishte e duhura dhe urojmë që në praktikë të japë rezultatin e duhur.

Reforma filloi me plotësimet e titullit të ligjit Antimafia.

2. Ndryshimet e titullit të ligjit

Ligji Anti-mafia kishte si qëllim sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të veprës penale, që rridhnin nga aktivitete kriminale. Këto masa me karakter pasuror sipas titullit të ligjit Antimafia drejtoheshin ndaj krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit, ndërkohë vetë ligji Anti-mafia për nga objekti i tij nuk vepronte vetëm kundër këtyre veprave penale por edhe ndaj akteve terroriste dhe veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale.

Pra dukshëm titulli nuk ishte i plotë dhe gjithë përfshirës, prandaj ndryshimet filluan që nga titulli, i cili ndryshoi¹ si më poshtë:

“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar.

Ashtu siç e thamë edhe më lart, reforma në këtë ligji ishte e thellë dhe pa diskutim ajo do të prekte thelbin e këtij ligji, masat me karakter pasuror, qoftë sekuestrimin apo edhe konfiskimin. Le ta shohim në vijim reformën ligjore në lidhje me masat me karakter pasuror.

¹ Për më shumë shiko nenin 1 të ligjit me nr.70/2017.

3. Sekuestrimi sipas ligjit me nr. 70/2017 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin me nr. 10 192, dt.3.12.2009, “PËR PARANDALIMIN DHE GODITJEN E KRIMIT TË ORGANIZUAR, TRAFIKIMIT DHE KORRUPSIONIT NËPËRMJET MASAVE PARANDALUESE KUNDËR PASURISË”, të ndryshuar

Edhe pse ligji Antimafia, i ndryshuar, kishte si qëllim sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të veprës penale, ai nuk kënaqi pritshmëritë e organeve ligjzbatuese, gjatë zbatimit të tij në praktikë pati probleme. Në këtë këndvështrim ndryshime ndodhin edhe në institutin e sekuestrimit, në procedurën e miratimit të sekuestrimit².

Sekuestrimi si një masë e shpejtë procedurale, parandaluese, por e përkohshme, që nuk pret vendoset nga gjykata në dhomë këshillimi pa prezencën e palëve. Gjykata e shqyrton këtë kërkesë vetëm mbi bazën e akteve të depozituara nga prokurori por pa prezencën e asnjë prej palëve as të prokurorit dhe as të personave, ndaj pasurive të të cilit vendoset sekuestrimi si masë paraprake. Kjo kërkesë shqyrtohet brenda afatit prej 5 ditësh.

Me ndryshimet e ligjit nuk ka ndryshuar ekzekutimi, pasi edhe ligji me nr. 70/2017 përcakton ekzekutimin e menjëhershëm pas shpalljes nga gjykata kompetente³. Vlefshmëria e kësaj mase është po 6 muaj, duke filluar nga momenti i zbatimit të saj. Në rastin e verifikimeve komplekse, me kërkesë të prokurorit ose kryesisht, gjykata mund të vendosë zgjatjen e afatit të zbatimit të masës së sekuestrimit për periudha gjashtëmuajore, por jo më shumë se dy vjet nga data e fillimit të afatit prej 6 muaj.

Masa e sekuestrimit përpos se është një masë e shpejtë është edhe një masë provizore, në këtë këndvështrim ajo jo vetëm duhet të shqyrtohet shpejt nga gjykata e shkallës së parë, për të garantuar mostransferimin e pasurisë por edhe kaq shpejt duhet të gjykohet në gjykatën e apelit kompetente qoftë për të garantuar dhe vendosur sekuestron, por qoftë edhe për të garantuar të drejtat e ligjshme të pasurisë të prekura nga vendimi i gjykatës së shkallës së parë, parë në këtë këndvështrim ligji vendos detyrimin për gjykatën e apelit kompetente, që ta shqyrtojë ankimin e ushtruar nga palët brenda 15 ditëve nga marrja e akteve.

4. Ekzekutimi i masës së sekuestrimit sipas ligjit me nr. 70/2017

Ndryshimet e reja ligjore të ligjit Antimafia, me ligjin me nr. 70/2017, sollën edhe një risi pozitive pasi përcaktuan edhe procedurën e ekzekutimit të vendimit të sekuestros⁴.

²Neni 12 i ligjit me nr. 70/2017.Procedura e sekuestrimit 1. Kërkesa për sekuestrimin e pasurisë shqyrtohet nga gjykata në dhomën e këshillimit, brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes, në bazë të dokumenteve dhe akteve të paraqitura nga prokurori.

³Neni 12 Procedura e sekuestrimit 1 2. Vendimi për masën e sekuestrimit është i ekzekutueshëm me shpalljen e tij

⁴Për më shumë shiko nenin 15 të ligjit me nr. 70/2017.

Vendimi i sekuestrimit është një vendim që ekzekutohet në mënyrë të menjëhershme, për shkak edhe të natyrës së këtij vendimi i cili duhet të bëjë të mundur bllokimin e pasurive, pengimin e tjetërsimit të pasurive produkt i veprës penale, në të ardhmen, pra mbrojtjen e një interesi publik. Procedura e ekzekutimit fillon nga sekretaria e gjykatës që ka dhënë vendimin, e cila i dërgon, pa vonesë, dy kopje të vendimit prokurorit që ka paraqitur kërkesën.

Procedura vazhdon më tej njëlloj siç ekzekutohen edhe vendimet penale, pasi është prokurori që merr masa për vënien në ekzekutim të vendimit nëpërmjet oficerit të policisë gjyqësore, por këtu shtohet edhe administratori i pasurive, i caktuar nga agjencia.

Ligji bën një përcaktim më të qartë të mënyrës së ekzekutimit të vendimit të sekuestrimit, në varësi të llojit të pasurisë së sekuestruar.

Kështu sekuestrimi ekzekutohet: a) për pasuritë e luajtshme dhe shumat monetare, sipas rregullave të përcaktuara nga Kodi i Procedurës Civile, në rastet e rizotërimit të aseteve nga debitori ose nga pala e tretë;

b) për pasuritë e luajtshme ose të paluajtshme në zyrat kompetente për regjistrimin e tyre;

c) për pasuritë e shoqërive tregtare, përveç mënyrës të parashikuar nga ky ligj për çdo pasuri tjetër të sekuestruar, edhe me anën e regjistrimit të vendimit në regjistrin e shoqërive tregtare;

ç) për kuotat dhe aksionet, me anën e publikimit në regjistrin e shoqërive tregtare dhe shënimin në regjistrat kontabël të shoqërisë.

Akti që vë në lëvizje ekzekutimin e vendimit të sekuestrimit është urdhri i prokurorit. Ky urdhër ekzekutohet nga policia gjyqësore, e cila procedon me marrjen e pasurisë dhe dorëzimin tek administratori i saj edhe kur personat që preken nga masa kanë të drejta reale ose personale për t'i gëzuar ato. Policia gjyqësore u njofton masën e sekuestrimit të pasurive personave ndaj të cilit është vendosur masa e sekuestrimit. Policia gjyqësore u njofton, gjithashtu, personave të mësipërm, edhe vendimin e gjykatës për shtyrjen e afatit të sekuestrimit. Kur masa e sekuestrimit caktohet ndaj pasurisë së paluajtshme ose pasurisë së regjistruar në regjistra publikë, administratori i emëruar njofton menjëherë këtë masë në zyrat pranë të cilave mbahen këta regjistra.

Ligji me nr. 70/2017 rregullon edhe rastet kur sendi mbahet pa titull pronësie ose në bazë të një titulli që daton përpara datës së vendimit të sekuestrimit dhe poseduesi i sendit nuk pranon ta dorëzojë atë vullnetarisht. Në këtë rast gjykata urdhëron lirimin e sendit. Ky urdhër i gjykatës ekzekutohet nga policia gjyqësore.

Policia gjyqësore në të gjitha rastet mban inventarin dhe përshkruan pasurinë e sekuestruar në një raport, i cili nënshkruhet nga të pranishmit. Ky raport përmban elementet e parashikuara nga neni 524 i Kodit të Procedurës Civile. Gjatë marrjes në dorëzim të pasurisë së sekuestruar nga administratori, policia gjyqësore u dorëzon një kopje të raportit, personave të pranishëm në kohën e inventarit.

Pas këtij momenti policia gjyqësore dorëzon pasurinë e sekuestruar tek administratori, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës ligjor dhe, nëse ka, edhe me regjistrat e llogarive të shoqërisë tregtare. Administratori i pasurisë, për qëllime të administrimit dhe në mungesë të dokumentacionit të parashikuar më sipër vë në dispozicion të audituesit ligjor, të caktuar nga Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, të dhënat e nevojshme për administrimin e pasurisë, duke i kërkuar hartimin e një raporti. Raporti vihet në dispozicion të Agjencisë. Pas përfundimit të procedurave të ekzekutimit, administrimi bëhet nga agjencia sipas rregullave të përcaktuara në aktet e saj ligjore.

Me ndryshimet ligjore të ligjit Anti-mafia me ligjin 70/2017⁵, gjykata thërrret kryesisht Kryeadministratorin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara për të marrë informacion për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe për çdo të dhënë tjetër që e konsideron të dobishme për vendimin e konfiskimit.”

5. Konfiskimi sipas ligjit me nr. 70/2017

Ndryshimet ligjore të ligjit Antimafia sollën edhe një risi tjetër, pasi gjyqtari kryesisht mund të vendosë konfiskimin edhe kur nuk ka një kërkesë për konfiskim nga prokurori. Ky rast ndodh atëherë kur gjykata po gjykon në seancën e posaçme, 5 ditë para afatit të përfundimit të sekuestrës⁶, pra në ato raste kur ka një masë sekuestro të vlefshme dhe akoma në fuqi.

Në lidhje me shqyrtimin e kërkesës për konfiskim, nuk ka ndonjë ndryshim të kushteve ligjore, por më shumë një plotësim të tyre. Duke pasur parasysh se në praktikë subjektet mbi të cilat vepronte ligji justifikoheshin duke thënë që këto nuk janë pasuri të vendosura për shkak të mosdeklarimit të të ardhurave, por janë pasuri të fituara në mënyrë të ligjshme. Ligji e ndalon përdorimin e këtij justifikimi pasi parashikon se⁷: *“Në çdo rast, personi nuk mund të përligjë pasurinë, duke deklaruar si burim të saj të ardhura ose riinvestime, që rrjedhin nga mospagimi i taksave dhe tatimeve”*.

Gjithashtu ligji parashikon se gjykata vendos pranimin e kërkesës për konfiskimin e pasurisë edhe kur akuza ose procedimi penal në ngarkim të personit ndaj të cilit ka filluar procedimi parandalues ose penal sipas këtij ligji, pushohet ose ai deklarohet i pafajshëm, me përjashtim të rasteve kur në vendimin e pushimit ose të pafajësisë deklarohet se: a) fakti nuk ekziston; b) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale; c) del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale.”. Ky parashikim është i pranueshëm ligjërisht pasi në këto raste personi nuk mban përgjegjësi penale, pasi në rastet e mësipërme personi nuk ka shkaqe dënueshmërie

⁵ Për më shumë shiko nenin 19, të ligjit 70/2017.

⁶ Për më shumë shiko nenin 22 të ligjit me nr. 70/2017.

⁷ Për më shumë shiko nenin 25 të ligjit me nr. 70/2017.

dhe se qartazi ai nuk e ka kryer veprën penale, ndërsa në rastet e tjera mund të vendoset sekuestrimi dhe konfiskimi, për rastet e tjera të pushimit të gjyqimit ose të pushimit të çështjes sipas nenit 328 të K.Pr.Penale.

Kështu në vijimësi do të flasim për reformën e ligjit për sa u përket subjekteve dhe objektit të veprimit të tij.

6. Objekti dhe subjektet e ligjit Antimafia sipas ligjit me nr. 70/2017

Ndryshimet ligjore patën si qëllim zgjerimin e fushës së zbatimit të ligjit Antimafia pasi u shtuan edhe disa vepra penale ndaj të cilave veprojnë masat me karakter pasuror apo procedimi parandalues. Sigurisht zgjerimi i fushës së veprimit ka si qëllim edhe rritjen e efikasitetit të zbatimit të ligjit.

Ndryshimet ligjore të ligjit Antimafia me ligjin me nr. 70/2017, kanë shtuar të gjitha veprat penale që kryhen nga banda e armatosur, organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal, të parashikuara nga kreu XI i Kodit Penal. Ndërkohë në ligjin Antimafia kishte vetëm disa krime që lidheshin me Krimin e Organizuar, ato të nenit 234/a dhe 234/b. Ky shtim i fushës së veprimit të ligjit për çfarëdo lloj vepre penale që kryen banda e armatosur dhe grupi i strukturuar kriminal është e lidhur me qëllimin që kanë këto organizata. Kanë si qëllim përfitime të paligjshme, kështu që ky ndryshim ishte i domosdoshëm dhe i pritshëm.

Ndërkohë kemi shtim të veprave penale të mëposhtme të parashikuara në nenet, 164/b⁸, 183⁹, 245/1¹⁰, 256¹¹, 257¹², 257/a¹³, 258¹⁴, 259¹⁵, 259/a¹⁶, 319¹⁷, 319/

⁸ Neni 164/b Korrupsioni pasiv në sektorin privat

⁹ Neni 183 Falsifikimi i monedhave

¹⁰ Neni 245/1 Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike.

¹¹ Neni 256 Shpërdorimi i kontributeve të dhëna nga shteti.

¹² Neni 257 Përfitimi i paligjshëm i interesave.

¹³ Neni 257/a Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim.

¹⁴ Neni 258 Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike.

¹⁵ Neni 259 Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike.

¹⁶ Neni 259/a Korrupsioni pasiv i nëpunësve të huaj publikë.

¹⁷ Neni 319 Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë.

a¹⁸, 319/b¹⁹, 319/c²⁰, 319/d²¹, 319/dh²² dhe 319/e²³ të Kodit Penal, në rastet kur ekzistojnë indicie për përfitim pasuror të paligjshëm. Këto vepra penale, të tilla si korrupsioni në sektorin privat, në sektorin publik, i nënpunësve dhe funksionarëve të huaj, apo ndërkombëtarë, ushtrimi i ndikimit të paligjshëm, falsifikimi i monedhave, refuzimi për deklaram, shpërdorimi i kontributeve të dhëna nga shteti, përfitimi i paligjshëm i interesave, shkelja e barazisë në tendera, janë vepra penale që prodhojnë produkte dhe kanë si qëllim përfitimin, prandaj ligji Antimafia duhet të veprojë edhe ndaj këtyre veprave, të cilat prodhojnë produkte.

Ndërkohë që është përjashtuar nga fusha e veprimit neni 114/b, për shkak se ky nen është i shfuqizuar dhe ky ndryshim ishte po i domosdoshëm.

Njëkohësisht, ndryshe nga sa pritej, ky ligj solli një reduktim të subjekteve të afërme ndaj të cilëve drejtohet²⁴, duke ulur kështu pritshmëritë për efikasitet. Pasi dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj pasurive të personave që dyshohen për pjesëmarrje në aktivitet kriminal, në pronësi ose të zotëruara në mënyrë të tërthortë nga: a) personat e afërm (bashkëshorti, fëmijët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit, motrat, bashkëjetuesi), pra kemi një reduktim të të afërmëve ndaj të cilëve vepron. Sipas ligjit Antimafia të pandryshuar ai vepronte ndaj një rrethi subjektësh më të gjerë, sië ishin të afërmit sipas nenit 16 të Kodit të Procedurës Penale, konkretisht: bashkëshorti, fëmijët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit, motrat, ungjërit, emtat, nipërit, mbesat, fëmijët e vëllezërve dhe të motrave, vjehri, vjehrra, dhëndri, nusja, kunata, kunati, bashkëjetuesi, thjeshtri, thjeshtra, njerku dhe njerka. Sot ligji vepron vetëm ndaj :bashkëshortit, fëmijëve, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit, motrat, bashkëjetuesi, duke mos vepruar ndaj subjekteve të tjerë; ungjërit, emtat, nipërit, mbesat, fëmijët e vëllezërve dhe të motrave, vjehri, vjehrra, dhëndri, nusja, kunata, kunati, thjeshtri, thjeshtra, njerku dhe njerka

Prezumimi i regjistrimit të rremë të pasurive dhe veprimtarive ekonomike të personave të cilët janë marrë me aktivitet kriminal, në emër të personave të afërm, zbatohet kur ka të dhëna të dobishme, të siguruar në rrugë të ligjshme, të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm për paligjshmërinë e origjinës së pasurisë.

Të dhënat e mjaftueshme që pasuritë ose veprimtaritë e personit fizik ose juridik të zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të tërthortë, nga personat që ushtrojnë aktivitet kriminal, nxirren nga marrëdhënia ndërmjet personit fizik

¹⁸ Neni 319/a Korrupsioni aktiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare.

¹⁹ Neni 319/b Korrupsioni aktiv i arbitrit vendas dhe të huaj.

²⁰ Neni 319/c Korrupsioni aktiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja.

²¹ Neni 319/d Korrupsioni pasiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare.

²² Neni 319/dh Korrupsioni pasiv i arbitrit vendas dhe të huaj.

²³ Neni 319/e Korrupsioni pasiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja.

²⁴ Për më shumë shiko nenin 5 të ligjit me nr. 70/2017.

dhe juridik me personat e përfshirë në aktivitet kriminal dhe nga të dhëna të dobishme, të siguruara në rrugë të ligjshme, të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm për paligjshmërinë e origjinës së pasurisë.

Ky reduktim i subjekteve është i lidhur edhe me një ekonomi informale në vendin tone dhe ka pasur si qëllim mbrojtjen e interesave pasurore të personave që kanë lidhje gjaku me personin nga ato që parashikon ligji, por që pasuritë e tyre nuk janë produkt i aktivitetit kriminal.

7. Gjykatat kompetente që do të shqyrtojnë kërkesat për vendosjen e masave me karakter pasuror sipas ligjit Antimafia të ndryshuar

Deri para ndryshimeve të ligjit Antimafia me ligjin 70/2017, gjykata kompetente ishte vetëm një dhe kjo ishte Gjykata e Krimeve të Rënda.

Por ndryshimet e ligjit Antimafia sollën edhe shtimin e objektit të ligjit duke përfshirë në fushën e veprimit të tij edhe vepra penale që nuk janë në kompetencë lëndore të Gjykatës së Krimeve të Rënda, sic janë ato të pastrimit të produkteve të veprës penale, falsifikimit të monedhave, shkelje të barazisë në tendera, ndikim i paligjshëm, apo vepra të tjera penale të korrupsionit, etj. Këto vepra penale që iu shtuan ligjit dhe që nuk janë në kompetencë të Gjykatës për Krimet e Rënda u pa e udhës që të gjykoheshin nga gjykatat e rretheve gjyqësore, të cilat kanë lëndën për të gjykuar themelin e akuzës.

Kështu ligji me nr. 70/2017, parashikon se²⁵: *“Kërkesa për marrjen e masave parandaluese, sipas këtij ligji, shqyrtohet në shkallë të parë, nga gjykatat e rretheve gjyqësore ose gjykata e shkallës së parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, në bazë të kompetencës përkatëse lëndore për veprën penale të kryer, sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale. Kërkesa për marrjen e masave parandaluese shqyrtohet në shkallë të dytë, nga gjykatat e apelit ose Gjykata e Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, sipas rregullit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni. Zbatohen, për aq sa janë të pajtueshme, dispozitat e paragrafit 1, të nenit 80, të Kodit të Procedurës Penale. Kërkesa për marrjen e masave parandaluese, sipas këtij ligji, shqyrtohet në shkallë të parë me një gjyqtar. Ankimi kundër vendimit për marrjen e masës parandaluese shqyrtohet nga gjykatat e apelit ose Gjykata e Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë”.*

Me rregullimin ligjor aktual shikojmë edhe ndryshimin e përbërjes së trupit gjykues, i cili të gjitha kërkesat me karakter pasuror edhe atë të konfiskimit, sipas këtij ligji e gjykon me 1 në shkallë të parë, krejt ndryshe nga më parë që gjykoheshin kërkesat për konfiskim me 3 gjyqtarë.

Duke pasur parasysh se ende nuk janë ngritur strukturat e posaçme anti-korrupsion, ligji ka parashikuar edhe dispozitë kalimtare²⁶ për të rregulluar zbatimin e ligjit në kohë dhe në hapësirë.

²⁵ Për më shumë shiko nenin 7 të ligjit me nr. 70/2017.

²⁶ Për më shumë shiko nenin 35 të ligjit me nr. 70/2017.

Ky ligj zbatohet për kërkesat e marrjes së masave parandaluese të paraqitura nga prokurori në gjykatën kompetente pas hyrjes në fuqi të tij. Për procedimet pasurore në fazën e hetimit, ky ligj fillon të zbatohet me hyrjen e tij në fuqi. Për pasuritë e vëna para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që kanë lidhje me veprat penale të reja që shtohen në nenin 3, pika 1, të tij, do të zabtohen masat me karakter pasuror edhe për pasuritë e personave, të vëna përpara hyrjes në fuqi të tij, me kusht që të ekzistojnë indicie të rëndësishme për përfshirjen e tyre në veprimtari kriminale, në kohën e vënies së pasurisë.

Deri në krijimin e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, çështjet për marrjen e masave parandaluese kundër pasurisë do të gjykohen nga Gjykata për Krimet e Rënda.

Me krijimin e Gjykatës Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar çështjet në gjykim për marrjen e masave parandaluese kundër pasurisë transferohen në këtë gjykatë dhe në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, sipas kompetencës lëndore për veprën penale të kryer, në bazë të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale. Me krijimin e Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar çështjet në hetim për marrjen e masave parandaluese kundër pasurisë transferohen në këtë prokurori dhe në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, sipas kompetencës lëndore për veprën penale të kryer, në bazë të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale.

8. Barra e provës sipas ligjit me nr. 70/2017

Sipas ligjit Antimafia të ndryshuar, kemi një përcaktim më të qartë dhe më të plotë të barrës së provës²⁷.

Të gjithë personat që janë subjekt i këtij ligji, kanë barrën për të provuar se veprimtaritë dhe pasuritë e sekuestruara, të zotëruara pjesërisht ose plotësisht prej tyre janë fituar nga burime të ligjshme.” Ata, kanë barrën për të provuar që pasuritë, për të cilat kërkohet konfiskimi, zotërohen me titull pronësie vetëm prej tyre, janë përfituar nga burime të ligjshme dhe nuk janë në pronësi të tërthortë të personave të cilët dyshohen për aktivitet kriminal. Personat që kanë lidhje me personat e përfshirë në aktivitet kriminal, kanë barrën për të treguar që të dhënat e siguruara gjatë procedimit pasuror janë të pamjaftueshme për të vërtetuar se veprimtaritë ose pasuritë e tyre: a) zotërohen tërësisht ose pjesërisht, në mënyrë të tërthortë, nga ana e personave të përfshirë në veprimtari kriminale ose; b) janë përdorur, kanë lehtësuar ose kanë ndikuar, në një formë të caktuar, në kryerjen e veprimtarive të jashtëligjshme nga ana e personave të përfshirë në veprimtari kriminale.

²⁷ Për më shumë shiko nenin 22/3 të ligjit me nr. 70/2017.

9. Revokimi i masave me karakter pasuror sipas ligjit me nr. 70/2017

Ndryshimet e reja ligjore në ligjin Antimafia mbartin me vete 2 parashikime ligjore në lidhje me revokimin e sekuestrimit²⁸. E para revokimi i masës së sekuestrimit, pasi mungojnë kushtet dhe kriteret ligjore mbi të cilat u vendos kjo masë. Revokimi në këtë rast është mëse logjike pasi kjo masë e vendosur, kur nuk ekzistojnë më kushtet ligjore, nëse do të eksiztojë do të jetë e paligjshme, prandaj në respektim të parimit të ligjshmërisë duhet të hiqet. Sigurisht në këtë rast gjykata nuk duhet të respektojë ndonjë afat, ajo bëhet në çdo kohë kur kushtet dhe kriteret ligjore që bënë të mundur vendosjen nuk ekzistojnë më gjatë ekzekutimit.

Por risia qëndron tek revokimi i vendimit të sekuestrimit të pasurisë së paligjshme²⁹ duke e zëvendësuar atë me pasuri të barasvlefshme kur palët japin pëlqimin dhe gjykata e çmon të përshtatshme. Ky përcaktim në këtë nen nuk është i qartë dhe për më shumë bie në kundërshtim me qëllimin e ligjit.

Në mendimin tonë ky revokim nuk duhet të ishte parashikuar, pasi qëllimi i ligjit është të nxjerrë nga qarkullimi civil pasuri të paligjshme. Ky revokim dhe zëvendësim njëherazi do të kishte vlerë, vetëm atëherë kur pasuritë e paligjshme zhduken apo tjetërsohen nga vetë personi. Në këtë rast vjen në lojë instituti i sekuestros zëvendësuese, ku në vend të pasurisë së paligjshme të tjetërsuar apo të zhdukur, sekuestrohet pasuria e ligjshme në vlerë të barabartë me atë të paligjshme. Ligji e ka lënë në diskrecion të gjykatës dhe urojmë që ky diskrecion të shkojë në përputhje me qëllimin që ka vetë ligji, sekuestrimin e pasurive të paligjshme.

Me ndryshimet e reja të ligjit, parashikohet se, revokimi i masës së sekuestrimit nuk pengon përdorimin për qëllime tatimore të të dhënave dhe provave të siguruara gjatë hetimit. Kjo bëhet me qëllim që këto të dhëna t'i nënshtrohen verifikimit dhe rivlerësimit sipas ligjit për procedurat tatimore.

Risia e këtij ligji është se kur gjykata vendos revokimin e sekuestrimit, urdhëron kthimin e pasurisë së sekuestruar, ose kundërvlerën e saj pronarit, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Ligji i ri me nr. 70/2017 ka një rregullim ligjor edhe në lidhje me shfuqizimin e vendimit të konfiskimit³⁰. Ky ligj parashikon se: *“Kur vendimi i formës së prerë që ka vendosur konfiskimin prishet nga gjykata më e lartë dhe pasuria i rikthehet zotëruesit të mëparshëm, me vendim të formës së prerë, ai ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim sipas legjislacionit në fuqi”*. Ky është një rregullim ligjor në përputhje me nenin 41 të Kushtetutës pasi mbron të drejtën e pronësisë si një e drejtë themelore e individit.

Ky rregullim ka ndryshuar plotësisht rregullimin ligjor të mëparshëm ku sipas të cilit edhe kur deklarohet i padrejtë konfiskimi, pasuria nuk kthehej i ngelej shtetit në pronësi, personit i kthehej kundërvlefte e pasurisë.

²⁸ Për më shumë shiko nenin 12/b të ligjit me nr. 70/2017

²⁹ Për më shumë shiko nenin 12/b të ligjit me nr. 70/2017, paragrafi i dytë.

³⁰ Për më shumë shiko nenin 31 të ligjit me nr. 70/2017.

Këto ishin disa nga ndryshimet e procedimit parandalues, por jo shterueset.

10. Konkluzione dhe rekomandime

Ligji Antimafia, në Mars të vitit 2017 iu nënshtrua ndryshimeve ligjore duke zgjeruar objektin e veprimit të tij pasi vepron edhe ndaj personave që dyshohen se kryejnë veprat penale të korrupsionit pasiv dhe ose aktiv, në sektorin privat, të korrupsionit të gjyqtarëve ndërkombëtarë, të arbitrave, të anëtarëve të jurive të huaja, por edhe ndaj veprës penale të falsifikimit të monedhave, ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike, shpërdorimi i kontributeve të dhëna nga shteti, përfitimi i paligjshëm i interesave, refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim, shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike. Ky zgjerim i fushës së veprimit pritet të sjellë rezultate pozitive në praktikë.

Ka kufizuar rrethin e subjekteve duke vepruar ndaj një rrethi më të afërt subjektsh, kjo garanton më shumë të drejtën e pronësisë si e drejtë themelore e individit, por ul efikasitetin e ligjit për shkak të ngushtimit të subjekteve.

Ndryshimet ligjore në lidhje me masat me karakter pasuror konkretisht sekuestrimin, kjo masë bëhet më fikase, pasi shqyrtohet në dhomë këshillimi pa prezencën e palëve. Kjo procedurë mbart me vete rrezikun që sjell mosdëgjimi i palëve, por ndryshimet garantojnë gjykimit e ankimit brenda një afati të arsyeshëm. Kemi një rregullim të qartë të procedurave të ekzekutimit.

Ndryshimet ligjore të ligjit Antimafia sollën edhe një risi tjetër, pasi gjyqtari kryesisht mund të vendosë konfiskimin edhe kur nuk ka një kërkesë për konfiskim nga prokurori. Kjo pa dyshim sjell rritjen e efikasitetit të ligjit, por mbart me vete rrezikun e antikushtetutshmërisë së kësaj procedure, pasi organi që jep drejtësi është edhe organi që fillon vetë kryesisht shqyrtimin e kërkesës për konfiskim, duke u shndërruar gjykata edhe në organin që vë në lëvizje vetveten dhe që jep drejtësi.

Ky rast ndodh atëherë kur gjykata po gjykon në seancën e posaçme, 5 ditë para afatit të përfundimit të sekuestros³¹, pra në ato raste kur ka një masë sekuestro.

Kemi një reduktim të subjekteve, me sa duket qëllimi i ligjit ishte të mos përfshinte subjekte të tilla, të cilët ishin të rrezikuar ndaj veprimit të masave me karakter pasuror. Sigurisht ky ndryshim anon më shumë nga garantimi i të drejtave të pronësisë se sa nga efikasiteti i ligjit.

Ndërkohë në lidhje me gjykatën ky ligj ka përcaktuar edhe gjykatat e rretheve gjyqësore kompetente për të shqyrtuar masat me karakter pasuror. Kjo do të sjellë efikasitet dhe fleksibilitet gjatë shqyrtimit të kërkesave me karakter pasuror, për shkak se kjo gjykatë është kompetente si për procedimin penal ashtu edhe për atë pasuror. Njëkohësisht ky parashikim ligjor respekton edhe parimin e një gjykate të

³¹ Për më shumë shiko nenin 22 të ligjit me nr. 70/2017.

krijuar me ligj. Ndërkohë në lidhje me barrën e provës, kjo barrë prove është më e plotë. Ligji ka një përcaktim më të qartë të instituteve të revokimit të sekuestrimit dhe të konfiskimit. Problematike paraqitet vendosja e konfiskimit të pasurive zëvendësuese, pasi në ligj nuk del e qartë se cila pasuri duhet të konfiskohet. Mendojmë që konfiskimi zëvendësues duhet të vendoset mbi pasuri të ligjshme, vetëm kur pasuritë e paligjshme humbasin për shkak të sjelljes me faj të personit.

Ndërkohë ligji parashikon kthimin e pasurisë, dëmit të shkaktuar kur gjykata vendos revokimin e masave me karakter pasuror, ky parashikim është në përputhje me nenin 41 të Kushtetutës, duke garantuar të drejtën e pronësisë.

Ndryshimet ligjore sapo kanë filluar të zbatohen, le të shprejmë se do të ketë rezultate pozitive në praktikë.

Mendojmë se ky sistem ka ende nevojë për reforma të cilat duhet të rrisin efikasitetin e tij në praktikë por gjithashtu edhe ligji aktual ka nevojë të plotësohet në këto elementë:

Në lidhje me aktet terroriste, ligji Antimafia duhet të parashikojë në mënyrë përjashtimore për veprën penale të financimit të terrorizmit, sekuestrimin dhe konfiskimin e gjithë pasurisë së ligjshme dhe të paligjshme në përputhje kjo edhe me Konventën e Këshillit të Evropës atë të Majit 2005 (Varshavës 2005).

Ligji Antimafia parashikon se këto masa me karakter pasuror drejtohen edhe kundër trashëgimtarëve ligjorë dhe/ose testamentarë të personit subjekt i këtij ligji, por në çdo rast jo më vonë se 5 vjet nga dita e vdekjes së subjektit. Ne mendojmë se duhet të hiqet kufizimi kohor, afati 5 vjeçar, nga dita e vdekjes duke vendosur si kufizim momentin e fillimit të aktivitetit kriminal nga trashëgimlënësi.

Një zgjidhje e mirë do të ishte zgjerimi i fushës së veprimit të këtij procedimi. Ky procedim duhet të drejtohet ndaj të gjitha atyre veprave penale që prodhojnë produkte, si edhe/ose ndaj veprave penale me rrezikshmëri penale në përputhje kjo edhe me aktet ndërkombëtare, siç janë ato në fushën e tatimeve dhe taksave, apo veprat penale kundër jetës dhe personit.

Ka ende konfuzion ligjor, paqartësi, pasaktësi në rregullimin ligjor të instituteve të rëndësishme të shuarjes, humbjes së fuqisë, apo të revokimit të masave me karakter pasuror.

Nga praktika shohim se kërkesat e organit të prokurorisë janë të pasakta dhe të paqarta, ata kërkojnë shuarjen dhe revokimin e masës së sekuestrimit dhe konfiskimit edhe kur nuk janë kushtet ligjore për t'i zbatuar ato. I lind detyra gjykatës që të zbatojë drejt këto institute, atë të humbjes së fuqisë, të shuarjes dhe të revokimit. Ligji i jep kompetenca oficerit të policisë gjyqësore, për të bërë inventarin e pasurisë, ndërkohë këtë kompetencë duhet ta ketë përmbaruesi gjyqësor.

BIBLOGRAFIA

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.

Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.

Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Kodi i Procedurave Administrative.

Ligji nr. 8920, datë 11.7.2002 “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe dy protokolleve shtesë të saj”; Protokoll i Palermos, i vitit 2000, “Për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave veçanërisht të femrave dhe fëmijëve, në plotësim të konventës së OKB-së “Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar”.

Ligji nr. 9646, dt. 27.11.2006 “Për Ratifikimin e Konventës të Këshillit të Evropës “Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit”, Varshavë 16.05.2005.

Ligji nr. 8865, dt. 14.03.2002 “Për ratifikimin e Konventës Ndërkombëtare për luftën kundër financimit të terrorizmit”, e OKB-së, dt. 09.12.1999.

Ligji nr. 8642, dt. 13.07.2000 “Për ratifikimin e “Konventës Evropiane për shtypjen e terrorizmit”, Strasburg 27.01.1977.

Ligji nr. 9258, dt. 15.07.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.

Ligji nr. 9284, dt. 30.09.2004 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar”.

Ligji nr. 10192, dt. 03.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet masave kundër pasurisë”.

Ligji me nr. 24/2014, për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin me nr. 10192, dt. 03.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet masave kundër pasurisë”.

Ligji me nr. 70/2017 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin me nr.10 192, dt. 3.12.2009, “PËR PARANDALIMIN DHE GODITJEN E KRIMIT TË ORGANIZUAR, TRAFIKIMIT DHE KORRUPSIONIT NËPËRMJET MASAVE PARANDALUESE KUNDËR PASURISË”, të ndryshuar.

TË DREJTAT E TË PANDEHURIT NË PROCESIN PENAL NË RAPORT ME NDRYSHIMIN E CILËSIMIT JURIDIK TË VEPRËS PENALE

Doktorant Klodian KURUSHI

Gjyqtar pranë Gjykatës së shkallës së parë
“Për Krimet e Rënda” Tiranë
email: klodi_kurushi@yahoo.com

Prof. Dr. Artan HOXHA

Dekan i Fakulteti të Drejtësisë, Universiteti Tiranë
Lektor në Departamentin e së Drejtës Penale
email: artan_hoxha@hotmail.com
Tiranë më 07. 12. 2017

ABSTRAKT

Kodi i Procedurës Penale në Shqipëri i miratuar me Ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 dhe i ndryshuar së fundmi me ligjin nr. 35/2017 ka prezantuar standardet më të mira të garancive të dhëna për të pandehurin dhe viktimën e veprës penale krahasuar me kornizën ligjore para këtyre ndryshimeve. Ndryshimet e reja në Kodin e Procedurës Penale ofrojnë sfida të reja për studiuesit e ligjit, punonjësit e praktikës gjyqësore si dhe për rrethin e gjerë të juristëve të cilët tashmë kanë mundësi praktike të paraqesin jurisprudencën më të mirë të Gjykatës Evropiane “Për të Drejtat e Njeriut” në proceset penale që do të zhvillohen në gjykatat shqiptare në lidhje me respektimin e të drejtave të të pandehurit si dhe me respektimin e të drejtave të personave të tjerë që kanë lidhje me procesin penal për shkak të pasojës së ardhur nga vepra penale.

Një ndër risitë e sjella në ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale është edhe raporti i ri vendosur midis ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale bërë nga gjykata gjatë procesit gjyqësor me të drejtat që gëzon i pandehuri pas kësaj situatë. Analiza e këtij punimi do të përqendrohet pikërisht në këtë raport juridik duke iu referuar sjelljes së gjykatës në ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale dhe garancitë ligjore që gëzon i pandehuri si pasojë e ndryshimit të situatës juridike. Gjithashtu punimi do t’i referohet edhe praktikës së Gjykatës Evropiane “Për të Drejtat e Njeriut” e cila pasqyron qëndrimin e saj për garancinë që duhet të ofrojë gjykata në rastin e rikualifikimit të veprës penale. Në përfundim punimi do të parashtrijë dhe disa konkluzione të cilat janë produkt i analizës së doktrinës dhe jurisprudencës së gjykatave të përmendura në këtë punim.

***Fjalët kyçe:** Ndryshim i cilësimit juridik, i pandehur, gjykatë, akuza të reja, garancitë procedurale, afat i përgatitjes së mbrojtjes.*

HYRJE

Kur i referohemi në tërësi Kodit të Procedurës Penale, përshtypja e parë që na vjen në mendjen tonë është tërësia e të drejtave dhe detyrime që ai ka parashikuar për subjektet procedurale. Procedimi penal nga një anë përcakton pushtetin ndëshkues të shtetit, duke lejuar në këtë mënyrë që ai nëpërmjet mjeteve shtrënguese të rivendosë të drejtat e shkelura nga sjellje njerëzore që kryejnë vepra penale dhe cenojnë rendin publik në tërësi dhe nga ana tjetër nëpërmjet interesit publik mbron të drejtat themelore të individit duke përfshirë në këtë kategori të drejtat e të pandehurit gjatë procesit penal si dhe të drejtat e subjekteve të tjera procedurale që marrin pjesë në procedimin penal.¹

Pra Kodi i Procedurës Penale përcakton tërësinë e rregullave që duhet të zbatohen nga subjektet procedurale tek të cilët drejtohen këto rregulla. Kur i referohemi rregullave duhet të kuptojmë dispozitat procedurale që mbartin të drejtat dhe detyrimet për subjektet procedurale. Pa dashur të anashkalojmë rëndësinë e të gjithë subjekteve procedurale, pjesa kryesore e normave procedurale i referohet funksionit të gjykatës, prokurorisë si dhe të drejtave të e pandehurit në procesin penal. Në përgjithësi nëse normat procedurale penale u ngarkojnë detyrime me pasoja juridike subjekteve të tilla si prokuroria dhe gjykata, kur i referohemi të pandehurit si subjekt procedural këto norma në përgjithësi i njohin atij të drejta procedurale gjatë procesit penal.

Dhënia e të drejtave nga Kodi i Procedurës Penale për të pandehurin është e kuptueshme referuar natyrës së procesit penal. Dihet se në një proces penal, përpara gjykatës shqyrtohet një çështje penale që lidhet me debatin rreth ekzistencës së veprës penale dhe fajësisë së të pandehurit të sjellë për gjykim. Kështu që për të pandehurin në gjykim nuk ka vend që ai të detyrohet të provojë pafajësinë e tij. Në të kundërt të kësaj, detyrimi për të provuar fajësinë e të pandehurit në gjykim i ngarkohet shtetit nëpërmjet prokurorit në procesin penal. Kështu që kjo është një nga arsyet se pse prokurori në një procedim penal është i ngarkuar me detyrimin ligjor për të kryer veprimet e caktuara nga Kodi i Procedurës Penale, pasi në fund ai duhet të provojë fajësinë e të pandehurit. Njëkohësisht edhe gjykata është e detyruar për shkak të ligjit që në procesin gjyqësor të respektojë të drejtat e të pandehurit, pasi ato mund të cenohen nga veprimtaria jashtë kufijve ligjor të kryera prej prokurorit. Nëse gjykata nuk përmbush detyrimin ligjor të saj që është respektimi i të drejtave të të pandehurit në gjykim, ajo vetë mund të jetë një subjekt kontrolli prej gjykatave më të larta të cilat si verifikojnë për shkak të ligjit, të gjithë procesin gjyqësor.

Për të njëjtën arsye, i pandehuri përgjithësisht në procesin penal gëzon të drejta të natyrës procedurale, pasi ndaj tij është ushtruar ndjekja penale prej prokurorit,

¹ Marcone. M, “Diritto Processuale Penale”, XI Edizione, “Edizioni Giuridiche Simone” 2003, faqe 5.

atij i janë kufizuar disa të drejta në fazën e hetimit paraprak dhe ndaj tij prokurori ka sjellë në gjykatë një çështje penale për gjykim.

Kështu që në tërësinë e të drejtave që gëzon i pandehuri në të gjithë procedimin penal janë edhe të drejtat që lidhen me ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga gjykata në fund të shqyrtimit gjyqësor.

Ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale

Në Kodin tonë të Procedurës Penale, në Seksionin e katërt të Kreut të dytë janë përfshirë dispozitat që lidhen me *akuzat e reja* në procesin penal. Këto dispozita rregullojnë situata të veçanta juridike, të cilat pasqyrojnë ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori përgjatë seancës gjyqësore kundrejt të pandehurit.

Si rregull prokuroria në përfundim të hetimeve paraprake, i njofton të pandehurit zyrtarisht akuzën përkatëse për veprën penale konkrete të hetuar dhe paraqet në gjykatë kërkesën për gjykim për akuzën e njoftuar dhe të verifikuar më pas në seancë paraprake. Gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor i pandehuri (jo detyrimisht) paraqet argumentet dhe provat që ka në dispozicion në favor të pozitës së tij procedurale në raport me akuzën. Ky proces që ndryshe njihet si debati gjyqësor ndihmon gjykatën që në përfundim të gjykimit të përcaktojë në mënyrë të saktë bazueshmërinë e akuzës mbi provat e shqyrtuara në gjykim e në sintezë të gjykimit, të shpallë edhe vendimin përfundimtar.

Rregulli i përmendur më lart njej edhe disa përjashtime. Mund të ndodhë që fakti i përshkruar nga prokurori në akuzë të dalë ndryshe gjatë gjykimit, apo në gjykim mund të evidentohet një vepër penale e lidhur me atë që është sjellë për gjykim, ose edhe një fakti i ri i cili nuk është përmendur në kërkesën për gjykim. Ndodhur përpara këtyre rasteve i pandehuri gjendet në një situatë të re të paparashikuar më parë dhe si rrjedhim ai nuk është i përgatitur. Në këto raste të pandehurit duhet t'i garantohen të drejtat e një mbrojtjeje efektive përballë ndryshimeve të papritura të paraqitura nga ana e prokurorisë.

Referuar rastit të mësipërm situata është e qartë nga ana ligjore. Në rast të ndryshimit të akuzës apo komunikimit të një akuze të re në gjykim, të pandehurit i njihet e drejta për të kërkuar në gjykatë një afat kohor të mjaftueshëm me qëllim që ai të përgatitet efektivisht për të realizuar mbrojtjen e tij. Për më tepër dispozitat procedurale që përcaktojnë veprimin e prokurorit në raport me akuzat e reja kanë disa ngjashmëri me njëra tjetrën, ngjashmëri që lidhen me faktin e sjellë për gjykim që transformohet ose pëson ndryshime gjatë debatit gjyqësor dhe reagimin e prokurorit për shkak të situatës së re të krijuar në gjykim.

Pra në përgjithësi fokusi i akuzave të reja në gjykim përqendrohet tek ndryshimi i faktit penal si rezultat i debatit të zhvilluar në seancë gjyqësore. Si rrjedhojë e ndryshimeve që mund të pësojë fakti penal në gjykim, që është element thelbësor i përfshirë në shkakun e akuzës, normalisht ndryshon dhe elementi i dytë përbërës i akuzës, pra natyra e saj e cila përfaqëson karakteristikat ligjore të përcaktimit juridik të faktit si vepër penale.

Kështu që mund të themi se dispozitat procedurale që lidhen me akuzat e reja, bëjnë të mundur njohjen e lidhjes së ngushtë që ekziston në gjykim midis faktit të transformuar në gjykim si pasojë e debatit gjyqësor dhe reagimit të prokurorit në seancë gjyqësore. Ky reagim i prokurorit mbi faktin e ndryshuar materializohet në ndryshimin e akuzës, njoftimin e akuzës për një veprë penale të lidhur me atë që po gjykohet, ose njoftimin e akuzës për një fakt të ri penal që nuk është përmendur në kërkesën për gjykim.

Përpos këtyre situatave të krijuara në gjykim Kodi parashikon mundësinë që jo vetëm prokurori por dhe gjykata, në funksion të parimit të dhënies së drejtësisë mund t'i japë faktit të sjellë për gjykim përcaktimin e drejtë ligjor, që normalisht mund të jetë i ndryshëm nga përcaktimi i dhënë prej prokurorit. Vetëm se në këtë rast gjykata nuk ka mundësi ta ndryshojë faktin e sjellë për gjykim, ashtu sikundër e realizon prokurori nëpërmjet akuzave të reja në gjykim. Pra ndryshimi në këtë rast lidhet vetëm me elementin e natyrës së akuzës, sipas të cilës lejohet që jo vetëm prokurori por edhe gjykata mund të ndërhyjë, duke ndryshuar këtë element me vendimin saj. Kështu që gjykata mund ta përcaktojë ligjërisht ndryshe faktin e sjellë për gjykim nga ana e prokurorit.

Përcaktimi i ndryshëm ligjor i faktit të bërë nga gjykata në vendim, mund të jetë më i lehtë apo më i rëndë. Në këtë rast i pandehuri vihet përpara një vështirësie reale, pasi vendimi i gjykatës i cili mund të ketë rënduar pozitën e tij, mund të jetë i papritur dhe surprizë për të, veçanërisht kur cilësimi ligjor i bërë nga gjykata lidhet me një veprë penale e cila paraqet rrezikshmëri më të lartë shoqërore se ajo që është sjellë për gjykim.

Neni 375 i K.Pr.Penale, i njuh të drejtën gjykatës që në vendimin e saj t'i japë faktit penal të konstatuar gjatë gjykimit një cilësim juridik të ndryshëm nga ai që kishte përcaktuar më parë prokuroria në akuzën e ngritur ndaj të pandehurit e të sjellë për gjykim. Mund të themi se edhe pse me natyrë të kufizuar, cilësimi juridik i faktit të konstatuar në gjykim, nga gjykata në vendimin e saj përfundimtar është shprehje e parimit latin *jura novit curia*².

Me ndryshim të cilësimit juridik të veprës penale nga gjykata, do të kuptojmë përcaktimin e saktë ligjor të figurës konkrete të veprës penale të parashikuar nga ligji penal të kryer nga i pandehuri me veprimet apo mosveprimet e tij. Pra cilësimi juridik i veprës penale lidhet ngushtësisht me përcaktimin e drejtë nga pikëpamja juridike të natyrës së veprimeve apo mosveprimeve të realizuara nga një person, veprime të cilat janë të parashikuara nga ligji penal si elementë thelbësorë të veprës penale dhe që janë konstatuar në gjykim si rrjedhojë e hetimit të kryer nga prokuroria. Në këtë rast gjykata faktit penal i vendos dispozitën penale konkrete që do të zbatohet ndaj autorit të veprës penale.

Ky veprim i gjykatës lidhet me ushtrimin e së drejtës që ajo ka për të përcaktuar

² Gjykata e njuh ligjin.

në mënyrë të drejtë cilësimin ligjor të veprës penale, të evidentuar përgjatë gjykimit të çështjes penale.

Më poshtë do të trajtojmë elementët përbërës të ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale nga gjykata.

Elementet e ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale

Subjekti procedural që mund t'i japë faktit një përcaktim ligjor të ndryshëm nga akuza është gjykata. Krahasuar me të drejtën që ka prokurori për të njëjtën çështje, gjykatës në këtë rast i njihet e drejta e përcaktimit përfundimtar të cilësimit të mëparshëm ligjor që prokuroria i ka bërë faktit penal të sjellë për gjykim. Në këtë kuptim, gjykata është subjekti procedural që vendos përfundimisht mbi ligjin që do të zbatohet në çështjen konkrete. Me cilësimin e drejtë ligjor nëpërmjet vendimit, gjykata i jep fund shqyrtimit gjyqësor duke zgjidhur përfundimisht dilemat e problemet që mund të mbartë një çështje penale e sjellë për gjykim nga prokurori. Nëse nuk do të ekzistonte në Kodin e Procedurës Penale instrumenti i ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale, atëherë gjykata do të kishte në dispozicion vetëm dy alternativa vendimi që janë vendimi i pafajësisë (përfshirë këtu edhe vendimin për pushimin e çështjes penale) si dhe vendimi i fajësisë sipas përcaktimit të veprës penale të kërkuar nga prokurori. Në sistemet procedurale penale civil law (e drejta kontinentale) pjesë e së cilës është edhe sistemi ynë procedural, gjykatat përgjithësisht marrin një rol aktiv në lidhje me atributin që i ka ngarkuar ligji për t'i dhënë faktit të sjellë për gjykim përcaktimin e drejtë ligjor të pavarur nga ai që i ka bërë prokuroria.

Siç e përmendëm edhe më sipër, cilësimi ligjor i fakteve në mënyrë të pavarur gjen mbështetje në parimin e mirënjohur latin *iura novit curia*, që do të thotë se gjykata e njih ligjin. Gjykata e aplikon këtë parim *ex officio* pa qenë e kufizuar nga argumentet ligjorë të sjella nga palët. Në formën e tij më të përhapur ky parim lejon gjykatën të bazojë vendimin e saj mbi një përcaktim të drejtë ligjor që nuk ka qenë subjekt i argumenteve nga palët. Megjithatë në këndvështrimin e së drejtës së palëve për t'u dëgjuar dhe parimit të kontradiktoritetit, kjo liri veprimi e gjykatës nuk është e pakufizuar. Për shkak të sistemit procedural të përzgjedhur themi se gjykata në procesin penal ka rol aktiv në lidhje me përcaktimin e duhur ligjor të faktit të sjellë për gjykim. Në këtë kontekst, gjykata në sistemin tonë, nuk ndodhet vetëm përpara dy alternativave vendimmarrëse të cilat i referohen vendimeve të pafajësisë ose të fajësisë së të pandehurit. Gjykata në sistemin tonë, brenda hapësirave të dhëna nga ligji ka mundësinë që përpos vendimeve tradicionale të përmendura më sipër, mund të japë vendime që ndryshojnë cilësimin ligjor të veprës penale të bërë nga prokurori.

Siç e përmendëm edhe më lart gjykata nuk gëzon pushtet të pakufizuar në ushtrimin e të drejtës së saj për të ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale. Ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale nga gjykata realizohet prej saj kur plotësohen disa kushte ligjore të cilat përmbajnë edhe elementet e ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale.

Së pari, fakti në cilësimin e veprës penale nga gjykata mbetet i pandryshuar.

Ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale nga gjykata bëhet vetëm në rastet kur ky ndryshim i referohet të njëjtit fakt të sjellë për gjykim nga prokuroria. Fakti të cilit i atribuohet të pandehurit nga prokuroria duhet të mbetet i pandryshuar nga momenti që ka filluar procesi gjyqësor deri në momentin që gjykata është tërhequr për dhënien e vendimit të saj përfundimtar. Kushti i faktit të pandryshueshëm përbën elementin më të rëndësishëm të instrumentit të ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale. Në aspektin procedural fakt i pandryshueshëm do të thotë pasqyrim i parimit të lidhjes së akuzës me vendimin e gjykatës³. Në këtë rast gjyqtari e vlerëson ndryshe faktin e sjellë për gjykim, në rastin kur prokurori nuk ka ndërhyrë vetë gjatë gjykimit për të proceduar me ndryshimin e akuzës, apo në rastin kur prokurori gabimisht ka ndryshuar akuzën në gjykim. Në këtë aspekt, mund të themi se një pushtet të tillë që i është dhënë gjykatës për të ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale përfaqëson një element të sistemit inkuizitor të procedurës penale⁴.

Së dyti, cilësimi juridik që gjykata i bën faktit në vendimin e saj përfundimtar mund të jetë më i lehtë ose më i rëndë se cilësimi ligjor që prokuroria i ka bërë këtij fakti në formulimin e akuzës të sjellë për gjykim. Pra gjykata në cilësimin juridik që i bën veprës penale nuk qëndron e lidhur me përcaktimin ligjor që i ka bërë faktit penal prokuroria.

Së treti, gjykata ndryshimin e cilësimit juridik mund ta bëjë me kushtin që vepra penale duhet të jetë në kompetencën e saj për t'u gjykuar. Kur i referohemi kompetencës në radhë të parë kemi parasysh kompetencën lëndore dhe më pas kompetencën funksionale dhe territoriale ku ushtron aktivitetin gjykata që po shqyrton çështjen penale të sjellë për gjykim.

Së katërti, ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale nga gjykata mund të bëhet prej saj në përfundim të procesit gjyqësor. Përfundimi i procesit gjyqësor sipas ndryshimeve të reja nuk barazohet me momentin e dhënies së vendimit përfundimtar nga gjykata. Sipas ndryshimeve të reja, nëse cilësimi juridik i veprës penale i bërë nga gjykata është më i rëndë se ai që ka bërë prokurori ose viktimi akuzuese, gjykata nuk merr vendim përfundimtar, por njofton palët mbi mundësinë e këtij ndryshimi duke u dhënë kohën e nevojshme për t'u mbrojtur. Ndryshimet e reja në nenin 375 të K.Pr.Penale na risjellin edhe një herë në vëmendje, të njëjtën dispozitë që ka qenë në fuqi në kohën e miratimit të Kodit të Procedurës Penale në vitin 1995. Fillimisht neni 375 i K.Pr.Penale ka qenë formuluar si në vijim:

“1. Gjykata mund t'i japë faktit një përcaktim juridik, të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori, me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj, duke vënë në dijeni palët.”

³ Conso Giovanni, Grevi Vittorio., “Compiendo di Procedura Penale” Seconda edizione, CEDAM 2003, faqe 710

⁴ Conso Giovanni, Grevi Vittorio., “Compiendo di Procedura Penale” Seconda edizione, CEDAM 2003, po aty

Përmbajtja e kësaj dispozite kaloi dhe kontrollin kushtetues për shkak të dyshimeve të ngritura në lidhje me paragjykimin (njëanshmërinë) e çështjes penale nga gjykata, në rastin e vënies në dijeni të palëve mbi ndryshimin e cilësimit juridik të faktit penal nga vetë gjykata, përpara dhënies së vendimit përfundimtar.

Kështu Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 50/1999 është shprehur mbi përputhshmërinë e nenit 375 të K.Pr.Penale të përmendur më sipër, në raport me Kushtetutën e Republikës së Shqipëri. Për pjesën e njoftimit të palëve mbi ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga gjykata përpara se ajo të shprehet me vendim përfundimtar, Gjykata Kushtetuese në këtë pikë është shprehur se⁵:

“... Kur gjykata bën cilësimin e drejtë ligjor të veprës, pavarësisht nga karakteri i saj më i rëndë, ajo ka bërë një zbatim të drejtë të ligjit dhe duke vënë në dijeni palët u krijon atyre mundësinë për t’u ankuar ndaj vendimit.

... Kushti tjetër është që për ndryshimin të verë në dijeni palët. Kur gjykata bën ndryshimin gjatë seancës me vendim të ndërmjetëm, ua komunikon atë palëve. Por në rast se gjykata konstaton se duhet bërë ndryshimi i cilësimit juridik të veprës pas mbylljes së shqyrtimit gjyqësor kur është tërhequr për vendim, atëhere duhet të riçelë seancën dhe të vejë në dijeni palët, dhe të dëgjojë edhe pretendimet e tyre. Kështu ajo garanton të drejtën e mbrojtjes dhe të akuzës së prokurorit. Zbatimi në këtë mënyrë i kërkesave të nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale, është një garanci për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, duke e vënë gjykatën në rolin që i takon për dhënien e drejtësisë.

Prandaj, neni 375 i Kodit të Procedurës Penale jo vetëm që nuk vjen në kundërshtim me nenin 148 të Kushtetutës, por është në përputhje edhe me parimet e tjera kushtetuese të zhvillimit të një gjykimi të drejtë nga një gjykatë e paanshme...”

Në këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese vihen re dy parime të rëndësishme në funksion të procesit të rregullt ligjor, që janë *e drejta e mbrojtjes dhe zhvillimi i një gjykimi të drejtë nga një gjykatë e paanshme*. Pra vënia në dijeni e palëve nga gjykata paraprakisht mbi ndryshimin e cilësimit juridik të faktit penal të sjellë për gjykim edhe në rastin kur ky ndryshim mund të rëndojë pozitën e të pandehurit, nuk është shkelje e parimit të pavarësisë dhe paanshmërisë së gjykatës kur ajo kryen këtë veprim. Gjykata Kushtetuese në këtë vendim gjyqësor shkon edhe më tej në argumentimin e saj, duke nënvizuar se vënia në dijeni nga gjykata për të pandehurin me vendim të ndërmjetëm mbi ndryshimin e cilësimit juri-dik të fakti penal edhe në rëndim të pozitës së tij është në përputhje me parimin e së drejtës së mbrojtjes. Pasi të vihet në dijeni me ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, i pandehuri ka mundësi që të përgatisë mbrojtjen e tij përpara të njëjtës gjykatë edhe për ndryshimin e cilësimit juridik të bërë nga gjykata.

Më vonë me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002 neni 375 i K.Pr.Penale u ndryshua si në vijim:

⁵ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 50 datë 30.07.1999

“Me vendimin përfundimtar gjykata mund t’i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori ose i dëmtuari akuzues, më të lehtë ose më të rëndë, me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj.”

Sipas këtij ndryshimi gjykata me vendimin e saj përfundimtar mund t’i japë faktit një cilësim të ndryshëm juridik edhe duke rënduar pozitën e të pandehurit, pa njoftuar palët paraprakisht për këtë ndryshim. Ky ndryshim ishte i dukshëm në raport me mënyrën sesi duhet të vepronte gjykata për të ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale.

Në pamje të parë, duket se ndryshimi i dytë i nenit 375 të K.Pr.Penale është më cilësor, pasi gjykata në këtë rast qëndron mbi palët, nuk përfshihet në shfaqjen e mendimit të saj mbi përfundimin e procesit penal paraprakisht, por mendimin e saj mbi zgjidhjen e çështjes penale gjykata e jep me vendimin e saj përfundimtar.

Në mënyrë indirekte kjo dispozitë procedurale është verifikuar edhe nga GJEDNJ-ja, mbi një ankim që i është drejtuar kësaj gjykate nga një i dënuar nga autoritetet gjyqësore shqiptare.

Më konkretisht një rast i gjykuar nga gjykatat shqiptare është shqyrtuar në Gjykatën e Strasburgut mbi bazën e ankimeve të paraqitura nga disa të dënuar.⁶ Ndër të tjera aplikuesit në Gjykatën e Strasburgut u ankuan edhe për shkeljen e së drejtës së mbrojtjes sipas nenit 6 të Konventës, për shkak të rikualifikimit të veprës penale të bërë nga gjykata e shkallës së parë në vendimin e saj përfundimtar duke u mbështetur në nenin 375 të Kodit tonë të Procedurës Penale.

Në lidhje me ndryshimin e cilësimit juridik të bërë nga gjykata e shkallës së parë, Gjykata e Strasburgut në vendimin e saj, arsyetoi se gjatë vlerësimit të drejtësisë së ushtruar në tërësinë e të gjitha procedurave, riklasifikimi i një krimi nuk përbën shkelje të së drejtës së mbrojtjes, nëse i pandehuri pas këtij veprimi të bërë nga gjykata ka pasur mjaftueshëm mundësi të mbrojë veten. Në vlerësimin e Gjykatës së Strasburgut ankuesi pati kohën dhe lehtësirat e duhura për të përgatitur mbrojtjen e tij ndaj riformulimit të veprës penale të bërë nga gjykata e shkallës së parë. Në fakt ankuesi paraqiti ankimin e tij *inter alia* në Gjykatën e Apelit, si pjesë të çënimit të së drejtës së mbrojtjes së tij për riklasifikimin e veprës penale.⁷

Pra neni 375 i K.Pr.Penale e ka kaluar testin e kontrollit të përputhshmërisë në raport me parimin e ushtrimit të një mbrojtjeje efektive nga i pandehuri në një proces penal, kur mundësinë për të përgatitur mbrojtjen mbi ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale i pandehuri e ushtron në Gjykatën e Apelit. Por në mënyrë implicite mund të themi se neni 375 i K. Pr. Penale i pandryshuar me ligjin e fundit, ashtu siç ishte mund të sillte probleme në zbatimin e tij pa iu referuar shkallës më të lartë të gjykimit, për të drejtën e mbrojtjes pa e lidhur këtë të drejtë me procesin e ankimit të vendimit.

⁶ EHRC – Case of Haxhia v. Albania Applications no. 29861/03

⁷ EHRC – Case of Haxhia v. Albania Applications no. 29861/03

Më konkretisht për këtë pjesë GJEDNJ u shpreh se⁸:

“...Gjatë vlerësimit të drejtësisë së ushtruar në tërësinë e procedurave penale gjykata pranoi se riklasifikimi i një krimi nuk shkel të drejtat e mbrojtjes nëse i pandehuri ka pasur mjaftueshëm mundësi të mbrojë veten e tij gjatë procedurave të rishqyrtimit (Dallos v Hungari, Sipavičius kundër Lituanisë). Në çështjen konkrete ankuesi e kundërshtoi dënimin e tij dhe riklasifikimin përpara gjykatës së Apelit, gjykatë e cila është kompetente për t’u marrë me këtë çështje...

Prandaj gjykata vlerëson se duke pasur parasysh faktet e çështjes veçanërisht materialet e paraqitura së fundmi nga prokurori në procesin gjyqësor siç paraqitet edhe në vendimin e Gjykatës së Rrethit, nuk mund të thuhet se ankuesi nuk mund ta studionte riklasifikimin e akuzës penale kundër tij. Ankuesi pati kohën dhe lehtësirat e duhura për të përgatitur mbrojtjen e tij ndaj akuzës së riformuluar dhe në fakt ai e paraqiti përpara gjykatës së Apelit mbrojtjen e tij për akuzën e riformuluar.

Pra neni 375 i K.Pr.Penale përpara ndryshimit të fundit mund të krijonte probleme me të drejtën e mbrojtjes së të pandehurit, nëse shqyrtimi gjyqësor fillon e mbaron në gjykatën e shkallës së parë dhe ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale bëhet me vendimin përfundimtar nga gjykata. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për gjykatën e apelit, pasi ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale mund të bëhet edhe në gjykatën e apelit e cila me vendim përfundimtar mund t’i japë faktit një cilësim të ndryshëm juridik duke rënduar pozitën e të pandehurit. Rëndimi i pozitës procedurale të të pandehurit në gjykatën e apelit për shkak të ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale të bërë nga kjo gjykatë në vendimin e saj përfundimtar, mund të krijojë probleme që lidhen me procesin e rregullt ligjor për shkak se i pandehuri pas vendimit rëndues që merr nga gjykata e apelit nuk ka mundësi reale për të paraqitur prova në ankimin e tij në një gjykatë më të lartë. Kujtojmë këtu se Gjkata e Lartë është një gjykatë që shqyrton ankimet vetëm për shkelje të ligjit e si e tillë ajo nuk merr në shqyrtim prova të kërkuara nga palët.

Në këtë mënyrë legjislatori duke iu referuar jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut, ka përditësuar (ndryshuar) nenin 375 të K. Pr. Penale në funksion të garantimit më të mirë të të drejtave të të pandehurit në procesin penal në të gjitha shkallët e gjyqimit.

Të drejtat e të pandehurit gjatë ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale

Me ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale ndaj të pandehurit nga gjykata, në rëndim të pozitës së tij, normalisht i pandehuri vendoset në një situatë të vështirë, pasi ai mund të dënohet nga gjykata për një vepër më të rëndë penale se ajo që është sjellë për gjykim nga prokurori. Në këtë ndryshimi i cilësimit juridik duhet të shoqërohet me disa garanci procedurale që gjykata në procesin gjyqësor

⁸ EHRC – Case of Haxhia v. Albania po aty.

duhet që t’ia ofrojë të pandehurit. Garancitë procedurale duhet të lidhen me të drejtën e informimit të të pandehurit për natyrën dhe shkakun e cilësimit të ri të veprës penale që mund të ndryshohet prej gjykatës, si dhe atij duhet t’i jepet nga gjykata e drejta për t’u përgatitur për mbrojtjen ndaj ndryshimit të mundshëm të cilësimit juridik të veprës penale.

Ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale ose siç ne e gjejmë në jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut me termin riklasifikimin e veprës penale të bërë nga gjykata, duhet të shoqërohet me garancitë e përmendura më lart pasi në të kundërt gjykata do të dështojë në respektimin e standardit të një procesi të rregullt ligjor.

Më konkretisht, në çështjen *Pélissier and Sassi v. France* GJEDNJ-ja thekson procedurën që duhet të ndjekë një gjykatë në rastin e ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale, me qëllim që të pandehurit të mos i cenohet:

E drejta për t’u informuar mbi natyrën dhe shkakun e akuzës

E drejta për të pasur kohën dhe lehtësirat e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tij.

Në lidhje me këtë moment GJEDNJ-ja është shprehur se⁹:

“... gjykata në përputhje me rrethanat vlerëson se në përdorimin e së drejtës së gjykatës për të riklasifikuar faktet e cila pa asnjë mëdyshje është pjesë e ushtrimit të juridiksionit të saj, Gjykata e Apelit të Aix – en – Provence duhet t’i kishte ofruar aplikantëve mundësinë e ushtrimit të mbrojtjes së tyre për ndryshimin e cilësimit të veprës penale në mënyrë praktike dhe efektive në kohën e duhur. Nuk rezulton asnjë shpjegim nga kjo çështje se pse psh seanca nuk u shty për argumente të mëtejshme, ose pse aplikantëve nuk u është kërkuar të parashtrijnë me shkrim pretendimet e tyre gjatë kohës që çështja ishte në gjykim në gjykatën e apelit.

Në të kundërt të kësaj të përmendur më lart, materiali përpara gjykatës informon se aplikuesve nuk u është dhënë mundësia të përgatisin mbrojtjen e tyre për akuzat e reja. Vetëm në vendimin e dhënë nga Gjykata e Apelit ata mësuan për rikualifikimin e fakteve. Thjesht kjo ishte tepër vonë për aplikuesit.

Për sa më sipër gjykata konkludon se e drejta e aplikuesve për t’u informuar në detaje për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tyre dhe e drejta e tyre për të pasur kohën dhe lehtësinë për të përgatitur mbrojtjen e tyre janë të cënuara. Rrjedhimisht ka shkelle të paragrafit 3 (a) dhe (b) të nenit 6 të Konventës e marrë së bashku me paragrafin e 1 të këtij neni e cila parashikon gjykimin e drejtë...”

Më tej jurisprudenca e GJEDNJ-së mbi rikualifikimin e veprës penale nga gjykata dhe rregullat që duhet të ndiqen prej saj në mënyrë që të mos cenohen të

⁹ EHRC - Case of *Pélissier and Sassi v. France*, Application no. [25444/94](#), 25 March 1999

drejtat e të pandehurit në lidhje me informimin në detaje të akuzës dhe e drejta e mbrojtjes ndaj këtij ndryshimi është konsoliduar edhe në çështje të tjera të ngjashme. Në këto vendime GJEDNJ-ja shprehet se “*informacioni që lidhet me akuzën duke përfshirë edhe karakteristikat ligjore të saj, të cilat gjykata mund t'i adoptojë si pjesë e vendimmarrjes së saj, duhet t'i bëhen të njohur të pandehurit përpara gjykimit të akuzës (siç mund të jetë rasti i seancës paraprake) ose së fundmi përgjatë fazës së shqyrtimit gjyqësor*”¹⁰.

Në këtë kuptim një referim i përgjithshëm në seancë mbi mundësinë e gjykatës për të arritur në përfundim të ndryshëm nga prokurori përpara i përket kualifikimit të një veprë penale është qartësisht e pamjaftueshme.¹¹ Pra në rastin e riklasifikimit të faktit penal nga gjykata gjatë gjykimit, të pandehurit duhet t'i ofrohet prej saj mundësia e ushtrimit të së drejtës së mbrojtjes në mënyrë praktike dhe efektive duke i dhënë të pandehurit dhe një afat të caktuar kohor për të përgatitur mbrojtjen¹².

Në rikualifikimin e një veprë penale sipas GJEDNJ-së, vlerësohet si veprim i mjaftueshëm për t'u parashikuar nga i pandehuri nëse gjykata në rikualifikim i referohet një elementi i cili është i lidhur me akuzën dhe i evidentuar si i tillë gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes penale¹³.

Edhe një herë sjellim në vëmendje se defektet mbi njoftimin për rikualifikimin e akuzës sipas GJEDNJ-së mund të riparohen në Gjykatën e Apelit, nëse i pandehuri ka pasur mundësinë të apelojë vendimin e dhënë nga gjykata në një gjykatë më të lartë, duke ushtruar të drejtën e tij të mbrojtjes në respekt të riformulimit të akuzës dhe të kundërshtojë dënimin e dhënë, si për kualifikimin e veprës penale ashtu edhe për faktin penal¹⁴.

Duke iu referuar pikërisht defekteve që paraqiste neni 375 i K. Pr. Penale që nuk i garantonte të pandehurit të drejtën për t'u informuar paraprakisht nga gjykata për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale si dhe të drejtën për t'u përgatitur për mbrojtjen ndaj këtij ndryshimi në të njëjtën shkallë nga gjykata, sollën edhe nevojën e amendimit të nenit 375 të K. Pr. Penale. Mendoj se jurisprudenca e GJEDNJ-së mbi rikualifikimin nga gjykata, të veprës penale të sjellë për gjykim nga prokurori ka ndikuar në lidhje me ndryshimin (e kryer me Ligjin nr. 35/2017) e nenit 375 të K.Pr.Penale.

Sipas ndryshimeve të fundit, gjykata në përfundim të gjykimit duhet të njoftojë të pandehurin për mundësinë e ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale me qëllim që t'i jepet koha e nevojshme për të përgatitur mbrojtjen mbi ndryshimin

¹⁰ Guide on Article 6 “Right to a fair trial”, Counsel of Europe 2014.

¹¹ EHRC case I. H and Others v. Austria

¹² EHRC case Block v. Hungary

¹³ EHRC case of De Salvador Torres v. Spain

¹⁴ EHRC case of Zhupnik v. Ukraine

e cilësimit të njoftuar prej gjykatës. Në këtë aspekt vlerësoj se ndryshimi i nenit 375 të K.Pr.Penale, na rikujton formulimin origjinal të kësaj dispozite dhe është në përputhje me standardet e kërkuara nga GJEDNJ-ja për të garantuar procesin e rregullt ligjor.

PËRFUNDIME

Qëllimi i këtij punimi ishte evidentimi i karakteristikave dhe i përmbajtjes së nenit 375 të K. Pr. Penale i vlerësuar në raport me të drejtat e të pandehurit. Në këtë punim u përpoqëm të vinim në dukje natyrën fleksibël të kësaj dispozite procedurale. Në vlerësimin tonë tashmë me ndryshimet e reja, të pandehurit në çdo shkallë procedimi përpara gjykatës riklasifikimi i veprës penale në gjykim shoqërohet gjithmonë me njoftimin paraprak të gjykatës për karakteristikat ligjore të faktit penal konkret që mund të adoptojë gjykata si dhe me të drejtën për t'i dhënë kohën dhe mjetet e mjaftueshme të pandehurit për t'u përgatitur edhe për mbrojtjen e tij ndaj mundësisë së ndryshimit të cilësimit juridik.

Në këtë aspekt një proces gjyqësor nuk mbaron me vendimin përfundimtar surprizë të dhënë nga gjykata ndaj të pandehurit duke i ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor. Referuar ndryshimeve të reja, mundësia e ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale në rëndim të pozitës së të pandehurit, i paraprin gjithmonë vendimit përfundimtar të gjykatës. Arsyeja e këtij ndryshimi lidhet me faktin se të pandehurit i njihet dhe i garantohet e drejta për të kundërshtuar riklasifikimin e veprës penale në të njëjtën shkallë gjykimi. Në këtë kuptim ligji procedural shqiptar, ashtu sikundër edhe ligje të tjera procedurale evropiane¹⁵, i krijon mundësinë të pandehurit të paraqesë mbrojtjen e tij përpara gjykatës që mund të ndryshojë cilësimin juridik të veprës penale, brenda një afati të arsyeshëm kohor duke përfshirë edhe të drejtën për të paraqitur provat të pakufizuara të cilat në vlerësimin e tij mund t'i shërbejnë atij për të realizuar një mbrojtje efektive.

Si rrjedhim mund të themi se raporti midis *ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale dhe ushtrimit të një mbrojtjeje efektive* nuk mund të vlerësohet në mënyrë të shkëputur në komponentët e tij. Në fillim iniciativa e ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale i takon gjykatës kur janë rastet ligjore që ajo duhet të bëjë këtë ndryshim dhe më pas iniciativa transferohet në anën e të pandehurit të cilit i garantohet e drejta e ushtrimit të mbrojtjes efektive në të njëjtën gjykatë edhe për të kundërshtuar riklasifikimin e veprës penale për të cilën ai është njohur paraprakisht prej saj.

Në përfundim konkludojmë se ndryshimi i cilësimit ligjor të veprës penale parashikuar nga neni 375 i K. Pr. Penale me ndryshimet e bëra nga ligji nr. 35/2017

¹⁵ Neni 265 i Kodit të Procedurës Penale Gjermane

i vlerësuar në harmoni me të drejtën e ta pandehurit për të kundërshtuar këtë ndryshim ligjor në të njëjtën gjykatë përmbush standardin më të mirë të ushtrimit të së drejtës së një mbrojeje efektive të të pandehurit në procesin penal të sanksionuar nga neni 6 i Konventës.

BIBLIOGRAFIA

Konventa Evropiane Për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut

Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë

Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 50 datë 30.07.1999

Vendim nr. 4 datë 10.02.2012 i Gjykatës Kushtetuese

EHRC – Case Block v. Hungary

ECHR – Case of I.H and others v. Austria

EHRC – Case of Haxhia v. Albania

EHRC – Case of Mulosmani v. Albania

EHRC – Case of Pélissier and Sassi v. France

EHRC – Case of De Salvador Torres v. Spain

EHRC – Case of Zhupnik v. Ukraine

Conso Giovanni, Grevi Vittorio., “Compiendo di Procedura Penale”
Seconda edizione,
CEDAM 2003

Guide on Article 6 “Right to a fair trial”, Counsel of Europe 2014

Marcone. M, “Diritto Processuale Penale”, XI Edizione, “Edizioni
Giuridiche Simone” 2003.

MARRËVESHJA PËR PRANIMIN E FAJËSISË DHE CAKTIMIN E DËNIMIT – INSTITUT I RI JURIDIKO - PROCEDURAL NË SISTEMIN PENAL SHQIPTAR

Dr. Bojana HAJDINI

(Departamenti i Drejtësisë, Kolegji Universitar Bedër)

Adrese e-mail: bojanahajdini@gmail.com

Prof. Asoc. Dr. Mirela BOGDANI

(Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës)

Adrese e-mail: mirelbogdani@gmail.com

Sistemet e drejtësisë penale i janë nënshtruar në mënyrë të vazhdueshme reformimit me qëllim garantimin e një sistemi sa më efektiv dhe ekonomik, i cili mundëson vënien në vend të drejtësisë brenda një kohe sa më të shkurtër. Për këtë arsye, përpjekjet janë orientuar në funksion të gjetjes së zgjidhjeve dhe alternativave që bëjnë të mundur përshpejtimin dhe thjeshtimin e procedurës në proceset penale. Legjislacionet anembanë botës, aplikojnë një sërë institutesh juridiko-procedurale që i shërbejnë efikasitetit dhe mirëadministrimit të proceseve penale. Në këtë drejtim ka ecur dhe reformimi i legjislacionit shqiptar, i cili me ndryshimet e fundit, të bëra në Kodin e Procedurës Penale, synoi rritjen e efektivitetit të gjykimeve të posaçme. Nëpërmjet këtyre ndryshimeve u përmirësua, në funksion të efektivitetit, procedura e gjykimit të drejtpërdrejtë dhe gjykimit të shkurtuar, si dhe u parashikuan dy lloje gjykimesh të posaçme të reja: (i) urdhri penal i dënimit dhe (ii) gjykimi me marrëveshje, në thelb të të cilit qëndron marrëveshja për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit.

Qëllimi i këtij punimi është që, nëpërmjet metodës analizuuese dhe asaj krahasuese, të paraqesë një analizë juridike të institutit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit, të parashikuar në ndryshimet e fundit të Kodit të Procedurës Penale. Punimi do të fokusohet në tiparet e këtij instituti, rastet dhe mënyrat e aplikimit, dallimet e tij nga legjislacione e tjera penale, si dhe në përparësitë që karakterizojnë atë si në përmirësimin e cilësisë së ndjekjes penale, ashtu edhe reduktimin e shpenzimeve.

***Fjalë Kyçe:** guilty plea, gjykimi me marrëveshje, marrëveshja për pranimin e fajësisë, sistem penal efektiv*

HYRJE

Dekadat e fundit sistemet e drejtësisë penale në Evropë i janë nënshtruar në mënyrë të vazhdueshme reformimit me qëllim garantimin e një sistemi sa më efektiv dhe ekonomik, i cili mundëson vënien në vend të drejtësisë brenda një kohe

sa më të shkurtër Kjo pasi, modeli i përzier i procedurës penale i aplikuar gjerësisht në vendet e Evropës është kritikuar vazhdimisht për ngurtësi e formalizëm, gjë që ka ndikuar në efikasitetin e dhënies së drejtësisë penale. Për këtë arsye, një pjesë e ndërhyrjeve legislative janë drejtuar drejt reformave që synonin përshtetimin e procedurave penale. Një rol domethënës në këtë drejtim ka luajtur edhe Këshilli i Evropës, i cili pas miratimit të Rekomandimit nr. (87) 18¹ ka theksuar gjithnjë e më tepër nevojën për thjeshtimin e procedurave në sistemin e drejtësisë penale. Si rrjedhojë, reformat penale, nëpërmjet ndryshimeve legislative kanë synuar futjen e instituteve të reja, tipike për sistemin e *common law*-t, duke ia përshtatur ato modelit të përzier të procedurës penale të aplikuar kryesisht në Evropë. Ndër këto institute është edhe ai i gjykimit me marrëveshje, i cili ka në thelb të tij *“marrëveshjen e negociuar ndërmjet të pandehurit dhe avokatit të tij nga njëra anë dhe prokurorit nga ana tjetër, në të cilin i pandehuri pajtohet të “pranojë fajin” ose “të mos bjerë dakord” për disa krime, në këmbim të caktimit të një akuze më të lehtë, shkarkimin e disa prej akuzave, caktimin e një dënimi më të butë nga prokurori, apo çdo dhënie e çdo përfitimi tjetër*². Gjykimi me marrëveshje, ka gjetur zbatim që nga fundi i shek. 20. I aplikuar fillimisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Angli, më pas u përhap, në forma të ngjashme, edhe në shtete evropiane si Gjermani, Francë, Itali, Norvegji dhe Hollandë, Serbi, Maqedoni, Bosnjë Hercegovinë, Kroaci, Kosovë, etj.

Këshilli i Evropës në Rekomandimin nr. (87) 18, lidhur me këtë institut, thekson se: *“Kudo ku e lejojnë traditat kushtetuese dhe ligjore, procedura e “pranimit të fajësisë” (guilty plea), ku një i dyshuar kërkohet të paraqitet para një gjykate, në një fazë të hershme të procesit për të deklaruar publikisht në gjykatë nëse ai pranon ose mohon akuzat kundër tij, ose procedura të ngjashme, duhet të futen.*³” Sipas kësaj procedure, *“gjykata duhet të jetë në gjendje të vendosë, pa bërë gjithë hetimet apo një pjesë të tyre, dhe të procedojë menjëherë në shqyrtimin e personalitetit të autorit të veprës penale, caktimin e dënimit dhe, sipas rastit, të vendosë çështjen e kompensimit.*⁴” Në këtë dokument, në përputhje me natyrën që ka, nuk jepen detaje mbi mënyrën si mund të aplikohen nga ky institut, por parashikohen disa udhëzime të përgjithshme lidhur me të. Kështu, referuar Rekomandimit (87)18, lidhur me procedurën e pranimit të fajësisë (*guilty plea*) përcaktohet se:

- *“Procedura e “pranimit të fajësisë” duhet të kryhet në një gjykatë, në një seancë publike.*

¹ Për më tepër shih Recommendation no. R (87) 18 concerning the simplification of criminal justice, 17 September 1987, [http://www.barobirlik.org.tr/dosyalar/duyurular/hsykanunteklifi/recR\(87\)18e.pdf](http://www.barobirlik.org.tr/dosyalar/duyurular/hsykanunteklifi/recR(87)18e.pdf), aksesuar me 1.12.2017

² Përkufizim i institutit të gjykimit me marrëveshje (plea bargain) sipas fjalorit ligjor (legal dictionary) <https://legal-dictionary.thefreedictionary.com/plea+bargain>, aksesuar me 1.12.2017

³ Recommendation no. R (87) 18 concerning the simplification of criminal justice, 17 September 1987, paragrafi III/a/7

⁴ Recommendation no. R (87) 18 concerning the simplification of criminal justice, 17 September 1987, paragrafi III/a/7, fjalia e dytë

- Duhet të ketë një përgjigje pozitive nga autori për akuzën e ngritur kundër tij.
- Para se të procedohet lidhur me dënimin e një autori nën procedurën e “pranimit të fajësisë” (guilty plea), duhet të ketë një mundësi për gjykatën që të dëgjojë të dyja palët e çështjes.

Kur mbahet çështja gjyqësore, pavarësisht gatishmërisë së të akuzuarit për të pranuar fajin e tij, gjykata duhet të kufizohet në ato hapa absolutisht të nevojshme që lidhen me faktet, duke marrë parasysh procedurën e zhvilluar para gjykatës. Në veçanti, thirrja e dëshmitarëve që kanë dëshmuar më parë para një autoriteti gjyqësor duhet të shmangen sa më shumë që të jetë e mundur.”

Në kuadër të reformimit të drejtësisë penale edhe Shqipëria me ndryshimet e fundit në Kodin e Procedurës Penale⁵, në funksion të thjeshtësimit të procedurave në procesin penal dhe rritjes së efikasitetit, reformoi gjykimet e posaçme. Krahas ndryshimeve të gjykimit të drejtpërdrejtë dhe atij të shkurtuar, të cilat kanë në fokus rritjen e efektivitetit u futën dhe dy gjykime të reja: urdhri penal dhe gjykimi me marrëveshje. Sipas relacionit të projektligjit ndryshues të Kodit të Procedurës Penale, qëllimi i përfshirjes së gjykimit me marrëveshje si një gjykim i ri, është në interes të palëve në proces⁶. Ai synon nga një anë uljen e shpenzimeve gjyqësore dhe rritjen e kohës për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve dhe autorëve të tjerë nga prokuroria dhe nga ana tjetër i jep të pandehurit një pozitë më të favorshme duke i mundësuar një dënim më të butë, në raport me dënimin që do të arrihej pas gjykimit⁷. Përveç sa më sipër, ky institut ndikon dhe në humanizimin e procesit penal, sa kohë që në thelb të tij është një përfitim që shteti i jep të akuzuarve që pranojnë fajin. Gjithashtu ai ndikon në rehabilitimin e individëve që pasi kuptojnë rëndësinë e veprimeve që kanë kryer dhe pasojat e ardhura, me ndergjegje ofrojnë bashkëpunimin e tyre me organet e ndjekjes penale⁸.

Karakteristikat e gjykimit me marrëveshje sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë

Në vijim analizohen dispozitat e Kodit të Procedurës Penale (KPP) lidhur me gjykimin me marrëveshje duke nxjerrë në pah tiparet dalluese të tij.

Sipas Kodit tonë, gjykimi me marrëveshje ka në thelb të tij “marrëveshjen mbi kushtet për pranimin e fajësisë dhe për caktimin e dënimit”, bazë e së cilës

⁵ Ligji nr. 35/2017“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar , botuar në Fletoren zyrtare të 5 majit 2017 dhe hyrë në fuqi më 1 gusht 2017

⁶ Për më tepër shih: Relacionin “Për K.P.Penale”, faqe 34, <https://www.parlament.al/ep-content/uploads/2017/01/RELACION-SHTESA-E-NDRYSHIME-7905-KODI-I-PROCEDURES-PENALE-Resized.pdf>, aksesuar me 1.12.2017

⁷ Po aty

⁸ Në Angli, pranimi i fajësisë dhe ndërgjegjësimi për ofrim të bashkëpunimit është shkaku kryesor që shtyn prokurorin të aplikojë këtë institut të së drejtës.

është pranimi i fajësisë kundrejt përfitimit të uljes së masës së dënimit, i negociuar ky i fundit prej palëve. I vetmi përfitim që jepet në këtë gjykim të posaçëm është caktimi i një dënimi më të zbutur nga ai që i akuzuari mund të merrte pas gjykimit. Marrëveshja do të caktojë llojin dhe masën e dënimit penal kryesor, dënimit plotësues, si dhe mënyrën e ekzekutimit të tyre, për të cilat palët kanë rënë dakord⁹. Kodi i Procedurës, si shumë vende të Evropës Kontinentale¹⁰ nuk ka përfitime të tjera për të pandehurin të cilat i gjejnë të aplikuara në shtete të tjera. Kështu, në Angli, SHBA, Itali pjesë e marrëveshjes është edhe negociimi mbi cilësimin juridik të veprës apo akuzat që mund t'i ngarkohen të dënuarit. Në Kosovë për shembull përveç uljes së masës së dënimit në këmbim të pranimit të fajësisë i akuzuari perfiton edhe “*konsiderime të tjera në interes të drejtësisë, siç është lirimi nga dënimi*”¹¹

Gjithashtu, në ndryshim nga vende si SHBA, Angli, Itali, Maqedoni, Kosovë, gjykimi me marrëveshje sipas ligjit shqiptar, nuk mund të aplikohet për të akuzuar me çfarëdo veprë penale. Ky institut kufizohet vetëm për individë të akuzuar për veprat penale, për të cilat ligji parashikon një dënim në maksimum jo më shumë se 7 vjet burgim¹². Një qasje për aplikim të kufizuar ka psh Franca, e cila e aplikon për vepra që dënohen maksimumi deri në 5 vjet.¹³ Megjithatë, një kufizim i tillë nuk gjen zbatim në rastin e aplikimit të këtij gjykimi për bashkëpunëtorët e drejtësisë¹⁴. Fillimisht në draftin e propozuar nga Qeveria në Kuvend parashikohej që aplikimi të bëhej për vepra për të cilat ligji parashikon një dënim në maksimum jo më shumë se 14 vjet¹⁵, por me të drejtë shohim një ngurrim të ligjëvënësit për të mos e shtrirë këtë gjykim gjerësisht, pa testuar efektet që do të sjellë zbatimin në praktikë në një fazë të parë.

Lidhur me fazën e procesit kur mund të gjejë aplikim gjykimin me marrëveshje KPP parashikon se propozimi për të negociuar një marrëveshje mbi kushtet për pranimin e fajësisë dhe për caktimin e dënimit mund të bëhet nga çasti i regjistrimit të emrit të personit që i atribuohet vepra penale derisa të mos ketë filluar shqyrtimi gjyqësor¹⁶. Nisur nga kjo personit duhet t'i komunikohet që në momentin e parë

⁹Neni Neni 406/d/3-c I Kodit të Procedurës Penale

¹⁰Gjermani, Maqedoni, Serbi

¹¹ Neni 233 I KPP të Kosovës http://www.kpk-rks.org/assets/cms/uploads/files/Kodi_i_procedures_penale.pdf, aksesuar me 2.12.2017

¹² Neni 406/d/2 I Kodit të Procedurës Penale

¹³ Zvrlevski, M, Vitlarov T, Ilievski J “Zbatimi praktik i marrëveshjes për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal në vitin e parë të zbatimit të ligjit të ri për procedurë penale analiza juridike”, Poliesterdej, Shkup 2016, <http://www.osce.org/sq/skopje/255936>, fq44, aksesuar më 2.12.2017

¹⁴ Po aty

¹⁵ Shih Relacionin “Për K.P.Penale”, faqe 34

¹⁶ Neni 406/d/1 I Kodit të Procedurës Penale

mundësia që ka për të zgjedhur këtë gjykim të posaçëm, nëse ai së bashku me mbrojtësin e tij e gjejnë me vend në rastin konkret. Në dallim nga legjislacione të tjera që e lejojnë edhe në fazën e gjykimit, si psh Kosova, Maqedonia, Kodi ynë e ka kufizuar negociimin e saj me momentin e fillimit të shqyrtimit gjyqësor. Si rregull, përfitimet e aplikimit të gjykimit me marrëveshje janë më të mëdha, (sa i takon përfitimeve të shtetit lidhur me kostot e hetimit dhe eficiencën e procedurës), nëse marrëveshja arrihet në një fazë sa më të hershme të procesit. Megjithatë, sa kohë që objekt i negociimit në marrëveshje është masa e dënimit, dhe jo dhe negociimi i akuzës së ngritur, prokurorit do t'i duhet të zhvillojë hetime për të bërë një cilësim të drejtë ligjor të veprës penale dhe për të caktuar drejt masën e duhur të dënimit që i takon të marrë personi, referuar shkeljes apo rrethanave lehtësuese apo rënduese që mund të gjejnë aplikim në rastin konkret. Gjithashtu, fakti se kjo marrëveshje mund të iniciohet edhe nga prokurori, nënkupton që ky i fundit mund ta propozojë atë jo për t'i akorduar ulje sanksioni të akuzuarit, por me qëllim eficiencën e procesit të vlerësuar si rezultat të hetimeve të kryera dhe përfundimeve të arritura prej tij deri në momentin e propozimit. Gjithashtu, vihet re se Kodi ynë nuk bën ndonjë lidhje midis momentit të arritjes së një marrëveshjeje të tillë, dhe përfitimeve që mund të ketë i akuzuari, referuar masës së dënimit, qëndrim ky i mbajtur p.sh në ligjin Kosovar¹⁷.

Një tipar tjetër dallues i institutit të marrëveshjes së pranimit të fajësisë në ligjin tonë lidhet edhe me faktin se nuk ka një përcaktim apo limit se sa mund të ulet dënimi. Shtete si Kosova psh përcaktojnë marzhe për uljen e dënimit në varësi të fazës procedurale kur realizohet marrëveshja, ndërkohë që vendosin si limit për uljen e dënimit jo më poshtë se minimumi i lejuar nga ligji. Në Itali është e përcaktuar se ky dënim është i detyrueshëm të ulet me 1/3, për çdo lloj vepre.¹⁸ Anglia, në përputhje dhe me natyrën e sistemit të *common law*-t ka Udhëzues për mënyrën se si mund të aplikohet dënimi, duke parashikuar ulje deri në 1/3 kur marrëveshja arrihet në fazat e hershme dhe më pak në fazat e mëvonshme¹⁹. Për shmangie të subjektivizmit dhe aplikim të drejtë të këtij instituti duhet që gjatë zbatimit, praktika të unifikohet duke u përcaktuar disa kritere bazë orientuese për masën e zbutjes së dënimit.

Subjektet që kanë të drejtë të propozojnë arritjen e një marrëveshjeje për pranimin e fajësisë dhe për caktimin e dënimit janë si prokurori ashtu dhe i pandehuri. Ky i fundit mund të veprojë vetë personalisht apo nëpërmjet përfaqësuesit të tij

¹⁷ Neni 233 I KPP të Kosovës

¹⁸ Zvrlevski, M, Vitlarov T, Ilievski J “Zbatimi praktik i marrëveshjes për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal në vitin e parë të zbatimit të ligjit të ri për procedurë penale analiza juridike”, Poliesterdej, Shkup 2016, fq. 40 <http://www.osce.org/sq/skopje/255936>

¹⁹ SENTENCING GUIDELINES COUNCIL, REDUCTION IN SENTENCE FOR A GUILTY PLEA: DEFINITIVE GUIDELINE (rev. 2007), https://www.sentencingcouncil.org.uk/ep-content/uploads/Reduction_in_Sentence_for_a_Guilty_Plea_-Revised_20071.pdf, aksesuar me 3.12.2017

të posaçëm²⁰. Në bisedimet për arritjen e marrëveshjes prania e mbrojtësit të të pandehurit është e detyrueshme²¹. Prania e mbrojtësit, të zgjedhur apo caktuar, gjatë gjithë fazës së bisedimeve për arritjen e marrëveshjes, është një standard i pranuar gjerësisht, i cili i shërben si garantimit të të drejtave të personit të akuzuar, në kushtet kur këto bisedime zhvillohen të mbyllura dhe nuk janë publike, ashtu edhe barazisë së palëve në një proces ku i akuzuari ka pozitë inferiore dhe heq dorë nga disa të drejta. Mungesa e mbrojtësit e bën absolutisht të pavlefshme procedurën dhe vetë marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit²². Si rregull, i akuzuari duhet që para hyrjes në negociatë të jetë konsultuar me mbrojtësin e tij, për këtë lloj gjykimi paraprakisht për të vlerësuar nëse është ose jo në favor të tij aplikimi.

Marrëveshja mbi kushtet për pranimin e fajësisë dhe për caktimin e dënimit, është një akt formal i cili duhet detyrimisht bëhet me shkrim. Ajo përbëhet nga dy palë, pokurori dhe i akuzuari, i përfaqësuar në çdo rast me mbrojtës. Në kod përcaktohen të gjithë elementët e detyrueshëm që duhet të përmbajë dhe që garantojnë vlefshmërinë e saj, si:

- përshkrimin e qartë të faktit penal, për të cilin akuzohet i pandehuri dhe cilësimin e tij juridik;

- deklarimin e pohimit të fajësisë nga ana e të pandehurit;

- llojin dhe masën e dënimit penal kryesor, dënimit plotësues, si dhe mënyrën e ekzekutimit të tyre, për të cilat palët kanë rënë dakord;

- disponimet për provat materiale dhe sendet që i përkasin veprës penale, si dhe për konfiskimin e mjeteve e produkteve të veprës penale, sipas nenit 36 të Kodit Penal;

- në rastin kur është legjitimuar paditësi civil, pëlqimin e tij me shkrim për masën e shpërblimit të dëmit nga i pandehuri;

- shumën e shpenzimeve procedurale;

- nënshkrimet e palëve dhe të mbrojtësit²³

Të gjithë elementët e mësipërm janë të detyrueshme dhe mungesa e tyre sjell si pasojë pavlefshmërinë e marrëveshjes, pa bërë dallim mes pavlefshmërisë absolute a relative të këtij akti. Kodi përcakton dhe një kusht ndalues gjatë negociimit të palëve, duke u shprehur se marrëveshja me kusht për pranimin e pjesëshëm të akuzave është e papranueshme²⁴. KPP nuk parashikon një afat brenda të cilit palët negociojnë marrëveshjen, megjithatë, referuar qëllimit të këtij instituti, kuptohet që ky afat duhet të jetë sa më i shkurtër dhe duhet të respektojë afatet e hetimit.

²⁰ Neni 406/d/1 i Kodit të Procedurës Penale

²¹ Neni 406/d/2 i Kodit të Procedurës Penale

²² Neni 406/d/3 i Kodit të Procedurës Penale

²³ Neni 406/d/3 i Kodit të Procedurës Penale

²⁴ Neni 406/d/5 i Kodit të Procedurës Penale

Nëse palët nuk arrijnë të bien dakord për marrëveshjen, ato nuk kanë të drejtë të ankohen. Në këto raste, çështja vazhdon të hetohet dhe gjykohet me procedurë të zakonshme.

Marrëveshja për pranimin e fajësisë ka dy palë dhe viktimën nuk është pjesë e saj. Megjithatë, pas nënshkrimit të marrëveshjes, prokurori njofton viktimën ose trashëgimtarët e saj, duke i dërguar kopje të marrëveshjes²⁵. Një veprim i tillë bëhet nëse identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, duke e parë si garanci për viktimën e identifikuar, sesa një detyrim për prokurorin. Në ligj nuk përcaktohet se cili do të jetë roli i qëndrimit të viktimës lidhur me marrëveshjen në këtë fazë, megjithatë nënkuptohet se ky qëndrim nuk ndikon në përfundimin apo jot të saj. Duket që KPP i jep viktimës një rol periferik në këtë procedurë. Në fakt, për të shmangur reagime potenciale të saj në të ardhmen, njoftimi duhet të ishte detyrim për procesin, edhe pse pëlqimi i saj nuk përbën kusht për lidhjen e marrëveshjes²⁶. Për më tepër, mendojmë se i akuzuari në çdo rast gjatë marrëveshjes, pavarësisht paraqitjes ose jo të kërkesave nga viktimën, duhet të marrë përgjegjësitë për kompensimin e dëmeve që u ka sjellë të dëmtuarve me veprimet e tij²⁷. Megjithatë, lidhur me dëmet, asgjë nuk e pengon viktimën që nëse nuk është njoftuar apo me vetëdije nuk bëhet pjesë e procedurës të ngrejë padi civile për dëmet e pësuar.

Siç theksohet dhe më sipër, marrëveshja për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit është proces mes prokurorit dhe të akuzuarit (i shoqëruar në çdo rast me mbrojtësin e tij) dhe gjykata nuk merr pjesë në negociatën dhe nuk ushtron asnjë rol në masën e dënimit të caktuar. Roli që Kodi i jep gjykatës është ai i miratimit të kësaj marrëveshjeje, vetëm pas shqyrtimit të saj dhe verifikimit të kushteve që kërkohen për vlefshmërinë. Një zgjedhje e tillë e bërë nga ligji është në të njëjtën linjë me Rekomandimin 87(18) të Këshillit të Evropës, sipas të cilit kërkohet që “*procedura e pranimit të fajësisë duhet të kryhet në një seancë gjyqësore publike*”, si dhe se “*kur mbahet çështja gjyqësore, pavarësisht gatishmërisë së të akuzuarit për të pranuar fajin e tij, gjykata duhet të kufizohet në ato hapa absolutisht të nevojshme që lidhen me faktet, duke marrë parasysh procedurën e zhvilluar para gjyqit*”. Për këtë arsye, prokurori pas arritjes së marrëveshjes e dërgon atë për

²⁵ Neni 406/d/4 i Kodit të Procedurës Penale

²⁶ Referuar Zvrlevski, M, Vitlarov T, Ilievski J “Zbatimi praktik i marrëveshjes për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal në vitin e parë të zbatimit të ligjit të ri për procedurë penale analiza juridike”, Poliesterdej, Shkup 2016, fq. 19 <http://www.osce.org/sq/skopje/255936>, njoftimi i viktimës në legjislacionin maqedonas është detyrim dhe marrja e deklaramit të saj në raste kur nuk ka pretendime pronësore, i bashkëlidhet tekstit të marrëveshjes.

²⁷ Një qëndrim i tillë mbahet në udhëzimin për marrëveshjen e pranimit të fajësisë të nxjerrë nga zyra e kryeprokurorit të shtetit të Kosovës, nëntor 2013, http://kpk-rks.org/assets/cms/uploads/files/Legjislacioni/Udhëzimet%20Administrative/Udhëzim_mbi_marrëveshjet_për_pranimin_e_fajësisë.pdf, aksesuar me 3.12.2017

miratim në gjykatë, së bashku me të gjitha aktet e hetimeve paraprake.²⁸ Gjykata e shqyrton kërkesën në seancë gjyqësore brenda tridhjetë ditëve nga paraqitja e saj²⁹. Seanca zhvillohet me praninë e detyrueshme të prokurorit, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij³⁰. Sa i takon viktimës ajo njoftohet dhe ka të drejtë të marrë pjesë, por mosparaqitja e saj nuk pengon shqyrtimin e çështjes.³¹ Gjithashtu, në rastin kur ajo është e pranishme, gjykata e fton të japë mendim mbi përmbajtjen e marrëveshjes³². Megjithatë nuk ka ndonjë përcaktim mbi vlerën që mund të ketë për vendimin e gjykatës ky mendim.

Seanca gjyqësore nis me verifikimin e paraqitjes së palëve. Pas këtij veprimi, gjykata e deklaron të hapur shqyrtimin gjyqësor dhe fton prokurorin për të paraqitur, në mënyrë të përmbledhur, rezultatet e marrëveshjes së arritur, ndërsa mbrojtësi e merr fjalën, nëse e kërkon³³. Roli i gjykatës në shqyrtimin e marrëveshjes kufizohet në: verifikimin e vullnetit të lirë të të pandehurit në pranimin e fajit dhe në kuptimin e pasojave që vijnë prej saj, si edhe në verifikimin e faktit se cilësimi juridik i veprës dhe rrethanat e saj, përshtatshmëria e dënimit të caktuar, si dhe mungesa e shkaqeve të padënueshmërisë apo të shuarjes së veprës penale, janë vlerësuar drejt nga ana e prokurorisë³⁴. Gjykata nuk mund të ndryshojë kushtet e marrëveshjes së arritur mes palëve³⁵, në ndryshim kjo nga praktika e ndjekur, psh në Itali, ku mund të jepet dhe një masë tjetër dënimi e ndryshme nga marrëveshja³⁶. Për këtë arsye, gjykata e pyet posaçërisht të pandehurin lidhur me faktin:

- nëse e ka bërë marrëveshjen me vullnetin e tij të lirë;
- nëse ka qenë i përfaqësuar nga mbrojtësi në bisedimet për arritjen dhe nënshkrimin e saj;
- nëse e kupton marrëveshjen dhe përmbajtjen e saj;
- nëse i ka kuptuar pasojat që vijnë prej miratimit të marrëveshjes; si dhe
- nëse jep pëlqimin që marrëveshja të miratohet dhe të vihet në ekzekutim³⁷.

²⁸ Neni 406/dh/1 i Kodit të Procedurës Penale

²⁹ Neni 406/dh/2 i Kodit të Procedurës Penale

³⁰ Idem

³¹ Idem

³² Neni 406/dh/3 i Kodit të Procedurës Penale

³³ Neni 406/dh/3 i Kodit të Procedurës Penale

³⁴ Shih nenin 406/e/2 i Kodit të Procedurës Penale

³⁵ Neni 406/e/4 i Kodit të Procedurës Penale

³⁶ Zvrlevski, M, Vitlarov T, Ilievski J “Zbatimi praktik i marrëveshjes për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal në vitin e parë të zbatimit të ligjit të ri për procedurë penale analiza juridike”, Poliesterdej, Shkup 2016, fq. 40

³⁷ Neni 406/dh/4 i Kodit të Procedurës Penale

Në përfundim të gjykimit nëse:

- i pandehuri nuk merr pjesë në gjyq, pa shkaqe të përligjura apo tërheq pëlqimin;

- provohet se vullneti i tij ka qenë i vesuar; provat në fashikullin e hetimeve vijnë në kundërshtim me pohimin e të pandehurit se ai e ka kryer veprën penale;

- cilësimi juridik i veprës penale dhe i rrethanave të kryerjes së saj është i gabuar; apo

- nëse dënimi i caktuar në marrëveshje është i papërshtatshëm, në raport me veprën e kryer dhe personalitetin e të pandehurit,

- gjykata refuzon marrëveshjen dhe i kthen aktet prokurorit³⁸. Në këtë rast vijohet me procedurë të zakonshme. Si garanci, Kodi përcakton se, deklarimet e të pandehurit gjatë seancës nuk mund të përdoren kundër tij³⁹. Vendimi për refuzimin e miratimit të marrëveshjes, si çdo vendim tjetër, duhet të jetë i arsyetuar. Nëse gjykata e refuzon marrëveshjen e paraqitur nuk mund të paraqitet një kërkesë e re⁴⁰. Gjithashtu vendimi i refuzimit është i paankimueshëm⁴¹. Në rast se ekziston një nga shkaqet e mosfillimit të procedimit ose të pushimit të akuzës ose çështjes ajo merr vendim pushimi⁴². Në këtë rast, prokurori ka të drejtë të bëjë ankim, sipas rregullave të parashikuara në Kod për ankimet⁴³.

Në të gjitha rastet e tjera, të ndryshme nga sa më sipër, gjykata vendos miratimin e marrëveshjes. Vendimi i gjykatës, që miraton marrëveshjen, përmban:

- gjenealitetet e të pandehurit dhe të dhënat e tjera personale të nevojshme për identifikimin e tij, si dhe gjenealitetet e viktimës, nëse është e pranishme;

- faktin që i pandehuri ka qenë i përfaqësuar dhe identitetin e mbrojtësit të tij;

- faktin që i pandehuri e ka kuptuar përmbajtjen e marrëveshjes dhe pasojat që vijnë prej saj dhe ka nënshkruar me vullnet të lirë;

- faktin se cilësimi juridik i veprës dhe rrethanat e saj, përshtatshmëria e dënimit të caktuar, si dhe mungesa e shkaqeve të padënueshmërisë apo të shuarjes së veprës penale, janë vlerësuar drejt nga prokurori;

- deklarimin fajtor të të pandehurit, caktimin e dënimit dhe disponime të tjera, sipas përmbajtjes së marrëveshjes;

- datën dhe nënshkrimin e vendimit.⁴⁴

Mungesa e këtyre elementëve e bën vendimin të pavlefshëm. Kodi nuk bën dallim mes pavlefshmërisë absolute apo relative në këtë rast.

³⁸ Neni 406/ë/1 dhe 2 i Kodit të Procedurës Penale

³⁹ Neni 406/ë/3 i Kodit të Procedurës Penale

⁴⁰ Neni 406/ë/2 i Kodit të Procedurës Penale

⁴¹ Neni 406/f/1 i Kodit të Procedurës Penale

⁴² Neni 406/ë/1 dhe 2 i Kodit të Procedurës Penale

⁴³ Neni Neni 406/f i Kodit të Procedurës Penale

⁴⁴ Neni 406/e/2 I KPP

PËRFUNDIME

Miratimi i institutit të gjykimit me marrëveshje në Kodin e Procedurës Penale, shihet si një risi që synon të sjellë përshpejtimin e procedurës penale për një kategori të caktuar veprash, duke ulur kostot e procesit, ngarkesën e prokurorëve dhe dënimin e autorëve. Njëkohësisht aplikimi i këtij gjykimi të posaçëm, pritet të ndikojë në humanizimin e mëtejshëm të sistemit të drejtësisë penale dhe njëkohësisht do t'i shërbejë rehabilitimit të suksesshëm të autorëve të veprave penale.

Gjykimi me marrëveshje, i parashikuar në Kodin tonë të Procedurës Penale paraqet tipare dalluese në raport me vende të tjera, si përsa i përket veprave për të cilat aplikohet, fazës në të cilën mund të negociohet, përfitimeve të të pandehurit, rolit të gjykatës në këtë proces, etj. Kjo tregon një kujdes të legjislatorit për t'ia përshtatur zbatimin e tij sistemit tonë të drejtësisë penale dhe duke marrë në konsideratë faktin e aplikimit të tij për herë të parë.

Ngelet në dorë të aktorëve të sistemit të drejtësisë penale që ta aplikojnë këtë institut në përputhje me qëllimin e caktuar nga legjislatori. Në funksion të tij, shihet e domosdoshme që me qëllim shmangien e subjektivizmit, të përpunohen udhëzues orientues në lidhje me rastet se kur duhet që nga prokurori të propozohet aplikimi i këtij instituti, kohën, kriteret që duhet të merren në konsideratë për të caktuar sanksionin, miratimi i formatit standard të marrëveshjes, etj.

Gjykimi me marrëveshje do të përmbushë qëllimin e vetë këtij instituti dhe do të sjellë efektet e dëshiruara nga publiku, vetëm nëse ai përdoret në praktikë në mënyrë korrekte dhe jo si një armë që i shërben sistemit të pandëshkueshmërisë.

BIBLIOGRAFIA

Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, http://www.pp.gov.al/web/kodi_i_procedures_penale_datë_30_gusht_2017_1201.pdf

Ligji 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” <https://www.parlament.al/ep-content/uploads/2017/04/ligj-nr.-35-dt.-30.3.2017.pdf>

Relacionin “Për K.P.Penale”, faqe 34, <https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2017/01/RELACION-SHTESA-E-NDRYSHIME-7905-KODI-I-PROCEDURES-PENALE-Resized.pdf>

Kodi i Procedurës Penale të Kosovës http://www.kpk-rks.org/assets/cms/uploads/files/Kodi_i_procedures_penale.pdf

Ligj për procedurë penale, <http://www.pravda.gov.mk/documents/30%20zakon%20za%20krivicna%20postapka.pdf>

Recommendation no. R (87) 18 concerning the simplification of criminal justice, 17 September 1987, [http://www.barobirlik.org.tr/dosyalar/duyurular/hsykanunteklifi/recR\(87\)18e.pdf](http://www.barobirlik.org.tr/dosyalar/duyurular/hsykanunteklifi/recR(87)18e.pdf)

Sentencing guidelines council, reduction in sentence for a guilty plea: definitive

guideline (rev. 2007), https://www.sentencingcouncil.org.uk/ēp-content/uploads/Reduction_in_Sentence_for_a_Guilty_Plea_-Revised_20071.pdf

Udhēzim pēr marrēveshjen e pranimit tē fajēsisē tē nxjerrē nga zyra e kryeprokurorit tē shtetit tē Kosovēs, nēntor 2013, http://kpk-rks.org/assets/cms/uploads/files/Legjislacioni/Udhezimet%20Administrative/Udhēzim_mbi_marrēveshjet_pēr_pranimin_e_fajēsisē.pdf

Zvrlevski. M, Vitlarov T, Ilievski J “Zbatimi praktik i marrēveshjes pēr llojin dhe lartēsiniē e sanksionit penal nē vitin e parē tē zbatimit tē ligjit tē ri pēr procedurē penale analiza juridike”, Poliesterdej, Shkup 2016<http://www.osce.org/sq/skopje/255936>

Cheesman, S, “A Comparative Analysis of Plea Bargaining and the Subsequent Tensions ēith an Effective and Fair Legal Defence”, Szeged, 2014,doktori.bibl.u-szeged.hu/2488/1/Samantha_Joy_Cheesman_ertekezes.pdf

Jovanović I, Stanisavljević M, “Simplified Forms of Procedure in Criminal Matters regional criminal procedure legislation and experiences in application”, OSCE Mission to Serbia Belgrade, 2013, www.osce.org/serbia/103129?download=true

Klein, R, “Due Process Denied: Judicial Coercion in the Plea Bargaining Process”, Hofstra Law Review, Volume 32 | Issue 4, 2004

TË DREJTAT E TË PANDEHURIT NË KUADËR TË PROCESIT PENAL, NË PERSPEKTIVËN E SISTEMIT JURIDIK TË KOSOVËS

Armend PODVORICA¹
Adelina RAKAJ²

ABSTRAKT

Punimi “Të drejtat e të pandehurit në kuadër të procesit penal, në perspektivën e sistemit juridik të Kosovës”, ka për qëllim që të trajtojë të drejtat e të pandehurit si kategori e të drejtave të njeriut, përkatësisht si të drejta të të pandehurit në procesin penal dhe rëndësinë që ka mbrojtja e këtyre të drejtave në pozitën juridike të të pandehurit.

Në këtë punim do të trajtohet korniza ligjore që ofron Republika e Kosovës për të drejtat e të pandehurit me qëllim sigurimin e një procesi penal të drejtë dhe të paanshëm. Një dimension i posaçëm në këtë punim i kushtohet statusit që ka Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe dokumentet e tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës. Gjithashtu, do të trajtohet aspekti i ndikimit që kanë vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).

Një analizë e posaçme në kuadër të punimit i kushtohet shkallës së zbatimit praktik të të drejtave të të pandehurit në kuadër të procesit penal në Republikën e Kosovës.

Fjalët kyçe: të drejtat e të pandehurit, proces penal, gjykim i drejtë, KEDNJ.

HYRJE

Të drejtat e të pandehurit në kuadër të procesit penal paraqesin një dimension të rëndësishëm i cili lidhet me pozitën juridike që ka i pandehuri si subjekt i procedurës penale. Natyrisht që përcaktimi taksativ i të drejtave që i përkasin të pandehurit në secilën fazë të procesit penal, paraqet avancim të pozitës së të pandehurit në procesin penal dhe gjithashtu krijon siguri juridike se të drejtat e tij do të zbatohen.

Në këtë punim me theks të veçantë do të trajtohet pozita e të pandehurit në kuadër të procesit penal sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), duke

¹ Professor, Faculty of Law, University of Prizren “Ukshin Hoti,” Kosovo, email. armendi_537@hotmail.com

² Teaching assistant, Faculty of Law, University of Prizren “Ukshin Hoti,” Kosovo, email. rakaj.adelinal@gmail.com

analizuar të drejtat që përcakton ky kod dhe rëndësinë e tyre për zhvillimin e një procesi penal të drejtë dhe të paanshëm.

Një dimension tjetër në këtë punim i kushtohet statusit që kanë aktet ndërkombëtare përkitazi me të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës, meqenëse të njëjtat janë të obligueshme dhe në pajtim me frymën e tyre janë nxjerrë edhe aktet e brendshme. Madje, një çështje specifike në kuadër të këtij dimension i është ndikimi i vendimeve gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), ku edhe pse Republika e Kosovës nuk është palë aktive në këtë gjykatë, e njëjta ka marrë obligim kushtetues që interpretimi i të drejtave dhe lirive themelore të bëhet në harmoni me frymën e vendimeve të GJEDNJ.

Gjithashtu, si dimension i tretë në kuadër të këtij punimi paraqitet shkalla e zbatimit praktik të të drejtave të të pandehurit në kuadër të procesit penal në Republikën e Kosovës, duke iu referuar hapave konkrete që ka ndërmarrë Republika e Kosovës për të realizuar zbatimin e këtyre të drejtave.

1. Kuptimi i të drejtave të të pandehurit në procesin penal

Procesi penal paraqet tërësinë e veprimeve procedurale të cilat ndërmerren nga organe të caktuara me ligj, me qëllim të zbardhjes së çështjes penale, vërtetimit të fajësisë apo pafajësisë dhe shqiptimit të sanksionit penal ndaj të pandehurit. Natyrisht që gjatë zhvillimit të procedurës penale, në secilën prej fazave të saj³, i pandehuri është subjekt procedural kundër të cilit zhvillohet procedura penale. Sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) shprehja i pandehur i referohet personit kundër të cilit zbatohet procedura penale, përkatësisht përdoret si shprehje e përgjithshme për të “pandehurin”, “akuzuarin” dhe “personin e dënuar”.⁴ Prandaj, kur flasim për të drejtat e të pandehurit në kuadër të procesit penal, i referohemi pozitës së tij gjatë të gjitha fazave të procedurës penale, si i pandehur, i akuzuar dhe i dënuar.

Në rregullimin juridik të procesit penal në vet-vete ngërthehen dy tendenca kryesore si: tendenca për efikasitet të procedurës dhe tendenca për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të të pandehurit, ku si të tilla këto tendenca janë antagonistë dhe e përjashtojnë njëra tjetrën, prandaj në procesin penal bashkëkohor bëhen përpjekje që të arrihet një barazpeshim ndërmjet këtyre dy tendencave.⁵ Prandaj, rregullimi i pozitës së të pandehurit në kuadër të procesit penal është një çështje kyçe për të siguruar një proces të drejtë dhe të paanshëm.

Në kuptim të asaj që u tha më lart, Republika e Kosovës ofron tri baza juridike në lidhje me përcaktimin e të drejtave të të pandehurit të cilat janë: Aktet ndër-

³ Neni 68, KPPK, “Procedura penale ka katër faza të ndryshme: fazën e hetimit, fazën e ngritjes së aktakuzës dhe deklarimit, fazën e shqyrtimit gjyqësor dhe fazën e mjetit juridik”.

⁴ Neni 19 parag 1.4., KPPK, Prishtinë 2013

⁵ Sahiti, E., Murati, R. E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2013, Fq. 13

kombëtare të zbatueshme në Republikën e Kosovës dhe praktika gjyqësore e GJEDNJ, Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe legjislacioni i aplikueshëm penal.

Sa i përket akteve të zbatueshme ndërkombëtare, Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton se disa nga instrumentet (aktet) ndërkombëtare, siç janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe protokollat e saj (KEDNJ) dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollat e saj (KNDCP), të cilat garantojnë edhe të drejtat e të pandehurit janë të zbatueshme drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës.⁶ Prandaj, nga kjo nënkuptohet se ato kanë përparësi ndaj akteve të tjera ligjore, që do të thotë se vlefshmëria e tyre në rendin juridik të Republikës së Kosovës është e drejtpërdrejtë. Pra, nga parimi i zbatimit të drejtpërdrejtë të akteve ndërkombëtare, të përfshira në nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për aq sa këto akte rregullojnë të drejtat e të pandehurit, të njëjtat paraqesin edhe garanci për respektimin e këtyre të drejtave në Republikën e Kosovës.⁷

Gjithashtu, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, konform nenit 22, përveç se i bën të zbatueshme KEDNJ dhe KEDCP, gjithashtu në Kapitullin e II të saj, në mënyrë të veçantë i garanton të drejtat e të pandehurit, ku në nenin 29 dhe nenin 30, Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton të drejtat e personit të arrestuar si dhe të drejtat e të akuzuarit.

Neni 30 dhe 31 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcakton të drejtat e të akuzuarit të cilat ndër të tjera janë: (1) të njoftohet menjëherë në gjuhën që kupton, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër saj/tij; (2) të njoftohet për të drejtat e tij/saj sipas ligjit; (3) të ketë kohë, mundësi dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet; (4) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën në të cilën zhvillohet gjykimi; (5) të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh, të komunikojë lirisht me të dhe nëse nuk ka mjete të mjaftueshme t'i sigurohet mbrojtja falas; (6) të mos shtrëngohet për të dëshmuar kundër vetvetes ose për të pranuar fajësinë e vet.

Padyshim, që Kushtetuta e Kosovës si akt më i lartë në hierarkinë e akteve juridike, paraqet një bazë të rëndësishme për sigurimin e të drejtave të të pandehurit në kuadër të procesit penal, por përveç kushtetutës, një bazë e rëndësishme e garantimit të të drejtave të të pandehurit në Republikën e Kosovës është edhe Kodi i Procedurës Penale (KPPK) i cili në mënyrë direkte i përcakton të drejtat të cilat i takojnë të pandehurit në secilën fazë të procesit penal.

⁶ Nenin 22, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Prishtinë 2008

⁷ Morina, V., Korenica, F., & Doli, D., *The relationship between international law and national law in the case of Kosovo: A constitutional perspective*, 2011, fq. 294

2. Të drejtat e të pandehurit në kuadër të procesit penal të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës

Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), aktual, në pajtueshmëri me Kushtetutën e Kosovës dhe me frymën e konventave ndërkombëtare, ka përcaktuar një sërë të drejtash për të pandehurin. Përcaktimi i këtyre të drejtave ka për qëllim zbatimin e parimeve procedurale penale që i pandehuri të trajtohet si subjekt procedural.⁸

Të drejtat e të pandehurit në kuadër të procesit penal të përcaktuara në KPPK janë: e drejta për gjykim të drejtë, të paanshëm dhe në afat të arsyeshëm (neni 5), e drejta për mbrojtës (neni 11), e drejta që të njoftohet për shkaqet e akuzës, mos detyrimi për vetëfajësim dhe ndalesa kundër imponimit për pranim të fajit (neni 10), e drejta e të pandehurit në përkthim (neni 14), e drejta në përdorimin e mjeteve juridike të goditjes.

E drejta për gjykim të drejtë, të paanshëm dhe në afat të arsyeshëm (neni 5), paraqet një ndër të drejtat bazë e cila reflekton edhe në zbatimin e të drejtave të tjera që i garantohen të pandehurit në procesin penal dhe është tregues i dominimit të tendencës për mbrojtjen e lirive dhe të të drejtave të të pandehurit në procesin penal.

E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm si e drejtë e të pandehurit, e përcaktuar edhe si parim i procedurës penale⁹ nënkupton të drejtën për t'u gjykuar nga një organ i përcaktuar me ligj, me një procedurë të paraparë me ligj dhe nga gjyqtarë të pavarur dhe të paanshëm. E drejta për gjykim të drejtë është parim bazë i sundimit të ligjit në një shoqëri demokratike që synon të sigurojë të drejtën për një administrim të duhur të drejtësisë.¹⁰

Mirëpo, shtrohet çështja se çfarë nënkupton pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit dhe pse këto janë predispozita kyçe për një gjykim të drejtë.

Pavarësia e gjyqësorit sigurohet nga shteti dhe mbrohet me kushtetutë dhe gjyqësori duhet të vendosë për çështjet paanësisht, duke u bazuar në fakte dhe në pajtim me ligjin, pa asnjë kufizim, ndikim të padrejtë, nxitje, presion, kërcënim apo ndërhyrje, direkte apo indirekte, nga ndonjë drejtim apo për çfarëdo arsye.¹¹ Pavarësia e gjyqësorit është thelbësore për një gjykim të drejtë, sepse nënkupton se vendimmarrësit e çështjes janë të lirë dhe të paanshëm në vendosje, bazohen vetëm

⁸ Për më shumë shih parimet procedurale penale që përcakton KPPK: Prezumimi i pafajësisë së të pandehurit dhe parimi in dubio pro reo (neni 3), Ne Bis in Idem (neni 4), Barazia e palëve (neni 9), Publiciteti i shqyrtimit gjyqësor (neni 293) dhe parimi Reformatio in Peius (neni 395).

⁹ Neni 5, KPPK, Prishtinë, 2013

¹⁰ Leanza, P., & Pridal, O. a. *The right to a fair trial: Article 6 of the European Convention on Human Rights*. Alphen aan den Rijn, The Netherlands: Wolters Kluwer Law & Business: Kluwer Law International., 2014, fq. 7

¹¹ Parimet Themelore të KB për Pavarësinë e gjyqësorit, të aprovuara më 1985 nga Asambleja e Përgjithshme, Rezolutat 40/32 dhe 40/146, para. 1 dhe 4

në faktet dhe në ligj, pa qenë të ndikuar nga ndonjë degë e qeverisë apo dikush tjetër.¹² Pavarësia e gjykatës është ngritur edhe në nivel të parimit procedural, si parim kyç për gjykim të drejtë.¹³

Për t'u siguruar se a janë plotësuar kushtet për një gjyqësor të pavarur i cili duhet të jetë bazë për gjykim të drejtë, duhet të vlerësohen nëse janë përmbushur disa kushte siç janë: mënyra e emërimit dhe shkarkimit të gjyqtarëve, mandati i tyre, mbrojtja e gjyqësorit nga presionet e jashtme dhe të shfaqurit e jashtëm të gjykatës së pavarur.¹⁴

Duke iu referuar mënyrës së emërimit dhe shkarkimit të gjyqtarëve dhe mandatit të tyre, duhet që e njëjta të jetë e rregulluar me kushtetutë dhe me ligj, për të evituar mundësitë e ndikimit të ekzekutivit në përzgjedhjen dhe shkarkimin e gjyqtarëve. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 104, ka përcaktuar se: gjyqtarët i emëron, riemëron dhe shkarkon Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ku Këshilli Gjyqësor është institucion plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij dhe siguron që gjykatat në Kosovë të jenë të pavarura, profesionale e të paanshme [...] (neni 108).

Sa i përket çështjes së mandatit të gjyqtarëve, është përcaktuar se mandati fillestar i gjyqtarëve është 3-vjeçar, derisa me riemërim mandati është i përhershëm deri në moshën e pensionimit.¹⁵ Natyrisht, që përcaktimi i mandatit të përhershëm me rastin e riemërimit të gjyqtarëve, krijon siguri juridike dhe ndikon që të njëjtit të mos bien pre e presioneve politike apo edhe presioneve të tjera.

Gjithashtu, Kushtetuta e Kosovës, përcakton edhe çështjen e emërimit, shkarkimit dhe kohëzgjatjen e mandatit për prokurorët e shtetit, natyrisht si organ i akuzës dhe subjekt primar në procedurën penale.¹⁶

Padyshim që kriteret për t'u emëruar gjyqtar i referohen përgatitjes profesionale, përvojës së punës dhe performancës, përfshirë të njohurit dhe respektimin e të drejtave të njeriut, integritetin personal etj.¹⁷ Pra, objektivisht emërimi në bazë të kriterëve profesionale dhe vlerësimit të integritetit personal do të pasqyrohet në pavarësinë e gjyqtarëve.

¹² AMNESTY INTERNATIONAL, FAIR TRIALS MANUAL, Amnesty International Publications, 1 Easton Street London WC1X 8DJ United Kingdom, 1998, fq. 88

¹³ Neni 8, KPPK, dhe Neni 3, KPP te Shqipërisë, 1995

¹⁴ Mahoney, P., *Right to a fair trial in criminal matters under article 6 E.C.H.R.*, Judicial Studies Institute Journal, Volume [4:2], 2004, fq. (116-117)

¹⁵ Neni 105, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2008

¹⁶ Po aty, Neni 109,

¹⁷ Neni 17, Ligjit nr. 05/1-094 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/1-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 05/1 -033 si dhe ligjin nr. 04/1-115, Data e Publikimit: 06.04.2016.

Për të mbrojtur pavarësinë e gjyqësorit duhet që të emëruarit për gjyqtarë të përzgjidhen në bazë të përgatitjes së tyre profesionale dhe përvojës së tyre.¹⁸

Dimensioni tjetër që lidhet me gjykimin e drejtë është edhe çështja e paanshmërisë së gjykatës. Paanshmëria e gjykatës nënkupton që gjyqtarët të mos kenë paragjykimë në rastet e paraqitura para tyre dhe njëkohësisht nuk duhet të veprojnë në atë mënyrë që të mbrojnë interesat e njëjës palë.¹⁹

Në rastin Clark kundër Mbretërisë së Bashkuar, GJEDNJ, për çështjen e paanshmërisë së gjykatës ka theksuar se: paanshmëria e gjykatës në vet-vete shtrondy kërkesa: së pari, gjykata duhet të jetë subjektivisht e lirë nga paragjykimet personale dhe së dyti, duhet të jetë e paanshme në pikëpamje objektive dhe të ofrojë garanci për të përjashtuar çdo dyshim të ligjshëm rreth paanshmërisë së saj.²⁰

Prandaj, nga kjo që trajtuam del qartë se e Drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm ndërthen në vete disa të drejta si trajtimin e barabartë para gjykatave, shqyrtimin publik dhe në kohë të arsyeshme, barazinë e armëve në procesin penal, të drejtën që i pandehuri të prezumohet i pafajshëm deri në vërtetimin e fajësisë dhe të drejtën për ndihmë juridike falas.²¹

Së këndejmi, sipas autorëve Leanza & Pridal, një gjyqtar/e nuk mund të nxjerrë një vendim të drejtë nëse vlerësohet se ka pasur një shkelje të rëndë të së drejtës për gjykim të drejtë.²²

Gjithashtu, krahas të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm edhe e drejta për gjykim në afat të arsyeshëm, paraqet obligimin e gjykatës që të zhvillojë procedurën pa zvarritje. Për të realizuar parimin e gjykimit në afat të arsyeshëm KPPK, në nenin 314, krahas përcaktimit të kësaj të drejte, në një nen të veçantë përcakton kohëzgjatjen e shqyrtimit gjyqësor duke përcaktuar afate ligjore prekluzive, ku “nëse shqyrtimi gjyqësor mbahet para gjyqtarit të vetëm gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundohet brenda 90 ditësh, përkatësisht brenda 120 ditësh nëse shqyrtimi mbahet para trupit gjykues, derisa janë numëruar në mënyrë taksative rastet kur mund të kërkohet vazhdimi i shqyrtimit gjyqësor edhe për 30 ditë, siç janë numri i shumtë i dëshmitarëve, numri jashtëzakonisht i madh i provave, dëshmitë e gjata dhe siguria e shqyrtimit gjyqësor.

Edhe pse e drejta për gjykim në kohë të arsyeshme është e përcaktuar në KPPK, nga praktika gjyqësore shihet se në Republikën e Kosovës gjyqtarët janë

¹⁸ AMNESTY INTERNATIONAL, FAIR TRIALS MANUAL, Amnesty International Publications, 1 Easton Street London WC1X 8DJ United Kingdom, 1998, fq.91

¹⁹ Rasti Karttunen v. Finland, (387/1989), 23 October 1992, Report of the HRC, vol. II, (A/48/40), 1993, at 120, para. 7.2

²⁰ Rasti 23695/02, CLARKE kundër Mbretërisë së Bashkuar, GJEDNJ, 2005

²¹ Neni 31, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2008

²² Leanza, P., & Pridal, O. a. *The right to a fair trial: Article 6 of the European Convention on Human Rights*. Alphen aan den Rijn, The Netherlands: Wolters Kluwer Law & Business: Kluwer Law International. 2014, fq.4

treguar tepër të “ngathët” në kuptim të zbatimit të afateve që përcakton KPPK, për të realizuar të drejtën për një gjykim në kohë të arsyeshme.

E drejta për mbrojtës (neni 11), paraqet një të drejtë tjetër, gjithashtu shumë të rëndësishme për pozitën e të pandehurit në kuadër të procesit penal. Ofrimi i ndihmës profesionale juridike për të pandehurin paraqet garanci të rëndësishme për mbrojtjen adekuate të të drejtave të tij dhe për realizimin e parimit të barazisë së armëve. Në përgjithësi, i akuzuari, nuk është avokat, nuk është i njohur me procedurat penale, prandaj e ka të vështirë të përballet me rregullat e ndërlikuara të ligjeve, dhe kjo në vete ngërthen frikë lidhur me pozitën e tij gjatë zhvillimit të procedurës.²³ Madje sipas Etienne, të drejtat e të pandehurve në procedurë varen jo vetëm nga njohja gjyqësore e këtyre të drejtave, por edhe nga gatishmëria e avokatëve për t’i mbrojtur këto të drejta.²⁴

Në rastin Quaranta kundër Zvicrrës, GJEDNJ, ka vendosur tri standarde sa i përket të drejtës për mbrojtje të obligueshme, ku sipas këtij rasti duhet të merren parasysh tri kritere dhe atë: serioziteti i veprës dhe lartësia e dënimit; kompleksiteti i veprës si dhe mundësitë e të akuzuarit për të siguruar përfaqësim.²⁵

E drejta që të njoftohet për shkaqet e akuzës, mosdetyrimi për vetëfajësim dhe ndalesa kundër imponimit për pranim të fajit (neni 10), gjithashtu paraqet një të drejtë mjaft të rëndësishme për të pandehurin. Kjo e drejtë e rëndësishme lidhet me të drejtën për liri dhe siguri, e cila përcaktohet nga KEDNJ, në nenit 5 parag. 2 ku thuhet se: “*çdo person i arrestuar, duhet të informohet me kohë për arsyet e arrestimit, në një gjuhë që e kupton në lidhje me çdo akuzë që i bëhet*”. Natyrisht që rëndësia e kësaj të drejte qëndron në të drejtën e secilit të pandehur që të njoftohet me kohë për shkaqet e arrestimit dhe të jetë në gjendje të përgatisë mbrojtjen e tij. Gjithashtu, mosdetyrimi për fajësim lidhet direkt me parimin e prezumimit të pafajësisë, si parim kyç i procedurës penale, madje edhe në rastet kur kemi marrëveshje për pranimin e fajësisë, gjykata duhet të vlerësojë nëse pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme dhe në pajtim me rregullat e KPPK.

E drejta e të pandehurit në përkthim (neni 14), paraqet të drejtë të rëndësishme, ku në paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: “*Personi që merr pjesë në procedurë penale i cili nuk e flet gjuhën në të cilën zhvillohet procedura, ka të drejtë të flasë gjuhën e vet dhe të jetë i informuar nëpërmjet përkthimit pa pagesë me faktet, provat dhe procedurën. Përkthimi sigurohet përmes një përkthyesi të pavarur*”. Natyrisht, që një e drejtë e tillë është edhe reflektim i standardeve të krijuara nga vendimet

²³ Kremens., K. *The protection of the accused in International Criminal Law According To The Human Law Standards*, Wroclaw Review of Law, Administration & Economics [Vol 1:2], 2011, fq. 41

²⁴ Etienne, M., *The Declining Utility of the Right to Counsel in Federal Criminal Courts: An Empirical Study on the Diminished Role of Defense Attorney Advocacy Under the Sentencing Guidelines*. California Law Review, 92(2), 427-485. 2004, fq. 428

²⁵ Rasti Quaranta kundër Zvicrrës, GJEDNJ, 1991

e GJEDNJ, dhe lidhet edhe me zbatimin e të drejtave të tjera të të pandehurit, duke ditur se njohja e gjuhës në të cilën zhvillohet procedura është hap kyç për të kuptuar shkaqet e arrestimit dhe për të përgatitur mbrojtjen. Kështu, në rastin Brozicek kundër Italisë, GJEDNJ, theksoi “... edhe pse është dorëzuar aktakuza, megjithatë fakti që i pandehuri nuk ka qenë me origjinë italiane dhe nuk ka pasur vendqëndrim në Itali, ka njoftuar autoritetet Italiane në një mënyrë të qartë, se për shkak të gjuhës ka vështirësi në kuptimin e komunikimit të tyre dhe ka kërkuar nga ata që të dërgojnë dikë që flet gjuhën e tij amtare, ose të flasin në njërën nga gjuhët zyrtare të kombeve të bashkuara. Prandaj, mospërmbyshja e kësaj kërkesë nga autoritetet italiane është konsideruar që i ka pamundësuar të pandehurit që të njoftohet me përmbajtjen e aktakuzës së tij dhe kjo është cilësuar si shkelje e nenit 6.3 (a) të KEDNJ.²⁶

E drejta në përdorimin e mjeteve juridike të goditjes, gjithashtu paraqet një të drejtë mjaft të rëndësishme për të pandehurin, ku është tregues i sigurisë juridike se rasti i tij do të trajtohet në më shumë se një instancë. Sipas Protokollit Nr. 7 i Konventës për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore (1984, neni 2), secili i pandehur që shpallet fajtor në shkallën e parë ka të drejtë të paraqesë edhe njëherë shqyrtimin e tij në një gjykatë të një shkalle tjetër.

Gjithashtu, Kushtetuta e Republikës së Kosovës (neni 29, paragrafi 4 dhe 5), garanton mjetet juridike për personin e arrestuar, në cilësinë e të pandehurit si dhe të drejtën e kompensimit për privimin në mënyrë të padrejtë nga liria. Konteksti i garantimit të së drejtës për mjete juridike, në frymën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës nënkupton që mjetet juridike të jenë efektive. Në rastin Mifsud kundër Francës, GJEDNJ ka dhënë përkufizimin mbi efektivitetin e mjeteve juridike dhe atë: “një mjet ankimi është efektiv nëse mund të përdoret ose për të përsheptuar marrjen e një vendimi nga gjykatat që shqyrtojnë çështjen, ose për t’u siguruar palëve ndërgjyqëse një adresim të përshtatshëm për vonesat që kanë ndodhur tashmë”.²⁷

Padyshim, që organizimi i sistemit gjyqësor në bazë të parimit të shumëshkallshmërisë për gjykatat e rregullta²⁸, krijon mundësinë e realizimit të së drejtës së apelimit në kushtet e parapara ligjore. Gjithashtu, edhe e drejta e iniciimit të rastit në Gjykatën Kushtetuese, në rastet kur pretendohet se është bërë shkelja e lirive dhe të drejtave të njeriut, paraqet një mundësi më tepër për realizimin e të drejtave të të pandehurit apo thënë më mire jepet një mundësi më shumë për korigjim të punës së gjykatave të rregullta nga ana e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

²⁶ Rasti Brozicek kundër Italisë, GJEDNJ, 1989, parag.12

²⁷ Rasti nr.57220/00, Mifsud kundër Francës, GJEDNJ, 2002, p.5,

²⁸ Shih për më shumë: Neni 8, Sistemi i gjykatave i Republikës së Kosovës përbëhet nga: Gjykatat Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, Ligji Nr. 03/L-199 për Gjykatat, Prishtinë 2010

Mirëpo, sa i përket të drejtës së apelimit, një mangësi e madhe në rastin e Republikës së Kosovës, paraqet fakti se e njëjta nuk është palë aktive në GJEDNJ, sepse nuk është pjesë e Këshillit të Evropës, edhe pse Republika e Kosovës ka marrë përsipër zbatimin e drejtpërdrejtë të akteve ndërkombëtare (në këtë rast KEDNJ dhe KEDCP), por edhe zbatimin e praktikës së GJEDNJ.²⁹

3.Zbatimi praktik i të drejtave të të pandehurit në kuadër të procesit penal në Republikën e Kosovës

Padyshim që përcaktimi i të drejtave të të pandehurit me akte ndërkombëtare, kushtetutë dhe kod të procedurës penale, do të ishte e pamjaftueshme nëqoftëse organet që zhvillojnë procesin penal, përkatësisht gjykatat, nuk do t'i zbatonin këto të drejta në praktikë. Natyrisht, që zbatimi i të drejtave të të pandehurit është tregues edhe i nivelit të respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut. Siç u theksua më sipër, duket qartë që Republika e Kosovës, në aktet e saj të brendshme ka respektuar frymën e akteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, rrjedhimisht edhe për të drejtat e të pandehurit, duke i përcaktuar taksativisht të drejtat që i takojnë, por shtrohet çështja se sa respektohen në praktikë këto të drejta.

Duke iu referuar disa rasteve të ngritura në Gjykatën Kushtetuese, kemi pretendime për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Në një rast të tillë, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, kishte konstatuar se Gjykatat e rregullta në Republikën e Kosovës kanë shkelur parimin e barazisë së armëve si dhe të drejtën për gjykim të drejtë, sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6.1 të KEDNJ, për shkak se në të gjitha instancat kanë dështuar të marrin parasysh dëshmitë dhe dëshmitarët e propozuar nga ana e parashtruesit të kërkesës.³⁰

Gjithashtu, në një raport të Avokatit të Popullit³¹, i përpiluar sipas ankesës së disa qytetarëve, del se Prokuroria Speciale e Kosovës nuk ka arritur që të zbatojë të drejtat për të pandehurin që t'i informojë ata për ngritjen e aktakuzës, ku të njëjtit për aktakuzën ishin informuar përmes mediave. (E drejta për informimin e të akuzuarit, për ngritjen e aktakuzës është e përcaktuar në KEDNJ neni 6 si dhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës 2008, neni 31).

Edhe e drejta e të pandehurit për të pasur mbrojtje, edhe pse e përcaktuar formalisht paraqet sfidë në aspektin e zbatimit praktik, ku e drejta e të pandehurit për mbrojtës, si një e drejtë themelore përmbushet mjaft rrallë, përveq rasteve kur i pandehuri gjendet brenda listës së rasteve të mbrojtjes së detyruar që përcakton KPPK (neni 57, Mbrojtësi në rastet e mbrojtjes së detyruar), kjo nënkupton që KPPK bën përjashtime në obligueshmërinë e caktimit të mbrojtësit për të pandehurit.

²⁹ Neni 53, Kushteuta e Kosovës, 2008

³⁰ Rasti nr. KI31/17, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, paragrafi 77

³¹ Raporti me rekomandime i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës, Rasti Halili dhe të tjerët, nr.564/2016.

Gjithashtu, në shumë raste është vërejtur se në seancat gjyqësore, gjyqtarët nuk i kanë informuar të pandehurit për të drejtën e tyre apo edhe nëse i kanë informuar këtë nuk e kanë bërë në mënyrë të qartë, ku një obligim i tillë i gjyqtarëve parashihet në nenin 246(1) i KPPK.³²

Padyshim që shkelja e të drejtës së të pandehurit për të pasur mbrojtës paraqet një shkelje të rëndë e cila ndikon në nivelin e mbrojtjes së të drejtave të tyre dhe rrjedhimisht ndikon edhe në zgjidhjen e çështjes përfundimtare.

PËRFUNDIME

Nga analizat e mësipërme duket qartë se Republika e Kosovës, në sistemin e saj juridik ofron një sërë të drejtash për të pandehurin në kuadër të procesit penal, qoftë përmes zbatimit të drejtpërdrejtë të akteve ndërkombëtare siç është KEDNJ, zbatimit të frymës së vendimeve të GJEDNJ, qoftë përmes inkorporimit të këtyre të drejtave në aktet e brendshme siç është Kushtetuta e Kosovës dhe KPPK.

Padyshim, që një rregullim i tillë i pozitës së të pandehurit paraqet një avancim për Sistemin Juridik të Kosovës dhe gjithashtu paraqet siguri juridike për qytetarët, përkatësisht të pandehurit se procesi penal ndaj tyre do të jetë i drejtë dhe i paanshëm.

Edhe pse, nga të dhënat e mësipërme duket se Sistemi Juridik i Republikës së Kosovës, është mjaft i avancuar në aspektin e njohjes së të drejtave të të pandehurit, shqetësues mbetet fakti i zbatimit të dispozitave të KEDNJ dhe praktikës së GJEDNJ-së, nga ana e gjykatave të rregullta, për sa i përket zbatimit të të drejtave të pandehurit. Në praktikën gjyqësore të gjykatave të rregullta në Republikën e Kosovës, nuk mund të gjejmë asnjë rast, ku gjyqtarët kanë aplikuar drejtpërdrejt dispozitat e KEDNJ apo ndonjë rast të GJEDNJ, sa i përket të drejtave të të pandehurit, ku kjo rrethanë ka aktivizuar Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, e cila përmes aktgjykimeve përfundimtare të saj, ka kompensuar lëshimet që kanë bërë gjykatat e rregullta në zbatimin e standardeve të KEDNJ. Ky fakt përbën një element mjaft shqetësues, duke marrë parasysh statusin kushtetues që ka KEDNJ dhe praktikën e GJEDNJ, në Republikën e Kosovës. Një faktor përcaktues në këtë aspekt del të jetë edhe pamundësia e Kosovës që të jetë palë aktive në GJEDNJ, pasi që nuk është akoma anëtare e Këshillit të Europës.

Padyshim që në të ardhmen, pasi Kosova të antarësohet në këtë mekanizëm, atëherë do të mund të vërehet niveli i zbatimit të të drejtave të pandehurit në procesin penal. Prandaj, mbetet shumë për t'u bërë në zbatimin praktik të të drejtave të të pandehurit, që Republika e Kosovës, të arrijë t'i zbatojë mjaftueshëm të drejtat e të pandehurit si dhe standardet e krijuara nga GJEDNJ.

³² Shqyrtim i zbatimit të Kodit të ri të Procedurës Penale në Kosovë, OSBE, misioni në Kosovë, Qershor 2016, fq.11

REFERENCAT

Etienne, M., *The Declining Utility of the Right to Counsel in Federal Criminal Courts: An Empirical Study on the Diminished Role of Defense Attorney Advocacy Under the Sentencing Guidelines*. California Law Review, 92(2), 427-485. 2004, fq. 428

Kremens., K. *The protection of the accused in International Criminal Law According To The Human Law Standards*, Wroclaw Review of Law, Administration & Economics [Vol 1:2], 2011, fq. 41

Leanza, P., & Pridal, O. a. (2014). *The right to a fair trial: Article 6 of the European Convention on Human Rights*. Alphen aan den Rijn, The Netherlands: Wolters Kluwer Law & Business: Kluwer Law International. Pp. 7

Mahoney, P., *Right to a fair trial in criminal matters under article 6 E.C.H.R.*, 2004, Judicial Studies Institute Journal, Volume [4:2], Pp. (116-117)

Morina, V., Korenica, F., & Doli, D., *The relationship between international law and national law in the case of Kosovo: A constitutional perspective*, 2011, fq. 294

Sahiti, E., Murati, R. E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2013, Fq. 13

Dokumente të tjera:

AMNESTY INTERNATIONAL (1998) FAIR TRIALS MANUAL, Amnesty International Publications, 1 Easton Street London WC1X 8DJ United Kingdom, Pp. 88

Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), Prishtinë 2013

Kodi i Procedurës Penale të Shqipërisë, 1995

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Romë, 4.XI.1950.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Prishtinë 2008

Ligjit nr. 05/l-094 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/l-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 05/l -033 si dhe ligjin nr. 04/l-115, Data e Publikimit: 06.04.2016.

Parimet Themelore të KB për Pavarësinë e gjyqësorit, të aprovuara më 1985 nga Asambleja e Përgjithshme, Rezolutat 40/32 dhe 40/146, para. 1 dhe 4

Raporti me rekomandime i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës, Rasti Halili dhe të tjerët, nr.564/2016.

Rasti nr.57220/00, Mifsud kundër Francës ,GJEDNJ, 2002, p.5,

Rasti 23695/02 , CLARKE kundër Mbretërisë së Bashkuar, GJEDNJ, 2005

Rasti Brozicek kundër Italisë, GJEDNJ, 1989, parag.12

Rasti Karttunen v. Finland, (387/1989), 23 October 1992, Report of the HRC, vol. II, (A/48/40), 1993, at 120, para. 7.2

Rastin nr. KI31/17 Parashtrues Shefqet Berisha, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.

Shqyrtim i zbatimit të Kodit të ri të Procedurës Penale në Kosovë, OSBE, misioni në Kosovë, Qershor 2016, fq.11.

KUMTESË

Kontributi i Avokatit të Popullit ndër vite për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, nëpërmjet rekomandimeve për ndryshimin e legjislacionit, reflektuar në Reformën në Drejtësi.

Prof. Dr. Ermir DOBJANI

ish Avokat i Popullit në vitet 2000-2010.

I - HYRJE

Reforma në drejtësi, me ndryshimet e realizuara sidomos në Kodet e Procedurës Penale dhe Procedurës Civile si dhe Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur ka përmirësuar mjaft garancitë ligjore për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Republikën e Shqipërisë. Në këtë Kumtesë kam parashtruar disa ndryshime për të cilat për më shumë se 15 vite AP ka insistuar për nevojën e tyre, me qëllim përmirësimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri. Tashmë ato ndryshime janë realizuar. Në veçanti do trajtojmë sidomos përmirësimin e situatës së të drejtave të viktimës nga vepra penale, deklaratën apo Letrën e të drejtave të personit në procesin penal, garancitë shtesë që duhet të kenë të miturit në procedimet penale si dhe ndonjë ndryshim në Procedurën Civile gjatë procesit të pezullimit të vendimeve civile në Gjykatën e Lartë.

II - Baza ligjore dhe rëndësia e rekomandimeve të AP për ndryshimin e ligjeve.

Qysh kur filloi nga funksionimi për herë të parë në Shqipëri, nga mesi i vitit 2000, institucioni i Avokatit të Popullit, ndër të tjera, si detyra dhe objektiva të tij, ka patur në vazhdimësi edhe respektimin e lirive themelore dhe të të drejtave të njeriut edhe në procedimet penale, duke filluar nga ngjarjet kriminale apo kallëzimet penale në organet e policisë apo prokurorisë, kryerjen e ndalimit apo arrestit nga policia gjyqësore ose prokuroria, kryerjen e hetimeve paraprake dhe deri në përfundim të gjykimit të çështjes në të gjitha shkallët e gjyqësorit. Po kështu edhe në gjykimet civile. Kryerjen e kësaj detyre AP e ka realizuar jo vetëm nëpërmjet pritjes dhe zgjidhjes së kërkesave apo ankesave konkrete për organet e drejtësisë, por edhe nëpërmjet rekomandimeve për ndryshime apo përmirësime të ligjeve.

- E drejta e Avokatit të Popullit për rekomandime legjislative parashikohet konkretisht në nenin 24 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar¹. Në këtë dispozitë përcaktohet se: *“Kur Avokati i Popullit vëren se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi*

¹ Ligji nr.8454, datë 04.02.1999”Për Avokatin e Popullit” është ndryshuar tre herë: 1-Me ligjin nr.8600, datë 10.04.2000; 2-me ligjin nr.9398, datë 12.05.2005 dhe 3-me ligjin nr.155/2014 më datën 27.11.2014.

i tyre shkakut që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera, ka të drejtë:

a. t'u rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjvënëse të bëjnë propozime për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve;

b. t'u propozojë organeve të administratës ndryshimin ose përmirësimin e akteve nënligjore; mosshqyrtimi i propozimit brenda 30 ditëve sjell si pasojë pezullimin e fuqisë së akteve nënligjore që shkaktojnë shkelje të të drejtave dhe lirive.

c. të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me kërkesën për shfuqizimin e akteve të tilla². Aplikimi i një rekomandimi për ndryshimin apo përmirësimin e ligjeve kuptohet se ka vlerë shumë të madhe, në raport me rekomandimin për të zgjidhur një ankesë apo një kërkesë që ka si shkak shkeljen e të drejtave të njeriut nga keqzbatimi i ligjit. Eshtë e qartë se nga ndryshimi i një ligji apo akti nënligjor me karakter normativ, për rastet kur vetë ligji krijon premisa për shkeljen e të drejtave të njeriut, rregullisht përfiton jo vetëm personi i caktuar që ankohet, por përfitojnë të gjithë personat që do kenë të bëjnë me marrëdhëniet që rregullon ligji apo akti nënligjor përkatës, kur ky ndryshohet apo përmirësohet me rekomandim të Avokatit të Popullit. Gjatë veprimtarisë së tij, prej vitit 2000, Avokati i Popullit e ka përdorur shpesh herë këtë të drejtë, kur ka konstatuar gjatë shqyrtimit të ankesave, kërkesave apo njoftimeve nga personat fizikë apo personat juridikë se janë kushtet e mësipërme për të bërë rekomandime për përmirësimin e legjislacionit.² Që këtej del rëndësia e madhe e përdorimit të këtij mjeti pune nga Avokati i Popullit.

III - Rekomandimet kryesore konkrete të AP, temë të kësaj kumtese

Qysh në Raportin e parë vjetor për veprimtarinë e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2000, dërguar dhe mbajtur para Kuvendit të Shqipërisë në muajin mars 2001, thuhet ndër të tjera se:

“... Duke studiuar ankesat kundër gjykatave për vonesa dhe zvarritje të gjykimeve, mos arsyetim në kohë të vendimeve, etj, kemi krijuar bindje se ka vend për të propozuar ndryshime apo plotësime në Kodet e Procedurës Penale dhe Civile. Më konkretisht;

- Kodi i Procedurës Penale duhet të lejojë personat e familjes së viktimave nga kryerja e një vepre penale, për t'u përfaqësuar në mënyrë direkte në gjyq ose me një avokat mbrojtës të tyre. Kjo do të bënte të mundur ballancimin e mbrojtjes së të pandehurit dhe të viktimës nga ana tjetër. Nga ankesat e paraqitura para nesh, në

² Për periudhën 10-vjeçare (2000-2009) Avokati i Popullit ka bërë 69 rekomandime drejtuar organeve që kanë të drejtën ligjvënëse (deputetëve të Kuvendit, Kryeministrit dhe anëtarëve të Qeverisë) që të bëjnë ata propozime për ndryshime apo përmirësime të ligjeve. Nga 69 rekomandimet janë pranuar 53, nga të cilët kanë rezultuar 32 ndryshime apo përmirësime të ligjeve; 21 kanë qënë në fazën e projektit për miratim në Kuvend apo në Qeveri; 9 janë refuzuar dhe 7 kanë qënë në shqyrtim apo pa përgjigje zyrtare. Shih Raportin e Avokatit të Popullit për veprimtarinë gjatë vitit 2009. faqe 371.

mjaft raste është pretenduar që çështjet penale janë zgjidhur nga ana e gjykatës në dëm të viktimës, thjesht për shkaqe korrupsioni..

- Shtetasve të ndryshëm dhe avokatëve të tyre duhet t'u jepet mundësia e pjesëmarrjes në shqyrtimin e çështjeve të tyre që lidhen me kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit, parashikuar nga neni 449 i K.Pr.Civile. Prania e tyre si palë në gjykim jo vetëm se do të realizojë një të drejtë të tyre..., por do t'u sigurojë edhe mundësinë për të paraqitur pretendimet e tyre nëse kanë të tilla, duke i dhënë kështu mundësinë Gjykatës së Lartë të vendosë për marrjen e një vendimi të drejtë e të bazuar në ligj. ...”³

Kurse në Raportin vjetor për veprimtarinë e vitit 2001 Avokati i Popullit e ka zgjeruar akoma më tej fushën e rekomandimeve të tij. Ai aty ka shkruar ndërmjet të tjerave se:

“...Korrupsioni është i përhapur gjerësisht si në administratë, ashtu edhe në gjyqësor. Për këtë aspekt në Raport kemi paraqitur disa Rekomandime të veçanta, por për gjyqësorin dhe prokurorinë do theksojmë se jo rrallë kemi patur ankesa për veprime në kundërshtim me të drejtat e njeriut. Ka patur raste kur janë mbajtur për një periudhë 5-6 muaj deri në 1 vit, persona të paraburgosur pa u kryer asnjë veprim me ta, gjë që ka bërë që të paraburgosurit të futen në grevë urie. Prandaj mendojmë se duhet ndryshuar Kodi i Procedurës Penale në lidhje me afatet e hetimit paraprak, që shkojnë deri 3 vjet, për t'i zvogëluar afatet e mbajtjes së njerëzve në dhomat e izolimit, pa i nxjerrë në gjykatë për gjykim të themelit të akuzës. Po kështu duhet parashikuar e drejta e familjarëve të viktimave nga krimet që të mbrojnë direkt me avokatët e tyre të drejtat e tyre në gjyqet penale. Kështu parandalohet edhe korrupsioni i prokurorëve dhe gjyqtarëve dhe realizohen plotësisht të drejtat e njerëzve të prekur nga krimet, sepse vendimet që do merren për akuzat dhe masat e dënimit do të mund të apelojnë edhe nga të interesuarit, pa u lënë Apeli kundër vendimit të gjykatës në diskrecionin vetëm të prokurorit ... Për të parandaluar vonesat në gjykime dhe korrupsionin duhen ndryshuar Kodet e Procedurave Penale e Civile, me qëllim që çështjet në shkallë të parë të gjykohen vetëm me një gjykatës. Kjo do të rriste shpejtësinë e gjykimeve, përgjegjësinë e gjyqtarëve, por edhe buxheti i shkurtuar mund të përdoret për të rritur pagat e gjyqtarëve që mbeten. Procesi i trajnimit dhe testimi të gjyqtarëve dhe prokurorëve duhet vazhduar, por me kritere e kontroll të rreptë për aftësitë e tyre profesionale.”⁴ Jo vetëm kaq, por në këtë Raport është propozuar edhe që “Për të siguruar më mire të drejtën e jetës dhe të drejtat dhe liritë private të njeriut propozojmë që të studiohet edhe përgatitja e një ligji për Investigatorin privat, siç e kanë edhe shumë vende të tjera të botës së qytetëruar”⁵.

³ Raporti vjetor për veprimtarinë e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2000, faqe 26-29.

⁴ Raporti vjetor për veprimtarinë e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2001, faqe 48-49

⁵ Po aty, faqe 48.

Duhet të evidentojmë se duke patur parasysh edhe rekomandimin tonë, me ligjin nr.8812, datë 17.05.2001 në lidhje me kompetencat e gjykatave civile të shkallës së parë u ndryshua neni 35 i KPrCivle, duke caktuar që pjesa më e madhe e çështjeve të gjykohej me një gjyqtar, kurse me ligjin nr.8813, datë 13.06.2002 në lidhje me kompetencat e gjykatave penale të shkallës së parë u ndryshua neni 13 i KPrPenale, duke caktuar që veprat penale që dënohen me gjobë ose dënim me burgim në maksimum jo më shumë se 7 vjet të gjykohej po me një gjyqtar.⁶ Po kështu u shtua pika 3 në nenin 58 të Kodit të Procedurës Penale. Sipas kësaj shtese “*I dëmtuari ka të drejtë të parashtrojë kërkesa në organin e procedurës dhe të kërkojë marrjen e provave. Kur kërkesa e tij nuk pranohet nga prokurori, ai ka të drejtë të ankohej në gjykatë brenda 5 ditëve nga marrja e saj*”. Por kjo shtesë nuk e kënaqte Avokatin e Popullit sepse nuk lejonte të dëmtuarin (viktimit apo trashëgimtarët e tij) t’i ushtrojë këto të drejta gjatë gjykimit si dhe të ankohej kundër vendimit të gjykatës. Prandaj në Raportin vjetor për veprimtarinë e vitit 2002 është shkruar:

“... në këtë Kre të këtij Raporti do të paraqesim shkurtimisht, vetëm ato rekomandime të cilat janë akoma në ndjekje edhe për vitin 2003.

1. *Ndryshime në Kodin e Procedurës Penale që familjarët e viktimave të veprave penale të kenë të drejtë të marrin pjesë në gjykim për mbrojtjen e interesave të tyre. Ky rekomandim do të përsëritet, duke propozuar edhe ndryshime të tjera që do të duhet t’i bëhen Kodit të Procedurës Penale, si për shkurtim të afateve të hetimeve paraprake etj.*

2. *Ndryshime në Kodin e Procedurës Civile, në lidhje me pjesëmarrjen e avokatëve të të dyja palëve ndërgjyqëse kur në Gjykatën e Lartë shqyrtohet kërkesa e ndonjëres nga palët për pezullim të ekzekutimit të vendimit. Gjithashtu edhe për gjykimin e të gjitha çështjeve me një gjyqtar të vetëm në shkallën e parë*⁷.

Duke qënë se edhe për vitin 2003 nuk u realizuan ndryshimet e mësipërme të parashtruara nga Avokati i Popullit, në Raportin për veprimtarinë e tij në vitin 2003, në Rubrikën “Në ndjekje të Rekomandimeve të raporteve të vitit 2000, 2001, 2002” është shkruar se;

“Disa nga rastet (ankesa, kërkesa apo rekomandime) që janë prezantuar në Raportet e viteve 2000, 2001 dhe 2002 kanë përfunduar dhe gjatë këtij raporti janë pasqyruar në pjesët përkatëse ku trajtohet problematika e tyre. Prandaj në këtë Kre të këtij Raporti do të paraqesim shkurtimisht, rekomandimet të cilat janë akoma në ndjekje edhe për vitin 2004.

1. *Ndryshime në Kodin e Procedurës Penale që familjarët e viktimave të veprave penale të kenë të drejtë të marrin pjesë në gjykim për mbrojtjen e interesave*

⁶ Pas miratimit në vitin 1995 të Kodit të Procedurës Penale, Ligji nr.8813 datë 13.06.2002 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Penale” ka bërë pjesën më të madhe të ndryshimeve më të rëndësishme të këtij Kodi para ndryshimeve të fundit me ligjin nr.35/2017.

⁷ Raporti vjetor për veprimtarinë e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2002, faqe 199.

të tyre. Ky rekomandim është përsëritur, duke propozuar edhe ndryshime të tjera që do të duhet t'i bëhen Kodit të Procedurës Penale, si për shkurtim të afateve të hetimeve paraprake etj. Në janar 2004, me rastin e projektit të sjellë nga Qeveria, iu sugjerua Komisionit të Ligjeve që të përfshihet dhe ky propozim duke patur si shkak ankesat e familjarëve të tragjedisë së 9-janarit, ankesën e familjes së komisar Gani Malushit etj". Ndërkohë duhet të evidentojmë se në janar 2003 kishte ndodhur keqtrajtimi dhe vdekja nga dhuna e policisë e shtetasit G.Tahirllari në Korçë⁸ dhe në vitet e mëvonshme edhe trashëgimtarët e tij patën probleme gjatë gjykimit të kërkesës për shpërbllim dëmi.

2. *Ndryshime në Kodin e Procedurës Civile, në lidhje me pjesëmarrjen e avokatëve të të dyja palëve ndërgjyqëse kur në Gjykatën e Lartë shqyrtohet kërkesa e ndonjërës nga palët për pezullim të ekzekutimit të vendimit. Gjithashtu edhe për gjykimin e të gjitha çështjeve me një gjyqtar të vetëm në shkallën e parë*"⁹.

Duke ndjekur plotësimin e rekomandimeve të mësipërme, AP edhe në raportet për veprimtarinë e tij në vitet 2004, 2005, 2006 e 2007 ka vijuar të evidentojë nevojën e ndryshimeve të legjislacionit. Por duke konstatuar se rekomandimet e tij në drejtimet e sipërtreguara nuk po gjenin zbatim, në Raportin për veprimtarinë e tij për vitin 2008 ka shkruar:

*"Nga praktika e punës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, gjatë shqyrtimit të mjaft ankesave, dhe ballafaqimet e tyre me ligjet në fuqi, kemi konstatuar se duhen zgjeruar garancitë ligjore të individëve (shtetasve) për t'i mbrojtur dhe zbatuar liritë dhe të drejtat themelore. Pikërisht ky ka qenë edhe synimi i AP në dërgimin e një numri jo të vogël rekomandimesh gjatë vitit 2008, në kuadrin e Reformës në drejtësi.*¹⁰ Kështu përmendim;

⁸ "Në datat 04 dhe 05.01.2003, u dha njoftimi publik nga mediat për vdekjen e shtetasit G.Tahirllari për shkak të dhunës së përdorur ndaj tij nga disa punonjës të policisë së Korçës. Sipas prononcimeve në media të drejtuesve të Policisë, të Prokurorisë dhe të spitalit Korçë, shtetasi G.Tahirllari kishte vdekur nga përdorimi mbi masë e pijeve alkoolike dhe jo nga përdorimi i dhunës. Për të arritur një konkluzion të saktë dhe objektiv për shkakun e vdekjes së të ndjerit, Avokati i Popullit mori vendim për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor dhe ekzumimin e kufomës së viktimës G.Tahirllari, nga një grup ekspertësh të Shërbimit Qëndror të Ekspertimit Mjeko-Ligjor Tiranë. Në datën 10.01.2003 u bë zhvarrimi dhe ekzumimi i kufomës dhe grupi i ekspertëve arriti në konkluzionin se: "Shkaku determinant i vdekjes së shtetasit G.Tahirllari ishte kontuzioni i trurit, si pasojë e goditjes me mjet të fortë (grusht, shkelm, etj) në fytyrë". Menjëherë pas konkluzionit të grupit të ekspertëve, organi i prokurorisë vendosi arrestimin e 6 punonjësve të policisë, të cilët u akuzuan dhe dënuan respektivisht për veprat penale të vrasjes, kryerjes së veprimeve arbitrare dhe atë të moskallëzimit të krimit. Për këtë ngjarje shumë të rëndë edhe nga M.R.Publik u morën masa disiplinore ndaj drejtuesve të Policisë Korçë, duke bërë shkarkimin nga detyra të Drejtorit të Policisë së Qarkut.: Raporti vjetor për veprimtarinë e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2003, faqe 100.

⁹ Raporti vjetor për veprimtarinë e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2003, faqe 181.

¹⁰ Duhet të themi se edhe në vitet 2002-2004 dhe 2007-2008 Qeveritë e radhës kanë folur për reformë në drejtësi dhe kanë realizuar në kohë të ndryshme përgjatë këtyre viteve edhe ndryshime në Kodet e Procedurës Penale dhe Procedurës Civile, por asnjëherë ajo nuk ka qenë kaq e thellë dhe e plotë sa Reforma e fundit.

1 - Rekomandim për ndryshimin e nenit 58 të Kodit të Procedurës Penale, dërguar më datën 23.09.2008, i cili u arsyetua si vijon: “Nga ankesat e paraqitura para nesh, në mjaft raste është pretenduar që çështjet penale janë zgjidhur nga ana e Gjykatës në dëm të viktimës, duke u pushuar çështja penale apo të pandehurit janë dënuar lehtë thjesht për shkaqe korrupsioni të lidhur ndërmjet prokurorëve dhe gjyqtarëve. Kurse të dëmtuarit nuk kanë patur asnjë mundësi reagimi kundër vendimeve të gjykatës, sepse nuk janë palë në gjykim dhe prokurori nuk bën ankim. Sipas ligjit ekzistues familjarët e viktimës gjatë procesit gjyqësor veçse mund të kërkojnë shpërblimin e dëmit, por nuk mund të bëjnë ankim në gjykatën më të lartë kundër vendimit të gjykatës që jep pafajësi për personin e akuzuar si vrasës apo trafikant, kundër masave të dënimit që konsiderohen të lehta etj, sepse këtë të drejtë e ka vetëm prokurori. Kështu mund të përmendim kërkesën e familjes së ish-komisar Gani Malushit, kërkesat e familjeve të viktimave të tragjedisë së 9 janarit 2004, mjaft ankesa të viktimave të trafikut njerëzor etj....

Prandaj sugjeruam që pika 1 e nenit 58 të Kodit të Procedurës Penale të ndryshohet si vijon: “Personi i dëmtuar nga veprat penale ose trashëgimtarët e tij kanë të drejtë të kërkojnë procedimin e fajtorit, të marrin pjesë në gjykimin e tij si palë si dhe të kërkojnë shpërblimin e dëmit”. Kurse në pikën 3 të nenit 58 të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: “Gjatë shqyrtimit gjyqësor personi i dëmtuar ka të drejtë të kërkojë marrjen e provave si dhe të ankohet kundër vendimit të gjykatës”. Kjo do të bënte të mundur ballancimin e mbrojtjes së të pandehurit dhe të interesave të viktimës nga ana tjetër. Ky rekomandim është ngritur vazhdimisht edhe në Raportet tona Vjetore pas vitit 2002, është pranuar në parim si rekomandim i drejtë. Por deri tani nuk ka gjetur ende zgjidhje të plotë nëpërmjet plotësimit të Kodit të Procedurës Penale”. Në këtë rekomandim AP përmendi si argument se “në mënyrë jo ligjore, pa qenë e parashikuar në Kodin e Procedurës Penale që ka qenë në fuqi,¹¹ kjo e drejtë është zbatuar në vitin 1991 në gjyqin për viktimat e 2 prillit 1991 në Shkodër, për avokatin e caktuar nga familjarët e viktimave në atë kohë, të ndjerin z. Nazif Bezhani. Pra, nuk ka pse tani pas rreth 18 vitesh (atë kohë në vitin 2008 kur u shkrua ky rekomandim) të mos rregullohet me ligj ky problem që, në fakt, veç të tjerave, lufton korrupsionin në drejtësi”.

Në lidhje me këtë Rekomandim, Ministri i Drejtësisë më datën 19.01.2009 i është përgjigjur me shkrim AP ku, ndër të tjera, thuhej se:” Rekomandimi ku propozohet nga ana juaj të ndryshohet neni 58 i Kodit të Procedurës Penale, çmohet si i panevojshëm për arsye se del jashtë natyrës së një procesi gjyqësor penal sipas legjisllacionit procedural penal shqiptar....e drejta penale dhe e drejta procedurale penale janë pjesë të së drejtës publike, çka do të thotë se shteti shfaqet si subjekt i tyre, duke u përfaqësuar nga prokurori. Është pikërisht shteti, nëpërmjet prokurorit që mbron interesat dhe të drejtat e personit të dëmtuar në procesin penal,... Nga ana tjetër, ju e dini që ligji procedural penal i jep një set të gjerë

¹¹ Ligji nr.6069, datë 25.12.1979, ndryshuar me ligjin nr.6300, datë 27.3.1981.

të drejtash të dëmtuarit nga vepra penale, ku përfshihen e drejta për të paraqitur kallëzim, e drejta për t'u ankuar kundër vendimit të mosfillimit dhe vendimit të pushimit të çështjes penale nga prokurori, e drejta për të kërkuar shpërblimin e dëmit material nga vepra penale, si dhe e drejta për të kërkuar marrjen e provave të caktuara. Për më tepër, për ushtrimin e këtyre të drejtave, i dëmtuari mund t'i drejtohet edhe gjykatës.”¹² Rekomandimet e mësipërme për ndryshimet në nenin 58 të KPrPenale janë përsëritur edhe në raportet vjetore të Avokatit të Popullit për vitin 2013¹³ dhe 2015¹⁴.

2. Rekomandimi për nxjerrjen e ligjit “Për hetuesin (investigatorin) privat”, dërguar më datën 09.07.2008, i cili u arsyetua si vijon: “Gjatë rreth 18 viteve të shtetit të ri demokratik në Shqipëri ka zhvillime mjaft pozitive në fushën e njohjes dhe realizimit të lirive themelore dhe të të drejtave të njeriut. Kjo situatë pozitive është edhe si rrjedhojë e zbatimit të legjislacionit të përparuar për të drejtat e njeriut si dhe të institucioneve përkatëse moderne që janë ngritur dhe vazhdojnë të ngrihen në këto fusha. Në këtë kuadër gjykojmë se është e nevojshme që të përgatitet edhe ligji “Për hetuesin (investigatorin) privat” sepse prej vitesh në zyrën e Avokatit të Popullit kanë ardhur ankesa dhe kërkesa që në themel argumentojnë nevojën e njohjes nga shteti dhe funksionimit të institucionit të investigatorit privat. Kështu ky mund të veprojë në rastet kur policia kriminale dhe prokuroria kanë dështuar që të zbulojnë p.sh. autorët e një vrasjeje, një grabitjeje, vjedhjeje apo aksidenti dhe të dëmtuarit apo familjarët duan që të angazhojnë me mjetet e tyre financiare një hetues apo një studio me hetues privatë. Ky organizëm privat të jetë i njohur nga shteti, të ketë kompetenca të caktuara sipas Kodit të Procedurës Penale, i cili (ky Kod) do të caktojë se çfarë dhe si do të trajtohen provat që do të mbledhë hetuesi privat. Ligji i posaçëm për këtë organizëm privat do të caktojë mënyrën e organizimit të këtij instituti (dhoma e hetuesve privatë), juridiksionin, të drejtat dhe detyrimet, kompetencat e këshillit kombëtar; të Ministrisë të Drejtësisë, kushtet për të ushtruar profesionin e hetuesit privat, objektin e aktivitetit të tij, shpërblimin, procedurat për marrjen e masave disiplinore etj. Ne gjykojmë se krijimi i një organizmi të tillë do ketë ndikim pozitiv në luftën kundër kriminalitetit, do të ulë shkallën e korrupsionit në organet e policisë kriminale dhe të prokurorisë si dhe do të krijojë konkurrencën edhe në fushën e zbulimit të krimeve. Për lehtësi, ne kemi marrë si model jo vetëm projektligjin Italian për këtë çështje, që jua kemi dërguar bashkëlidhur, por edhe bazën ligjore aktuale për ushtrimin e këtij profesioni në Itali”.

Në lidhje me këtë rekomandim, më datën 08.10.2008, Ministri i Drejtësisë i ka kthyer përgjigje AP se: “Në përgjigje të shkresës Tuaj Nr. 161 Prot., datë 09.07.2008, me anë të së cilës rekomandohet përgatitja e ligjit “Për hetuesin

¹² Raporti vjetor për veprimtarinë e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2008, faqe 127-129.

¹³ Raporti vjetor për veprimtarinë e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2013, faqe 303.

¹⁴ Raporti vjetor për veprimtarinë e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2013, faqe 178.

(investigatorin) privat”, pas shqyrtimit të materialit të dërguar nga ana 136 juaj, ju vëmë në dijeni se Ministria e Drejtësisë, është angazhuar në përgatitjen e një studimi mbi mundësinë e përfshirjes së këtij instituti në legjislacionin shqiptar”.¹⁵ Por ky rekomandim nuk është realizuar deri tashmë.

3. Rekomandim për plotësimin e nenit 449 të Kodit të Procedurës Civile, dërguar më datën 23.09.2008. i cili u arsyetua si vijon:”Në Institucionin e AP kanë ardhur dhe vazhdojnë të vijnë mjaft ankesa kundër vendimeve të gjykatave,¹⁶ përfshirë edhe ato të pezullimit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore që bën Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë. Qytetarët ankohen sepse për të marrë vendimet gjyqësore që pezullohen atyre u është dashur shpesh herë të bëjnë gjyqe për 3-4 vjet ose më shumë dhe kur vjen momenti i shumëpritur prej tyre për ekzekutimin e vendimit, marrin dijeni se pala tjetër ka siguruar vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për pezullim të ekzekutimit. Kolegji Civil zbaton nenin 449 të Kodit të Procedurës Civile, duke e marrë vendimin në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve apo avokatëve të tyre. Por ne mendojmë se ky nen duhet ndryshuar, duke lënë të drejtën e pezullimit, por të kushtëzohet me zhvillimin e një seance të hapur, me pjesëmarrjen e palëve apo avokatëve të tyre. Pezullimi i vendimeve të formës së prerë është një moment shumë i rëndësishëm dhe nuk duhet të bëhet vetëm pas kërkesës së një pale, asaj që ka humbur gjyqin. Prania e palës gjyqituese në një seancë gjykimi të shkurtër të kërkesës për pezullim do të realizojë një të drejtë kushtetuese për të paraqitur pretendimet e tyre ndaj kërkesës për pezullim... Gjithashtu kjo mënyrë gjykimi në prezencën e palëve rrit përgjegjësinë e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, rrit transparencën si dhe mbyll shtigje për akuza për korrupsion, të cilat nuk janë të pakta për të gjitha shkallët e gjyqësorit shqiptar, përfshirë dhe Gjykatën e Lartë. Këtë rekomandim e kemi paraqitur disa herë në Raportet tona vjetore para Kuvendit të Shqipërisë. Prandaj rekomandojmë që në nenin 449 të Kodit të Procedurës Civile të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: “Në këtë rast vendimi merret në seancë, në prezencë të palëve që duhet të njoftohen me shpallje, jo më pak se 5 ditë më parë”. Në lidhje me këtë rekomandim, po më datën 19.01.2009 Ministri i Drejtësisë i është përgjigjur me shkrim AP se”Rekomandimi ku propozohet nga ana juaj të ndryshohet neni 449

¹⁵ Raporti vjetor për veprimtarinë e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2008, faqe 136-137.

¹⁶ Pas ndryshimit të nenit 25 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999”Për Avokatin e Popullit”, realizuar me ligjin nr.9398, datë 12.05.2005,”Avokati i Popullit kishte të drejtë të priste ankesa, kërkesa ose njoftime për shkelje të të drejtave të njeriut, që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor, vendimet e formës së prerë dhe procedurat gjyqësore. Hetimi dhe kërkesa e tij nuk prekin pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimit.”Kjo e drejtë mbeti e pa zbatuar plotësisht sepse në Kodet e Procedurës Penale dhe Civile nuk u përcaktuan mjetet dhe rrugët ligjore me anë të të cilave AP do t’i drejtohej Gjykatës së Lartë kundër vendimeve të formës së prerë që ai do konsideronte se duheshin rishikuar. Për më tepër shih në raportin e AP për veprimtarinë e vitit 2008, faqe 130-135. Me ndryshimet e bëra me ligjin nr.155/2015 Avokatit të Popullit i është hequr e drejta që të presë ankesa kundër vendimeve gjyqësore.

i Kodit të Procedurës Civile, çmohet si i panevojshëm për arsye... se ligjvënësi nuk ka vendosur asnjë detyrim të shprehur për zhvillimin e këtyre seancave me ose pa praninë e palëve. Aty ku ligjvënësi ka synuar që gjykimi të zhvillohet pa pjesëmarrjen e palëve, e ka përcaktuar shprehimisht një gjë të tillë si në rastin e nenit 480 të Kodit të Procedurës Civile, etj”. Por AP ka vazhduar t’i qëndrojë mendimit se pezullimi i vendimeve pa qenë në dijeni dhe pa paraqitur pretendimet palët krijon shtigje për padrejtësi dhe korrupsion.¹⁷

Duke qenë se edhe gjatë vitit 2008 nuk pati ndryshime në drejtimit që propozonte AP, edhe në Raportin e tij për veprimtarinë e vitit 2009, është shkruar se “Për prokurorinë dhe gjykatat vazhdon të ketë një numër të madh ankesash, sidomos për vonesat e paarsyeshme (zvarritjet) e çështjeve gjyqësore, civile apo penale, sidomos duke kërkuar që të paraburgosurit e padënuar të dalin para gjyqit sa më shpejt që të jetë e mundur. Në këto kushte, ne kemi rekomanduar vazhdimisht se duhet vazhduar puna për përmirësimin dhe hartimin e ligjeve të reja për luftën kundër korrupsionit brenda sistemit gjyqësor.. përmirësimin e marrëdhënieve konkrete të punës së përditshme midis prokurorisë, policisë gjyqësore dhe gjykatave kundër krimit të organizuar etj. Për të siguruar më mire të drejtën e jetës dhe të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, edhe në kuadrin e reformës në drejtësi, Avokati i Popullit ka paraqitur prej vitesh pranë Komisionit Parlamentar të Ligjeve si dhe pranë Ministrisë së Drejtësisë, propozimin për përgatitjen e një ligji për Investigatorin privat si dhe për pjesëmarrjen e avokatit të personit të dëmtuar (viktimit), qysh në fazën e hetimit, siç e kanë edhe shumë vende të tjera të botës së qytetëruar. Njohja e këtyre dy funksioneve, me të drejta dhe detyrime procedurale në procesin penal, do të rrisë forcën zbuluese ndaj krimeve, do të parandalojë vonesat në hetime dhe gjykime, si dhe do të reduktojë edhe korrupsionin në prokuroritë dhe gjykatat tona, veçse edhe krijohet konkurrencë dhe rriten mundësitë e individit në luftën kundër kriminalitetit...”¹⁸

- Përveç rekomandimeve të mësipërme në Raportin për veprimtarinë e vitit 2002 Avokati i Popullit ka bërë disa rekomandime, për shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Penale dhe në legjislacionin e Policisë së Shtetit, miratimi i të cilave do të sillte parandalimin e torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimit dhe të shkeljeve të ligjit nga policia. Kështu p.sh. duhet të përmendim rekomandimet që:

1- *Personave të privuar nga liria (të ndaluar apo arrestuar) prej policisë, duhet t’u dorëzohen formularë ku të pasqyrohen e saktësohen të drejtat e tyre. Këta formularë duhet që të jenë të disponueshëm edhe në gjuhë të huaj. Për më tepër, të interesuarit duhet të ftohen që të firmosin një deklaratë që ata kanë qenë të informuar mbi të drejtat e tyre.*

2. *Duhet të nxirret një udhëzimi (Kod i sjelljes) për marrjen në pyetje nga policia. Ky Kod duhet ndër të tjera, të trajtojë aspektet e mëposhtme; t’i tregohet*

¹⁷ Raporti vjetor për veprimtarinë e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2008, faqe 129-130.

¹⁸ Raporti vjetor për veprimtarinë e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2009, faqe 50-51.

sistematikisht të ndaluarit identiteti i personave të pranishëm gjatë marrjes në pyetje (emri dhe/ose matrikulli); kohëzgjatja e lejuar e një seance pyetjesh; periudhat e pushimit ndërmjet këtyre seancave dhe pauzat gjatë marrjes në pyetje; vendi apo vendet ku mund të mbahet një seancë e tillë; nëse do t'i kërkohet të ndaluarit të qëndrojnë në këmbë gjatë marrjes në pyetje; të ndalohet marrja në pyetje e personave nën ndikimin e drogës, alkoolit, ilaçeve ose nën një gjendje tronditjeje. Ky kod duhet gjithashtu të parashikojë që të shënohet sistematikisht momenti i fillimit dhe i përfundimit të çdo marrjeje në pyetje, identitetin e çdo të pranishmi gjatë çdo seance pyetjeje, si dhe çdo kërkesë të formuluar nga i ndaluari/ personi që merret në pyetje gjatë kësaj seance. Situata e personave veçanërisht të pambrojtur (për shëmbull, minorenët, personat e prekur nga sëmundje ose mangësi mendore) duhet të bëhen objekt i garancive specifike.

3. Duhet të ndryshohen e përmirësohen kushtet e mbajtjes së të ndaluarve e të arrestuarve në dhomat e paraburgimit në ambientet e policisë, sidomos të ndahen të rriturit nga minorenët dhe t'i kushtohet këtyre të fundit një vëmendje e veçantë në planin e shëndetit dhe të edukimit.

4. Detyrimi i organeve të procedimit penal që të sigurohet e drejta e vizitës nga një mjek për personat e privuar nga liria, qysh në çastet e para të privimit të tyre nga liria..., të gjitha ekzaminimet mjekësore të këtyre personave duhet të jenë larg dëgjimit, dhe... në ndonjë rast të veçantë, edhe larg shikimit të punonjësve të policisë kur ata vizitohen nga mjeku. Rezultatet e çdo ekzaminimi, si dhe çdo deklaratë e bërë nga personi i vizituar, duhet të shënohen nga mjeku dhe të jenë në dispozicion të personit të privuar nga liria dhe të avokatit të tij.¹⁹

Edhe këto rekomandime specifike për deklaratën e të drejtave, kodin e sjelljes për marrjen në pyetje të personave nga policia, për vizitën e mjekut, garancitë për objektivitetin gjatë marrjes në pyetje të të miturve etj, janë përsëritur në vazhdimësi me ndryshime të vogla në të gjitha raportet e Avokatit përgjatë viteve 2003 e deri në vitin 2010.

IV - Reflektimi i rekomandimeve të AP në ndryshimet e legjislacionit në kuadër të Reformës në drejtësi.

Rekomandimet e mësipërme mund të themi se janë shqyrtuar me seriozitet, janë pranuar në thelb dhe janë reflektuar në ndryshimet e realizuara në kuadrin e Reformës në Drejtësi, gjatë vitit 2016-2017si vijon.

1 - Rekomandimi për ndryshimin e nenit 58 të KPrPenale për të drejtat e viktimës së veprës penale.

Kështu tashmë në Kodin e Procedurës Penale janë bërë ndryshimet në nenin 58 “*Të drejtat e viktimës së veprës penale*” ku ndër të tjera viktimat ka të drejtë që: 1. - d) të kërkojë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit,

¹⁹ Raporti vjetor për veprimtarinë e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2002, faqe 118-120.

si dhe të njihet me aktet e provat, pa cënuar parimin e sekretit hetimor; dh) të kërkojë marrjen e provave, si dhe të parashtrijë kërkesa të tjera përpara organit procedues; e) të informohet për arrestimin e të akuzuarit dhe lirin e tij, në kushtet e caktuara në këtë Kod; ë) të njoftohet për mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes, fillimin dhe përfundimin e gjykimit; f) *të bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit e prokurorit për të mos filluar procedimin dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake për të pushuar akuzën ose çështjen*; g) të kërkojë shpërblimin e dëmit .. i) *të dëgjohet nga gjykata, edhe kur asnjëra nga palët nuk ka kërkuar thirrjen e saj si dëshmitar*; j) të ushtrojë të drejta të tjera të parashikuara nga ky Kod.etj.. 2. Organi procedues njofton menjëherë viktimën për të drejtat e përmendura në paragrafin 1, të këtij neni, dhe mban procesverbal për njoftimin e tyre. .4. *Trashëgimtarët e viktimës kanë të drejtat e parashikuara në shkronjat “a”, “e”, “ë”, “f”, “g” dhe “j”, të paragrafit 1, të këtij neni. Nëse trashëgimtari i viktimës është i mitur, ai përfaqësohet nga kujdestari ligjor.”.Po kështu, veç të drejtave të mësipërme, janë shtuar garancitë për viktimat që janë të mitur, konkretisht “Të drejtat e viktimës së mitur”(Neni 58/a) dhe “Të drejtat e viktimës së abuzuar seksualisht dhe viktimës së trafikimit të qenieve njerëzore (Neni 58/b).²⁰Gjithashtu viktima ose trashëgimtarët e tij marrin pjesë dhe disponojnë kërkesa jo vetëm gjatë gjykimit të zakonshëm të të pandehurit, por edhe kur shqyrtohet çështja me gjykim të shkurtuar apo marrëveshja e të pandehurit me prokurorin.²¹*

2 - Rekomandimi për deklaratën(letrën) e të drejtave të personit të ndaluar, apo arrestuar:

Për Rekomandimin në lidhje me njoftimin e personave të ndaluar dhe arrestuar dhe firmosjen nga këta persona të një deklaratë për marrjen dijeni të këtyre të drejtave, ndryshimet e bëra në KPrPenale jo vetëm që janë reflektuar, por edhe janë tejkaluar, duke zgjeruar garancitë procedurale të këtyre personave.Kështu që në nenin 34 të KPrP enale janë shtuar nenet 34/a dhe 34/b në lidhje me të drejtat e personave të ndaluar dhe të arrestuar,qoftë edhe si person nën hetim apo i pandehur apo si person që i atribuohet vepra penale. Ndër të tjera, në këto dispozita thuhet se ”*Organi procedues e njofton menjëherë personin e arrestuar ose të ndaluar për të drejtat e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe “e”, të paragrafit 1, të nenit 34/a, të këtij Kodi, duke i dhënë, kundrejt nënshkrimit, letrën e të drejtave në formë të shkruar. Personi ka të drejtë ta mbajë letrën e të drejtave*”.²² Për të garantuar vlerën themelore të Letrës së të Drejtave të personave që ndalohen

²⁰ Nenet 40-42 etj,të ligjit nr.35/2017”Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Penale”.

²¹ Nenet 226,228, etj,të ligjit nr.35/2017”Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Penale”.

²² Nenet 26,27,135,226, etj të ligjit nr.35/2017”Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Penale”.

apo arrestohen, KPrPenale në nenin 256, pas pikës 1, janë shtuar pikat 2 dhe 3 me këtë përmbajtje: “2. *Prokurori fillimisht e pyet të arrestuarin ose të ndaluarin nëse e ka marrë letrën e të drejtave dhe sigurohet që ai i ka kuptuar të drejtat e tij. Kur i arrestuari ose i ndaluar nuk e ka marrë letrën e të drejtave, prokurori ia jep atë përpara marrjes së parë në pyetje dhe i sqaron të drejtat e tij.* 3. **Deklarimet e bëra nga i arrestuari ose i ndaluar përpara se të ketë marrë letrën e të drejtave ose përpara takimit me mbrojtësin e tij, nuk mund të përdoren.**”²³ Gjithashtu janë shtuar garancitë procedurale për marrjen në pyetje të të miturit ose ballafaqimin e tij me të pandehurin e rritur.²⁴

3 - Rekomandimi për njoftimin e palës tjetër kur bëhet shqyrtimi i kërkesës për pezullim vendimi në Gjykatën e Lartë.

Ndryshime janë bërë edhe në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile për pezullimin e vendimit nga Gjykata e Lartë, ku kërkesa për pezullim duhet t'i njoftohet palës tjetër, e cila ka të drejtë që brenda 3 ditëve të parashtrijë me shkrim argumentet e saj kundër kërkesës për pezullim.²⁵

- Duke shqyrtuar në mënyrë kronologjike sa më sipër mund të themi pa mëdyshje se këto ndryshime dhe të tjera në Kodet e Procedurës penale dhe Civile kanë reflektuar kontributin e Avokatit të Popullit në Reformën në drejtësi dhe sjellë si pasojë shtimin e garancive ligjore për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri gjatë proceseve penale dhe civile.

V - Sfidat e Avokatit të Popullit për rekomandimet e përcaktuara.

Për sa kohë që vlen aksioma se “**nuk ka ligje të përkryera**”, Avokati i Popullit gjatë veprimtarisë së tij duhet të vijojë përpjekjet jo vetëm që të merren në konsideratë rekomandimet e tij, si psh ai për Investigatorin privat, por edhe për përmirësimin më tej të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, sidomos gjatë fazës së parë të procedimit penal, të quajtur “**të flagrancës**”, kur personi që dyshohet për kryerjen e një vepre penale ndiqet, shoqërohet apo ndalohet nga organet e policisë së shtetit. Kështu që AP do t'i duhet të vëzhgojë edhe më tepër jo vetëm zbatimin e dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, por edhe legjislacionin për policinë e Shtetit, që jo rrallë mbart dispozita që janë të papajtueshme me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Në këto raste AP mund të veprojë jo vetëm nëpërmjet rekomandimeve për shfuqizimin apo përmirësimin e dispozitave të tilla, por edhe nëpërmjet kërkesave drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Tashmë me ndryshimet Kushtetuese të fundit,

²³ Neni 136 i ligjit nr.35/2017”Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Penale”.

²⁴ Neni 95,161 dhe 203 i ligjit nr.35/2017”Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Penale”.

²⁵ Neni 99 i ligjit nr.38/2017.”Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Civile.

pozicioni i AP është përmirësuar ndjeshëm,²⁶ duke realizuar kërkesat e hershme të Avokatit të Popullit²⁷, sipas të cilës AP, si subjekt i parashikuar nga Kushtetuta duhet të jetë i radhës së parë, që të mos kufizohet nga ndonjë lloj kushti, për të paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese²⁸ sa herë që ai gjykon se dispozita të caktuara vijnë në kundërshtim apo janë të papajtueshme me Kushtetutën dhe liritë themelore dhe të drejtat e njeriut. Por duke shqyrtuar vetë qëndrimet që ka mbajtur Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj²⁹ duket qartë se nuk ka qenë e lehtë arritja e këtij ndryshimi, që padyshim sjell përmirësime në katalogun e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Shqipërisë.

²⁶ Sipas Nenit 12të ligjit nr.76/2016”Për disa ndryshime në Kushtetutën e RSH”Neni 134 ndryshohet si vijon: 1. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të:a) Presidentit të Republikës;b) Kryeministrit; c) jo më pak se një të pestës së deputetëve; ç) Avokatit të Popullit;...2. Subjektet e parashikuara nga nënparagrafët “d”, “dh”, “e”, “ë”, “f”, “g”, “gj”, “h” dhe “i”, të paragrafit 1, të këtij neni, mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre.»

²⁷ Ermir Dobjani. - Gjykata Kushtetuese mund të shqyrtojë kërkesat e Avokatit të Popullit për shfuqizimin e ligjeve antikushtetuese. - Tribuna Juridike nr.57 (6) viti 2005.

²⁸ Ermir Dobjani-“A duhet ndryshuar neni 134 i Kushtetutës për të mos kufizuar të drejtën e Avokatit të Popullit për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese”-Revista “Studime juridike”,dhjetor 2008.

²⁹ Vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.49/2000;nr.2/2004 dhe nr.40/2007 etj.

ASPEKTE TË GJYKIMIT TË SHKURTUAR DHE DISA PROBLEME TË DALA NGA PRAKTIKA GJYQËSORE, NË SHQIPËRI

Dr. Luan HASNEZIRI

Gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë dhe
pedagog i jashtëm pranë Fakultetit të Drejtësisë,
Universiteti i Tiranës
Adresa e email-it: lhasneziri@yahoo.com

Prof. Dr. Artan HOXHA

Profesor efektiv në Fakultetin e Drejtësisë,
Universiteti i Tiranës si dhe Dekan i Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i
Tiranës
Adresa e email-it: artan_hoxha@yahoo.com

ABSTRAKT

Gjykimi i shkurtuar është një nga gjykimet e posaçme që parashikohet në Kodin e Procedurës Penale, i cili, ka hyrë në fuqi më 1 gusht të vitit 1995. Në kohën e hyrjes në fuqi të tij, ky lloj gjykimi përbënte një risi, për të drejtën procedurale në Shqipëri, ndërsa, sot, ai ka një histori të ekzistencës së tij, mbi 20 vjeçare, gjatë të cilës nga studiues të ndryshëm të doktrinës, por edhe nga praktika gjyqësore, kanë dalë një sërë problemesh që lidhen me kuptimin dhe zbatimin e drejtë të këtij instituti.

Pavarësisht nga fakti që, për këtë lloj gjykimi është shkruar nga autorë të ndryshëm, jemi të mendimit që, në këtë punim të japin edhe ne, disa ide dhe mendime, për natyrën dhe veçoritë e këtij gjykimi, si dhe problemet që kanë dalë në praktikë për zbatimin e tij. Ky punim do të përbëhet nga dy çështje kryesore. Në çështjen e parë do të trajtohen, në mënyrë të përmbledhur rregullat procedurale që zbatohen gjatë gjyqimit të shkurtuar, duke u ndalur edhe tek veçoritë kryesore që paraqet ky lloj gjykimi, përballë gjyqimit të zakonshëm. Një vëmendje e veçantë do t' i kushtohet në këtë çështje edhe ndryshimeve të bëra në procedurën e gjyqimit të shkurtuar, sipas ndryshimeve që ka bërë ligji Nr. 35/2017 për këtë lloj gjykimi.

Në çështjen e dytë do të trajtohen disa nga problemet që kanë dalë në praktikën gjyqësore, në Shqipëri për këtë institut të së drejtës procedurale penale, në gjykata të niveleve të ndryshme, përfshirë edhe Gjykatën Kushtetuese. Në këtë çështje do të trajtohen shkurtimisht edhe vendime të Gjykatës së Strasburgut, e cila, në kuadër të trajtimit të konceptit të procesit të rregullt ligjor, është shprehur edhe për çështje që, kanë të bëjnë me gjykimin e shkurtuar.

Në fund të këtij punimi, do të jepen edhe konkluzionet, si dhe bibliografia ku është bazuar ky punim

Fjalë kyçe: proces i rregullt gjyqësor, barazia e palëve në proces, gjykimi i shkurtuar, të drejtat e të pandehurit, gjykimi i drejtë dhe i paanshëm

HYRJE

Në Kodin e Procedurës Penale që hyri në fuqi, më datë 1 gusht 1995, si një nga gjykimet e posaçme u parashikua edhe gjykimi i shkurtuar. Ky lloj gjykimi, në kohën e miratimit të Kodit përbënte një institut të ri të procedurës penale, i cili, nuk parashikohej më parë, në Kodet e Procedurave Penale të shtetit monist dhe ishte i panjohur për gjyqtarët, prokurorët, avokatët dhe profesionistët e tjerë të drejtësisë të asaj periudhe, prandaj pritej me interes zbatimi që, ai do të kishte në praktikë.

Parashikimi i këtij instituti nga ana e ligjvënësit u diktua nga nevoja praktike, sepse, kishte shumë raste kur, aktet e mbledhura gjatë hetimit paraprak nga ana e organit të akuzës, ishin të plota, si dhe provimi i faktit penal rezultonte i qartë dhe i pandehuri së bashku me mbrojtësin e tij, ishin dakord me këto akte, si dhe, pavarësisht nga kjo, gjykata, ishte e detyruar që t'i nënshtonte debatit gjyqësor, të gjitha aktet që ishin marrë, në fazën e hetimeve paraprake. Në këto raste, në kushtet kur, aktet e mbledhura në fazën e hetimeve paraprake ishin të plota, si dhe i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, nuk kishin kundërshtime për formën dhe përmbajtjen e tyre, duke i pranuar ato, zhvillimi i debatit gjyqësor nga gjykata, ishte një punë e padobishme dhe formale, pa ndikuar në thelbin ose meritën e zgjidhjes së çështjes.

Pikërisht për të shmangur zhvillimin e panevojshëm të debatit gjyqësor, i cili, përbën edhe pjesën kryesore të procesit penal, si në pikëpamje të vlerës, ashtu edhe në pikëpamje të zgjatjes në kohë të tij, në rastet kur, aktet e hetimit paraprak, janë të plota dhe i pandehuri dhe mbrojtja i pranojnë ato, pa patur kundërshtime, nga ana e Kodit të Procedurës Penale, u parashikua gjykimi i shkurtuar, si një nga llojet e gjykimeve të posaçme. Ky lloj gjykimi, nga vetë emërtimi i tij, “gjykimi i shkurtuar”, nënkupton, zhvillimin e procesit gjyqësor penal, me procedurë të shkurtuar, duke eliminuar fazën e hetimit gjyqësor ose të debatit gjyqësor (cross examination) dhe, duke kaluar, drejtpërdrejt, në fazën e diskutimit përfundimtar të palëve.

Në aspektin e teknikës legislative, Kodi ynë i Procedurës Penale, gjykimin e shkurtuar, e ka huazuar, kryesisht, nga Kodi i Procedurës Penal, të Italisë, ashtu siç ka huazuar edhe pjesën më të madhe të dispozitave të tij. Në zhvillimin e këtij lloj gjykimi, përveç dispozitave të veçanta ligjore që Kodi parashikon për këtë lloj të veçantë gjykimi, zbatohen për aq sa është e mundur edhe dispozitat ligjore që rregullojnë gjykimin e zakonshëm.

Parashikimi nga ana e Kodit të Procedurës Penale i gjykimit të shkurtuar, tregoi që, ishte një zgjidhje e drejtë dhe shumë e vlefshme, në praktikën e punës së gjykatave tona. Duke iu referuar të dhënave statistikore për çështjet penale që zhvillohen në gjykatat e rretheve të ndryshme gjyqësore, rezulton që, rreth 80% e të gjitha çështjeve penale të themelit, zhvillohen në bazë të procedurës së gjykimit të

shkurtuar, çka tregon që, njohja e këtij instituti nga ana e legjislacionit procedural penal, ka qenë e domosdoshme.

Zhvillimi i një numri aq të madh çështjesh me anë të procedurës së gjyqimit të shkurtuar, ndodh për faktin e thjeshtë se, ai është një lloj gjykimi, prej të cilit kanë përfitim të dy palët si prokurori, ashtu edhe i pandehuri dhe siç dihet, në një procedurë apo në çdo gjë, ku kanë përfitim të dy palët, sukcesi i asaj gjëje është i sigurt. Përfitimi konkret që ka prokurori tek gjykimi i shkurtuar qëndron tek kursimi i kohës, sepse, nuk i duhet që të paraqitet në gjykatë në disa seanca, siç ndodh tek gjykimi i zakonshëm, seanca që, në rastet të caktuara, zgjasin edhe një ose më shumë vite, por përfitimi i tij qëndron edhe tek shmangia e debatit gjyqësor që, zhvillohet tek procedura e gjyqimit të zakonshëm. Zhvillimi i procedurës së gjyqimit të shkurtuar paraqet përfitime, të drejtpërdrejta edhe për të pandehurin, sepse, nëse, ai do të deklarohet fajtor nga gjykata, për veprën penale për të cilën ai akuzohet, dënimi me burgim ose me gjobë që, gjykata cakton ndaj tij, ulet me një të tretën.

Por, nga zbatimi i procedurës së gjyqimit të shkurtuar, përveç të pandehurit dhe prokurorit, mund të themi që, përfitojnë edhe interesat e shtetit dhe të drejtësisë, pasi nga ana e shtetit shmangen shpenzimet gjyqësore, si dhe garantohet zhvillimi i një procesi të rregullt gjyqësor, brenda një periudhë të shpejtë. Fakti që, gjykimi i shkurtuar është një lloj gjykimi me përfitime të dyanshme, si për të pandehurin, ashtu edhe për interesat e drejtësisë, është konstatuar edhe nga Gjykata e Lartë, në Vendimin e saj Unifikues, Nr. 2, datë 29.1.2003, e cila, ndër të tjera, është shprehur: *“Gjykimi i shkurtuar ka vlerë për ekonomi gjyqësore sepse thjeshton dhe shkurton procedurat, rrit shpejtësinë dhe efektivitetin e gjyqimit dhe sjell si pasojë një përfitim për të pandehurin, në uljen e 1/3 të masës së dënimit dhe mos aplikimin e dënimit me burgim të përjetshëm”*¹.

Gjatë zbatimit të tij, në praktikë nga gjyqtarët, prokurorët dhe profesionistët e tjerë të drejtësisë, për gjykimin e shkurtuar janë ngritur një sërë problemesh ligjore, të cilat do të trajtohen, konkretisht, në çështjen e dytë të këtij punimi. Në këtë pjesë hyrëse do të mjaftohemi me konstatimin që, rregullat ligjore që Kodi i Procedurës Penale, i vitit 1995, kishte parashikuar për këtë lloj gjykimi, nuk ishin të qarta, çka e detyroi, ligjvënësin, që më në fund, të ndërhynte dhe të bënte ndryshimet që ai i çmoi të nevojshme, për rregullimin më të plotë të këtij instituti.

1. Normat ligjore procedurale që rregullojnë gjykimin e shkurtuar dhe veçoritë e këtij gjykimi

Gjykimi i shkurtuar, si një nga llojet e gjyqimit e posaçme, është parashikuar nga Kodi i Procedurës Penale, në fuqi, në tre dispozita ligjore, që janë nenet 403, 405 dhe 406 të tij, ndërsa, neni 404 i tij, është shfuqizuar me ligjin Nr. 35, të vitit 2017. Vlen të theksohet që në fillim fakti se, ligji Nr. 35, i vitit 2017, ka bërë disa ndryshime të rëndësishme për këtë institut procedural, si dhe për procedurën

¹ Shih për tepër: Vendimin Penal Unifikues të Gjykatës së Lartë Nr. 2, datë 29.1.2003.

e zhvillimit të seancës së gjykimit të shkurtuar dhe, trajtimi jonë, në lidhje me gjykimin e shkurtuar, do të bëhet duke mbajtur ndryshimet që janë bërë me këtë ligj, si dhe duke i bërë një krahasim edhe me dispozitat procedurale që ishin në fuqi, para ndryshimeve të bëra me këtë ligj.

Kërkesa për gjykim të shkurtuar, për vetë natyrën e tij, është një kërkesë që mund të bëhet, vetëm nga i pandehuri ose mbrojtësi i tij me autorizim të posaçëm, ku, në rastet kur kërkesa bëhet nga mbrojtësi, i pandehuri duhet që t'ia ketë njohur, mbrojtësit të tij, në mënyrë të shprehur, të drejtën që ai të kërkojë gjykim të shkurtuar, në emër dhe për llogari të tij. Kjo nënkupton që, e drejta për të kërkuar gjykim të shkurtuar, është një e drejtë që i përket, personalisht të pandehurit dhe, ashtu siç është edhe e drejta për pohimin ose pranimin e fajësisë, e cila, nuk mund të ushtrohet nga mbrojtësi, nëse, i pandehuri, nuk ia ka kaluar, shprehimisht një tagër të tillë mbrojtësit të tij, me anë të një akti të hartuar, në formën e kërkuar procedurale.

Sipas nenit 403, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, ndryshuar me ligjin Nr. 35, të vitit 2017, kërkesa për gjykim të shkurtuar, si rregull, paraqitet nga i pandehuri ose mbrojtësi i tij me autorizim të posaçëm, në seancën paraprake, e cila, është një seancë që është parashikuar, për herë të parë, në legjislacionin procedural shqiptar, me ligjin e mësipërm. Në këtë seancë, gjyqtari i seancës paraprake, zgjidh disa çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me zhvillimin e gjykimit në themel, nga gjykata e shkallës së parë, siç janë verifikimi, nëse, hetimet janë të plota, nëse, nga ana e prokurorit janë ngritur akuzat, në mënyrë të drejtë ndaj të pandehurit, nëse, konstatohen akte të pavlefshme ose të papërdorshme, etj. Pika 3, e nenit 332/c të Kodit të Procedurës Penale, i njeh, ndër të tjera, të drejtë të pandehurit që, të paraqesë kërkesë për gjykim të shkurtuar, duke kërkuar që çështja të gjykohet në gjendjen që janë aktet.

Përsa i përket afatit të paraqitjes së kërkesës për gjykim të shkurtuar nga i pandehuri, neni 403, pika 1, e këtij Kodi, është shprehur, në mënyrë të qartë dhe të prerë, kjo kërkesë duhet të paraqitet prej tij, gjatë seancës paraprake dhe nuk mund të paraqitet më vonë, kur çështja kalon për gjyq, me vendim të gjyqtarit të seancës paraprake, as në kërkesat paraprake dhe as në ndonjë moment tjetër të gjykimit të themelit. Një gjë e tillë, rezultoi e qartë, nga përmbajtja e kësaj dispozite, në të cilën thuhet që, kërkesa për gjykim të shkurtuar paraqitet nga i pandehuri ose mbrojtësi i tij, me autorizim të posaçëm, në seancë paraprake, me pasojë mospranimi². Një parashikim i tillë ligjor do të thotë që, nëse, i pandehuri ose mbrojtësi i tij, me autorizim të posaçëm, nuk e paraqesin kërkesën për gjykim të shkurtuar, gjatë seancës paraprake, kjo e drejtë e të pandehurit shuhet, humbet dhe, ai nuk ka të drejtë që ta ushtrojë atë më vonë.

²Pika 1 e nenit 403 të Kodit të Procedurës Penale, shtuar me ligjin Nr. 35, të vitit 2017, parashikon: *“1. Kërkesa për gjykim të shkurtuar paraqitet nga i pandehuri ose mbrojtësi i tij me autorizim të posaçëm në seancën paraprake ose në seancë gjyqësore kur procedohet sipas nenit 400 dhe paragrafi i 3 i nenit 406/ç të këtij Kodi, me pasojë mospranimi”.*

Si përjashtim nga rregulli, në ligjin procedural penal përcaktohet që, kërkesa për gjykim të shkurtuar mund të paraqitet, jo në seancën paraprake, por në seancën gjyqësore të themelit, kur gjykata procedon me anë të gjykimit të drejtpërdrejtë dhe si dhe me anë të gjykimit të veçantë të parashikuar për herë të parë në Kodin e Procedurës Penale, me ligjin Nr. 35, të vitit 2017 dhe që është “Urdhri penal”. Në këto dy raste, është parashikuar që, kërkesa për gjykim të shkurtuar të paraqitet nga i pandehuri në seancën gjyqësore të themelit, sepse, për këto dy lloje gjykimi të posaçme, për vetë natyrën e tyre, nuk zhvillohet seancë paraprake dhe për pasojë, i pandehuri nuk ka se kur ta paraqesë kërkesën e tij, përveçse, në seancën gjyqësore të themelit.

Në rastet kur, procedohet me gjykim të drejtpërdrejtë, sipas nenit 402 të këtij Kodi, gjykata, kryesisht, ka detyrimin që ta njohë të pandehurin për të drejtën që ai ka për të kërkuar gjykim të shkurtuar, si dhe pavarësisht nga fakti që, kjo dispozitë ligjore, nuk shprehet për momentin se kur, i pandehuri mund të kërkojë gjykimin e shkurtuar, nga interpretimi që i bëhet dispozitave ligjore që rregullojnë këtë formë gjykimi, mendojmë që, kjo kërkesë duhet të bëhet, në fazën e kërkesave paraprake, para se të jetë deklaruar i hapur shqyrtimi gjyqësor. Paraqitja e kërkesës për gjykim të shkurtuar kur ndodhemi para Urdhrit penal, paraqet specifikat e saj, sepse, kjo ndodh pasi gjykata ka miratuar me vendim përfundimtar, pa praninë e palëve, kërkesën e prokurorit për miratimin e urdhrit penal dhe, ky vendim i është njoftuar të pandehurit. Me marrjen e njoftimit të këtij vendimi, kur i pandehuri nuk është dakord me këtë vendim, e kundërshton atë, brenda 10 ditëve dhe gjykata është e detyruar që, të caktojë seancë gjyqësore dhe në këtë seancë gjyqësore, i pandehuri ka të drejtë që, të kërkojë gjykim të shkurtuar.

Me ndryshimet e bëra në ligjin Nr. 35, të vitit 2017, në Kodin e Procedurës Penale, për herë të parë është parashikuar që, nuk mund të paraqitet kërkesë për gjykim të shkurtuar për veprat penale për të cilat dispozita e posaçme e Kodit Penal parashikon dënimin me burgim të përjetshëm. Ky parashikim ligjor është çmuar që të bëhet nga ligjvënësi, duke u nisur nga rrezikshmëria e madhe shoqërore e veprave penale për të cilat parashikohet dënimi me burgim të përjetshëm, të cilat janë vepra penale që për shkak të rrezikshmërisë së tyre, sjellin pasojë të rënda, jo vetëm për individin, por edhe për shoqërinë, në tërësi. Nisur nga fakti i rrezikshmërisë së madhe që paraqesin këto vepra penale, ligjvënësi ka çmuar që, për këtë kategori veprash edhe pse i pandehuri mund t’i pranojë aktet dhe të jetë dakord që çështja të zgjidhet në gjendjen që janë aktet, ai, nuk mund të kërkojë gjykim të shkurtuar, sepse, një të drejtë të tillë, ia ka mohuar, shprehimisht, pika 2 e nenit 403 të Kodit të Procedurës Penale.

Përsa i përket këtij parashikimi ligjor, ku, të pandehurit i mohohet e drejta për të kërkuar gjykim të shkurtuar, për veprat penale për të cilat parashikohet burgimi i përjetshëm, në dijeninë tonë, një ndalim të tillë ligjor, nuk e gjejmë të parashikuar në Kodet Procedurale Penale të shteteve të rajonit dhe as në atë të Italisë, nga ku është marrë ky lloj gjykimi i posaçëm dhe është përfshirë në Kodin

tonë të Procedurës Penale. Duke pranuar që, një parashikim i tillë ligjor është një çështje që ka të bëjë me vlerësimin e ligjvënësist, të cilët ne, si profesionistë të ligjit, duhet t'i bindemi, mendojmë që, ai mund të paraqesë probleme në lidhje me kushtetutshmërinë e normës ligjore, pasi mund të pretendohet që, ky parashikim ligjor, bie në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës që, sanksionon parimin e barazisë para ligjit dhe të mosdiskriminimit pa shkaqe të arsyeshme, si dhe me nenin 17 të Kushtetutës, sepse, mund të argumentohet që, ky kufizim i të drejtës, nuk respekton kriterin e proporcionalitetit në kufizimin e së drejtës, në raport me gjendjen që e ka diktuar këtë kufizim.

Gjithsesi, duke qenë se, norma ligjore, pika 2 e nenit 403 të Kodit të Procedurës Penale që, e ndalon të pandehurin që të kërkojë gjykim të shkurtuar, ka vetëm pak muaj që ka hyrë në fuqi, kjo çështje mbetet për t'u zgjidhur në të ardhmen, nga praktika gjyqësore, ndoshta me anë të kontrollit incidental ose rastësor kushtetues që, gjykatat e zakonshme mund t'i bëjnë kësaj norme, në përputhje me nenin 145, pika 2 të Kushtetutës. Tek e fundit, i takon Gjykatës Kushtetuese që, në eventualitetin e kontrollit kushtetues të kësaj norme, duke e ballafaquar atë me nenet 17 dhe 18 të Kushtetutës, të vendosë, nëse, ajo është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti ynë.

Sipas nenit 405 të Kodit të Procedurës Penale, gjykimi i shkurtuar zhvillohet në prani të prokurorit, të të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, palëve private që janë paditësi dhe i padituri civil në procesin penal, si dhe në bazë të ndryshimeve të bëra në këtë dispozitë me ligjin Nr. 35, të vitit 2017, edhe me praninë e viktimës ose trashëgimtarëve të tij, kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit³. Nisur nga ndryshimet që i janë bërë kësaj dispozite procedurale, me ligjin Nr. 35, të vitit 2017, duke e krahasuar atë edhe me përmbajtjen që kishte kjo dispozitë, para këtyre ndryshimeve, në rastet kur, i pandehuri e ka paraqitur kërkesën për gjykim të shkurtuar, me anë të mbrojtësit të tij, në seancën paraprake, pa qenë vetë fizikisht i pranishëm, mund të shtrohet pyetja, nëse, është e detyrueshme prania fizike e të pandehurit, në seancë gjyqësore të themelit, ndërkohë që, ai ka dijeni për datën dhe orën e gjykimit dhe ka shfaqur vullnetin që të mos paraqitet në seancë, duke u shprehur që të përfaqësohet nga mbrojtësi i tij, i pajisur me autorizim të posaçëm dhe ky i fundit është në seancë gjyqësore dhe kërkon që, të vijojë gjykimi në bazë të rregullave të gjykimit të shkurtuar, duke u konsideruar i pandehuri i pranishëm?

Një pyetje e tillë shtrohet për zgjidhje, sepse, pika 1 e nenit 405 të këtij Kodi, parashikon, shprehimisht që, seanca e gjykimit të shkurtuar zhvillohet, ndër të tjera, me praninë e të pandehurit, si dhe pika 5 e kësaj dispozite avancohet më tej, duke parashikuar që, gjatë kësaj seance gjyqësore, gjykata, pasi dëgon palët

³ Vlen të theksohet fakti që, në ligjin Nr. 35 të vitit 2017, janë shtuar një numër dispozitash në Kodin e Procedurës Penale, të cilat parashikojnë, në mënyrë të shprehur, të drejtat e viktimës në procesin penal, që nga momenti i fillimit të procedimit penal e deri në përfundim të tij, por që trajtimi i tyre nuk ka lidhje me temën e këtij punimi.

mbi kërkesat paraprake, lexon kërkesën për gjykim të shkurtuar, si dhe pyet të pandehurin, nëse, i qëndron asaj⁴. Për këtë pyetje, praktika gjyqësore në Shqipëri, për këtë periudhë kaq të shkurtër, sepse, dispozita ka vetëm 4 muaj që ka hyrë në fuqi, duke u nisur, veçanërisht nga parashikimi i pikës 5 të nenit 403 të këtij Kodi, të ndryshuar me ligjin Nr. 35, të vitit 2017, duket që i ka bërë një interpretim strikt dispozitës, duke kërkuar që, i pandehuri edhe pse mbrohet nga mbrojtësi i tij, me autorizim të posaçëm, në të cilin i ka dhënë, shprehimisht edhe tagrin për të kërkuar gjykim të shkurtuar, të jetë fizikisht i pranishëm në seancë gjyqësore, në të cilën gjykata ta pyesë, personalisht atë, nëse, i qëndron kërkesës për gjykim të shkurtuar.

Për këtë çështje, personalisht jemi të mendimit që, kur i pandehuri, gjatë seancës paraprake, me anë të mbrojtësit të tij, të pajisur me autorizim të posaçëm, i ka dhënë, shprehimisht edhe të drejtën për të kërkuar gjykim të shkurtuar dhe, mbrojtësi i tij e ka paraqitur këtë kërkesë në seancën paraprake, i pandehuri, nuk është e nevojshme që të jetë i pranishëm fizikisht, në seancën gjyqësore të themelit, në të cilën gjykata ta pyesë, personalisht, nëse, i qëndron kërkesës për gjykim të shkurtuar. Në këtë rast, mendojmë se, i duhet bërë një interpretim i zgjeruar pikës 5 të nenit 405 të këtij Kodi, në favor të të drejtave të të pandehurit, në procesin penal, duke e kuptuar këtë dispozitë që, kur i pandehuri, në seancën paraprake, ka paraqitur kërkesë për gjykim të shkurtuar, me anë të mbrojtësit të tij, të pajisur me autorizim të posaçëm, nuk është e detyrueshme prania fizike e të pandehurit, në seancën gjyqësore të themelit, mjafton që, ai të përfaqësohet nga mbrojtësi i tij me autorizim të posaçëm dhe, gjykata, duhet të pyesë këtë të fundit, pra, mbrojtësin me autorizim të posaçëm, nëse, i qëndron kërkesës për gjykim të shkurtuar.

Në një interpretim të tillë ligjor ne arrijmë, nisur nga fakti që, përderisa, i pandehuri ia ka deleguar mbrojtësit të tij, me autorizim të posaçëm, të drejtën për të kërkuar gjykim të shkurtuar, në seancën paraprake, duke mos qenë, ai, fizikisht i pranishëm, delegimi i kësaj të drejtë vazhdon edhe gjatë seancës gjyqësore të themelit dhe nëse, i pandehuri shfaq vullnetin që të mos paraqitet në gjykimin e themelit, duke u përfaqësuar nga mbrojtësi i tij me autorizim të posaçëm, prania e tij fizike, në seancë gjyqësore, nuk është e detyrueshme dhe, gjykata, duhet të pyesë mbrojtësin e tij, të pajisur me autorizim të posaçëm, nëse, i qëndron kërkesës për gjykim të shkurtuar.

Në bazë të ndryshimeve që i janë bërë pikës 6 të nenit 405 të këtij Kodi, me ligjin Nr. 35, të vitit 2017, prokurori parashtron, në mënyrë të përmbledhur rezultatet e hetimeve paraprake, dhe nuk shprehet, nëse, është dakord apo jo me kërkesën e të pandehurit që, gjykimi ndaj tij të zhvillohet në bazë të procedurës së gjyimit të shkurtuar. Mendojmë që, një ndryshim i tillë ligjor është i drejtë dhe i

⁴ Pika 5 e nenit 405 të Kodit të Procedurës Penale, shtuar me ligjin Nr. 35, të vitit 2017, parashikon: *“Pasi dëgjon palët për kërkesat paraprake, gjykata lexon kërkesën për gjykim të shkurtuar dhe pyet të pandehurin nëse i qëndron asaj. Kur i pandehuri deklaron që i qëndron kërkesës, gjykata deklaron të hapur shqyrtimin gjyqësor dhe i jep fjalën prokurorit që në mënyrë të përmbledhur të parashtojë rezultatet e hetimit paraprak”.*

bazuar, sepse, meqenëse, prokurori ka paraqitur aktet për miratimin e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq dhe kjo kërkesë është miratuar nga gjyqtari i seancës paraprake, duke u vendosur dërgimi i çështjes në gjyq, prokurori kuptohet që, ka qenë dakord që, aktet janë të plota dhe çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet, sepse të kundërt, ai nuk do të kishte paraqitur para gjyqtarit të seancës paraprake, kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq.

Përveç këtij argumenti, sipas të cilit nuk është e nevojshme që, prokurori të shprehet për kërkesën e të pandehurit për gjykim të shkurtuar, mendojmë që, një ndryshim i tillë ligjor, kontribuon edhe në marrjen e një vendimi të drejtë nga ana e gjykatës. Kjo, pasi nisur nga situata e sotme e pushtetit gjyqësor, ku, gjyqtarët, për arsye edhe të opinionit publik dhe mediatik, në realitet, nuk janë të gjithë jashtë ndikimit dhe qëndrimit që mban prokurori për zgjidhjen e çështjes, në rastet kur, prokurori do të shprehej për mos pranimin e kërkesës së të pandehurit për gjykim të shkurtuar, ky qëndrim i prokurorit, mund të ushtronte presion të panevojshëm mbi vendimmarrjen e gjykatës.

Nisur nga qëndrime të ndryshme që kishte praktika gjyqësore, me shtesat që iu bënë nenit 405 të këtij Kodi, me ligjin Nr. 35, të vitit 2017, u parashikua, shprehimisht që, kërkesa për gjykim të shkurtuar nuk pranohet kur i pandehuri ka pretendime për pavlefshmërinë e akteve ose papërdorshmërinë e provave⁵. Një parashikim i tillë ligjor është më se i logjikshëm dhe i arsyeshëm, sepse, duke qenë se gjykimi i shkurtuar, nënkupton pranimin e akteve nga i pandehuri dhe gjykimin në gjendjen që janë aktet dhe përderisa, i pandehuri ka pretendime për pavlefshmërinë e akteve ose papërdorshmërinë e provave, kjo do të thotë që, ai nuk pranon aktet dhe nuk është dakord që, çështja të zgjidhet në gjendjen që janë ato dhe, kjo do të thotë që, ai vetë, me vullnetin e tij, heq dorë nga kërkesa për gjykim të shkurtuar dhe, gjykata nuk ka si ta pranojë një kërkesë të tillë, nga e cila, i pandehuri me qëndrimin që mban, ka hequr dorë, në mënyrë vullnetare, prej saj.

Kërkesa për gjykim të shkurtuar nuk pranohet nga gjykata edhe në rastet kur konstaton, kryesisht, pavlefshmëri absolute të akteve apo papërdorshmëri të provave. Megjithatë, sipas dispozitës ligjore, në ndryshim nga sa ka ndodhur, në ndonjë rast të praktikës gjyqësore, kërkesa për gjykim të shkurtuar nuk pranohet, jo për konstatimin, kryesisht nga gjykata të pavlefshmërisë absolute të çdo akti apo të papërdorshmërisë së çdo prove, por kur gjykata konkludon që, si rezultat i pavlefshmërisë absolute të një apo disa akteve apo të papërdorshmërisë së një ose disa provave, çështja nuk mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet. Kjo sepse, mund të ndodhë që, gjykata të konstatojë kryesisht, pavlefshmërinë absolute të një

⁵ Fjalja e parë e pikës 7 të nenit 405 të Kodit të Procedurës Penale, shtuar me ligjin Nr. 35, të vitit 2017, parashikon:

“Kërkesa për gjykim të shkurtuar nuk pranohet nëse i pandehuri apo mbrojtësi i tij ngrenë pretendime mbi vlefshmërinë e akteve apo papërdorshmërinë e provave të grumbulluara gjatë hetimit paraprak, apo kur kërkojnë marrjen e provave të reja në gjykim”.

ose disa akteve apo papërdorshmërinë e një ose disa provave, por ato janë të tilla, që nuk paraqesin rëndësi për zgjidhjen e çështjes. Në këto raste, gjykata duhet të vendosë pranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar dhe jo ta refuzojë atë, me pretendimin që, një ose disa akte janë absolutisht të pavlefshme apo një ose disa prova, janë të papërdorshme, sepse, këto akte ose prova, nuk ndikojnë në zgjidhjen e çështjes dhe, nuk e pengojnë gjykatën që, ta zgjidhë çështjen në gjendjen që janë aktet.

Kur gjykata konstaton, kryesisht, një ose disa akte të pavlefshme apo një ose disa prova të papërdorshme, pika 7 e nenit 495 të këtij Kodi, shtuar me ligjin Nr. 35, të vitit 2017, parashikon, në mënyrë të shprehur që, gjykata, së bashku me mospranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar, duhet të përcaktojë edhe aktet që janë të pavlefshme ose provat që janë të papërdorshme në atë gjykim. Ky përbën një detyrim ligjor për gjykatën që, duhet zbatuar, në çdo rast prej saj dhe, është i ndryshëm nga rasti kur, gjykata nuk pranon kërkesën për gjykim të shkurtuar, sepse, çmon se çështja nuk mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet, rast në të cilin, gjykata nuk ka detyrim për të përcaktuar se, cilat janë aktet e pavlefshme apo provat e papërdorshme në gjykim.

Ligji Nr. 35, i vitit 2017, ka bërë edhe një ndryshim tjetër ligjor, në procedurën e gjykimit të shkurtuar, duke përcaktuar që, kur gjykata pranon kërkesën për gjykim të shkurtuar, padia civile në procesin penal, nuk shqyrtohet. Ky parashikim ligjor ndryshonte atë të mëparshmin, sipas të cilit padia civile nuk shqyrtohej kur, paditësi nuk e prante gjykimin e shkurtuar. Ndryshimi i mësipërm ligjor mendojmë se është i drejtë dhe në fakt nuk ka bërë tjetër veçse ka ligjëruar praktikën gjyqësore të gjykatave tona, të cilat, në të gjitha rastet që pranonin kërkesën për gjykim të shkurtuar, nuk e pranonin për shqyrtim padinë civile, duke vendosur ndarjen e saj dhe dërgimin për kompetencë, pranë gjykatës civile.

2. Problemet e dala në praktikën gjyqësore, në Shqipëri, për gjykimin e shkurtuar.

Gjatë zbatimit të procedurës së gjykimit të shkurtuar, i cili, siç e thamë më lart, ka një histori të ekzistencës së saj mbi 20 vjeçare, në praktikën gjyqësore të gjykatave tona, janë ngritur disa çështje problematike, zgjidhja e të cilave ose nuk ishte parashikuar në ligj ose nuk ishte e parashikuar, në mënyrë të qartë. Ligji Nr. 35, i vitit 2017, me shtesat dhe ndryshimet që ka bërë, ka zgjidhur një nga çështjet problematike që kishte dalë gjatë praktikës gjyqësore dhe që kishte të bënte me rastet kur, i pandehuri, para se të paraaqiste kërkesën për gjykim të shkurtuar, pretendonte pavlefshmërinë e akteve apo papërdorshmërinë e provave.

Për zgjidhjen, ndër të tjera edhe të kësaj çështjeje, nga ana e Gjykatës së Lartë, u mor Vendimi Penal Unifikues Nr. 2, datë 29.1.2013, i cili, konkludoi që, kur pas paraqitjes së kërkesës për gjykim të shkurtuar, i pandehuri ngren pretendime për pavlefshmërinë e akteve ose papërdorshmërinë e provave, gjykata vendos revokimin e vendimit për zgjidhjen e çështjes sipas procedurës së gjykimit të shkurtuar dhe

fillimin e çështjes me procedurën e gjykimit të zakonshëm. Megjithatë, ky Vendim Unifikues, nuk zgjidhte rastet kur, i pandehuri para paraqitjes së kërkesës për gjykim të shkurtuar, paraqiste kërkesë për pavlefshmërinë e akteve ose papërdorshmërinë e provave dhe gjykata vendoste rrëzimin e kësaj kërkesë, si të pabazuar në prova dhe ligj, pyetja që shtrohej ishte, nëse, i pandehuri, pas rrëzimit të kërkesës për pavlefshmërinë e akteve ose papërdorshmërinë e provave nga gjykata, a kishte të drejtë ai që të paraqiste kërkesë për gjykim të shkurtuar dhe, a duhej gjykata që ta pranonte një kërkesë të tillë?

Për këtë çështje, praktika gjyqësore, në Shqipëri, në të gjitha shkallët e gjykimit, i ka bërë një interpretim të zgjeruar ligjit, në favor të të drejtave të të pandehurit në procesin penal, në kushtet kur, ligji, nuk e trajtonte, shprehimisht këtë çështje, jo vetëm duke e lejuar të pandehurin që të bëjë kërkesë për gjykim të shkurtuar, por edhe duke e pranuar kërkesën e tij, në rastet kur gjykata ka çmuar që, çështja mund të zgjidhej në gjendjen që ishin aktet. Ky qëndrim i mbajtur nga praktika gjyqësore për këtë çështje, duhet të ndryshohet në të ardhmen, sepse, ligji Nr. 35, i vitit 2017, parashikon, shprehimisht që, nëse, i pandehuri paraqet pretendime për pavlefshmërinë e akteve ose papërdorshmërinë e provave, gjykata nuk e pranon kërkesën për gjykim të shkurtuar.

Një nga çështjet e rëndësishme për të cilën ka patur debate në praktikën gjyqësore është nëse, mundet gjykata që, për një çështje, e cila, po gjykohet sipas procedurës së gjykimit të shkurtuar, me vendimin e saj përfundimtar, të bëjë ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale, nga një vepër penale më të lehtë, në një vepër penale më të rëndë, se ajo e përcaktuar nga prokurori në kërkesën për gjykim dhe anasjelltas? Për këtë çështje, gjykatat e niveleve të ndryshme, duket që kanë qenë në unison, duke mbajtur qëndrimin që, mund të bëhej një cilësim ligjor i veprës penale për të cilën akuzohej i pandehuri, nga ai më i lehtë në më të rëndë dhe anasjelltas, nga më i rëndë në më të lehtë, edhe në rastet kur, ajo procedonte me gjykim të shkurtuar.

Ky qëndrim i praktikës gjyqësore, ka ndryshuar pas daljes së vendimit të Gjykatës Kushtetuese Nr. 4, të vitit 2012, si rezultat i gjykimit prej saj të një çështjeje konkrete që, kishte shkuar për gjykim para saj, për shkeljen e procesit të rregullt gjyqësor, ku, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, me procedurën e gjykimit të shkurtuar, kishin ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale, nga një vepër më të lehtë, për të cilën akuzohej i pandehuri, në një vepër penale më të rëndë. Gjykata Kushtetuese, në vendimin e mësipërm, konkludoi që, kur gjykimi zhvillohej me procedurën e gjykimit të shkurtuar, gjykata, nuk mund të ndryshonte cilësimin ligjor të veprës penale, veçanërisht ajo nuk mund t'i bënte një cilësim ligjor më të rëndë veprës penale për të cilën akuzohej i pandehuri, sepse, duke vepruar në këtë mënyrë, gjykata cenonte parimin e mbrojtjes dhe të barazisë së palëve në procesin penal, duke e bërë procesin të parregullt, në pikëpamjen kushtetuese.

Duke qenë se, ky vendim i Gjykatës Kushtetuese, ka ndryshuar të gjithë praktikën gjyqësore për këtë çështje, e çmojmë të arsyeshme, që ta trajtojmë, shkurtimisht, Casus-in në fjalë. Kjo çështje i referohet një rasti të gjykuar nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, ku tre të pandehur akuzoheshin për veprën penale të: “*Trafikimi i narkotikëve*”, në bashkëpunim, mbetur në tentativë, të parashikuar nga neni 283/a/2 e 22 i Kodit Penal, ndërsa i pandehuri L.L., akuzohej për veprën penale të: “*Moskallëzimi i krimit*”, i parashikuar nga neni 300, paragrafi i parë i këtij Kodi.

Referuar akteve të këtij gjykimi, rezulton që katër të pandehurit kanë paraqitur kërkesë për gjykim të shkurtuar, kërkesë, e cila, është pranuar nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, e cila me vendimin e saj Nr. 72, datë 04.12.2009, ka vendosur, ndër të tjera, deklarinim fajtor të të pandehurit L.L., për veprën penale të: “*Trafikimi i narkotikëve*”, të kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 283/a/2 dhe 22 e 23 i KP-së dhe e ka dënuar atë me 9 vjet burgim. Në aplikim të nenit 406 të KPP-së ka dënuar të pandehurin, përfundimisht, me 6 vjet burgim. Duke e analizuar këtë vendim gjyqësor, rezulton që, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, nuk është ndalur për të trajtuar konkretisht çështjen, nëse, shkeleshin apo jo të drejtat e të pandehurit L.L., në këtë proces penal, siç janë barazia e palëve, parimi i kontraktitorialitetit, e drejta e mbrojtjes, etj, në kushte kur, gjykata kishte ndryshuar cilësimin juridik, për këtë të pandehur, nga një vepër penale më të lehtë, në një vepër penale më të rëndë⁶.

Mbi bazën e ankimit të të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, Tiranë, me vendimin e saj Nr. 14, datë 15.2.2010, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit Nr. 72, datë 04.12.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, edhe për të pandehurin L.L., ku, edhe nga ana e kësaj gjykate, nuk është bërë një analizë e veçantë për çështjen, nëse, cenoheshin të drejtat e të pandehurit në procesin penal, si pasojë e ndryshimit të cilësimit ligjor të veprës penale, nga një vepër më e lehtë, në një vepër më të rëndë, në kushtet kur është proceduar në bazë të procedurës së gjykimit të shkurtuar⁷. Po mbi rekursin e të pandehurit L.L., çështja është gjykuar nga ana e Gjykatës së Lartë, e cila me vendimin e saj Nr. 971, datë 8.11.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit dhe, duke qenë se, ajo nuk e ka kaluar çështjen për gjykim, në seancë gjyqësore, as Gjykata e Lartë, nuk kishte si të shprehej nëse, në procedurën e gjykimit të shkurtuar, duke u ndryshuar cilësimi ligjor i veprës penale, për të pandehurin nga një vepër penale më e lehtë, në një vepër penale më të rëndë, cenoheshin apo jo të

⁶ Shih për më tepër: Vendimin Nr. 72, datë 04.12.2009, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

⁷ Shih për më tepër: Vendimin Nr. 14, datë 15.2.2010, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, Tiranë.

drejtat e të pandehurit në procesin penal⁸.

I pandehuri L.L., duke mos qenë dakord me vendimin e Gjykatës së Lartë, ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për shkelje të procesit të rregullt ligjor dhe kjo Gjykatë, pasi u ka bërë një analizë, shumë të qartë, instituteve të gjykimit të shkurtuar dhe ndryshimit të cilësimit ligjor të veprës penale, ka arritur në përfundimin që, kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm e zhvillojnë gjykimin mbi bazën e procedurës së gjykimit të shkurtuar, ato nuk mund të bëjnë ndryshimin e cilësimit ligjor të vepës penale. Konkrertisht, Gjykata Kushtetuese, në vendimin e mësipërm, ndër të tjera, shprehet që: “... 33. Nga sa më lart, Gjykata arrin në konkluzionin se, kur nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm procedohet me gjykim të shkurtuar, procedim në të cilin, duke qenë se gjykata merr në konsideratë vetëm dosjen e prokurorit, nuk ekziston mundësia e realizimit të së drejtës së mbrojtjes efektive nga i pandehuri, ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale nga ana e gjykatës, është në kundërshtim me qëllimin e këtij gjykimi. ...”⁹.

Fakti ,nëse, kur zhvillohet gjykimi në bazë të procedurës së gjykimit të shkurtuar, gjykata mund të ndryshojë cilësimin ligjor të veprës penale, duke e deklaruar fajtor të pandehurin për një vepër penale të ndryshme nga ajo për të cilën është akuzuar, është trajtuar edhe nga Gjykata Kushtetuese e Italisë, në disa vendime, ku, edhe ajo ka arritur në përfundimin që, gjykata nuk ka të drejtë që ta bëjë një gjë të tillë. Kështu, në vendimin e saj të fundit për këtë çështje, Nr. 140, të vitit 2010, Gjykata Kushtetuese e Italisë, ndër të tjera, shprehet se: “... Me kërkesën për gjykim të shkurtuar i pandehuri pranon të gjykohet me gjykimin e posaçëm në raport me akuzat e formulara nga prokurori, e vetëm ndaj tyre ai shpreh vlerësimin e dobisë së këtij gjykimi; kështu që nuk do të ishte kushtetutshmërisht e pranueshme që ai të gjendej i detyruar nga zgjedhja e tij edhe ndaj veprave penale të reja (të ndryshme) që mund t'i ngarkoheshin. ...”¹⁰.

Problemi i ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale kur, gjykata procedon në bazë të procedurës së gjykimit të shkurtuar, është trajtuar edhe nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ose Gjykata e Strasburgut, në disa vendime të saj, në të cilat është shprehur që, gjykata kur procedon me gjykim të shkurtuar, ajo nuk ka të drejtë që të bëjë ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, pasi duke vepruar në këtë mënyrë, ajo cenon standardet e një gjykimi të drejtë, barazinë e palëve dhe të drejtat e të pandehurit në procesin penal. Kështu, Gjykata e Strasburgut, në çështjen Kwiatkowska kundër Italisë, nr. 52868/99, ndër të tjera, paraqet disa nga veçoritë e gjykimit të shkurtuar, duke arsyetuar se:

⁸ Shih për më tepër: Vendimin Nr. 971, datë 8.11.200 të Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë.

⁹ Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr. 4, datë 10.2.2012.

¹⁰ Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Italisë, Nr. 140, të vitit 2010.

“... Kjo procedurë gjithsesi është e shoqëruar me një lehtësim të garancive procedurale të ofruara nga e drejta e brendshme, në veçanti për sa i përket publicitetit të diskutimit si dhe mundësisë që të kërkohet paraqitja e provave dhe thirrja e dëshmitarëve... Këto garanci përbëjnë aspekte themelore të së drejtës për një proces të rregullt ligjor të sanksionuar nga neni 6 i KEDNJ-së. Gjithsesi as teksti dhe as fryma e kësaj dispozite nuk ndalojnë që një person të heqë dorë në mënyrë spontane dhe të shprehur nga kjo e drejtë. Por, që të merret në konsideratë nën këndvështrimin e Konventës, kjo heqje dorë duhet të jetë e shprehur në mënyrë eksplicite dhe duhet të jetë e shoqëruar me një minimum garancish...¹¹”.

Ndërsa, në një çështje tjetër, konkretisht në çështjen Scoppola kundër Italisë, kërkesa nr. 10249/03, Gjykata e Strasburgut, në mënyrë të shprehur, vlerëson që, kur procedon me procedurën e gjykimit të shkurtuar, gjykata, nuk mund të bëjë ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale, të ndryshme nga ajo e paraqitur, nga prokurori, në kërkesën për gjykim, duke arsyetuar, ndër të tjera, se: “...një i pandehur duhet të presë që Shteti të veprojë në mirëbesim dhe të ketë marrë mirë parasysh zgjedhjet procedurale të mbrojtjes, duke përdorur mundësitë e ofruara nga ligji. Është kundër parimeve të sigurisë juridike dhe të mbrojtjes të besimit legjitim të personave që janë në gjykim që Shteti mund, në mënyrë të njëanshme, të ulë avantazhet që rrjedhin nga heqja dorë e disa të drejtave që kanë të bëjnë me nocionin e procesit të rregullt. Nëse kjo heqje dorë bëhet në këmbim të avantazheve të lartpërmendura, nuk mund të konsiderohet e drejtë që, pasi autoritetet e brendshme kanë pranuar të procedojnë me gjykim të thjeshtuar, një element themelor i marrëveshjes ndërmjet Shtetit dhe të pandehurit mund të modifikohet në disavantazh të këtij të fundit, pa konsensusin e tij. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, nëse është e vërtetë që Shtetet kontraktuese nuk janë të detyruar nga Konventa të parashikojnë procedura të thjeshtuara, qëndron gjithsesi fakti se, kur këto procedura ekzistojnë dhe aplikohen, parimet e procesit të rregullt ligjor imponojnë që të mos privohet në mënyrë arbitrare i pandehuri nga avantazhet që me atë procedurë lidhen...¹²”.

Nisur sa u trajtua lart, kur gjykata procedon me gjykim të shkurtuar, ashtu siç kanë konkluduar edhe praktika gjyqësore në Shqipëri, në Itali, por edhe jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut, në këto raste, ajo nuk mundet që të bëjë ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale, të ndryshme nga ajo që ka paraqitur prokurori në kërkesën për gjykim. Por, meqenëse, me ligjin Nr. 35, të vitit 2017, në nenin 375 të Kodit të Procedurës Penale, janë bërë ndryshime, duke parashikuar që, kur gjykata vlerëson që, fakti për të cilin akuzohet i pandehuri, mund të ketë cilësim ligjor më të rëndë se, ai që ka bërë prokurori, njofton palët dhe u jep kohën e

¹¹ Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës së Strasburgut në çështjen Këiatkoxska kundër Italisë, nr. 52868/99.

¹² Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës së Strasburgut në çështjen Scoppola kundër Italisë, kërkesa nr. 10249/03.

nevojshme për t'u mbrojtur, si dhe duke qenë se, sipas këtyre ndryshimeve, palët njoftohen paraprakisht dhe kanë të drejtën e mbrojtjes ndaj cilësimit ligjor më të rëndë që mund të bëjë gjykata¹³, mund të shtrohet për diskutim edhe njëherë çështja, nëse, mundet gjykata që, të bëjë ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale, kur ajo procedon me gjykim të shkurtuar?

Për këtë çështje, duke u bazuar në natyrën dhe veçoritë e gjykimit të shkurtuar, por edhe në praktikën gjyqësore, në Shqipëri dhe Itali, por edhe në jurisprudencën e Gjykatës së Stranburgut, mendimi ynë është se, pavarësisht nga ndryshimet që ka pësuar dispozita e nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale, ligjin Nr. 35, të vitit 2017, përsëri, kur procedon me gjykim të shkurtuar, gjykata nuk mundet që të bëjë ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale, në një vepër penale më të rëndë se, ajo e paraqitur nga prokurori. Kështu, pavarësisht nga fakti që, sipas ndryshimeve të reja, kur gjykata çmon se, mund të bëjë një cilësim ligjor më të rëndë të veprës penale, ajo njofton palët dhe iu jep kohën e nevojshme për t'u mbrojtur, përsëri, mendimi ynë është që, neni 375 i Kodit të Procedurës Penale, është një dispozitë që zbatohet vetëm kur procedohet sipas rregullave të gjykimit të zakonshëm. Ky vlerësim i yni bazohet në faktin se, ashtu siç ka konstatuar edhe praktika gjyqësore në Itali dhe jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut, në një proces penal një i pandehur duhet të presë që shteti të veprojë në mirëbesim dhe të marrë mirë parasysh zgjedhjet procedurale të mbrojtjes, duke përdorur mundësitë e ofruara nga ligji dhe se është kundër parimeve të sigurisë juridike dhe të mbrojtjes të besimit legjitim të personave që janë në gjykim që shteti mund, në mënyrë të njëanshme, të ulë avantazhet që rrjedhin nga heqja dorë e disa të drejtave që kanë të bëjnë me nocionin e procesit të rregullt gjyqësor.

Një tjetër çështje që ka dalë nga praktika gjyqësore, në lidhje me gjykimin e shkurtuar, është fakti, se si, duhet të veprojë gjykata, kur çështja penale, ka disa të pandehur dhe një ose disa prej tyre kërkojnë gjykim të shkurtuar dhe disa të tjerë, kërkojnë të procedohet me gjykim të zakonshëm. Në lidhje me këtë çështje, pas daljes së Vendimit Penal Unifikues të Gjykatës së Lartë, nr. 02, datë 29.01.2003, i cili, ka përcaktuar se, në një gjykim me disa të pandehur, nuk mund të procedohet për disa të pandehur me gjykim të posaçëm dhe për të tjerët me gjykim të zakonshëm, gjykatat në Shqipëri, kanë vepruar, duke vendosur më parë, ndarjen e çështjes, në rastet kur, ndarja e çështjes nuk dëmtonte vërtetimin e fakteve, dhe duke vazhduar gjykimin për të pandehurit që kanë kërkuar gjykim të shkurtuar, ndërsa, për të pandehurit e tjerë, është hedhur çështja në short dhe, ka filluar gjykimi nga e para, sipas procedurës së gjykimit të zakonshëm.

¹³ Pika 2 e nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale parashikon:

“2. Kur në përfundim të shqyrtimit gjyqësor gjykata vlerëson se fakti për të cilin akuzohet i pandehuri mund të ketë cilësim juridik më të rëndë se ai që ka bërë prokurori ose viktima akuzuese, njofton palët për këtë mundësi dhe i jep kohën e nevojshme për t'u mbrojtur. Palët kanë të drejtë të paraqesin prova të reja”.

Një tjetër çështje që ka dalë, së fundmi, nga praktika gjyqësore, është rasti kur, çështja përbëhet nga disa të pandehur dhe të gjithë të pandehurit kanë kërkuar gjykim të shkurtuar, kërkesë që është pranuar nga gjykata dhe çështja ka vijuar me procedurën e gjykimit të shkurtuar dhe, pasi janë lexuar konkluzionet e prokurorit dhe të të gjithë të pandehurve dhe mbrojtësve të tyre, vetëm njëri prej mbrojtësve dhe i pandehuri i mbrojtur prej tij, në diskutimin përfundimtar, pretendojnë pavlefshmëri të akteve dhe kërkojnë revokimin e vendimit për gjykim të shkurtuar, duke vijuar gjykimin sipas rregullave të gjykimit të zakonshëm, vetëm për këtë të pandehur. Pyetja që shtrohet është: Në këto raste, në kushtet kur, gjykata çmon se, nuk jemi para pavlefshmërisë së akteve ose para papërdorshmërisë së provave, fakt që është konfirmuar, tashmë, prej saj, pasi ajo ka pranuar më parë kërkesën për gjykim të shkurtuar, për të gjithë të pandehurit, si dhe në kushtet kur, gjykata çmon që ndarja e çështjes, vetëm për njërin nga të pandehurit, nuk dëmton vërtetimin e fakteve për të pandehurit e tjerë, a duhet gjykata që ta revokojë gjykimin e shkurtuar për të gjithë të pandehurit dhe të vijojë atë, sipas rregullave të gjykimit të zakonshëm për të gjithë ata, apo gjykata duhet që, në këtë fazë që, është në diskutimin përfundimtar të mbrojtjes, të vendosë ndarjen e çështjes për të pandehurin që ka pretenduar pavlefshmëri të akteve dhe vijimin e gjykimit, në fazën që ka mbetur, në bazë të procedurës së gjykimit të shkurtuar, për të gjithë të pandehurit e tjerë?

Për këtë çështje praktika gjyqësore, në Shqipëri, duke u bazuar në Vendimin Penal Unifikues të Gjykatës së Lartë, nr. 02, datë 29.01.2003, i cili, ka konkluduar se, kur gjatë gjykimit të shkurtuar, i pandehuri ose mbrojtësi i tij, në diskutimin përfundimtar, pretendojnë pavlefshmëri të akteve, gjykata revokon vendimin për gjykim të shkurtuar dhe vijon gjykimin sipas rregullave të gjykimit të zakonshëm, duket se, ka mbajtur qëndrimin duke vendosur revokimin e vendimit për gjykim të shkurtuar për të gjithë të pandehurit dhe vijimin e gjykimit sipas rregullave të gjykimit të zakonshëm, për të gjithë ata. Në ndryshim nga qëndrimi që ka mbajtur praktika gjyqësore, jemi të mendimit që, kur procedohet në bazë të gjykimit të shkurtuar, në një çështje me disa të pandehur dhe, një ose disa prej tyre, në fazën e diskutimit përfundimtar të mbrojtjes, ngrejnë pretendime për pavlefshmërinë e akteve ose papërdorshmërinë e provave, duke kërkuar edhe revokimin e vendimit për gjykim të shkurtuar dhe ndarjen e çështjes së tyre, nga të pandehurit e tjerë, për të vijuar për ta me rregullat e gjykimit të zakonshëm, ndërsa të pandehurit e tjerë i qëndrojnë kërkesës për gjykim të shkurtuar, gjykata nuk duhet që automatikisht dhe vetëm për këtë shkak, të revokojë vendimin për gjykim të shkurtuar, për të gjithë të pandehurit, duke e shndërruar të gjithë gjykimin nga gjykim i shkurtuar, në gjykim të zakonshëm.

Në raste të tilla, mendojmë se, nëse, gjykata çmon që, ndarja e çështjes së të pandehurit ose të pandehurve që kanë paraqitur pretendime për pavlefshmëri të akteve dhe kanë kërkuar të procedohet me gjykim të zakonshëm, nuk dëmton vërtetimin e fakteve për të pandehurit e tjerë, si dhe nëse, të pandehurit e tjerë i

qëndrojnë kërkesës për gjykim të shkurtuar, mund të vendoset ndarja e çështjes, vetëm për këta të pandehur, duke zbatuar gjykimin e zakonshëm për to dhe, vijimin e gjykimit në bazë të procedurës së gjykimit të shkurtuar, në fazën ku ka mbetur, për të pandehurit e tjerë. Referimi që praktika gjyqësore bën tek Vendimi Penal Unifikues të Gjykatës së Lartë, nr. 02, datë 29.01.2003, për të revokuar vendimin për gjykim të shkurtuar për të gjithë të pandehurit, mendojmë që, nuk është relevant ose nuk lidhet me rastin konkret, sepse, në atë Vendim Unifikues është unifikuar praktika gjyqësore, duke iu referuar rasteve kur gjykimi i shkurtuar zhvillohet, vetëm ndaj një të pandehuri dhe, në atë Vendim, nuk është trajtuar, aspak çështja e gjykimit të shkurtuar që, zhvillohet ndaj disa të pandehurve dhe, për këtë arsye, nuk mund të shërbejë si argument dhe për më tepër si bazë ligjore e detyrueshme, për gjykatat në këto raste.

KONKLUZIONE

Në përfundim të këtij punimi, konkluzioni i parë që mund të nxjerrim është se parashikimi nga ana e Kodit të Procedurës Penale, i gjykimit të shkurtuar, si një nga llojet e gjykimeve të posaçme, është një zgjidhje me vlera konkrete praktike, pasi, nga praktika gjyqësore e gjykimit të çështjeve penale, rezulton që, rreth 80% e çështjeve zgjidhen nga gjykata në bazë të këtij gjykimi të posaçëm. Duke iu referuar, përsëri, praktikës gjyqësore, në Shqipëri, si dhe përmbajtjes së normave ligjore të Kodit të Procedurës Penale, që rregullojnë gjykimin e shkurtuar, konstatohet që, në përgjithësi, praktika gjyqësore, i ka zbatuar drejt dhe saktë, normat ligjore që rregullojnë këtë formë gjykimi, çka do të përbënte edhe një tjetër konkluzion të këtij punimi.

Ndryshimet ligjore të bëra me ligjin Nr. 35, të vitit 2015, në Kodin e Procedurës Penale, që kanë të bëjnë me gjykimin e shkurtuar, janë ndryshime të nevojshme dhe që kontribuojnë në rregullimin e plotë dhe të saktë të këtij instituti të procedurës penale. Para bërjes së këtyre ndryshimeve, normat ligjore që rregullonin këtë lloj gjykimi, nuk ishin të plota dhe të qarta dhe disa çështje që, janë ngritur nga praktika gjyqësore, nuk gjenin zgjidhje, çka e detyroi edhe Gjykatën e Lartë që të nxirrte një Vendim Unifikues për të trajtuar këto çështje të praktikës gjyqësore, i cili, në fakt plotësoi boshllëkun ligjor që, kishin normat proceduriale.

Megjithëse, normat ligjore që rregullojnë gjykimin e shkurtuar, duke iu referuar edhe shtesave dhe ndryshimeve të bëra me ligjin Nr. 35, të vitit 2017, në përgjithësi, e rregullojnë në mënyrë të plotë, këtë institut, përsëri, jemi të mendimit që, nga ana e ligjvënësit, duhet të ishin rregulluar, në mënyrë të shprehur, rastet kur, i pandehuri pasi ka paraqitur kërkesën për gjykim të shkurtuar dhe ajo është pranuar nga gjykata, në diskutimin përfundimtar, paraqet pretendime për pavlefshmërinë e akteve ose papërdorshmërinë e provave, çështje që, aktualisht është rregulluar nga

Vendimi Penal Unifikues të Gjykatës së Lartë, nr. 02, datë 29.01.2003, por që e këshillueshme është që, të rregullohet, shprehimisht, edhe nga norma ligjore procedurale.

Një tjetër çështje që mendojmë që duhet të ishte zgjidhur, duke u parashikuar, shprehimisht në normën ligjore janë edhe rastet kur, gjykata procedon me gjykim të shkurtuar ndaj disa të pandehurve dhe vetëm njëri ose disa prej tyre, pasi kanë paraqitur kërkesën për gjykim të shkurtuar dhe ajo është pranuar nga gjykata, paraqesin pretendime për pavlefshmërinë e akteve ose papërdorshmërinë e provave, duke kërkuar edhe revokimin e vendimit për gjykim të shkurtuar dhe vijimin e gjykimit sipas rregullave të gjykimit të zakonshëm, ndërkohë që, një ose disa të pandehur të tjerë, i qëndrojnë kërkesës për gjykim të shkurtuar. Për këtë çështje, jemi të mendimit që, norma ligjore procedurale të parashikojë, në mënyrë të shprehur se, kur procedohet me gjykim të shkurtuar ndaj disa të pandehurve dhe, një ose disa prej tyre, në diskutimin përfundimtar, paraqesin pretendime për pavlefshmërinë e akteve ose papërdorshmërinë e provave dhe një ose disa të pandehur të tjerë, i qëndrojnë kërkesës për gjykim të shkurtuar, nëse, gjykata çmon se, ndarja e çështjes për të pandehurit që kanë paraqitur pretendime për pavlefshmërinë e akteve ose papërdorshmërinë e provave, nuk dëmton vërtetimin e fakteve për të pandehurit e tjerë që, i qëndrojnë kërkesës për gjykim të shkurtuar, ajo vendos, ndarjen e çështjes për të pandehurit që kanë paraqitur këto pretendime dhe, fillimin e gjykimit sipas rregullave për gjykimin e zakonshëm për to, si dhe vijimin e gjykimit, në fazën që ka mbetur, për të pandehurit e tjerë që, i qëndrojnë kërkesës për gjykim të shkurtuar.

Një tjetër konkluzion i këtij punimi është se, duke iu referuar normave ligjore që rregullojnë gjykimin e shkurtuar, por edhe praktikës gjyqësore, në Shqipëri, si edhe jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut, kur procedohet me gjykim të shkurtuar, gjykata, në asnjë rast, nuk mund të bëjë ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale, të ndryshëm nga ai që e ka paraqitur prokurori, në kërkesën për gjykim. Në qoftë se, gjykata, pas paraqitjes së kërkesës për gjykim të shkurtuar, vlerëson që, mund t'i bëjë një cilësim ligjor faktit penal, të ndryshme nga ai i paraqitur nga prokurori, qoftë më të rëndë, qoftë më të lehtë, ajo nuk duhet të pranojë kërkesën për gjykim të shkurtuar, por duhet të vijojë gjykimin sipas rregullave të gjykimit të zakonshëm dhe, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, ajo mund të bëjë ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale, duke zbatuar rregullat e parashikuara në pikën 2 të nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale.

Duke u nisur nga fakti që, çështja e ndryshimit të cilësimit ligjor të veprës penale, kur procedohet me gjykim të shkurtuar, është një çështje e debatuar, jo vetëm në praktikën gjyqësore, në Shqipëri, por edhe në Itali dhe madje edhe në jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut, për të shmangur çdo lloj diskutimi të mëtejshëm, do të ishte e këshillueshme, që vetë ligjvënësi, në një dispozitë të veçantë,

të parashikonte, shprehimisht që, kur gjykata procedon sipas rregullave të gjykimit të shkurtuar, ajo nuk mund të bëjë ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale.

Si konkluzion i fundit i këtij punimi është fakti që, parashikimi ligjor sipas të cilit, nuk lejohet kërkesa për gjykim të shkurtuar për veprat penale që parashikojnë dënimin me burgim të përjetshëm, i shtuar me ligjin Nr. 35, të vitit 2017, mund të jetë një zgjidhje ligjore që, paraqet probleme kushtetuese, përsa i përket cenimit të parimit të barazisë para ligjit dhe të mosdiskriminimit, të parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës së Shqipërisë, si dhe cenimit të parimit të proporcionalitetit dhe masës së kufizimit të të drejtave, të parashikuar nga neni 17 i Kushtetutës, por, që, kjo është një çështje që i takon që të zgjidhet nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në rast se, një çështje e tillë do të paraqitet, në rrugën dhe formën ligjore, për zgjidhje para saj.

BIBLIOGRAFIA

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë;
- Islami H; Panda i dhe Hoxha A; “*Procedura Penale*”, Shtëpia Botuese Morava, Tiranë 2007;
- Vendimi i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në çështjen Scoppola kundër Italisë, kërkesa nr. 10249/03;
- Vendimi i Gjykatës së Strasburgut në çështjen Kwiatkowska, kundër Italisë, nr. 52868/99.
- Vendim i nr. 4, i vitit 2012 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë;
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Italisë, Nr. 140, të vitit 2010;
- Vendimi Penal Unifikues i Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë, nr. 02, datë 29.01.2003;
- Vendimi Nr. 971, datë 8.11.200 i Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë;
- Vendimi Nr. 14, datë 15.2.2010, i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, Tiranë;
- Vendimi Nr. 72, datë 04.12.2009, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

SOME OF THE MAIN CHALLENGES AND OBSTACLES OF STATE PROSECUTORS: *CASE OF KOSOVO*

Dr. sc. Xhevdet HALILI

Assistant Professor of Law,

(xhevdet.halili@uni-pr.edu)

Faculty of Law, University of Prishtina

“Hasan Prishtina” Republic of Kosovo

ABSTRACT

An effective persecution system is one of the most significant compounds of a democratic and legal state. Having this said, a research on this area is very welcomed. From this point of view, the purpose of this paper is identifying the main challenges and obstacles of persecution system in the Republic of Kosovo. Based on the findings, the proper conclusions have been highlighted as well.

Indeed, Kosovo is facing with several challenges and obstacles on fulfilling the tasks of an effective persecution system. But bearing in mind that this challenges and obstacles are stretched through cross-sectorial aspects, it is quite impossible to list all of them on this paper! Nevertheless in this paper are stressed just some of them, on which I think it should be posed more weight while fighting criminality and improving persecution system in Kosovo. This way we will focus on *the need for additional training for new prosecutors, the lack of physical security of prosecutors and their families, different threats and low salaries of persecutors, the interference on the independence of prosecutors*, etc.

Unfortunately, during the research I stepped on several corruption cases committed by state persecutors in Kosovo. Actually these cases are not a real point of matter since they have been lightened through legal procedures. But as it will explained further, it is a reasonable doubt that a concerning “dark number” of these kind of corruption cases is hidden. This means that corruption in the persecution system in Kosovo is still a worth worrying of obstacle.

So the focus of this paper will be more or less on these challenges and obstacles we mentioned above. On this regard we also reached proper conclusions. From this point of view I am convinced that having better results with overtaking these challenges and obstacles will lead us to a more effective persecution system and to a more successful combat of criminality as well.

Key words: *Challenges, Obstacles, State Persecutor, Republic of Kosovo*

ABBREVIATION

KFOR - Kosovo Force for peacekeeping which was responsible for established secure environment
NATO - North Atlantic Treating Organization
UNMIK - United Nations Mission in Kosovo
EULEX - European Mission for Rule of Law in Kosovo
UN - United Nations
PPCCK - Provisional Procedural Criminal Code of Kosovo
CCK - Criminal Code of Kosovo
KPC - Kosovo Prosecutorial Council
CSP - Chief State Prosecutor
SP - State Prosecutor
IAP - International Association of Prosecutors
PCCK - Procedural Criminal Code of Kosovo
KJC - Kosovo Judicial Council
EULEX - European Union Mission for Rule of Law in Kosovo
EU - European Union
ODC - The Office of the Disciplinary Counsel
SPRK - Special Prosecution of Republic of Kosovo
USA - United States of America
ISP - International Standards Prosecution
USKOK – Bureau for Combating Corruption and Organized Crime in Croatia
RK - Republic of Kosovo
SPR- Standards of Professional Responsibility
SEDRP - Statements of the Essential Duties and Rights of Prosecutors
SEE - South Eastern Europe
UK - United Kingdom
EC – European Commission

INTRODUCTION

When we talking about the challenges, problems and obstacles in implementing the tasks of PS in Kosovo, we should take into consideration the current existing circumstances. Based on that, they really exist many problems, obstacles and challenges during the work of PS in this country. Further, we will have discussed some of them which are present often during their working in investigation against others persons which they committed crime.

We are awareness because challenges from country to country are different, and we know very well we are not in that level to compare with the United States of America (USA) but we just mention some of the challenges prescribed form the Association of Prosecuting Attorneys in a Policy Guides for the Prosecutor's. The

emphasis some of the main challenges for the prosecutors in U.S. such as follow: Leadership; Trust and independence; Organization-wide involvement; balancing management with leadership; insular attitudes; internal resistance to change; Organizational inertia; Divisions over strategies; Lack of awareness.¹ But the mention also: “Without effective leadership, prosecutorial offices will be unable to fulfill their mission. Elected prosecutors must be the leaders of their organizations. Leadership is the ability to see innovation and make change by motivating awareness and facilitating action.”²

Unfortunately, we founded cases in prosecutor’s office in Kosovo when the prosecutors committed corruption, and that will be one of the main challenges to PS and KPC to eliminate this occurrence. Further, other big obstacles are interference in the independence of prosecutors during them doing their duties in investigation or prosecution against others persons from different perspective. Moreover, exist also and other challenges and problems such as: Lack of physical security of prosecutors and their families, threats and low salaries; on the last but not les important is challenge of the needing for additional training for new prosecutors which just starting to work in the office of prosecutors in Kosovo.

Corruption as one of the main challenges to prosecutors

The most popular and simplest definition of corruption is that it is: “*The abuse of public power for private benefit*”. This is definition used by the International World Bank, based on this definition we should not concluded that corruption cannot exist within private sector activities.³ Further, *Corruption has been described as a disease*”,⁴ as the many authors mention this phrase. But, unfortunately, countries in transition like is Kosovo, corruption cases are more frequent, and the do not left without even touching the institutions that are established with the aim of combating this phenomenon, such is the institution of prosecution.

The issue of fighting corruption in general in Kosovo society, but also in its institution of the state prosecutor is one of the main challenges of the newest country in the world. We also encounter corruption in the prosecutor in the European Union Rule of Law Mission in Kosovo (EULEX). This mission, is a largest common

¹ Association of Prosecuting Attorneys, *The Prosecutor’s Policy Guide: A Roadmap to Innovation*, by Roy Hubert& Linsey Carlson, Washington D.C., 2012 page 6-15. Available at: <http://www.prosecutingattorneys.org/wp-content/uploads/The-Prosecutors-Policy-Guide-4.26-1.pdf>;

² Id.

³ International Monetary Fund, Fiscal Affairs Department, WP/98/63, *Corruption Around the World: Causes, consequences, scope, and Cures*, prepared by Vito Tanzi, 1998, page 8. Available at: file:///E:/FINAL%20PAPER%20ALL%20DOCUMENTS%20-%20Rule%20of%20Law%20Seminar/Corruption%20Around%20the%20World.pdf;

⁴ Tim Mackey, *The Disease of Corruption: Views on How to Fight Corruption to Advance 21st Century Global Health Goals*. Available at: <https://bmcmecicine.biomedcentral.com/articles/10.1186/s12916-016-0696-1>

foreign and security mission with a budget spend of more than 950 Million Euro's from 2009, has been mandated to fight high level corruption in Kosovo.⁵ Main purposes of this mission have been to support our institution in combating crime, but in contrary we have cases which are related with their self-prosecutors in corruption. Further, this mission amongst other has been preoccupied dealing with own staff accusation for corruption erupting in 2014 with the Maria Bamieh case, a former European Union (EU) prosecutor from United Kingdom (UK) raising suspicions over internal corruption of EULEX senior staff.⁶ In a statement the prosecutor's office said that the November 7, 2016, the SPRK filed in Pristina Basic Court decision to dismiss the investigation prosecution case number 24/2015 PPS, which cases was linked to doubts Bamieh.⁷

But, the main focus of this paper are related with the corruption in local institution of persecution, which have many cases which are where we punish certain cases and the procedure for prosecutors who have committed corruption offenses during the performance of duty, these we will discussed in more detail now.

One case which was happen in Prizren town related with allegations of corruption to the prosecutor for serious crimes in Prizren, B.H., where witnesses talk about the requirements of middlemen and prosecutor for giving bribes to close a case of attempted murder. Emission brings footage during meetings middlemen and intermediaries prosecutor family P, meetings in which it comes to money supply and withdrawal of charges. In other details included allegations that B.H. prosecutor had contacted relatives of the suspects also had the car dress serviced and had a courtyard tent without pay.⁸ Another cases we have when the by aggrieved party A.T. from Ferizaj has shown his facts which the prosecution from Ferizaj V.M. has lunch with the accused R.R. Aggrieved party has evidence has raised doubts about the possibility that the prosecutor had violated ethics rules when she was photographed dining with the accused.⁹ What happen with this Cases? A month after the prosecutor charged for violation of code of ethics, he asks the KPC to

⁵ European Mission for Rule of Law in Kosovo (EULEX), web page available at: <http://www.eulex-kosovo.eu/?page=2.16>.

⁶ Kosovar Institute for Policy Research and Development, Impunity in Kosovo: The Fight Against High Profile Corruption, No, 1/16, 2016, page 8, Available at: http://www.kipred.org/repository/docs/Final_4th_Paper_2016_Impunity_in_Kosovo_The_Fight_Against_High_Profile_Corruption_247857.pdf;

⁷ Online Newspaper Insider, title: Close Investigations into Corruption in EULEX witness Florim Hasani prosecuted for false testimony. Available at: <http://www.insajderi.com/hulumtime/mbyllen-hetimet-per-korrupsion-ne-eulex-deshmitari-florim-hasani-ndiqet-penalisht-per-deshmi-te-rrejshme/>;

⁸ Online webpage for reporting corruption entitled: Kallxo.com. available at: <http://kallxo.com/drejtesia-ne-kosove-korrupsioni-filmuar-ne-prokurorine-e-prizrenit/>.

⁹ Id. Available at: <http://kallxo.com/dreka-e-gabuar-e-gjykatesit-dhe-prokurorit-te-akuzuarin/>;

approve his resignation in the exercise acting prosecutor. KPC on November 30, 2016 approved his resignation and relieve from duty, see decision of KPC related to that.¹⁰

² Pika nr. 12 e REKOMANDIMIT NR. R (99) 19, të Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare në lidhje me ndërmjetësimin në çështjet penale (Miratuar nga Komiteti i Ministrave në datë 15 shtator 1999 në takimin e 697-të të zëvendësministrave), ku parashikohet se: “*Rregulloret e veçanta dhe masat mbrojtëse ligjore që rregullojnë pjesëmarrjen e minoreneve në ndjekjen gjyqësore duhet të vlejnjë, gjithashtu, edhe për pjesëmarrjen e tyre në ndërmjetësim për çështjet penale.*”

³ Pika nr. 2 e REKOMANDIMIT NR. R (99) 19, më sipër ku parashikohet se: “*Diskutimet gjatë ndërmjetësimit janë informacion i rezervuar dhe nuk mund të përdoren më pas, përveç se me pëlqimin e palëve.*”.

⁴ Prof. Dr. Ismet ELEZI, në “NDËRMJETËSIMI PËR PAJTIM NË KONFLIKTET PENALE”, Tiranë, 2004, paragrafi i parë fq. 121.

Referuar këtij grupimi, ligji u referohet neneve 59 dhe 284 të K.Pr.P, ku përcaktohen veprat penale që ndiqen me kërkesën e të dëmtuarit akuzues ose me ankim dhe për të cilat mund të iniciohet procesi ndërmjetësues, me qëllim arritjen e pajtimit mes palëve në konflikt. Bazuar në dispozitat e këtij ligji, zgjidhja e konflikteve penale me ndërmjetësim për pajtim bëhet atëherë kur pranohet nga të dy palët me vullnet të lirë, ndryshe çështja zgjidhet nga gjykata si dhe pasojat e tjera sociale e juridike, siç janë hakmarrja e gjakmarrja, si shprehje e vetëgjyqësisë, përçarjet e hasmëritë mes vetë palëve por dhe familjarëve të këtyre të fundit.

Në vitin 2003, me ligjin e ri për ndërmjetësimin nr. 9090, datë 26/06/2003 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e konflikteve”, ligjvënësi shqiptar ndërhyr në mënyrë radikale në legjislationin përkatës, duke shfuqizuar ligjin nr. 8465, datë 11.3.1999⁵. Në ndryshim me ligjin e mëparshëm, sa i përket fushës së zbatimit të ligjit, sipas parashikimeve të nenit 2, ndërmjetësimi zbatohet për zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve në fushën e së drejtës civile, tregtare, familjare dhe ato penale sipas neneve 59 e 284 të K.Pr.P. Siç shihet, ndryshe nga ligji i mëparshëm që i përcaktonte qartë e saktë fushat e mosmarrëveshjeve civile e familjare (nenet 10 e 11), ligji i ri parashikon zbatueshmërinë e procesit të ndërmjetësimit tek të gjitha llojet e mosmarrëveshjeve, përfshirë ato penale.

Sa i përket procesit ndërmjetësues për konfliktet në fushën penale, ligji i ri, nuk sjell ndonjë ndryshim parimor nga ligji i mëparshëm sa i takon llojeve të veprave penale për të cilat mund të bëhet ndërmjetësim. Sipas nenit 2 të ligjit nr. 9090, datë 26.6.2003, ndërmjetësimi krahas zgjidhjes së konflikteve familjare, pronësore, tregtare, zbatohet edhe për zgjidhjen e konflikteve penale, që shqyrtohen nga gjykata me kërkesën e të dëmtuarit akuzues ose me ankimin e personit të dëmtuar nga vepra penale, sipas neneve 59 e 284 të K.Pr.P. Përmbajtja e nenit 2 të ligjit nuk ka ndryshim nga neni 12 i ligjit të mëparshëm. Në bazë të nenit 59 të K.Pr.P, i dëmtuari akuzues që është dëmtuar ka të drejtë të paraqesë kërkesë për gjykim në gjykatë për veprat penale të parashikuara nga neni 90, 91, 92, 112 paragrafi i parë, 119, 119/b, 120, 121, 122, 125, 127, dhe 254 të K.P. Për këto vepra penale, veç të dëmtuarit akuzues, ka të drejtë të marrë pjesë në gjykimin e këtyre çështjeve edhe prokurori, i cili sipas rastit kërkon dënimin e të pandehurit ose pafajësinë e tij. Përpara se çështja të kalojë për gjykim, ankimi paraqitet në polici ose në prokurori. Këto organe, kanë detyrimin që, me pëlqimin e palëve në konflikt, t’ua dërgojnë çështjen për ndërmjetësim qendrave të ndërmjetësimit ose ndërmjetësuesve. Në bazë të nenit 284 të K.Pr.P, pala e dëmtuar ka të drejtë të paraqesë ankim për ndjekje penale dhe mund ta tërheqë atë në çdo fazë të procedimit e të kërkojë aktivizimin e procedurave ndërmjetësuese për veprat penale të parashikuara në nenin 84, 89, 102 paragrafi i parë, 105, 106, 130, 148, 149, 243, 254, 264, 275, 290 paragrafi i parë dhe 318 të K.P.

⁵ Neni 20 i ligjit Nr. 9090, datë 26.6.2003, sanksionon se: “Ligji nr. 8465, datë 11.3.1999 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve”, shfuqizohet”.

Në frymën e këtij ligji, në plan të parë synohet të arrihet parandalimi i konflikteve penale dhe rritja e vazhdueshme e cilësisë së procesit ndërmjetësues, në mënyrë që marrëveshja e arritur mes palëve në konflikt të jetë e qëndrueshme. Kjo kërkon një rritje të bashkëpunimit të qendrave të ndërmjetësimit e ndërmjetësuesve me organet e policisë së rendit e ato gjyqësore, si dhe me të gjithë operatorët e tjerë, si prokuroria, gjykata, pushteti vendor, që për shkak të detyrës që kryejnë, luajnë një rol të rëndësishëm në arritjen e qëllimeve të ligjit.

Së fundi, ligji nr. 10385, datë 24/02/2011 “*Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve*”, aktualisht në fuqi, ka ngritur në një shkallë më të lartë profesionale dhe organizative procesin e ndërmjetësimit të konflikteve e mosmarrëveshjeve jashtëgjyqësisht. Zbatimi i tij sjell efekte pozitive në shoqëri, pasi rrit atmosferën paqësore midis njerëzve dhe ul ndjeshëm volumin e punës në organet gjyqësore. Me ligjin nr. 10385, datë 24.2.2011, “*Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve*” janë hedhur hapa të rëndësishëm dhe është arritur në një stad më të avancuar. Instituti i ndërmjetësimit, në të drejtën tonë civile e penale, tashmë rregullohet në mënyrë të plotë me parashikimet dhe dispozitat e këtij ligji.

Një element i rëndësishëm i parashikuar nga ky ligj, është se ndërmjetësimi në proceset penale e civile nuk mund të fillojë e të realizohet në kundërshtim me vullnetin e palëve në konflikt, pavarësisht faktit nëse ky konflikt është kërkuar ose jo të zgjidhet në rrugë gjyqësore. Në nenin 2 të këtij ligji përcaktohet në mënyrë të detyrueshme, se për zgjidhjen e konflikteve me ndërmjetësim duhet detyrimisht që të kërkohej apo të shprehet vullneti i palëve në konflikt, për zgjidhjen me ndërmjetësim të këtij të fundit, pa iu drejtuar gjykatës për këtë qëllim. Në këtë dispozitë parashikohet gjithashtu se gjykata, apo organi përkatës shtetëror, mund të orientojë palët drejt procedurës së ndërmjetësimit edhe pas vënies në lëvizje për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, që do të thotë se gjykata, jo vetëm kur kjo kërkohej nga palët por edhe kryesisht mund të orientojë palët në konflikt drejt procesit ndërmjetësues.

Në parag. 2 dhe 3 përcaktohet fusha e veprimit të institutit të ndërmjetësimit, i cili vepron për zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve në fushën e së drejtës civile, tregtare, të punës dhe familjare, si dhe në fushën penale për mosmarrëveshjet që shqyrtohen nga gjykata me kërkesën e të dëmtuarit akuzues, ose me ankim të të dëmtuarit, sipas neneve 59 dhe 284 të K.Pr.P. Parashikimet e parag. 4 dhe 5 të nenit 2 të këtij ligji, në lidhje me detyrimin e organit shtetëror apo gjykatës për njoftimin e palëve për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me pajtim është në përputhje me parashikimet e bëra nga ligjvënësi në dispozitat procedurale penale dhe civile. Në këtë dispozitë ligjvënësi ka përjashtuar rastet të cilat nuk mund të kërkohej apo zgjidhen nëpërmjet ndërmjetësimit, sikurse janë paditë me karakter pasuror në shumën mbi 500.000 lekë apo në rastet e konflikteve të cilat nuk mund të zgjidhen me ndërmjetësim. Pika nr. 5 e nenit nr. 2 të ligjit, detyron Gjykatën që në rastet e mosmarrëveshjeve në fushën penale, për rastet e parashikuara nga pika 3 e të njëjtin nen, të ndërpresë hetimin gjyqësor dhe të ftojë palët t’i drejtohen zgjidhjes së konfliktit me ndërmjetësim.

Një karakteristikë e parashikuar në këtë ligj është rasti i mosmarrëveshjeve në fushën penale, për të cilat kur procesi penal ka nisur, gjykata detyrimisht fton palët për zgjidhjen me ndërmjetësim të mosmarrëveshjeve, si dhe fakti se mosmarrëveshjet për të cilat është e detyrueshme zgjidhja në rrugë gjyqësore nuk mund të zgjidhen me ndërmjetësim. Ky sanksionim i fundit, limiton fushën e veprimit të ndërmjetësuesve, për rrjedhojë edhe të palëve në lidhje me konfliktet objekt mosmarrëveshjeje, duke përjashtuar kategorikisht mosmarrëveshjet për të cilat e vetmja mundësi zgjidhjeje është procesi gjyqësor.

Ekspierienca e vendeve me legjislacion më të përparuar, e për rrjedhojë me një mentalitet shumë më të hapur referuar individëve që përbëjnë komunitetin, ka treguar se ky është një limit që mund të tejkalohet, por që ka nevojë për një sensibilizim dhe ndërgjegjësim shumë të lartë të individit, pjesë e komunitetit. Në një vend si Shqipëria, është e domosdoshme të përcaktohet me ligj një kufizim i fushës së veprimit të ndërmjetësimit dhe ndërmjetësuesit, pasi në rast të kundërt, nga një instrument që priret të favorizojë viktimën e veprës penale, do ta vinte këtë të fundit përballë presioneve të forta që vijnë nga ana e autorit apo të afërmëve të tij, që do të kërkonin me çdo kusht pjesëmarrjen e viktimës në ndërmjetësim, me qëllim që të përfitonte nga lehtësirat që parashikon pjesëmarrja në këtë proces edhe për vepra penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore.

Në nenin 14 rregullohet procedura për ndërmjetësim në procesin penal, dispozitë ku parashikohet shprehimisht detyrimi i gjykatës që për çështjet penale objekt gjykimi dhe për veprat penale të përkufizuara nga nenet 59 dhe 284 të K.Pr. Penale, në përputhje me nenet 33 dhe 338 të K.Pr.P., ti kërkojë palëve zgjidhjen e konfliktit me ndërmjetësim, duke caktuar edhe një afat të arsyeshëm për zhvillimin e këtyre procedurave. Nën këtë këndvështrim, në procesin e ndërmjetësimit të konflikteve penale, mund të afirmojmë faktin se në ligj është respektuar parimi i lirisë dhe vullnetit të palëve, duke i lënë subjekteve të përfshira në konflikt lirinë e zgjedhjes së mënyrës që më shumë i përshtatet rastit konkret dhe karakteristikave të subjekteve të përfshira në të, me qëllimin e vetëm të arritjes së zgjedhjes jashtë-gjyqësisht të konfliktit që i ndan. Respektimi i këtyre parimeve të rëndësishme, është parashikuar edhe nga neni 15 i këtij ligji, i cili i njej gjithashtu palëve të drejtën për të përcaktuar rregullat dhe mënyrën e realizimit të ndërmjetësimit, si dhe caktimin – zgjedhjen - e një apo disa ndërmjetësuesve nga Regjistri i Ndërmjetësuesve pranë Ministrisë së Drejtësisë, zgjedhje që i lihet vullnetit të lirë të palëve.

Nga analiza e këtyre tre ligjeve arrijmë në konkluzionin se, siç mund të konstatohet lehtë, në dispozitat përkatëse, vetëm një vend i vogël i kushtohet ndërmjetësimit në fushën penale dhe thuhet asnjë element që të lidhë apo t'i kushtohet ndërmjetësimit për të miturit, autor apo viktimë qoftë. Kjo është pasqyrë e qartë dhe shprehje e drejtpërdrejtë e kulturës që procesi i ndërmjetësimit mbart në vetvete, një kulturë e cila konstaton, pranon dhe tenton të zgjidhë konfliktin brenda vetë komunitetit shoqëror nga ku ka dhe origjinën. Sa më lart, dalim lehtë në konkluzionin se në Shqipëri, rruga drejt kulturës së ndërmjetësimit në përgjithësi dhe të atij penal në veçanti, duhet ende të kultivohet në mendjet e qytetarëve të këtij vendi.

3. Ligji nr.37/2017 “Kodi i drejtësisë penale për të mitur”, risia e fundit e sistemit të drejtësisë penale për të miturit

Ligji në fjalë është miratuar më 30.03.2017 dhe hyn në fuqi më 1 janar 2018.

Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës, integrimi social i tyre, rehabilitimi i fëmijëve në konflikt me ligjin, mbrojtja e të drejtave të fëmijëve dëshmitar dhe viktimë, parandalimi i viktimizimit të dytë ose ri-viktimizimit, parandalimi në kryerjen e veprës penale dhe sigurimi i rendit publik gjatë administrimit të drejtësisë.

Numri i fëmijëve në konflikt me ligjin në Shqipëri ka ardhur në rritje. Një nga treguesit është pikërisht rritja e numrit të përsëritësve. Në një analizë të shkaqeve kryesore që i çon fëmijët në konflikt me ligjin padyshim është mungesa e masave social-ekonomike në drejtim të familjeve, por gjithashtu mungesa e një sistemi referimi kombëtar dhe lokal ka sjellë një situatë të tillë aq problematike. Në sistemin tonë të drejtësisë dhe atë social fëmijët në konflikt me ligjin janë vulnerabel.

Nëpërmjet këtij ligji garantohet një qasje e plotë e drejtësisë miqësore për fëmijët. Drejtësia miqësore për fëmijët nënkupton garantimin e respektit dhe efektivitetin e zbatimit të të gjithë të drejtave të fëmijëve, në nivelin më të lartë të arritshëm, në sistemet e drejtësisë së një vendi. Për këtë, në veçanti, kërkohet që drejtësia të jetë e aksesueshme, e përshtatur sipas moshave, e shpejtë, e fokusuar në nevojat dhe të drejtat e fëmijëve. Kjo përfshin të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të drejtën për pjesëmarrje dhe për të kuptuar procedurat, të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, si dhe të integritetit dhe dinjitetit. Drejtësia miqësore për fëmijët ka në thelb të saj garantimin e respektit dhe efektivitetin e zbatimit të të gjithë të drejtave të fëmijëve, në nivelin maksimal të mundshëm.

Kodi i Drejtësisë për të Mitur parashikon norma specifike procedurale për organet përgjegjëse gjatë procedurës së administrimit të drejtësisë; norma specifike procedurale që duhet të respektohen në proceset penale që afektojnë fëmijët si dhe rregulla të posaçme për ekzekutimin e vendimeve dhe masave të tjera. Ky Kodi garanton që sistemi penal në Shqipëri të shikohet në mënyrë integrale dhe multidisiplinore. Shërbimet sociale, arsimore, policia e shtetit, shërbimi i proves, e prokuroria duhet të bashkëpunojnë jo vetëm në parandalimin, por edhe në përcaktimin e masave restauruese më të përshtatshme për fëmijët në konflikt me ligjin dhe sidomos për rehabilitimin e tyre.

Në Kod parashikohen:

- Parimet e përgjithshme të drejtësisë për fëmijët si: interesi më i lartë i fëmijës; mosdiskriminimi; proporcionaliteti; heqja e lirisë si alternativë e fundit e dënimit, e drejta e pjesëmarrjes së fëmijës; afati i përfundimit të procedurës; e drejta e privatësisë; të drejtat procedurale;

- Subjektet në procedurën e drejtësisë për fëmijët, kualifikimi, gjykimi i çështjeve, specializimi i tyre;

- Fëmijët viktimë dhe dëshmitarë, masa për mbrojtjen e fëmijëve dëshmitarë,

e drejta e kompensimit në rast të shkakimit të dëmit dhe e drejta për të kundërshtuar masën e kompensimit;

- Rregulla të përgjithshme materiale dhe procedurale për drejtësinë për fëmijë; parashikimi i moshës së fëmijëve që janë objekt i ligjit; raporti individual i vlerësimit; mbrojtja e fëmijës; e drejta për përkthyes dhe asistencë; ndarja e çështjes së të miturit nga çështja e të rriturve ;kufizimet në përdorimin e forcës dhe mjeteve special (të posaçme); përjashtimi nga përgjegjësia penale dhe procedurat paragjyqësore; alternativat; masat parandaluese; masat e drejtësisë restauruese; arrestimi, hetimi dhe ndjekja penale; procesi gjyqësor; vendimet e dënimit për fëmijën, qellimi dhe llojet e tyre; ekzekutimi i vendimit; dënimi me heqje lirie dhe kujdesi për fëmijën pas vendimit dhe vendimet me kusht.

Interesi më i lartë i fëmijës është një parim i rëndësishëm i cili duhet të gjejë zbatim pikësëpari në të drejtën penale. Të miturit në sistemin e drejtësisë penale përbëjnë një kategori vulnerabel ndaj edhe mbrojtja e tyre përbën një ndër objektivat strategjike më të rëndësishme të reformës në sistemin e drejtësisë penale.

Kodi për të miturit është në përputhje të plotë me dokumentet e miratuara në kuadër të procesit të Reformës në Drejtësi, Strategjia dhe Plani i Veprimit. Në këto akte është parashikuar në mënyrë të qartë rikonceptimi i sistemit të trajtimit dhe rehabilitimit të të miturve që nuk kanë arritur moshën për përgjegjësi penale dhe që kryejnë një veper penale duke ngritur dhe venë në funksionim struktura të posaçme shtetërore për trajtimin dhe integrimin e tyre në shoqëri. Në analizë të këtyre akteve veçojmë një prej objektivave kryesore dhe pikërisht ***Reformimin e sistemit të drejtësisë për të miturit në konflikt me ligjin duke forcuar sistemin e drejtësisë restauruese dhe mbrojtjen efektive të të drejtave të tyre procedurale.***

Duke i përmbledhur parimet dhe standardet, të konkretizuara në veprime konkrete procedurale dhe administrative, të shprehura nëpërmjet dispozitave përkatëse në një akt të vetëm, siç është Kodi i Drejtësisë për të Mitur, vemendja e punonjësve dhe e subjekteve procedurale që trajtojnë të miturit do të jetë më e përqëndruar, idetë do të jenë më të qarta, trajtimi do të jetë më i përshtatshëm dhe miqësor, ndërsa gabimet apo shkeljet do të minimizohen.

Ky Kod në tërësinë e tij është risi për sistemin e drejtësisë penale pasi parashikon institute, rregulla, procedura të reja në drejtësinë penale ku ndër to, parashikimi i shmangies nga ndjekja penale të të miturit në konflikt me ligjin është ndër risitë. Zbatimi i shmangies nga prokurorët në hetimet paraprake, gjyqtarët në procesin e gjykimit sipas procedurës së parashikuar do të ketë inpakt pozitiv së pari për të miturit në konflikt me ligjin ndaj të cilëve do të zbatohet duke i përjashtuar nga ndjekja penale dhe caktuar ndaj tyre masa të tjera alternative po që nuk konsiderohen dënime, së dyti do të lehtësoj punën e prokurorëve me qëllim fokusimin e tyre në hetimin e çështjeve penale të vështira dhe komplekse.

Përsa i përket drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit, Kodi i Drejtësisë për të mitur parashikon, konkretisht në nenet 63 dhe 64, si më poshtë vijon:

Neni 63

Programet e drejtësisë restauruese dhe/ose ndërmjetësimi

1. Organi procedues vendos për zbatimin e programit të drejtësisë restauruese, në përputhje me legjislacionin për ndërmjetësimin, me qëllim krijimin e mundësive për të miturin që të korrigjojë pasojat e veprës penale të kryer prej tij ndaj viktimës, komunitetit dhe/ose shoqërisë.

2. Programi i drejtësisë restauruese, sipas pikës 1, të këtij neni, mund të zbatohet nëse:

a) i mituri, mbrojtësi dhe, sipas rastit, përfaqësuesi ligjor, japin lirisht pëlqimin për marrjen e një vendimi të tillë; dhe

b) çdo marrëveshje për korrigjimin e pasojave të veprës penale të kryer nga i mituri është e arsyeshme ose e përshtatshme.

3. Kur i mituri nuk ka prindër, ose ekziston një konflikt interesi midis prindërve dhe të miturit, pëlqimin, sipas pikës 2, shkronja "a", të këtij neni, mund ta japë një prej përfaqësuesve proceduralë, sipas parashikimeve të nenit 3, pika 17, të këtij Kodi.

4. Programi i drejtësisë restauruese, i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, mund të parashikojë që të miturit t'i kërkohej:

a) të pranojë dhe të tregojë se e kupton përgjegjësinë për veprën penale dhe të pasojës së ardhur ndaj viktimës;

b) të kompensojë dëmin e shkaktuar viktimës, komunitetit dhe/ose shoqërisë;

c) t'i kërkojë falje viktimës; dhe

ç) të ndërmarrë veprime të pranueshme edhe nga viktimia ose/dhe komuniteti.

5. Masat e drejtësisë restauruese, të marra në përputhje me parashikimet e këtij neni, mund të përfshijnë pjesëmarrjen në një program të shmangies dhe ndërmjetësimit, të punës në interes publik dhe/ose çdo program tjetër që çon në rehabilitimin e pasojave të veprës penale të kryer nga një i mitur.

6. Ndërmjetësimi familjar dhe në grup është një masë alternative për shmangien e ndjekjes penale, ku marrin pjesë bashkërisht me viktimën dhe të miturin në konflikt me ligjin, edhe të afërmit e tyre, persona nga rrethi i tyre shoqëror, përfaqësues nga agjenci publike për mbrojtjen e të miturve, mbikëqyrjen e tyre dhe parandalimin e kriminalitetit për të miturit. Në këtë proces i akuzuari dhe familja e tij pritet të arrijnë një marrëveshje me viktimën, e cila përfshin kompensimin e dëmit, kryerjen e detyrimeve që janë të pranueshme prej viktimës dhe që pritet të mbajnë të akuzuarin larg situatave konfliktuale të ngjashme në të ardhmen.

Neni 64

Procedura e ndërmjetësimit

1. Ndërmjetësimi si procedurë jashtëgjyqësore zhvillohet nga ndërmjetësi sipas dispozitave të këtij Kodi dhe ligjit në fuqi për ndërmjetësimin.

2. Ndërmjetësimi mund të zhvillohet vetëm nëse ekziston pëlqimin i lirë për ndërmjetësimin i shprehur si nga i të miturit i akuzuar i veprës penale dhe palës së dëmtuar. Dhënia e pëlqimit duhet të shënohet në procesverbalin e organit procedues.

3. Ndërmjetësimi mund të zhvillohet vetëm me pjesëmarrjen personale të të miturit autor i veprës penale dhe palës së dëmtuar.

4. Në procesin e ndërmjetëimit, me pëlqimin e palëve, mund marrin pjesë gjithashtu përfaqësuesi ligjor i të miturit, psikologu, punonjësi i Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, prokurori dhe/ose personat e tjerë të caktuar prej tij. Prokurori mund të marrë pjesë në procesin e ndërmjetëimit nëse ai e vlerëson.

5. Ndërmjetësimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, sipas rastit, mund të zbatohet edhe si masë shmangieje por edhe si një mundësi që çon në përmirësimin e marrëdhënieve midis të miturit autor dhe viktimës së veprës penale.

6. Prokurori gjatë hetimit dhe gjyqtari gjatë gjykimit, sipas rastit, mund të propozojnë ndërmjetësimin nëse vlerësojnë se kjo alternativë është më e përshtatshme, duke pasur parasysh natyrën e veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, historinë e të miturit, mundësinë e kthimit të raporteve normale mes të miturit dhe palës së dëmtuar, mundësinë e zvogëlimit të dëmit të palës së dëmtuar, mundësinë e rehabilitimit të të miturit dhe riintegrimin e tij në shoqëri.

7. Në rast se propozimi i prokurorit/gjyqtarit për ndërmjetësim pranohet nga palët, atëherë prokurori/gjyqtari vendos pezullimin e procesit penal për një afat jo më shumë se 45 ditë. Nëse marrëveshja e ndërmjetëimit arrihet prokurori/gjyqtari vendos pushimin e çështjes. Nëse marrëveshja e ndërmjetëimit nuk arrihet me kalimin e 45 ditëve, pezullimi bie dhe vazhdon hetimi/gjykimi i çështjes.

8. Shpenzimet e procedurës së ndërmjetëimit bëhen sipas legjislacionit në fuqi.

Siç shihet qartë në këto dy dispozita, nisur nga interesi më i lartë i të miturit, me qëllim krijimin e mundësive për të miturin që të korrigjojë pasojat e veprës penale të kryer ndaj viktimës, komuniteti ose shoqërisë, organi procedues parashikon zbatimin e programit të drejtësisë restauruese në përputhje me legjislacionin për ndërmjetësimin.

Programi i drejtësisë restauruese mund të zbatohet nëse: i mituri, mbrojtësi dhe, sipas rastit, përfaqësuesi ligjor, japin lirisht pëlqimin për marrjen e një vendimi të tillë si dhe çdo marrëveshje për korrigjimin e pasojave të veprës penale të kryer nga i mituri është e arsyeshme ose e përshtatshme.

Gjithashtu, programi i drejtësisë restauruese, mund të parashikojë që të miturit t'i kërkohet: të pranojë dhe të tregojë se e kupton përgjegjësinë për veprën penale dhe të pasojës së ardhur ndaj viktimës, të kompensojë dëmin e shkaktuar viktimës, komunitetit dhe/ose shoqërisë, t'i kërkojë falje viktimës dhe të ndërmarrë veprime të pranueshme edhe nga viktimat ose/dhe komuniteti.

Edhe kodi, ashtu sikurse ligji për ndërmjetësimin, parashikojnë së ndërmjetësimi mund të zhvillohet vetëm nëse ekziston pëlqimin i lirë për ndërmjetësim i shprehur si nga i të miturit i akuzuar i veprës penale dhe palës së dëmtuar. Dhënia e pëlqimit duhet të shënohet në procesverbalin e organit procedues. Prokurori gjatë hetimit dhe gjyqtari gjatë gjykimit, sipas rastit, mund të propozojnë ndërmjetësimin nëse

vlerësojnë se kjo alternativë është më e përshtatshme, duke pasur parasysh natyrën e veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, historinë e të miturit, mundësinë e kthimit të raporteve normale mes të miturit dhe palës së dëmtuar, mundësinë e zvogëlimit të dëmit të palës së dëmtuar, mundësinë e rehabilitimit të të miturit dhe riintegrimin e tij në shoqëri.

Ky legjislacion revolucionar, përbën një ndryshim madhor në konceptim, duke u zhvendosur nga një qasje ndëshkuese drejt asaj rehabilituese dhe restauruese, për trajtimin e përfshirjes së të miturve në veprat penale.

Nuk na mbetet gjë tjetër vetëm të presim zbatimin e tij në praktikë, zbatim ky i cili do të ndikojë ndjeshëm në rehabilitimin e të miturve që kryejnë vepra penale.

BIBLIOGRAFIA

Castelli S. - “La mediazione, teorie e tecniche”, Milano, 1996;

Centomani G., Ghera B. - “Conflitto, reato e riconciliazione”, në “Esperienze di Giustizia Minorile”, nr. 2, 1991, fq. 52;

Conso G., Grevi V., Neppi Modona G. - “Il nuovo codice di procedura penale, dalle leggi delega ai decreti delegati”, Vol. VII^o, “Il processo penale a carico di imputati minorenni, Padova, 1990;

Abrate M. - Artikull në internet, “La mediazione nell’ambito minorile”. Ueb: ëëë.serviziosociale.com/mediaz.htm - Milano, 06/11/1998;

Bruno Z., Armocida G. - “La vittima nella storia”. Nën kurën e G. Ponti, “Tutela della vittima e mediazione penale”, Milano, 1995, fq. 11;

Bouchard M. - “La mediazione: una terza via per la giustizia penale”, tek “Questione giustizia”, 1992, fq. 757-783;

Castelli S. - “La mediazione, teorie e tecniche”, Milano, 1996;

Cerretti A. - “La mediazione penale”, 46^o Kongres i Juristëve Katolikë Italianë i mbajtur në Romë në datat 6-8/12/1997, në Iustitia, Roma, 1997 nga faqe 376 në faqe 398;

Cerretti A. - “Progetto per un ufficio di mediazione penale presso il Tribunale per i minori di Milano”, në La sfida della mediazione penale, nën kurën e G.U. Pisapia, 1997, nga faqe 85 në faqen 99;

Fiandaca G., Musco E. - “diritto penale. Parte speciale”, Bologna, 1995;

Gatti U., Marugo I.M. - “La vittima e la giustizia riparativa”, nën kurën e G. Ponti, Tutela della vittima e mediazione penale, Milano, 1995;

Lanza L. - “La tutela della vittima nel sistema penale italiano”, nën kurën e G. Ponti, Tutela della vittima e mediazione penale, Milano, 1995;

Losana C. - “Commento agli articoli 28 e 29 D.P.R. 448/88”, në Commento al Codice di Procedura Penale, leggi collegate, Vol. I^o, Il processo minorile, Chiavaro M., Torino, 1994;

Martucci P. - “La conciliazione con la vittima nel processo minorile”, nën kurën e G. Ponti, Tutela della vittima e mediazione penale, Milano, 1995;

Palomba F. - “Il sistema del nuovo processo penale minorile”, con il contributo di Vassalli G., Milano, 1991;

Ponti G. - “Tutela della vittima e mediazione penale”, Milano, 1995;

Spirito D. - “Principi ed istituti del diritto penale nel nuovo processo penale a carico di minori”, në Giustizia Penale, pjesa e III-të, Roma, 1990;

Komentar i Ligjit “PËR NDËRMJETËSIMIN NË ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE” Nr. 10835, datë 24.02.2011, Tiranë, 2012;

Ligji Nr. 7905, datë 21.3.1995 “KODI I PROCEDURËS PENALE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”;

Prof. Dr. Ismet ELEZI, në “NDËRMJETËSIMI PËR PAJTIM NË KONFLIKTET PENALE”, Tiranë, 2004.

Ligji nr. 8465, datë 11/03/1999 “Për zgjidhjen e konflikteve dhe pajtimin e mosmarrëveshjeve”;

Ligji nr. 9090, datë 26/06/2003 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e konflikteve”;

Ligji nr. 10385, datë 24/02/2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”;

Prof.Dr. Ismet ELEZI - Zgjidhja e konflikteve penale dhe eksperiencia shqiptare; Ndërmjetësimi Prill 2004;

Prof. Asoc. Dr. Qazim DUSHKU, artikull studimor me temë: “Roli i tolerancës në trajtimin dhe zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve në shkollë përmes ndërmjetësimit”, botuar në revistën gjashtëmujore sociologjike, juridike dhe kulturore Ndërmjetësimi, Nr. 1 (28), i vitit 2008 – botim i Fondacionit “Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrveshjeve”;

Prof. Asoc. Dr. Qazim DUSHKU, artikull studimor me temë: “Adoleshentët në rrugëtimin e gjatë të konflikteve”, botuar në revistën gjashtëmujore sociologjike, juridike dhe kulturore Ndërmjetësimi, Nr. 2 (27), i vitit 2007 – botim i Fondacionit “Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrveshjeve”;

Komentar i ligjit nr. 10385, datë 24/02/2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” - Botim i vitit 2012, përgatitur nga një grup ekspertësh të fushës, nën koordinimin e Fondacionit “Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve” dhe Shkollës së Magjistraturës, me mbështetjen e UNICEF-it dhe IFC-së;

KONVENTA MBI TË DREJTAT E FËMIJËS, Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989;

REKOMANDIMI NR. R (99) 19 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare në lidhje me ndërmjetësimin në çështjet penale (Miratuar nga Komiteti i Ministrave në datë 15 shtator 1999 në takimin e 697-të të zëvendësministrave);

www.camera.it

www.giustizia.it

www.parlamenti.al

www.asistentisociale.org

E DREJTA PËR T’U MBROJTUR ME AVOKAT NË PROCESIN PENAL

Av. Eris MILOVA MA¹

ABSTRAKT

E drejta për t’u mbrojtur me avokat në procesin penal është pjesë e nje procesi të rregullt ligjor, por është ligji procedural e material dhe gjykatat e zakonshme, mekanizmat të cilat e jetësojnë në praktikë këtë parim të rëndësishëm Kushtetues.

Fusha e studimit

Në këtë punim do pasqyrohet rëndësia e mbrojtjes me avokat në procesin penal si garanci Kushtetuese për një proces të rregullt ligjor duke u gërshetuar me analizimin e jurisprudences së gjërë të GJEDNJ, Gjykatës Kushtetuese dhe Vendimeve Unifikuese të Gjykatës së Lartë.

Studimi synon analizimin teorik të problemeve duke e pasqyruar me zgjidhje konkrete nga gjykatat.

Trajtimi i temës

Kryesisht në procesin penale drejta për tu mbrojtur vetë ose me avokat është thelbësore për të sigurua të drejtat e mbrojtjes që ka ose që duhet të ketë personi i dyshuar për kryerjen e një veprë penale po ashtu dhe për mbrojtjen e të pandehurit që i është komunikuar akuza penale. Jurisprudenca e pasur e GJEDNJ e Gjykatës Kushtetuese dhe Vendimeve Unifikuese të Gjykatës së Lartë kanë krijuar një praktikë të konsoliduar mbi qëndrimin që duhet të mbajnë gjykatat e zakonshme për të siguruar zbatimin sa më efektiv të së drejtës për tu mbrojtur me avokat në cdo fazë të procesit penal që nga momenti i ndalimit, i caktimit si person nën hetim si dhe me përcaktimin e statusit si i pandehur.

Punimi do të ndahet në dy shtylla kryesore, së pari në rrafshin e teorisë dhe së dyti në rrafshin e praktikës gjyqësore.

KONKLUZION

E drejta për t’u mbrojtur me avokat në procesin penal ka një praktik të konsoliduar në jurisprudencën e gjykatave tona. Parimisht kjo e drejta është e garantuar duke marrë edhe rastin kur i pandehuri nuk ka mundësi të zgjedhë vetë një mbrojtës.

Keywords: proces penal, avokat, gjykatë, e drejta

¹ Avokat në zyrën e avokatisë Albania Debt Collection Agency, erismilova84@gmail.com

HYRJE

Procesi i rregullt ligjor është njëparim i rëndësishëm kushtetutes për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Qëllimi i tij është të krijojë balancat midis mbrojtjes së të drejtave të individit nga veprimet e kunderligjshme të autoriteve shtetore. Ky parim është sanksionuar në Kushtetutën e Shqipërisë dhe është pjesë përbërëse e Konventës Europiane e të Drejtave të Njeriut. Në përputhje me frymën e Konventës dhe Kushtetutës ky parim është përthithur dhe nga Kodi i Procedurës Penale si rregullatori i gjithë procesit penal. E drejta për t'u mbrojtur vetë, ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij dhe, në qoftë se s'ka mjete për të shpërblyer një mbrojtës, të asistohet falas nga një avokat i caktuar nga gjykata, kur e kërkojnë interesat e drejtësisë², është pjesë e një procesi të rregullt ligjor.

E drejta për tu mbrojtur nga avokati përfshin të drejtën për njoftimin e gëzimit të së drejtës për avokat, të drejtën për tu takuar dhe zhvilluar komunikime konfidenciale me të, si dhe të drejtën për ndihmë nga avokati i zgjedhur prej tij ose i caktuar për ta mbrojtur atë. Duhet që ky njoftim t'i japi kohën e nevojshme për të përgatitur mbrojtjen. Kushdo që do të zhvillojë një gjykim penal i duhet bërë me dije se gëzon të drejtën për tu mbrojtur me avokat. Kjo e drejtë zbatohet si në rastet e arrestimit, ndalimit, hetimeve paraprake, si për personin nën hetim, të pandehurin kur del ose jo përpara gjyqit. E drejta për kohë dhe lehtësi në përgatitjen e mbrojtjes i garantohet si të akuzuarit dhe avokatit të tij në çdo fazë të procedimit penal.

1. Këndvështrimi sipas legjislacionit të brendshëm

Në këndvështrimin e së drejtës së brendshme dhe mekanizmave kushtetues dhe ligjor për mbrojtjen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor e për më tepër të së drejtës për tu mbrojtur me avokat, jurisprudenca e gjykatës Kushtetuese është thelbësore. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nënenin 31/ç parashikon se “kushdo gjatë procesit penal ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme.” Kjo në funksion të nenit 42 të Kushtetutës “Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.”

Kodi i procedurës penale si korpusi ligjor që rregullon procesin penal në të gjithë komponentët e tij nën dritën e Konventës dhe Kushtetutës përcakton rregullat e të drejtës për tu mbrojtur. Neni 6 i kodit “i pandehuri ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e mbrojtësit. Kur nuk ka mjete të mjaftueshme i sigurohet mbrojtja

²Neni 6. 3/c I KEDNJ

falas me avokat.”Mbrojtësi ndihmon të pandehurin që t’i garantohen të drejtat procedurale dhe t’i ruhen interesat e tij. Për shkak të rëndësisëqë ka besimi dhe koinfidenca midis të akuzuarit dhe avokatit, është e rëndësishme që ai ta zgjedhi vetë avokatin që do ta përfaqësojë.

NëKreun IV të K.Pr.Penale, përcaktohen si subjekt të procedimit penal të pandehurin dhe në kreun V, mbrojtësin e të pandehurit. Kodi njuh si subjekte procedurale të pandehurin, personin nën hetim dhe personit të cilit i atribuohet vepra penale. Me shumë rëndësi për tu theksuar është se ndryshimet e realizuara në K.Pr.Penale kanë rritur standartet e mbrojtjes dhe garancisë për tëpandehurin dhe mbrojtësin e tij. Nenet 34/a dhe 34/b, të shtuar me ndryshimet e Kodit me ligjin nr. 35/2017, përcaktojnë të drejtat për të pandehurin, personin nën hetim, për personin e arrestuar ose tëndaluar. Thelbi i këtyre të drejtave i siguron këto subjekte për një proces të rregullt ligjor;

a) të njoftohet në një kohë sa më të shkurtër, në gjuhën që kupton, për veprën penale për të cilën hetohet, si edhe për shkaqet e akuzave;

b) të përdorë gjuhën që flet ose kupton ose të përdorë gjuhën e shenjave, si dhe të ndihmohet nga një përkthyes dhe interpretues nëse ka paaftësi të kufizuar në të folur dhe në të dëgjuar;

c) të heshtë, të paraqesë lirisht mbrojtjen e tij, si dhe të mos u përgjigjet pyetjeve të caktuara;

ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur prej tij;

d) të ketë një mbrojtës të siguar nga shteti, nëse mbrojtja është e detyrueshme ose nuk ka mundësi financiare për të pasur një mbrojtës, sipas parashikimeve të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi për ndihmë juridike;

dh) të takohet privatisht dhe të komunikojë me mbrojtësin që e përfaqëson;

e) të ketë kohë të mjaftueshme dhe lehtësi për të përgatitur mbrojtjen;

ë) të njihet me materialet e çështjes, sipas parashikimeve të këtij Kodi;

f) të paraqesë prova që i shërbejnë mbrojtjes së tij; g) t’u bëjë pyetje dëshmitarëve, ekspertëve dhe të pandehurve të tjerë gjatë gjykimit³;

Këto të drejta i sigurohen dhe personit të arrestuar ose ndaluar të cilit i sigurohet gjithashtu a) të takojë vetëm për vetëm mbrojtësin e tij përpara marrjes në pyetje për herë të parë; b) të njihet me aktet, provat e nevojshme dhe arsyet e arrestimit ose ndalimit të tij; c) të kërkojë që një anëtar i familjes ose një person tjetër i afërt të njoftohet menjëherë për arrestimin e tij. Në rast se i arrestuari ose i ndaluari është shtetas i huaj, ai ka të drejtë të kërkojë të njoftohet përfaqësia konsulllore ose diplomatike e vendit të tij⁴.

Me qëllim që të sigurohet realizimi i të drejtës për mbrojtje, cilido i akuzuar për veprën penale dhe avokati i, nëse ka, duhet të kenë në dispozicion kohën dhe lehtësinë e nevojshme për të përgatitur mbrojtjen. E drejta për kohë dhe lehtësi të

³ Neni 34/a I Kodit të Procedurës Penale

⁴ Neni 34/b I Kodit të procedurës Penale

mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen përdoret njëlloj si për të akuzuarin dhe për avokatin e tij në të gjitha fazat e procedimit, përfshirë kohën përpara gjykimin dhe gjatë fazës së ankimit të vendimit. Garantimi që një person i ndaluar ka mundësinë të marrë një avokat është siguri e rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave të tij dhe mundësi për realizimin e mbrojtjes sa më profesionale.

Kodi i nje dhe mbrojtjen e detyrueshme si mjetin e nevojshëm për të garantuar të drejtat për këta persona: është nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç; nuk dëgjon dhe nuk flet; c) është me aftësi të kufizuara, që e pengojnë për të realizuar vetë të drejtën e mbrojtjes; është akuzuar për një veprë penale, për të cilën ligji parashikon dënim në maksimum jo më pak se 15 vjet me burgim; akuzohet për një veprë penale, krim i organizuar; është deklaruar i ikur ose në mungesë, me vendim gjykate; merret në pyetje personi i arrestuar ose i ndaluar; për kontroll të vendeve, marrja e të dhënave ndaj personit nën hetim; në çdo rast tjetër të parashikuar nga ligji.

Sipas përcaktimeve të Kodit i pandehuri ka të drejtë ta zgjedhë vetë avokatin, ai ka të drejtë që të marrë deri në dy të tillë. Kur i pandehuri nuk ka mundësi financiare atëherë i caktohet një avokat nga shteti. Një avokat mund të ketë disa të pandehur në një gjykim por me kushtin që most ë ketë kontradikta midis mbrojtjes së tyre. Mbrojtësi ka të drejtë të caktojë një zëvendësues kur ka shkaqe që pengojnë kryerjen e detyrës. Zëvendësuesi merr përsipër detyrimet e mbrojtësit. Mbrojtësi ka të drejtat që ligji i nje të pandehurit, përveç atyre që i rezervohen personalisht këtij të fundit. Mbrojtësi ka të drejtë të komunikojë lirisht dhe vetëm për vetëm me të ndaluarin, të arrestuarin apo të dënuarin, të njoftohet paraprakisht për kryerjen e veprimeve hetimore ku është i pranishëm i pandehuri dhe të marrë pjesë në to, t'u drejtojë pyetje të pandehurit, dëshmitarëve dhe ekspertëve, të njihet me të gjithë materialin e çështjes në përfundim të hetimeve. I pandehuri mund të zhvleftësojë, me deklaram të shprehur, veprimin e kryer nga mbrojtësi para se të jetë marrë një vendim nga gjykata lidhur me këtë veprim. Avokati ka të drejtë të njihet me të gjitha provat e grumbulluara në përfundim të hetimit dhe të parashtrijë pretendimet për to. Avokati gjithashtu është i garantuar nga çdo ndërhyrje e paligjshme duke pasur garanci të vecanta për ruajtjen e komunikimeve dhe zyrës së tij⁵.

2. Këndvështrimi sipas praktikës së GJEDNJ

Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut është udhëzuesi kryesor për funksionimin e një shoqërie demokratike, “në një shoqëri demokratike, në kuptim të Konventës, e drejta për një process të rregullt gjyqësor zë një vend kaq të rëndësishëm, saqë çfarëdo interpretim i ngushtë i nenit 6, par 1 nuk do ti përgjigjej as qëllimit dhe as karakterit të këtij ligji.”⁶ Gjykata theksoi se neni 6 është pasqyrim i një parimi të rëndësishëm, që shtrihet në themelet e Konventës Europiane të

⁵ Kapitulli V I Kodit të Procedurave Penale

⁶ Vendimi “Delcourt vs Belgjik 1968,

drejtave të njeriut dhe përkatësisht, parimit të rendit ligjor⁷.

GJEDNJ ka përcaktuar konceptin e “akuzë penale” duke bërë një interpretim të gjerë të këtij termi, duke venë në zbatim tre kriteret për të përcaktuar nëse një çështje e caktuar merret në shqyrtim nga ky nen: klasifikimi ligjor vendas i akuzës, natyra e akuzës dhe shkallës së rëndësisë së saj për të marrë dënimin e mundshëm⁸. GJEDNJ ka theksuar se, ndërsa neni 6/3 c) i KEDNJ i jep të drejtën çdokujt që është akuzuar për një veprë penale “të mbrohet vetë ose nëpërmjet një mbrojtësi”, nuk specifikon mënyrën e ushtrimit të kësaj të drejte. Konventa i’u le shteteve anëtare të bëjnë zgjedhjen e mjeteve që do të mund të sigurojnë brenda sistemit të tyre gjyqësor të drejtën e mbrojtjes. Detyra e GJEDNJ konsiston vetëm në kontrollin që ajo ushtron për të verifikuar nëse metoda që ata kanë zgjedhur është e pajtueshme ose jo me kërkesat e gjykimit të drejtë⁹.

Konventa përcakton *mbrojtjen vetë* ndaj akuzave penale por thelbësore është që kjo mbrojtje të jetë praktike dhe efektive. Mbi këtë bazë, ajo ka konkluduar në mjaft raste se trajtimi nga gjykata respektive jo i problemeve të faktit, por vetëm i problemeve ligjore, jo vetëm që justifikon plotësisht përfaqësimin me avokat, por për më tepër është e domosdoshme për garantimin e një mbrojtje efektive dhe të dobishme, gjithnjë në favor të të pandehurit apo palëve në gjykimin civil¹⁰. Në procesin penal në fazën e ndalimit apo arrestimit është e pamundur që i pandehuri të mund të mbrohet vetë për aq sa është në burg. Përfaqësimi me avokat është aq sa i domosdoshëm dhe i efektiv pas i është përfaqësim profesional dhe i specializuar. Avokati është një njohës shumë i mirë i ligjit dhe i praktikës gjyqësore dhe në këtë mënyrë mbrojtja e tij është më rezultative ndaj veprimeve të Prokurorisë. I pandehuri mund të mbrohet vetë vetëm nëse kjo nuk është në kundërshtim me intereat e drejtësisë¹¹. Asnjë gjykatë nuk mundet që të ndalojë të pandehurin që të mbrohet vetë¹². Gjykata është shumë e kujdesshme në interpretimin e tog-fjalëshit “interesi i drejtësisë”. Ngarkesën e llojit të çështjes, llojin e masës së dënimit që kanoset, shkallën e komplikimit të çështjes në sferën e fakteve dhe problemeve juridike, që janë të angazhuara¹³. *Në po këtë çështje gjykata tërhoqi vëmëndjen se “caktimi i avokatit nga gjykata në gjykimin e apelit nuk mund të riparojë efektet e mungesës së avokatit në procesin para gjykatës së shkallës së parë, në rastin kur gjykata e apelit nuk është kompetente në shqyrtimin e çështjes në tërësi, të anës së saj faktike dhe juridike”.*

⁷ Vendim (nr)1 Sanday Time vs Angli

⁸ Vendimi Pierre-Bloch vs Francë 1997

⁹ Quaranta vs Zvicër 1991

¹⁰ Airey k. Irlandës, 1979

¹¹ Croissant vs Gjermani, 1992

¹² Pakell vs Gjermani 1983

¹³ Quaranta vs Zvicër 1991

Por ligji njuh raste specifike ku mbrojtja me avokat është e detyrueshme. Gjykimet në Gjykatën e Lartë janë të nevojshme të zhvillohen vetëm me avokat. Në çështjen Pakelli kundër Gjermanisë, GJEDNJ ve në dukje, ndër të tjera, nisur pikërisht nga natyra e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe fokusimin e saj në çështje të ligjit, se “... pa ndihmën e një avokati ai nuk mund të kontribuonte në mënyrë të dobishme në shqyrtimin e çështjeve juridike që qëndronin në thelb të mosmarrëveshjeve”. E drejta për tu mbrojtur me avokat nuk nënkupton se prej këtij momenti ai nuk ka më të drejtë të marrë pjesë vetë në proces¹⁴.

Gjykata në shumë vendime ka ezauruar dallimin midis mbrojtjes faktike *de facto* nga mbrojtja ligjore *de jurosi* p.sh: avokati i palës mbrojtëse nuk ishte profesional (Artico vs Itali (1980), Godddi vs Itali (1984), rasti kur avokatët mungonin pasi nuk ishin njoftuar (Alimena vs Itali (1991), kur gjykata refuzonte avokatët e klientëve të cilët nuk ishin prezent gjatë seancave gjyqësore (Poitrimol vs Francë (1993), Lala vs Hollandë (1994), Pelladoha vs Holland (1994), Van Geysseghem vs Belgjik (1999), Van Pelt vs Francës (2000)¹⁵. Gjykata theksoi se në një proces penal avokati dhe i pandehuri duhet të komunikojnë lirisht ndërmjet tyre në konfidencialitet të plotë, në cdo kohë, me gojë apo me shkrim. Duhet të kenë kohën e mjaftueshme që nga momenti i ndalimit, arrestimit, marrjes në pyetje, dhe gjithë veprimeve procedurale për tu mbrojtur në gjykim.

Tepër e rëndësishme për mbrojtjen efektive të të akuzuarit është aksesi i avokatit që në fillimet e hetimeve për të pandeurin, pikërisht këtë fakt theksoi gjykata në rastin John Murray vs Britania e Madhe “ku bëhej fjalë për pretendimin e aksesit të kufizuar të avokatit, i cili nuk mund të merrte pjesë në pyetjen e të akuzuarit”¹⁶. *Gjykata theksoi se e drejta e brendëshme mund ti japë domethënie sjelljes së të pandehurit në fazën fillestare të hetimeve policore. Rrjedhja e ngjarjeve në këtë periudhë mund ti kufizojë seriozisht mundësitë e mbrojtjes së nevojshme përpara gjykatës. Gjykata konstatoi se neni 6, zakonisht kërkon që i pandehuri të ketë mundësi të përfitojë ndihmën e avokatit që në fillim të marrjes në pyetjenga policia. Në rastin Murray, ai ishte ndaluar dhe paskëtaj aficeri, i cili zhvillonte hetimet e zgjati deri në 48 orë periudhën, në të cilën nuk mund të takonte me avokatin, duke e konsideruar se kjo mund të pengonte në veprimet e policisë kundër terroristëve. Me avokatin u pa për të parën herë, para dy seancave të fundit të pyetjeve, gjatë të cilave avokati përsëri nuk mund të ishte i pranishëm. Kjo u konsiderua shkelje e nenit 6 nga Gjykata*¹⁷.

Neni 6 para3 pika c, gjithashtu përcakton kriterin shumë të rëndësishëm që i akuzuari kur nuk ka mundësi të zgjedhë vetë një avokat t’i caktohet një i tillë nga

¹⁴ FCB vs Itali 1991

¹⁵ Udhëzuesi i shkurtër i Konventës Europiane për të Drjtat e Neriut, Donna Gomein, fq 67

¹⁶ Rreth Konventës Europiane, Marek Antoni Noëicki, faqa 217

¹⁷ Rreth Konventës Europiane, Marek Antoni Noëicki, faqa 217

gjkata. E drejta për tu dhënë ndihmë ligjore pa pagesë kur e kërkojnë interesat e drejtësisë nuk është një alternativë ndaj të drejtës për tu mbrojtur vetë, por një e drejtë e pavarur në të cilën zbatohen standarte objektive¹⁸. Ndhima juridike që pret i akuzuari dhe ajo që kërkohet në prizmin e interesit të drejtësisë dhe të rolit të rëndësishëm të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor në shoqërinë demokratike, duhet të jetë praktike dhe efikase dhe jo teorike e iluzorike¹⁹. Në çështjen Goddi vs Itali gjykata u shpreh se *“në shumicën e rasteve avokati i zgjedhur është më mirë i përgatitur për mbrojtjen. Prandaj i akuzuari nuk mund të privohet pa pëlqimin e tij të cilin vetë e ka zgjedhur. Kjo do të thotë gjithashtu se brenda mundësive, megjithësenjë gjë e tillë në praktikë është mjaft e vështirë, duhet të merret parasysh dëshira e të akuzuarit, edhe kur i referohet avokatit të zgjedhur nga gjykata.*

Gjykata ka krijuar një praktikë të gjerë lidhur me avokatët e caktuar nga gjykata duke theksuar se ata duhet të jenë të specializuar dhe të mirë përgatitur sidomos kur kemi çështje tejet delikate dhe mbrojtja duhet të jetë aftë të bëjë një mbrojtje dinjitoze. Një ndihmë juridike efikase mund të ofrojë vetëm avokati i përgatitur në mënyrën e duhur për të përfaqësuar të akuzuarin në një stad konkret të procesit, në lidhje me të cilën i akuzuari ka kërkuar caktimin e avokatit nga gjykata²⁰. Gjithashtu Gjykata është mjaft sensitive lidhur me përmbushjen sa më të plotë të kësaj të drejte ku në çështjen Artico vs Itali, se *“nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi shteti për të gjithë pakujdesitë e avokatit të caktuar nga gjykata, por në rastin në fjalë autoritetet italiane ishin të detyruara të ndërmerinin veprimet që do t’i mundësonin të akuzuarit ushtrimin e sukseshëm të të drejtave të poseduara. Autoritetet kishin dy alternativa, ose të zëvendësonin avokatin e caktuar nga gjykata me një avokat tjetër, ose të kërkonin nga ai, që të ndërmernte një mbrojtje të vërtetë. Por ato zgjedhën alternativën e tretë, që do të thotë: pasivitet, në rastin kur respektimi i Konventës kërkon prej tyre veprimin. Për këtë arsye ishte shkelur konventa”*²¹.

Gjykata në çështjen Mulosmani vs Shqipëria 2013 ku u theksua *“Ai u ankua se avokati i tij i caktuar nga gjykata nuk kishte kohë të mjaftueshme për të studiuar dosjen hetimore. Ai nuk kishte qasje në të gjitha dokumentet në atë dosje dhe në veçanti në deklaratën e A.L më 8 maj 2001. Gjykatat e brendshme kishin ndryshuar riklasifikimin ligjor të akuzave pa i dhënë atij një mundësi për t’u informuar për natyrën e akuzat e reja dhe të përgatisë një mbrojtje të përshtatshme për të. Ankuesit i ishte mohuar mundësia për të dhënë dëshmi më 8 mars 2002. Gjykatat e brendshme nuk ishin në gjendje të detyronin zotin Berisha të jepte dëshmi.*

¹⁸ Udhëzuesi I shkurtër I Konventës Europiane për të Drjtat e Neriut, Donna Gomein, fq 66

¹⁹ Airey vs Irlandë 1979

²⁰ Vendimi Biondo vs Itali, 1983

²¹ Rreth Konventës Europiane, Marek Antoni Noëicki fq 222

Aplikanti e konsideroi si dëshmitar kyç”, Ajo nuk e konsideroi shkelje të neni 6/3 të Konventës. Të njëjtin qëndrim Gjykata mbajti dhe në çështjen Caka vs Shqipëri po ashtu dhe çështja Haxhia vs Shqipëria 2014,.

Të njëjtin qëndrim gjykata mbajti dhe në rastin Kamasinski vs Austri ku theksoi se “shteti nuk mund të mbajë përgjegjësi për cdo të metë në punën e avokatit të caktuar nga gjykata ose të atij të zgjedhur. Autoritetet janë të detyruara të ndërhyjnë vetëm në rastet e pakujdesive të rënda të avokatit, me kusht që autoritetet ta njohin situatën në një masë të mjaftueshme²²

Sipas nenit 6, par. 3, pika c, nuk i garanton të akuzuarit drejtën e zgjedhjes së avokatit nga gjykata dhe madje as të drejtën të kërkojë nga gjykata të konsultohet me të para se të marrë vendimin, (*Vendimi X vs Gjermani, 1982*). Nuk mund të kërkojë ndryshimin e avokatit të caktuar nga gjykata, pas caktimit të tij, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe të arsyeshme (*Ostergren dhe të tjerë vs Suedi 1991, Croissant vs Gjermani 1992*). Nuk ka gjithashtu të drejtë të kërkojë nga avokati i caktuar nga gjykata të realizojë një linjë të caktuar mbrojtje, në rast se mendon se ajo është e paarsyeshme (*Vendimi X vs Britani e Madhe 1980*)²³.

Mendimi lidhur me caktimin e personit në mungesë dhe e caktimit të një avokati nga gjykata është ritheksuar dhe në vendimin e Shkalla vs Shqipëri 2011 ku theksohet “Në çështjen në fjalë, Gjykata vëren se apelimet para Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë kishin nënshkrimin e ankuesit. Megjithatë, në apelin e tij kushtetues, ankuesi kundërshtoi vërtetësinë e nënshkrimit. Meqenëse apeli kushtetues është deklaruar i papranueshëm, ankuesit i është privuar mundësia që të paraqesë çështjen e tij në Gjykatën Kushtetuese, pasi nënshkrimi nuk ishte i tij dhe se, për rrjedhojë ai nuk kishte dijeni efektive të procedurave ndaj tij. Fakti që ankuesi është mbrojtur në apel nga një avokat i caktuar nga babai i tij nuk do të thotë se ai kishte dijeni të mëparshme reale të procedurave ndaj tij. Gjykatat vendase nuk e shqyrtuan fare këtë çështje dhe Qeveria nuk parashtrroi ndonjë provë për të kundërtën. Së fundi, thjeshtë mungesa e ankuesit në shtëpi nuk mjafton për të konsideruar se ai kishte dijeni për procedurat dhe, për rrjedhojë kishte ikur. Më tej, nuk duket se është kryer ndonjë kërkim tjetër në vend apo jashtë. Për më tepër, kuptohet nga dosja e çështjes se ankuesi iu dorëzua autoriteteve me qëllim që të kundërshtojë dënimin e tij in absentia sapo u njoftua për dënimin e caktuar ndaj tij”.

Gjithashtu Gjykata është shprehur dhe në lidhje me gjykimin në mungesë tëtëpandehurit. Ajo ka qenë e prerë lidhur me faktin që nëse “kemi të bëjmë me një mohim të drejtësisë në rastin kur një individ, i dënuar in absentia, nuk mund të ketë një gjykim të ri, pasi ai është vënë në dijeni të themelit të akuzës, për sa i përket fakteve dhe të drejtës²⁴”. Gjykata ka qenë pro faktit që duhen ezauruar

²² Vendimi Imbrioscia vs Itali 1993

²³ Rreth Konventës Europiane, Marek Antoni Noëicki fq 221

²⁴ Vendimi Somogy vs Itali 2004

të gjitha mjetet për njoftimin e të gjykuarit dhe se duhet të hiqet çdo dyshim i arsyeshëm lidhur me njoftimin e tij. Por gjykata gjithashtu u shpreh se “nuk përbën shkelje të nenit 6 të Konventës, për proces të rregullt ligjor, gjykimi në mungesë, kur njoftimi është bërë në vendbanimin e zgjedhur në momentin e daljes nga burgu pranë avokatit²⁵”. Po ashtu gjykata u shpreh se kur i pandehuri është në mungesë me dëshirën e tij, nuk mund të ekzistojë rregulli që duhet të pyetet nga gjyqtari lidhur me akuzat ndaj tij, pasi fakti që nuk është i interesuar është i barsvlefshëm me heqjen dorë nga paraqitja në seancë.

Lidhur me qëndrimet e GJEDNJ u përshtat dhe legjislacioni penal për Urdhër-arrestin European me Vendimin e Këshillit nr. 2002/584/GAI i 13 qershorit 2002 parashikon se, nëse urdhër arresti european është dhënë për ekzekutimin e një vendimi dënimi të një të gjykuari në mungesë dhe i gjykuari nuk është njoftuar personalisht, dhe as është informuar në mënyrë tjetër për datën dhe vendin e seancës gjatë së cilës është dhënë dënimi, dorëzimi i tij mund të kushtëzohet nga fakti që autoriteti gjyqësor i cili ka bërë kërkesën të japë “garanci të mjaftueshme për t’u siguruar personave ndaj të cilëve është dhënë urdhër arresti european, mundësinë që të kërkojnë një proces të ri në shtetin që ka bërë kërkesën dhe të jenë të pranishëm në gjykim”. Kjo dispozitë gjeti zbatim në shumë vende anëtare, legjislacioni i të cilave parashikon në mënyrë eksplicite refuzimin e ekzekutimit të urdhër-arrestit european të dhënë nga një shtet anëtar kur, në rast gjykimi në mungesë, legjislacioni i vendit që bën kërkesën nuk garanton të drejtën për një proces të ri²⁶.

3. Këndvështrimi sipas praktikës së Gjykatës Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese ka qenë mjaft e kujdesshme për të trajtuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor dhe për më tepër të drejtës për tu mbrojtur me avokat përpara gjykatës. Për këtë arsye kjo gjykatë ka elaboruar një praktikë të gjerë lidhur me këto të drejta në funksion të mbrojtjes së të pandehurit në proces. Gjykata Kushtetuese ka krijuar një jurisprudencë të pasur për të krijuar standartet dhe garancitë e nevojshme për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Gjykata ka konstatuar se është shkelur e drejta për t’u mbrojtur me avokat, sepse avokati nuk ka përmbushur në përputhje me ligjin detyrimet e tij ndaj klientit, të cilin kishte marrë përsipër për ta mbrojtur. Mbrojtësi në këtë proces gjyqësor ka përfaqësuar njëkohësisht pesë të pandehur të akuzuar për veprën penale të vrasjes, në një kohë, që midis të pandehurve, rezulton e vërtetuar dhe e pohuar nga vetë gjykata në vendimin e saj që të ketë patur papajtueshmëri interesash. Neni 54 i Kodit të Procedurës Penale nuk lejon në kushte të tilla realizimin e mbrojtjes ligjore në procesin penal, duke vendosur për të shmangur shkeljen e konstatuar detyrim jo vetëm për mbrojtësin, por edhe për vetë organin procedues. Mbrojtësi, përpara gjykatës së shkallës së parë, por edhe në të gjithë shkallët e tjera të gjykimit ka

²⁵ Kimmel vs Itali 2004

²⁶ Procesi i rregullt ligjor në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, Arta Vorpsi

kërkuar deklarimin fajtor për kërkuesin dhe pafajësinë për të pandehurin tjetër. Edhe në mbrojtjen e paraqitur me shkrim përpara gjykatës së shkallës së parë rezulton se avokati është mbështetur kryesisht mbi atribuimet e të pandehurit tjetër, për të cilin ai ka kërkuar pafajësinë.²⁷

Në vendimin nr. 23. Dt 30.07.2003, kjo gjykatë i bëri njëinterpretim të përgjithshëm të drejtës për tu mbrojtur në gjykimin penal si në aspektin e mbrojtjes vetë të pandehurit po ashtu dhe mbrojtjes me avokat. Gjatë interpretimit të kërkesës për shfuqizimi si antikushtetues i nenit 437 pikat 3 dhe 5 të Kodit të Procedurës Penale si dhe nenit 483 paragrafi i dytë dhe pjesërisht paragrafi i tretë të Kodit të Procedurës Civile”, gjykata theksoi se shqyrtimi i çështjeve në Gjykatën e Lartë ka karakter të veçantë. Ajo nuk përsërit gjykimet e zhvilluara për të njëjtën çështje në shkallë të parë ose edhe në gjykatën e apelit, pra nuk e trajton çështjen edhe nga pikëpamja e faktit, por kufizohet kryesisht në çështjet ligjore, në mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga këto gjykata. Gjykata e Lartë kontrollon nëse në gjykimet e zhvilluara në gjykatën e shkallës së parë dhe në gjykatën e apelit janë zbatuar ose jo kërkesat e ligjit.

Kur çështja kalon në seancë gjyqësore zbatohen parimet bazë të procesit të rregullt ligjor. Në funksion të sigurimit të një mbrojtje sa më efektive, vetë specifika e trajtimit të çështjes në këtë fazë në Gjykatën e Lartë imponon disa veçanti. Problemet që shtrihen aty kanë karakter të mirëfilltë ligjor, prandaj diskutimi i tyre kërkon përgatitje dhe nivel të lartë profesional. Në emër të të pandehurit apo palëve në gjykim, një gjë të tillë mund ta realizojë me profesionalizëm avokati i tyre. Ai i ka të gjitha mundësitë dhe aftësitë për të mbrojtur realisht dhe me efikasitet përpara Gjykatës së Lartë interesat e subjektit që përfaqëson. Pikërisht për këto arsye ka raste që edhe nga këndvështrimi formal, vende të ndryshme ofrojnë zgjidhje të ngjashme me atë të vendit tonë e procesi në Gjykatën e Lartë quhet edhe si “Procesi i Avokatit”. Për më tepër dhe në funksion të kësaj specifike të trajtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, në shumë vende, të drejtën e mbrojtjes së të pandehurit apo palëve pranë kësaj Gjykate, e ka një numër i kufizuar avokatësh që zgjidhen sipas kriterëve të përcaktuara rigorozisht në ligj, mes të cilave vemendje e veçantë i kushtohet përgatitjes profesionale. Një mbrojtje e tillë me avokat është nga ana tjetër edhe në interes dhe në funksion të kërkesave të shtetit të së drejtës, pasi i shërben më mirë krijimit të sigurisë juridike dhe dhënies së drejtësisë në përgjithësi, për të cilat një rol tepër të spikatur Kushtetuta jonë i ngarkon Gjykatës së Lartë. Mbrojtja objektive e të drejtave dhe lirive themelore ka prioritet dhe rëndësi të veçantë në Gjykatën e Lartë. Përmes kësaj mbrojtje bëhet njëkohësisht edhe njësimi i praktikës gjyqësore, zbatimi i drejtë dhe i njëjlojtë i ligjit si dhe vetë garantimi i të drejtave dhe lirive individuale. Pjesëmarrja e të pandehurit në seancë gjyqësore dhe mundësia e mbrojtjes vetë janë padyshim elemente të rëndësishëm të

²⁷ Vendimi Nr 222 dt 04.11.2002 i Gjykatës Kushtetuese

së drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.²⁸

Gjykata Kushtetuese e ka trajtuar të drejtën për tu mbrojtur nën këndvështrimin e disa parimeve kryesore si “interesi i drejtësisë”, *Në këtë kuadër, theksohet se ndihma ligjore është veçanërisht e rëndësishme në vendet ku e drejta e aksesit në këto gjykata mund të realizohet vetëm nëpërmjet avokatit mbrojtës ose legjislativoni procedural përkatës nuk parashikon mundësinë e kundër-rekursit nga ana e palës kundërshtare...Gjykata Kushtetuese vlerëson se interesat e drejtësisë kërkojnë detyrimisht realizimin e mbrojtjes, qoftë edhe me avokat të caktuar kryesisht, të të akuzuarit që gjykohet nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë mbi bazën e rekursit të paraqitur nga prokurori, në të cilin, ndër të tjera kërkohet një rëndim i dukshëm i pozitës së tij, në krahasim me vendimin e dhënë për këtë çështje nga gjykata e apelit. Në rastin në shqyrtim, kërkuesit një e drejtë e tillë nuk i është garantuar në Gjykatën e Lartë. Gjykata e apelit ka vendosur pushimin e çështjes dhe lirimin e tij të menjëhershëm nga paraburgimi. Në gjykimin që ka zhvilluar Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, gjykim i bërë pas rreth 7 muajsh mbi bazën e rekursit të prokurorit, nuk ka marrë pjesë as i pandehuri dhe as mbrojtësi i tij. Ky kolegji praktikisht ka vlerësuar vetëm pretendimet e prokurorit të paraqitura në rekurs dhe në seancë, në të cilat është kërkuar deklarimi fajtor dhe dënimi me burgim i të pandehurit. Pala e akuzuar, pra mbrojtja e saj, nuk ka pasur mundësi të shprehet për asnjërin nga këto pretendime²⁹.*

Po ashtu një parim i rëndësishëm për të cilën Gjykata Kushtetuese është ndalur shpesh është dhe parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoriteti. Në vendimin nr.16, datë 08.06.2006 thekson se “në këto kushte, duket mjaft qartë se nuk është respektuar parimi i barazisë së armëve dhe ai i kontradiktoritetit dhe, për pasojë, është cenuar rëndë e drejta e mbrojtjes së kërkuesit. Gjykata Kushtetuese çmon se përputhja me kërkesat e procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues, të garantuar në nenet 31/1, 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ, duhej të ishte verifikuar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë...i cili duhej të verifikonte arsyet e mosparaqitjes dhe më pas, në funksion të këtij verifikimi, duhej të kishte vendosur shtyrjen e seancës gjyqësore ose edhe mbrojtjen e kërkuesit me avokat të caktuar kryesisht”.

Për respektimin e këtyre parimeve, gjykata duhet të përmbushë një sërë detyrimesh, mes të cilave, sipas rastit, rëndësi të veçantë paraqet edhe njoftimi i të pandehurit apo mbrojtësit të tij ligjor për akuzën, ankimin, rekursin, ditën dhe vendin e gjykimit të çështjes, etj., me synimin që të realizohet një debat real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata.

Në lidhje me praninë e mbrojtësit, veçanërisht në gjykimin në Gjykatën e Lartë, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar, *se situata juridike kur rekursi paraqitet nga i*

²⁸ Vendimi nr. 25 dt. 30.07.2003 i Gjykatës Kushtetuese

²⁹ Vendimi nr 16. Dt 08.06.2006 i Gjykatës Kushtetuese

akuzuari nuk është e njëllotë me rastin kur rekursi paraqitet nga prokurori (vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.23, datë 13.10.2005). Në rastin e parë, prania personale e të pandehurit ose e avokatit të tij në seancën gjyqësore nuk është e domosdoshme dhe Gjykata e Lartë nuk ka ndonjë pengesë për të vazhduar shqyrtimin e çështjes për shkak, se argumentet ligjore, ai i ka depozituar me shkrim në rekursin e paraqitur përpara saj dhe vendimi i gjykatës më të ulët nuk mund të ndryshohet në disfavor të të pandehurit. Ndryshe paraqitet situata kur, si rrjedhojë e një rekursi të paraqitur nga prokurori, që mbart në potencë mundësinë e përkeqësimit të pozitës së të pandehurit, gjykimi zhvillohet pa praninë e të gjykuarit ose të avokatit të tij³⁰.

Me këtë rast, Gjykata Kushtetuese ripërsërit se, garancitë kushtetuese për një proces të rregullt ligjor duhet të respektohen edhe në gjykimin në Gjykatën e Lartë. Natyrisht, mënyra me të cilën aplikohen këto garanci në gjykimin në këtë Gjykatë, duhet të varet në karakteristikat e veçanta të procesit në këtë instancë, në mbajtjen parasysh të tërësisë së procesit (pra, në të tre shkallët) dhe në rolin e Gjykatës së Lartë në këtë proces. Respektimi i parimit të barazisë së armëve si dhe ai i mbrojtjes me avokat, janë aspekte të rëndësishme të një procesi të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Për pasojë, në funksion të respektimit të këtyre parimeve një rol të veçantë luajnë edhe njoftimi i palës si dhe i avokatit mbrojtës të tij, si për kopjen e rekursit ashtu edhe për ditën e gjykimit....³¹.

Gjithashtu nuk mund të mos i jepej vëmendje dhe të pandehurit të mitur në gjykimin kushtetues dhe pikërisht në vendimin nr 13. dt 10.06.2005 ku theksohet “Kur i pandehuri është nën moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç, ..., ndihma nga një mbrojtës është e detyrueshme”; kurse në pikën 5 të po kësaj dispozite, parashikohet, se “... kur kërkohet prania e mbrojtësit, dhe kur mbrojtësi i zgjedhur ose i caktuar nuk është siguruar, nuk është paraqitur ose e ka lënë mbrojtjen, gjykata ose prokurori cakton si zëvendës një mbrojtës tjetër, i cili, ushtron të drejtat dhe merr përsipër detyrimet e mbrojtësit”.

Problematike ka qenë praktika e mbajtur në lidhje me caktimin e avokatit nga të afërmit e të pandehurite cila ka sjell përplasje institucionale me Gjykatën e Lartë lidhur me qëndrimet e ndryshme që kanë pasur keto të dyja. Gjykata Kushtetuese ka ndryshuar qëndrim në lidhje me këtë problem i cila ka sjell shpesh dhe zgjidhje të ndryshme për të njëjtën çështje.

Pikërisht Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 386, dt 29.07.1999, i rikonfirmuar nga Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 371, dt 27.10.2000, mbajtën qëndrim kundër legjitimit të avokatit të zgjedhur kryesisht ose i zgjedhur nga familjaret e të pandehurit kur ky i fundit është në mungesë. Qëndrim të kundërt ka mbajtur Gjykata Kushtetuese e cila në vendimin nr 17, dt 17.04.2000, vendosi të shpall antikushtetues Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 386, dt29.07.1999

³⁰ Vendimi nr 13. Dt 21.07.2008 i Gjykatës Kushtetuese

³¹ Vendimi nr. 21. Dt 20.09.2005 i Gjykatës Kushtetuese

pasi duke qenë përfaqësues ligjor i të pandehurit në mungesë gëzon të gjithë të drejtat e mbrojtësit duke përfshirë dhe të drejtën e ankimit.

Kjo gjykatë e konsolidoi këtë qëndrim me Vendim i GJK nr.15/2003. Me anë të këtij vendimi, GJK shfuqizoi fjalën “*I pandehuri*” nga neni 410/2 i KPP, kur parashikohej se ankimi mund të bëhet ngambrojtësi i pajisur me prokurë nga i pandehuri. GJK në atë vendim çmoi se kjo përbënte një kufizim të së drejtës së ankimit, pasi nuk lejonte familjarët e të pandehurit të zgjidhnin një mbrojtës kur i pandehuri ishte në mungesë.

Në vendimin nr. 30./2010 i GJykata Kushtetuese ndryshoi praktikën e saj duke theksuar se i pandehuri e ushtron këtë të drejtë veti duke përdorur mbrojtësit familjarë të tij, të cilët kanë mundësinë objektive për të kontaktuar me avokatë, në mënyrë që këta të fundit të shqyrtojnë mundësinë për të marrë cilësinë e mbrojtësit ligjor të të pandehurit.

KONKLUZIONE

E drejta për tu mbrojtur si pjesë e një procesi të rregullt ligjor është fundamentale për të siguruar të drejtat e të pandehurit. Legjislacioni penal i ndikuar dhe nga standartet ndërkombëtare dhe kushtetuta ka arritur të krijojë rregulla për t’i siguruar të pandehurit mbrojtëjen e nevojshme ligjore. Po ashtu dhe praktika e konsoliduar tashme e GJEDNJ dhe Gjykatës Kushtetuese e ka bërë të prekshme këtë mbrojtje. Është detyrë e shtetit të sigurojë një mbrojtje më efektive të pandehurit duke i dhënë mundësinë të mbrohet vetë ose me avokat. Legjislacioni ynë penal ka përmirësuar gjithmonë dhe më shumë këto standarte të cilat dhe me ndryshimet e fundit në K.Pr.Penale e kanë rritur garancitë ligjore e procedurale që të pandehurit t’i sigurohen të drejtat e tij.

BIBLIOGRAFIA

1. Udhëzuesi i shkurtër i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, Donna Gomein,
2. Rreth Konventës Europiane, Marek Antoni Nowicki,
3. Procesi i rregullt ligjor në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, Arta Vorpsi,
4. Kodit të Procedurave Penale,
5. Konventa Europiane e Të Drejtave të Njeriut
6. Vendimi “Delcourt vs Belgjik 1968,
7. Vendim (nr)1 Sanday Time vs Angli,
8. Vendimi Pierre-Bloch vs Francë 1997,
9. Quaranta vs Zvicër 1991,
10. Airey k. Irlandës, 1979,
11. Croissant vs Gjermani, 1992,

12. Pakell vs Gjermani 1983,
13. Quaranta vs Zvicër 1991,
14. FCB vs Itali 1991,
15. Airey vs Irlandë 1979,
16. Vendimi Biondo vs Itali, 1983,
17. Vendimi Imbrioscia vs Itali 1993,
18. Vendimi Somogy vs Itali 2004,
19. Kimmel vs Itali 2004,
20. Vendimi Nr 222 dt 04.11.2002 i Gjykatës Kushtetuese,
21. Vendimin nr. 23. Dt 30.07.2003i Gjykatës Kushtetuese,
22. Vendimi nr. 25 dt. 30.07.2003 i Gjykatës Kushtetuese,
23. Vendimi nr 16. Dt 08.06.2006 i Gjykatës Kushtetuese,
24. Vendimi nr 13. Dt 21.07.2008 i Gjykatës Kushtetuese,
25. Vendimi nr. 21. Dt 20.09.2005 i Gjykatës Kushtetuese,
26. Vendimin nr 13. dt 10.06.2005i Gjykatës Kushtetuese,
27. Vendimin nr 17, dt 17.04.2000i Gjykatës Kushtetuese,
28. Vendimin nr. 30,/2010 i Gjykata Kushtetuese,
29. Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 386, dt 29.07.1999,
30. Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 371, dt 27.10.2000,

RISHIKIMI I VENDIMIT PENAL TË FORMËS SË PRERË NË KUADRIN E NDRYSHIMEVE TË KODIT TË PROCEDURËS PENALE

Prof. asoc. Dr. Klodjan SKËNDERAJ
(Universiteti i Tiranës)
klodjans@gmail.com

Prof. Dr. Sokol MËNGJESI
(Universiteti i Tiranës)
smengjesi@yahoo.com

ABSTRAKT

Me Ligjin Nr. 35/2017 Kodi i Procedurës Penale u ndryshua në mjaft pjesë të tij. Një prej instituteve që u prek nga ndryshimet është rishikimi penal i vendimit të formës së prerë. Ky ndryshim erdhi si pasojë e ndryshimeve kushtetuese në kuadrin e reformimit të sistemit të drejtësisë penale. Neni 141 i Kushtetutës, pika 1 përpara ndryshimeve me Ligjin Nr. 76/2016 parashikonte se “*I. Gjykata e Lartë ka juridiksion fillestar dhe rishikues...*”. Ndërkohë me ndryshimet e vitit 2016 është riformuluar paragrafi 1 i nenit 141 të Kushtetutës sipas të cilit “*I. Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit.*” Gjykata e Lartë ka humbur juridiksionin e saj rishikues për shkak të faktit e kjo u materializua dhe në ndryshimet e Kodit të procedurës Penale në lidhje me pjesën e rishikimit penal. Nga një vështrim historik duket se instituti i rishikimit penal të formës së prerë në lidhje me gjykatën kompetente u kthye në versionin origjinal të Kodit të Procedurës. Kjo pasi kërkesa për rishikim vendimi të formës së prerë shqyrtohej nga gjykata që kishte dhënë vendimin, ndërkohë vetëm me Kushtetutën e vitit 1998 gjykimi i kërkesave për rishikim vendimi iu dha si atribut Gjykatës së Lartë. Në këtë punim do të merret në studim rishikimi penal i vendimit të formës së prerë duke u fokusuar fillimisht në trajtimin historik të tij, duke u ndalur në shkaqet e rishikimit penal përpara ndryshime të fundit të Kodit, problematika e gjykimit të rishikimit të vendimit të formës së prerë. Më pas, punimi do të ndalet në pasqyrimin e ndryshimeve të fundit, si përsa i përket gjykatës kompetente, shqyrtimit të kërkesës për rishikim vendimi penal, por mbi të gjitha dhe shkaqeve të reja të rishikimit të vendimit penal të formës së prerë. Në përfundim do të parashtrihen konkluzione rezultat i hulumtimit mbi problematikat e mundshme që mund të hasen në praktikë edhe pse duhet thënë se është ende herët për të trajtuar ndonjë rast të praktikës mbi rishikimin në kuadrin e rregullave të reja të kodit të procedurës penale.

Fjalë kyçe: *rishikim penal; shkaqet e rishikimit; juridiksion rishikues; kodi i procedurës penale, gjykatë, i dënuar;*

I. Vështrim historik mbi rishikimin penal

Rishikimi i vendimeve penale të formës së prerë parashikohej në K.Pr.Penale të vitit 1953. Ky kod¹ në pjesën e pestë të tij parashikonte rastet e “shqyrtimit të kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe rishikimin e çështjeve për rrethana të zbuluara rishtazi”. Në rastet e rishikimit për shkak të ligjit, ky kod rezervonte të drejtën për ngritjen e kërkesave për rishikim vendimi vetëm dy subjekteve, respektivisht Prokurorit të Përgjithshëm dhe Kryetarit të Gjykatës së Lartë. Në nenin 331 të kodit të 1953-it parashikohej se “Kryetari i Gjykatës së Lartë dhe Prokurori i Përgjithshëm kanë të drejtë të kërkojnë nga gjykata çdo çështje vendimi i së cilës ka marrë formë të prerë, me qëllim që të paraqesin kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, duke urdhëruar njëkohësisht dhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit”.

Në rastet e kërkesës për rishikim kundrejt vendimeve të pafajësisë (përveç rasteve të krimeve kundër shtetit), kjo e drejtë e Gjyqtarit dhe e Prokurorit të Përgjithshëm ishte e kufizuar në kohë duke parashikuar afatin 3 vjeçar nga dita që vendimi kishte marrë formë të prerë. Në rastet e rishikimit për shkak të rrethanave të zbuluara rishtazi, kishin të drejtë për rishikim prokurori, i dënuari, mbrojtësi i tij, të afërmit si dhe organizatat shoqërore në të cilat bënte pjesë i dënuari. Vdekja e të dënuarit nuk pengonte rishikimin e çështjes penale, për të cilën i dënuari ishte deklaruar fajtor².

E drejta e Prokurorit për paraqitjen e kërkesës për rishikim në rastet kur vendimi kishte marrë formë të prerë, njihej jo vetëm në rastet e vendimeve të dënimit por dhe për vendimet e pafajësisë, e drejtë kjo e kufizuar në kohë, pasi kërkesa mund të paraqitej vetëm brënda 5 viteve nga dita kur vendimi kishte marrë formë të prerë. Megjithatë në rastet e parashikuara nga neni 335 paragrafi 3 i K.Pr.Penale të 1953 (për rrethana të reja që vetëm ose së bashku me rrethanat e vërtetuara më parë, tregojnë pafajësinë e të dënuarit ose pjesëmarrjen e tij në një krim më të rëndë) afati për paraqitjen e kërkesës parashikohej deri në një vit nga dhënia e vendimit.

Prokurori i rrethit ku kishte qendrën gjykata që kishte dhënë vendimin objekt rishikimi, shqyrtonte kërkesat e të interesuarve e kur çmonte se kishte të dhëna të mjaftueshme fillonte çështjen penale duke zhvilluar hetime sipas rregullave të përgjithshme procedurale. Hetimet kryheshin nga vetë prokurori ose ndihmësat e tij. Kur prokurori çmonte se nuk kishte prova të mjaftueshme për fillimin e çështjes penale, mund të vendoste refuzimin e kërkesës, me vendim të arsyetuar. Një kopje e vendimit u dërgohej personave apo organizatave të interesuara të cilat kishin paraqitur kërkesën.

Kërkesa për rishikim depozitohej në sekretarinë e Gjykatës së Lartë dhe shqyrtohej në Këshill me pjesëmarrjen e Prokurorit të Përgjithshëm dhe kur çmohej

¹ Miratuar me Ligjin Nr. 1650 datë 30.03.1953

² Neni 344 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë

e arsyeshme dhe në prani të palëve. Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës për rishikim, Gjykata e Lartë mund të dispononte në disa mënyra³:

Së pari, mund të linte në fuqi vendimin e ankimuar (në rastet kur nuk ishin zbuluar prova të mjaftueshme për rishikimin e vendimit penal të formës së prerë); së dyti, mund të prishte vendimin dhe t'a dërgonte çështjen për një hetim të ri ose rigjykim; së treti mund të prishte vendimin dhe të pushonte çështjen në rastet kur çmohej se nuk kishte nevojë për hetim të ri ose rigjykim.

Ligji procedural penal i vitit 1953, nuk i njihte Gjykatës së Lartë të drejtën të ndryshonte vendimin objekt rishikimi. Në rast se Gjykata e Lartë dispononte për rigjykim të çështjes penale, në procesin e rigjykimit, aplikoheshin rregullat e zakonshme të gjykimit sipas rastit të gjykimit në shkallë të parë apo të gjykimit në apel.

Kodi i procedurës penale të 1958 parashikonte institutin e rishikimit respektivisht në nenet 341 - 347. Fill pas miratimit të këtij kodi në Shqipëri nisën reformat “revolucionarizuese” të ligjit procedural penal. Më konkretisht me Ligjin Nr. 4406 datë 24.06.1968 “Për organizimin gjyqësor të Republikës së Shqipërisë”, u ndryshua struktura e organeve gjyqësore dhe funksionin gjyqësor e kryenin gjykatat popullore të cilat ishin, Gjykata e Lartë, gjykatat e rretheve, gjykatat e fshatrave, të qyteteve dhe të lagjeve të qyteteve. Me këtë ligj u suprimuan gjykatat e qarqeve dhe gjykimi në shkallë të dytë u përqëndrua në Gjykatën e Lartë⁴. Gjithashtu u hoqën dhe gjykatat ushtarake, të cilat u zëvendësuan me këshillat ushtarake pranë gjykatave të rretheve.

Në K.Pr.Penale të 1958-ës⁵, instituti i rishikimit nuk pësoi ndryshime në raport me parashikimet e kodit të mëparshëm. Më konkretisht kodi i 1958-ës parashikonte dy mjete të jashtëzakonshme për rishikimin e vendimeve penale të formës së prerë. Së *pari* kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë (rishikimi për shkak të ligjit) e së *dyti*, rishikimin e vendimit për shkak të rrethanave të zbuluara rishtazi (rishikim për shkak të faktit).

Në lidhje me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, ky kod para-shikonte se “*Kryetari i Gjykatës së Lartë dhe Prokurori i Përgjithshëm kanë të drejtë të kërkojnë nga gjykata çdo çështje, vendimi i së cilës ka marrë formën e prerë, me qëllim që të paraqitin kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë duke urdhëruar njëkohësisht pezullimin e ekzekutimit të vendimit. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër vendimeve të pafajësisë dhe të pushimit të çështjes, përveç çështjeve për krimet kundër shtetit, mund të paraqitet vetëm brenda tre vjetëve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë*”⁶.

³ Neni 346 i Kodit të sipërcituar.

⁴ R. Murati, “Rishikimi i procedurës penale për shkak të fakteve dhe rrethanave të reja”, faqe 119, Prishtine 2006

⁵ Miratuar me Ligjin Nr. 2805 datë 04.12.1958

⁶ Neni 331 e 332 të Kodit të Procedurës Penale të 1958-ës

Nga parashikimet e mësipërme vërehet se rishikimi për shkak të ligjit shqyrtohej nga kolegjet civile apo penale të Gjykatës së Lartë sipas llojit të çështjeve me pjesëmarrjen e prokurorit dhe të palëve të interesuara.

Në rastin e rishikimit për shkak të faktit, Kodi i vitit 1958, parashikonte⁷ se rishikimi i çështjeve për rrethana të zbuluara rishtazi pasi vendimi gjyqësor të ketë marrë formë të prerë, lejohet vetëm në ato raste kur janë zbuluar rrethana të reja të cilat nuk mund të diheshin nga gjykata në momentin e dhënies së vendimit. Rastet kur zbulohen rrethana të reja ishin:

a) kur vërtetohet (me anë të vendimit gjyqësor) falsifikimi i provave mbi të cilat është bazuar vendimi i ankimuar. Si prova mbi të cilat bazohet vendimi objekt rishikimi mund të jenë të gjitha llojet e provave të parashikuara në kodin e procedurës penale të 1958 si dëshmia, njohja, ekspertimi, ballafaqimi, eksperimenti, prova shkresore etj. Kusht i kërkuar nga ligji procedural penal ishte se falsifikimi i provave duhet të karakterizohet nga elementi volitiv ose dashja në kryerjen e falsifikimit. Në rastet kur falsifikimi i provave ka ardhur si pasojë e pakujdesisë, ky fakt nuk përbënte shkak për rishikimin e vendimit penal⁸. Thelbësor është fakti se prova e falsifikuar duhet të ketë shërbyer si bazë mbi të cilën është dhënë vendimi i ankimuar. Pra kërkesa për rishikim sipas nenit 341 pika 1 të K.Pr.Penale të 1958-ës mund të pranohej vetëm nëse vendimi i gjykatës rezultonte të ishte bazuar mbi një provë të rreme e cila duhet të ishte konstatuar si e tillë me anë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

b) kur vërtetohet se disa prej subjekteve të procedimit penal si gjyqtarët, prokurorët apo organet e hetimit të cilët kanë marrë pjesë në gjykim ose hetim të çështjes penale kanë kryer vepra penale gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre (neni 341/1 pika 2 të K.Pr.Penale të 1958).

Subjektet e sipërcituar, duhet që gjatë ushtrimit të detyrës së tyre të kenë konsumuar një prej veprave penale⁹ të parashikuara nga ligji penal i kohës, e për më tepër vepra e konsumuar duhet të kishte lidhje me çështjen objekt gjykimi. Sipas kësaj dispozite, duhej vërtetuar nëse subjektet e sipërpërmendur me pjesëmarrjen e tyre në gjykimin ose në hetimin e çështjes duke shpërdoruar detyrën, kanë kryer vepra penale. Në këtë rast nuk kërkohej të vërtetohej se me kryerjen e veprave penale nga ana e subjekteve të procedimit të ishte dhënë një vendim i padrejtë. Pra e thënë ndryshe edhe po të mos vërtetohej se vendimi i gjykatës është i padrejtë, kërkesa për rishikim duhej pranuar.

c) një kusht i tretë i cili shërbente si bazë për rishikimin e vendimit penal ishte

⁷ Nenet 341 - 347 të Kodit të sipërcituar

⁸ Psh. në rast se eksperti nga pakujdesia e bazon aktin e ekspertimit në të dhëna të gabuara, ky fakt nuk përbën bazë për rishikimin e vendimit. Në rast se vendimi i ankimuar është bazuar në dëshmi të rreme, kërkohej gjithashtu që vepra penale (dëshmi e rreme) të jetë konstatuar me anë të një vendimi gjyqësor.

⁹ Si psh. mitmarrje, fshehje e provave, falsifikim i dokumentave etj

rasti kur ekzistojnë rrethana të tjera të cilat vetëm ose së bashku me rrethanat e vërtetuara më parë, tregojnë pafajësinë e të dënuarit, ose pjesëmarrjen e tij në një krim më të rëndë apo më të lehtë nga ai për të cilin ka qenë dënuar ose tregojnë pafajësinë e të pandehurit të deklaruar të pafajshëm (neni 341 paragrafi 1 pika 3 e kodit të procedurës penale të 1958).

Ky kusht nënkuptonte rrethana të zbuluara rishtazi e të zbuluara pasi të ishte dhënë vendimi gjyqësor. Këto rrethana, për të shërbyer si shkak i rishikimit, duhet të mos ishin të njohura për gjykatën në momentin e marrjes së vendimit. Në ndryshim me sa parashikohej për dy shkaqet e para të rishikimit të analizuara më sipër, në shkakun e tretë nuk kërkohej ekzistenca e elementit subjektiv të përgjegjësisë penale të personit. Si rrethanë e re mund të ishte rasti kur vërtetohej se viktimja e veprës penale për të cilën rezultoi të jetë dënuar personi nuk kishte vdekur por është gjallë.

Gjykata e Lartë, kërkesën për rishikim e gjykoi në kolegji me dyer të hapura (dhe jo në dhomën e këshillimit siç parashikonte kodi) duke zbatuar rregullat e përgjithshme që aplikoheshin në rastet e shqyrtimit të rekursit për shkelje të ligjit¹⁰.

Gjykata e Lartë, pasi të shqyrtojë kërkesën për rishikim, mund të disponojë sipas rastit lënie në fuqi të vendimit të ankimuar, të prishë vendimin dhe çështjen ta dërgojë për rigjykim pranë gjykatës që ka dhënë vendimin e së fundi të prishë vendimin e ankimuar dhe të pushojë çështjen. Siç mund të vërehet, ligji procedural penal nuk i njihet drejtën Gjykatës së Lartë që të ndryshonte vendimin e ankimuar. Në rast se çështja kthehet për rigjykim, atëherë në gjykimin e rishikimit aplikoheshin rregullat e zakonshme të gjyqësorit.

Kodi i procedurës penale i 1979-ës u karakterizua nga një frymë ideologjike e mjaft prej parimeve themelore të procesit penal u hoqën¹¹. Në këtë kod nuk u njoh instituti i rishikimit penal (për shkak të faktit) si mjet ankimi kundër vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Suprimimi i këtij instituti u justifikua me arsyetimin se vendimet e gabuara në fakt, mund të korrigjohen nëpërmjet goditjes me kërkesë¹² për mbrojtje të ligjshmërisë nga Kryetari i Gjykatës së Lartë Prokurori i Përgjithshëm. Në këtë mënyrë ky mjet i rëndësishëm ligjor për mbrojtjen e të drejtave të palëve nga vendimet e padrejta, u kthye në një mjet për mbrojtjen e interesave të shtetit.

Edhe pse kishte raste kur vendimi ishte haptazi i gabuar në dëm të të dënuarit, ankimi nuk mund të bëhej direkt në gjykatë por vetëm tek Kryetari i Gjykatës së Lartë ose te Prokurori i Përgjithshëm, subjekte këta të cilet kishin të drejtë të

¹⁰ G. Gjika, Procedura Penale e Republikës Popullore të Shqipërisë, pjesa e posaçme, Tiranë 1970

¹¹ Islami H. “Mbi organizimin dhe kompetencat e gjykatave të fshatrave, të qyteteve dhe të lagjeve të qyteteve”, Tiranë 1970

¹² Neni 41 i Kodit të Procedurës Penale të 1979 citon se “Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është akti, me anë të të cilit, Kryetari i Gjykatës së Lartë ose Prokurori i Përgjithshëm kërkojnë prishjen ose ndryshimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë”

refuzonin ankimin pa pasur asnjë detyrim për respektimin e ndonjë kriteri ligjor dhe pa dhënë asnjë shpjegim mbi arsyet e refuzimit të kërkesës.

Kodi i vitit 1979 nuk vendoste asnjë kufizim për vendimet që do të goditeshin apo do të kundërshtoheshin me anë të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë. Pra kjo kërkesë mund të ushtrohej kundër çdo vendimi gjyqësor, qoftë ky një vendim përfundimtar ose që ka marrë formë të prerë. Kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë Kryetari i Gjykatës së Lartë ose Prokurori i Përgjithshëm e paraqisnin për shqyrtim përpara Gjykatës së Lartë¹³. Kjo kërkesë shqyrtohej nga Kolegji përkatës i Gjykatës së Lartë dhe vendimi i dhënë për këtë çështje mund të ankimohej në Pleniumin e Gjykatës së Lartë¹⁴.

Përsa i përket paraqitjes së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, kodi i 1979-ës, nuk parashikonte afate të caktuara, pra kërkesa mund të paraqitej në çdo kohë, pavarësisht datës kur ishte dhënë vendimi objekt i kërkesës. Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës gjykata mund të dispononte për: a) lënien në fuqi të vendimit të ankimuar; b) prishjen e vendimeve të gjykatës së shkallës së parë e të dytë dhe zgjidhjen e çështjes në themel; c) prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së dytë dhe dërgimin për shqyrtim të çështjes në të njëjtën gjykatë; d) prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së dytë dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë; e) ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë e të apelit¹⁵.

Me ligjin nr. 7561, date 29.04.1992 “Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese” u ndryshua sistemi gjyqësor, duke krijuar Gjykatën e Kasacionit. Ky emërtim lidhej me funksionin dhe juridiksionin e kësaj gjykate¹⁶. Gjykata e Kasacionit kishte një funksion të verifikimit të zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Në bazë të nenit 7 të Dispozitave Kushtetuese, “Gjykata e Kasacionit shqyrton vetëm bazën ligjore të vendimeve gjyqësore që i paraqiten në rrugë kundërshtimi, ose që i tërheq vetë”. Gjykata e Kasacionit u kthye në një gjykatë, e cila kishte vetëm një juridiksion, atë të gjykimit vetëm mbi verifikimin e zbatimit të ligjit prej gjykatave më të ulëta.

Me Kushtetutën e vitit 1998 u ndryshua jo vetëm emërtimi i autoritetit më të lartë gjyqësor nga Gjykatë Kasacioni në Gjykatë të Lartë, por u arrit te ndryshohej dhe juridiksioni i kësaj gjykate. Në nenin 141 të Kushtetutës citohej se “Gjykata e Lartë ka juridiksion fillestar dhe rishikues”. Kjo e drejtë kushtetuese e Gjykatës

¹³ Shiko neni 179 i Ligjit nr. 6069 date 25.12.1979 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”

¹⁴ Neni 184 i kodit të sipërpërmendur citon se “Çështja mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër vendimeve të kolegjeve të Gjykatës së Lartë shqyrtohet nga Pleniumi i Gjykatës së Lartë me pjesëmarrjen e Prokurorit të Përgjithshëm. Kur shihet e arsyeshme, mund të thirren edhe pjesëmarrësit e tjerë në procesin penal. Shqyrtimi fillon me parashtrimin mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe pastaj si të bëhen bisedime dhe të shfaqë mendimin Prokurori i Përgjithshëm, pleniumi jep vendimin”

¹⁵ Vërehet se në ndryshim me kodin e vitit 1958, në kodin e vitit 1979, Gjykata e Lartë ka të drejtë të ndryshojë vendimet e gjykatës së shkallës së parë e të dytë

¹⁶ Islami H. “Demokratizimi i legjislativitetit penal”, faqe 30, Tiranë 2000

së Lartë u vendos pa pasur një përcaktim të kufijve se deri ku shtrihet juridiksioni rishikues i kësaj gjykate e më tej, pa përcaktuar institutin e rishikimit. Megjithatë doktrina¹⁷, ka arritur në konkluzionin se kuptimi i rishikimit nga ana e Gjykatës së Lartë nënkupton si rishikimin apo riekzaminimin me qëllim modifikimi apo korrigjimi të vendimeve të formës së prerë për shkak të gabimeve në ligj ashtu dhe rishikimin për shkak të gabimit në fakt. Thënë ndryshe, juridiksioni rishikues i Gjykatës së Lartë deri përpara ndryshimeve të vitit 2016, ndahej në juridiksion rishikues për shkelje të ligjit dhe në juridiksion rishikues për shkak të faktit.

Në kodin e procedurës penale të 1995-ës¹⁸ përpara ndryshimeve me Ligjin nr. 35/2017 insituti i rishikimit parashikohej si mjet ankimi kundrejt vendimeve gjyqësore që kanë marrë formë të prerë për ndreqjen e vendimeve të gabuara në lidhje me faktin. Ky kod në nenin 452 paragrafi 1 në formulimin origjinal parashikonte se *“Kërkesa e rishikimit bëhet personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit. Ajo duhet të përmbajë provat që e përligjin dhe duhet të paraqitet, bashkë me dokumentet eventuale, në sekretarinë e gjykatës së rrethit që ka dhënë vendimin”*.

Ky parashikim nuk i përgjigjej frymës së Kushtetutës e më konkretisht nenit 141 të saj, e për rrjedhim ligjvënësi me Ligjin nr. 8813 datë 13.06.2002 rishkroi versionin origjinal të nenit 452 të K.Pr.Penale duke parashikuar se *“Kërkesa e rishikimit bëhet personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit. Ajo duhet të përmbajë provat që e përligjin dhe duhet të paraqitet, bashkë me dokumentet eventuale, në sekretarinë e Gjykatës së Lartë”*.

Më tej në nenin 453 paragrafi i parë të Kodit aktual citohet se *“Kërkesa e rishikimit shqyrtohet nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve”*. Në lidhje me subjektet e legjitimuara për kërkesë për rishikim parashikohej se mund të kërkonin rishikim së pari, i dënuari ose kujdestari i tij dhe kur ai ka vdekur, trashëgimtari ose një i afërm i tij e së dyti, prokurori pranë gjykatës që ka dhënë vendimin. Ndërkohë që në lidhje me vendimet objekt rishikimi parashikohej se lejohej në çdo kohë rishikimi i vendimeve që kanë marrë formën e prerë edhe kur dënimi ishte ekzekutuar ose shuar si dhe në lidhje me vendimet e pafajësisë për krime mund të rishikoheshin me kërkesë të prokurorit, por me kusht që të mos kishin kaluar 5 vjet nga dhënia e vendimit.

Kodi i Procedurës Penale përpara ndryshimeve me Ligjin nr. 35/2017 në lidhje me shkaqet e rishikimit parashikonte katër raste se kur mund të kërkohej rishikimi i vendimit penal të formës së prerë. *Së pari*, parashikohej se rishikimi mund të kërkohej kur faktet e vëna në themel të vendimit nuk pajtoheshin me ato të një vendimi tjetër të formës së prerë; *së dyti*, kur vendimi ishte bazuar në një vendim të gjykatës civile, i cili ishte revokuar më pas; *së treti*, kur pas vendimit kanë dalë ose janë zbuluar prova të reja, të cilat vetëm ose së bashku me ato që ishin vlerësuar njëherë, tregojnë se vendimi ishte i gabuar e *së katërti*, kur vërtetohej se vendimi

¹⁷ Islami H. “Demokratizimi i legjislacionit penal”, faqe 171-172, Tirane 2000

¹⁸ Miratuar me Ligjin nr. 7905 date 21.03.1995

ishite dhënë si pasojë e falsifikimit të akteve të gjykimit ose të një fakti tjetër të parashikuar nga ligji si vepër penale.

II. Kuadri ligjor aktual mbi rishikimin penal të vendimit të formës së prerë

Me Ligjin nr. 35/2017 u ndërhy dhe në Kreun IV të Kodit të Procedurës Penale në pjesën e ankimeve. Ky ndryshim erdhi dhe si pasojë e ndërhyrjes që iu bë pikës 1 të nenit 141 të Kushtetutës ku kjo dispozitë e ndryshuar me Ligjin nr. 76/2016 parashikon se *“1. Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit.”*

Pra Gjykata e Lartë mbi bazën e ndryshimeve “ka humbur” juridiksionin e saj rishikues për shkak të faktit e detyrimisht ky ndryshim u reflektua dhe në ndryshimet e kodit të procedurës penale duke zbritur shqyrtimin e kërkesës për rishikim të vendimit penal në gjykatën e shkallës së parë. Më konkretisht me ndryshimet e reja në nenin 452 të K.Pr.Penale parashikohet se kërkesa për rishikim paraqitet së bashku me dokumentat eventuale në sekretarinë e Gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin. Një ndryshim domethënës i dispozitave të kodit mbi rishikimin ka të bëjë dhe me vendimet objekt rishikimi ku nuk lejohet rishikimi i vendimit të pafajësisë dhe as rishikimi i vendimit të dënimit kur synohet rëndimi i pozitës së të dënuarit, ndërkohë që vendimet e fajësisë rishikohen në çdo kohë.

Fillimisht mund të themi se me ndalimin e rishikimit në rastet e vendimeve të pafajësisë ligjvënësi ka dashur të sanksionojë dhe njëherë parimin e sigurisë juridike, pasi ndryshe do të ishte e pakuptimtë që pasi i gjykuari ka marrë pafajësi me vendim gjyqësor të formës së prerë të mund t’i nënshtrohej përsëri gjykimit në ngarkim të tij. Ndërkohë që ligjvënësi përveç këtij fakti ndalon rishikimin dhe të vendimit të dënimit në ato raste kur synohet rëndimi i pozitës së të dënuarit. Dhe ky ndryshim përsëri është i arrirë në të njëjtën linjë mendimi si më sipër, pasi nëse i gjykuari është deklaruar fajtor njëherë nuk mundet logjikisht që ti nënshtrohet përsëri një gjykimi të dytë, në ato raste kur synohet një dënim më i rëndë në ngarkim të, ku me rëndim pozite nuk duhet kuptuar vetëm një dënim më i rëndë por dhe në rastin kur synohet ndryshimi i cilësimit ligjor të veprës nga vepra për të cilën është dënuar në një vepër penale tjetër e cila parashikon si kufij dënimi më të lartë sesa vepra e parë për të cilën është dënuar i gjykuari.

Në lidhje me shkaqet e rishikimit neni 450 i Kodit është ndryshuar me Ligjin nr. 35/2017 ku përveç katër rasteve janë shtuar dhe tre raste të tjera se kur mund të kërkohet rishikimi i vendimit të formës së prerë. Më konkretisht me dispozitën e ndryshuar parashikohen si shkaqe të reja rishikimi dhe rastet: kur shkak për rishikimin e vendimit të formës së prerë rezulton nga një vendim i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut që e bën të domosdoshëm rigjykimin e çështjes. Në këtë rast kërkesa për rishikim vendimi duhet të paraqitet brenda gjashtë muajve nga njoftimi i vendimit. Në lidhje me këtë shkak të ri të rishikimit të vendimit të formës së prerë

duhet kuptuar se mund të përbëjë shkak për rishikim jo çdo lloj vendimi i GJEDNJ-së por vetëm ato vendime ku disponohet në lidhje me rigjykimin e çështjes.

Madje në një rast tjetër Gjykata Kushtetuese është shprehur¹⁹ se “...*Interpretimi i Gjykatës së Lartë, se vendimet e GJEDNJ-së nuk janë të barasvlershme me vendimet e gjykatave shqiptare, bie në kundërshtim edhe me nenin 10 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon se marrëdhëniet me autoritetet e huaja në fushën penale rregullohen nga marrëveshjet ndërkombëtare të pranuar nga shteti shqiptar, nga parimet dhe normat përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare, si edhe dispozitat e këtij Kodi. Duke pasur parasysh, veç të tjerave, edhe dispozitën e sipërpërmendur, Gjykata çmon se për sa i përket institutit të rishikimit nuk mund të pretendohet se vendimet, të cilave u referohet neni 450/1/a, janë vetëm ato të dhëna nga gjykatat e Republikës së Shqipërisë, pasi neni 10 i Kodit të Procedurës Penale në mënyrë eksplicite detyron gjykatat që të zbatojnë dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.”*

Një rast tjetër rishikimi të vendimit të formës së prerë është dhe kur ekstradimi i të dënuarit të gjykuar në mungesë jepet me kushtin e shprehur të rigjykimin të çështjes. Kërkesa për rishikim paraqitet brenda tridhjetë ditëve nga data kur personi është ekstraduar dhe kërkesa e paraqitur brenda afatit nuk mund të refuzohet.

Në lidhje me këtë shkak të ri rishikim vendimi të formës së prerë duket se ligjvënësi ka zgjidhur problematikat e hasura në praktikë pasi në jo pak raste është shtruar problemi i rishikimit/rigjykimin të çështjes në rastet e gjykimin në mungesë dhe kur ekstradimi nga jashtë shtetit është lejuar nga autoritetet e huaja me kusht që të rigjykohet çështja. Praktika gjyqësore²⁰ sidomos ajo e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me këtë aspekt ka theksuar se detyrimi për të garantuar paraprakisht respektimin e të drejtës për rigjykim të të ekstraduarit vjen si pasojë e ratifikimit nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr. 8322, datë 02.04.1998, të Konventës së Këshillit të Europës për Ekstradimin dhe të Dy Protokolleve Shtesë dhe në nenin 2 të të cilës parashikohet se: “*Kur një nga Shtetet Palë kërkon nga Shteti tjetër Palë ekstradimin e një personi për qëllim të ekzekutimit të një vendimi ose dënimi të vendosur nga një vendim i dhënë ndaj tij in absentia, pala e kërkuar mund të refuzojë ekstradimin, nëse, sipas saj, procedurat që çuan në marrjen e atij vendimi nuk kanë kënaqur të drejtat minimale të mbrojtjes të njohura për çdo person që akuzohet penalisht. Megjithatë, ekstradimi mund të lejohet nëse pala kërkuuese jep siguri të mjaftueshme se do të garantojë të drejtën e pretenduar të personit për një rigjykim, i cili do të sigurojë të drejtat e mbrojtjes. Vendimi për lejimin do të autorizojë palën kërkuuese ose të zbatojë vendimin në fjalë nëse personi i dënuar*

¹⁹ Shiko Vendimin nr. 20 datë 01.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

²⁰ Shiko Vendimin nr. 21 datë 29.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

nuk e kundërshton këtë, ose, nëse ai e kundërshton, të zhvillojë procedurat kundër personit të ekstraduar”.

Në të njëjtën kohë, bazuar në zhvillimet e reja të legjislacionit në fushën penale, rezulton se është miratuar Ligji nr.10193, datë 03.12.2009 “Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale”, i cili nëpërmjet nenit 51, ka krijuar bazën e përshtatshme ligjore për respektimin e marrëveshjeve ndërkombëtare nëpërmjet detyrimeve që Shteti Shqiptar merr përsipër të realizojë për të përfutur një dimension më të plotë, sa i përket mbrojtjes që siguron parimi i procesit të rregullt ligjor.

Sipas Gjykatës Kushtetuese “...duke mos e vlerësuar garancinë për rigjykim që parashikohet nga Konventa për Ekstradimin, jo vetëm që shkelet një detyrim ligjor ndërkombëtar por, në të njëjtën kohë, nuk krijohen as mundësinë për të qenë i pranishëm në seancë, me qëllim respektimin e parimit të barazisë së armëve. Pretendimin e kërkuesit për të qenë i pranishëm në seancë, në rastin në shqyrtim, Gjykata nuk e lidh me pjesëmarrjen e domosdoshme të kërkuesit në dhomën e këshillimit, por me mundësinë që iu duhet dhënë palëve për t’iu respektuar të drejtën për rigjykim, në kuptim të garancive që jepen nga Shteti Shqiptar, sipas Ligjit nr. 8322, datë 2.4.1998 “Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për Ekstradimin dhe të Dy Protokolleve Shtesë”. Gjykata vlerëson, se interpretimi dhe zbatimi i legjislacionit penal dhe, në veçanti, shqyrtimi i ekzistencës ose jo të shkaqeve ligjore për rishikimin e vendimit, në çështjen konkrete, mbetet një atribut i vlerësimit për Gjykatën e Lartë.”

Ndërkohë që rasti i fundit për rishikimin e vendimit është kur kemi të bëjmë me një person të gjykuar në mungesë sipas nenit 352 të K.Pr.Penale dhe kërkon rigjykimin e çështjes. Në këtë rast kërkesa paraqitet brenda tridhjetë ditëve nga data e marrjes dijeni dhe kërkesa nuk mund të refuzohet. Kujtojmë se në lidhje me nenin 352 të K.Pr.Penale (Gjykimi në mungesë) në rastet kur kemi të bëjmë me një të pandehur në gjëndje të lirë, i cili megjithë kërkimet nuk paraqitet në seancë dhe rezulton se nuk ka marrë dijeni personalisht për gjykimin, atëherë gjykata procedon me pezullimin e gjykimin duke urdhëruar policinë gjyqësore të vazhdojë kërkimet e të pandehurit. Me kalimin e një viti nga data e pezullimit të gjykimin, gjykata rifillon gjykimin duke urdhëruar përsëritjen e njoftimit dhe vetëm edhe pas kërkimeve rezulton se i pandehuri nuk gjendet atëherë gjykata deklaron mungesën e tij. Ndërkohë që në pikën 3 të nenit 352 të K.Pr.Penale parashikohet se gjykata deklaron mungesën dhe në rastin kur provohet se i pandehuri ndodhet jashtë vendit dhe ekstradimi i tij nuk është i mundur.

Pra në rastet kur kemi të bëjmë me të pandehur të gjykuar në mungesë si për shkak se nuk gjendet dhe nuk ka marrë dijeni për gjykimin apo dhe në rastin kur provohet se i pandehuri ndodhet jashtë shtetit dhe ekstradimi i tij nuk ka qënë i mundur, atëherë pasi vendimi të ketë marrë formë të prerë dhe në rastet kur fillon ekzekutimi i tij personi i gjykuar në mungesë ka të drejtë të kërkojë rishikimin e vendimit penale të formës së prerë të dhënë kunrejt tij.

Në lidhje me shqyrtimin e kërkesës për rishikim vendimi kërkesa shqyrtohet siç u citua më sipër nga gjykata e shkallës së parë që ka dhënë vendimin në dhomë këshillimi pa praninë e palëve. Në rastet kur konstatohet se kërkesa është bërë jashtë rasteve të parashikuara nga neni 450 i K.Pr.Penale ose në rastet kur kërkesa është bërë nga persona të palegjitimuar apo kur rezulton haptai e pambështetur gjykata merr vendim mbi mospranimin e saj. Ndërkohë kur kërkesa pranohet, atëherë gjykata vendos dërgimin e çështjes për rigjykim me një tjetër trup gjykues të së njëjtës gjykatë ose vendos dërgimin e çështjes në gjykatën e apelit në rastin kur kërkesa për rishikim ka pasur për objekt vendimin e asaj gjykate. Kundër vendimit mbi pranimin ose mospranimin e kërkesës për rishikim nuk lejohet ankim.

Në rastet kur kërkesa për rishikim pranohet dhe çështja do të rigjykohet atëherë në këtë rast në rigjykim do të zbatohen rregullat e kodit të procedurës penale në lidhje me gjykimin në shkallë të parë. Ndërkohë në nenin 453 të K.Pr.Penale në paragrafin 4 është përcaktuar se deri në dhënien e vendimit nga gjykata e rishikimit, i dënuari ruan të njëjtën pozitë procedurale. Duket se ligjvënësi ka sanksionuar me ligj dhe diskutimet e hasura në praktikë në lidhje me pozitën procedurale të personit. Më konkretisht praktika²¹ ka arsyetuar se *“Në rastin kur kërkesa e të dënuarit pranohet dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në bazë të kompetencës rishikuese që ka sipas nenit 453 të K.Pr.Penale i hap rrugë procesit gjyqësor të rishikimit, i gjykuari do të vazhdojë të ketë statusin procedural të të dënuarit.”*

III. PËRFUNDIME

Me Ligjin nr. 35/2017 ashtu si në pjesët e tjera të kodit të procedurës u ndryshua dhe pjesa e rishikimit të vendimit penal të formës së prerë. Me ndryshimet e reja u zgjidh përfundimisht handikapi i mosparashikimit si shkak rishikimi në ato raste kur Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka dalë me vendim në lidhje me një çështje e cila i ka ezauruar të gjitha shkallët e gjykimin të brendshëm. Megjithatë kjo nuk duhet kuptuar se çdo lloj vendimi i GJEDNJ-së mund të përbëjë shkak për rishikimin e vendimit penale të formës së prerë por vetëm ato vendime të cilat disponojnë në lidhje me rigjykimin e çështjes penale.

²¹ Shiko Vendimin nr. 03 datë 08.07.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ku gjithashtu theksohet se *“Pranimi i kërkesës për rishikim nuk pas sjell në vetvete revokimin e dënimit as edhe lirimin e të dënuarit, por vetëm rihapjen e procesit gjyqësor për efekt të sqarimit të rrethanave të reja me qëllim që vendimi gjyqësor t’i përgjigjet të vërtetës. Ky fakt do të ndodhë vetëm nëse në zbatim të nenit 454 të K.Pr.Penale Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ose gjykata kompetente e cila do të gjykojë çështjen në rishikim, e çmon të nevojshëm pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur nga ecuria e procesit penal vazhdimi i mëtejshëm i vuajtjes së dënimit me burgim do të vinin pasoja të rënda të pariparueshme. Pranimi i kërkesës për rishikim nuk e ndryshon pozitën procedurale nga ajo e të dënuarit në atë të të pandehurit. Në rast se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i hap rrugë rishikimit dhe në gjykimin rishikues në gjykatën e shkallës së parë i gjykuari deklarohet i pafajshëm pozicioni procedural i subjektit nuk është më ai i të dënuarit, por i të pandehurit. Kjo gjendje (statusi i të pandehurit) do të vazhdojë derisa vendimi i ri i pafajsisë i dhënë mbas rishikimit të marrë formë të prerë.”*

Gjithashtu në ligj u zgjidh dhe problematika e mospasjes së mundësisë për ankim në rastin e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë në rastet e rishikimit, pasi me rregullat e reja rishikimi penal zbriti në gjykatën e shkallës së parë e nëse kjo gjykatë çmon se ndodhemi përpara rastit të rishikimit atëherë në rigjykim do të zbatohen rregullat e kodit të procedurës sipas shkallës së gjyqimit. Një risi tjetër përbën dhe fakti që me rregullat e reja nuk mund të ketë rishikim vendimi në rastet kur ndodhemi përpara vendimit të pafajësisë duke garantuar në këtë mënyrë parimin e sigurisë juridike e për më tepër nuk mund të ketë rishikim dhe në ato raste kur sytonohet rëndimi i pozitës së të dënuarit.

BIBLIOGRAFIA

- Ligj Nr. 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Penale, i ndryshuar”
- Islami H., Hoxha A., Panda I., “Procedura Penale, Komentar, Tiranë 2010, ribotim, 2012, 2014, 2015, 2016, Shtëpia botuese “Morava”
- R. Murati, “Rishikimi i procedurës penale për shkak të fakteve dhe rrethanave të reja”, Prishtinë 2006
- *Ligj Nr. 1650 datë 30.03.1953 “Për miratimin e Kodit të Procedurës Penale të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”*
- *Grigor Gjika, “Procedura Penale e Republikës Popullore të Shqipërisë, pjesa e posaçme”, Tiranë 1970*
- *Islami Halim, “Mbi organizimin dhe kompetencat e gjykatave të fshatrave, të qyteteve dhe të lagjeve të qyteteve”, Tiranë 1970*
- *Ligj nr. 6069 datë 25.12.1979 “Kodi i Procedures Penale i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”*
- *Vendim nr. 20 datë 01.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*
- *Vendim nr. 21 datë 29.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*
- *Vendim nr. 03 datë 08.07.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*

REFORMA KUSHTETUESE, REFORMA NË SISTEMIN E DREJTËSISË PENALE PËR PARANDALIMIN E KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIT

Dr. Rezana BALLA

Universiteti Akademia Profesionale e Biznesit,
Fakulteti i Drejtësisë
Përgjegjëse e Departamentit të së Drejtës Penale
e-mail: ballarezana@gmail.com

ABSTRAKT

Ndryshimet e fundit kushtetuese si dhe reforma në drejtësi synojnë të ripërcaktojnë pushtetin gjyqësor dhe sistemin e prokurorisë, të ndalojnë lulëzimin e korrupsionit në fushën e drejtësisë dhe të shkëpusin lidhjet ndërmjet gjyqtarëve dhe prokurorëve me politikën dhe krimin. Ndryshimet përmbajnë propozime të vlefshme për dizenjimin e ardhshëm institucional të drejtësisë shqiptare. Parashikimet janë koherente dhe në përputhje me standartet evropiane. Bashkimi Evropian kërkon që reforma të sigurojë krijimin e një drejtësie të pavarur në vend të aftë për të luftuar korrupsionin endemik dhe të përfundojë mosndërrshkimin e politikanëve. Që prej antarësimit në NATO, Shqipëria u bë vend kandidat në Bashkimin Evropian në Qershor të vitit 2014 dhe nga ana e Brukselit iu kërkuar për t'u bërë më shumë për të luftuar krimin dhe korrupsionin, për administratën publike dhe për të drejtat e pronësisë, por përcaktoi se reforma në drejtësi përbën prioritetin kryesor. Përmbajtja e paketës së reformës në drejtësi është vlerësuar si shumë e mirë duke marrë në konsideratë se disa liderë shqiptarë të cilët në të shkuarën i kanë shpëtuar dënimeve të korrupsionit bazuar teknikalitete procedurale dhe tek gjyqtarët miq dhe këta lidere tani mund të kërcënohen nga pavarësia e gjyqësorit.

Qëllimi i këtij punimi është adresimi ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar ndaj dhunimit të vlerave fundamentale dhe humane të komunitetit, si edhe faktorëve që kanë kontribuar në përforcimin dhe evoluimin e sistemit të drejtësisë penale. Reforma e sistemit të drejtësisë nuk mund të ndalojë në nivel konstitucional, një paketë e tërë e zbatimit të ligjeve do të kërkohet në mënyrë që të rregullohen në detaje më të hollësishme veprimtaria e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe procesit të vettingut, etj. Reforma në drejtësi do të përshkrohet nga fryma e një dialogu konstruktiv dhe aderimi në vlerat dhe praktikatat më të mira evropiane. Por, ajo që adresojmë në këtë artikull është pikërisht përpjekjet që duhet të bëhen për ta çuar përpara këtë reformë me ngrijten e gjykatës kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Rekomandimi sipas këtij artikulli është padyshim krijimi i kuadrit ligjor dhe institucional të përshtatshëm, për të luftuar korrupsionin në nivelet më të larta, veçanërisht të pushtetarëve të lartë shtetërorë.

Fjalë kyçe: krim i organizuar, sekuestrim dhe ngrirje e transaksioneve financiare, institucione financiare, pastrim parash, financimi i terrorizmit; etj.

ABSTRACT

The justice reform recently is determined by the last constitutional amendments and their aim is to redefine or redesign the judicial power and the prosecution system. The new constitutional reform has a major concern which is stopping the flourishing corruption in the justice field and to detach all the relations between judges and prosecutors with the politic and crime. The amendments contain accountable proposals valuable for future redesign of the Albanian institutional justice system. Dispositions are coherent and in compliance with European standards. It is required by the European union for several times that Albanian justice system must ensure the establishment of a new independently system able to tackle the fight against endemic corruption and to finalize politicians' impunity. Since becoming NATO member Albania applied to be European union candidate member as on June 2014, it is required for Albania from the Brussel to invest more effort on the fight against crime and corruption, public administration and property rights, but it is determined that the justice reform constitutes the main priority. The content of the justice reform package has been evaluated as very good, considering that some Albanian leaders who in the past have rescued corruption sentences based on procedural techniques and court judges and these leaders may now be threatened by the independence of the judiciary.

The purpose of this paper is to address national and international legal violations of the fundamental and human values of the community as well as the factors that have contributed to the strengthening and evolution of the criminal justice system. Reform of the justice system can not stop at the constitutional level, a whole package of law enforcement will be required in order to regulate in more details the activities of the High Judicial Council, the High Prosecution Council and the vetting process, etc. Reform in the justice system will be described by the spirit of constructive dialogue and adherence to European values and best practices. What it is addressed by this paper is the fact that every high authority in the Republic of Albania should undertake and strike all efforts necessary for the finalizing of the reform. Above all this reform should be advanced by establishing the special court against corruption and organized crime. The recommendation raised on this paper is undoubtedly the creation of an adequate legal and institutional framework to fight corruption at the highest levels, especially of high state officials.

I - HYRJJE

Në ditët e sotme krimi i organizuar shfaq tendecën e kamuflimit të veprimtarisë kriminale, duke shfrytëzuar rrugët operacionale dhe ligjore të zhvillimit të veprimtarisë, si në sektorin privat ashtu edhe në sektorin publik. Nëpërmjet, këtij punimi synohet të realizohet një trajtim i sistemit juridiko penal të institutit të parandalimit dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe krimit të korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë. Artikulli synon të trajtojë reagimin ligjor dhe institucional kombëtar dhe ndërkombëtar, ndaj shkeljeve të vlerave themelore të bashkësisë njerëzore si dhe faktorëve që kanë qënë kyç në përforsimin dhe evoluimin e sistemit juridiko penal.

Ai shpreh në mënyrë të qartë një trajtim të përgjithshëm ndërkombëtar, një trajtim të hollësishëm mbi legjislationin në Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimit Evropian, si dhe një analizë të hollësishme të legjislationit shqiptar. Punimi nuk synon vetëm një pasqyrë të reagimit juridiko-penal në rrafshin ndërkombëtar, por edhe një reagim institucional mbi praktikën institucionale të institucioneve ndërkombëtare, me qëllim përfitimin e praktikës më të mirë institucionale për pastrimin e parave dhe financimit të terrorizmit. Sipas përfundimeve të arritura në këtë punim rekomandohet reformimi i sistemit ligjor dhe institucional për të bërë eficiente luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit¹.

Republika e Shqipërisë është aktualisht duke reformuar sistemin e drejtësisë. Kohët e fundit kanë hyrë në fuqi ndryshimet që iu bënë Kushtetutës² shqiptare në korrik të vitit 2016. Ndryshimet më të fundit të saj dhe reforma në drejtësi synojnë të reformojnë kryesisht dhe veçanërisht sistemin gjyqësor dhe sistemin e prokurorisë, të parandalojnë dhe të luftojnë lulëzimin e korrupsionit dhe të shkatërrojnë lidhjet e krimit me gjyqtarët e korruptuar. Ndryshimet përmbajnë dispozita të qarta dhe të plota, mbi riformatimin e ardhshëm të sistemit gjyqësor. Këto ndryshime në legjislation janë koherente dhe në përputhje me standartet evropiane. Bashkimi Evropian³ kërkon që reforma në sistemin gjyqësor të kthejë sistemin gjyqësor, në një sistem vertet të pavarur, të aftë për të luftuar korrupsionin endemik dhe t'i japë fund pandërshkueshmërisë së politikanëve. Që prej antarësimit në NATO, Shqipëria u bë kandidat për t'u bërë pjesë e bashkimit evropian në Qershor të vitit 2014. Nga ana e Brukselit i është kërkuar që të bëjë më shumë për të luftuar krimin

¹ Balla, R., "Reagim Ligjor apo Ushtarak ndaj Fenomenit të Terrorizmit sipas Legjislationit Shqiptar dhe Ndërkombëtar", "Revista Shkencore, E Drejta Parlamentare, Tirana, 2007, fq. 98.

² Ndryshimet më të fundit janë bërë me Ligjin nr. 76/2017 "Për disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin nr. 8417 datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 138, viti 2006.

³ Bazuar në raportet e progresit të Komisionit Evropian për Eficencën në Drejtësi i cili është themeluar në 18 September 2002 me Resoluten Res(2002)12 të Komitetit të Ministrave Keshillit të Europës. https://www.coe.int/t/dghl/cooperation/cepej/presentation/cepej_en.asp. Autorja ka qene perfaqesuese e Republikës së Shqipërisë nga vitet 2006-2010 pranë CEPEJ.

dhe korrupsionin, administratën publike dhe të drejtat dhe liritë njerëzore dhe të pronave, por të vendosë si prioritet të të gjitha këtyre reformën në sistemin gjyqësor. Në të kaluarën shumë pushtetarë i kanë shpëtuar dënimeve të korrupsionit bazuar në disa taktika të gjyqtarëve miq të tyre, por tashmë kjo reformë do të sigurojë pavarësi të plotë të pushtetit gjyqësor.

Pavarësisht nga sa parashtruam, procesi i hartimit të ligjeve, në përputhje me Kushtetutën është i gjatë dhe i vështirë, duke përcaktuar vazhdimin e përpjekjeve për hartimin e legjisllacionit demokratik modern. Gjithsesi, mund të shprehemi se tashmë është plotësuar pothuajse kuadri ligjor, i cili perbën një premisë të domosdoshme për shtetin e së drejtës. Sfida, që na paraqitet tashmë është akoma më e madhe, duke marrë në konsideratë funksionimin e mekanizmave të ndryshëm të kontrollit të zbatimit të kuadrit ligjor të përcaktuar. Vecanërisht, krijimi dhe frymëzimi i një mentaliteti të ri, që do të përfshijë si funksionarët publike ashtu edhe sensibilizimin e qytetarëve në zbatimin e normave juridike dhe përdorimin e mjeteve ligjore e demokratike ndaj shkeljeve të tyre.

II - Gjykatat dhe Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

Bazuar në nenin 135 të Kushtetutës⁴ së ndryshuar përcaktohet krijimi i gjykatave të specializuara. Këto gjykata do të krijohen me ligj si gjykata të specializuara, në nivelin e shkallës së parë dhe gjykatë të apelit për të gjykuar krimin e organizuar dhe korrupsionin dhe akuzat penale kundër zyrtarëve të lartë në raste të shkeljeve disiplinore dhe të marrjes së masave disiplinore për antarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektorin e Lartë Gjyqësor dhe Prokurorin e Përgjithshëm. Gjithashtu, këto gjykata do të gjykojnë gjyqtarë dhe personelin gjyqësor të këtyre gjykatave si edhe antarët e afërt të familjeve të tyre. Në bazë të ligjit për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve do të bëhet një verifikimi i pasurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve një vlerësim profesional i tyre dhe i llogarive financiare dhe të telekomunikacionit në përputhje me këtë ligj. Ashtu siç është vlerësuar nga institucionet ndërkombëtare dhe është pranuar tashmë edhe nga qeveria, lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar si një çështje e jashtëzakonshme do të themelojë krijimin e gjykatave speciale për të trajtuar dhe gjykuar këto çështje të rëndësishme penale.

Në mënyrë që të bëhet efektive lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar është parashikuar themelimi i një prokurorie të posaçme në sistemin e drejtësisë penale i cili përcakton nevojën për prokurorë që të jenë në pozitë ose të aftë për të ushtruar ndjekjen penale për këto krime të rënda si korrupsioni dhe krimi i organizuar pa ndonjë ndalesë ose pengesë⁵, por të ndjekë në mënyrë objektive dhe

⁴Omari, L., Anastasi A., E Drejta Kushtetuese, publikuar ABC, Tirana 2008, pg. 35-200.

⁵Bazuar në opinionin e Komisionit të Venecias. [http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)036-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)036-e)

të çojë përpara gjykatës penale të posacme personat që kanë kryer ose konsumuar këto vepra penale të rënda. Në vitet e fundit, shtetet që kanë themeluar dhe ngritur prokurori të tilla përfshijnë Rumaninë, Kroacinë, Malin e Zi, Ukrainën, dhe ish Republika Jugosllave e Maqedonisë. Disa, Prokurori të tilla kanë ekzistuar për vite me rradhë si për shembull në Britaninë e Madhe është ushtruar ndjekja penale dhe investigimi për mashtrimet dhe korrupsionet e rënda dhe serioze nga Zyra e Krimeve të Rënda dhe Korrupsionit e cila është krijuar që prej vitit 1987. Bazuar në opinionin e Komisionit të Venecias me anë të të cilit rekomandohet se roli i prokurorisë së posaçme duhet të jetë i pavarur nga Prokurori i Përgjithshëm, e cila është një dispozitë që është përshëndetur nga institucionet ndërkombëtare që kanë qënë të përfshira në procesin e hartimit dhe miratimit të ndryshimeve kushtetuese dhe ligjit për ngritjen dhe funksionimin e Prokurorisë së Posaçme. Sipas, nenit 148 të Kushtetutës parashikohet zgjedhja e Kryetarit të Prokurorisë së Posaçme nga rradhët e trupës së prokurorëve. Këtu duhet të mbahet parasysh që personat që do të zgjidhen të mos kenë asnjë lidhje me politikën dhe të përjashtohen ndërhyrjet e saj në këtë proces.

Një ndër risitë që sjell ky ligj është ulja e standardit të provueshmërisë që kërkohet për të provuar ose krijuar lidhjen e pasurisë me krimin e organizuar, trafikimin apo korrupsionin dhe krimet e tjera në funksion të sekuestrimit dhe konfiskimit të saj. Ligji sanksionon standardin “dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicie” me qëllim aplikimin e dispozitave të tij ndaj pasurisë së personave që sipas këtij standardi provueshmërie rezultojnë se janë të përfshirë në një nga krimet që përcaktohen në ligj.

Po kështu e veçanta e ligjit qëndron në faktin që dispozitat e tij janë të aplikueshme edhe ndaj pasurive të personave që janë lidhje e afërt gjaku me personin e dyshuar, si të përfshirë në veprimtari kriminale, ndaj pasurisë së personave fizikë ose juridikë, kur ka të dhëna që pasuritë e tyre zotërohen pjesërisht ose plotësisht nga këta persona të dyshuar si dhe ndaj trashëgimtarëve.

Gjithashtu ligji i shtrin efektet edhe ndaj pasurisë së personave të krijuara para hyrjes në fuqi të ligjit me kushtin që këto pasuri të jenë krijuar ose vënë si rezultat i përfshirjes së personit të dyshuar në veprimtari kriminale.

Është shumë e rëndësishme për tu theksuar raporti që vendoset ndërmjet procedurës së caktimit dhe zbatimit të masave parandaluese sipas këtij ligji me gjendjen, shkallën apo mënyrën e përfundimit të procedimit penal që zhvillohet ndaj personave të dyshuar subjekte të këtij ligji. E thënë ndryshe procedura dhe zbatimi i masave parandaluese që përcakton ky ligj janë autonome dhe nuk ndikohen nga ecuria apo mënyra e përfundimit të një procedimi penal që mund të jetë duke u zhvilluar ndaj një ose disa personave të dyshuar.

III - Korniza Ligjore

Në procesin e hartimit dhe miratimit të ndryshimeve Kushtetuese dhe paketave ligjore për zbatimin e këtyre ndryshimeve kanë marrë pjesë dhe kanë kontribuar me

opinionet dhe ndihmën e tyre shumë institucione ndërkombëtare si PAMECA IV, EURALIUS, OPDAT, etj.

Përveç dispozitave të reja që janë miratuar tashmë një punë e madhe është bërë në kuadrin e kodifikimit të këtyre ndryshimeve me legjislacionin aktual. Kështu janë propozuar ndryshime në legjislacion që ta sjellin atë në përputhje me nenin 75/a të projektligjit të Kodit të Procedurës Penale⁶ që parashikon juridiksionin e gjykatave kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Sipas ndryshimeve kushtetuese⁷ janë ngritur gjykata të reja: shkalla e parë dhe apeli për të gjykuar të gjitha veprat penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Konkretisht neni 135 paragrafi 3 i këtyre ndryshimeve parashikon si vijon: “3 Gjykata e posaçme e shkallës së parë dhe e apelit për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe të akuzave penale kundër funksionarëve të lartë.”.

Këto ndryshime kushtetuese janë pasqyruar si duhet në projektligjin e Kodit të Procedurës Penale që parashikon juridiksionin e këtyre gjykatave dhe në projektligjin “Mbi organizimin dhe funksionimin e institucioneve kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar”. Sikundër u shpjegua më lart, shkronja a) e paragrafit të parë të këtij neni është hequr dhe ndryshuar për të përfshirë pjesëmarrjen dhe kryerjen jo vetëm të veprave penale të parashikuara nga nenet 333 “Organizata kriminale⁸” dhe 333/a “Grupi i strukturuar kriminal”, por të gjitha veprat penale të parashikuara nga Kreu XI i Kodit Penal “Veprat penale të kryera nga banda e armatosur dhe organizata kriminale”.

Për këto arsye dispozitat e ligjit Anti-mafia zbatohen gjithashtu, mbi pasurinë që zotërohen plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të personave mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicie, për të gjitha veprat penale të parashikuara nga Kreu XI i Kodit Penal. Shkronja b) e këtij neni është fshirë dhe ndryshuar për të njëjtën arsye dhe llogjikë.

Gjykatat e reja kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar do të gjykojnë jo vetëm veprat penale të parashikuara nga nenet 234/a “Organizata terroriste” dhe 234/b “Banda e armatosur”, por të gjitha veprat penale të parashikuara nga Kreu VII i Kodit Penal “Veprat penale për qëllime terroriste”.

Për këto arsye dispozitat e ligjit Anti-mafia zbatohen gjithashtu mbi pasurinë që zotërohen plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të personave mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicie, për të gjitha veprat penale të parashikuara nga Kreu VII i Kodit Penal. Kjo është gjithashtu arsyeja për të cilën shkronja c) është fshirë dhe bashkuar me shkronjën e re b).

⁶ Ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale publikuar në Fletoren Zyrtare, Maj 2017.

⁷ Ndryshimet e reja Kushtetuese miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 138 Korrik 2016.

⁸ Kodi Penal.

Për sa më sipër rendi alfabetik i shkronjave në paragrafin 1 është ndryshuar. Shkronja d) e cila është shkronja e mëparshme dh) pasqyron ndryshimet e PAMECA por jo vetëm. Ajo pasqyron të gjitha veprat e parashikuara në projektin e Kodit të Procedurës Penale si vijojnë: Neni 244 “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”; Neni 244/a “Korrupsioni aktiv i nëpunësve të huaj publikë”, Neni 245 “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendore”, Neni 245/1 “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, Neni 248 “Shpërdorimi i detyrës”, Neni 256 “Shpërdorimi i kontributeve të dhëna nga shteti”; Neni 257 “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”; Neni 258 “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”; Neni 259 “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”; Neni 259/a Korrupsioni pasiv i nëpunësve të huaj publikë”; Neni 260 “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, Neni 319 “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, Neni 319/a “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare”; Neni 319/b “Korrupsioni aktiv i arbitrit vendas dhe të huaj” Neni 319/c “Korrupsioni aktiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja”; Neni 319/ç “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”; Neni 319/d “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare”; Neni 319/dh “Korrupsioni pasiv i arbitrit vendas dhe të huaj” dhe Neni 319/e”.

Nevojitet të theksohet që projekti i Kodit të Procedurës Penale është në diskutim e sipër dhe neni 75/a mund të jetë objekt ndryshimesh në varësi të diskutimeve të Kodit të Procedurës Penale, të cilat më pas duhet të pasqyrohen si duhet në këtë projekt; Neni 7 Paragrafi i parë i nenit 7 është ndryshuar duke zëvendësuar Gjykatën e Shkallës së Parë dhe Apelit për Krimet e Rënda me Gjykatën e Shkallës së Parë dhe Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar. Këto ndryshime janë propozuar me qëllim për ta sjellë këtë nen në përputhje me formulimin dhe emrin e këtyre gjykatave të parashikuara nga projekti i ndryshimeve kushtetuese i cili thotë si vijon në neni 135 paragrafi 3 “Gjykata e posaçme e shkallës së parë dhe e apelit për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimet të organizuar, si dhe të akuzave penale kundër funksionarëve të lartë.

Këto projekt ndryshime kushtetuese janë reflektuar më pas në projektligjin e Kodit të Procedurës Penale dhe projektligjin “Mbi organizimin dhe funksionimin e institucioneve kundër korrupsionit dhe krimet të organizuar”. Përsa I përket nenit 12 të projektligjit përveç propozimeve të PAMECA IV për këtë nen të cilat janë pasqyruar si duhet, EURALIUS propozon të ndryshohet më tej paragrafi 3 i këtij neni duke zgjatur afatin e zbatimit të masës së sekuestros nga tre në gjashtë muaj por jo më shumë se dy vjet me qëllim për të qene në përputhje me nenin 324 të projektligjit të ri të Kodit të Procedurës Penale. Kjo periudhë duhet të zgjatet

deri sa vendimi të marrë formë të prerë, me qëllim që të parandalohet çdo shitje e mundshme e pronësisë nga personi.

Neni 27/a është parashikuar si një nen i ri por formulimi është assis-tuar nga misionet e asistences ligjore PAMECA dhe EURALIUS. Kështu është parashikuar që kundra vendimeve të gjykatës së apelit, mund të ushtrohet rekurs sipas rregullave të parashikuara në projektligjin e Kodit të Procedurës Penale. Neni 37 është ndryshuar në paragrafin e parë duke hequr periudhën dhe shumën 50% për arsye se të ardhurat e fituara nëpërmjet zbatimit të këtij ligji nuk duhet të kufizohen në sasi apo në kohë. Paragrafi i dytë është ndryshuar për të përfshirë Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme si një strukturë e re për të ndjekur penalisht korrupsionin dhe krimin e organizuar sikundër është parashikuar nga projekti i ri i ndryshimeve kushtetuese, konkretisht neni 148 paragrafi i dytë që thotë si vijon “Prokuroria e Posaçme për ndjekjen penale si dhe njësia e posaçme për hetimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar, si dhe të akuzave penale kundër funksionarëve të lartë janë të pavarura nga Prokurori i Përgjithshëm dhe krijohen me ligj”.

IV - KONKLUZIONE

Në lidhje me kuadrin ligjor që prezantuar më sipër vlerësojmë se këto ndryshime si ato kushtetuese por edhe ndryshimet e gjithë paketës ligjore anti-mafia janë dispozita shumë progresive dhe padyshim do të ndihmojnë në luftën kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit. Reforma e sistemit gjyqësor nuk mundet të ndalojë në nivel kushtetues. Tashmë janë miratuar ligjet për ngritjen e funksionimin e gjykatës speciale dhe prokurorisë speciale, për luftën kundër krimin të organizuar korrupsionit nga pushtetarët e niveleve të larta shtetërore. Ligje të tjera janë implementuar për krijimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe ligjet për krijimin dhe funksionimin e institucioneve të kontrollit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Reforma duhet të përshkruhet nga fryma konstruktive e dialogut dhe aderimit në vlerat europiane dhe praktikat me të mira. Lidhur me shqetësimet e partisë demokratike dhe të disa nga gjyqtarëve dhe prokurorëve në lidhje me shkeljet e neneve 6 dhe 8 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut në procesin e reformës në drejtësi të drejtat dhe liritë që përmbahen në skemën legislative dhe kushtetuese duken të plota dhe ky është një qëllim legjitim në vështrimin e nenit 8 të Konventës. Kështu që ne mund të përfundojmë se bazuar në ndryshimet kushtetuese dhe pakata ligjore në zbatim të saj, çdo qytetar shqiptar është shpresëplotë se reforma në drejtësi do ta çojë vendin përpara intergimit në Bashkimin Evropian.

BIBLIOGRAPHY

1. Ndryshimet e reja Kushteuëse miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 138 Korrik 2016.
2. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë 1998, publikuar në Fletoren Zyrtare 1998.
3. Kodi Penal.
4. Ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale publikuar në Fletoren Zyrtare, Maj 2017.
5. Omari, L., Parimet dhe Institucionet e së Drejtës Shtetërore, publikuar “Pegi” Tiranë, 2005.
6. Omari, L., Anastasi A., E Drejta Kushtetuese, publikuar ABC, Tiranë 2008.
7. Balla, R., “Reagim Ligjor apo Ushtarak ndaj Fenomenit të Terrorizmit sipas Legjislacionit Shqiptar dhe Ndërkombëtar”, “Revista Shkencore, E Drejta Parlamentare, Tiranë, 2007,
8. Resolution Res(2002)12 of the Committee of Ministers of the Council of Europe.
9. CEPEJ yearly Progress Reports for year 2006-2008, 2008-2010 https://www.coe.int/t/dghl/cooperation/cepej/presentation/cepej_en.asp.
10. The opinion of the Venice Commission. [http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)036-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)036-e).

RISITË DHE SFIDAT E PËRFSHIRJES SË LLOJEVE TË REJA TË GJYKIMEVE TË POSAÇME NË KODIN E PROCEDURËS PENALE

Av. Franc TERIHATI¹
Msc. Arbesa KURTI²

ABSTRAKT

Në datën 1 Gusht 2017, hyri në fuqi ligji për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Penale, i cili ka sjellë risi dhe ndryshime thelbësore në zhvillimin e procesit penal, që nga faza e hetimeve paraprake deri në dhënien e vendimit përfundimtar nga gjykata. Një nga ndryshimet e rëndësishme që është bërë, lidhet me parashikimin e dy llojeve të reja të gjykimeve të posaçme, konkretisht “*urdhri penal*” dhe “*gjykimi me marrëveshje*”.

Parashikimi i dy llojeve të reja të gjykimeve të posaçme, krahas dy llojeve që ishin të parashikuara në Kod, si “*gjykimi i posaçëm*” dhe “*gjykimi i drejtëpërdrejtë*”, erdhi si domosdoshmëri për mirëfunksionimin e procesit penal dhe dhënien e drejtësisë penale. Shmangia e procedurës së gjykimit të zakonshëm dhe zbatimi i llojeve të reja të gjykimeve të posaçme, do të ketë ndikim në ekonominë gjyqësore, nëpërmjet shkurtimeve të shpenzimeve gjyqësore, uljen e ngarkesës në punë të gjykatave dhe prokurorive, për veprat penale që kanë një rrezikshmëri të ulët dhe uljen e numrit të të burgosurve në burgje.

Qëllimi i këtij punimi është analizimi i dispozitave ligjore të Kodit të Procedurës Penale që parashikojnë llojet e reja të gjykimeve të posaçme, risitë dhe avantazhet që do sjell në praktikë zbatimi i tyre, si do të garantohen të drejtat procedurale të të pandehurve dhe viktimave të veprave penale, duke e ndërthurur analizën ligjore me praktikën gjyqësore.

Fjalët kyçe: urdhri penal, gjykimi me marrëveshje, i pandehur, viktimë.

I. HYRJA

Nga viti 1995, vit kur hyri në fuqi Kodi i Procedurës Penale, njiheshin dy forma procedimi të posaçme, të cilat ishin përshtim nga gjykimi i zakonshëm, siç është gjykimi i drejtëpërdrejtë dhe gjykimi i shkurtuar. Në kuadër të reformimit të sistemit

¹ Diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë Tiranë, email: francterihati@yahoo.com

² Diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë, email: arbesakurti@gmail.com, pedagog e jashtme në Univeristetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë

të drejtësisë në Shqipëri, gjatë analizës që iu bë sistemit të drejtësisë³, u konstatua se gjykimi i shkurtuar zbatohet pa asnjë kufizim për të gjithë kategoritë e veprave penale dhe për të gjithë autorët, ndërsa gjykimi i drejtëpërdrejtë është zbatuar më pak.

Lehtësimi i procedurave gjyqësore, është në përputhje me standartet ndërkombëtare dhe me rekomandimet e Këshillit të Evropës⁴, të cilat parashikojnë se procedurat penale duhet të lehtësohen kur kemi të bëjmë me vepra penale jo shumë të rrezikshme, me qëllim pasjen e një sistemi drejtësie efikas dhe brenda një afati të shkurtër.

Me ndryshimet që i'u bënë KPP, përveç gjykimit të shkurtuar dhe gjykimit të drejtëpërdrejtë, u shtuan dhe dy lloje të reja të gjyqësorëve të posaçme, gjykimi me marrëveshje dhe urdhri penal.

Në këtë punim do analizojmë në mënyrë të detajuar se si do të zbatohen në praktikë “gjykimi me marrëveshje” dhe “urdhri penal”, duke u ndalur në mënyrë të veçantë në disa nga problematika që mund të hasen gjatë zbatimit të tyre, konkretisht për garantimin dhe respektimin e të drejtave të të pandehurit dhe të viktimave.

II. Gjykimi me marrëveshje, si një risi në KPP dhe sfidat që do sjellë në praktikë zbatimi i kësaj procedure

Gjykimi me marrëveshje është një procedurë që shmang gjykimin e zakonshëm, duke u bazuar në një marrëveshje që lidhet midis prokurorit dhe të pandehurit. Ky lloj gjykimi njihet dhe në shtete të tjera, psh në Kodin e Procedurës Penale Italiane, si dhe është rekomanduar dhe në aktet ndërkombëtare, pasi është një procedurë e shpejtë, efikase, garanton të drejtat e të pandehurit dhe rivendos në vend të drejtat e viktimave. Gjykimi me marrëveshje është parashikuar në neni 406/d deri në neni 406/f të KPP, në të cilën janë parashikuar kushtet dhe kriteret kur zbatohet kjo procedure.

1. Procedura e lidhjes së marrëveshjes midis prokurorit dhe të pandehurit

Gjykimi me marrëveshje zhvillohet mbi bazën e një marrëveshjeje që lidhet midis prokurorit dhe të pandehurit. Në mënyrë që marrëveshja të jetë e vlefshme, duhet të përmbushen kushtet dhe kriteret e mëposhtme:

1. Vullneti dhe pëlqimi i të pandehurit

Një nga elementet thelbësor mbi të cilën mbështet kjo procedure, është pëlqimi dhe vullneti i plotë dhe i lirë i personit të akuzuar. Pranimi i fajësisë nga

³ Shih “*Analiza e Sistemit të Drejtësisë*”, hartuar nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, Qershor 2015, fq 149

⁴ Shih Rekomandimi nr. (87)18E i Komitetit të Ministrave pranë Këshillit të Evropë, 1987 “*Në lidhje me lehtësimin e procedurave në sistemin drejtësisë penale*”

i pandehuri është një element kyç i marrëveshjes, pasi ndryshe nga gjykimi i zakonshëm, ku fajësia apo pafajësia vërtetohet në përfundim të hetimit gjyqësor, në këtë rast marrëveshja lidhet mbi pohimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, dhe në “këmbim” të këtij pohimi bëhet dhe caktimi i llojit dhe masës së dënimit.

Edhe gjykata, elementin e parë që verifikon është nëse vullneti i personit ka qenë i lirë dhe i pa vesuar. Në rast se konstatohet që marrëveshja është lidhur nën kushtet e kërcënimit ose i pandehuri nuk i ka kuptuar kushtet e marrëveshjes, gjykata nuk e miraton atë, pasi vullneti është një element, mungesa e të cilit sjellë pavlefshmërinë e marrëveshjes. Për të garantuar që i pandehuri i kupton kushtet e marrëveshjes dhe vullneti i tij është i plotë në nënshkrimin e marrëveshjes, si dhe për të garantuar të drejtat procedurale në këtë proces, në Kod është parashikuar që gjatë bisedimeve për lidhjen e marrëveshjes është e detyrueshme pjesëmarrja e avokatit. Në rastet ku i pandehuri nuk ka zgjedhur një mbrojtës, ai i sigurohet *ex officio* nga organi i akuzës ose nga gjykata.

2. Vepra penale për të cilën akuzohet personi dënohet në maksimum jo më shumë se 7 vjet burgim

Gjykimi me marrëveshje zbatohet vetëm në rastet kur një person akuzohet për vepra penale, të cilat e kanë dënimin maksimal jo më shumë se 7 vjet burgim. Sipas këtij kufizimi, gjykimi me marrëveshje zbatohet si për kundërvajtje ashtu edhe për krime. Referuar pjesës së posaçme të Kodit Penal, disa nga veprat penale, për të cilat mund të zbatohet gjykimi me marrëveshje janë shitëblerja e paligjshme e organeve (neni 89/a), përfitimi apo përdorimi i shërbimeve të ofruar nga personat e trafikuar (neni 110/b), kontrabanda me mallëra të tjera (neni 174), moskryerja e detyrave nga organet tatimore (neni 181/a parag.1) etj.

Referuar veprave të mësipërme, konstatojmë që këto vepra kanë një rrezikshmëri të lartë, për këtë arsye organi akuzës dhe gjykata duhet të analizojnë dhe vlerësojnë me kujdes kushtet dhe kriteret për zhvillimin e kësaj procedure.

3. Përmbajtja e marrëveshjeje

Nga vetë emërtimi i këtij gjykimi, kusht thelbësor për këtë proces është ekzistenca e një marrëveshje me shkrim, e lidhur midis prokurorit dhe të pandehurit. Elementet që duhet të përmbajë marrëveshja janë:

- a. përshkrimi i qartë i faktit penal, për të cilin akuzohet i pandehuri;*
- b. cilësimin juridik të faktit;*
- c. deklarinë e pohimit të fajësisë nga ana e të pandehurit;*
- d. llojin dhe masën e dënimit penal kryesor, dënimit plotësues;*
- e. mënyrën e ekzekutimit të tyre, për të cilat palët kanë rënë dakord;*
- f. disponimet për provat materiale dhe sendet që i përkasin veprës penale, si dhe për konfiskimin e mjeteve e produkteve të veprës penale, sipas nenit 36 të Kodit Penal;*

- g. në rastin kur është legjitimuar paditësi civil, pëlqimin e tij me shkrim për masën e shpërblimit të dëmit nga i pandehuri;
- h. shumën e shpenzimeve procedurale;
- i. nënshkrimet e palëve dhe të mbrojtësit.

Mos përmbushja e njërit prej elementeve të mësipërm sjell pavlefshmërinë e marrëveshjes. Nga analiza e elementeve të mësipërme konstatohet që prokurori ka një diskrecion shumë të madh, në përcaktimin e faktit penal dhe cilësimin juridik të tij, si dhe përcaktimin e llojit dhe të masës së dënimit. Për të balancuar këtë pozitë të prokurorit, është parashikuar pjesmarrja e detyrueshme e avokatit. Referuar nenit 49 të KPP, duke qenë se jemi përpara një dispozite që parashikon pjesmarrjen e detyrueshme të avokatit, në rast kur pandehuri nuk ka zgjedhur një avokat dhe është në pamundësi financiare, avokati i caktohet kryesisht nga organi i akuzës. Pikëpyetja që ngrihet është se sa i paanshëm dhe profesional do jetë një avokat i caktuar nga organi i akuzës për të lidhur një marrëveshje me vetë prokurorin dhe a garantohen në mënyrë të plotë të drejtat procedurale të të pandehurit⁵. Edhe pas ndryshimeve në KPP konstatohet që nuk janë adresuar problematikat për të zgjidhur “konfliktin e interesit” midis avokatit dhe prokurorit.

Një element tjetër jo shumë efektiv dhe problematikë është pjesa e legjitimitetit të viktimave dhe përcaktimi i masës së dëmshpërblimit. Sipas parashikimit të mësipërm është prokurori ai që do të legjitimojë viktimën dhe do ta përfshijë në marrëveshje. Përcaktimi i një elementi të tillë, pa specifikuar mënyrën dhe procedurën se si do të përfshihet viktimja, si do të caktohet masa e dëmshpërblimit dhe kriteret e llogaritjes së dëmit, është një tagër “quazi gjyqësor” që i është lënë prokurorit dhe mund të kthehet në abuzim dhe në cënim të të drejtave të viktimave.

4. Lidhja e marrëveshjes përpara fillimit të hetimit gjyqësor

Të drejtën për të kërkuar zhvillimin e procedimit me gjykim me marrëveshje e ka prokurori, i pandehuri/përfaqësuesi i tij. Marrëveshja duhet të lidhet përpara fillimit të hetimit gjyqësor. Nga interpretimi *a contrario* që i bëhet dispozitës, në rast se hetimi gjyqësor ka filluar, nuk mund të kërkohej që të arrihet një marrëveshje, por do vazhdohej me gjykimin e zakonshëm. Dispozita parashikon se e drejta për të kërkuar lidhjen e një marrëveshje fillon nga momenti kur bëhet rregjistrimi i emrit të personit që i atribuohet vepra penale.

Megjithëse Kodi e njeh këtë të drejtë nga ky moment, shprehim mendimin që marrëveshja duhet të lidhet nga momenti kur prokurori ka mbledhur provat e mjaftueshme dhe ka krijuar bindjen se fakti përbën veprë penale dhe kjo veprë është kryer nga ky person⁶. Kërkimi i lidhjes së marrëveshjes që në momentin që rregjistrohet emri, mund të krijojë abuzime, pasi në momentin që rregjistrohet

⁵ Shih Studimin “Efektiviteti i Ndhmës Juridike në Procesin Penal në Shqipëri”, Qendra Res Publica, Mars 2016, fq 151

⁶ Shih Vendimi nr.3, datë 27.09.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

emri i personit, hetimet sapo kanë filluar dhe nuk ka prova të mjaftueshme për të vërtetuar ekzistencën e veprës penale dhe për të provuar fajësinë e personit. Për këtë arsye mendojmë që momenti kur duhet të kërkohet lidhja e një marrëveshjeje është momenti kur të pandehurit i njoftohet akuza.

Kodi parashikon se nuk mund të pranohet marrëveshja kur bëhet vetëm pranimi i pjeshëm i akuzave, që do të thotë nëse i pandehuri akuzohet për më shumë se një veprë penale, ai duhet të shpreh vullnetin për të lidhur marrëveshje për të gjitha akuzat. Shikohet problematikë fakti sesi do të përcaktohet dënimi për secilën akuzë dhe si do të bëhet mbledhja e dënimeve. Në kushtet kur Kodi nuk ka parashikuar rregulla të qarta për këtë pjesë, bashkimi i dënimeve do bëhet sipas parashikimit të Kodit Penal dhe është në kompetencë të prokuroit zbatimi i kësaj procedure.

Një pyetje që ngrihet lidhet në rast se kemi disa bashkpunëtor, disa prej të cilëve kërkojnë lidhjen e marrëveshjes dhe disa zhvillimin e gjykimit të zakonshëm, cila procedurë do të zbatohet?

Në Kod nuk është parashikuar asnjë procedurë se si do të veprohet në këto raste, pasi nëse do të pranohet faktin që çështja mund të ndahet dhe për pandehurin që kërkon lidhjen e marrëveshjes mund të procedohet me gjykimin me marrëveshje ndërsa për bashkpunëtorët e tjerë mund të procedohet me gjykim të zakonshëm, pyetja që ngrihet është se cila do jetë vlera provuese e marrëveshjes në gjykimin e zakonshëm? Shprehim mendimin që në këto raste nëse çështja mund të ndahet, mund të procedohet me gjykime të ndara dhe marrëveshja mund të vlerësohet në unitet me provat e tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre sipas nenit 152 pika 3 e KPP.

2. Procedura gjyqësore për miratimin e marrëveshjes

Pas nënshkrimit të marrëveshjes dhe plotësimit të të gjitha kushteve për vlefshmërinë e marrëveshjes, prokuroi e dërgon marrëveshjen për miratim në gjykatë⁷. Gjykata brenda 30 ditëve nga momenti nënshkrimit të marrëveshjes, zhvillon seancën gjyqësore, duke njoftuar për datën e seancës, prokurorin, të pandehurin dhe mbrojtësin, si dhe viktimën. Sërisht në këtë dispozitë konstatohet një pozitë jo shumë e favorshme për viktimën, pasi në Kod parashikohet se mospjesmarrja e viktimës nuk përbën shkak për mos zhvillimin e gjykimit, megjithëse siç u shprehëm dhe më lartë në marrëveshje mund të jetë përcaktuar masa e dëmshpërblimit. Nëse vendimi merr formë të prerë dhe është përcaktuar dhe masa e kompensimit për viktimën, ai nuk mund të kërkojë dhe ti drejtohet gjykatës civile, për tu dëmshpërblyer nëse nuk është dakort me vlerën e përcaktuar, pasi ky fakt do konsiderohet “*res judicata*”.

Ndryshe nga gjykimi i zakonshëm, në gjykimin me marrëveshje gjykata luan vetëm një rol verifikues, nëse janë plotësuar kushtet e vlefshmërisë së marrëveshjes. Gjithashtu gjykata nuk ka të drejtë të ndryshojë kushtet e përcaktuara në marrëveshje, as llojin dhe masën e dënimit.

⁷ Shih nenin 406/dh të Kodit të Procedurës Penale

Gjatë seancës gjyqësore, pasi prokurori përmbledh çështjen dhe kushtet e marrëveshjes, gjykata pyet të pandehurin, prania e të cilit është e detyrueshme në këtë seancë, në lidhje me:

- a) nëse e ka bërë marrëveshjen me vullnetin e tij të lirë;
- b) nëse ka qenë i përfaqësuar nga mbrojtësi në bisedimet për arritjen dhe nënshkrimin e saj;
- c) nëse e kupton marrëveshjen dhe përmbajtjen e saj;
- ç) nëse i ka kuptuar pasojat që vijnë prej miratimit të marrëveshjes;
- d) nëse jep pëlqimin që marrëveshja të miratohet dhe të vihet në ekzekutim.

Përveç verifikimit formal të ekzistencës së kushteve dhe elementeve të marrëveshjes, si dhe ekzistencës së vullnetit të të pandehurit, gjykata verifikon nëse cilësimi juridik i faktit është i saktë dhe nëse nuk ekzistojnë shkaqe për pushimin ose mofillimin e gjykimit.

Nëse konstatohet që cilësimi nuk është i saktë dhe provat janë në kundërshtim me pohimin e të pandehurit, gjykata vendos mos miratimin e marrëveshjes dhe kthimin e çështjeve prokurorit. Gjithashtu gjykata vendos kthimin e çështjeve prokurorit, në rastet kur konstatohet që vullneti i të pandehurit është i vesuar ose në rastet kur i pandehuri heq dorë nga marrëveshja gjatë seancës.

Gjykata ka vendosur refuzimin e marrëveshjes pasi gjatë gjykimit, i pandehuri nuk konfirmoi vullnetin e tij për marrëveshjen, pasi kjo nuk ishte në interesin e tij më të mirë:

Pas pyetjes nga gjykata në lidhje me marrëveshjen e arritur, i pandehuri deklaroi se e ka bërë marrëveshjen me vullnetin e tij të lirë, ka qenë i përfaqësuar nga mbrojtësi në bisedimet për arritjen dhe nënshkrimin e saj, e kupton marrëveshjen dhe përmbajtjen e saj. I pandehuri i kupton pasojat që vijnë prej miratimit të marrëveshjes nga gjykata, por vlerëson se në arritjen e marrëveshjes nga ana e prokurorit nuk janë vlerësuar drejtë rrethanat lehtësuese në caktimin e masës së dënimit. Për pasojë kjo marrëveshje e arritur nuk është marrë në interesin më të mirë të të pandehurit⁸

Në rast se gjatë seancës gjykata konstaton se jemi përpara rasteve të pushimit apo mosfillimit të çështjes, gjykata vendos mos miratimin e marrëveshjes dhe pushimin e çështjes.

Kur gjykata konsaton se marrëveshja përmbush të gjitha kushtet dhe cilësimi juridik i veprës është në përputhje me dispozitat ligjore, miraton marrëveshjen sipas kushteve të përcaktuara.

Vendimi i gjykatës duhet të përmbajë elementet e mëposhtme:

1. Pjesën hyrëse, ku përcaktohen të dhenat e Gjykatës, sekretares, prokurorit dhe gjeneralitetet e të pandehurit dhe mbrojtësit

⁸ Shih vendimin nr.2975, datë 07.11.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

2. Pjesën analizuuese, në të cilën përfshihen fakti që i pandehuri e ka kuptuar marrëveshjen dhe ka shprehur vullnetin e tij, analizohen cilësimi juridik i veprës dhe rrethanat e saj, përshtatshmëria e dënimit të caktuar, si dhe mungesa e shkaqeve të padënueshmërisë apo të shuarjes së veprës penale, të cilat janë vlerësuar drejt nga prokurori. Në pjesën analizuuese duhet të përfshihet dhe marrëveshja për dëmin civil.

3. Dispozitivi, i cili përmban deklarinimin fajtor të të pandehurit dhe llojin dhe masën e dënimit, sipas parashikimit të marrëveshje.

Nga praktika rezulton se në dispozitivin e vendimit, gjykata vetëm shprehen: *“Miratimin e marreveshjes “Për pranimin e fajsisë nga i pandehuri*** nga dënimi”⁹.*

Shprehim mendimin që duhet të unifikohet praktika gjyqëore dhe çdo vendim në dispozitiv duhet të përmbajë deklarinimin fajtor të pandehurit, llojin dhe masën e dënimit, si dhe mënyrën e ekzekutimit të tij, sipas parashikimeve në marrëveshje.

Një tjetër risi që paraqet ky lloj gjykimi është mosparashikimi i të drejtës për tu ankuar kundër vendimit të gjykatës. I vetmi rast kur lejohet ankimi është kur gjykata ka vendosur pushimin e çështjes dhe në këtë rast ankimi i lejohet prokurorit.

Megjithëse mos parashikimi i të drejtës së ankimit mund të “justifikohet” me faktin që i pandehuri ka pranuar kushtet me vullnetin e tij dhe këtë vullnet e ka ri shprehur në seancë gjyqësore, shprehim mendimin që duhet të ishte njohur e drejta ankimit¹⁰, të paktën në një shkallë të dytë, pasi mund të ndodhë, psh. në rastet kur i pandehuri përfaqësohet nga një avokat i caktuar kryesisht mos të ketë kutpuar procedurën dhe kushtet e marrëveshjes, ose jan ëshkelur dispozitat procedural gjatë zhvillimit të gjykimit etj.. Ky parashikim bie në kundërshtim me Kushtetutën dhe me Protokollin 7, neni 2 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, të cilat parashikojnë që e drejta e ankimit nuk mund të jetë absolute, por personi që është dënuar nga një vendim penal duhet të ketë të drejtën të kundërshtojë vendimin në një shkallë të dytë¹¹.

Gjithashtu e drejta e ankimit nuk i është njohur as viktimës, duke sjellë cënimin e të drejtave, pasi siç analizuam më lartë procedura e përcaktimit të masës së dëmit civil është e parregulluar dhe nuk garanton të drejtat e viktimave, viktimja mund të mos jetë dakort me zhvillimin e këtij gjykimi, mohimi i të drejtës së ankimit cënon të drejtat për një process të rregullt ligjor të viktimës.

⁹ Shih vendimin nr.2989, datë 08.11.2017të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹⁰ Shih Klodjan Skënderaj , Doktoratura “Gjykimet e Posaçme dhe rëndësia e tyre në procesin penal”, fq 208

¹¹ Shih Ledi Bianku, ‘Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut’ , vendimi Papon kundër Francës, fq.309; Vendimi Zaicevs kundër Latvisë, Kërkesa 67022/01, datë 31 Korrik 2007

III. Avantazhet dhe risitë e zbatimit në praktikë të “Urdhrit Penal”

Një tjetër procedurë e posaçme, që shmang gjykimin e zakonshëm, është gjykimi i posaçëm nëpërmjet urdhrit penal të dënimit. Parashikimi i këtij lloj gjykimi ka për qëllim¹²:

1. Ekonominë gjyqësore, nëpërmjet shkurtimeve të shpenzimeve gjyqësore;
2. Uljen e ngarkesës në punë të gjykatave dhe prokurorive, që lidhet me veprat penale të një rrezikshmërie të ulët;
3. Uljen e numrit të burgosurve në burgjet shqiptare.

Urdhri penal i dënimit¹³, është një procedurë që i lë një hapësirë shumë të madhe prokurorit, i cili vepron si një organ “*quazi gjyqësor*”, pasi ka të drejtën të “vendos” nxjerrjen e urdhrit penal, kur konstaton përmbushjen e kushteve dhe kriterëve për nxjerrjen e urdhrit.

Kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushen për zbatimin e procedurës, për nxjerrjen e urdhrit penal janë:

1. Për vepra penale që përbëjnë kundërvajtje penale.
2. Kur prokurori mbi aktet që ka në dosje, krijon bindjen që dënimi që duhet të jepet është me gjobë dhe jo burg;
3. Urdhri penal duhet të nxirret brenda 3 muajve nga rregjistrimi i emrit të personit që i atribuohet vepra penale.

Prokurori është i detyruar të arsyetojë pse jemi në kushtet për nxjerrjen e urdhrit penal dhe provat mbi të cilën është bazuar, si dhe dënimin që ka caktuar. Ky detyrim nuk rrjedh drejtëpërdrejtë nga interpretimi gramatikor i dispozitës, por duke analizuar rastet kur gjykata mund të vendos refuzimin e miratimit të urdhrit penal, konstatohet që një nga rastet është kur krijon bindjen se çështja nuk mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet e hetimeve paraprake që i bashkëlidhen kërkesës për miratim.

Në urdhrin penal, përcaktohet dënimi me gjobë, si dënim kryesor, por prokurori ka të drejtë të caktojë një ose më shumë dënime plotësues. Në lidhje me caktimin e dënimit me gjobë, në Kod është parashikuar një kufizim, që dënimi nuk mund të kalojë më shumë se gjysmën e dënimit maksimal të parashikuar në Kodin Penal. Nëse i referohemi nenit 34 të Kodit Penal, konstatojmë që dënimi me gjobë për kundërvajtje është 50.000 lekë deri në 3 milion lekë. Sa më sipër prokurori në urdhrin penal nuk mund të caktojë një dënim më të lartë se 1.5 milion lekë.

Një element tjetër, që duhet të mbajë parasysh prokurori është gjendja ekonomike e të pandehurit, duke caktuar në përmbajtjen e urdhrit penal mënyrën e pagimit të gjobës, psh. pagimin me këste dhe afatin për pagimin e kësteve.

¹² Shih “Analiza e Sistemit të Drejtësisë”, hartuar nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, Qershor 2015, fq 35

¹³ Shi nenet 406/a deri në nenin 406/ç të Kodit të Procedurës penale

Pas nxjerrjes së urdhrit penal, prokurori i dërgon kërkesë gjykatës për miratimin e tij, së bashku me aktet e fashikullit hetimor. Gjithashtu në të njëjtën kohë, prokurori ka detyrimin që kërkesën për miratim t'ia njoftojë të pandehurit.

Një nga risitë që ka sjellë KPP në këtë gjykim, është zhvillimi i seancës në dhomë këshillimore brenda 10 ditëve nga depozitimi i kërkesës, pa praninë e palëve. Në këtë seancë gjykata verifikon nëse janë respektuar kriteret dhe procedurat për dhënien e urdhrit penal të dënimit.

Kur kushtet dhe kriteret janë përmbushur, gjykata vendos miratimin e urdhrit penal, vendim i cili duhet të arsyetohet dhe përmban elementet si: *a) gjenealogjitetet e të pandehurit; b) parashtrimin e faktit dhe cilësimin juridik të veprës penale; c) burimet e provës dhe faktet që ato u referohen; ç) masën e dënimit me gjobë, modalitetet e ekzekutimit të saj dhe llojin e dënimit plotësues të caktuar; d) të drejtën e të pandehurit për të kundërshtuar vendimin e gjykatës, si dhe afatin brenda të cilit ky vendim mund të kundërshtohet; dh) disponimet për provat materiale dhe sendet që i përkasin veprës penale; e) datën dhe nënshkrimin e gjyqtarit.*

Kur gjykata konstaton se nuk janë përmbushur kriteret për dhënien e urdhrit penal, vendos kthimin e akteve prokurorit për hetime të mëtejshme. Gjykata vendos pushimin e çështjes kur jemi përpara rasteve të pushimit të çështjes. Gjykata duhet të vendos pushimin e çështjes edhe në rastet kur jemi përpara mosfillimit të procedimit, mendojmë që ky është një lapsus dhe është harruar të përfshihet në pikën a) të nenit 406/c.

Si në rastin e gjykimit me marrëveshjes, ashtu dhe në miratimin e urdhrit penal, nuk mund të ndryshohen dënimet e caktuara nga prokurori. I vetmi rast kur gjykata mund të shqyrtojë aftësinë paguese të të pandehurit dhe mënyrën e pagimit, është me kërkesë të të pandehurit gjatë fazës së ekzekutimit të dënimit.

Një tjetër përjashtim, që parashikon zbatimin e këtij gjykimi është mos rregjistrimi i dënimit në vërtetimin e gjendjes gjyqësore (përveç rasteve kur është përsëritës) dhe mos krijimi i efekteve që sjell një vendim penal. Në nenin 70 të KPP parashikohet se vendimi penal është i detyrueshëm për gjykatën civile dhe administrative, që shqyrton pasojat civile të veprës, vetëm përse i përket faktit nëse vepra penale është kryer dhe nëse është kryer nga i gjykuari.

Mos krijimi i efekteve të njëjta, do të sjellë problem në praktikë për garantimin e të drejtave të viktimave, pasi sipas këtij parashikimi, viktimat nuk mund ta përdorin vendimin penal për miratimin e urdhrit penal në gjyqin civil apo administrativ.

Pavarësisht se i pandehuri nuk është palë as në procedurën e nxjerrjes së urdhrit penal nga prokurori, por edhe në seancën gjyqësore për miratimin e urdhrit, ai ka të drejtë ta ankimojë vendimin. Afati i ankimit është brenda 10 ditëve nga marrja e dënimit. Ndryshe nga ankimet e zakonshme që u bëhet vendimeve, në rastin e ankimit të vendimit për miratimin e urdhrit penal, ankimi nuk bëhet në Gjykatën e Apelit, por në të njëjtën gjykatë, që ka dhënë vendimin. Përveç rasteve kur ankimi është bërë nga një person i palegjitimuar ose ka kaluar afati 10 ditor, depozitimi i ankimit “detyron” gjykatën të vazhdojë me procedurën e zakonshme të gjykimit.

IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Aspektet bashkëkohore të drejtësisë penale kategorizohen me një zhvillim dhe reformim dinamik në shumë drejtime, me qëllim që drejtësia penale të jetë njëlloj e arritshme për të gjithë qytetarët dhe të realizohet në afatin më të shkurtër të mundshëm. Procedurat penale të thjeshtëzuar janë parakusht për përshpejtimin dhe dhënien e drejtësisë penale. Në kuadër të një drejtësie penale efektive, ku garantohen në mënyrë të barabartë të drejtat e të pandehurve dhe viktimave, përveç 2 llojeve të gjykimeve të posaçme, u parashikuan dhe 2 gjykime të tjera, si përjashtim nga gjykimi i zakonshëm. Duket që ky parashikim ka dhënë efektet e para, pasi nga momenti i hryrjes në fuqi të ndryshimeve, prokuroria dhe gjykata po zbatojnë në mënyrë të konsiderueshme gjykimin me marrëveshje dhe urdhrin penal. Nga shqyrtim i vendimeve të dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, konstatohet se është shumë i vogël numri i vendimeve të mospranimit të marrëveshjes apo mos miratimit të urdhrin penal, ndërsa nurmi i miratimit është i konsiderueshëm. Zbatimi i këtyre dy gjykimeve do sjellë kosto më të ulëta, procedura më të shpejta, uljen e numrit të të denuarve nëpër burgje etj.

Por nga ana tjetër, megjithëse ndryshimet kanë pak muaj që kanë hyrë në fuqi, konstatohen disa problematika, si pozita procedural jo e favorshme e viktimave, mos trajnimi i subjekteve të procesit penal për ndryshimet e reja dhe mënyrën e zbatimit të procedurave, vakume ligjore etj.

Sa më sipër rekomandojmë:

1. Në rastin e gjykimin me marrëveshje, prokurori duhet të garantojë të drejtat dhe të krijojë mundësi efektive që viktimat të marrin pjesë në lidhjen e marrëveshjes, për të propozuar dhe dakortësuar masën dhe llojin e dëmshpërblimit;
2. Gjykata gjatë miratimit të marrëveshjes, duhet të garantojë dhe ti japë mundësinë viktimës për tu dëgjuar;
3. Të parashikohet e drejta e ankimit ndaj vendimit për miratimin e marrëveshjes, të paktën në një shkallë, sipas parashikimeve të Protokollit 7, neni 2 i KEDNJ-së
4. Duhe të bëhet një ndryshim në KPP, ku të parashikohet që në rastet kur viktima nuk pranon masën e dëmshpërblimit të përcaktuar në marrëveshje, gjykata duhet ta ndajë dhe t'ia dërgojë gjykatës kompetente;
5. Duhet të bëhet një parashikim në KPP, që në rastet e nxjerrjes së urdhrin penal dhe miratimit të tij, të dëgjohet dhe viktima;
6. Duhet të zhvillohen trajnime periodike për gjyqtarët, prokurorët, avokatët etj.

V. LITERATURA

1. Klodjan Skënderaj , Doktoratura “Gjykimet e Posaçme dhe rëndësia e tyre në procesin penal”
2. Zvrlevski.M, Vitlarov.T, Ilievski.J “Zbatimi praktik i marrëveshjes për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal në vitin e parë të zbatimit të ligjit të ri për procedurën penale”, Shkup 2016
3. Ledi Bianku, ‘Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut’, vendimi Papon kundër Francës, fq.309;
4. Analiza e Sistemit të Drejtësisë, hartuar nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, Qershor 2015,
5. Studimin “Efektiviteti i Ndihmës Juridike në Procesin Penal në Shqipëri”, Qendra Res Publica, Mars 2016
6. Rekomandimi nr. (87)18E i Komitetit të Ministrave pranë Këshillit të Evropë, 1987 “Në lidhje me lehtësimin e procedurave në sistemin drejtësisë penale”
7. Vendimi nr.3, datë 27.09.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë
8. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
9. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Protokollit 7, neni 2
10. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar
11. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar
12. Relacioni “Për disa shtesa dhe ndryshimi në Kodin e Procedurës Penale”
13. Vendimi nr.2975, datë 07.11.2017të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë
14. Vendimi nr.2989, datë 08.11.2017të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë
15. Ledi Bianku, ‘Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut’ , vendimi Papon kundër Francës, fq.309;
16. Vendimi Zaicevs kundër Latvisë, Kërkesa 67022/01, datë 31 Korrik 2007

URGENT NECESSITY OF INCREASING EFFECTIVENESS AND EFFICIENCY OF THE JUDICIAL SYSTEM IN KOSOVO

Bahrie BESIMI

December 2017
Tirana

ABSTRACT

The lack of public trust in the judicial system is widespread across Kosovo. Lack of results in fighting corruption – especially high profile corruption cases -, excessive length of proceedings and chronic non-enforcement of judicial decisions are among the factors that contribute to this lack of trust. Increasing effectiveness and efficiency of the judicial system are essential not only to regain public trust in the courts but also to ensure a sound business and investment environment. Restoring public’s confidence in judicial system, in return, would be crucial to attract investments, which would lead to economic development. As such, by analysing and comparing the European Commission’s requirement/criterion and considering my own assessment as a lawyer who deals in daily basis with the judicial institutions/stakeholders, this paper tends to address the challenge of inefficiency and ineffectiveness of the judicial system in Kosovo with the aim of suggesting/recommending the key areas which need support with concrete indicators/measures.

Key words: *Efficiency and effectiveness of Judicial institutions; Lack of public trust; EU Commission; Corruption; Lack of results.*

INTRODUCTION

An effective functional state is built on respect for fundamental values, for the rule of law and for democracy. It requires effective justice systems, which involve components such as quality, independence, accountability and efficiency. Effective justice system of a country is a prerequisite for attracting investments, which in return would contribute to economic development. Thus, judicial reforms are the most crucial component for effective functioning of a state.

The rule of law first appeared in the 1780 Bill of Rights of the Constitution of Massachusetts equated with the idea of a ‘government of laws, not of men,’¹ Its Article XXX provides that “In the government of this Commonwealth, the

¹Marbury v. Madison (1803) 1 Cranch 137, p. 163,

legislative department shall never exercise the executive and judicial powers, or either of them: The executive shall never exercise the legislative and judicial powers, or either of them: The judicial shall never exercise the legislative and executive powers, or either of them: to the end it may be a government of laws and not of men.”² This formed the basis and defined the boundary of the separation of powers between the branches of the executive, judicial and legislative.

Kosovo as the youngest country in Europe has established from scratch a solid legal and institutional framework. This is a good step but insufficient for a proper functioning of rule of law as it requires implementation of the legislation. European Commission in its 2016 Country Report has congratulated Kosovo for ‘adopting amendments to the Constitution and most of the secondary legislation necessary to implement the 2015 justice package laws as well as for appointing most members of key judiciary institutions.’ However, this report has also criticised/assessed Kosovo for/as being at ‘early stage in developing a well-functioning judicial system’ mostly due to the ‘slow and inefficient administration of justice, accountability of judicial officials and vulnerable to undue political influence’³

The signature of the Stabilisation and Association Agreement (SAA) between Kosovo and EU and its entering into force in April 2016 marked a new phase for Kosovo, as it is the first contractual agreement with specific terms and requirements in different areas, including judiciary system. It has identified the areas in the Rule of Law that Kosovo needs to fulfil in order to make progress in its membership endeavours.

Having in mind the importance of rule of law, in general, and effective functioning judicial system, in particular, through this qualitative assessment, this paper aims to analyse and shed some light regarding the challenges of Kosovo judiciary system with the aim of suggesting/recommending the key areas, which need support with concrete indicators/measures. In order to do that, I will start by first analysing the European Union approach on RoL with the focus in Judiciary from inside-out perspective and then exploring European Commission (EC) criterion with regard to Kosovo judiciary. Secondly, I will concentrate in Kosovo’s judiciary challenges by elaborating the current state of affairs. After providing a clear picture of both challenges as well as requirements by the EC, this paper aims to suggest measures to address the mentioned challenges.

² University of Chicago Press, Bill of Rights, Massachusetts Constitution of 1780, PT. 1, received from: http://press-pubs.uchicago.edu/founders/documents/bill_of_rightss6.html

³ Commission Staff Working Document – Kosovo 2016 Report - https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_kosovo.pdf

European Commission Criterion on Rule of Law efficiency and effectiveness

European Union, established first as a Union for economic purposes, has identified ‘effectiveness of justice system in its Members States (MS) as a key structural component subject to economic adjustment programmes.’⁴ So, effectiveness of justice system is crucial for economic development of a country. I assume that, despite other important reasons, one of the most crucial approaches why EU gives so much importance to RoL and effectiveness of judiciary is the fact that this leads to economic development and attracts investors. This is seen also at the negotiation phase between EU and EU aspiring countries due to the fact that the first chapters, which are negotiated, are chapter 23 (judiciary and fundamental rights) and 24 (justice, freedom and security).

If we were to analyse from an inside-out perspective, we can refer to the EU Justice Scoreboard⁵ as an evolving information tool, which contributes to the European Semester by providing objective, reliable and comparable data on the quality, independence and efficiency of justice systems in all Member States. ‘It assists the EU and Member States in identifying potential shortcomings, improvements, good practices and trends over time. This cross examination of the functioning of national justice systems is complemented by a country specific assessment, presented in the country reports, which take into account the particularities of the legal system and the context of the Member State concerned.’⁶

Three components, which have been analysed and taken as the most important ones, are *efficiency*, *quality* and *independence* of justice system. From European Commission point of view on efficiency, ‘Timely decisions are essential for business, investors and consumers. In their investment decisions, companies take into account the risk of being involved in commercial disputes, labour or taxation disputes or insolvencies. The efficiency with which a judicial system in a Member State handles litigation is hence an important factor.’⁷

⁴ The 2016 Annual Growth Survey of 26 November 2015 underlined that “enhancing the quality, independence and efficiency of Member States’ justice systems is a prerequisite for an investment and business friendly environment. [...] It is necessary to ensure swift proceedings, address court backlogs, increase safeguards for judicial independence and improve the quality of the judiciary, including through better use of ICT in courts and use of quality standards.”, COM(2015) 690 final, p.13 https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/european-semester_thematic-factsheet_effective-justice-systems_en.pdf

⁵ The 2016 EU Justice Scoreboard – Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Central Bank, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions, COM(2016) 199 final. http://ec.europa.eu/justice/effectivejustice/scoreboard/index_en.htm

⁶ European Semester Thematic Factsheets – Effective Justice System 2016 – p. 1; https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/european-semester_thematic-factsheet_effective-justice-systems_en.pdf

⁷ Ibid, p. 3

Secondly, ‘Improving the quality of justice systems High-quality institutions, including the national justice systems, are a determinant for economic performance. Effective justice requires quality throughout the entire judicial process.’⁸ Quality of justice system requires certain factors such as ‘case management systems, training of judges and courts’ staff, monitoring and evaluating the activities of courts, the use of satisfaction surveys and equipping justice systems with adequate resources, both on the budget and the human resources side.’ Even in the European Union, the situation, regarding both the quality and efficiency of judiciary, varies significantly among the MS. This in turn might explain also the differences related to economic development.

Thirdly, EC emphasises the independence of judiciary as ‘a requirement stemming from the right to an effective remedy enshrined in the Charter of Fundamental Rights of the EU (Article 47). It is a fundamental element of an effective justice system. It is also important for an attractive investment and business environment, as it assures the fairness, predictability and certainty of the legal system in which businesses operate.’⁹

When it comes to EU aspiring countries, such as Kosovo, the requirements and expectations from the EU are similar. However, due to the unfavourable conditions, - namely not being able to have the final court decisions published - we can notice that EC does not concentrate as much to the quality of judiciary compared with efficiency, accountability and transparency. More specifically, we can see this at the requirements set out in SAA, Country Report, and European Reform Agenda.

Article 81 – Reinforcement of institutions and rule of law requires ‘strengthening the independence, impartiality and accountability of the judiciary in Kosovo and improving its efficiency, developing adequate structures for the police, prosecutors and judges and other judicial and law enforcement bodies to adequately prepare them for cooperation in civil, commercial and criminal matters, and to enable them to effectively prevent, investigate, prosecute and adjudicate organised crime, corruption and terrorism.’¹⁰

European Reform Agenda (ERA) was developed as a platform between EU and GoK, following the entry into force of the Stabilization and Association Agreement (SAA), with an aim to maximise the economic and political benefits of SAA. ERA gives the highest political attention to: 1) strengthening the rule of law and consolidation of good governance, 2) improving competitiveness and investment climate, and 3) education and employment. ERA contains 22 priorities

⁸ Ibid, p. 4

⁹ Ibid, p. 6

¹⁰ STABILISATION AND ASSOCIATION AGREEMENT between the European Union and the European Atomic Energy Community, of the one part, and Kosovo *, of the other part, Article 83, received from [http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:22016A0316\(01\)&rid=8](http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:22016A0316(01)&rid=8)

and an annual Action Plan for their implementation containing around 130 actions ambitiously planned to be implemented by the end of 2017.

So far, on RoL, it seems that Kosovo has done a mixed progress. More specifically, in legislative requirements, GoK has just recently managed to adopt the concept document on ‘Mandatory removal of public officials from office once convicted and suspending them once indicted’, which is crucial in closing the legal loopholes of allowing senior public officials retain their position even after their conviction or indictment is filed. The Draft Law on Conflict of Interest which aims to strengthen the integrity of the public sector and prevent, manage and resolute conflict of public and private interests in discharge of official public duties has still to be approved by the Assembly. On the other hand, requirements regarding the increasing capacities of Economic Department and Fiscal Division have been partially implemented since four additional staff are placed in these important institutions. This is positive because it will contribute to reduce backlog of cases. Nevertheless, when it comes to increase capacities of Special Prosecution, in order to improve track record in fighting corruption and organised crime, no concrete steps have been.

In *2016 EC Country report for Kosovo*, EC assessed that ‘administration of justice is slow and inefficient, and there is insufficient accountability of judicial officials. The judiciary is still vulnerable to undue political influence and rule of law institutions suffer from lack of funding and human resources.’¹¹

Challenges of Kosovo judiciary

Kosovo as a democratic Republic is based on the principle of separation of powers and the checks and balances among them as stipulated in the Constitution of Republic of Kosovo. (par.1) The judicial power is unique and independent and is exercised by courts.¹² Legal framework provides that judiciary institutions are independent and exercise their functions in an impartial manner. Legislative, Executive and the President have zero competences when it comes to the work of judiciary. However, practically, neither the Government, nor the Assembly approves adequate budget for judiciary institutions. Through the budget, the Assembly is interfering in the independence of the judiciary. Judiciary institutions have approximately 1.5% of the total budget.

Under the constitution, the Kosovo Judicial Council (KJC) and the Kosovo Prosecutorial Council (KPC) are responsible for ensuring the independence and impartiality of the judiciary. In February 2016, following Venice Commission and

¹¹ Commission Staff Working Document – Kosovo 2016 Report, p.5 - https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_kosovo.pdf

¹² Par.5 of Art.4 of the Kosovo Constitution, received in November 2017, https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Constitution_of_the_Republic_of_Kosovo_with_amend.I-XXV_2017.pdf

European Commission recommendations, the Assembly adopted a constitutional amendment on the composition of the Kosovo Judicial Council, whereby the majority of its members are to be elected by their peers – 7 out of 13 members now being appointed by judges, and the other 6 by the Assembly.

The amendment strengthens judicial independence from political influence, and was considered by European Commission as a welcome step. The amendments provide that out of the 6 members appointed by the Assembly, 2 shall be from the Kosovo/Serbian community and 2 from the other minority communities.

Although some progress has been made, GoK is falling behind meeting the deadlines for most of the agreed priorities both in terms of requirements from European Reform Agenda as well as conditions from the process of visa liberalisation. Results in fighting corruption are lacking and this is accompanied with the lack of accountability, efficiency and effectiveness.

According to the UNDP Public Pulse, it shows that satisfaction with the work of judicial and prosecutorial system in 2016 marked the largest decline of almost all times, dropping to 18.4% for the judiciary and 16.9% for the prosecution offices. The lack of confidence and satisfaction with judiciary work reflects the judgments that share these institutions¹³

More specifically, citizens are faced with a considerable backlog of cases, which decreases court's and prosecution offices' efficiency. On the other hand, high profile cases always know how to find legal loopholes to escape justice. For example, cases such as Xhabir Zharku¹⁴, Lemje Xhema¹⁵ and Medicus¹⁶ repre-

¹³ Trust in the judiciary system since 2007 when UNDP has conducted their surveys remained at low percentage. The highest percentage of satisfaction was recorded in 2013 (16.7%). September 2015 has marked the largest decline only 13.9%. Whereas, in the 2016 report the satisfaction with the judiciary has been 18.4%. "Public Pulse 11" (Pristina: UNDP, May 2016). Page 4.

¹⁴ Xhabir Zharku six years ago was found guilty of extortion and illegal possession of weapons and was sentenced to three years of imprisonment. Expiration of statutory limitations is five years from the time International Warrants at Interpol is raised requesting Xhabir Zharku to come back and execute the punishment. After 2018, his conviction can no longer be executed due to expiration of statutory limitations.

¹⁵ Lemja Xhema, the former head of Kosovo Post and Telecom, was found guilty of corruption in 2008 and sentenced to three years in prison. However, before the Supreme Court confirmed the sentence in 2011, she fled - reportedly to her hometown of Medvegje in Serbia. An Interpol arrest-warrant was issued by the UN mission in Kosovo, UNMIK, on behalf of the Pristina authorities because Kosovo is not a member at the international police organisation. After the statute of limitations in her case expired in May 2014, Xhema's name was removed from the Interpol wanted list and the Kosovo authorities ceased to pursue her.

¹⁶ Appeal Court in Prishtina, composed of two international judges and a local one, confirmed the jailing of three men convicted of organised crime in connection with organ-trafficking at Kosovo's Medicus clinic in 2008. However, the Supreme Court's panel of judges comprising two local and one international judge, annulled the court ruling citing procedural irregularities and ordered a retrial after the defendants appealed the case. This is the highest-profile case handled by EU prosecutors and judges who arrived in Kosovo in 2008 to handle sensitive cases such as war

sent State's failure to bring the convicted individuals face justice within the legal deadlines. After the statutory limitation of these cases, State loses power to endlessly investigate, prosecute or adjudicate the same cases.

In all of these cases the lack of accountability and efficiency from judicial institutions is evident. Questions that citizens – if informed – could raise would be: Who was responsible for letting both Zharku and Xhema escape from Kosovo? How come EULEX judges, given their experience and expertise, made these procedural violations? How come no one is kept accountable and responsible for these cases? Therefore, it is an urgent necessity to increase efficiency, effectiveness and accountability of judicial institutions.

Kosov Law Institute, which is monitoring systematically the work of prosecutorial and judicial systems since 2013 in dealing with corruption cases, in its report¹⁷ demonstrate the findings which show that 'despite the adopted policies and the expression of declarative will by the judicial and prosecutorial system in combating corruption, concrete results in combating it, especially high-profile corruption, are still missing. Pursued corruption mainly belongs to low-profile, eventually medium, which more than 60% of indictments fail in courts. Over the last three years have been filed indictments of high-profile, which in more than 90% of cases have failed to be proven. Most of them have failed during the initial stage.' These statistic findings prove the point that accountability and efficiency of judiciary is lacking. In cases when judges and prosecutors are not held accountable and do not act efficiently, create the spill over effect on nourishing the impunity of strong political figures. In these conditions, it is clearly understood why citizens have almost no faith in the justice institutions. This is jeopardizes the mere existence of the state. Therefore, urgently proper policies need to be pushed forward in the direction of increasing transparency, accountability, efficiency and effectiveness of the judiciary.

Suggested measures to address challenges

As demonstrated above, Kosovo institutions are facing various challenges when it comes to proper functioning of the judiciary. Having ambitious approach in the planning phase and then not being able to implement set priorities shows lack of real and objective vision. On the other hand, failing to meet deadlines for both priorities defined in European Reform Agenda and conditions from the visa

crimes, organized crime and corruption. The director of the clinic, urologist Lutfi Dervishi, was jailed for eight years for organized crime and human trafficking and his son for seven years in 2013. Both of them went into hiding and never served the sentence. Four other people, including Health Ministry officials, received lesser terms but never served time following appeal after appeal in different courts.

¹⁷ Prosecution and Special Court of the Republic of Kosovo, received from: <http://kli-ks.org/wp-content/uploads/2017/08/1.-SPRK-KLI-29.08.2017.pdf>

liberalization process demonstrates lack of efficiency, effectiveness and accountability of responsible stakeholders/institutions.

As elaborated above, the key challenge remains results in the fight of high profile corruption cases. As such, this paper recommends two-fold approach from both local institutions as well as EU Commission.

In one hand, it is urgent for judicial institutions – specifically – to establish policies that would lead to increase of citizen’s trust in the judiciary. This can be achieved by increasing their transparency, accountability and efficiency.

More specifically, Kosovo Judicial Council and Kosovo Prosecutorial Council must be transparent for their approved decisions and regulations (legal and sub-legal acts). This requires an establishment of electronic platform where every decision taken by Councils, courts and prosecution offices is published electronically, which would allow access for citizens. Both Councils have published some of their approved legal acts. However, the public has the right to know for every decision or regulation adopted by judicial institutions and not only for some of them. This would contribute to increase transparency towards citizens.

In order to increase efficiency, it is of paramount importance to improve administrative capacity, skills and professionalism of the judiciary actors. Nevertheless, before thinking about improving their capacities, it is essential to have objective and transparent appointment of judges and prosecutors. As such, they need to be recruited based on meritocratic, fair and transparent process. Previous recruitment process, especially the one organized by KJC in December 2016, has been criticized by international actors in Kosovo such as EU Office, US and UK Embassies.¹⁸ More specifically, the joint statement reads

‘as we indicated to the KJC at the time, we were disappointed by the decision to keep the vote secret. We believe that establishing an open ballot would have sent a strong signal of the KJC’s commitment to the principles of transparency, meritocracy and accountability. Unfortunately, our observation of the recently re-run selection processes for these positions has caused us again to question the KJC’s sincere commitment to these principles. The absence of any meaningful discussion on the merits of the short-listed candidates means that a member of the public attending these processes would have been unable to understand why one candidate was preferred over another. The written reasoning subsequently provided by the KJC does nothing to correct this impression. We must emphasize that our concern is about ensuring a transparent process, not about individual candidates,’¹⁹

¹⁸ US and UK Embassy joint press release, August 2017, <https://www.gov.uk/government/news/statement-of-the-embassies-of-the-united-kingdom-and-united-states-on-the-kosovo-judicial-council>

¹⁹ Ibid.

On the other hand, this paper suggests that international actors, especially US Embassy and EU Office must promote compliance through the mechanisms of financial inducements. In other words, international partners should have the approach as to make Kosovo institutions comply with the required conditions and make the reforms in return for the financial support. This transaction might create both stick and carrot, which may turn to be effective. This paper argues that by modifying their approach, implementation of legal framework and compliance with set requirements would be increased. In this way, Kosovo institutions have to deserve the support they are receiving.

CONCLUSION

Seeking to explore importance of rule of law, in one hand, and challenges in Kosovo context, on the other hand, this paper argued why it is urgent necessity to increase effectiveness and efficiency of the judicial system. In one hand citizens are the ones who are suffering the most for the lack of delayed justice as a result of the backlog or the inefficiency of judiciary institutions. On the other hand, Kosovo institutions have failed so many times to meet the deadlines for key processes which in return would lead with 'carrot' of European integration.

Also, along side with inefficiency and ineffectiveness, judicial institutions in Kosovo are suffering from the lack of transparency, practical independence and accountability. This paper demonstrated with concrete examples lack of results. As such, there is an urgent need to increase efficiency, effectiveness, transparency and accountability of judicial institutions. In order to do this, this paper suggests that it is not sufficient to have only Kosovo institutions deal with the necessary reforms. In order to prompt Kosovo institutions for these changes, it is of paramount importance to have a different/more stronger commitment and approach from the international stakeholders, especially from the EU Commission and EU Office in Kosovo. This paper argued that a different approach would entail linking financial support with the implemented reforms, hence giving the carrot in return for compliance.

REFERENCES

Baç, M. M. (2016). Judicial Reform in Turkey and the EU's Political Conditionality. *MAXCAP Project "Maximizing the integration capacity of the European Union: Lessons of and prospects for enlargement and beyond"*, 1. doi: 10.4324/9780203847381.

Commission, E. (n.d.). Effective justice systems in the EU. Retrieved December 23, 2017, from http://ec.europa.eu/justice/events/assises-justice-2013/justice_systems_en.htm.

COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT Kosovo* 2016 Report. (2016, November 9). Retrieved October 6, 2017, from https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_kosovo.pdf

Constitution of the Republic of Kosovo. (2015, August 5). Retrieved April 23, 2016, from https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Constitution_of_the_Republic_of_Kosovo_with_amend.I-XXV_2017.pdf

*Country Reports on Human Rights Practices For 2006, Vol. 1, April 2008, 110-2 Joint Committee Print, S. Prt. 110-40, ** (2008 ed., Vol. 1). (2008). Government Printing Office.

Dori, A. (2015). The EU Justice Scoreboard - Judicial Evaluation as a New Governance Tool. *SSRN Electronic Journal*. doi:10.2139/ssrn.2752571

Efficiency, Accountability and integrity of Judicial and Prosecutorial System. (2016). Prishtina, Kosovo: Kosovo Law Institute. Retrieved December 10, 2017, from: <http://kli-ks.org/wp-content/uploads/2017/01/9.-Efficiency-Accountability-and-Integrity-of-KJC-and-KPC-26.12.2016.pdf>

EUR-Lex Access to European Union law. (n.d.). Retrieved December 23, 2017, from <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?qid=1512421966664&uri=CELEX%3A22016A0316%2801%29>

EUROPEAN SEMESTER THEMATIC FACTSHEET EFFECTIVE JUSTICE SYSTEMS. (2016, November 14). Retrieved March 3, 2017, from https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/european-semester_thematic-factsheet_effective-justice-systems_en.pdf

Institute, K. L. (2016, October 23). Monitoring report of the treatment of corruption cases in justice system in Kosovo . Retrieved December 11, 2016, from <http://kli-ks.org/wp-content/uploads/2017/08/1.-SPRK-KLI-29.08.2017.pdf>

IV.C.2f-4 International Bovine Meat Agreement (15 April 1994). (n.d.). *International Law & World Order*, 1-6. doi:10.1163/ilwo-ivc2f-4

Justice and Consumers. (2017, December 15). Retrieved December 23, 2017, from http://ec.europa.eu/justice/effectivejustice/scoreboard/index_en.htm

Maja Kocijančič. (2015, October 27). Retrieved December 23, 2017, from <http://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2015/10/27/kosovo-eu-stabilisation-association-agreement/#>

Marbury v. Madison, 5 U.S. 137 (1803). (n.d.). Retrieved November 11, 2017, from <https://supreme.justia.com/cases/federal/us/5/137/case.html>

Medicus case update. (2011, March 1). Retrieved December 23, 2017, from <http://www.eulex-kosovo.eu/en/pressreleases/0121.php>

Medicus: Five guilty in Kosovo human organ trade case. (2013, April 29). Retrieved December 23, 2017, from <http://www.bbc.com/news/world-euro-pe-22343589>

Official Journal of the European Union; STABILISATION AND ASSOCIATION AGREEMENT between the European Union and the European Atomic Energy Community, of the one part, and Kosovo*, of the other part. (2016, March 16). Retrieved December 23, 2017, from [http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:22016A0316\(01\)&rid=8](http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:22016A0316(01)&rid=8)

Palokaj, A., & Tuhina, G. (2017). The Upshot of the SAA: Kosovo - EU Relations. *Kosovo Foundation for Open Society, 1*. doi:10.18411/a-2017-023

Part the First. A Declaration of the Rights of the Inhabitants of the Commonwealth of Massachusetts. (n.d.). Retrieved December 23, 2017, from http://press-pubs.uchicago.edu/founders/documents/bill_of_rightss6.html

Pech, L. (2010). 'A Union Founded on the Rule of Law': Meaning and Reality of the Rule of Law as a Constitutional Principle of EU Law. *European Constitutional Law Review, 6*(03), 359-396. doi:10.1017/s1574019610300034

Prosecution and Special Court of the Republic of Kosovo. (2017). In (Vol. 1). Prishtina: Kosovo Law Institute. Retrieved from <http://kli-ks.org/wp-content/uploads/2017/08/1.-SPRK-KLI-29.08.2017.pdf>

RETORIKA NË LUFTIMIN E KORRUPSIONIT: Raport i monitorimit të trajtimit të rasteve të korrupsionit në sistemin e drejtësisë në Kosovë. (n.d.). Retrieved December 23, 2017, from <http://kli-ks.org/retorika-ne-luftimin-e-korrupsionit-raport-i-monitorimit-te-trajtimit-te-rasteve-te-korrupsionit-ne-sistemin-e-drejtise-ne-kosove/>

Rule of law. (n.d.). Retrieved November 1, 2017, from http://ec.europa.eu/justice/effective-justice/rule-of-law/index_en.htm

Rule of Law: Commission issues recommendation to Poland. (n.d.). Retrieved December 23, 2017, from http://europa.eu/rapid/press-release_IP-16-2643_en.htm

Statement of the Embassies of the United Kingdom and United States on the Kosovo Judicial Council. (2017, August 25). Retrieved December 23, 2017, from <https://www.gov.uk/government/news/statement-of-the-embassies-of-the-united-kingdom-and-united-states-on-the-kosovo-judicial-council>

Supreme Court judgement in Zharku case. (2012, May 8). Retrieved December 23, 2017, from <http://www.eulex-kosovo.eu/en/pressreleases/0278.php>

UNDP Public Pulse. (n.d.). Retrieved December 23, 2017, from http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/operations/projects/democratic_governance/PublicPulse.html

TRANSPARENCA E PROCEDIMIT PENAL

Arjada MYRTJA
arjadamyrtja@hotmail.com,
Akademia e Studimeve Albanologjike

Redjona MYRTJA
r.myrtja@yahoo.com,
specialiste e studimeve në Gjykatën e Lartë

ABSTRAKT

Ky punim synon të analizojë legjislacionin e brendshëm përsa i takon transparencës së procedimit penal.

Transparenca e procedimit penal është një element i rëndësishëm i së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Transparenca rrit përgjegjshmërinë e punonjësve të drejtësisë ndaj publikut dhe ndihmon në edukimin e shoqërisë me rëndësinë e zbatimit të ligjit.

Sipas dispozitave të KPrP gjykimi bëhet i hapur, ndërsa hetimi i mbyllur. Ruajtja e sekretit hetimor është detyrim ligjor i sanksionuar në nenin 279 të KPrP. Publikimi i veprimeve hetimore pa lejen e prokurorit pengon zbulimin në kohë të veprave penale dhe të autorëve të tyre. Zbulimi vështirësohet kur publikohen gjeneralitetet dhe thëniet e dëshmitarëve. Dekonspirimi çënon mbrojtjen që u siguron ligji dhe rrezikon të bëhen pre e joshjeve ose kërcënimeve për të ndryshuar thëniet. Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete përbën vepër penale dhe dënohet penalisht nga Kodi Penal.

Hetimi gazetaresk nuk duhet të dublojë hetimin shtetëror por të orientohet në kërkimin e fakteve të reja. Gazetarët kanë për detyrë të ndjekin “performancën ligjore” të punonjësve publikë që merren me zbulimin e veprave penale. Ata mund të investigojnë nëse policët dhe prokurorët zhvillojnë një veprimtari hetimore zbuluese të ligjshme dhe në përputhje me garancitë procedurale kushtetuese e ligjore që mbrojnë të drejtat dhe liritë e njeriut. Ky është roli i medias në luftën kundër korrupsionit.

Ligjërish, ndalohej publikimi i fakteve hetimore, por jo publikimi i arrestimit ose ndalimit. Oficerët e policisë gjyqësore që kryejnë këto veprime kanë detyrimin të njoftojnë jo vetëm mbrojtësit e zgjedhur ose të caktuar por edhe familjarët e personave të izoluar.

***Fjalët kyçe:** Procesi i rregullt ligjor, sekretit hetimor, publiciteti i seancës, transparenca e procedimit, publikimi i arrestimit ose ndalimit.*

HYRJE

Parimet procedurale janë rregullat themelore që përcaktojnë karakterin dhe përmbajtjen e mënyrës së procedimit. Një element i rëndësishëm i parimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor është edhe transparencja e procedimit penal. Transparenca e ndjekjes penale, hetimit dhe gjykimit rrit përgjegjshmërinë e punonjësve të drejtësisë ndaj publikut dhe ndihmon në edukimin e shoqërisë me rëndësinë e zbatimit të ligjit. Legjislacioni procedural penal ka për detyrë të sigurojë një procedim publik të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, të mbrojtë liritë personale dhe të drejtat e interesat e ligjshme të shtetasve, të ndihmojë për forcimin e rendit juridik dhe zbatimin e Kushtetutës e të ligjeve të shtetit.

Gjatë dekadës së fundit të shekullit XX-të Shqipëria ka përparuar me hartimin, sanksionimin dhe miratimin e normave ligjore dhe krijimin e institucioneve bazë të qeverisjes demokratike, të cilat synonin, gjeneronin dhe siguronin lirinë e individit, të mbrojtur nga abuzimet e shtetit e të subjekteve të tjera përmes një katalogu të gjerë të të drejtave të njeriut që synonin krijimin e një shoqërie demokratike me ekonomi tregu funksionale.¹

Pas krijimit dhe vënies në funksion të institucioneve të reja demokratike dilte në plan të parë problemi i zbatimit në terren i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Në lidhje me këtë, kërkohej që pushteti gjyqësor të konstruktohej si një institucion që natyrshëm ushtron presion për zbatimin e rregullave dhe proceseve demokratike, si një mjet efikas për respektimin e të drejtave të qytetarit në Shqipëri. Për rrjedhojë u sanksionua në Kushtetutë e drejta për një proces të rregullt gjyqësor,² për të mbrojtur lirinë, pronën dhe të drejtat e njohura me këtë akt themelor dhe me ligjet e tjera. Parimi në fjalë, midis të tjerave, presupozon që shteti duhet të marrë të gjitha masat për të mbrojtur jetën, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën, mjedisin, të sigurojë që asnjë person të mos ndiqet dhe dënohet penalisht në mënyrë të padrejtë. Për mbrojtjen e këtyre të drejtave ose të akuzave të ngritura kushdo gëzon të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj.

Shqipëria tashmë ka një legjislacion procedural penal bashkëkohor, të pajtueshëm me standardet demokratike ndërkombëtare, të harmonizuar me sistemet e modelet e shteteve perëndimore dhe të bazuar në traditat e veçoritë historike, politike e legjislative të vendit.

Pavarësisht se pjesa dërmuese e elementëve të të ashtuquajturit proces të rregullt ligjor janë bërë pjesë përbërëse e legjislacionit shqiptar, zbatimi me rigozitet i tyre nga organet e drejtësisë merr rëndësi të dorës së parë.

Kuadri i ri kushtetues, ligjor e procedural synon të promovojë dhe vendosë në Shqipëri standarde bashkëkohore në qeverisjen qendrore e vendore si dhe në

¹ Ratifikimi i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut

² Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

funksionimin e pushtetit gjyqësor. Ky kuadër ligjor ka në fokus respektimin e të drejtave të njeriut në një nga rrafshet më të rëndësishme të ushtrimit të tyre përpara organeve të drejtësisë me pikësynimin e garantimit të gjykimit të drejtë dhe procesit të rregullt ligjor e gjyqësor.

E drejta për një proces të drejtë, profesional dhe të paanshëm bën pjesë në të drejtat themelore të njeriut. Shteti shqiptar, si anëtar me të drejta të plota në Këshillin e Europës, ka një legjislacion të plotë dhe të detajuar, që i rregullon të gjitha aspektet e procesit të rregullt gjyqësor. Nënshkrimi dhe ratifikimi i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, së bashku me protokollet shtesë, e bën këtë dokument pjesë të legjislacionit të brendshëm.³

E drejta për një proces të rregullt gjyqësor parashikohet jo vetëm në tekstin e Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut por edhe në Kushtetutën e Shqipërisë. Gjykimi i drejtë dhe të drejtat e njeriut në procesin gjyqësor garantohen më tej me dispozitat konkrete të Kodit të Procedurës Penale.⁴ Korpusi i dispozitave procedurale penale është bazë juridike e mirë, që rregullon në mënyrë të detajuar kompetencën e gjykatës dhe sjelljen e subjekteve të tjera procedurale në hetim e gjykim. Kodi i Procedurës Penale është një ligj i plotë që parashikon dhe garanton të gjitha standardet e një procesi të rregullt gjyqësor që fillon me ushtrimin e ndjekjes penale, hetimin, gjykimin e mbyllet me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Nga përmbajtja e tij konstatohet me lehtësi se nenet bëjnë një rregullim ligjor të detajuar të procesit të rregullt gjyqësor. Shkelja e këtyre rregullave përbën shkak për prishjen e vendimeve të dhëna nga gjykatat e faktit dhe gjykatat e apelit.⁵ Normat procedurale janë të detyrueshme për subjektet e procedimit penal, për organet shtetërore, personat juridikë dhe shtetasit.

Nga fondi ligjor shqiptar e drejta për një proces penal të rregullt ligjor mund të shihet në tre këndvështrime: së pari në respektimin e të drejtave të subjekteve në procesin penal deri në fillimin e shqyrtimit gjyqësor (fazën e hetimeve paraprake), së dyti në respektimin e të drejtave të palëve gjatë shqyrtimit gjyqësor, së treti në transparencën që duhet bërë për veprimtarinë procedurale hetimore e gjyqësore.

Ky punim synon të analizojë legjislacionin e brendshëm përsa i takon transparencës së procedimit penal. Qëllimi i këtij punimi është prezantimi dhe konsolidimi i koncepteve demokratike për transparencën, kuptimi i drejtë i kësaj veprimtarie procedurale penale dhe i dispozitave të veçanta kushtetuese, ligjore e procedurale si dhe zbatimi me korrektësi i tyre.

³ Neni 116 dhe 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

⁴ Nenet e Kodit të Procedurës Penale përcaktojnë parimet, subjektet, juridiksionin, kompetencën, afatin, garancitë dhe çdo institut tjetër që i shërben procesit të rregullt ligjor.

⁵ Neni 428/1 gërma “ç” dhe neni 432/1 gërmat “b”.

Transparenca e hetimeve paraprake

Sfidë e reformave në Shqipëri është edhe përmirësimi i mekanizmave për edukimin ligjor të publikut, ndërgjegjësimin dhe vendosjen e tij në pozita aktive reaguese, ndaj rasteve të shkeljes së etikës dhe të ligjit nga punonjës të korrumpuar. Për ushtrimin e ndjekjes penale prokurorët mund dhe duhet të shfrytëzojnë çdo sinjal që vjen nga publiku nëpërmjet gazetave, radiove, televizioneve, mediave të ndryshme, rrjeteve sociale apo denoncimeve të drejtëpërdrejta.

Në teorinë e të drejtës procedurale penale, ndjekja penale nënkupton një aktivitet juridik procedural që ndërmerret kundër dikujt që ka shkelur ligjin. Ndjekja penale përfaqëson tërësinë e veprimeve procedurale të parashikuara nga ligji, me qëllim vërtetimin ose rrëzimin e akuzës së ngritur nga prokurori.⁶ Ndjekja penale (procedimi penal) përfshin dy faza të ndryshme, por të lidhura në mënyrë funksionale, fazën e hetimeve paraprake, që konsiston në kryerjen e veprimeve hetimore për të zbardhur ngjarjen dhe identifikuar autorin dhe fazën e gjykimit, ku shqyrtohet akuzat e ngritura nga prokurori në emër të shtetit.

Dispozitat e Kodit të Procedurës Penale kanë përcaktuar në mënyrë rigorozë rregullat për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, të zhvillimit të hetimit dhe gjykimit.⁷ Sipas tyre, si rregull, vetëm gjykimi bëhet i hapur,⁸ ndërsa hetimi bëhet gjithmonë i mbyllur.⁹ Kodi i Procedurës Penale ndalon publikimin, qoftë edhe të pjesëshëm, të akteve sekrete që lidhen me çështjen penale.

Sipas kodit ndalohet publikimi i përmbytjes së akteve procedurale nëpërmjet shtypit ose informacionit masiv. Veprimet hetimore janë sekrete. Në nenin 103 të Kodit të Procedurës Penale përcaktohet se: ndalohet publikimi i akteve procedurale deri në përfundim të hetimeve; ndalohet publikimi i akteve të hartuara gjatë shqyrtimit gjyqësor kur gjykimi bëhet me dyer të mbyllura; ndalohet publikimi i gjeneraliteteve dhe i fotografive të pandehurve dhe të dëshmitarëve të mitur, të akuzuar ose të dëmtuar nga vepra penale. Gjykata mund të lejojë publikimin vetëm kur e kërkojnë interesat e të miturit ose kur i mituri ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç. Shkelja e ndalimit të publikimit e bërë nga nëpunësi i shtetit ose i një entit publik, kur nuk përbën vepër penale, është shkelje disiplinore. Në këtë rast prokurori njofton organin që ka të drejtë të marrë masa disiplinore.¹⁰

Kodi i Procedurës Penale përcakton në mënyrë të shprehur se rregullat procedurale për ushtrimin e ndjekjes penale, të hetimit dhe gjykimit janë të detyrueshme për subjektet e procedimit, për organet shtetërore, personat juridikë dhe shtetasit.¹¹

⁶ Vendim Nr. 03, date 06.02.2008 i Gjykatës Kushtetuese

⁷ Neni 2 i Kodit të Procedurës Penale.

⁸ Neni 339 i Kodit të Procedurës Penale.

⁹ Nenet 103/2 dhe 279 të Kodit të Procedurës Penale.

¹⁰ Neni 104 i Kodit të Procedurës Penale

¹¹ Neni 2 i Kodit të Procedurës Penale

Në këtë kuadër vlen të theksohet se pavarësisht se ngjarja kriminale ose denoncimi mund të jenë publike, hetimi është gjithmonë i mbyllur për publikun. Gjatë hetimit është i ndaluar publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve hetimore deri në përfundimin e hetimeve paraprake. Ruajtja e sekretit të hetimeve është detyrim profesional dhe ligjor për gjykatën, prokurorin, policinë gjyqësore dhe këdo që ka akses në procesin penal.

Ruajtja e sekretit gjatë zhvillimit të hetimeve është detyrim ligjor i sanksionuar në nenin 279 të Kodit të Procedurës Penale në të cilin parashikohet se aktet hetimore janë sekrete derisa i pandehuri të mos ketë marrë dijeni për to. Më tej në dispozitën në fjalë parashikohet se në rast nevojë për vazhdimin e hetimeve prokurori mund të urdhërojë ruajtjen e sekretit për akte të veçanta deri në përfundim të hetimeve. Në raste përjashtimore, prokurori mund të lejojë, me vendim të arsyetuar, publikimin e akteve të hartuara gjatë hetimeve ose ndonjë pjesë të tyre. Aktet e publikuara depozitohen në sekretarinë e prokurorit.

Në realitet vërehet se nga një pjesë e mirë e mediave të shkruara dhe ato elektronike publikohen aktet e veprimeve hetimore. Nuk mund të thuhet nëse gazetarët e njohin apo jo detyrimin ligjor që kanë për të mos zbuluar karakterin sekret të veprimeve hetimore. Me keqardhje konstatojmë se gazetaret, radiot dhe televizionet janë të mbushura me fakte që dalin nga dosjet hetimore në dorë të oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurorëve të ndryshëm që marrin pjesë në hetime. Korrektësia morale dhe ligjore e ndjekjes dhe publikimit të fakteve që lidhen me vepra të ndryshme penale kërkon nga gazetarët kulturën e nevojshme profesionale siç ndodh me gazetarët e fushave të tjera shkencore, kulturore dhe sportive.

Publikimi i veprimeve hetimore pa lejen e prokurorit pengon dhe vështirëson zbulimin në kohë të veprave penale dhe të autorëve të tyre. Zbulimi vështirësohet akoma më shumë kur publikohen gjeneralitetet e dëshmitarëve dhe thëniet e tyre. Në radhë të parë kjo bën që dëshmitarët të mos gëzojnë mbrojtjen që u siguron ligji, së dyti rrezikojnë të bëhen pre e joshjeve, premtimeve dhe kërcënimeve për të ndryshuar thëniet dhe së treti mund t'i detyrojë ata të tërhiqen fare nga shpjegimet pavarësisht përgjegjësisë penale që kanë për deklaratat apo dëshmitë e rreme apo refuzimin për të dëshmuar. Për nxjerrjen e emrit të një dëshmitari të mbrojtur është akuzuar, arrestuar dhe dënuar edhe gazetari i njohur kosovar B. H.¹²

Raporti i gazetarëve me organet proceduese

E drejta e informimit përfshin të drejtën e gazetarit për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike. Ushtrimi i këtyre të drejtave përmban detyrime dhe përgjegjësi për gazetarët. Ato mund t'u nënshtrohen formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara

¹² Aktgjykim 24 korrik 2008 i Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelja të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të kryera në territorin e ish_Jugosllavisë prej vitit 1991.

me ligj që janë të nevojshme në shoqëritë demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e veprimeve kriminale.

Një numër i caktuar personash, nuk mund të detyrohen të dëshmojnë për sa dinë për shkak të profesionit, me përjashtim të rasteve kur kanë detyrimin që t'ua referojnë autoriteteve proceduese. Këtu bëjnë pjesë: përfaqësuesit e besimeve fetare, avokatët, përfaqësuesit ligjorë, noterët, mjekët, kirurgët, farmacistët, obstetrët dhe kushdo që ushtron një profesion tjetër, që ligji u njuh të drejtën të mos dëshmojnë për faktet që lidhen me sekretin profesional. Nga kjo e drejtë përfitojnë edhe gazetarët por vetëm lidhur me emrat e personave nga të cilët ata kanë marrë të dhëna gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Megjithatë, kur këto të dhëna janë të domosdoshme për të provuar veprën penale dhe vërtetësia e këtyre të dhënave mund të dalë vetëm nëpërmjet identifikimit të burimit, organet proceduese e sidomos gjykata urdhëron gazetarin që të tregojë burimin e informacionit të tij.¹³

Gazetarëve u garantohet pjesërisht konfidencialiteti i burimeve por u ndalohe publikimi, qoftë edhe i pjesshëm i akteve procedurale deri në përfundimin e hetimeve. Publikimi i akteve procedurale hetimore ngarkon me përgjegjësi zyrtarët që duhet ta ruajnë këtë sekret dmth oficerët e policisë gjyqësore dhe prokurorët. Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete përbën veprë penale dhe dënohet penalisht nga Kodi Penal.¹⁴ Në bazë të tij dënohet prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore që zbulon aktet sekrete dhe nuk respekton detyrimet e përcaktuara në nenin 103 të Kodit të Procedurës Penale. Penalisht dënohen edhe persona të tjerë, që kanë dijeni për të dhëna për procedimin penal e që janë paralajmëruar nga prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore për moszbulimin e tyre. I dënueshëm penalisht është edhe zbulimi i të dhënave sekrete, që kanë lidhje me identitetin e dëshmitarëve e të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, që përfitojnë mbrojtje të veçantë. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore, si dhe personeli i shërbimit informativ nuk mund të detyrohen të tregojnë emrat e informatorëve të tyre. Informacionet e dhëna prej tyre nuk mund të merren dhe as të përdoren në qoftë se këta zyrtarë nuk pyeten si dëshmitarë lidhur me informacionin. Kur informatorët pranojnë të dëshmojnë, dëshmia merret duke respektuar rregullat mbi ruajtjen e fshehtësisë së identitetit të tyre.

Të pa drejta na duken intervistat që u merren të ndaluarve ose të arrestuarve gjatë izolimit nga gazetarë të ndryshëm. Për këtë nuk bëjmë fajtor gazetarët, përkundrazi mendojmë se në këtë mënyrë të vepruari ka ndikuar mungesa e disa rregullave të veçanta sqaruese që duhet të kishin dalë në bazë e për zbatim të nenit 279 të Kodit të Procedurës Penale nga Prokuroria e Përgjithshme. Nëse gazetarët nuk e dinë rregullimin ligjor që duhet të merret leje tek prokurori është detyrë e

¹³ Neni 159 i Kodit të Procedurës Penale

¹⁴ Neni 295/a i Kodit Penal

policiisë gjyqësore dhe prokurorisë që të respektojnë vetë këtë urdhërim ligjor dhe gjatë punës t'ia mësojnë të tjerëve qoftë edhe punonjësve të mediave.

Në qoftë se oficerët e policiisë gjyqësore dhe prokurorët në rrethe nuk e respektojnë detyrimin ligjor për të ruajtur sekretin hetimor duhet të këshillohen, të ndihmohen, të kualifikohen, të kontrollohen dhe në fund të fundit të detyrohen nga eprorët e tyre nëpërmjet urdhërave dhe udhëzimeve nga strukturat përkatëse në piramidën e prokurorëve. Në bazë të ligjeve për zbatimin e reformës në drejtësi prokurorët më të lartë mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme dhe të arsyetuara me shkrim, që janë të detyrueshme për prokurorët më të ulët. Prokurorët e Prokurorisë së Posaçme i nënshtrohen vetëm udhëzimeve të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme. Ndërsa Prokurori i Përgjithshëm mund të nxjerrë udhëzime të përgjithshme me shkrim për prokurorët e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe të mbikqyr zbatimin e tyre.¹⁵

Gazetarët si pjesë e “pushtetit të katërt” nuk kanë asnjë pengesë të zhvillojnë gazetari investigative, por hetimi gazetaresk nuk mund dhe nuk duhet të dublojë hetimin shtetëror por të orientohet në kërkim të fakteve të reja që nuk kanë dalë nga veprimtaria hetimore e policiisë apo prokurorisë. Zhvillimi i një gazetarie zbuluese e në kërkim të së vërtetës do të thotë se ndjekja e veprimtarisë kriminale dhe e fakteve deri në skutat më të errëta duhet të bëhet pa çenuar karakterin sekret të hetimeve zyrtare dhe pa bërë publike të dhënat që dalin nga hetimi i organeve të specializuara shtetërore.

Në zbardhjen dhe dokumentimin e aktivitetit kriminal, hetimi gazetaresk, ka për detyrë të ndjekë edhe “performancën ligjore” të punonjësve publikë që merren me zbulimin e veprave penale dhe vënien para përgjegjësisë të autorëve të tyre. Zbulimi dhe ndjekja e “kriminelëve” përshkohet nga rregulla të caktuara ligjore e procedurale që duhet të zbatohen nga oficerët e policiisë gjyqësore, hetuesit, prokurorët dhe gjyqtarët por dhe garanci që i afrohen të dyshuarit që i nënshtrohet ndjekjes penale. Njohja dhe zotërimi i këtyre rregullave dhe garancive i ndihmon gazetarët që të bëjnë transparente për publikun veprimtarinë e këtyre punonjësve qofshin këta policë, hetues, prokurorë apo gjyqtar. Gazetarët mund dhe duhet të investigojnë nëse policët, hetuesit dhe prokurorët zhvillojnë një veprimtari hetimore zbuluese të ligjshme dhe në përputhje me garancitë procedurale penale të parashikuara nga Kushtetuta,¹⁶ e akte të tjera të së drejtës ndërkombëtare që mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Në luftën ndaj korrupsionit media e lirë dhe profesionale ka fushë të gjerë veprimi. Zyrtari që i shpëton vëzhgimit të rreptë të publikut është punonjës që s'jep llogari. Veprimet antiligjore të zyrtarëve janë të mundshme për t'u zbuluar dhe njohur nga publiku. Media duhet të ndjekë, zbardhë dhe dokumentojë aktivitetin

¹⁵ Për më shumë shiko nenet 38 e 46 të ligjit 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë.”

¹⁶ Neni 31 i Kushtetutës.

korruptiv të çdo zyrtari. Ajo mund dhe duhet të shfrytëzojë çdo sinjal që vjen nga revolta e publikut. Ky është roli moral, profesional dhe ligjor i medias në luftën kundër korrupsionit.

Detyrimi i organeve proceduese për të bërë transparencë

Ligjërisht vërtet ndalohet publikimi i fakteve të administruara gjatë hetimit, por nuk ndalohet publikimi i arrestimit ose ndalimit. Përkundrazi oficerët e policisë gjyqësore që bëjnë këto veprime (arrestimin dhe ndalimin) kanë detyrimin të njoftojnë jo vetëm mbrojtësit e zgjedhur ose të caktuar por edhe familjarët e personave të izoluar me këto masa.¹⁷ Në nenin 255 të Kodit të Procedurës Penale përcaktohen në detaje detyrat e oficerëve dhe të agjentëve të policisë gjyqësore në rastet e arrestimit në flagrancë dhe të ndalimit të të dyshuarit për kryerjen e një krimi. Me pëlqimin e të arrestuarit ose të ndaluarit, policia gjyqësore, duhet të lajmërojë pa vonesë familjarët për izolimin dhe vendndodhjen e tij. Kur i arrestuari ose i ndaluar është i mitur lajmërohet detyrimisht prindi ose kujdestari, si dhe zbatohen rregullat e Kodit të Drejtësisë për të Miturit. Seanca e vleftësimit të arrestimit ose ndalimit është e një natyre të veçantë për shkak të procedurës specifike të parashikuar në nenin 259 të Kodit të Procedurës Penale. Nga dispozita në fjalë nuk del e qartë nëse seanca e vleftësimit duhet të bëhet e hapur apo e mbyllur për publikun. Proceduralisht seanca e vleftësimit zhvillohet me pjesëmarrjen e domosdoshme të prokurorit dhe të mbrojtësit. Nga një monitorim që është kryer, gjatë këtij viti, nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit në rrethet Tiranë e Durrës, është vërejtur se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka një praktikë edhe pse jo të unifikuar që të gjitha seancat gjyqësore të vleftësimit zhvilloheshin pa prezencën e publikut dhe të medias me arsyetimin që të mos çenohej parimi i prezumimit të pafajësisë së personave ndaj të cilëve prokurori kërkonte vleftësimin e më pas caktimin e masës së sigurimit. Në literaturën juridike është shfaqur idea që kjo mënyrë së vepruari është një çështje e diskutueshme, për sa kohë publiku shpesh njoftohet me anë të medias që në fazat e para të arrestimit ose ndalimit të personave nga strukturat e policisë.¹⁸ Sipas kësaj pikëpamje publiku dhe media kanë interes për çështje që kanë ndjeshmëri të lartë publike, për t'u njohur me argumentet e organit të akuzës dhe të mbrojtjes lidhur me vleftësimin e arrestimit ose ndalimit si dhe kërkesën për caktimin e masave të sigurimit gjatë këtyre seancave.

Prokurorët dhe gjithë personeli i prokurorisë, gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, si dhe pas përfundimit të saj, janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin dhe sekretin shtetëror për fakte për të cilat vijnë në dijeni, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe. Prokurorisë nuk i lejohet të bëjë publike ose t'u japë

¹⁷ Neni 255 i Kodit të Procedurës Penale.

¹⁸ Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, "Parimi i publicitetit dhe regjistrimi audio i seancës gjyqësore", botuar në revistën "Avokatia" Nr. 24, botim i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, faqe 54.

personave të tretë të dhëna që dëmtojnë çështjen në proces hetimi apo gjykimi, që çënojnë dinjitetin dhe jetën private të personave, të drejtat e të miturve, si dhe të dhëna me karakter konfidencial ose të rezervuar.¹⁹

Sipas ligjit të ri 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", shërbimet e marrëdhënies me publikun do të kryhen nga nëpunësi civil i caktuar nën drejtimin e prokurorit të caktuar për marrëdhëniet me publikun dhe nën mbikëqytjen e tij. Ky shërbim duhet të kryhet duke respektuar parimin për të drejtën e informimit, duke i kushtuar vëmendje mbrojtjes së dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe të dhënave personale, reputacionit dhe prezumimit të pafajësisë. Nëpunësi civil dhe prokurori i ngarkuar për realizimin e marrëdhënies me publikun duhet të zbatojnë në çdo kohë kërkesat ligjore e procedurale për garantimin e sekretit dhe mbarëvajtjes së hetimit.

Publiciteti i seancës gjyqësore

Zhvillimi publikisht i gjykimit vjen si detyrim nga neni 6/1 i Konventës Europiane të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ku sanksionohet: "*Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshem... Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalojë shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë". Detyrimi për një gjykim të drejtë e publik vjen edhe nga neni 42 i Kushtetutës. Në legjislacionin procedural penal janë pranuar dhe konkretizuar kërkesat e nenit 6/1 të KEDNJ dhe nenit 42 të Kushtetutës për zhvillimin publikisht të gjykimit.*

Seanca gjyqësore, sipas nenit 339 të Kodit të Procedurës Penale, është publike, përndryshe quhet e pavlefshme. Në nenin 340 të këtij Kodi janë parashikuar rastet kur lejohet gjykimi me dyer të mbyllura. Sipas legjislacionit procedural penal shqiptar media dhe publiku mund të largohen me vendim të gjykatës gjatë gjithë procesit gjyqësor ose një pjese të tij. Largimi i pjesshëm ose tërësor i publikut dhe medias mund të bëhet kur e kërkon interesi i sjelljes së moralshme, sekretit shtetëror, rendit publik, siguria kombëtare, jeta private e palëve, mbrojtja e viktimave si dhe në të gjitha rastet e tjera kur i mituri është i pandehur ose viktimë. Interesi i të miturve e ka detyruar ligjvënësin të sanksionojë: "Shqyrtimi gjyqësor zhvillohet gjithmonë me dyer të mbyllura kur: **a)** gjykohen të miturit; **b)** gjykohen të pandehur të rritur, të cilët akuzohen për kryerjen e veprave penale ndaj të miturve si viktimë, pavarësisht moshës së viktimës gjatë gjykimit".²⁰ Vendimi i gjykatës për zhvillimin

¹⁹ Neni 9 i ligjit 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë"

²⁰ Neni 340/2 i Kodit të Procedurës Penale

e seancës me dyer të mbyllura revokohet kur pushojnë shkaqet që e sollën atë. Kryetari i trupit gjykues informon personat që marrin pjesë në një gjykim me dyer të mbyllura për detyrimin që kanë për të mbajtur konfidencial informacionin e mësuar në seancë.

Normat procedurale penale që kufizojnë publicitetin e gjykimit janë në pajtim me standardet ndërkombëtare të procedimit penal. Këto norma njihen nga gjyqtarët, prokurorët, avokatët dhe subjektet e tjera procedurale penale. Mirëpo gjendja e ndërtesave të disa gjykatave të shkallës së parë, para disa vitesh, nuk krijonte kushtet e nevojshme për një gjykim publik dhe solemn. Atëherë kishte pak salla të përshtatshme për gjykim dhe për këtë shkak shpeshherë gjyqet zhvilloheshin në zyrat e gjyqtarëve, ku mund të qëndronin vetëm gjyqtarët dhe palët. Në të vërtetë gjykimi në fakt bëhej i mbyllur edhe pse deklaroheshin hapur për publikun.²¹ Për të garantuar publicitetin e gjykimit duhet që seancat gjyqësore të zhvillohen gjithmonë në sallat e posaçme të gjykimit. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me vendimin Nr.238/1/b, datë 24.12.2008 ka përcaktuar se të gjitha proceset gjyqësore, për sa ishte e mundur duhej të zhvilloheshin në salla gjykimi të përshtatshme për natyrën e çështjeve konkrete. Në monitorimin e kryer në 38 gjykata gjatë tre mujorit të parë të këtij viti evidentohet përmirësim i dukshëm në drejtim të respektimit të parimit të publicitetit. Nga 5437 seanca të vëzhguara, vetëm afro 7 për qind e tyre nuk u zhvilluan në sallat e përshtatshme të gjykimit, për shkak se nuk kishte salla të lira. Mungesë më e theksuar është vërejtur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Vlen të theksohet, se kjo është gjykata e vetme me numrin dhe ngarkesën më të lartë të çështjeve penale në shkallë Republike.²²

Në disa prej rasteve të zhvillimit të seancës me dyer të mbyllura vërehet që neni 340 i Kodit të Procedurës Penale i jep deri diku gjykatës një diskrecion me elementë të natyrës subjektive, për të bërë rast pas rasti vlerësimin nëse do të kufizojë ose jo publikun nga pjesëmarrja në proces. Kufizimet për median janë të njëjta me ato të publikut. Kjo e drejtë që i është dhënë gjykatës duket normale edhe për shkak të përcaktimeve që janë sanksionuar në nenin 6 të Konventës Europiane të cituar më sipër. Sipas këtij akti të së drejtës ndërkombëtare, media dhe publiku mund të mos pranohen në sallën e gjykimit kur gjykata e çmon krejtësisht të domosdoshme se rrethana të veçanta të çështjes penale mund të dëmtojnë interesat e drejtësisë penale. Diskrecioni që i është dhënë gjykatës me nenin 340 të Kodit të Procedurës Penale na duket se është më i gjerë. Kjo vërehet kur publiciteti mund të dëmtojë moralin shoqëror ose kur nga ana e publikut ka shfaqje që prishin zhvillimin e rregullt të seancës.

Në Shqipëri mungojnë studimet për realizimin në praktikë të parimit të publicitetit të seancave gjyqësore. Nga studimi i vendimeve të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese nuk kemi konstatuar ndonjë çështje konkrete ku të

²¹ H. Islami, A. Hoxha, I. Panda, "Procedura Penale", Tiranë 2012

²² Raport i Komitetit Shqiptar të Helsinkit

jetë shqyrtuar dhe debatuar parimi i shqyrtimit publik të çështjeve penale. Kuartri ligjor shqiptar shtron nevojën e një studimi për të interpretuar dhe zbatuar në praktikë “moralin shoqëror” dhe “shfaqjet që prishin zhvillimin e rregullt të seancës gjyqësore. Në mungesë të praktikës gjyqësore vendase po i referohemi qëndrimeve të Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut. Qëndrimi i kësaj gjykate ka evoluar në mënyrë të ndjeshme lidhur me çështjen e transparencës (publicitetit), raportin e tij me të drejtën e informimit, të drejtën për jetë private e familjare dhe me çështjet apo interesat e sigurisë kombëtare. Liria e shprehjes e sanksionuar nga neni 10/1 KEDNJ, dobësohet nëse interpretohet në raport me të drejtën për respektimin e jetës familjare dhe private, të sanksionuar nga neni 8 i të njëjtës Konventë. Karakteri publik i procesit penal merr rëndësi shumë të madhe se ai mbron të gjitha palët ndërgjyqëse nga segmente të caktuara të sistemit të drejtësisë që zhvillojnë gjykimin në fshehtësi dhe pa kontroll publik. Sistemet procedurale penale në përgjithësi kërkojnë ruajtjen e balancës së drejtë midis publicitetit, paanshmërisë dhe prezumimit të pafajësisë. Një nga funksionet më të rëndësishme të transparencës është t’i mundësojë medias dhe publikut të drejtën për t’u informuar. Nëpërmjet informimit media mbikqyr jo vetëm shqyrtimin gjyqësor por edhe administrimin e drejtësisë.

Regjistrimi audio ose audioviziv i seancës gjyqësore

Organet proceduese, në çdo kohë, kanë qenë të detyruara të dokumentojnë çdo veprim procedural të kryer, në mënyrën dhe formën e treguar me ligj. Tradicionalisht dokumentimi i veprimtarisë procedurale penale bëhej me procesverbal. Procesverbali përpilohej nga sekretari i gjykatës, në formë të plotë ose të përbledhur me stenotip, me mjet tjetër teknik dhe, kur mungonin mjetet, me dorëshkrim. Teorikisht me Kodin e Procedurës Penale të hartuar e miratuar në vitin 1995 lejohej riprodhimi fonografik. Kjo veprimtari kryhej nga persona teknikë, qoftë edhe jashtë administratës gjyqësore nën drejtimin e sekretarit të gjykatës. Regjistrimet fonografike ose audiovizive i bashkoheshin akteve të dosjes gjyqësore.

Një rregullim më i plotë ligjor mbi regjistrimin audio u bë me udhëzimin Nr. 353, date 03.09.2013 të Ministrisë së Drejtësisë “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për mbajtjen e ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës me mjete audio”. Në vazhdim praktika gjyqësore u pasurua me vendimin unifikues Nr. 1, datë 27.04.2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që arritën në përfundimin se: “... mbajtja e procesverbalit të seancës gjyqësore nëpërmjet regjistrimit audio dhe audioviziv, është jo vetëm në përputhje me nenin 115 e vijues të K.Pr.Penale, por duke u parashikuar prej tij si një nga mjetet e mbajtjes së procesverbalit, rrit efektivitetin, eficiencën dhe garanton transparencën në seancat gjyqësore duke përmbushur në mënyrë shteruese dhe autonome funksionin dokumentues të veprimeve procedurale”.

Në kuadër të Reformës në Drejtësi, neni 115 i Kodit të Procedurës Penale është ndryshuar plotësisht me ligjin 35/2017. Ndryshimet e fundit ligjore kanë

rregulluar në mënyrë të qartë e të plotë dokumentimin e veprimeve procedurale nëpërmjet regjistrimit audio ose audiovizive duke përcaktuar se: *“Kur është e mundur, aktet e kryera gjatë seancës gjyqësore, si dhe çdo akt tjetër i kryer jashtë saj, dokumentohen nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv. Regjistrimi fillon dhe mbaron në të njëjtën kohë me seancën gjyqësore...Regjistrimi i seancës gjyqësore bëhet nga sekretari gjyqësor, nën udhëzimet dhe mbikëqyrjen e kryetarit të trupit gjykues...Kur mbahet me regjistrim audio ose audioviziv, regjistrimi ruhet në programin elektronik përkatës për aq kohë sa ruhet dosja gjyqësore...Palët kanë të drejtë në çdo kohë të marrin kopje të regjistrimit dhe procesverbalit të mbajtur me shtypshkrim apo dorëshkrim, kundrejt tarifave përkatëse”*. Nga një monitorim i kryer nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, gjatë periudhës janar-mars 2017 u evidentua se volumi i seancave të regjistruara në të gjitha gjykatat e vendit ka arritur në masën 91.5 për qind. Vetëm 8.5 për qind e seancave nuk janë regjistruar për defekte në pajisje, probleme me internetin ose për mungesë të energjisë elektrike.²³ Mjetet e regjistrimit audio ose audioviziv mund të përdoren edhe gjatë fazës së hetimeve paraprake për dokumentimin e akteve (veprimeve procedurale).²⁴

Nga leximi, studimi dhe interpretimi i paragrafit të fundit të nenit 115 të Kodit të Procedurës Penale të cituar më sipër del se palët gëzojnë të drejtën për të marrë kopje të regjistrimit audioviziv, por nuk del nëse mund të transmetohen në media kronikat e regjistruara të çështjeve penale. Në legjislacionin procedural vendas, të cituar më sipër, nuk janë vendosur kufizime specifike për organet e ndryshme mediatike. Në disa vende të Europës Perëndimore, medias i ndalohej të transmetojë dhe publikojë audio ose video të seancave gjyqësore. Në këto vende e drejta e informimit nuk prevalon mbi ligjet e pushtetit gjyqësor. Përkundrazi, për të publikuar ekstrakte të regjistruara me zë e figurë në seancë gjyqësore duhet leje e posaçme e gjykatës.

Zbatimi ose jo i kufizimeve në Shqipëri, nuk është përcaktuar akoma edhe nga praktika gjyqësore. Për këtë çështje mund dhe duhet t'i referohemi ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”. Ligji i cituar përcakton: *“Shërbimet për marrëdhëniet me publikun kujdesen për informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtarinë e gjykatës si dhe për çështje të caktuara gjyqësore, në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor...”*. Ky lloj shërbimi duhet të kryhet duke respektuar parimin për të drejtën e informimit, mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe të dhënave personale, reputacionit dhe prezumimit të pafajësisë.²⁵ Interes të veçantë në ligjin 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, paraqet figura e gjyqtarit të caktuar për marrëdhëniet me publikun, i cili vetë ose nëpërmjet nëpunësit të caktuar nga këshilli i çdo gjykate do të kujdeset që

²³ Raport i Komitetit Shqiptar të Helsinkit mbi gjetjet e monitorimit të përdorimit të sallave të gjyqit dhe sistemit të regjistrimit dixhital audio në gjykata, gusht 2017

²⁴ Neni 116/5 i Kodit të Procedurës Penale

²⁵ Neni 46/2 i Ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”

institucioni gjyqësor të funksionojë në mënyrë transparente, të shpejtë dhe efikase. Punonjësit e ngarkuar për marrëdhëniet me publikun duhet të bashkëpunojnë për të garantuar që pushteti gjyqësor të jetë i pavarur, efikas, i besueshëm dhe transparent.

KONKLUZIONE

Të respektohet detyrimi ligjor për të ruajtur sekretin e veprimeve hetimore sipas përcaktimeve të bëra nga neni 279 i Kodit të Procedurës Penale nga të gjitha subjektet procedurale. Për të disiplinuar ruajtjen e sekretit të hetimeve Prokurori i Përgjithshëm mund të nxjerrë udhëzime të përgjithshme me shkrim për prokurorët e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe të mbikëqyr zbatimin e tyre.²⁶ Udhëzime mund të nxjerrë edhe drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme. Prokurorët e Prokurorisë së Posaçme i nënshtrohen vetëm udhëzimeve të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.²⁷ Drejtuesit e prokurorive pranë rretheve gjyqësore duhet të përmbushin detyrimet ligjore dhe udhëzimet e dhëna nga Prokurori i Përgjithshëm.²⁸ Këta të fundit duhet të drejtojnë, bashkërendojnë dhe mbikëqyrin edhe veprimtarinë e policisë gjyqësore nën juridiksionin e tyre. Prokurorët e caktuar për marrëdhëniet me publikun dhe median duhet të zbatojnë me rigorozitet kërkesat ligjore për garantimin e sekretit dhe mbarëvajtjen e hetimeve paraprake.

Të përmirësohet infrastruktura e godinave të gjykatave duke rritur numrin e sallave të gjykimit. Kjo kërkesë shtrohet më shumë për gjykatat e rretheve gjyqësore që kanë një numër të lartë të çështjeve penale. Shqyrtimi i çështjeve penale në salla të posaçme shpërfaq elemente të rëndësishme të etikës dhe solemnitetit, rrit respektin dhe transparencën për publikun dhe median.

Infrastruktura dixhitale e regjistrimit audio dhe audiovizive të shtrihet për gjithë procesin penal. Regjistrimi audio ose audioviziv i seancave gjyqësore në çdo gjykatë është një dukuri pozitive që ka gjetur përherë e më shumë zbatim në praktikën gjyqësore, për shkak edhe të investimeve përkatëse të bëra nga partnerët ndërkombëtar. Regjistrimi audio dhe audioviziv **së pari** i jep mundësi gjyqtarëve të kenë akses të menjëhershëm në procesverbalin e seancës, **së dyti** i jep mundësi subjekteve procedurale dhe palëve ndërgjyqëse të njihen ose kërkojnë kopje të transkriptuar të procesverbalit dhe **së treti** lehtëson gjykimin e çështjeve penale në shkallët e tjera të gjykimit. Për këtë sugjerojmë që edhe veprimet e kryera gjatë fazës së hetimeve paraprake të dokumentohen nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv. Ndryshimet e fundit procedurale të bëra me ligjin 35/2017 e kanë hapur përfundimisht rrugën në këtë drejtim. Në pikën 5 të nenit 116 të Kodit të Procedurës Penale thuhet shprehimisht: *“Për dokumentimin e akteve gjatë fazës së hetimeve paraprake zbatohen, për aq sa është e mundur, dispozitat e mësipërme”*.

²⁶ Neni 38/2 gërma “b” e ligjit 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë”

²⁷ Neni 46/1 i ligjit 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë”

²⁸ Neni 42 i Ligjit 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë”

Për përmirësimin e marrëdhënies ndërmjet gjykatës dhe prokurorisë nga njëra anë dhe publikut dhe medias nga ana tjetër të institucionalizohet sa më parë figura e gjyqtarit dhe prokurorit të caktuar për këtë detyrë dhe të preçizohen kompetencat dhe detyrat e tyre.

LITERATURA

Akte normative

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut.
- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë.
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr. 35, datë 30.03.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
- Ligji nr. 98, datë 06.10.2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji nr. 97, datë 06.10.2016 “Për organizimin e funksionimit të prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

Doktrinë

- H. Islami, A. Hoxha, I. Panda “Procedura Penale”, Tiranë 2012.
- Erida Skëndaj “Parimi i publicitetit dhe regjistrimi audio i seancës gjyqësore”, botuar në periodikun e pavarur “Avokatia”, nr. 24, botim i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, faqe 54.
- Raport i Komitetit Shqiptar të Helsinkit mbi gjetjet e monitorimit të përdorimit të sallave të gjykimit dhe sistemit të regjistrimit dixhital audio në gjykata, gusht 2017.

Jurisprudencë

- Vendimi Unifikues nr. 1 datë 27.04.2015 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Vendimi nr. 3 datë 06.02.2008 i Gjykatës Kushtetuese.
- Aktgjykim 24 korrik 2008 i Tribunalit Ndërkombëtar për ndjekjen penale të personave përgjegjës për shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare të kryera në territorin e ish Jugosllavisë prej vitit 1991.
- Vendime të për zgjedhura të Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane, botim i vitit 2009.
- Axen kundër Gjermanisë 1983, “Udhëzues i shkurtër i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut”, botim i Këshillit të Europës.

MARRJA DHE PËRDORIMI I KOMPIONËVE BIOLOGJIKË TË REJAT QË SJELLIN NDRYSHIMET E KODIT PROCEDURËS PENALE

Nga: Enea SHEQI

*Student në Master Shkencor Civil
Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
Email: enea.sheqi@yahoo.com*

ABSTRAKT

Përdorimi i kampionëve biologjikë në vitet e fundit është rritur ndjeshëm. Këqyrja e këtyre kampionëve me qëllim arritjen të prova është bërë edhe më e domosdoshme me zhvillimet teknologjike. Njohja dhe rëndësia e tyre në legjislacionin tonë procedural penal është relativisht e re, ku për këtë arsye ngrihen shumë pikëpyetje mbi mënyrën e marrjes dhe përdorjes të tyre në kuadrin e respektimit dhe të të drejtave të njeriut. Ndryshimet e reja të KPP-sw në funksion të reformës në drejtësi, kanë si synim kryesor forcimin e procesit të rregullt ligjor duke zbatuar në mënyrë rigorozë dhe standarte, parashikimet e dispozitave. Arritja e procesit të të provuarit kërkon që shpesh herë marrja e kampionëve biologjikë të bëhet kundër vullnetit të vetë personit me kusht respektimin e integritetit të tij fizik, moral dhe psikologjik me qëllim vlefshmërinë e saj si provë.

Ekzaminimi i kampionëve biologjikë, përdorimi i tyre në proceset penale, roli i prokurorit dhe gjykatës, arritja në bindjen e krijimit të provës penale, si dhe ruajtja e të drejtave të të pandehurit do t'i jepen përgjigje në artikullin e mëposhtëm nën frymën e krijimit të një drejtësie penale solide, të paanshme, mes sfidës së kapërcimit të të gjithave problematikave aktuale dhe perspektivës europiane.

***Fjalë Kyçe:** Kampionë biologjikë, Proçes i rregullt ligjor, Proçes penal, Provë.*

I. Vështrim hyrës

Këqyrja është një nga mjetet e kërkimit të provës së parashikuar në Kodin e Procedurës Penale (KPP). Këqyrja e vendeve, sendeve dhe personave janë veprime procedurale të kryera nga ana e organit procedues me qëllim zbulimin e gjurmëve apo provave të tjera material, që mund të shërbejnë si objekt i të provuarit në procesin penal. Këqyrja e personave në veçanti paraqet disa problematika me fokus kryesor respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nga ana e organeve ligjzbatuese në momentin e këqyrjes.

Ndryshimet e reja të KPP-së janë nën prizmin e zhvillimeve bashkëkohore dhe për këtë arsye në dispozitat që parashikojnë “Këqyrjen” si një mjet kërkimi prove shtuan dispozita të reja në lidhje me marrjen dhe përdorimin e kampionëve dhe materialeve biologjikë, si dhe një procedurë strikte dhe të mirëpërcaktuar.

Ky ndryshim erdhi dhe për shkak se në kodin e vjetër të procedurës penale këto kampionë biologjikë merreshin sipas dispozitave të përgjithshme të këqyrjes, gjë kjo, që bëntë që shpesh herë të shfaqeshin disa probleme, ku më kryesorët ishin për mënyrën e marrjes dhe përdorimit të tyre, shkatërrimin e tyre, dhe respektimin e të drejtave të personave gjatë marrjes së këtyre kampionëve.

Për të treguar mënyrën e marrjes dhe përdorimit të tyre do të ishte e domosdoshme një përcaktim i tyre pasi koncepti i gjurmëve nuk mbetet vetëm nën gjurmët e ADN-së, por është dhe më i gjerë. Gjurmët biologjike në vetvete ndahen në tre grupe, duke përfshirë gjurmë me prejardhje humane, bimore dhe shtazore.¹ Gjurmët më të zakonshme me prejardhje humane janë gjaku, floku, sperma, përshtyma etj. Në rastin konkret për përcaktimin e gjurmëve me prejardhje humane një rol të rëndësishëm luan përcaktimi i ADN-së, kjo për shkak dhe të individualitetit të saj dhe për faktin që është unik për çdo person, duke e lidhur këtë provë biologjike me autorin e kryerjes së veprës penale.

Ekzaminimi i ADN-së përbën një provë e cila për nga rëndësia është e njëjtë me gjurmët daktiloskopike. Ajo gjendet në bërthamën e cdo qelize të gjallë njëzore, bimore apo shtazore. Krahasimi i gjurmëve gjenetike të nxjerrë nga objektet e ndryshme shërben dhe për të bërë të mundur identifikimin e personit të dyshuar për kryerjen e veprës penale. Kampionët biologjikë mund të ndodhen në vende të ndryshme por edhe në persona apo kufoma.² Në ndryshimet e kodit të procedurës penale është përcaktuar një procedurë e vecantë për marrjen e përdorimin e tyre të personat në të cilët nevojitet të bëhet një krahasim.

Kampioni biologjik i ADN-së është përdorur relativisht vonë në një proces penal kjo për shkak të arsyeve të njohura. Edhe pse në botë filloj të përdorej si një provë qysh në vitet 1980³ në Shqipëri fillesat i ka më të vonshme. Por që nga ai rast i përdorimit,⁴ u hap një dritare për krijimin dhe konsolidimin e një praktike ligjore që është tepër efektive dhe në rastet kur përbën objekt i të provuarit nuk lë vend për dyshime, e as në krijimin e pistave të gabuara dhe të panevojshme për hetimet, duke përjashtuar personat që mund të mos kenë lidhje me veprën penale e duke forcuar në vetvete vetë dhënien e drejtësisë.

Edhe pse përdorimi i kampionëve biologjikë dhe përkatësisht i ADN-së në proceset penale shqiptare është i rrallë dhe i vonshëm, studimi dhe përcaktimi i procedurave rigorozë është i nevojshëm edhe për shkak të sfidave që e presin vendin për shkak të zhvillimeve teknologjike dhe zhvillimeve ekonomike.

¹ Adrian Gaxha, "Gjurmët biologjike, dhe roli e rëndësia e tyre në procesin penal", Doktoratura, Tiranë 2014, fq.9

² Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda, "Procedura Penale" Tiranë 2012, fq. 267.

³ Helena Soletu Muñoz Anna Fiodorova "DNA and Law Enforcement in the European Union: Tools and Human Rights Protection", Utrecht law Review, fq.149.

⁴ Vendimi nr.201, viti 2001, Gjykata e shkallës parë rrethit gjyqësor Tiranë

II. Procedura e marrjes së kampionëve biologjikë.

Duke analizuar shtesat e reja në KPP vihet re se për marrjen e kampionëve biologjikë mund të procedohet në disa forma.

Marrja e kampionëve biologjikë me qëllim përcaktimin e profilin të ADN-së bëhet nga ana e prokurorit pasi më parë ka marrë pëlqimin e të pandehurit apo të personave të tjerë sipas parashikimeve të nenit 201/a.

Pëlqimi i këtyre personave duhet të jetë me shkrim, ku nënshkruhet një deklaratë para prokurorit në të cilën ai bie dakord që i është njoftuar arsyeja e marrjes së kampionëve biologjikë apo nënshtrimit të procedurës mjekësore.⁵ Kjo lloj metode është më efektive dhe më e shpejtë duke sjellë edhe ecuri të procesit penal por nuk është në të gjitha rastet e zbatueshme, kjo edhe për shkak të kundërshtimeve që hasen për shkak të refuzimit të personit të cilit do ti merret kampioni biologjikë. Gjithashtu edhe elementi formal i dhënies së pëlqimit me shkrim përpara prokurorit është një garanci më tepër ndaj personit që do ti nënshtrohet marrjes së kampionit biologjik apo procedurës mjekësore për të shmangur në këtë mënyrë edhe abuzimet e mundshme që mund të ndodhin, pasi i janë treguar edhe arsyet se pse do ti nënshtrohet procedurës në fjalë. Për personat e mitur kodi ka përcaktuar se pëlqimi jepet nga ana e prindërve apo të kujdestarëve ligjorë.⁶

Në rastin kur personi të cilit duhet ti merret kampioni biologjik refuzon që të jap miratimin për marrjen e kampionit apo të nënshtrimit të procedurës mjekësore prokurori mund të veprojë në dy forma, në varësi kjo edhe të situatës konkrete dhe cështjes në të cilën ai po heton. Neni 201/a lejon që kampionët biologjikë të domosdoshëm të merren edhe në mënyrë të detyruar në përputhje me ligjin. Prokuori mund të iniciojë një kërkesë të motivuar kur refuzohet pëlqimi për marrjen e kampionëve biologjikë dhe nënshtrimit të procedurës ligjore.

Për vlerësimin e një kërkesë të tillë, Gjykata mund të vendosë ose jo nëse këto kampionë do të merren edhe pa pëlqimin e nevojshëm. Fakti që duhet të jetë e domosdoshme dhe e nevojshme marrja e këtyre materialëve biologjikë e justifikon këtë veprim, por kurrsesi të dëmtojë shëndetin e personit. Një kufizim i vecantë është dhe ai lirisë së vetë personit që do ti merret ky material apo do ti nënshtrohet procedurës mjekësore me qëllim provimin e fakteve që janë në procedim.⁷ Ky nen mund të has në disa kritika mbi kufizimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut si një mjet që i cënon atyre këto të drejta dhe i detyron të kryejnë procedura mjekësore të cilat ata nuk i pranojnë ka një justifikim (ultima ratio) për shkak të nevojshmërisë për provimin e fakteve penale. Gjithashtu është vendosur edhe një mjet mbrojtës në po këtë dispozitë duke parashikuar se nuk mund të merren procedura mjekësore të cilat çenojnë integritetin dhe shëndetin fizik të personave, apo të dëmtojnë shëndetin e tyre a ta vendosin në rrezik jetën e personave, të

⁵ Neni 201/a pika 3 i KPP-së.

⁶ Neni 201/a pika 4 e KPP-së

⁷ Neni 201/a pika 5 I KPP-së

dëmtojnë fëmijën e palindur apo të shkaktojnë dëmtime dhe vuajtje të cilat nuk përlligjen sipas protokolleve mjekësore.

Në nenin 201/a pika 6 janë parashikuar se kush janë dhe elementët e vendimit të gjykatës mbi bazën e të cilave do të merret vendimi për marrjen e kampionëve biologjikë apo nënshtrimin e një procedure mjekësore duhet të përmbajë në vetvete disa element që janë: të dhënat personale të personit që i nënshtrohet marrjes së kampionit biologjik ose procedurës mjekësore ose informacionin e nevojshëm për identifikim; veprën penale për të cilën ka nisur procedimi dhe një përshkrim të përmbledhur të fakteve përkatëse; një përshkrim të detajuar të llojit të kampionit biologjik që do të merret ose të procedurës mjekësore që do të kryhet, si edhe arsyet përse prova nuk mund të merret në mënyrë tjetër; të drejtën e personit që i nënshtrohet marrjes së kampionit biologjik ose procedurës tjetër mjekësore të ndihmohet nga një mbrojtës ose një person i besuar; vendin, datën, kohën dhe mënyrën e saktë të marrjes së kampionit biologjik ose kryerjes së procedurës tjetër mjekësore; njoftimin që personi që i nënshtrohet marrjes së kampionit biologjik ose procedurës tjetër mjekësore është i detyruar të paraqitet dhe paralajmërimin për shoqërim të detyrueshëm nëse nuk paraqitet pa shkaqe të ligjshme; nëse i pandehuri ose personi ka dhënë pëlqimin për marrjen e kampionit biologjik ose procedurës mjekësore, prokurori e bashkëngjit pëlqimin me shkrim në dosje.

Për këtë procedurë e nevojshme gjithashtu është edhe njoftimi i palës ndaj të cilës do të nënshtrohet në procedurë mjekësore apo marrjes së kampionit biologjikë, ku neni 201/a pika 7 ka parashikuar se personit në fjalë i njoftohet tre ditë më parë vendimi për marrjen e kampionëve biologjikë, apo për nënshtrimin e procedurës mjekësore të detyruar.

Gjithashtu KPP vazhdon me procedurën e noftimit ku në rastet se personit ndaj të cilëve do ti nënshtrohet procedurës mjekësore apo kampionit biologjik është i pandehuri apo viktimë, vendimi i njoftohet të pandehurit, avokatit mbrojtës dhe viktimës. Ndërsa në rastet kur personi që do ti nënshtrohet ndërhyrjeve në fjalë nuk është i pandehuri apo viktimë vendimi i njoftohet të pandehurit, viktimës dhe avokatit të tij mbrojtës. Kurse në rastet e të miturve vendimi i njoftohet prindërve ose kujdestarit ligjor.⁸

Në rastet kur është dhënë një vendim nga ana e gjykatës për tju nënshtruar një procedure mjekësore apo marrjes së kampionit biologjikë dhe personi refuzon për tu paraqitur pa ndonjë arsye të ligjshme në vendin e caktuar nga ana e gjykatës, prokurori mund ti kërkojë gjykatës që të urdhërojë shoqërimin e detyrueshëm të personit në mënyrë që ti nënshtrohet procedurës mjekësore apo marrjes së kampionit biologjik.⁹

Mund të ndodhë që për ndonjë arsye të ngutshme apo dhe për shkak se në qoftë se pritet më shumë, vonesa mund të shkaktojë dhe humbjen apo vërtetësinë e

⁸ Neni 201/a pika 8 e KPP-së

⁹ Neni 201/a pika 9 e KPP

provës. Për këtë arsye në kod në nenin 201/a është parashikuar pika 10 dhe 11 për të rregulluar këtë situatë. Prokurori në raste të këtilla mund të nxjerrë një vendim për shoqërimin e detyrueshëm të personit që do të nënshtrohet procedurës mjekësore apo marrjes së kampionit biologjikë. Në këto raste këto kampionë merren me urdhër të prokurorit dhe jo të gjykatës. Por prokurori është i detyruar që brenda 48 orëve nga nxjerrja e një urdhëri të tillë ti vleftësojë përpara gjykatës, e cila njofton dhe prokurorin dhe mbrojtësin në qoftë se i ka vleftësuar këto veprime. Qëllimi i këtij vleftësimi është shmangja e cdo lloj abuzimi apo keqpërdorimi i mostrës së marrë.

Prania e mbrojtësit është kurdoherë e detyrueshme në rastet kur procedura mjekësore apo marrja e kampionit biologjikë ushtrohet ndaj personit të pandehur apo të dyshuar.¹⁰ Gjithashtu në rastet kur kjo procedurë ushtrohet ndaj të miturit është e domosdoshme prania e prindrit apo kujdestarit ligjor ose e një personi të besuar prej tij është e nevojshme.¹¹

Në cdo rast kur procedura e ndërhyrjes mjekësore apo e marrjes së kampionit biologjik është kryer jashtë rregullimeve të shprehura nga nenet e KPP-së, ato janë të pavlefshme dhe nuk mund të përdoren.

III. Asgjësimi i kampionëve biologjikë dhe procedura e asgjësimit.

Për sa i përket asgjësimit të kampionëve biologjikë në kod është parashikuar një mënyrë specifike, në mënyrë që këto të dhëna të disponohen në kuadër të funksionit që ato kanë dhe mënyrës së përfundimit të çështjes penale. Rregulli i përgjithshëm i parashikuar nga ana e kodit është që kampionët ruhen nga ana e organit procedues për sa kohë që është e nevojshme dhe i shërben procedimit¹², por që kjo ndryshon edhe në varësi të vendimit të gjykatës ndaj personit ndaj të cilit është marrë një vendim i formës së prerë.

Në kod në nenin 201/1b pika 2 dhe 3 parashikohet se në rastet kur i pandehuri deklarohet i pafajshëm këto kampionë asgjësohen, për shkak se nuk i shërbejnë më procedimit penal, por edhe për faktin se për këto të dhëna biologjike kanë shërbyer edhe si mjet për mos deklarimin e fajshëm të të pandehurit. Sigurisht që vendimi për asgjësimin e kampionëve biologjikë ndodh pas një vendimi të formës së prerë për pafajsi, pra kur ai ka marrë formën e prerë sipas parashikimeve ligjore të KPP.

Vendimi për asgjësimin e kampionëve biologjikë jepet nga ana e gjykatës, pra gjykata që ka dhënë dhe vendimin për pafajsi. Në rastet kur vihet re se kampionët biologjikë mund të përdoren dhe në procedime të tjera penale, dhe janë marrë ndaj personave të tjerë në këtë çështje, gjykata mund të urdhërojë edhe ruajtjen e këtyre kampionëve biologjikë me qëllim përdorimin e tyre në procedimin e lidhur me të. Ky vendim i gjykatës nuk mund të bëhet ex- officio, por me anë të një kërkesë të

¹⁰ Neni 201/a pika 12 e KPP

¹¹ Neni 201/a pika 13 e KPP

¹² Neni 201/b pika 1 e KPP.

motivuar nga ana e prokurorit, viktimës apo pëfaqësuesit ligjor të viktimës brenda 60 ditëve nga dhënia e vendimit për pafajsi.

Në rastet kur i pandehuri shpallet i fajshëm në kodin e procedurës penale janë parashikuar dispozita të tjera. Kur i pandehuri deklarohet fajtor me vendim të formës së prerë atë herë kampionët biologjikë ruhen për një periudhë kohe prej 20 vitesh nga dhënia e vendimit të formës së prerë.¹³ Ky afat i gjatë kohor mendoj se i shërben një qëllimi për ruajtjen e të dhënave dhe krijimin e një database e cila mund të përdoret efektivisht në të ardhmen, me qëllim krahasimin e kampionëve biologjikë që mund të merren në vepra të tjera penale, duke rritur me efektivitet luftën ndaj kriminalitetit dhe duke forcuar sistemin e drejtësisë. Në të njëjtën qëndrim mendoj se ka qenë dhe arsyeja e ligjvënësimit (ratio), ku në pikën 5 të këtij neni ka vendosur që për veprat penale që paraqesin një rrezikshmëri të lartë shoqërore këto kampionë të ruhen për një afat më të zgjatur, duke ja dyfishuar afatin dhe duke e lënë në 40 vite nga dhënia e vendimit të formës së prerë për fajësi. Për veprat shoqërore me rrezikshmëri të lartë dhe për personat që i kanë kryer këto vepra KPP ka bërë një përcaktim rigoroz të tyre duke futur aty vetëm veprat që kanë një afat dënimi jo më pak se 10 vjet në maksimum. Krijimi i kësaj praktike është dhe nën frymën e zhvillimeve europiane apo të vendeve të tjera të zhvilluara për një parandalim dhe ndëshkim sa më efektiv në luftën ndaj kriminalitetit.

Në rastet kur janë marrë disa kampionë biologjikë me qëllim përcaktimin e profileve të ADN-së, por nuk i atribuohen një personi të caktuar, ato mbahen deri në afatin e parashkrimit të ndjekjes penale sipas parashikimeve të kodit penal për parashkrimin e ndjekjes penale dhe më pas urdhërohet asgjësimi i tyre.¹⁴

Kampionët biologjikë të cilët janë marrë në kundërshtim me parashikimet e KPP janë të pavlefshëm dhe ato nuk mund të përdorën në procedime penale, pavarësisht nëse ato janë thelbësore për provimin e faktit penal. Ndaj këtyre kampionëve të cilët janë marrë në mënyrë të tillë organi procedues vendos asgjësimin e tyre.¹⁵

Një bashkëpunim i nevojshëm duhet që të ekzistojë ndërmjet organeve të sistemit gjyqësor, forcave të rendit por edhe organeve ligjore të shëndetsisë. Ky bashkëpunim ka për synim forcimin e procedurave ligjore të cilat duhet të jenë sa më korrekte, të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të individit, të mos çenojnë shëndetin e personit dhe integritetin e tij fizik e të mos i shkaktojnë atij vuajtje. Gjithashtu nevojitet një sërë aktesh nënligjore që kanë të bëjnë me mënyrën e ruajtjes së kampionëve biologjikë, apo dhe asgjësimit të tyre, duke përcaktuar një procedurë të qartë dhe strikte, në bashkëpunimin e domosdoshëm ndërmjet të gjithë aktorëve që kanë për detyrë mbajtjen dhe shkatërrimin e këtyre kampionëve.

¹³ Neni 201/b pika 4 e KPP.

¹⁴ Neni 201/b pika 6 i KPP.

¹⁵ Neni 201/b pika 7 i KPP.

IV. Mbrotja e të drejtave të njeriut gjatë marrjes dhe përdorimit të kampionëve biologjikë

Një nga problematikat që mund të lindë nga marrja e kampionëve biologjikë siç e kemi përmendur më sipër është dhe shkelja e të drejtave të njeriut. Kjo shkelje mund të ndodhë si në fazën e marrjes së këtyre kampionëve, ashtu dhe gjatë përdorimit apo analizimit të tyre. Gjithashtu një shkelje potenciale e të drejtave të njeriut mund të ndodhë dhe në fazën e përpunimit të të dhënave të ADN-së apo dhe përdorimit të tyre në ndonjë procedim tjetër të mundshëm penal.

Të drejtat potenciale që mund të shkelen janë e drejta për të mos çenuar integritetin dhe moralin e personit, e drejta për të mos ju nënshtruar një trajtimi çnjerzor dhe degradues, e drejta për të mos u vetëinkriminuar, e drejta për jetë private etj.

Në legjislacionin e çdo vendi përcaktohet se të drejtat e njeriut mund të kufizohen sipas disa kushteve dhe kriterëve të caktuara në qoftë se kanë një qëllim public dhe janë proporcionale e në përputhje dhe me aktet ndërkombëtare,¹⁶ pra në qoftë se këto të dhëna merren ligjërisht kjo shkelje e të drejtave ka një justifikim ligjor.

Në rastet e nënshtrimit ndaj procedurave mjekësore ndaj shteteve ekziston një detyrim, për të mbrojtur një nga të drejtat themelore që është për të mos ju çenuar integriteti fizik dhe moral si dhe për të mos ju çenuar shëndeti i tyre fizik e mendor. Praktika e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) ka qenë në këtë qëndrim duke argumentuar se: *“Per sa i perket nderhyrjeve mjekesore to cilave nje person i ndaluar u nenshtrohet kunder vullnetit to tij apo te saj, neni 3 i Konventes vendos nje detyrim mbi shtetin per to mbrojtur mireqenien fizike to personave to privuar nga liria, per shembull, duke u ofruar atyre ndihmen e nevojshme mjekesore”*.¹⁷ Po në këtë qëndrim GjEDNJ ka argumentuar se në rastet se këto ndëryhje janë në përputhje me parimet e mjekësisë apo ato teurapike, ato nuk mund të quhen trajtime çnjërzore apo degraduese.¹⁸

Edhe pse dy shkeljet më të pretenduara janë neni 3¹⁹ dhe 8²⁰ të Konventës, praktika e konsoliduar e GJEDNJ ka vendosur që marrja e mostrave të gjakut në kundërshtim me vullnetin e të dyshuarit nuk është në kundërshtim me këto nene me qëllim hetimin e veprave penale.²¹

¹⁶ Neni 17 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

¹⁷ Jalloh v. Gjermanise

¹⁸ Herczegfalvy v. Austrise,

¹⁹ Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjërzore ose poshtëruese.

²⁰ E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare.

²¹ X v. Holandes

Në çdo rast, çdo ndërhyrje për të marrë mostra nga trupi i njeriut me qëllim analizimin e tyre duhet të jetë e justifikuar me prova bindëse dhe fakte në varësi të rastit. Këto nuk janë të vetmet elementë që mbahen parasysh pasi shihet dhe natyra e veprës penale dhe rrezikshmëria shoqërore e saj. Këto ndërhyrje duhet të jenë gjithmonë në përputhje me procedurat dhe me mjetet e përshtatshme në mënyrë që të mos i ushtrojnë dëmtime personave ndaj të cilët ushtrohet.

Gjithashtu një nga shkeljet e tjera që mund të pretendohen nga palët është dhe shkelja e privatësisë. Për këtë arsye një sërë çështjesh kanë mbërritur në GJEDNJ në lidhje me shkatërrimin e të dhënave të ADN-së. Në praktikën e deri më tanishme gjykata ka argumentuar se që mbajtja e pakufizuar e këtyre të dhënave nuk është e justifikueshme dhe rezulton në shkelje të së drejtës për privatësi.²² Por në praktikën e gjykatës në rastet kur kemi një të pandehur që shpallet fajtor atëherë situata ndryshon, ku këto të dhëna mund të ruhen me qëllim që të parandalohet kriminaliteti dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të personave të tjerë.²³ Edhe pse mbrojtja e të dhënave personale është një nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut e sanksionuar në disa akte ndërkombëtare, ajo është një e drejtë që duhet të shihet dhe në funksionin e saj në shoqëri²⁴, pra e lidhur me të drejtat e tjera. Në këtë mënyrë ajo mund të kufizohet për qëllimet dhe funksionet me interes publik, në mënyrë proporcionale dhe e parashikuar në mënyrë strikte sipas parashikimeve ligjore.

V. Përdorimi i ADN-së në vendet e Bashkimit Europian

Bashkimi Europian ka krijuar një procedurë fikse dhe të mirëpërcaktuar për të rregulluar çështjet që kanë të bëjnë me përdorimin e kampionëve biologjikë dhe kryesisht ADN-së, si dhe për shkëmbimin e të dhënave të këtyre databeseve për të parandaluar dhe luftuar efektivisht kriminalitetin.

Për të rregulluar këtë situatë në Bashkimin Europian (BE) janë nxjerrë disa akte të cilat janë me karakter të ndryshëm, me qëllim përdorimin e tyre në mënyrë efektive, ruajtjen e të dhënave personale, dhe respektimin e të drejtave themelore të njeriut.

Nga aktet e nxjerra nga Bashkimi Europian mund të përmendim disa, duke i renditur dhe në bazë të rregullimit të tyre, ku përmendim për shembull vendimin kuadër për mbrojtjen e të dhënave personale të përpunuara në kuadër të bashkëpunimit policor dhe gjyqësor në çështjet penale²⁵. Gjithashtu organet e bashkimit europian kanë rregulluar në mënyrë strikte dhe proceduriale dhe mbrotjen e individëve mbi përdorimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të këtyre të

²² S & Marper kundër Mbretërisë së Bashkuar

²³ Van der Velden vs the Netherland

²⁴ Volker und Markus Schecke GbR, Hartmut Eifert v Land Hessen, Gjykata Europiane e Drejtësisë.

²⁵ Vendimit kuadër 2008-977

dhënave.²⁶ Këto akte të sipërpërmendura kanë qenë dhe shpesh objekt i shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën Europiane të Drejtësisë (GJED) dhe GJEDNJ.

Vendimi i Këshillit 2008/615/JHA detyron shtetet anëtare të BE të krijojnë bazat e të dhënave kombëtare dhe parashikon rregullat për autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare të BE-së për të kërkuar në ADN-në në vendet e tjera, dhe të gjitha të dhënat e ruajtura nga shtetet antarë, duke qenë në këtë mënyrë instrumenti i parë i BE-së që parashikon qasje të drejtpërdrejtë në bazat e të dhënave kombëtare të vendeve të tjera.²⁷ Por për të vazhduar në këtë frymë institucionet e Bashkimit Europian vendosën gjithashtu dhe të standartizonin dhe laboratorët përkatës të shteteve anëtarë, në mënyrë që të kenë të njëjtët rezultate dhe të jenë brenda standardeve ndërkombëtarë. Kështu do jetë një kredibilitet më i madh në çdo shtet anëtar dhe do jetë më i besueshëm e më transparent në procedurat e shkëmbimit të të dhënave personale ndërmjet shteteve antare të BE-së.²⁸

Në këtë mënyrë BE ka parashikuar në mënyrë të qartë mundësitë e bashkëpunimit ndërmjet shteteve antarë për të parandaluar dhe luftuar me efektivitet kriminalitetin dhe terrorizmin. Por aktet e nxjerra nga ana e BE nuk janë vetëm akte me karakter të detyrueshëm, por edhe me qëllim për arritjen e një mbrotje të fortë ndaj të drejtave dhe lirive personale, e kryesisht ndaj të dhënave personale dhe jetës familjare. Një sërë aktesh të tjerë me karakter detyrues apo në formën e rekomandimeve janë nxjerrë nga ana e BE për vendet anëtare, por që patën dhë një ndikim të drejtpërdrejtë dhe në ndryshimet e reja të KPP-së. Kjo gjë nuk u krye vetëm në kuadrin e përafrimit të legjislacionit, por edhe për të qenë në përputhje me standarte ndërkombëtare të ushtrimit të këqyrjeve dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

VI. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

ADN-ja luan një rol thelbësor në përcaktimin dhe individualizimin e personave të mundshëm të kryerjes së veprës penale. Vlera e saj shkencore, por edhe e të të provuarit është e rëndësishme për faktet dhe proceset penale. Shqipëria në rrugën drejt europianizimit dhe BE-së, ka përpara një sfidë të rëndësishme në luftën ndaj kriminalitetit dhe ruajtjes së të drejtave dhe lirive themelore të individit.

Ndryshimet e reja në kod janë të rëndësishme, pasi përcaktojnë procedura dhe parashikime ligjore të cilat më parë nuk ekzistonin, duke rritur në këtë mënyrë mbrojtjen ligjore të individëve dhe garancitë e tyre procedurale në proceset penale. Zbatimi në mënyrë rigorozë i procedurave të marrjes së kampionëve biologjikë dhe

²⁶ Direktivën e BE-së 95/46 / KE te Parlamentit Evropian

²⁷ Helena Soletto, Muñoz Anna Fiodorov “DNA and Laë Enforcement in the European Union: Tools and Human Rights Protection”, Utrecht law Review fq.152.

²⁸ Vendimi Kuadër i Këshillit 2009/905 / JHA

i nënshtrimit të procedurave mjekësore duhet të bëhet kurdoherë në përputhje me ligjin.

Si në rastet e marrjes së këtyre kampionëve me qëllim përcaktimin e profilit të ADN-së në mënyrë të detyruar ashtu dhe me vullnet, nevojitet një bashkëpunim efektiv, por edhe në çdo rast duke parë faktet, veprat penale, e çështjen konkrete duke mënjanuar në këtë mënyrë çdo abuzim të mundshëm.

Ruajtja e të dhënave të AND-së parashikuar në KPP bëhet me qëllim krijimin e databaseve dhe skedarëve për të parandaluar krimet në të ardhmen, por edhe për të pasur një skedar efektiv për të lejuar që koha e proceseve penale të mos jetë më e tejzgjatur dhe e zvarritur, por të përcaktojë me shpejtësi, në rastet kur një individ konkret është fajtor apo i pafajshëm. Por ky parashikim është bërë dhe për të rritur bashkëpunimin me shtetet e tjera antare të BE-së apo në rajon, duke forcuar kështu bashkëpunimin gjyqsor dhe policor në çështjet penale.

Përkrah kritikave të shumta për një shkelje potenciale të të drejtave të njeriut GJEDNJ ka krijuar një praktikë të konsoliduar në çështjet e trajtuara deri më tani, duke na dhënë zgjidhje të mundshme, por edhe interpretime me vlerë të cilat duhet të jenë si themel në rastet e trajtimit të këtyre çështjeve në gjykatat kompetente apo në prokurori. Gjithashtu për të forcuar mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nevojitet dhe nxjerrja e një sërë aktesh të tjera nënligjore, të cilat përcaktojnë në mënyrë të detajuar mënyrën e ruajtjes dhe përdorimit të këtyre të dhënave të marra, si dhe për procedurën e asgjësimit që të dhënat personale të jenë të mbrojtura deri në fund.

Kryerja e të gjithave veprimeve proceduriale nga ana e organit procedues në përputhje të plotë me ligjin dhe me këto ndryshime është e domosdoshme, e për këtë arsye praktika shqiptare në këtë drejtim është e re, kjo edhe për shkak të zhvillimit teknologjik e kushteve konkrete, ku pritet me mjaft interes se si kjo çështje do të zhvillohet në të ardhmen.

BIBLIOGRAFIA

- Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda, “Procedura Penale” Tiranë 2012.
- Adrian Gaxha, ”Gjurmët biologjike, dhe roli e rëndësia e tyre në procesin penal” , Doktoratura, Tiranë 2014.
- Helena Soletto Muñoz Anna Fiodorova “DNA and Law Enforcement in the European Union: Tools and Human Rights Protection”, Utrecht law Review.
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Kodi i Procedurës Penale.
- Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut.
- Vendimi nr.201, viti 2001, Gjykata e shkallës parë rrethit gjyqësor, Tiranë.
- Direktiva e BE-së 95/46 / KE te Parlamentit Evropian.
- Vendimi Kuadër i Këshillit 2009/905 / JHA.
- Vendimit kuader 2008-977

- Jalloh v. Gjermanise, aplikimi numër 54810/00, GJEDNJ.
- Herczegfalvy v. Austrise, aplikimi numër 10533/83, GJEDNJ.
- X v. Holandës, aplikimi numër 8978-80, GJEDNJ.
- S & Marper kundër Mbretërisë së Bashkuar, aplikimi numër 30562/04, GJEDNJ.
- Van der Velden vs Netherland, aplikimi numër 21203/10, GJEDNJ.
- Volker und Markus Schecke GbR, Hartmut Eifert v Land Hessen C92-09, Gjykata Europiane e Drejtesise.

GJYKIMI I DREJTËPËRDERJTË. RISITË E KODIT TË PROCEDURËS PENALE

Nga: Ina HASANKOLLI

*Studente në: Master Shkencor Penal,
Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.
Email: inainna63@ymail.com*

ABSTRAKT

Ndryshimet e bëra në Kodin e Procedurës Penale synojnë të forcojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut si dhe përshtetshmërinë e procedurave penale. Me ndryshimet e KPP, një pjesë e instituteve kanë pësuar një sërë ndryshimesh, një prej këtyre instituteve është dhe Gjykimi i Drejtëpërdrejtë. Gjykimi i Drejtëpërdrejtë është Gjykim i Posaçëm i cili mund të përdoret në rastet e arrestit në flagrancë të të pandehurit dhe kur gjykata çmon se nuk ka nevojë për hetime të mëtejshme.

Gjykimi i Drejtëpërdrejtë është një procedure e veçantë gjykimi, pasi ajo synon shmangien e zvarritjeve të proceseve penale si dhe shkurtimin e shpenzimeve gjyqësore. Ky gjykim i posaçëm çon në shkurtimin e afateve të zakonshme gjyqësore pasi në këtë rast disa faza procedurale nuk zbatohen dhe kalohet direkt në gjykimin e çështjes brenda 48 orëve nga arrestimi i personit. Gjykata ka një rol mjaft të rëndësishëm pasi është pikërisht ajo që vendos lidhur me gjykimin ose jo të drejtëpërdrejtë duke u bazuar në kërkesën dhe provat e paraqitura nga prokurori.

Një nga problemet më thelbësore që mund të lindin është mbrojtja e të drejtave të të pandehurit në procesin penal, duke marrë shkas nga fakti që koha e gjykimit është më e shpejtë duke lënë pas një sërë procedurash të cilat janë të zakonshme në proceset penale.

Praktika gjyqësore shqiptare në kuadër të gjithë këtyre ndryshimeve është e hapur për të gjetur zgjidhjet dhe metodat e përshtatshme me qëllim zbatimin sa më me efikasitet të gjykimeve të posaçme në funksion të një procesi të rregullt ligjor.

***Fjalë kyçe:** gjykimi i drejtëpërdrejtë, procedura penale, ndryshimet në KPP, gjykime të posaçme.*

I. Gjykimi i drejtëpërdrejtë

Gjykimi i drejtëpërdrejtë është një nga gjykimet e posaçme, të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale (KPP). Ndryshimeve të bëra në KPP nuk mund t'u shmangej as ky lloj gjykimi. Ky gjykim ndonëse është huazuar nga e drejta italiane¹, ai është përshtatur me kushtet dhe realitetin shqiptar. Qëllimi i këtyre

¹ Nenet 449-452 të Kodit të Procedurës Penale Italiane.

ndryshimeve ka në thelb forcimin e mbrojtjes së të drejtave dhe garantimit të lirive të të pandehurit gjatë procesit penal, shmangien e zvarritjeve në gjykimin penal, shkurtimin e shpenzimeve gjyqësore dhe funksionimin më me efikasitet të organeve të drejtësisë.

Ky lloj gjykimi ka qënë thujse aspak i përdorur në praktikë. Çështjet e gjykuara me gjykim të drejtpërdrejtë kanë qënë thujse të pallogaritshme në numër nëse do e krahasonim me gjykimin e zakonshëm apo me atë të shkurtuar, duke marrë parasysh faktin se deri para ndryshimeve të pësuara në kod ekzistonin vetëm dy lloj gjykimesh të posaçme konkretisht: gjykimi i drejtpërdrejtë dhe ai i shkurtuar. Me ndryshimet e pësuara në kod janë shtuar dhe dy gjykime të tjera të posaçme, përveç atyre ekzistuese siç janë: gjykimi me marrëveshje dhe gjykimi me urdhër penal, te cilat gjithashtu mbartin në vetvete një sërë karakteristikash specifike.

Gjykimi i drejtpërdrejtë ndonëse në thelb ka vazhduar të jetë i njëjti institut që ka qënë përpara ndryshimeve në kod, ai ka pësuar disa ndryshime në procedurën e zhvillimit të tij si dhe duke ndryshuar rastet ekzistuese të zbatimit të tij në praktikë. Kto ndryshime kanë gjithashtu në thelb të tyre, që ky institut të bëhet më i përdorshëm dhe sa më efektiv në praktikë.

Karakteristikë e gjykimit të drejtpërdrejtë është koha e reduktuar e zhvillimit të procedurave gjyqësore si dhe mungesa e disa formaliteteve të nevojshme në gjykimet e zakonshme. Ky fakt konsiston në realizimin e një gjykimi sa më të shpejtë në kohë dhe dhënien e një vendimi gjyqësor të drejtë. Pavarësisht nevojës që mund të ketë sistemi apo ndjeshmëria e çështjes konkrete për një zgjidhje sa më të shpejtë, gjykimi nuk duhet të bjerë në kundërshtim me të drejtën e individit për një proces të rregullt ligjor². Të pandehurit duhet t'i respektohen të gjitha të drejtat në proces si: e drejta për t'u gjykuar brenda një afati kohor të arsyeshëm, e drejta për të pasur një mbrojtës, barazia e armëve në proces dhe respektimi i parimit të kontradiktioriteti, etj. Përveç karakteristikave të veçanta që gëzon ky institut ai zbaton për sa është e mundur rregullat e përgjithshme në gjykimet e zakonshme.

Praktika shqipëtare ndonëse e varfër në zbatimin e këtij gjykimi, pritet të shihet se si do të përshtatet lidhur me ndryshimet që ka pësuar kodi i procedurës penale në tërësi, me futjen e institutive të reja si: gjyqtari i hetimeve paraprake, gjykimet e reja të posaçme, roli i viktimës si palë në procesin penal, shtimi i garancive procedurale për të pandehurin në procesin penal, përmirësimi i rregullave të ankimit dhe të njoftimeve, ripërkufizimi i kopetencave të Gjykatës së Lartë etj., si dhe gjykimi i drejtpërdrejtë në mënyrë të veçantë.

II. Rastet e gjykimit të drejtpërdrejtë

Gjykimi i drejtpërdrejtë zbatohet në dy raste të parashikuara shprehimisht në KPP përkatësisht në nenin 400. Rasti i parë lidhet me arrestin në flagrancë, kur prokurori mbas 48 orëve të arrestimit kërkon vlerësimin e masës së arrestit

²Neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

dhe kërkesën për gjykim të drejtpërdrejtë, si dhe në bazë të provave e sheh si të panevojshme kryerjen e hetimeve të tjera. Pas këtij veprimi procedural, gjykata merr një rol vendimtar lidhur me vleftësimin e ligjshmërisë së arrestit. Në qoftë se gjykata e vlerëson si të ligjshëm arrestin në flagrancë ajo mund të vendosë gjykimin e menjëhershëm të çështjes.

Gjëndja e flagrancës si kusht për kryerjen e arrestimit në flagrancë kushtëzohet nga disa faktorë, siç janë: kur personi është kapur në kryerje e sipër të veprës penale; menjëherë pas kryerjes së veprës penale ndiqet nga Policia Gjyqësore, nga personi i dëmtuar ose nga persona të tjerë; është kapur me sende dhe prova materiale, nga të cilat duket që ka kryer veprën penale. Gjëndja e flagrancës do të vazhdojë për aq kohë sa zgjat ndjekja e pandërprerë e autorit të veprës, e cila mund të zgjasë disa orë dhe në raste të veçanta edhe ditë.³

Arrestimi e humbet fuqinë kur vendimi i gjykatës nuk është shpallur brenda 48 orëve nga çasti kur kërkesa e prokurorit është paraqitur në gjykatë. Seanca e vlerësimit zhvillohet me pjesëmarrjen e domosdoshme të mbrojtësit dhe prokurorit. Gjykata pasi ka dëgjuar prokurorin dëgjon mbrojtësin dhe të pandehurin ose vetëm mbrojtësin kur i pandehuri ka refuzuar të paraqitet.⁴

Kusht thelbësor është gjithashtu të mos jetë e nevojshme të kryhen hetime të tjera bazuar në aktet e çështjes në shqyrtim. Kur gjykata vlerëson se nuk ka nevojë për hetime të mëtejshme procedon me gjykimin e drejtpërdrejtë, në të kundërt i kthen aktet prokurorit për vazhdimin e hetimeve. Në rastin e fundit pavarësisht nevojës për hetime të tjera prokurori dhe i pandehuri mund të japin pëlqimin për gjykimin e drejtpërdrejtë.⁵ Pra pavarësisht nevojës për hetime të mëtejshme nëse i pandehuri dhe prokurori bien në konsensus për të proceduar me gjykim të drejtpërdrejtë, gjykata detyrohet të pranojë kërkesën e prokurorit për këtë lloj gjykimi të posaçëm.

Gjykimi drejtpërdrejtë gjykohet nga një gjyqtar, që është dhe gjyqtari i vlerësimit të masës së arrestit. Në ndryshim nga Kodi i mëparshëm i cili linte hapësirë që çështja të gjykohej nga një gjyqtar ose nga një trup gjykues në varësi të veprës penale, kodi i ri e ka parashikuar në mënyrë eksplicite për çështjet në të cilat kërkohet si vlerësimi i masës së arrestit ashtu edhe gjykimi i drejtpërdrejtë, gjykohen nga një gjyqtar i vetëm. Ky parashikim bëhet për të gjitha ato vepra penale që arrijnë në maksimum deri në 10 vite burgim, pra nuk kanë një rrezikshmëri shumë të lartë shoqërore.⁶

³ Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda, “Procedura Penale”, Tiranë, 2012, fq. 362-363.

⁴ Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë 3/2002.

⁵ Neni 400/2 i KPP-së.

⁶ Sipas ndryshimeve të bëra në KPP, në nenin 13/3 për veprat penale që parashikojnë në maksimum deri në 7 vite burgim, mund të gjykoreshin nga një gjyqtar i vetëm. Këto vepra me kodin e ri parashikojnë gjykimet me një gjyqtar deri në 10 vite burgim në maksimum.

Rasti i dytë i parashikuar në nenin 400 paragrafi 3 i KPP, shfaqet si risi e ndryshimeve që ka pësuar kodi. Kur gjykata pas vlerësimit si të ligjshëm të masës së arrestit në flagrancë, vendos një nga këto masa sigurimi: arrestin në shtëpi⁷, arrestin me burgim⁸ ose shtrimin e përkohshëm në një spital psikiatrik⁹, prokurori detyrohet të paraqesë në gjykatë kërkesën për gjykim të drejtpërdrejtë brenda 30 ditëve nga data e arrestimit. Në qoftë se prokurori e çmon si të nevojshme vazhdimin e hetimeve të mëtejshme, ai duhet ta motivojë vendimin e tij për mosdorzimin e kërkesës për gjykimin e drejtpërdrejtë.

Në ndryshim nga Kodi i vjetër ku rasti i dytë parashikohej krejtësisht ndryshe, sipas tij prokurori duhej të procedonte me kërkesën për gjykim të drejtpërdrejtë dhe në rastet kur i pandehuri kishte pranuar fajësinë e tij, si dhe nuk kishte nevojë për hetime të mëtejshme, pasi fajësia ishte e qartë. I pandehuri duhej të paraqitej brenda 15 ditëve nga data e rregjistrimit të veprës penale. Në këtë rast nuk ishte e nevojshme që personi të ishte në gjëndjen e arrestit në flagrancë për kryerjen e nje vepre penale, apo të ishte ndërmarë ndaj tij ndonjë masë sigurimi, pra ai mund të ndodhej dhe në gjëndje të lirë.

Në rastet kur jemi përballë procedimeve të lidhura dhe për një prej tyre kërkohet gjykimi i drejtpërdrejtë dhe procedimet e tjera nuk plotësojnë kushtet e gjykimit të drejtpërdrejtë, në qoftëse nuk dëmtohen hetimet, çështjet mund të ndahen. Kur ndarja e procedimeve do të dëmtonte hetimet, për shkak se çështjet janë të lidhura ngushtësisht me njëra-tjetrën do të zbatohet gjykimi i zakonshëm.

Gjykimi i drejtpërdrejtë synon eliminimin e disa fazave proceduriale: këtu nuk gjejmë zbatim rregullat e zakonshme në veprimet përgatitore në gjykim si dhe afatet proceduriale janë më të shkurtra.

Në rastet kur gjyqtari vlerëson masën e arrestit në flagrancë, mund të krijohet hipoteza e një situatë pamundësie për gjykimin e çështjes në themel, kjo pasi ai mund të paragjykojë çështjen dhe se ndodhet në rastet e papajtueshmërisë për shkak të pjesëmarrjes në gjykim.

Në gjykimin e drejtpërdrejtë nuk aplikohet ky rregull i cili është parashikuar në nenin 15/2 i Kodit të Procedurës Penale në lidhje me rastet e papajtueshmërisë për shkak të pjesëmarrjes në gjykim të gjyqtarit i cili ka vleftësuar masën e arrestit. Për rrjedhojë në gjykimin e drejtpërdrejtë bëhet shqyrtimi i njëkohshëm i masës së arrestit dhe gjykimit në themel të çështjes e nëse arrestimi vleftësohet i drejtë dhe nuk ka nevojë për hetime të tjera, procedohet menjëherë me gjykimin e çështjes. Kur ndodhemi përpara një akuze për një vepër për të cilën parashikohet një dënim

⁷ Neni 237 i KPP-së.

⁸ Neni 238 i KPP-së.

⁹ Neni 239 i KPP-së.

në maksimum më tepër se dhjetë vjet burgim, kërkesa e prokurorit për vleftësimin e arrestit dhe gjykimin e drejtpërdrejtë duhet të shqyrtohet nga tre gjyqtarë.¹⁰

Në Kodin e Procedurës Penale nuk gjenden përcaktime që lidhen me aplikimin e gjykimit të drejtpërdrejtë me kualifikimin juridik të faktit objekt akuze. Megjithatë duket qartë se gjykimi i drejtpërdrejtë zbatohet për veprat penale për të cilat është kryer dhe arresti në flagrancë. Ekzistojnë disa vepra penale të cilat për nga mënyra e zhvillimit të anës objektive, do të kërkonin hetime më të detajuara, për të cilat zbatimi i gjykimit të drejtpërdrejtë do të ishte i vështirë. Kështu vepra të tilla si: korrupsioni, trafikimi, organizatat kriminale etj., kërkojnë hetime të gjëra e të ndërlikuara, pasi në to përfshihen shumë subjekte dhe kanë një shtrirje territoriale mjaft të gjërë, pasojat e të cilave vështirë se zbulohen që në fillim. Për këto vepra gjykimi i drejtpërdrejtë mund të mos ishte efektiv, ndonëse në teori nuk përjashtohet mundësia që dhe këto vepra të gjykohen me gjykim të drejtpërdrejtë.¹¹

III. Veprimet përgatitore për zhvillimin e gjykimit të drejtpërdrejtë

Kur ndodhemi në një nga dy rastet e procedimit me gjykim të drejtpërdrejtë dhe prokurori pasi ka mbledhur të gjitha provat e domosdoshme për provimin e faktit të çështjes penale, ai urdhëron për të pandehurin i cili është në gjëndjen e arrestit në flagrancë detyrimin për t'u paraqitur në seancë. Në rastin kur prokurori është i detyruar të nisë procedimin për gjykim të drejtpërdrejtë, pasi ndaj të pandehurit është vendosur një nga masat e sigurimit sipas parashikimeve të bëra në nenin 400/3, ekziston po i njëjti detyrim si dhe në rastin e pare. Kur i pandehuri ndodhet në gjëndje të lirë, afati për t'u paraqitur nuk mund të jetë më i shkurtër se tre ditë.¹²

Urdhëri i prokurorit është një akt procedural mjaft i rëndësishëm i cili duhet të përmbajë disa elementë thelbësorë siç janë: gjeneralitetet e të pandehurit dhe të dhëna të tjera personale që vlejné për identifikimin e tij, si dhe gjeneralitetet e palëve private dhe të mbrojtësve të tyre, gjeneralitetet e viktimës, në rast se rezulton e identifikuar, parashtrimin e faktit penal dhe rrethanave të tij, duke treguar dispozitat përkatëse të ligjit. Urdhëri i prokurorit duhet të përmbajë gjithashtu dhe vendin, datën dhe orën e paraqitjes, nënshkrimin e prokurorit dhe datën e nënshkrimit prej tij, si dhe paralajmërimin se në rast mosparaqitjeje të të pandehurit ai do të shoqërohet detyrimisht. Pasi në mungesë të njëjës nga kërkesat e sipër përmendura do të gjendemi përballë një prej rasteve të pavlefshmërisë. Ky parashikim në kod është mjaft i rëndësishëm jo vetëm për pasojë pavlefshmërie, por dhe për efekt

¹⁰ Klodjan Skënderaj, "Gjykimet e posaçme dhe rëndësia e tyre në procesin penal", Doktoratura, 2014, fq.53-54.

¹¹ Kreshnik Ajazi, "Mbi gjykimin e drejtpërdrejtë aspekte procedurale dhe diskutime nga praktika gjyqësore", Revista Jeta Juridike, Botimet Morava, Tiranw, 2010, nr 1, Viti i II i botimit, fq.151.

¹² Neni 401/1 i KPP-së.

njoftimi me qëllim për të patur një proces të rregullt ligjor sa më efektiv e për të mbrojtur pozitën e të pandehurit nga cënimet arbitrare të organeve proceduese.

Mbrojtësi i cili ka një rol thelbësor në garantimin e të drejtave procedurale të të pandehurit dhe ruajtjes së interesave të tij ligjore, njoftohet nga prokurori për datën e gjykimit. Gjithashtu për efekt të një mbrojtje juridike sa më efektive mbrojtësi lejohet të njihet me aktet dhe provat në proces, në gjëndjen që ato ndodhen. E drejta e mbrojtjes është një nga të drejtat themelore të individit, e cila parashikohet dhe në kushtetutën e Shqipërisë. Gjatë procesit penal gjithkush ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij, të komunikojë lirisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme.¹³

Në rastin e dytë të parashtruar më lart kur i pandehuri i arrestuar në flagrancë gjendet në një nga mast e sigurimit sic jane: arresti me burgim, arresti në shtëpi apo shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik, prokurori njoftohet të paktën dhjetë ditë përpara mbi datën dhe orën e gjykimit, si dhe për gjykatën që do të gjykojë çështjen. Kjo bëhet në mënyrë që prokurorit t'i jepet më tepër kohë për të përgatitur akt-akuzën, në funksion të një mbrojtje sa më efektive të interesit publik.

IV. Procesi i zhvillimit të gjykimit të drejtpërdrejtë

Gjykimi i drejtpërdrejtë edhe pse një nga gjykimet e posacme, ku afatet dhe procedurat janë më të shkurturtra dhe një pjesë e tyre eliminohen, ai zbaton për aq sa është e mundur dispozitat e shqyrtimit gjyqësor në gjykimet e zakonshme. Pra, pavarësisht parashikimeve specifike që bën kodi për këtë lloj gjykimi, për të gjitha ato hapa procedurale për të cilat nuk ka një parashikim të veçante për gjykimin e drejtpërdrejtë zbatohen dispozitat e shqyrtimit gjyqësor.

Rastet e gjykimit të drejtpërdrejtë janë dy rastet e parashikuara shprehimisht në KPP, në këtë mënyrë legjislatori përjashton çdo rast tjetër i cili mund të pretendohet për të kërkuar gjykim të drejtpërdrejtë. Kur kërkohet gjykim i drejtpërdrejtë jashtë rasteve të parashikuara në kod, gjykata ja kthen aktet prokurorit duke refuzuar kërkesën. Ky është një parshikim i ri në ndryshimet që ka pësuar kodi, pasi kodi i vjetër nuk parashikonte shprehimisht asgjë lidhur me këtë veprim procedural, ndonëse është e logjikshme që gjykata nuk e pranonte gjykimin e drejtpërdrejtë jashtë rasteve të parashikuara në kod.

Për sa i përket rastit të parë, pra arrestimin në flagrancë, në seancën e vlerësimit të masës së arrestit dhe kërkesës për gjykim të drejtpërdrejtë, prokurori mund t'i komunikojë akuzën të arrestuarit në seancë gjyqësore.

Me ndryshimet dhe risitë e sjella nga KPP, viktimja merr një status të veçantë procedural ajo tashmë mund të mbrojë interesat e saj në seancë gjyqësore. Për këtë arsye ajo mund të marrë pjesë edhe në këtë lloj gjykimi, ku gjithashtu ekziston detyrimi për t'u njoftuar nga ana e policisë gjyqësore për seancën¹⁴. Ky parashikim

¹³ Neni 31, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

¹⁴ Neni 402 paragrafi 1/1 i Kodit të Procedurës Penale.

vlen edhe për dëshmitarët të cilët përbëjnë një element thelbësor në shqyrtimet gjyqësore.

Prova është element i rëndësishëm i çdo procesi gjykimi, e njëjta gjë vlen dhe për gjykimin e drejtpërdrejtë. Në këtë gjykim të posaçëm prokurori, i pandehuri dhe paditësi civil mund të paraqesin gjatë shqyrtimit gjyqësor dëshmitarë, pa u thirrur paraprakisht nga gjykata. Në ndryshim kjo nga sa parashikonte kodi i vjetër i cili përdorte shprehjen “prova të tjera” duke mos e përcaktuar llojin e provës.

Përveç të drejtave të tjera që duhet të jenë të garantuar në gjykim, gjykata i njej të pandehurit të drejtën për të kërkuar një nga dy format e tjera të gjykimit të pasacëm. I pandehuri mund të kërkojë gjykimin e çështjes me gjykim të shkurtuar në gjëndjen që janë aktet ose të përfitojë nga gjykimi me marrëveshje, një gjykim i ri ky i parashikuar nga kodi i ri. Ky institut i ri është huazuar nga vendet e common law, që konsiston në pranimin e fajësisë nga i pandehuri në bazë të një marrëveshjeje me prokurorin mbi kushtet e pranimit të fajësisë dhe caktimin e dënimit. Gjykimi me marrëveshje mund të zbatohet vetëm për ato vepra që kanë në maksimum deri në 7 vite burgim.

Pasi i pandehuri merr djeni se mund të zgjedhë një nga dy format e tjera të gjykimeve të posaçme, por zgjedh të vazhdojë me gjykimin e drejtpërdrejtë, ai ka të drejtë të kërkojë afat për të përgatitur mbrojtjen deri në pesë ditë, ndryshe nga kodi i vjetër i cili parashikonte një afat më të shkurtër, prej tre ditësh. Kjo shërben për të siguruar një mbrojtje sa më efektive të interesave ligjore të të pandehurit.

Në rastet kur i pandehuri kërkon të vazhdojë procesin gjyqësor ndaj tij me gjykimin e shkurtuar, gjykata pasi shqyrton kërkesën dhe ka marrë mendimin e prokurorit, vendos shqyrtimin e çështjes me gjykim të shkurtuar duke respektuar rregullat për këtë gjykim. Nëse gjykata nuk e sheh kërkesën e të pandehurit për gjykim të shkurtuar si të bazuar, e refuzon atë duke vazhduar me gjykimin e drejtpërdrejtë¹⁵.

V. Gjykimi i drejtpërdrejtë i parë në një vështrim krahasimor lidhur me gjykimet e tjera të posaçme

Gjykimi drejtpërdrejtë dhe gjykimi i shkurtuar janë dy gjykime të posaçme të cilat kanë qënë të parashikuara që me kodin e vjetër të procedurës penale, ndonëse kanë pësuar një sërë ndryshimesh. Gjykimi i shkurtuar është aplikuar më shpesh në praktikën gjyqësore shqiptare në krahasim me gjykimin e drejtpërdrejtë.¹⁶ Faktori kryesor i aplikimit më të shpeshtë të këtij gjykimi është fakti se kur jepet vendim dënimi, gjykata e ul dënimin me burgim ose gjobë me një të tretën. Gjykimi i shkurtuar me ndryshimet e kodit të procedurës penale nuk aplikohet për veprat penale për të cilat parashikohet dënimi me burgim të përjetshëm. Gjykimi i

¹⁵ Neni 402 i Kodit të Procedurës Penale.

¹⁶ Gerti Tartale, “Gjykimet e posaçme si alternativë gjykimi në aspektin krahasues”, doktoratura, Tiranë, 2016, fq.165.

shkurtuar zhvillohet në gjëndjen që janë aktet, pra marrja e provave në shqyrtim të këtij gjykimi nuk lejohet, në ndryshim nga gjykimi i drejtpërdrejtë. Pranimi i zhvillimit të procesit me gjykim të shkurtuar në gjëndjen që janë aktet nuk do të thotë domosdoshmërisht dhe pranimi i fajësisë.

Gjykimi me marrëveshje siç kemi përmendur dhe më lart është një nga risitë e kodit të ri të procedurës penale. I cili konsiston në një marrëveshje midis të pandehurit ose mbrojtësit të autorizuar prej tij dhe prokurorit për pranimin e plotë të fajësisë dhe kushtet për caktimin e dënimit, për sa kohë nuk ka filluar ende shqyrtimi gjyqësor. Nëse tek gjykimi i drejtpërdrejtë gjykata zbaton për sa është e mundur rregullat e shqyrtimit gjyqësor, në gjykimin me marrëveshje gjykata miraton ose jo pranimin e marrëveshjes pasi ka një rol më tepër kontrollues. Ajo duhet të bindet për vullnetin e lirë të palëve në nënshkrimin e marrëveshjes apo nëse jemi përpara ndonjë abuzimi. Arritja e marrëveshjes lejohet për veprat penale, për të cilat ligji parashikon një dënim në maksimum jo më shumë se 7 vjet burgim, ndërsa tek gjykimi i drejtpërdrejtë legjislatori nuk parashikon një kufi veprash penale për tu gjykuar.

Gjykimi me urdhër penal ashtu si dhe gjykimi me marrëveshje nuk parashikohet në kodin e vjetër. Gjykimi me urdhër penal kërkohet nga prokurori, kur ai çmon se nuk duhet të zbatohet dënimi me burgim, kur i pandehuri akuzohet për kryerjen e një kundravajtje penale. Në ndryshim nga gjykimi i drejtpërdrejtë i cili parashikohet për çdo lloj vepre penale. Prokurori në urdhërin penal mund të kërkojë caktimin e dënimit kryesor me gjobë dhe sipas rastit dhe dënime të tjera plotësuese, pra prokurori ka një rol më të madh se në gjykimin e drejtpërdrejtë ku është gjykata ajo që cakton llojin dhe masën e dënimit. Në gjykimin me urdhër penal gjykata shqyrton kërkesën e prokurorit pa zhvilluar seancë gjyqësore, pra pa praninë e palëve dhe debat gjyqësor. Duke e parë në një rrafsh krahasimor gjykimi drejtpërdrejtë zhvillohet duke respektuar rregullat e shqyrtimit gjyqësor.

VI. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Gjykimi i drejtpërdrejtë është një nga gjykimet e posaçme i cili ka ekzistuar që në kodin e vjetër, ndonëse ka pësuar një sërë ndryshimesh. Ndryshimet kanë pasur në thelb përmirësimin e këtij instituti në mënyrë që ai të bëhet më i zbatueshëm, pasi është vënë re se në vitet e shkuara ai ka qënë thujse i papërdorur në praktikën gjyqësore.

Ky gjykim ka si qëllim zgjidhjen e çështjeve penale në një kohë sa më të shkurtër duke shmangur tejzgjatjet e proceseve gjyqësore, duke shkurtuar njëkohësisht dhe shpenzimet procedurale. Rregullat e shqyrtimit gjyqësor zbatohen dhe në gjykimin e drejtpërdrejtë për sa është e mundur.

Gjykimi i drejtpërdrejtë me ndryshimet e pësuara në kod zbatohet vetëm në rastet e flagrancës, si dhe kur kjo masë arresti vlerësohet si e ligjshme. Dikshëm na paraqitet se ky gjykim i posaçëm zbatohet vetëm kur ska nevojë për

hetime të mëtejshme, pasi bindja e brendshme e gjykatës krijohet në bazë të rrethanave të cilat paraqiten në mënyrë të dukshme në rastet konkrete flagrante.

Një nga rastet ku mund të zbatohet gjykimi i drejtpërdrejtë është rasti i dytë i parashikuar në kod, ku pasi gjykata e ka vlerësuar si të ligjshëm arrestin në flagrancë dhe vendos një nga këto masa sigurimi: arrestin në shtëpi, arrestin me burgim ose shtrimin e përkohshëm në një spital psikiatrik, prokurori detyrohet të paraqesë në gjykatë kërkesën për gjykim të drejtpërdrejtë brenda 30 ditëve nga data e arrestimit. Në këtë rast kemi detyrimin e prokurorit për të kërkuar gjykimin e drejtpërdrejtë brenda afatit të përcaktuar e nëse ai nuk e bën kërkesën duhet ta motivojë mendimin e tij.

Ndryshimet e reja të marra në tërësi ofrojnë një garanci më të madhe procedurale, duke i dhënë një pozitë më të favorshme të pandehurit, për të pasur një proces të rregullt ligjor dhe sa më efektiv.

Me ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale, kemi futjen e një subjekti të ri, pra viktimës e cili ka dhe një trajtim më të veçantë, për shkak dhe të vetë pozitës që ka. Viktima duhet të njoftohet për të qënë prezente në gjykimet që zhvillohen në mënyrë që të mbrohen më tepër interesat e saj ligjore. Viktima njoftohet për të qënë prezente dhe në gjykimin e drejtpërdrejtë, pavarësisht se ai është një gjykim i posaçëm dhe koha në të cilën zhvillohet është më e shkurtër.

Në gjykimin e drejtpërdrejtë nuk zbatohen rastet e papajtueshmërisë së gjyqtarit në gjykim, pasi këtu bëhet shqyrtimi i njëkohshëm i masës së arrestit në flagrancë dhe gjykimin në themel të çështjes, e nëse arrestimi vleftësohet i drejtë dhe nuk ka nevojë për hetime të tjera. Çështjet të cilat arrijnë në maksimum deri në dhjetë vjet burgim gjykohen nga një gjyqtar i vetëm.

Në rastet kur i pandehuri kërkon të vazhdohet gjykimi i çështjes me gjykim të shkurtuar, gjykata nëse e sheh kërkesën si të bazuar dhe pasi merr mendimin e prokurorit, mund të vazhdojë nga gjykimi i drejtpërdrejtë në gjykim të shkurtuar duke respektuar rregullat e këtij të fundit. Pra në këtë mënyrë është përcaktuar qartë se një çështje nuk mund të gjykohej njëkohësisht me gjykim të drejtpërdrejtë dhe me gjykim të shkurtuar.

Gjykimi i drejtpërdrejtë pritet të zbatohet më tepër me ndryshimet më të fundit në kod, bazuar në faktin se praktika shqiptare nuk është e unifikuar ende në drejtim të këtij instituti. Qëllimi i ndryshimeve ka si tendencë zbatimin më të shpeshtë të gjykimin të drejtpërdrejtë duke e konsoliduar në vijim, në mënyrë që të shmangen sa më tepër konfuzionet apo paqartësitë në zbatimin e tij. Pavarësisht përpjekjes së ligjvënësive për të mos lënë asnjë hapësirë për keqinterpretim, përsëri shihet e nevojshme zhvillimi i jurisprudencës përkrah doktrinës në këtë fushë.

BIBLOGRAFIA

Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda, “Procedura Penale”, Tiranë, 2012.

Klodjan Skënderaj, “Gjykimet e posaçme dhe rëndësia e tyre në procesin penal”, Doktoratura, 2014.

Gerti Tartale, “Gjykimet e posaçme si alternativë gjykimi në aspektin krahasues”, doktoratura, Tiranë, 2016.

Kreshnik Ajazi, “Mbi gjykimin e drejtpërdrejtë aspekte procedurale dhe diskutime nga praktika gjyqësore”, Revista Jeta Juridike,

Botimet Morava, Tiranë, 2010, nr 1, Viti i II i botimit, , fq.151.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Kodi i Procedurës Penale, ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017.

Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë 3/2002.

**PËRMBAJTJA E LETRËS ME SHKRIM E TË DREJTAVE
E PERSONIT NËN HETIM APO TË PANDEHUR SIPAS NENIT 34/a
TË KODIT TË PROCEDURËS PENALE DHE STANDARDET
EVROPIANE NË KËTË ASPEKT**

**Dr. Edlira JORGAQI¹
Dr. Entela NIKAJ²**

ABSTRAKT

Letra e të drejtave të personit nën hetim apo të pandehur është parashikuar nga neni 34/a i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, e konkretisht me ndërhyrjet nëpërmjet ligjit nr. 35/2017. Qëllimi i këtij punimi është të bëjë përshkrimin e objektit dhe qëllimit të kësaj dispozite të re në legjislacionin shqiptar. Të përshkruajë përmbajtjen e letrës të së drejtave të personit nën hetim apo të pandehur. Gjithashtu, punimi synon të vërë në dukje edhe aspektin krahasimor të kësaj dispozite duke analizuar përmbajtjen e saj me standardet evropiane në këtë drejtim.

Autorët e këtij punimi besojnë se, tema e zgjedhur për t'u trajtuar në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare “Legjislacioni penal midis traditës dhe sfidave të aktualitetit”, të organizuar nga Departamenti i së Drejtës Penale pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, do të zgjojë interes jo vetëm në planin e zhvillimit të mendimit juridik në fushën e së drejtës penale dhe të së drejtës në vendin tonë.

***Fjalë kyçe:** të drejtat e personit nën hetim, të drejtat e të pandehurit, letra e të drejtave, neni 34/a i Kodit Penal, garantimi i së drejtës së mbrojtjes së të pandehurit dhe personit nën hetim.*

1. HYRJE

Grupi i ekspertëve³ i angazhuar nga Kuvendi në kuadër të reformës në drejtësi konstatoi, se dispozitat që rregullonin njoftimin e të pandehurit, nuk ishin

¹ Anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Republika e Shqipërisë, E-mail : ejorgaqi@gmail.com

² Kuvendi i Shqipërisë nikajentela@gmail.com

³ Dokumenti Analizë e sistemit të drejtësisë në Shqipëri, Qershor 2015, faqe 87, paragrafi 4.2.5 “Efikasiteti nëpërmjet së drejtës procedurale Problemet në lidhje me njoftimin e dokumenteve vazhdojnë të ekzistojnë dhe kanë nevojë për zgjidhje. Në Shqipëri njoftimi i besueshëm i dokumenteve ende është problem në një numër të konsiderueshëm rastesh, në qoftë se i padituri nuk është i regjistruar ose nuk gjendet ose nuk ka një adresë postare. Ky nuk është vetëm një problem i regjistrimit të qytetarëve. Në Kodet e Procedurës mungojnë dispozita specifike që të mundësojnë një gamë të gjerë të njoftimit të vlefshëm”.

në përputhje të plotë me standardet e jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian. Në këtë kuadër u konsiderua i nevojshëm edhe ndryshimi i nenit 34/a të Kodit të Procedurës Penale me ndërhyrjet *nëpërmjet ligjit nr. 35/2017, datë 30.03.2017* “Për Disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin 7905, Datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar.

Nëpërmjet parashikimit të Nenit 34/a të Kodit të Procedurës Penale, legjislatori ka synuar vendosjen qartë të standardeve ndërkombëtare të parashikuara nga direktivat e detyrueshme për Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian dhe vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut mbi të drejtat e të pandehurit dhe personit nën hetim në procesin penal si dhe garantimi i së drejtës së mbrojtjes së të pandehurit dhe personit nën hetim, të parashikuar në nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Neni 34/a i Kodit të Procedurës Penale, liston të drejtat e të pandehurit dhe personit nën hetim dhe përcakton mënyrën e njohjes së tij me të drejtat në proces.

2. Komente për çështje të ndryshme të dispozitës

E drejta e parë që i jepet personit nën hetim ose të pandehurit, e parashikuar në shkronjën “a” të paragrafit të parë të nenit 34/a, ka lidhje me të drejtën e tij për t’u njoftuar në një kohë sa më të shkurtër, në gjuhën që kupton, për veprën penale për të cilën hetohet, si edhe për shkaqet e akuzave. Të drejtat e garantuara nëpërmjet parashikimeve të germës “a” të paragrafit 1 të nenit 34/a janë në përputhje të plotë me të drejtat e garantuara nëpërmjet Direktivës 2012-13-BE mbi të drejtën e informimit në procedimin penal, me të drejtat e garantuara sipas Direktivës 2013-48BE mbi të drejtën e aksesit tek një avokat mbrojtës në procedimin penal dhe me të drejtat e garantuara sipas Direktivës 2010-64-BE mbi të drejtën e përkthimit në procedimin penal, si dhe të drejtat e parashikuara nga neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe vendimeve të GJEDNJ-së. Parashikimet e shkronjës “a” të paragrafit të parë të nenit 34/a janë në përputhje të plotë edhe me parashikimet e nenit 9 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe me parashikimet e nenit 31/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Kjo e drejtë është theksuar dhe trajtuar në një sërë vendimesh të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila thekson se dispozitat e paragrafit 3(a) të Nenit 6 të KEDNJ tregojnë nevojën për vëmendjen e veçantë që duhet t’i kushtohet njoftimit të ‘akuzës’ për të pandehurin. Detajet e veprës penale për të cilën i pandehuri hetohet luajnë një rol të veçantë në procesin penal dhe duhet të njoftohet për faktet dhe bazën ligjore që në momentin e parë që ai vihet në kontakt me autoritetet proceduese për këtë shkak. Gjithashtu, njoftimi duhet të bëhet në gjuhën që personi nën hetim kupton. Në këtë aspekt, nuk është e nevojshme që të përkthehen të gjithë dokumentet perkatës. Një përmbledhje e fakteve dhe detajeve të veprës penale si dhe kualifikimi ligjor i tyre në gjuhën që i hetuari kupton është i

mjaftueshem (*Kamasinski*).⁴ Në çështjet penale, dhënia e informacionit të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me akuzat e ngritura ndaj një të pandehuri duhet të bëhet edhe gjatë fazës së gjykimit, sidomos në rastet e ndryshimit të cilësimit ligjor të veprës nga gjykata (*Abramyan*).⁵

Ky parashikim vjen në zbatim të drejtpërdrejtë të Direktivës 2012/13/Bashkimit Evropian, e cila parashikon, në nenin 6 të saj “*njohjen e personit nën hetim dhe të pandehurit në lidhje me veprën penale për kryerjen e së cilës dyshohen ose akuzohen. Këto të dhëna duhet të njoftohen menjëherë dhe në mënyrë të detajuar, me qëllim garantimin e një procesi të drejtë dhe ushtrimin efektiv të të drejtës së mbrojtjes*”.

Gjithashtu, sipas Direktivës 2012/13/EU, përshkrimi i fakteve, duke përfshirë, nëse njihen, kohën dhe vendin e veprës penale që personat dyshohen apo akuzohen se kanë kryer si dhe cilësimin e mundshëm juridik të veprës së pretenduar, duhet të jepen me detaje të mjaftueshme. Natyrisht duhet marrë në konsideratë edhe faza e procedimit penal gjatë të cilit jepet ky përshkrim, për të garantuar një procedim të drejtë dhe për të bërë të mundur ushtrimin efektiv të të drejtës së mbrojtjes (paragrafi 28 i preambulës). Direktiva parashikon që detyrimi i njoftimit të akuzës përfshin edhe detyrimin e njoftimit të ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale gjatë procedimit penal, në rast se ky ndryshim mund të ndikojë në mënyrë thelbësore në pozicionin e të pandehurit (paragrafi 29 i preambulës).

Parashikimi i germës “a” të paragrafit të parë të nenit 34/a ka marrë vëmendjen edhe të Gjykatës Kushtetuese e cila ndër të tjera, thekson se drejta e individit për t’u vënë në dijeni menjëherë dhe në mënyrë të hollësishme mbi natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij, është sanksionuar gjithashtu nga neni 31/a i Kushtetutës dhe nga neni 6/3/a i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Sipas Gjykatës Kushtetuese, qëllimi i këtyre dispozitave është të krijojnë mundësinë për të akuzuarin të njihet paraprakisht me materialet, provat dhe rezultatet e hetimit, në mënyrë që të ushtrojë të drejtën e tij për të përgatitur një mbrojtje efektive, pra për të paraqitur argumentet në favor të tij dhe për të kundërshtuar akuzën e ngritur.⁶

Në shkronjën “b” të paragrafit të parë të nenit 34/a parashikohet e drejta e të pandehurit dhe e personit në hetim të përdorë gjuhën që flet ose kupton ose të përdorë gjuhën e shenjave, si dhe të ndihmohet nga një përkthyes dhe interpretues nëse ka paafësi të kufizuar në të folur dhe në të dëgjuar. Nëpërmjet këtij parashikimi garantohet asistenca e duhur për personat me vështirësi në të folur ose të dëgjuar si

⁴ Kamasinski k. Austrisë, 19.12.1989, Nr. aplikimit 9783/82, para 72-86.

⁵ Abramyan k. Ruisë, 09.01.2009 aplikimi nr. 10709/02, para. 34.

⁶ *Shih vendimin nr.4, datë 10.02.2012* Shfuqizimi, si i papajtuësëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit nr.72, datë 04.12.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; vendimit nr.14, datë 15.02.2010 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda; vendimit nr.00-2010- 1356 (971), datë 08.11.2010, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi), para. 12.

dhe (i përsëritur nga dispozita e përgjithshme) e drejta e të pandehurit për të patur një përkthyes nëse ai nuk flet gjuhën shqipe. Kjo e drejtë themelore e të pandehurit parashikohet gjithashtu në përputhje me nenin 6(3)/e të KEDNJ-së. Sipas GJEDNJ-së e drejta e garantuar nga neni 6 § 3 (e) përfshin, për të gjithë ata që nuk mund të flasin ose të kuptojnë gjuhën e përdorur në gjykatë ose gjatë hetimeve, të drejtën për të marrë ndihmën e një përkthyesi pa pagesë (Öztürk), (*Luedicke, Belkacem and Koç*)⁷.

Parashikimet e shkronjës “b” të paragrafit të parë të nenit 34/a janë në përputhje të plotë edhe me parashikimet e nenit 2 të Direktivës 2010-64-BE ku parashikohet detyrimi i shteteve anëtare që të sigurojnë për personat e dyshuar ose të akuzuar që nuk flasin apo kuptojnë gjuhën, t’i ofrohet pa vonesë, interpretim gjatë procedurës penale, duke filluar që në momentin e marrjes në pyetje nga ana e policisë. Gjithashtu, parashikimet e shkronjës b), të paragrafit të parë të nenit 34/a janë në përputhje të plotë edhe me parashikimet e nenit 3 të Direktivës 2010-64-BE. Ky nen parashikon detyrimin e shteteve anëtare që të sigurojnë që personat e dyshuar ose të akuzuar që nuk e kuptojnë gjuhën e procedimit penal, brenda një kohe të arsyeshme duhet të pajisen me një përkthim me shkrim të të gjitha dokumenteve që janë thelbësore, me qëllim që të sigurojnë e të drejtës së mbrojtjes.

Parashikimet e germës “c” të paragrafit 1 të nenit 34/a të Kodit të Procedurës Penale i garantojnë të pandehurit dhe personit nën hetim të heshtë, të paraqesë lirisht mbrojtjen e tij, si dhe të mos u përgjigjet pyetjeve të caktuara. Këto parashikime janë në përputhje me parashikimet e Direktivës 2012/13 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe konkretisht me nenin 3 paragrafi 1(e). Sipas GJEDNJ-së, megjithëse nuk përmendet në mënyrë specifike në nenin 6 të Konventës, e drejta për heshtje dhe e drejta për të mos akuzuar veten, janë të njohura nga standardet ndërkombëtare të cilat janë në qendër të nocionit të një procesi të rregullt sipas nenit 6 të KEDNJ-së. E drejta për të mos akuzuar veten, në veçanti, supozon që prokuroria në një çështje penale të kërkojë të provojë çështjen kundër të akuzuarit pa përdorur dëshmi të fituara nëpërmjet metodave të shtrëngimit në kundërshtim me vullnetin e të akuzuarit. Në këtë kuptim, e drejta është e lidhur ngushtësisht me prezumimin e pafajësisë që parashikohet në nenin 6, paragrafi 2 të KEDNJ (*Saunders*)⁸, (*Funke*)⁹, (*JB*)¹⁰, (*Serves*)¹¹.

Në shkronjën ç) të paragrafit 1 të nenit 34/a parashikohet e drejta e të pandehurit dhe personit nën hetim të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi

⁷ Öztürk k. Republikës Federale të Gjermanisë, 21.02.1984, Nr. i aplikimit 8544/79; *Luedicke, Belkacem and Koç k. Republikës Federale të Gjermanisë*, 28.11.1978, Nr. i aplikimit 6210/73; 6877/75; 7132/75, para. 40 dhe 48.

⁸ *Saunders k. Mbretërisë së Bashkuar*, 17.12.1996, Nr aplikimit 19187/91, para 68.

⁹ *Funke k. Francës*, 25.02.1993, Nr. i aplikimit 10828/84, para. 44.

¹⁰ *JB k. Zvicrës*, 03.08.2001, Nr. i aplikimit 31827/96, para. 64.

¹¹ *Serves k. Francës*, 20.10.1997, Nr. i aplikimit (82/1996/671/893), para. 46.

të zgjedhur prej tij. Një parashikim i tillë është në përputhje me parashikimet e nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe me parashikimet e nenit 6(3) c të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Parashikimi i shkronjës ç) të paragrafit 1 të nenit 34/a përfshin aspekte të veçanta të së drejtës për një gjykim të drejtë brenda kuptimit të nenit 6 § 1 të KEDNJ si për barazia e armëve. Ky nënparagraf garanton që procedurat kundër një personi të akuzuar nuk do të mund të zhvillohen pa një përfaqësim adekuat të çështjes për mbrojtje (*Pakelli*)¹². E drejta e parashikuar në shkronjën ç) të paragrafit 1 të nenit 34/a, përfshin dy të drejta të ndara: e drejta për t'u mbrojtur personalisht dhe e drejta të mbrohet me ndihmën juridike të një mbrojtësi të zgjedhur vet.

Çdo person i cili është subjekt i një akuze penale duhet t'i garantohet e drejta për t'u mbrojtur nga një mbrojtës në çdo fazë të procedurës (*Imbrioscia v. Sëitserland*)¹³. Kjo mbrojtje është e rëndësishme të bëhet edhe para se një çështje të dërgohet për gjykim, në të kundërt ka gjasa të paragjykohet seriozisht nga një dështim fillestar në përputhje me dispozitat e nenit 6 të KEDNJ (*Öcalan*)¹⁴, (*Imbrioscia*)¹⁵, (*Magee*)¹⁶. E drejta për sigurimin e aksesit të mbrojtjes duhet të garantohet që në momentin e marrjes në pyetje për herë të parë nga policia ose autoritetet e tjera proeduese (*Salduz*)¹⁷, (*Dayanan*)¹⁸, (*Šebalj*)¹⁹.

E drejta e parashikuar në nenin 34/a, paragrafi i parë, shkronja ç) i Kodit të Procedurës Penale, duhet të zbatohet që në fazën paragjyqësore, për shëmbull gjatë hetimeve paraprake. Neni i sipërcituar i ofron të akuzuarit mundësinë për të mbrojtur veten personalisht, prandaj, normalisht nuk është në kundërshtim me kërkesat e nenit 6 të KEDNJ-së nëse një i akuzuar është i vetëpërfaqësuar në përputhje me vullnetin e tij, përveç nëse interesat e drejtësisë kërkojnë ndryshe (*Galstyan*)²⁰. Megjithatë, e drejta për t'u mbrojtur vetë personalisht nuk është një e drejtë e pakufizuar. Kodi i Procedurës Penale parashikon në nenin 49 edhe institutin e mbrojtjes së detyrueshme.

Kur i akuzuari zgjedh për të mbrojtur veten, ai me dashje heq dorë nga e drejta e tij për t'u asistuar nga një avokat dhe konsiderohet se ka për detyrë për të treguar

¹² *Pakelli k. Gjermanisë*, 12.12.1981, Nr. i aplikimit 8398/78, para. 84

¹³ *Imbrioscia k. Zvicrës*, 24.11.1993, Nr. i aplikimit 13972/88, para. 36

¹⁴ *Öcalan k. Turqisë*, 12.05.2005, Nr. i aplikimit 46221/99, para. 131.

¹⁵ *Imbrioscia k. Zvicrës*, 24.12.1993, Nr. i aplikimit 13972/88, para. 36

¹⁶ *Magee k. Mbretërisë së Bashkuar*, 6.9.2000, Nr. i aplikimit 28135/95, para. 41

¹⁷ *Salduz k. Turqisë*, 27.11.2008, Nr. i aplikimit 36391/02, para. 50-62.

¹⁸ *Dayanan k. Turqisë*, 13.01.2010, Nr. i aplikimit 7377/03, para 24-43

¹⁹ *Šebalj k. Kroacisë*, 28.09.2011, Nr. i aplikimit 4429/09.

²⁰ *Galsyan k. Armenia*, 15.02.2008, Nr. i aplikimit 26986/03, para.91

zell në mënyrën në të cilën ai kryen mbrojtjen e tij (*Melin*)²¹. Heqja dorë nga një e drejtë e garantuar nga KEDNJ - në atë sa është e lejueshme - nuk duhet të bjerë në kundërshtim me ndonjë interes të rëndësishëm publik, duhet të përcaktohet në mënyrë të qartë dhe duhet të ndiqet nga masat mbrojtëse minimale të barabarta me rëndësinë e heqjes dorë. Heqja dorë nga ai ose në emër të të pandehurit (qoftë edhe i mitur), për një të drejtë të rëndësishme sipas nenit 6 të KEDNJ-së mund të pranohet vetëm kur ajo shprehet në një mënyrë të qartë pasi autoritetet kanë ndërmarrë të gjitha hapat e arsyeshëm për të siguruar që ai ose ajo është plotësisht në dijeni të drejtave të tij të mbrojtjes dhe mund të vlerësojë, për atë sa është e mundur, pasojat e sjelljes së tij (*Panovits*)²², (*Pishchalnikov*)²³.

Në lidhje me ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur prej tij theksojmë se është një e drejtë themelore e cdo personi kundër të cilit është ngritur një akuzë penale e parashikuar shprehimisht në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë e konkretisht në nenin 31 shkronja ç e saj dhe në Kodin e Procedurës Penale (neni 6 Sigurimi i Mbrojtjes), paragrafi i parë.

Në lidhje me të drejtën për ndihmë nga një mbrojtës i zgjedhur nga vetë i pandehuri, me qëllim që asistenca ligjore të jetë praktike dhe efektive, dhe jo thjesht teorike, theksohet se ushtrimi i saj nuk duhet të varet nga përmbushja e kushteve thjesht nga pikëpamja formaliste. Asnjëherë, thjesht emërimi i avokatit të ndihmës juridike nuk siguron ndihmë efektive pasi avokati i caktuar mund të vdesë, të sëmuret seriozisht, të pengohet për një periudhë kohe të caktuar nga veprimi ose drejtimi i detyrave të tij (*Artico*)²⁴. GjEDNJ ka thekuar megjithatë, se një Shtet Kontraktues nuk mund të jetë përgjegjës për çdo mangësi të një avokati të caktuar për qëllime të ndihmës juridike ose të zgjedhur nga i akuzuari (*Lagerblom*)²⁵, (*Kamasinski*)²⁶ (*Imbroscia*)²⁷, (*Daud*)²⁸. Detyrimi i Shtetit, është që, nëpërmjet gjykatës, në raste flagrante të një mbrojtjeje jo efektive të ndërhyjë. Përgjegjësia e shtetit mund të lindë kur një avokat thjesht nuk vepron për të akuzuarin (*Artico*)²⁹, ose kur ai nuk arrin të përmbushë një kërkesë thelbësore procedurale që nuk barazohet me një linjë

²¹ *Melin k. France*, 22.06.1993, Nr. i aplikimit 12914/87 para. 25

²² *Panovits k. Qipros*, 11.03.2009, Nr. i aplikimit 4268/04, para 68.

²³ *Pishchalnikov k. Rusisë*, 24.12.2009, Nr. i aplikimit 7025/04, para 76-80

²⁴ *Artico k. Italisë*, 13.05.1980, Nr. i aplikimit 6694/74, para. 30.

²⁵ *Lagerblom k. Suedisë*, 14.11.2003, final 14.04.2003, Nr. i aplikimit 26891/95, para. 56.

²⁶ *Kamasinski k. Austrisë*, 19.12.1989, Nr. i aplikimit. 9783/82, para 65.

²⁷ *Imbroscia k. Zvicrës*, 24.11.1993, Nr. i aplikimit 13972/88, para.41.

²⁸ *Daud k. Portugalisë*, 21.04.1998, Nr. i aplikimit 11/1997/795/997, para. 38.

²⁹ *Artico k. Italisë*, 13.05.1980, Nr. i aplikimit 6694/74, para. 33, 36.

mbrojtjeje të gabuar ose një defekt të thjeshtë të argumentimit (*Czekalla*)³⁰. Një qëndrim të tillë ka mbajur edhe gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë.^{31 32}

GjEDNJ ka theksuar se e drejta e të gjithë atyre që akuzohen për një vepër penale për t'u mbrojtur nga avokati i zgjedhur prej tij nuk është absolute (*Meftah & Others*),³³ (*Pakelli*)³⁴. Edhe pse, si rregull i përgjithshëm, zgjedhja e avokatit të akuzuarit duhet të respektohet (*Lagerblom*),³⁵ gjykatat kombëtare mund të anashkalojnë zgjedhjen e këtij personi kur ekzistojnë baza të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të vendosur që kjo është e nevojshme dhe në interes të drejtësisë (*Meftah & Others*)³⁶ (*Croissant*)³⁷. Për shembull, natyra e veçantë e procedurave, e konsideruar si një e tërë, mund të justifikojë avokatët e specializuar në fusha të caktuara të së drejtës ose duke konsideruar aftësisistë argumentuese apo oratorinë e avokatit mbrojtës (*Meftah & Others*)³⁸.

Sa është parashikuar në shkronjën ç, të paragrafit të parë të nenit 34/a të Kodit të Procedurës Penale është në përputhje të plotë edhe me parashikimet e nenit 3 të Direktivës 2013-48. Në paragrafin e parë të tij është parashikuar shprehimisht se Shtetet Anëtare sigurojnë që personat e dyshuar dhe të akuzuar kanë të drejtën e pasjes të një avokati në atë kohë dhe në atë mënyrë që të lejojë personat në fjalë të ushtrojnë praktikisht dhe në mënyrë efektive të drejtat e tyre të mbrojtjes.

Shkronja d) e paragrafit të parë të nenit 34/a të Kodit të Procedurës Penale parashikon të drejtën e të pandehurit të ketë një mbrojtës të siguruar nga shteti.. E drejta për një mbrojtës të siguruar nga shteti i nënshtrohet dy kushteve alternative, së pari, mbrojtja e subjektit të procedimit penal duhet të jetë e detyrueshme dhe së dyti, duhet që subjekti i procedimit penale të vërtetojë përpara organit procedues që nuk ka mundësi financiare për të pasur një mbrojtës.

E drejta e parashikuar sa më sipër është parashikuar në ligjin nr. 10 039,

³⁰ *Czekalla k. Portugalisë*, 10.01.2003, Nr. i aplikimit 38830/97, para. 65, 71.

³¹ Vendimi nr. 37, datë 24.12.2010, (v – 37/10), kërkues: Ilmir Hajdari, objekti: shfuqizimi si i papajtueshëm me kushtetutën i vendimit nr.279, datë 04.06.2008 të kolegjit penal të Gjykatës së Lartë

³² Vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.30, datë 26.11.2009; nr.33, datë 24.11.2003; nr.5, datë 17.02.2003).

³³ *Meftah & others v. France*, 26.07.2012, Nr. i aplikimit. [32911/96](#), [35237/97](#) dhe [34595/97](#), para. 45.

³⁴ *Pakelli k. Gjermanisë*, 12.12.1981, Nr. i aplikimit 8398/78, para. 31.

³⁵ *Lagerblom v. Sweden*, 14.11.2003, final 14/04/2003, Nr. i aplikimit [26891/95](#), para. 54.

³⁶ *Meftah & others v. France*, 26.07.2012, Nr. i aplikimit [32911/96](#), [35237/97](#) dhe [34595/97](#), para. 45.

³⁷ *Croissant v. Gjermanisë*, 25.09.1992, Nr. i aplikimit 13611/88, para 29.

³⁸ *Meftah & others v. France*, 26.07.2012, Nr. i aplikimit [32911/96](#), [35237/97](#) dhe [34595/97](#), para. 47.

datë 22.12.2008 “PËR NDIHMËN JURIDIKE”,³⁹ si dhe në nenin 6 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë. Neni 49/a i Kodit të Procedurës Penale parashikon se kur nuk janë rastet e mbrojtjes së detyrueshme⁴⁰ dhe i pandehuri që nuk ka mjete financiare të mjaftueshme kërkon mbrojtës, organi procedues cakton mbrojtësin nga lista e vënë në dispozicion nga institucionet e ndihmës juridike falas.

Në lidhje me kushtin se i akuzuari duhet të tregojë se nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar ndihmën juridike është shprehur edhe GJEDNJ në disa vendime të saj në kuadër të nenit 6 § 3 (c) KEDNJ. Gjykata thekson se ai nuk ka nevojë të provojë përtej çdo dyshimi që nuk ka mjete të mjaftueshme financiare. Për gjykatën mjafton që të ketë “disa indikacione” se i pandehuri nuk mund të financojë mbrojtjen e tij ose, me fjalë të tjera, se mund të krijohet një “mungesë e rreguesve të qartë për të kundërtën” (*Pakelli*)⁴¹.

Pavarësisht nga rëndësia e një marrëdhënieje të besimit midis avokatit dhe klientit, e drejta për t’u mbrojtur nga avokati “me zgjedhjen e vet” është domosdoshmërisht subjekt i kufizimeve të caktuara në lidhje me ndihmën juridike falas. Për shembull, kur caktohen avokatët mbrojtës, gjykatat duhet të kenë parasysh dëshirat e të akuzuarit, por ato mund të anashkalohen kur ekzistojnë baza të mjaftueshme për të vendosur që kjo është e nevojshme në interes të drejtësisë (*Croissant*),⁴² (*Lagerblom*)⁴³. Neni 6 § 3 (c) KEDNJ nuk mund të interpretohet se siguron të drejtën e zëvendësimit automatik të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht (*Lagerblom*)⁴⁴. Prandaj, kur mbrojtja e avokatit të caktuar kryesisht ka rezultuar efektive dhe ka garantuar një proces të drejtë dhe të rregullt, interesi i drejtësisë nuk duhet kuptuar si detyrim për zëvendësim të avokatit të caktuar kryesisht sa herë që i pandehuri e kërkon (*Monell & Morris*)⁴⁵.

Në shkronjën dh) të paragrafit të parë të nenit 34/a parashikohet e drejta e personit të akuzuar apo nën hetim që të takohet privatisht dhe të komunikojë me mbrojtësin që e përfaqëson. Në thelb, kjo e drejtë ka të bëjë me atë që konsiderohet ndihmë juridike praktike dhe efektive. E drejta për ndihmë juridike efektive përfshin, *inter alia*, të drejtën e të akuzuarit për të komunikuar me avokatin e tij privatisht. Vetëm në rrethana të jashtëzakonshme (i pandehuri apo personi nën hetim dyshohet

³⁹ (Ndryshuar me Ligj, Nr.143/2013, datë 02.05.2013, botuar në FZ nr.83) (Ndryshuar me Ligj, Nr.77/2014, datë 10.07.2014, botuar në FZ nr.124)

⁴⁰ Neni 49 Kodi i Procedures Penale

⁴¹ *Pakelli k. Gjermanisë*, 12.12.1981, Nr. i aplikimit 8398/78, para. 34

⁴² *Croissant k. Gjermanisë*, 25.09.1992, Nr. i aplikimit 13611/88, para. 29.

⁴³ *Lagerblom k. Suedisë*, 14.01.2003, final 14.04.2003, Nr. i aplikimit 26891/95, para. 54.

⁴⁴ *Lagerblom k. Suedisë*, 14.01.2003, final 14.04.2003, Nr. i aplikimit 26891/95, para. 55, 59.

⁴⁵ *Monell & Morris k. Mbretërisë së Bashkuar*, 2.03.1987, Nr. i aplikimit 9562/81; 9818/82, para. 67.

se është anëtar i një bande dhe ishte e domosdoshme kufizimi për të kapur anëtarët e tjerë) shteti mund të kufizojë kontaktin konfidencial ndërmjet një personi që i është hequr liria dhe mbrojtësit të tij (*Sakhnovskiy*)⁴⁶. Nëse një avokat nuk është në gjendje të kontaktojë me klientin e tij dhe të marrë udhëzime konfidenciale prej tij pa mbikëqyrje, asistenca e tij humbet shumë nga të qëniet e dobishme (*S. v. Sëizerland*)⁴⁷ dhe (*Brennan*)⁴⁸. Çdo kufizim në marrëdhëniet midis klientëve dhe avokatëve, qofshin ato të natyrshme (të qenësishme) apo të shprehura, nuk duhet të pengojnë ndihmën juridike efektive ndaj të cilës i pandehuri ka të drejtë (*Sakhnovskiy*)⁴⁹. Prekja e bisedave telefonike midis një të akuzuari dhe avokatit të tij (*Zagaria*)⁵⁰, kufizimi i numrit dhe gjatësisë së vizitave të avokatëve ndaj të akuzuarit si dhe prania e detyrueshme e autoriteteve shtetërore gjatë takimeve me avokatin (*Öcalan*)⁵¹ paraqesin shkelje të mëtejshme të mundshme të kërkesës për të siguruar ndihmë efektive.

Në shkronjën e), të paragrafit të parë të nenit 34/a të Kodit të Procedurës Penale parashikohet e drejta e të pandehurit dhe e personit nën hetim të këtë kohë të mjaftueshme dhe lehtësi për të përgatitur mbrojtjen. E drejta e parashikuar në këtë nënparagraf është në përputhje të plotë me parashikimet e nenit 6(3)/b të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Neni 34/a, paragrafi i parë, shkronja e), ka të bëjë me dy elemente të mbrojtjes së duhur, përkatësisht çështjes së lehtësive dhe asaj të kohës. Kjo dispozitë nënkupton që aktiviteti i mbrojtjes substanciale në emër të të akuzuarit mund të përfshijë gjithçka që është “e nevojshme” për përgatitjen e gjykimit. I akuzuari duhet të ketë mundësinë për të organizuar mbrojtjen e tij në mënyrë të përshtatshme dhe pa kufizime për të paraqitur të gjitha argumentet përkatëse të mbrojtjes në gjykatë dhe për rrjedhojë të ndikojë në rezultatin e procedimit (*Can*)⁵² dhe (*Gregaçević*)⁵³. Çështja e kohës së mjaftueshme dhe lehtësive që i ofrohen një të akuzuari duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të secilit rast të veçantë (*Iglin*)⁵⁴ dhe (*Galstyan*)⁵⁵.

Në lidhje me elementin kohë e mjaftueshme. Neni 34/a, paragrafi i parë,

⁴⁶ *Sakhnovskiy k. Rusisë*, 2.11.2010, Nr. i aplikimit [21272/03](#), para. 102.

⁴⁷ *S k. Zvicrës*, 28.11.1991, Nr. i aplikimit [12629/87](#); [13965/88](#), para 48.

⁴⁸ *Brennan k. Mbretërisë së Bashkuar*, 16.10.2001, Nr. i aplikimit [39846/98](#), para. 58.

⁴⁹ *Sakhnovskiy k. Rusisë*, 2.11.2010, Nr. i aplikimit [21272/03](#), para. 102.

⁵⁰ *Zagaria k. Italisë*, 27.11.2007, Nr. i aplikimit [58295/00](#), para. 36.

⁵¹ *Öcalan k. Turqisë*, 12.05.2005, Nr. i aplikimit [46221/99](#), para. 135.

⁵² *Can k. Austrisë*, 12.07.1984, Nr. i aplikimit [.9300/81](#), para 53.

⁵³ *Gregaçević k. Kroacisë*, 10.07.2012, final 10.10.2012, Nr. i aplikimit [58331/09](#), para 51.

⁵⁴ *Iglin k. Ukrainës*, 12.01.2012, final 12.04.2012, Nr. i aplikimit [39908/05](#), para 65.

⁵⁵ *Galstyan k. Armenisë*, 15.11.2007, final 15.02.2008, Nr. i aplikimit [26986/03](#), para. 84.

shkronja e) mbron të akuzuarin ndaj një procesi të nxituar (Kröcher & Möller),⁵⁶ (Bonzi)⁵⁷. Megjithëse është e rëndësishme që procedurat të zhvillohen pa humbur kohë, kjo nuk duhet të bëhet në kurriz të të drejtave procedurale të njëres nga palët (OAO Neftyanaya Kompaniya Yukos)⁵⁸. Gjatë vlerësimit nëse i akuzuari kishte kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së tij, duhet pasur parasysh natyra e procedurës, si dhe kompleksiteti i çështjes dhe faza e procedimit (Gregaçević)⁵⁹.

Duhet të merret parasysh edhe ngarkesa e zakonshme e punës së avokatit dhe nuk mund të pretendohet që avokati mbrojtës të ndryshojë të gjithë programin e tij për t'i kushtuar kohë dhe vëmendje vetëm një çështjeje. Megjithatë, nuk është e paarsyeshme që një avokat mbrojtës të bëjë të paktën disa zhvendosje në punën e tij nëse kjo është e nevojshme për shkak të urgjencës së veçantë të një rasti të veçantë (Mattick)⁶⁰.

Mbrojtjes duhet t'i jepet kohë shtesë pas ngjarjeve të caktuara gjatë procedurës për të rregulluar pozicionin e saj, për të përgatitur një kërkesë, për të parashtruar ankesë, etj. (Miminoshvili)⁶¹. Këto “ndodhi” mund të përfshijnë ndryshime në aktakuzë (Pélissier dhe Sassi)⁶², paraqitjen e provave të reja nga prokuroria, ose një ndryshim të papritur dhe drastik të opinionit të një eksperti gjatë gjykimit (GB k. Francës)⁶³.

Me elementin lehtësi të parashikuar në nenin 34/a, paragrafi i parë, shkronja e) duhet kuptuar aksesin në prova dhe konsultimi me avokatin. Në lidhje me aksesin në prova GJEDNJ ka theksuar se “lehtësitë” që të gjithë personat e akuzuar për një vepër penale duhet të gëzojnë përfshijnë mundësinë për t'u familjarizuar me rezultatet e hetimeve të kryera gjatë gjithë procedurës për qëllimet e përgatitjes së mbrojtjes së tij, (Huseyn and Others)⁶⁴, (OAO Neftyanaya Kompaniya Yukos).⁶⁵

Një i akuzuar nuk është e nevojshme të ketë akses të drejtpërdrejtë në dosjen e çështjes (case file). Është e mjaftueshme që ai të informohet për materialin në dosje

⁵⁶ *Kröcher & Möller k Zvicrës* (dec), 9.07.1981, Nr. i aplikimit 8463/7 8.

⁵⁷ *Bonzi k. Zvicrës*, 12.07.1978, Nr. i aplikimit 7854/77.

⁵⁸ *OAO Neftyanaya Kompaniya Yukos k. Rusisë*, 20.09.2011, final 08.03.2013, Nr. i aplikimit 14902/04, para. 540.

⁵⁹ *Gregaçević k. Croacisë*, 10.11.2012, Nr. i aplikimit 58331/09, para. 51

⁶⁰ *Mattick k. Gjermanisë*, 31.03.2005, Nr. i aplikimit 62116/00.

⁶¹ *Miminoshvili k. Rusisë*, 28.06.2011, final 28.09.2011, Nr. i aplikimit 20197/03, para. 141.

⁶² *Pélissier & Sassi k. Francës*, 25.03.1999, Nr. i aplikimit 25444/94) para 62.

⁶³ *GB k. Francës*, 2.10.2001, final 02.01.2002, Nr. i aplikimit 44069/98, para 69-70.

⁶⁴ *Huseyn dhe të tjerë k. Azerbaixhan*, 26.07.2011, final 26.10.2011, Nr. i aplikimit 35485/05, 45553/05, 35680/05 and 36085/05, para. 175.

⁶⁵ *OAO Neftyanaya Kompaniya Yukos k. Rusisë*, 20.09.2011, final 08.03.2013, Nr. i aplikimit 14902/04, para. 538.

nga përfaqësuesit e tij (Kremzoë)⁶⁶. Megjithatë, qasja e kufizuar e një të akuzuari në dosjen e gjykatës nuk duhet të pengojë që provat të vihen në dispozicion të të akuzuarit para gjykimit dhe të ketë mundësinë për të komentuar mbi to nëpërmjet avokatit të tij në parashtrimet verbale (Öcalan)⁶⁷. Kur një i akuzuar është caktuar për të kryer vetë mbrojtjen e tij, mosdhënia e aksesit në dosjen në ngarkim të tij, përbën një shkelje të të drejtave të mbrojtjes (Foucher)⁶⁸. Me qëllim të lehtësimit të sjelljes së mbrojtjes, i akuzuari nuk duhet të pengohet në marrjen e kopjeve të dokumenteve përkatëse nga dosja dhe përpilimi dhe përdorimi i shënimeve të marra (Rasmussen)⁶⁹, (Moiseyev)⁷⁰, (Matyjek)⁷¹, (Seleznev)⁷²

E drejta e aksesit në dosje nuk është absolute. Në disa raste mund të jetë e nevojshme që të mbahen prova të caktuara nga mbrojtja në mënyrë që të ruhen të drejtat themelore të një individi tjetër ose të mbrohet një interes i rëndësishëm publik, siç janë siguria kombëtare ose nevoja për të mbrojtur dëshmitarët ose për të mbrojtur metodat e policisë për hetimin e krimit. Megjithatë, vetëm masat e tilla që kufizojnë të drejtat e mbrojtjes, të cilat janë rreptësisht të nevojshme janë të lejuara sipas nenit 6 paragrafi i parë i KEDNJ. Gjykata do të shqyrtojë procedurën e vendimmarrjes për të siguruar që ajo është në pajtim me parimin e barazisë së armëve dhe që garanton mbrojtjen e interesave të të akuzuarit (Natunen)⁷³, (Doësett)⁷⁴, (Mirilashvili)⁷⁵.

Dështimi për t'i bërë të njohur mbrojtjes provat të cilat përmbajnë të dhëna që mund të shfajësojë veten ose të ulë dënimin e tij, mund të përbëjë një refuzim të lehtësive të nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes, gjë e cila do të thotë një shkelje të së drejtës së garantuar nga neni 6, paragrafi 3, (b) e KEDNJ. I akuzuari ose personi nën hetim megjithatë mund të japë arsyet përkatëse për kërkesën e tij në lidhje me provat më cilat do të njihet dhe autoriteti procedues duhet të shqyrtojë vlefshmërinë e këtyre arsyeve (Natunen).⁷⁶

⁶⁶ *Kremzoë k. Austrisë*, 21.11.1993, Nr. i aplikimit 12350/86, para. 52.

⁶⁷ *Öcalan k. Turqisë*, 12.05.2005, Nr. i aplikimit 46221/99, para. 140.

⁶⁸ *Foucher k. Francës*, 18.03.1997, Nr. i aplikimit 22209/93, para. 33-36.

⁶⁹ *Rasmussen k. Polonisë*, 28.04.2009, final 28.07.2009, Nr. i aplikimit 38886/05, para. 48-49.

⁷⁰ *Moiseyev k. Rusisë*, 9.11.2008, final 06.04.2009, Nr. i aplikimit 62936/00, para. 213-218.

⁷¹ *Matyjek k. Polonisë*, 24.04.2007, final 24.09.2007, Nr. i aplikimit 38184/03, para. 59.

⁷² *Seleznev k. Rusisë*, 26.06.2008, final 01.12.2008, Nr. i aplikimit 15591/03, para. 64-69.

⁷³ *Natunen k. Finlandës*, 31.03.2009, final 30.06.2009, Nr. i aplikimit 21022/04, para. 40-41.

⁷⁴ *Doësett k. Mbretërisë së Bashkuar*, 24.09.2003, Nr. i aplikimit 39482/98, para. 42-43

⁷⁵ *Mirilashvili k. Rusisë*, 1.11.2008, final 05.06.2009, Nr. i aplikimit 6293/04, para. 203-209

⁷⁶ *Natunen k. Finlandës*, 31.03.2009, final 30.06.2009, Nr. i aplikimit 21022/04, para.43.

Elementi lehtësi përfshin edhe komunikimin e lirshëm dhe pa pengesa të të pandehurit ose personit nën hetim me avokatin e tij me qëllim përgatitjen e mbrojtjes (*Campbell and Fell*)⁷⁷, (*Goddi*), (*Bonzi*)⁷⁸, (*Can*)⁷⁹.

Neni 34/a, paragrafi i parë, shkronja g) i Kodit të Procedurës Penale parashikon të drejtën e të pandehurit apo personit nën hetim t'u bëjë pyetje dëshmitarëve, ekspertëve dhe të pandehurve të tjerë gjatë gjykimit. Një parashikim i tillë është në linjë me parashikimet e nenit 6, paragrafi 3, shkronja d) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Nuk është e mjaftueshme që një i pandehur të ankohet se nuk i është lejuar të pyesë dëshmitarë të caktuar. Ai duhet gjithashtu të mbështesë kërkesën e tij duke shpjeguar se pse është e rëndësishme për të dëgjuar dëshmitarët në fjalë dhe dëshmitë e tyre duhet të jenë të nevojshme për vendosjen e së vërtetës dhe të drejtave të mbrojtjes (*Perna*)⁸⁰, (*Bacanu et SC R.S.A.*),⁸¹

Paragrafi 2 i Neni 34/a të Kodit të Procedurës Penale parashikon të drejtën e të pandehurit për të marrë një letër me shkrim mbi të drejtat. Letra e të Drejtave me shkrim si dhe përmbajtja e saj parashikohet në Direktivën 2012/13 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 22 Majit 2012 “Mbi të drejtën e informimit në procedimin penal”. Kjo Direktivë përmban modelin për letrën e të drejtave me shkrim. Është tepër e rëndësishme që i pandehuri para marrjes së tij të parë në pyetje të jetë në dijeni të të drejtave që ai ka.

Përmbajtja e letrës së të drejtave është parashikuar në paragrafin 2 të neni 34/a. Nga leximi i përbashkët i paragrafëve 1 dhe 2, të nenit 34/a, rezulton se letra e të drejtave do të përmbajë informacion vetëm mbi një pjesë të të drejtave të pandehurit, sikurse përcaktuar në paragrafin 1. Megjithatë, në praktikë kjo dispozite duhet të interpretohet në mënyrë të zgjeruar për të bërë të mundur përfshirjen e të gjithë garancive në mënyrë që të përmbushet plotësisht qëllimi i dispozitës të nenit 34/a. Ndonëse nuk ekziston ende një formular i miratuar për përmbajtjen e letrës së të drejtave, Direktiva 2012/13/BE, për qëllim standardizimi të të drejtave minimale të garantuara në të, përmban një model të letrës së të drejtave si vijon, të cilës mund t'i bëhet referim gjatë zbatimit të nenit 34/a.

Mënyra e njoftimit të letrës së të drejtave: nga leximi i përbashkët i nenit 34/a dhe neneve 304, 307 dhe 308 të Kodit të Procedurës Penale, konkludohet se:

- letra e të drejtave duhet t'i njoftohet, kundrejt nënshkrimit, të pandehurit ose personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, së bashku me ftesën për paraqitje që i

⁷⁷ *Campbell and Fell k. Mbretërisë së Bashkuar*, 28.06.1984, Nr. i aplikimit 7819/77; 7878/77, para. 99.

⁷⁸ *Bonzi k. Zvicrës*. Nr. i aplikimit 7854/77.

⁷⁹ *Can k. Austrisë*, 12.07.1984, Nr. i aplikimit 9300/81, para 275.

⁸⁰ *Perna k. Italisë*, 6.05.2003, Nr. i aplikimit 48898/99, para. 29.

⁸¹ *BĂCANU ET SC « R » SA k. Rumanisë*, Nr. i aplikimit 4411/04, para.75

dërgohet atij nga prokurori ose policia gjyqësore kur do ta marrë në pyetje ose kur duhet të kryejë veprime që kërkojnë praninë e tij.

- në rast se personi ndaj të cilit zhvillohen hetime paraqitet vullnetarisht te prokurori për të bërë deklarime, letra e të drejtave i dorëzohet në formë të shkruar këtij të fundit – kundrejt nënshkrimit - nga organi procedues, përpara fillimit të deklarimeve.

Neni 34/a, paragrafi i 2, i referohet “organit procedues” si autoriteti përgjegjës për njoftimin e letrës së të drejtave të pandehurit, çka do të thotë që krahas prokurorit, veprimet e parashikuara në nenin 34/a kryhen, sipas rastit, edhe nga oficerët e policisë gjyqësore, kur kjo është urdhëruar apo deleguar nga prokurori (nenet 30 dhe 304/2 të Kodit të Procedurës Penale.

Mosrespektimi nga organi procedues i detyrimit të njohjes paraprakisht të të pandehurit me të drejtat e tij, sipas nenit 34/a, përpara marrjes në pyetje sjell si pasojë papërdorshmërinë e akteve të kryera. Kjo parashikohet shprehimisht në nenin 38, paragrafi 3, dhe nenin 296 të Kodit të Procedurës Penale.

Model tregues i Letrës së të Drejtave të marra nga Direktiva 2012/13/EU e datës 24 maj 2012 “Mbi të drejtën e informacionit në procedimin penal”

Qëllimi i vetëm i këtij modeli është të ndihmohen autoritetet e brendshme në përpilimin e Letrës së të Drejtave në nivel kombëtar. Shtetet Anëtare nuk janë të detyruara të përdorin këtë model. Gjatë përgatitjes së Letrës së të Drejtave, Shtetet Anëtare mund të ndryshojnë këtë model me qëllim që ta përshtatin atë me rregullat e brendshme dhe për të shtuar informacion tjetër të dobishëm. Letra e të Drejtave e Shteteve Anëtare duhet të jepet në momentin e arrestimit ose ndalimit. Megjithatë, kjo nuk i pengon shtetet Anëtare t’u japin personave të dyshuar ose të akuzuar informacione me shkrim në situata të tjera gjatë procedimit penal.

Ju keni të drejtat e mëposhtme nëse arrestoheni ose ndaloheni:

A. ASISTENCËN E NJË AVOKATI/TË DREJTËN PËR NDIHMË JURIDIKE

Ju keni të drejtën të flisni konfidencialisht me një avokat. Një avokat është i pavarur nga policia. Kërkojini policisë nëse juve u duhet ndihmë për të kontaktuar me një avokat, policia duhet t’ju ndihmojë juve. Në raste të caktuara, asistenca mund të jetë falas. Kërkojini policisë informacione të mëtejshme.

B. INFORMACION NË LIDHJE ME AKUZËN

Ju keni të drejtën të dini se pse jeni arrestuar ose ndaluar dhe për çfarë dyshoheni ose akuzoheni se keni bërë?

C. INTERPRETIM DHE PËRKTHIM

Nëse ju nuk e flisni apo kuptoni gjuhën e folur nga policia ose autoritetet e tjera kompetente, ju keni të drejtën për t’u asistuar nganjë interpret, falas. Interpreti mund t’ju ndihmojë juve të flisni me avokatin dhe duhet të ruajë konfidencialitetin e këtij komunikimi. Ju keni të drejtën e përkthimit ose të paktën të pasazheve përkatës të dokumenteve thelbësore, duke përfshirë një urdhër nga një gjyqtar që lejon arrestin tuaj ose mbajtjen tuaj të ndaluar, çdo akuzë apo akt-akuzë dhe çdo vendim.

Në rrethana të caktuara juve mund t'ju bëhet një përkthim gojor ose një përmbledhje.

D. E DREJTA PËR TË MOS FOLUR

Ndërsa merreni në pyetje nga policia ose autoritetet e tjera kompetente, ju nuk jeni të detyruar t'ju përgjigjeni pyetjeve në lidhje me veprat penale që akuzoheni. Avokati mund t'ju ndihmojë për të vendosur për këtë.

E. AKSESI NË DOKUMENTE

Nëse arrestoheni ose ndaloheni, ju (ose avokati juaj) keni të drejtën e aksesit në dokumentet thelbësore që u duhen për të kundërshtuar arrestin ose ndalimin tuaj. Nëse çështja juaj shkon në gjykatë, ju (ose avokati juaj) keni të drejtën e aksesit në provat materiale na favor ose na dëm tuaj.

F. INFORMIMI I DIKUJT TJETËR NË LIDHJE ME ARRESTIMIN OSE NDALIMIN TUAJ/INFORMIMI I KONSULLATËS OSE AMBASADËS SUAJ

Nëse ju arrestoheni ose ndaloheni, ju duhet t'ju thoni policisë nëse ju doni që dikush të njoftohet në lidhje me ndalimin tuaj, për shembull, një anëtar familjeje ose punëdhënësin tuaj. Në raste të caktuara e drejta për të informuar një person tjetër për ndalimin tuaj mund të kufizohet përkohësisht. Në këto raste, policia do t'ju njoftojë në lidhje me këtë.

Nëse ju jeni i huaj, kërkojini policisë nëse doni që të njoftohet për ndalimin tuaj konsullata apo ambasada juaj. Jeni të lutur t'ju thoni policisë nëse ju doni të kontaktoni një punonjës të konsullatës ose ambasadës suaj.

G. NDIHMË MJEKËSORE EMERGJENTE

Nëse ju arrestoheni ose ndaloheni, ju keni të drejtën e ndihmës mjekësore emergjente.

Jeni të lutur t'ju thoni policisë nëse juve u nevojitet një ndihmë e tillë.

H. PERIUDHA E HEQJES SË LIRISË

Pas arrestit tuaj, juve mund t'ju hiqet liria ose të ndaloheni për një periudhë maksimale prej (vendosni numrin përkatës të orëve/ditëve). Në përfundim të asaj periudhe ju duhet të liroheni ose të dëgjoheni nga një gjyqtar i cili do të vendosë për ndalimin tuaj të mëtejshëm. Kërkojini avokatit tuaj ose gjyqtarit informacion në lidhje me mundësinë e kundërshtimit të arrestit, rishikimit të ndalimit ose kërkojini lirim të përkohshëm.

4. KONKLUZIONE

- Ndërhyrjet në Kodin e Procedurës Penale në ligjin 35/2017, me anë të parashikimeve të nenin 34/a të tij padyshim janë risi në legjislacionin procedural penal. Sfidë e organeve ligjzbatuese mbetet aplikimi në praktikë i kësaj dispozite duke patur në konsideratë ngarkesën e saj.

- Gjithashtu, në një shqyrtim të detajuar të modelit tregues të letrës së të drejtave të rekomanduara nga Direktiva 2012/13/EU e datës 24 maj 2012 “Mbi të drejtën e informacionit në procedimin penal, lehtësisht vihet re se ekzistojnë disa

te drejta të parashikuara në të, që në variantin e miratuar nga ligjvënësi shqiptar si përmbajtje e letrës së të drejtave e parashikuar në paragrafin e dytë të nenit 34/a të Kodit të Procedurës Penale, nuk janë të parashikuara.

- Nga leximi i përbashkët i paragrafëve 1 dhe 2, të nenit 34/a, rezulton se letra e të drejtave do të përmbajë informacion vetëm mbi një pjesë të të drejtave të pandehurit, sikurse përcaktuar në paragrafin 1. Megjithatë, në praktikë kjo dispozite duhet të interpretohet në mënyrë të zgjeruar për të bërë të mundur përfshirjen e të gjithë garancive në mënyrë që të përmbushet plotësisht qëllimi i dispozitës të nenit 34/a.

- Jemi të mendimit se ligjvënësi do të duhej të ndërhynte në kohën e miratimit të kësaj dispozite edhe me një model rekomandues të letrës së të drejtave të pandehurit apo të personit nën hetim dhe kjo me qëllim unifikimin e praktikave zbatuese të kësaj dispozite.

5. Legjislacioni, standarde ndërkombëtare, vendime të GJEDNJ, vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

- Direktiva 2012-13-BE mbi të drejtën e informimit në procedimin penal
- Direktiva 2013-48BE mbi të drejtën e aksesit tek një avokat mbrojtës në procedimin
- Direktiva 2010-64-BE mbi të drejtën e përkthimit në procedimin penal,

Në vitin 2009, Këshilli i Bashkimit Europian miratoi më 30 nëntor 2009 një *Roadmap*⁸² për fuqizimin e të drejtave procedurale të personave të dyshuar ose të akuzuar në procedimin penal me qëllim realizimin e një bashkëpunimi më të fortë mes Shteteve anëtare në sektorin e drejtësisë penale, në mënyrë specifike përmes formulimit dhe miratimit të pesë masave legjislative: Masa A: e drejta për interpretim dhe përkthim; Masa B: e drejta për informacion lidhur me të drejtat dhe akuzën (*Letter of Rights*); Masa C: këshillimi ligjor dhe ndihma ligjore falas (përpara dhe gjatë procesit); Masa D: e drejta e të dënuarve për komunikim me familjarët, punëdhënësit dhe autoritetet konsullore; Masa E: garanci të posaçme për të hetuarit ose të pandehurit vulnerabël.

Vendime të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Colozza k. Italisë, 12.02.1985, Nr. i aplikimit 9024/80;

Abramajn k. Ruisë, 09/01/2009 aplikimi nr. 10709/02

Öztürk k. Republikës Federale të Gjermanisë, 21 shkurt 1984, aplikimi nr. 8544/79.

Luedicke, Belkacem and Koç k. Republikës Federale të Gjermanisë, 28 nëntor 1978, aplikimi nr. 6210/73; 6877/75; 7132/75.

Pakelli k. Gjermanisë, 12. Dhjetor 1981, aplikimi nr. No. 8398/78.

Imbrioscia k. Zvicrës, 24 nëntor 1993, aplikimi nr. 13972/88.

⁸² Shih RESOLUTION OF THE COUNCIL of 30 November 2009 on a Roadmap for strengthening procedural rights of suspected or accused persons in criminal proceedings (Text with EEA relevance) (2009/C 295/01)

Öcalan k. Turqisë, 12 maj 2005 aplikimi nr. 46221/99.
 Magee k. Mbretërisë së Bashkuar, 6/9/2000, aplikimi nr. 28135/95.
 Galsyan k. Armenisë, 15 shkurt 2008, aplikimi nr. 26986/03.
 Melin k. Francës, 22 qershor 1993, aplikimi nr. 12914/87
 Salduz k. Turqisë, 27 nëntor 2008, aplikimi nr. 36391/02.
 Dayanan k. Turqisë, 13 tetor 2009, final 13/01/2010, aplikimi nr. 7377/03
 Van Geyseghem k. Belgjikës, 21 janar 1999, aplikimi, 26103/95.
 Pelladoah k. Netherlands, 22 shtator 1994, aplikimi nr. 16737/90
 Meftah & others k France, 26 korrik 2012, aplikimet
 nr. 32911/96, 35237/97 dhe 34595/97.
 Lagerblom k. Suedisë, 14 janar 2003, final 14/04/2003, aplikimi nr. 26891/95.
 Croissant k. Gjermanisë, 25 shtator 1992, aplikimi nr. 13611/88.
 Monell & Morris k. Mbretërisë së Bashkuar, 2 mars 1987 aplikimi nr.
 9562/81; 9818/82.
 Artico k. Italisë, 13 maj 1980, aplikimi nr. 6694/74.
 Kamasinski k. Austrisë, 19 dhjetor 1989, aplikimi nr. 9783/82.
 Daud k. Portugalisë, 21 Prill 1998, aplikimi nr. 11/1997/795/997.
 Czekalla k. Portugalisë, final 10/01/2003, aplikimi nr. 38830/97.
 Sakhnovskiy k. Ruisë, 2 nëntor 2010, aplikimi nr. 21272/03.
 S k. Sëitserland, 28 nëntor 1991, aplikimi nr. 12629/87; 13965/88.
 Brennan k. Mbretërisë së Bashkuar, 16 tetor 2001, aplikimi nr. 39846/98.
 Zagaria k. Italisë, 27 nëntor 2007, final 70/07/2008, aplikimi nr. 58295/00.
 Can k. Austrisë, 12 korrik 1984, aplikimi nr. 9300/81.
 Gregačević k. Kroacisë, 10 korrik 2012, final 10/10/2012, aplikimi nr.
 58331/09.
 Iglin k. Ukrainës, 12 janar 2012, final 12/04/2012, aplikimi nr. 39908/05.
 Galstyan k. Armenisë, 15 nëntor 2007, final 15/02/2008, aplikimi nr. 26986/03.
 Kröcher & Möller k. Zvicrës (dec), aplikimi nr. 8463/78, vendimin
 i 9 korrik 1981
 Bonzi k. Zvicrës, 12 korrik 1978, aplikimi nr. 7854/77.
 OAO Neftyanaya Kompaniya Yukos k. Ruisë, 20 shtator 2011, final
 08/03/2013, aplikimi nr. 14902/04.
 Mattic k. Gjermanisë
 Miminoshvili k. Ruisë, 28 qershor 2011, final 28/09/2011, aplikimi nr.
 20197/03.
 Pélissier & Sassi k. Francës, 25 mars 1999, aplikimi nr. 25444/9.
 GB k. Francës, 2 tetor 2001, final 02/01/2002, aplikimi nr. 44069/98.
 Huseyn dhe të tjerë k. Azerbaixhan, 26 korrik 2011, final 26/10/2011, aplikimet
 nr. 35485/05, 45553/05, 35680/05 and 36085/05.
 Padin Gestoso k. Spanjës (vendimi)
 Mayzit k. Ruisë, aplikimi nr. 20 janar 2005, final 06/07/2005, 63378/00
 Kremzoë k. Austrisë, 21 shtator 1993, aplikimi nr. 12350/86.

Foucher k. Francës, 18 mrs 1997, aplikimi nr. 22209/93.
Rasmussen k. Polonisë, 28 prill 2009, final 28/07/2009, aplikimi nr. 38886/05.
Moiseyev k. Rusisë, 9 tetor 2008, final 06/04/2009, aplikimi nr. 62936/00.
Matyjek k. Polonisë, 24 prill 2007, final 24/09/2007, aplikimi nr. 38184/03.
Seleznev k. Rusisë, 26 qershor 2008, final 01/12/2008, aplikimi nr. 15591/03.
Natunen k. Finlandës, 31 mars 2009, final 30/06/2009, aplikimi nr. 21022/04, para. 40-41.
Doasett k. Mbretërisë së Bashkuar, 24/09/2003 aplikimi nr. 39482/98
Mirilashvili k. Rusisë, 11 December 2008, final 05/06/2009, aplikimi nr. 6293/04
Campbell and Fell k. Mbretërisë së Bashkuar, 28 qershor 1984, aplikimi nr. 7819/77; 7878/77.
Goddi k. Italisë, 9 prill 1984, aplikimi nr. 8966/80.
BĂCANU ET SC « R » SA k. Rumanisë, aplikimi nr. 4411/04.
ANALIZË E SISTEMIT TË DREJTËSISË NË SHQIPËRI Qershor, 2015

Vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Vendimi nr. 37, datë 24.12.2010
Vendim nr.222, datë 04.11.2002
Vendimet nr.30, datë 26.11.2009;
Vendim nr.33, datë 24.11.2003;
Vendim nr.5, datë 17.02.2003.
Vendim nr.5, datë 17.02.2003
Vendim nr.10, datë 02.04.2009;
Vendim nr.13, datë 21.07.2008;
Vendim nr.5, datë 04.03.2008;
Vendim nr.16, datë 08.06.2006

**GARANCITË PROÇEDURIALE TË TË PANDEHURIT
NË NJË PROÇES PENAL, NËPËRMJET APLIKIMIT TË GRUP
DISPOZITAVE MBI NDRYSHIMIN E AKUZAVE,
PARË NË KËNDVËSHTRIM HISTORIK DHE FORCIMI I TYRE
ME DISPOZITAT PROÇEDURIALE TË NDRYSHUARA**

Dr. Admir BELISHTA

Kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor
Korçë

Nëse do i referoheshim historikut të ligjeve proceduriale penale në vendin tonë, padyshim që do shihnim dallime esenciale në lidhje me nocionet juridike penale, ndryshim akuze, fakt i ri, vepër penale e re, rrethanë e re, ndryshim cilësimi juridik, kalim aktesh prokurorit, apo respektim të drejtash proceduriale të pandehurit. Këto dallime nuk janë vetëm tek mënyra e formulimit të dispozitave, por dhe tek përmbajtja e tyre. Herë herë ato nuk janë të pasqyrara në mënyrë kaq të qartë sa në Kodin e Proçedurës Penale aktuale dhe herë herë nuk gjejmë pasqyrim. Këto fakte justifikohen kryesisht me kontekstin historik kur janë implementuar këto dispozita, me frymën që mbizotëronte në këtë kohë, apo me sistemin e gjykimeve penale që aplikoheshin (nëse ishte sistemi inkuizitor apo sistemi akuzator), me rolin që luante në kohë të ndryshme hetuesia, prokuroria dhe gjykata, si dhe me një sërë faktorësh të tjerë dytësorë, të cilat kishin ndikimin e tyre në mënyrën e këtyre parashikimeve ligjore. Në këtë këndvështrim, këto institute proceduriale i kam trajtuar referuar të drejtave të personave të marrë si të pandehur, e parë kjo fillimisht në optikën e të drejtave kushtetuese dhe më pas në atë të të drejtave proceduriale.¹

Për efekte praktike studimi, kam marrë në analizë Kodin e Proçedurës Penale të vitit 1979, duke e krahasuar me Kodin e Proçedurës Penale të vitit 1995², si dhe me ndryshimet e fundit ligjore në Kodin e Proçedurës Penale. Ky Kod, nisur dhe nga periudha historike ku ai gjente zbatim, e kufizonte gjykimin, duke e lejuar gjykatësin që në shqyrtimin e çështjes penale të shrinte këtë shqyrtim vetëm për personat që ishin dërguar në gjyq dhe vetëm për atë akuzë për të cilën ata ishin marrë si të pandehur. Nga ana tjetër, konstatohej se edhe pse ndodheshim në një sistem inkuizitor gjykimi, ligjvënësi i asaj kohe i jepte një rol tepër aktiv gjykatës duke i dhënë të drejtën që nëse gjatë gjykimit të çështjes dilnin të dhëna se i pandehuri veç veprës penale për të cilën po gjykohej, kishte kryer dhe një vepër penale tjetër, dhe nëse çështja ishte pushuar nga hetuesia, ta rifillonte kryesisht çështjen për veprën penale të konstatuar duke ia dërguar me pas për hetime hetuesisë. Në këtë rast të drejtën për të çmuar nëse i pandehuri kishte kryer ndonjë vepër tjetër penale që

¹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, viti 1998, Pjesa e dytë, Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, Nenet 27-35.

² Kodi Proçedurës Penale i vitit 1979 dhe Kodi i Proçedurës Penale të vitit 1995.

nuk kishte lidhje me akuzën e parë e kishte vetëm gjykata. Ky organ, pra pikërisht gjykata në këtë kohë, si dhe ne keto raste kishte marë funksione akuzatore. Ndërkohë prokurorisë i ishte hequr funksioni i ndjekjes penale, funksion i cili i kishte kaluar organit të hetuesisë. Po kështu, zbatohet rregullisht sipas të cilit provat formoheshin gjatë hetimit paraprak. Në këtë mënyrë drejtësia penale shqiptare në këtë kohë ishte bërë varianti më regresiv në Europë.³

Më pas, gjatë ndryshimeve të fundit ligjore, në kuadër të reformës në drejtësi, me ligjin Nr. 35/2017, datë 30.3.2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.7905, datë 21.3. 1995, Kodi i Proçedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar”, i cili është botuar në fletoren zyrtare Nr. 97, datë 05.05.2017 dhe që i ka filluar efektet juridike në datën 1 gusht 2017, janë parashikuar një tërësi dispozitash proceduriale penale. Konkretisht Kodi aktual i Proçedurës Penale ka pësuar në 285 nene, shtesa dhe ndryshime. Një pjesë e dispozitave kanë pësuar në përmbajtje ndryshime, duke u hequr paragrafe apo fjali, sikundër duke u shtuar paragrafe apo parashikime ligjore më të detajuara. Nga ana tjetër një risi thelbësore e dispozitave të këtij ligji është implementimi i disa instituteve proceduriale të reja, të cilat parashikojnë nocione dhe subjekte proceduriale që nuk kishin qënë të parashikuara më parë në këtë kod.

Kështu, Seksioni i Katërt, i Kreut të Dytë, të K. Pr. Penale, ka pësuar ndryshime të pakta në përmbajtjen e dispozitave të tij. Mendoj që ky seksion nisur nga problematikat e konstatuara nga praktika gjyqësore kishte nevojë për më shumë ndryshime. Duhej që të kishte një studim më objektiv, si dhe marrja e sa më shumë mendimeve nga prakticienët e së drejtës penale para se të beheshin ndryshimet e këtij seksioni. Kjo pasi ata ishin subjektete reale që i njihnin nga afër dhe i ndeshnin përditë në punën e tyre këto problematika. Megjithatë le të ndalemi konkretisht tek analiza dhe interpretimi i dispozitave të këtij seksioni.⁴

Neni 372 i K. Pr. Penale, dispozitë e cila ka parashikuar rregullat proceduriale për ndryshimin e akuzës nga prokurori gjatë shqyrtimit gjyqësor, me gjithë analizën, interpretimet dhe konstatimet praktike të zbatimit të kësaj dispozite proceduriale në kapitujt e cituar më sipër, konstatohet se me ndryshimet e ligjit nuk është prekur fare kjo dispozitë. Këtu duhet të kemi parasysh parashikimet ligjore mbi të drejtën e disponimit të akuzës gjatë gjykimeve të themelit, referuar ndryshimeve të Kodit të Proçedurës Penale. Në këtë mënyrë hartuesit e këtyre ndryshimeve nuk i kanë pasur në konsideratë çështjet e hasura në praktikën gjyqësore gjatë aplikimit të kësaj dispozite proceduriale penale në gjykimet e themelit.

E njëjta gjë konstatohet gjatë përmbajtjes së ligjit Nr. 35/2017, datë 30.3.2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.7905, datë 21.3. 1995, Kodi i Proçedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar”, me të cilin janë bërë

³ Shih “Demokratizimi i Legjislacionit Penal”, të autorit H. Islami, faqe 66.

⁴ Shih Ligjin Nr. 35/2017, datë 30.3.2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin Nr.7905, datë 21.03. 1995, Kodi i Proçedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar”.

shtesa dhe ndryshime në ligjin proçedural penal, të emërtuar Kodi i Proçedurës Penale, edhe për përmbajtjen e neneve 373 dhe 374 të K. Pr. Penale. Në të njëjtën mënyrë hartuesit e kodit nuk e kanë parë të arsyeshme që dispozitat proçeduriale të cilat parashikojnë rregullat proçeduriale që duhet të respektohen gjatë gjykimeve të themelit, në lidhje me akuzën për një vepër tjetër penale, veç asaj që gjykohet i pandehuri, apo komunikimi i një rrethane rënduese, si dhe në situatën tjetër faktike, kur gjatë gjykimit konstatohet një fakt i ri, që ka lidhje me veprën penale për të cilën gjykohet i pandehuri.

Ashtu si dhe për nenin 372 të K. Pr. Penale edhe për dy nenet e tjera, nenit 373 dhe 374 të K. Pr. Penale, referuar vështirësive praktike të hasura gjatë aplikimit të tyre në çështje konkrete, ndaj mendimin që edhe këto dy dispozita proçeduriale duhet të kishin pësuar ndryshime në përmbajtjen e tyre. Kjo pasi ishte plotësisht e mundur që nëpërmjet amendimeve ligjore, për të cilat ishte dhe momenti i duhur kohor, dispozitat e cituara më sipër të kishin në përmbajtjen e tyre parashikime proçeduriale më të sakta dhe më të plota, duke zgjidhur çështjet konkrete të diskutueshme në praktikën gjyqësore. Nëpërmjet zgjidhjeve ligjore të amendimeve do i jepej një zgjidhje përfundimtare këtyre problematikave të hasura, në lidhje me zbatimin e të trejave këtyre dispozitave proçeduriale penale.

Nga ana tjetër, konstatohet se neni 375 i K. Pr. Penale me ndryshimet e fundit të sapo hyra në fuqi, ka pësuar një ndryshim në përmbajtje, duke u bërë një formulim më i plotë i kësaj dispozite proçeduriale. Nëse do krahasonim këtë dispozite me dispozitën proçeduriale që është shfuqizuar me këtë ligj konstatojmë se ligjvënësi ka shtuar dy paragrafe të tjerë, përkatësisht në numra 2 dhe 3. Padyshim që paragrafi i dytë e sjell dispozitën proçeduriale të ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale, në harmoni me standartet e konventës dhe qëndrimet e gjykatës ndërkombëtare penale, ku palët vihen në dijeni paraprakisht me qëllim ushtrimin e të drejtës së mbrojtjes në rast të një cilësimi juridik më të rëndë. Komunikimi i të pandehurit që gjykohet në mungesë do jëtë sipas parashikimeve të nenit 352 të K. Pr. Penale.

Edhe pse duhet pranuar fakti që ligjvënësi me këtë parashikim jep një zgjidhje ligjore përfundimtare një situatë të tillë konkrete, duhet theksuar fakti se ky ligjvënës nuk ka parashikuar dhe rregulluar situatën kur trupi gjykues i themelit që konstaton në përfundim të shqyrtimit gjyqësor se vepra penale mund të ketë një cilësim juridik me të rëndë nuk është kompetent nga pikëpamja funksionale, psh vepra penale që do rezultojë gjatë ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale, është në kompetencë gjykimi me tre gjyqtarë, ndërkohë që gjykimi i çështjes deri në ato momente është zhvilluar me një gjyqtar. Në këtë rast konstatohet se nuk ka një parashikim ligjor për daljen nga kjo situatë faktike. Përsëri praktika gjyqësore duhet të veprojë edhe pas këtyre ndryshimeve ligjore me zgjidhje oportune, psh një rast zgjidhje ishte shpallja e kompetencës funksionale dhe dërgimin e saj gjykatës kompetencë, trupit gjykues kompetent që do ishte një treshe gjyqtarësh e dhomës penale, e po së njëjtës gjykatë. Problematikat në këto raste ishin të njëjta me ato

çka janë trajtuar gjerësisht në disa trajtime juridike, ku mund të nënvizojmë faktin se mbi çfarë akti apo kriteri ligjor formohet një trup gjykues, etj.

Nga ana tjetër konsatohet gjithashtu fakti se ndryshime ka pësuar dhe neni 377 i K. Pr. Penale, i cili ka të bëjë me kalimin e akteve prokurorit kur tërheq akuzën dhe pas konstatimit të faktit nga gjykata që nuk ndodheshim në rastet e pafajësisë apo pushimit të çështjes. Sipas nenit 209, të ligjit Nr. 35/2017, datë 30.3.2017, *“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.7905, datë 21.3. 1995, Kodi i Proçedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar”*, në nenin 377, pika 1, fjalia e dytë e parashikimit të nenit 377 të K.Pr. Penale, hiqet. Pra hiqet parashikimi ligjor me përmbajtje *“Në rast të kundërt gjykata kalon aktet prokurorit”*.

Referuar një ndryshimi ligjor të tillë nuk konstatohet në mënyrë të qartë se cili ka qënë qëllimi i draftuesit dhe më pas i ligjvënësit në heqjen e një parashikimi të tillë ligjor. Kjo pasi mendoj që edhe pse është hequr kjo pjesë e dispozitës, parashikimi që ajo kishte në përmbajtje duhet zbatuar përsëri nga gjykata nëse ka një kërkesë të prokurorit për tërheqjen e akuzës dhe në gjëndjen që janë provat gjykata nuk konstaton vërtetimin e faktit se i pandehuri nuk ka faj, ose del që ekziston një nga rastet e pushimit të çështjes, duke disponuar me pafajësi apo pushim çështje. Pra përballë një kërkesë të tillë të prokurorit, nëse gjykata nuk jep dot pafajësi apo pushim të çështjes, duhet të pranojë kërkesën e prokurorit për tërheqjen e akuzës duke ia kaluar aktet prokurorit, pasi në mungesë të këtyre dy lloj disponimesh, gjykata nuk duhet të lerë pa asnjë disponim kërkesën e prokurorisë. Edhe pa një parashikim të tillë të shkruar gjykata do zbatojë të njëjtin disponim siç ka vepruar dhe më parë, duke patur një praktikë gjyqësore të konsoliduar në këtë drejtim. Gjykata në këto raste ka detyrimin tashme të paparshikuar ligjërisht, por si të vetmen mundësi që të zbatojë pikërisht obsionin e tretë atë të pranimit të kërkesës së prokurorit. Ajo që mbetet për tu kuptuar gjatë zbatimit të kësaj dispozitë në praktikë siç u theksua dhe më sipër është fakti i qëllimit të ligjvënësit në impementimin e kësaj dispozite me një përmbajtje të tillë, pra interpretimi teleologjik i normës.

Ndryshimi i tretë në ligjin Nr. 35/2017, datë 30.3.2017, *“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.7905, datë 21.03. 1995, Kodi i Proçedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar”*, në lidhje me Seksionin e Katërt, të Kreut të Dytë, ka të bëjë me të drejtat e të pandehurit, gjatë momentit proçedural të aplikimit të akuzave të reja në proçesin penal. Në nenin 208 të ligjit, të cituar më sipër, ligjvënësi ka bërë ndryshime në përmbajtjen e nenit 376, duke bërë disa shtesa. Këto shtesa konsistojnë kryesisht tek dy elemente, e konkretisht elementi i parë ligjor ka të bëjë me shtimin e respektimit të këtyre të drejtave edhe në situatën apo rastin e zbatimit të nenit 375 të K. Pr. Penale. Ky parashikimi ligjor ndjek një rrjedhë llogjike me ndryshimet në përmbajtje që ka pësuar vetë neni 375 i K. Pr. Penale. Pra, tashmë me ndryshimet e reja ligjore, të pandehurit duhet ti garantohen të njetat rregulla mbrojtje si dhe në rastet e aplikimit të neneve 372, 373 dhe 374 të K. Pr. Penale. Elementi i dytë ligjor është përsëri në llogjikën e drejtë të ndryshimeve, ku në paragrafin e tretë të nenit 376 të K. Pr. Penale pas nocionit

proçedural “mungesë”, janë shtuar fjalët “sipas neneve 351 dhe 352 të këtij kodi”. Duke qënë se me ndryshimet e kodit edhe dispozitat proçedurale të gjykimit në mungesë, nenet 351 dhe 352 të K. Pr. Penale kanë pësuar ndryshime në përmbajtje, me të drejtë ligjvënësi i ka kushtuar një vëmendje të veçantë, duke parashikuar rregulla të detajuara për respektimin e të drejtave proçeduriale të të pandehurve, në rastin e aplikimit të akuzave të reja, të cilët gjykohen në mungesë, duke referuar me të drejtë në dispozitat proçeduriale konkrete të gjykimit në mungesë.

Në analizën e saj rreth shtesave apo ndryshimeve, në grup dispozitat për akuzat e reja në proçesin penal, konstatohen se ato kanë prekur vetëm tre dispozita proçeduriale, të cilat zbatohen gjatë gjykimeve të themelit. Referuar tërësisë së problematikave të konstatuara nga praktika gjyqësore mendoj se ndryshimet duhet të preknin jo vetëm tërësinë, por dhe thelbin e këtyre dispozitave. Ato ishin nevojë imediate e diktuar nga raste të shumta të praktikës gjyqësore. Megjithatë, pavarësisht këtyre ndryshimeve, koha do diktojë nevojën e ndryshimeve të tjera ndaj këtyre dispozitave proçeduriale, të cilat duhet të jenë derivat i një analize të hollësishme, si dhe e një grupi të gjërë profesionistësh dhe praktikienësh të ligjit proçedural penal.

Po kështu ligjvënësi ka parashikuar një sanksionim të ri në lidhje me akuzat e reja, në nenin 332/d të Kodit të Proçedurës Penale, e cila është gjithashtu një dispozitë e shtuar në kod me ndryshimet e fundit ligjore, i emërtuar *ndryshimi i akuzës në seancën paraprake*. Duke qënë se një dispozitë e tillë është e implementuar rishtazi në kod, në mungesë të një praktikë gjyqësore në këtë drejtim, po japim disa konstatime dhe konsiderata apo mendime rreth përmbajtjes së saj dhe pritshmërive në zbatim, në rolin e një praktikieni të së drejtës penale për me shumë se një dekadë. Referuar përmbajtjes dhe interpretimit të paragrafit të parë të kësaj dispozite konstatojme se ligjvënësi ka permbledhur dy parashikime ligjore që zbatohen nga gjykata e themelit, duke i përcaktuar sipas kësaj dispozite, referuar dhe renditjes së saj në kod, si attribute të gjyqtarit të seancës paraprake. Konkretisht ky parashikim ligjor, rregullon dhe disiplinon situatat faktike të ndryshimit të akuzës, si dhe konstatimit të një vepre tjetër penale apo rrethane rënduese që nuk ishte përmendur në kërkesën për gjykim, institute proçeduriale të parashikuara dhe në nenet 372 dhe 373 të K. Pr. Penale. Ndryshimi qendron se sipas kësaj dispozite që kemi marrë në analizë konstatimi i këtyre fakteve prej prokurorit bëhet gjatë zhvillimit të seancës paraprake nga gjyqtari i seancës paraprake. Ashtu si dhe në dy dispozitat e tjera të cituara të drejtën për disponim e ka vetëm prokurori kur konstaton fakte të tilla. Nga ana tjetër gjykata ka detyrimin që në rast mungese të pandehurit akuzat të komunikohet mbrojtësit, por që ti garantohet e drejta e komunikimit me të pandehurin dhe në funksion të një mbrojtje efektive rreth këtij fakti, duke i lënë një afat jo më shumë se dhjetë ditë.

Duke qënë se ky paragraf i kësaj dispozite është i njëjtë në përmbajtje me parashikimet ligjore të neneve 372 dhe 373 të K. Pr. Penale, vlej në të njëjtat

problemtika që do ndeshen në praktikën gjyqësore ashtu siç dhe kemi konstatuar dhe analizuar në këtë punim, për këto dy dispozita. Nëse nga ligjvënësi do ishin marre në konsideratë edhe momentet proceduriale të konsideruara si probleme nga praktika gjyqësore, padyshim që do e bënte parashikimin ligjor më të saktë, duke i shtuar vlerat praktike. Implementimi i një parashikimi të tillë në kod, mendoj që i vjen së tepërmi në ndihmë praktikës gjyqësore, në një kohë që prokurorit i jepet dy herë mundësia për të disponuar në lidhje me akuzat e reja, njëherë në gjykimin e seancës paraprake dhe njëherë në gjykimin themelut. E padyshim kjo gjë shihet në funksion të garantimit të një procesi të rregullt ligjor, në aspektin e një drejtësie proceduriale.

Nga ana tjetër, në paragrafin e dytë të nenit 332/d të K. Pr. Penale, ligjvënësi parashikon të drejtën e prokurorit për të disponuar gjatë zhvillimit të seancës paraprake, nëse konstaton një fakt të ri penal veç akuzës së ngritur. Në përmbajtje kjo dispozitë është e njëjtë me disponimin që bën prokurori sipas nenit 374 të K. Pr. Penale, por me ndryshimin që sipas kësaj dispozite prokurori disponon në seancën paraprake kur konstaton një fakt të tillë, kurse sipas nenit 374 prokurori disponon kur konstaton faktin gjatë gjyqimit të themelut. Edhe për këtë paragraf të dispozitës vlejné të njëtat risi dhe rëndësi praktike si dhe paragrafi i parë, pasi prokurorit i jepet dy herë mundësia që të disponojë në lidhje me faktin e ri, gjatë të njëtit procedim penal, apo çështje gjyqësore.

Ndërsa në paragrafin e tretë ligjvënësi i jep attribute gjyqtarit të seancës paraprake që kur konstaton tre elemente si, cilësim ligjor të gabuar, akuzë të pa formuluar qartë, apo të pa formuluar saktë, fton prokurorin që të bëjë korrigjimet ose saktësimet e nevojshme. Nëse prokurori pas “orientimit” apo sipas terminologjisë së përdorur nga ligjvënësi “ftesës së gjykatës” nuk vepron, gjykata ka detyrimin t’i ktheje aktet prokurorit. Në pamje të parë implementimi i këtij parashikimi ligjor në paragrafin e tretë të nenit 332/d të K. Pr. Penale, ngjason me nenin 375 të K. Pr. Penale, me ndryshimin që ky paragraf zbatohet nga gjyqtari i seancës paraprake, kurse neni 375 zbatohet nga gjyqtari i themelut.

Nga ana tjetër konstatohet qartësisht fakti se ligjvënësi në këtë paragraf ka implementuar nocione të reja proceduriale veç atyre që parashikon neni 375 i po këtij kodi. Kështu ligjvënësi parashikon nocione të tilla të reja si mos formulimin e qartë të akuzës, si dhe mos formulimin e saktë të akuzës. E ndërsa nocioni i parë referuar rasteve të shumta të ndeshura në praktikën gjyqësore, është një nocion më i kuptueshëm, pasi ka të bëjë me përkrahim elementësh në mënyrë të detajuar, apo për përcaktim në mënyrë të qartë të faktit penal dhe kualifikimit ligjor, si dhe lidhjes midis tyre, e kundërta ndodh me pasaktësinë e formulimit të akuzës. Kjo pasi mendoj se pasaktësia e akuzës ka të bëjë pikërisht me momentin e përcaktimit të drejtë cilësimit juridik të veprës penale, prej prokurorit, terminologji që është parashikuar në pjesën e parë të përmbajtjes së paragrafit të tretë. Megjithatë, përpos analizës së këtij fakti, mendoj se elaborimi apo lëvrimi i kësaj terminologjie do

bëhet me zhvillimin e praktikës gjyqësore në këtë drejtim. Ajo që duhet vlerësuar gjithësesi është fakti që ligjvënësi me parashikimin e këtyre nocioneve të reja, padyshim që e bën këtë paragraf të dispozitës më të plotë në përmbajtje dhe jo të thatë.

Nga ana tjetër, konstatohet së referuar momentit procedural kur konstatohen këto fakte që është seanca paraprake, e cila ka një objekt gjykimi konkret dhe të caktuar qartësisht, të cituara në paragrafin e tretë, të nenit 332/d të K. Pr. Penale, me të drejtë ligjvënësi i ka dhënë të drejtë gjykatës vetëm të konstatojë këto fakte kryesisht, dhe të verë në dijeni përfaqësuesin e prokurorisë, duke i dhënë orientimet për të vepruar rreth fakteve të konstatuara. Me këtë veprim ligjor, përfundon detyrimi i gjykatës në situata të tilla. Është më pas në ndërgjegjën, vlerësimin dhe profesionalizmin e prokurorit nëse do veprojë ose jo në lidhje faktet që është vënë në dijeni nga gjykata. Nëse prokurori nuk mban qëndrim, duke mos vepruar, gjykata duke mos qënë një gjykatë themeli nuk ka attribute të veprojë kryesisht për këtë ndryshim cilësimi ligjor, siç e ka sipas nenit 375 të K. Pr. Penale, disponon me kthimin e akteve prokurorit. Në vendim padyshim që gjykata arsyeton dhe shkaqet për të cilat i janë kthyer aktet prokurorisë. Një vendimmarrje të tillë gjykata ka gjithashtu detyrimin që t'ia komunikojë edhe drejtuesit të prokurorisë.

Pra, në funksion të kësaj analize mendimi, nëse prokurori nuk vepron me “dëshirë, bazuar në ftesën e gjykatës”, gjykata disponon me vendimmarrje urdhëruese, duke ia kaluar aktet prokurorisë dhe dhënë dhe detyrat përkatëse se si duhet të veproje ky organ. Në fakt nocioni i parashikuar nga ligjvënësi në këtë paragraf të dispozitës, kthim aktesh prokurorit ishte një nocion i huazuar nga neni 377 i K. Pr. Penale, para ndryshimeve, i analizuar gjerësisht në këtë punim. E përbashkëta e këtij nocioni qëndron pikërisht në faktin se kalimi i akteve ndodh, vetëm pas mos realizimit të kushteve të tjera paraparke, që parashikonin këto dy dispozita.

Vështirësia apo problemi që mund të dalë në praktikën gjyqësore e që i përket padyshim se ardhmes është fakti që pas disponimit të gjykatës për kthimin e akteve, prokurori të sjellë për vleftësim në seancë tjetër paraparke të njëjtën cilësim juridik, apo të njëjtën akuzë pa bërë rregullimet përkatëse, ndërkohë që gjyqtari i seancës tjetër paraprake nuk mund të ketë pengesë që të jetë një gjyqtar tjetër nga gjyqtari i parë, bazuar në kriterin e përcaktimit të tij me short. Personalisht mendoj që në raste të tilla organi i prokurorisë ka detyrimin që pavarësisht nëse kryen ose jo veprime të tjera procedurale të përmbushë detyrimet e përcaktuara në vendimin gjyqësor, për të cilin i janë kthyer aktet dhe se subjekt vlerësimi, duke qënë se kemi të bëjmë me çmuarjen në dinamikë të së njëjtës çështje, edhe në rastin e dyte duhej të ishte i njëjti gjyqtar i seancës paraprake. Gjithësesi këto mbeten për tu parë në vijim, në varësi të ecurisë apo zhvillimit të praktikës gjyqësore, e veçanërisht nga qëndrimet e gjykatave më të larta.

Referuara fakteve të konstatuara, analizuar dhe trajtuara në këtë referim duhet të theksojme faktin se me ndryshimet e bëra Kodit të Procedurës Penale në tërësi, dhe dispozitave që parashikojnë nocionet procedurale të akuzave të reja

në procesin penal në veçanti, e lidhur në mënyrë integrale me respektimin e të drejtave procedurale të pandehurve, pavarësisht mendimeve të ndryshme, të cilat janë relative, në funksion të qëllimit për të patur një kod sa më të arrirë, iu është dhënë një zgjidhje përfundimtare shumë problemeve të konstatuara nga praktika gjyqësore. Ajo që mbetet si pritshmëri tashmë, është zhvillimi dhe më pas konsolidimi i kësaj praktike gjyqësore, gjatë zbatimit të dispozitave të ndryshuara të Kodit të Proçedurës Penale.

BIBLIOGRAFIA

1. Kodi i Proçedurës Penale i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, miratuar me ligjin Nr. 6069, datë 25.12.1979.
2. Kodi i Proçedurës Penale i vitit 1995, miratuar me ligjin Nr. 7905, datë 21.03.1995, i ndryshuar.
3. Ligji Nr. 35/2017, datë 30.3.2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.7905, datë 21.03. 1995, Kodi i Proçedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar”.
4. Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda, Proçedura Penale-Komentar, Shtëpia Botuese Morava, Tiranë 2003.

**OBJEKTI, QËLLIMI DHE FUSHA E ZBATIMIT TË LIGJIT
“PËR PARANDALIMIN DHE GODITJEN E KRIMIT TË ORGANIZUAR,
TRAFIKIMIT DHE KORRUPSIONIT NËPËRMJET MASAVE
PARANDALUESE KUNDËR PASURISË”**

Referon: Saimir VISHAJ

Krimi i organizuar dhe aktet ndërkombëtare

Krimi i organizuar përbën një ndër rreziqet më të mëdha të sigurisë dhe të zhvillimit të një vendi. Ai mbart me vehte implikime tepër negative me karakter politik, social dhe ekonomik. Lëvizja e lirë e njerëzve dhe hapja e tregjeve ndërkombëtare edhe në rajonin tonë u shoqërua me rritjen e krimit të organizuar brenda vendit dhe ndërkombëtarizimin e tij.

Për shkak të ndërkombëtarizimit, lufta kundër krimit të organizuar, ka qënë në fokus të marrëdhënieve midis shteteve dhe organizatave ndërkombëtare. Një hap i rëndësishëm shënoi në vitin 2000, Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar”, dhe dy protokollat shtesë të saj, “Protokolli kundër trafikimit të migrantëve me rrugë tokësore, ajrore dhe detare” dhe “Protokolli për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve”.

Konventa Nr.141 “Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit”, është një dokument tjetër i rëndësishëm, që ndihmon në luftën kundër kriminalitetit në shtetet që e kanë miratuar këtë konventë, ku ndër ta është edhe shteti ynë.

Në zbatim të akteve ndërkombëtare në Shqipëri janë marrë një sërë masash legjislative dhe institucionale për harmonizimin e legjislacionit të brendshëm me dispozitat e konventes.

Në Dhjetor 2009 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin Nr. 10192, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë.” Ky ligj i njohur gjerësisht si ligji Anti-Mafia hyri në fuqi në 24 Janar 2010.

Objekti dhe qëllimi i ligjit

Objekti i këtij ligji është përcaktimin e procedurave, kompetencave dhe kriterëve për zbatimin e masave parandaluese kundër pasurisë së personave, që janë subjekt i këtij ligji, si të dyshuar për pjesëmarrje në krimin e organizuar, trafikimin, dhe korrupsionin.

Ligji në fjalë rregullon në mënyrë të detajuar:

- Fushën e zbatimit të tij,
- Procedurat e marrjes së masave parandaluese,
- Veprimet paraprake të prokurorit dhe të policisë gjyqësore,
- Gjykatat kompetente që shqyrtojnë kërkesën e prokurorit,
- Procedurat e sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive
- Mënyrat e administrimit të këtyre pasurive,

Qëllimi ketij ligji është parandalimi dhe goditja e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit përmes konfiskimit të pasurisë së personave, të cilët kanë një nivel të pajustificuar ekonomik, si rezultat i veprimtarisë së dyshuar kriminale.¹

Krimi i organizuar në Shqipëri është shfaqur në format e trafikimit të njerëzve dhe armëve, trafikimit të femrave dhe të të miturve, kontrabandës së naftës dhe mallrave të ndryshme, trafikun e narkotikeve, trafikun e armeve, vrasjet me pagesë e gjobëvëniet, përdorimi i eksplozivit etj.

Masat parandaluese dhe masat penale

Masat parandaluese: sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë, që rrjedh prej krimit janë të lidhura ngushtë me masat penale, dënimet që u jepen autorëve të tyre. Megjithatë lidhjen që ekziston midis tyre, kanë dallime objektive me njëra tjetrën .

Dënimi jepet ndaj individit, që provohet se ka kryer një vepër penale, ndërsa masat parandaluese nuk përbëjnë dënim, por synojnë të frenojnë subjektet në kryerjen e veprave penale dhe në këtë mënyrë mbrojnë interesin publik.

Në zbatimin e masave parandaluese rëndësi ka balancimi interesave të kundërta: nga njëra anë respektimi dhe garantimi të drejtave dhe lirive të individit dhe nga ana tjetër kufizimi i këtyre të drejtave për qëllime madhore të luftës ndaj krimit të organizuar , trafikimit dhe korrupsionit.

Zgjidhja e balancuar nënkupton kufizimin e së drejtës së pronës (apo edhe lirisë ekonomike) së një kategorie të caktuar individësh, të dyshuar për zotrim të pasurive që rrjedhin nga krimi apo për krijim të ardhurash financiare në mënyrë jo të ligjshme, për të mbrojtur dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore për një kategori më të gjerë personash.

Ndryshimi i ligjit

Ligjit 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë, me ligjin nr. 24 të vitit 2014 i u bë një shtesë në objekt, ku në fushën e veprimit të tij u përfshi edhe vepra penale e korrupsionit.

¹Ligji nr.10192, date 3.12.2009 , me ndryshimet e bera ne nenin 2

Ndryshimi i ligjit ishte i nevojshëm:

Së pari: Për të harmonizuar më mirë legjislacionin e brendshëm me Konventen e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe protokolleve shtesë të saj.

Në Konventën e Palermos thuhet se “secili shtet palë duhet të adaptojë, në masën e duhur dhe në pajtim me sistemin e tij ligjor, masa legjislative, administrative ose masa të tjera efektive për të forcuar integritetin dhe për të parandaluar, zbuluar dhe ndëshkuar korrupsionin e zyrtareve publike”.²

Së dyti: Për të luftuar më mirë korrupsionin, pasi përbën një sfidë serioze për vendin.

Në atë vit kur u ndryshua ligji, Shqipëria zbriti 18 vënde në renditjen e indeksit të korrupsionit, siaps organizatës prestigjioze Transparency International, duke u klasifikuar si vendi më i korruptuar në Evropë.

Së treti: Për të harmonizuar më mirë masat parandaluese me masat penale ndaj personave që zhvillojnë korrupsion.

Sekuestrimi i pasurive, që merret me vendim të Gjykatës së Shkallës Parë të Krimeve të Renda, harmonizohet me faktin se edhe hetimi i veprave penale të korrupsionit ishte në kompetencë të Prokurorisë së Krimeve të Rënda.

Lufta ndaj korrupsionit nuk është bazuar tani vetëm në konceptin klasik të masave represive, pra vetëm nëpërmjet dënimit. Rëndësi ka edhe marrja e masave parandaluese nëpërmjet sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë. Të dyja këto masa, si ato penale ashtu edhe ato parandaluese ndikojnë efektivisht në reduktimin e këtij krimi në institucionet e shoqërisë apo ekonomisë së vendit.

Rëndësia e ligjit

Ligji 10192, datë 3.12.2009, me ndryshimet e bëra, ka rëndësi të madhe pasi jep ndikim në tre drejtime kryesore:

1. U heq mundësinë krimineleve që t'i gëzojnë këto pasuri.

Krimi i organizuar duhet goditur atje ku i dhemb me shumë, në pasurinë e tij. Veprimtaria e grupeve kriminale të organizuara është e rrezikshme për të gjithë shoqërinë, prandaj nuk duhen lejuar të përfitojnë nga krimet e tyre. Është e nevojshme që prokuroria dhe organet e tjera ligjzbatuese të bëjnë të gjitha përpjekjet për të konfiskuar këto pasuri kriminale.

2. U heq mundësinë krimineleve që t'i përdorin këto pasuri për rritjen e sferës së krimit apo për t'i shpëtuar përgjegjësisë penale

Pasuritë që rrjedhin nga krimi, duke qënë në shumta të konsiderueshme, përdoren nga kriminelët për rritjen e mëtejshme të aktivitetit kriminal, për shtimin

² Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, Neni 9 pika

e transaksioneve të paligjshme, për zgjerimin e bashkëpunorëve të krimit, për korrupsionin e organeve të zbatimit të ligjit.

Krimi investon për t'i shpëtuar zbulimit të veprimtarisë apo përgjegjësisë penale, nëpërmjet korrupsionit të organeve të zbatimit të ligjit, sidomos policisë, prokurorisë e gjykatës.

3. I jep mundësi shtetit që të ardhurat, që nxirren nga këto pasuri, t'i përdorë për fuqizimin e kapaciteteve të organeve ligjzbatuese

Pasuritë e konfiskuara, që rrjedhin nga krimi i organizuar, trafiqet dhe korrupsioni, që kalojnë në favor të shtetit, përdoren për të fuqizuar punën dhe mjetet e organeve ligjzbatuese.

Mjetet monetare të konfiskuara apo të ardhurat e përfuara nga pasuritë e konfiskuara përdoren për ngritjen e fondit të posaçëm për parandalimin e kriminalitetit dhe edukimin ligjor. Ky fond shërben për:

- përmirësimin e funksionimit të drejtësisë penale,
- përmirësimin e hetimeve paraprake penale të krimit të organizuar dhe zhvillimin e programeve të mbrojtjes së dëshmitarëve e të bashkëpunorëve të drejtësisë;
- dhënien e ndihmës viktimave të krimit të organizuar dhe të dhunës, si dhe nxitjen e programeve sociale për këto kategori,

Ligji përcakton se të ardhurat e përfuara nga zbatimi i këtij ligji, për vitet financiare 2009 -2010, në masën 50 % do të shërbejnë për krijimin e fondit të posaçëm për parandalimin e kriminaliteti dhe edukimit ligjor.

Fusha e Zbatimit të ligjit

Neni 3 i ligjit “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” përcakton fushën e zbatimit të këtij ligji.

Ligji zbatohet ndaj dy kategori pasurie:

I. Për pasuritë e personave, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicie, për pjesëmarrje në organizata kriminale ose në grupe të strukturuar kriminale ose kanë kryer krime që parashikohen në nenin 3 pika 1 i ligjit. Pra, në këtë rast, bëhet fjalë për pasuritë e personave kryesore, të lidhur drejtpërdrejt me krimin, për të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicia.

Konkretisht ndaj pasurise se personave mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicie, për:

a) pjesëmarrje në organizata kriminale ose në grupe të strukturuar kriminale, sipas parashikimeve të neneve 333 dhe 333/a të Kodit Penal dhe për kryerje të krimeve prej tyre;

b) pjesëmarrje në organizata terroriste ose në banda të armatosura, sipas parashikimeve të neneve 234/a dhe 234/b të Kodit Penal dhe për kryerje të krimeve prej tyre;

c) kryerjen e veprave të tjera, për qëllime terroriste, të parashikuara në pjesën e posaçme kreu VII i Kodit Penal;

d) kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet 109, 109/b, 110/a, 114/b, 128/b, 278/a, 282/a, 283, 283/a dhe 284/a të Kodit Penal.

e) kryerjen e krimeve për qëllime të fitimit të pasurive të paligjshme, të parashikuara në nenet 114/a dhe 287 të Kodit Penal

Siç shikohet ligji i ri sjell një ndryshim në standartin e provueshmërisë, nga standardi “dyshim i arsyeshëm i mbështetur në prova” në standardin e ri “dyshim i arsyeshëm mbështetur në indicie”.

Ç’ kuptojmë me dyshim të arsyeshëm bazuar në indicie?

Hetimi pasuror nuk mund të fillojë në mënyrë arbitrare ndaj personave të caktuar dhe jo për çfarëdo lloj shkelje penale të supozuar, që mund të ketë kryer një person.

Hetimi pasuror fillon vetëm ndaj atyre personave, të cilët dyshohen se janë të përfshirë në veprimtari kriminale me rrezikshmëri të theksuar shoqërore dhe që prodhojnë të ardhura me natyrë kriminale .

Prandaj gjatë gjykimit duhet të provohet lidhja që duhet të ekzistojë midis ekzistencës së veprës penale ose veprimtarisë kriminale dhe sendit që kërkohet konfiskimi.

Si dyshime të arsyeshme, të mbështetur në indicie, praktika ka pranuar:

- Përgjime telefonike të të paditurit me persona të tjerë të dyshuar, të përfshirë në veprimtari kriminale,
- Deklarata të dhëna gjatë fazës së hetimit penal të shtetasve me cilësinë e personave ndaj të cilëve zhvillohen hetime;
- Këqyrje dhe sekuestri sendesh të dyshuara si produkte të veprave penale.
- Foto apo filmime etj.

Një kusht tjetër i rëndësishëm është se: masat parandaluese merren vetëm ndaj atyre pasurive, të cilat e kanë burimin nga aktivitet kriminale

Gjykata në vendimin për caktimin e masës së sekuestros apo të konfiskimit duhet të individualizojë secilën pasuri veçmas, duke provuar nëse është fituar në mënyrë të ligjshme apo jo. Për këto pasuri nuk ekziston prezumimi se janë të gjitha të paligjshme, kjo nuk përjashton mundësinë që të ketë pasuri të fituar në mënyrë të ligjshme. Gjykata duhet të vërtetojë që ekziston një lidhje shkakësore midis pasurive të sekuestruara dhe veprimtarisë kriminale.

Pasuritë nuk mund të sekuestrohen kur vërtetohen se këto pasuri janë fituar në mënyrë të ligjshme përpara apo gjatë kohës kur personi dyshohej të kryente veprimtari kriminale.

Identifikimi me saktësi i këtyre pasurive është e domosdoshme, pasi jo në të gjitha rastet pasuritë që zotërohen prej personave të përfshirë dhe personave të afërt me të, mund të kenë prejardhje të paligjshme, dhe kjo lidhje duhet dhe mund të provohet mbi bazën e indicieve, të cilat duhet të jenë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën, për të provuar përfshirjen e personit në veprimtari kriminale dhe nivelin ekonomik të pajustificueshm.

Lidhur me dyshimin e arsyeshëm, të bazuar në indicie dhe të lidhjes që duhet të këtë pasuria me veprimtarine kriminale flet rasti i mëposhtëm:

Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, me vendim Nr.01, datë 16.01.2014, ka vendosur:

- Konfiskimin e pasurive ndaj personave të Paditur F.D, K.D dhe A.D dhe i palës së tretë P.H, Sh.D, A.B, si persona të dyshuar për pjesëmarrje në veprimtari kriminale.

Me arsyetimin se këta shtetas nuk arrijnë të provojnë prejardhjen e ligjshme të pasurisë së tyre, në kuptim të nenit 21, pika 3 të ligjit 10192, date 03.12.2009.

Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, me vendim Nr.08 datë 02.04.2014, ka vendosur:

- Lënien në fuqi të vendimit Nr.01, date 16.01.2014, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë.

Gjykata e Lartë, me vendim Nr.224 datë 09.12.2014, ka vendosur:

- Prishjen e vendimeve të të dy shkallëve të gjykimit dhe rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë.

Kolegj Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar midis të tjerash: Se gjykatat nuk kanë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme, pas shqyrtimit të indicjes provuese dhe aktit të ekspertimit, duke mos argumentuar në mënyrë shteruese mbi bindjen e brëndshme rreth pranisë dhe të plotësisimit të kushteve ligjore, të parashikuara në nenin 24 të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009, *mbi krijimin e dyshimeve të arsyeshme, bazuar në indicje, për pjesëmarrjen e personit të paditur në veprimtari kriminale, të parashikuar në nenin 3 të këtij ligji.*

Në këto kushte gjykatat e themelit kanë proceduar kryesisht përtej kërkesës së prokurorit, duke mos kryer një analizë tërësore të indicjeve dhe të qëndrimit të palëve në gjykim, nuk kanë arritur të plotësojnë respektimin e kushteve ligjore të dyshimit të arsyeshëm, se pasuria e pretenduar rrjedh nga veprimtari e jashtëligjshme dhe se është drejtpërdrejtë ose tërthorazi në zotërim të pjesshëm apo të plotë të personit të dyshuar.

II. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj pasurive të një katigorie tjetër personash, që janë sekondarë në krahasim me grupin e parë, të cilët janë lidhje të afërta të tyre ose pasuritë e këtyre personave janë përdorur ose kanë ndikuar në kryerjen e veprimeve të paligjshme.

Konkretisht ndaj pasurive të:

a) personave të afërm (bashkëshorti, fëmijët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit, motrat, ungjërit, emta, nipërit, mbesat, fëmijët e vëllezërve dhe të motrave, vjehri, vjehrra, dhëndri, nusja, kunata, kunati, bashkëjetuesi, thjeshtri, thjeshtra, njerku dhe njerka) të subjekteve të pikës 1 të këtij neni;

b) personave fizikë ose juridikë, për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se pasuritë ose veprimtaritë e tyre zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, a janë përdorur, kanë lehtësuar apo në një formë kanë ndikuar në kryerjen e veprimtarive të jashtëligjshme nga personat e parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

III. Masat parandaluese mund të kërkohen dhe ndaj trashëgimtarëve të personit, subjekt I zbatimit të këtij ligji, por, në çdo rast, jo më vonë se 5 vjet nga data e vdekjes.

IV. Ky ligj zbatohet edhe për pasuritë e personave, të krijuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kusht që pasuritë të jenë vënë gjatë përfshirjes së dyshuar të tij në veprimtarinë kriminale, sipas pikës 1 të këtij neni.

TAPPING OF A SPECIFIC CATEGORY OF PEOPLE

PhD. Ivas KONINI
PhD.C. Arbër BASHOLLI

ABSTRACT

Tapping, as a penal institution, represents the interference in a communication or in the private life of two or more persons for the provision of data to be used for a particular purpose.

The aim of this paper is on the treatment of procedural legitimacy of direct or indirect interceptions of people who have some special qualities, such as a lawyer or a judge. The analysis of this topic is related to the current state of the provision, in relation to its content, before it was changed with the amendments adopted in 2014, which is directly related to the interception of persons with immunity

The theme is written primarily using the using classic analytical, historical, logical and comparative methods. The comparison method is used mainly with the Italian system.

The novelty in this paper is the need of meeting the legal process with constitutional coverage in the field of interceptions of people who have special qualities and in full compliance with the legal practice of The European Court of Human Rights, through the proposal of a technical process of improving the respective provisions in the Republic of Albania.

Keywords: *interception, evidence, procedural law, lawyer, prosecutor.*

PËRGJIMI I NJË KATEGORIE TË VEÇANTË PERSONASH

PhD. Ivas KONINI

Departamenti i të Drejtës Penale,
Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
ivas.konini@fdut.edu.al

PhD.C. Arbër BASHOLLI

ILDKPKI –Tiranë
abasholli@gmail.com

ABSTRAKT

Përgjimi, si institut penal, përfaqëson ndërhyrjen në komunikimin apo jetën private të dy apo më shumë personave, për sigurimin e të dhënave, për tu përdorur për një qëllim të caktuar.

Qëllimi i këtij studimi është të trajtojë legjitimitetin procedural të përgjimit si direkt ashtu edhe indirekt te personave që kanë disa cilesi të vecanta, si psh përgjimi i avokatit, apo i personave që kanë imunitet. Analiza e kësaj teme lidhet me gjendjen aktuale të dispozitës, në raport me përmbajtjen e saj përpara se të ndërhyhej me ndryshimet e miratuara në vitin 2014, e cila lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me përgjimin e personave me imunitet.

Tema është punuar duke përdorur metodat klasike analitike, historike, logjike dhe atë krahasuese. Metoda e krahasimit ka gjetur përdorim të gjerë sidomos me sistemin italian.

Risia në këtë punim është nevoja e plotësimit me koperturë kushtetuese të procesit ligjor në fushën e përgjimeve të personave me cilësi të vecanta dhe përputhja e plotë me praktikën juridike të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, nëpërmjet propozimit të një procesi teknik të përmirësimit të dispozitave respektive në Republikën e Shqipërisë.

Fjalë kyçe: përgjim, provë, ligj procedural, avokat, prokuror.

HYRJE

Përgjimi si formulim juridiko penal në të drejtën penale ndërkombëtare ka qenë pjesë e pandashme e hetimit, i cili historikisht ka shërbyer si mjet i kërkimit të provës. Por edhe pse shtete të ndryshme kanë tradita të vlerësueshme në hartimin dhe perfeksionimin e ligjit vendor në lidhje me përgjimin, ato nuk kanë mundur të sigurojnë një trajtim të unifikuar të përgjimit si instrument penal në përputhje me të drejtat ndërkombëtare dhe, aktualisht nuk ekziston ndonjë Konventë, direktivë apo

akt i çfardo lloji me karakter ndërkombëtar për këtë qëllim. Kryesisht mardhëniet në fushën e përgjimit janë shkrirë në veprimet operacionale të hetimit ndërshtetëror të bazuara në marrëveshjet bilaterale ndërmjet shteteve respektive.

Mungesa e një akti ndërkombëtar në fushën e përgjimeve ka prodhuar për pasojë mungesën jo vetëm të një përkufizimi të saktë mbi përgjimet, por edhe për qëndrime institucionalisht të qëndrueshme dhe me karakter gjithpërfshirës në raport me kushtet dhe rrethanat konkrete të çdo vendi. Por vakuumi i krijuar nga mungesa e akteve ndërkombëtare në një farë mënyre plotësohet nga praktika e shteteve të veçanta në këtë fushë, ku padyshim vendin përcaktues e zë jurisprudenca e Komisionit Europian dhe ajo e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), e cila nëpërmjet praktikave të saj po orienton procesin e përgjimit drejt një qëndrimi të unifikuar, nëpërmjet të cilave nuk është e vështirë të konstatohet se përgjimi i komunikimeve në një shoqëri të konsoliduar përmbledh një kategori të mirëpërcaktuar veprimesh teknike që lidhen me mbikqyrjen, vëzhgimin, grumbullimin dhe përdorimin e të dhënave të fituara, ndaj individëve të veçantë në një realitet shoqëror të caktuar. Këto veprime bëhen akoma më komplekse në momentin që i drejtohen një kategorie të caktuar personash që gëzojnë disa cilësi të vecanta.

Në mënyrë të përmbledhur më poshtë do të paraqes disa koncepte në lidhje me përgjimet për këtë kategori të caktuar të shoqërisë, të cilat për shkaqe ligjore gëzojnë status të veçantë, në raport me publikun e gjërë.

1. Përgjimi i avokatit

Sikurse dihet, avokati, në ushtrim të profesionit, ka detyrim ligjor të ruajë konfidencialitetin e të dhënave që i janë besuar atij nga klienti i vet. Në këtë kuptim, çdo tentativë për të marrë dijeni të këtyre të dhënave të besuara në mënyrë konfidenciale, e kryer nga cilido subjekt, ligjor ose jo, me forma dhe mjete të ç'fardo lloji apo karakteri, e në mënyrë të veçantë me anë të ndërhyrjes nëpërmjet përgjimit dhe për shkak të ushtrimit të profesionit, duhet të konsiderohet si një ndërhyrje e paligjshme dhe e dënueshme nga legjislacioni penal. Normimi i një domosdoshmërie të tillë buron jo vetëm për shkak të ligjit organik mbi të cilin ushtrohet ky profesion, por është edhe një parim i përcaktuar në dokumente ndërkombëtare që rregullojnë ushtrimin e profesionit të avokatit. CCBE në dokumentat e saj strategjike ka përcaktuar se është me rëndësi të madhe për funksionin e avokatit, që atij t'i tregohen nga klienti gjëra të cilat klienti nuk duhet t'ia tregojë të tjerëve – detajet personale më intime apo sekretet më të rëndësishme të biznesit – dhe që avokati të jetë marrësi i informacionit mbi bazën e besimit. Pa pasur siguri mbi konfidencialitetin, nuk mund të ketë besim. Mbikëqyrja e konfidencialitetit nuk është vetëm detyrë e avokatit por edhe një e drejtë themelore e njeriut/klientit. Në disa juridiksione, e drejta e konfidencialitetit shikohet si “sekreti profesional”.

Ky është një parim universal i Kartës së Parimeve Themelore të Profesionit Ligjor Evropian, miratuar në Seancën Plenare të datës 25.11.2006, prej nga ku

burojnë detyrime të ndërsjella, nëpërmjet të cilave shprehet detyrimi negativ i avokatit, në drejtim të ruajtjes së sekretit të të dhënave, ndërkohë që, nga ana tjetër, buron detyrimi pozitiv i shtetit, i cili nëpërmjet normimit ligjor duhet të sigurojë garantimin për të ushtruar profesionin e avokatit nga çdo ndërhyrje e paligjshme.

Në këtë kuptim, ndërhyrja ndaj avokatit, në raport me kategoritë e tjera shoqërore, duhet të jetë e diferencuar në mënyrë të tillë, që të përcaktohen kritere të qarta ligjore me anë të cilave të bëhet diferencimi midis avokatit në ushtrim të profesionit dhe po atij avokati, si individ në shoqërinë civile. Ndërsa për shkak të kësaj të fundit, ai duhet t'i nënshtrohet rregullave të përgjithshme të shoqërisë dhe mund të jetë subjekt përgjimi për çdo lloj veprimtarie të dyshuar si antiligjore nga ana e tij, në funksion të ushtrimit të profesionit dhe në mardhëniet avokat-klient, mundësia e realizimit të përgjimit përjashtohet nëpërmjet akteve ligjore vendase apo ndërkombëtare. Në legjislacionin procedural në Shqipëri është përcaktuar drejt nëpërmjet dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, në të cilin dallimi në ndërhyrje në ushtrim të profesionit të avokatit lejohet në kushte dhe rrethana të tilla që lidhen para së gjithash me disa veprime paraprake procedurale. Kështu këqyrjet dhe kontrollimet në zyrën e avokatit lejohen vetëm në kushtet kur avokati është shpallur i pandehur dhe nuk lejohet përgjimi i bisedimeve ose i komunikimit të mbrojtësve dhe të asistentëve të tyre, as ndërmjet njëri-tjetrit dhe as me personat që ata mbrojnë. Njëkohësisht ligji parashikon ndalimin apo çdo formë kontrolli të korrespondencës ndërmjet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij. Rezultatet e këqyrjeve, të kontrollimeve, të sekuestrimeve, të përgjimeve të bisedave ose të komunikimit, të kryera në shkelje të dispozitave të mësipërme, nuk mund të përdoren.

Por, në fakt, legjislacioni procedural penal nuk mjaftohet vetëm me kufizimet e mësipërme në kuadër të ushtrimit të profesionit të avokatit, por, përkundrazi, ka parashikuar ruajtjen e sekretit profesional në dispozitat e tij edhe në drejtim të detyrimit për dhënien e dëshmisë. Kështu, në Kodin e Procedurës Penale thuhet se: *“Nuk mund të detyrohen të dëshmojnë për sa dinë për shkak të profesionit, me përjashtim të rasteve kur kanë detyrimin që t’ua referojnë autoriteteve proceduese... (përcaktohen disa kategori) si dhe avokatët, përfaqësuesit ligjorë dhe noterët”*¹. Inkorporimi i këtyre dispozitave në legjislacionin shqiptar i jep atij karakter solid, të qartë dhe efektiv, jo vetëm në drejtim të ekzistencës së ligjit, por, para së gjithash të përmbajtjes cilësore të tij.

Qëllimi i këtij trajtimi të veçantë në artikull lidhet me rrezikun që i kanoset sekretit profesional të avokatit prej përgjimeve në përgjithësi dhe atyre të jashtëligjshme në mënyrë të veçantë. Informacioni sekret i shkëmbyer ndërmjet avokatit dhe klientit, i cili rezulton nën regjimin e “çelësit” në zyrë, është lehtësisht i disponueshëm nëpërmjet mjeteve elektronike, në internet, nëpërmjet shërbimit

¹ Ligji nr. 7905 dt. 21.3.1995, i ndryshuar, K. Pr. Penale të Republikës së Shqipërisë, Pjesa e parë, neni 52, Garancitë për mbrojtësin.

“cloud”². Në prill të vitit 2014, Gjykata Europiane e Drejtësisë me seli në Luksemburg ka marrë një vendim të fortë dhe të paprecedent, nëpërmjet të cilit anulohet Direktiva e Ruajtjes së të Dhënave e vitit 2006, në mënyrë elektronike. Argumenti ligjor i anulimit të kësaj direktive ishte, se, *nëpërmjet kërkesës për ruajtjen e të dhënave nga ana e operatorëve elektronikë, krijohet akses i autoriteteve kombëtare për të ndërhyrë në këto të dhëna dhe jo vetëm kaq, por kishte burime të besueshme se këto të dhëna ishin përdorur nga qeveritë respektive*³. Pikërisht mbi këtë fakt, Bashkimi i Shoqatave Europiane të Avokatëve (CCBE) ka fokusuar qëndrimin e saj në drejtim të ushtrimit të trysnisë ndaj shteteve respektive, për hartimin e një legjislacioni efektiv, ku të fokusohet mbrojtje e sekretit profesional të komunikimeve avokat-klient.

Në të njëjtën linjë paraqitet situata edhe në raport me jurisprudencën e Strasburgut, nëpërmjet të cilës ajo shprehet se: *“Gjykata vëren se shtetet kontraktuese kanë pranuar ta zgjerojnë nocionin edhe në kuptimin e ambienteve të biznesit, i cili do të ishte plotësisht i pranueshëm me tekstin francez, se fjala banesë ka një kuptim më të gjerë. Si përfundim, - konkludon ajo, - ka pasur një ndërhyrje në jetën private të ankuesit (ankuesi ishte në ushtrim të profesionit të avokatit) në rastin kur telefoni nën përgjim mbulonte si thirrjet telefonike private, ashtu edhe ato për shkak të profesionit”*⁴.

Edhe pse jurisprudenca europiane pranon faktin e pamundësisë ligjore të përgjimit të avokatit, për shkaqe që lidhen me ushtrimin e profesionit, praktika legjislative e saj nuk e ka parashikuar qëndrimin e organeve ligjzbatuese të përgjimeve në raport me të dhënat rastësore të përfituara nga komunikimi i avokatit me klientin e vet, në kushtet kur klienti gjendet nën regjimin e përgjimit. Për ta shprehur edhe më qartë, kërkohet, cila duhet të jetë qasja ligjore me të dhënat e përfituara në mënyrë indirekte nga një përgjim i ligjshëm që është realizuar ndaj një personi nën hetim, gjatë kontrollit të bisedës së këtij të fundit me avokatin e tij, të dhëna këto të cilat mund të krijojnë rrethana hetimi edhe në lidhje me përfshirjen e avokatit në një krim, pavarësisht se biseda është përgjuar në kushtet e ushtrimit të detyrës së avokatit. Gjendemi përpara rastit të klasifikimit në grupin e personave të cilësuar sipas pikës 4 të nenit 221 të Kodit të Procedurës Penale, në të cilin thuhet se: *“Rezultati i përgjimit është i vlefshëm për të gjithë komunikuesit”*.

Nga ana tjetër, neni 52 i K.Pr.Penale përcakton detyrimin e ndalimit të përgjimit të bisedimeve ose i komunikimit të mbrojtësve dhe të asistentëve të tyre, as ndërmjet njëri-tjetrit dhe as me personat që ata mbrojnë. Ndalohet çdo formë

² “Cloud” është shërbim hostimi (ruajtje), ku kompani të ndryshme që ofrojnë këtë shërbim e përdorin për të ruajtur në internet materiale të ndryshme. Serverët e “Cloud” janë virtualë dhe ndodhen në shtete të ndryshme

³ <http://curia.europa.eu/juris/fiche.jsf>, çështje të lidhura C-293 dhe C-594/12, datë 8 prill 2014.

⁴ Vendimi i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, Strasburg datë 16 dhjetor 1992, Niemietz kundër Gjermanisë, kërkesa nr. 13710/88.

kontrolli e korrespondencës ndërmjet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, si dhe rezultatet e këqyrjeve, të kontrollimeve, të sekuestrimeve, të përgjimeve të bisedave ose të komunikimit, të kryera në shkelje të dispozitave të mësipërme, nuk mund të përdoren.

Situata juridike në kushtet e kapjes së komunikimeve të avokatit me klientin e vet, i cili gjendet nën regjimin e përgjimit, paraqitet e tillë, që kërkon interpretim juridik vetëm në dy drejtime: e para, rezultatet e përgjimit duhet të konsiderohen të përdorshme në referim të nenit 221/4 të K. Pr. Penale dhe, e dyta, rezultatet e përgjimit nuk mund të kenë vlerë procedurale si më lart, pasi bien ndesh me nenin 52 të K. Pr. Penale. Në çdo rast, referimi i njërës dispozitë na çon detyrimisht në kundërshtim me dispozitën tjetër. Duke qenë se edhe praktika e Gjykatës së Lartë nuk e ka trajtuar rastin për të krijuar modele unifikuese, por as si rast të veçantë nëpërmjet trajtimit të të cilit të mund të krijohej një praktikë gjyqësore me argumente në favor të njërës apo tjetrës zgjidhje, atëherë nuk është e vështirë të konkludohet, se kualifikimi ligjor i pranimit dhe përdorimit të rezultateve në rastin e improvizuar do të jetë ekskluziviteti tërësor i gjykatës së shqyrtimit gjyqësor.

Personalisht mendoj, se situata ligjore duhet të vlerësohet në favor të vlefshmërisë së përdorimit të rezultateve të përfituara nga një përgjim indirekt, pasi fryma e dispozitës i referohet mbrojtjes së të drejtave të avokatit në ushtrim të profesionit të tij. Në çfarëdolloj rrethanash të zbulohet veprimtaria antikushtetuese dhe antiligjore e një personi dhe, në këtë kuptim, edhe e avokatit, ushtrimi i profesionit nuk mund të përdoret si mburojë për fshehjen apo aq më keq për pjesëmarrjen në këtë veprimtari, prandaj dhe të dhënat përgjuese që inkriminojnë avokatin nuk mund dhe nuk duhet të klasifikohen si të papërdorshme me justifikimin e ushtrimit të profesionit. Një konkluzion i tillë përputhet plotësisht edhe me dispozitat që rregullojnë ushtrimin e profesionit të avokatit në ligjin specifik, në të cilat në asnjë rast nuk parashikohet abuzimi me detyrën apo veprimtaritë antiligjore dhe antikushtetuese si veprimtari legjitime e avokatit. Korrektësia dhe shërbimi ndaj klientit, si një detyrim ligjor, në asnjë rast nuk mund të kërkojnë rreshtimin e avokatit në anën e krimit, apo aq më keq të bëhet pjesë e tij.

2. Përgjimi i personave me imunitet

Me shumë interes paraqitet situata edhe në rastin e trajtimit të përgjimit për kategoritë e individëve që gëzojnë cilësi të veçanta dhe imunitare për shkak të ligjit. Duke qenë se përgjimi është pjesë operationale e pandarë e procedimit penal, krahas trajtimit të problemit në aspektin teknik të procesit, analiza duhet të marrë në konsideratë edhe veçoritë që parashikon legjisllacioni procedural në trajtimin e kësaj kategorie funksionarësh publikë.

2.1. Përgjimi i drejtpërdrejtë i personave me imunitet

Legjisllacioni procedural i referohet personave me imunitet si subjekte të hetimit paraprak, nëpërmjet dispozitës përkatëse, e cila parashikon trajtim të diferencuar

nga pikëpamja procedurale në krahasim me personat e tjerë. *Prokurori dhe policia gjyqësore zhvillojnë, brenda kompetencave të caktuara, hetimet e nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale. Për veprat penale që gjykohen në Shkallë të Parë nga Gjykata e Lartë, procedohet nga Prokuroria e Përgjithshme*⁵. Duke e analizuar këtë dispozitë në raporte simetrike me qëllimin e shprehur në të, lehtësisht konstatojmë të drejtën e organit procedues të përfaqësuar nga prokurori për të ushtruar ndjekjen penale si rast i përgjithshëm dhe, njëkohësisht, edhe mungesa e kompetencës së tij në hetimin e personave që akuzohen për vepra penale me *juridiksion fillestar Gjykatën e Lartë*.

Nga këndvështrimi teknik legjislativ, mendoj se formulimi i kësaj dispozite të krijon perceptimin e gabuar se kompetencat e gjykimit në Gjykatën e Lartë orientohen nga kritere juridiksionale të kualifikimit të veprës penale, kur shprehet *për veprat penale...*, por në fakt nuk është ashtu. Kualifikimi i veprës, në një procedim penal është i njëjtë si për çdo person ashtu edhe për personat që gëzojnë imunitet për shkak të ushtrimit të funksioneve që parashikohen sipas përcaktimeve të Kodit Penal, por cilësimi juridik në dispozitën referenciale është përcaktimi i dallimit vetëm në funksion të subjekteve dhe *vetëm për shkak të funksioneve publike* që ata kryejnë, kur përcakton se, *Gjykata e Lartë gjykon në Shkallë të Parë, me trup gjyqësor të përbërë nga 5 gjyqtarë të caktuar me short, veprat penale të kryera nga Presidenti i Republikës, deputetët, Kryeministri dhe anëtarët e Këshillit të Ministrave, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, kur këta janë në këto funksione në kohën e gjykimit*⁶.

Në raport me këtë cilësim juridik, dispozita është në harmoni të plotë me kompetencën e hetimit të kësaj kategorie subjektsh si autoritet procedues, që është Prokuroria e Përgjithshme, sikurse edhe është ligjore që kërkesa për fillimin e ndjekjes penale në ngarkim të tyre mund të firmoset vetëm nga Prokurori i Përgjithshëm. Në kushtet normale të interpretimit të ligjit në frymë dhe në gërmë, duke qenë se provat të cilat përfaqësojnë njoftime mbi faktet dhe rrethanat që lidhen me veprën penale, mbliidhen në lidhje me procedurat e përcaktuara në legjisacionin procedural penal, edhe përgjimi si mjet i sigurimit të provës duhet të shërbejë si i tillë edhe në rastin e parashikuar të ndjekjes penale për personat e cilësuar në dispozitë. Atëherë, prej këtej buron edhe fakti procedural i pranimit të ushtrimit të përgjimit ndaj personave me imunitet, me ndryshimin që e drejta për bërjen e kërkesës dhe marrjen e vendimit për lejimin e përgjimit nuk do të ushtrohet më nga prokurori dhe nga gjyqtari i hetimit paraprak, por në vend të tyre ligji autorizon përkatësisht Prokurorin e Përgjithshëm dhe Gjykatën e Lartë. Ky fakt

⁵ Ligji nr. 7905 dt. 21.3.1995, i ndryshuar, K. Pr. Penale të Republikës së Shqipërisë, Pjesa e dytë, Titulli VI, Hetimet paraprake, Kreu I, Dispozita të përgjithshme, neni 227/1/3, Organet e ngarkuara për hetimet paraprake.

⁶ Ligji nr. 7905 dt. 21.3.1995, i ndryshuar, K. Pr. Penale të Republikës së Shqipërisë, Pjesa e parë, Titulli II, Juridiksioni dhe Kompetencat, Kreu II, Kompetencat, Seksioni I, Kompetenca lëndore, neni 75/b, Kompetencat e Gjykatës së Lartë.

bëhet më i konsoliduar duke iu referuar përcaktimit në dispozitë të kompetencave të prokurorit, në lidhje me hetimin paraprak, kur shprehet se *prokurori dhe policia gjyqësore zhvillojnë, brenda kompetencave të caktuara, hetimet e nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale*. Dhe përgjimi si institut penal nuk mund të përjashtohet nga procedimi penal në tërësi, si një instrument i rëndësishëm për sigurimin e provës dhe, si i tillë, brenda këtij paragrafi të ligjit përfshihet edhe detyrimi për të ushtruar proceduralisht përgjimin ndaj çdo personi, pa dallime të cilësuar në ligj, por gjithmonë mbi kompetenca të autoriteteve të përcaktuara në mënyrë të qartë.

Por situata juridike, nuk duhet vlerësuar vetëm nëpërmjet leximit të thjeshtëzuar të ligjit, por, para së gjithash, ky vlerësim duhet të jetë pasojë logjike në raport me mjetet dhe mënyrat që hartuesit e tij kanë përdorur në funksion të rritjes së efikasitetit të funksionimit të ligjit. Dhe e parë në këtë vështrim, veprimet e procedimit, përfshirë në të edhe ato për realizimin e përgjimit në ngarkim të personave me imunitet, përveç kushteve të përgjithshme standard që duhet të respektohen në një proces rutinë, për rastin e personave të cilësuar për shkak të imunitetit që ata gëzojnë, ligji parashikon garanci shtesë procedurale për dhënien e autorizimit nga ana e organeve kushtetuese të përcaktuara në të. Kërkesa e organit procedues për një autorizim të tillë bazohet mbi kriterin motivues të ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm të mbështetur në prova, si dhe kur ekzistojnë kushtet ligjore të përcaktuara në K. Pr. Penale në lidhje me arrestin apo kufizimin e lirisë në çfarëdo formë të saj. Por, ajo që është e rëndësishme, lidhet me faktin se asnjë veprim procedural nuk mund të lejohet pa lëshimin e autorizimit, madje edhe arresti në flagrancë kërkon marrjen e autorizimit, me kushtin që ky autorizim të lëshohet brenda afatit të vlerësimit të masës së sigurimit. *“Deri në dhënien e autorizimit, për personat e parashikuar në nenin 288 nuk lejohet arrestimi ose heqja e lirisë në çfarëdolloj forme, ushtrimi i kontrollit personal ose të banesës, pa autorizimin e organit përkatës”*⁷.

Pezullimi i veprimeve të procedimit të parashikuara nga kjo dispozitë, në kushtet e mungesës së autorizimit, sjell pasoja që lidhen me procedimin penal në terma të përgjithshëm dhe, si pjesë e këtij procedimi, ligji në mënyrë shteruese kondicionon si veprime jo ligjore heqjen e lirisë në çdo formë, si dhe kontrollin personal ose të banesës të personave me imunitet. Pra, asnjë veprim tjetër procedural përveç këtyre cilësimeve specifike të shprehura në dispozitë nuk mund të inkludohet në pasojat që prodhohen, për shkak të mungesës së autorizimit, duke cilësuar këtu posaçërisht edhe për shkak të qëllimit të analizës, veprimet procedurale që lidhen me përgjimin e tyre.

⁷ Ligji nr. 7905 dt. 21.3.1995, i ndryshuar, K. Pr. Penale të Republikës së Shqipërisë, Pjesa e dytë, Titulli VI, Hetimet paraprake, Kreu III, Kushtet e procedimit, neni 289/1, Ndalimi për të kryer veprime.

Në vijim të argumentit të mësipërm, doja të fokusoj analizën time edhe në lidhje me gjendjen aktuale të dispozitës, në raport me përmbajtjen e saj përpara se të ndërhyhej me ndryshimet e miratuara në vitin 2014, e cila lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me përgjimin e personave me imunitet. Dispozita referuese përpara ndryshimeve të vitit 2014, kishte në formulim të saj pezullimin e veprimeve proceduese, madje të shprehur në mënyrë eksplicite, edhe përgjimin, krahas heqjes së lirisë dhe kontrollit personal dhe të banesës. *Deri në dhënien e autorizimit për të proceduar, nuk lejohet ndalimi, caktimi i masave të sigurimit, kontrollimet, këqyrja e personit, njohja, ballafaqimi dhe përgjimi i bisedimeve ose i komunikimit ndaj personit për të cilin kërkohet autorizimi. Ai mund të merret në pyetje vetëm nëse e kërkon vetë.* Kjo ka qenë përmbajtja e dispozitës, deri përpara këtyre ndryshimeve. Riformulimi i dispozitës nëpërmjet së cilës është shfuqizuar togfjalëshi *dhe përgjimi i bisedimeve ose i komunikimit ndaj personit për të cilin kërkohet autorizimi*, mund të vlerësohet vetëm nëpërmjet dy argumenteve bazë që janë:

- Së pari, duke qenë se në dispozitat e K. Pr. Penale që i referohen procedimeve penale në ngarkim të personave me imunitet, në asnjë rast nuk gjendet i përdorur tekstualisht termi *përgjim* dhe përdorimi i tij në një dispozitë kufizuese, pa u përdorur më parë në një dispozitë lejuese, do të përbënte nonsens juridik. Në funksion të argumentit, ligjvënësi, ose do të ndërhynte në dispozitat përkatëse të K. Pr. Penale që trajtojnë përgjimin, duke përcaktuar kushtet e lejimit të përgjimit ndaj personave imunitarë, ose do të hiqte nga dispozita referuese përgjimin, si cilësim të veçantë. Me sa duket, ligjvënësi e ka parë më të arsyeshme të ndërhyjë në ndryshimin e dispozitës, në raport me arsyetimin e dytë dhe duke qenë se justifikimi i mësipërm ka karakter ligjor, nuk duhet të konsiderohet ndërhyrje jo efektive.

- Së dyti, ndërhyrja në dispozitë nëpërmjet mospërfshirjes së përgjimit në të, duhet të trajtohet në kuptimin konceptual dhe që merr kuptim të motivuar nga një fakt tjetër i rëndësishëm juridik, sipas të cilit ligjvënësi nuk ka qenë dakord që kufizimet procedurale të përcaktuara në rastin e mungesës së dhënies të autorizimit duhet të përfshijnë edhe përgjimin, duke i krijuar kështu hapësirën e nevojshme ligjore të procedimit nëpërmjet institutit penal të përgjimit, në kushtet e mungesës së autorizimit.

Në lidhje me të dy këto komente të mospërfshirjes së përgjimit në kufizimet e përcaktuara në dispozitën përkatëse, qëndrimi im orientohet drejt prirjes për të pranuar më tepër arsyetimin e parë në raport me këtë të dytin. Kjo për faktin se në rastin e parë, ka një shkak ligjor, i cili krijon *non sens*, në kuptimin që duke qenë se përgjimi si instrument penal nuk është cilësuar specifikisht në procedimin penal të personave që gëzojnë imunitet të veçantë për shkak të funksionit të tyre, edhe në të kundërt, nuk duhet të ketë asnjë dispozitë tjetër që ta ndalojë një normim juridik i cili nuk ekziston. Dhe, në këto kushte, procesi i përgjimit funksionon dhe luan rolin e vet procedural normalisht rast pas rasti, gjithnjë duke respektuar hierarkinë e ligjit. Duke dashur që njëkohësisht të realizoj edhe oponencën e argumentit që

sapo thashë, do t'i krijoj hapësirën e vet edhe për oponencë negative, për faktin që, dispozita ka kufizuar dy elemente thelbësorë që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kufizimin e jetës private të individit, duke iu referuar një kategorie të veçantë juridike sikurse janë kufizimi i lirisë dhe kontrolli vetjak dhe i banesës i personave me imunitet. Duke qenë se edhe përgjimi ka po të njëjtat vlera në ndërhyrjen e jetës private si dy elementët e cilësuar më lart dhe që mbeten në hapësirën që përcakton dispozita e ndryshuar, arrihet në konkluzionin, se ligjvënësi nuk ka pasur qëllim respektimin e të drejtave dhe lirive të personave me imunitet. Si përfundim, heqja e përgjimit nga kategoria e elementëve që i nënshtrohen kufizimit në mungesë të autorizimit, mund të konsiderohet si një veprim që buron për shkak të mos ekzistencës së këtij elementi dhe jo për shkak të rëndësisë që mbart ky element.

Ndërsa, rasti i dytë i argumentit justifikues, nëpërmjet të cilit me koshiençë ligjvënësi e ka parë të arsyeshme, se përgjimi si proces duhet t'i nënshtrohet rrjedhës normale në një procedim penal mbart mbi vete ngarkesën e kufizimeve për shkaqe ligjore, në kuadër të kufizimeve të përgjithshme që karakterizojnë fillimin e një procedimi penal ndaj një personi me imunitet të cilësuar.

Principet bazë të edukimit eksperimental⁵ u zhvilluan nga Deëey⁶ dhe profesorë të tjerë amerikanë dhe europianë, të cilët argumentuan se edukimi përveçohet përmes eksperiencës duke vendosur në praktikë njohuritë, dhe jo përmes memorizimit të teorisë. Kësisoj, fokusi i edukimit qëndron midis studentit dhe të mësuarit, dhe jo midis profesorit dhe mësimit. Rrjedhimisht, nëse studentët janë të vullnetshëm dhe të përgjegjshëm, ata do të mësojnë, dhe nga ana tjetër, profesorët i kushtojnë më pak vëmendje teorisë, dhe më shumë udhëzimit, krijimit të mundësive e mjeteve për të aftësuar studentët. Së dyti, eksperiencia është e ndërthurur me veprimtarinë e përditshme jetësore, në të cilën ndërveprojnë dimensionet sociale, politike, e morale të edukimit. Dewey u përqëndrua në zhvillimin dhe aplikimin e edukimit për të gjithë shoqërinë, pasi ai besonte se të gjithë qytetarët, dhe jo vetëm elita e shoqërisë, ka të drejtë për një ‘jetë të mendjes’. Kështu, principi i tretë bazohet në dimensionin social, pasi individi është qenie sociale i cili duhet të ndërveprojë me shoqërinë, ndaj dhe metoda më e mirë e edukimit është ajo që

³ Vance W.R., Proceedings of Section of Legal Education, 1914, ABA ANN. REP. 804

⁴ Reimann Mathias, The Progress and Failure of Comparative Law in the Second Half of the Twentieth Century, 50 Am. J. Comp. L. 671, 685 (2002).

⁵ Webb Julian, Where the Action Is: Developing Artistry in Legal Education, 2 Int’l J. Legal Prof. 187, 190-191 (1995).

⁶ Wizner Stephen & Curtis Dennis, “Here’s What We Do”: Some Notes About Clinical Legal Education, 29 Clev. St. L. Rev. 673 (1980)

mundëson edukimin në një kontekst kolektiv. Ndërsa dimensionimi moral i referohet zhvillimit të ndërgjegjjes dhe përgjegjësisë së përkujdesjes për të tjerët, kryesisht për grupet më vulnerabel të shoqërisë, me qëllimin për të përmirësuar jetesën e tyre. Së fundmi, dhe mbase principi më i rëndësishëm, ngrihet mbi faktin se edukimi nuk është një hallkë e fundit, por një proces, dhe institucionet arsimore janë vetëm fillimi i një procesi jetësor të edukimit të studentëve mbi njohuritë ekzistente, duke i dhënë studentit aftësinë për të zgjidhur të panjohurat. Këta pesë komponentë mundësojnë aplikimin e edukimit ligjor përtej metodave klasike të mësimdhënies bazuar në tekste teorike.

Teoria e Dewey ishte një teori që fokusohet tek praktika, ndërsa teoria e analizimit të çështjeve ligjore e Langdell fokusohet kryesisht tek mendimi kritik, por ndërthurja e të dy filozofive të edukimit ndihmoi në balancimin e programeve dhe kurseve të edukimit ligjor në klinikat e para të ligjit në SHBA, nga të cilat morën shembull dhe u krijuan klinikat ligjore në sistemin ligjor të civil law.

2. Aplikimi i Klinikës së Ligjit në sistemet ligjore, në fushën penale

Programi ideal i Klinikës së Ligjit, parë në këndvështrimin e sistemit common law, do të përfshinte vlerësimin e studentit për pjesëmarrjen (nëpërmjet akordimit të krediteve të lëndës), ofrimi i shërbimeve ligjore nga studentët për klientë konkrete me probleme reale ligjore, klientët të cilët përfitojnë nga programi, janë realisht individë të cilët nuk mund të përballojnë shpenzimet e një përfaqësimi ligjor, studentët duhet të vëzhgohen dhe udhëzohen nga një praktikant i licensuar i ligjit, dhe çështja ligjore e cila do të trajtohet nga studentët duhet të mbështetet me materiale doktrinale ose studentët të kenë njohuri të mjaftueshme ligjore, të arrira përmes ndjekjes së një programi tjetër edukues mbi ligjin.

Një ndër objektivat kryesorë të Klinikës së Ligjit është ofrimi i asistencës ligjore. Pavarësisht modelit të klinikës së ligjit, e cila mund të jetë një klinikë e ndërtuar sipas modelit individual, pra një klinikë ligji private, e ngritur nga student dhe profesionistë të ligjit, apo një klinikë ligji e ndërtuar në strukturën e shkollës së ligjit dhe integruar në programet educative ligjore, një ndër programet më shpesh të aplikuara, është programi pro-bono. Edhe pse edukimi klinik ligjor përfshin disa projekte të ndryshme edukimi, asistencë ligjore është një ndër më të rëndësishmet, për vetë natyrën dhe qëllimin e saj.

Në këtë aspekt, Klinika e Ligjit, në sistemin common law, shihet kryesisht si një projekt, proces apo metodë aftësimi në praktikë⁷, angazhuese për studentët pjesëmarrës, dhe jo domosdoshmërisht si një kurs i veçantë, i cili mund të përmbajë dhe programe apo projekte të tjera.

⁷ Backman James, Externships and New Lawyer Mentoring: The Practicing Lawyer's Role in Educating New Lawyers, 24 BYU J. Pub. L. 65 (2009)

Në SHBA, Klinika e Ligjit vepron si një program në të cilin, studentët pjesëmarrës, angazhohen në praktikimin e ligjit përmes trajtimit të çështjeve ligjore konkrete. Organizatat jo-qeveritare dhe institucionet shtetërore mund të 'punësojnë' pa pagesë, për një periudhë të kufizuar kohore, disa studentë të klinikës së ligjit, për të kryer hulumtimet mbi çështje ligjore konkrete dhe aktuale. Studentët kryesisht realizojnë kërkimin ligjor, përgatisin dokumentat ligjore, mund të kontaktojnë klientët, etj. Të gjitha veprimet dhe iniciativat e studentëve konsultohen dhe korrigjohen me profesorët e klinikës, të cilët janë praktikantë të licensuar të ligjit. Ky lloj sistemi i shërben si institucioneve shtetërore dhe organizatave, të cilat nga njëra anë shmangin kostot e larta të shpenzimeve për një profesionist të ligjit (përsa i përket shqyrtimit të çështjes ligjore, kërkimit ligjor, përgatitjes së dokumenteve, referimeve, etj), dhe gjithashtu u shërben studentëve në aftësimin praktik⁸. Sistemi ligjor i SHBA, u mundëson studentëve të përfaqësojnë klientët e tyre në gjykatë, nëse ata aplikojnë dhe u akordohet 'bar card'. Megjithatë, kjo praktikë nuk ndiqet në cdo shkollë të ligjit, në disa shtete si Texas apo Virgjinia, studentit duhet t'i akordohet karta e avokatisë për të përfaqësuar klientin në rolin e një avokati, duke përmbytur të gjitha funksionet e avokatit, ndër në shtete të tjera, mjafton pranimi i studentit në rolin e avokatit nga trupi gjykues i çështjes ligjore konkrete. Mundësia e përfaqësimit nga studenti vlerësohet në varësi të çështjes ligjore, dhe edhe pse student mund të luajë rolin e avokatit në seancat gjyqësore, ai në mënyrë absolute nuk mund të firmosë asnjë document apo akt ligjor, këto janë veprime që do të realizohen nga vetë person i përfaqësuar dhe nga avokati i licensuar që mbikëqyr studentin. Institucionet apo firmat private ligjore, nuk mund të punësojnë studentë të ligjit, në kuadër të veprimit të klinikës së ligjit.

Ndërsa në aplikimin e edukimit klinik ligjor në sistemin civil law⁹, shkollat e ligjit e shohin klinikën e ligjit si një program edukimi mbi ligjin, i cili aplikohet dhe zhvillohet si një kurs lëndor i veçantë. Disa prej shkollave të ligjit aplikojnë metodën e zhvillimit të seminareve¹⁰, në të cilat mund të trajtohet teoria dhe raste praktike¹¹, disa të tjera aplikojnë si kurs të veçantë analizimin dhe zhvillimin e çështjeve ligjore konkrete¹², ndërsa shkolla të tjera të ligjit aplikojnë kurse të cilat referohen si 'metoda mësimdhënies bazuar në zgjidhjen e problemeve'¹³.

⁸ Wizner Stephen, The Law School Clinic: Legal Education in the Interests of Justice, 70 Fordham L. Rev. 1929 (2002)

⁹ Abel Richard I., Lawyers in the Civil Law World, Richard I. Abel & Philip S.C. Lewis eds. 1988

¹⁰ Belgjika, Republika Ceke, Greqia, Hungaria dhe Turqia

¹¹ Wilson Richard J., Training for Justice: The Global Growth of Clinical Legal Education, 22 Penn. St. Int'l L. Rev. 421 (2004)

¹² Belgjikë, Hungari, Portugali, Zvicër, Turqi dhe Venezuelë

¹³ "Problem-based learning", aplikuar në disa prej shkollave të ligjit në Belgjikë, Greqi dhe Turqi

Referuar aplikimit të asistencës ligjore, në kuadër të klinikës së ligjit, sistemi i civil law, nuk u krijon mundësi studentëve të ligjit, të përfaqësojnë klientët e klinikës së ligjit në gjykatë. Megjithatë, praktika e ndjekur në shqyrtimin e çështjeve konkrete ligjore, me klientë konkretë, aplikohet edhe në shkollat e ligjit të këtij sistemi ligjor. Kryesisht, janë vetë individët vulnerabel të shoqërisë, të cilët absolutisht nuk mund të mbulojnë shpenzimet e përfaqësimit ligjor, që i drejtohen klinikës së ligjit për asistencë ligjore. Gjithashtu, ekziston dhe mundësia që vetë gjykata, në rastet kur individit nuk mund të përballojë shpenzimet e përfaqësimit dhe lind nevoja për caktimin e një mbrojtësi, i drejtohet Klinikës së Ligjit për të përzgjedhur studentët të cilët do të merren me shqyrtimin e çështjes ligjore.¹⁴

Në rastet e marrjës përsipër të një çështje ligjore konkrete, studentët e klinikës së ligjit, janë përgjegjës për cdo akt ligjor që përpilojnë, si dhe për mbarëvajtjen e çështjes, pavarësisht se veprimet e tyre konsultohen dhe mbikëqyren nga profesorët apo një avokat i licensuar. Përgjithësisht, prirja është të merren në duar çështje të cilat kanë një kohëzgjatje relativisht të shkurtër¹⁵ në mënyrë që të trajtohen nga i njëjti grup studentësh nga fillimi në fund. Por pavarësisht kësaj, në rast se çështja shtrihet përtej periudhës së shkollimit dhe pjesëmarrjës së studentit te programi i klinikës, çështjen më pas e marrin përsipër studentët e rinj të klinikës së ligjit, të cilët njihen më të gjitha detajet e procesit të zhvilluar deri në atë moment, dhe domosdoshmërisht do të ndjekin të njëjtën linjë logjike si kur nisi trajtimi i çështjes. Kryesisht, çështjet ligjore që referohen tek Klinika e Ligjit janë çështje të dhunës në familje, lidhur me marrjen e urdhrit të mbrojtjes, nisjen e një procesi divorci, por edhe çështje të tjera penale, të cilat vlerësohen të përshtatshme dhe efektive të trajtueshme nga studentët e klinikës, duke mbajtur parasysh zgjatjen e programit të klinikës, dhe mundësinë e përkushtimit të duhur e angazhimit të studentëve, në raport me kurse e aktivitete të tjera edukative.

Çështjet ligjore të vogla¹⁶, të cilat zakonisht përfshijnë një klient, për të cilin rezultatet e çështjes kanë një vlerë të rëndësishme personale, janë çështje të cilat i shërbejnë më mirë studentit të klinikës së ligjit për të ndërtuar marrëdhënien avokat-klient. Pra, nëse profesorët e klinikës i japin prioritet edukimit mbi aftësi që mund të fitohen vetëm nga përballja me klientë të vërtetë, merr rëndësi trajtimi i këtyre çështjeve dhe krijimi i mundësive të vendosjes së marrëdhënieve profesionale midis studentëve dhe klientëve të klinikës, mundësi të cilat nuk mund të gjehen në

¹⁴ White Lucie E., The Transformative Potential of Clinical Legal Education, 35 Osgoode Hall L.J. 635 (1997)

¹⁵ Marshall John, How much clinic for how many students? Examining the decision to offer clinics for one semester or an academic year, Law Journal, 2011

¹⁶ Maurer Nancy M., Handling Big Cases in Law School Clinics, or Lessons from my Clinic Sabbatical, 9 Clinical L.Rev. fq. 879 (2003)

kurrikula të tjera educative, dhe aftësi që mund të përfitohen ekskluzivisht vetëm nga programi pro-bono i Klinikës së Ligjit.

Duke marrë parasysh se në sistemin civil law, Klinika e Ligjit është një program i elaboruar në një kurs të veçantë të edukimit ligjor, dhe përgjithësisht i shtrirë në një semester shkollor, çështje të fushës penale janë më lehtë të ezaurueshme në një kohëzgjatje të shkurtër, dhe gjithashtu, u jep mundësi studentëve të fokusohen në një spektër të drejtash e veprash penale, duke realizuar më së mirë objektivin kryesor të klinikës, atë të praktikimin të ligjit.

Pavarësisht mënyrës së aplikimit të edukimit klinik ligjor, dhe përtej sistemit ligjor, praktika e klinikës së ligjit, nuk mund dhe nuk duhet të mundësojë vetëm “ushtrime vëzhgimi”¹⁷, gjatë të cilave studentët ndjekin zhvillimin e një seance gjyqësore, duke mbetur esencialisht pasiv. Pikërisht dritarja e bashkëpunimit me klientin konkret dhe trajtimin e çështjeve konkrete, është ajo që e bën Klinikën e Ligjit një kurs edukimi ligjor të domosdoshëm dhe e vecon nga kurse të tjera edukimi të cilat mund të ofrojnë vetëm ‘ushtrime vëzhgimi’. Kjo lloj metode nuk mund të kualifikohet si eksperiencë dhe aplikim i klinikës ligjore, pasi nuk përlligj objektivat dhe filozofinë e klinikës së ligjit si një program që kërkon domosdoshmërisht angazhimin dhe pjesëmarrjen aktive të studentit.

3. Projekte të tjera të Klinikës së Ligjit në fushën penale

Klinika e Ligjit është krijuar në vitin 2011 në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, si një lëndë që synon edukimin e studentëve të ligjit, jo vetëm në aspektin teorik, por kryesisht në aspektin praktik. Edukimi klinik ligjor është një metodë e re mësimdhënie në Shqipëri, nëse e krahasojmë me universitete të tjera në botë, e megjithatë ka rezultuar e suksesshme dhe efektive në aftësimin e studentëve të drejtësisë përsa i përket aplikimit në praktikë të normave ligjore.

Klinika përfshin në programin e saj metoda interaktive mësimdhënie si dhe praktika të mësimdhënies të cilat u shërbejnë studentëve të ligjit duke i aftësuar ata të aplikojnë teorinë e përthithur nga materiale të shkruara, në praktikë. “Street law” është një nga metodat praktike të implementuara në edukimin klinik ligjor, i njohur ndryshe edhe si “E drejta e aplikuar në rrugë”.

Edukimi klinik ligjor, nëpërmjet “Street law”, përveç fokusit në aftësimin praktik të studentëve të ligjit, gjithashtu fokusohet edhe në informimin e shoqërisë mbi tema të ndjeshme sociale.

Një nga mënyrat si klinika e realizon këtë qëllim është referimi mbi një tematikë të caktuar në shkollat e mesme të përzgjedhura. Studentët e klinikës përgatisin një prezantim mbi një temë të caktuar, të cilin e referojnë më pas në klasat e shkollave të mesme. Prezantimi përmban njohje me aktet ligjore në fuqi,

¹⁷ Maxeiner James R., Integrating Practical Training and Professional Legal Education, in The Internationalization of Law and Legal Education, fq. 37 (Jan Klabbbers & Mor-timer Sellers, eds. 2008)

njohje me koncepte të ndryshme në aspektin ligjor dhe social, njohje me mënyrat dhe mjetet të aksesueshme nga publiku i gjerë për të raportuar një rast apo për t'a ndjekur një çështje në rrugë ligjore.

Mënyra e zhvillimit të kësaj ore të "Street law" nuk konsiston vetëm në një referim projekti të studentëve të ligjit, por edhe në mirëpritjen e pyetjeve nga nxënësit e shkollave të mesme, të cilët kanë kuriozitet mbi një problem të caktuar, shfaqin paqartësi, apo presin përgjigje më të plota dhe të kuptueshme mbi rastet konkrete që i kanë prekur ata.

Studentët e klinikës synojnë që të informojnë nxënësit edhe në aspektin social apo psikologjik duke marrë në konsideratë mentalitetin dhe arsyen për të cilën një fenomen problematik për shoqërinë mbetet i tillë pavarësisht ndryshimeve apo zhvillimit në aspekte të ndryshme shoqërore. Por, gjithnjë, synimi kryesor i studentëve të ligjit nuk i largohet njohjes së nxënësve të shkollave të mesme me ligjin, mënyrën e aplikimit të ligjit dhe si mund të trajtohet fenomeni duke u bazuar në ligjin konkret. Gjithashtu, studentët e klinikës ofrojnë ndihmën dhe njohuritë e tyre duke referuar numra kontakti për nxënësit, apo duke i referuar ata në shoqata e fondacione të cilat kanë si qëllim ndihmesën e shtresave të ndryshme të popullsisë mbi fenomene shqetësuese shoqërore, pasi studentët e klinikës e kuptojnë se jo gjithnjë ndjekja e një situatë në rrugë ligjore është zgjidhja e menjëhershme dhe e duhur e problemit.

Projekti i "Street law" filloi të aplikohet për herë të parë më 15 Shkurt 2015. Një nga temat e para të prezantuara tek nxënësit e shkollave të mesme dhe më konkretisht në gjimnazin "Sami Frashëri" ishte tema e dhunës në familje dhe krimit mjedisor. Në këtë projekt të parë, u angazhuan 14 studentë të klinikës së ligjit, të cilët studionin në masterin shkencor penal, viti i dytë. Projektet pasardhëse trajtuan tema të tjera si korrupsioni dhe aksesit në drejtësi.

Një tjetër projekt i aplikuar nga Klinika e Ligjit në fushën penale, është gjyqi imitues. Gjyqi imitues është një ndër projektet e klinikës së ligjit, i aplikuar qysh në fillimet e edukimit klinik ligjor, pasi bazohet në filozofinë e analizimit dhe referimit të çështjeve ligjore, por me një element të shtuar, i cili konsiston në ndarjen e roleve të palëve gjyqësore për studentët. Gjyqi imitues u kërkon studentëve të marrin përsipër role, mbështetur në karakteret e përshkruar në çështjen specifike dhe të aktrojnë duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e dhëna. Kjo rrugë i ndihmon studentët të perceptojnë efektivisht problemin, të kuptojnë më mirë këndvështrimin e karakterit të rolit të tyre dhe rrjedhimisht të eksplorojnë më në detaje të gjitha zgjidhjet e mundshme, duke u aftësuar të prodhojnë zgjidhje të ndryshme me shkathtësi. Gjithashtu, ata nxiten të reagojnë me shpejtësi, të jenë të vëmendshëm dhe të mprehtë, të shfrytëzojnë imagjinatën e tyre, për t'iu përshtatur rrjedhës së seancës së gjyqit imitues, e cila mund të zhvillohet ndryshe nga pritsshmëritë apo llogaritë e tyre. Gjyqi Imitues krijon mundësinë që studentët të praktikojnë aftësi të

tilla si shpalosja e vlerave individuale etiko-morale, komunikimi i zhdërvjellët dhe aftësinë për të ‘manipuluar’ mendimin¹⁸.

Gjyqi Imitues zhvillohet mbi një çështje korrupsioni, shpesh të supozuar, të ndërtuar në mënyrë të tillë ku parashtrohet afera korruptive, shoqëruar me procesverbale dhe fakte, dhe në zhvillim të së cilës, studentët e ndarë në grupe, marrin rolet e avokatëve, prokurorëve dhe dëshmitarëve, subjektë të përgjegjësisë penale apo profesionistë dhe ekspertë të ligjit. Çështja e supozuar, në mënyrë të qëllimshme, ka ‘mangësi’ të tilla në fakte, rrethana e të dhëna, me synimin për të lënë hapësira të mjaftueshme, midis të cilave studentët mund të manovrojnë në ndërtimin e pyetjeve, nëse janë në rolin e avokatit apo prokurorit, si dhe në dhënien e përgjigjeve nëse janë në rolin e dëshmitarit.

Studentët para-përgatiten në kursin e një jave, duke filluar me njohjen e çështjes, shqyrtimin dhe analizimin e fakteve të dhëna, për të kaluar më pas në analizimin e argumentave dhe kundër-argumentave në favor të objektivit të tyre, në bazë të rolit që kanë. Prezantimi i çështjes në seancën gjyqësore imituese, realizohet përballë një trupe gjyqësore të përbërë nga profesionistë të ligjit, të cilit vlerësojnë objektivisht performancën e studentëve, duke vlerësuar prezantimin e çështjes, mënyrën e ndërtimit të argumentave, rrjedhshmërinë në komunikim dhe logjikën e ndjekur për të arritur qëllimin final.

KONKLUSIONE

Qëllimi i këtij artikulli nuk konsiston në formimin e edukimit ligjor vetëm për të mësuar praktikimin e ligjit. Fokusimi i edukimit ligjor ekskluzivisht në aftësitë praktike, mund të dështojë, duke kufizuar dhe shtypur mendimin sistematik dhe kritik. Kështu, qëllimi i artikullit shtrihet në referimin e spektrit në të cilin mund të shtrihet edukimi klinik ligjor, në hapësirën e mësimdhënies së praktikës, si një metodë komplementare e aftësimin të mendimit logjik dhe kritik.

Studentët e ligjit kanë nevojë të rikujtohen se ‘drejtësia’ nuk është dicka që përfitohet ipso facto nga legjislacioni aktual apo sistemi ligjor konkret. Studentët kanë nevojë të edukohen mbi faktin se ligji nuk është thjesht një mekanizëm pa vlera, i cili mbron vetëm interesat individualë të shoqërisë, por është gjithashtu një mekanizëm politik për ushtrimin dhe mbrojtjen e pushtetit. Studentët duhet të edukohen mbi përfaqësimin ligjor, por edhe mbi mangësitë e shërbimeve ligjore në shoqëri, fakte të cilat rezultojnë në mungesë të aksesit në drejtësi dhe ‘korrigjimit’ të pabarazisë në shoqëri.

Përtej materialeve teorike, jetojnë individë me të ardhura të pakëta, të cilët nuk mund të përballojnë shpenzimet e shërbimeve ligjore, shërbime të cilat janë

¹⁸ Williams G., *The Case Method: An Approach to Teaching and Learning in Educational Administration*, (1987), RIE, fq 31.

esenciale për zgjidhjen e problemeve të tyre ligjore. Kjo situatë tregon një keq-funksionim të sistemit ligjor, i cili de jure garanton barazinë përpara ligjit. Për këtë arsye, lind e domosdoshme që shkollat e ligjit të ofrojnë programin e Klinikës së Ligjit, duke përmbushur kështu objektivat për aftësimin profesional të studentëve, si objektiv thel-bësor mbi të cilin ngrihet një institucion arsimor, si dhe objektivin e ndërgjegjësimit së shoqërisë, ndihmës e mbështetjes ndaj shtresave në nevojë, dhe së fundmi, mund të plotësojnë pa-barazinë para ligjit.

REFERENCA

- Abel R. I., *Lawyers in the Civil Law World*, Richard I. Abel & Philip S.C. Lewis eds. (1988)
- Appleman L. I., *The Rise of the Modern American Law School: How Professionalization, German Scholarship, and Legal Reform Shaped Our System of Legal Education*, 39 *New Eng. L. Rev.* 251 (2005)
- Backman J., *Externships and New Lawyer Mentoring: The Practicing Lawyer's Role in Educating New Lawyers*, 24 *BYU J. Pub. L.* 65 (2009)
- Marshall J., *How much clinic for how many students? Examining the decision to offer clinics for one semester or an academic year*, *Law Journal*, (2011)
- Maurer N. M., *Handling Big Cases in Law School Clinics, or Lessons from my Clinic Sabbatical*, 9 *Clinical L.Rev.* (2003)
- Maxeiner J. R., *Integrating Practical Training and Professional Legal Education*, in *The Internationalization of Law and Legal Education*, (Jan Klabbers & Mortimer Sellers, eds. 2008)
- Reimann M., *The Progress and Failure of Comparative Law in the Second Half of the Twentieth Century*, 50 *Am. J. Comp. L.* 671, (2002).
- Stevens R., *Law School: Legal Education in America from the 1850 to the 1980*, (1983)
- Vance W.R., *Proceedings of Section of Legal Education*, (1914)
- Webb J., *Where the Action Is: Developing Artistry in Legal Education*, 2 *Int'l J. Legal Prof.* 187, (1995).
- White L. E., *The Transformative Potential of Clinical Legal Education*, *Osgoode Hall L.J.* 635 (1997)
- Williams G., *The Case Method: An Approach to Teaching and Learning in Educational Administration*, (1987), RIE
- Wilson R. J., *Training for Justice: The Global Growth of Clinical Legal Education*, 22 *Penn. St. Int'l L. Rev.* 421 (2004)
- Wizner S. & Curtis D., *Here's What We Do: Some Notes About Clinical Legal Education*, 29 *Clev. St. L. Rev.* 673 (1980)
- Wizner S., *The Law School Clinic: Legal Education in the Interests of Justice*, 70 *Fordham L. Rev.* 1929 (2002)

ASPETTI LEGALI-PENALI CONTEMPORANEI DEL CRIMINE ORGANIZZATO

PhD.c. Erdi KUKA

Facoltà di Legge, UT

Email:erkuka@gmail.com

Dr. Saimir SHATKU

Facoltà di Legge, UT

Email:s_shatku@gmail.com

L'ASTRATTO

In questo elaborato, è rilevante fornire un quadro generale delle dimensioni del crimine organizzato nella società, evidenziando l'ambiente, le caratteristiche, le forme di apparenza derivata della sua nascita e delle sue funzioni, che si riflettono normalmente nel nostro paese e altrove. Il crimine organizzato, oggigiorno, è diventato un fenomeno globale, che è una delle forme più pericolose di criminalità per la nostra società nel suo insieme. A causa degli eventi accaduti durante il XXI secolo, possiamo dire che la criminalità è in aumento ogni giorno e ciò è dimostrato dal fatto che vari criminologi, sociologi, psicologi, avvocati e molti esperti provenienti da diversi campi è impossibile indicare le misure concrete necessarie per adottare la loro legislazione penale per prevenire e combattere queste figure criminali. Come in qualsiasi altro paese del mondo, le inclinazioni della criminalità organizzata hanno esteso i loro «tentacoli» anche nel nostro paese, normalmente in vari gradi di azione a partire da speciali fattori di sviluppo e l'ambiente circostante nel corso degli anni.

In questo modo, il crimine organizzato si è diffuso con una rapidità impressionante in tutti gli aspetti della vita e ha trovato impreparati i legislatori albanesi nelle condizioni in cui la legislazione precedente non riconosceva questi reati per via delle circostanze del potere e degli sviluppi delle vicissitudini del tempo. In queste condizioni, la necessità di adottare misure concrete per l'efficace prevenzione della criminalità organizzata ed economica, che stava crescendo a fianco del processo del libero mercato, non solo in Albania, nella regione, e oltre. Gli effetti e le conseguenze della diffusione della criminalità organizzata sono stabiliti in molti paesi, dimostrando chiaramente l'istituzione di solide basi di cooperazione tra organizzazioni criminali internazionali, diventando così uno dei reati più gravi e più difficili essere eliminato al giorno d'oggi. Attraverso questo studio, miriamo a identificare le principali questioni e ad adottare misure preventive e punitive attraverso il quadro giuridico e penale, sia interno che estero.

***Parole chiave:** Crimine; Criminalità; Organizzazione criminale; delitti; quadro giuridico, profilassi del crimine;*

ABSTAKTI

Në këtë punim, është e rëndësishme të ofrojmë një tablo të përgjithshme të përmasave të krimit të organizuar në shoqëri, duke evidentuar mjedisin, karakteristikat, format e shfaqjes derivative të lindjes dhe funksionimit të tij, normalisht të pasqyruara këto në vendin tonë dhe më gjerë. Krimi i organizuar, në ditët e sotme është kthyer në një fenomen global, i cili përbën një nga format më të rrezikshme të shfaqjes së kriminalitetit për shoqërinë tone në tërësi. Duke marrë shkas nga ngjarjet e konstatuara gjatë shekullit të XXI, mund të themi se kriminaliteti është në rritje çdo ditë e më shumë dhe kjo evidentohet edhe me faktin se analistë të ndryshëm kriminolog, sociolog, psikologë, juristë, e shumë ekspert të fushave të ndryshme, e kanë të pamundur që të tregojnë masat konkrete që duhet të marrin legjislacionet e tyre penale për t'i parandaluar dhe luftuar këto figura krimi. Ashtu si dhe në çdo vend tjetër të botës, tendencat e krimit të organizuar i shtrinë “tentakulat e tyre” edhe në vendin tonë, normalisht në shkallë të ndryshme veprimi nisur kjo me faktorët e veçantë të zhvillimit dhe mjedisit rrethues ndër vite.

Në këtë mënyrë krimi i organizuar u përhap me një shpejtësi marramendëse në të gjitha aspektet e jetës dhe i gjeti legjislatorët shqiptarë të papregatitur në kushtet kur legjislacioni i mëparshëm nuk i njihte këto vepra penale për arsye të rrethanave të pushtetit dhe zhvillimeve të kohës. Të ndodhur në këto kushte, shtohet nevoja e marrjes së masave sa më konkrete për parandalimim me efikasitet të krimit të organizuar dhe atij ekonomik, i cili po lulëzonte përherë e më shumë së bashku me procesin e tregut të lirë, jo vetëm në Shqipëri, në rajon dhe më gjerë. Efektet dhe pasojat e shtrirjes së krimit të organizuar konstatohen në shumë vende, duke dëshmuar qartë për krijimin e bazave të forta të bashkëpunimit ndërmjet organizatave kriminale në nivel ndërkombëtar, duke u kthyer në këtë mënyrë në një nga veprat penale më të rënda dhe më të vështira për tu eliminuar në ditët e sotme. Përmes këtij studimi synojmë evidentimin e problematikave kryesore dhe marrjen e masave parandaluese e ndëshkuese, përmes kuadrit juridiko-penal, vendas dhe atij të huaj.

Fjalë kyçe: *Krim; kriminalitet; organizatë kriminale; vepra penale; kuadër ligjor; profilaksi e krimit;*

1. **Tratta degli esseri umani**

La tratta degli esseri umani è un fenomeno a diffusione mondiale, in cui quasi tutti i paesi sono inclusi come paese di origine, di transito o di destinazione. Il fenomeno sembra diventare sempre più galoppante, ma non esiste ancora un metodo per fermarlo o eradicarlo dalla società, nonostante i numerosi sforzi di organismi universali come le Nazioni Unite e quelli regionali come l'UE, il KiE e i governi cittadini attuando diverse sanzioni.

Va sottolineato che la tratta di esseri umani è l'oggetto principale dell'attività criminale organizzata, per il fatto che la commissione di tali reati richiede un gran numero di persone coinvolte. L'attività dei gruppi criminali in questo campo implica necessariamente l'elemento di cooperazione e continuità dell'attività criminale.

La tratta di esseri umani comporta il reclutamento di persone, il trasporto, il trasferimento, l'occultamento o la ricezione di persone con la minaccia o l'uso della forza o altre forme di cooperazione. L'Albania è classificata tra paesi di origine, di transito e di destinazione di traffico temporaneo.

I cambiamenti politici dopo il 1991, così come la frantumazione delle strutture statali durante gli eventi del 1997, hanno portato alla diffusione della tratta di esseri umani in Albania. Le vie della tratta di esseri umani hanno seguito diverse rotte come: dall'Albania alla Macedonia, dall'ex Jugoslavia e dopo con destinazione in paesi occidentali. Oppure attraverso il sistema tangente che partiva dall'Albania e terminava in paesi dell'Europa Occidentale come Italia, Grecia, Francia e Germania. Sono stati compiuti passi importanti nel campo della prevenzione della tratta di esseri umani, nonché della loro protezione e del loro rimpatrio¹.

Per queste e decine di altri motivi, è stato approvato il Quadro per il Piano Strategico Nazionale per la lotta contro la tratta di esseri umani, che comprende un piano d'azione per un periodo di due anni (il Piano Nazionale d'Azione 2005-2007). La strategia include un accordo di cooperazione per l'istituzione di un meccanismo nazionale di riferimento per l'individuazione e l'assistenza alle vittime della tratta di esseri umani². Questo quadro della strategia nazionale nella sua attività si riferisce alla prevenzione della tratta e della re-tratta in 4 punti come;

¹“Kriminologjia” (Crimine Organizzato), V. Hysi, Tirana 2005, f.173-175.

²Rapporto del Dipartimento Americano dello Stato sulle Pratiche del Diritto dell'Uomo per 2006, trasmesso in data 06.03.2007. f.26.

- La sensibilizzazione del pubblico,
- Introduzione nel sistema di istruzione, come corrente generale,
- La riduzione della vulnerabilità, in particolare per donne e bambini e gruppi a rischio,
- Nuove iniziative per lo sviluppo socio-economico e la riduzione della povertà.

Ma, secondo l'anno statistico, il maggior numero di traffico viene costituito dalla tratta di donne al meretrico, di cui 27 reati sono stati inviati a processo, e sono stati processati 19 casi di tratta e sono state condannate 34 persone. La dinamica della tratta di esseri umani è in aumento per l'anno 2005 e questa situazione richiede delle misure alquanto concrete per prevenire il traffico di prostituzione. Per quanto riguarda il traffico di minori, la curva di questo traffico è stata contrassegnata

da una leggera diminuzione, dovuta all'attività dei Procuratori Distrettuali in cooperazione con quella di Tirana, nonché con le strutture della polizia criminale. Per il 2005, secondo le statistiche, 5 reati sono stati inviati al processo e 5 casi sono stati processati e 3 persone sono state condannate.

1.2 Le misure di prevenzione contro la tratta degli esseri umani Propositi Strategici.

Come misure preventive sulla tratta di esseri umani, specifichiamo la Strategia Nazionale per la lotta contro la tratta di esseri umani del piano d'azione 2005-2007, che contiene il miglioramento della attività degli organismi statali per la sensibilizzazione del pubblico, l'istruzione e l'informazione dei cittadini albanesi, lo sviluppo delle alternative professionali per le vittime di tratta, nonché una repressione continua della tratta e della re-tratta.

Obiettivi Strategici. Estensione dei programmi governativi dei finanziamenti per l'istruzione, la stampa e altri modi di informazione, per aumentare in modo sempre più efficace la popolazione, in particolare le donne, i bambini e i gruppi a rischio, sui pericoli e le cause della tratta e sulla loro attivazione in corsi di formazione e professionali. Le istituzioni responsabili nel piano di questa strategia sono MPCs, MASH, MSH, ON, che coopereranno tra loro nella elaborazione di piani per la prevenzione sociale della violenza domestica contro le donne e contro i bambini, della violenza sessuale, delle false proposte di lavoro o di matrimonio, la discriminazione razziale o del genere.

³“Strategjia Kombëtare Shqiptare për Luftën Kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore”, Tirana 2005.

⁴“Vjetari Statistikor 2005”, al Ministero della Giustizia, Tirana 2006.

Inoltre, anche nel Rapporto del Dipartimento Statunitense del 6 marzo 2007, l'accento è posto sull'adozione di misure interne per fermare la tratta di donne e di minori e l'ulteriore perfezione della legislazione penale per la repressione del traffico di esseri umani. Secondo le O.J.F, quasi 1.000 bambini albanesi non accompagnati vivono in Italia.

Uno studio del 2002 condotto dal Servizio Sociale Internazionale riferisce che 1.800 bambini albanesi non accompagnati vivono in Grecia. Secondo le statistiche della Procura per i Reati Gravi per il periodo del 2005, sono rinviati a processo 69 procedimenti penali oppure il 32% di diversi tipi di tratta di esseri umani⁵. Per quanto riguarda la tratta delle donne per il 2005, sono stati inviati 11 casi/il 22% con 13 imputati/l'11,8%. Secondo le statistiche, si registra una lieve riduzione dei procedimenti per il periodo 2005, mentre per il 2006 sono stati inviati a processo dalla Procura per i Reati Gravi 13 casi con 16 imputati.

Il rapporto del Dipartimento di Stato degli Stati Uniti considera una soluzione per prevenire la tratta di esseri umani il coordinamento e la cooperazione tra le tre importanti istituzioni: il Ministero degli Interni (Polizia di Stato), l'Ufficio del Procuratore Generale (Le Procure Distrettuali e la Procura per i Reati Gravi) e il Ministero degli Affari Sociali e delle pari opportunità (in coordinamento con le O.J.F (NPO).

Per l'elaborazione del piano di progetto non solo di carattere nazionale ma anche settoriale, dividendo le zone urbane in tre categorie:

1. Zone ad alta di pericolosità tratta di esseri umani, comprese le zone marine e di confine in cui la tratta di persone è più facile e organizzata.
2. Aree di medio grado di pericolosità della tratta di persone dove si includono le aree urbane e grandi
3. Le aree a basso pericolo sociale per la tratta di esseri umani, dove sono incluse quelle città che sono meno esposte alla tratta e hanno un livello economico più elevato rispetto alle due categorie precedenti.

⁵“Statistika Zyrtare te Prokurorise se Krimeve te Renda”, per il periodo 2005

1.3 Raccomandazioni e conclusioni

Come è stato sopra sottolineato, il crimine organizzato in generale costituisce attualmente una seria minaccia per i Paesi Europei. Pertanto, molti orientamenti criminali si focalizzano principalmente sulla prevenzione ed il contrasto di questo tipo di criminalità con elementi contemporanei. Di seguito sono riportati alcune raccomandazioni:

1. Il contrasto e la repressione della criminalità organizzata nel campo degli stupefacenti richiedono forti politiche penali che consentano l'individuazione, l'investigazione, il perseguimento e la punizione delle diverse forme di tratta. Tra queste forme, i continui cambiamenti intervenuti nelle politiche penali nel nostro paese in merito al contrasto al traffico di narcotici migliorano significativamente la strategia degli enti statali per la punizione dei loro autori.

2. Tranne il diritto penale nella prevenzione e nella lotta contro il crimine organizzato, anche le leggi internazionali come le convenzioni, i protocolli, gli accordi di cooperazione tra gli Stati per integrare il quadro internazionale nel colpire i gruppi criminali a carattere multinazionale o le organizzazioni, svolgono ruoli importanti. Le prassi mondiali hanno dimostrato che la non imposizione e il non funzionamento della normale cooperazione tra i paesi hanno comporta come conseguenza lo sviluppo della criminalità organizzata e del traffico delle sostanze psicotrope. Pertanto, per evitare questo grande male, dovrebbe essere stabilita la più stretta cooperazione tra gli stati.

3. La preparazione, la qualificazione e la specializzazione degli ufficiali di polizia presso i pubblici ministeri e dei giudici per quanto riguarda la loro

professionalità contro il crimine della tratta di sostanze psicotrope costituisce un altro impegno degli organismi statali per prevenire e al contrasto della criminalità organizzata.

4. È necessaria come requisito la istituzione immediata di strutture appropriate e specializzate come la polizia privata e/o investigativa per combattere questo tipo di reato, in collaborazione con Europol e Interpol.⁶

⁶“Interpoli dhe Shqiperia” rivista Giustizia f.75.

5. Un ruolo positivo nella prevenzione della criminalità organizzata e della tratta delle sostanze psicotrope sta anche nella elaborazione di strategie complesse in cui i servizi segreti e operativi svolgono un ruolo speciale. D'altra parte, la fornitura di dati sui gruppi criminali, le loro attività, le modalità di azione e i mezzi che usano, è di grande importanza per il loro contrasto.

6. L'individuazione e l'investigazione della criminalità organizzata in generale e della tratta degli esseri umani, delle sostanze narcotiche, richiedono l'adozione di misure protettive contro le vittime che possono essere pregiudicate da queste organizzazioni criminali, testimoni e persone pentite, che assistono nella scoperta di attività di gruppi criminali.

7. Poiché le organizzazioni criminali operano nella cospirazione e utilizzano strumenti sofisticati, dovrebbero considerarsi per la scoperta di attività illegali l'uso di tecniche di informazione come l'intercettazione dei telefoni cellulari, della corrispondenza. Questi metodi sono utili per prevenire e combattere la tratta di esseri umani non solo contro la criminalità organizzata, ma anche la tratta di stupefacenti.

8. Il carattere internazionale della criminalità organizzata richiede che organismi come la polizia, il Pubblico Ministero e le Corti di un paese coordinino il lavoro con gli organismi di contropartita con le autorità limitrofe o regionali come un rapido scambio di informazioni tra i paesi e la loro cooperazione nella lotta e la prevenzione del crimine organizzato, la criminalità economica internazionale e il traffico di droga, ad esempio, il nostro paese ha ratificato la Convenzione delle Nazioni Unite e ha firmato una serie di Accordi bilaterali e multilaterali per la repressione della criminalità organizzata insieme ad altri Stati⁷

TESTI DI RIFERIMENTO

*Abdullahi, H. e Zeneli, I.: *Bashkëpunimi dhe masat parandaluese në luftën kundër krimit të organizuar*, pubblicato nella tesi “Gjendja e krimit të organizuar në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni si dhe problemet që lidhen më të”, Tirana, 12-13 Dicembre 2002.

*American Bar Association, Central and East European Law Initiative (ABA/CEELI), American Department of Justice (DOJ) e Suisse Agencie for Development and Cooperation (SDC), materiali del seminario, *Tirana*, Luglio 1998.

*Banca Nazionale e il Centro Albanese delle Ricerche Economiche, osservazione presentata nel seminario “*Qeverisja dhe korrupsioni në Shqipëri*”, Tirana, 30 qershor 1998;

*Bejko, Sh.: *Aspekte të krimit ekonomik të organizuar*, Tesi, inedito, Tirana, 1997.

*Bicaj, K.: *Aspekte kriminologjike dhe juridike të kriminalitetit të organizuar me narkotikë në shoqëritë bashkëkohore*, Tesi, inedito, Tirana, 2002.

*Bicaj, K. e Camaj, K.: *Disa aspekte parandaluese të kriminalitetit të organizuar me narkotikë në shoqërinë e sotme të Ballkanit*, pubblicato nella tesi “*Gjendja e krimit të organizuar në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni si dhe problemet që lidhen më të*” riassunto di comunicazioni, Tirana, 12-13 Dicembre 2002

*Elezi, I.: *Per la criminologia*, lezioni, Tirana, 1994.

*Halili, R.: *Disa karakteristika të krimit të organizuar më Kosovë dhe parandalimi i tij*, “*Gjendja e krimit të organizuar në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni si dhe problemet që lidhen me të*”, Tirana, 12-13 Dicembre 2002.

*Heba, E.: *Evidentimi i formave të krimit të organizuar që ekzistojnë aktualisht në Shqipëri*, “*Lufta kundër krimit të organizuar*”, rapporto, Building Democracy Institute, OSCE, IRI, Tirana, Luglio 1999.

*Hysi, V.: *Aspekte kriminologjike të krimit të organizuar dhe disa drejtime të punës parandaluese të tij*, “*Lufta kundër krimit të organizuar*”, rapporto, Building Democracy Institute, OSCE, IRI, Tirana, Luglio, 1999. ‘

*Hysi, V.: *Organized Crime in Albania*, “*Organized Crime in Europe*’, *Concepts, Patterns and Control Policies in European Union and Beyond*”, Springer, Olanda, 2004.

*Latifi, V. *Problematika e krimit të organizuar në Kosovë dhe bashkëpunimi në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar*”, bot në “*Gjendja e krimit të organizuar në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni si dhe problemet që lidhen më të*”, riassunto di comunicazioni, Tirana, 12-13 Dicembre 2002.

*IOM and ICMC: *Research report on the third country national trafficking victims in Albania*, Tirana, Aprile 2001.

*IOM and ICMC : *II Research Report on third country national trafficking victims in Albania (January-December 2001)*, Tirana, 2002.

*IOM e il Ministero di Ordine Pubblico: “*Workshop on operational improvements in combating illegal migration, trafficking and smuggling of migrants in Albania*, Rapporto, Tirana, 2001.

*Kërçuku, M. dhe Kavaja, M.: *Funksionimi dhe efikasiteti i organeve shtetërore në luftën kundër krimit të organizuar*, “*Gjendja e krimit të organizuar në*

Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni si dhe problemet që lidhen me të”, Tirana, 12-13 Dicembre 2002.

*il Ministero di Ordine Pubblico: “Report of the liaison officer of the Italian Interforce Police Mission in Albania”, *raport*, 2002, indirizzo del sito web:

<http://www.mpo.gov.al/mpo/29korrik%20statistika-klandestine.htm>

*Murati, R.: “*Kriminaliteti i organizuar në Kosovë dhe legjislacioni penal – procedural*”, “*Gjendja e krimit të organizuar në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni si dhe problemet që lidhen me të*”, riassunto di comunicazioni, Tirana, 12-13 Dicembre 2002.

DISKRECIONI LEGJISLATIV NË ZGJEDHJEN E MBËSHTETJES NË SANKSION PENAL, OSE NË DEKRIMINALIZIM, PARIMI I ARSYESHMËRISË SI DERIVAT I PARIMIT TË LIGJSHMËRISË

PhD kandidat. Ylli PJETËRNIKAJ

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë

ABSTRAKT

Parimi i ligjshmërisë kërkon që legjislatori të përcaktojë në mënyrë preçize denimin, sanksionin për çdo figurë të veprës penale. I përket ligjvënësit të përcaktojë se cilat sjellje të ndëshkojë, me ç’lloj sanksioni dhe në ç’masë, ndërsa gjykata mund të hyjë në themel të vlerësimeve të tilla vetëm nëse e gjykon që është në kundërshtim me parametratë parimit të arsyeshmërisë.

Të njëjtin diskrecion legjislatori e shpreh kur vendos të depenalizojë fakte tipike të parashikuara si vepër penale. Edhe në këtë rast, ndërhyrja normative duhet të bëhet me arsyeshmëri. Diskrecionaliteti i legjislatorit vlen edhe për zgjedhjen e llojit dhe tërësisë së sanksioneve plotësuese

Është e rëndësishme që zgjedhja për të përdorur sanksionin penal, meqë ky i fundit nuk paraqet instrumentin e vetëm me të cilin ligjvënësi mund të kërkojë të ndjekë efektivitetin e mbrojtjes së të mirave juridike, të konsiderohet një “*extrema ratio*”, i rezervuar për rastet në të cilat nuk janë efektive instrumentet e tjera për mbrojtjen e atyre që konsiderohen thelbësore për shoqërinë.

Pretendimi eventual që ligjvënësi ka dështuar të kriminalizojë sjellje të caktuara, në mënyrë hipotetike shoqërisht të rrezikshme ose të dëmshme, apo edhe të paligjshme në aspekte të tjera, ose që ka përcaktuar shumë strikt dhe shterues sjelljet kriminale, duke lënë jashtë sjellje të tjera, nuk mund në parim, të rezultojë si një censurë e kushtetutshmërisë së ligjit. Është e qartë së kërkesat për mbrojtje nuk ezaurohen në mbrojtjen e mundshme penale, sepse mund të jenë në gjendje të përmbushen me forma të ndryshme të urdhërimeve dhe sanksioneve, përkundrazi inkriminimi është një *extrema ratio*, ku legjislatori mbështetet, kur e konsideron të nevojshme në mungesë ose papërshtatshmëri të mjeteve të tjera mbrojtëse.

Fjalët kyçe: *parimi, ligjshmëri, arsyeshmëri, inkriminim, legjislatori.*

HYRJE

Parimi i ligjshmërisë në të drejtën penale është themel, bazë dhe shtyllë kryesorepër respektimin e lirive, të drejtave dhe sigurisë e barazisë së qytetarëve. Gjithashtu, parimi i legalitetit është shumë i rëndësishëm për luftimin efikas

dheadekuat të kriminalitetit. Gjithashtu ai paraqet rëndësi në shumë aspektepër çdo qytetar, për tërë kombin dhe për funksionimin e shtetit ligjor¹.

Parimi i ligjshmërisëka rëndësi të postulatit elementar, përcaktim themelor i së drejtës penale si e drejtë e bazuar në ligj. E drejta për dë-nim del nga vullneti i qytetarëve, të cilët shtetit i mbartin autorizime të kufizuara për shpallje të disa sjelljeve ndëshkuese dhe për ndëshkim të kryerësve të tyre. Si akt për legjitimim dhe vetëkufizim të së drejtës shtetërore për ndëshkim, ligji njëkohësisht është garant për liritë dhe të drejtat e njeriut dhe mbrojtës nga çdo autokraci, nëçdo lloj kriminaliteti apo keqpërdorim të pushtetit².

Parimi i ligjshmërisë vepron në përgjithësi si një parim kushtëzues për organin ekzekutiv në ushtrimin e funksioneve të saj, i cili gjen zbatim edhe në të drejtën penale. Ky parim në kuptimin e ngushtë është një parim me baza doktrinare, i cili është vendosur sot në konturet e një rregullimi juridik modern me natyrë demokratike bazuar në shtetin e së drejtës duke rregulluar çdo veprimtari shtetërore.

Doktrina tradicionalisht përshkruan parimin e ligjshmërisë në një kuptim të dyfishtë, në kuptimin formal dhe atësubstancial.³

Në kuptimin formal, ky parim konsiston në ndalimin e ndëshkimit të çdo fakti tipik, kur në kohën e kryerjes së tij, nuk parashikohet shprehimisht nga ligji si vepër dhe kur dënimi nuk është përcaktuar saktësisht.⁴ Kështu ky parim merr natyrë formale, pasi konsideron vepër penale vetëm sjelljen që është përshkruar formalisht në një ligj. Në këtë kuptim, stigmatizimi negativ i një fakti tipik mund të rrjedhë vetëm nga ligji, jo nga burime me natyrë të ndryshme. Rrjedhimisht, nuk mund të ndëshkohen veprimet që nuk janë inkriminuar shprehimisht me ligj, edhe nëse janë shoqërisht të rrezikshme dhe anasjelltas, janë të dënueshme vetëm veprimet e parashikuara si vepra penale me ligj, edhe pse shoqërisht janë jo të rrezikshme.

Kykoncept është kritikuar për dy problematika. Së pari, është kriti-kuar për papërshtatshmërinë e supozuar në trajtimin e krimit. Duke mos lejuar ndëshkimin

¹ Shih Ismet Salihu / Hilmi Zhitija / DrFejzullah Hasani “Komentari i kodit penal të republikës së kosovës”, Botimi 1, i publikuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, 2014 fq 4.

² Shih Shih Vllado Kambovski, E drejta penale. Pjesa e përgjithshme, Furkan, 2007, fq. 87

³ Mantovani, Diritto penale, parte generale, cit., p. 4 ss.

⁴ Vassalli, voce Nullum crimen, nulla poena sine lege, in Dig.disc. pen., VIII, 1994, p. 278; Moccia, La “promessa non mantenuta”. Ruolo e prospettive del principio di determinatezza/tassatività nel sistema penale italiano, Napoli, 2001, passim; Bricola, La discrezionalità nel diritto penale. Nozione e aspetti costituzionali, 1965, p. 229; Id., in Commentario della Costituzione, cit., p. 242; Petrocelli, Appunti sul principio di legalità nel diritto penale, in Saggi di diritto penale, 1965, p. 191; SPASARI, Il principio di legalità nel diritto penale italiano, in Arch. pen., 1966, I, 36; Id., Diritto Penale e Costituzione, Milano, 1966; Grasso P. G., Il principio “Nullum crimen, nulla poena sine lege” nella Costituzione italiana, Milano, 1972; Cordero, Legalità penale, in Enc. giur. Treccani, XVII, Roma, 1990; Trapani, voce Legge penale, in Enc. giur. Treccani, XVIII, Roma, 1990; Palazzo, Legge penale, in Dig.disc. pen., VII, Torino, 1993; BOSCARELLI, voce Nullum crimen sine lege, in Enc. giur. Treccani, XXI, 1990, p. 2.

e sjelljeve që nuk janë parashikuar ligjërisht si vepër penale, nga ky parim do të përfitonin ata që vepronë në kufijtë e ligjit ose ata që, duke shfrytëzuar papërsosmëritë e ligjeve arrijnë të kryejnë veprime të rrezikshme por që nuk kategorizohen si vepër penale.

Së dyti, ndëshkimi i fakteve të parashikuara ende si vepra penale, por që nuk janë më shoqërisht të rrezikshme, do të ishte në kundërshtim me ndjenjën e drejtësisë substanciale të komunitetit.

Në kuptimin substancial, parimi i ligjshmërisë, tipik në eksperiencat totalitare, lejon që të konsiderohen si vepra faktet shoqërisht të rrezikshme, pavarësisht nga parashikimet ligjore. Për këtë arsye, në këtë kuptim parimi përfshin dënimin e veprimeve të rrezikshme edhe nëse nuk parashikohen me ligj si vepër penale, nga ana tjetër, përjashton ndëshkimin për veprime shprehimisht të kriminuara nga ligji por që nuk janë shoqërisht të rrezikshme. Karakteri kriminal i veprës lidhet me rrezikshmërië shoqërore. Pra, në kuptimin substancial, parimi i ligjshmërisë sjell një nocion substancial që është i aftë për të kriminalizuar të gjitha ato sjellje që çënojnë rendin shoqëror të një shteti të caktuar⁵.

Parimi i ligjshmerisë është i përbërë nga disa komponentë, të cilët mund të quhen nënparime të tij, të tillë si:

- Parimi i rezervës ligjore, që nënkupton detyrimin për të përcaktuar vetëm me ligj veprat penale dhe dënimet,
- Parimi i taksativitetit, i ndalimit i zbatimit të analogjisë,
- Parimi i ndalimit të fuqisë prapavepruese, ndalimi i veprimit retroaktiv të ligjit penal,
- Parimi i përcaktueshmërisë,
- Parimi i proporcionalitetit,
- Parimi i arsyeshmërisë, diskrecioni legjislativ në zgjedhjen e mbështetjes në sanksion penal, ose në dekriminalizim.

Në këtë punim do të trajtojmë vetëm njërin nga nënparimet, atë të arsyeshmërisë, i cili i jep legjitimitet ligjit penal, ekzistencës së veprës penale.

1. Legatiteti dhe legjitimiteti

Sistemi i denimeve penale i Republikës së Shqipërisë është i ndërtuar duke u bazuar në frymën e parimit të ligjshmërisë, i cili ka natyrë kushtetuese. Sipas këtij parimi është vetëm ligji, ai që përcakton veprat penale, sipas tipareve të specifikës, të plotësisë (përcaktimit të rasteve), dhe fuqisë joprapavepruese, duke identifikuar të mirat juridike që duhet të mbrohen nga sanksioni penal, nëpërmjet

- (c) testifying by means of sound and imaging devices with closed circuits;
- (d) providing a nickname;

Forms that guarantee anonymity are left to the discretion of the court. Maintaining anonymity in general means using the means (using a nickname mainly a number)¹³ to avoid witness identification. The preservation of anonymity leads to the concealment of the identity of the witness both to the accused and his defense counsel. Naturally, this raises the issue of guaranteeing the rights of the accused and the regular legal process. In such cases, it would be difficult for the accused

¹¹ However, referring to the post-conflict situation in the former Yugoslavia, one of the judges of the case filed an objection against the requirement that witnesses should prove that the fear expressed by them is true. For more see Tadic’s case, No. IT-94-1-T, 25 June 1996, paragraf 25.

¹² Cryer, R., Friman, H., Robinson, D., Wilmshurst, E., An introduction to international criminal law and procedure, cited page 83.

¹³ Duraj E. The right of victims under international criminal justice, Academic Journal of Business, Administration, law and Social Sciences, Vol 1, No.2, July, 20015, page, 109.

to guarantee the principles of a fair trial, especially the possibility of questioning witnesses if it is not known what they actually represent. This problematic is also reflected in the jurisprudence of the court. In the Tadic case, the court accepting three anonymous testimonies claimed that anonymity should only be allowed in exceptional circumstances. Further, it set out 5 conditions for guaranteeing anonymity:

1. There should be a real fear for the safety of the witness and his family¹⁴;
2. Evidence must be very important for the matter, the importance of which must be proved by objective evidence.
3. Courts should ensure that the witness is not unreliable;
4. The lack of effectiveness or non-existence of a victim protection program should have an impact on the decision to grant anonymity;
5. This measure should be indispensably necessary.

To guarantee the standard sanctioned by the ECHR, in the Tadic case, the court also noted some guidelines regarding the anonymous testimonies as follows:

Some guidelines on standards for a fair trial can be from the ECHR's practice or the practice of domestic courts. But these standards should be interpreted in the context of the Tribunal's unique purpose, especially considering its mission to protect victims and witnesses. The following guidelines are in the function of this goal:

First, the court must be able to assess the witness's behavior in order to assess the credibility of the testimony.

Second, the judge must recognize the witness's identity in order to test his credibility.

Third, the defense should be given the opportunity to ask the witness about matters such as receiving incriminating information, but excluding the information that reflects his/her identity data.

Finally, the identity of a witness can become known when there is no longer any reason for anonymity or the fear of witness security.

Particularly the final point that provides for the possibility of abolition of anonymity is in line with the case law of the ECHR, which in the Kostovski case against the Netherlands has foreseen the danger of threatening the rights of the accused if witnesses remain at all times anonymous as follows:

¹⁴ In this case, the court asserted that: "The prosecutor could keep hiding on the defense and the accused names and other identifying information about witnesses." Regarding the providence of this fear, the court asserted that "it is sufficient for the ruthless nature of the crimes to justify the fear of the witness and his relatives". For more see Tadic's above mentioned case.

The Convention does not stop supporting the investigative phase of criminal proceedings in sources such as anonymous information. But the further use of anonymous testimonies as sufficient proof of a charge is another matter. It includes limits on the rights of the accused, which would be incompatible with the guarantees provided for in Article 6.

If the defense does not recognize the identity of the witness, she is deprived of the opportunity to prove that the witness is presumptive or unreliable.

The Tribunal itself has maintained such an attitude in the case of Baskiç, where it has evidenced that:

Victims and witnesses deserve protection even from the accused during the preliminary trial or until a reasonable time before the trial begins. After that time, the right of the accused to a fair trial takes precedence and requires anonymity to be abolished, while preserving public and media exposure.

In fact, Tadic's case is the only issue where the court has allowed anonymous testimonies at the trial stage. In other cases the Prosecutor has used other procedural means of protection or the use of documentary evidence.

4. Out of process protection regime

The ICC system is an even more advanced system for sanctioning the protection of victims and witnesses¹⁵. The Rome Statute not only extensively addresses the defense system at all stages of the procedure, but sanctions the creation of special structures that enable the protection and treatment measures to be taken out of the procedure. Article 43/6 of the Rome Statute provides for the creation of a special unit, Victims and Witnesses Unit (UNW)¹⁶ whose purpose is to provide protection measures to guarantee the physical and psychological for the well-being of witnesses. Through the activity of this unit it is possible not only protection but also counseling and assistance for witnesses and victims who appear before the Court. Creating this uniqueness has enabled the guarantee of protection beyond the process of giving evidence.

This unit provides protection not only for the witness but also for his or her family members if they are subject to intimidation or intimidation as a result of the giving of evidence. The UNW may advise the Prosecutor and the Court on

¹⁵ Unlike the ICRM system where these rules are sanctioned in RRPMP, the Statute of Rome in Article 68 details all forms of victim and witness protection during their participation in the trial.

¹⁶ According to Article 43/6 of the Statute of Rome: "The Referent raises the Secretariat to the Victim and Witness Unit. This Unit assigns, in consultation with the Office of the Prosecutor, safeguards and security arrangements, counseling and other appropriate assistance to witnesses, victims who appear before the Court, and others who are at risk due to the evidence provided by such witnesses. The unit has experienced trauma personnel, including traumas related to sexual assault crimes".

appropriate safeguards, security arrangements, counseling and helpers who need to be carried out.

As far as it is concerned, the ICTY, during his stay in The Hague, the witnessed witnesses enjoy the right to be protected and treated by the Witness Assistance Program¹⁷.

LITERATURE

Cryer R., Friman H., Robinson D., Wilmschurst, E, *Introduction to International Criminal Law and Procedure*, Cambridge University Press.

Duraj E. *The Right of Victims under International Criminal Justice*, Academic Journal of Business, Administration, law and Social Sciences, Vol. 1, No.2, July, 2015.

Guidelines, *European Court of Human Rights case law*, Albanian Center for Human Rights, ARS, Tirana 2001.

Human Rights in International Law, Publication of AHC, Albinform, Tirana 1994.

Law no. 8984 dated 23.12.2002 *On the ratification of the Rome Statute for the International Criminal Court*.

Rules of Procedure and Evidence, Assembly of States Party, New York, 3-10 September 2002.

Statute of the International Tribunal for the Judgment of Persons Responsible for Serious Violations of International Humanitarian Law in the Territory of the Former Yugoslavia since 1991, approved by the UN Security Council on 25 May 1993.

Statute of the Military Court of Nuremberg, part of the London Agreement, August 8, 1945.

Summary of International Acts, Publication of AHC, Albinform, Tirana 1994.

Tadic case, No. IT-94-1-T, 25 June 1996.

Tadic's case, No. IT-94-1-PT, 10 August 1995.

Brdani&Talić, No. IT-95-14-A, September 26, 2000.

¹⁷ Rome Statute Rule 68/4.

“SHPËRBLIMI I DËMIT TË SHKAKTUAR NGA DËNIMI DHE BURGIMI I PADREJTË”

Prof. Asoc. Dr. Anjeza LIÇENJI

*Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
anjeza.licenji@fdut.edu.al*

MsC. Jola SADO

*Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë
Kryeministria
jola_sado@hotmail.com*

ABSTRAKT

Përmes këtij punimi kemi si qëllim për të treguar ndikimin e rregullave juridike për kompensimin nga dënimi dhe burgimi i padrejtë, rregullimin e marrëdhënieve që lindin nga dëmi i pësuar si dhe zhdëmtimi i tij. Gjithashtu, rëndësi e veçantë kushtohet edhe trajtimit teorik të konceptit të dëmit të shkaktuar nga dënimi dhe burgimi i padrejtë, rolit dhe përgjegjësisë së shtetit si dhe të drejtave e palës së dënuar për të fituar të drejtën e kompensimit si rezultat i dëmit të pësuar.

Ligji për kompensim për burgim të padrejtë, nuk rregullon marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe personit, por thjesht orienton gjykatat mbi kriteret e caktimit të masës së kompensimit. Kompensimit të dëmit, si rregull, i paraprin fakti i shkaktimit të dëmit. Dëmi mund të shkaktohet si nga burgimi i padrejtë ashtu edhe nga dënimi i padrejtë, si pasojë e cënimit të të drejtave personale dhe reale, si ndaj personave fizikë dhe juridikë.

Dëmet që mund t’ju shkaktohen këtyre personave mund të jenë me natyrë të ndryshme, si përsa i përket të mirës materiale që mund të çenohet, ashtu edhe nga llojet e dëmeve që mund të shkaktohen si dëme psikike, fizike, morale, etj.

Në rastin e burgimit dhe dënimit të padrejtë, si rregull lind për shtetin detyrimi për të shpërblyer dëmin, ndërsa për palën të cilës i është cënuar e drejta, gjithmonë lind e drejta për të kërkuar riparimin e situatës së krijuar apo shpërblyimin e dëmit.

Theksojmë se, ligji për kompensim për burgim të padrejtë, në lidhje me kompensimin e dëmit, kasi synim kryesor përmirësimin e arsyeshem të gjendjes ekonomike të një kategorie të caktuar personash, të cilët janë prekur nga veprime të tilla të padrejta.

Fjalë kyçe: Kompensim, koncepti i dëmit, dënim i padrejtë, burgim i padrejtë.

1. Vështrim historik i institutit të dënimit dhe burgimit të padrejtë

Ky punim fokusohet në problematikën dhe rëndësinë që ndesh në sistemin tonë të drejtësisë kompensimi i përshtatshëm i personave të pafajshëm të cilët janë burgosur gabimisht dhe padrejtësisht. Pas kalimit të kohës në burg, para dhe pas dënimit, për krimet që nuk i kryen, këta individë shpesh janë të privuar nga kryerja e një jete normale. Miqësitë dhe marrëdhëniet familjare janë përkeqësuar gradualisht, aftësia për të gjetur punë të mirë vështirësohet së tepërmi nga ekzistenca e një dosje penale dhe mundësia për të patur një jetesë të qëndrueshme ka humbur. Prandaj, dhe e drejta e tyre për t'u kompensuar synon deri diku ri-vendosjen në vend të asaj qetësie shpirtërore që është trazuar si rezultat i një vendimi të padrejtë.

Sistemi ynë i drejtësisë i siguron një mbrojtje specifike personit të akuzuar për një krim, sikurse është ndalimi i masave dhe konfiskimeve të paarsyeshme, prezumimi i pafajësisë në një procedim penal, e drejta për mbrojtës ligjor efektive, e drejta për një gjykim të shpejtë dhe të drejtë, si dhe e drejta për mbrojtje të barabartë para ligjit. Është plotësisht e përshtatshme dhe me vend që shteti të kompensojë personin në rastet në të cilat vërtetohet dënimi i padrejtë.

Nevoja për të përgatitur një sërë mekanizmash dëmshpërblyes ndaj viktimave të burgosur në mënyrë të padrejtë, është evidentuar që në kohën e lëvizjes iluministe, teksa studiuesit e kësaj doktrine u ngarkuan për të përgatitur këto mekanizma¹. Këto mekanizma për herë të parë u përfshinë në Kodin Penal Italian të vitit 1786, të miratuar nga Duka i Toskanës, Pietro Leopoldo. Konkretisht, në një prej nenet e këtij kodi, sanksionohet dëmshpërblimi në favor të subjekteve të cilët njiheshin të pafajshëm, pasi procedoheshin dhe burgoseshin. Në veçanti, kompesimi dhe shpërblimi u njihej dhe atyre personave ndaj të cilëve ishin aplikuar masat e sigurisë, qoftë gjatë procesit apo para fillimit të tij. Shuma e parave e cila do të vrente për të dëmshpërblyer individët, ishte përcaktuar të merrej nga një fond i veçantë.²

Edhe pse tashmë u mundësua ekzistenca e një rregullimi konkret ligjor, ky kod nuk u zbatua asnjëherë, por pavarësisht kësaj ky kod u shndërrua në model për ndërhyrjet e mëtejshme që do të kryheshin mbi këtë institut.

Eksponentët e doktrinës pozitiviste italiane afirmuan nevojën që ligjvënësi të përqëndronte vëmendjen e vet mbi institutin e dëmshpërblimit për burgim të padrejtë, ku në diferencë me Kodin Penal Francez, dëmshpërblimi duhej t'i njihej vetëm individëve të cilët ishin dënuar në mënyrë definitive dhe më pas ishin deklaruar të pafajshëm. Pra, mundësia e kompesimit të dëmit të derivuar si pasojë e aplikimit të padrejtë të masave të sigurisë, përjashtohet.³

¹ Ersi Bozhegu, "Burgimi i padrejtë dhe dëmshpërblimi ndaj tij", "Avokatia", Nr 2, Botimi 2012, fq 55-68.

² Gaetano Filangeri, "La science della legislazione francese", Milano, 1780.

³ Raffaele Garofalo, "Riparazione alle vittime del delitto, Fratelli Bocca, Torino, 1887.

Në Kodin Penal Gjerman të vitit 1904 ka ekzistuar një nen për viktimat e “gabimeve gjyqësore”. Në diferencë nga Italia, Gjermania nëpërmjet këtij kodi kishte parashikuar edhe detyrimin e Shtetit për t’i njohur viktimave të “burgimit të padrejtë” “një dëmshpërblim, edhe në rastin kur ky burgim ndodhte gjatë fazës së aplikimit të masave të sigurisë.

Në ditët e sotme ky institut parashikohet nga të gjitha vendet e Bashkimit Evropian, të cilët kanë radifikuar Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive themelore të Njeriut (KEDNJ). Njëkëtë Konventë, përveç mbrojtjes gjyqësore të të drejtave, kemi edhe garantimin e të drejtës për dëmshpërblim, në rastet e dënimit të padrejtë, ku konkretisht parashikohet se: “Çdo person viktimë e arrestimit ose ndalimit në kundërshtim me ndonjë dispozitë të këtij neni, ka të drejtën e dëmshpërblimit”.

Në vendin tonë ky institut është parashikuar për herë të parë në Kodin e Procedurës Penale, megjithatë kultura për dëmshpërblimin nga burgimi i padrejtë, është prezente edhe në Kushtetutën e Nëntorit të vitit 1998. Në nenin 44 të Kushtetutës përcaktohet se “*kushdo ka të drejtë të zhdëmtohet, në përputhje me ligjin në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore*”. Pikërisht, në këtë dispozitë kushtetuese gjendet legjitimiteti i së drejtës për kompensimin e burgimit të padrejtë si dhe për dëmet e shkaktuara nga veprimet e tjera të dhunshme të kryera nga personat zyrtarë. Kompensimi i burgimit të padrejtë është një institut relativisht i ri i së drejtës dhe shumë pak i studiuar në doktrinën juridike shqiptare. Megjithëse instituti i kompensimit të burgimit të padrejtë bazën e ka në dispozitat kushtetuese⁴, për të përcaktuar kriteret e tij të aplikimit, duhet patjetër t’i referohemi dispozitave procedurale civile, në mënyrë të posaçme për sa i përket legjitimitetit të padisë dhe masës së shpërblimit. Instituti i kompensimit të burgimit të padrejtë është një institut juridik “*sui generis*”, ka një natyrë juridike “*interdisiplinore*”.⁵

Për të parën herë, e drejta për kompensim është parashikuar në Kushtetutën e Republikës Popullore të Shqipërisë të vitit 1946⁶. Në nenin 34 të kësaj Kushtetute parashikohet: “*Në konditat e caktuara me ligje, shtetasit kanë të drejtë të kërkojnë prej shtetit ose nëpunësve të tij një shpërblim për dëmin që kanë pësuar nga fakti i kryerjes së një shërbimi në kundërshtim me ligjin ose në mënyrë të parregullt.*”

Sipas kësaj dispozite kushtetuese, shtetasit i njihej e drejta të kërkonte prej shtetit ose prej nëpunësve të tij një shpërblim për dëmin që shtetasi ka pësuar nga

⁴ Neni 44 i Kushtetutës së RSH.

⁵ Eniana Qarri, “Aspekte civile të kompensimit të burgimit të padrejtë dhe viktimave të krimeve të dhunshme, Punim Masteri, 2011.

⁶ Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë, miratuar nga Asambleja Kushtetuese e dalë nga zgjedhjet e Dhjetorit të vitit 1945, u shpall dhe hyri në fuqi në 16 Mars 1946. Për më shumë shih, Aurela Anastasi, “E drejta Kushtetuese” (cikël leksionesh), Tiranë, 2003, fq.50.

një shërbim i kryer nga organet shtetërore në mënyrë të parregullt ose në mënyrë të paligjshme. Në raport me nenin 44 të Kushtetutës aktuale, kjo dispozitë i njeh të drejtën individit për të kërkuar shpërblim vetëm në ato raste kur organet shtetërore ose nëpunësit e tyre kryejnë një shërbim (kur kryejnë një veprim) të paligjshëm ose të parregullt. Ndërkohë që neni 44 parashikon të drejtën për të zhdëmtim jo vetëm në rastin e një veprimi të paligjshëm të organeve shtetërore por dhe në rastin e mosveprimit të tyre.

Gjithashtu, neni 44 parashikon që ky veprim ose mosveprim i cili lind të drejtën për të kërkuar shpërblim të jetë i paligjshëm, në dallim nga neni 34 i Kushtetutës së vitit 1946 e cila kërkon që ky veprim i organeve shtetërore të jetë i paligjshëm ose i parregullt. Në bazë të kësaj dispozite kushtetuese (neni 34 i Kushtetutës së RPSH), shtetasi, i cili kishte pësuar një dëm nga një veprim i paligjshëm ose i parregullt i organeve shtetërore gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre, kishte të drejtë të kërkonte shpërblimin e dëmit jo vetëm nga shteti, por edhe drejtpërdrejtë nga nëpunësi shtetëror, i cili kishte shkaktuar dëmin.⁷

Më pas e drejta për kompensim është parashikuar edhe në Kushtetutën e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë të vitit 1976.⁸ Në nenin 59 pika 2 të saj parashikohet se: *“Shtetasi, sipas kushteve të caktuara me ligj, kanë të drejtë të kërkojnë zhdëmtim nga shteti ose nga nëpunësit e tij për dëmet që u shkaktohen nga veprimet e paligjshme të organeve shtetërore dhe të nëpunësve gjatë ushtrimit të detyrës”*

Ky nen ashtu si neni 34 i Kushtetutës së 1946, në ndryshim nga neni 44 i Kushtetutës aktuale garanton të drejtën për të kërkuar zhdëmtim për dëmin e pësuar vetëm si pasojë e një veprimi të paligjshëm të organeve shtetërore apo të nëpunësve të tyre, por nuk parashikon rastin kur dëmi është shkaktuar nga një mosveprim i organeve shtetërore gjatë ushtrimit të detyrës.

2. Natyra juridike e dënimit dhe burgimit të padrejtësi dhe rregjimi juridik i institutit të dënimit dhe të burgimit të padrejtë

Përcaktimi i natyrës juridike të dënimit dhe burgimit të padrejtë, ka rëndësi të veçantëpraktike, pasi në bazë të tij përcaktohet rregjimi juridik i kompesimit dhe shpërblimit nga dënimi dhe burgimi i padrejtë.

Përsa i përket kuptimit të dënimit, duke qenë se në Kodin Penal aktual nuk jepet as përkufizimi dhe as qëllimi i dënimit, jemi të detyruar t'i drejtohem doktrinës së të drejtës penale. Konkretisht, në bazë të doktrinës dalim në konkluzionin se,

⁷ Eniana Qarri, “Aspekte civile të kompesimit të burgimit të padrejtë dhe viktimave të krimeve të dhunshme, Punim Masteri, 2011.

⁸ Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, miratuar nga Kuvendi popullor më 28 Dhjetor 1976. Për më shumë shih, Aurela Anastasi” E drejta Kushtetuese” (cikël leksionesh), Tiranë, 2003, op.cit., fq.52.

dënimi penal është forma juridike e shtrengimit shtetëror, i lindur dhe i destinuar për ndëshkimin dhe parandalimin e veprave penale.⁹ Dënimi penal ka funksion të dyfishtë, pasi ai vepron njëkohësisht si mjet i domosdoshëm detyrimi dhe ndëshkimi, që zbatohet nga gjykata kundër të gjithë personave që kryejnë vepra penale, por njëkohësisht dhe si masë për parandalimin e veprave penale.¹⁰

Qëllimi i dënimit penal, përfshin shumë momente të rëndësishme, që ndikojnë tek i dënuari, sikurse mund të përmendim: riedukimin, izolimin, përpjekjen për riintegrimin e tij në shoqëri etj.¹¹ Dënimi penal ekziston dhe zbatohet në përputhje me parimin e ligjshmërisë, çka nënkupton se dënimi i autorëve të veprave penale bëhet vetëm me ligj dhe caktimi i tij bëhet gjithashtu në përputhje të plotë me ligjin penal në fuqi. Me respektimin e këtij parimi mbrohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, paprekshmeria e tij fizike, morale dhe pasurore, duke synuar dhe garantuar që asnjë fajtor të mos ketë mundësi që ti shmanget dënimit dhe marrjes në përgjegjësi nga ana e shtetit për veprën dhe dëmin e shkaktuar si dhe për të shmangur ato situata të padëshiruara dhe të papranueshme për shoqërinë, me qëllim që asnjë shtetas të mos dënohet në mënyrë të padrejtë.

Deri në këtë moment kemi dhënë një panoramë të qartë për kuptimin e dënimit, porçfarë kuptojmë dënimin e padrejtë?

Nga leximi i ligjit material dhe procedural që parashikojnë këtë institut, nuk del kuptimi i dënimit të padrejtë, por kuptimin mund ta nxjerrim nëpërmjet interpretimit të dispozitave në të cilat parashikohet ky institut. Nga leximi i nenit 459 të Kodit të Procedurës Penale del se *“Ai që ka marrë pafajësinë gjatë rishikimit ..., ka të drejtë për një kompesim në përpjestim me kohëzgjatjen e dënimit dhe me pasojat personale dhe familjare që rrjedhin nga dënimi”*. Nga interpretimi i kësaj dispozite, me dënim të padrejtë, do të kuptojmë atë situatë ku personi është dënuar nga një gjykatë kompetente, sipas një procedure të caktuar, duke respektuar procesin e rregullt ligjor, i cili është shpallur fajtor me vendim të formës së prerë, por që më vonë gjatë rishikimit gjyqësor ai është shpallur i pafajshëm për dënimin e dhënë. Pra, mund të themi se dënim i padrejtë, është çdo dënim i dhënë ndaj një personi që më vonë është prishur dhe personi është shpallur i pafajshëm, pavarësisht se dënimi mund të jetë ekzekutuar plotësisht ose personi mund të ketë vdekur para se të jetë shpallur i pafajshëm.

Të drejtën për të përfituar kompensimin e ka çdo person i cili është deklaruar i pafajshëm ose për të cilin është pushuar çështja me vendim gjykate të formës së prerë apo të prokurorit, ose është mbajtur në burg tej kohës së caktuar në vendimin e dënimit.¹²

⁹ Shefqet Muçi, “E Drejta penale”, Tiranë, 2007, fq 225.

¹⁰ Po Aty.

¹¹ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr. 65, datë 10.12.1999.

¹² Neni 2, Ligji nr. 9831, datë 28.04.2005 “Për Kompesimin e Burgimit të Padrejtë”.

Përsa i përket burgimit të padrejtë, kuptohen të gjitha ato raste të parashikuara shprehimisht në nenin 3 të ligjit nr. 9831, datë 28.04.2005 “Për Kompesimin e Burgimit të Padrejtë”, të cilat kanë të bëjnë me:

- periudhën e paraburgimit për një çështje apo akuzë, për të cilën prokuroria ka pushuar hetimet ose gjykata ka dhënë pafajësi ose ka pushuar çështjen;

- periudhën e burgimit në zbatim të një vendimi, i cili, pas vënies në ekzekutim, është prishur dhe është dhënë pafajësi ose është pushuar çështja me vendim të formës së prerë;

- periudhën e paraburgimit ose të burgimit më tepër nga sa është dënuar me vendim të formës së prerë;

- periudhën e paraburgimit kur me vendim gjykate të formës së prerë, është vërtetuar se akti ishte nxjerrë pa respektuar kushtet e parashikuara në nenet 228 dhe 229 të Kodit të Procedurës Penale;

- Periudhën e paraburgimit të padrejtë e shkaktuar nga gabimi në urdhrin e ekzekutimit të vendimit si dhe me periudhën e vuajtjes së arrestimit në rastet e përcaktuara në periudhën e 1-rë, 3-të, 4-të dhe të 5-të, të lartpërmendura¹³.

Përveçpërcaktimit të natyrës juridike të dënimit dhe burgimit të padrejtë, i një rëndësie të veçantë është dhe trajtimi i rregjimit juridik të institutit të kompesimit dhe shpërblimit nga dënimi dhe burgimi i padrejtë. Me rregjim juridik të këtij instituti, kuptojmë tërësinë e rregullave të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale, të cilave i nënshtrohen rastet e dënimit dhe burgimit të padrejtë. Kategorizimi i institutit të kompesimit nga burgimi i padrejtë paraqet një rëndësi të veçantë, për shkak të rregjimit juridik të ndryshëm të parashikuar në kodin e sipërcituar, për secilin rast të dënimit dhe të burgimit të padrejtë.

Ndër aktet ndërkombëtare tek të cilat është parashikuar ky insti-tut,vlen të ndalemi tek neni 5-së i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në nenin 5/5 të kësaj Konvente si dhe në nenin 14/6 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike”. Neni 5-së i Konvetës parashikon se: “Çdo person ka të drejtën e lirisë dhe sigurisë. Askujt nuk mund t’i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në mënyrën e përcaktuar me ligj...” Neni 5/5 i Konvetës parashikonse “Çdo person viktimë e arrestimit ose ndalimit në kundërshtim me ndonjë dispozitë të këtij neni, ka të drejtë dëmshpërblimi”.Përsa i përket neni 14/6 të paktit të sipërcituar, parashikohet se “Kur një dënim penal përfundimtar anulohet më pas, ose kur jepet falje për shkak se një fakt i ri ose i zbuluar rishtaz provon se është bërë një gabim gjyqësor, personi që ka pësuar nga ky dënim do të dëmshpërblehet në përputhje me ligjin, me përjashtim të rasteve kur provohet se mospërmendja e faktit të panjohur në kohën e duhur tërësisht ose pjesërisht i detyrohet vetë atij”.

¹³ Neni 3, Ligji nr. 9831, datë 28.04.2005 “Për Kompesimin e Burgimit të Padrejtë”.

Lidhur me këto dy nene, është e qartë se klauzolat e përfshira në to, u përgjigjen nevojës për të siguruar dëmshpërblimin sa herë që kufizimi i lirisë personale është vendosur kundër ligjit. Dëmshpërblimi nga dënimi dhe burgimi i padrejtë për shkak të gabimit gjyqësor, janë aspekte të ndryshme të një parimi të vetëm të kulturës ligjore, sipas të cilave shteti është i detyruar të sigurojë kompesim, për ata që kanë qënë të dëmtuar¹⁴.

Kompesimi financiar nga dënimi dhe burgimi i padrejtë, në të drejtën tonë, parashikohet shprehimisht në ligjin nr. 9381, datë 28.04.2005, "*Për Kompensimin e Burgimit të Padrejtë*". Në këtë ligj parashikohen rastet e përfitimit dhe kompesimit për burgim të padrejtë, përfshirë arrestin në shtëpi dhe masën e mënyrën e llogaritjes së tij, si dhe procedurat për pagesën dhe kompesimin për burgim të padrejtë. Përfshirja e këtij instituti konsiston në njohjen e parimit sipas të cilit, kushdo që ka qenë i privuar padrejtësisht nga liria personale, ka të drejtën e një shpërblimi të drejtë nga shteti për dëmin e pasurisë dhe sidomos për dëmin moral që vuan subjekti.

Kërkesa për kompensimin e burgimit të padrejtë me qëllim shpërbimin e një dëmi të shkaktuar individit nga organet e administratës shtetërore ka natyrë juridike civile, ka karakter pasuror dhe interesa ekskluzivisht ekonomike. Këtë qëndrim ka mbajtur dhe praktika gjyqësore shqiptare. Në vendimin nr.118, datë 16.03.2010, Kolegji civil i Gjykatës së Lartë shprehet se: "*Mosmarrëveshja objekt gjykimi, me të cilën kërkohet të dëmshpërblehet financiarisht paditësi për pasojat që i kanë ardhur nga arrestimi i padrejtë, është një mosmarrëveshje e natyrës juridike civile*".

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vendimin nr.864, dt. 03.07.2007, sipas të cilit: "*Mosmarrëveshja objekt gjykimi ka të bëjë me rivendosjen e të drejtave të pretenduara që i janë shkelur palës nga një procedim penal i filluar duke bërë burgim të padrejtë, për të cilin i kërkon palës përfaqësuese të shtetit ta kompensojë në vlerë monetare për dëmin e shkaktuar, pra është mosmarrëveshje civile*".

Një rregullim tjetër i së drejtës për kompesim bëhet dhe nga praktika e unifikuar e Gjykatës së Lartë¹⁵. Në këtë vendim Gjykata e Lartë është shprehur për njëhësimin e praktikës gjyqësore, për problemet e dala deri në atë kohë. Ky vendim i ka dhënë zgjidhje një sërë problematikash, të cilat deri në atë kohë kanë qënë të parregulluara nga ligjet në fuqi. *Kolegjet e Bashkuara*, në vendim, kanë konkluduar se natyra e dëmtimeve të karakterit pasuror që pëson personi gjatë kohës së qëndrimit padrejtësisht në burg nuk është e njëjtë me dëmin që i shkaktohet një personi, në mënyrë të paligjshme dhe me faj në kuptimin e "dëmit" sipas konceptit të së drejtës civile. *Kurrsesi nuk mund të vihet shenja e barazimit midis kompesimit, nga ana*

¹⁴ Një detyrim i tillë, vlen edhe për vendin tonë, të cilin e gjejmë të sanksionuar në Kushtetutë në nenin 44.

¹⁵ Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë, nr.3, datë 27.03.2003

e shtetit, për personin e burgosur pa të drejtë, për dëmet pasurore që ai ka pësuar gjatë kohës që ai ka qëndruar në burg pa të drejtë e për shkak të këtij qëndrimi, nga njëra anë, dhe shpërblimit të dëmit si institut i të së drejtës civile, nga ana tjetër.¹⁶

Prandaj dhe nga mënyra e llogaritjes dhe kriteret që duhen ndjekur gjatë procesit të llogaritjes, në rastin e shqyrtimit nga gjykata të kërkesave për kompesim për burgim të padrejtë, i nënshtrohen një rregullimi tjetër ligjor dhe jo atij të parashikuar nga neni 640 i Kodit Civil i cili vlen për konceptin e dëmit në kontestin e së drejtës civile.

Përgjegjësia civile jashtëkontraktore për shpërblimin e dëmit kërkon patjetër ekzistencën e fajit të shkaktuesit të dëmit në formën e dashjes apo pakujdesisë së rëndë, në rastin konkret të gjyqtarit që ka dhënë vendimin.

Ndërsa kompensimi i burgimit të padrejtë nuk kërkon si kusht fajin e gjyqtarit në dhënien e vendimit që ka çuar në kufizimin arbitrar të lirisë¹⁷. Meqenëse në rastin e përgjegjësisë së kompensimit të burgimit të padrejtë mungon një nga elementët e sipërpërmendur, atëherë jemi të mendimit, që e drejta për kompensimin e burgimit të padrejtë nuk mund të identifikohet me institutin civil të shpërblimit të dëmit.

Sipas pikës 2, të nenit 269, të Kodit të Procedurës Penale, masa e kompesimit për burgim të padrejtë dhe mënyra e llogaritjes së tij, caktohen me ligj të veçantë. Këtu kemi një vakum të krijuar në legjislacion, për shkak të mosmiratimit ende të një ligji të veçantë, me objekt përcaktimin e masës së kompesimit për burgim të padrejtë dhe për mënyrën e llogaritjes së tij. Kjo vendos në vështirësi gjykatat teksa kanë çështje me natyrë të tillë, e konkretisht teksa llogarisin masën e kompesimit.

Pavarësisht mungesës së dispozitave të cilat përcaktojnë konkretisht masën e shpërblimit, përsëri legjislatori me anë të ligjit nr. 9831, datë 28.04.2005 “Për Kompesimin e Burgimit të Padrejtë” ka përcaktuar disa kriteret të cilave duhet tju referohen gjykatat në momentin e caktimit të shpërblimit. Këto kriteret janë:¹⁸

- a) të ardhurat nga paga për të punësuarit në sektorin publik ose në sektorin privat, deri një muaj para burgimit;
- b) fitimin e realizuar nga veprimtaritë tregtare dhe fitimprurëse gjatë tri viteve të fundit para burgimit;
- c) pensionet e përfituara para ose gjatë paraburgimit;
- ç) pagën minimale në shkallë vendi për ata që kanë qenë pa punë, të paktën një muaj para datës së burgimit;
- d) rrethana të tjera, të lidhura me gjendjen ekonomike e familjare të të burgosurit;
- dh) të ardhurat nga puna në burg.

¹⁶ Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë, nr.3, datë 27.03.2003

¹⁷ Elga Turco, “L’equa riparazione tra errore giudiziario e ingiusta detenzione”, Milano, Giuffrè Editore, 2007, fq.4.

¹⁸ Neni 5, Ligji nr. 9831, datë 28.04.2005 “Për Kompesimin e Burgimit të Padrejtë”.

Baza e përgjegjësisë, për zhdëmtimin e dëmit të pësuar nga dënimi dhe burgimi i padrejtë, është vetë fakti i dënimit në mënyrë të padrejtë, ndërsa si burime për dëmshpërblim shërben i gjithë legjislacioni në fuqi, jo vetëm ai kombëtar por dhe ndërkombëtar.

3. Kushtet për lindjen e dëmshpërblimit nga dënimi dhe burgimi i padrejtë

Kushtet e dënimit të padrejtë, dalin nga leximi i nenit 459/1 i Kodit të Procedurës Penale, në të cilin parashikohet se: *“Ai që ka marrë pafaqësinë gjatë rishikimit, kur nuk ka dhënë shkak me dashje apo pakujdesi të rëndë për gabim gjyqësor, ka të drejtë për një kompesim në përpjestim me kohëzgjatjen e dënimit dhe me pasojat personale dhe familjare që rrjedhin nga dënimi”*.

Në bazë të këtij neni nxjerrim në dukje domosdoshmërinë e ekzistencës së një vendimi gjyqësor të formës së prerë, e për rrjedhojë dhe kërkesën për rishikim në bazë të së cilës subjekti del i pafashëm me vendim si dhe domosdoshmërinë e ekzistencës së një gabimi gjyqësor në vendimin e mëparshëm.

Kemigabim gjyqësor në të gjitha ato raste të cilat kanë çuar në dhënien e një vendimi të padrejtë fajësie, ku më vonë gjatë procesit të rishikimit është dhënë vendim pafajësie. Duke qenë se në ligj nuk parashikohet gabimi gjyqësor dhe rastet e tij, kuptimi i tij, del nga referimi në doktrinën juridike. Një gabim gjyqësor, në rradhë të parë, është bindja dhe dënimi i një personi për një vepër të cilën ai nuk e ka kryer. Termi gjithashtu mund të aplikohet për gabime në drejtim të “gabimit të mosndëshkimit”. Për të dhënë raste e dënimit të padrejtë do të na duhet një lexim i kombinuar i dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, konkretisht të nenit 450, i cili parashikon kushtet e rishikimit, me neni 459 të këtij kodi.

Për sa më sipër mund të themi se gabim gjyqësor do të kemi në të gjitha ato raste kur:

- faktet e vëna në themel të vendimit që rishikohet nuk pajtohen me ato të një vendimi tjetër të formës së prerë;
- kur vendimi është bazuar në një vendim të gjykatës civile, i cili është revokuar më pas;
- kur pas vendimit kanë dalë ose janë zbuluar prova të reja, të cilat vetëm ose sëbashku me ato që janë vlerësuar njëherë, tregojnë se vendimi është igabuar;
- si dhe kur vërtetohet se vendimi është dhënë si pasojë e falsifikimit të akteve të gjykimit ose të një fakti tjetër të parashikuar nga ligji si vepër penale.

Kushtet për burgim të padrejtë, kanë të bëjnë më gabime të lidhura me kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal, vlerësimin e gabuar të faktit i cili nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, gabimin në urdhërin e ekzekutimit të vendimit, vuajtjen e dënimit më shumë seçështë dhënë në vendimin përfundimtar, qëndrimin në paraburgim tej afateve të parashikuara për një masë të tillë. Kushte të

tjera janë si: pushimi i çështjes apo akuzës nga gjykata ose prokuroria, dhënia e pafajësisë apo ekzekutimit të vendimit të formës së prerë.

4. Roli i individit të dënuar dhe të burgosur në mënyrë të padrejtë

Roli i individit për të fituar të drejtën për kompesim është i një rëndësie të veçantë. Pozita e tij si subjekt i së drejtës për kompesim nga dënimi dhe burgimi i padrejtë mund të shpjegohet lehtë duke pasur para-

sysh numrin më të vogël të akteve të së drejtës për kompesim, të cilat parashikojnë të drejta dhe detyrime për individët, në krahasim me ato që parashikojnë të drejta dhe detyrime për shtetin. Gjatë procesit të kompesimit personi, përveç të drejtës për tu kompesuar ka dhe detyrime. Në bazë të këtyre detyrimeve që ka individi i dënuar dhe i burgosur në mënyrë të padrejtë, varet e drejta e tij për tu kompesuar.

Përsa i përket detyrimeve të individit të burgosur padrejtësisht na shërben neni 268 i Kodit të Procedurës Penale si dhe neni 4 i Ligjit Nr 9381, datë 28.04.2005 “Për kompesimin e burgimit të padrejtë”. E drejta për tu kompesuar humbet ose për shkak të qëndrimit të individit ose për shkaqe të pavarura nga vullneti i individit.

❖ Dy janë rastet e humbjes së të drejtës për kompesim për shkak të qëndrimit të individit, konkretisht, kur është provuar që vendimi i gabuar ose moszbulimi në kohën e duhur i faktit të panjohur është shkaktuar tërësisht ose pjesërisht prej tij.

❖ Gjithashtu, dy janë dhe rastet e humbjes së të drejtës për kompesim për shkaqe të pavarura nga vullneti i individit¹⁹.

Personi do të përjashtohet nga e drejta për kompensim për burgim të padrejtë vetëm në rast se:

- gabimi në marrjen e një vendimi, i cili ka kufizuar gabimisht lirinë personale të këtij personi, është shkaktuar nga veprimet e këtij të fundit, p.sh: personi ka deklaruar se, ka qenë ai që ka kryer veprën penale ndërkohë, që në përfundim të hetimeve apo të shqyrtimit gjyqësor, përkatësisht prokurori apo gjykata arrin në përfundimin se, vepra penale nuk është kryer nga personi në fjalë i akuzuar por, nga një person tjetër;

- moszbulimi në kohë i faktit të panjohur është shkaktuar tërësisht apo pjesërisht nga veprimet e personit të akuzuar dhe për këtë shkak është shtuar koha e burgimit të vuajtur padrejtësisht nga ky person, p.sh.: personi i akuzuar m.gj.s. e di se kush e ka kryer veprën penale nuk bashkëpunon me organet e drejtësisë, duke qëndruar vetë në burg, apo personi m.gj.s. ka djeni se, ndaj tij ka një shkak që pengon fillimin apo/dhe vazhdimin e procedimit penal nuk e deklaron këtë të dhënë përpara organit procedues (prokurorisë apo gjykatës).

- zgjatja e periudhës së burgimit të padrejtë ka ardhur si rezultat i mosveprimeve me faj (dashje apo pakujdesi) të personit të akuzuar, p.sh: në rastin kur gjykata, në vendimin e saj përfundimtar me të cilin ka deklaruar të pafajshëm të pandehurin,

¹⁹ Neni 4 i ligjit Nr.9381, datë 28.04.2005, “Për kompesimin e burgimit të padrejtë”.

nuk është shprehur për lirimin e të pandehurit të paraburgosur apo për heqjen e masës së sigurimit personal «arrest në burg», e cila po zbatohet ndaj këtij të pandehuri dhe ky i fundit nuk kërkon që, gjykata, në zbatim të nenit 389 të K.Pr. Penale, të shprehet për lirimin e tij nga paraburgimi, apo nga detyrimi për të zbatuar masën e sigurimit «arrest në shtëpi».

Përveç rolit të individit në lidhje me të drejtën e tij për të fituar kompesim nga dënimi dhe burgimi i padrejtë, shumë i rëndësishëm është dhe roli i shtetit, i cili është garanti kryesor në përfitimin e kësaj të drejte.

5. Dëmi i pësuar nga dënimi dhe burgimi i padrejtë. Llojet dhe procedura e shpërblimit të dëmit

Në të gjitha raportet juridike, i dëmtuari që të mund të realizojë të drejtën për shpërblimin e dëmit të shkaktuar, ka parashikuar plotësimin e disa kushteve të caktuara. Kushtet për lindjen e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, nënkuptojnë ato rrethana të cilat, duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, që subjekti përgjegjës që ka shkaktuar dëmin të mund të përgjigjet. Në kuadër të kësaj mund të përcaktojmë se kushtet e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar nuk janë unike, por ato dallohen në rastet kur përgjegjësia krijohet duke u bazuar tek përgjegjësia objektive apo tek ajo subjektive.

Në doktrinë është përcaktuar se, që të lindin detyrime nga dëmi jashtëkontraktor duhet të kontribuojnë disa kushte sëbashku ashtu si:

- ekzistenca e dëmit;
- ekzistenca e paligjshmërisë së veprimit ose të mosveprimit;
- ekzistenca e fajit, si dhe
- ekzistenca e lidhjes shkakësore midis veprimeve të veprimit dhe dëmit të ardhur²⁰.

Gjithsesi mos të harrojmë vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë²¹, ku ishte konkluduar se dëmi në këtë rast nuk trajtohet identik si dëmi në konceptin e së drejtës civile. Pra, faji i shtetit në këtë rast është i ndryshëm nga faji tek dëmet jashtëkontraktore, pasi shteti ngarkohet me përgjegjësi për shkak të detyrimeve të tij negative dhe pozitive si dhe për shkak të veprimeve të organeve që veprojnë në kuadër të tij. Përsa i përket termit dëm²², ky përdoret për të treguar dëmin që i shkaktohet pasurisë por dhe dëmin ndaj personave, dinjitetit dhe nderit të tij.²³

²⁰ Mariana Semini (Tutulani), “E drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave”, pjesa e Përgjithshme, Skanderbegbook, Tiranë, 2006, fq.226.

²¹ Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë, nr.3, datë 27.03.2003.

²² Kodi Civil, Neni 608/2, “Dëmi quhet i paligjshëm kur është rrjedhim i shkeljes ose i cenimit të interesave dhe i të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira.”

²³ Andon Sallabanda, “E drejta e detyrimeve”, Tiranë, 1961, fq. 301.

Llojet e dëmeve të shkaktuara nga dënimi dhe burgimi i padrejtë janë si: dëmi pasuror, dëmi ekzistencial, dëmi jopasuror, dëmi moral si dhe dëmi biologjik. Gjithashtu, dëmet e pësuar ndaj personave fizikë apo juridike vijnë si nga dënimet kryesore por dhe nga dënimet plotësuese.

Dëmi paraqet cënimin e vlerave materiale apo personale të personit, të cilat janë të mbrojtura juridikisht. Detyrimi për shpërblimin e dëmit paraqitet si sanksion që në momentin e lindjes sëpërgjegjësisë civile. Duke shpërblyer dëmin e shkaktuar, synohet që të vendoset ajo gjendje që ka ekzistuar para momentit të shkakimit të dëmit. E drejta për të shpërblyer dëmin, siç e kemi përmendur buron si nga Kushtetuta ashtu dhe nga ligji specifik *“Për kompesimin e burgimit të padrejtë”*.

Personi i dënuar padrejtësisht që të realizojë të drejtat e tij, në ushtrimin e kërkesës për kompesim të dëmit, duhet të vërtetojë se ka përjetuar dëmin në rastin konkret dhe kjo realizohet me anë të kërkesës përpara gjykatës.

Gjyqtari, që gjykon kërkesën për kompensimin e burgimit të padrejtë, gëzon liri dhe autonomi të gjërë për të gjykuar mbi procesin dhe vendimin penal, që kanë çuar në kufizimin e padrejtë të lirisë, jo për ta rivlerësuar këtë vendim, por për të evidentuar ekzistencën ose jo të rrethanave ligjore që çojnë në përjashtimin e subjektit nga e drejta e përfitimit të kompensimit. Vlerësimet e gjyqtarit penal dhe të gjyqtarit civil, që shqyrton kërkesën për kompensimin e burgimit të padrejtë, janë plotësisht autonome dhe të ndara njëri nga tjetri.

Me realizimin e rehabilitimit dhe/ose zhdëmtimit (shpërblimit) të dëmit, pasojat e dëmit të padrejtë kalojnë përfundimisht në anën e shtetit, sepse tani për personin e dënuar ose kthehet gjendja e mëparshme, ose merr shpërblimin në të holla, në formën e pagimit të një shume parash ose me dhënien e një të ardhure jetësore, duke pasur parasysh dëmin të cilin ka pësuar. Që të konsiderohen të zhdëmtuara pasojat e dënit, duhet që në tërësi të shpërblehet i gjithë dëmi, si ai pasuror dhe jopasuror.

Përsa i përket llojeve të shpërblimit të dëmit, doktrina njih dy lloje kryesore të shpërblimit të dëmit si: të dëmit material dhe të dëmit jomaterial. Në lidhje me procedurën e shpërblimit të dëmit, theksojmë domosdoshmërinë e bërjes së kërkesës nga ana e palës së dëmtuar për shpërblimin e dëmit.

KONKLUZIONE

E drejta për kompensimin e një dëmi të shkaktuar nga organet shtetërore gjatë veprimtarisë së tyre është një e drejtë e nivelit kushtetues. E drejta për kompensim për burgim të padrejtë, buron nga shkelja e një tjetër të drejte të garantuar nga kushtetuta që është e drejta për liri. Parashikimi i këtj instituti përfaqëson njohjen, në nivelin kushtetues, të parimit të një legjislacioni të qytetëruar dhe të mbrojtjes së vlerave të një shoqërie demokratike sipas së cilit kush është privuar padrejtësisht

nga liritë e tij personale, ka të drejtën e dëmshpërblimit për dëmet morale dhe materiale të vuajtura.

Drejtësia vihet në vend, jo vetëm atëherë kur fajtori dënohet për krimin e kryer, por atëherë kur viktimi e krimin merr kompensimin e drejtë për dëmet morale dhe materiale të pësuar nga krimi si dhe rehabilitohet, pra kthehet në gjendjen e mëparshme. Parashikimi i këtij instituti përfaqëson njohjen, në nivelin kushtetues, të parimit të një legjislacioni të qytetëruar dhe të mbrojtjes së vlerave të një shoqërie demokratike sipas së cilit kush është privuar padrejtësisht nga liritë e tij personale, ka të drejtën e dëmshpërblimit për dëmet morale dhe materiale të vuajtura.

Infrastruktura ligjore ndonëse në zhvillim, vazhdon të jetë mbrapa, në lidhje me kompesimin nga dënimi dhe burgimi i padrejtë, për personat fizikë dhe juridikë. Përpjekjet e Gjykatës së Lartë, për unifikim të praktikave gjyqësore, në disa raste kanë shkaktuar konfuzion, ndaj rekomandohet që vendimet unifikuese të dalin në mënyrë të qartë, duke shmangur kështu konfuzionin si dhe të dalin në përputhje me periudhën kohore aktuale. Është përmendur se legjislacioni për dëmin e pësuar nga burgimi dhe dënimi i padrejtë, si për personat fizike dhe juridike, ka hapësira boshe, për shkak të mungesës së legjislacionit, kohezjonit të ligjeve apo praktikave të gabuara dhe të vjetëruara. Kjo infrastrukturë ligjore, krijon pasiguri juridike. Mënyra e vetme për të minimizuar efektet e pasigurisë juridike është vazhdimi i përafrimit të legjislacionit me zhvillimet bashkohore evropiane. Gjithashtu, theksojmë se gjyqtarët nuk kanë asnjë pengesë institucionale, për të zgjidhur çështjen në themel, duke ju referuar zgjidhjeve të dhëna nga GJEDNJ-ja.

Në lidhje me kompesimin e burgimit të padrejtë, me ligjin nr.9381, datë 28.04.2005 “Për kompesimin e burgimit të padrejtë” janë bërë hapa përpara, duke u plotësuar kuadri ligjor në këtë fushë. Deri në momentin e miratimit të këtij ligji kompesimi i burgimit të padrejtë rregullohej nga vetëm dy nene të K.Pr.Penale dhe më vonë nga një vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë.

Neni 268 i K.Pr.P. e ka mjaft të ngushtë rrethin e rasteve, në të cilat mund të kërkohet kompesimi. Kjo dispozitë lë jashtë objektin të rregullimit të saj rastet e burgimit të padrejtë të vuajtur nga një person tej kufij-ve të përcaktuara në vendimin gjyqësor. Këtë boshllëk të K.Pr.Penale e rregullon ligji i ri “Për kompesimin e burgimit të padrejtë” i vitit 2005.

Është e drejtë të konstatojmë, që ky ligj, në krahasim me Kodin e Procedurës Penale e ka zgjeruar rrethin e subjekteve që legjitimohen për të kërkuar kompesim, ka përcaktuar masën e kompesimit, afatin e paraqitjes së kërkesës në gjykatë, gjykatën kompetente dhe ligjin e zbatueshëm në gjykim.

BIBLIOGRAFI

1. Andon Sallabanda, “E drejta e detyrimeve”, Tiranë, 1961.
2. Aurela Anastasi, “E drejta Kushtetuese” (cikël leksionesh), Tiranë, 2003.
3. Ersi Bozhegu, “Burgimi i padrejtë dhe dëmshpërblimi ndaj tij”, Revista “Avokatia”, Nr. 2, 2012.
4. Eniana Qarri, “Aspekte civile të kompensimit të burgimit të padrejtë dhe viktimave të krimeve të dhunshme, Punim Masteri, 2011.
5. Elga Turco, “L’equa riparazione tra errore giudiziario e ingiusta detenzione”, Milano, Giuffrè Editore, 2007.
6. Gaetano Filangeri, “La science della legislazione francese”, Milano, 1780.
7. Mariana Semini (Tutulani), “E drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave”, pjesa e Përgjithshme, Skanderbegbooks, Tiranë, 2006.
8. Raffaele Garofalo, “Riparazione alle vittime del delitto, Fratelli Bocca, Torino, 1887.
9. Shefqet.Muçi, “E Drejta Penale”, Tiranë,2007
10. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
11. Konventa e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
12. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile e Politike
13. Ligji nr.7905,datë 21.03.1995,Kodi i Procedurës Penalei Republikës së Shqipërisë
14. Ligji nr.7895, datë 27.01.1995, Kodi Penal i i Republikës së Shqipërisë
15. Ligji nr.7850, datë 29.07.1994, Kodi Civil i i Republikës së Shqipërisë
16. Ligji Nr. 9381, datë 28.04.2005, “Për kompesimin e burgimit të padrejtë”.
17. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr. 65, datë 10.12.1999
18. Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë, nr.3, datë 27.03.2003

INVESTIGIMI FINANCIAR, NJË MEKANIZËM KONTROLLI KUNDËR RRIJES SË KRIMINALITETIT

Msc. Odise MOÇKA
Këshilli i Ministrave

ABSTRAKT

Duke pasur parasysh rrezikun në rritje të depërtimit në ekonominë e ligjshme nga krimi i organizuar, hetimi ose investigimi financiar është një mjet thelbësor dhe një reagim bashkëkohor dhe efektiv ndaj kërcënimeve kriminale duke përfshirë financimin e terrorizmit.

Investigimi financiar mund të ofrojë metoda të reja të ndjekjes së veprimtarive kriminale, të përshkruajë të gjitha rrjetet kriminale përfshirë në degëzimet e tyre transnacionale dhe është kyç në zhvillimin e veprimeve parandaluese dhe proaktive përmes hartimit të mjeteve zbuluese dhe monitoruese.

Hetimi financiar mbart një vlerë proaktive dhe parandaluese. Është një mjet i rëndësishëm për të zbuluar Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe krime të tjera të rënda. Rezultatet e arritura nga përdorimi i metodave të hetimit financiar mund të shfrytëzohen kundër të gjitha tregjeve kriminale. Në shumë raste, hetimet financiare janë të nevojshme për të zhvilluar prova kundër kriminelëve të sofistikuar të nivelit të lartë me qëllim të çmontimit të rrjeteve të krimit të organizuar dhe transnacionale. Hetimet financiare mund të kontribuojnë gjithashtu në vlerësimin kombëtar të rrezikut të ardhur nga qarkullimi i parasë së fituar në mënyrë të paligjshme pasi ato sigurojnë njohuri mbi modelet dhe metodat e përdorura nga organizatorët e krimeve.

Megjithatë hetimet financiare kërkojnë një sërë aftësish, burimesh financiare, njerëzore dhe logjistike në mënyrë që të sjellë rezultatet e kërkuara. Njëkohësisht me zhvillimet e reja në rendin botëror lufta ndaj krimit të organizuar mund të arrihet vetëm nëpërmjet një bashkpunimi të shpejtë dhe efikas midis agjensive ligjzbatuese.

Nëpërmjet këtij artikulli synohet të sillen njohuri mbi zhvillimin e hetimeve financiare, metodat e përdorura, sugjerimet dhe rezultatet e arritura, me qëllimin e rritjes dhe forcimit të luftës ndaj kriminalitetit.

Fjalët kyçe; Investigim, Financë, Krim, Terrorizëm, Ligj.

Globalizimi i ekonomisë përveç prurjeve pozitive në ekonomi ndër të tjera ju shton mundësinë edhe organizatave kriminale të gjejnë lehtësira dhe mundësi qarkullimi të parave dhe të mirave materiale të fituara në mënyrë të paligjshme. Nëpërmjet mundësive që ofron globalizimi, krimi i organizuar ka arritur dhe tenton të gjej mënyra dhe metoda të reja për shtrirjen e tij dhe në aspektin ndërkombëtar. Këto organizata synojnë këtë shtrirje me qëllim të shtimit të kapitaleve të tyre dhe përfitimit të metejshëm. Në kundërpërgjigje të përhapjes së këtij fenomeni ju takon organeve ligjzbatuese hetimore të zgjerojnë bashkpunimin midis tyre si dhe të tregohen të ashpra dhe vigjilente në luftën kundër krimit të organizuar. Por përpara se të dalim në konkluzione, është me rëndësi të marrim në analizë format e krimit të organizuar si dhe disa fenomene të lidhura me to.

Krimi i Organizuar

Ky lloj krimi bën pjesë në krimet më të rënda sa i përket cenimit dhe shkatërrimit të marëdhënieve juridike që mbrojnë shëndetin, pasurinë, sigurinë publike si dhe vetë jetën. Ky lloj krimi zhvillohet në mënyrë paralele me zhvillimet ekonomike dhe shoqërore të shteteve dhe kryhet nga individë apo grupe personash të organizuar në formën e grupit të strukturuar kriminal apo organizata kriminale. Ndër format më të përdorura të krimit, nga këto grupe apo organizata mund të përmendim;

Trafikimi i qënieve njerëzore

Kjo lloj veprimtarie kriminale është një shkelje e rëndë e të drejtave themelore të njeriut dhe një formë jashtëzakonisht shkatërrimtare dhe shumë fitimprurëse të krimit të organizuar tashmë në nivel ndërkombëtar. Si i tillë, ai është e ndaluar nga legjislacioni penal me karakter kombëtar¹, rajonal², dhe ndërkombëtar³.

Ky lloj krimi trajtohet sot si një nga problemet prioritare të shoqërisë. Në instrumentet e ndryshme ndërkombëtare, trafikimi i qënieve njerëzore konsiderohet si “një shkelje e të drejtave themelore të njeriut, të dinjitetit dhe të integritetit të qënieve njerëzore”. Në këtë vështrim, trajtimi dhe analiza juridike e veprave penale në këtë fushë përbën një çështje të rëndësishme për të gjithë profesionistët e drejtësisë.⁴

¹ Kushtetuta, Neni 3 bazat e shtetit, Neni 25, 26, 27 liritë dhe të drejtat vetjake, Neni 122 Marrëveshjet ndërkombëtare. Kodi Penal: Dispozitat mbi trafikimin Neni 110/a; Neni 114/b; Neni 128/b. Ligji Nr. 10192, date 3.12.2009 “Mbi parandalimin dhe Luftën e Krimit të Organizuar”.

² Traktati i Funksionimit të Unionit European neni 83. Trafikimi i qënieve njerëzore si një formë veçanërisht serioze e krimit të organizuar. Karta e të Drejtave Themelore të BE-së (neni 5.3)

³ Dokumenti më i rëndësishëm ndërkombëtar që krijoi bazën për të luftuar Trafikimin e Njerëzve është Konventa e OKB kundër Krimit të Organizuar Transnacional, si dhe dy protokollat e saj shtese të ratifikuar nga Shqipëria me ligjin 8920 dt 11.07.2002.

⁴ Për më tepër shiko, Kuadri ligjor mbi trafikimin e qënieve njerëzore në Shqipëri dhe sfidat e hasura në praktikën gjyqësore, 2013, Shkolla e Magjistraturës.

Trafikimi human po bëhet gjithnjë e më tepër një fenomen global në rritje. Aspekti më i herët i globalizmit të shek.21. Asnjë vend apo rajon i botës nuk ka imunitet. Shifrat e trafikimit janë marramendëse, rreth 800,000-900,000 persona në vit (trafikim ndërkuftar). Rreth 2,000,000 persona në total (trafikim ndërkuftar + trafikim të brendshëm). Rreth 700,000 gra e fëmije të trafikuar çdo vit. Rreth 7-8 miliard dollarë amerikan të ardhura vjetore. Rreth 90 % e femra të huaja që punojnë në industrinë e seksit në Evropën Juglindore janë viktima të dyshuara të trafikimit, dhe 10-15 % e tyre janë të mitura.⁵

Trafikimi i qenieve njerëzore ka qënë një problem i mprehtë përgjatë gjithë periudhës së tranzicionit të shtetit shqiptar. Faktorët ekonomikë dhe shoqërorë kanë ndikuar në krijimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të këtij fenomeni kriminal. Ky lloj krimi ka qënë i preferuar për grupet kriminale për shkak të fitimeve të larta monetare dhe materiale që ata mund të realizonin. Faktorë ndihëms të zhvillimit të tij kanë qënë afërsia si dhe vendndodhja gjeografike e vendit tonë, i cili për hir të së vërtetës ka ndodhet në kryqëzimin midis vendëve ballkanike dhe të Europës lindore me ato të perëndimore. Në pjesën më të madhe të potencialit kriminal, vend ynë ka shërbyer si rrugë e ‘sigurt’ për grupet kriminale për zhvillimin e trafikimit.

Përgjithsisht viktima të këtij krimi kanë qënë femrat dhe fëmijët. Përvece trafikimit këto viktima janë shfrytëzuar më vonë edhe për prostitucion (femrat) ndërsa fëmijët për të ushtruar lypje në rrugë. Vitet e vështira ekonomike të pas 90, ndikuan edhe penguan në krijimin e një shteti ligjor të fortë. Kjo gjëndje apatike e krijuar nga institucione të dobëta, ju dhanë mundësi individëve të caktuar të organizoheshin në grupe kriminale si dhe të zgjeroheshin bashkpunimin duke u bërë pjesë e rrjeteve kriminale të rajonit dhe më gjërë.

Megjithatë, pas viteve 2000, organet ligjvënëse dhe ligjzbatuese filluan të merrnin masa për frenimin dhe luftimin e këtij fenomeni. Nëpërmjet shtimit dhe ashpërsimit të kuadrit ligjor, krijimit të gjykatave të posacme⁶ dhe ri organizimit të organit të Prokurorisë, u arrit një përmirsim i ndjeshëm luftës ndaj këtij krimi. Lufta kundër krimit të rëndë e atij të organizuar, hyri tashmë një fazë të rëndësishme të zhvillimit shoqëror të shoqërisë shqiptare e sistemit të drejtësisë në vecanti.

Në planin ndërkombëtar trafikimi i qenieve njerëzore e ka detyruar Unionin, të vendosë një kornizë ligjore dhe politike gjithëpërfshirëse, të fokusuar në gjini dhe në qendër të viktimave, përkatësisht Direktivës 2011/36/BE, Për luftimin dhe parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të saj”. Po kështu është hartuar dhe një strategji e cila ka për qëllim, çrrënjosjen e trafikimit të qenieve njerëzore për periudhën 2012-2020. Kjo strategji ka ofruar një bazë koherente dhe një drejtim të ri për politikën e BE-së në fushën e trafikimit të

⁵ Koça A. 2013. Trafikimi i qenieve njerëzore. Këndvështrimi juridik.

⁶ Ligji nr. 9110 dt.24.07.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave për Krimet e Rënda

qenieve njerëzore dhe që arrin të sjellë pothuajse të gjitha qëllimet e parashikuara.

Direktiva 2011/36/BE është akti legjislativ themelor i BE-së që adreson trafikimin e qenieve njerëzore. Ai vendos dispozita të forta për mbrojtjen, ndihmën dhe mbështetjen e viktimave, por gjithashtu për parandalimin dhe ndjekjen penale të krimit.

Së fundmi, Komisioni Europian miratoi një komunikatë mbi “Raportimin mbi ndjekjen e Strategjisë së BE-së për Zhdukjen e Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe identifikimin e veprimeve të mëtejshme konkrete”. Kjo komunikatë ndërtohet mbi politikën dhe legjislacionin ekzistues dhe propozon veprime të mëtejshme për të rritur parandalimin. Ajo fokusohet në ndërprerjen e modelit të biznesit që varet trafikimi i qenieve njerëzore, përmirësimin e aksesit të viktimave në të drejtat dhe sigurimin që veprimet e brendshme dhe të jashtme të BE ofrojnë një përgjigje të koordinuar dhe të qëndrueshme.⁷ Në bazë të kësaj komunikate vendoset theksi në zgjerimin e bazës së njohurive, ngritjen e vetëdijes dhe përmirësimin e të kuptuarit të këtij krimi kompleks, si dhe siguri i fondeve të duhura.

Trafikimi i armëve dhe municioneve luftarake

Me veprën penale të trafikimit të armëve dhe municionit do të kuptojmë importimin, eksportimin, tranzitimin dhe tregtimin, në kundërshtim me ligjin.⁸ Prania e këtij fenomeni kriminal në realitetin shqiptar ka pasur fillesat kryesore gjatë trazirave të vitit 97. Depozitat e mëdha të armatimit pronë e ushtrisë, ranë në duart e individëve të cdo lloji kategorie. Grupet kriminale shfrytëzuan këtë mundësi për trafikimin e këtij armatimi me qëllim realizimin e fitimeve monetare dhe materiale. Tregtia e paligjshme e tyre u zhvillua fillimisht kufijve dhe më pas mori shtrirje rajonale dhe ndërkombëtare.

Armët dhe municionet ju shërbejnë grupeve dhe rrjeteve kriminale fillimisht për krijimin e fitimeve por edhe për zhvillimin e veprimtarive të tjera kriminale si vjedhje, rrëmbim personi, akte terroriste, vrasje, kërcënime etj. Për këtë arsye, organet e drejtësisë janë të fokusuar në mënyrë të posacme për lufrimin e këtij aktiviteti. Kontrolli i armëve të zjarrit është vendimtar në luftën kundër krimit në tërësi, dhe në këtë aspekt politikatat e sigurisë publike fokusohen dhe orientohen drejtë prishjes së tregjeve kriminale.

Korrupsioni

Korrupsioni thënë ndryshe është shpërdorimi i pushtetit për përfitime private. Korrupsioni merr shumë forma, si ryshfeti, dhurata, favore, të mira materiale, pasuri, por gjithashtu mund të fshihet pas nepotizmit, konfliktit të interesit ose burokracive

⁷ Për më tej shiko në www.europa.lex

⁸ Kodi Penal i RSH, neni 278a.

shtetërore. Efektet e tij janë serioze dhe të përhapura fatkeqsisht në të gjitha institucionet me natyrë publike. Korrupsioni përbën një kërcënim për sigurinë, dhe një mundësi më shumë për krimin dhe terrorizmin. Ai ndikon tejet negativisht në rritjen ekonomike, duke krijuar pasiguri në gëzimin e të drejtave, duke ngadalësuar proceset dhe duke imponuar kosto shtesë për individët dhe organizimet e tjera shoqërore. Megjithëse natyra dhe fushëveprimi i korrupsionit mund të ndryshojnë nga një shtet i në tjetrin, pasojat e tij janë gati të njëjta pasi aot ndikojnë duke ulur nivelet e investimeve, duke penguar funksionimin e konkurrencës së ndershme dhe duke reduktuar financat publike.

Korrupsioni ndikon negativisht në objektivat e qeverisë duke filluar ndukuar në shtimin e të ardhurave buxhetore. Më e rëndësishmja, korrupsioni minon besimin tek qeveritë, institucionet publike dhe demokracia në përgjithësi.

Një mjet për të ndihmuar përpjekjet kundër korrupsionit është sigurimi i një standardi të lartë të legjislacionit, veçanërisht në lidhje me korrupsionin ose përfshirjen e elementeve anti-korrupsion në legjislacionin tjetër sektorial. Gjatë viteve të fundit në vëndin tonë klasa politike e ndikuar nga presioni publik dhe ai i komunitetit europian kanë shtuar përpjekjet në luftën kundër korrupsionit duke e parë këtë të fundit si një element kyç që kontribuon në rritjen ekonomike, punën dhe rritjes së investimeve. Parandalimi dhe luftimi i korrupsionit është një element kyç në ciklin e mirëqeverisjes ekonomike. Përgjithësisht tipologjitë e identifikuara të korrupsionit janë;

- ✓ Rryshfeti në sistemin e drejtësisë;
- ✓ Korrupsioni në procedurat e prokurimit;
- ✓ Rryshfeti në tatime, dogana;
- ✓ Keqpërdorimi i pozitave të nivelit të lartë me motive korruptive;
- ✓ Korrupsion për rimbursime të rreme shëndetsore dhe të ndryshme;

Trafikimi i Narkotikëve

Kjo lloj veprimtarie kriminale përfshin importimin, eksportimin, tranzitimin dhe tregtimin e paligjshëm të substancave narkotike ose psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike. Vecanërisht ky lloj krimi ka edhe përfitimet më të larta, dhe për këtë arsye grupet kriminale orientohen drejt zhvillimit të kësaj veprimtarie. Aktualisht, Shqipëria përmendet për herë të parë me shqetësim në raportin vjetor Europian të Drogave të vitit 2017, nga Qendra Europiane e Monitorimit të drogave dhe Varësisë nga Droga, me seli në Lisbonë (EMCDDA). Ndryshe nga vitet e kaluara, ku Shqipëria nuk përmendej, në raportin e 2017s vendi ynë veçohet si për rritjen e kultivimit të kanabisit ashtu dhe për faktin se ajo po bëhet një rrugë kryesore e trafikimit të narkotikëve në Europë.

“Raportet e fundit e vënë theksin në ndryshimet në rrugën e trafikut të narkotikëve, me rritje të trafikut si të barit të kanabis ashtu dhe vajit të kanabisit nga Ballkani Perëndimor, veçanërisht Shqipëria, e lidhur me rritjen e kultivimit

të kanabisit në këto vende”, thuhet në raportin vjetor të EMCDDA për vitin 2017.

Në një publikim të mëparshëm të EMCDDA⁹ në bashkëpunim me Europol, thuhet se vendet kryesore të prodhimit të kanabisit në rajonin e Ballkanit, përfshirë Shqipërinë, Serbinë, Bullgarinë dhe në një farë mase Kosovën, furnizojnë tregjet e Europës qendrore dhe Europës Lindore. Shqipëria duket të ketë qenë një prodhues i rëndësishëm (raporti i referohet dhe zhvillimeve në Lazarat dhe mbylljes së prodhimit aty). Greqia, ku prodhohet gjithashtu kanabisi, është një pikë e rëndësishme hyrëse në BE për kanabisin shqiptar, që shpërndahet në disa shtete anëtare, përfshirë Italinë, Kroacinë, Hungarinë, Republikën Çeke dhe Austrinë.

Një pjesë e kanabisit shqiptar mund të shitet dhe në Europën perëndimore, si në Gjermani, ose Francë. Për më tepër, Europol bën të ditur se kanabisi me fuqi të ulët trafikohet në Holandë dhe përdoret për të prodhues kanabis të fortë, që më pas destinohet për tregjet e Mbretërisë së Bashkuar. Shqipëria dhe Holanda duket të jenë nyjet kryesore të shpërndarjes për vajin afgan të kanabisit¹⁰ (Europol, 2015d).

Pastrimi i Parasë

Pastrimi i parave është procesi i të cilit “pastrohen” të ardhurat kriminale në mënyrë që origjina e tyre e paligjshme të jetë e fshehur. Zakonisht është i lidhur me llojet e krimit të organizuar që gjenerojnë fitime të mëdha në para të gatshme, si trafikimi i drogës, armëve dhe qenieve njerëzore si dhe mashtrimi. Megjithëse nuk është e mundur të matet pastrimi i parave në të njëjtën mënyrë si veprimtaria e ligjshme ekonomike.

Meqënëse pastrimi i parave është një aktivitet i ndërlikuar, i përhapur dhe shumëfishtë, ai trajtohet nga disa kënde të ndryshme. Fokusi është, njëkohësisht, në rregullimin e institucioneve financiare me qëllim parandalimin e pastrimit të parave dhe aspekteve të zbatimit të ligjit.

Investigimi Financiar dhe hetimet penale

Njësitë e Inteligjencës Financiare

Njësitë e Inteligjencës Financiare (NJIF) luajnë një rol kyç në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Këto njësi janë përgjegjëse për pranimin, kërkimin, analizimin dhe shpërndarjen e informacionit tek autoritetet kompetente për aktivitetet e mundshme të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit. Ata zakonisht vendosen brenda agjencive të zbatimit të ligjit ose organeve administrative që raportojnë në Ministrinë e Financave. Një numër i entiteteve dhe personave bien nën kërkesat e raportimit të pastrimit të parave, të tilla si bankat, institucionet financiare, noterët ose kazinotë. Ata duhet të dorëzojnë një raport transaksioni të dyshimtë pa vonesë tek NjIF kur ata e dinë ose dyshojnë se

⁹ Shiko raportin mbi drogat, 2016.

¹⁰ Report of Europol, drugs, 2015.

pastrimi i parave ose financimi i terrorizmit është duke u kryer ose është kryer ose tentuar. Raportet pastaj transmetohen tek autoritetet kompetente, duke përfshirë agjencitë e zbatimit të ligjit. Në bazë të këtyre raporteve, hetimet penale mund të fillojnë nëse është e nevojshme.

Njësia e Inteligjencës Financiare në Shqipëri është Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP). Misioni i saj është parandalimi i pastrimit të parave dhe lufta kundër financimit të terrorizmit. Ky mision përbushet nëpërmjet grumbullimit, verifikimit, vlerësimit, kontrollit, analizës dhe dhenies së informacionit për agjencitë e zbatimit të ligjit, ruajtjes së informacioneve nga subjektet e ligjit pezullimit, bllokimit dhe ngrirjes të çdo veprimi me qëllim parandalimin e transferimit, tjetërsimit ose kalimit të pasurisë dhe produkteve që rrjedhin nga veprimtaria kriminale. Drejtoria bashkërendon punën me struktura të tjera të zbatimit të ligjit, të tilla si: Ministria e Punëve të Brëndshme, Prokurorinë e Përgjithshme, Shërbimi Informativ Shtetëror dhe me Organizma homologë e Institucione ndërkombëtare.

DPPPP-ja mbledh, analizon dhe shpërndan informacionin në organet e zbatimit të ligjit për aktivitete të dyshimta në fushën e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Vendi ynë ka shënuar progres në masat e mara për garantimin e një sistemi funksional parandalues dhe goditës ndaj krimit ekonomik, specifikisht ndaj pastrimit të parave.

Me miratimin e paketës së ligjeve të reformës në drejtësi, kësaj njësia ju dhanëtribute të tjera atyre të verifikimit të gjithë pasurisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ky institucion do të ketë një rol shumë të madh në zbulimin e llogarive bankare, transfertave bankare edhe parave të politikanëve, prokurorëve dhe gjyqtarëve të korruptuar, depozituar jashtë vendit. Megjithatë me ngritjen e prokurorisë së posaçme, Drejtoria e Pastrimit të Parave do të ketë një rol thelbësor pikërisht sa i takon vetingut në radhët e drejtësisë dhe politikës shqiptare.

Metodat e përdorura për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar

Lufta ndaj krimit të organizuar kërkon domosdoshmërisht edhe një përgjigje të ashpër nga ana e organeve shtetërore. Ndër to mund të përmendim;

Konfiskimi

Aktivitetet e krimit të organizuar janë të nxitura nga fitimi. Konfiskimi dhe rikuperimi i të ardhurave nga krimi i privojnë kriminelët nga ajo që ata kanë punuar shumë për të fituar. Konfiskimi mund të ketë një efekt parandalues. Megjithatë, numri aktual i procedurave të ngrirjes dhe konfiskimit dhe shumat e rikuperuara nga krimi i organizuar duken modeste në krahasim me të ardhurat e parashikuara të grupeve kriminale të organizuara. Konfiskimi në shumë raste është i vështirë për tu realizuar pasi grupet kriminale bëjnë të mundur fshehjen e pasurisë kriminale nëpërmjet shfrytëzimit të personave të afërt ose familjarë, të cilët në dukje

zhvillojnë një jetë normale. Në vëndin tonë janë të njohura lidhjet e ngushta midis të afërmeve dhe krushqisë. Ky faktor ndikon së tepërmi në gjurmimin dhe hetimin e pasurisë kriminale të përfituar padrejtësisht pasi pasuritë e fshehura vendosen në emër të këtyre personave. Janë të njohura rastet kur shumë qytetarë kanë në pronësi një numër të lartë pasurish të paluajtmshme ose të luajtmshme, megjithëse këta qytetarë kanë të ardhura mesatare nga veprimtaria e tyre e përditshme. Si argument kryesor që përdoret për justifikimin e kësaj pasurie lidhet me faktin e krijimit të të ardhurave nga emigracioni i të afërmeve ose nga zhvillimi i punës në mënyrë informale. Parë në këtë aspekt një pjesë e madhe e përgjegjësisë qëndron edhe mbi organet shtetërore pasi për shumë vite me radhe, vendi ynë renditej ndër vëndët me të shkallë të lartë të informalitetit ose ekonomisë së zezë. Megjithatë ky lloj argumenti nuk duhet të shërbejë si frenues në punën e organeve hetimore. Struktura të posaçme si ajo e krijimit të Prokurorisë së Posaçme e krijuar me ligj së fundmi, mund të përbëjë një mjet tejet efikas në kryerjen e hetimeve të plota dhe të fokusuar në pasuritë kriminale të transferuar apo fshehur.

Gjurmimi dhe identifikimi i pasurive kriminale

Sa më shpejt të gjurmohen pasuritë që rrjedhin nga krimi, aq më efektive mund të jetë konfiskimi dhe rikuperimi i fitimeve kriminale. Bashkimi Europian psh, ka krijuar Zyrat Kombëtare të Riparimit të Aseteve (AROs) të cilat ndihmojnë në privimin e kriminelëve nga fitimet e tyre kriminale. Ato identifikojnë pasuritë që janë fituar ilegalisht në territoret e tyre dhe lehtësojnë shkëmbimin e informatave relevante në nivel evropian. Në këtë kuadër, njësia e Inteligjencës financiare në vëndin tonë së bashku me prokurorinë e posaçme që pritet të krijohet së shpejti mund të përdorin eksperiencën dhe metodat e përdorura nga këto zyra me qëllim arritjen e rezultateve të shpjeta dhe me rilevancë financiare për ekonominë e vëndit. Megjithatë mund të shihet si tejet pozitive imponimi me ligj e drejta e Prokurisë së Posaçme për të pasur akses në të gjitha transaksionet financiare bankare dhe jo vetëm, me qëllim identifikimin në kohë reale të pasurive që janë krijuar në mënyrë të paligjshme dhe marrjen e masave të menjëhershme për bllokimin e këtyre transaksioneve me qëllim mos tjetërsimin apo fshehjen e tyre.

Parandalimi i krimit

Parandalimi i krimit përfshin të gjitha aktivitetet që kontribuojnë në ndalimin ose reduktimin e krimit si fenomen social. Këto aktivitete ndërmerren nga të gjithë aktorët që ka gjasa të luajnë një rol parandalues. Agjencitë e zbatimit të ligjit dhe sistemi gjyqësor, mediat, bankat shërbimet sociale, sistemi i arsimit, organizatat e shoqërisë civile, industria, sektori privat, publiku i gjerë. Në këtë pikëpamje një organizim apo një politikë gjithëpërfshirëse mbarështetërore mund të përbëjë një

mjet të fuqishëm për gjurmimin dhe parandalimin e pasurive të jashligjshme të fituar nga organizatorët e veprimtarisë kriminale.

Parandalimi i krimit nga natyra kërkon një qasje shumë-disiplinore. Prandaj, politika të shumta kombëtare mund të kontribuojnë në parandalimin e krimit. Sa i përket krimit të përgjithshëm, veprimi parandalues më efektiv duhet të bëhet sa më afër nivelit bazë. Kjo reflektohet nga shfaqja e shumë iniciativave lokale, praktikat e “policimit në komunitet”, të cilat përfshijnë forcat e policisë, autoritetet lokale, bizneset, shoqatat dhe qytetarët.

PËRFUNDIME

Krimi i organizuar synimin e vet kryesor ka krijimin e pasurive të natyrave të ndryshme me qëllim forcimin e dhe rritjen e mëtejshme të tij. Duke pasur parasysh këtë synim, mbi organet ligjzbatuese qëndron përgjegjësia dhe detyrimi për shtimin e mjeteve dhe metodave për rritjen e efikasitetit në luftimin e krimit të organizuar. Ndër metodat kryesore të cilën ky punim e përfshin në trajtimin e tij ka të bëjë me kontrollin e gjithëanshëm të pasurive të natyrave të ndryshme. Fokusi kryesor i kontrollit lidhet me transaksionet monetare bankare pasi prej tyre nis të krijohet një zinxhir i plotë transaksionesh fiktive të pasurive të tjera, si psh pasuritë e paluajtshme ose të si mjete luksove apo sende të shtrenjta. Siç u përmend në këtë punim organet kryesore që kanë tagrin të verifikojnë dhe identifikojnë transaksione monetare janë Organet e Posaçme kundër Krimit dhe Korrupsionit (Prokuroria dhe Gjykata e posaçme), si dhe Njësia e Inteligjencës Financiare. Më qëllim arritjen e rezultateve të shpejta rekomandohet një bashkpunim në kohë reale midis këtyre organeve ose në pikëpamje futuriste bashkimi i këtyre institucioneve në një të vetëm. E rekomandueshme do të ishte krijimi i një strategjie afatgjatë dhe fillimi i një lëvizjeje kombëtare me fokus në identifikimin e pasurisë kriminale ku brenda saj të përfshihen të gjithë aktorët e politikës, medias, shoqërisë civile dhe publiku i gjërë.

REFERENCA DHE BIBLIOGRAFI

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
2. Traktati i Funkcionimit të Unionit Europian.
3. Karta e të Drejtave Themelore të BE-së.
4. Konventa e OKB kundër Krimit të Organizuar Transnacional, si dhe dy protokollet e saj shtese të ratifikuar nga Shqipëria me ligjin 8920 dt 11.07.2002.
5. Kodi Penal i RSH, neni 278a.
6. Ligji nr. 97/2016, “Për Organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë.

7. Ligji nr. 95/2016 “Për Organizimin dhe funksionimin e Institucioneve për të luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.
8. Ligji nr.9917, datë 19.5.2008 “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”, I ndryshuar.
9. Ligji nr. 9110 dt.24.07.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave për Krimet e Rënda.
10. Kuadri ligjor mbi trafikimin e qënieve njerëzore në Shqipëri dhe sfidat e hasura në praktikën gjyqësore, 2013, Shkolla e Magjistraturës.
11. Koça A. 2013. Trafikimi i qënieve njerëzore. Këndvështrimi juridik.
12. Report of Europol, drugs, 2016.
13. Report of Europol, drugs, 2015.
14. www.europa.lex.

**KOMPENSIMI I VIKTIMAVE TË KRIMEVE TË DHUNSHME,
NË KUADRIN E NDRYSHIMEVE TË VITIT 2017, TË KODIT
TË PROCEDURËS PENALE¹**

Dr. Eniana QARRI,

Departamenti i së Drejtës Civile,
Fakulteti i Drejtësisë, UT
eniana.qarri@fdut.edu.al

Dr. Xhensila KADI

Departamenti i së Drejtës Civile,
Fakulteti i Drejtësisë, UT
xhensila.kadi@fdut.edu.al

ABSTRAKT

Krimi u shkakton dëme të mëdha viktimave, kundërvajtësve dhe shoqërisë, për rrjedhojë është e nevojshme të riparohet dëmi, sa më shumë që të jetë e mundur. Është e natyrshme që viktimat dëshirojnë një kompensim për dëmet morale dhe materiale të pësuar, kompensim të cilin viktimat mund ta kërkojnë të paguhet nga autori i veprës penale ose nga shteti.

Marrja e kompensimit nga autori i veprës penale mund të realizohet nëpërmjet padisë civile në gjykatën civile ose me anë të një padie civile në procesin penal. Nëse viktimat e ka të pamundur të marrë një kompensim nga autori i veprës penale, atëherë është shteti ai që duhet t'i sigurojë viktimës kompensimin për të gjitha dëmet e pësuar.

Në Shqipëri pozita juridike e viktimës në procesin penal mbetet akoma shumë problematike. Nuk ka një dokument të vetëm ku të sanksionohen të drejtat e viktimave; nuk është ndërtuar akoma skema shtetërore për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme; ka mjaft probleme me padinë civile në procesin penal; si edhe ka probleme me garantimin e mbrojtjes ligjore falas për viktimat. Arritje pozitive e legjislacionit shiptar është parashikimi, në ndryshimet e vitit 2017 të Kodit të Procedurës Penale, i mundësisë së viktimës për të kërkuar shpërbelimin e të gjitha dëmeve të pësuar nga vepra penale (dëmi pasuror dhe personal jopasuror), nëpërmjet padisë civile në procesin penal.

¹ Ky punim është bazuar në Mikrotezën “Aspekte civile të së drejtës për kompensimin e burgimit të padrejtë dhe viktimave të krimit”, për marrjen e diplomës Master i Nivelit të Dytë në Shkencat Juridike Civile, mbrojtur nga Dr. Eniana Qarri në Departamentin e së Drejtës Civile, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, 2011.

Gjatë punimit do të analizohen këto probleme me qëllim identifikimin e zgjidhjeve të mundshme, në funksion të përmirësimit të pozitës juridike të viktimës në procesin penal.

Fjalë kyçe: drejtësia restauruese, viktimë e krimit, kompensimi, padia civile në procesin penal.

I. Konsiderata të përgjithshme për kompensim e viktimave të krimit

Viktimat e krimit, veçanërisht të krimeve të dhunshme, mund të pësojnë dëme të rënda morale dhe materiale si pasojë e krimit të pësuar. Dëme veçanërisht të rënda të tilla si dëmtime të rënda fizike, psikologjike, stresi post traumatik, shpenzime mjekësore, humbje të aftësisë për punë, dhunim i integritetit moral dhe dinjitetit personal si dhe prishja e cilësisë së jetesës.

Me termin krime të dhunshme do të kuptojmë veprën penale të trafikimit të qenieve njerëzore, të shfrytëzimit të personave të trafikuar për prostitucion, lypje si dhe veprën penale të shfrytëzimit të emigrantëve të paligjshëm për punë të detyruar.

Është e natyrshme që viktimat dëshirojnë një kompensim për dëmet morale dhe materiale të pësuar, kompensim të cilin viktimat mund ta kërkojnë të paguhet nga autori i veprës penale ose nga shteti. Përgjegjësia e autorit të veprës penale për kompensimin e dëmeve të shkaktuara viktimave të tyre është e ndryshme nga përgjegjësia penale e tyre ndaj shtetit. Kompensimi ka të bëjë me marrëdhënien që krijohet ndërmjet autorit të veprës dhe viktimës. Ky kompensim realizohet nëpërmjet padisë civile në gjykatën civile ose me anë të një padie civile në procesin penal. Ndërsa nga ana tjetër, përgjegjësia penale ka të bëjë me marrëdhënien që krijohet ndërmjet individit dhe shtetit dhe vendimi do të merret në fund të një procesi penal.

Në mjaft raste viktimat e ka të pamundur të marrë një kompensim nga autori i veprës penale. Ky i fundit mund të mos jetë identifikuar ose në përfundim të hetimeve prokuroria nuk arrin të sigurojë prova të mjaftueshme për fajësinë e tij. Mund të ndodhë, që edhe në rastin kur viktimat ka marrë një vendim gjyqësor që detyron kundërvajtësin të paguajë kompensim për dëmet e shkaktuara, autori i veprës të mos ketë të ardhura të mjaftueshme, pra të mos jetë në gjendje të paguajë shumën e caktuar nga gjykata si kompensim. Në këto raste është shteti ai që duhet t'i sigurojë viktimës kompensimin për të gjitha dëmet e pësuar. Në disa shtete është kusht që viktimat të kërkojnë më parë të marrë kompensim nga kundërvajtësi dhe pasi dështon në marrjen e këtij kompensimi mund të kërkojnë të marrë kompensim për krimin e pësuar nga shteti. Shtete të tjera e kushtëzojnë përfitimin e një kompensimi nga plotësimi i kushteve të tjera, të cilat mund të jenë përfitimi i kompensimit vetëm për disa lloje veprash penale si dhe kompensimi vetëm i dëmeve materiale.

Në Shqipëri trafikimi i qenieve njerëzore, veçanërisht i grave si një nga kategoritë më të rrezikuara, është një problem mjaft i madh. Shqipëria është një shtet

burim dhe tranzit i trafikimit të qenieve njerëzore. Për këtë arsye legjislacioni shqiptar nuk duhet t'i kushtojë vëmendje vetëm zbulimit, kapjes dhe dënimit të autorëve të krimit, por duhet t'i kushtojë një vëmendje mjaft të madhe parandalimit dhe kompensimit moral dhe material të viktimave të trafikimit në veçanti dhe të krimeve të dhunshme në përgjithësi.

II. Garancitë ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare

Në Shqipëri çështja e rehabilitimit dhe zhdëmtimit të viktimave është sanksionuar si një e drejtë kushtetuese vetëm në rastet e dëmtimeve të pësuar si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të paligjshme të organeve shtetërore (shih nenin 44 të Kushtetutës)². Megjithatë, ligjërish, e drejta për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme ka një kuptim më të gjerë, përveç kuptimit kushtetues³. Kjo e drejtë është e parashikuar në shumë akte ndërkombëtare të detyrueshme për zbatim për shtetet që i kanë nënshkruar ato, si dhe në legjislacionin e brendshëm procedural penal dhe civil.

Në bazë të legjislacionit shqiptar, viktimat ka të drejtë të kërkojnë kompensim për dëmet e pësuar nga autori i veprës nëpërmjet padisë civile në gjykatën civile apo nëpërmjet padisë civile në procesin penal. Këto instrumente ligjore gjenden të rregulluara si në legjislacionin civil ashtu edhe atë penal (material dhe procedural).

Në Kreun e VI-të të Kodit të Procedurës Penale, në kuadrin e të drejtave që i njihen viktimës së krimit në procesin penal, parashikohet edhe e drejta e të dëmtuarit nga vepra penale dhe trashëgimtarëve e tij për të kërkuar jo vetëm procedimin e fajtorit, por njëkohësisht edhe shpërblimin e dëmit. Kjo e drejtë realizohet me anë të ngritjes së një padie civile në procesin penal. Me ndryshimet e reja, të vitit 2017, sipas nenit 61 të Kodit të Procedurës Penale i dëmtuari nga vepra penale apo trashëgimtarët e tij kanë të drejtë të kërkojnë, me anë të një padie civile në procesin penal, kthimin e pasurisë dhe shpërbimin e dëmit. Në interpretim të kësaj dispozite të ndryshuar, konkludojmë që viktimat ka të drejtë të kërkojnë jo vetëm shpërblimin e dëmeve materiale të pësuar nga vepra penale, por edhe të dëmit personal jopasuror. Para këtij ndryshimi, neni 61 i KPrPenale parashikonte vetëm të drejtën për shpërblimin e dëmeve materiale.

Ligji “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, nr. 10 192, datë 3.12.2009 parashikon që një nga mënyrat e përdorimit të pasurive të luajtshme, të paluajtshme dhe të veprimtarive tregtare të krimit të organizuar, të sekuestruara dhe më pas të konfiskuara me vendim gjyqësor është shitja e tyre

² Anastasi, Aurela. “Leksione për Shqipërinë nga një analizë e krahasuar mbi të drejtën për kompensim të viktimave të trafikimit.” *Revista Ligji mundësi zhvillimi për gratë*, nr.1 (18), mars 2008, fq. 18.

³ Anastasi, “Leksione për Shqipërinë nga një analizë e krahasuar mbi të drejtën për kompensim të viktimave të trafikimit,” fq. 18.

me qëllim dëmshpërblimin e viktimave të krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit.

Gjithashtu, e drejta e viktimës për shpërblimin e dëmit gjen mbështetje edhe në legjisllacionin civil. Sipas nenit 608 të KC, personi që, në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar. Dëmi quhet i paligjshëm kur është rrjedhim i një shkeljes ose i cenimit të interesave dhe i të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik ose zakonet e mira.

Shqipëria ka nënshkruar një sërë Konventash në fushën e mbrojtjes dhe kompensimit të viktimave të krimeve, më e rëndësishmja nga të cilat është Konventa Evropiane “Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme”⁴, dokument ky i Këshillit të Evropës. Kjo konventë ka hyrë në fuqi në 24.11.1983, dhe është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 9265, datë 29.07.2004.

Konventa parashikon detyrimin e shteteve anëtare të saj për të ndërtuar skemën shtetërore të kompensimit të viktimave të krimeve të dhunshme. Konventa e kufizon mundësinë e kompensimit si për sa i përket viktimave që kanë të drejtë të kërkojnë kompensimin ashtu dhe për sa i përket dëmeve që mund të kompensohen nga ky fond shtetëror. Bazuar në nenin 2 të Konventës kompensimi i jepet atyre viktimave, të cilat kanë pësuar një dëmtim të rëndë trupor ose dëmtim të shëndetit që ka rrjedhur direkt nga një krim i dhunshëm si dhe personave të varur prej personave që kanë vdekur si rezultat i një krimi të tillë. Konventa lejon vetëm kompensimin e dëmet materiale të pësuar nga një krim i dhunshëm (neni 4).

Një tjetër konventë e rëndësishme, e ratifikuar nga RSh, është Konventa e Organizatës së Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit Ndërkombëtar të Organizuar (UNTOC)⁵, e cila është ratifikuar nga RSh në vitin 2002. Konventa është plotësuar nga Protokollin shtesë “Për parandalimin, ndjekjen dhe dënimin e trafikimit të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve”. Në nenet 6 dhe 25 të Konventës parashikohet detyrimi i çdo shteti kontraktues për të të parashikuar procedura të përshtatshme për të siguruar mundësinë e viktimave të krimeve për kompensimin dhe rehabilitimin e tyre.”⁶ Gjithashtu, çdo shtet anëtar duhet të sigurojë që sistemi i tij ligjor dhe administrativ të përmbajë masat e nevojshme për t’i siguruar viktimave të trafikimit

⁴ Konventa e Këshillit të Europës “Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme (“ECCVVC”), është ratifikuar nga Kuvendi i R. Sh me ligjin nr. 9265, dt. 29.07.2004. Në vazhdim të këtij punimi do t’i referohemi si “Konventa”.

⁵ Konventa e Kombeve të Bashkuara “Kundër krimit të organizuar ndërkombëtar”, është ratifikuar nga Kuvendi i R.SH. me ligjin nr. 8920, dt. 11.07.2002, së bashku me dy protokollet e saj.

⁶ Raporti “Dëmshpërblimi për personat e trafikuar dhe të shfrytëzuar në rajonin e OSBE-së”, përgatitur nga OSCE-ODIHR, Varshavë, 2008, fq. 225-232.

të qenieve njerëzore mundësinë e përfitimit të një kompensimi për dëmet e pësuar.”⁷

Konventa e Këshillit të Evropës “Për veprimin kundër trafikimit të qenieve njerëzore⁸”, e ratifikuar nga RSH në vitin 2006, parashikon detyrimin e çdo shteti anëtar të sigurojë në të drejtën e tij të brendshme të drejtën e kompensimit të viktimave nga kundërvajtësi. Çdo shtet anëtar duhet të adoptojë masa legislative dhe masa të tjera të nevojshme për t’i garantuar viktimës kompensimin, në përputhje me parashikimet e së drejtës së brendshme, masa të tilla si krijimi i një fondi shtetëror për kompensimin e viktimave ose programe për asistencën sociale dhe integrimin në shoqëri të viktimave. Kjo konventë është një standard i rëndësishëm ndërkombëta në lidhje me luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore⁹.

Përveç akteve ndërkombëtare juridikidht të detyrueshme për RSH, vlen të përmenden dhe aktet ndërkombëtare politikisht të detyrueshme (soft laë). Ndër këto dokumente politikisht të detyrueshme mund të përmendim si më të rëndësishmen Deklaratën e OKB-së, e njohur si “Deklarata mbi parimet bazë të drejtësisë për viktimat e krimit të abuzimit me pushtetin”, nr.40/34, datë 29.11.1985. Megjithëse nuk është një dokument ligjërishit i detyrueshëm për shtetet anëtare, deklarata ka ndihmuar në politikëbërjen e shteteve në fushën e parandalimit të kriminalitetit dhe të krijimit të shërbimeve për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimës. Sipas kësaj konvente, viktimës së një krimi shtetet anëtare duhet t’i sigurojnë kompensim dhe restitucion për dëmet e pësuar. Kjo e drejtë i njihet vetëm viktimave të krimeve të rënda (të dhunshme), të cilët kanë pësuar dëmtime të rënda, serioze. Deklarata nuk e ka bërë në mënyrë të qartë dallimin midis restitucioni dhe konceptit të kompensimit. I vetmi dallim që vërehet në këtë drejtim është ai midis burimeve të kompensimit. Në rastin e restitucionit, kompensimin për dëmet e pësuar viktimat ka të drejtë t’a kërkojë nga fajtori nëpërmjet një padie në gjykatën civile apo nëpërmjet një padie civile në procesin penal. Ndërsa në rastin e kompensimit shuma e kompensimit, për dëmet e pësuar, i paguhet viktimës nga skema shtetërore e kompensimit.

Në kuadrin e legjislacionit të Bashkimit Europian, në kushtet, ku Shqipëria po bën përpjekje të vazhdueshme për t’u pranuar si anëtare e BE-së, përqsja e legjislacionit të brendshëm me këto *acquis* është një domosdoshmëri. Dokumenti më i rëndësishëm është Direktiva e Këshillit të Evropës së BE-së “Për kompensimin e viktimave të krimit”, e vitit 2004¹⁰. Kjo direktivë i detyron shtetet anëtare të BE-së të bashkëpunojnë në ndërtimin e një sistemi, i cili do të krijojë lehtësi për

⁷ Raporti “Dëshmipërblimi për personat e trafikuar dhe të shfrytëzuar në rajonin e OSBE-së”, përgatitur nga OSCE-ODIHR, Varshavë, 2008, fq. 225-232.

⁸ Konventa e Këshillit të Europës “Për veprimin kundër trafikimit të qenieve njerëzore”, është ratifikuar nga Kuvendi i R.SH. me ligjin nr. 0642, dt. 20.11.2006.

⁹ Raporti “Dëshmipërblimi për personat e trafikuar dhe të shfrytëzuar në rajonin e OSBE-së”, përgatitur nga OSCE-ODIHR, Varshavë, 2008, fq. 226-229.

¹⁰ Direktiva e Këshillit të BE-së nr. 2004/80/EC, dt. 29.04.2004.

viktimat në aksesin e tyre në drejtësi, veçanërisht në të drejtën e kompensimit për krimet e dhunshme ndërkombëtare të pësuara në territorin e të gjitha shteteve anëtare¹¹. Gjithashtu në bazë të kësaj direktive shtetet janë të detyruar të ndërtojnë një fond shtetëror për kompensimin e viktimave të krimeve ndërkombëtare, që kanë ndodhur në territorin e tyre. Në bazë të paragrafit 6 të Direktivës, viktimat e krimit në Bashkimin Europian, duhet të jenë të titulluar për përfitimim e një kompensimi të drejtë dhe të përshtatshëm për dëmet që ato kanë pësuar, pavarësisht se në cilin shtet anëtar është kryer krimi.

Një dokument tjetër i rëndësishëm për mbrojtjen e viktimave të krimit është Rekomandimi i Komitetit të ministrave të BE-së, nr (2006)8, dt. 14 Qershor 2006 “Për asistencën e viktimave të krimit”. Rekomandimi ka për qëllim vendosjen e standarteve minimale për mbrojtjen dhe kompensimin e viktimave të krimit. Në bazë të rekomandimit, shtetet anëtare duhet t’i sigurojnë çdo viktime akses në sistemin e drejtësisë, nëpërmjet padisë civile, me qëllim marrjen e një kompensimi për vuajtjet e pësuar. Ky dokument, i rekomandon shteteve anëtare krijimin e skemave shtetërore të kompensimit, për kompensimin e viktimave të krimeve ndërkombëtare, të krimeve të dhunshme, të dhunës seksuale dhe kompensimin e antarëve të familjes së viktimave, të cilat kanë humbur jetën si pasojë e krimit. Rekomandimi bazohet në dy parime të rëndësishme: parimin e mosdiskriminimit në bazë shtetësie dhe parimin e solidaritetit social.

III. Mekanizmat e kompensimit të viktimave të krimit

Dy janë mekanizmat me anë të të cilave viktimat e një krimi ka të drejtë të kërkojë kompensim për dëmet e pësuar nga krimi. Mekanizmi i parë dhe më i rëndësishëm është ndërtuar në bazë të parimit, që në rradhë të parë viktimat duhet të kërkojë kompensim nga autori i krimit. Kompensimi nga autori i krimit mund të realizohet nëpërmjet lidhjes së një marrëveshje midis viktimës dhe autorit të krimit, në rrugë jashtëgjyqësore, nëpërmjet procedurës së ndërmjetësisë.

Nëse një marrëveshje e tillë nuk është e mundur të realizohet (siç ndodh në numrim më të madh të rasteve), atëherë viktimat ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit nga autori i krimit nëpërmjet padisë civile dhe padisë civile në procesin penal. Nëse asnjëri nga mjetet e mësipërme nuk rezulton i efektshëm, atëherë në analizë të fundit, viktimat ka të drejtë t’i drejtohet skemës shtetërore të kompensimit.

3.1 Kompensimi nga personi që ka kryer veprën penale

E drejta për kompensimin e viktimës nga ana e autorit të krimit është në fokusin e pjesës më të madhe të standardeve ndërkombëtare të kompensimit të viktimave, dhe veçanërisht atyre të krimeve të dhunshme. Kjo e drejtë mund të arrihet vullnetarisht ose nëpërmjet detyrimit (shtrëngimit) të organeve kompetente

¹¹ Ky është një objektivi i vendosur edhe në Takimin e Tampare-s, në 15-16 tetor 1999.

shtetërore. Marrëveshjet vullnetare për kompensimin e viktimës, mund të arrihen nëpërmjet një zgjidhje me ndërmjetësim, me anë të një veprimi individual ose kolektiv, i cili zhvillohet në rrugë jashtë gjyqësore; nëpërmjet marrëveshjeve të negociuara midis viktimës dhe autorit të krimit nga organet shtetërore ose nga shoqëria civile; nëpërmjet një zgjidhje të ndërmjetme në një çështje penale (shembulli i Francës), ose nëpërmjet një zgjidhje të negociuar në një çështje civile ose të punës.¹² Kompensimi i detyrueshëm arrihet nëpërmjet një vendimi gjyqësor në një çështje penale, civile apo të punës.

Legjislacioni procedural penal dhe civil shqiptar realizimin e së drejtës për kompensim nëpërmjet dy procedurave: padisë civile në procesin penal si dhe padisë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor në procesin civil.

3.1.1 Padia civile si mjet për shpërblimin e dëmit

Padia civile mund të ngrihen pavarësisht nëse procedimi penale ka filluar. Nëse një viktimë e krimit vendos të paraqesë një padi civile jashtë çështjes penale ai duhet të provojë se personi i paditur është përgjegjës për veprimin kriminal dhe se veprimi kriminal i ka shkaktuar atij humbjet dhe dëmet. Ato duhet të paraqesin prova në përputhje me natyrën dhe me rëndësinë e humbjeve dhe të dëmeve (fatura, dëshmitare gojore etj.). Ato duhet gati gjithmonë të paraqiten në gjykim dhe të japin dëshmi për të provuar këto çështje. Kjo mund të jetë frikësues, ri-traumatizuese ose e pamundur për disa persona të trafikuar.

Çështjet civile ka gjasa të jene çështje të gjata dhe komplekse (në disa shtete zgjasin me vite). Ato gjithashtu janë të kushtueshme, sepse është e nevojshme bërja e shpenzimeve të tilla si: shpenzimet gjyqësore, pagesat e avokatëve dhe të ekspertëve. Personat e trafikuar kërkojnë asistencë ligjore të specializuar për të paraqitur faktet e çështjes dhe argumentet ligjore përpara gjykatës. Megjithatë, procedimet civile mund të duken më lehtësisht të përdorshme për një person të trafikuar për shkak se policia nuk merr pjesë, ato kërkojnë identifikimin e keqbërësit dhe në mënyrë që personi i trafikuar të marrë shpërblimin, keqbërësi duhet të jetë brenda juridiksionit gjyqësor dhe financiarisht në gjendje të përballojë shumat e shpërblimit të dëmit. Kur vendimi për kompensim nuk zbatohet vullnetarisht nga keqbërësi, atëherë personi i trafikuar mund të ndërmarrë një procedurë ekzekutimi të detyrueshme, gjë që paraqet vështirësi të mëtejshme. Të gjithë këto faktorë e kufizojnë mundësinë e personit të trafikuar për të përfituar një kompensim nëpërmjet një padie civile.¹³

¹² Raporti “Dëmspërblimi për personat e trafikuar dhe të shfrytëzuar në rajonin e OSBE-së”, përgatitur nga OSCE-ODIHR, Varshavë, 2008, fq. 23-38.

¹³ Për më shumë rreth kësaj analize shih: Raporti “Dëmspërblimi për personat e trafikuar dhe të shfrytëzuar në rajonin e OSBE-së”, përgatitur nga OSCE-ODIHR, Varshavë, 2008, fq.23-38.

Në praktikën gjyqësore shqiptare, kur paraqitet një kërkesë civile në gjykatën civile për shpërblim dëmi, ndërkohë që është njëkohësisht në gjykim çështja penale, gjyqtari pezullon gjykimin deri në dhënien e një vendimi nga gjykata penale. Për të përcaktuar përgjegjësinë e të paditurit gjykata civile mer gjithmonë për bazë vendimin e gjykatës penale, në lidhje me këtë çështje.

3.1.2 Padia civile në procesin penal

Në legjislacionin aktual shqiptar, padia civile në procesin penal, si mjet për të kërkuar shpërblimin e dëmeve pasurore drejtpërdrejtë nga autori i veprës, gjatë procesit penal në ngarkim të tij, rregullohet nga nenet 58 e vijues të K.Pr.Penale.

Në nenin 58.1(g) të Kodit të Procedurës Penale, midis të tjerave garantohet e drejta e personit të dëmtuar nga vepra penale apo e trashëgimtarëve të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal. Ndërsa, neni 61 i K.Pr.Penale parashikon që *“ai që ka pësuar një dëm nga vepra penale ose trashëgimtarët e tij mund të ngrenë padi civile në procesin penal kundër të pandehurit ose të paditurit civil, për të kërkuar kthimin e pasurisë dhe shpërblimin e dëmit.”* (është hequr fjala material, me ndryshimet e vitit 2017). Para ndryshimeve të vitit 2017, me anë të padisë civile në procesin penal, mund të kërkohej vetëm shpërblimi i dëmeve pasurore dhe jo i atyre jopasurore. Me ndryshimet e vitit 2017 mund të kërkohej shpërblimi i të gjitha dëmeve, të pësuar nga viktimat.

Të drejtën për të kërkuar shpërblimin e dëmit pasuror me anë të padisë civile në procesin penal e kanë këta subjekte: a) i dëmtuari nga vepra penale; b) trashëgimtarët e tij, në rast se i dëmtuari nga vepra penale ka vdekur. Padia mund të ngrihet jo vetëm kundër të pandehurit, por dhe kundër të paditurit civil. I padituri civil është ai person i cili përgjigjet për veprën e kryer nga i pandehuri.¹⁴ I pandehuri që ka marrë pafajësinë ose ndaj të cilit është pushuar çështja, mund të thirret si i paditur civil për veprat e të bashkëpandehurve të tjerë.

Legjitimimi i paditësit civil në procesin penal mund të bëhet nga organi procedurës, derisa të mos ketë filluar procedimi gjyqësor. Ky afat nuk mund të zgjatet në asnjë rast.¹⁵ Padia civile nuk mund të paraqitet në një fazë të procedimit që nuk e parashikon K.Pr.Penale. Ky procedim nuk mund të fillojë në gjykatën e shkallës së dytë, pasi do të ndodheshim përpara cenimit të parimit të respektimit të shkallëve të gjykimit civil, të parashikuar nga neni 135 i Kushtetutës dhe të parashikuar hollësisht në ligjin procedural.¹⁶

Gjykata ka të drejtë të veçojë padinë civile nga procesi penal dhe ta dërgojë atë në gjykatën civile. Kjo bëhet në ato raste kur gjykimi i padisë civile në procesin

¹⁴ Neni 65 i K.Pr.Penale.

¹⁵ Neni 62/1,2 i K.Pr.Penale.

¹⁶ Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuar të Gjykatës së Lartë, nr. 284, datë 15.09.2000.

penal e vështirëson ose e zvarrit ketë proces.¹⁷ Veçimi i padisë civile mund të bëhet me kërkesën e palëve ose kryesisht nga gjykata. Veçimi i padisë civile në procesin penal dhe dërgimi i saj në gjykatën civile, ka treguar se çon në zvarritjen e saj në procedurën civile. Praktika shqiptare ka treguar se ka qenë gati e pamundur të bëhet gjykimi i saj në procesin civil, pa përfunduar më parë procesi penal.¹⁸

Në nenin 63 të K.Pr.Penale parashikohet sigurimi i padisë civile në procesin penal, nëpërmjet sekuestrimit të pasurisë së të pandehurit ose të të paditurit civil.

Paditësi ose përfaqësuesi i tij mund të heqin dorë nga gjykimi i padisë civile në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit me anë të një deklarate të bërë në procesin gjyqësor ose me anë të një akti të shkruar, i cili depozitohet në sekretarinë e gjykatës dhe i njoftohet palëve të tjera¹⁹. Gjithashtu, paditësi quhet se ka hequr dorë nga gjykimi i padisë civile, nëse ai nuk paraqet konkluzionet në diskutimin përfundimtar ose kur ngre padi përpara gjykatës civile.²⁰ Heqja dorë nuk pengon ngritjen e padisë në gjykatën civile.

Në lidhje me disponimin e padisë civile në procesin penal, në nenin 68 të K.Pr. Penale parashikohet se gjykata sipas rastit mund të vendosë një nga alternativat e mëposhtme:

- pranon tërësisht ose pjesërisht padinë civile dhe në këtë rast ajo akordon një shumë kompensimi për dëmet materiale të pësura nga viktimi nga vepra penale;
- rrëzon padinë civile. Kur rrëzohet padia civile në procesin penal nuk lejohet ngritja e saj përsëri në gjykatën civile.

- lë pa shqyrtuar padinë civile, në ato raste kur jepet vendim pafajësie, për shkak se fakti nuk parashikohet si vepër penale ose kur vendoset pushimi i çështjes. Në këtë rast, paditësi civil ka mundësi që ta paraqesë këtë padi në gjykatën civile. Kjo është mjaft e vështirë pasi në praktikën shqiptare gjyqtarët e pezullojnë gjykimin në gjykatën civile, deri në përfundimin e çështjes penale.

Gjithashtu neni 399 i K.Pr.Penale, i cili parashikon që me kërkesën e paditësit civil, gjykata urdhëron publikimin e vendimit të dënimit, si një mënyrë e riparimit të dëmit jopasuror të rrjedhur nga vepra penale. Publikimi i vendimit bëhet i plotë ose me shkurtime, në gazetata e treguara nga gjykata, me shpenzimet e të pandehurit ose të paditurit civil. Në qoftë se publikimi nuk bëhet në afatin e caktuar, paditësi civil mund të veprojë vetë me të drejtën për të kërkuar shpenzimet nga i dënuari.

Një nga problemet e ndeshura në praktikën gjyqësore shqiptare ka të bëjë me fazën proceduriale në të cilën mund të paraqitet padia civile në procesin penal. Në bazë të nenit 62/1 të K.Pr.Penale dhe të Vendimit Unifikues të Kolegjeve të

¹⁷ Neni 62/3 i K.Pr.Penale.

¹⁸ Anastasi, “Leksione për Shqipërinë nga një analizë e krahasuar mbi të drejtën për kompensim të viktimave të trafikimit,” fq. 22.

¹⁹ Neni 64/1 i K.Pr.Penale.

²⁰ Neni 64/2 i K.Pr.Penale.

Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 284, dt. 15.09.2000, padia civile mund të paraqitet në gjykatën penale deri në momentin që nuk ka filluar shqyrtimi gjyqësori i çështjes penale në gjykatën e shkallës së parë. Ky konkluzion buron nga vetë konceptimi i institutit procedural të gjykimit të padisë civile në procesin penal. Padia civile në procesin penal nuk ka asnjë dallim nga padia civile sipas konceptimit nga dispozitat e Kodit të Procedurës Civile. Dallimi në këtë rast, vazhdon arsyetimin e saj Gjykata e Lartë, ka të bëjë vetëm me faktin se kjo padi civile, për shkak të specifikës, se lidhet me dëmin material nga vepra penale, do të gjykohet nga gjykta penale së bashku me procedimin penal. Ky rregullim i veçantë nga rregulli i përgjithshëm i gjykimit të padive civile duke vlerësuar oportunitetin e bashkimit të dy gjykimeve, të cilat kanë të përbashkët palët, provat e nevojshme etj. Ky bashkim nuk mund të çenojë as procedimin penal dhe as atë civil. Të dy procedimet ruajnë karakteristikat e tyre të veçanta sipas dispozitave respektive që i rregullojnë, por për shkak të elementëve të përbashkët bashkohen në një procedim të përbashkët. Për rrjedhojë padia civile në procesin penal nuk mund të paraqitet në një fazë procedimi që nuk e parashikon Kodi i Procedurës Civile. Nëse do të lejohej paraqitja e kësaj padie në gjykatën e Apelit, pa u paraqitur më parë në gjykatën e shkallës së parë, atëherë do të ndodheshim përpara cënimit të parimit të respektimit të shkallëve të procedimit civil, parim ky i parashikuar nga neni 135 i Kushtetutës²¹.

Nëse gjatë një gjykimi penal me shumë të pandehur, viktimat e krimit paraqet një padi civile me qëllim shpërblimin e dëmit pasuror, atëherë të gjithë të pandehurit do të përgjigjen solidarisht ndërmjet tyre për shpërblimin e dëmit, kuptohet nëse gjykata pranon padinë. Në bazë të nenit 626 të Kodit Civil, kur dëmi është shkaktuar nga disa persona së bashku, këta përgjigjen ndaj të dëmtuarit solidarisht.

Një tjetër problem i rëndësishëm në lidhje me padinë civile në procesin penal, ka të bëjë me detyrimin e paditësit civil që në bazë të K.Pr.Penale të paguajë taksën gjyqësore mbi bazën e vlerës së padisë. Jo në të gjitha rastët taksa gjyqësore mund të përballohet financiarisht nga viktimat e krimit.

Praktika gjyqësore në lidhje me kompensimin e viktimave të krimeve është shumë e pakët. Një studim i bërë nga Qendra për Iniciativat Ligjore i fokusuar në 54 procedime penale për trafikim, midis viteve 2001-2003 nuk gjeti asnjë çështje në të cilën të ishte paraqitur kërkesa civile për kompensim në procesin penal. Arsytet që qëndrojnë për këtë problem janë: mungesa e ndihmës ligjore falas për viktimat e krimit, niveli i ulët i të drejtave të garantuara nga ligji për viktimat e krimit, mungesa e informimit të viktimave nga avokatët e tyre si dhe frika e viktimave për të kërkuar kompensim nga një hakmarrje nga autori i krimit ose nga rreziku

²¹ Për më shumë shih Vendimin Unifikues të Kolegjeve Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 284, dt. 15.09.2000 dhe Vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. 284, dt. 26.06.2000.

i riviktimizimit²². Sipas Kryetarit të gjykatës së Krimeve të Rënda, aty nuk është paraqitur kurrë një kërkesë për kompensimin e dëmeve nga viktimat. Nga viti 2000-2006, është evidentuar vetëm një rast, kur gjykata penale ka gjykuar dhe padinë civile në procesin penal në një çështje me objekt shfrytëzimin e prostitucionit.²³

Sipas Raportit të OSCE-ODIHR “Dëmshpërblimi për personat e trafikuar dhe të shfrytëzuar në rajonin e OSBE-së” ka shumë pak raste të procedimeve gjyqësore për kërkimin e kompensimit në rastet e trafikimit të qenieve njerëzore (ka 2.45 milion raste në vitin 2005, ILO). Gjykimi i veprave penale të trafikimit është i vështirë sepse shpesh trafikuesi është i panjohur, është jashtë juridiksionit të gjykatës, krimi kërkon një numër të madh elementesh për t’u provuar, ka mungesë të theksuar provash për të provuar trafikimin ose personi i trafikuar nuk është në gjendje ose nuk dëshiron të bashkëpunojë me drejtësinë. Në shumë vende ligjet janë të reja dhe ka një boshllëk kohor midis hyrjes në fuqi dhe zbatimit të ligjit. Kështu që kompensimi në procesin penal është i vështirë të realizohet për pjesën më të madhe të personave të trafikuar.²⁴

Disa nga avantazhet e padisë civile në procesin penal në raport me padinë civile janë:

- Gjyqtari penal ka një pamje më të qartë dhe më të plotë në lidhje me ngjarjen e ndodhur dhe për rrjedhojë ai është në gjendje të vlerësojë më mirë kushtet dhe masën e dëmit.

- Procesi penal është më i shpejtë dhe më ekonomik pasi zhvillohet në bazë të parimit të gjykimit të pandërprerë, në raport me procesin civil, i cili zgjat më shumë në kohë dhe është më i kushtueshëm.²⁵

- Paditësi civil në procesin penal është i çliruar nga barra e provës në lidhje me fajtorin e dëmit të shkaktuar, i cili kërkohet të shpërblehet, sepse në procesin gjyqësor penal kjo barrë prove bie mbi organin e akuzës.

3.2 Mekanizmi shtetëror i kompensimit të viktimave të krimit

Në rastet kur asnjë prej mjeteve procedurale të sipërpërmendura nuk është efikas në garantimin e së drejtës për kompensim të viktimës së krimit, për shkak se autori i krimit nuk është zbuluar, ose është zbuluar por nuk është arritur të dënohet, ose nuk ka mjete monetare për të paguar kompensimin, është shteti që duhet të realizojë kompensimin monetar të viktimave të krimit.

²² Raporti “Dëmshpërblimi për personat e trafikuar dhe të shfrytëzuar në rajonin e OSBE-së”, përgatitur nga OSCE-ODIHR, Varshavë, 2008, fq. 23-52.

²³ Anastasi, “Leksione për Shqipërinë nga një analizë e krahasuar mbi të drejtën për kompensim të viktimave të trafikimit, Revista “Ligji mundësi zhvillimi për gratë,” fq. 24-25.

²⁴ Raporti “Dëmshpërblimi për personat e trafikuar dhe të shfrytëzuar në rajonin e OSBE-së”, përgatitur nga OSCE-ODIHR, Varshavë, 2008, fq. 23-52.

²⁵ Mustafaj, Ilir. “Trajtimi i dëmit civil të ardhur nga vepa penale”, temë doktrature, Tiranë, tetor 2009.

Kompensimi shtetëror i viktimave të krimit duhet të bëhet nëpërmjet krijimit të një fondi shtetëror për kompensimin. Fondi shtetëror i kompensimit të viktimave mund të financohet me të ardhurat e garantuara nga sekuestrimi i pasurisë së të pandehurve dhe të përfitimeve të ardhura nga vepra penale. Në Konventën e Këshillit të Evropës “Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme” të ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar më datë 29.07.2004, vendoset si detyrim për shtetet anëtare krijimi i një skeme shtetërore për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme. Shqipëria akoma nuk e ka krijuar një skemë të tillë.

Kriminologët tradicionalisht paraqesin dy argumente në favor të krijimit të skemave shtetërore të kompensimit të viktimave të krimit. Së pari, skemat shtetërore të kompensimit janë të bazuara mbi parimet e barazisë dhe solidaritetit social. Sipas kësaj teorie viktimat e krimit janë viktimat të shoqërisë, për rrjedhojë duhet të kompensohen nga shoqëria për dëmet e pësuarat. Argumenti i dytë në favor të skemave shtetërore ka të bëjë me faktin që këto skema fillojnë të veprojnë në momentin që mjetet e tjera nuk kanë rezultuar të efektshme²⁶.

Nga ana tjetër, të tjerë kriminologë japin argumentet e tyre kundër krijimit të skemave shtetërore të kompensimit, për shkak të kostos së madhe që i sjellin këto skema buxhetit të shtetit.²⁷

Shtete të rajonit të OSBE-së kanë bërë shumë hapa përpara në ndërtimin e skemave të kompensimit të viktimave nga shteti, si p.sh. Mbretëria e Bashkuar, Franca dhe Rumania. Skemat shtetërore të kompensimit kanë avantazhet dhe të metat e tyre. Këto skema shpesh përfshijnë mundësinë për të dhënë pagesat e kompensimit urgjentisht ose përkohësisht. Disa skema i lejojnë shtetet të trashëgojnë nga viktimat të drejtën për të paditur kundërvajtësin për kompensim, siç ndodh në Francë dhe Ukrainë. Kjo masë tregon për karakterin “moral” dhe ndëshkues të skemës. Një tjetër avantazh i këtyre skemave është mos ekzistenca e domosdoshmërisë për të identifikuar fajtorin. Një raport policie dhe një dëshmi për të ndihmuar policinë në hetimet e saj janë zakonisht të mjaftueshme për të fituar të drejtën e përfitimit nga skema.

Skemat shtetërore janë më fleksibël, më pak burokratike dhe të shpejta se sa procedimet civile. Megjithatë ato shpesh kanë kritere të rrepta pranimit të bazuara në statusin e kombësisë ose të rezidencës të cilat mund të mos jenë në gjendje të kënaqin të gjithë personat e trafikuar. Ato mund të jenë gjithashtu të vlefshme vetëm për viktimat e disa lloje krimesh të tilla si krimet e dhunshme. Përveç vuajtjes së traumave, shfrytëzimit dhe humbjeve ekonomike ndaj viktimës mund të mos jetë ushtruar dhunë fizike gjatë trafikimit, fakt ky që nuk i jep mundësi asaj

²⁶ Katsoris, Nicholas C. “The European Convention on the Compensation of victims of violent crimes: a decade of frustration.” *Fordham International Law Journal*, Volumi 14, 1990.

²⁷ Katsoris, “The European Convention on the Compensation of victims of violent crimes: a decade of frustration.”

të kërkojë kompensim nga fondi i skemës shtetërore të kompensimit për viktimat e krimit.

Së fundi shpërblimi i paguar nga shteti mund të mos mbulojë të gjitha dëmet të cilat mbulon një padi civile, p.sh. ato mund të mos mbulojnë dëmet morale siç ndodh në Ukrainë dhe Rumani. Këto skema mund të kufizojnë shumën e përfituar me vendosjen e një tarife fikse siç ndodh në Mbretërinë e Bashkuar, gjë e cila e çon viktimën në mundësinë e zgjedhjes së pranimit të kësaj shume të vogël apo të ngritjes së padisë civile kundër keqbërësit.²⁸

Disavantazhi qëndron në faktin se skemat shtetërore janë të shtrenjta si për nga shpenzimet administrative ashtu dhe për nga shumat e kompensimit të paguara. Qeveritë preferojnë më shumë t'i investojnë këto para në aktivitete që kanë për qëllim forcimin e shtetit të së drejtës ose për të asistuar dhe ndihmuar personat e trafikuar.

IV. KONKLUZIONE

Në Shqipëri pozicioni i viktimës mbetet akoma shumë problematik. Nuk ka një dokument të vetëm ku të sanksionohen të drejtat e viktimave, veçanërisht viktimave të trafikimit, të shfrytëzimit për prostitucion apo për punë të detyruar. Gjithashtu nuk është ndërtuar akoma skema shtetërore për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme. Ka mjaft probleme me padinë civile në procesin penal, pasi pjesa më e madhe e gjyqtarëve e veçojnë padinë civile nga procesi penal. Probleme ka edhe me mbrojtjen ligjore falas.

Pavarësisht kuadrit të pasur ligjor, në fushën e kompensimit të viktimave të krimeve të dhunshme, ka akoma probleme të rëndësishme. Për këtë qëllim rekomandojmë:

- Plotësimin e kuadrit ligjor, duke i dhënë të drejtën gjyqtarëve për të vendosur akordimin e një shume kompensimi viktimës kryesisht, pa qenë nevoja e paraqitjes nga saj të një padie civile;
- ngritjen sa më shpejt të jetë e mundur skema shtetërore e kompensimit të viktimave krimeve të dhunshme;
- ndryshimin e K.Pr.Penale në pjesën kur parashikon të drejtën e gjyqtarit për veçimin e padisë civile nga procesi penal duke mos ia dhënë atij këtë të drejtë;
- garantimin e ndihmës ligjore falas për viktimën kur ajo paraqet një padi civile në procesin penal për kërkimin e kompensimit;
- hartimin e një karte për të drejtat e viktimave në procesin penal.

²⁸ Për më shumë rreth avantazheve dhe disavantazheve të skemave shtetërore shih: Raporti “Dëmspërblimi për personat e trafikuar dhe të shfrytëzuar në rajonin e OSBE-së”, përgatitur nga OSCE-ODIHR, Varshavë, 2008, fq. 23-53.

Vetëm nëse është arritur kompensimi dhe rehabilitimi i viktimave të krimit dhe dënimi i autorit të veprës, mund të pohojmë, që drejtësia ka bërë rrugën e saj. Ekzistenca e këtij instituti tregon për shkallën e lartë të qytetërimit juridik të një shteti.

BIBLIOGRAFIA

Anastasi, Aurela. "Leksione për Shqipërinë nga një analizë e krahasuar mbi të drejtën për kompensim të viktimave të trafikimit." Revista Ligji mundësi zhvillimi për gratë, nr.1 (18), mars 2008, fq. 17-32.

Raporti "Dëmshtëpërblimi për personat e trafikuar dhe të shfrytëzuar në rajonin e OSBE-së", përgatitur nga OSCE-ODIHR, Varshavë, 2008.

Katsoris, Nicholas C. "The European Convention on the Compensation of victims of violent crimes: a decade of frustration, Fordham International Law Journal, Volumi 14, 1990.

Mustafaj, Ilir. "Trajtimi i dëmit civil të ardhur nga vepa penale", temë doktorature, Tiranë, tetor 2009.

Vendimin Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 284, dt. 15.09.2000.

BURGIMI SHTËPIAK SI ALTERNATIVË E VUAJTJES SË DËNIMIT ME BURGIM NË INSTITUCIONET PENITENCIARE DHE SFIDAT E APLIKIMIT NË PRAKTIKË

MSc. Abidin TRENA

Universiteti Ndërkombëtar në Strugë/Fakulteti Juridik
e-mail: a.trena@eust.edu.mk

MSc. Guximtar RUSHANI

Universiteti Ndërkombëtar në Strugë/Fakulteti Juridik
e-mail: g.rushani@eust.edu.mk

ABSTRAKT

Burgimi shtëpiak është një nga gjashtë llojet e masave alternative të paraqitura në Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë, i cili përdoret kundër kryerësve të veprave penale kur plotësohen kushtet ligjore për aplikimin e tij. Aplikimi i kesaj mase alternative sjell një numër përfitimesh të karakterit objektiv dhe subjektiv dhe njëkohësisht i përgjigjet natyrës së politikës penale të cilën pretendon të zhvillojë Republika e Maqedonisë. Burgimi shtëpiak është modaliteti i vuajtjes së dënimit me burgim: i dënuari të cilit në kushte të caktuara ligjore i është shqiptuar dënim me burgim dhe të njëjtin e vuan në shtëpi! Sipas kësaj, ky sanksion nuk është alternativë e burgut, por alternativë e vuajtjes së tij në entet penalo-përmirësues.

Aplikimi në praktikë i burgimit shtëpiak në Republikën e Maqedonisë paraqitet në nivel të ulët për shkak të disa faktorëve të natyrave të ndryshme. Në radhët e mangësive për aplikimin e masave alternative renditet mungesa e politikës kriminale për çrrënosjen së krimit, ku një ndër kushtet bazë për zbatimin e sanksioneve është ekzistenca e institucioneve përkatëse, përkatësisht stafit të institucioneve. Drejtoria për zbatimin e sanksioneve penale ka paraqitur projektin për zhvillimin e Shërbimit të provës e cila pritet të nxisë rritjen e aplikimit të burgimit shtëpiak.

Fjalë kyçe: sanksion, burgimi shtëpiak, alternativë, politika penale

HYRJE

Në zhvillimin e sistemit të sanksioneve penale masat alternative, njëkohësisht dënimi me burgim shtëpiak si pjesë e tyre, janë lloje të reja të sanksioneve penale të cilat në mënyrë të kompletuar në legjislacionin e RM-së janë futur në vitin 2004. Karakteristikë e veçantë e tyre dhe njëkohësisht edhe përparësi është që ato nuk paraqesin qëllimin fillestar të dënimit, që është hakmarrja ndaj kryerësit,

mirëpo rëndësi parësore paraqet nxitja e drejtësisë restorative dhe humanitare si tendenca më të reja të drejtësisë në botë, që kanë për qëllim minimalizimin apo shmangien e efekteve negative që jep dënimi me burgim, meqë këto masa paraqiten si zëvendësues të burgut.

Benefitet e aplikimit të masave alternative në shoqëri janë të shumëllojshme. Përfitimi më i madh gjithmonë i përket kryerësit të veprës penale ndaj të cilit jepet mundësia të kryejë dënimin në liri, ndërsa nga ana tjetër shmangen harxhimet financiare të cilat shteti e ka të nevojshme ti shpenzojë për secilin të burgosur, por edhe zbutet mbipopullimi i burgjeve që përfshin RM-në.

Nga aspekti i rregullativës ligjore kjo pjesë e sistemit të sanksioneve penale ka mangësi në pjesën e implementimit të tyre. Si shembull organ të zbatimit të burgimit shtëpiak Ligji për mbrojtje sociale parasheh Qendrat për punë sociale, mirëpo ka mungesë në sqarimin se si do të bëhet realizimi i kësaj. Hap i rëndësishëm në këtë drejtim në RM është bërë me projektin për aplikimin e Shërbimit të provës. Projekti ka filluar që nga viti 2013 për të krijuar kushtet që të fillojë të zbatohet Shërbimi i provës. Parashihet që si projekt të përfundojë në vitin 2016 kur edhe do të fillojë të zbatohet Shërbimi i provës.

Politika e sanksioneve penale në Republikën e Maqedonisë

Sistemi i sanksioneve penalo-juridike në kuptimin më të ngushtë i përfshin pasojat ligjore të veprës penale që i shqiptohen kryerësit nga ana e gjykatës: dënimet, masat alternative, masat e sigurisë dhe masat edukuese. Në kuptim më të gjërë, nocioni i sistemit penal-juridik, më saktë sistemi i pasojave penalo-juridike të veprës penale i përfshin të gjitha ndalesat juridike tjera që e godasin kryerësin pa marrë parasysh se a e shqipton gjykata a hyn në fuqinë e ligjit, të tilla janë masat e posaçme të konfiskimit, marrjes së sendeve dhe pasojat juridike të dënimit.¹

Nga të dhënat teorike penalo-juridike konkludoj se, politika e sanksioneve penale në RM është në raport të ngushtë me zhvillimet e legjisllacioneve ndërkom-bëtare, kjo si pasojë e aspiratës së RM-së për anëtarësim në Bashkimin Europian. Në kuadër të kësaj, edhe miratimi i dënimeve alternative në legjisllacionin tonë penal është pasojë e adoptimit të legjisllacionit tonë me atë të BE-së si njëri ndër kushtet për anëtarësim në BE. Pjesa tjetër e normave penale në fushën e dënimeve vijnë nga dokumentet e OKB-së të cilat RM i ka miratuar në cilësinë e të qenit anëtar këtë organizatë.

Zhvillimi i sanksioneve penale deri tek masat alternative

Koncepti i dënimit është i vjetër sa edhe vetë njeriu, mirëpo gjatë historisë kanë ndryshuar llojet dhe mënyra e ekzekutimit të dënimit. Format e para të reagimit të shoqërisë kanë qënë dëbimi nga fisi, gjakmarrja, hakmarrja, më pas si

¹ Kambovski, Dr Vllado, E drejta penale pjesa e pergjithshme, Shkup, 2010, fq. 451

dënime aplikoheshin dënimi me vdekje, gjymtimi, më pas edhe dënimi me burg. Por ndryshimet më të rëndësishme në fushën e sanksioneve penale janë bërë në kohën më të re (shekulli XIX – XX) ku sipas profesor Halilit dënimet me heqje lirie janë paraqitur pas Revolucionit borgjez francez (1789) si një lloj përpjekje për ndryshimin e gjendjes që ekzistonte deri atëherë, ku një numër i madh i veprave penale si sanksion parashihte dënimin me vdekje².

Refoma e legjislacioneve penale të shekullit XX realizohet me emë-ruesin e përbashkët të hulumtimit pas alternativave për burg mbi idenë e bifurkimit: dënim heqje lirie si përgjigje implementuese për veprat e rënda dhe delikuentët e rëndë, dënim me të holla, masat e mbikqyrjes dhe trajtim për lirim për veprat më të lehta dhe të shkallës së parë. Zhvillimi i këtillë i sistemit të sanksioneve është i determinuar nga disa faktorë, nga të cilët rol vendimtar kanë: qëndrimet e përgjithshme në raport mes veprës penale dhe dënimin, koncepti i shtetit dhe e drejta e saj për dënim dhe e treta, roli dhe ndikimi i shkencave mbi kriminalitetin.³

Në një pikëpamje më të gjeneralizuar mund të shihet se politika e sanksioneve penale është e orientuar kah qëllimi restorativ i sanksioneve penale dhe kah individualizimi i dënimin. Pra, qëllimi i dënimin është të vetëdijësojë kryerësin, t'a parandalojë atë që mos të kryejë vepra të tjera penale, që ai pas vuajtjes së dënimin t'i kthehet jetës normale në shoqëri, ndërsa karakteri individual i dënimin shihet në aspektin që dënimi duhet t'i përshtatet individit, karakterit të tij, personalitetit, dosjes së tij penale (ka kryer ose jo vepra tjera penale në të kaluarën), gjendjes së tij sociale, shkaqet e kryerjes së veprës etj; pra, jo domosdoshmërisht dënimi për të njëjtën vepër penale duhet të aplikohet njëlloj tek personat e ndryshëm.

Dënimi me burgim në sistemin e tërësishëm ndëshkiomor në botë, edhe pse më së shpeshti u është shqiptuar, por edhe u shqiptohet kryerësve të veprave penale, nuk dha efektet e pritura në:

- luftimin e kriminalitetit në tërësi
- mbrojtjen më të mirë të vlerave më vitale të individit dhe shoqërisë
- zvogëlimin e kriminalitetit, përkundrazi kemi rritje të kriminalitetit klasik dhe krijimin e formave të reja të kriminaliteit, e sidomos të krimit të organizuar (trafikimit me qenie njerëzore, kontrabandës me armë, drogë, derivate të naftës, duhan, para të pista, shtim i kriminalitetit në shoqëri, terrorizmi dhe forma të tjera të kriminalitetit të organizuar)
- zvogëlimin e krimeve që i kryejnë femrat dhe të miturit
- zvogëlimin e recidivistëve
- sigurimin e paqes dhe rendit në përmasa kombëtare dhe ndërkombëtare

² Halili, Dr Ragip, Penologjia – shkenca mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, Prishtinë, 2002, fq.15

³ Kambovski, Dr Vllado, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Shkup, 2010, fq. 453

- zvogëlimin e personave që mbahen në shtëpitë ndëshkuese-përmirësuese dhe edukuese-përmirësuese, dhe çështje të tjera.⁴

Duke shqyrtuar këtë problematikë mbi rritjen e kriminalitetit në vend dhe për pasojë krijimin e disa problemeve tjera zinxhir, si mbingopja e burgjeve, dyshimi mbi efikasitetin e sistemit të dënimeve penalo-juridike etj, lind nevoja për studimin e këtij sistemi sidomos të pjesës së dënimeve alternative. Si një faktor për përmirësimin është nxitja e shqiptimit më të madh të masave alternative, si lloje të dënimeve me karakter më human dhe si dënime të cilat shmangin pasojat negative të dënimit me burg dhe qëndrimit në institucionet penitenciare. Në favor të zbatimit më të gjerë të masave alternative theksohen në shumë argumente, të mbështetura edhe në kritikën e burgut. Theksohet se ata janë më adekuat për një sërë kryerësish, siç janë kryerësit e parë, e përkrahin reintegrimin në shoqëri dhe për këtë janë më human se burgu. Veç kësaj, kushtojnë më pak se burgu, i lehtësojnë burgjet dhe mundësojnë në to të zhvillohet trajtim me adekuat i të burgosurve.”⁵

Në kohën në të cilën jetojmë, përkundër kritikave dhe anëve negative të dënimit me burgim, ky lloj dënimi nuk mund të abrogohet menjëherë për shumë kryerës të veprave penale, ngase edhe sot e kësaj dite është i domosdoshëm.⁶ Domosdoshmëria e këtij dënimi shihet në kryerësit e veprave të rënda penale, recidivistëve, personave tek të cilët konstatohet se aplikimi i masave alternative nuk do të arrinte qëllimin e ndërjegjësimin të kryerësit për veprën e kryer në dëm të të mirës së caktuar, etj. Duke e analizuar efikasitetin e dënimit me burg në rast të disa veprave të caktuara penale (vrasja, terrorizmi, etj.) mund të konstatoj se aplikimi i dënimit me burg do të jetë i nevojshëm gjatë gjithë ekzistencës së shoqërisë njerëzore, mirëpo kjo nuk do të thotë që të mos avancohen masat alternative, përkundrazi aplikimi i tyre do të ketë efekt të lartë pozitiv.

Masat alternative tregojnë idenë themelore mbi të cilën është koncentruar reforma bashkëkohore dhe sistemi i sanksioneve. Të gjitha inovacionet në këtë fushë në të cilën janë të mbërthyer dënimet klasike dhe masat e sigurisë, ndodhin kryesisht si shprehje e tendencave bashkëkohore për zbatim restriktiv të burgut dhe trajtim të autorit jashtë burgut. Kjo tendencë gjenë mbështetje dhe arsyetim si në aspektin teorik, ashtu edhe në atë praktik. Ajo është më shumë se përgjigje gjatë krizave të shpeshta nëpër burgje, hyrje në shfrytëzimin e metodave dhe teknikave të reja të kontrollit social të kriminalitetit që janë në hap me erën e re teknologjike-informatike. Zbatimi i alternativave tradicionale të burgut (dënimi me të holla, dënimi me kusht) në dekadat e fundit të shekullit të kaluar nuk ndihmoi shumë në reduktimin e tij. Për këtë sot në shumë legjilatura perëndimore ka filluar trendi në

⁴ Ukaj, Dr. Bajram, vep. e cit., fq. 295

⁵ Kambovski, Dr Vllado, vep. e cit., fq 562

⁶ Salihu, Dr. Ismet, E drejta penale – pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2008, fq. 459

gjetjen e masave të reja alternative.⁷ Edhe RM bën pjesë në grupin shteteve të cilat në masë të konsiderueshme vënë në zbatim këto lloje të sanksioneve.

Nivelin e shqiptimit të masave alternative në RM e kam paqyruar në Tabelën 1.

Tabela 1⁸

Niveli i masave alternative të shqiptuara ne krahasim me numrin e përgjithshëm të gjykrimeve për periudhën (2010 – 2015).

	Numri i përgjithshëm i gjykrimeve	Dënime kryesore	Dënime dytësore	Dënim e Alternative	Të liruar nga dënimi	Përqindja e dënimeve alternative
2010	9 169	4 705	177	4 283	4	46.71%
2011	9 810	5 243	169	4 394	4	44.79%
2012	9 042	5 230	245	3 565	2	39.43%
2013	9 539	5 464	160	3 914	1	41.03%
2014	11 683	6 039	224	5 417	3	46.37%
2015	10 312	5613	235	4464	/	43.29%

Nga Tabela 1 vërejmë se, masat alternative kanë vend të rëndësishëm në tërësinë e sanksioneve penale drejtësinë e RM-së. Niveli i ekzekutimit të këtyre llojeve të sanksioneve penale në RM është i lartë. Duke analizuar numrin e masave alternative të shqiptuara ne krahasim me numrin e përgjithshëm të gjykrimeve për periudhën 2010 – 2015 në RM zënë një përqindje e cila varion nga 39% deri më 46% nga numri i përgjithshëm i gjykrimeve.

Karakteristika të masave alternative

Si lloje të sanksioneve të paraqitura veçmas në KPM, masat alternative dallohen nga sanksionet tjera penale. Si grup i veçantë i sanksioneve penale ato përfshijnë disa karakteristika edhe atë:

- Masat alternative janë sanksione, që do të thotë se ato nuk paraqesin alternativë të dënimit, ose më saktë, të ikjes nga dënimi, por një nga llojet e sanksionimit, me të cilat i iket burgimit, si dënim.⁹

⁷ Kambovski, Dr Vllado, vep. e cit., fq. 561

⁸ Të dhënat statistikore janë grumbulluar nga publikimi “Kryerës të veprave penale, të paraqitur, të akuzuar dhe të dënuar në vitin (2010; 2011; 2012; 2013; 2014), madhorë dhe të mitur”, Enti statistikor shtetëror i Republikës së Maqedonisë, kumtesa 2.4.11.15-2011; 2.4.12.09-2012; 2.4.13.11-2013; 2.4.14.11-2014; 2.4.15.12-2015, Shkup, marrë nga web faqja zyrtare www.stat.gov.mk, më 3 shkurt 2016.

⁹ Kovaçiq, Marina, Vlerësimi i gjendjes së masave alternative në Republikën e Maqedonisë, Shkup, 2007, fq. 20

- Dimensioni human i dënimit. Në justifikimet dhe shpjegimet e nevojës për miratimin e masave alternative në rend të parë vendoset “aspekti apo dimensionin humanitar”, si një karakteristikë që kanë këto sanksione dhe masa. Ky dimension njerëzor është krijuar kryesisht nga vërejtjet kritike që i bëhen dënimit me burgim në pjesën e pasojave negative që mbyllja lë në personalitetin e të dënuarit dhe paralel me këtë, dështimi për të arritur objektivin kryesor të burgimit, risocializimit të të dënuarit.¹⁰

- Gjatë aplikimit të këtyre masave rëndësi e madhe i kushtohet individit (kryerësit). Dmth, shihet mundësia e aplikimit të masës së caktuar alternative ndaj personit konkret, kështu, këto masa nuk mund të shqiptohen ndaj kryerësit të rrezikshëm. Se, cili do të konsiderohet kryerës i rrezikshëm, teoria e konstaton këtë:

“Kryerës të rrezikshëm janë ata për të cilët konstatohet se rishtazi do të kryejnë veprën penale, përkatësisht, recidivistë të supozuar. Për shembull, personat që përdorin drogë, më saktësisht vartësit kanë më shumë gjasa të bëhen recidivistë se personat që nuk përdorin drogë, të cilët për shkak se nuk ekziston varësi kanë gjasa më të vogla për këtë (edhe pse nuk janë pa gjasa)”.¹¹

Kur është në pyetje dënimi me burg, më e rëndësishmja është se sa dhe cili është potenciali i personit të dënuar për risocializim, dhe sa është e përshtatshme për shoqërinë që të realizohet ai dënim. Këtu ka dy aspekte: Cili është përfitimi i shtetit dhe cili është përfitimi i individit?¹² Kjo tregon interesin e të dy palëve për zbatimin ose moszbatimin e dënimit me burg, ku në rast të moszbatimit do të vinin në shprehje masat alternative.

Në aspektin individual të kryerësit, në rast të mundësisë për zbatimin e masave alternative kërkohet edhe pranimi i tij për aplikimin e masës alternative të caktuar.

- Masat alternative nuk e anashkalojnë rëndësinë e viktimës në një veprën penale, kështu teoria juridike jep këtë shpjegim për rolin që i jep viktimës politika e aplikimit të masave alternative:

Kur është në pyetje viktima, masat alternative kanë kuptim dhe përmbajtje të dyfishtë: së pari, ato paraqesin gjetjen e mjeteve dhe metodave në vetë procedurën penale për dëmshpërblimin e viktimës së veprës dhe e dyta, përmes implementimit të përmbajtjes së masave alternative në fakt ndikohet në mënjanimin e menjëhershëm të shkaqeve, kushteve, marrëdhënieve të cilat kanë sjellë në paraqitjen e asaj veprë penale.¹³

¹⁰ Arnaudovski, Dr. Lupço; Buzharovska, Dr. Gordana; Celevski, Dragi; Nanev, M-sc. Lazar;, Strategjia për implementimin e masave alternative, Shkup, 2004, fq. 18

¹¹ Kovaçiq, Marina, Vlerësimi i gjendjes së masave alternative në Republikën e Maqedonisë, Shkup, 2007, fq.21

¹² Arnaudovski, Dr. Lupço; Buzharovska, Dr. Gordana; Celevski, Dragi; Nanev, M-sc. Lazar;, Strategjia për implementimin e masave alternative, Shkup, 2004, fq. 20

¹³ Po aty, fq. 22

- Preventiva speciale.¹⁴ Duke parë rëndësinë që i jepet kryerësit dhe karakteristikave të tij, mundësisë që të kompenzojë viktimën, mund të konkludojmë se me anë të kësaj i jepet mundësi të njëjtit që të reflektoj në veprën e kryer dhe kjo të paraqes një parandalim për kryerjen eventuale të ndonjë vepre tjetër penale në të ardhmen.

Përparësitë e përdorimit të masave alternative

Zhvillimi i së drejtës penale, me këtë edhe sistemi i sanksioneve penale, ka pësuar ndryshime të shumta, si në nivelin ndërkombëtar edhe në nivelin tonë shtetëror, duke eliminuar kështu mangësitë dhe duke krijuar zgjedhje që do të përkonin me zhvillimin e shoqërisë njerëzore. Ndër këto zhvillime dhe përmirësime të sistemit të sanksioneve, edhe pse akoma në zhvillim e sipër, janë masat alternative. Përparësitë e aplikimit të tyre literatura juridike i rradhiti këto:

- Dënimet alternative zvogëlojnë probabilitetin e rikthimit në rrethin e krimit.
- Dënimet alternative u kushtojnë më pak taksapaguesve.
- Dënimet alternative ofrojnë mundësi për zhdëmtimin e dëmit dhe viktimës.
- Dënimet alternative shmangim marrjen e kulturës së burgut, në mënyrën e të jetuarit, të të shprehurit dhe zakonet e ndryshme që fitohen gjatë qëndrimit në burg.
- Dënimet alternative ndihmojnë në mbajtjen e lidhjeve familjare dhe sociale.
- Dënimet alternative i japin mundësi të dënuarit për t'u riintegruar në shoqëri.
- Dënimet alternative e eliminojnë stigmën e dënimit me burgim. Turpi i të qenit në burg është kaq real, sa dhe anëtarët e pafajshëm të familjes e vuajnë atë edhe më shumë se i dënuari.

- Komuniteti përfiton nga anëtarët e tij të rregullt dhe që kanë një plan të qartë për jetën. Ky plan përfshin pjesëmarrjen në jetën ekonomike, një punë të rregullt dhe i japin një kontribut konkret komunitetit në vend të krijimit të problemeve.

- Financiarisht dënimet alternative kanë më pak shpenzime krahasuar me mbajtjen në institucione të të dënuarit.¹⁵

- Dënimet alternative duke u aplikuar ndaj kryerësve të cilët i kryejnë veprë kundrejt të mirave shoqërore, ato paraqesin mbrojtje për të mirat shoqërore dhe për shoqërinë.

- Dënimet alternative paraqiten edhe si preventivë ndaj kryerësve të mundshëm në shoqëri, veçanërisht ndaj të dënuarit tek i cili janë shqiptuar këto masa.

¹⁴Po aty.

¹⁵ Leka, Adrian, Alternativat e dënimit në Shqipëri, vështrim krahasues me Republikën e Maqedonisë dhe Republikën e Kosovës, Tiranë, 2015, fq. 31, marrë nga <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2015/11/Doktoratura-Adrian-Leka-Fakulteti-i-Drejtesise-Departamenti-i-se-Drejtes-Penale.pdf>, më datë 15.01.2016

Mangësitë që pamundësojnë zbatimin e masave alternative

Mangësitë, kryesisht ndahen në disa nivele:

- Në nivelin e politikës, më saktësisht mungesa e saj do të ishte në funksion të vendosjes së një sistemi efikas dhe sigurimit të kushteve që ai të funksionojë në mënyrë adekuate;
- Korniza jo e plotë juridike;
- Kompetencat dhe mekanizmat e padefinuara për zbatimin e sanksioneve dhe masave alternative;
- Mosekzistimi i një strukture të organizuar përkatëse;
- Kuadër jomjaft i edukuar;
- Mungesa e mjeteve financiare;
- Opinioni i pa informuar.¹⁶

Ndër faktorët kyç në mesin e mangësive për përdorimin e masave alternative është standardi nën nivelin e duhur të RM-së, sidomos kur flitet për standardin ekonomik (mungesën e mjeteve financiare). Mjetet financiare ndikojnë në të gjitha aspektet e zhvillimit të përdorimit të masave alternative që nga krijimi i një politike të mirëfilltë për përdorimin e tyre, krijimi i strukturës përkatëse për zbatimin e tyre, krijimin e kuadrove përkatës, informimi i opinionit, etj.

Faktorët që ndikojnë në nxitjen e aplikimit të masave alternative

Ndër faktorët të cilët mund të përmend si nxitës të aplikimit të masave alternative janë: mbipopullimi i burgjeve, dyshimi mbi efektin jo adekuat që mund të japë dënimi afatshkurtër me burgim, karakteri human i masave alternative, trendi botëror i përdorimit të tyre dhe të tjera. Në këtë kapitull do të përmenden dy prej tyre, të tjerat janë cekur në pjesë të ndryshme gjatë tërë punimit.

Mbipopullimi i burgjeve është fenomen që përcaktohet nga faktorë demografike, ekonomik, shoqëror dhe politik. Është një çështje që shkakton shumë probleme administrative dhe shpesh herë ndikon në shëndetin, sjelljen, dhe moralin e të burgosurve. Një nga problemet krye-sore për mbipopullimin e burgjeve është mungesa e politikës penale.¹⁷

Në Republikën e Maqedonisë sistemi penitenciar paraqet mangësi në shumë drejtime, në krijimin e kushteve standarde të të drejtave të të burgosurve të caktuara nga rregullat ndërkombëtare, në krijimin e ambienteve të përshtatshme në këto institucione, ndër të cilat është edhe siguri i kapacitetit për popullatën e burgosur.

Sipas raportit të Depratamentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës mbi të drejtat dhe liritë e njeriut, gjatë muajit tetor 2014, popullata e burgosur e RM-së

¹⁶ Kovaçiç, Marina, Vlerësimi i gjendjes së masave alternative në Republikën e Maqedonisë, Shkup, 2007, fq.14

¹⁷ Mandro-Balili A., Xhaferllari M., Hoxha G., Belishta A., Manual për aplikimin e alternativave të dënimit me burgim, Tiranë, 2010, fq. 6

është 3,034 të vendosur në 11 burgje dhe 2 institucione korrektuese për të mitur.¹⁸ Ndërsa të dhënat zyrtare mbi kapacitetin e institucioneve penitenciare në RM thonë se kapaciteti i këtyre institucioneve është 2531.¹⁹ Siç mund të shohim se popullata e burgosur në RM është rreth 500 vetë mbi kapacitetin e institucioneve.

Sipas artikullit të gazetës “Vest” më 14 gusht 2015, me titull “1900 të burgosur njëri mbi tjetrin në “Idrizovë”, Shtëpia Korrektuese Penale – Idrizovë ka arritur rekord prej 1900 të burgosurish, përderisa kapaciteti i institucionit është për 700 të burgosur.²⁰

Ndër politikat e shtetit për të ulur mbipopullimin e burgjeve është përmes faljes dhe amnistisë, por kjo nuk mjafton për mbipopullimin e burgjeve në këtë situatë si në RM, sepse mundësia për aplikimin e faljes dhe amnistisë paraqitet në numër të vogël në raport me nevojat. Për shembull, 45 ishtë numri i të falurve të fundit nga presidenti Ivanov, më 2 gusht 2015.

Kjo situatë paraqet një nga faktorët nxitës për përdorimin masave jo burgosëse, siç janë masat alternative. Duke shikuar se mundësia për aplikimin e masave alternative paraqitet tek rreth 90% e të burgosurve, sepse rreth 90% e tyre janë të dënuar me burgim afatshkurtër (shih tabelën 1), do të ulte numrin e mbipopullimit të burgjeve të paktën rreth kapacitetit maksimal.

Sipas Marina Kovacic, dënimet afatshkurtëra me burgim nuk mund të arrijnë qëllimin e dënimit, e as të ndikojë tek personi i dënuar, e as tek të tjerët në bashkësi, sepse me këtë nuk frikësojnë e as nuk zbrapsin nga kryerja e veprave penale, nuk ndikojnë në përmirësimin e të dënuarve, sepse janë tejet të shkurtëra që të mund të risocializojnë dhe rehabilitojnë ndokënd.²¹

¹⁸ Raport i Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës – Zyra për Demokraci, të drejtat e njeriut dhe punës, Raporti i shteteve mbi praktikën e të drejtave të njeriut për 2014, fq. 3, marrë nga web faqja zyrtare e Departamentit të shtetit, <http://www.state.gov/documents/organization/236762.pdf>, shikuar më 5 shkurt 2016

¹⁹ Të dhënat janë marrë nga Instituti për Hulumtimin e Politikës Kriminale pranë Universitetit të Londrës (ICPR – World Prison Brief), web faqja zyrtare, <http://www.prisonstudies.org/country/macedonia-former-yugoslav-republic>, shikuar më 6 shkurt 2016

²⁰ 1900 të burgosur njëri mbi tjetrin në “Idrizovë”, Gazeta “vest”, 14 gusht 2015, të dhënat janë marrë nga faqja zyrtare, <http://www.vest.mk/default.asp?ItemID=FAE8C29BDA6ECE4AAB-185374C6033FA0> shikuar më 6 shkurt 2016

²¹ Kovaçiq, Marina, Vlerësimi i gjendjes së masave alternative në Republikën e Maqedonisë, Shkup, 2007, fq.18

TABELA 2²²

Përqindja e dënimeve afatshkurtëra me burgim në raport me numrin e përgjithshëm të dënimeve me burgim

	Numri i përgjithshëm i dënimeve me burgim	Dënimet afatshkurtëra				Përqindja e dënimeve afat-shkurtëra
		Deri më 6 muaj	Prej 6 deri më 12 muaj	Prej 1 deri më 2 vjet	Prej 2 deri më 3 vjet	
2010	2596	997	693	506	210	92.68%
2011	3020	1230	794	592	177	92.48%
2012	2807	1206	746	480	157	92.23%
2013	3064	1148	808	613	198	90.30%
2014	3507	1372	750	653	285	87.25%
2015	3524	1276	795	696	312	87.37%

Nga Tabela 2, e cila shqyrton periudhën pesë vjecare 2010 – 2015, konstatohet se dënimet afatshkurtëra me burgim nga numri i përgjithshëm i dënimeve me burgim të shqiptuara, përbëjnë numrin më të madh të sanksioneve penale, edhe atë nga 87% deri më 92 %. Siç vërehet, numri i dënimeve me burg afatshkurtë është në një përqindje shumë të lartë.

Korniza ligjore e RM-së mbi masat alternative

Masat alternative në Republikën e Maqedonisë rregullohen nëpërmjet disa akteve juridike: Kodit Penal të Maqedonisë; Ligjit për Procedurë Penale; Ligjit për Kundërvajtje; Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale; Ligjit për Gjykata dhe Ligjit për Mbrojtje Sociale, të cilat domosdoshmërisht janë të lidhura zinxhir për zbatimin sa më efektiv dhe realizimin e qëllimit të këtij lloji të sanksioneve penale.

Alternativë e dënimit në të drejtën tonë penale të mëhershme paraqet dënimi me burg dhe vërejtja gjyqësore e pozicionuar si sanksion adominante. Me ndryshimet në KPM të vitit 2004 është vendosur sistem i rumbullakuar i masave alternative i cili përmban: dënimin me kusht, dënimi me kusht me mbikqyrje mbrojtëse,

²² Të dhënat statistikore janë grumbulluar nga publikimi “Kryerës të veprave penale, të paraqitur, të akuzuar dhe të dënuar në vitin (2010; 2011; 2012; 2013; 2014), madhorë dhe të mitur”, Enti statistikor shtetëror i Republikës së Maqedonisë, kumtesa 2.4.11.15-2011; 2.4.12.09-2012; 2.4.13.11-2013; 2.4.14.11-2014; 2.4.15.12-2015, Shkup, marrë nga web faqja zyrtare www.stat.gov.mk, më 3 shkurt 2016.

ndërprerje me kusht të procedurës penale, punë me interes publik vërejtje gjyqësore dhe burgim shtëpiak (n.48-a).²³ Përfshirja e masave alternative në sistemin e sanksioneve penale në RM dhe rritja e numrit të tyre, padyshim vë në dukje zbutjen, humanizmin dhe ridefinimin e politikës ndëshkimore dhe afirmimin e konceptit të të drejtave dhe lirive të njeriut në sistemin e sanksioneve në Republikën e Maqedonisë.²⁴

Burgimi shtëpiak

Burgimi shtëpiak është modaliteti i vuajtjes së dënimit me burgim: i dënuari të cilit në kushte të caktuara ligjore i është shqiptuar dënim me burgim dhe të njëjtin e vuanë në shtëpi. Sipas kësaj, ky sanksion nuk është alternativë e burgut, por alternativë e vuajtjes së tij në entet ndëshkimore-përmirësuese. Në legjislacionet bashkëkohore kjo alternativë kryesisht depërton në dy forma: burgu shtëpiak i thjeshtë dhe burgu shtëpiak me kontroll elektronik.²⁵

Sot edhe përkundër rezervave teorike të formuluar rreth kundërshtimit se mbikqyrja e realizimit të masës hyn në pacënueshmëri të shtëpisë, ekziston kryesisht raport pozitiv në pranimin e kësaj alternative si mënyrë për mënjanimin e burgut afatshkurtër për një kategori autorësh (pleq, të sëmurë).²⁶

Kushtet për shqiptimin e burgimit shtëpiak (neni 59-a). Nëse kryerësi i veprës penale për të cilën është paraparë dënim me gjobë ose dënim me burgim deri më një vjet, është i vjetër, i paaftë, rëndë i sëmurë apo është grua shtatzënë, gjykatësi mund t'i shqiptojë dënim me burgim dhe njëkohësisht të vendosë që me pëlqimin e tij dënimin ta vuajë me burgim shtëpiak.

Gjykata mund ta zëvendësojë dënimin me burgim me burgim shtëpiak nëse ekzistojnë kushte me mjete bashkëkohore elektronike apo të telekomunikacionit që të kontrollohet ekzekutimi i burgimit shtëpiak që përbëhet nga ndalesa për braktisjen e shtëpisë nga i dënuari.

Mbikqyrje mbi ekzekutimin e burgimit shtëpiak kryen gjykata e cila mund të caktojë ndërmarrje të masave të caktuara të mbikqyrjes, nga policia në vendin ku gjendet shtëpia e të dënuarit me obligim që rregullisht ta informojë për kryerjen e tyre.

Nëse i dënuari e shkel ndalesën për braktisje të shtëpisë, gjykata mund të caktojë që dënimi i zëvendësuar me burgim të ekzekutohet në tërësi në institucion për ekzekutimin e dënimit me burg.

²³ Kambovski, Dr Vllado, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Shkup, 2010, fq. 566

²⁴ Kovaçiq, Marina, Vlerësimi i gjendjes së masave alternative në Republikën e Maqedonisë, Shkup, 2007, fq. 25

²⁵ Osmani, Dr. Afrim, Komentari i ligjit për ekzekutimin e sanksioneve, Shkup, 2013, fq. 273

²⁶ Kambovski, Dr Vllado, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Shkup, 2010, fq. 580

Masat alternative mund t'i propozojë prokurori themelor publik ku, sipas ligjit për procedurë penale (neni 506), mund të shqiptohen këto masa alternative: punë në dobi të përgjithshme, ndërprerje me kusht të procedurës penale dhe burgim shtëpiak, dhe atë me propozim të prokurorit publik nëse janë plotësuar kushtet në Kodin penal për zbatimin e këtyre sanksioneve penale, gjykata mund t'i shqiptojë pa mbajtjen e seancës kryesore. Gjithashtu masat alternative mund të shqiptohen edhe nga paditësi privat.

Prokurori edhe paditësi privat mund të propozojnë tri nga llojet e masave alternative (sipas ligji për procedurë penale). Në Gjykatën Themelore të Strugës nuk ekzistojnë të dhëna të cilat tregojnë se është shqiptuar një nga këto masa të cilat mund t'i propozojë prokurori ose paditësi privat, kjo sjell në konstatimin se nuk ka raste të propozimit të masave alternative.

Nivel i varfër i informacionit mbi masat alternative ekziston në radhët e personave që merren me shqiptimin dhe zbatimin e masave alternative. Për sa i përket Prokurorisë, ato kanë kompetencë sipas ligjit që të mund të propozojnë masa alternative, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur gjatë periudhës kohore të shqyrtuar në këtë punim. Gjykata si hallka e dytë e zinxhirit të sistemit për aplikimin e masave alternative është organi më i nformuar në këtë drejtim, edhe pse kushtet nuk mundësojnë implementimin e tyre në praktikë. Siç thekson edhe gjykatësi në fjalë, sidomos për burgimin shtëpiak, për të cilin thotë se ka mungesë të mjeteve teknike për kontrollin e të dënuarve, ndërsa organi më pak i informuar rezulton Qendra për Punë Sociale, i cili njëkohësisht paraqet një pjesë shumë të rëndësishme të këtij sistemi.

Themelimi i shërbimit të provës

Drejtoria për zbatimin e sanksioneve po merr masa dhe aktivitete sistematike për krijimin e një shërbimi të veçantë prove i cili do të jetë përgjegjës për zbatimin e masave alternative të dënimit, duke ndjekur shembullin e disa vendeve evropiane, ku shërbimi i provës luan një rol të madh në procesin e risocializimit të personave në liri (në komunitet). Funkionimi i këtij shërbimi në të gjitha vendet ku ajo është themeluar, ka treguar rezultate jashtëzakonisht të mira në uljen e popullsisë të burgut, për të përmirësuar risocializimin e të burgosurve dhe të reduktuar recidivizmin.

Sipas analizës së Drejtorisë, shërbimi i provës do të zvogëlojë përsëritjen dhe parandalimin krimin; reduktimin e kostove të ekzekutimit të sanksioneve; Miratimi i vendimeve të duhura nga ana e gjykatave me dënime të përshtatshme për personat e dënuar (Krijimi i një sistemi për vlerësimin e rrezikut të të pandehurve në rrjedhën e procedurës gjyqësore); zbatimi praktik i masave alternative të dënimit dhe mbikëqyrjen efektive të personave të liruar me kusht ose që kanë qenë të dënuar me kusht me një mbikëqyrje mbrojtëse dhe ekzekutimin e suksesshëm të burgimit shtëpiak nëpërmjet mbikëqyrjen elektronike.

Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve në bashkëpunim me Ambasadën Britanike ka zhvilluar Strategjinë për zhvillimin e shërbimit sprovues në Republikën e Maqedonisë, i cili më 29.06.2013 është miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Kjo Strategji përcakton me saktësi synimet strategjike dhe aktivitetet për krijimin e një shërbimi të qëndrueshëm të provës në vend dhe që do të arrijë qëllimet e themelimit të saj.

Ndër përgjegjësitë e tjera, shërbimi i provës në përputhje me Strategjinë do të jetë përgjegjës për organizimin, ekzekutimin dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të masave alternative duke përfshirë monitorimin elektronik të personave që do të dënohen me burgim shtëpiak ose paraburgim. Mbikëqyrja elektronike siguron monitorimin dhe zbatimin e ndalimit të largimit nga banesa/vendbanimi i personit të cilit i është shqiptuar masa e paraburgimit/dënimit si alternativë ndaj paraburgimit / burgimit.

Trajnimi i stafit gjithashtu sigurohet për trajnimin e punonjësve në shërbimet publike, ndërmarrjet publike dhe organizatat humanitare (ku puna sociale kryhet në përputhje me ligjin) me qëllim pranimin e kryerësit gjatë ekzekutimit të dënimit; Trajnimi i publikut profesional (gazetarëve) për informimin e duhur dhe promovimin e aktiviteteve të fushatës mediale për të përmirësuar perceptimin e masave alternative. Është duke u përgatitur një analizë e nevojave dhe mundësive ekonomike për trajnimin e personave të dënuar për t'u angazhuar në prodhimin e produkteve të caktuara (p.sh. angazhimi i punës si pjesë e trajtimit) dhe përmbushjen e nevojave të caktuara të institucioneve të burgjeve.

Është përgatitur tashmë raport mbi vlerësimin e nevojave dhe specifikave teknike për të gjitha pajisjet e nevojshme për monitorimin elektronik. Gjithashtu është e nevojshme për të kryer aktivitetet për trajnim të specializuar të stafit për monitorimin elektronik dhe trajnim të specializuar të oficerëve të ardhshëm të shërbimit të provës për të përdorur sistemin për monitorim elektronik.

Themelimi i një sistemi provës në shtet është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Për të trajtuar problemin e ndëshkimit në kontekstin e një shoqërie komplekse është e qartë se nuk mund të mbështetet vetëm dhe ekskluzivisht në burgim, dmth dënime me burg. Sistemi i drejtësisë penale duhet të kërkojë vazhdimisht ide dhe zgjidhje të reja duke pasuruar sistemin e sanksioneve dhe mënyrat në të cilat janë liruar, dhe veçanërisht përmes masave alternative të pranuar gjerësisht që janë zhvilluar dhe dorëzuar nga shërbimi i provës. Zhvillimi dhe zbatimi i sanksioneve të cilat zbatohen në komunitet por të menaxhuara nga një shërbim special i provës është shumë më i përhapur në shumë sisteme ligjore.

KONKLUZIONE

Duke u bazuar në të dhënat teorike, legjislacionin pozitiv dhe në të dhënat nga praktika (statistikat nga Enti Statistikor i RM-së, statistikat nga Gjykata Themelore

e Strugës, intervistat me Gjykatës dhe të punësuar në Entin për Punë Sociale) konkludoj se burgimi shtëpiak si masë alternative nuk ka gjetur zbatim në praktikë që nga fillimi i miratimit të saj në KPM, për shkak të disa mangësive të cilat e pengojnë realizimin e kësaj mase.

Në radhët e mangësive për aplikimin e burgimit shtëpiak renditet mungesa e politikës kriminale në Republikën e Maqedonisë. Sipas raportit mbi gjendjen e masave alternative në RM, nuk ekziston politikë e çrrënosjes së krimit, përveç rasteve ad hoc si ‘lufta kundër terrorizmit’, ‘krimi i organizuar’ e presioni i organizatave ndërkombëtare dhe bashkësisë ndërkombëtare për çështjet e caktuara. Vetë ndryshimet e vitit 2004 në Kodin Penal të Maqedonisë janë bërë me shtysë dhe në përputhje me Rekomandimin 92 të Këshillit të Europës.²⁷ Këto ndryshime të bëra sidomos në pjesën e masave alternative edhe sot ngelen vetëm pjesë të shtuara në ligj sepse në praktikë nuk kanë hasur përdorim.

RM është vendi i vetëm në rajon i cili nuk përfshin në legjislacionin e vetë Shërbimin e provës. Ekziston projekt nga Ministria e Drejtësisë – Zyra për zbatimin e sanksioneve penale, për inkuadrimin e Shërbimit të provës në legjislacion e cila parashikon të hyjë në zbatim në fund të këtij viti.

Një ndër kushtet bazë për zbatimin e sanksioneve është ekzistenca e institucioneve përkatëse, përkatësisht stafit të institucioneve. Drejtoria për zbatimin e sanksioneve penale në projektin për zhvillimin e Shërbimit të provës 2013 – 2016 parashikon hapjen e 12 zyrave të reja në qytetet kryesore të Maqedonisë dhe rritjen e numrit të të punësuarve për 90 deri në fund të projektit tre vjeçar.

Zgjerimi i projektit për zhvillimin e Shërbimit të provës detyrimisht rrit nevojën për mjete financiare. Sipas Drejtorisë për zbatimin e sanksioneve deri në vitin 2016 do të sigurohen 47 milionë denarë për pagat e të punësuarve dhe mjete bazë për punën e tyre.

Komunikimi dhe bashkëpunimi mes institucioneve përgjegjëse për zbatimin e masave alternative në aspektin e aplikimit të tyre është mjaft i dobët.

Si mangësi paraqitet edhe mungesa e trajnimeve dhe seminareve mbi rëndësinë dhe ndikimin e aplikimit të masave alternative në shoqëri. Këtë gjë e pohojnë të intervistuarit.

Gjykatësi Lloga si mangësi radhit kushtet jo të plota për hetim të cilat do të ndikojnë direkt edhe në implementimin e masave alternative. Konkretisht, sipas gjykatësit, mungesë paraqitet në mjetet teknike për zbatimin e burgimit shtëpiak sepse pa ato mjete nuk mund të realizohet qëllimi i burgimit shtëpiak. Këtu përmend dhe thekson rast të shqiptimit të kësaj mase dhe mospërbajtjen e saj nga i dënuari, gjë që ka sjell pezullimin e kësaj mase.

Mundësi e vetme për vënien në zbatim të burgimit shtëpiak paraqitet realizimi i projektit për Shërbimin e provës nga ana e qeverisë.

²⁷ Kovaçiç, Marina, Vlerësimi i gjendjes së masave alternative në Republikën e Maqedonisë, Shkup, 2007, fq. 37-38

KUFIZIMI I TË DREJTAVE TË TË DËNUARVE NË BURGUN E SIGURISË SË LARTË

Prof. Asoc. Dr. Skeridian KURTI

Adela BUÇPAPAJ

Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës

ABSTRAKT

Kufizimi i lirisë personale nëpërmjet ekzekutimit të dënimit me burgim ka si kusht kryesor riedukimin e të dënuarve. Në varësi të rrezikshmërisë shoqërore të të dënuarve por edhe të veprës penale të kryer, Gjykata zbaton masa të ndryshme dënimi. Për pasojë kjo masë dënimi kërkon regjimin e duhur të sigurisë i cili mund t'i garantojë të dënuarit riedukimin e tij duke i siguruar të gjitha të drejtat që atij i'a njeht ligji. Për këtë qëllim në Ligjin Nr.8328 datë 16.04.1998 “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*” janë përcaktuar edhe llojet e institucioneve të ekzekutimit të vendimit penal. Një nga këto institucione është edhe burgu i sigurisë së lartë.

Qëllimi i këtij punimi është të tregojë se cila është rëndësia e këtij institucioni në sistemin e drejtësisë, cilat janë të drejtat që u zbatohen të dënuarve në këto institucione, a e ka prekur reforma në drejtësi burgun e sigurisë së lartë dhe kufizimin e të drejtave në këtë institucion, cili është raporti midis realizimit të funksionit riedukues dhe kufizimit të të drejtave të të dënuarve në këtë institucion.

Fjalë kyçe: Penologji, Ekzekutimi i vendimeve penale, Funkcioni riedukues, Sistemi penitenciar, Burgu i sigurisë së lartë

1. HYRJE

Sipas nenit 12 të Ligjit “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*” i ndryshuar, institucionet e ekzekutimit të vendimeve me burgim janë: burgu i sigurisë së lartë; burgu i sigurisë së zakonshme; burgu i sigurisë së ulët; institute të veçanta; institucionet e paraburgimit. Ndërsa në nenin 12/1 të po këtij ligji, legjislatori i ndan institucionet e ekzekutimit të dënimit me burgim në publike dhe private. Në ligj janë përcaktuar edhe kategoritë e personave të dënuar që mund të vendosen në institucionet private të vuajtjes së dënimit. Sipas nenit 12/2 të ligjit, në institucionet private të ekzekutimit të vendimeve penale vendosen të dënuar, për të cilët është caktuar si masë dënimi në maksimum deri në 5 vjet burgim. Pavarësisht këtij përcaktimi, legjislatori e ndalon vendosjen në këto institucione për të dënuar që, me vendim gjykate, janë caktuar në burg të sigurisë së lartë.

Personat e vendosur në institucionet e ekzekutimit të dënimit me burgim duhet të trajtohen me dinjitet dhe duke respektuar të drejtat njerëzore të tyre; ata trajtohen pa njëanshmëri dhe pa diskriminim mbi bazë gjinie, race, ngjyre, përkatësie etnike, gjuhe, feje, bindjeje politike, fetare ose filozofike, orientimi seksual, identiteti gjinor gjendjeje ekonomike, arsimore ose shoqërore, përkatësie prindërore, moshe, gjendjeje familjare ose martesore, gjendjeje shëndetësore, aftësie të kufizuar, shtetësie ose përkatësie në një grup të caktuar ose për çdo shkak tjetër që përbën diskriminim. Ligji kërkon edhe respektimin e të drejtave të kategorive të veçanta të të dënuarve siç janë të miturit, gratë, të dënuarit me probleme të shëndetit mendor apo fizik, të dënuarit e huaj.

Në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale ndalohet përdorimi i të gjitha formave të dhunës. Në raste të përdorimit të dhunës, autoritetet e institucionit, në çdo rast, mundësojnë fillimin e menjëhershëm të një hetimi të pavarur, nga strukturat dhe organet kompetente të ngarkuara me ligj, duke respektuar parimin e privatësisë, mbrojtjes dhe sigurisë personale.

Trajtimi i të paraburgosurve dhe të dënuarve synon rehabilitimin për riintegrimin e tyre në jetën familjare, shoqërore dhe ekonomike. Përgatitja për riintegrim fillon në paraburgim, vazhdon gjatë kryerjes së dënimit dhe pas lirisë nga burgu¹. Trajtimi i të paraburgosurve dhe të dënuarve duhet të bëhet sipas kriterit të individualizimit në përputhje me gjendjen dhe karakteristikat individuale të secilit të prej tyre. Individualizimi i trajtimit bëhet duke vlerësuar nevojat individuale psikologjike, shoqërore, të moshës, gjinore, gjendjen shëndetësore, orientimin seksual ose identitetin gjinor, situatën kulturore dhe ekonomike, mjedisin ku ka jetuar i paraburgosuri ose i dënuari, faktorët e riskut dhe motivimin për t'u përfshirë në veprimtaritë që organizohen në institucion. Vëzhgimi bëhet në fillim të trajtimit dhe rezultatet e tij verifikohen vazhdimisht gjatë ekzekutimit, duke bërë përshtatjet e duhura në bashkëpunim me të dënuarin.

Personat e dënuar vendosen në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale në bazë të një klasifikimi paraprak². Ky klasifikim bëhet në përputhje me realizimin e funksionit riedukues të dënimit dhe për këtë arsye ndahet në klasifikim të jashtëm dhe klasifikim të brendshëm. Klasifikimi i jashtëm shërben si bazë për të vendosur llojin e institucionit në të cilin personi do të vuajë dënimin: bazohet në kriteret objektive të tilla si: mosha, gjinia, lloji i veprës penale, lloji i dënimit, fakti nëse personi është përsëritës ose jo, etj.; ky klasifikim bëhet përpara se personi

¹ Sipas nenit 11 të Ligjit Nr.8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” i ndryshuar, pas procesit të vlerësimit bëhet programimi i trajtimit, në bashkëpunim me të paraburgosurin ose të dënuarin. Për çdo të paraburgosur dhe të dënuar hartohet plani i riintegrit, ndërsa për kategoritë e veçanta të të paraburgosurve dhe të dënuarve hartohet programi individual i trajtimit duke mbajtur parasysh edhe nevojat specifike të tyre.

² Shih, V. Hysi, *Penologjia*, Kristalina-KH, Tiranë, 2009, fq. 72.

të vendoset në institucion. Klasifikimi i brendshëm bëhet duke mbajtur parasysh personalitetin, prirjen dhe qëndrimet e personit të dënuar; ky klasifikim bëhet nga institucioni ku do të ekzekutohet dënimi: klasifikimi i brendshëm është rezultat i studimit gjithëplanësh që i bëhet personit të dënuar në fazën e pranimit dhe të materialeve që përmban fashikulli, i cili shoqëron personin.

Më poshtë do shpjegojmë vendosjen e të dënuarve në burgun e sigurisë së lartë dhe mënyrën e trajtimit të tyre në këtë institucion.

2. Vendosja e të dënuarve në burgun e sigurisë së lartë

Në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.8328 datë 16.04.1998 “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*” i ndryshuar, në burgun e sigurisë së lartë ekzekutohen vendimet me burgim për subjekte të krimit të organizuar dhe të dënuar të tjerë të cilët në kryerjen e veprës penale ose gjatë vuajtjes së dënimit janë karakterizuar nga qëndrime e sjellje që bëjnë të pamundur qëndrimin në burgjet e kategorive të tjera. Sipas këtij neni, kategoritë e të dënuarve që vendosen në burgun e sigurisë së lartë janë:

➤ Subjektet e krimit të organizuar. Në këtë rast, legjislatori nuk i lë mundësi interpretimi Gjykatës, e cila menjëherë pasi është provuar fajësia e të dënuarit për pjesëmarrje në një nga format e veçanta të bashkëpunimit e dënon atë për veprën penale të kryer duke përcaktuar si vend të vuajtjes së dënimit burgun e sigurisë së lartë.

➤ Të dënuar që për shkak të personalitetit të tyre nuk mund të vuajnë dënimin në burgjet e kategorive të tjera. Ky është rasti kur Gjykata, në përputhje edhe me funksionin riedukues të dënimit³, për shkak të rrethanave të kryerjes së veprës penale dhe rrezikshmërisë së të dënuarit vendos që dënimi të ekzekutohet në burgun e sigurisë së lartë.

➤ Të dënuar, të cilët gjatë vuajtjes së dënimit karakterizohen nga qëndrime dhe sjellje që e bëjnë të pamundur qëndrimin në burgjet e kategorive të tjera. Në një rast të tillë mund të flasim për transferim të të dënuarve nga burgjet e kategorive të tjera në burgun e sigurisë së lartë.

Vendosja e të dënuarit në burgun e sigurisë së lartë bëhet me vendim të Gjykatës. Në bazë të nenit 14 të Ligjit Nr.8328 datë 16.04.1998 “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*” i ndryshuar, kur Gjykata, në vendimin me burgim, nuk është shprehur për llojin e institucionit, ku do të vuhet dënimi, të dënuarit vendosen në një burg të sigurisë së zakonshme. Në këtë rast ka dy mundësi:

³ Sipas nenit 2 të Ligjit Nr. 8331 datë 21.04.1998 “*Për ekzekutimin e vendimeve penale*” i ndryshuar, me ekzekutim të vendimit penal kuptohet zbatimi i urdhërimeve që përmban vendimi penal i formës së prerë dhe i vendimeve që, sipas Kodit të Procedurës Penale, kanë ekzekutim të menjëhershëm, me synimin e riedukimit të të dënuarve, të rivendosjes së të drejtave të personave të proceduar padrejtësisht dhe të drejtave të subjekteve juridike të cenuara nga vepra penale, duke ndikuar në parandalimin e tyre.

– Gjykata në bazë të ligjit nuk e përcakton llojin e institucionit ku do të vuhet dënimi pasi mendon se në rastin konkret dënimi duhet të vuhet në një burg të sigurisë së zakonshme;

– Gjykata ka harruar të përcaktojë llojin e institucionit ku do të vuhet dënimi dhe për më tepër bëhet fjalë për një veprë penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe autori gjatë kryerjes së veprës penale ka shfaqur rrezikshmëri të lartë shoqërore.

Sipas paragrafit të dytë të nenit 13 të Ligjit Nr.8328 datë 16.04.1998 “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*” i ndryshuar, vendosja e të dënuarit në burgun e sigurisë së lartë kur nuk është shprehur Gjykata me vendim, bëhet me kërkesë të prokurorit tek ajo Gjykatë. Në këtë rast është i debatueshëm fakti se deri në çfarë moment duhet ta paraqesë kërkesën prokurori, para nxjerrjes së urdhërit të ekzekutimit apo mund ta paraqesë edhe pas nxjerrjes së urdhërit të ekzekutimit.

Sipas mendimit tonë, kërkesa e prokurorit drejtuar Gjykatës për përcaktimin e vendit të vuajtjes së dënimit duhet të paraqitet përpara se të fillojnë procedurat për ekzekutimin e vendimit. Vetëm në këtë moment do të kishte kuptim një kërkesë e cila do të mbështetej në rrethanat e kryerjes së veprës penale dhe rrezikshmërinë e autorit të saj. Në qoftë se kërkesa do të bëhej mbasi i dënuari të ishte vendosur në një burg të sigurisë së zakonshme atëherë këto argumente nuk do të mjaftonin më. I këtij mendimi është edhe jurisprudenca e Gjykatës së Lartë⁴, sipas së cilës: *Rrethanat e kryerjes së veprës penale, si dhe rrezikshmëria e autorit, nuk janë një argument i plotë, bindës për vendosjen e të dënuarit në një burg të sigurisë së lartë. Si rrjedhim gjyqtari mund të vendosi në një burg të sigurisë së zakonshme edhe një të dënuar për kryerjen e një veprë penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Në rast se kërkohet transferimi në një burg të sigurisë së lartë, i takon Gjykatës që, në zbatim të ligjit, mos të shikojë vetëm formën por edhe sjelljen e të dënuarit për atë periudhë kohore të vuajtur në burgun e sigurisë së zakonshme.*

Ndryshimi i klasifikimit të sigurisë nga institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së lartë në institucione të tjera të ekzekutimit të dënimit bëhet me kërkesë të prokurorit, të dënuarit ose përfaqësuesit të tij ligjor, pranë Gjykatës së rrethit gjyqësor ku ndodhet institucioni. Mbi bazën e këtij parashikimi ligjor, dhe në kuadër të zbatimit të funksionit riedukues të dënimit, Gjykata mund të urdhërojë transferimin e të dënuarit nga burgu i sigurisë së lartë në një institucion të një tjetër kategorie.

3. Parimet e përgjithshme të trajtimit të të dënuarve

Në bazë të nenit 3 të Ligjit Nr. 8331 datë 21.04.1998 “*Për ekzekutimin e vendimeve penale*” i ndryshuar, ekzekutimi i vendimeve që përmbajnë dënim, kufizon vetëm ato të drejta, në atë masë dhe kohë, sa përcakton vendimi penal, duke respektuar të gjitha të drejtat e tjera të njohura ligjërisht, përveç rasteve të

⁴ Shih, Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë Nr. 100 datë 10.02.2010.

përcaktuara shprehimisht në këtë ligj. Personi i dënuar në të gjitha fazat e ekzekutimit të vendimit, gëzon të drejtat që i takojnë sipas këtij ligji dhe, kur nuk i njihen ose i cenohen ato, kërkon mbrojtjen dhe realizimin e tyre në mënyrën që përcaktohet në këtë ligj.

Sipas nenit 5 Ligjit Nr.8328 datë 16.04.1998 “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*” i ndryshuar, të paraburgosurit dhe të dënuarit trajtohen me dinjitet dhe duke respektuar të drejtat njerëzore të tyre. Ndërsa sipas nenit 9 të po këtij ligji, trajnimi i të paraburgosurve dhe të dënuarve synon rehabilitimin për riintegrimin e tyre në jetën familjare, shoqërore dhe ekonomike. Përgatitja për riintegrim fillon në paraburgim, vazhdon gjatë kryerjes së dënimit dhe pas lirimit nga burgu.

Sipas nenit 10 Ligjit Nr.8328 datë 16.04.1998 “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*” i ndryshuar, trajtimi i të paraburgosurve dhe të dënuarve duhet të bëhet sipas kriterit të individualizimit në përputhje me gjendjen dhe karakteristikat individuale të secilit të dënuar. Individualizimi i trajtimit bëhet duke vlerësuar nevojat individuale psikologjike, shoqërore, të moshës, gjinore, gjendjen shëndetësore, orientimin seksual ose identitetin gjinor, situatën kulturore dhe ekonomike, mjedisin ku ka jetuar i paraburgosuri ose i dënuari, faktorët e riskut dhe motivimin për t’u përfshirë në veprimtaritë që organizohen në institucion. Vëzhgimi bëhet në fillim të trajtimit dhe rezultatet e tij verifikohen vazhdimisht gjatë ekzekutimit, duke bërë përshtatjet e duhura në bashkëpunim me të dënuarin. Ndërsa sipas nenit 11 të po këtij ligji, pas procesit të vlerësimit bëhet programimi i trajtimit, në bashkëpunim me të paraburgosurin ose të dënuarin. Për çdo të paraburgosur dhe të dënuar hartohet plani i riintegrimit, ndërsa për kategoritë e veçanta të të paraburgosurve dhe të dënuarve hartohet programi individual i trajtimit duke mbajtur parasysh edhe nevojat specifike të tyre. Rëndësi e veçantë i kushtohet trajtimit psiko-social të të paraburgosurve dhe të dënuarve të mitur, të rinjve 18 deri 21 vjeç, grave, personave me çrregullime të shëndetit mendor, të pasura ose të fituara gjatë burgimit, personave me aftësi të kufizuara, personave me orientim seksual të ndryshëm, personave me sëmundje kronike ose në varësi të drogës, të moshuarve, personave të dënuar me dënime afatgjatë, personave që i përkasin minoritetëve etnike ose gjuhësore, shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi. Për çdo të mitur të paraburgosur ose të dënuar përgatitet një plan individual rehabilitimi dhe riintegrimi, i cili merr në konsideratë arsimin e tij, vlerësimin psikologjik, situatën emocionale, dëshirat dhe mundësitë e tij/saj për të ndjekur kurse profesionale ose për të avancuar në arsim. Vëzhgimi, programimi dhe realizimi i trajtimit bëhen nga administrata e institucionit me anë të personelit të vet, në bashkëpunim me organet dhe institucionet shtetërore përkatëse. Bashkëpunimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës për hartimin, zhvillimin, realizimin e programeve të mbikëqyrjes së të paraburgosurve dhe të të dënuarve bëhet me urdhër të nxjerrë nga Ministri i Drejtësisë. Kontributi i organizatave jofitimprurëse

dhe individëve të veçantë inkurajohet dhe mbështetet nga administrata e burgjeve në realizimin e programit të trajtimit.

4. Të drejtat dhe trajtimi i të dënuarve në burgun e sigurisë së lartë

Të drejtat dhe mënyra e trajtimit të të dënuarve nëpër institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale janë parashikuar në Ligjin Nr.8328 datë 16.04.1998 “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*” i ndryshuar. Në bazë të nenit 31 të këtij Ligji, institucionet dhe seksionet e veçanta janë të organizuara sipas nevojave të trajtimit individual ose në grup të të dënuarve. Trajtimi i të paraburgosurve dhe i të dënuarve bëhet duke siguruar mjediset dhe mjetet e përshtatshme, si dhe në përputhje me të dhënat e personalitetit të tyre⁵.

Në burgun e sigurisë së lartë, ashtu sikurse e përmendëm edhe më sipër, vendosen persona me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Për këtë arsye, jemi të mendimit se duhen përcaktuar kushte dhe mënyra trajtimi të veçanta dhe specifike në krahasim me kategoritë e tjera të të dënuarve. Mënyra e trajtimit duhet të bëhet në përputhje edhe me qëllim riedukues të dënimit: personalitete me rrezikshmëri të lartë shoqërore kërkojnë rregulla më strikte, më të vështira jo vetëm për të realizuar riedukimin por edhe për të parandaluar realizimin e aktiviteteve kriminale nga qelia e vuajtjes së dënimit. Parashikimet e bëra nga legjislatori për të burgosurit që vuajnë dënimin në burgun e sigurisë së lartë nuk janë të mjaftueshme për të realizuar këto objektiva. Disa nga parashikimet e bëra për këtë kategori të burgosurish janë:

– Lejet shpërblyese për të dënuarit që kryejnë dënimin në seksionet e sigurisë së lartë, jepen vetëm me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, apo me autorizim të Ministrit të Drejtësisë nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve.

Ministri i Drejtësisë dhe Drejtori i Përgjithshëm, me marrjen e kërkesës nga i dënuari, i kërkon Drejtorit të I EVP-së të përgatisë informacionin përkatës.

Në rast refuzimi, brenda 5 ditëve i dënuari mund të ankohet në gjykatë, e cila vendos për kërkesën për dhënien e lejes shpërblyese⁶;

– Të dënuarit që zbatojnë rregullat dhe kanë një pjesëmarrje shembullore në veprimtaritë trajtuese, duke dhënë prova për riintegrim në shoqëri, mund të përfitojnë një ose disa ulje, deri 90 ditë në çdo vit të vuajtjes së dënimit. Në burgjet e sigurisë së lartë ulja e dënimit bëhet deri 45 ditë në vit⁷.

– Transferimet e të burgosurve nga burgjet e sigurisë së lartë në institucionet e tjera të ekzekutimit të vendimeve penale dhe nga institucionet e tjera në burgun e sigurisë së lartë bëhen vetëm me vendim të gjykatës.

⁵ Neni 32 i Ligjit Nr.8328 datë 16.04.1998 “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*” i ndryshuar.

⁶ Neni 59 i Ligjit Nr.8328 datë 16.04.1998 “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*” i ndryshuar; Neni 52 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

⁷ Neni 63 i Ligjit Nr.8328 datë 16.04.1998 “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*” i ndryshuar.

Sipas mendimit tonë, legjislatori duhet të parashikojë rregulla strikte për burgun e sigurisë së lartë që nga momenti i pranimit në institucion, përcaktimi i qelisë së vuajtjes së dënimit dhe të mënyrës së trajtimit të të burgosurve: koha e ajrimit; numri i personave që mund të rrinë bashkë gjatë ajrimit; numri, mënyra e realizimit dhe kohëzgjatja e takimeve me familjarët;⁸ numri, kohëzgjatja dhe përcaktimi i personave me të cilët mund të mbajnë lidhje telefonike; në raste të caktuara të lejohet edhe kontrolli i korrespondencës;⁹ rregulla të përcaktuara qartë për rastet e shoqërimeve në Gjykatë, në spital, për leje të veçanta apo edhe për transferimet nga njëri institucion në tjetrin, brenda të njëjtut regjim; në përputhje edhe me rekomandimet e Gjykatës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të Njeriut duhet të përcaktojë edhe kohëzgjatjen e këtij rregjimi me qëllim që të mos shndërrohet në trajtim çnjerëzor apo degradues¹⁰.

Një parashikim i tillë edhe pse mund të duket jo në përputhje me qëllimin riedukues të dënimit është i domosdoshëm kur shihet si i pamundur riedukimi i të dënuarit përmes ekzekutimit të dënimit ose kur i dënuari nuk është i ndjeshëm ndaj funksionit frikësues-ndëshkues¹¹. Mund të përmendim këtu rastin e pjestarëve të organizatave kriminale, që nga mafja dhe deri tek organizatat terroriste. Në raste të tilla qëllimi i dënimit duhet të jetë vetëm mbrojtja e shoqërisë nga rreziku që këta të dënuar, duke mbajtur kontakte me organizatën kriminale, mund të kryejnë vepra penale edhe gjatë ekzekutimit të dënimit. Kjo mënyrë e të arsyetuar gjente mbështetje edhe në nenet e shfuqizuar 55/1 dhe 55/2 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve që paraqesnin një rregjim të veçantë të ekzekutimit të dënimit në rastet e gjendjeve të jashtëzakonshme.¹²

⁸ Vendim i Gjykatës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Lesiak kundër Polonisë datë 01.02.2011. Nuk kemi shkelje kur e drejta për të pasur vizita pëson kufizime në përputhje me rregullat që përcaktojnë vuajtjen e dënimit në një institucion.

⁹ Vendim i Gjykatës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Montani kundër Italisë datë 19.01.2010. Kontrolli i korrespondencës së të burgosurve që ndodhen në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme nuk mund të ushtrohet mbi letrat që u dërgohen avokatëve mbrojtës dhe organizmave ndërkombëtarë kompetentë në fushën e të drejtave njerzore, pasi në të kundërt do të kishim shkelje të nenit 8 KEDNJ.

¹⁰ Parlamenti Evropian, Relacion i Komisionit për liritë dhe të drejtat e qytetarëve, drejtësinë dhe punët e jashtme, datë 24 shkurt 2004, që përmban një propozim të Parlamentit Evropian drejtuar Këshillit për të drejtat e të burgosurve në Bashkimin Evropian 2003/2188 (INI).

¹¹ Shih, S. Kurti, *Funksioni riedukues i dënimit dhe kufizimet e tij*, në Konferencën Shkencore Kombëtare “Evoluimi i ligjit penal nga momenti i shpalljes së pavarësisë deri në ditët e sotme”, datë 21.11.2012, të realizuar nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, me rastin e 100 vjetorit të shpalljes së pavarësisë.

¹² Një nga rastet e gjendjes së jashtëzakonshme ishte edhe përkatësia e të dënuarve në organizata kriminale. Këto subjekte në bazë Ligjit Nr.8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” i ndryshuar, e vuajnë dënimin në një burg të sigurisë së lartë.

5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Në përfundim të këtij punimi arrijmë në konkluzionin se Ligji Nr.8328 datë 16.04.1998 “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*” i ndryshuar, nuk është i plotë dhe ka nevojë për ndryshime dhe shtesa për sa i përket përcaktimit të të drejtave të të dënuarve në burgun e sigurisë së lartë.

Për këtë kategori të dënuarish kërkohet një kufizim i të drejtave me qëllim parandalimin e rrezikshmërisë së lartë shoqërore që ata paraqesin. Kufizimi i të drejtave në raste të tilla nuk përbën trajtim çnjerëzor apo degradues dhe është në përputhje edhe me Gjykatën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. Një shembull i ngjashëm mund të gjendet në legjislacionin penitenciar italian dhe konkretisht në nenin 41 bis të Ligjit mbi rregullimin e sistemit penitenciar. Në lidhje me këtë nen Gjykata Kushtetuese e Italisë është shprehur në shumë vendime të saj se është në përputhje me Kushtetutën dhe me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

Në radhë të parë, duhet ndërhyrë në nenin 13 të Ligjit Nr.8328 datë 16.04.1998 “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*” i ndryshuar, duke përcaktuar në mënyrë taksative kategoritë e personave që duhet të vuajnë dënimin në burgun e sigurisë së lartë duke mos i lënë vend subjektivizmit të gjyqtarit në përcaktim e vëndit të vuajtjes së dënimit për këtë kategori të burgosurish.

Më pas, për të realizuar këtë qëllim është e domosdoshme ngritja e strukturave të posaçme me qëllim pritjen, vendosjen dhe trajtimin e të dënuarve që do t’i nënshtrohen një rregjimi të tillë. Sipas mendimit tonë, strukturat aktuale, burgjet e sigurisë së lartë apo seksionet e sigurisë së lartë, nuk janë të përshtatura në përputhje me rekomandimet evropiane për zbatimin e këtij rregjimi.

Duke qenë se të dënuarit që do të vuajnë dënimin në këto institucione paraqesin një kategori të veçantë dhe të rrezikshme, propozohet një specializim i posaçëm për punonjësit që do të ushtrojnë profesionin e tyre në këto struktura. Kjo është shumë e rëndësishme me qëllim që vuajtja e dënimit të mos shndërrohet në trajtim çnjerëzor apo degradues dhe të jetë në përputhje me vendimet e Gjykatës së Strasburgut.

Në kushtet aktuale është e papranueshme që në institucionet e vuajtjes së dënimit të mos ketë rregullore të veçanta për të dënuar që vuajnë dënimin në seksione të ndryshme brenda të njëjtit institucion. Një mënyrë e tillë e të vepruarit është e jashtëligjshme dhe në kundërshtim me arritjen e funksionit riedukues të dënimit.

BIBLIOGRAFIA

- Hysi V., *Penologjia*, Kristalina-KH, Tiranë, 2009.
- Kurti S., *Funksioni riedukues i dënimit dhe kufizimet e tij*, në Konferencën Shkencore Kombëtare “*Evoluimi i ligjit penal nga momenti i shpalljes së pavarësisë*”

deri në ditët e sotme”, datë 21.11.2012, të realizuar nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, me rastin e 100 vjetorit të shpalljes së pavarësisë.

- Parlamenti Evropian, Relacion i Komisionit për liritë dhe të drejtat e qytetarëve, drejtësinë dhe punët e jashtme, datë 24 shkurt 2004, që përmban një propozim të Parlamentit Evropian drejtuar Këshillit për të drejtat e të burgosurve në Bashkimin Evropian 2003/2188 (INI).

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

- Ligjit Nr.8328 datë 16.04.1998 “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*” i ndryshuar.

- Ligjit Nr. 8331 datë 21.04.1998 “*Për ekzekutimin e vendimeve penale*” i ndryshuar.

- Regullore e Përgjithshme e Burgjeve.

- Vendim i Gjykatës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Lesiak kundër Polonisë datë 01.02.2011.

- Vendim i Gjykatës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Montani kundër Italisë datë 19.01.2010

PROSTITUCIONI I FËMIJËVE PËRMES WEB-KAMERAVE METODAT AKTUALE TË ZBULIMIT DHE E ARDHMJA E TYRE

Ermal YZEIRAJ dhe Flavjo XHUVELI

ABSTRAKT

Prostitucioni i fëmijëve përmes web-kamerave është një formë e re e abuzimit seksual të fëmijëve në internet, ku viktima thjesht shet imazhet seksuale të jetës së tij përmes aplikacioneve Voice-over-IP (VoIP). Megjithëse nuk krijon në mënyrë të drejtpërdrejtë disa efekte negative të prostitucionit tradicional të fëmijëve, si sëmundjet seksualisht të transmetueshme, mund të krijojë potencialisht autorë dhe viktima të krimeve tradicionale si prostitucioni i fëmijëve dhe turizmi i seksit të fëmijëve. Në këtë aspekt, ky artikull diskuton mbi efikasitetin e metodave aktuale të zbulimit dhe propozon disa metoda futuriste, të tilla si metadatum dhe analiza e të dhënave të përmbajtjes së komunikimeve VoIP nga sektori privat dhe përdorimi i chatbots plotësisht të automatizuar për operacione të fshehta. Zbatueshmëria e këtyre metodave të reja në jetën reale kërkon pikësisht një mbështetje adeguate ligjore si dhe njëkohësisht kërkime të mëtejshme mbi aspektet teknike në veçanti.

Fjalët kyçe: *Abuzimi seksual online i fëmijëve, Prostitucioni i fëmijëve përmes web-kamerave, VoIP, Krimi Kibernetik.*

HYRJE

Interneti dhe zhvillimet e tjera teknologjike e kanë bërë komunikimin mes njerëzve më të shpejtë dhe më të lirë. Voice over IP (VoIP) është një nga mënyrat më efektive përmes së cilës përdoruesit kanë përfituar shumë që nga fillimi i viteve 2000. Në teknologjinë VoIP, komunikimet audio dhe video janë të ndara në disa paketa të vogla të informacionit digjital dhe transmetohen përmes rrjeteve IP. Ndryshe nga shërbimet tradicionale të telefonit, karakteristika të veçanta të tilla si komunikimi i koduar midis palëve, shpërndarja dhe struktura e decentralizuar e disa rrjeteve dhe dominimi i tregut të ofruesve të këtij shërbimi nga kompani të cilat e kanë qendrën e tyre jashtë kufijve të një shteti, e bëjnë të vështirë interceptimin e ligjshëm të abuzuesve të kësaj teknologjie. Për këto arsye, si të gjitha shpikjet novatore gjatë gjithë historisë, aplikacionet VoIP përdoren gjithashtu edhe nga krimi i organizuar si dhe nga abuzuesit seksualë të fëmijëve në internet.

Duke përdorur funksionin e transmetimit video të aplikacioneve VoIP, prodhohen imazhe live të abuzimit të fëmijëve të cilat nganjëherë shiten edhe për përfitim. “Online grooming”, “pornografia e vetë-prodhuar”, “sexting” dhe “kërcë-

nimet seksuale” janë shembujt kryesore dhe më të zakonshëm në të cilët teknologjia VoIP është përdorur edhe për qëllime përtej atyre komerciale. Në thelb, prostitucioni i fëmijëve përmes web-kamerës nuk ndryshon shumë nga varianti tradicional i veprës penale pasi në thelb viktimat plotëson nevojat seksuale të dikujt tjetër në këmbim të një pagese përmes internetit. Metodatat e ndryshme të ndërveprimit të zgjedhura nga palët nuk ndikojnë në elementët thelbësorë inkriminues të veprës penale. Gjithsesi shpesh herë në praktikë parapëlqehet të përdoret termi “prostitucion i fëmijëve përmes web-kamerës” në vend të termit “live streaming” i abuzimit me fëmijët apo termit “abuzim/turizëm seksual i fëmijëve përmes web-kamerës” (Europol, 2015).

Megjithëse Europol pretendon që pornografia e fëmijëve përmes web-kamerës nuk është një krim i përhapur por thjesht një realitet i cili ka lidhje me turizmin seksual të fëmijëve (Europol, 2015) (Europol, 2016) ekzistojnë shembuj konkretë që mund të hedhin poshtë këto thënie. Mjafton të përmendim që gjatë operacionit “Endeavour” (përpjekja), shembulli i vetëm i njohur publikisht i hetimeve në lidhje me pornografinë e fëmijëve përmes web-kamerave, u bënë 29 arrestime ndërkombëtare dhe u shpëtuan 15 fëmijë filipinas. Megjithatë, sipas organizatës joqeveritare “Terre des Hommes”, Holandë, kjo nuk është as maja e ajtërgut. Për të treguar një pamje të shkallës së vërtetë të problemit, “Terre des Hommes”, Holandë krijoi një model 3D të një vajze 10-vjeçare filipinase dhe e quajti atë “Sweetie”. Në një operacion të kryer nga “Terre des Hommes” në dhomat chat publike dhe në faqet online të takimeve, 1000 abuzues potencialë nga 71 vende të ndryshme i ofruan para Sweeti(t) për akte seksuale dhe kjo përgjatë 10 javëve. Mbi 20000 individë kërkuan të hyjnë në kontakt me Sweeti(n) gjatë rrjedhës së eksperimentit cka ishte e papërbalueshme për katër operatorët të cilët menaxhonin llogarinë e Sweeti(t). Ndërsa dy prej tyre merreshin me bisedat dy të tjerët përpiqeshin të identifikonin individët përmes informacionit që rridhte nga biseda. (Hans Guijt, personal communication, 16 January, 2017)

Për më tepër, besohet se seancat e pornografisë së fëmijëve përmes web-kamerës inskenohen sipas kërkesave seksuale të konsumatorëve. Për rrjedhojë, intensiteti dhe çmimi i abuzimit seksual mund të rritet gjatë seancës. Kjo përbën një model biznesi tepër efektiv, fitimprurës dhe fleksibël për abuzuesit, veçanërisht në krahasim me tregtinë e imazheve të abuzimit seksual të fëmijëve në internet. Meqenëse çdo bashkëveprim, madje edhe ato me viktimat të njëjta, krijon për shkelësin një përvojë unike dhe të pazëvendësueshme, ata janë të gatshëm që të paguajnë shuma të konsiderueshme për imazhe video të drejtpërdrejta ndonëse në internet ata mund të gjejnë edhe imazhe foto falas të fëmijëve të ndryshëm.

Ky artikull, ndër të tjera, fokusohet kryesisht në zbulimin dhe interceptimin e pornografisë së fëmijëve përmes web-kamerave duke analizuar dhe diskutuar në lidhje me metodatat aktuale dhe atyre të së ardhmes të zbulimit dhe interceptimit. Qëllimi

kryesor i këtij artikulli është inicimi i një debati teknik dhe ligjor përmes së cilit mund të shikohet mundësia e paraqitjes së zgjidhjeve të reja ose më të mira dhe më praktike në zbulimin dhe interceptimin e pornografisë së fëmijëve përmes web-kamerave.

Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë pornografia e fëmijëve përmes web-kamerave mbulohet nga parashikimet e bëra në paragrafin e tretë të nenit 117 në të cilin përcaktohet:

“Rekrutimi, përdorimi, shtrëngimi, ose bindja e një fëmije, për të marrë pjesë në shfaqje pornografike, ose marrja pjesë në shfaqje pornografike që përfshijnë fëmijët, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.”

Metodat aktuale të zbulimit

Të komunikosh në privatësi është një nga të drejtat më të rëndësishme dhe themelore të njeriut. Prandaj, në shumicën e vendeve, përgjimi i ligjshëm i komunikimeve private kufizohet sa më shumë që të jetë e mundur. Në përgjithësi organet e hetimit kanë nevojë ose për prova të forta ose për një shkak të ligjshëm dhe e zbatojnë këtë masë të jashtëzakonshme të cënimit të privatësisë vetëm për një numër të kufizuar veprash të rënda penale. Këto rregulla ligjore ngrihen kryesisht për metodat e komunikimit tradicional, përmbajtja e të cilëve nuk është penale. Megjithatë, bisedat VoIP në rastet e pornografisë së fëmijëve përmes web-kamerave janë shumë të ndryshme nga telefonatat tradicionale në aspektin e kriminal. Për shembull, një bisedë telefonike mes dy shkelësve mund të japë informacionin e një krimi të vërtetë para se të ndodhë ose pasi të jetë kryer dhe kështu, përgjimi i ligjshëm i asaj thirrjeje telefonike ndihmon organet e hetimit që të marrin masa parandaluese ose që të mbledhin prova. Në këtë rast, vetë komunikimi telefonik nuk konsiderohet një krim i veçantë. Ai thjesht siguron një lidhje ndërmjet autorëve të akteve të kundërligjme. Ndërsa komunikimet VoIP të pornografisë së fëmijëve përmes web-kamerës janë kriminale pavarësisht faktit se ato (në thelb) janë thjesht një lloj komunikimi. Ato zhvillohen plotësisht brenda një chat(i) online pa lënë asnjë gjurmë në botën reale. Nëse shkelësit dhe fëmijët nuk mund të lidhen me video chat, kjo veprë penale definitivisht nuk mund të ndodhë.

Në pornografinë e fëmijëve përmes web-kamerës komunikimi dhe akti krimi-nal janë të pandashëm me njëri tjetrin dhe akte të tilla shumë rrallë mund të kenë si dëshmitarë një person të tretë. Prandaj, zbulimi i ekzistencës së kësaj veprë penale mbështetet shumë në veprimet e palëve të përfshira, meqenëse komunikimi ndërmjet autorëve dhe viktimave është shumë privat si natyrë. Për fat të keq, për shkak të përfitimeve monetare të pornografisë së fëmijëve përmes web-kamerave dhe perceptimit që akte të tilla janë më pak të dëmshme se prostitucioni tradicional, raportimi nga vetë viktimat nuk ka shumë pak gjasa që të ndodhë (Terre des Hommes Netherlands, 2013b). Për këto arsye, zbulimi i rasteve të tilla mund

të bëhet ose përmes kapjes në flagrancë të autorëve ose përmes konfiskimit dhe ekzaminimit të pajisjeve kompjuterike të të dyshuarve. Gjithsesi, pavarësisht se kompjuterat e autorëve mund të regjistrojnë video chat(et) e kryera, për shumicën e produkteve VoIP përdoren aplikacione të veçanta dhe për këtë arsye në shumicën e rasteve ekzaminimi i pajisjeve kompjuterike të të dyshuarve si autorë të këtyre veprave penale mund të dështojë.

Teorikisht (ndonëse në praktikë kjo ka shumë pak gjasa që të ndodhë) komunikimi ndërmjet autorit dhe fëmijës mund të zbulohet/interceptohet edhe gjatë kryerjes e sipër të veprës penale. Interceptimi i ligjshëm i komunikimeve në kohë reale ndërmjet palëve mund të përbëjë një provë të fortë në këtë rast. Megjithatë, për shkak të kufizimeve ligjore dhe teknike, ky opsion është pothuajse i pamundur për momentin. Kështu, kompania që ofron shërbimin duhet të respektojë kuadrin ligjor të vendit ku ndodhet selia e saj dhe/ose vendit ku ndodhet qendra operationale. Për të parandaluar konfliktet ndërkombëtare, çdo vend ka mbrojtje të ngjashme ligjore të cilat në të vërtetë janë hartuar për të zgjidhur problemet juridiksionale të krimeve tradicionale. Në shumicën e rasteve të pornografisë së fëmijëve përmes web-kamerës, as viktimi dhe as autori nuk kanë të bëjnë aspak me vendin ku vepron kompania VoIP. Për shembull, kuadri ligjor amerikan lejon vetëm monitorimin në kohë reale të komunikimeve në hetimet që ndodhin ose në tokën amerikane ose në të cilat të paktën një nga palët është shtetas amerikan. Prandaj, përgjimi i ligjshëm i një komunikimi të pornogramifë së fëmijëve përmes web-kamerave ndërmjet një vajze 10 vjecare Filipineze dhe një të personi të rritur në një vend European i cili përdor për kryerjen e këtij krimi një shërbim VoIP të një kompanie me bazë në SHBA, duket se është jashtë juridiksionit për autoritetet amerikane. Interpretimet e mundshme të këtij rregulli ligjor nga ana e organeve hetimore në situata të tilla nuk janë të qarta për momentin, por teorikisht, nuk duket e realizueshme të monitorohet çdo incident i pornogramifë së fëmijëve përmes web-kamerave në kohë reale.

Përveç ekzistencës së një kuadri rregullator joadekuat ekzistojnë edhe probleme teknike me monitorimin në kohë reale të rasteve të mundshme të pornografisë së fëmijëve përmes web-kamerave. Nga pikëpamja teknike, teknologjitë VoIP i ofrojnë kompanive skema fleksibile për strukturimin e shërbimeve të tyre. Përveç modeleve tradicionale klient/server ekzistojnë edhe aplikacione që bazohen në rrjet si struktura peer-to-peer e Skype. Sa i përket kryesisht telefonisë në internet, ekzistojnë korniza ligjore teorike për përgjimin e ligjshëm të disa prej llojeve të këtyre shërbimeve. Sidoqoftë, zbatueshmëria e këtyre zgjidhjeve në jetën reale nuk është ende e qartë. Për më tepër, me rritjen e shqetësimeve të konsumatorëve për privatësinë e tyre (sidomos pas epokës post-Snoëden), shumica e kompanive të VoIP kanë reklamuar me padurim veçori shtesë të sigurisë, siç janë: inkriptimi dhe struktura peer-to-peer. Me shumë mundësi masa të tilla shtesë të sigurisë do të krijojnë në praktikë probleme edhe për ato skema teorike të përgjimit të ligjshëm

që pritet ende të zbatohen dhe të japin efektet e shumëkërkuara në shkallë të gjerë. Këto dallime dhe kompleksitete teknike e bëjnë të pamundur aplikimin e një regjimi të përgjimit të ligjshëm për të gjitha llojet e teknologjive VoIP.

Për parandalimin, zbulimin dhe identifikimin e autorëve të këtyre veprave penale (apo edhe viktimeve të tyre) organet hetimore mund të përdorin gjithashtu edhe agjentë të maskuar. Në fillet e epokës së internetit, ka pasur vetëm disa mjedise të kufizuara në internet ku autorët dhe viktimat mund të takoheshin me njëri tjetrin. Sot, vendet/ambientet online ku autorët dhe viktimat mund të takohen dhe komunikojnë me njëri tjetrin janë shtuar së tepërmi. Kështu mund të përmendim: forumet e faqeve web, dhomat publike të chat(it), rrjetet sociale si Facebook, Instagram, etj., faqet web të lojërave dhe aplikacionet mobile që takimeve me qëllimin e krijimit të lidhjeve të reja në çift. Edhe pse mjediset tradicionale online preferohen akoma nga abuzuesit, zgjerimi i vazhdueshëm i ambienteve ku mund të kryhet vepra penale dhe sulmohen fëmijët mbetet sfidues (Livingstone & Smith, 2014). Për më tepër, përdoruesit e internetit dhe koha që ata shpenzojnë në internet është shumëfishuar ndërsa burimet e organeve hetimore nuk kanë mundur të kapin këtë ritëm të zhvillimit teknologjik dhe antikulturës që e shoqëron atë. Në eksperimentin Sweetie, organizata Terre des Hommes në Hollëndë u përball me më shumë se 20000 shkelës potencial për vetëm 10 javë dhe madje ishte e pamundur që të merrej me të gjithë ata. Për rrjedhojë, është e natyrshme që organet hetimore ti japin përparësi rasteve të veçanta duke shpërndarë resurset e tyre të kufizuara në hetime të rëndësishme si psh., kapja e web faqeve Darknet (Cox, 2016). Pavarësisht se institucionet hetimore kanë autoritetin ligjor që të luftojnë pornografinë e fëmijëve përmes web-kamerave duke aplikuar operacionet e simulimit sërish ato janë në pamjaftueshmëri të resurseve të nevojshme për një fitore të sigurtë.

Përveç këtyre kufizimeve të përgjithshme, si një kërkesë specifike për suksesin e operacioneve të simulimit që mundtë përdoren në luftën kundër pornografisë së fëmijëve përmes web-kamerave, viktimat (agjenti) duhet ti tregojë autorit fytyrën e tij/saj në mënyrë që ta bindë atë që fëmija është një fëmijë real. Sipas raportit të organizatës Terre des Hommes, autorët ishin të gatshëm që të zbulonin identitetin e tyre sapo ata shikonin fytyrën e Sweetie, (Terre des Hommes Netherlands, 2013b). Në operacionet e simulimit agjentët e maskuar ose komunikojnë me autorët e dyshuar përmes thënieve dhe shprehjeve fëminore ose i dërgojnë atyre imazhe të kontrolluara të fëmijëve të abuzuar. Në shumicën e rasteve organet hetimore e kanë të pamundur që të bindin autorët e këtyre veprave penale në rast se ata nuk përdorin si simulim fëmijë të vërtet, cka është edhe një metodë e papranueshme në aspektin etik dhe ligjor. Për rrjedhojë edhe kjo metodë tradicionale manipulative e operacioneve të simulimit rrezikon të jetë e padobishme në zbulimin e autorëve të pornogramifë së fëmijëve përmes web-kamerës.

METODAT E ZBULIMIT NË TË ARDHMEN

1. Chatbot(e) tërësisht të automatizuara

Organet e hetimit duhet të krijojnë strategji të reja për parandalimin e krimit që mbështeten në teknologjitë e reja pasi kriminelët gjithmonë i kanë përdorur këto zhvillime teknologjike për aktivitetet e tyre kriminale. Eksperimenti Sweetie i organizatës Terre des Hommes është një shembull i mrekullueshëm se si ky parim i thjeshtë mund të zbatohet në luftën kundër pornografisë së fëmijëve përmes web-kamerave. Për fat të keq, edhe aplikimi në praktikë i eksperimentit Sweetie paraqet një sërë pengesash tradicionale pasi operacione të tilla simulimi jo vetëm që janë të kushtueshme por njëkohësisht kërkojnë që oficeri i policisë të jetë i pranishëm dhe të komunikojë direct me cdo autor potencial cka shman automatikisht idenë e aplikimit të kësaj metode në një shkallë të gjerë. Por në rast se agjentët e policisë do të zëvendësoheshin me inteligjencën artificiale, kjo metodë novatore do të ishte më efektive në drejtim të pasjes së një produktiviteti të lartë nga burimet të kufizuara.

Shumica e autorëve e humbasin kontrollin e tyre kur shohin në ekran fytyrën e një fëmije. Imazhi i Sweetie ishte aq i fuqishëm dhe bindës për ta sa që dyshimet në lidhje me identitetin real të një fëmije I linin vendin fantazive seksuale për ndërveprime të mëtejshme. Kjo situatë I bën autorët e këtyre veprave penale më të prekshëm ndaj mashtrimit të simulimeve. Kjo ishte dhe arsyeja kryesore pse gjatë operacionit Sweetie shumica e autorëve jepnin pothuajse në çast informacione personalisht të identifikueshme për veten e tyre. Shfrytëzimi i kësaj ndjeshmërie në një shkallë të madhe mund të bëhet vetëm duke zhvilluar një chatbot të automatizuar në të cilin ndërhyrja njerëzore minimizohet dhe ku kombinohen disa teknologji të ndryshme. (Angga et al., 2015). Chatbot mund të marrë do të njohte fjalët tekst të autorit dhe më pas përgjigja e kopjuterit mund të jetë ose tekst ose dhe audio për të simuluar zërin e vërtetë të një fëmije. Më pas kompjuteri mund të gjenerojë një pamjen e një fëmije (avatar) gjestet dhe lëvizja e buzëve të të cilit sinkronizohen me përgjigjen audio.

2. Analizimi i të dhënave të Metadate(ve) nga kompanitë VoIP

Metadate është një e dhënë e cila përshkruan atributet e një burimi të dhënash ose e thënë thjesht “Metadate është një e dhënë për të dhënat”. Ndërsa të dhënat e përmbajtjes zbulojnë natyrën e vërtetë të komunikimit VoIP ndërmjet palëve, të tilla si tekstet, skedarët audio dhe video; metadate tregojnë vetëm disa attribute të komunikimit si data e komunikimit, krijuesi dhe adresa IP, pa kompromentuar rëndë privatësinë e komunikimeve. Prandaj, grumbullimi i metadate(ve) është më i lehtë si teknikisht ashtu edhe ligjërisht, pasi merr më pak hapësirë në disk dhe përfshin më pak informacione personale sesa të dhënat që lidhen me përmbajtjen. Sic dihet vetë ofruesit e shërbimeve të internetit i analizojnë vazhdimisht të dhënat që përdoruesit e tyre kanë krijuar dhe kjo për arsye komerciale si psh për ti shfaqur

atyre në ekran reklamën e duhura. Në varësi të vecorive të produkteve të caktuara, kompanitë VoIP mund të kryejnë një sërë analizash në lidhje me metadata(t) e komunikimit të përdoruesve të tyre. Në rast se struktura e shërbimeve bazohet në një server të centralizuar është tërësisht e mundur që të analizohen metadata(t) e të gjitha komunikimeve ndërsa në rast se struktura e shërbimeve bazohet në një sistem të decentralizuar (si Skype) metadata është e kufizuar, por ende ekziston deri diku.

Sic dihet, vendet e Azisë Juglindore kanë një reputacion famëkeq në lidhje me prostitucionin e fëmijëve (Lim, 1998). Përveç skemave kryesisht të drejtuara familjarisht ekzistojnë edhe biznese të maskuara sit ë ligjshme të cilat janë të përfshira në prodhimin e materialeve pornografike. Për këto arsye, analiza metadata e bazuar në vendndodhjen e të dhënave mund të zbulojë organet e hetimit që të abulojnë autorët dhe viktimat e këtyre veprave penale.

3. Analizimi i të dhënave të përmbajtjes nga kompanitë VoIP

Analiza e të dhënave të përmbajtjes duhet të konsiderohet si një metodë e jashtëzakonshme e zbulimit të pornografisë së fëmijëve përmes web-kamerave për shkak të natyrës së lartë të saj intrusive (ndërhyrëse) ndaj privatësisë. Megjithatë, kjo metodë nuk mund të përjashtohet krejtësisht. Në kushte të caktuara dhe me procedura strikte ligjore dhe teknike, kjo masë mund të krijojë rezultate të jashtëzakonshme në drejtim të parandalimit të krimit dhe mbrojtjes së fëmijëve. Zhvillimet aktuale të tekno-logjisë mundësojnë bërjen e një parashikimi në lidhje me atë cka mund të realizojë në të ardhmen inteligjenca artificiale. Aktualisht ekziston teknologjia e përkthimit në kohë reale e cila aplikohet nga kompania Skype. Meqënëse një pjesë e mirë e autorëve dhe viktimave përdorin aplikacionin dhe shërbimet e Skype përkthimi në kohë reale që bën sistemi i Skype mund të sjellë një zgjidhje konkrete në filtrimin e fjalëve të përdoruesve për nevoja të organeve hetimore.

KONKLUZIONE

Metodat aktuale të zbulimit të pornografisë së fëmijëve përmes web-kamerave mbështeten së tepërmi në raportimin e palëve në institucionet e hetimit dhe për rrjedhojë ato nuk janë shumë efektive në zbulimin e këtyre veprave penale. Operacionet simuluese të maskimit të agjentëve të policisë mund të zbulojnë disa raste por sigurisht duke konsumuar një numër të konsiderueshëm resurcesh financiare dhe njerëzore për të përballuar mijëra autorë potencialë. Meqënëse kriminelët kanë përshtatur gjithmonë modus operandi(n) e tyre ndaj teknologjive të reja, organet e hetimit duhet gjithashtu të ideojnë dhe aplikojnë masa të reja në përputhje me rrethanat aktuale që parashtron teknologjia kompjuterike. Në këtë drejtim, aplikimi i chatbot(seve) tërësisht të automatizuara dhe shfrytëzimi i analizës së metadatave të komunikimeve VoIP mund të sjellë një përmirësim dhe lehtësim në parandalimin

dhe zbulimin e autorëve dhe viktimave të pornografisë së fëmijëve përmes web-kamerave. Krahasuar me komplikimet e tjera ligjore dhe socio-psikologjike, vësh-tirësitë teknike të aplikimit të këtyre ideve mund të kapërcehen shumë shpejt në të ardhmen dhe për këtë arsye ndryshimet ligjore duhet të jenë të gatshme që ti paraprijnë apo ecin në të njëjtin hap me zhvillimet teknologjike në mënyrë që ato të mos jenë një pengesë e panevojshme por një por përkundrazi një ndihmë e madhe në luftën kundër fenomeneve të veprave të tilla penale të cilat kapërcejnë kufijtë tradicional shtetëror.

REFORMA NË DREJTËSINË PENALE DHE MBROJTJA E VIKTIMAVESFIDAT NË ZBATIMIN E REFORMËS

Prof. Dr. Vasilika HYSI¹

Anda Hysi, studente në programin master

ABSTRAKT

Pjesa më e madhe e veprave penale shkaktojnë një ose më shumë viktima, pasoja në jetën dhe shëndetit e njerëzve, dëme materiale, psikologjike, sociale, mjedisore, shpesh të pariparueshme. Gjatë dy dekadave të fundit, Shqipëria ka ratifikuar pjesën më të madhe të konventave ndërkombëtare që mbrojnë të drejtat e viktimave. Megjithatë, deri pak muaj më parë, legjislacioni në fushën e drejtësisë penale parashikonte pak të drejta për viktimën në procesin penal, ndërsa respektimi në praktikë i të drejtave të viktimës është jo i kënaqshëm. Vëmendja mbi të drejtat e personave të privuar nga liria ka qenë më e madhe sesa për të drejtat e viktimës dhe viktimave shpesh është trajtuar në cilësinë e dëshmitarit për të marrë dëshmi për ngjarjen dhe autorin.

Rritja e numrit të raportimeve të viktimave në polici ose në organe të tjera, përfshirë edhe OJF-të, llojshmëria e viktimave që shkaktojnë veprat penale, nevojat specifike të tyre diktojnë një qasje tjetër jo vetëm nga këndvështrimi ligjor, por edhe për masat dhe programet që duhet të zbatohen në praktikë për mbrojtjen, asistimin, mbështetjen dhe rehabilitimin e tyre.

Në këtë artikull synohet që trajtohen disa çështje që lidhen me pozitën e viktimës në sistemin e drejtësisë penale, analizohen sfidat dhe nevojat për veprime konkrete që duhen ndërmarrë, jo vetëm nga këndvështrimi i kornizës ligjore, por edhe institucionale dhe burimeve njerëzore. Jo të gjitha të drejtat e viktimës mund të trajtohen në këtë prezantim dhe se çështjet objekt trajtimi nuk mund të kenë një trajtim shterues.

Në cilësinë e anëtares së komisionin të posaçëm parlamentar për reformën në sistemin e drejtësisë, do të doja të trajtoja disa risi në mbrojtjen e viktimës, por edhe vështirësitë që duhet të kapërcehen që viktimave të gëzojë realisht të drejtat e saj. Autorja tjetër e këtij artikulli, një juristeje të re që ka pasur mundësi të vëzhgojë proceset gjyqësore në gjykata, mes ndjesive jo të mira lidhur me trajtimin e viktimave, ka ndihmuar në adresimin më të mirë të problemeve lidhur me respektimin më të mirë të viktimës në sistemin e drejtësisë në përgjithësi dhe në atë penal, në veçanti, të para nga vështrimi i një profesioniste të re. Bazuar në risitë që solli reforma

¹ Prof. dr Vasilika Hysi është pedagoge me kohë të pjesshme pranë Departamentit të së Drejtës Penale, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Anda Hysi ndjek studimet në programin master pranë Departamentit të së Drejtës Publike, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

në drejtësi dhe sfidat që mund të ndeshen në praktikë, jepen disa përfundime dhe sugjerime.

1.0 Të drejtat e njeriut -boshti i reformës së drejtësisë penale

Të drejtat e viktimës parashikohen në disa ligje që rregullojnë elementë të sistemit të drejtësisë penale, civile, administrative dhe të marrëdhënieve të punës. Edhe para kryerjes së reformës më të fundit në drejtësi (2014), ligjet ceknin disa prej të drejtave të viktimës, por ato ishin të përcipta dhe jo të plota. Sipas analizës së sistemit të drejtësisë, pozita procedurale e të dëmtuarit nga vepra penale është e dobët. Ka mungesa të rregullimit ligjor dhe të detajimit të të drejtave dhe garancive procedurale, në përputhje me standardet minimale të BE-së.²

Autorë të ndryshëm, në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar venë në pah se viktima nuk gëzon realisht mbrojtje sipas standardeve të përcaktuara në sistemin e drejtësisë penale. Groenhuijsen, duke analizuar të drejtat minimale të viktimës, shprehej se shumë pak të drejta të viktimës janë përfshirë në kodet procedurale penale të vendeve dhe se është e lehtë të përfshihen në kodin e procedurës penale të drejtat e reja për viktimat, por është shumë e vështirë që ato të zbatohen në mënyrë efektive.³ Sipas autores Hysi, pozita e viktimës në procesin penal shqiptar është e dobët dhe mundëson riviktimizimin e saj dhe se nevoja e rregullit të statusit të viktimës në procesin penal argumentohet edhe me faktin se Shqipëria ka ratifikuar një sërë konventash ndërkombëtare që parashikojnë të drejtat e viktimave, por ato nuk janë zbatuar drejtëpërdrejtë në praktikën shqiptare.⁴

Për më tepër, pozita e dobët e viktimës në procesin penal në Shqipëri ka edhe arsye të tjera, krahas mangësive në rregullin ligjor, në aktet nënligjore. Kuptimi dhe interpretimi i të drejtave shpesh nuk është i njëjtë ose është i gabuar. Ky fakt konstatohet edhe në raportet e mekanizmave monitorues të Koventave. Grupi i ekspertëve për Masat kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje i Këshillit të Evropës (GREVIO), në raportin vlerësimit të zbatimit të detyrimeve Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, nga autoritetet shqiptare, të bërë publik më 17 Dhjetor 2017,

² *Analizë e sistemit të drejtësisë*, hartuar nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë, i ngritur pranë komisionit të posaçëm parlamentar për reformën në sistemin e drejtësisë në Shqipëri, Qershor, 2015. Ky raport gjendet në faqen zyrtare: http://reformatdrejttesi.al/sites/default/files/dokumenti_shqip.pdf

³ Groenhuijsen, Marc: *Victims' Rights in the Criminal Justice System: a Call for More Comprehensive Implementation Theory*, botuar në *Caring for Crime Victims, selected Proceedings of the 9th International Symposium Victimology*, red nga Jan.J.M.van Dijk, Ron G.H.van Kaam dhe JoAnne Wemmers, New York, 1999, fq. 88-89.

⁴ Hysi, Vasilika: *Sistemi i drejtësisë penale, kriminalizimi i krimeve të reja në Shqipëri dhe roli i shërbimeve sociale në ditët tona*, botuar në *Forcimi i institucioneve sociale në sistemin e Drejtësisë, punime të konferencës ndërkombëtare*, OSBE, 2014, f. 209-226, ISBN:978-92-9235-262-2.

në lidhje me viktimat e dhunës në familje konstaton se interpretimet divergjente të ligjit në Shqipëri kanë prirje të dëmtojnë viktimat dhe t'u mohojnë atyre një akses efikas në sistemin e drejtësisë.⁵ Gjithashtu, Komisioni Europian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI)⁶ duke analizuar zbatimin e legjislacionit për parandalimin e diskriminimit vë në pah keqkuptime në zbatimin e ligjit.

Reforma në sistemin e drejtësisë e ndërmarrë nga Kuvendi i Shqipërisë në vitin 2014 u mbështet në gjashtë shtylla, mes të cilëve drejtësia penale, profesionet ligjore dhe edukimi ligjor. Rreth 40 nisma ligjore⁷ u ndërmorën bazuar në analizën e sistemit të drejtësisë dhe në planin e veprimit të miratuar nga Komisioni Parlamentar⁸. Pjesë e tij është ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorë-it në Republikën e Shqipërisë” i miratuar në 2016⁹ i cili parashikon si një kriter të vlerësimit të punës së magjistratëve etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale (neni 75 i ligjit). Një nga elementët e vlerësimit është paanësia e magjistratit, që matet me tregues të tillë si: respektimi i çështjeve të grupeve në nevojë, përfshirë barazinë gjinore dhe pakicat, numri i ankesave për përdorim të gjuhës diskriminues (paragrafi 3 i nenit 75 të ligjit).

Pjesa më e madhe e të drejtave të viktimave në kontakt me sistemin e drejtësisë penale rregullohet në Kodin e Procedurës penale (K.Pr.P), i cili pësoi ndryshime të mëdha në vitin 2017¹⁰, ndërsa mbrojtja juridike penale e viktimës nga veprat penale parashikohen në kodin penal. Ky i fundit, ka pësuar shtesa dhe ndryshime të herpashershme lidhur me mbrojtjen e viktimave, sidomos në periudhën 2012-2017¹¹. Për të herë të parë, drejtësia penale për të mitur rregullohet me një ligj të

⁵ Raporti i vlerësimit të zbatimit të detyrimeve Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, 2017, fq.8. Raporti gjendet në faqen zyrtare: <http://www.shendetesia.gov.al/al/publikime/raportet/shendetesia1516991290/raportigrevio>

⁶ Raporti i ECRI-t për Shqipërinë (cikli i pestë monitorues), miratuar më 19 mars 2015, botuar më 9 qershor 2015, Këshilli i Europës, fq.14. Raporti gjendet në faqen zyrtare: <https://www.coe.int/t/dghl/monitoring/ecri/Country-by-country/Albania/ALB-CbC-V-2015-18-ALB.pdf>

⁷ Deri në dhjetor 2017 janë miratuar 29 ligje dhe pjesa tjetër është paketës së projektligjeve është në procedurë parlamentare.

⁸ Vendimi nr.14, datë 30.07.2015 i Komisionit Parlamentar “Për miratimin e Dokumentit “Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri”. Përmbajtja e vendimit gjendet në faqen zyrtare: http://reformanedrejttesi.al/sites/default/files/vendim_nr.14_dt.30.07.2015.pdf dhe vendimi nr.15, datë 30.07.2015 i komisionit parlamentar “Për miratimin në parim të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Reformën e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri”. Ky dokument gjendet në faqen zyrtare: http://reformanedrejttesi.al/sites/default/files/vendim_nr.15_dt.30.07.2015.pdf

⁹ Ligji 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”

¹⁰ Ligji nr. 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës penale të Republikës së Shqipërisë”

¹¹ Gjatë periudhës 2012-2017, Kodin penal ka ndryshuar 10 herë, nga të cilat 8 herë mes nimeve ligjore dhe dy herë është ndryshuar me vendim të Gjykatës Kushtetuese. Disa ligje që kanë

posaçëm: Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, që u miratua në datën 30.3.2017 dhe që hyri në fuqi në datën 1 Janar 2018¹². I miturit viktimë gëzon një mbrojtje të veçantë.

Ndryshimet e bëra në K.Pr.P në vitin 2017 përmbajnë disa risi. *Së pari*, përdorimi i termit “viktimë”, përfshirja e të cilit nuk ishte e lehtë dhe u miratua mes debateve në komisionin e ligjeve në Kuvendin e Shqipërisë. Arsyeja e kundërshtimit ishte kuptimi jo i saktë të fjalës “vik-timë” në praktikën e deritanshme, ndërkohë që në shumicën e akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi dhe në ligje, udhërfyjes dhe raporte dhe në diskutimet e përditshme termi “viktimë” ka një përdorim të gjerë dhe është terminologjia e përdorur edhe në versionin shqip të përkthimit të këtyre akteve ndërkombëtare.

Së dyti, lista e të drejtave të viktimës së veprës penale është zgjeruar, duke parashikuar 12 të drejta, por përsëri kjo nuk është listë shteruese, pasi në nenin 58, shkronja ‘j’ të K.Pr.P është parashikuar se viktima ka të drejtë “të ushtrojë të drejta të tjera të parashikuara nga ky Kod”

Së treti, llojet e të drejtave të parashikuara për viktimën, janë të larmishme dhe kërkojnë shkronjës “b” të nenin 58 të K.Pr.P, viktima ka të drejtë të përfitojë kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse për ndihmën ndaj viktimave të veprës penale. Ushtrimi i këtyre të drejtave nënkupton nevojën e përfshirjes së shërbimeve mjekësore, psikologjike, sociale, psikiatrike, nëse është e nevojshme, pra të profesionistëve të ndryshëm. Për më tepër, parashikimi i kësaj të drejtë vë në pah nevojën e identifikimit dhe bashkëpunimit me institucionet, sistemet e referimit të rregulluara dhe protokolle të miratuara sesi do të ofrohet kujdesi, ndihma, këshillimi dhe shërbimet për viktimën në çdo fazë të procesit penal dhe pas përfundimit të tij.

Ligji parashikon që këto shërbime mund të ofrohen nga autoritetet, organizatat dhe institucione të posaçme të krijuara për të ndihmuar viktimat. Numri i madh i tyre dikton nevojën e identifikimit, të lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe ngritjes së një sistemi të mirëkordinuar mes tyre në të gjithë vendin, por jo vetëm. Ofrimi i shërbimeve duhet të bëhet nga persona, jo vetëm të profesionistë, por edhe të specializuar.

Nga ana tjetër, ndërtimi i rrjetit të shërbimeve mbrojtëse, mbështetëse dhe asistues për viktimat dhe financimi i tij kërkon njohje reale të nivelit të viktimizimit dhe llojeve të viktimave, treguesve demografike. Sikurse theksohet nga autorë të

pasur si fushë të rregullimit të tyre mbrojtjen e viktimave janë: Ligji 23/ 2012, Ligji nr. 144/2013 dhe 36/2017 “Për disa shtesa në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Për më shumë shih: *Hysi, Vasilika, Politika penale për veprat penale kundër grave dhe fëmijëve, Refleksione mbi ndryshimet në kodin penal (2012- 2013)*, botuar në revistën “Studime juridike”, nr 2, 2014, botim i Fakultetit të Drejtësisë, UT.

¹² Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur” është miratuar me ligjin 37/2017.

ndryshëm, për edhe sikurse është shprehur më parë një nga autoret e këtij punimi, statistikat zyrtare nuk tregojnë niveli real të viktimizimit, se disa lloje vepra penale raportohen më pak sesa të tjerat.¹³ Në kushte të tilla, vrojtimet sistematike kombetare, anketimet e viktimave dhe studimet shkencore, krahas përmirësimit të statistiakave zyrtare duhet të jenë shtrati i hartimit dhe përmirësimeve të politikës penale në Shqipëri dhe se kjo e fundit ka nevojë të orinetohet më mirë edhe nga interesi i viktimës.¹⁴

Së katërti, njoftimi dhe informimi i viktimës për të drejtat dhe aspekte të veçanta të procedimit penal përbën një nga risitë e ndryshimeve në vitin 2017, por që rokin një sërë problemesh dhe sfidash që duhen kapërcyer.

Neni 3 i Direktivës 2012/29/EU së Parlamentin Europian¹⁵ nënvizon mundësinë e viktimës të ndjekë procesin, pra duhet të kapërcehen të gjitha barrierat për shkaqe të ndryshme si: gjuha, aftësitë e kufizuara të kuptuarit dhe të lexuarit, moshë, matura etj. Informimi i viktimës nuk mund të jetë formal dhe standard për të gjithë kategoritë e palëve në proces dhe për aq më tepër për viktimat, por kërkon të mbahen parasysh tregues të tillë si: moshë, gjinia, nevojat, lloji i viktimizimit, niveli i të kuptuarit. Gjithashtu, informimi është një proces dinamik, dhe nuk ka të bëjë vetëm me fillimin e procedimit penal. Kjo nënkupton që organet e procedimit të mos plotësojnë shkresa standarde për informim, por gjuha dhe mënyra e informimit duket të jenë të kuptueshme dhe jo formale, por ta orientojnë viktimën lidhur me hapat që do të hedhë dhe ecurinë e procesin penal.

Kjo risi në K.Pr.P nxjerr në pah disa vështirësi të mundshme që mund të jenë rrjedhojë e kulturës juridike të punonjësve të praktikës dhe rutinës së punës së deritanishme lidhur me ushtrimin e të drejtës së informimit të pakëve në proces dhe të kategorive të veçanta të viktimave. Në kushte të tilla, lind nevoja urgjente e identifikimit dhe hartimit të listave të profesionistëve të licencuar për interpretues i gjuhës së shenjave, ose lehtësues i komunikimit për personat me aftësi të kufizuar në të folur dhe në të dëgjuar dhe vënia në dispozicion e tyre gjithëve organeve të procedimit dhe gjykatave; hartimi i një liste të avokatëve, jo vetëm profesionistë, por edhe të specializuar për kategori të veçanta të viktimave, përfshirë edhe të mitur; disponibiliteti i tyre për të informuar pa çënuar sekretin hetimor gjatë

¹³ Hysi, Vasilika, *A njihet realisht kriminaliteti? Refleksione dhe mundësi për matjen më të mirë të krimit në Shqipëri*, botuar në revistën “Studime juridike, Botim i Fakultetit të Drejtësisë, nr. 1, 2010, Tiranë, faqe 273-303.

¹⁴ Hysi, Vasilika, *Criminal Policy in Albania: Realities and Challenges. The need for Studies and Scientific Reflexions*, botuar në “*Criminology, Criminal Policy and Criminal Law in an International Perspective*”, Stämpfli Verlag AG Bern, 2013, faqe 573-596.

¹⁵ DG JUSTICE GUIDANCE DOCUMENT related to the transposition and implementation of Directive 2012/29/EU of the European Parliament and of the Council of 25 October 2012, Establishing minimum standards on the rights, support and protection of victims of crime, and replacing, Council Framework Decision 2001/220/JHA. Raporti gjendet i botuar në adresën: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=CELEX:32012L0029>

ecurisë së procedimit penal, informimi në rastet kur i arrestuari mund të lirohet, për mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes, fillimin dhe përfundimin e gjykimit.

Së pesti, një nga risitë e ligjit është e drejta e përjashtimit nga pagimi i çdo shpenzimi për marrjen e akteve dhe tarifave gjyqësore për paraqitjen e kërkesë-padisë që lidhen me statusin e viktimës së veprës penale, në kushte të caktuara me ligj (neni 58, shkronja ‘gj’ e K.Pr.P). Ligji “Për ndihmën juridike falas nga shteti”¹⁶ parashikon katagoritë e viktimave që përfitojnë ndihmë juridike, pavarësisht nivelit të ardhurave si dhe kriteret që duhet të përmbushë një person që nuk ka të ardhurave të mjaftueshme për të përfitur ndihmë juridike falas dhe përjashtim nga pagimi i shpenzimeve. Kjo e drejtë është një standard minimal që parashikohet nga Direktiva 2012/29/EU, por edhe në konventat ndërkombëtare dhe europiane që mbrojnë kategori specifike të viktimave, si për shembull, konventa e Stambollit parashikon që palët të sigurojnë të drejtën për ndihmë juridike dhe ndihmë ligjore falas për viktimat sipas kushteve të parashikuara nga ligji i tyre i brendshëm (neni 57 i Konventës).

Një nga vështirësitë që mund të haset në zbatimin e kësaj të drejtë është njohja e saj nga viktimat, prokurorët dhe gjyqtarët si dhe financimi i mjaftueshëm e këtyre shërbimeve nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera të parashikuara nga ligji. Gjithashtu, procedura e përfitimit të kësaj ndihme si dhe organi që e miraton atë është ndryshuar duke e kaluar këtë të drejtë gjykatës. Ky parashikim përbën risi dhe një lehtësi, thjeshtim procedurash dhe ofrim shërbimi në një kohë sa më të shkurtër. Ndaj, njohja e rregullave proceduralë të reja dhe krijimi sa më shpejt i praktikës gjyqësore në këtë fushë është e nevojshme pasi mundëson mbrojtjen reale të viktimave dhe inkurajon denciminin e veprave penale prej tyre.

Njoftimi për të drejtat e viktimës dhe dokumentimi i këtij veprimi është një sfidë tjetër në rastet kur viktimat është e mitur ose niveli i të kuptuarit të ligjit nga ana e viktimës nuk është i kënaqshëm. Ky veprim nuk mund të jetë formal, por rëndësi ka gjuha e transmetimit të të drejtave me qëllim që të kuptohen lehtësisht (neni 58, pika 2, i K.Pr.P). Praktika e paraqitjes së të drejtave në formë të shkruar dhe nënshkrimi nga ana e viktimës se u njoh më të drejtat e saj nuk është gjithnjë një mënyrë efektive dhe e mjaftueshme e njoftimit të të drejtave për disa kategori viktimash si për shembull të miturit, njerëzit që nuk shohin dhe/ose dëgjojnë etj.

2. Trajtimi i viktimës së mitur në kontakt me sistemin e drejtësisë penale

Të miturit janë gjithnjë e më shumë viktimat të krimeve të ndryshme në shoqërinë e sotme, madje të kimit të organizuar si trafikimi për qëllimi shfrytëzimi seksual ose forma të tjera të shfrytëzimit. Sipas raporteve të organizatave ndërkombëtare numri i të miturve viktimat të trafikimit është rritur në nivel global dhe në vendet e

¹⁶ Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

Bashkimit European¹⁷. Edhe në Shqipëri, fëmijët janë shpesh viktimë të dhunës në familje dhe në shoqëri¹⁸ si dhe viktimë të krimit të organizuar.¹⁹

Në të gjitha vlerësimet e politikës penale dhe masave që shteti duhet të marrë për parandalimin e viktimizimit të fëmijëve dhe trajtimit të tyre, mekanizmat monitorues të konventave si GRETA dhe GREVIO vënë theksin në nevojën e mbrojtjes më të mirë të viktimave mes rregullimeve në ligje dhe ofrimit të shërbimeve në praktikë. Me ndryshimet e vitit 2017, Kodi i Procedurës Penale dhe Kodi për Drejtësinë Penale për të Mitur rregullojnë për herë të parë të drejtat dhe trajtimin e të miturit-viktimitë të një veprë penale, në mënyrë të detajuar. Neni 58/a i K.Pr.P parashikon disa të drejta shtesë për viktimat e mitur në raport me viktimat e rritura si: e drejta që të shoqërohet nga një person i besuar prej tij, ruajtja e konfidencialitetit të të dhënave personale si dhe të kërkojë, nëpërmjet përfaqësuesit, që gjykimi të zhvillohet pa praninë e publikut.

Një nga çështjet delikate dhe që kërkon vëmendje është përcaktimi i personit të besuar për të miturin në rastet kur i mituri është viktimë e dhunës në familje ose e abuzimit nga kujdestari ose përfaqësuesi i tij. Meqënese kodi parashikon një rregullim të përgjithshëm, me rëndësi është krijimi i praktikave gjyqësore si modele të mira.

Pyetja e të miturit –viktimitë është një veprim që ka rëndësi të madhe.²⁰ Disa çështje janë të nevojshme të qartësohen si: “koha e pyetjes”, prania e personave të specializuar, pasja e mjeteve audiovizive dhe e mjediseve të pështatura për të miturin. Parashikimi i këtyre kushteve për pyetjen dhe trajtimin e të miturve vë në

¹⁷ *Child Trafficking in Europe, A Broad Vision to Put Children First*, UNICEF, 2007. Studimi gjendet i botuar në adresën: https://www.unicef-irc.org/publications/pdf/ct_in_europe_full.pdf. Global Report on Trafficking in Persons in 2016, UNITED NATIONS New York, 2016, fq/11. https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/glotip/2016_Global_Report_on_Trafficking_in_Persons.pdf

¹⁸ *Dhuna ndaj fëmijëve në Shqipëri*, UNICEF, 2008. Ky studim gjendet i botuar në adresën: https://www.unicef.org/albania/sq/Dhuna_ndaj_femijeve_ne_Shqiperi.pdf. Shih gjithashtu: *Dhuna në familje në Shqipëri: Vrojtim kombëtar me bazë popullatën*, 2008, faqe 59. Raporti gjendet i botuar në adresën: <http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/Domestic%20Violence%20in%20Albania%20-%20National%20Survey.pdf>. Shih: Dr. Robin N. Haarr: *Dhuna në familje në Shqipëri Vrojtim kombëtar me bazë popullatën*, 2013, fq.68. Botimi gjendet i botuar në adresën: http://www.instat.gov.al/media/2618/dhuna_ne_familje_ne_shqiperi_2013.pdf

¹⁹ *Report concerning the implementation of the Council of Europe Convention on Action against Trafficking in Human Beings by Albania*, second evaluation. GRETA, Këshilli i Europës, 2016, fq. 15. Raporti gjendet i botuar në adresën: <https://rm.coe.int/168065b87>.

²⁰ Sipas nenit 58/a &4 të Kodit e Procedurës Penale viktimë e mitur pyetet pa vonesë nga persona të specializuar për këtë qëllim. Kur është e mundur dhe e përshtatshme, biseda regjistrohet me mjete audiovizive, sipas parashikimeve të këtij Kodi. Ky regjistrim mund të përdoret si provë në procedimin penal dhe vlerësohet së bashku me provat e tjera, sipas kritereve që parashikohen nga paragrafi 4, i nenit 361/a, të këtij Kodi. Kur viktimë e mitur është nën 14 vjeç, biseda zhvillohet në mjedis të përshtatura për të.

diskutim faktin se sa dhe kur këto kërkesa të ligjit do të mund të zbatohen në gjithë territorin e vendit.

3. Viktimat e abuzuara seksualisht dhe viktimat e trafikimit të qënieve njerëzore

Vrojtimi i vitit 2007²¹ tregoi se gratë e dhunuara rrallë kërkojnë ndihmë nga shërbimet për mbështetjen e viktimave ose punonjësit e ligjit për probleme të dhunës në familje. Arsyet janë të shumta, ndër të cilat: mungesa e shërbimeve për viktimat femra të dhunës në familje, sidomos në zonat rurale; familja dhe shoqëria i këshillojnë shumë gra të mos kërkojnë ndihmë nga organet e shtetit apo shërbimet në bashkësi; shumë gra ia vënë fajin vetes për viktimizimin e tyre; dhe shumë gra kanë frikë se, po të flasin hapur e të kërkojnë ndihmë, do t'ua vënë fajin atyre për viktimizimin e tyre (35). Vrojtimi i dytë kombëtar i kryer në vitin 2013²², tregoi se raportimi në polic, prokurori dhe gjykatë është rritur.

Rritja e sensibilizimit të viktimave për të raportuar atë çfarë u ka ndodhur ka diktuar nevojën për rregullime ligjore dhe ngritjen e mekanizmave të specializuar në fushë. Nga ana tjetër, standardet ndërkombëtare rekomandojmë që shtetet të kenë struktura të specializuara të hetimit të rasteve të trafikimit të personave për arsye të kompleksitetit të hetimit.²³

Grupi i Ekspertëve për Veprimet kundër Trafikimit (Greta) ka vlerësuar progresin e bërë nga Shqipëria pas botimit të raportit të parë të saj lidhur me zbatimin e Konventës së Këshillit të Europës për Masat kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore. Ndryshimet në kodin penal të bëra gjatë vitit 2013²⁴ lidhur me trafikimin e qënieve njerëzore, burra dhe gra, fëmijë dhe të rritur, përfshirë trafikimin e brendshëm, përdorimi shërbimeve të viktimave të trafikuar kur personi ka dijeni se personi është i trafikuar, mosdënimi i viktimave të trafikimit për veprat penale të kryera si rezultat i trafikimit janë vlerësuar si masa pozitive.²⁵

Megjithatë, të drejtat procedurale të viktimës deri në vitin 2017 kanë qënë të dobëta. Deri më sot, hetimi dhe gjykimi i veprës penale të trafikimit të qënieve njerëzore bëhet nga prokuroria dhe gjykata e krimeve të rënda, ndërsa viktimat e abuzimeve seksuale kryesisht hetohen dhe gjykohen nga prokuroria dhe gjykata

²¹ Studimi i parë kombëtar është kryer në vitin 2007.

²² Po aty, fq.56

²³ *Needs Assessment Toolkit on the Criminal Justice Response to Human Trafficking*, United Nations Office on Drugs and Crime Vienna, United Nations New York, 2010 https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/Needs_Assessment_Toolkit_ebook_09-87518_June_2010.pdf, fq. 19.

²⁴ Ligji 144/2013.

²⁵ Group of Experts on Action against Trafficking in Human Beings, raport vjetor, GRETA, Këshilli i Europës, 2016, fq. 54. Raporti gjendet i botuar në adresën: https://ec.europa.eu/anti-trafficking/sites/antitrafficking/files/greta_2017_7_web_6gr_en.pdf

me juridiksion të përgjithshëm. Në bazë të ligjit për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë (ligji 97/2016) prokuroria e posacme ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën për veprat penale të krimit të organizuar (neni 15 & 1). Vepra penale të trafikimit të qenieve njerëzore kur kryhen nga një grup i strukturuar kriminal, organizatë kriminale, organizatë terroriste ose banda të armatosura do të hetohen dhe gjykohen nga struktura të posacme (SPAK), organizimi dhe funksionimi i të cilave rregullohen nga ligji 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Në kushte të tilla, funksionimi strukturave të specializuar në polici, prokurori dhe gjykatë për rastet e hetimit të trafikimit, qoftë edhe nga një person i vetëm, krijimi infrastrukturës së nevojshme për krijimin e kushteve të trajtimit të viktimës dhe zbatimi rregullave të pyetjes dhe referimit të tyre për të marrë shërbime e nevojshme sipas nevojës ka rëndësi. Fakti që viktima ka informacione që ndihmojnë hetimin, nuk nënkupton që e gjithë fokusi është zbulimi i veprës penale nga dëshmia e viktimës. Standardet ndërkombëtare rekomandojnë përdorimin e metodave inteligjente proaktive të hetimit me qëllim parandalimin e traumatizimit të mëtejshëm të viktimës.²⁶ Përmbushja e këtij standardi dikton nevojën e zgjerimit të përdorimit të teknologjisë në pyetjen e viktimës dhe shmangien e ripyetjes së saj sa më shumë që të jetë e mundur.

4. Raportimi i veprës penale nga viktima- hap me rëndësi, por jo i mjaftueshëm

Sikurse është vënë në pah edhe më lart, raportimi i disa lloje vepra penale është në nivele të ulta. Studimet²⁷ tregojnë se veprat penale të dhunë në familje, krimet seksuale raportohen më pak se veprat e tjera penale, se niveli i raportimit varet nga kultura dhe sjellja e organeve të drejtësisë dhe policisë, por edhe nga programet që zbatohen në mbrojtje të viktimave.²⁸

²⁶ Po aty, faqe 19.

²⁷ Robin N. Haarr, *Dhuna në familje në Shqipëri Vrojtim kombëtar me bazë popullatën*, vep. e cit, 2013, fq.11. Studimi gjendet i botuar në adresën: http://www.instat.gov.al/media/2618/dhuna_ne_familje_ne_shqiperi_2013.pdf.

²⁸ Po aty, fq. 55. Sipas këtij studimi arsyet pse gratë e dhunuara nuk kërkojnë ndihmë për dhunën në familje janë të shumta, ndër të cilat: ato nuk besojnë se mund të përmirësohet gjë; ato nuk dinë ku të kërkojnë ndihmë; kanë frikë se po të raportojnë, kjo mund t'i dëmtojë emrin e mirë familjes; ato kanë frikë se dhunuesi(t) do t'i rrahin edhe më shumë; ato mendojnë, ose e dinë nga përvoja, se do t'ju vihet etj faji për viktimizimin e tyre; ato kanë frikë se po të kërkojnë ndihmë, kjo do të çojë në zgjidhjen e martesës ose do t'i japë fund martesës/ marrëdhënies; ato mendojnë se nuk do t'u besojnë e nuk do t'i marrin seriozisht, madje edhe mund t'i përqeshin; ato kanë frikë se do të humbin fëmijët dhe e perceptojnë dhunën si pjesë normale të martesës, prandaj nuk kanë arsye të ankohen; ato nuk ndihen të qeta kur kërkojnë ndihmë sepse aftësitë e tyre për të kuptuar të drejtat e tyre ligjore janë të kufizuara.

Konventa Europiane për Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas dhe Dhunës në Familje detyron shtetet nënshkruese (*nënkupto edhe Shqipërinë*) të ngrejnjë dhe të forcojnë mekanizmat e referimit të rasteve të dhunës. Këto mekanizma ngrihen në nivel vendor dhe në Shqipëri deri në vitin 2017 janë ngritur mekanizmat në 28 bashki, nga 61.²⁹

Zbatimi i rregullave reja të parashikuara në kodin e procedurës penale, pasi ndryshimeve të vitit 2017 bën të nevojshme ngritjen dhe funksionimin me efikasitet të mekanizmave të referimit dhe koordinimi mes tyre. Kjo është një sfidë me të cilën do të përballen punonjësit e praktikës në bashkitë ku ky mekanizëm nuk është ngritur ose nuk funksion.

Legjislacioni shqiptar, konkretisht neni 58/b,shkronja ‘a’ e K.Pr.P parashikon disa të drejta shtesë për këtë kategori viktimash si e drejta e viktimës të pyetet pa vonesë nga një oficer i policisë gjyqësore ose prokuror i të njëjtës gjini që viktimat e trafikimit, të dhunës në familje dhe të abuzimeve seksuale të trajtohen nga personel femra dhe të specializuar; të refuzojnë t’u përgjigjen pyetjeve në lidhje me jetën private, e cila qartësisht nuk ka lidhje me veprën penale si dhe të kërkojnë të dëgjohen nëpërmjet mjeteve audiovizive, sipas parashikimeve të bëra në kod (neni 58/b, shkronjat “b” dhe “c” të K.Pr.P).Gjithashtu, personeli i kualifikuar dhe specializuar në trajtimin e viktimave ka rëndësi për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimës dhe mos riviktimizimin e saj.

Respektimi i të drejtave të sipërcituara shtron për diskutim disa çështje”. *Së pari*, a kanë strukturat e policisë, personel të policisë gjyqësore ose prokurore gra të specializuara për hetimin e këtyre veprave në çdo komisiarit, drejtori policie ose prokurori? Nëse jo, sa kohë do të duhet të përgatiten dhe të specializohen? *Së dyti*, teknikat e pyetjes së viktimës kanë specifikat e tyre. Standardet ndërkombëtare përcaktojnë teknikat e pyetjes dhe për tu ardhur në ndihmë punonjësve të praktikës janë përgatitur udhërryës për punonjësit e policisë, prokurorisë dhe gjykatës. Një pyetje që mund të shtrohet është sesa të familjarizuar dhe të specializuar janë punonjësit e policisë, prokurorët për teknikat e pyetjes me qëllim që të shmangen pyetjet për jetën private, kur nuk ka lidhje me veprën penale. *Së treti*, mundësitë e përdorimit të mjeteve audiovizive në të gjitha drejtoritë e policisë dhe prokuroritë e vendit.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Sa për sipër, drejtësia penale në Shqipëri ka një rrugë të gjatë për të bërë në mënyrë që viktima në kontakt me sistemin e drejtësisë penale të trajtohet me dinjitet dhe të gëzojë realisht të drejtat e saj. Pozita e dobët e viktimës në procesin penal në

²⁹ Raporti i GREVIO-s, për Shqipërinë, 2017.

Shqipëri është ndikuar nga mangësitë në rregullimin ligjor, kuptimi dhe interpretimi i të drejtave të viktimës, por edhe nga mungesa e mekanizmave të referimit të viktimës ose aty ku ky i fundit funksionon paarqet dobësi ose moskordinim të mirë. Nevojat e viktimës për kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera dikton nevojën njohjes reale të nivelit të viktimizimit dhe llojeve të tij. Bazuar në studime sistematike të viktimave është e rekomandueshme krijimi dhe forcimi i mekanizmave vendore, forcimi i bashkëpunimit me institucionet dhe organizatat e shoqërisë civile, përfshirë edhe sektorin privat.

Parashikimi i të drejtave të viktimës në ligj është një hap pozitiv, por nuk mjafton. Informimi i viktimës, trajtimi me humanizëm dhe dinjitet, krijimi i grupeve të profesionistëve dhe të personeli të specializuar për kategori të veçanta të viktimave, përfshirë edhe të mitur janë sfida që duhet të kapërcehen në një kohë sa më të shkurtër. Krahas kualifikimit dhe specializimit të punonjësve të policisë, prokurorëve dhe gjyqtarëve, më rendësi është financimi i mjaftueshëm e shërbimeve nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera të parashikuara nga ligji.

Zbatimi i rregullave reja të parashikuara në kodin e procedurës penale dhe në kodin për drejtësinë penale për të mitur bën të nevojshme ngritjen dhe funksionimin me efikasitet të mekanizmave të referimit dhe koordinimi mes tyre në gjithë vendin. Por kjo nuk mjafton pasi publiku ka nevojë të informohet dhe të njohë ligjet dhe ti zbatojë ato.

BIBLIOGRAFIA

Aeibi, M, Akdeniz, G, Barclay, G, etj “*European Sourcebook of Crime and Criminal Justice, Statistics*, 2014, HEUNI, f.37. Ky botim gjendet edhe në internet në adresën:

http://www.heuni.fi/material/attachments/heuni/reports/qrMWoCVTF/HEUNI_report_80_European_Sourcebook.pdf

Groenhuijsen, Marc: *Victims’ Rights in the Criminal Justice System: a Call for More Comprehensive Implemenation Theory*, botuar në *Caring for Crime Victims*, selected Proceedings of the 9th International Symposium Victimology”, red nga Jan.J.M.van Dijk, Ron G.H.van Kaam dhe JoAnne Wemmers, New York, 1999.

Hysi, Vasilika: *Sistemi i drejtësisë penale, kriminalizimi i krimeve të reja në Shqipëri dhe roli i shërbimeve sociale në ditët tona*, botuar në “Forcimi i institucioneve sociale në sistemin e Drejtësisë, punime të konferencës ndërkombëtare, OSBE, 2014, f. 209-226, ISBN:978-92-9235-262-2

Hysi, Vasilika, *A njihet realisht kriminaliteti? Refleksione dhe mundësi për matjen më të mirë të krimit në Shqipëri*, botuar në revistën “Studime juridike, Botim i Fakultetit të Drejtësisë, nr. 1, 2010, Tiranë, faqe 273-303.

Hysi, Vasilika, Politika penale për veprat penale kundër grave dhe fëmijëve, Refleksione mbi ndryshimet në kodin penal (2012- 2013), botuar në revistën “Studime juridike”, nr 2, 2014, botim i Fakultetit të Drejtësisë, UT.

Hysi, Vasilika, *Criminal Policy in Albania: Realities and Challenges. The need for Studies and Scientific Reflexions*, botuar në “Criminology, Criminal Policy and Criminal Law in an International Perspective”, Stämpfli Verlag AG Bern, 2013, ISBN print: 978-3-7272-2967-1, faqe 573-596.

STUDIME, ANALIZA RAPORTE

Analizë e sistemit të drejtësisë, hartuar nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë, i ngritur pranë komisionit të posaçëm parlamentar për reformën në sistemin e drejtësisë në Shqipëri, Qershor, 2015. Ky raport gjendet në faqen zyrtare me adresë: http://reformatdrejtesi.al/sites/default/files/dokumenti_shqip.pdf

DG JUSTICE GUIDANCE DOCUMENT related to the transposition and implementation of Directive 2012/29/EU of the European Parliament and of the Council of 25 October 2012, Establishing minimum standards on the rights, support and protection of victims of crime, and replacing, Council Framework Decision 2001/220/JHA.

Raporti gjendet i botuar në adresën: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=CELEX:32012L0029>

Child Trafficking in Europe, A Broad Vision to Put Children First, UNICEF, 2007. Studimi gjendet i botuar në adresën: https://www.unicef-irc.org/publications/pdf/ct_in_europe_full.pdf. Global Report on Trafficking in Persons in 2016, UNITED NATIONS New York, 2016, fq. 11. Raporti gjendet në faqen zyrtare https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/glotip/2016_Global_Report_on_Trafficking_in_Persons.pdf

Dhuna ndaj fëmijëve në Shqipëri, UNICEF, 2008. Ky studim gjenden i botuar në adresën: https://www.unicef.org/albania/sq/Dhuna_ndaj_femijeve_ne_Shqiperi.pdf.

Dhuna në familje në Shqipëri: Vrojtim kombëtar me bazë popullatën, 2008. Raporti gjendet i botuar në adresën: <http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/Domestic%20Violence%20in%20Albania%20-%20National%20Survey.pdf>.

Needs Assessment Toolkit on the Criminal Justice Response to Human Trafficking, United Nations Office on Drugs and Crime Vienna, United Nations New York, 2010 https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/Needs_Assessment_Toolkit_ebook_09-87518_June_2010.pdf

Group of Experts on Action against Trafficking in Human Beings, raport vjetor, GRETA, Këshilli i Europës, 2016. Raporti gjendet i botuar në adresën: https://ec.europa.eu/anti-trafficking/sites/antitrafficking/files/greta_2017_7_web_6gr_en.pdf

Raporti i GREVIO-s, për Shqipërinë, 2017.

Raporti i vlerësimit të zbatimit të detyrimeve Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, 2017. Raporti gjendet në faqen zyrtare:

<http://www.shendetesia.gov.al/publikime/raportet/shendetesia1516991290/raporti-grevio>

Raporti i ECRI-t për Shqipërinë (cikli i pestë monitorues), miratuar më 19 mars 2015, botuar më 9 qershor 2015, Këshilli i Europës. Raporti gjendet në faqen zyrtare: <https://www.coe.int/t/dghl/monitoring/ecri/Country-by-country/Albania/ALB-CbC-V-2015-18-ALB.pdf>

Robin N. Haarr: *Dhuna në familje në Shqipëri Vrojtje kombëtar me bazë popullatën*, 2013, fq.68. Botimi gjendet i botuar në adresën: http://www.instat.gov.al/media/2618/dhuna_ne_familje_ne_shqiperi_2013.pdf.

Report concerning the implementation of the Council of Europe Convention on Action against Trafficking in Human Beings by Albania, second evaluation. GRETA, Këshilli i Europës, 2016. Raporti gjendet i botuar në adresën: <https://rm.coe.int/168065bf87>.

LIGJE DHE VENDIME

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur” është miratuar me ligjin 37/2017.

Ligji 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”

Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

Ligji nr. 36/2017 “Për disa shtesa në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës penale të Republikës së Shqipërisë”

Ligji nr. 144/2013 “Për disa shtesa në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji 23/ 2012, “Për disa shtesa në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Vendimi nr.14, datë 30.07.2015 i Komisionit Parlamentar “Për miratimin e Dokumentit “Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri”. Përmbajtja e vendimit gjendet në faqen zyrtare:

http://reformanedrejtisi.al/sites/default/files/vendim_nr.14_dt.30.07.2015.pdf

Vendimi nr.15, datë 30.07.2015 i komisionit parlamentar “Për miratimin në parim të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Reformën e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri”: Përmbajtja e vendimit gjendet në faqen zyrtare

http://reformanedrejtisi.al/sites/default/files/vendim_nr.15_dt.30.07.2015.pdf

Panel Session IV
International

ALCUNE SFIDE PER L'ARMONIZZAZIONE DEL DIRITTO PENALE ALBANESE CON GLI STANDARDS EUROPEI: TRA "TRADIZIONE" ED ESIGENZE DI RIFORME GIURIDICHE E CULTURALI

Some challenges on the harmonization of Albanian criminal law with European standards: between "tradition" and needs of juridical and cultural reforms

Prof. Asoc. Dr. Ersi BOZHEKU

Direttore Esecutivo del CESIAL – Centro Studi, Alta Formazione e Ricerca Italo-Albanese del CEMAS "Sapienza" Università di Roma

SOMMARIO: 1. Introduzione. – 2. Pregi e limiti strutturali e tecnico-giuridici del codice penale del 1995: gli errori da non ri-fare. – 3. I limiti dei giuristi albanesi tra transizione e tradizione giuridica. – 4. Alcune considerazioni per una corretta realizzazione di un "nuovo" codice penale albanese.

1. INTRODUZIONE

La riforma della giustizia costituisce oramai il "leitmotiv" della vita politica, giuridica e sociale in Albania. Non vi è dubbio che si tratta di un momento epocale che mira a riportare l'ordine giuridico e il dominio della certezza della legge in una società che per più di venticinque anni, dalla caduta del regime comunista in poi, è stata in balia di politici e magistrati non solo corrotti, ma anche legati con il mondo del crimine organizzato. Trattasi di un avvenimento che si può certamente definire storico e di ampia portata, destinato a toccare quasi tutti i settori della giustizia, dalla configurazione del sistema giudiziario e delle strutture cardine che lo compongono, alla riforma dei codici sostanziali e processuali, fino a giungere alla ri-designazione delle regole e dei programmi di istituzioni importanti per la giustizia, come la Scuola della Magistratura, la Scuola dell'Avvocatura, la formazione giuridica negli Atenei ecc.

E' naturale dunque che della giustizia se ne parli molto, soprattutto se si considera che l'obiettivo primario degli albanesi di entrare nell'Unione Europea è profondamente legato alla riformattazione dell'intero sistema. Non è un caso che sono proprio la Commissione Europea – ma anche e soprattutto l'Ambasciata Americana in Albania – a premere fortemente sul Governo di Tirana affinché proceda velocemente alla realizzazione della riforma (ma sarebbe il caso di parlare di "riforme"). Del resto, tramite le riforme a 360 gradi in tutti i settori della giustizia si ritiene si possa giungere alla realizzazione di una classe di magistrati informata ai principi di correttezza, probità e professionalità e conseguentemente si pongano le basi per combattere efficacemente i fenomeni particolarmente diffusi

della corruzione, della coltivazione e traffico di stupefacenti e della criminalità organizzata.

Sicuramente sono apprezzabili gli interventi del Governo e del Parlamento albanese: in poco più di un anno e mezzo sono riusciti a portare a termine la riforma della Costituzione, l'approvazione di diverse importanti leggi, come quella di modifica del codice di procedura penale, e l'istituzione di commissioni cardine attraverso cui renderla concretamente efficace, come è quella del "vetting", chiamata a giudicare la professionalità, l'immagine (soprattutto nell'ottica dei legami con ambienti della criminalità organizzata) e le possidenze patrimoniali di tutti i magistrati albanesi.

Sicuramente la modifica del codice di procedura penale, che ha interessato oltre 200 disposizioni, rappresenta uno dei momenti più importanti della riforma. In questo modo si ritiene si possano risolvere una serie di problematiche attinenti alla buona amministrazione della giustizia penale: una maggiore responsabilità e un maggiore controllo reciproco tra magistrati sono le direttrici che la animano.

Per ovvi motivi, in questo scritto non si parlerà delle novità – importantissime – apportate al codice di rito, bensì delle problematiche – non solo di natura tecnico-giuridica ma anche socio-culturali – che contraddistinguono il codice penale albanese.

A modesto avviso di chi scrive, è nel codice penale che si annida la più grande sfida, sia per il legislatore, sia per i giuristi, sia per il popolo albanese. Ciò in quanto, differentemente dal codice di procedura ove vengono in rilievo le regole del processo (c.d. regole del gioco) affinché possa considerarsi ragionevole, giusto ed equo, il codice penale riguarda la tutela dei valori fondanti di una società e dunque risente irrimediabilmente della cultura e del grado di sviluppo della stessa.

Non è detto pertanto che norme d'importazione e connotate da profili di alta ingegneria giuridica possano trovare terreno fertile nella prospettiva di una loro corretta applicazione da parte dei giuristi albanesi; così come alcuni limiti culturali legati alla tradizione giuridica albanese – che è ancora fortemente influenzata dalla passata esperienza comunista – possano costituire dei veri e propri ostacoli non solo nel momento di produzione delle norme del codice penale ma anche in quello della loro applicazione da parte degli operatori della giustizia.

La vera sfida sarà dunque legata: a) alla realizzazione di un codice moderno in grado di garantire al meglio i cittadini e, al contempo, a tutelare i valori cardine cui si fonda una società moderna e democratica come vuol essere quella albanese; b) la sua effettiva applicazione pratica mediante la corretta interpretazione, in primo luogo, nelle università e nelle scuole di alta formazione dei professionisti del diritto, e, in seconda battuta, nelle aule dei Tribunali e delle Corti dove il codice sarà applicato.

2. Pregi e limiti strutturali e tecnico-giuridici del codice penale del 1995: gli errori da non ri-fare

Il codice penale del 1995 è costellato da poche luci e molte ombre. E' innegabile che si tratta di un prodotto alieno rispetto all'esperienza albanese precedente; e ciò si comprende e condivide atteso che il codice penale del 1977 era connotato da una matrice chiaramente totalitaria, tipica dei codici dei paesi comunisti, e in alcun modo aderente con i valori condivisi delle democrazie, tra cui spicca il rispetto dei diritti del cittadino, i principi di determinatezza, tassatività, divieto di analogica, offensività, colpevolezza ecc.

Per la verità, molti di tali principi, li troviamo pienamente affermati nel codice del 1995. Ciò tuttavia l'opera risulta contraddittoria: essa manca di organicità, coerenza e sistematicità. La parte generale assomiglia più a un miscuglio di disposizioni del codice penale italiano, quello francese e tedesco, senza mancare di disposizioni, come la mediazione, propria dei sistemi del nord Europa, mentre la parte speciale sembra rifarsi, almeno per quanto riguarda i contenuti delle singole disposizioni, al codice francese, anche se diversamente da quest'ultimo i reati sono ripartiti non già in crimini, delitti e contravvenzioni, ma solo tra delitti e contravvenzioni e quest'ultime sono appannaggio del parlamento e non dell'esecutivo.

Va dato merito tuttavia che, almeno sulla carta, i principi cardine del diritto penale moderno si trovano sia nella Costituzione che nel codice penale albanese.

L'articolo 29 della Costituzione, ad esempio, afferma che "nessuno può essere accusato o dichiarato colpevole per un'opera penale, la quale non è prevista come tale dalla legge nel momento della sua realizzazione". L'articolo 2 del codice penale precisa, inoltre, che "nessuno può essere punito penalmente per un'opera che precedentemente non è stata prevista espressamente nella legge come crimine o contravvenzione".

Non v'è dubbio che l'inciso espressamente richiama i contenuti dell'articolo 1 del codice penale italiano del 1930. Se, però, in Italia l'utilizzo della locuzione "espressamente" è stata la fonte per l'elaborazione dogmatica del principio di determinatezza, secondo cui il "reato", non deve, né può, essere solo previsto formalmente dalla legge, ma occorre altresì che quest'ultima determini chiaramente – cioè "espressamente" – ciò che s'intende incriminare, che non può essere altro che un fatto, nel codice penale albanese una simile attività manca. Mancano approfondimenti in dottrina; mancano valide proposte sia in termini ricostruttivo-interpretativi, sia in chiave critica, da parte della giurisprudenza sia di merito che di legittimità.

Peraltro, a ben vedere, il codice già nell'incipit esordisce con una anomalia: si parla in generale di "opera penale" da intendersi quale sinonimo di reato, senza tuttavia precisare cosa si debba intendere per reato. Quali sono i limiti entro cui il legislatore può inserire delle "opere penali" all'interno dell'ordinamento, non è dato

sapere (). Una precisazione doverosa quanto scontata (fino ad un certo punto) è che si deve trattare di fatti preveduti dalla legge come reato; nella prospettiva albanese non sembra si tratti di una precisazione da poco posto che, il precedente codice di stampo comunista del 1977, prevedeva in generale la locuzione “opera penale” svincolata dal fatto; proprio facendo leva sull’oscurità del concetto di “opera penale” si punivano anche delle mere manifestazioni di pensiero (il riferimento va ai delitti di agitazione e propaganda) o condotte non espressamente disciplinate dal legislatore.

Dunque, già sul versante dell’oggetto di riferimento della normativa penale, il codice nasce male; ne manca il presupposto cardine ossia che l’oggetto di attenzione per il diritto penale è costituito dai fatti intesi quali accadimenti umani apprezzabili all’esterno e non mere manifestazioni di pensiero; fatti che peraltro devono essere offensivi di beni giuridici cui la società attribuisce e riconosce un valore importante e condiviso e che dunque li rende meritevoli di tutela sul versante penalistico. Solo così, infatti, si può ritenere giustificato e legittimo l’intervento del legislatore orientato alla produzione della norma penale.

Orbene, queste che sembrano delle scontate quanto ovvie considerazioni si scontrano con l’arretratezza giuridica che connota l’Albania, nella cui elaborazione giurisprudenziale o dottrinale, salvo rare e sperdute voci in dottrina, manca qualsiasi riferimento al concetto di bene giuridico nonché al principio di necessaria offensività; il mancato appro-fondimento di natura scientifica, ancorché pratica, ha portato spesso la giurisprudenza a punire condotte nonostante fossero totalmente prive di un’effettiva carica lesiva per il bene giuridico.

Qui il punto non riguarda tanto la struttura del codice, ma la concezione del diritto penale da parte del giurista albanese, ancora troppo legata agli schemi tradizionali del diritto penale dell’autore e della pericolosità sociale delle fattispecie.

Se quest’ultima è ancora intesa quale fulcro del sistema – a fronte dell’opposto concetto di bene giuridico quale vero e unico oggetto di tutela da parte delle legislazione penale – ciò non si può imputare alla struttura del codice ma al humus culturale in cui lo stesso vive.

Tornando al codice, sicuramente è da apprezzare l’articolo 4 c.p.alb. il quale prevede che l’ignoranza della legge penale non scusa, salvo che si tratti di ignoranza inevitabile. La norma sembra ricalcare in modo pedissequo l’articolo 5 del codice penale italiano in seguito all’intervento della Corte Costituzionale del 1988, con la famosissima sentenza 364.

Anzi, in tema di colpevolezza, il codice penale albanese sembrerebbe fare un passo in avanti. L’articolo 14 c.p. al primo comma sanziona il principio di colpevolezza in generale, senza la quale nessuno può essere punito, per prevedere, al secondo comma, le due forme di colpevolezza e segnatamente il dolo e la colpa (pakujdesi). Se analizzata bene la disposizione, sia in sé medesima, sia in relazione all’articolo 4 c.p.alb., emerge come l’attuale codice aderisca alla c.d.

teoria normativa della colpevolezza e non già a quella della colpevolezza in senso psicologico.

Ma la domanda è: dottrina e giurisprudenza in che termini hanno interpretato tale norma?

E ancora.

Le disposizioni sul tentativo sembrano riprendere quelle previste dal legislatore tedesco negli artt. 23 ss. del proprio codice, ove per tale forma di manifestazione del reato la diminuzione di pena è prevista come meramente facoltativa dal momento che la colpevolezza per il delitto tentato, di regola, è considerata del tutto equivalente a quella per il delitto consumato ().

Tuttavia, la domanda poc' anzi posta ritorna prepotentemente: il codice albanese si ispira alla stessa concezione di colpevolezza fatta propria dal codice tedesco?

La dottrina e la giurisprudenza albanese hanno analizzato nella corretta prospettiva tale norma?

La dottrina e la giurisprudenza albanese si sono mai rifatte alle interpretazioni proposte dai giuristi dell'ordinamento da cui la norma è ripresa?

La conseguenza in termini pratici è: un'eccessiva discrezionalità della magistratura nell'irrogazione delle condanne nei casi di tentativo, senza che le stesse siano seguite da una solida argomentazione giuridica, come invece avviene in punto sia di fatto che di diritto nella magistratura tedesca.

Il codice albanese prevede tra le forme di manifestazione della condotta l'azione e l'omissione.

Tuttavia, seguendo la scia del codice francese, manca di una disposizione che disciplini il reato omissivo e in special modo la fonte dell'obbligo giuridico, ma contrariamente dal più nobile codice cui si ispira, non presenta un numero elevato di ipotesi di responsabilità omissiva, con la conseguenza che, in assenza di un referente normativo, molti fatti commissivi mediante omissione rimangono esenti da qualsiasi forma di responsabilità.

Ma vi è di più.

Gli articoli 48, 49 e 50 c.p.alb. disciplinano le circostanze attenuanti ed aggravanti comuni.

La disciplina ricalca pedissequamente gli articoli 61 e 62 del codice penale italiano. Addirittura l'articolo 49 riporta in modo identico le attenuanti generiche previste dal codice penale italiano all'articolo 62 bis c.p. Sennonché, nel codice albanese, l'articolo 47 stabilisce che le circostanze attenuanti ed aggravanti devono essere usate quale parametro per il giudice nello stabilire la pena tra il massimo e il minimo editale previsto dalla norma incriminatrice. Da un lato vi sono le circostanze così come codificate nel codice Rocco, dall'altro, in punto di applicazione delle stesse, si segue la disciplina codicistica tedesca, nonostante quest'ultima non prevede un regime generale in tema di circostanze per singoli

reati, ma autonome ipotesi circostanziate. Insomma, in Albania, il codice penale oltre a prevedere singole ipotesi circostanziate, contempla anche delle disposizioni di parte generale che codificano le c.d. circostanze comuni, le quali, però, posso assumere rilievo solo ai fini della graduazione della risposta sanzionatoria al interno del minimo e massimo edittale previsti per la singola fattispecie.

Problematico è anche il regime dell'imputabilità delle circostanze. Sul punto, il codice penale albanese tace, mentre la giurisprudenza propende per la loro applicazione oggettiva (sia se si tratti di attenuanti che di aggravanti), prescindendo dalla conoscenza/conoscibilità delle stesse da parte del soggetto agente.

A fronte di ciò, però, vi sono molte norme di parte speciale che sono costruite in termini meramente obbiettivi e non lasciano la possibilità in merito ad un effettivo scrutinio della colpevolezza.

Molte sono previsioni aggravate dall'evento, il quale si imputa obbiettivamente per il sol fatto di essere venuto ad esistere; ad esempio situazioni obbiettive legate all'età della vittima, ovvero situazioni oggettivamente non conoscibili dal reo sono comunque fonti di responsabilità. La manca, poi, come detto, di un regime di imputazione delle circostanze rende quasi automatica la loro applicazione al reo a prescindere se conosciute o conoscibili dallo stesso.

La mancanza di una disciplina sull'errore per molti viene considerata un errore. Probabilmente lo è se lo si analizza nella prospettiva del diritto albanese. Probabilmente con dei piccoli sforzi dogmatici la dottrina poteva giungere alla realizzazione di una disciplina al riguardo nonostante la mancanza di indicazioni da parte del legislatore; e ciò non già forzando le norme o accedendo ad interpretazioni in malam partem, bensì mediante una attenta esegesi delle disposizioni che disciplinano le nozioni di dolo e colpa. Ma se manca una teoria sul dolo, il suo oggetto ed accertamento, come si può pretendere di costruire una valida teoria sul concetto dell'errore (lajthitje)?

³ Miratuar me rezoluten e Asamblesë së përgjithshme nr 40/33 datë 29.11.1985

⁴ Miratuar me rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme nr 45/113 datë 14.12.1990

⁵ Miratuar në 1966 dhe hyri në fuqi në 1976

⁶ Relacion për projektligjin “Kodi i drejtësisë për të miturit në Republikën e Shqipërisë”

⁷ Neni 8 “Kodi i drejtësisë për të miturit në Republikën e Shqipërisë”

⁸ Neni 10 “Kodi i drejtësisë për të miturit në Republikën e Shqipërisë”

- Parimi i mbrojtjes nga diskriminimi⁹
- E drejta për zhvillim harmonik të të miturit
- Parimi i proporcionalitetit¹⁰
- Përparësia e masave alternative të shmangies¹¹
- Kufizimi ose heqja e lirisë si masë e fundit¹²
- Pjesëmarrja e të miturit në proces
- Shqyrtimi pa vonesë dhe me përparësi
- Pjesëmarrja e detyrueshme e psikologut

1.3 Të drejtat dhe garancitë procedurale të të miturit në konflikt me ligjin

Legjislacioni penal aktual, deri para miratimit të kodit të ri, nuk kishte një kapitull të veçantë në KPrP mbi trajtimin e të miturit në procesin penal. Në këtë kod nuk janë parashikuar parime të procedimit penal që lidhen me të miturit dhe nuk gjen pasqyrim, në mënyrë të shprehur parimi i interesit më të lartë të fëmijës.¹³

Me miratimin e Kodit të ri garancitë procedurale dhe të drejtat e të miturit si dëshmitar dhe si viktimë në procedimin penal është bërë një diferencim si në të drejta ashtu dhe në mënyrën e trajtimit të tyre në procesin penal.

I mituri gëzon të njëjtat të drejta me të rriturit përveç atyre që Kodi ia ka garantuar posaçërisht të miturit si subjekt i së drejtës. Ndihma ligjore dhe psikologjike falas është element esencial i procedimit penal për të mitur, mungesa e të cilave çon në pavlefshmërinë absolute të procesit. Mbrojtja e privatësisë së të miturit përbën një element esencial. Ajo parashikohet në nenin 8 të KEDNJ¹⁴. Në frymën e Konventës është hartuar dhe KPrP¹⁵ i cili ndalon publikimin e gjeneraliteteve dhe të fotove të të pandehurve dhe dëshmitarëve të mitur të akuzuar për veprën penale ose të demtuar nga ajo. Kodi i ri shprehet se nuk publikohet asnjë informacion që çënon identifikimin e të miturit dhe të dhënat mbi dënimin e mëparshëm të të miturit fshihen menjëherë mbas vuajtjes së dënimit.¹⁶

⁹ Neni 11 “Kodi i drejtësisë për të miturit në Republikën e Shqipërisë”

¹⁰ Neni 13 “Kodi i drejtësisë për të miturit në Republikën e Shqipërisë”

¹¹ Neni 14 “Kodi i drejtësisë për të miturit në Republikën e Shqipërisë”

¹² Neni 15” Kodi i drejtësisë për të miturit në Republikën e Shqipërisë”

¹³ Xhafo.J “I mituri dhe procesi penal”, Monografi, shtëpia botuese “Geer” fq 97

¹⁴ 1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

¹⁵ Neni 103/4

¹⁶ Neni 21/1/2 ” Kodi i drejtësisë për të miturit në republikën e shqipërisë”

Një elemnt i ri i pahasur më parë as në KP dhe as në KPrP është vlerësimi individual i të miturit¹⁷. Në çdo vendimmarrje në lidhje me të miturin, merren në konsideratë rrethanat individuale të tilla si: mosha, niveli i zhvillimit, kushtet e jetesës, mënyra e rritjes dhe e zhvillimit, edukimi dhe arsimimi, gjendja shëndetësore, gjendja familjare dhe rrethanat e tjera, të cilat lejojnë vlerësimin individual.¹⁸

1.4 I mituri viktimë dhe i mituri dëshmitar i veprës penale

Një nga risitë e Kodit të ri është trajtimi si subjekt të drejtësisë penale për të mitur viktimën dhe dëshmitarin. KP dhe KPrP nuk bënë trajtimin si subjekte të veçantë të viktimës dhe dëshmitarit por i trajton ato si subjekte të përgjithshëm dhe nuk bënë diferencimin midis viktimës apo dëshmitar madhor dhe të rritur. KDM trajton në mënyrë të hollësishme të drejtat dhe mënyran e trajtimit të këtyre subjekteve nga organet kompetente. Me termin “*I mitur viktimë*” do të kuptojmë personin nën 18 vjeç të cilit i është shkaktuar një dëm moral, fizik apo material, që rrjedh direkt nga vepra penale. Ndërsa “*I mitur dëshmitar*” do të kuptohet personin nën 18 vjeç i cili mund të ketë informacione lidhur me veprën penale. Kodi parashikon një sërë parimesh që organet duhet të mbajnë parasysh kur ata kanë të bëjnë më këtë kategori subjektesh. I mituri viktimë ose dëshmitar i veprës penale të trajtohet me përkujdesje, në mënyrë miqësore dhe të ndjeshme, të tilla që respektojnë dinjitetin e tij gjatë gjithë procesit, duke marrë në konsideratë gjendjen e tij personale, nevojat e menjëhershme dhe të veçanta, moshën, gjininë, aftësitë e kufizuara, nëse ka, dhe nivelin e pjekurisë;¹⁹Kodi parashikon një sërë garancish dhe të drejtash për të miturin viktimë dhe dëshmitar të cilat në mënyrë të përmbledhur paraqiten si më poshtë:

- E drejta e të miturit viktimë për t’u informuar²⁰
- Parashikon një sërë detyrash për Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës lidhur me të miturin dëshmitar dhe viktimë²¹
- Ndihma juridike për të miturin viktimë²² si një ndër risitë e këtij kodi.
- Masat mbrojtëse për të miturin viktimë ose dëshmitar²³
- Rregulla të veçanta të pyetjes së të miturit viktimë ose dëshmitar.²⁴

¹⁷Neni 22 ” Kodi i drejtësisë për të miturit në republikën e shqiperisë”

¹⁸ Po aty pika 2

¹⁹ Neni 33 (a) “Kodi i Drejtësisë për të Mitur”

²⁰ Po aty neni 34

²¹ Po aty neni 35

²² Po aty neni 36

²³ Po aty neni 37

²⁴ Po aty neni 39

Rregulla të posaçme për pyetjen e të miturit 14 vjeçë-18 vjeç.²⁵ Rregulla të veçanta të pyetjes së të miturit viktimë dhe/ose dëshmitar i shfrytëzimit seksual ose dhunësseksuale²⁶ Rregulla të veçanta të pyetjes së të miturit viktimë/dëshmitar nën 14 vjeç,²⁷

- Masat për të mbrojtur jetën private dhe mirëqenien e të miturve viktimë dhe dëshmitarë.²⁸
- Masa për drejtësi restaurues dhe kompensim të dënimit.²⁹

1.5 Organet kompetente në procesin e drejtësisë penale për të mitur

Përpara miratimit të Kodit organet si prokuroria dhe gjykata ishin të ndara në seksione të veçanta të cilat gjykojnë çështjet për të mitur. Po ashtu edhe strukturat e policisë që merren me të miturit është synuar të trajtohen në mënyrë të veçantë. Me miratimin e Kodit, kreu IV i kushtohet totalisht organeve kompetente dhe masat që ato duhet të marrin për të siguruar që personat të cilët punojmë me këtë kategori moshe të kenë njohuritë e nevojshme, formimin specific, ndërgjegjësim profesional të lartë si dhe të marrin masat e duhura për qëndrueshmërinë e tyre në këtë pozicion. Përsa i përket kompetencës së gjyqimit të çështjeve të drejtësisë për të miturit kodi parashikon se: i mituri në konflikt me ligjin gjykohet nga seksionet për të mitur, të krijuara në gjykatat e rretheve gjyqësore, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë. Seksionet janë kompetente edhe për gjykimin e të pandehurve të rritur që akuzohen për kryerjen e veprave penale ndaj të miturve si viktimë. Gjyqtari i caktuar për gjykimin e të miturit në këto seksione duhet të jetë i specializuar dhe trajnuar për drejtësinë penale për të mitur.³⁰

Një risi e Kodit është përcaktimi i numrit të trupit gjykues të cilët duhet të jenë të specializuar posaçërisëht për të mitur si në rastet kur është në konflikt me ligjin ashtu edhe kur ai është viktimë. Në gjykatat e rretheve gjyqësore, në të cilat, për shkak të numrit të gjyqtarëve nuk mund të ngrihet seksioni për të mitur, kur çështja gjykohet nga tri gjyqtarë, të paktën njëri prej tyre duhet të jetë gjyqtarë i specializuar dhe trajnuar në drejtësinë penale për të mitur.³¹

Po ashtu edhe ndjekja penale në çështjet e drejtësisë penale për të mitur bëhet nga prokurorë dhe punonjës të policiasë gjyqësore të trajnuar dhe specializuar në

²⁵ Po aty neni 40

²⁶ Po aty neni 41

²⁷ Po aty neni 42

²⁸ Po aty neni 43

²⁹ Po aty neni 44/45

³⁰ Neni 27 “Kodi i Drejtësisë për të Mitur”

³¹ Po aty, Neni 28

këtë fushë. Specializim kodi parashikon edhe për punonjësit e policisë së shtetit. Risi interesante e kodit përbën edhe përgatitja e avokatëve të specializuar dhe të njohur nga Dhoma Kom-bëtare e Avokatëve të specializuar për të miturit.

1.6 Shmangia nga ndjekja penale dhe nga dënimi përmes masave alternative

Sistemi i drejtësisë penale për të mitur duhet të jetë i orjentuar drejt qëllimit të edukimit dhe rehabilitimit të të miturit, si dhe zhvillimit të tij. Ky qëllim mund të zbatohet në mënyrë të suksesshme vetëm nëse reflektohet në natyrën dhe llojin e sanksioneve që aplikohen ndaj të miturit.³²

Sipas nenit 1 të KDF do të konsiderohet fëmijë çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç.

Në analizën e neneve të kodit vihet re përdorimi për herë të parë i konceptit “*shmangies nga ndjekja penale*” dhe dënimi përmes masave alternative. “*Shmangia*” është përjashtimi i të miturit në konflikt me ligjin nga procedimi penal nëpërmjet zhvillimit dhe zbatimit të procedurave dhe programeve të cilat synojnë minimizimin e efekteve negative që mund të shkaktojnë tek të miturit procedurat hetimore dhe gjyqësore ndaj të miturit, me qëllim mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të të miturve.

Organi kompetent, në marrjen e vendimit për zbatimin e masës së shmangies nga ndjekja penale vlerëson interesin më të lartë të të miturit, rëndësinë e veprës penale të kryer dhe dënimin e parashikuar për atë vepër, moshën e të miturit, shkallën e fajësisë, dëmin e shkaktuar, efektin frikësues të ndjekjes penale, sjelljen e të miturit pas kryerjes së veprës penale, si dhe raportin e vlerësimit individual.³³ Masës e shmangies kërkohet nga prokurori deri në momentin para se të ketë filluar shqyrtimi gjyqësor i çështjes. Zbatimi i masës së shmangies mund të vendoset, sipas rastit, edhe nga gjykata.

Masat alternative për shmangien nga ndjekja penale mund të përfshijnë:

- programet e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit;
- këshillimin për të miturin dhe familjen;
- paralajmërimin me gojë;
- paralajmërimin me shkrim;
- masat detyruese;
- vendosjen nën kujdes.

Ndaj të miturit mund të zbatohen në të njëjtën kohë disa masa nga ato të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.³⁴

³² Xhafo.J “I mituri dhe procesi penal”, Monografi, shtëpia botuese “Geer” fq 97

³³ Po aty, Neni 55/2

³⁴ Neni 62 “Kodi i Drejtësisë për të Mitur”

Gjatë procesit hetimor Kodi synon që të miturit ti sigurohen garanci procedurale me qëllim që të mbrohen maksimalisht të drejtat e tij.

1.7 Dënimi dhe llojet e tij

Qëllimi i dënimit të të miturit është rishoqërizimi, riintegrimi, rehabilitimi dhe parandalimi i rikryerjes së veprës penale ose i kryerjes së një vepre tjetër penale, duke i ofruar të miturit kujdes, asistencë dhe mbikëqyrje.³⁵Filozofi i lashtë grek Platoni, qëllimin e dënimit e ka përcaktuar në këtë mënyrë “Kush ndëshkohet në mënyrë të drejtë duhet të bëhet i mirë dhe të përfitojë nga dënimi, ose ai duhet të bëhet shembull për të tjerët.Kështu ata do të shikojnë çfarë ai vuan dhe do të frikësohen të vuajnë edhe ata” Pra qëllimi që një person të privohet nga liria është që ai të riedukohet, risocializohet, të bëhet i dobishëm për rrethin familjar, dhe kur të lirohet të jetë më i përgjegjshëm për veprimet e tij në të ardhmen.

Gjatë gjithë procesit të marrjes së vendimit, gjykata, mban në konsideratë se dënimi me burgim i të miturit është mjeti i fundit i mundshëm, i cili konsiderohet vetëm nëse masat e shmangies, të parashikuara në kreun VII, të këtij Kodi, janë të papërshtatshme.³⁶

Dënimet ndaj të miturit klasifikohen në dënime kryesore dhe plotësuese. Janë dënime kryesore: si burgimi, kufizimi i lirisë dhe gjoba.

Janë dënime plotësuese: ndalimi për kryerjen e një veprimtarie; kryerja e një pune me interes publik; përmbushja e detyrimeve të caktuara dhe qëndrimi në shtëpi.

Ndaj të miturit mund të jepet vetëm një dënim kryesor. Dënimi kryesor mund të jepet së bashku më jo më shumë se një dënim plotësues. Bashkë me dënimin mund të jepen një ose disa masa të parashikuara nga kreu VII i këtij Kodi.

2. KODI I DREJTËSISE PËR TË MITUR I KOSOVËS

Sa i përket mënyrës së organizimit të drejtësisë penale për të mitur në Kosovë do të vëmë re se Kosova ka qënë avangard krahasuar me ne, pasi me 20 prill 2004 në Kosovë hyri në fuqi “Ligji Penal për të Mitur i Kosovës”.³⁷

Në dispozitën e nenit 1 të Ligjit Penal për të Mitur (LPM) janë dhënë parimet udhëzuese, që janë parime plotësuese të parimeve të përgjithshme të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, dhe Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës. Dispozitat e kapitujve I-IX të LPM kanë të bëjnë me të drejtën materiale penale, dispozitat e kapitujve X- XV për procedurën, dispozitat e kapitullit XVII për ekzekutimin e masave edukative, dispozitat e kapitullit XVIII për ekzekutimin e denimeve, dispozitat e kapitullit XIX për ndihmën që duhet dhënë të miturit pas

³⁵ Po ty Neni 93

³⁶ Po aty Neni 94/1

³⁷ Ligji “Mbi ekzekutimin e sanksioneve penale” Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut 2004/46

ekzekutimit të masave edukuese institucionale, ose burgimit për të mitur, kapitull XX për ekzekutimin e masave për trajtimin e detyrueshëm për rehabilitimin ose trajtimin psikiatrik të detyrueshëm, dhe kapitulli XXI për gjykimin e autorëve madhorë të veprave penale të kryera ndaj të miturve. Qëllimi i drejtësisë për të mitur përcaktohet i atillë që të sigurojë mirëqenien e të miturve dhe që masat dhe dënimet e shqiptuara të miturve të jenë në proporcion me nevojat për largimin nga rruga e kriminalitetit dhe edukimi i tyre.³⁸

Ky ligj për herë të parë i nxori të miturit nga legjislacioni penal i cili u atribuohet personave madhorë që kryejnë një vepër penale. Pas 5 vitesh ky ligj ju nënshtrua ndryshimeve dhe plotësimeve të caktuara përfshirë këtu edhe çështjen e emërimit dhe tashme ai njihet si :” Kodi i drejtësisë për të mitur”. Ky kod vuri bazat e një sistemi të ri penal, procedural dhe penalogjik për të mitur në përputhje me sistemin e ri politik dhe standartet demokratike ndërkombëtare në këtë fushë.³⁹

2.1 Karakteristika të përgjithshme të Kodit

Për shkak të veçorive sociologjike, psikologjike, juridike etj, sistemi i drejtësisë për të mitur trajtohet i diferencuar nga ai për personat madhorë. Numri i të miturve të përfshirë në krim ka pësuar vazhdimisht rritje, dhe kjo dukuri nuk vihet re vetëm në vendet me zhvillim me të ulët ekonomik dhe shoqëror por dhe tek ato më të zhvilluara. Aktualisht lufta më e madhe zhvillohet në hartimin e politikave edukative të cilat mundësojnë zhvillimin pozitiv të personalitetit të të miturit, zgjidhjen e problemeve sociale dhe dhe familjare, aftësitë e tyre profesionale dhe garantimin e prespektivave të tyre.

Nëse i bëjmë një vështrim legjislacionit në fuqi të Kosovës do të vihet re se ky legjislacion sa i përket të miturve përfaqëson koncepte bashkëkohore si në aspektin juridiko penal ashtu dhe në pjesën procedurale dhe të ekzekutimit të dënimeve.

Ky Kod rregullon procedurën e shqiptimit dhe ekzekutimit të masave dhe dënimeve ndaj të miturve, procedurën gjyqësore si dhe procedurën e ndërmjetësimit për të mitur.⁴⁰

Parimet mbi të cilat mbështete ky kod janë parime që përbëjnë bazën e së drejtës penale material, procedurale dhe të ekzekutimit sic janë:

- Parimi i mirqënies dhe proporcionalitetit
- Parimi i proklamimit dhe shqiptimit të masave të diversitetit
- Parimi i zbatimit të privimit të lirisë së të miturit si mjet i fundit dhe për kohë sa më të shkurtër
- Parimi i të shprehurit lirisht

³⁸ “Komentar për ligjin penal për të mitur” Rexhep Haxhimusa, Ismet Kabashi

³⁹ Hajdari. A “Sistemi i drejtësisë për të mitur” Komentar, Prishtinë 2010, fq 3

⁴⁰ Neni 1 Kodi Nr. 03/L-193 i Drejtësisë për të mitur

- Parimi i humanizmit
- Parimi i ndihmës ligjore dhe kundërshtimit të privimit të lirisë
- Parimi i respektimit të privatësisë

2.2 Masat dhe dënimet e zbatueshme

Ky kod parashikon një numër të madh të masave cilat zbatohen ndaj personave të mitur që kryejnë një vepër penale. Masat që mund të zbatohen janë masat e diversitetit dhe masat edukative. Qëllimi i këtyre masave konsiston në tërheqjen e vërejtjes ndaj të miturit për faktin e kryerjes së veprës penale dhe trajtimi i tyre me qëllim rehabilitimin dhe edukimin dhe zhvillimin e të miturit. Disa prej masave kanë karakter institucional dhe e veçojnë kryersin e mitur nga mjedisi familjar dhe social. Përveç masave të diversitetit dhe masave edukative, për kryersit e mitur të veprës penale ligjvënësi ka parashikuar dhe dënime të caktuara.⁴¹ Dënimet që mund të shqiptohen ndaj të miturve janë: gjoba, urdhri për punë në dobi të përgjithshme dhe burgimi për të mitur.⁴²

Kodi bën një diferencim midis kategorive të të miturve, disi të ndryshëm nga Kodi ynë duke i specifikuar kategoritë e të miturve:

Ndërkohë që ne përcaktojmë si të mitur persona nën 18 vjeç dhe “i ri” personat 18-21 vjeç.

I mitur - personi ndërmjet moshës katëmbëdhjetë (14) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet

I mitur i ri - personi ndërmjet moshës katëmbëdhjetë (14) dhe gjashtëmbëdhjetë (16) vjet.

I mitur i rritur - personin ndërmjet moshës gjashtëmbëdhjetë (16) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet.

Madhor i ri - personi ndërmjet moshës tetëmbëdhjetë (18) dhe njëzetënjë (21) vjet. Kjo është një fazë midis të miturit dhe personit totalisht të përgjegjshëm. Ky legjislacion i kushton një vëmendje specifike kësaj kategorie duke i dhënë një pozitë më të favorshme se personat madhorë. Ligji sheh mundësinë që dhe ndaj kësaj kategorie të zbatohen masat e diversitetit, masatet edukuese dhe dënimet për të mitur.

Ashtu si në legjislacionin tonë edhe ai i Kosovës njeh ndërmjtësimin si institute penal material dhe procedural që është në funksion të zgjidhjes së çështjeve penale me një procedurë jashtëgjyqësore.

2.3 Masat e diversitetit

Masat e diversitetit paraqiten si masa të veçanta të cilat parashikohen në legjislacionet e shteteve bashkëkohore. Keto masa ju rreferohen kryersve të mitur të

⁴¹ Hajdari. A “Sistemi i drejtësisë për të mitur” Komentar, Prishtinë 2010, fq 25

⁴² Neni 7/2 Kodi Nr. 03/L-193 i Drejtësisë për të mitur

veprës penale. Ato mbështetn në rekomandimet e Tokios dhe Pekinit. Ato përfshijnë një kategori masash më të lehta që zbatohen ndaj kryerësve të mitur. Kohëzgjatja e këtyre masave lidhet në cmimin e gjykatës duke marrë në konsideratë interesin më të madh të të miturit.

Qëllimi i masave të diversitetit është që të parandalojë, kur është e mundur, fillimin e procedurës ndaj kryerësit të mitur, të ndihmojë rehabilitimin pozitiv dhe riintegrimin e të miturit në bashkësinë e tij me qëllim të parandalimit të sjelljes recidiviste.⁴³

Masa e diversitetit mund të shqiptohet ndaj të miturit i cili ka kryer vepër penale për të cilën është paraparë dënim me gjobë apo me burgim deri në tri vite ose për vepër penale të kryer nga pakujdesia për të cilën është paraparë dënimi deri në pesë vite burgim, me përjashtim të atyre të cilat sjellin si pasojë vdekjen.

Kushtet për shqiptimin e masës së diversitetit janë: pranimi i përgjegjësisë për veprën penale nga i mituri; shprehja e gatishmërisë nga i mituri që të pajtohet me palën e dëmtuar dhe pëlqimi i të miturit ose i prindit, prindit adoptues ose kujdestarit në emër të të miturit për të zbatuar masën e shqiptuar të diversitetit.

Masat e diversitetit që mund të shqiptohen ndaj kryerësit të mitur janë: pajtimi në mes të kryerësit të mitur dhe palës së dëmtuar, duke përfshirë edhe kërkim faljen nga i mituri ndaj palës së dëmtuar, pajtimi ndërmjet të miturit dhe familjes së tij kompensimi i dëmit palës së dëmtuar në bazë të marrëveshjes së ndërsjellë ndërmjet të dëmtuarit, të miturit dhe përfaqësuesit të tij ligjor, në përputhje me situatën financiare të të miturit vijimi i rregullt në shkollë, pranimi i punësimit apo aftësimin në një profesion adekuat me aftësitë dhe shkathtësitë e tij, kryerja e punës pa pagesë në dobi të përgjithshme në pajtim me aftësinë e kryerësit të mitur për kryerjen e punës së tillë. Kjo masë mund të shqiptohet me pëlqimin e të miturit në kohëzgjatje prej dhjetë deri në gjashtëdhjetë orë, edukimi në rregullat e trafikut, dhe këshillimi psikologjik.⁴⁴

2.4 Masat edukative

Krahës masave të diversitetit kodi njeh dhe masat edukative të cilat përfaqesojnë llojin kryesor të sanksioneve penale që jepen ndaj të miturve që kryejnë një vepër penale. Këto masa ndikojnë në rehabilitimin mbrojtjen ndihmën dhe edukimin e të miturit delikuent madje në pjesën më të madhe të rasteve pa i izoluar nga mjedisi i deri atëhershëm familjar dhe shoqëror.

Kodi i drejtësisë për të mitur i njeh tre lloje të masave edukative të cilat mund t'i shqiptohen të kryerësit të mitur, si të tilla janë masat disiplinore, masat e mbikëqyrjes së shtuar dhe masat institucionale⁴⁵

⁴³ Neni 16 Kodi Nr. 03/L-193 i Drejtësisë për të mitur

⁴⁴ Neni 18 Kodi Nr. 03/L-193 i Drejtësisë për të mitur

⁴⁵ Neni 20 paragrafi 1 Kodi Nr. 03/L-193 I Drejtësisë për të mitur

2.5 Sistemi i dënimeve

Dënimet që mund të shqiptohen ndaj të miturve janë: gjoba, urdhri për punë në dobi të përgjithshme dhe burgimi për të mitur, qortimi gjyqësor, dërgimi në qendër disiplinore, mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit, adoptuesit ose kujdestarit, mbikëqyrja e shtuar nga familja tjetër, mbikëqyrja e shtuar nga organi i kujdestarisë.

Gjykata gjithashtu ndaj të miturit mund të shqiptojë këto detyrime të veçanta: sic mund të jenë personalisht t'i kërkojë falje palës së dëmtuar, palës së dëmtuar t'ia kompensojë dëmin në pajtim me gjendjen financiare të të miturit, të vijojë rregullisht shkollimin, të pranojë punësimin ose të aftësohet për një profesion i cili i përshtatet shkathtësive dhe aftësive të tij, të përmbahet nga çfarëdo kontakti me individë të caktuar që mund të kenë ndikim negativ tek i mituri, të pranojë këshilla psikologjike; të mos vizitojë vende ose mjedise të caktuara që mund të kenë ndikim negativ tek i mituri dhe të përmbahet nga përdorimi i drogës dhe i alkoolit.

2.6 Masat edukative institucionale

Masat edukative institucionale janë masa që u shqiptohen kryerësve të mitur të veprave penale ndaj të cilëve duhet të ndërmerren masa më afatgjate të edukimit nga institucionet e specializuara në këtë fushë. Vendosja e personave të mitur në ente dhe institucione të veçanta arsyetohet edhe me faktin se ambienti i deritanishëm ka pasur ndikim negativ dhe vlerësohet se është e domosdoshme që ata të largohen edhe në mënyrë fizike për një kohë të caktuar nga ai ambient, me qëllim të eliminimit të ndikimeve të tilla dhe krijimit të shprehive e vetive të reja konstruktive.⁴⁶

Masa të tilla institucionale janë dërgimi i të miturit në institucion edukues, dërgimi i të miturit në institucion edukues korrektues dhe dërgimi i të miturit në institucion të kujdesit të posaçëm.

Masën edukative dërgim në institucion edukativ gjykata e vendos kur del në përfundim se edukimi dhe riedukimi i të miturit delinkuent nuk mund të arrihet pa ndarjen e plotë të të miturit nga mjediset ku jeton dhe vepron dhe pa ndërmarrjen e masave afatgjate edukuese dhe riedukuese. Shërbimi sprovues i Kosovës ka një rol kyç në ekzekutimin e kësaj mase, ngaqë është mbikëqyrëse e ekzekutimit të kësaj mase.⁴⁷

Dërgimi në institucionin edukativo-korrektues është masa më e rëndë në kodin e drejtësisë për të mitur, e cila vendoset ndaj kryerësve të mitur të veprave penale ndaj të cilët është e nevojshme ndërmarrja e masave dhe trajtimit më të specializuara nga institucionet edukative. Institucioni edukativo-korrektues u ofron

⁴⁶ Liridon Maloku, Ekzekutimi i masave edukative, Revista shkencore "Justica", nr.1/2012, Prishtinë, 2012, f.337

⁴⁷ Taulant Bajrami "Masat ndaj të miturve delikuentë në Kosovë" C E N T R U M 7 fq 301

të miturve mbrojtje, ndihmë dhe mbikëqyrje të specializuar nga profesionistët me qëllim të riedukimit dhe arsimimit të suksesshëm të tyre.⁴⁸

Masa edukative e dërgimit në institucionin për kujdes të posaçëm zbatohet ndaj personit të mitur i cili ka kryer vepra penale për shkak të çrregullimeve të tij biopsikike dhe kur kjo është në interesin më të mirë të të miturit. Çdo i mituri i cili vuan nga sëmundjet mendore apo nga paaftësi të tjera fizike e psikike, duhet të shërohet në një institucion të specializuar, nën drejtimin e pavarur mjekësor. Para vendosjes të kësaj mase gjykata kërkon rekomandimin e ekspertit të mjekësisë së kjo masë është e nevojshme për trajtimin e të miturit.

Kodi njeh si dënimë kryesore, rë sastët kur është e pamundur të zbatohet ndonjë nga dënimet alternative, gjoba dhe urdhëri për punë në dobi të përgjithshme si dhe burgimi për të mitur

2.7 Grancitë procedurale të të miturve

Sa i përket trajtimit procedural të miturit vihen në një pozitë më të favorshme. Kjo për shkak të elementit moshë por dhe një sërë specifikash që lidhen me persona e mitur. Vihet theksi në veprimin urgjent gjatë procesit të marrjes në pyetje dhe gjykim në mënyrë urgjente të të miturit në paraburgim dhe cdo instance tjetër gjyqësore. Një vëmënde të vecantë Kodi i kushton analizës së procedurave që ndiqen në rast së të miturit janë nën 14 vjec. Cështjet penale për të mitur shqyrtohen dhe vendosen në përbërje individuale dhe kolegjiale. Në përbërjen individuale vepron gjyqtari i vetëm që është gjyqtar për të mitur. Trupi gjykues për të mitur në gjykatën e shkallës së parë dhe trupi gjykues për të mitur në gjykatën e shkallës së dytë, me përjashtim të kolegeve në Gjykatën Supreme të Kosovës, përbëhet nga një gjyqtar për të mitur dhe dy gjyqtarë porotë. Gjyqtari për të mitur është kryetari i trupit gjykues. Gjyqtarët porotë në trupin gjykues për të mitur emërohen nga mes i profesorëve, arsimtarëve, edukatorëve, punëtorëve socialë, psikologëve dhe personave të tjerë që kanë përvojë në edukimin e të miturve. (praktikë kjo që nuk zbatohet në legjislacionin tone).

2.8 Shqyrtimi gjyqësor lidhur me procedurën gjyqësore që përfshijnë veprën penale të kryera ndaj fëmijëve

Krahës dispozitave të procedurës penale në Kod janë parashikuar një sërë garancish të cilat synojnë mbrojtjen optimale të fëmijëve jo vetëm gjatë zhvillimeve procedurale por edhe gjatë ushtrimit të shërbimit të provës por dhe organit të kujdestarisë. Si rregull procedura penale ndaj kryersve madhore të veprave penale zhvillohen sipas K.Pr.P. por kur bëhet fjalë për disa vepra të kryer ndaj të miturve me të cilat është cënuar rëndë morali dinjiteti dhe zhvillimi i fëmijëve. Në raste të tilla gjykimi i personave madhore do të bëhet nga trup gjykues për të mitur apo gjyqtarë për të mitur.

⁴⁸ Taulant Bajrami “Masat ndaj të miturve delikuentë në Kosovë” C E N T R U M 7 fq 301

REKOMNADIME

Kur flasim për përfundime apo rekomandime që mund të nxjerrim nga analiza e lartpërmendur shohim që problematikat e hasura si në Shqipëri dhe në Kosovë janë përafërsisht të njëjta dhe masat parandaluese po ashtu.

Ne jemi të mendimit se masat që duhet të ndërmeren për parandalimin e kriminalitetit të të miturve duhet të ndahen në dy kategori kryesore: Së pari janë masat edukative. Lufta më e madhe duhet të zhvillohet në hartimin e politikave edukative të cilat mundësojnë zhvillimin pozitiv të personalitetit të të miturit, zgjidhjen e problemeve sociale dhe familjare, aftësitë e tyre profesionale dhe garantimin e prespektivave të tyre. Duhet të synohet parandalimi i kriminalitetit përpara se të shkojmë tek mënyra e trajtimit të kontigjentit të miturve në konflikt me ligjin. Kjo realizohet nëpërmjet synimit të arsimit të plotë të të miturve dhe monitorimit të vazhdueshëm të sistemit arsimor. Të ndiqen politika sociale për të mitur të komuniteteve të vecanta të cilat kanë problematika për arsimimin siç mund të jenë komunitetet rome apo egjiptiane apo femijët e rrugës. Të ndiqen politika favorizuese për të rinjtë për punësimin dhe integrimin ekonomik të tyre. Mbështetja familjare dhe skemat financiarë në favor të famileve në nevojë me vështirësi ekonomike si dhe të trajtohen programe sociale argetuese dhe sportive .

Por krahas masave sociale një rol të rëndësishëm luajnë hartimi i politikave legjislative dhe respektimi si duhet i ligjit. Së pari duhet të synohet të gjejë zbatim të plotë në praktikë Kodi i drejtësisë për të mitur. Ti jepet përparësi shanges nga ndjekja penale apo nga dënimi për vepra me rezikshmëri të ulët shoqërore. Ti kushtohet rëndësi prioritare eliminimit të vonësve gjatë hetimit dhe gjyqimit të çështjes, reduktimit të paraburgimit dhe burgimit dhe rritjen e përdorimit të alternativave të dënimit. Rritja e ndërgjegjësimit të përmirësimit të vazhdukshëm të viktimave të dhunës në familje dhe krim. Si dhe të sigurohet një mbrojtje e veçantë për dëshmitarët e mitur. Element i rëndësishëm është krijimin e strukturave të specializuara institucionet e drejtësisë penale, të pajisura me kapacitetet, infrastrukturen si dhe burimeve e nevojshme (financiare ashtu edhe njerezore) përgjegjëse për trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin Zhvillimin e programeve të trajnimit për përfaqësuesit e institucioneve të sistemit të drejtësisë penale (prokurore, gjyqtare, punonjes të sherbimit të provës dhe administrates së burgjeve) në lidhje me të drejtat e femijeve dhe trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin.

Dhe se fundi, riintegrimi i të miturve pasi ata kanë kryer dënimi në shoqëri. Dhe kujdes i veçantë që mos shndërohet në një recidivist. Kjo duhet të realizohet përmes riedukimit trajtimit dhe punesimit.

BIBLIOGRAFI

- I. Kodi i Drejtësisë për të mitur i Republikës së Shqipërisë
- II. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
- III. Kodi I Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë
- IV. Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2012. VII.
- V. Kodi i drejtësisë për të mitur i Kosovës, Prishtinë, 2010.
- VI. Relacion per projektligjin “Kodi i drejtesise per te miturit ne Republikën e Shqiperise”
- VII. Xhafo.J “I mituri dhe procesi penal”, Monografi, shtëpia botuese “Geer”
- VIII. Azem Hajdari, Sistemi i drejtësisë për të mitur, Prishtinë, 2010 II.
- IX. Ismet Salihu , E drejta penale për te mitur, Prishtinë, 2005
- X. III. Ismet Salihu: E drejta penale - Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2015.
- XI. Revista shkencore “Justica”, nr,1/2012, Prishtinë, 2012 VI.
- XII. Ligji “Mbi ekzekutimin e sanksioneve penale” Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut 2004/46
- XIII. Komentar për ligjin penal për të mitur”Rexhep Haxhimusa,Ismet Kabashi
- XIV. Liridon Maloku, Ekzekutimi i masave edukative, Revista shkencore “Justica”, nr,1/2012, Prishtinë, 2012,
- XV. Taulant Bajrami “Masat ndaj të miturve delikuentë në Kosovë”

C E N T R U M 7

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE TË SHOQËRIVE TREGTARE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA

Dr. Armela KROMIÇI

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë,
Departamenti i së Drejtës Civile
armelakromici@fdut.edu.al

ABSTRAKT

Ligji nr. 70/2017, datë 27.4.2017 ka ndryshuar aspekte thelbësore të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”. Kjo reformë shprehimisht ka parashikuar se, nëse ekziston një nivel i pajustificuar ekonomik si rezultat i veprimtarisë së dyshuar kriminale, kuotat, aksionet dhe pasuritë e shoqërive tregtare mund të sekuestrohen apo të konfiskohen. Ky ligj dhe vendimi nr. 687, datë 5.10.2011 i ndryshuar me VKM-në nr.83, datë 8.2.2017, rregullojnë kompetencën e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK-së) për administrimin dhe ruajtjen e pasurive të vendosura nën masa parandaluese. AAPSK-ja mund të administrojë drejtpërsëdrejti, apo të japë me qira të tretëve, pasuritë e sekuestruara nëse vlerëson se marrja e këtyre masave mund të ruajnë dhe të shtojnë vlerën e tyre. Qëllimi i këtij punimi është analizimi i kompetencave të administratorëve të caktuar nga gjykata për administrimin e shoqërive tregtare si dhe trajtimin e problematikave që mund të lindin në praktikë nga zbatimi i legjislacionit në fuqi.

Fjalë kyçe: *shoqëri tregtare, përgjegjësi, sekuestrim/konfiskim, administrim*

1. Përgjegjësia penale e shoqërive tregtare

Ligjvënësi shqiptar, me ligjin nr. 9754 datë 14.06.2007, ka njohur dhe rregulluar përgjegjësinë penale për personat juridikë. Ky ligj shtrin efektet e tij edhe për shoqëritë tregtare të cilat fitojnë personalitetin juridik duke u regjistruar pranë QKB-së. Ligji në fjalë përcakton kriteret që ngarkojnë me përgjegjësi personin juridik dhe llojet e masave ndëshkuese, referuar veprës penale që i ngarkohet atij. Ky ligj vepron si një lex specialis dhe gjen zbatim për aq kohë sa mungon një rregullim specifik në dispozitat e Kodit Penal dhe në atë të Procedurës Penale.

Përgjegjësia penale e shoqërive tregtare lind kur vepra penale është kryer në emër ose në dobi të saj, drejtpërsëdrejti nga organet dhe përfaqësuesit e shoqërisë, ose në mënyrë të tërthortë nga një person i tretë, që vepron nën autoritetin e personit që e drejton apo e administron atë. Gjithashtu, shoqëria tregtare ngarkohet

me përgjegjësi penale edhe për shkak të mosveprimit të personit, që ka për detyrë ta kontrollë apo mbikqyrë atë .

Nga interpretimi literal dhe sistematik i dispozitave të Kodit Penal dhe i ligjit nr. 9754 datë 14.06.2007, “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë” vërejmë se mungon një rregullim i veçantë i veprave penale të cilat i ngarkohen personi juridik. Në parim, çdo veprë penale që i ngarkohet personit fizik, në të njëjtën mënyrë i ngarkohet edhe personit juridik. Përgjegjësia penale e personave juridikë në vendin tonë është e përgjithshme, pra teorikisht çdo veprë penale mund të kryhet edhe nga personi juridik, por ajo do t’i ngarkohet këtij të fundit, vetëm nëse përmbushen kushtet e përcaktuara në nenin 3 të Ligjit “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë” .

Përsëri, neni 25 i ligjit nr. 9754 datë 14.06.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë” përcakton se: ‘Ndaj personit juridik, që ka përgjegjësi për kryerjen e veprës penale, për aq sa është e mundur, zbatohen dispozitat procedurale penale për personin në hetim dhe të pandehurin’. Në këtë mënyrë, të gjitha masat parandaluese të parashikura dhe të rregullura në Kodin e Procedurës Penale, janë të zbatueshme edhe për personat juridik.

Mundësia për të vendosur masa parandaluese mbi shoqëritë tregtare parashikohet edhe në ligje të tjera të posaçme. Kështu, ligji nr. 157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit” parashikon vendosjen e masave parandaluese mbi fondet dhe pasuritë e personave që ushtrojnë veprimtari terroriste, apo të atyre personave kundrejt të cilëve ka dyshime të bazuara se mbështesin dhe financojnë këtë veprimtari. Ministri i Financave, ka kompetencë për të urdhëruar marrjen e masave për bllokimin e përkohshëm të fondeve dhe pasurive të personave për të cilët është në proces verifikimi përfshirja e tyre në veprimtari terroriste, deri sa këta persona të përfshihen në listën e shpallur nga Këshilli i Ministrave. Ndër të tjera, Ministri i Financave, mund të urdhërojë sekuestrimin e fondeve dhe pasurive të personave të shpallur nga Këshilli i Ministrave, apo të verifikuar nga organet përgjegjëse. Fondet dhe pasuritë e sekuestruara i kalojnë në administrim AAPSK-së. Kjo e fundit ka kompetenca administrimi mbi fondet dhe pasuritë e sekuestruara dhe ndërmerr të gjitha masat që konsideron të nevojshme për mirëmbajtjen e tyre. Për pasojë, edhe shoqëritë tregtare nëse janë krijuar në mbështetje të veprimtarive terroriste mund të sekuestrohen. Por me ligjin nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” i ndryshuar, procedura e vendosjes së masave parandaluese mbi shoqëritë tregtare dhe kalimi i tyre në administrim të AAPSK-së rregullohet në mënyrë të detajuar .

2. Sekuestrimi dhe konfiskimi i shoqërive tregtare sipas ligjit n.10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar

Gjykata e Shkallës së Parë ose Gjykata e Apelit në rastin e korrupsionit dhe të krimit të organizuar, me kërkesë të arsyetuar të prokurorit, vendosë sekuestrimin apo konfiskimin e shoqërive tregtare, kur ekziston një nivel i pajustificuar ekonomik si rezultat i veprimtarisë së dyshuar kriminale. Procedura e caktimit dhe e zbatimit të masave parandaluese sipas këtij ligji, është e pavarur nga gjendja apo përfundimi i procedimit penal që zhvillohet në ngakim të personave sipas pikës 3 të këtij ligji. Neni 6 i ligjit n. 10192, përcakton se prokurori verifikon, edhe nëpërmjet policisë gjyqësore, nëse këta persona janë zotërues të lejeve, licencave, autorizimeve, koncesioneve dhe të drejtave të tjera për të ushtruar veprimtari ekonomike, përfitimet e marra nga organet shtetërore apo nga persona të tjerë juridik publik, zotërimi i pasurive apo të ardhura që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara, etj.

Gjykata do të vendosë masën e sekuestrimit mbi pasuritë e personave që dyshohen si pjesëmarrës në organizata kriminale, brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së një kërkesë të arsyetuar nga prokurori . Kërkesa e prokurorit duhet të argumentojë ekzistencën e një rreziku real për humbje apo marrje apo tjetërsim të fondeve, pasurive apo të drejtave të tjera apo kur ekzistojnë dyshime të arsyeshme që tregojnë se zotërimi i pasurive dhe ushtrimi i veprimtarive tregtare është në gjendje rreziku apo ndikimi nga ana e një organizate kriminale apo mund të lehtësojnë veprimtaritë kriminale. Vendimi për masën e sekuestrimit është i ekzekutueshëm me shpalljen e tij. Masa e sekuestrimit është e vlefshme për një periudhë gjashtëmujore, duke filluar nga momenti i zbatimit të saj, por në rastet kur kërkohet një vlerësim më i detajuar, me kërkesë të prokurorit, por edhe gjykata ex officio, mund të ripërtërijë këtë afat për periudha gjashtëmujore, por jo më shumë se dy vjet nga data e fillimit të afatit të caktuar. Vendimi është ekzekutiv dhe i dërgohet në dy kopje prokurorit që ka paraqitur kërkesën. Është në kompetencën e prokurorit që të ekzekutojë vendimin nëpërmjet oficerit të policisë gjyqësore dhe administratorit të pasurive.

Ligji nr. 70/2017, datë 27.4.2017 ka ndryshuar rrënjësisht nenin 14 të ligjit n. 10192 datë 03.12.2009 duke listuar shprehimisht kuotat, aksionet dhe pasuritë e shoqërive tregtare ndër pasuritë e sekuestrueshme. Vendimi i sekuestrimit të pasurive të shoqërive tregtare duhet të regjistrohet në regjistrin tregtar të mbajtur nga QKB-ja, ndërsa sekuestrimi i kuotave/aksioneve regjistrohet në regjistrat kontabël të shoqërisë. Regjistrimi, pranë regjistrit tregtar, i vendimit të sekuestrimit të pasurisë bëhet për të informuar të tretët. Kjo dispozitë nuk parashikon detyrimin për të vendosur, në aktet e korrespondencës së shoqërisë, faktin që shoqëria është në sekuestrim sikurse parashikohet për shembull për likuidimin e shoqërive tregtare. Pasqyrimi i vendosjes së shoqërisë në sekuestro tek aktet e korrespondencës së saj do të përbente një garanci më shumë për të informuar të tretët me të cilët shoqëria ndërvepron, mbi faktin se mbi këtë shoqëri është vendosur një masë

parandaluese. Kjo për faktin se, të tretët që kanë marrëdhënie tregtare me shoqërinë jo gjithmonë konsultojnë regjistrin tregtar të mbajtur nga QKB-ja apo shoqëria mund të mbajë marrëdhënie me palë të treta jashtë vendit. Për këtë arsye, do të ishte e këshillueshme që vendosja e shoqërisë në sekuestrim të pasqyrohej edhe në aktet e korrespondencës të shoqërisë.

Gjykata do të vendosë masën e konfiskimit brenda 3 muajve nga data e paraqitjes së kërkesës së prokurorit. Një ndër risitë e sjella me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017, ka të bëjë me faktin se gjykata përpara se të lëshojë udhërin e konfiskimit duhet të dëgjojë edhe pretendimet e personave kundrejt së cilës kërkohet vendosja e konfiskimit. Këta të fundit do të kenë barrën e provës për të provuar se veprimtaritë tregtare dhe pasuritë e sekuestruara janë krijuar nga burime të ligjshme. Në këtë mënyrë, pas kryerjes së hetimit gjyqësor, garantohet e drejta e palës kundrejt së cilës kërkohet masa parandaluese të argumentojë pretendimet e saj. Personat fizikë ose juridikë, për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se pasuritë ose veprimtaritë e tyre zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të tërthortë nga personat mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm se kanë qenë pjesë e kriminit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit dhe rasteve të tjera të përcaktuara nga pika 1 e nenit 3 të këtij ligji, kanë barrën e provës për të provuar se veprimtaritë e tyre tregtare nuk zotërohen nga personat e listuar në pikën 1 të nenit 3 dhe asetet e shoqërisë nuk kanë ndikuar në lehtësimin e veprimtarisë së jashtëligjshme. Nëse çështja në gjykim paraqitet komplekse, gjykata edhe kryesisht, mund të vendosë mbi konfiskimin e veprimtarisë tregtare përtej afatit 3 muajor, por në çdo rast, duhet të vendosë brenda 1 viti nga data e kërkesës për konfiskim. Konfiskimi i shoqërisë tregtare kërkohet dhe vendoset edhe në rastet kur ndaj pasurive objekt gjykimi nuk është kërkuar dhe vendosur masa e sekuestrimit. Vendimi i konfiskimit vihet në ekzekutim menjëherë pas shpalljes së tij. Gjykata që ka vendosur masën e konfiskimit, ka të drejtë që gjatë ekzekutimit të konfiskimit, të nxjerrë, në dhomë këshillimi, urdhëra për kryerjen e veprimeve të posaçme apo të caktojë masa të tjera të nevojshme, duke përcaktuar afatet dhe procedurat që duhen respektuar. Vendimi dhe urdhërat për kryerjen e veprimeve të posaçme i përcillen pa vonesë prokurorit që procedon dhe mbikëqyr veprimet e ekzekutimit. Vendimi për konfiskim i dërgohet AAPSK-së dhe nëse është i formës së prerë, pasuria kalon në pronësi të shtetit në mënyrë të pakthyeshme. Nëse vendimi i konfiskimit prishet nga Gjykata e Lartë, atëherë pasuria i rikthehet zotëruesit. Ky i fundit ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim. E drejta për të kërkuar dëmshpërblim mungonte përpara reformës së vitit 2017. Rregullimi i kësaj të drejte shprehimisht në dispozitat e ligjit nr. 70/2017, datë 27.4.2017 është një hap pozitiv në ekuilibrimin dhe garantimin e të drejtave të personave, pasuria e të cilëve është konfiskuar padrejtësisht. Megjithatë, nëse pasuria e konfiskuar është një shoqëri tregtare, heqja e masës parandaluese dhe rikthimi i saj në gjendjen e mëparshme ka pak gjasa që të ndodhë. Kjo për faktin se vendosja e një mase parandaluese ndikon negativisht në imazhin e shoqërisë dhe

në marrëdhëniet e saj me të tretët. Gjithashtu, administratori nuk mund të kryej çdo veprimtari që konsideron të nevojshëm për ushtrimin e aktivitetit tregtar sepse për disa veprime juridike kërkohet një miratim paraprak nga gjykata. Kjo situatë mund të krijojë vonesa dhe vështirësi në ushtrimin normal të aktivitetit tregtar duke e ngadalësuar atë dhe duke ndikuar në të ardhmen e shoqërisë në treg. Për këtë arsye, gjykata duhet të vlerësojë me kujdes vendosjen në konfiskim të shoqërisë tregtare.

3. Kompetencat e administratorëve të AAPSK-së

Sikurse e përmendëm edhe më lart, gjykata me vendimin e sekuestrimit/konfiskimit të pasurisë, duhet të caktojë edhe një apo më shumë administratori nga lista e administratorëve të AAPSK-së. Kjo e fundit është një institucion në varësi të Ministrisë së Financave, por struktura dhe organika e saj miratohet me urdhër të Kryeministrit dhe me propozim të Ministrit të Financave. Rregullat për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e AAPSK-së caktohen nga Këshilli i Ministrave. Veprimtaria e kësaj agjencie mbikëqyret nga Komiteti Këshillimor Ndërinstitucional i Ekspertëve për masat kundër krimit të organizuar që mbliidhet pranë Ministrisë së Financave .

AAPSK-ja drejtohet nga kryeadministratori, i cili mbikëqyr dhe kontrollon administrimin e pasurive të sekuestruara/konfiskuara. Me vendimin nr. 687, datë 5.10.2011 të ndryshuar me VKM-në nr. 83, datë 8.2.2017, kryeadministratori mban statusin e nënpunësit civil. Është detyrë e tij të paraqesë në gjykatë listën e administratorëve që përmbushin kriteret ligjore dhe janë trajnuar nga AAPSK-ja për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Gjithashtu, është përgjegjësi e kryeadministratorit raportimi në Ministrinë së Financave. Kryeadministratori, përfaqëson AAPSK-në dhe negocion lidhjen e kontratave të qirasë, huapërdorjes dhe enfitozës për pasuritë në administrim. Ndër të tjera, kryeadministratori ka tagrin e përfaqësimit të autoritetit kontraktor në procedurat e prokurimit publik. Një tjetër kompetencë e rëndësishme e kryeadministratorit ka të bëjë me ngritjen e komisioneve për vlerësimin e çmimit me të cilin do të jepen me qira apo do të shiten pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara.

Një figurë tjetër e rregulluar në vendimin nr. 687, datë 5.10.2011 është ajo e administratorit koordinator. Ky i fundit vepron si një urë lidhëse ndërmjet administratorit të pasurive të sekuestruara/konfiskuara dhe kryeadministratorit. Ai verifikon mirëmbajtjen edhe administrimin e pasurive mbi të cilat është vendosur masa parandaluese, si dhe kontrollon raportet e përgatitura nga administratorët e pasurive përpara se të paraqesë këto akte tek kryeadministratori. Në bazë të propozimeve të bëra nga administratorët e pasurive, administratori koordinator, i rekomandon kryeadministratorit që administrimi i pasurive të bëhet nëpërmjet administrimit të drejtpërdrejtë apo me anë të të tretëve .

Kryeadministratori, në cilësinë e përfaqësuesit të AAPSK-së, të paktën 1 herë në vit, i vë në dispozicion gjykatës, listën e administratorëve dhe tregon kriteret

e përzgjedhjes së tyre. Veçanërisht, nëse pasuritë e sekuestruara/konfiskuara janë shoqëri tregtare, është e nevojshme që kriteret përzgjedhëse të administratorëve të jenë transparente dhe të kenë në fokusin e tyre eksperiencën në praktikë që këta persona zotërojnë në fushën e administrimit të shoqërive tregtare. Administratori, me emërimin e tij, merr në dorëzim pasurinë e sekuestruar nga policia gjyqësore së bashku me inventarin dhe përshkrimin e pasurisë. Ky dorëzim duhet të dokumentohet në një raport, i cili nënshkruhet nga të pranishmit. Nëse sekuestro është vendosur mbi një shoqëri tregtare, administratorit duhet t'i dorëzohen edhe regjistrat e llogarive të shoqërisë. Nëse ka mungesë dokumentacioni, atëherë administrator i kërkon AAPSK-së caktimin e një audituesi ligjor, i cili do të hartojë një raport mbi gjendjen financiare të shoqërisë. Me marrjen në dorëzim të pasurisë, mbi të cilën është vendosur masa parandaluese, administratori kryen një studim fizibiliteti mbi gjendjen e pasurisë dhe ia paraqet kryeadministratorit. Ky i fundit do të vendosë për mënyrën e administrimit dhe përkatësisht do të vlerësojë nëse pasuria e sekuestruar do të administrohet drejtpërsëdrejti nga AAPSK-ja apo do të jepet me qira, që të administrohet nga të tretët.

Neni 16 pika 1 e ligjit n. 10192 datë 03.12.2009 përcakton se: “Administratori ka për detyrë të ruajë dhe të administrojë pasurinë e sekuestruar. Gjithashtu ai ka për detyrë të rrisë, nëse është e mundur, vlerën e këtyre pasurive”. Nga interpretimi literal i kësaj dispozite vërehet se administratori me caktimin e tij duhet të vlerësojë se çfarë veprimesh do të ndërmarrë me qëllim ruajtjen dhe administrimin sa më të frytshëm të pasurisë. Nëse pasuria e sekuestruar është një shoqëri tregtare, administratori duhet të vlerësojë edhe nëse vazhdimi i aktivitetit tregtar do të ishte më i përshtatshëm për ruajtjen e pasurisë së shoqërisë. Në një shoqëri tregtare ndërthurren interesat e grupeve të ndryshme si punëmarrësit, kreditorët, nënkontraktorët apo ortakët dhe aksionarët që nuk kanë qenë në dijeni të shkeljeve të kryera nëpërmjet ushtrimit të aktivitetit tregtar të shoqërisë. Për këtë arsye, administratori i caktuar nga gjykata, në vendimmarrjen e tij duhet të ketë në konsideratë edhe interesin më të mirë të grupeve të sipërpërmendura. Në çdo rast, vendimi për të vazhduar ushtrimin e aktivitetit tregtar nëse kjo është e mundur, nuk është në diskrecion të tij. Administratori raporton përpara kryeadministratorit, gjykatës dhe prokurorit të çështjes. Gjithashtu, ligji qartësisht ka përcaktuar nevojën e autorizimit paraprak nga gjykata në rast se administratori në përmbushjen e detyrave të tij, vlerëson se është e nevojshme marrja e kredisë, nënshkrimi i marrëveshjeve të pajtimit si dhe të veprimeve të tjera juridike si dorëzania, hipotekimi ose tjetërsimi të pasurisë së sekuestruar, apo të kryejë veprime të tjera juridike administrimi jo të zakonshme. Neni 17 i ndryshuar me Ligji nr. 70/2017, datë 27.4.2017 ka përcaktuar rrugën që duhet të ndjekë administratori për të marrë autorizimin e gjykatës për të kryer veprimet e sipërpërmendura. Administratori, nëpërmjet AAPSK-së, i paraqet prokurorit një kërkesë të argumentuar, ku sqaron arsyet se përse duhet ndërmarrë një ndër veprimet e sipërpërmendura. Gjykata, me kërkesë të prokurorit, autorizon

veprimet e kërkuara nga administratori nëse vlerëson se këto veprime shërbejnë për të ruajtur vlerën e pasurisë. Reformulimi i kësaj dispozite nuk sqaron nëse administratori i pasurisë ka të drejtë t'i drejtohet drejtpërsëdrejti gjykatës, nëse prokurori refuzon kërkesën e tij apo e konsideron të pabazuar. Në mungesë të një rregullimi specifik do të mbetet për t'u parë në praktikë sesi do të veprojnë administratorët e AAPSK-së dhe sesi do të orientohet gjykata.

Administratori, duhet të raportojë në mënyrë periodike në gjykatë dhe të informojë atë mbi ecurinë e administrimit të pasurisë së sekuestruar. Administratori brenda 15 ditëve nga emërimi i tij duhet të raportojë përpara gjykatës për gjendjen në të cilën ndodhet pasuria e sekuestruar nëpërmjet inventarizimit të dokumentuar të pasurisë. Nëse gjatë verifikimit të pasurisë së sekuestruar, administratori konstaton ekzistencën e pasurive të tjera të cilat nuk janë nën sekuestrim, duhet pa vonesë të njoftojë gjykatën dhe prokurorinë. Përveç raportimit të parë, administratori raporton në mënyrë të vazhdueshme përpara gjykatës. Është detyrë e tij hartimi i raportit tekniko-financiar, brenda 90 ditëve nga marrja e njoftimit për vendimin e formës së prerë për konfiskimin e pasurisë. Raportet e paraqitura përpara gjykatës, administratori ia dërgon edhe prokurorit të çështjes dhe AAPSK-së. Gjithashtu ndryshimet e sjella me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017 kanë parashikuar të drejtën e gjykatës për të thirrur edhe kryesisht kryeadministratorin e AAPSK-së për t'u informuar mbi administrimin e pasurive të sekuestruara. Gjykata, në çdo kohë edhe kryesisht mund ta shkarkojë nga detyra administratorin për paaftësi apo mospërshtatshmëri të tij me detyrën e ngarkuar. Ndërkohë edhe prokurori, kryesisht apo me propozim të argumentuar të AAPSK-së, mund të kërkojë në çdo kohë në gjykatë shkarkimin e administratorit nga detyra .

4. Administrimi i shoqërive tregtare të sekuestruara dhe të konfiskuara

Në rastin e vendosjes së masës parandaluese mbi pasuritë e shoqërisë tregtare, administratori bashkë me studimin e fizibilitetit duhet t'i dorëzojë kryeadministratorit edhe planin e biznesit në të cilin përfshihen edhe të ardhurat dhe shpenzimet e parashikuara. Ndër risitë e sjella me reformën e 2017, përmendim faktin se tashmë procedurat e ndërmarra nga AAPSK-së përpara i përket kryerjes së shpenzimeve mbi administrimin e pasurive të sekuestruara/konfiskuara duhet të kryhen në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik .

Sikurse e përmendëm më lart, administratori ka detyrë jo vetëm të ruajë dhe të administrojë shoqërinë mbi të cilën është vendosur masa e sekuestrimit/konfiskimit por, nëse është e mundur, ai duhet të rrisë vlerën e këtyre pasurive. Vendimi nr. 687, datë 5.10.2011, "Për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e agjencisë së administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara" i ndryshuar, në pikën e), referuar menaxhimit të pasurisë në administrim përcakton se: "Në rastet e menaxhimit të drejtpërdrejtë zbatohen të gjitha procedurat ligjore në fuqi për funksionimin e një veprimtarie ekonomike në Republikën e Shqipërisë". Për

pasojë, nëse AAPSK-ja vendos të administrojë drejtpërsëdrejti shoqërinë tregtare të sekuestruar/konfiskuar do të gjejnë zbatim dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, i ndryshuar. Këto dispozita rregullojnë aktivitetin e tregtarit dhe aspektet që lidhen me themelimin dhe administrimin e shoqërive tregtare që operojnë në tregun tonë, por që nuk janë vendosur në sekuestro/konfiskim. Për këtë arsye, vendosja e një mase parandaluese mbi një shoqëri tregtare do të kërkonte një rregullim ad hoc. Ndërkohë, vendimi nr. 687, datë 5.10.2011, i ndryshuar i referohet kompetencave të administratorëve të pasurive të sekuestruara/konfiskuara në përgjithësi pa u ndalur në mënyrë specifike tek shoqëritë tregtare. Mungesa e dispozitave specifike mbi mënyrën sesi do të administrohen shoqëritë tregtare, kuotat/aksionet dhe pasuritë e të cilave janë nën sekuestrim/konfiskim mund të krijojnë probleme në praktikë. Kështu për shembull, ndërsa vendimi nr. 687, datë 5.10.2011, i ndryshuar përcakton se marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë rregullohen sipas parashikimeve të Kodit të Punës, dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare e karakterizojnë marrëdhënien e punës së administratorit si një marrëdhënie atipike pune. Kjo për faktin se nga performanca e administratorit varet vetë ecuria e shoqërisë në treg. Ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” ka përcaktuar një sërë parametrash për të vlerësuar punën e administratorit, dhe e ngarkon atë me përgjegjësi personale për dëmin që mund t’i shkaktojë shoqërisë. Por nga ana tjetër, këto përgjegjësi ekuilibrohen nga shpërblimi financiar që përfiton administratori për performancën e tij në shoqëri. Për këtë arsye, është e nevojshme që të koordinohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” me kriteret e shpërblimit të përcaktuara për administratorit të shoqërive të vendosura në sekuestrim nëse AAPSK-ja.

Përsëri, administratori i shoqërive tregtare duhet të evitojë ushtrimin e aktivitetit të tij në konflikt me shoqërinë apo të kryej veprimtari në konkurrencë me shoqërinë në të cilën është i punësuar. Neni 13 i ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, përcakton se personi i autorizuar për të përfaqësuar shoqërinë nuk mund të lidhë kontrata në kushtet e konfliktit të interesit. Por nga ana tjetër, ky ndalim shfuqizohet nëse ai deklaron kushtet e veprimit, natyrën e objektin e interesit të tij dhe veprimi autorizohet, paraprakisht tek shoqëritë e personit dhe shpk-ja nga të gjithë ortakët dhe tek sha-ja nga këshilli (i administrimit apo mbikëqyrës, në varësi të modelit qeverisës që ka zgjedhur shoqëria). Ndërsa neni 17 i ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” ndalon administratorin që të ushtrojë një aktivitet në konkurrencë me atë të shoqërisë që administron. Por edhe kjo dispozitë rregullon mundësinë e shfuqizimit të këtij ndalimi nga të gjithë ortakët tek shoqëritë e personit, dhe me një vendim me shumicë të cilësuar të votave të vlefshme që përfaqësojnë më shumë se 50% të kapitalit të shoqërisë tek shoqëritë e kapitalit. Për këtë arsye, si dhe duke patur në konsideratë natyrën e detyrës të administratorit të emëruar nga AAPSK-ja, do të ishte më e përshtatshme që ndalimi i konfliktit të interesit dhe ndalimi i konkurrencës të gjejnë zbatim pa lejuar mundësinë e shfuqizimit të tyre, sikurse përcaktojnë dispozitat e sipërpërmendura.

Nevoja për koordinim të dispozitave të legjislacionit tregtar me atë penal prek edhe mbrojtjen e të drejtave të grupeve të ndryshme të interesit. Për ilustrim, kujtojmë se ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar i garanton ortakëve/aksionarëve të pakicës dhe kreditorëve të shoqërisë që pretendojnë se shoqëria ka ndaj tyre detyrime në një vlerë jo më të vogël se 5% e kapitalit të shoqërisë, të kërkojnë shfuqizimin e vendimeve të administratorit që janë në shkelje të rëndë të ligjit dhe të statutit. Nëse pasuria e shoqërisë tregtare do të ishte vendosur në sekuestrim, sipas pikës e) të vendimit nr. 678, datë 05.10.2011 i ndryshuar, këto grupe interesi kanë të drejtë të kundërshtojnë edhe vendimet e administratorit të emëruar nga lista e AAPSK-së. Por lind pyetja, cila do të jetë gjykata kompetente për të shqyrtuar pretendimet e kreditorëve dhe të ortakëve/aksionarëve të pakicës? Kompetenca do të jetë e seksionit tregtar të gjykatës ku e ka selinë shoqëria apo e gjykatës që ka vendosur sekuestrimin/konfiskimin e shoqërisë? Në mungesë të një rregullimi të shprehur, për koherencë, do të ishte më e përshtatshme që kërkesa për shfuqizimin e vendimeve të administratorit në shkelje të rëndë të ligjit dhe të statutit të ngrihej përpara gjykatës që ka vendosur sekuestron/konfiskimin e shoqërisë.

5. PËRFUNDIME

Vitet e fundit, jurisprudenca shqiptare është orientuar drejt zbatimit të përgjegjësive penale të shoqërive tregtare dhe vendosjes në sekuestrim të pasurive të tyre . Vendosja e një mase parandaluese mbi kuotat/aksionet dhe pasurinë e një shoqërie tregtare, bën të nevojshëm hartimin e detajuar dhe transparentë të kriterëve përzgjedhëse të administratorëve, që do të ngarkohen me administrimin e tyre. Në mënyrë të veçantë, kriteret përzgjedhëse duhet të përqendrohen tek eksperiencia në administrimin e shoqërive tregtare dhe njohja e legjislacionit tregtar. Gjithashtu, edhe shpërblimi i administratorëve të AAPSK-së duhet të jetë i përshtatshëm me detyrat dhe përgjegjësitë që lidhen me natyrën e administrimit të një shoqërie tregtare.

Regjistrimi pranë regjistrit tregtar të vendimit të sekuestrimit të pasurisë së shoqërisë tregtare është një hap i rëndësishëm përse i përket mbrojtjes së të tretëve që hyjnë në marrëdhënie me shoqërinë. Megjithatë, është e këshillueshme që ky fakt të pasqyrohet edhe në aktet e korrespondencës së shoqërisë. Administratori, duhet të autorizohet paraprakisht nga gjykata, nëse gjatë ushtrimit të kompetencave të tij, vlerëson të nevojshëm për administrimin e shoqërisë kryerjen e disa veprimeve që nuk hyjnë në sferën e veprimeve të zakonshme të administrimit të shoqërisë, si psh. marrjen e një kredie apo nënshkrimin e marrëveshjeve të pajtimit, etj. Neni 17 i ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 i ndryshuar, me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017, ka përcaktuar se administratori nëpërmjet AAPSK-së, i paraqet prokurorit kërkesën e argumentuar ku sqaron arsyet e autorizimit nga gjykata për kryerjen e një apo disa veprimeve të caktuara. Më pas, prokurori paraqet kërkesën e administratorit në

gjykatë dhe kërkon autorizimin e këtyre veprimeve. Në heshtje të kësaj dispozite, nëse prokurori do të refuzojë kërkesën e administratorit, do të ishte e këshillueshme që administrator, drejtpërsëdrejti apo nëpërmjet kryeadministratorit, t'i drejtohet gjykatës për të marrë autorizimin e nevojshëm me qëllim ushtrimin e kompetencave të tij.

Ky punim nuk mund të trajtojë të gjitha problematikat që mund të lindin me vendosjen në sekuestrim apo konfiskim të kuotave apo të pasurive të një shoqërie tregtare. Qëllimi i këtij punimi është evidentimi i nevojës së koordinimit të legjislacionit tregtar me dispozitat e legjislacionit penal dhe atij procedural. Në këtë mënyrë nga njëra anë zbatimi i legjislacionit penal të jetë efikas në parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, korrupsionit, terrorizimit dhe nga ana tjetër, të mos penalizohen të drejtat e grupeve të ndryshme të interesit që ndërthurin interesat e tyre me shoqërinë tregtare.

6. REFERENCA

- A. Malltezi, E drejta shqiptare e shoqërive tregtare, Mediaprint, Tiranë, 2011;
- A. Malltezi, J. Rystemaj, A. Kromiçi, Gjykatat Shqiptare mbi shoqëritë dhe veprimtarinë tregtare, Mediaprint, Tiranë, 2015;
- Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9754 datë 14.06.2007, “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”;
- Ligji nr. 157/2013 “Për Masat kundër financimit të terrorizmit”;
- Ligji nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” i ndryshuar me ligjin nr. 24/2014, datë 20.3.2014, nr. 70/2017, datë 27.4.2017;
- Vendim nr. 687, datë 5.10.2011 “Për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e AAPSK-së, ndryshuar me VKM nr. 324, datë 28.5.2014; nr. 83, datë 8.2.2017;
- Vendimin nr. 768, datë 05.06.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

KODI I DREJTËSISË PENALE PËR TË MITUR – NJË VËSHTRIM ANALITIK MBI RISITË DHE SFIDAT E REJA TË LEGJISLACIONIT SHQIPTAR

Dr. Oljana HOXHAI

Departamenti i Drejtësisë,
Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë
Vlora, Albania
oljana.hoxhaj@gmail.com

ABSTRAKT

Miratimi i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur shënon një prej risive në plotësimin e kornizës së të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, i cili jo vetëm formalizon, por njëherazi ofron një sërë garancish në konsolidimin e raportit të të miturit me drejtësinë penale. Kodi i Drejtësisë Penale është miratuar fill pas miratimit të Ligjit të ri “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”. Këto standarde të reja ligjore, synojnë të shpërfaqin hapësirat e nevojshme në funksion të revolucionarizimit dhe progresit të mëtejshëm në aspektin e shndërrimit të filozofisë penale për të miturit nga një vizion kryesisht ndëshkues, drejt një qasjeje të re, që vendos në themel drejtësinë rehabilituese dhe restauruese në raportin e të miturit me sistemin e drejtësisë. Në këtë mënyrë, projektohet një drejtësi më humane dhe miqësore me fëmijët. Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit është hartuar në harmoni të plotë me frymën kushtetuese dhe me një sërë direktivash të BE-së, duke patur objektiv parësor ofrimin e qasjes në drejtësi përmes mjeteve juridike që e lehtësojnë aksesin e të miturve në sistemin e drejtësisë penale. Punimi ynë ka për qëllim të pasqyrojë risitë që do të sjellin dispozitat e këtij kodi, duke analizuar efektet e pritshme në pozitën e të miturit në konflikt me ligjin, si dhe nivelin e përafrimit me standardet ndërkombëtare.

Fjalë kyçe: *drejtësi penale, i mitur, drejtësi rehabilituese, akses, risi*

1. Ekzigjencat social-juridike për hartimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit

Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit¹ shënon një prej iniciativave ligjore më të rëndësishme në konsolidimin e raportit mes të miturit dhe drejtësisë penale. Në këtë kontekst, miratimi i tij reflekton përmbushjen e një sërë mangësive të shfaqura në vazhdimësi, të ndërlidhura me nevojën për t’i garantuar të miturit një mbrojtje të posaçme, duke konsideruar zhvillimin fizik, psikologjik, emocional dhe social të tij.

¹ Ligji nr. 37/2017 datë 30.3.2017, Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, është miratuar në datën 30.3.2017 dhe është botuar në Fletoren Zyrtare të RSH-së, viti 2017, numri 92

Këto garanci shpërfaqen në gjithë përmbajtjen e Kodit, duke sanksionuar qartësisht rregullimet e posaçme procedurale të cilat nisin me fazën e hetimit, vijnë në ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, duke u finalizuar me rehabilitimin, ose të çdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, si dhe një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale². Domosdoshmëria e hartimit të këtij Kodi, filozofia dhe fryma e përgjithshme e tij, sintetizohen më së miri me detyrimin kushtetues, duke i trajtuar fëmijët dhe të rinjtë, si subjekte me një pozitë më të privilegjuar në raport me subjektet e tjerë, në sajë të gëzimit të së drejtës për një mbrojtje të veçantë nga shteti³. Respektimi i kësaj dispozite nxjerr në plan të parë vullnetin e shtetit për të renditur respektimin e të drejtave të fëmijëve në përballjen e tyre me drejtësinë, si një prej prioriteteve kombëtare, e cila korrespondon me një angazhim shumëplanësh të organeve ligjzbatuese. Shtylla themelore në të cilën mbështetet një sistem drejtësie efektiv, lidhet ngushtësisht me përmirësimin e aksesit dhe pozitës së të miturit në drejtësinë penale.

Pavarësisht statistikave zyrtare të kriminalitetit, përçindja e të miturve që përfshihen në veprimtari të kundërligjshme, ka rezultuar në shifra të larta dhe në mënyrë permanente kjo situatë ka prodhuar një shqetësim serioz për shoqërinë në tërësi. Pikërisht ky fakt, ka diktuar vullnetin e ligjvënësit për të përsheptuar procesin e hartimit të një Kodi, të dedikuar specifikisht për të miturit. Analizuar në këtë këndvështrim, është e nevojshme të sjellim në vëmendje sensibilizimin e vazhdueshëm, si dhe presionet e herë pas herëshme të organizatave joqeveritare, që kanë në fokusin e veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve⁴, hulumtuesve dhe profesionistëve të së drejtës, të cilët në përfundim të punëve kërkimore-shkencore, të prezantuara këto të fundit përmes studimeve, statistikave ose raporteve, hartimi i një Kodi, është identifikuar si një prej mangësive të konstatuara në legjisllacionin shqiptar. Gjithsesi, vlen të theksojmë faktin se rrugëtimi sapo ka nisur dhe sfidat me të cilat do të përballen të gjithë aktorët dhe faktorët janë të shumtë. Miratimi i Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit është hapi i parë i një rruge të vështirë, pasi në thelb procesi i miratimit të tij shënon thjesht finalizimin me sukses të një misioni në planin teorik, por që në thelb kjo nuk nënkupton as uljen e kriminalitetit dhe as zhdukjen e fenomenit në tërësi. Janë të shumtë organet shtetërore, të cilat duhet të angazhohen në të gjitha dimensionet, duke përfshirë këtu përmirësimin e infrastrukturës, trajnimin periodik të burimeve njerëzore, akordimin e shumave monetare më të larta në fondin e investimeve për fëmijët, me

² Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, neni 1

³ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, neni 54/1

⁴ Children's Human Rights Centre of Albania – CRCA, Raport: “Drejtësia për të Mitur në Shqipëri - Një Analizë e Sistemit të Administrimit të Drejtësisë për të Mitur dhe Gjendjes së të Miturve në Konflikt me Ligjin në Shqipëri”, *Visi Disign*, Tiranë 2007, fq. 80

qëllim që të miturit t'i krijohen të gjitha hapësirat e nevojshme për t'i mundësuar ushtrimin e të gjitha të drejtave të tij, në përputhje me dispozitat e Kodit.

2. Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit dhe qasja drejt standardeve demokratike

Kuadri ligjor i drejtësisë penale për të miturit, i materializuar tashmë në dispozitat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit, është produkt i vullnetit të legjislatorit shqiptar për të revolucionarizuar në tërësi qasjen ndaj të miturve në të gjitha fazat e përbaljes së tyre me drejtësinë. Kodi është hartuar në përputhje me standardet më të larta të sistemit juridik shqiptar dhe njëherazi është formatuar në mbështetje me frymën e Konventës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve si dhe me ato standarde dhe norma ndërkombëtare, të cilat kanë si objektiv parësor mbrojtjen efektive dhe interesin më të lartë të të miturit⁵. Nëse do të bënim një retrospektivë në kornizën ligjore shqiptare, rezulton se përpjekjet për të hartuar politika penale miqësore dhe efektive me të miturit kanë qenë të shpeshta, por asnjëherë më parë nuk është miratuar një kod që do të rregullonte marrëdhëniet e të miturit në sferën penale. Kësisoj, Kodi i miratuar disa muaj më parë përbën aktin e parë që i dedikohet specifikisht raportit të të miturve me sistemin e drejtësisë penale. Impakti dhe pritshmëritë mbi efektet që do të prodhojë zbatimi i tij janë të larta dhe përforcohen edhe më tepër nga fakti se ai është modeluar në harmoni me aktet më të rëndësishme në rang hierarkik, si në nivelin kombëtar edhe ndërkombëtar. Është akoma herët që diskutimi ynë të shtrihet në identifikimin e rasteve konkrete, pasi aktualisht Kodi nuk ka hyrë ende në fuqi⁶. Në këtë kuptim, analiza jonë do të jetë kryesisht teorike, duke u përqëndruar te studimi i dispozitave të veçanta, të cilat reflektojnë një koncept të moderuar në trajtimin e subjekteve të mitur në konflikt me ligjin.

Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”⁷ është një tjetër akt i një rëndësie të veçantë, që i ka paraprirë në kohë miratimit të Kodit. Në shumë komponentë të dy aktet e mësipërm janë komplementarë, pasi të dy kanë objektiv parësor mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës. Në këtë drejtim, Ligji i Fëmijëve parashikon një risi në kuadrin e të drejtës së strukturave të Njërive të Mbrojtjes së Fëmijës në nivel bashkie për të hartuar periodikisht çdo vit një listë me përfaqësuesit proceduralë⁸, për

⁵ Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, miratuar në datën 30.3.2017, neni 2/1

⁶ Po aty, neni 143

⁷ Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, është miratuar më 23.02.2017 dhe është botuar në Fletoren Zyrtare të RSH-së, viti 2017, numri 43

⁸ Ligji përkufizon si “Përfaqësues procedural” personin e caktuar nga autoriteti procedues nga lista e dërguar nga njësia për mbrojtjen e fëmijës, që do të kryejë përfaqësimin procedural të fëmijës në mungesë të përfaqësuesit të tij ligjor ose, në rast konflikti interesi mes tij dhe fëmijës dhe ka të drejta përfaqësuese në emër të fëmijës në konflikt me ligjin, ose fëmijës dëshmitar/viktimitë, me qëllim për të mbrojtur interesin më të lartë të fëmijës.”

fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktime dhe dëshmitarë në procesin penal dhe më pas ia përcjell këtë listë strukturave vendore të Policisë së Shtetit, Prokurorisë dhe gjykatës së rrethit gjyqësor e të apelit përkatës. Në plotësim të misionit të ligjit, është parashikuar dispozita e Kodit, e cila përcakton specifikisht detyrat që i ngarkohen Përfaqësuesit të Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, duke përfshirë detyrimin për mbështetje, këshillim, komunikim, informim dhe në tërësi marrjen e atyre masave që synojnë të garantojnë mbrojtjen e interesit më të lartë të të miturit⁹. Përpos sa trajtuam më sipër, një tjetër karakteristikë e Kodit është filozofia mbi aplikimin e burgimit, si masa e fundit dhe në një kohë sa më të shkurtër. Në ato raste që është e mundur, dënimi duhet të zëvendësohet me kryerjen e shërbimeve të rehabilitimit me bazë komunitare. Në këtë mënyrë, ligjvënësi krijon të gjitha premiset e nevojshme që të miturit t'i lehtësohet procesi i riintegritimit në shoqëri. Në nxitjen e mëtejshme të integritimit të të miturit, Kodi parashikon organizimin e programeve edukuese dhe rehabilituese, në mënyrë që fëmijët gjatë të gjitha fazave të procesit gjyqësor të kenë akses në përfitimin e arsimit brenda standardeve të garantuara nga shteti shqiptar¹⁰. Të njëjtën qasje e konstatojmë të përshkruar edhe në tekstin e Kodit të Drejtësisë për të Mitur në Kosovë¹¹.

Duke u udhëhequr nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës, në këtë aspekt, nuk mund të lëmë pa përmendur dhe kontributin e rëndësishëm të UNICEF-it, i cili në sajë të propozimeve dhe bashkëpunimit të frytshëm në kuadër të përmirësimit të draftit fillestar të ligjit, në vazhdimësi ka synuar promovimin e të drejtave dhe mirëqenies së fëmijëve në çdo politikë të hartuar¹². Në vëmendjen e posaçme të legjislatorit shqiptar kanë qenë të miturit gjatë procesit të ndryshimeve të propozuara në Kodin e Procedurës Penale. Harmonizimi me standardet e Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve është një tjetër garanci e rëndësishme legjislative për të miturit. Projektimi i Kodit të Procedurës Penale, bazohet dhe reflekton krahas ndryshimeve kushtetuese dhe ligjet e tjera të miratuara në kuadër të Reformës në Drejtësi në fushën penale, duke përfshirë dhe paketën ligjore të Drejtësisë Penale për të Mitur. Kësisoj, një prej objektivave është mbrojtja e të drejtave të të miturit, duke trajtuar në mënyrë të veçantë çdo proces që lidhet me të¹³. Miratimi i Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit e ka shtrirë impaktin

⁹ Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, miratuar në datë 30.3.2017, neni 35

¹⁰ Po aty, neni 117

¹¹ Kodi Nr. 03/L-193 i Drejtësisë për të Mitur, botuar në *Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës / Prishtinë: VITI V / Nr. 78 / 20 GUSHT 2010, shpallur me dekretin Nr. DL-039-2010, datë 28.07.2010 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, neni 3/5*

¹² https://www.unicef.org/albania/Press_Release_J4C_Code.pdf

¹³ Relacioni për Kodin e Procedurës Penale - Projekt Ndryshimet për Kodin e Procedurës Penale, fq. 2 <https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2017/01/RELACION-SHTESA-E-NDRYSHIME-7905-KODI-I-PROCEDURES-PENALE-Resized.pdf>

gjerësisht në përmbajtjen e Kodit të Procedurës Penale, pasi në shumë dispozita të këtij të fundit, konstatojmë komplementaritetin e akteve në funksion të ofrimit të mbrojtjes së duhur ndaj të miturit që përballlet me drejtësinë penale¹⁴. E njëjta qasje dëshmohet dhe në ndryshimet që ka pësuar Kodi Penal, ku në pjesën më të madhe të rasteve, legjislatori i referohet drejtpërdrejtë Kodit të të Miturve¹⁵.

3. Një vështrim analitik mbi rrishtë e Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit

Mungesa e efikasitetit për të sjellë një paketë ligjore lehtësisht të aksesueshme dhe miqësore me të miturit është identifikuar si një ndër pikat e dobëta të sistemit të drejtësisë penale. Si rrjedhojë e mosmarrjes së iniciativave të duhura për një kohë të gjatë, kemi konstatuar disa fenomene të ndërlidhura me përhapjen e kriminalitetit të të miturit. Përfshirja e tyre në veprimtari kriminale dhe recidivizmi përbënin shqetësimet kryesore. Mjetet e përdorura për edukimin dhe rehabilitimin e kësaj kategorie të të miturve nuk kanë qenë eficiente dhe në shkallën e duhur¹⁶. Në këtë kontekst, Kodi i miratuar së fundmi synon t'i përgjigjet nevojave dhe interesave të të miturve. Një hap cilësor dhe risi e këtij Kodi mund të konsiderohet ngritja e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, si një strukturë që do të funksionojë pranë Ministrisë së Drejtësisë. Qëllimi i krijimit të saj, konsiston në mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e të miturit dhe të rinjve pas kryerjes së dënimit, në funksion të realizimit të veprimtarisë rehabilituese të të miturit¹⁷. Një tjetër veçanti e Kodit është përcaktimi i kriterëve të qarta për personat që do të administrojnë dhe asistojnë procesin e drejtësisë penale. Këta të fundit duhet të jenë të specializuar dhe të kualifikuar në menaxhimin e rasteve të të miturve në konflikt me ligjin. Në fakt, specializimi i tyre përbën një garanci me impakt të gjerë, sepse do të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë te subjekti i mitur, por në të njëjtën kohë do të garantojë mbarëvajtjen e procesit në tërësi.

Parametrat ligjorë që dikton Kodi ndaj organeve kompetente përfshijnë detyrimin e punonjësve që do të administrojnë dhe asistojnë drejtësinë penale për të patur njohuritë e nevojshme mbi të drejtat e fëmijëve, ndërgjegjësim profesional të lartë për mbrojtjen e të drejtave të të miturve në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitarë, si dhe disponibilitetin e tyre për qëndrueshmërinë në këto pozicione

¹⁴ Shih: Ligj nr. 35/2017 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar

¹⁵ Ligj nr. 36/2017 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, neni 1, 2, 11, 12

¹⁶ Raport i Komitetit Shqiptar të Helsinkit "Mbi situatën e respektimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri për vitin 2015", Tiranë, 2015, fq. 11-12

¹⁷ Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, miratuar në datë 30.3.2017, neni 133/4

pune¹⁸. Ndër të tjera, Kodi parashikon specifkisht fushat e trajnimit dhe njohuritë e posaçme me të cilat duhet të jetë pajisur personeli që do të shërbejë në këtë proces¹⁹. *Referuar dispozitave të Kodit, subjektet që kanë detyrim të trajnohen dhe t'u nënshtrohen specializimeve janë punonjësit e Policisë së Shtetit*²⁰, avokatët, të cilët duhet të specializohen me njohuri të posaçme mbi drejtësinë për të miturit²¹ dhe një sërë punonjësish të tjerë që janë pjesë e sistemit²². Përjasja e dispozitave të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit me direktivat e BE-së përforcon edhe më tepër angazhimin për të jetësuar efektivisht standardet që garantojnë mundësitë për t'i garantuar të miturit përfitimin nga qasja në drejtësinë penale përmes aplikimit të mjeteve juridike që i lehtësojnë aksesin brenda sistemit. Stadi i harmonizimit reflektohet qartësisht në ushtrimin e të drejtës së informimit²³, e cila shtrihet gjerësisht në tekstin e Kodit, duke ngarkuar organet kompetente me detyrimin për të informuar menjëherë dhe gjatë gjithë procesit të miturin viktimë, përfaqësuesin e tij ligjor ose procedural dhe mbrojtësin lidhur me modalitetet e procesit.

Duke e çmuar interesin e veçantë që mbart e drejta e informimit, Kodi parashikon se nëse informimi nuk i është bërë drejtpërdrejtë të miturit nga organi kompetent, ky detyrim përmbushet, sipas rastit, nga përfaqësuesi ose mbrojtësi i të miturit. Në këtë drejtim, vlen të nënvizojmë faktin se njoftimi i të miturit duhet të bëhet në mënyrë të tillë që informacioni të jetë i përshtatshëm dhe i kuptueshëm për të²⁴. Përmbajtja e kësaj dispozite është një garanci që e përmbush efektivisht të drejtën e sipërpërmendur. Duke u frymëzuar nga parimi i interesit më të lartë të të miturit, në tekstin e Kodit parashikohet e drejta e fëmijës për të patur mbrojtës²⁵, pjesëmarrja e të cilit është e detyrueshme. Përfaqësuesi ligjor gëzon të drejtën për të zgjedhur mbrojtësin e të miturit. Në rastet kur i mituri në konflikt me ligjin nuk

¹⁸ Po aty, neni 25

¹⁹ Po aty, neni 26

²⁰ Po aty, neni 30

²¹ Po aty, neni 31

²² Në sistemin e drejtësisë për të mitur përfshihet punonjësi i Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, psikologu, përfaqësuesi procedural, ndërmjetësi, punonjësi i shërbimit të provës, punonjësi i qendrës së rehabilitimit për të mitur dhe paraburgimit, i specializuar në drejtësinë për të mitur.

²³ *Directive 2012/13/Eu of the European Parliament and of the Council of 22 May 2012 on the right to information in criminal proceedings*

²⁴ Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, miratuar në datën 30.3.2017, neni 34

²⁵ *Directive 2013/48/EU of the European Parliament and of the Council of 22 October 2013 on the right of access to a lawyer in criminal proceedings and in European arrest warrant proceedings, and on the right to have a third party informed upon deprivation of liberty and to communicate with third persons and with consular authorities while deprived of liberty*

ka zgjedhur mbrojtës, organi kompetent që kryen veprimet përkatëse procedurale, cakton menjëherë mbrojtësin në kuadrin e krijimit të hapësirave ligjore që i mituri të përfitojë ndihmën e nevojshme juridike. Sikundër rezulton nga interpretimi i dispozitës përkatëse, prania e mbrojtësit është e domosdoshme për procesin dhe për rrjedhojë, thëniet e të miturit të dyshuar, të bëra jo në prani të mbrojtësit, nuk mund të përdoren si provë²⁶. Për më tepër, roli i mbrojtësit të të miturit merr një rëndësi të veçantë gjatë fazës së ekzekutimit të vendimeve penale, ndaj caktimi i tij bëhet kryesisht. Në përputhje me interesin më të lartë të të miturit dhe me pëlqimin e këtij të fundit, mbrojtësi mund të jetë i njëjti që e ka përfaqësuar atë në fazat e mëparshme të procesit²⁷.

Një tjetër dispozitë e harmonizuar me standardet europiane reflektohet në të drejtën e të miturit për të komunikuar në gjuhën që kupton²⁸, i asistuar nga një përkthyes pa pagesë. Në këtë aspekt, Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur sanksionon caktimin e përkthyesit në rastet kur i mituri nuk e kupton ose e kupton pjesërisht gjuhën, si dhe kur nuk mund të flasë gjuhën me të cilën procedohet. Prania e përkthyesit pa pagesë, është një garanci për pozitën e të miturit gjatë çdo veprimi procedural. Nga sa analizuam më sipër, duke synuar mbrojtjen e të drejtave të të miturit në procesin gjyqësor dhe për të verifikuar që ata e kuptojnë njëri-tjetrin, përkthyesi duhet të takohet me të miturin përpara gjyqimit ose veprimeve procedurale²⁹. Fryma e përafrimit të Kodit, në sajë të instrumenteve ligjorë efektivë që parashikon, në të njëjtën kohë reflekton angazhimin shtetëror që shtrihet në parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjes së viktimave të mitur³⁰, si dhe në vendosjen e standardeve minimale mbi të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimt³¹.

4. Interesi më i lartë i të miturit në optikën e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur

Interesi më i lartë i të miturit është parimi themelor që shoqëron ndërtimin e Kodit, duke u shpërfaqur në shumë dispozita. Pavarësisht frymës së legjislatorit për të përmbledhur në këtë parim të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim

²⁶ Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, miratuar në datën 30.3.2017, neni 48

²⁷ Po aty, neni 112

²⁸ *Directive 2010/64/EU of the European Parliament and of the Council of 20 October 2010 on the right to interpretation and translation in criminal proceedings*

²⁹ Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, miratuar në datën 30.3.2017, neni 50

³⁰ *Directive 2011/36/EU of the European Parliament and of the Council of 5 April 2011 on preventing and combating trafficking in human beings and protecting its victims, and replacing Council Framework Decision 2002/629/JHA*

³¹ *Directive 2012/29/EU of the European Parliament and of the Council of 25 October 2012 establishing minimum standards on the rights, support and protection of victims of crime, and replacing Council Framework Decision 2001/220/JHA*

të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror, social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën³², gjithsesi është shumë e vështirë të japim një përkufizim shterues dhe gjithëpërfshirës mbi konceptin e interesit më të lartë të të miturit. Parimi mbart në vetvete përgjegjësi dhe detyrime të drejtpërdrejta të organeve shtetërore dhe strukturave të rëndësishme sociale, të cilat janë bashkëudhëtare në rrugëtimin e fëmijëve dhe të drejtave të tyre³³. Në praktikë shtohet edhe më tepër shkalla e vështirësisë mbi vlerësimin e rrethanave ose kushteve, të cilat do të konsiderohen si më të përshtatshme dhe më të volitshme për fëmijën. Kësisoj, gjyqtarët, janë dhe do të vazhdojnë të jenë profesionistët dhe zyrtarët kompetentë, mbi të cilët do të rëndojë barra e gjykimit të çështjeve, duke diktuar nevojën e pasqyrimin të analizave të zgjeruara dhe argumentime të posaçme lidhur me mënyrën se si janë përcaktuar parametrat mbi të cilët është interpretuar rast pas rasti interesi më i lartë i të miturit. Parë në këtë këndvështrim, vlen të sjellim në vëmendje faktin se volumi i punës hulumtuese-profesionale, duhet analizuar në përputhje me rrethanat specifike dhe dinamikën e çdo ngjarjeje. Në këtë kuadër, një prej risive të Kodit, në përmbushje të interesit më të lartë të të miturit, do të konsiderohet përparësia që iu është dhënë subjekteve të mitur që nga fillimi i procesit penal deri në ekzekutimin e tij. Ligji i trajton fëmijët në mënyrë të diferencuar, pasi parashikon qartësisht detyrimin e organeve kompetente të shqyrtojnë në një kohë sa më të shkurtër dhe pa vonesa të pajustificuara çështjet e të miturve. Ky qëndrim reflekton qasjen e legjislatorit për t'i mundësuar të miturit ofrimin e garancive të nevojshme ligjore, në mënyrë që të miturit të mos përballen me trauma të tjera³⁴.

5. KONKLUZIONE

Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit është akti më i rëndësishëm dedikuar fëmijëve, i miratuar së fundmi. Ai ka ardhur si ekzigjencë e shoqërisë, veçanërisht e subjekteve të mitur, të cilëve, për herë të parë, iu është ofruar një paketë legjislative, që reflekton përmbushjen e një sërë standardeve me karakter demokratik, human dhe miqësor me të miturit. Në tekstin e këtij Kodi janë mishëruar vlera dhe parime të larta, të cilat janë produkt i kërkesave dhe objektivave të drejtpërdrejta të fëmijëve. Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit është hapi i parë i një rrugëtimi të gjatë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Ai është prezantuar paralelisht me ligjin e ri “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”. Këto akte komplementare me njëra tjetrën, janë të dyja të një rëndësie të veçantë, pasi janë të harmonizuara me aktet më të përparuara europiane. Në përmbajtjen e tyre ofrohen garancitë e nevojshme në

³² Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, miratuar në datë 30.3.2017, neni 3/9

³³ Po aty, neni 10

³⁴ Po aty, neni 17

mënyrë që i mituri në konflikt me ligjin të jetë i mbrojtur, t'i respektohen të drejtat dhe të jetë përfytyrë i gjithë lehtësive të parashikuara nga ligji. Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit është frymëzuar nga Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Femijëve, e cila konsiderohet si Kushtetuta e Fëmijëve në mbarë botën. Interesi më i lartë i fëmijës është parimi themelor mbi të cilin është strukturuar kuadri ligjor mbi drejtësinë penale për të mitur. Përmes analizës së dispozitave të Kodit Shqiptar të Drejtësisë Penale për të Mitur, si një ndër rrisitë që ka prodhuar miratimi i tij, do të veçonim përshtatjen e drejtësisë penale me profilin e të miturit, duke marrë në konsideratë nevojat e veçanta të tij. Të gjitha këto prirjen të realizohen në funksion të ofrimit të një drejtësie sa më efektive për fëmijët. Në këtë kontekst, objektivat parësorë dhe pritshmëritë ndaj këtij ligji të ri lidhen me mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të të miturit gjatë përballjes së tij me drejtësinë penale; krijimi i hapësirave që do t'i mundësonte të miturit një proces sa më të lehtë riintegruar në shoqëri; angazhimi profesional dhe infrastrukturor në implementimin e politikave që nxitin rishoqërimin dhe rehabilitimin e të miturit; si dhe gjithëpërfshirja e aktorëve pjesë të procesit. Kodi ende nuk ka hyrë në fuqi, por pavarësisht këtij fakti, pritshmëritë ndaj tij janë të larta, pasi ai është akti që do të garantojë ridimensionimin e filozofisë së trajtimit të të miturit në konflikt me ligjin, duke krijuar një drejtësi penale humane dhe miqësore me të miturin.

BIBLIOGRAFIA

- Ligji nr. 37/2017 datë 30.3.2017, Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, miratuar në datën 30.3.2017, botuar në Fletoren Zyrtare të RSH-së, viti 2017, numri 92
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016
- Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, miratuar më 23.02.2017, botuar në Fletoren Zyrtare të RSH-së, viti 2017
- Ligj nr. 36/2017 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar
- Ligj nr. 35/2017 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar
- *Kodi Nr. 03/L-193 i Drejtësisë për të Mitur, botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës/Prishtinë: VITI V / Nr. 78 / 20 GUSHT 2010, shpallur me dekretin Nr. DL-039-2010, datë 28.07.2010 nga Presidenti i Republikës së Kosovës*
- Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989
- Children’s Human Rights Centre of Albania – CRCA, Raport: “Drejtësia për të Mitur në Shqipëri - Një Analizë e Sistemit të Administrimit të Drejtësisë për

të Mitur dhe Gjendjes së të Miturve në Konflikt me Ligjin në Shqipëri”, *Visi Disign*, Tiranë 2007

- Raport i Komitetit Shqiptar të Helsinkit “Mbi situatën e respektimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri për vitin 2015”, Tiranë, 2015
- Relacioni për Kodin e Procedurës Penale - Projekt Ndryshimet për Kodin e Procedurës Penale <https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2017/01/RELACION-SHTESA-E-NDRYSHIME-7905-KODI-I-PROCEDURES-PENALE-Resized.pdf>
- *Directive 2012/13/Eu of the European Parliament and of the Council of 22 May 2012 on the right to information in criminal proceedings*
- *Directive 2011/36/EU of the European Parliament and of the Council of 5 April 2011 on preventing and combating trafficking in human beings and protecting its victims, and replacing Council Framework Decision 2002/629/JHA*
- *Directive 2012/29/EU of the European Parliament and of the Council of 25 October 2012 establishing minimum standards on the rights, support and protection of victims of crime, and replacing Council Framework Decision 2001/220/JHA*
- *Directive 2013/48/EU of the European Parliament and of the Council of 22 October 2013 on the right of access to a lawyer in criminal proceedings and in European arrest warrant proceedings, and on the right to have a third party informed upon deprivation of liberty and to communicate with third persons and with consular authorities while deprived of liberty*
- https://www.unicef.org/albania/Press_Release_J4C_Code.pdf

HARMONIZIMI I PARASHIKIMIT TË VEPRËS PENALE DHUNA NË FAMILJE ME STANDARTET NDËRKOMBËTARE DHE EVROPIANE

Phd. Candidate. Lorena MUSAI

O.P.Gj Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë
Elbasan

ABSTRAKT

Dhuna ndaj grave është sot një prej shkeljeve më të mëdha të të drejtave të njeriut pasi përbën pengesën kryesore për arritjen e barazisë gjinore, gëzimin e të drejtave themelore, si dhe integritetin fizik dhe psikik. Dhuna është konsideruar prej kohësh si diçka private dhe për këtë arsye shteti nuk ka bërë asnjë gjë për të ndërhyrë .

Një dhunë që për shumë kohë është kryer dhe justifikuar nga morali, feja, kodet e nderit apo ligjet diskriminuese është e dëmshme për të drejtat e njeriut.

Në gjendjen aktuale të zhvillimit të së drejtës ndërkombëtare, traktatet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut parashikojnë gjithnjë e më tepër përfshirjen e palëve kontraktuese për të parandaluar dhunën, për të mbrojtur viktimat dhe për të ndëshkuar fajtorët.

Kjo do të thotë, detyrimin për shtetet për të ushtruar kujdesin e duhur për të parandaluar, hetuar dhe ndëshkuar, në përputhje me ligjet e tyre kombëtare, aktet e dhunës ndaj grave, qoftë të kryera nga aktorët shtetëror apo subjektet private.

Do të japim një kuadër të përgjithshëm për të ilustruar fazat nëpër të cilat bashkësia ndërkombëtare është bërë e vetëdijshme për natyrën ndërkombëtare të problemit të dhunës kundër grave dhe nevojën për të pajisur veten me instrumente bashkëpunimi për t'u marrë me të dhe për të shtypur një fenomen kaq të rezikshëm dhe të inkurajojë vetëndërgjegjësimin e shoqërisë civile, duke mbështetur veprimtaritë e organizatave jo qeveritare dhe levizjeve feministe.

Panvarsisht pranisë së shumë instrumenteve të ligjshëm, të detyrueshëm ose *soft law* të miratuar në nivel ndërkombëtar, rajonal dhe kombëtar, gratë viktimat të dhunës vazhdojnë të jenë shumë. Sfida e vërtetë është të sigurohet zbatimi i *corpus normativo*, në të drejtën kombëtare sot e kërcënuar nga ekzistenca e praktikave diskriminuese të rrënjosura në zakonet dhe traditat e shoqërisë njerëzore, të cilat pengojnë qasjen e grave në drejtësi, duke penguar në fakt zgjidhjen e problemit.

Do analizohet harmonizimi i akteve kombëtare Shqipëtare në lidhje me aktet ndërkombëtare dhe ato evropiane, për të kuptuar edhe strategjitë që duhet të ndër-marr shteti shqiptarë në parandalimin e dhunës kundër grave.

Fjalët kyçe: *dhunë në familje, akte ndërkombëtare, legjislacioni evropian; parandalim*

1. Përkufizimi i dhunës sipas legjislacionit shqiptar dhe ndërkombëtar

Dhuna me bazë gjinore në Shqipëri adresohet nga *Ligji Nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*. Në këtë ligj, koncepti "Dhunë" dhe "Dhunë në familje" jepet në nenin 3, si më poshtë: 1. "Dhunë" është çdo veprim apo mos-veprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cënim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik. 2. "Dhunë në familje" është çdo akt dhune, sipas pikës 1 të këtij neni, i ushtruar midis personave që janë apo kanë qënë në marrëdhënie familjare. 3. "Pjesëtarë të familjes" janë: a) bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja apo ish-bashkëshorti/ja apo ish partneri/ja bashkëjetues; b) vëllezërit, motrat, gjinia në vijë të drejtë, përfshirë prindërit adoptues dhe fëmijët e adoptuar; c) bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja i personave të parashikuar në shkronjën "b"; ç) gjinia në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit, edhe fëmijët e adoptuar të bashkëshortit/es ose bashkëjetuesit/es; d) vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit/es nëse kanë bashkëjetuar gjatë 3 muajve të fundit; dh) fëmijët e bashkëshortëve apo partnerëve bashkëjetues.

Deklarata "Për Eliminimin e Dhunës Ndaj Gruas", bërë nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, e ka përkufizuar dhunën me baze gjinore si: "... një akt të bazuar në përkatësinë gjinore, që rezulton ose mund të rezultojë me lëndime fizike, seksuale, psikologjike apo vuajtje afatgjata të grave, përfshirë kërcënime e akte të ngjashme, detyrime apo nëvlerësime arbitrare, që ndodhin në jetën personale ose publike".

Në 1993, *Deklarata e Vjenës dhe Programi për Veprim* përkufizon dhunën ndaj grave si "... një akt të dhunës me bazë gjinore, që rezulton në dëmtim fizik, seksual ose psikologjik ose vuajtje të grave, përfshirë kërcënimin për akte të tilla, shtrëngim ose deprivim të paarsyeshëm të lirisë, që ndodhin si në jetën private ashtu dhe në atë publike".

Një tjetër përcaktim për dhunën ndaj gruas është dhënë në *Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW)* duke e emërtuar dhunën si "... një manifestim i marrëdhënieve historikisht jo të barabarta mes burrave dhe grave", dhe cilësuar dhunën si "... një mekanizëm kryesor nga i cili gratë janë detyruar të qëndrojnë në një pozicion më të ulët, krahasuar me burrat".

Në *Konferencën e Katërt të Kombeve të Bashkuara në Pekin (1995)* është theksuar se "... dhuna ndaj gruas përbën një dhunim të të drejtave njerëzore dhe përbën një pengesë në arritjen e barazisë, zhvillimit dhe paqes në shoqëri". Në Deklaratën e Këshillit të Europës në vitin 1993, pohohet se "... eliminimi i dhunës kundër grave është aspekt kyç i kundërvënies ndaj pabarazisë strukturore midis burrave dhe grave".

Në rezolutën e 1997-ës, Parlamenti Evropian pohon se “... dhuna kundër grave është pa kurrfarë dyshimi e lidhur me një pabarazi të fuqisë midis sekseve në sferën sociale, ekonomike, fetare dhe politike, pavarësisht shpalljes së barazisë në legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar¹”.

Organizata Botërore e Shëndetësisë jep këtë përkufizim për dhunën: “Përdorim i qëllimshëm i forcës apo pushtetit fizik, e kërcënuar apo ushtruar kundër vehtes, një personi tjetër ose kundër një grupi apo komuniteti, i cili rezulton ose ka shumë të ngjarë të rezultojë në lëndim, vdekje, dëmtim psikologjik, keqzhvillim apo privim.

Pra, Dhuna në familje është një formë e diskriminimit gjinor që dhunon të drejtat themelore të grave dhe pjestarëve të tjerë të familjes dhe shpreh pushtetin e dhunuesit/es mbi mbijetuesit e dhunës në marrëdhëniet familjare.

2. Kuadri Ligjor Ndërkombëtar mbi dhunën në familje

Tema e dhunës kundër grave nuk ka gjetur përmendje specifike në aktet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejta e njeriut në përgjithsi e që më tepër ato që shohin në mënyrë të veçantë gratë deri disa vite më parë.

Edhe Kombet e Bashkuara dhe organizatat e saj, tri dhjet vjet më parë nuk e kishin përmendur aspak problemin e dhunës kundër grave, duke marrë parasysh edhe një dokument shumë të rëndësishëm përsa i përket të drejtave të barabarta, në vitin 1979, tema mbi dhunën kundër grave, u ngrit në nivel ndërkombëtar me Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW). Kjo Konventë, u miratua dhe u hap për nënshkrim, për ratifikim dhe për Aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 34/180 të datës 18.12.1979 dhe hyri në fuqi më 03.09.1981, e firmosur aktualisht nga 131 vënde, nuk përfshin në mënyrë të hapur dhunën si formë diskriminimi apo si një pengesë për të drejta të barabarta të grave dhe liritë.¹

Sipas kësaj Konvente, shprehja “*diskriminimi ndaj grave*” nënkupton çdo dallim, përjashtim ose kufizim që bëhet mbi bazën e seksit, e që ka për pasojë ose për qëllim të komprometojë ose të asgjësojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gratë, pavarësisht nga gjendja e tyre martesore, mbi bazën e barazisë së burrit dhe të gruas, të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile ose në çdo fushë tjetër.

Shtetet palë dënojnë diskriminimin ndaj grave në të gjitha format, pranojnë të ndjekin me të gjitha mjetet e përshtashme dhe pa vonesë, një politikë të eliminimit të diskriminimit kundrejt grave dhe për këtë arsye zotohen të venë në zbatim fuqinë ndërhyrëse të shtetit, si një ndërhyrje positive. Kjo ndërhyrje do të bëhet duke marrë masa për parashkime ligjore, me qëllim marrjen e masave për të ndaluar çdo formë

¹Ivanka Corti, presidente della CEDAW, in “La violenza domestica: un fenomeno sommerso” acura dell’ADMI (Associazione Donne Magistrato Italiane, F. Angeli, Milano,

të diskriminimit ndaj gruas, vendosjen e një mbrojtje gjyqësore, si dhe nëpërmjet ndërhyrjes negative, për të mos ndërmarrë asnjë verpim që do të diskriminonte gratë, apo politikë. Ndërhyrja pozitive do të ishte si në aspektin legjislativ ashtu dhe në atë ekzekutiv.

Dhuna mungonte jo sepse nuk kishte manifestime të ndryshme por sepse konsiderohej normale dhe në manifestimet më të mëdha konsiderohej si shprehje patologjike e agresorëve sikurse shihej edhe tek gratë e dhunuara (mazokizëm, keqkuptim shpirtëror sakrifice).

Ndryshimet e rëndësishme të ndodhur në politikë bënë të mundur që dhuna të shikohej e të bëhej diçka në lidhje me këtë fenomen, lëvizjet politike në fillim ato të SHBA-së dhe pastaj ato të Evropë filluar nga vitet 60 filluan me feminizmin, lëvizjen për të drejtat civile dhe antimilitarizëm².

Tema e dhunës në familje bëhet pjesë e dokumentave më të rëndësishme në organizmat ndërkombëtare nga mezi i viteve 80 mbas denoncimeve të organizatave feministe të cilat e kishin drejtuar edhe vëmëndjen nga media duke i përfshirë edhe kto të fundit.

Në këtë punim do të përmëndim dokumentat më të rëndësishëm të organizatave ndërkombëtare duke i dhënë preferenzë atyre më të hershme.

‘Deklarata e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së mbi eliminimin e dhunës kundër grave’ është një dokument i rëndësishëm pasi është dokumenti i parë në të cilën një organizëm i niveleve më të larta ndërkombëtare siç referohet edhe në Deklaratë mbi ‘një përkufizim të qartë edhe të kompletuar të dhunës kundër grave’ si dhe ‘afirmim të qartë të të drejtave që duhet të aplikohen për të garantuar eliminimin e të gjitha formave të dhunës kundër grave’.

Deklarata nis nga disa premissa disa prej të cilave kanë kuptim të veçantë:

1. ekziston urgjenca për të aplikuar tek grate të drejtat e barazisë, sigurisë, të lirisë, integritetit dhe dinjitetit;
2. dhuna nuk respekton, dobëson dhe anulon gëzimin e të drejtave të njeriut dhe të lirisë nga ana e gruas;
3. dhuna është një manifestim historik i marrëdhënive jo të barabarta ndërmjet burrit dhe gruas, të cilat përbëjnë edhe një moment krucial nëpërmjet të cilit gratë janë të detyruara në një pozicion të nënshtuar në krshasim me burrat;
4. lëvizja e grave ka luajtur një rol të rëndësishëm dhe vendimtar në rritjen e vëmëndjes së natyrës, të rëndësisë dhe dimensionit të problemit.

Gjashtë nenet e Deklaratës kanë të bëjnë me përkufizimin e dhunës dhe aktet e dhunshme, listën e të drejtave të njeriut që janë shkelur nga sjelljet e dhunshme, veprime të rekomanduara për Shtetet për të luftuar këtë fenomen, veprimet e ndërmarra nga agjencitë e Kombeve të Bashkuara.

² Patrizia Romito in “Violenza alle donne e risposta delle istituzioni”, a cura di P.Romito, F.Angeli, Milano, 2000.

Dokumenti i dytë, i cili riprodhon plotësisht pjesën e “*Platformës për Veprim*” e miratuar nga Konferenca e Katërt Botërore mbi Gratë e Pekinit në vitin 1995 është shumë e rëndësishme sepse, kjo Konferencë ishte takimi më i madh ndërkombëtar i mbajtur ndonjëherë për gratë. Deklarata dhe Platforma e Veprimit rezultoi të jetë produkti i një debate të gjata në mesin e rreth 5.000 delegatëve qeveritarë nga 189 vende. Në orët e fundit të Konferencës, pavarësisht nga rezervat e shprehura nga vende të ndryshme dhe nga Ati i Shenjtë, Deklarata dhe Platforma e Veprimit u miratuan unanimisht”.

Dymbëdhjetë tema problematike janë identifikuar në Platformën për Veprim njëra nga këto është dhuna ndaj grave. Dokumenti në thelb rifillon përmbajtjen e Deklaratës së Kombeve të Bashkuara mbi Eliminimin e Dhunës kundër grave të vitit 1993 që është përshkruar më herët, me disa koncepte shtesë që kanë të bëjnë me: në pjesën hyrëse

1. Përfshirjen në listën e shkeljeve të dhunshme të të drejtat e grave në situata të konfliktit të armatosur, në veçanti vrasje, përdhunimin sistematik, skllavërinë seksuale dhe format e tjera të dhunës;

2. Dhuna ndaj grave është veçanërisht e përkeqësuar nga presioni social, mungesa e qasjes mbi informacionet ligjore, ndihmë apo mbrojtje, mungesa e ligjeve që i ndalojnë ato duke vepruar në mënyrë të dhunshme, nga përpjekjet e pamjaftueshme të autoriteteve publike për të promovuar vetëdijen dhe për të zbatuar ligjet ekzistuese;

3. Barazia, bashkëpunimi mes burrave dhe grave dhe respektimi i dinjiteti njerëzor duhet të përshkojë të gjitha nivelet e procesit të socializimit;

4. Mobilizimi i meshkuj është i domosdoshëm për luftën kundër dhunës;

5. Heqja efektive e trafikimit të grave dhe vajzave në tregun e seksi është një problem urgjent për të gjithë bashkësinë ndërkombëtare.

Në të njëjtën Platformë i kërkohet, më në fund:

1. Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për të ofruar të gjithë mbështetjen dhe mjetet që i nevojiten Raportuesit Special të OKB-së për Dhunën kundër Grave;

2. Qeverive dhe organizatave ndërkombëtare që të angazhohen në aplikimin e Direktivave të OKB-së për Gratë Refugjatë;

3. vendet e origjinës, tranzitit dhe destinacionit të grave dhe vajzave që i nënshtrohen trafikut për prostitucion, martesë ose punë të detyruar të merren masat e duhura për të adresuar shkaqet e saj të thella, për të rritur bashkëpunimin me qëllim çmontimin e kapaciteteve kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare të trafikut, ndarjen e burimeve për të ndihmuar viktimat e trafikut, si dhe për të miratuar masat legjislative për ndalimin e turizmit seksual.

Rezoluta e Asamblesë Botërore e Shëndetësisë “Parandalimi i dhunës: një prioritet i shëndetit publik” e vitit 1996 gjejmë njohjen e OKB-së mbi temën e dhunës si çështje të rëndësishme për shëndetin e grave. Prandaj duhet të njihet,

dihet dhe luftohet në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar: atë që Organizata Ndërkombëtare është e angazhuar, me Rezolutën, për të promovuar.

Në të vërtetë, dokumenti i njëj, ndër të tjera, se:

- dhuna ka implikime serioze të menjëhershme, të ardhshme dhe afatgjata shëndetësore;

- dhuna ka një ndikim në rritje në shërbimet e kujdesit shëndetësor;

- Punonjësit e shëndetësisë janë shpesh midis të parëve që shohin viktimat e dhunës dhe gjithashtu të gëzojnë një pozitë të veçantë në komunitet për t'i ndihmuar ata kërkesa drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të ABSH-së për të aktivizuar ndërhyrjet në shëndetin publik drejtuar problemit të dhunës (përskrimi i fenomenit, vlerësimi i efektiviteteve të programeve parandaluese, zbulimin e medias dhe menaxhimin e pasojave, hulumtimet mbi dhunën si prioritet i hulumtimeve shëndetësore, bashkëpunimi midis ABSH-së dhe qeverive në programim dhe monitorimin e programeve të parandalimit dhe kujdesit);

- kërkesa nga Drejtori i Përgjithshëm i ABSH-së për të paraqitur një Plan Veprimi mbi parandalimin e dhunës në shëndetin publik.

Dy vjet më vonë, në vitin 1998, përsëri është Asambleja e Përgjithshme e OKB-së e cila ndërhyrë me një Rezolutë (Nr.52/86) mbi *“Parandalimin e Krimeve dhe Masave të drejtësisë penale për të eliminuar dhunën ndaj grave”*, me shtojcën *“Strategjitë model dhe masa praktike për eliminimin e dhunës kundër tyre gratë në fushën e parandalimit të krimit dhe drejtësisë penale”*.

Pjesa e Rezolutës në kuptimin e ngushtë përbëhet nga një seri rekomandimesh dhe ftesa për Shtetet Anëtare ose organizmat e tjera, që janë:

1. Ftesë shteteve për të rishikuar ligjet dhe politikat e tyre mbi çështjet penale për të kontrolluar ndikimin e tyre mbi gratë dhe përfundimisht t'i modifikojnë ato, në mënyrë që t'u ofrojnë grave trajtim të drejtë nga ana e sistemit të drejtësisë penale;

2. Duke ftuar shtetet për të zhvilluar politika për nxitjen e sigurisë të grave në shtëpi dhe në përgjithësi në shoqëri;

3. Duke ftuar organet e OKB-së për të koordinuar aktivitetet e tyre mbi çështjen e dhunës kundër grave;

4. Një ftesë për shtetet dhe organizatat ndërkombëtare për të përmirësuar botimin e tyre dhe zbulimin e dokumenteve të ndryshme, udhëzimeve dhe dokumenta të OKB-së;

5. Ftesë për Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së për miratimin e *“Strategjive”* të bashkangjitura modele dhe masa praktike *“si udhëzime për qeveritë në përpjekjet e tyre për të adresuar, në nivelin e drejtësisë penale, manifestimet e ndryshme të dhunës kundër grave;*

6. Thirrja e Komisionit për parandalimin e krimit dhe drejtësinë të vazhdojnë të marrin në konsideratë eliminimin e dhunës kundër gratë janë një nga prioritetet e Programit të Parandalimit të Kombeve të Bashkuara e krimit.

Aneksi “*Strategjitë Model dhe Masat Praktike për Eliminimin e dhuna kundër grave*” përmban propozime shumë të hollësishme në lidhje me fushat e ndryshme tematike: legjislacionin, aktet dhe procedurat gjyqësore, procedurat e policisë, sistemin e gjykimeve dhe gjobave, shërbimet sociale dhe shëndetësore, trajnimin, hulumtimin dhe parandalimin.

Për shembull, sa i përket shërbimeve sociale dhe shëndetësore, propozohet që:

1. Aktivizimi dhe financimi i një rrjeti komunikimi të objekteve dhe shërbimeve të arritshme për strehimin emergjent dhe të përkohshëm për gratë dhe fëmijët, subjekteve që janë në rrezik nga dhuna;

2. Aktivizimi dhe financimi i shërbimeve të konsulencës, pritjes telefonike, grupeve mbështetëse për gratë viktime të dhunës dhe fëmijëve tyre;

3. Programimi i programeve për parandalimin e abuzimit me alkoolin dhe drogën, duke pasur parasysh abuzimin e shpeshtë të substancave të tilla në rastet e dhunës;

4. Aktivizimin e njësive të specializuara me profilet e ndryshme profesionale, formimi i të cilave e bëjnë të përshtatshme për t’u marrë me kompleksitetin e rasteve të dhunës.

Në vitin e ardhshëm, 1999, ende në zonën e OKB-së, është miratuar një *Protokoll i Fakultativ* në lidhje me Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) (në kuptimin që çdo shtet mund të vendosë nëse do të bashkohet ose jo, dhe deri më 30 korrik 2001, 72 shtete (duke përfshirë Italinë dhe gati) u bashkuan të gjitha shtetet e Bashkimit Evropian) me qëllim të ripohimit të vendosmërisë së shteteve nënshkruese për të siguruar gëzimin e plotë dhe të barabartë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe të ndërmarrin veprime efektive për të parandaluar shkeljen e këtyre të drejtave dhe lirive.

Megjithëse është një dokument që nuk merret ekskluzivisht me dhunë, por me të gjitha format e diskriminimit dhe privimit të të drejtave themelore të njeriut që gratë inënshtrohen, ky protokoll ka një rol të rëndësishëm në terren për sa i përket dhunës, pasi është një instrument më shumë në dispozicion të grave për të mbrojtur të drejtat e tyre nga dhuna.

Protokollin lejon dhe rregullon dorëzimin e ankesave nga individë ose grupe që u përkasin vendeve që kanë nënshkruar Protokollin njësoj si ato që kanë të bëjnë me diskriminimin dhe shkeljen e të drejtave të njeriut që gratë vuajnë

Dokumenti i paraqitur është është nxjerrë nga rezoluta e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në seancën speciale të titulluar “Pekin + 5” sepse ai synonte të bënte një pikë mbi statusin e grave në lidhje me të dymbëdhjetët zonat kritike të identifikuar në Konferencën e Pekinit më 1995 tema specifike që po i drejtohem, në pikën D të dokumentit të bashkangjitur në Rezolutë i, është folur duke theksuar ndjeshmëri më të madhe dhe më të madhe iniciativa në të kaluarën, por edhe si një problem që është shumë prapa nga zgjidhja.

Konventa e Këshillit të Evropës “*Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje*” – Konventa e Stambollit, u ratifikua me Ligjin nr. 104/2012. Objektivi i kësaj konvente është zbatimi i saj për të gjitha viktimat e dhunës në familje sidomos duke i kushtuar një rëndësi të veçantë grave. Kjo Konventë është hapur për ratifikim që nga 11.05.2011. Kjo Konventë kërkon të vendoset një tolerancë zero për këtë lloj dhune. Prandalimi i dhunës, mbrojtja e viktimave të saj dhe ndjekja penale e dhunuesve.

Kjo Konventë e njeh dhunën ndaj grave si shkelje të të drejtave të njeriut dhe si një formë diskriminimi

Sipas kësaj konvente, dhuna kundër grave konsiderohet shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave dhe nënkupton të gjitha aktet e dhunës gjinore që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, qoftë nëse ndodh në jetën publike ose private. Dhuna në familje, nënkupton të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike, ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose nësisë shtëpiake, ose ndërmjet ish-bashkëshortëve ose partnerëve, ose ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve aktualë, pavarësisht nga fakti nëse autori i veprës penale ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën. Gjini nënkuptohen rolet e ndërtuara në kontekstin social, sjelljet aktivitetet dhe atributet që një shoqëri e caktuar i konsideron të përshtatshme për burrat dhe gratë.

4. Kuadri Evropian mbi Dhunën në Familje

Do të përmëndim disa akte Evropiane mbi dhunën në familje pa hyr në brëndësi të tyre por të cilat rregullojnë dhe parashikojnë rekomandime për parandalimin e dhunës të tillë si: Rekomandimi 1450 (2000) mbi dhunën kundër grave në Evropë; *Rezoluta 1212 (2000) për përdhunimin gjatë konflikteve të armatosura*; *Rezoluta 1247 (2001) mbi gjymtimin gjenital të femrave*; *Rekomandimi 1523 (2001) për skllavërinë e brendshme*; *Rekomandimet 1585 (2002) mbi dhunën në familje kundër grave*; *Rezoluta 1327 (2003) për të ashtuquajturat “krime të nderit”*; *Rekomandimi 1663 (2004) për skllavërinë e brendshme*; *Rekomandimi 1681 (2004) mbi fushatën për të luftuar dhunën në familje*; *Rekomandimi 1723 (2005) për martesat e detyruara dhe martesat me të mitur*; *Rekomandimi 11 (2000) i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare kundër trafikimit të qenieve njerëzore që synojnë instrumentin seksual*; *Programi Daphne* (synon parandalimi e dhunës, fizike, seksuale, psikologjike ndaj fëmijë, të rinjve dhe grave. Ka si synim të mbrojë viktimat dhe grupet të cilat janë të rrezikuara për të grantuar një nivel të lartë mbrojtjeje të shëndetit fizik dhe mendor në të gjithë territorin e Bashkimit Evropian.

5. Kuadri ligjor kombëtar mbi dhunën në familje

Me ratifikimin e Konventës CEDAW, me Ligjin nr. 7767, datë 9.11.1993 dhe Protokollit shtesë të kësaj konvente, me Ligjin nr. 9052, datë 17.4.2003, shteti shqiptar shprehu vullnetin e tij për të përmbushur detyrimet që dalin nga kjo konventë, në lidhje me barazinë gjinore dhe eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e vitit 1998 e miratuar përmes referendumit popullor, si akti ligjor më i lartë i shtetit sanksionoi parimin e barazisë dhe diskriminimit. Në nenin 5 të saj proklamoi se: *‘Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të’*. Referuar hierarkisë së normave, Kushtetuta përcaktoi se ato gjejnë zbatim të drejtëpërdrejtë përveç kur për zbatimin e tyre kërkohet ratifikimi i tyre dhe i dha një epërsi mbi ligjet e shtetit, duke i vendosur në një plan me kushtetutën.

Evokimi drejtëpërdrejtë i Konventës Europiane për të drejtat e Njeriut, në Kushtetutë, i hapi rrugën garancive që ofronin organizmat ndërkombëtarë. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut u pa tashmë si një institucion së cilës mund t’i drejtohej çdo person, organizëm joqeveritar ose grup individësh që pretendojnë se janë dëmtuar nga ndonjë shkelje e shtetit shqiptarë e të drejtave të njohura nga konventa ose protokollet e saj.

Sistemi ligjor shqiptar është i bazuar në parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit dhe mbrojtja dhe respektimi i dinjitetit, i të drejtave dhe i lirive të njeriut përbëjnë detyrim kushtetues. Jeta, martesja, familja gëzojnë mbrojtje të vecantë nga ana e shtetit. Kushtetuta nuk e përjashton mbrojtjen e familjes edhe në rastet kur nuk është e krijuar me martesë. Fëmijët, të rinjtë, gratë shtazëna dhe nënat e reja kanë të drejtë në një mbrojtje të vecantë nga shteti.³

Kushtetuta që në pamje të parë duket sikur ofron vetëm dispozita deklarative, ka krijuar mekanizma garantues të përgjithshëm për mbrojtjen nga dhuna si: Sistemi Gjyqësor, Gjykata Kushtetuese, Avokati i Popullit.

Por megjithëse Kushtetuta sanksionoi barazinë ndërmjet burrave dhe grave kjo pabarazi vazhdon të mbetet e prekshme. Dhuna ndaj gruas, mbeti një problem social, me rrënjë në të kaluarën historike të këtij vendi. Viktimizimi i grave ka ndër faktorët kryesorë gjendjen ekonomike, mentalitetin, të drejtën zakonore.

Kodi Civil, duke i trajtuar të gjithë njerëzit si të barabartë, nëpërmjet instituteve të tij, në nenin 322 sanksionoi rastet kur ndaj trashgimlënësit është ushtruar dhunë nga një trashgimtar, atëherë ky i fundit nuk mund të trashgojë duke qenë i padenjë. I padenjë do të konsiderohet ai trashëgimtar që ka ushtruar dhunë e konkretisht ai që me dashje ka vrarë ose ka tentuar të vrasë trashëgimlënësin, bashkëshorten, fëmijët dhe prindërit e tij; ai që ka bërë ndaj trashëgimlënësit kallëzim ose dëshmi të rreme,

³ Neni 54 i kushtetutës përcakton se “çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht për moshën minimale për punën e fëmijëve që mund të dëmtojnë shëndetin, moralin, jetën ose zhvillimin e tij normal.

për kryerjen e një vepre penale për të cilën parashikohet dënim me vdekje ose me heqje lirie mbi 10 vjet, kur kallëzimi ose dëshmia janë deklaruar të rreme në një gjykim penal; ai që me mashtrim, kanosje e dhunë ka shtyrë trashëgimlënësin që të bëjë, të ndryshojë ose të shfuqizojë testamentin ose ka përpiluar vetë një testament të rreme ose e ka përdorur atë për interesa të tij apo të të tjerëve; ai që është sjellë ndaj trashëgimlënësit në mënyrë poshtëruese dhe që e ka keqtrajtuar atë. Pra siç vërtehet ky është parashikimi i një forme dhune familjare, e cila bënte të mundur që trashëgimlënësi të kishte mundësi për këto shkaqe të përjashtonte nga trashëgimia një pjeshtar të familjes që ai e konsideronte të padenjë, pikërisht për këto arsye.

Ligji nr. 9198 datë 01.07.2004 *“Për barazinë gjinore në Shqipëri”* kishte si qëllim sigurimin e të drejtave të barbarta të grave dhe burrave të garantuara nga Kushtetuta, promovimin e mundësive të barabarta midis burrave dhe grave për të eliminuar diskriminim direkt dhe indirekt, bazuar në gjininë, në jetën publike të vendit, përcaktimin e përgjegjësive të administratës qendrore dhe vendore për të hartuar politikën për promovimin e e një shoqërie gjinore të barabartë. Sipas n. 2 të këtij ligji *“shoqëri gjinore e barabartë”* është ajo shoqëri, ku burrat dhe gratë kanë mundësi të barabarta për të marrë pjesë në veprimtaritë e të gjitha fushave si partnere të barabarta, të ndajnë bashkarisht përgjegjësiutë dhe të gëzojnë të drejta politike, sociale, ekonomike dhe kulturore të barabarta. *“Dhunimi i të drejtave të barabarta për gratë dhe burrat”* ose *“diskriminim”* janë veprimet aktive ose pasive që shprehin nënvlerësim, përbuzje dhe kufizim të të drejtave ose të privilegjeve për arsye të seksit.

Kodi i Familjes në Nenin 62 i K.Familjes *“Masat kundër dhunës”* parashikon se: *“Bashkëshorti ndaj të cilit ushtrohet dhunë, ka të drejtë t’i drejtohet Gjykatës me kërkesë për vendosjen si masë urgjente largimin e bashkëshortit, që ushtron dhunë, nga banesa bashkëshortore”*. E reja që sjell kjo dispozitë është që nuk përcakton gjininë e bashkëshortit të dhunuar.

Me miratimin e ligjit *“Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”* (dhjetor 2006), Kuvendi i Shqipërisë hodhi një nga hapat më të sigurtë për përafrimin e legjislationit shqiptar me standardet ndërkombëtare në fushën e legjislationit kundër dhunës në familje. Zbatimi konkret Ligjit i Nr. 9669, datë 18.12.2006 *“Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”* i cili ka hyrë në fuqi më 1 qershor 2007, mbetet ende një sfidë për institucionet përgjegjëse që ky ligj i ka ngarkuar me detyra të rëndësishme në realizimin e qëllimit të tij: Parandalimi dhe mbrojtja nga dhuna në familje. Ky ligj është plotësuar me një shtojcë përmes ligjit Nr. 9914, datë 12.5.2008 *“Për disa shtesa në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”*. Duke përkufizuar dhunën në familje dhe duke e konsideruar atë si një akt apo qëndrim të një personi ndaj një personi tjetër që çënon integritetin fizik, moral, psikologjik, seksual, social dhe ekonomik të individit, ky ligj siguron mbrojtjen e anëtarëve nga dhuna në familje, në të gjitha format me të cilat ajo mund të shfaqet. Gjithashtu, duke përcaktuar pjesëtarët e familjes që

mbrohen nga ky ligj, ai e shtrin mjaft efektin e tij për subjektet e marrëdhënieve bashkëshortore, të gjinisë, birësisimit, kujdestarisë, deri tek ato të bashkëjetesës, të ish-marrëdhënieve martesore apo të lidhjeve intime, përfshirë edhe lidhjet që nuk ekzistojnë më. Sipas ligjit, gjykatat civile mund të vendosin masa mbrojtëse për viktimat përmes një procedure të thjeshtë, të shpejtë e të përbalueshme nga viktimat. “Urdhër mbrojtjeje” është urdhri i lëshuar me vendim gjykate ku parashikohen masat mbrojtëse për viktimën. UM shqyrtohet nga gjykata brenda 15 ditëve nga bërja e kërkesës ose kërkesë-padisë. “Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje” është urdhri i lëshuar përkohësisht me vendim gjykate, brenda 24 orëve pas parashtrimit të kërkesës, në rastet kur viktimat është një i mitur apo kërkohet mbrojtje për një të mitur, dhe brenda 48 orëve nga bërja e kërkesës, në rastet e tjera. (Ligji nr.10 329, datë 30.9.2010, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar”, neni 18).

Me ligjin nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” u kërkua të arrihej si qëllim parimi i barazisë në lidhje me gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, shtatzaninë, etj. Diskriminim sipas këtij ligji është çdo dallim, përrjashtim, kufizim apo preferenc që e bazuar në cilindo nga shkaqet e sipërcituara..

Ky ligj u përafhua plotësisht me Direktivën e Këshillit 2004/42/KE të 29.06.2000 për “Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave opavarësisht preardhjes racore apo etnike”; Direktivën e Këshillit 2000/78/KE të 27.11.2000 për “Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”; Direktivën e Këshillit 2004/113/KE të 13.12.2004 për “Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t’u furnizuar me mallra dhe shërbime”; Direktivën e Parlemntit Europian dhe të Këshillit 2006/54/KE të 05.07.2006 për “Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës”.

Ndërkohë, K.Penal, i miratuar me ligjin nr. 7895 të vitit 1995, në fillim përveç krimeve seksuale, nuk është se bënte ndonjë diferencim, pasur parasysh tërësinë e zhvillimeve ndërkombëtare, në ndërgjegjësimin e shoqërisë për dhunën në familje apo specifikisht atë ndaj grave. Parashikonte një përmblendje të veprave penale të kryera ndaj fëmijëve, martesës dhe familjes por duke mos u mbajtur parasysh se dhuna e ushtruar në familje kufizohet vetëm në këta anëtarë.

Krimet seksuale dhe ato të trafikimit ishin ndër krimet më specifike që i referoheshin gjinisë.

Megjithatë në kuadrin e përafrimit të legjislacionit vendas me atë ndërkombëtar, edhe Kodi Penal, iu nënshtrua një tërësie ndryshimesh.

Me ligjin nr. 23/2012 datë 01.03.2012, u sanksionua dhuna në familje, si një vepër penale e posaçme. Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit

fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim gjer në dy vjet. Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ishbashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit psikik të tij, dënohet me burgim gjer në tre vjet. Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim gjer në pesë vjet. Po këto vepra, të kryera në mënyrë të përsëritur, ose në praninë e fëmijëve, dënohen nga një deri në pesë vjet.

5.1 Kuadri institucional i dhunës në familje

Ligji i Nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” parashikon dy rrjetet e autoriteteve kryesore kundër dhunës në familje:

1. Autoritetet Administrative
2. Autoritetet Gjyqësore

Autoritetet Administrative

Autoriteti Përgjegjës që mundëson zbatimin e këtij ligji dhe merr përsipër hartimin e politikave dhe strategjive në parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje është Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Ndërsa, aktorë të tjerë të cilët do të bashkërendojnë punën me të janë: Ministria e Brendshme me komisaritetet e policisë në rrethe, Ministria e Shëndetësisë me qendrat shëndetësore në rrethe, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit si dhe Autoritetet lokale (bashki, komuna) me qendrat e shërbimeve sociale pranë tyre.

Është shumë e rëndësishme që të njohim institucionet e përfshira drejtpërdrejt në parandalimin e dhunës në familje; strukturat e krijuara brenda tyre qoftë në nivel qendror dhe në atë vendor si edhe efektivitetin e tyre përmes koordinimit të veprimtarisë ndërmjet tyre më qëllim mbrojtjen e anëtarëve të familjes nga dhuna.

Ligji nr.10 329, datë 30.9.2010, “për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar parashikon ngritjen e “Mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare”⁴. Mekanizmi dhe mënyra e procedimit të tij për mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.” Në hallkat e këtij mekanizmi do të përfshihen përfaqësues të drejtorisë së shëndetit publik dhe mirë funksionimi i tij do të synojë koordinimin midis OJF-ve, policisë, shërbimeve shëndetësore, gjykatave, shërbimeve sociale, dhe institucioneve/organizatave të referimit për të dhënë informacion, për t’i lidhur viktimat me shërbimet dhe për

⁴ Vendimi Nr.334, datë 17.2.2011 i KM

të siguruar vazhdimësinë e kujdesit ndaj tyre; Marrëveshje Bashkëpunimi, datë 14.11.2008, “Për zbatimin e ligjit nr. N9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, ndërmjet: MPCSSHB; MB; MD; MSH; MASH.

Autoritetet përgjegjëse kanë disa detyra të përbashkëta të:

1. hartojnë çdo fillim viti një plan pune të përbashkët, mbështetur në përgjegjësitë ligjore;
2. parashikojnë çdo vit në projekt buxhetin e tyre një zë të veçantë për zbatimin e aktiviteteve konkrete për dhunën në familje;
3. dërgojnë informacione të tjera në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, pranë MPCSSHB

Pushteti vendor në kuadër të reformës së decentralizimit të shërbimit social dhe të ngritjes së rrjetit të shërbimeve komunitare ka disa role dhe përgjegjësi staturore (detyruese), që e bëjnë atë faktor me rëndësi në fushën e koordinimit të të gjithë hallkave dhe veprimeve komunitare kundër dhunës në familje në territorin e tyre. Për këtë, pushteti vendor ka për detyrë të krijojë pranë Sektorit, Drejtorisë apo Departamentit të Çështjeve Sociale në Qark, Bashki apo Komunë një njësi specialistësh që kanë detyrë dhe përgjegjësi administrative zbatimin e kërkesave të Ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Sektori, Drejtoria apo Departamenti i Çështjeve Sociale në Qark, Bashki, Komunë është struktura administrative e specializuar, e cila ka për detyrë:

1. Të njohë problematikën dhe specifikat e ushtrimit të dhunës në territorin që njësia ka në juridiksion, të njohë veçoritë rajonale, zakonet dhe traditat që favorizojnë dhunën në grupe dhe shtresa të veçanta të popullsisë në rajon.

2. Të ketë të atashuar pranë Njesisë, Drejtorisë apo Departamentit të Çështjeve Sociale një ekip multidisiplinar për vlerësimin e rasteve të konstatuara dhe, mbi bazën e vlerësimit të secilit rast, të bëjë propozimet dhe rekomandimet e nevojshme në fushën e parandalimit, zgjidhjes së problemit apo të fillimit të procedurave të procesit rehabilitues në qendrat sociale rajonale apo komunitare.

3. Të ketë statistika sociale të sakta, të marra nga strukturat e vartësisë, të organeve të drejtësisë, policisë dhe informacioneve të tjera në rrugë informale për çdo rast të deklaruar të ushtrimit të dhunës në familje dhe mbi këtë bazë të fillojë punën në përputhje me detyrimet që i ngarkon Ligji “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Në përputhje me kërkesat e Ligjit 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të V.K.M Nr. 563, datë 12.08.2005 “Për përcaktimin e përgjegjësive të Qarkut për shpërndarjen e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore” si dhe Udhëzimin Nr. 1, datë 02.02.2007, për zbatimin e këtij Vendimi të Qeverisë, në çdo Qark janë krijuar Komitetet e Planifikimit të nevojave dhe ofrimeve të shërbimit komunitar, të cilat janë organe që realizojnë procesin e vlerësimit të nevojave, përcaktojnë prioritetet për shërbime dhe planifikojnë shpërndarjen e shërbimeve sociale.

REKOMANDIME

- Nevoja e harmonizimit të legjislacionit të brendshëm me standartet që parashikon Konventa e Këshillit të Evropës ‘Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje’ në lidhje me rrethin e subjekteve që gëzojnë mbrojtje ligjore nga dhuna, përfitimin e shërbimeve panvarsisht raportimit nga viktimat.

- Të përfshihet në detyrimet ligjore të aktorëve përgjegjës informimi i viktimave të dhunës në familje, në rastet kur familja e saj mund të jetë në rrezik, kure autori i veprës penale arratiset ose lirohet përkohësisht ose përfundimisht (ligji nr.104/2012 ‘Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje)

- Është përmirësuar ndjeshëm kuadrin ligjor, por Shqipëria ende duhet të punojë në këtë drejtim - nevojiten përmirësime shtesë për përmbushjen e kërkesave të konventave ndërkombëtare të miratuara dhe për të treguar tolerancë zero ndaj dhunës

- Programe të trajnimit vazhdues për përfaqësuesit e të gjithë institucioneve përgjegjëse për rritjen e ndërgjegjësimit të tyre.

- Të zhvillohen trajnime vazhduese për të gjithë autoritetet përgjegjëse vendore që punojnë në zbatim të legjislacionit kundër dhunës në familje

- Trajnimi I punonjësve të shëndetësisë në indentifikimin e rasteve të dhunës në familje, ofrimin e ndihmës psikologjike, pajisjen e viktimave të dhunës me raport mjekësor, shoqërimin dhe transportimin e viktimave.

- Përmirsimi I situatës *de facto* mbi dhunën në familje si dhe ngritjen e një linje telefonike 24-orëshe si dhe ngritjen e sa më shumë strehëzave.

- Dhënia e informacioneve viktimave të dhunës në familje mbi hapat që ndjek organi I policisë mbi vendimet e gjykatës gjyqësore;

- Vizita të mbikqyrura nga ana e psikologut, punonjësit social apo një person përgjegjës ndërmjet dhunuesit dhe fëmijëve të tij edhe në rastet kur viktimat janë akomoduar në një strehës, gjatë kohës që UM/UMM është në fuqi.

- Në buxhetin e shtetit një zë ti dedikohet jo vetëm viktimave të dhunës në familje por edhe rehabilitimit të dhunuesit.

BIBLIOGRAFI

Dichiarazione sull’eliminazione della violenza contro le donne adottata nella 48° sessione ONU-20 dicembre 1993

Deklarate e Pekinit dhe Platforma për Veprim,1995

Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminit ndaj grave (CEDAW),1979.

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë

K.Penal i Republikës së Shqipërisë 1995.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 1998.

Kodi i Familjes, 2004.

Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” – Konventa e Stambollit, 2011.

Ligji Nr. 9669 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, 2006.

Ligji nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”

Marrëveshje Bashkëpunimi, datë 14.11.2008, “Për zbatimin e ligjit nr. N9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, ndërmjet: MPCSSHB; MB; MD; MSH; MASH.

Prevenzione della violenza: una priorità della sanità pubblica, OMS 1996

Prevenzione del crimine e misure di giustizia penale per eliminare la violenza contro le donne ONU 1998

Protokolli Fakultativ në lidhje me Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAË)

Patrizia Romito in “Violenza alle donne e risposta delle istituzioni”, a cura di P.Romito, F.

Angeli, Milano, 2000

Rezoluta e Asamblesë Botërore e Shëndetësisë “Parandalimi i dhunës: një prioritet i shëndetit publik“, 1996;

Rezolutë (Nr.52/86) mbi “Parandalimin e Krimeve dhe Masave të drejtësia penale për të eliminuar dhunën ndaj grave “, me shtojcën” Strategjitë model dhe masa praktike për eliminimin e dhunës kundër tyre gratë në fushën e parandalimit të krimit dhe drejtësisë penale, 1998

VKM Nr. Nr.334, datë 17.2.2011 “Për Mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij.

VKM Nr.505 dt.13.07.2011 ‘Për miratimin e standarteve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje, në qendrat residenciale, publike dhe jo publike

Sintesi del Protocollo facoltativo relativo alla “Convenzione per l’eliminazione di tutte le forme di discriminazione contro le donne” ONU 1999

REFORMIMI GJYQËSOR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË, NJË DOMOSDOSHMERI PËR INTEGRIM

Msc. Senada LAÇKA

International University of Struga
s.lacka@eust.edu.mk

PHD Candidate Nurten Kala DAUTI

International University of Struga
n.kala@eust.edu.mk

ABSTRAKT

Vetëm një sistem gjyqësor i reformuar qe ka si qëllim forcimin e respektimit të parimit të ndarjes së pushteteve dhe depolitizimit që nënkupton forcimin e pavarësisë së gjyqësorit, funksionimin e pavarur të gjykatave dhe eliminimin e ndikimit të politikës dhe elementeve tjera në vendimet e sistemit gjyqësor, emërimin e gjyqtarëve të paanshëm dhe profesional sipas meritës përmes një procesi transparent dhe të drejtë, rritjen e cilësisë dhe efikasitetit në punën e gjyqtarëve dhe të gjykatave, kanë ndikim të drejtpërdrejtë në forcimin e shtetit ligjor dhe në rritjen e shkallës së demokracisë në Maqedoni.

Integrimi i Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian paraqet qartë dhe padiskutueshëm interes strategjik të shprehur dhe qëllim prioritar në politikën e RM-së.

Fjalë Kyçe: *Sistem gjyqësor, depolitizim, Republika e Maqedonisë, Integrim, Bashkimin Evropian.*

HYRJE

Fushëveprimi i organeve gjyqësore është i caktuar sipas akteve të përgjithshme juridike, domethëne akteve më të larta. Parimisht, gjykatat merren me zgjidhjen e rasteve konkrete, të çështjeve jonormale të cilat krijohen ndërmjet subjekteve të ndryshme të së drejtës, duke pretenduar secila në të drejtën e vet.

Organet gjyqësore interpretimin e ushtrojnë si veprimtari kryesore, në mënyrë profesionale të paanshme natyrisht, duke u bazuar vetëm në autorizimet ligjore dhe në bazë të bindjes së lirë lidhur me rastin apo rastet konkrete. Në këtë mënyrë, rendi juridik mund të zbatohet drejt dhe me efekt, që normat juridike të arrijnë efikasitetin e vet duke siguruar të drejtat dhe liritë e njeriut-qytetarit. Duke siguruar dhe duke mbrojtur këto vlera shoqërore, arrihet barazia dhe siguria juridike e qytetarëve.

Bashkimi i sotëm Evropian është rezultat i një pune të vështirë të atyre që kanë punuar për një Evropë të bashkuar. BE mbështetet në arritjet e tij konkrete. Në asnjë rajon tjetër të botës, shtetet sovraane nuk kanë tërhequr sovranitetin e tyre deri në këtë masë dhe në atë sferë të një rëndësie kruciale për qytetarët. BE-ja ka krijuar një valutë unike dhe një treg dinamik unik, ku njerëzit, shërbimet, mallrat dhe kapitali lëvizin lirish. Unioni përpiqet që përmes progresit social dhe konkurrencës së shëndoshë t'ua mundësojë sa më shumë njerëzve të përfitojnë nga ky treg unik.

Integrimi në BE padyshim si për vendet e tjera ashtu edhe për Maqedoninë kërkon mund dhe reforma. Në rradhë të parë, Maqedonia duhet të respektojë vlerat e demokracisë, shtetit ligjor, respektimit të të drejtave të njeriut dhe minoriteteve, solidaritetit dhe ekonomisë së tregut, në dijeni të plotë se ato përbëjnë themelet e Bashkimit Evropian (kriteret e Kopenhagës). Respektimi i të drejtës ndërkombëtare, paprekshmëria e kufinjve ndërkombëtarë, zgjidhja paqësore e konflikteve dhe bashkëpunimi rajonal janë parime të rëndësishme më të lartë të cilëve ajo duhet përkushtuar. Këtyre elementeve duhet bashkangjitur edhe lufta ndaj ekstremizmit, terrorizmit dhe dhunës, qofshin ato të motivuara etnikisht, politikisht apo kriminalisht.

BASHKËPUNIMI GJYQËSOR MAQEDONI-BE

Anëmbanë Evropës Juglindore, reformat gjyqësore dhe lufta kundër krimit të organizuar janë kyç për perspektivat e integritetit. Për shkak se kriminelët veprojnë ndërmjet kufijve, vendet e Evropës Juglindore duhet të punojnë së bashku me qëllim që t'i sjellin ata para drejtësisë. Veçanërisht për shkak të veprimeve kriminale ndërkufitare, bashkëpunimi midis vendeve është jetik.

Zyrtarët thonë se një bashkëpunim i tillë gjyqësor dërgon një mesazh të fuqishëm për kriminelët, duke i paralajmëruar ata se nuk do të jenë në gjendje të kërkojnë mbrojtje në kufi dhe se sjellja e tyre nuk do të tolerohet cilido vend. Nga bashkëpunimi midis institucioneve dhe autoriteteve, të gjithë ata që kanë kryer akte kriminale duhet të mbahen përgjegjës për krimet e tyre. Vrulli i kohëve të fundit drejt bashkëpunimit mund t'i vishet ofertave të vendeve për në BE e NATO. Antarësimi në dy organizatat ndërkombëtare është kushtëzuar me ngritjen e sektorëve të pavarur gjyqësor dhe mbështetjen e një lufte të efektshme kundër krimit. Një gjyqësor i dobët dhe mungesa e bashkëpunimit të ndërsjellë dhe rajonal e bën të pamundur luftimin e krimit të organizuar.

Shumë krerë rajonalë kanë shprehur pikëpamje të ngjajshme në takimet mbajtur nën patronazhin e BE-së, NATO-s, Paktit të Stabilitetit dhe Këshillit të Evropës.

Në shkurt të vitit të 2011, ministrat e drejtësisë dhe ministrat e punëve të brendshme të dhjetë vendeve të Evropës Juglindore ranë dakord të forcojnë bashkëpunimin në luftën kundër krimit të organizuar, trafikut njerëzor dhe terrorizmit. Shqipëria, Bosnjë Hercegovina (BIH), Bullgaria, Kroacia, Greqia, Maqedonia, Moldavia, Rumania, Sërbi- Mali i Zi dhe Turqia u zotuan të miratojnë ligjet e

tyre që përmbushen standartet e BE-së dhe të Këshillit të Evropës. Ministrat ranë gjithashtu dakord të ngrenë grupe pune me prokurorë e oficerë policie për të hetuar krimin e organizuar në nivelet kombëtare e rajonale.

BE dhe NATO kanë ngritur programe që synojnë rritjen e bashkëpunimit nëpërmjet edukimit dhe trajnimit. Një sërë projektesh për trajnim gjyqtarësh, buxhetimin, zhvillimin institucional, krijimin e institucioneve të reja gjyqësore dhe programet e mbrojtjes së dëshmitarëve janë mbajtur në tërë rajonin nëpërmjet programit të BE-së, CARDS.¹

Vendet në rajon duhet të kapërcejnë dobësitë dhe të arrijnë bashkëpunim më të mirë për një numër arsyesh. Së pari, gjyqësori i pavarur e i besueshëm është një çelës për stabilitetin institucional. Së dyti, një sistem gjyqësor efektiv e i ndershëm është edhe më i rendësishëm për rritjen e zhvillimit ekonomik dhe tërheqjen e investitorëve të huaj. Së treti, sistemet gjyqësore në rajon prirjen të jenë të ngadalta dhe kanë raste të panumërta të pazgjidhura prej kohësh. Dështimi i këtyre sistemeve rrit mungesën e besimit të qytetarit në qeverinë dhe institucionet e saj. Kjo, nga ana e vet, shpie në krim e korrupsion të mëtejshëm, kështu që krijohet një rreth i mbyllur.

Ministria e Drejtësisë të Republikës së Maqedonisë aktualisht po punon në drejtim të përmbushjes së reformave të parashikuara në gjyqësorin të cilat janë pjesë e planit 3-6-9 të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Ministria e Drejtësisë të Republikës së Maqedonisë ka informuar për statusin e realizimit të obligimeve që i ka ministria në përputhje me planin si dhe për aktivitetet të cilat janë të parashikuara për periudhën e ardhshme e që kanë të bëjnë me plotësimin e prioritetëve reformuese. Në këtë kontekst euro ambasadori Zhbogar u informua se së shpejti pritet të finalizohet teksti i Strategjisë për reforma në sektorin e gjyqësorit dhe se përkaj kësaj janë shqyrtuar propozimet e marra nga të gjitha palët e interesuara. Kjo deklaratë u përshëndet nga ana e euro ambasadorit Zhbogar i cili e theksoi rëndësinë e këtij dokumenti strategjik për vendin në përpjekjet e Republikës së Maqedonisë për integrim sa më të shpejtë në Bashkimin Evropian dhe shprehi mbështetjen për të gjitha obligimet që i ka Ministria e Drejtësisë në drejtim të krijimit të kushteve për lehtësimin e procesit euro - integrues.²

Ekspertët theksojnë se kufijtë, kombësitë dhe feja nuk duhet të bëhen pengesë për kapjen e kriminelëve. Ajo që është penalisht e papranueshme në një vend duhet

¹ Programi CARDS është projektuar nga Komuniteti European si vazhdim i Programit Phare. Financimet e destinuar për FSHZH pas vonesash të ndryshme procedurale u bënë efektive vetëm në shkurt të 2004. Menyra e shpërndarjes, seleksionimit dhe buxhetizimit dhe realizimit të nenprojekteve të këtij Programi ka ndjekur të njëjten metodologji të aplikuar nga FSHZH në Projektet/Programet e financuara nga Banka Botërore. Komponenti social i këtij financimi është me i zbehtë se Projektet e Bankes Botërore, nga ana tjetër është me i theksuar komponenti i ngritjes së kapaciteteve të personelit të qeverisë lokale nëpërmjet trainimeve.

² Faqja zyrtare e Ministrisë të Drejtësisë-<http://www.pravda.gov.mk>

të mos tolerohet në një tjetër. Bashkëpunimi në çështjet gjyqësore do të forcojë çdo vend individualisht duke rritur kështu opinionin për rajonin si të tërë. Në të njëjtën kohë, sukcesi në nivelin rajonal do të forcojë gjithashtu perspektivat për vendet individuale.

(PA)VARËSIA E GJYQËSORIT NË MAQEDONI-NEVOJA PËR REFORMA

Çështja e pavarësisë së Gjyqësorit në Maqedoni shihet nga këndvështrime të ndryshme nga pushteti dhe ekspertët. Sipas Qeverive të kaluara, gjyqësia në Maqedoni po shënon përparime të theksuara në drejtim të pavarësisë dhe rritjes së efikasitetit të punës së gjykatave. Por, me këtë qëndrim nuk pajtohen ekspertët, të cilët merren për çdo ditë me këto çështje, si dhe qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët ballafaqohen më së shumti me problemin e gjyqësisë së korruptuar. Ato, madje, nuk janë optimist se edhe gjatë këtij viti do të arrihet që në Maqedoni të vendoset një sistem i pavarur gjyqësor.

Por, ekspertët për çështje juridike nuk janë optimistë se Gjyqësori në Maqedoni edhe gjatë vitit 2017 do të arrijë objektivin e pavarësisë dhe të efikasitetit në raport me kërkesat e qytetarëve, por edhe të evitimit të kritikave të shumta nga bashkësia ndërkombëtare.

Ekspertët për çështje juridike thone se të gjitha dukuritë negative të pushtetit gjyqësor vështirë se do të mund të evitohen edhe gjatë këtij viti, për shkak të, siç shprehet ai, mungesës së gatishmërisë së dy pushteteve tjera për të hequr dorë nga kontrolli i punës së gjykatave.

Arsyeja pse nuk kemi gjyqësor të pavarur, meqë përsëri kemi raste konkrete kur para gjyqësorit paraqiten pushtetet tjera dhe presioni politik shpeshherë ndikon që të mos kemi vendime juridike, por vendime politike. Edhe në raportin e fundit të Komisionit Evropian në vend të parë theksohet gjyqësori, duke insistuar në pavarësimin e plotë të tij, që është kusht, pa të cilin nuk mund të kemi një gjyqësor, që do t'i përgjigjej kompetencës dhe funksionit që ka. Nuk mjafton vetëm miratimi i rregullores pozitive, por kërkohet që ajo rregullore edhe të zbatohet. Bazuar në proceset që ndodhin sot para gjyqësorit, nuk mund të flasim se kemi një gjyqësor të pavarur. Komisioni Evropian në raportin e fundit të progresit, kishte veçuar pikërisht pushtetin gjyqësor si një nga pika më të dobëta të sistemit në Maqedoni.

Nga ana tjetër, projekti ambicioz për bashkim evropian sot gjendet para sfidës më të madhe të deritanishme. Në vitet e ardhshme, Evropa ka gjasa të humb karakterin e trungut. Por, gjithmonë kur hyhet në substancë, thyhen skemat e qëndrimit kombëtar dhe linjat tradicionale historike. Supozohet se janë paraprogramuar konfliktet mes të vegjëlve dhe të mëdhenjve, të vegjlit dhe të mëdhenjtë njëri pas tjetrit, vendet pjesëmarrëse të vjetra kundër të rejave. Karroca dyshe e Francës dhe Gjermanisë rrezikon të dalë nga takti. E tërë kjo vetëm se keqësohet nga dramaturgjia e konferencave qeveritare, një model tani më i demoduar të i cili më shumë vlerësohen

fitimet e pikëve në politikën e brendshme, sesa lufta e përbashkët për Evropën. Nga kjo, del pyetja, a ka Evropa kohë të presë Maqedoninë të ndryshojë qëndrimet e veta apo më mirë të themi, kur do jetë Maqedonia gati, Evropa a do mund të pranojë edhe një shtet tjetër problematik brenda saj?

Në kohën kur organet e drejtësisë në vend po bien ndesh me njëra tjetër për masat që duhen marrë ndaj personave të dyshuar apo akuzuar për krime të ndryshme, e të cilët janë persona publik, thënë ndryshe më së shumeti politikanë, në Maqedoni po del edhe më shumë në sipërfaqe ajo që thuhet tashmë një kohë të gjatë nga ndërkombëtarët se në vend kemi gjyqësor të ngulfatur nga obstruktionet që bënte Qeveria e kaluar dhe i njëjti ende nuk është çliruar. Pikërisht kjo ka bërë që Qeveria e re t'i përvishet punës për kthimin e drejtësisë jo selektive, vendimeve të drejta, sistemit gjyqësorë të pavarur. Thënë më shkurt kthimi i besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë. Fillimish u përfol se Maqedonia, për reformat në gjyqësor, mund të marrë shembullin e Shqipërisë, e cila do të zbatojë Vetting-un, por dje zv. kryeministri Bujar Osmani qartësoi se diçka e tillë nuk do të ndodhë dhe se reformat në gjyqësorin në vend do të zbatohen sipas një tjetër mënyre, duke shtuar se Vetting-u nuk është i përshtatshëm për Maqedoninë, Sipas eksperëve, edhe pse Vetting-u nuk zbatohet në Maqedoni, përsëri ka pjesë shumë të ngjashme mes tij dhe hapave që po merr Qeveria e Maqedonisë për reformat në gjyqësor. Nëse reformat në drejtësi, që janë hapi i parë drejt rikthimit të shtetit të së drejtës, dështojnë, atëherë do të dështojë e gjithë politika e Qeverisë.

Aktualisht, është formuar edhe një këshill për reformat në gjyqësor dhe ai këshill edhe pse nuk sjell vendime ekzekutive, por është organ këshilldhënës, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, Qeverinë dhe shumicën parlamentare, duhet të vendosë për hapat e rradhës që duhet të ndërmerren në gjyqësor. Tani për tani duhet të fillohet me çështjen e shkarkimit që do të thotë përgjegjësia e bartësve të pushtetit gjyqësor, duke përfshirë edhe Këshillin Gjyqësorë të Maqedonisë dhe Këshillin e Prokurorëve dhe pastaj nëpërmjet këtyre dy organeve të kërkohet edhe përgjegjësia konkrete për gjykatës konkret të cilët janë të përfshirë në krim, korrupsion dhe të cilët bëjnë obstrukcione të ndryshme. Duhet të shkohet në reforma radikale, që nënkupton në rend të parë shkarkimin e shumë gjykatësve e prokurorëve duke përfshirë edhe dy organet më përgjegjëse në pushtetin gjyqësor, pra Këshillin Gjyqësorë të Maqedonisë dhe Këshillin e Prokurorëve. Andaj nga ky segment ndoshta edhe ka pika të përbashkëta me Vetting-un, i cili po ashtu në një qasje apo në një nivel të duhur duhet të zbatohet edhe në Maqedoni. Ministria e Drejtësisë ka formuar këshillin për ndjekjen e reformave në gjyqësor. Gjithashtu, ka formuar edhe grupin punues i cili do të bëjë përgatitjen dhe plotësimin e strategjisë në gjyqësor të cilën qeveria duhet ta miratojë deri në tetor të këtij viti.

Sipas analizave nga Instituti i Politikave Europiane në Shkup, në dy vitet e fundit nuk është realizuar pothuajse asgjë nga lista e prioriteve për reforma të përcaktuara nga Komisioni Evropian.

Sipas Ambasadorit të Bashkimit Evropian, Shkelqesia e tij Samuel Zhbogar, tha se prioritet numër një i Maqedonisë duhet të jenë reformat në Gjyqësor duke u marrë parasysh rekomandimet e z.Reinhard Priebe, Eksperti për çështje juridike nga Gjermania, rekomandime të dhëna qysh në vitin 2015, që nënkuptojnë nevojën për debat, transparencë dhe konsensus më i gjërë, pa marrë parasysh kush do të jetë në pushtet.³

KONKLUZION

The Inter-American Court of Human Rights has taken a very innovative position regarding the right of arrested foreigners to consular assistance. It considers it as part of the due process of law. For IACtHR, the right to due process of law must be recognized as one of the minimum guarantees that should be offered to any foreigners/migrant, irrespective of his migratory status. As an essential element of due process of law, the detainee/arrested foreigners must have access to free legal representation provided by a qualified lawyer and be informed of the possibility to request consular assistance.⁴IACtHR refers to the right to consular assistance as human right⁵and an essential element of the right to a fair trial. It has also adopted a specific Advisory Opinion on the Right to Information on Consular Assistance where it explicitly argues on the development of a human right to be informed on consular assistance. As Dembour points, it is a 'truly pioneering' Advisory Opinion,⁶ given that American Convention on Human Rights does not envisage such a right, and neither do other HR instruments. As mentioned in the section above, it was stipulated as a human right for the first time by the Convention on the Rights of all Migrants and their Family Members (art.23). Judge Trindade of IACtHR who firmly advocated a human right approach for the right to information on consular assistance declared that it contributes to extending '*the protecting shield of Law to those who find themselves in a disadvantaged situation- the foreigners under*

² See article 16 (7) of the UN Convention on the Rights of Migrants and Their Family Members.

³ UN Protocol Against Smuggling of Migrants, article 16 (5) which stipulates that 'In the case of the detention of a person who has been the object of conduct set forth in article 6 of this Protocol, each State Party shall comply with its obligations under the Vienna Convention on Consular Relations, where applicable, including that of informing the person concerned without delay about the provisions concerning notification to and communication with consular officers'.

⁴ See the Case of Velez Lloor, Nadege Dorzema, Expelled Haitians adjudicated by the IACtHR

⁵ See also the Advisory Opinion of IACtHR on the Right to Information on Consular Assistance.

⁶ See Dembour 'When humans become migrants', Oxford University Press, 2015.

detention...'.⁷ Along similar lines, Judge Garcia Ramirez added that the right to information on consular assistance puts aliens in the same footing as nationals.⁸ According to him, the 'arrested foreigners face additional difficulties in a country of destination due to limitations posed by their lack of familiarity with the culture, language and environment and other real restrictions on their chances of defending themselves. If these limitations persist, without countervailing measures that establish realistic avenues to justice, then procedural guarantees become rights 'in name only', mere normative formulas devoid of any real content. When that happens, access to justice becomes illusory'.⁹

However, this approach is not shared by other tribunals.¹⁰In two occasions (La Grand Case and Avena Case), the ICJ did not refer to it as a human right, but rather as an obligation deriving from Vienna Convention on Consular Relations.¹¹ The court did not accept the argument of Germany that the right of the arrested foreigner to be informed that he has the right to communicate with consular office and obtain the needed protection, is a human right in the La Grand Case. Similarly, in the Avena Case it did not consider it as a human right, but as an obligation deriving from Vienna Convention on Consular Relations. ICJ argued that in compliance with Vienna Convention on Consular Affairs '*once it is realised that the person is a foreign national, or once there are grounds to think that the person is probably a foreign national*' the authorities must inform him/her on the right to consular assistance'.

ECtHR also has not accepted the existence of a right to information on consular assistance, as part of the right to a fair trial. In the case *Kimmel v. Italy*, it observed that article 6 of the ECHR does not impose an obligation of one member state to inform the Embassy of another state on its proceedings with a foreigner.¹²As Dembour argued 'if the ECHR opted for a dynamic and teleological interpretation of human rights law, as did the Inter-American Court, it could have found that Article 6 of ECHR implicitly encompasses the right of arrested/detained foreigners to consular information. Instead, the ECtHR settled the point by declaring that

⁷ The Right to Information on Consular Assistance in the Framework of the Guarantees of the Due Process of Law, Advisory Opinion OC-16/99, October 1, 1999, Inter-Am. Ct. H.R. (Ser A) No. 16 (1999). See also Dembour p.291 for more details.

⁸ Dembour p 292 and 294.

⁹ Ibid.

¹⁰ Judge Jackman of IACtHR found it difficult to accept that in international law, in every possible case where an accused has not had the benefit of consular assistance, the judicial procedure leading to a capital conviction must, per se, be considered to be *arbitrary*. *Ibid*, See also P. 292 of Dembour.

¹¹ For a detailed analyses of the two cases in Albanian language refer to Luljeta Ikonimi 'E drejta e Migracionit', Botim i Onufrit (2017).

¹² *Kimmel v. Italy*, ECtHR.

Article 6 does not impose an obligation of consular information'.¹³ As it has been noted elsewhere, the ability of ECtHR to establish new avenues for rights protection is not unknown. It has articulated in several cases that Convention is a *living law*. If ECtHR would have wanted, it could have examined the right to consular assistance as part of the right to a fair trial. In this context, Judge Pinto De Albuquerque urged the Court to embrace a theory of interpretation of human rights treaties in a way which not only secures their *effet utile* (*ut res magis valeat quam pereat*), but is also the most protective of the rights and freedoms which they enshrine.¹⁴ The Strasbourg Court judge also cited the Advisory Opinion of IACtHR on *The Right to Information on Consular Assistance in the Framework of the Guarantees of the Due Process of Law* as an illustration of the most protective approach.¹⁵ However, it seems that ECtHR was reluctant to broaden its scope and to recognise the development of a human right to consular assistance for arrested foreigners and/or detained migrants.

It should be emphasised that even though ECtHR refuses to acknowledge a human right for information on consular assistance, it still has pointed to the necessity of consular assistance for noncitizens in the case *Kim v. Russia*.¹⁶ In this case, the Court highlighted the particular vulnerable situation of the applicant, a stateless person, who was unable to benefit from consular assistance and advice, which would normally be extended by diplomatic staff of an incarcerated individual's country of nationality'.

Thus, IACtHR is currently the only international tribunal that refers to the right to information on consular assistance as a human right- as part of the right to due process of law. It should be noted that it is pioneering not only regarding the right to information on consular assistance as part of the fair trial guarantees, but also regarding the applicability of fair trial clause to immigration procedures. IACtHR consolidated this approach in the case of *Velez Lloor*. The applicant was apprehended in Panama without a valid visa in November 2002 and was detained for violation of migration rules for 10 months, in conditions which ACTHR declared to amount to torture.¹⁷ IACtHR did not focus only on the individual claim, but considered it an opportunity to reinforce its approach on detention of immigrants in general. Referring to its Advisory Opinion no.18, the Court reiterated that in

¹³ Dembour cited above p. 294.

¹⁴ Pinto De Albuquerque Concurring opinion in the case of *Centre for Legal Resources on Behalf of Valentin Câmpeanu v. Romania* (*Application no. 47848/08*) He indicates that evolutive interpretation of human rights treaty law has been the position adopted by the Court since *Tyler v. the United Kingdom*.

¹⁵ Judge Pinto de Albuquerque, *Ibid*.

¹⁶ ECHR -Application no. 44260/13.

¹⁷ See for more, Dembour cited above p. 361.

exercise of their power to adopt migratory policies, *States may establish mechanisms to control the entry and departure of non-nationals, but such mechanisms should comply and respect human rights of migrants.*¹⁸ In particular, states must guarantee the right to due process of law, regardless of the migratory status of the individual, in all immigration proceedings. It found in *Velez Loor* that Panama had violated Article 7 of Inter American Convention of Human Rights on safeguards on detention because it did not issue an order of detention, did not provide opportunity of judicial review of lawfulness of detention, did not provide the opportunity for due process of law, no access to free legal aid, nor *effective consular assistance*.¹⁹ It further found that the applicant was subjected to cruel, inhuman, degrading treatment contrary to human dignity, in violation with article 5.1 and 5.2 of the Convention.²⁰ Thus, according to IACtHR the right of foreigners to be informed on their right to communicate with consular office pertains not only to those arrested but also to those detained in the view of the immigration procedures.

According to the IACHR, the right to consular assistance and interpreter, as part of fair trial, are necessary to neutralize the disadvantages faced by detained and arrested foreigners, in order to help reduce, or eliminate the obstacles and deficiencies that impair or diminish an effective defense of one's interests.²¹

4. Developments in Albania

Albania has ratified the Vienna Convention on the Consular Relations. Consequently, the relevant authorities are obliged, by virtue of article 36 the Vienna Convention, to inform all the arrested foreigners that they have the right to communicate with the consular offices of the country of nationality and to be provided with effective means to exercise such a right. In addition, Albania has ratified the International Convention on the Rights of Migrants and Their Family Members, which refers to that right as a human right. Thus, by virtue of hierarchy of legal norms in Albania (article 116 of Albania Constitution), Albanian authorities must respect the human right of every arrested foreigner to be informed regarding the possibility and relevant mechanisms to communicate with their consular officers. However,

¹⁸ This is a standard paragraph used by IACtHR in most of its cases related to undocumented migrants. See also *Pacheco Tineo, Nadege Dozema* and the case of *Expelled Haitians*.

¹⁹ The applicant was not given the possibility to defend himself, could not benefit from consular authorities for support during the process, because administrative procedure did not allow for consular assistance as part of due process of law. He was arrested the criminal contravention of illegal border crossing.

²⁰ Article 5 of the Inter American Convention on Human Rights envisages that *Every person has the right to have his physical, mental, and moral integrity respected* and *'No one shall be subjected to torture or to cruel, inhuman, or degrading punishment or treatment. All persons deprived of their liberty shall be treated with respect for the inherent dignity of the human person'*.

²¹ *Nadege Dozema*, See also *Velez Loor*, para 146.

as it is the case, in practice, the relevant authorities refer less to the international conventions and first and foremost to the national laws. The Albanian Code of Criminal Procedure included such a procedural guarantee only in March 2017, as part of general amendments done to that Code. Thus, article 34/b which envisages the rights of the arrested or detained persons includes an additional guarantee for arrested or detained foreigners, as following:

If the detainee is a foreigner, he has the right to request that the diplomatic or consular representative of his country be informed, and if the person is stateless or refugee, he has the right to request that an international organisation be informed (art 34/b of the Criminal Procedure code).

In compliance with the provisions of the Vienna Convention on Consular Relations and of the International Convention on the Rights of Migrants and their Family members, article 34 (b)(2) obliges the relevant organs to inform the arrested (foreigner) on his right(s), by providing him with in written form the charter of the rights. It goes without saying that the charter of the rights to arrested foreigners should be provided in a language that he understands. The inclusion of this provision is a very positive development in the process of the approximation of the Albanian legislation with the international conventions ratified on the right to consular assistance.

CONCLUSIONS

The need of arrested foreigners for additional safeguards during criminal proceedings as compared to arrested citizens is well known. Such safeguards are necessary to address the barriers that the arrested foreigners face in the trials such as the language and/or lack of information on the legal system. Other difficulties might arise in different context, including discrimination, or factors related with the relations between the country of origin and the country where the foreigner has been arrested. In this framework, international law has tried to diminish such barriers by envisaging the right of the arrested foreigner to be informed on the right to consular assistance and the right of the consular post to communicate, visit, and provide the required assistance to the arrested national, if the later so requests. Originally stipulated in the Vienna Convention on the Consular Affairs, such a right has been reinforced in recent international instruments, with particular relevance to foreigners and/or migrants. As analyzed in this paper, the UN Convention on the Rights of Migrants and their Family Members refers to a human right of arrested or detained migrants to communicate with their consulate and obtain assistance if they request so. Following the Migrants Convention, the Inter-American Court of Human Rights strongly argued for a human right of the arrested foreigner to communicate with the consular office of his state of origin, as an essential part of the right to fair trial. Even though this approach is not widely accepted by other international

and human rights tribunals, the latter, nonetheless point to the importance of such a right in relation to procedural balances when arrested foreigners are concerned.

Albania recognized such a right in its national legislation in 2017, by including an explicit provision in the Code of Criminal Procedure, finally harmonizing the latter with the international conventions ratified. The development of the *charter of rights* for arrested and detained individuals is very positive in this framework, because it enables a clear procedure for informing the arrested individual on his rights. Thus, the responsible authorities are deemed to have complied with their obligation to inform only following the signature of the arrested individual, after receiving the charter of rights.

BIBLIOGRAPHY

Marie Benedicte Dembour ‘When humans become migrants’,
Oxford University Press, 2015.

Luljeta Ikonimi ‘E drejta e Migracionit’, Botim i Onufrit, 2017.

International Treaties

- European Convention on Human Rights
- International Covenant on Civil and Political Rights
- Inter-American Convention on Human Rights
- Protocol against the smuggling of migrants by Land, Sea and Air, Supplementing the United Nations Convention Against Transnational Organized Crime
- UN Convention on the Rights of Migrants and Their Family Members
- Vienna Convention on the Consular Relations

National Law

The Code of Criminal Procedure 7905/1995 as amended by Laws no. 7977/1995, 8027/1995, 8180/1996, 8460/1999, 8570/2000, 8602/2000, 8813/2002; 9085/2003, 9187/2004, 9276/2004, 9911/2008, 10 054/2008, 145/2013, 21/2014, 99/2014, 35/2017.

Decisions and Advisory Opinions of International Tribunals

European Court of Human Rights

Kimmel v. Italy Application 32823/02,

Centre for Legal Resources on Behalf of Valentin Câmpeanu v. Romania, *Application no. 47848/08*.

Tyrrer v. the United Kingdom application No. 5856/72.

International Court of Justice

LaGrand (Germany v. United States of America)

Avena and Other Mexican Nationals (Mexico v. United States of America)

Inter-American Court of Human Rights

The Right to Information on Consular Assistance in the Framework of the Guarantees of the Due Process of Law, Advisory Opinion OC-16/99, October 1, 1999, Inter-Am. Ct. H.R. (Ser A) No. 16 (1999)

Case of Velez Loo v. Panaman 2010

Nadege Dorzema et al v. Dominican Republic 2012

Expelled Dominican and Haitians v. Dominican Republic 2014

Pacheco Tineo Family v. Bolivia

VËREJTJA GJYQËSORE- VËSHTRIM I SAJ NË REPUBLIKËN E KOSOVËS DHE SIPAS KONVENTAVE NDËRKOMBËTARE

Prof. Dr. Sc. Arif RIZA¹
LL. M. Uran ZOGAJ²

ABSTRAKT

Sipas të gjitha parimeve dhe akteve ndërkombëtare, kohët e fundit është bërë përpjekje dhe rekomanduar që të reduktohen në maksimum dënimet me burgim efektiv dhe të vijnë në shprehje dënimet alternative dhe sanksionet tjera penale. Në këtë grup të sanksioneve penale bënë pjesë edhe vërejtja gjyqësore, që paraqet masë apo sanksion të posaçëm penal të tipit “suigeneris”, e cila i përmban disa karakteristika specifike, që bëjnë të veçohet nga të gjitha dënimet dhe sanksionet tjera penale.

Vërejtja gjyqësore është paraparë me dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), duke përfshirë aspektet kryesore lidhur me kuptimin, qëllimin dhe efektet e këtij sanksioni penal, si dhe procedura e shqiptimit të vërejtjes gjyqësore, që sistemohet në kuadër të procedurave të posaçme të KPPRK-së.

Veçoritë specifike që posedon ky sanksion dhe statusi unik i tij, ka bërë që në shumë akte dhe kode penale-procedurale të vendeve të rajonit dhe botës të përcaktohet dhe përfshihet në to, ashtu që vërejtjes gjyqësore i është kushtuar rëndësi e madhe, ku në shumë shtete ajo trajtohet si alternativë e dënimit me burgim.

Fjalë kyçe: *Vërejtje gjyqësore, gjykatë, sanksion penal, aktgjykim, KPRK, KPPRK.*

HYRJE

1. Objektivat dhe arsyet e punimit

Në punimin tonë me titull “*Vërejtja gjyqësore- vështrim i saj në Republikën e Kosovës dhe sipas Konventave Ndërkombëtare*”, si masë veçantë dhe sanksion i posaçëm penal, objekt i studimit është vërejtja dhe qortimi që gjykata ia bënë

¹ Arif RIZA, bornon 29/01/1964, in Dragas, Kosovo, PhD in the domain of International and European – Constitutional Law, at the Law Faculty of the University of Vienna, currently holds a position of the dean at the Faculty of Law, and the professor of the subjects: International Organizations, Constitution and European Law, at the University of Prizren ‘Hoti’ Prizren, Kosovo.

² Uran ZOGAJ was born on 21/9/1989, in Prizren, Kosovo, LL.M. in the domain of Penal Law, at the Faculty of Law of the University of Prishtina “Hasan Prishtina”, Republic of Kosovo. Currently holds a position of the assistant professor- part time for the subjects: Criminal Law, at the University of Prizren “Ukshin Hoti” Prizren, Republic of Kosovo.

kryerësit të veprës penale, në atë mënyrë që atij i bëhet me dije se ka kryer një vepër penale dhe se në të ardhmen do t'i shqiptohet dënim apo sanksion më i rëndë penal, nëse përsëritë një veprim të tillë të kundërligjshëm.

Në të vërtetë, me dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Kosovës³ vërejtjes gjyqësore i kushtohet rëndësi e veçantë, pasi që me një kapitull të ndarë është paraparë ky sanksion penal. Kështu, me Kapitullin e IV-të, në nenet 85 dhe 86 është paraparë në mënyrë konkrete qëllimi që ka vërejtja gjyqësore, kuptimi i saj dhe kriteret që duhet përmbushur për t'u shqiptuar ky sanksion penal.

Pastaj, me Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës⁴ është përcaktuar procedura për shqiptimin e vërejtjes gjyqësore. Në këtë mënyrë, ajo bënë pjesë në kuadër të procedurave të veçanta. Kështu, me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, procedura e shqiptimit të vërejtjes gjyqësore është sistemuar në Kapitullin e XXXI-të, duke përcaktuar aspektet themelore të kësaj procedure, siç janë: organi që është kompetent për shqiptimin dhe mbikëqyrjen e vërejtjes gjyqësore, vendimi me të cilin shqiptohet, mundësia e atakimit të aktgjykimit, etj.

Edhe me konventat dhe aktet tjera ndërkombëtare, si Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (1948), Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (1950), Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (2000), Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, etj., në mënyrë sipërfaqësore përcaktohet detyrimi për shqiptim të masave dhe ndëshkimeve adekuate, në raport me peshën e veprave që kryhen në shoqëri.

Arsyeshmëria e trajtimit të punimit qëndron në faktin se qëllimi i dënimit dhe sanksioneve penale në thelb është riedukimi dhe risocializimi i të dënuarve në shoqëritë demokratike, e më pak ndëshkimi i tyre, shtrohet nevoja që masave dhe sanksioneve alternative, në kuadër të cilave bënë pjesë edhe vërejtja e gjykatës, t'u jepet prioritet dhe rëndësi e nevojshme në teori dhe praktikë gjyqësore, ashtu që në këtë mënyrë do të respektoheshin parimet esenciale demokratike. Pasi që vërejtja gjyqësore paraqet formë të posaçme në mesin e këtyre masave dhe sanksioneve penale, konsiderojmë se ka nevojë që të studiohet dhe trajtohet jo vetëm në aspektin teorik, por edhe në atë legjislativ.

2. Metodologjia e punimit

Sa i përket metodologjisë së studimit, vlen të theksohet se ky punim do të përfshijë këndvështrimin profesional-ligjor, përkatësisht konsultimin dhe shfrytëzimin e literaturës profesionale.

³ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-082, G.Z. Nr. 19/2012 dhe Nr.30/2012, miratuar më 20.04.2012 dhe hyrë në fuqi më 01.01.2013.

⁴ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-123, G.Z. Nr. 37/2012, miratuar më 13/12/2012 dhe hyrë në fuqi më 01/01/2013.

Në pasqyrimin më të mirë të temës përkatëse, metoda hulumtuuese dhe metoda normative- shqyrtimi i akteve vendore dhe atyre të organizatave ndërkombëtare, zënë një vend me rëndësi në këtë punim.

Gjithashtu, gjatë trajtimit të punimit tonë do të përdoret edhe metoda statistikore apo prezantimi i të dhënave nga praktika gjyqësore, sipas burimeve të Agjencisë së Statistikave të Kosovës.

3. Historiku, kuptimi dhe karakteristikat e vërejtjes gjyqësore

Në gjysmën e dytë të shekullit XIX, përkatësisht në periudhën kur në shkencën e së drejtës penale me argumente u cekën pasojat negative të dënimeve afatshkurtra me burg, filluan të paraqiten ide dhe propozime ndërkombëtare, në forume dhe organizime të shumta, që në vend të dënimit me burgim të parashihen sanksione të atilla me të cilat kryerësi i veprës penale nuk do të privohej nga liria, ku në kuadër të këtyre sanksioneve penale padyshim se bënë pjesë edhe vërejtja e gjykatës (Salihu, 2010, 520). Pra, vërejtja gjyqësore paraqitet dhe propozohet si zëvendësim i dënimeve me burgim dhe sanksioneve tjera penale me të cilët cenohen liritë dhe të drejtat e njeriut.

Kështu, në kohët bashkëkohore një metodë gjithnjë e më e zakonshme është ajo e detyrimit të dënimeve minimale, gjegjësisht për kufizimin e lirisë me anë të dënimeve gjyqësore duhen miratuar ligje të detyrueshme, të cilat përcaktojnë dënime dhe sanksione tjera penale që në masë minimale kufizohet liria e individëve në shoqëritë moderne (Dressler&Thomas, 2010, 498).

Edhe me Kartën e të Drejtave Themelore të Unionit Evropian⁵ (2000), në kuadër të preambulës përcaktohet, shtetet evropiane janë të vendosura që të ndajnë së bashku një të ardhme në paqe, bazuar në vlera të përbashkëta, gjithnjë e më shumë të vetëdijshëm për trashëgiminë shpirtërore dhe morale, UE-ja ka rrënjët tek vlerat e pandashme dhe universale të dinjitetit njerëzor, lirisë, barazisë dhe solidaritetit; ai bazohet në parimet e demokracisë dhe të sundimit të së drejtës. (Riza, 2016, 172, AJBALSS).

Në të vërtetë, me Kartën e të Drejtave Themelore të Unionit Evropian, në paragrafin 3 të nenit 49, përpos tjerash theksohet se nuk është e lejuar që ashpërsia e dënimit të jetë në shpërpjesëtim me veprën penale të kryer nga persona të caktuar. Pra, nga kjo dispozitë përcaktohet që dënimi apo sanksioni penal duhet të jetë në përputhje me peshën e veprës penale dhe rrethanat tjera të saj, jo detyrimisht të shqiptohet një dënim me burgim efektiv, që të konsiderohet si meritë në raste konkrete të procedurës penale.

⁵ Karta e të Drejtave Themelore e Unionit Evropian u shpall solemnisht me Traktatin e Nices (2000), ndërsa Projekt Kushtetuta e Evropës në vitin 2004 do t'i jepte fuqinë vepruese. Mirëpo, deri në vitin 2007 me miratimin dhe me hyrjen në fuqi në vitin 2009 të Traktatit të Lisbonës, Karta u bë ligjërishit e detyrueshme.

Po ashtu, sipas nenit 67 të Traktatit për Funkcionimin e Unionit Evropian, Bashkimi bën përpjekje për të siguruar një nivel të lartë sigurie përmes masave për parandalimin dhe luftën kundër kriminalitetit, racizmit dhe ksenofobisë dhe përmes masave për bashkërendimin dhe bashkëpunimin midis autoriteteve policore dhe gjyqësore dhe autoriteteve të tjera kompetente, si edhe përmes njohjes së ndërsjellë të aktgjyqësive në çështjet penale dhe, nëse është nevojë, përmes përafritimit të legjislacionit penal. (Riza & Halili, 2016, 325-326, AJBALSS).

Pastaj, me Deklaratën Universale për të Drejtave të Njeriut⁶ (1948) dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore⁷ (1950) me nenin 11, përkatësisht me nenin 7, në mënyrë shprehimore përcaktohet që dënimet nuk duhet të jenë më të rrepta se sa që parashihen me ligj dhe se në kushtet e përcaktuara me ligj duhet shqiptohen dënime dhe sanksione penale, që janë në përpjesëtim me veprën penale.

Në këtë segment, pas Luftës së Dytë Botërore, kontribut të rëndësishëm dhe konkret kanë dhënë edhe Rregullat e Tokios, që janë miratuar nga ana e Asamblesë së Përgjithshme e OKB-së në Dhjetor të vitit 1990, të cilat rregulla janë krijuar sipas konceptit se dënimi duhet të jetë mjet i fundit dhe se duhet të stimulohen masat dhe sanksionet alternative në vend të dënimit me burgim (Salihu, 2010, 521). Për të realizuar këtë koncept në formë të duhur, një numër i madh i shteteve të Evropës Perëndimore, përpos vërejtjes gjyqësore, kanë paraparë edhe lloje tjera të sanksioneve verbale, siç janë qortimi, paralajmërimi, premtimi nga i pandehuri se nuk do të kryejë veprën penale, etj. (Salihu, 2010, 521).

Kështu, parimet dhe zgjidhjet adekuate që i kushtohen mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut në ligjet e procedurës penale të shteteve bashkëkohore, mbështetjen e kanë në të drejtën ndërkombëtare, përkatësisht në këto akte ndërkombëtare (Salihu, 2011, 84).

Fillimisht, është e rëndësishme të ceket se vërejtja gjyqësore me KPRK është paraparë në kuadër të sistemit të dënimeve dhe sanksioneve penale, respektivisht ajo është përcaktuar si sanksion penal me natyrë specifike. Po ashtu, me Ligjin mbi ekzekutimin e sanksioneve penale të Republikës së Kosovës⁸ (LESPRK), në nenin 2 paragrafi 2 parashihet që përveç dënimeve kryesore, dënimeve alternative, dënimeve plotësuese edhe vërejtja gjyqësore llogaritet si sanksion penal që mund të shqiptohet nga gjykata kompetente

⁶ Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, nxjerrë dhe shpallur në Paris nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 10/12/1949.

⁷ Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, hartuar në Këshilli i Evropës në Romë më 1950 dhe hyrë në fuqi më 3/9/1953.

⁸ Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale i Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-149, miratuar më 29.07.2013 dhe hyrë në fuqi më 12.09.2013.

Vërejtja gjyqësore zakonisht përbëhet apo theksohet në paralajmërimin e personit të dënuar (Kambovski, 2007, 541). Ajo në të vërtetë është qortim i personit të dënuar nga ana e shoqërisë për shkak të veprës së kryer dhe paralajmërim që në të ardhmen të mos bëjë vepra të tilla penale, sepse për veprimtarinë e tillë do të dënohet dhe se shqiptohet në vend të dënimit me burgim, të dënimit me gjobë ose të dënimeve dhe sanksioneve tjera penale që parashihen për atë veprë të kundërligjshme, për kryerësit përgjegjës të veprave penale, veçmas të veprave të lehta penale (Petroviq, 2006, 138). Kështu, kryerësit të një veprë penale apo personit të dënuar nuk i shqiptohet dënimi apo sanksionit tjetër penal që është përcaktuar për atë veprim, mirëpo atij vetëm i bëhet një paralajmërim dhe qortim nga ana e gjykatës.

Siç shihet, vërejtja e gjykatës përbën një masë të veçantë për zëvendësimin e dënimit dhe sanksioneve më të rënda penale, veçanërisht të dënimit me burgim afatshkurtër dhe paraqet hap të rëndësishëm në drejtim të uljes së këtyre dënimeve.

Në këtë mënyrë, masa e vërejtjes së gjykatës është lloji i veçantë i sanksionit jopunitiv, jondëshkues, përkatësisht sanksion verbal, admonitiv dhe këtë masë mund ta shqiptojë vetëm gjykata në kushtet e parapara me ligj (Salihu, 2010, 520). Që të mund ta shqiptojë këtë lloj të sanksionit, gjykata duhet të formojë bindjen në mënyrë të plotë, të parashikojë se vetëm vërejtja gjyqësore do ta arrijë qëllimin e dënimit, qëllimin e preventivës speciale, që personi ndaj të cilit shqiptohet vërejtja, në të ardhmen të mos kryejë veprë tjetër penale (Salihu, Zhitija&Hasani, 2014, 290). Në brendinë e saj apo natyrën e saj, vërejtja gjyqësore është që kryerësit të veprës penale apo të dënuarit t'i tërhiqet vërejtja se ka kryer një veprë të kundërligjshme, të cilën shoqëria në aspektin social dhe etik e vlerëson si negative, të dëmshme, të keqe dhe për atë gjykata i shqipton qortim, gjegjësisht vërejtje (Salihu, 2010, 520). Pra, natyra e kësaj mase është e posaçme, e cila ngërthen në vetvete elemente të vërejtjes, të qortimit dhe elemente të edukimit.

Prandaj, qëllimi i vërejtjes gjyqësore është që kryerësin e veprës penale apo personin e dënuar, në rastet kur vepra penale është më pak e rrezikshme, të mos e ndëshkojë me dënim me burgim nëse kjo nuk është e domosdoshme për mbrojtjen juridike-penale (Salihu, Zhitija&Hasani, 2014, 290). Edhe me dispozitat e KPRK-së, përkatësisht në nenin 85, në një dispozitë të vetme është përcaktuar qëllimi i vërejtjes gjyqësore.

Në mënyrë që të shqiptohet vërejtja gjyqësore, duhet të plotësohen dy kushte në mënyrëkumulative: 1. Që të jetë kryer një veprë penale për të cilën parashihet dënimi me burg deri nënjë (1) vit ose dënimi me gjobë, në rrethana veçanërisht lehtësuese dhe 2. Bindja e gjykatës lidhur me personalitetin e kryerësit të veprës penale apo të dënuarit (Petroviq, 2006, 138-139).

Gjithashtu, edhe me Kodin tonë Penal në paragrafin 2 të nenit 86 përcaktohet se ky sanksion penal mund të shqiptohet për vepra penale për të cilat është paraparë dënimi me burgim deri në një (1) vit ose dënimi me gjobë, në rastet kur veprat

e tilla janë kryer në rrethana lehtësuese të cilat i bëjnë këto vepra veçanërisht të lehta. Pra, me KPRK parashihet që për shqiptimin e vërejtjes gjyqësore, duhet të plotësohen këto dy kushte në mënyrë të përbashkët: vepra konkrete penale dhe rrethanat lehtësuese të kryerjes së tyre. Është e rëndësishme të thuhet se këto vepra penale janë të shumta në numër që inkriminohen sipas dispozitave të Kodit Penal dhe se vërejtja e gjykatës mund të shqiptohet edhe për vepra tjera të kundërligjshme, sipas kushteve të përcaktuara me dispozita të KPRK-së.

Pastaj, me nenin 86 në paragrafin 3ë shtë paraparë se vërejtja gjyqësore mund të shqiptohet edhe për vepra penale të caktuara, për të cilat është paraparë dënimi deri në tri (3) vjet, sipas kushteve të përcaktuara me ligj. Në këtë aspekt, vërejtja gjyqësore përpos veprave penale të parapara në paragrafin 2, ajo mund të shqiptohet edhe për vepra penale më të rënda, ndaj veprave penale për të cilat me ligj parashihet dënimi deri në tri vjet, mirëpo sipas kushteve strikte të parapara me ligj.

Në këto raste, gjykata mund të shqiptojë vërejtjen e gjykatës në lidhje me veprat penale të lartë cekura vetëm nëse Kodi Penal në mënyrë specifike e parasheh këtë mundësi dhe nëse janë plotësuar kushtet e përgjithshme dhe të posaçme që parashihen me ligj (Salihu, Zhitija & Hasani, 2014, 290).

Më tutje, me Kodin Penal përcaktohet që gjykata mund të shqiptojë vërejtjen gjyqësore për më shumë se një vepër penale të kryer në bashkim, nëse për çdonjërin nga këto vepra ekzistojnë kushtet përkatëse nga paragrafi 2 ose 3 të nenit 86. Pra, nëse janë kryer më shumë se një vepër penale në bashkim, atëherë për secilën nga këto vepra penale duhet plotësohen kushtet për shqiptimin e këtij sanksioni penal.

Me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e vërejtjes gjyqësore, gjykata duke pasur parasysh qëllimin e këtij sanksioni, veçmas do të marrë në konsideratë personalitetin e kryerësit, jetën e tij të mëparshme, sjelljen e tij pas veprës së kryer penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrethanat e tjera në të cilat është kryer vepra, si dhe gatishmërinë e tij që vullnetarisht t'i nënshtrohet programit të mjekimit (Salihu, 2010, 522-523).

Andaj, nocioni i vërejtjes gjyqësore, karakteristikat unike të këtij sanksioni penal, qëllimi dhe natyra e vërejtjes gjyqësore, kriteret që duhet përmbushur në mënyrë që të shqiptohet ky sanksion dhe veçori tjera, bëjnë që vërejtja gjyqësore të konsiderohet masë e posaçme penale apo sanksion penal me natyrë “suigeneris”.

4. Procedura për shqiptimin e vërejtjes gjyqësore

Është e rëndësishme dhe karakteristike e posaçme që vërejtja gjyqësore si sanksion i posaçëm penal shqiptohet *me aktgjykim*. Një gjë e tillë është përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 498 të KPPRK-së. Më tutje, dispozitat e KPPRK-së, përkatësisht në paragrafin 2 të këtij neni theksohet se dispozitat e këtij Kodi lidhur me aktgjykimin që i pandehuri shpallet fajtor, zbatohen përshtatshmërisht edhe ndaj aktgjykimit për vërejtje gjyqësore.

Për dallim nga vendi ynë, me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Maqedonisë⁹ (KPPRM), në nenin 521 përcaktohet se vërejtja e gjykatës shqiptohet me anë të vendimit-aktvendimit, e jo me anë të aktgjykimit. Me këtë vendim lidhur me vërejtjen gjyqësore, kryerësi i veprës penale nuk shpallet fajtor (Kambovski, 2007, 543).

Gjithashtu, edhe me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Malit të Zi¹⁰ (KPPRMZ), me nenin 465 përcaktohet që vërejtja gjyqësore shqiptohet me anë të vendimit-aktvendimit, pra jo me anë të aktgjykimit.

Vërejtja gjyqësore, gjegjësisht aktgjykimi lidhur me këtë sanksion penal shpallet menjëherë pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, së bashku me arsyet esenciale dhe shpallja nuk ka mundësi që të shtyhet dhe menjëherë posa të shpallet aktgjykimi, palët kanë të drejtë që të heqin dorë nga e drejta në ankesë (Sahiti & Murati, 2013, 445).

Në vazhdim, dispozitivi i aktgjykimit lidhur me vërejtjen gjyqësore përmban të dhënat personale për të akuzuarin, emërtimin ligjor të veprës penale, fakti se ajo shqiptohet për veprën që është objekt i aktakuzës, urdhrin për shqiptimin e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim ose urdhrin për marrjen e dobisë pasurore si dhe vendimin për shpenzimet e procedurës penale, për kërkesën pasurore juridike dhe përcaktimi nëse aktgjykimi i formës së prerë duhet shpallur nëpërmjet medieve apo mjeteve tjera të informimit (Sahiti, Murati & Elshani, 2014, 1171). Pasi që aktgjykimi mbi vërejtjen gjyqësore është më i afërt me aktgjykimin dënues dhe nuk ka të bëjë me llojet e tjera të aktgjykimit, gjykata në dispozitiv të këtij aktgjykimit, krahas konstatimit se i akuzuari ka kryer veprën penale, duhet ta shpall fajtor të akuzuarin (Sahiti, Murati & Elshani, 2014, 1171).

Pastaj, me paragrafin 3 të nenit 499, parashihet që në arsyetim të aktgjykimit mbi vërejtjen gjyqësore, gjykata paraqet arsyet dhe shkaqet në të cilat është bazuar me rastin e shqiptimit të këtij sanksioni penal.

Palët që janë të përfshira në procedurë penale, gjegjësisht palët që janë të etiketuar nga aktgjykimi i vërejtjes gjyqësore, kanë të drejtë të paraqesin ankesë kundër këtij aktgjykimi, nëse pretendojnë se është bërë ndonjë cenim i dispozitave penale-procedurale apo për shkak të ndonjë pasaktësie tjetër.

Kështu, kundër aktgjykimit mbi shqiptimin e vërejtjes gjyqësore mund të paraqitet ankesë për shkak të shkeljes së dispozitave esenciale të procedurës penale, shkeljes së dispozitave të Kodit Penal, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të mosekzistimit të rrethanave që e arsyetojnë shqiptimin e vërejtjes gjyqësore (Hajdari, 2013, 150). Po ashtu, sipas nenit 500 në

⁹ Kodi nr. 15/97 i Procedurës Penale i Republikës së Maqedonisë, miratuar më 3/4/1997, i ndryshuar dhe plotësuar ndër vite.

¹⁰ Kodi nr. 57/09 i Procedurës Penale i Republikës së Malit të Zi, miratuar më 18/8/2017, ndryshuar dhe plotësuar ndër vite.

paragrafin 2 përcaktohet se aktgjykimi mbi vërejtjen gjyqësore mund të atakohet edhe për shkak se gjykata nuk e ka aplikuar drejtë masën për trajtim të detyrueshëm për rehabilitim, ose të marrjes së dobisë pasurore, apo për shkak se vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale ose kërkesën pasurore juridike është marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore (Sahiti&Murati, 2013, 445). Pra, palët sipas mendimit të tyre mund ta kundërshtojnë aktgjykimin mbi vërejtjen gjyqësore, kur vendimet lidhur me çështjet e lartë cekura janë në kundërshtim me ligjin.

Sipas dispozitave të KPPRK-së, në nenin 501 parashihet se shkelje e ligjit penal ekziston edhe atëherë kur me rastin e shqiptimit të vërejtjes gjyqësore, gjykata tejkalon autorizimet që i ka me ligj, përkitazi me vërejtjen gjyqësore, masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitimin ose konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale.

Në rastet kur ankesa kundër aktgjykimit për vërejtje gjyqësore paraqitet nga ana e prokurorit në dëm të të akuzuarit, Gjykata e Apelit mund të marrë aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor dhe gjykohet me dënim ose shqiptohet dënim alternativ kur çmon se gjykata themelore përkatëse saktë ka vërtetuar dhe administruar provat materiale, por zbatimi i drejtë i ligjit kërkon shqiptimin e dënimit (Hajdari, 2013, 150). Gjithashtu, sipas paragrafit 2 të nenit 501 të KPPRK-së, Gjykata e Apelit mund të vendosë për çfarëdo ankese kundër aktgjykimit mbi vërejtjen gjyqësore të paraqitur nga cilado palë, me aktgjykim me të cilin aktakuza hedhet, ose me aktgjykim me të cilin i akuzuari lirohet nga akuza kur çmon se gjykata themelore i ka vërtetuar saktë faktet vendimtare, por zbatimi i drejtë i ligjit kërkon marrjen e ndonjërit nga këto aktgjykime.

Në paragrafin 3 të këtij neni theksohet se në rast kur Gjykata e Apelit vërteton se nuk ekzistojnë shkaqet për të cilat është parashtruar ankesë kundër aktgjykimit mbi vërejtjen gjyqësore dhe se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje të Kodit Penal, shkelje të dispozitave lidhur me mbrojtjen në procedurë penale, atëherë ajo merr aktgjykim me të cilin refuzohet ankesa si e pabazë dhe vërteton aktgjykimin e gjykatës themelore mbi vërejtjen gjyqësore.

Vërejtja gjyqësore, si masë dhe sanksion penal me karakter të posaçëm, shqiptohet vetëm nga gjykata kompetente dhe karakteristikë e saj është se mbikëqyrja e ekzekutimit të saj nuk bëhet nga ndonjë institucion specifik, pasi as me ligj nuk parashihet ndonjë dispozitë e posaçme lidhur me këtë çështje, mirëpo në një formë ajo në mënyrë indirekte mbikëqyret nga ana e gjykatës dhe institucionet tjera të drejtësisë, si: policia, prokuroria, etj.

5. Shqiptimi i vërejtjes gjyqësore në praktikën gjyqësore

Vërejtja gjyqësore si sanksion penal është i kohës së vonshme dhe për këtë arsye në praktikën gjyqësore, sidomos të vendit tonë, ekziston një numër i vogël i shqiptimit të saj nga ana e gjyqtarëve të gjykatave kompetente.

Nëtë vërtetë, idetë dhe propozimet e para për futjen e vërejtjes gjyqësore në sistemin e dënimeve dhe sanksioneve penale u paraqitën që nëgjysmën e dytë të shek. XIX. Mirëpo, këto përpjekje u intensifikuan më shumë nëgjysmën e dytë dhe fund të shek. XX, atëherë kur me akte, konventa dhe rregulla të organizatave më të rëndësishme ndërkombëtare, filloi shprehimisht të theksohet nevoja për reduktim të shqiptimit të dënimeve me burgim efektiv dhe zëvendësim të tyre me disa alternativa të dënimit, sidomos në rastet kur me ligj parashihen dënime me burg afat shkurtër dhe kur përmbushen kushtet tjera për sanksione të tilla.

Edhe me legjislacionin procedural-penal të vendit tonë është përcaktuar vërejtja gjyqësore, duke paraparë aspektet kryesore në mënyrë konkrete lidhur me këtë sanksion penal.

Mirëpo, në praktikën gjyqësore të gjykatave kompetente në vendin tonë, numri i vërejtjes gjyqësore si sanksion penal është i vogël, ku në periudhën 2013-2016 nga numri i përgjithshëm i dënimeve dhe sanksioneve tjera penale, rreth 2% përbënte aktgjykimetme të cilët është shqiptuar vërejtja gjyqësore.

Në të vërtetë, nëse vështrijmë në aspektin tabelor vërejtjen gjyqësore që është shqiptuar nga ana e gjykatave themelore të Republikës së Kosovës, ndaj kryerësve të veprave penale, na paraqitet kjo gjendje:

Tabela 1. Shqiptimi i vërejtjes gjyqësore në gjykatat themelore të Republikës së Kosovës¹¹

Shqiptimi i vërejtjes gjyqësore në territorin e Republikës së Kosovës			
Viti	Numri i personave të dënuar me dënime dhe sanksione penale	Numri i personave të dënuar me vërejtje gjyqësore	Përqindja e aktgjykimëve mbi vërejtjen gjyqësore
2013	15,046	170	1.13%
2014	17,490	325	1.86%
2015	16,344	579	3.65%
2016	17,859	672	3.76%
Gjithsej	66,739	1,746	2.60%

Siç mund të shihet nga të dhënat e prezantuara, në vitin 2013 nga 15,046 dënime, sanksione penale dhe masa tjera që janë shqiptuar ndaj kryerësve madhor të veprave penale, 170 apo 1,13% të tilla ishin vërejtje gjyqësore.

Pastaj, gjatë vitit 2014, numri i aktgjykimëve me të cilët është shqiptuar vërejtja gjyqësore është 325, nga 17,490 dënime dhe sanksione penale që janë shqiptuar ndaj kryerësve të veprave penale apo përkthyer në përqindje 1,86%

¹¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e jurisprudencës për persona madhor 2013-2016, Prishtinë, 2014-2017.

përbënin vërejtjen e gjykatës.

Në vazhdim, në vitin 2015, nga gjykatat themelore në territorin e Republikës së Kosovës u shqiptuan gjithsej 16,344 dënime dhe sanksione tjera penale, prej të cilëve 579 apo 3,65% përbënin vërejtjen e gjykatës.

Në fund, gjatë vitit 2016, nga gjithsej 17,859 dënime dhe sanksione penale që janë shqiptuar nga gjykatat kompetente ndaj kryerësve të veprave penale, 672 apo 3,76% prej tyre ishin aktgjykime lidhur me vërejtjen e gjykatës.

Prandaj, nga të dhënat e prezantuara lidhur me shqiptimin e këtij sanksioni penal nga ana e gjykatave kompetente në vendin tonë, vërehet një tendencë e rritjes së shqiptimit të saj në mënyrë të vazhdueshme.

6. PËRFUNDIMET

Vërejtja gjyqësore përbën një sanksion penal apo masë të posaçme, që me të drejtë cilësohet e natyrës “suigeneris”, e cila shqiptohet vetëm nga ana e gjykatës sipas kushteve të përcaktuara me ligj, me anë të së cilës kryerësit të një veprimi të kundërligjshëm apo të dënuarit i tërhiqet vërejtja, paralajmërohet apo qortohet se ka kryer vepër penale, të cilën shoqëria e vlerëson si negative, të dëmshme, të keqe dhe për atë gjykata i shqipton vërejtje, në rastet kur nuk është e domosdoshme të ndëshkohet me dënim më të rëndë.

Arsyeshmëria dhe nevoja për shqiptimin e këtij sanksioni penal nga ana e gjykatave kur plotësohen kushtet dhe rrethanat që parashihen me ligj, qëndron në atë se ajo përbën zëvendësim të dënimit me burg dhe dënimeve tjera dhe efekti i kësaj mase arrihet te personi i dënuar, pa pasur nevojë që të shqiptohen dënime me burgim, gjithnjë kur një gjë e tillë nuk është e nevojshme.

Që të shqiptohet vërejtja gjyqësore, duhet të plotësohen dy kushte në mënyrë shprehimore dhe të përmbledhur: 1. Që të jetë kryer një vepër penale për të cilën sipas ligjit mund të shqiptohet ky sanksion penal dhe të jetë kryer në rrethana veçanërisht lehtësuese dhe 2. Të ekzistoj bindja e gjykatës lidhur me personalitetin e kryerësit të veprës penale apo të dënuarit.

Me dispozitat e KPRK-së përcaktohet që vërejtja e gjykatës mund të shqiptohet ndaj veprave penale për të cilat është paraparë dënimi me burgim deri në një (1) vit ose dënimi me gjobë, për vepra penale për të cilat është paraparë dënimi me burgim deri në tri (3) vjet, sipas kushteve të përcaktuara me ligj dhe ajo mund të shqiptohet për më shumë se një vepër penale të kryer në bashkim, nëse për çdonjërin nga këto vepra ekzistojnë kushtet përkatëse për shqiptimin e vërejtjes gjyqësore.

Me dispozitat procedurale-penale të Republikës së Maqedonisë, Malit të Zi dhe të vendeve të shumta të rajonit e më gjerë, përcaktohet se ky sanksion penal shqiptohet me anë të aktvendimit, e jo aktgjykimit. Në këtë drejtim, Kodi ynë Penal konsiderojmë se me shumë të drejtë ka paraparë që vërejtja gjyqësore të shqiptohet me aktgjykim, duke i dhënë rëndësi dhe vlerë të posaçme në sistemin e dënimeve dhe sanksioneve penale.

Sipas dispozitave të KPPRK-së, përcaktohet që kundër aktgjykimit mbi shqiptimin e vërejtjes gjyqësore mund të paraqitet ankesë për një grup arsyesh dhe shkaqesh, ndër të cilat theksohen: për shkak të shkeljes së dispozitave esenciale të procedurës penale, shkeljes së dispozitave të Kodit Penal, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, për shkak të mosekzistimit të rrethanave që e arsyetojnë shqiptimin e vërejtjes gjyqësore, për shkak se gjykata nuk e ka aplikuar drejtë masën për trajtim të detyrueshëm për rehabilitim, për shkak të marrjes së dobisë pasurore, për shkak se vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale ose kërkesën pasurore juridike është marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe për shkak të tejkalimit të autorizimeve të gjykatës lidhur me vërejtjen gjyqësore.

Nga fillimi i vitit 2013 deri në fund të vitit 2016, aktgjykimet lidhur me vërejtjen gjyqësore nga gjykatat themelore të Republikës së Kosovës është rritur në vazhdimësi numri dhe pjesëmarrja në përqindje në totalin e dënimeve dhe sanksioneve penale, që tregojnë për një zhvillim pozitiv në drejtim të zvogëlimit të dënimit me burg, kur ekziston mundësia dhe përcaktimi me ligj dhe për një vetëdijesim të vazhdueshëm të gjyqtarëve të këtyre gjykatave që të mos shqiptohen vetëm dënime me burg në mënyrë klasike.

7. REFERENCAT

I. Libra dhe artikuj shkencor

- Dressler, J. & Thomas, C. G. (2010). Criminal procedure: Prosecuting crime. Ohajo.
- Hajdari, A. (2013). E drejta e procedurës penale- Pjesa e posaçme. Prishtinë. Universiteti Iliria.
- Kambovski, V. (2007). E drejta penale- pjesa e përgjithshme. Shkup. UEJL.
- Petroviq, B. (2006). E drejta penale. Sarajevë/Prishtinë. AAB dhe FKN.
- Riza, A. (2016). Relations between the EU and Republic of Kosovo - The path of Kosovo integration towards the EU. *Academic Journal of Business, Administration, Law and Social Sciences, Vol. 2(2)*, 171-177. ose marrë nga <http://iipcl.org/wp-content/uploads/2016/07/171-177.pdf>.
- Riza, A. & Halili, F. (2016). European Criminal Law after the Lisbon Treaty, or Europeanization of European law, under the co-responsibility of the Member States. *Academic Journal of Business, Administration, Law and Social Sciences, Vol. 2(3)*, 324-328. ose marrë nga <http://iipcl.org/wp-content/uploads/2016/12/324-328.pdf>.
- Sahiti, E. (2005). E drejta e procedurës penale. Prishtinë.
- Sahiti, E. & Murati, R. (2013). E drejta e procedurës penale. Prishtinë. Universiteti i Prishtinës.
- Sahiti, E., Murati, R. & Elshani, Xh. (2014). Komentari i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Prishtinë. GIZ.
- Salihu, I. (2010). E drejta penale-pjesa e përgjithshme. Prishtinë. Universiteti Fama.

Salihu, I. (2011). E drejta penale ndërkombëtare. Prishtinë. Universiteti Fama.
Salihu, I., Zhitija, H. & Hasani, F. (2014). Komentari i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Prishtinë. GIZ.

Sijerçiq-Çoliq, H. & Halilović, H. (2007). Krivičnoprocesnopravo s posebni-mosvrtnom na krivičniprostupak Kosova. Prishtinë.

II. Ligjet dhe aktet ndërkombëtare

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut. (1949).

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. (1950).

Karta e të Drejtave Themelore e Unionit Evropian shpallur me Traktatin e Nices. (2000).

Kodi Penal i Republikës së Kosovës. (2013). Nr. 04/L-082, G.Z. Nr. 19/2012 dhe Nr.30/2012.

Kodi i procedurës penale i Republikës së Kosovës. (2013). Nr. 04/L-123 dhe G.Z. Nr. 37/2012.

Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale i Republikës së Kosovës. (2013). Nr. 04/L-149.

Kodi nr. 15/97 i Procedurës Penale i Republikës së Maqedonisë. (1997).

Kodi nr. 57/09 i Procedurës Penale i Republikës së Malit të Zi. (2009).

III. Burime të tjera

Ajencia e Statistikave të Kosovës. (2014). Statistikat e jurisprudencës për persona madhor 2013. Prishtinë.

Ajencia e Statistikave të Kosovës. (2015). Statistikat e jurisprudencës për persona madhor 2014. Prishtinë.

Ajencia e Statistikave të Kosovës. (2016). Statistikat e jurisprudencës për persona madhor 2015. Prishtinë.

Ajencia e Statistikave të Kosovës. (2017). Statistikat e jurisprudencës për persona madhor 2016. Prishtinë.

8. Shkurtesat

KPRK Kodi Penal i Republikës së Kosovës.

KPPRK Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës.

LESPRK Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale i Republikës së Kosovës.

OKB Organizata e Kombeve të Bashkuara.

UE Unioni Evropian.

KPPRM Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Maqedonisë.

KPPRMZ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Malit të Zi.

“ASGJËSIMI I KAMPIONËVE BIOLOGJIKË NË PRESPEKTIVËN EUROPIANE”

Dr. Entela NIKAJ¹
Dr. Edlira JORGAQI²

ABSTRAKT

Qëllimi i këtij neni është të sigurojë procedurën e shkatërrimit të mostrave biologjike që janë marrë në përputhje me parashikimet e nenit 201/a të Kodit të Procedurës Penale. Një parashikim i tillë është në përputhje me nenin 8 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Nje-riut; me Vendimin Kuadër të Këshillit të Bashkimit Evropian, 2008-977 “Mbi mbrojtjen e të dhënave personale të përpunuara në kuadër të bashkëpunimit policor dhe gjyqësor në çështjet penale” dhe Direktivës së BE-së 95/46/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 24 tetorit 1995 “Mbi mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave. Neni 201/b i Kodit të Procedurës Penale parashikon kohën e ruajtjes së kampionëve biologjikë dhe detyrimin që asgjësimi i tyre të bëhet në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale si dhe procedurat që duhet të ndjekin organet shtetërore për këtë qëllim në rastin kur i pandehuri deklarohet i pafajshëm me vendim të formës së prerë, ashtu edhe kur i pandehuri deklarohet fajtor. Dispozitat e nenit 201/b parashikojnë rregulla edhe në lidhje me profilet e ADN-së të kampionëve që janë marrë në vendin e ngjarjes dhe që nuk i atribuohen një personi të caktuar. Punimi synon të vërë në dukje aspektin krahasimor të kësaj dispozite duke analizuar përmbajtjen e saj me standardet evropiane në këtë drejtim.

***Fjalë kyçe:** procedura e shkatërrimit të mostrave biologjike, të dhënat personale dhe lëvizja e lirë, ruajtja e kampionëve biologjikë të marra nga persona të tjerë, marrja me detyrim e kampionëve biologjikë, kryerja e procedurave mjekësore të detyruara.*

¹ Entela Nikaj, Këshilltare për Pëafrimin e Legjislacionit Kuvendi i Shqipërisë, email: nikajentela@gmail.com ose entela.nika@parlament.al

² Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (anëtar) , email : ejorgaqi@gmail.com

1. HYRJE

Kodi i Procedurës Penale parashikon rregullat e zhvillimit të procedimit penal në të gjitha fazat e tij, duke filluar nga hetimi, gjykimi, nxjerrja e vendimit dhe zbatimi i vendimit. Analiza e Sistemit të Drejtësisë, e përgatitur nga ana e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë³ nxori në pah disa probleme që dobësojnë garancitë procedurale gjatë procesit penal. Gjatë fazës së hetimit, këto probleme përfshijnë: (i) mungesën e qartësisë në lidhje me pozitën dhe rolin e prokurorit në fazën fillestare të hetimit; (ii) mungesën e përputhshmërisë ndërmjet afateve kohore për hetimin dhe tipin e krimit që hetohet; (iii) mungesën e përkufizimit të pasojave konkrete për rastet kur afatet e hetimit tejkalohen; (iv) mungesën e qartësisë në lidhje me pozitën e prokurorit në përfundimin e hetimeve dhe në kontrollin e tyre. Problemet e theksuara për fazën e gjykimit përfshijnë: (i) mungesën e efikasitetit të gjykimit; (ii) respektimi i parimit të procesit të rregullt ligjor sa i takon mundësisë së zhvillimit të gjykimit në mungesë; (iii) kufijtë e shqyrtimit nga gjykatat e apelit dhe kolegji penal i Gjykatës së Lartë, etj.

Si praktika gjyqësore e deritanishme, ashtu edhe dokumenti analitik i sistemit të drejtësisë penale dhe dokumenti strategjik⁴ kanë evidentuar nevojën për ndryshimin e disa prej instituteve të Kodit të Procedurës Penale, me qëllim përfshirjen e standardeve europiane më të mira në legjislacionin shqiptar.

Nga ana tjetër, ndryshimet kushtetuese dhe miratimi i ligjeve të tjera që i pasuan ato sollën nevojën për reflektimin e këtyre ndryshimeve edhe në ligjin procedural penal.

Në Dokumentin Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë, miratuar me vendimin nr.15, datë 30.07.2015 të Komisionit të Posaçëm, ndër objektivat e parashikuara në fushën e drejtësisë penale janë: (1) Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit të drejtësisë penale nëpërmjet konsolidimit të misionit dhe funksioneve të prokurorisë, si dhe përmes riorganizimit të strukturave të saj dhe rishpërndarjes së përgjegjësisë mes tyre (2) Forcimi i garancive procedurale në fazën e hetimeve paraprake dhe gjatë gjykimit në shkallë të parë dhe në apel; (3) Forcimi dhe përmirësimi i statusit dhe pozitës juridike të viktimës në procesin penal. Këto objektiva u konkretizuan në Planin e Veprimit për zhvillimin e strategjisë, duke përcaktuar rishikimin e Kodit të Procedurës Penale edhe në pjesën e mjeteve të kërkimit të provës.

Në këtë kontekst ligjor dhe historik, ndërhyrje masive në Kodin e Procedurës Penale u bënë nëpërmjet parashikimeve të ligjit nr. 35/2017 ***“Për Disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin 7905, Datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” të Ndryshuar***. Neni 201/b i Kodit të Procedurës Penale

³ Për më gjerë shiko http://reformanedrejttesi.al/sites/default/files/dokumenti_shqip.pdf

⁴ Për më gjerë shiko <http://reformanedrejttesi.al/dokumenti-strategjik-dhe-plani-i-veprimit>.

është një dispozitë e re e shtuar pas nenit 201/a meqënëse një rregullim i tillë të garantohet nga Kodi i Procedurës Penale, sepse Shqipëria nuk ka një ligj të veçantë që siguron ruajtjen dhe shkatërrimin e mostrës të marrë dhe së dyti mostrat e ADN-së janë shumë personale dhe ndërhyjnë në mënyrën se si janë garantuar liritë personale dhe të dhënat personale.

2. Qëllimi

Neni 201/b i Kodit të Procedurës Penale është një dispozitë e re e shtuar pas nenit 201/a. Qëllimi i këtij neni është të sigurojë procedurën e shkatërrimit të kampionëve biologjike që janë marrë në përputhje me parashikimet e nenit 201/a të Kodit të Procedurës Penale. Çmohet e domosdoshme që një rregullim i tillë të garantohet nga Kodi i Procedurës Penale, sepse Shqipëria nuk ka një ligj të veçantë që siguron ruajtjen dhe shkatërrimin e kampionëve biologjikë të marrë dhe së dyti kampionët biologjikë janë shumë personale dhe ndërhyjnë në mënyrën se si janë garantuar liritë personale dhe të dhënat personale. Dispozitat e nenit 201/b garantojnë mbrojtjen e të dhënave personale të lidhura me kampionët biologjikë (apo që rrjedhin nga kampionët biologjikë). Neni 201/b është në përputhje me parashikimet e neneve 15-21 dhe nenin 32 të Kushtetutës⁵ së Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, parashikimet e neni 201/b të Kodit të Procedurës Penale janë në përputhje edhe me parashikimet e ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, (i ndryshuar) “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”⁶.

3. Objekti

Neni 201/b i Kodit të Procedurës Penale parashikon kohën e ruajtjes së kampionëve biologjikë dhe detyrimin që asgjesimi i tyre të bëhet në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale si dhe procedurat që duhet të ndjekin organet shtetërore për këtë qëllim në rastin kur i pandehuri deklarohet i pafajshëm me vendim të formës së prerë, ashtu edhe kur i pandehuri deklarohet fajtor. Dispozitat e nenit 201/b parashikojnë rregulla edhe në lidhje me profilet e ADN-së të kampionëve që janë marrë në vendin e ngjarjes dhe që nuk i atribuohen një personi të caktuar.

⁵ <https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2015/10/kushtetuta-perditesuar-1.pdf>

⁶ Ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, dhe me ligjin nr.120/2014

4. Komente për çështje të ndryshme të dispozitës

4.1 Nëpërmjet parashikimeve të paragrafit 1 tënenit 201/b⁷ të Kodit të Procedurës Penale, ligjvënësi synon të disiplinojëdy elementë shumë tërëndësishëm.

Synohet të përcaktohet qartë koha e ruajtjes së kampionëve biologjikë, duke e lidhur këtë të fundit me kohën që këta kampionë biologjikë i shërbejnë qëllimeve të procedimit dhe së dyti, rregullin e përgjithshëm që asgjësimi i tyre duhet të bëhet në përputhje me rregullat e Kodit të Procedurës Penale. Kjo edhe me qëllimin për të shmatur abuzimet e mundshme në këtë drejtim. Ligjvënësi në këtë paragraf përdor termat "... i shërbejnë qëllimeve të procedimit" në lidhje me kampionët biologjikë. Qëllimi në këtë rast ka të bëjë me faktin se ruajtja e kampionëve biologjikë të marrë në përputhje me parashikimet e ligjit do të duhet të bëhet për aq kohësa zgjat edhe procedimi penal. Një procedim penal, si rregull, përfundon me një vendim fajësie ose pafajësie për të pandehurin. Në vijim të procedimit penal, deri në Gjykatën e Apelit, palët, mbrojtësi apo i pandehuri mund të paraqesin prova të reja apo mund të kërkojnë riekspertim të kampionëve biologjikë të marrë, riekspertim i cili mund të ndikojë objektivisht në themelin e çështjes. Në këto kushte është e çmuar nga ligjvënësi që të parashikojë një lidhje logjike të kohëzgjatjes së ruajtjes së kampionëve biologjikë me nevojën që procedimi penal ka për këta kampionë.

Në rast se asgjësimi i mostrave biologjike nuk bëhet në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale, atëherëky është element që lidhet me pafajshmërinë e akteve respektive të parashikuar në nenet 128 dhe 129 të Kodit të Procedurës Penale

4.2 Paragrafi i dytë i këtij neni parashikon që mostrat që merren nga i pandehuri duhet të shkatërrohen në rast se ai është shpallur i pafajshëm me vendim të formës së prerë. Në këtë rast asgjësimi urdhërohet nga gjykata. Një parashikim i tillë është në përputhje me parashikimet e nenit 4, paragrafi i dytë i Vendimit Kuadër

⁷ "Neni 201/b Asgjësimi i kampionëve biologjikë

1. Kampionët biologjikë ruhen për aq kohë sa i shërbejnë qëllimeve të procedimit. Asgjësimi i tyre bëhet në përputhje me rregullat e këtij Kodi. 2. Në rastet kur i pandehuri deklarohet i pafajshëm me vendim të formës së prerë, gjykata urdhëron asgjësimin e kampionëve biologjikë të marra prej tij. 3. Brenda 60 ditëve nga vendimi i pafajësisë, prokurori, viktimia ose përfaqësuesi ligjor i viktimës mund t'i kërkojë gjykatës që të urdhërojë ruajtjen e kampionëve biologjikë të marra nga persona të tjerë, të ndryshëm nga i pandehuri, nëse kampionët duhet të përdoren në një procedim penal tjetër. Në të kundërt gjykata urdhëron asgjësimin. 4. Kur i pandehuri deklarohet fajtor, kampionët biologjikë të marra prej tij ruhen për 20 vjet nga dita që vendimi merr formë të prerë. 5. Gjykata mund të urdhërojë ruajtjen e kampionëve deri në 40 vjet kur i pandehuri është deklaruar fajtor për një vepër për të cilën në Kodin Penal parashikohet një dënim me burgim jo më pak se 10 vjet në maksimum. 6. Profilët e ADN-së të kampionëve që janë marrë në vendin e ngjarjes dhe që nuk i atribuohen një personi të caktuar mbahen deri në plotësimin e afateve të parashkrimit të ndjekjes penale. 7. Në rast se marrja e kampionëve kryhet në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi, organi procedues urdhëron shkatërrimin e tyre. 8. Mënyra e ruajtjes së kampionëve, procedura dhe organi kompetent për asgjësimin e tyre, parashikohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë".

i Këshillit të Bashkimit Evropian paragrafi i cili rregullon që të dhënat personale fshihen ose bëhen anonime nëqoftëse nuk janë më të nevojshme për qëllimin për të cilin janë mbledhur ligjërisht. Një parashikim i tillë kërkon detyrimisht që mostrat të jenë marrë në përputhje me parashikimet e nenit 201/a të Kodit të Procedurës Penale. Nevoja për të ruajtur të dhënat personale duhet të rishikohet rregullisht, me afate kohore të caktuara për fshirjen e tyre.⁸ Një parashikim i tillë është në përputhje me parashikimet e paragrafit të parë të nenit 3 “Parimet e ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe qëllimit” të Vendimit Kuadër, ku parashikohet se të dhënat personale blidhen nga autoritetet kompetente vetëm për qëllime specifike, eksplicite dhe të ligjshme, në përmbushje të detyrave të tyre dhe duhet të trajtohen vetëm për qëllimet për të cilat janë mbledhur. Dhënia e pafajësisë për të pandehurin me vendim gjyqësor të formës së prerë është tregues për autoritetet që procedojnë për të asgjësuar mostrat që janë marrë nga i pandehuri.

4.3 Paragrafi i tretë i nenit 201/b të Kodit të Procedurës Penale kërkon që brenda një afati prej 60 ditëve nga vendimi i pafajësisë, prokurori, viktimja ose përfaqësuesi ligjor i viktimës mund t’i kërkojë gjykatës që të urdhërojë ruajtjen e kampionëve biologjikë të marra nga persona të tjerë, të ndryshëm nga i pandehuri, nëse kampionët duhet të përdoren në një procedim penal tjetër. Një parashikim i tillë është në përputhje me parashikimet e paragrafit të tretë të nenit 4 të Vendimit Kuadër ku rregullohet që të dhënat personale nuk do të fshihen por do të bllokohen vetëm nëse ekzistojnë baza të arsyeshme për të besuar se fshirja mund të dëmtojë interesat legjitime të personit në fjalë. Gjithashtu, dispozita ka të parashikuar edhe rrethin e personave që mund të kërkojnë përpara gjykatës ruajtjen e kampionëve biologjikë të marra nga persona të tjerë nëse ata do të përdoren në një procedim penal tjetër. Nëse një kërkesë e tillë nuk bëhet përpara gjykatës, atëherë kjo e fundit urdhëron asgjësimin e tyre.

4.4 Paragrafi i katërt i nenit 201/b, parashikon afatin 20 vjeçar për ruajtjen e kampionëve biologjikë. Afati prej 20 vitesh për ruajtjen e kampionëve biologjikë do

⁸ Shiko neni 4 dhe neni 5 i Vendimit Kuadër të Këshillit të Bashkimit Evropian <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32008F0977&from=EN> Article 4 Rectification, erasure and blocking 1. Personal data shall be rectified if inaccurate and, where this is possible and necessary, completed or updated. 2. Personal data shall be erased or made anonymous when they are no longer required for the purposes for which they were lawfully collected or are lawfully further processed. Archiving of those data in a separate data set for an appropriate period in accordance with national law shall not be affected by this provision. 3. Personal data shall be blocked instead of erased if there are reasonable grounds to believe that erasure could affect the legitimate interests of the data subject. Blocked data shall be processed only for the purpose which prevented their erasure. 4. When the personal data are contained in a judicial decision or record related to the issuance of a judicial decision, the rectification, and erasure or blocking shall be carried out in accordance with national rules on judicial proceedings. Article 5. Establishment of time limits for erasure and review. Appropriate time limits shall be established for the erasure of personal data or for a periodic review of the need for the storage of the data. Procedural measures shall ensure that these time limits are observed.

të zbatohet për rastet kur i pandehuri është deklaruar fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë. Parashikimi i afatit është në përputhje me parashikimet e Vendimit Kuadër.

4.5 Paragrafi i pestë i nenit 201/b të Kodit të Procedurës Penale kërkon që kur i pandehuri është shpallur fajtor me vendim të formës së prerë për një vepër penale për të cilën Kodi Penal⁹ parashikon një dënim me burgim jo më pak se 10 vjet ne maksimum, gjykata mund të urdhërojë ruajtjen e kampionëve të marë në përputhje me ligjin deri në një afat prej 40 vitesh.

4.6 Paragrafi i gjashtë i nenit 201/b të Kodit të Procedurës Penale e lidh afatin e ruajtjes së profilevetë ADN-së të kampionëve që janë marrë në vendin e ngjarjes dhe që nuk i atribuohen një personi të caktuar me plotësimin e afateve të parashkrimit të ndjekjes penale të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

4.7 Neni 201/b, paragrafi i shtatëparashikon rregullin qënë rast se marrja e kampionëve kryhet në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi, organi procedues urdhëron shkatërrimin e tyre. Pra, ka një lidhje organike ndërmjet parashikimeve të nenit 201/adhe nenit 201/b të Kodit të Procedurës Penale. Një parashikim i tillë synon disiplinimin e procedurave të marrjes dhe të asgjësimit të kampionëve biologjikë vetëm brenda kornizave ligjore, edhe për të shmangur abuzimet e mundshme në këtë drejtim nga autoritetet proceduese që sipas rastit mund të jetë gjykata ose prokuroria.

4.8 Paragrafi i tetë i nenit 201/b parashikon një detyrim për miratimin e një udhëzimi të përbashkët të Ministrisë të Brendshme dhe Ministrisë të Shëndetësisë për ruajtjen e mostrave, procedurën për shkatërrimin e tyre dhe afatin kohor për shkatërrimin e tyre si dhe autoritetin kompetent. Qëllimi në lidhje me këtë parashikim ka lidhje me faktin se parimi i përgjithshëm i parashikuar nga Kodi, si një normë e përforcuar në raport me akte të tjera nënligjore sikurse është udhëzimi i përbashkët i dy ministrave, do të duhet të detajohet më tej në një akt nënligjor.

5. Legjislacioni ndërkombëtar

Parashikimet e nenit 201/b janë në përputhje me nenin 8 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut; me Vendimin Kuadër të Këshillit të Bashkimit Evropian, 2008-977 “Mbi mbrojtjen e të dhënave personale të përpunuara në kuadër të bashkëpunimit policor dhe gjyqësor në çështjet penale” dhe Direktivës së BE-së 95/46/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 24 tetorit 1995 “Mbi mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave. Një parashikim i tillë është në përputhje edhe me parashikimet e nenit 7a të Traktatit të Bashkimit Evropian, që siguron që lëvizja e lirë e mallrave, personave, shërbimeve dhe kapitalit të kërkojë jo vetëm që të dhënat personale duhet të jenë në gjendje të rrjedhin lirshëm nga një Shtet Anëtar

⁹ shiko <http://www.qbz.gov.al/botime/Kodi%20Penal-2017.pdf>

në një tjetër, por gjithashtu që të drejtat themelore të individëve duhet të ruhen. Parashikimet e nenit 201/b janë në përputhje edhe me parashikimet e neneve 30, 31 and 34(2) (b) të Traktatit të Bashkimit Evropian.

6. Vendime të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Çështjet e trajtuara më sipër kanë marrë edhe vëmendjen e GJEDNJ në disa vendime të saj. Kështu, fakti që të dhënat personale nuk mund të mbledhen dhe mbahen për çdo rast, në veçanti nëse personi, të dhënat e të cilit janë mbledhur, lirohet me vendimin përfundimtar, është ngritur nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së. Gjykata ka qëndrimin e saj se shqetësimi i një individi lidhur me përdorimin e mundshëm të informacionit privat të mbajtur nga autoritetet është i ligjshëm dhe i rëndësishëm për përcaktimin e çështjes nëse ka pasur një ndërhyrje. Në të vërtetë, duke pasur parasysh ritmin e shpejtë të zhvillimeve në fushën e gjene-tikës dhe teknologjisë së informacionit, Gjykata nuk mund të zvogëlojë mundësinë që në të ardhmen interesat e jetës private të lidhura me informacionin gjenetik mund të ndikohen negativisht në mënyra të reja ose në një mënyrë të cilat nuk mund të parashikohen me saktësi sot (*S. dhe Marper*)¹⁰.

Gjykata përsërit se është po aq esenciale, në këtë kontekst, si në përgjimin e telefonave, mbikëqyrjen sekrete dhe grumbullimin e fshehtë të informacionit, që të ketë rregulla të qarta dhe të hollësishme që rregullojnë fushën dhe zbatimin e masave, si dhe masat mbrojtëse minimale që ndërliken, ndër të tjera, ruajtjen, përdorimin, qasjen e palëve të treta, procedurat për ruajtjen e integritetit dhe konfidencialitetit të të dhënave dhe procedurave për shkatërrimin e tij, duke siguruar garanci të mjaftueshme kundër rrezikut të abuzimit dhe arbitraritetit (*S. dhe Marper*)¹¹.

Marrja e materialit qelizor dhe mbajtja e tij, si dhe përcaktimi dhe mbajtja e profileve të ADN-së të nxjerra nga mostrat qelizore përbëjnë një ndërhyrje në të drejtën e respektimit të jetës private në kuptim të nenit 8 § 1 të Konventës (*Van der velden v the Netherlands*).¹²

Një ndërhyrja e tillë do të jetë në kundërshtim me nenin 8 të Konventës Evropiane të të drejtave të Njeriut përveç rasteve kur mund të justifikohet sipas paragrafit 2 të tij si «*në përputhje me ligjin*», duke ndjekur një ose më shumë qëllime legjitime të listuara në të dhe si “të nevojshme në një demokraci “në mënyrë që të arrijë qëllimin ose synimet në fjalë (*Peruzzo dhe Martens*)¹³

¹⁰ *S. dhe Marper k. Mbretërisë së Bashkuar*, 4.12.2008, aplikimi nr. 30562/04 dhe 30566/04

¹¹ *S. dhe Marper k. Mbretërisë së Bashkuar*, 4.12.2008, aplikimi nr. 30562/04 dhe 30566/04, para. 74.

¹² Shih Guide on Article 8 of the Convention – Right to respect for private and family life, faqe 28, para. 122; http://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_8_ENG.pdf

¹³ *Peruzzo dhe Martens k. Germany*, 4 qershor 2013, aplikimi nr. 7841/08 and 57900/12

GJEDNJ nëpërmjet jurisprudencës së saj ka përcatuar kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojë legjislacioni vendas në mënyrë që ndërhyrja në jetën private të jetë në përputhje me ligjin (in accordance with the law). Dy kriteret e përgjithshme janë *aksesushmëria* dhe *parashikueshmëria* (*accessibility* and *foreseeability*) “... Megjithatë, ligji duhet të jetë mjaft i qartë në termat e tij për t’i dhënë qytetarëve treguesë të përshtatshëm për rrethanat dhe kushtet në të cilat autoritetet publike janë të autorizuar të përdorin këtë ndërhyrje sekrete dhe potencialisht të rrezikshme në të drejtën për respektimin e jetës private dhe korrespondencën”¹⁴ (Kruslin)¹⁵. Teknika legjislative e përdorur në shkrimin e dispozitave të nenit 201/a të Kodit të Procedurës Penale, detajimi i tyre, është në linjë me çfarë është vlerësuar nga ana e GJEDNJ

Më tej, shprehja “në përputhje me ligjin”, në kuptim të nenit 8 § 2 të KEDNJ kërkon së pari që masa e kundërshtuar duhet të ketë disa baza në të drejtën vendase; ai gjithashtu i referohet cilësisë së ligjit në fjalë, duke kërkuar që ai të jetë i arritshëm për personin në fjalë, i cili duhet të jetë i aftë të parashikojë pasojat e tij për të dhe në përputhje me sundimin e ligjit (*Huvig v. France*).¹⁶

6. Standarde, referenca, faqe web, dokumente, vendime të Gjykatës Evropiane të të Rejtave të Njeriut, etj.

- Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;
 - Vendimin Kuadër të Këshillit të Bashkimit Evropian, 2008-977 “Mbi mbrojtjen e të dhënave personale të përpunuara në kuadër të bashkëpunimit policor dhe gjyqësor në çështjet penale”
 - Direktivës së BE-së 95/46/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 24 tetorit 1995 “Mbi mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave
 - Dokumentin Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë
 - Dokumenti analitik i sistemit të drejtësisë penale
- Vendime të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut
- S. dhe Marper k. Mbretërisë së Bashkuar, 4.12.2008, aplikimi nr. 30562/04 dhe 30566/04
 - Peruzzo dhe Martens k. Gjermanisë, 4 qershor 2013, aplikimi nr. 7841/08 and 57900/12
 - Kruslin k. Francës, 24 prill 1990, aplikimi nr. 11801/85
 - Van der Velden k. Hollandës, 31 tetor 2012, aplikimi nr. 21203/10)
 - Huvig k. Francës, 24 prill 1990, aplikimi nr. 11105/84

¹⁴ Përkthim i autorit.

¹⁵ *Kruslin k. Francës*, 24 prill 1990, aplikimi nr. 11801/85), faqe 19, pika 2. “Quality of the law”, para. 26, 27, 30 dhe 33

¹⁶ *Shih Huvig k. Francës*, 24 prill 1990, aplikimi nr. 11105/84, shkronja A, “In accordance with the law”, para. 26

Faqe web

- <https://www.parlament.al/>
- <http://www.qbz.gov.al/>
- <http://www.reformanedrejttesi.al/>
- http://www.echr.coe.int/Documents/Convention_ENG.pdf
- <https://hudoc.echr.coe.int/eng> {"documentcollectionid2": ["GRANDCHAMBER", "CHAMBER"]}
- <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TEXT/PDF/?uri=CELEX:32008F0977&from=EN>

THE PROTECTION OF HUMAN RIGHTS IN KOSOVO AS A FACTOR IN DEVELOPMENT OF THE COUNTRY

University "Ukshin Hoti" of Prizren

Halim BAJRAKTARI

Prof. ass. dr. University "Ukshin Hoti" of Prizren,

Law Faculty.

Vice Dean.

E-mail: halim.bajraktari@uni-prizren.com

ABSTRACT

Possibility to respect freedoms and human rights in Kosovo today is not a lack of knowledge, knowing that these rights in a large measure are addressable in local and international laws, but lack access their implementation in practice. The possibility to implement these rights is indicative of new horizons of economic and legal development of the country. Where those rights in social and business life, as these rights are respected in these sectors. Why should eliminate these obstacles in future we as a country?.

What is a negative indicator in the area of discrimination in economic development not, as done in this direction in order to eliminate those obstacles in principle to smaller but heavy viewing to eliminate. The question as we stumble from the violation of these rights?. Are indicators important for this society disregard of these rights. These and many other aspects will be the main pillars that supported development of the country rather than being seen as an obstacle for the country.

***Key words:** Human rights, Kosovo, relevance, discrimination, development and Obstacles.*

The protection of Human Rights in Kosovo as a factor in development of the country

Where do these rights come today to us as a place? Knowing that their violation puts in uncertainty about the progress and security of the state. How do we defend these rights as a new state¹, can we have a strong state if we have injustice in this dimension of rights, how much can be the inequality of the risk of social equity that has just been formed as a state.

¹ Kosovo declared independence on February 17, 2008.

Strengthening the state nowadays is not enough just to have a constitution and laws, but it is required to apply them to the citizens to the citizens. This is done by the competent local and international institutions implementing or implementing them every day in Kosovo. Human rights and freedoms as a definition, nowadays it is easy to write them, but to respect them is a challenge in itself, although these categories of rights are guaranteed and affirmed by the Constitution and local laws and international², but also binding on all internationally recognized sovereign and sovereign countries.

Problems in Building and Developing States Nowadays in Many Developing Countries of the Balkans Common Common Address Worship to Develop the Country Working together in Respecting Human Rights, which Rights are the Key Indicator and Provider in Each Process vital, political and economic for a country, on the other hand one of the weak points of non-compliance with global trends is the violation of these rights in many countries by creating socio-economic crises that also bring other state problems. These injustices come in many respects, such as gender inequality in the labor discrimination markets, gender junctions are weakening the role of human rights and non-functioning of the business market, which are an inadequate indicator in cases where these rights are not respected, both for businesses and for states. The role of these rights must be secured without any distinction based on such causes, such as gender, race, color, language, religion as the European Convention on Human Rights addresses.³

Human rights are an investment key to opening up new trade horizons to the development of small economies in the country, without which the overall role of women's rights, in particular women's rights, should play an equal role in gender and not to be sidelined both by access and by the opportunity to become part of the economic race. But as we are an institution practically in promoting and respecting these rights in our country at this time, one thing we must know is that the citizens of Kosovo in 2016 are in a bad state in relation to the European system of human rights, where these reports are mainly built around the European Convention on Human Rights and the European Court of Human Rights as the last legal instance guaranteeing the respect and interpretation of the rights set forth in this convention, and if these rights are violated, knowing that the citizens of Kosovo are unable to have an appellate approach to these judges is that in Strasbourg, even though we as a state still do not enjoy the presence of these addresses in this justice mechanism. On the other hand, to raise a level to do business is not so easy in our country,⁴

² According to the Universal Declaration of Human Rights; and the European Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms and its Protocols.

³ Article 13, Prohibition of Discrimination.

⁴ Doing Business, Kosovo is ranked 113th out of 183 countries where business can be done. However, when it comes to employment, Kosovo takes 34th place.

knowing that such a possibility for you engaging in such a business is not so easy from the competition and the opportunity that our country offers to female gender in terms of economic forms and not talk about political ones.

Respect and its discrimination approach

Respect for human rights and freedoms are a challenge in many democratic countries, and in particular it is a challenge for countries that are in a democratic transition that are harmonizing their legacies with those of European democratic countries.

Do not forget a fact The Republic of Kosovo has learned from its sad Serbian slave story for decades by denying these rights, but at the same time as a peaceful, democratic country oriented to the values of democracy, has now managed to prove that it has the capacity to respect fundamental freedoms of human rights. At the same time, the process of declaring independence has made the country motivate and challenge the issue of human rights and freedoms. Kosovo is getting more and more strengthened in the contest by becoming a part of the international cooperation on the promotion and protection of peace, security and human rights. These agreements add to the stability of institutions and society in the fulfillment of human rights, conceived as untouchable elements, which are at the same time the basis of the legal order of the Republic of Kosovo.

This horizon of rights is a key pillar in the normal functioning of democratic states because the political, economic and legal development of the country depends directly on their respect. This is proven by the European states, such examples are Scandinavian states where respect for human rights and freedoms has reached the highest pedestal of freedoms as the most powerful democratic and social democratic states.

The implementation of human rights in everyday life raises the need for a position in which value judgments, moral judgments and the ability to think as citizens of the world play an influential and prosperous role for the country. These rights in principle identify the values of indispensable, which are essential for the realization of human dignity. These begin from the protection from torture to the private life, from the right to a fair trial, to an adequate standard of living. The other approach relates to determining and identifying the extent to which these rights can be balanced with each other⁵ or even excluded, taking into account the public interest assessment.

The important investment element is lawfully intervened in particular rights, assessing the legality, necessity and proportionality of this intervention, taking into account also the protection from discrimination, considering that there is a grounded

⁵ For example: See, *Perincek v. Switzerland*, relating to the criminalization of a speech on Armenian genocide and the balance or balance between the applicant's right to freedom of expression (Article 10) and the right of Armenians to respect their dignity in the group.

claim that human rights-the individual are being violated, and the individual is entitled to an effective remedy.

Today, more and more internationally recognized human rights standards necessarily require government policy to be the most influential and guaranteed in this key process to implement universal principles.⁶ This places a high level of discipline on government agencies, which, if ignored or bypassed these human rights standards, give more account to the justice system.

Part of the dark currencies in relation to human rights include corruption, favoring prisons, ineffectiveness of the judiciary, long-term detention, unrealistic judgments, over judgments and bypassing the principles of justice.⁷

Violations of rights are also faced by persons with disabilities. Although the Constitution and the law prohibit their discrimination formally, seeing that such controversies are virtually lacking in these violations. The government is not implementing enough laws and programs to ensure that persons with disabilities have access to conforming buildings that they have as citizens, information and communication⁸ and other services that are legally guaranteed. Other Poor Aspect remains domestic violence against women, including spousal abuse, seen as a serious ongoing serious problem despite the progress made in the country.

Although the Republic of Kosovo is not internationally recognized by the United Nations, this has not prevented us from implementing these laws, Kosovo has fully incorporated and implemented the Universal Declaration of Human Rights and Freedoms and all conventions other related to their respect that apply to us.⁹ By giving them legal force and their enforcement in the country.

Although we are moderate in terms of human rights, in line with the European Convention on Fundamental Rights and Freedoms. It is not enough for Kosovo to have the newest constitution in Europe, which should undoubtedly have to admire its approach to the highest degree in the protection of human rights and freedoms and in the spirit of communities, this is the result of a peaceful, democratic and European orientation which is this people, harmonizing the legacy that represents the essential covenant for the country's involvement in this international organization. One particular is the challenges of minorities which represent the essential problem of all countries that are in democratic transition but for Kosovo this problematic approach is beneficial for the minorities living in the country. As far as

⁶ See more: Constitution of the Republic of Kosovo. Article 22.

⁷ <http://www.evropaelire.org/content/article/24684903.html> consulting on 24.02.2017.

⁸ Inclusive policy framework on disability issues in Kosovo.

⁹ Mostly see: the Constitution of the Republic of Kosovo, Article 19 and the second chapter referring to fundamental rights and freedoms where are included the main international acts that protect and guarantee fundamental rights and freedoms.

minority rights are concerned, they have contributed to the involvement and active participation in social and state life.

This facilitation is linked by the constitutional basis with the automatism that makes all minorities in the country equal in all respects in terms of legal, political, economic, social, cultural, and so on.

The very fact that Kosovo has made progress in the area of human rights “Responding to the call of the people to build a society that respects human dignity: *“by implementing every day and many new laws in this area. An aspect addressed remains for employed mothers during and after pregnancy, paid vacations or holidays accompanied by appropriate social security benefits”*.”¹⁰

Kosovo needs more lobbying for inclusion and support in the UN organization, and other international mechanisms, such cooperation requires international support and from countries that have still recognized Kosovo. For Kosovo, respect for human rights is understood as a primary and constitutional obligation, which as general principles of the Constitution of the Republic of Kosovo has been addressed in the following way:

- Basic human rights and freedoms are inseparable, inalienable and inviolable and are the basis of the legal order of the Republic of Kosovo.
- The Republic of Kosovo protects and guarantees the fundamental human rights and freedoms provided for in this Constitution.
- Every citizen has a duty to respect the human rights and fundamental freedoms of others.
- The fundamental rights and freedoms set forth in the Constitution also apply to legal persons, as far as they are applicable.

We need to be more vigilant to what local and international laws address to us, knowing that the starting point starts with the right to life, their life, their breathing, and not their downfall. We are not the best in the world, but we feel free and respected, without breed, language, and religion.

CONCLUSIONS

In a country where injustice triumphed over the right, discrimination can be equal and the judiciary loses its justice, there is no trust in justice, abuse of society and the state. Kosovo needs a more enforceable European formula on respect for the rights and freedoms of human beings.

Only constitutional legal provisions are not sufficient, but they must be fulfilled and realized with factual actions on the ground. Reality in paper and reality in practice are two different realities. The state should play an active role in the

¹⁰ Dejan Millenkovic, Human Rights, Freedom of Expression and the role of the media in terms of confusion and tension, p. 19.

promotion and equal treatment of raising awareness among public officials and enforcers of the law on the responsibility they have on implementing the legislation in force.

Seeing that the European future is a way to make the most appropriate rule of law implementation with the aim of speeding up Kosovo's integration processes.

Better coordination between local institutions and EU missions, helping to strengthen integration efforts on the road to the EU. At the same time raising interests for clearer commitment to the EU, increasing the level of education and training of new cadres to define common integration issues.

Kosovo's perspective towards the European family is secure, but it is in the hands of all the institutions to coordinate the activities and increase the commitment of unity in the implementation of all the recommendations and obligations which are the basic criteria that can challenge injustice that are related to the Human Rights.

REFERENCES

- Lauren Paul Gordon, History and Human Rights: People and Forces in Paradoxical Interaction, 7 Journal of Human Rights (2008);
- Konventat Ndërkombëtare Karta Sociale Evropiane 1966;
- Marrëveshja Ndërkombëtare e të drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore 1976;
- Kadriu Bekim, Mbrojtja nga Diskriminimi në të drejten ndërkombetare ne Republikën e Maqedonisë, Tetovë, 2016;
- Qerimi Qerim - Gentian Zymberi- E drejta nderkombetare, Prishtinë 2011;
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj,
- Gruda, Zejnullah, mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut, Prishtinë, 2010,
- ILO Orari i Punës (Komerical dhe Zyre) Konventa e vitit 1930,
- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- Ligji Nr. 05/L -021 Për Mbrojtjen Nga Diskriminimi;
- Ligji për Përkrahjen Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të Përhershme, Nr. 03/L-022;
- Ligji për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar, Nr. 2003/23;
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;
- Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare,
- Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor,
- Pakti Ndërkombetar për të Drejtat Civile dhe politike: Miratuar nga Asambleja e

Përgjithshme me Rezoluten 2200A (XXI), të datës 16 dhjetor (1996) NewYork: Human Rights Support Programe.

- Dejan Millenkoviç, Të drejtat e njeriut, liria e shprehjes dhe roli i medimeve ne kushtet e konfilktit dhe tensionit.
- <http://www.humanrights.is/en/human-rights-education-project/human-rights-concepts-ideas-and-fora/part-i-the-concept-of-human-rights/definitions-and-classifications>
- http://www.kipred.org/repository/docs/T%C3%AB_drejtat_e_njeriut_n%C3%AB_Kosov%C3%AB___30299.pdf
- <https://freedomhouse.org/report/freedom-world/2013/kosovo>
- <https://rm.coe.int/168047e169>.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Universiteti i Tiranës. Fakulteti i Drejtësisë
Criminal law between tradition and challenges of
actuality: international scientific conference: Tirana,

7 December 2017 / Universiteti i Tiranës. Fakulteti i
Drejtësisë. – Tiranë: Onufri, 2018

784 f.; 25 cm.

Bibliogr.

ISBN 978-9928-261-16-8

1.E drejta penale 2.Kriminologjia 3. Konferenca

343.2/.7 (062)